

**Behgjet Pacolli**

# **Një mision i parealizuar deri në fund**

*Përpiluar dhe redaktuar nga:*

*Mimoza Muja & Bukuriye Makolli Sahiti*

*Prishtinë, Nëntor – 2022*



# PARATHËNIE

Prej momentit kur vëmendjen time e ka tërhequr krijimtaria e teoricienit liberal Mishael Walzer, i cili thelbin e teorisë së tij e mbështet në marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe bashkëveprimin e njeriut brenda një bashkësie, kam filluar ta dua frymën liberale. Ai e shpjegon pluralizmin, barazinë e thjeshtë dhe barazinë komplekse, dominimin, monopolin, hierarkinë dhe kastën e shoqërisë, duke na treguar në fakt sa efekt ka komunitarizmi te vet njeriu.

Si një vëzhguese e thuktë, e ndikuar nga teoria liberale, kam vërejtur se Presidenti Behgjet Pacolli, ka arritur të sjellë në Kosovë frymën liberale, duke vendosur parimet e udhëheqjes në përputhje me parametrat kulturore dhe historike të shoqërisë sonë. Qasja liberale e Presidentit, veprimtaria humane dhe kontributi i madh që ka dhënë dhe vazhdon të japë në të mirë të komunitetit, punësimi i mijëra kosovarëve brenda dhe jashtë Kosovës, veçanërisht lobimi i vazhdueshëm për njohjen e shtetësisë së Republikës së Kosovës, e bëjnë atë një liberal të përmasave të Wallzerit, i cili e gërsheton suksesshëm teorinë me praktikën.

I brumosur me bindje liberale dhe duke mbartur mbi shpinë arritje brilante në fushën e biznesit, në zemër të Evropës e ngado nëpër botë, Presidenti Behgjet Pacolli, kthen përfundimisht vëmendjen nga Kosova. Duke parë domosdoshmërinë e angazhimit të tij të drejtpërdrejtë në zhvillimin e vendit të tij të dashur, Kosovës, kthehet në vendlindje dhe i ofron popullit të tij një alternativë të re politike: *“Nuk i dija rregullat e lojës në këtë fushë, e cila për mua shumë kohë kishte qenë e huaj, madje ndaj së cilës në të shkuarën shpesh isha sjellë me mosbesim. Por Kosova s’kishte kohë për të humbur dhe asaj i duheshin të gjithë, pra edhe unë.”*

Krijimi i lëvizjes, e më pas i partisë politike “Aleanca Kosova e Re”, erdhi si domosdoshmëri e keqqueverisjes dhe nevojës imediate që kishte Kosova për zhvillim, veçanërisht për zhvillim ekonomik. Ofrimi i hapësirës për çdo individ të aftë që të kontribuonte për vendin, përkrahja dhe fuqizimi i grave të zonja dhe fryma shtetndërtuese që solli me partinë e tij politike, e bëjnë më të veçantë dhe karizmatik këtë figurë të lartë me përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare.

Nisur nga të gjitha këto fakte interesante, nga bindjet e mia liberale, edhe unë si shumë të tjerë vendosa të bëhem pjesë e AKR-së dhe të jem kandidatë për deputete nga radhët e saj në Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të 6 Tetorit të vitit 2019, për Parlamentin Republikës së Kosovës.

Që prej atij momenti, në mendjen time, formulova një pyetje të cilën do t’ia bëja Presidentit Behgjet Pacolli, nëse do të më rastiste të gjendesha në një bashkëbisedim miqësor, larg formaliteteve që ofrojnë takimet zyrtare, sidomos gjatë fushatave elektorale. Pyetja ime vinte nga kureshtja dhe ishte formuluar në mënyrë të tillë:

Si njeriu që mund të keni pothuajse gjithçka që dëshironi, çfarë ju jep kënaqësi?

Dëshira për të marrë një përgjigje në pyetjen e ngritur, sa vinte bëhej edhe më e madhe. Ideja për të ditur se çfarë mund të ishte ajo gjë, që do t’i ofronte shkallën superiore të kënaqësisë, dikujt që mund të ketë gjithçka, sa vinte e bëhej një dëshirë mbytëse, derisa e lash anash dhe vazhdova me angazhimet e mia.

U desh të vinte pranvera e 2022-ës, që përveç privilegjit tim për të shkruar këtë parathënie, të merrja përgjigje në pyetjen që më ka munduar që sa kohë...

Fillova të shfletoj një e nga një materialin e ofruar, dhe njëkohësisht të plotësoj pjesët e enigmës së pazgjidhur. Tek shfletoja aq shumë pjesëza nga veprimtaria e ngjeshur shumëdimensionale e kësaj figure, habitesha me përkushtimin për secilën prej tyre.

Në shumë faqe gazetash, si kryetitull të del angazhimi i Presidentit Behgjet Pacolli në procesin e njohjeve të shtetësisë së Kosovës. Kontributi i veçantë, para, gjatë veshjes me petkun e zyrtarit institucional, por dhe më pas, e bëjnë atë të pazëvendësueshëm.

Në 2007, gazeta “Dani” e Bosnjës, në një artikull të gjatë shkruante: *“Njeriu i cili po ua rrëmben serbëve Kosovën - kosovari Behgjet Pacolli, njeriu i suksesshëm i biznesit, lobist për pavarësinë e Kosovës dhe lider partiak, po e financon një grup të fuqishëm lobimi në Uashington, në Bruksel dhe në Moskë”*.

Ashtu siç e njohim të gjithë, z. Pacolli nuk rrëmben, s’ka rrëmbyer kurrë asgjë të huaj, asgjë që nuk i përket. Me sjelljet e tij ai demonstroi, përsëriti dhe ripërsëriti të vërtetën, derisa të jetë e nevojshme, e kështu me angazhim të pashoq, punë dhe përkushtim, arrin të bindë dhe ta rifitojë atë që i përket!

Po ashtu, ka me dhjetëra e dhjetëra artikuj që flasin për njohje të reja të ardhura në adresë të Republikës së Kosovës, nga lobimi i pandërprerë dhe i fuqishëm i Presidentit Pacolli.

Me angazhimin politik dhe futjen e AKR-së në Parlament, ndjehet në mënyrë të dukshme, angazhimi dhe kontributi institucional i kësaj partie dhe i vet z. Behgjet Pacolli. Më 22 shkurt 2011, Parlamenti i Republikës së Kosovës në raundin e tretë të votimeve zgjodhi President të vendit z. Behgjet Pacolli. Ky ishte nderi që iu bë z. Pacolli nga 62 deputetë të RKS-së, por që më vonë u kontestua nga Gjykata Kushtetuese për shkaqe procedurale (mungesë e kuorumit).

Sipas mendimit të opinionit të gjerë, nëse është dikush që e meriton atë pozitë dhe atë nder për të qenë në krye të vendit, ai është z. Behgjet Pacolli. Gjithsesi, edhe pas këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese, dhe respektimit të atij vendimi, asnjëherë nuk e ndali punën dhe përkushtimin për zhvillimin e Kosovës. Vizioni i Presidentit Pacolli për një shtet të fortë ekonomikisht, vërehet në artikuj të ndryshëm gazetash: Rritje ekonomike dyshifrore, ambient i sigurt për investimet e huaja dhe të diasporës, mbrojtja e prodhimit vendor dhe bashkimi kombëtar ekonomik ose tregu i përbashkët Kosovë-Shqipëri, janë disa nga prioritetet e AKR-së.

Sa ishte në opozitë por edhe në pushtet, AKR-ja fliste pa pushim për ndaljen e privatizimit, derisa në 2014-ën, me insistimin e Zëvendëskryeministrit të RKS-së z. Behgjet Pacolli, u miratua Projektligji për Ndërmarrjet Publike. Gazeta “Tribuna”, e jepte lajmin në këtë mënyrë: *“Realizohet kërkesa e kamotshme e Pacollit, miratohet Projektligji për Ndërmarrjet Publike”*. AKR-ja ka ardhur gjithmonë me ide revolucionare për gjigandin “Trepça”, për inkuadrimin e Veriut nëpërmjet krijimit të zonave të lira ekonomike, për koncentrimin në sektorin e bujqësisë, por sidomos për krijimin e industrisë së shërbimeve si një sektor inovativ që do të lulëzonte shumë në një vend me kaq shumë rini. Ideja e ardhur nga z. Pacolli për të mos doganuar pajisjet kompjuterike, kishte për qëllim fuqizimin dhe dhënien e mundësisë të rinjve për t’u kyçur në trendet bashkëkohore.

Mbi të gjitha, me dhe pa forcën e pushtetit, asnjë anëtar i kabineteve qeveritare të AKR-së gjatë qeverisjes në dikasteret e ndryshme, nuk kanë afëra korruptive apo të jenë marrë me punësime familjare apo partiake. Kjo tregon seriozitetin dhe instalimin e frymës shtetformuese nga ana e z. Behgjet Pacolli.

Çdo ditë e më tepër, po dëshmohet fakti se prezenca e AKR-së në skenën politike kosovare kishte dhe ka një arsye madhore dhe një qëllim kryesor. Kjo arsye mbështetet në faktin se AKR-ja është partia e parë me idetë liberale, partia e parë e cila suksesin e sheh gjithmonë nga puna dinjitoze. Në Kosovë kishte shumë punë për t'u bërë, dhe pikërisht këtu harmonizoheshin qëllimet e AKR-së si parti e re liberale në këtë pjesë të botës, dhe nga ana tjetër nevoja e madhe për të ndërtuar vendin dhe për të krijuar një shoqëri e cila mbështetet vetëm në punë dinjitoze, të sinqertë, ku racionalisht do të shfrytëzohej ajo që ishte ekzistente në Kosovë.

Kosova kishte shumë të rinjë që bridhnin rrugëve dhe nga ana tjetër Kosova kishte shumë nevojë për punëtorë/operatorë profesionistë, të përgatitur mirë.

Z. Pacolli që nga dita e parë, kishte propozuar hapjen e shkollave profesionale, ku për një periudhë të shkurtër, do të mund të përgatiteshin kadro në të gjitha fushat e nevojshme. Këto shkolla do të financoheshin më së shumti nga ata që kishin nevojë për fuqi punëtore, dhe njëkohësisht të kishte një shtytje nga shteti dhe nga vetë pjesëmarrësit ose kursantët.

Kjo do të bëhej realitet duke iu falënderuar shumë njerëzve, kadrove profesionistë të cilët ishin të papunë dhe të cilët do të ishin të gatshëm t'i kyçen kësaj ndërmarrësie për trajnimin e profesionistëve të rinjë. Objektet ku këto përgatitje profesionale do të mund të zhvilloheshin do të ishin shkollat ekzistuese, e kurset do të zhvilloheshin në orët e mbrëmjes.

Objektiv, apo në fokus të kësaj përgatitjeje ishte bujqësia. Në fakt z. Pacolli që nga dita e parë, fliste për nevojën e madhe për ushqim (ai thoshte se sipërfaqet e tokave bujqësore janë duke u tkurrur dhe kërkesat janë në rritje e sipër). Për këtë mendim, askush nuk e mbështeti z. Pacolli, bile ishte kritikuar nga opinioni politik, me atë se z. Pacolli dëshiron të krijojë bujqëri nga studentët dhe kooperativa nga tokat bujqësore. Për fat të keq partnerëve të z. Pacolli, qartazi u mungonte vizioni për të ardhmen.

Një pikë tjetër që z. Pacolli e përsëriste, ishte krijimi i institucioneve të qëndrueshme (ato që do të respektoheshin nga qytetarët dhe ato që do të merrnin përgjegjësinë për përditshmërinë në Kosovë). Ai argumentonte me bindje të fortë se për të pasur fuqi politike dhe legjitimitet, presidenti i shtetit duhej të zgjidhet me votë të drejtpërdrejtë nga qytetarët, duke reformuar një ligj zgjedhor dinjitoz.

Privatizimi duhej të marrë kahje tjetër (fillimisht të ringjallen subjektet ekonomike, atëherë t'u gjendet autori/blerësi adekuat dhe pastaj atij t'i ndihmohet që ta zhvillojë atë). Vetëm kur kjo të ndodhë, atëherë t'i kërkohet pagesa dhe asetet e përvetësuara. Pra, asetet nuk duhet të shiten, të mos iu merren paratë qytetarëve, ashtu siç ka ndodhur. Në këto kushte blerësi nuk ka pasur mundësi që të zhvillojë objektin dhe si i tillë ai është bërë kandidat për falimentim.

Zhvillimi i agroekonomisë, krijimi i një zinxhiri të pafund në agroekonomi (secili të prodhojë për nevojat e tjetrit, si për shembull, prodhuesi i ushqimit të prodhojë për fermerin, kurse fermeri të prodhojë qumështin dhe produktet e tjera për procesuesin e këtyre produkteve dhe pastaj distributorët të merren me punët e tyre). Në këtë kuadër, z. Pacolli kërkonte gjithsesi që

nga viti 2007 brendimin e produkteve ushqimore dhe kërkonte që prodhimet e Kosovës të jenë pjesë e kompanive globale.

Si këto dhe shumë ide të tjera, të cilat janë të shkruara bukur në programin e AKR-së, e patën të vështirë të gjejnë partneritet dhe të vihen në jetë. Fatkeqësisht ardhja e z. Pacolli, ishte në momentin kur secili luftonte me vetveten, ku meritokracia mbeti vetëm term dhe kurrsesi nuk mundi të gjejë aplikim.

Mund të flasim gjerë e gjatë për kontributin e Presidentit Pacolli në arenën ndërkombëtare, për lobimin që ka bërë për shtetësinë e Kosovës, për ndikimin e AKR-së në zhvillimin e Kosovës dhe për qeverisjen e mirë të partisë së tij, por nuk duhet të harrojmë anën e tij humaniste. Ndërsa shfletojmë këtë përmbledhje, humaniteti i z. Behgjet Pacolli, ndihet ngado, shpeshherë duke kaluar edhe dimensionin kombëtar. Fondacioni “Behgjet Pacolli”, në nëntor të 2007-s bën me ujësjellës katër fshatra të Pejës, vazhdon duke ndërtuar shtëpi në Mitrovicë, duke dhuruar të holla po për këtë qëllim, ndihmon Universitetin e Prishtinës duke rindërtuar Fakultetin Filozofik. Ndhmon qytetarë, ndihmon institucione, kontribuon në arsim, jep bursa për të rinj, dërgon për shërim të sëmurë, negocion për shpëtim pengjesh nëpër botë, riatdheson qytetarë që iu rrezikohet jeta, etj., etj.

Janë kaq shumë veprimtari humane në emër të këtij njeriu, sa është e pamundur të përmenden të gjitha. Nuk mjaftojnë çmimet ndërkombëtare dhe nderimet që iu kanë bërë, në mbarë botën për të shprehur mirënjohjen ndaj tij.

Tek shfletova me ëndje këtë përmbledhje gazetash e revistash të ndryshme, me artikuj kushtuar Presidentit Behgjet Pacolli, AKR-së dhe veprimtarisë shumëdimensionale, arrita të marr përgjigje në pyetjen që më mundonte prej kohësh.

A ka kënaqësi më të madhe se t’u dhurosh jetë të sëmurëve, t’u dhurosh dije të rinjve, t’i bësh me shtëpi të varfrit, të lartësosh emrin e atdheut, e mbi të gjitha të lartësosh emrin SHQIPTAR?!

Nëse çmimi i madhështisë është përgjegjësia, shumë lider e kanë humbur madhështinë për shkak të papërgjegjësisë që kanë pasur ndaj të tjerëve.

Presidenti Behgjet Pacolli, është treguar i përgjegjshëm në gjithçka ka bërë, prandaj do të ngelet gjithmonë madhështor, edhe kur të tjerët mundohen të përlyejnë figurën e tij.

Asnjëherë mirësia dhe humanizmi nuk kanë shkuar dëm. Prandaj, jam plotësisht e bindur se në një të ardhme të afërt, emri i Presidentit Behgjet Pacolli, do të zërë vendin e merituar në piedestalin e shtetit më të ri të Evropës. Vendi i tij, për të cilin ka dhënë e po vazhdon të japë kaq shumë, do ta nderojë dhe t’i japë meritat që i takojnë!

**Alma LAMÇJA**

**Ish kandidatë për deputetë nga radhët e AKR-së, lektore/redaktore, krijuese letrare.**

## Parathënie nga z.Behgjet Pacolli

Për të krijuar një biznes dhe karrierë të shkëlqyer në një mjedis perëndimor, siç është Zvicra, nuk është aq e lehtë, ndërsa kur zhvillon një kulturë të punës në Zvicër, kudo je i mirëpritur. Pas një lobimi të suksesshëm në SHBA për katër vite me radhë, me kompaninë time “Aleance for New Kosovo“, dhe pas deklaratës së Presidentit Bush në Shqipëri se “Kosova duhet të jetë e pavarur”, vendosa të kthehem në Kosovë.

Kthehem ashtu thjeshtë, me dëshirën për t’i kontribuar vendit tim, pa paramendimin se do të merresha me politikë.

Në vitin 2006 kthehem në Kosovë dhe filloj iniciativën për të promovuar ekonominë kosovare. Në eventin e organizuar për këtë çështje erdhën më tepër se 1200 persona (shumë nga ta edhe të paftuar) dhe në foltore u paraqiten shumë folës. Secili nga folësit aludonte se sot kishte filluar punën një organizatë (parti) politike. Madje secili na përgëzonte për këtë iniciativë. Në këtë event kishin ardhur edhe shumë fytyra të njohura politike të asaj kohe, të cilët po ashtu më përgëzonin.

Në mbrëmje duke biseduar me disa nga miqtë dhe familjarët e mi, ata më bindën që kjo gjë duhej të ndodhte. Pra, vendosëm që kompania që ishte e regjistruar në Washington DC, të vazhdonte aktivitetin si parti politike në Kosovë.

E nisa në këtë mënyrë rrëfimin tim, për të treguar se qëllimi im ishte zhvillimi i ekonomisë kosovare, zhvillim i cili ndikonte drejtpërsëdrejti në ngritjen e standardit jetësor të popullatës, e cila çonte drejt ngritjes së vetëdijes te qytetarët.

Një njeri është i vetëdijshëm atëherë ku bën një ndarje në mes të së drejtës dhe obligimeve që i takojnë atij. Kur e them këtë, kam ndërmend se çdo qytetar duhet ta ketë të drejtën e tij legjitime që të jetë i respektuar dhe të ketë lirinë dhe benefitet e barabarta, pa dallime të gjendjes sociale dhe mentale, pa dallime të moshës, gjinisë, etnisë apo pozitës që ai ka, por edhe duke qenë koshient që këto gjëra t’i kuptojë edhe si obligim të tij ndaj shoqërisë dhe shtetit.

Unë vendosa të kthehesha në Kosovë e të hyja në skenën politike, me vizion liberal dhe modern, sepse kishin kaluar disa vjet që nga përfundimi i luftës dhe jeta në ato vite ishte e zymtë. Megjithatë, e rëndësishme për mua ishte që bashkësia ndërkombëtare ta kuptonte rëndësinë e pavarësisë së Kosovës, që vendi ynë të kishte një vizion modern ekonomik si Evropa dhe që të rinjtë të kenë perspektivë në Kosovë.

Nisur nga këto parime të miat e pas një aktiviteti të ngjeshur lobues për pavarësinë e Kosovës nëpër vende të ndryshme të botës, mora një vendim aspak të lehtë por të domosdoshëm: të themeloja një parti politike me orientim liberal, të parën parti shqiptare nga Kosova që u bë pjesë e grupeve politike evropiane, në këtë rast Partisë Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve për Evropën.

Në zgjedhjet e para në të cilat kemi marrë pjesë, Aleanca Kosova e Re (AKR), e udhëhequr nga unë, doli subjekti i tretë më i fuqishëm në skenën politike të Kosovës, duke lënë pas shumë parti politike të themeluara në Kosovë dekada më parë dhe që kishin krijuar një monopol politik, ekonomik dhe mediatic.

Qytetarët e Kosovës e panë ardhjen time në Kosovë si diçka pozitive, si një ndryshim të mundshëm. Arritëm të thyejmë strukturën partiake që kishte filluar të bëhej tradicionale dhe

konservatore në Kosovë, pa vizion, pa model politik dhe pa ideologji. Unë së bashku me AKR-në kemi bërë histori, por kemi shkaktuar edhe tërmet politik. Isha politikani i parë në Kosovë që shihja ndryshe dhe që më konsideronin alternativë e skenës politike, e cila ishte zhytur në polarizim, zyrtësi dhe pa perspektivë për vendin. Me AKR-në erdhi një frymë e re politike në Kosovë. Hapëm një mundësi të re politike për partitë e reja në Kosovë, jashtë shtratit të partive tradicionale. Kjo ishte meritë e vizionit dhe besimit tim ndaj Kosovës, e cila demokratizoi skenën politike në vend. Qytetarët e mirëpritën. Ata e votuan dhe e besuan programin tim liberal. Por kjo mbështetje e qytetarëve u shoqërua me frikë, intriga dhe lojëra të pista politike e mediatike në një vend që nuk ishte mësuar me ndryshime politike. Skena politike po shihte kërcënime dhe frikë nga vizioni im dhe i AKR-së. Sa më e madhe bëhej përkrahja e qytetarëve ndaj nesh, aq më shumë kundërshtime vinin kundër nesh me metoda të pista politike.

Të bëhej betejë politike në mënyrë demokratike e mirëprisja, por, ja që nuk ishte kështu. Beteja ishte parapolitike dhe ballkanase. Mjedisi politik dhe mediatik në Kosovën e pasluftës ka qenë i vështirë dhe shumë polarizues. Konceptet dhe idetë politike kanë qenë në një nivel të ulët. Politika është zhvilluar në një model loje me shumë zero, një situatë në të cilën fitimi i një personi është i barabartë me humbjen e një tjetri. Kështu u zhvillua skena politike dhe fatkeqësisht, sot, pas gati dy dekadash, kjo nuk ka ndryshuar shumë. Në Kosovë luheshin lojëra të ulëta politike dhe publike. Ato synonin sulme të ulëta kundër alternativave që nuk dilnin nga ky mjedis i krijuar parapolitik. Është një fenomen i çuditshëm në Kosovë, ata që merren me politikë dhe kanë ndikim publik, edhe kanë qenë pronarë mediash, kanë bërë jetë publike të dyfishtë. Sot, nga njëra anë na shfaqen si intelektualë, si njerëz të lartë me karakter dhe integritet, nga ana tjetër po të njëjtit kanë qenë krijuar të lojërave dhe fushatave të pista kundër individëve dhe grupeve që i kanë parë si kërcënim.

Pra, siç mund ta shihni, ky botim përmban shkrime dhe artikuj të gazetave, të pandryshuara, artikujt përmbajnë shumë herë fyerje, lëvdata por edhe shprehje mendimesh të autorëve të teksteve, tekste të cilat mund të ishin artikuluar ndryshe, por që qëllimisht i kam lënë të gjitha siç janë, autentike, të pandryshuara.

Gjatë leximit ju do të hasni veçanërisht në artikujt e gazetës “Koha ditore”, pronari i së cilës, Veton Surroi, nëpërmjet kësaj medie paraqet edhe frustrimin e tij, i hidhëruar që nuk arriti të mbesë pjesë e politikëbërjes në Kosovë.

Në fakt, me paraqitjen e AKR-së dhe me programin e ideuar nga unë, program ky që nëse shihet nga dimensionet e tanishme ishte më se i qëlluar për Kosovën e asaj kohe, Veton Surroi u largua nga skena politike. Mund të lexoni artikujt që paraqesin mjedisin e vështirë të asaj kohe dhe janë pasqyrë e fushatave të zhvilluara për shkak të tërmetit politik që u shkaktua nga thyerja e monopolit të tregut partiak në vend.

Ky realitet e frustroi shumë zotin Surroi, i cili në të ardhmen do të zotohej se do të më kundërshtonte, denigronte dhe shantazhonte. Ndonëse nuk kisha asgjë kundër tij dhe në asnjë intervistë nuk e kisha përmend emrin e zotit Surroi, si unë apo ndonjë koleg imi, ai nuk kishte potencial gazetaresk dhe kishte pikëpamje personale krejtësisht të ndryshme kundër meje, me bindjen se në këtë mënyrë do të më godiste. Nuk ndodhi kështu. Me kalimin e kohës opinioni publik e kuptoi se shoqëria kosovare, edhe pse e rraskapitur, nuk ishte e gatshme të ndikohej nga shpifjet e zotit Surroi dhe grupit të tij, bashkë me “Kohën ditore” dhe televizionin e tij KTV.

Karvani ynë eci përpara i sigurt, pa rënë pre e shantazhit të kohës ditore. Rreth zotit Surroi dhe grupeve që mendonin si ai, kishte një problem shpeshherë patologjik. Ishte e pamundur të



pranohej dikush që fliste me krenari për origjinën e tij nga fshati, që ishte bërë biznesmen i suksesshëm në Evropë dhe që kishte ndikim të madh politik. Ishte e panatyrshme për të, që të pranohej roli dhe mbështetja qytetare për mua. Logjika e tij dhe atyre të tjerëve ishte se në Kosovë publiku udhëhiqet dhe dominohet nga një klasë e vogël urbane që e kishte humbur pushtetin me rënien e Jugosllavisë komuniste dhe për këtë grup, problematikë ishte që dikush që nuk bën pjesë në plejadën e tyre, mund të krijonte një bagazh të tillë për të pasur sukses dhe për të hyrë në politikë me një vizion liberal.

Fatmirësisht, këto dallime të shprehura prej tyre u thyen. Unë dhe partia ime sollëm në Kosovë diçka që nuk mund të pranohej lehtë. Kam ardhur me një koncept liberal të hapjes së ekonomisë dhe shoqërisë. Kjo shihej si diçka problematike për një vend ku ekonomia kontrollohej nga komunizmi dhe më pas nga grupe të ndryshme parapolitike që kishin krijuar monopole për dekada të tëra në Kosovë.

Pjesë e produktit të ri politik që solla në Kosovë ishte besimi në skenën politike dhe sistemin politik të vendit. Për mua nuk kishte vija të kuqe. Nuk kishte as urrejtje politike. Udhërrëfyesi im politik ishte konstruktiviteti, ishte dialogu politik. Këto ishin shtyllat e vetme se si të krijohet një kohëzgjatje politike moderne në Kosovë. Nuk e duroja dot kulturën politike që u krijua në Kosovë: goditja e kujtudo që nuk pajtohej. Për mua ishte normale të kisha një komunikim të hapur dhe konstruktiv me të gjithë aktorët politikë në vend, por kjo nuk u pëlqente disave që në atë kohë kishin monopolin mediatik. Me çdo kusht ata u përpoqën të parandalonin një model të tillë. Për këtë ata kishin krijuar dhe udhëhequr fushata destruktive që në një moment të caktuar në politikë janë shfaqur si diçka e keqe, si diçka e papranueshme, që rezultoi me ndëshkim elektoral për shkak të konstruktivitetit të treguar.

Pra, kjo kulturë e imja nuk u pranua dhe u pa si diçka jonormale në një mjedis që nuk ishte mësuar me një shfaqje kaq të hapur, pa marifete politike.

Mendova se në Kosovë do të gjeja një ambient politik që synon përparimin e vendit. Ky do të ishte motivi im për ta sjellë Kosovën në një fillim të ri të shtetndërtimit si ideal shekullor i shqiptarëve për çlirim. Pritja imja u kthye në zhgënjim. Programi im politik nuk u prit mirë ose lehtë nga skena politike. Nuk isha mësuar me situata të tilla parapolitike që më bëheshin. Kam hyrë në partneritete politike e që besoj se programi im mund të zbatohet edhe nga të tjerët, nga një vizion i ri ekonomik dhe real, deri te reformat kushtetuese që kanë të bëjnë me funksionalitetin e sistemit politik të Kosovës. Premtimet e dhëna nga partnerët politikë nuk u realizuan. U shkaktuan pengesa të mëdha.

Përveç politikës së brendshme, kam qenë i përfshirë edhe në politikën e jashtme. Dhjetëra njohje që gëzon sot Kosova janë sjellë për shkak të lobimit tim në lidhje me diplomacinë kosovare. Për mua ky ishte një kontribut i padiskutueshëm për Republikën e Kosovës, por më vonë kuptova se nuk ishte mirëpritur nga politikanët dhe publicistët në Kosovë, të cilët besonin se kishin monopol mbi diplomacinë dhe politikën e jashtme dhe se po shpenzonin shumë kohë duke e kthyer tytën drejt meje, e jo drejt Beogradit, i cili ishte armiku real dhe konkret në këtë betejë diplomatike.

Skena politike dhe mediatike u kthye me shantazhe, sfida dhe lojëra parapolitike ndaj meje. Nuk ishte e rëndësishme nëse do ta kisha vullnetin për të punuar dhe për të arritur rezultate. Ata ishin të shqetësuar për nxjerrjen e të gjitha gjërave të mia, kërkesat e tyre për para, sesa për ide, projekte dhe vizion.

Kandidimi dhe zgjedhja ime President i Republikës së Kosovës, ishte me vullnetin tim të madh për ta zbatuar vizionin liberal dhe modern për Kosovën nga ana ime, por nga ana e të tjerëve kjo ishte bërë me intriga dhe lojëra parapolitike, të cilat u shfaqën në sipërfaqe gjatë zgjedhjeve. Kjo dhe shumë situata si pjesë e dy qeverive të Kosovës, treguan një mjedis të vështirë politik në Kosovë, ku vullneti për punë dhe vizioni për zhvillim, siç besoja, ishte mirëpritur, por ishte penguar.

Partnerët politikë nuk kishin hyrë me sinqeritet të plotë në marrëdhëniet e bashkëpunimit në qeveri. Premtimet dhe marrëveshjet politike që u bënë për krijimin e koalicioneve nuk u mbajtën nga partnerët, prandaj nuk u bë një punë e madhe që do ta bënte dallimin, atë dallim për të cilin iu futa politikës.

Nga ekonomia, politika e jashtme, energjia dhe bashkëpunimi ndërshqiptar, unë dhe partnerët e koalicionit ishim në anët e kundërta. Për një gjë më vjen keq, që nuk arrita ta udhëheq Kosovën vetëm një vit. Jam i bindur se Kosovës do t'ia ktheja ardhmërinë, do të krijoja një perspektivë të paimagjinueshme për çdo banor të këtij shteti. Unë do ta kisha përkrahjen jo vetëm të miqve tanë tradicionalë, por të të gjithë botës.

Liderëve tanë që shërbyen u ka munguar sharmi politik, strategjia dhe vetëdija për të kuptuar se jemi shumë të vegjël për t'i shtyrë gjërat me “gjoks”, me pseudopatriotizëm e gënjeshtër, pa asnjë ide kreative diplomatike e as ekonomike.

Edhe shpresa e fundit e qytetarëve të Kosovës, koha e Kurtit, me shpejtësi po zbehet, pa lënë ndonjë gjurmë të ekzistencës. Sigurisht gjurma më e theksuar e tij mbetet zhgënjimi për “mashtimin e madh”.

A handwritten signature in black ink, reading "Behgjet Pacolli". The signature is written in a cursive, flowing style with large, connected letters.

# **Fjalimi i BEHGJET PACOLLI- it para Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës pas zgjedhjes president**

*Të nderuar qytetarë të Kosovës,*

*I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi,*

*I nderuar kandidat për Kryeministër të Kosovës, zoti Hashim Thaçi,*

*Të nderuar deputetë,*

*E nderuara familje Rugova,*

*E nderuara familje Jashari,*

*Të nderuara familje Haradinaj, Pajaziti dhe të gjitha familjet e tjera të çmuara të dëshmorëve tanë,*

*Të nderuar përfaqësues të korit diplomatik në Kosovë,*

*Të nderuar pjesëmarrës e mysafirë,*

*Sot është një ditë e madhe, për mua fillon sfida e radhës me plot përgjegjësi.*

*Ju, të dashur deputetë, më zgjodhët mua për të vazhduar rrugën për përkryerjen e vizionit të Presidentit historik, dr. Ibrahim Rugovës, për të plotësuar amanetin e heronjve tanë, komandantit historik, Adem Jasharit dhe gjithë të tjerëve që ranë për shtetin e pavarur të Kosovës.*

*Falënderoj presidentin e Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiun dhe ushtruesin e këtij posti, dr. Jakup Krasniqin, për angazhimin dhe përkushtimin e tyre në këtë detyrë.*

*Të dashur qytetarë të Kosovës,*

*Sot ndihem i përlulur para jush dhe ndjej se nuk më mjafton fjala që të përshkruaj këtë moment. Nuk ekziston ndjenjë më e mirë se të fitosh besimin e përfaqësuesve të popullit, që t'i shërbesh popullit dhe vendit tënd.*

*Unë jam i emocionuar por, nga ana tjetër, shumë i përgatitur që këtë besim që m'u dha sot ta arsyetoj me dinjitet, me përgjegjësi, me gjithë energjinë, time, me dijen dhe qenien time.*

*Jam krenar që jam njëri nga ju, i lindur dhe i rritur në mjediset e një familje tipike të Kosovës, domosdoshmëria më shtyu të ballafaqohem me sfidat e jetës të civilizuar në Perëndim, jetë kjo jo e lehtë për mua. Gjatë rrugëtimit tim, shpeshherë jam rrëzuar, por gjithmonë jam ngritur dhe kam vazhduar ende më i fortë.*

*Ky rrugëtim më solli edhe suksese, me të cilat unë sot krenohem. Këto suksese i kam arritur me punë të ndershme. Këto suksese janë sukseset e mia, të bashkëpunëtorëve të mi, farefisit*

*tim dhe familjeve të bashkëpunëtorëve të mi. Këto sfida dhe suksese të arritura në Perëndim duhej të plotësoheshin një ditë me arritjet e vendit tim, Kosovës.*

*Unë u ktheva në Kosovë dhe e kuptova se këtu e kam vendin, në mesin e njerëzve të mi. Këtu zemra ime rreh ndryshe, këtu i gëzohem tokës dhe diellit, më gëzon çdo gjë këtu dhe më fascinon Perëndimi. Perëndimi është prej nga erdha unë dhe Perëndimi është rruga, të cilës ia ka mësuar Kosova jonë.*

*I falënderoj miqtë tanë perëndimorë, në veçanti Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkësinë Evropiane, për ndihmën e madhe dhe kontributin që vazhdojnë dhe kontribuojnë për ndërtimin dhe forcimin e shtetit demokratik të Kosovës, për të gjithë qytetarët e saj, për shqiptarët, za srbe, tyrkler için, za Bošnjake i Crnogorce, për romët, ashkalinjtë dhe gjithë të tjerët.*

*Kosova ka fituar pavarësinë, lirinë dhe ndërton barazinë, tani po ndërtojmë shtetin. Këto arritje i synuam të gjithë dhe punuam me aq sa ditëm dhe mundëm, por ende jemi larg prej të qenit të kënaqur me arritjet tona e arritur e veçantë e shtetit të ri të Kosovës është njohja nga 75 shtete të botës, të cilat unë sot, prej këtu, i falënderoj në emër të popullit të Kosovës.*

*Kosova, sot po ballafaqohet me sfidat më të mëdha që nga çlirimi i saj. Ato janë të shumta dhe do të jenë përgjegjësi e funksionit tim që më besuat sot.*

*Përprjekjet e kosovarëve për një të ardhme më të mirë, janë virtyt i kosovarëve, jo dobësi. Asnjëherë nuk iu jemi dorëzuar sfidave dhe vështirësive, prandaj, përprjekjet tona për të forcuar institucionet dhe një Kosovë ndryshe, duhet të trajtohen si virtyt dhe domosdoshmëri e kohës në të cilën ne jetojmë.*

*Ishim dëshmitarë të përfoljeve, akuzave, etiketimeve të përmasave globale të drejtuara shtetit të Kosovës dhe njerëzve të saj. Por, të dashur deputetë, ju garantoj se kjo nuk është asgjë e jashtëzakonshme, e njëjta ka ndodhur edhe diku tjetër.*

*Në procesin e pavarësimit të Kosovës ndodhen veprime të jashtëzakonshme, si të njerëzve të Kosovës, ashtu edhe të ndërkombëtarëve, veprime këto në të cilat u përqendrua edhe opinioni botëror. Pavarësia e Kosovës ishte një storie e suksesit; përvoja ime më ka bindur se suksesi mund nganjëherë edhe të mos falet. Kosova dhe njerëzit e saj shënuan një sukses, shënuan, historinë e shtetit më të ri në botë.*

*Sot, unë kam marrë një detyrim jo të lehtë, kam zgjedhur pajtimin dhe angazhimin kundrejt konfliktit dhe pasivitetit, kam zgjedhur të punoj dhe angazhohem në këtë rrugë të domosdoshme për Kosovën dhe të ardhmen e saj. Nuk e them se dikush tjetër do ta kishte më të lehtë, sfidat janë për t'u tejkaluar e detyra ime e re është sfida e radhës, institucionet demokratike forcohen me angazhimin e pozitës, opozitës dhe shoqërisë civile.*

*Unë ju garantoj se do t'i përfaqësoj interesat e të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa marrë parasysh bindjet politike. Institucioni të cilin e përfaqësoj do të garantojë unitet, stabilitet dhe jam tërësisht i dedikuar t'i shërbej këtij funksioni.*

*Të dashur qytetarë të Kosovës,*

*Unë, si President i Republikës së Kosovës, do të jem gjithmonë me ju, pjesë e juaja dhe halleve tuaja, do të punoj dhe angazhohem që të jem pjesë e zgjidhjeve tuaja.*

*Do të punoj për të sotmen dhe të ardhmen e të gjithë qytetarëve të Kosovës: fëmijëve, të rinjve, prindërve dhe veteranëve të të gjitha kategorive.*

*Do të angazhohem me mundësitë dhe kompetencat e mia, për mirëqenie më të mirë dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Kosova ka mundësi për më shumë dhe më mirë.*

*Do të punoj për ruajtjen e integritetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës, kjo është e shenjtë për ne, për barazinë në mes të shqiptarëve dhe komuniteteve të tjera etnike, si dhe respektimin e të drejtave të të gjithë kosovarëve pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fetare, gjinore apo racore, na kraju svi smo ravnopravni građani slobodnog, nezavisnog Kosova.*

*Do të punoj për një shtet të së drejtës dhe për një shtet ku askush nuk është mbi ligjin, do të mbështes fuqishëm luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar duke siguruar pavarësinë e plotë të sistemit gjyqësor dhe kushtet optimale për punën e tyre.*

*Do të promovoj idenë për një Kosovë të hapur, e cila garanton lëvizje të lirë të njerëzve, të mallrave dhe shërbimeve, për një Kosovë të integruar plotësisht në shtëpinë e madhe evropiane, në NATO dhe organizatat e tjera globale.*

*Do të promovoj idenë për plotësimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në mënyrë që në të ardhmen presidenti i Kosovës të votohet nga vota e lirë e qytetarit.*

*Do të promovoj idenë e funksionalizimit të referendimit - referendumi është qelizë e demokracisë.*

*Do të promovoj idenë e ndryshimit të Ligjit zgjedhor, në mënyrë që në të ardhmen Kosova të ketë zgjedhje fer, zgjedhje të lira dhe korrekte.*

*Kosova ka qenë dhe mbetet vend, i cili respekton fqinjët dhe kryen obligimet e saj për marrëdhënie sa më të mira fqinjësore me të gjithë fqinjët e saj.*

*E falënderoj shumë Republikën e Shqipërisë dhe institucionet e saj, për kontributin e jashtëzakonshëm dhënë afirmimit të shtetit të Kosovës.*

*E çmoj lart gatishmërinë e Malit të Zi dhe Maqedonisë, për avancimin e raporteve të mira fqinjësore me Kosovën.*

*Për të gjithë strukturën politike në Kosovë është i rëndësishëm dialogu me Serbinë. Në këtë proces, Kosova do të prezantojë vlerat, idenë dhe vizionin për një fqinjësi të mirë, ku të drejtat e njeriut respektohen dhe vlerësohen në mënyrë reciproke. Parimet e fqinjësisë së mirë janë bazë për integritet rajonale e më tutje për integritet global.*

*Do të punoj me gjithë qenien time që ta ngrejë Kosovën në mesin e shteteve të respektuara dhe të vlerësuara të botës, në mesin e shteteve të respektuara me të ardhme të ndritur, atje ku qytetari është në qendër të vendimmarrjes dhe është esenca e qeverisjes.*

*Kosova e meriton këtë, kosovarët e meritojnë këtë. Kosovarët e meritojnë të jetojnë në vend me një të ardhme të ndritur dhe këtë mund ta arrijmë vetëm, e vetëm me përkushtim dhe me punë të ndershme.*

*Rol të veçantë në këtë proces ka rinia jonë. Për rininë kemi bërë pak, për rininë ne duhet të krijojmë kushte më të mira jetësore dhe një perspektivë të sigurt.*

*Me këtë mandat po hyjmë në fazën e re të shtetndërtimit të Kosovës, në fazën kur duhet të forcojmë fundamentet e shtetit të Kosovës, me vizion të qartë dhe pa frikë nga e ardhmja. Ne do të korrin sukses, këtë ju garantoj qytetarë të nderuar, sepse jemi të përkushtuar që suksesin ta arrijmë vetëm me punë profesionale dhe me nderë.*

*Prandaj, të dashur qytetarë të Kosovës dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës, së bashku t'ia fillojmë punës – jemi në vonesë.*

*Faleminderit edhe një herë dhe Zoti na ndihmoftë në këtë rrugëtim të përbashkët!*

*Zoti e bekoftë popullin e Kosovës,*

*Zoti i bekoftë të gjithë popujt në botë!*

*Faleminderit!*



*Fjalimi i Behgjet Pacolli para deputetëve të Kuvendit të Kosovës pas zgjedhjes President*

---

## **Figura të reja në dhjetëshen e më të votuarve**

---

Azem Sylja, Elmi Reçica, Shaip Muja dhe Latif Gashi nga PDK - ja: Arben Gashi, Anton Quni dhe Hashim Deshishku nga LDK - ja; Ukë Rugova, Daut Haradinaj, Blerim Shala, Ramiz Kelmendi, Burim Ramadani dhe Kymete Bajraktari nga AAK - ja: Ferid Agani, Mimoza Kusari - Lila, Agim Çeku, Muhamet Mustafa dhe Sevdije Lama nga AKR - ja, edhe pse për herë të parë kanë garuar për postin e deputetit, kanë zënë vend në dhjetëshen e më të votuarve në listën e partive nga vijën

### **Dhjetëshja më e votuar e PDK - së**

Hashim Thaçi (160 850), Fatmir Limaj (75 68), Jakup Krasniqi (35 379), Azem Sylja (30 357), Enver Hoxhaj (30 302), Hajredin Kuçi (16 836), Elmi Reçica (15 834), Shaip Muja (14 996), Bajram Rexhepi (14 656), Latif Gashi (13 877).

### **Dhjetëshja më e votuar e LDK - së**

Isa Mustafa (130 213), Sabri Hamiti (33 777), Ismet Beqiri (21 090), Arben Gashi (20 443), Nekibe Kelmendi (14 862), Lutfi Haziri (12 097), Naser Osmani (11 907), Anton Quni (11 851), Hashim Deshishku (11 714), Eqrem Kryeziu (11 678).

### **Dhjetëshja më e votuar e Vetëvendosje! - së**

Albin Kurti (58 467), Florin Krasniqi (17 842), Glauk Konjufca (16 646), Rexhep Selimi (13 600), Afrim Hoti (11 801), Liburn Aliu (8 909), Albana Fetoshi (8 132), Agim Kuleta (7 169), Visar Ymeri (6 892), Afrim Kasolli (6 711).

### **Dhjetëshja më e votuar e AAK - së**

Ramush Haradinaj (54 713), Ukë Rugova (25 085), Daut Haradinaj (13 954), Donika Kadaj - Bujupi (13 447), Blerim Shala (13 081), Ramiz Kelmendi (7 531), Ahmet Isufi (7 450), Ardian Gjini (6 998), Burim Ramadani (6 669), Kymete Bajraktari (4 326).

### **Pesëshja më e votuar e AKR - së**

Behgjet Pacolli (29 294), Ferid Agani (24 947), Mimoza Kusari - Lila (19 574), Agim Çeku (13 710), Muhamet Mustafa (10 611).

PRISHTINË, 31 JANAR - Dhjetë deputetët më të votuar të PDK - së në zgjedhjet e 12 dhjetorit janë: Hashim Thaçi, Fatmir Limaj, Jakup Krasniqi, Azem Sylja, Enver Hoxhaj, Hajredin Kuçi, Elmi Reçica, Shaip Muja, Bajram Rexhepi dhe Latif Gashi. Në mesin e dhjetë më të votuarve, katër nga ta që do të jenë për herë të parë deputetë janë: Azem Sylja, Elmi Reçica, Shaip Muja dhe Latif Gashi. Ulësen e deputetit nga kjo parti s'e kanë fituar: Ramë Buja, Rrustem Mustafa, Bahri Hyseni, Nait Hasani, Rexhep Hoti etj. Në Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) dhjetë deputetët më të votuar janë: Isa Mustafa, Sabri Hamiti, Ismet Beqiri, Arben Gashi, Nekibe Kelmendi, Lutfi Haziri, Naser Osmani, Anton Quni, Hashim Deshishku dhe Eqrem Kryeziu. Për herë të parë në karrigen e deputetit këtë herë në vend do të ulen Hashim Deshishku dhe Anton Quni, kurse jashtë kuvendit kanë mbetur personalitete të njohura si: Ramë Manaj, Ali



Lajçi, Berim Ramosaj, Alush Gashi etj. Forca më e re parlamentare, Lëvizja Vetëvendosje, në Kuvendin e Kosovës do të përfaqësohet me figurat kryesore të saj. Dhjetë deputetët më të votuar të Lëvizjes Vetëvendosje! janë: Albin Kurti, Florin Krasniqi, Glauk Konjufca, Rexhep Selimi, Afrim Hoti, Liburn Aliu, Albana Fetoshi, Agim Kuleta, Visar Ymeri dhe Afrim Kasolli. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AA) në Kuvendin e Kosovës këtë herë do të paraqitet me ndryshime rrënjësore. Pas Ramush Haradinajt, deputetët më të votuar në këtë parti janë: Ukë Rugova, Daut Haradinaj, Donika Kadaj - Bujupi, Blerim Shala, Ramiz Kelmendi, Ahmet Isufi, Ardian Gjini, Burim Ramadani dhe Kymete Bajraktari. Kurse jashtë Kuvendit nga kjo parti kanë mbetur: Naim Maloku, Gjylnaze Syla, Shkumbin Demaliaj, Ethem Çeku etj. Edhe Aleanca Kosova e Re në përbërjen e re të Kuvendit të Kosovës do të paraqitet me disa deputetë të rinj: Ferid Aganin, Mimoza Kusari - Lilan, Agim Çekun dhe Muhamet Mustafën. Por, në Kuvend do të mungojë Ibrahim Gashi, i cili nuk ka marrë vota të mjaftueshme për deputet.

**E KAM MIRË ME NDËRKOMBËTARËT**

---

**Kam raporte korrekte dhe bashkëpunuese me gjithë faktorët ndërkombëtar**

---

PRISHTINË, 1 SHKURT - Presidenti i AKR - së, Behgjet Pacolli, njëri ndër kandidatët e mundshëm për kryetar të Kosovës, ka shprehur habinë lidhur me shkrimet e disa medimeve, se "nuk është i pranueshëm për ndërkombëtarët". Pacolli ka thënë për "Epokën e re" se raportet e tij me ambasadorët dhe gjithë faktorët ndërkombëtarë vazhdimisht kanë qenë korrekte, bashkëpunuese, transparente dhe të përcjella me respekt reciprok. **"Unë vazhdoj të jem në pushim dhe nuk jam i informuar detajisht për ato që po thoni ju, por marrëdhëniet e mia me përfaqësuesit diplomatikë ndërkombëtarë në vazhdimësi kanë qenë korrekte, fer, transparente, bashkëpunuese dhe të një respekti reciprok"**, ka thënë Pacolli. Pacolli ka deklaruar se me përfaqësuesit e shteteve të Quint-it, në Prishtinë, ka pasur për qëllim mbarëvajtjen e proceseve demokratike dhe shtyrjen përpara të proceseve integruese euroatlantike. **"Kontaktet e mia me përfaqësuesit e shteteve të Quint-it në vazhdimësi kanë pasur të bëjnë me mbarëvajtjen e proceseve demokratike në vend, interesat e qytetarëve të Kosovës dhe ndërtimin e një shteti efikas, dinjitoz dhe me orientime euroatlantike"**, ka theksuar Pacolli. Ndërkaq, i pyetur lidhur me informacionet në medie, se kandidatura e tij për kryetar të Kosovës nuk është pranueshme për ndërkombëtarët, Pacolli është përgjigjur: **"Nëse është tërësisht anonime, atëherë për mua nuk është e besueshme. E nëse, ai burim ekziston, unë konsideroj se gjithçka është tendencioze për ta njollosur personalitetin tim dhe subjektin të cilin e udhëheq. Unë e di se bashkësia ndërkombëtare është e prirë të veprojë dhe jo të bëjë propaganda. Bashkësia ndërkombëtare nuk bën propaganda mediale, prandaj jam i bindur se ai 'burim ndërkombëtar' nuk mund ta transmetojë qëndrimin e tërë bashkësisë ndërkombëtare"**. Pacolli ka shprehur qëndrimin e vet se në angazhimet politike e jetësore asnjëherë nuk ka qenë servil i askujt. Ai ka thënë se gjithçka që ka fituar në jetë e ka fituar me punë. **"Unë nuk jam servil i askujt për interesa personale, sepse gjithçka që kam ndërtuar në jetën time, duke iu falënderuar Zotit, e kam ndërtuar mbi bazën e punës së pandërprerë dhe investimit të shpirtit tim. Nuk kam fituar asgjë me servilizëm, as me shpirtngushtësi, as me hajni, por vetëm me punë"**, ka deklaruar ai. Si lider partiak, i cili haptas ka shprehur kushtet për t'u bërë pjesë e një koalicioni qeverisës duke marrë presidencën në udhëheqje, Pacolli ka thënë se gjatë jetës asnjëherë nuk ka pasur probleme me drejtësinë. Ai ka thënë se e kaluara e tij është shumë e pastër, e dëshmuar në një vend me demokraci të vjetër. **"Unë asnjëherë në jetë nuk kam pasur probleme me gjyqësinë, bile as për parkim të gabuar të veturës. E kam të kaluarën time me shumë të pastër"**, ka deklaruar Pacolli. Në këtë kontekst, ai ka thënë se e ardhmja e tij politike do të varet pikërisht nga pozicioni me të cilin do t'i jepet mundësia për të ndërmarrë hapa konkretë për të mirën e Kosovës, për zhvillimin dhe integrimin e saj. **"Unë do të vazhdoj të mbes në politikë, vetëm nëse kam mundësi të punoj për zhvillimin ekonomik-social të qytetarëve, për përmirësimin e imazhit të Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe për avancimin e proceseve integruese në BE dhe NATO. E kjo mundësi më jepet vetëm në pozitën e**

**presidentit të shtetit. Aty do ta jap kontributin tim, por edhe përfaqësuesit e AKR-së do ta dëshmojnë një gjë të tillë, në rast se na krijohet hapësira në dikastere të caktuara", ka thënë Pacolli. - Jetlir Zyberaj**

---

## **MPJ dhe Pacolli ndihmojnë evakuimin e shtetasve të Kosovës**

---

Në mungesë të raporteve diplomatike me Egjiptin, Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës u ka rekomanduar shtetasve kosovarë të kontaktojnë me Ambasadën e Republikës së Turqisë në Kajro dhe me Ambasadën e Republikës së Kosovës në Ankara. Adresa elektronike e Ambasadës së Kosovës në Ankara është: [embassy.turkey@ks-gov.net](mailto:embassy.turkey@ks-gov.net). Tel: +90 312 446 70 54; Fax: +90 312 445 70 55

PRISHTINË, 3 SHKURT - Krahas Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës, edhe presidenti i Aleancës Kosova e Re, Behgjet Pacolli, ka ndërmarrë një iniciativë që nga e enjtja për t'i evakuuar të gjithë shtetasit e Kosovës, të cilët janë identifikuar, rreth 160 prej tyre, që ndodhen në Egjipt për studime apo veprimtari të ndryshme. Në mungesë të raporteve diplomatike me Egjiptin, Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës u ka rekomanduar shtetasve kosovarë të kontaktojnë me Ambasadën e Republikës së Turqisë në Kajro dhe me Ambasadën e Republikës së Kosovës në Ankara. Adresa elektronike e Ambasadës së Kosovës në Ankara është: [embassy.turkey@ks.gov.net](mailto:embassy.turkey@ks.gov.net), Tel: +90 312 446 70 54; Fax: +90 312 446 70 55. Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës po të njëjtën ditë ka njoftuar se po punohet për evakuimin e shtetasve nga Egjipti. "Në mungesë të marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Egjiptit, MPJ e Kosovës po vepron nëpërmjet kanaleve të saj diplomatike në vendet e afërta që t'i ndjekë nga afër zhvillimet e situatës. Ministria e Punëve të Jashtme i ka dhënë prioritet të lartë evakuimit të qytetarëve tanë nga Egjipti. Mënyra më e drejtpërdrejtë është që qytetarët e interesuar të kontaktojnë me Ambasadën e Republikës së Turqisë në Kajro dhe me Ambasadën e Republikës së Kosovës në Ankara. Adresa elektronike e Ambasadës së Kosovës në Ankara është: [embassy.turkey@ks.gov.net](mailto:embassy.turkey@ks.gov.net), Tel: +90 312 446 70 54; Fax +90 312 446 70 55.", është thënë në njoftimin e MPJ - së. Në njoftimin e MPJ - së të enjten paradite është thënë se aranzhimet në fjalë janë realizuar nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Ankara. "Me angazhimin e drejtpërdrejtë të ambasadorit Bekim Sejdiu, po punohet për evakuimin e shtetasve tashmë të paraqitur në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Ankara, ndërkohë që Ministria e Punëve të Jashtme e Turqisë nëpërmjet Ambasadës së Turqisë në Kajro ka shprehur gatishmërinë ta marrë përsipër pritjen dhe dërgimin për në Turqi të shtetasve të Kosovës që gjenden në Egjipt dhe paraqitjen në këtë ambasadë", është thënë në këtë njoftim. Gjatë ditës së enjte në një komunikatë për medie të AKR - së është thënë se: "Pjesa e parë e shtetasve kosovarë që do të evakuhon janë familjet me fëmijë me banim në Kajro dhe Aleksandri, të cilët gjatë natës të së enjtes pritet të tërhiqen nga aeroporti i Kajros me aeroplan dhe do të mbërrijnë sot (e premte) në Kosovë. Ndërsa evakuimi i pjesës tjetër do të vazhdojë edhe ditën e sotme (premtë), deri në pasditen e së nesërme (e shtunë)", është thënë në këtë komunikatë. Po në këtë komunikatë është thënë se Pacolli i ka marrë përsipër të gjitha shpenzimet e nevojshme për evakuimin dhe sigurinë e të gjithë shtetasve të Kosovës të cilët ndodhen në Egjipt. Edhe AKR ka publikuar disa numra të telefonit në të cilët mund të lajmërohen të gjithë familjarët në Kosovë, të cilët posedojnë ndonjë shenjë për ekzistimin e familjarëve të tyre që ndodhen në Egjipt ose që kanë nevojë për ndihmë: 038 / 224-021; 038 / 243-877 ose [rejhanv@gmail.com](mailto:rejhanv@gmail.com). "Evakuimi është duke u bërë në mënyrë të organizuar dhe për çdo

informatë shtesë ju lutem kontaktoni në kontaktet e sipërshënuara", është thënë në vazhdim të komunikatës së AKR - së. Mbi 70 shtetas të Kosovës kanë kërkuar ndihmë nga Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës për t'u evakuuar nga Egjipti për shkak situatës së rëndë, si pasojë e përleshjeve dhe mbështetësve të presidentit Hosni Mubarak.

---

## **Pengesa e Pacollit, bashkëshortja**

---

**Derisa në AKR ende thonë se Pacolli është kandidat serioz, analisti Shkëlzen Maliqi thotë se kreu i AKR - së nuk mund të jetë president për shkak të aferave të së kaluarës dhe lidhjeve me Rusinë. Bajram Rexhepi i PDK - së mohon emrin e Edita Tahirit, ndërsa burime të "Politikës" thonë se Veton Surroi nuk do të kandidohet, ndërsa Blerim Shala ka problem me përkrahje brenda partisë së vet**

BEOGRAD, 4 SHKURT - Derisa në qarqet politike në Prishtinë nuk ka dilemë se mandatar për formimin e Qeverisë së re të Kosovës do të jetë Hashim Thaçi, ka shumë dilema se cili do të jetë presidenti i ardhshëm i Kosovës, shkruan gazeta serbe "Politika". Duke përcjellë raportimin e mediave kosovare. "Politika" përkujton se në mesin e emrave që tashmë janë përmendur për postin e presidentit të shtetit të Kosovës janë Edita Tahiri, Blerim Shala, Agim Çeku e Veton Surroi. Por, "Politika" shkruan se mediat e Prishtinës tashmë nuk e përmendin më Behgjet Pacollin si kandidat, edhe pse ai në një intervistë për këtë gazetë serbe citohet të ketë thënë se do të kërkojë të jetë president i Kosovës. Në partinë e Pacollit, AKR, pohojnë se Pacolli ende është kandidat serioz për president. "Pacolli është personaliteti më kredibil politik në skenën kosovare. Në fushatën zgjedhore publikisht kemi porositur se marrim pjesë në zgjedhje për të fituar ulësen e njeriut të parë të shtetit. Tash për tash, rreth kësaj kemi pasur vetëm një bisedë joformale me Hashim Thaçin, nga fillimi i muajit janar. Duhet të ulemi në tavolinë. Ndërsa, gjykuar në rrethanat që sundojnë në skenën politike shqiptare të gjitha variantet duket se janë në qarkullim", ka thënë për "Politikën" Ibrahim Gashi, nënkryetar i AKR - së. Por, analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë se Pacolli, duke marrë parasysh kërkesat e bashkësisë ndërkombëtare që kërkon njerëz me "duar të pastra", nuk mund të jetë në ulësen e njeriut të parë të shtetit. "Ai është njeri nga biznesi, në të kaluarën ka pasur shumë afera, padi, ndërsa është e njohur se edhe Carla del Ponte e ka ndjekur në Zvicër për shkak të mosrespektimit të ligjeve. Ende është aktiv në biznes dhe është pyetje nëse ai do të mund t'i ndihmonte Kosovës, posaçërisht tash kur imazhi ynë jashtë vendit është nxirë, por, ka edhe një pengesë nga arsyet e sigurisë. Është e ditur se Behgjet Pacolli është i martuar me ruse. Përveç kësaj, ai ka edhe shumë punë në Rusi", tha për "Politikën" Maliqi, duke theksuar se është shumë reale mundësia që në krye të shtetit të vendoset Agim Çeku, edhe pse, siç thotë ai, bashkësia ndërkombëtare insiston që shtetin ta udhëheqë një grua. Kur bëhet fjalë për Veton Surroin, vazhdon "Politika", një burim në Prishtinë ka thënë se ai nuk do të kandidohet, sepse do të duhej të udhëhiqte ekipin e Kosovës në bisedimet e ardhshme me Beogradin. Në partinë e Thaçit e refuzojnë mundësinë që Edita Tahiri, kryetare Alternativës Demokratike që deri tani ka qenë në koalicion me PDK - në, të jetë presidente e Kosovës". Sipas Kushtetutes na takojnë vendet e kryeministrit dhe kryetarit të Kuvendit të Kosovës, ndërsa kur bëhet fjalë për Edita Tahirin, këto janë vetëm spekulime dhe supozime, sepse ajo nuk është nga radhët e partisë sonë. Në fakt, ne as që do të kërkojmë postin e presidentit", ka thënë për "Politikën" Bajram Rexhepi, nënkryetar i PDK - së. Në anën tjetër, "Politikë" citon edhe analistë që thonë se në AAK - në e Ramush Haradinajt janë të përbajtur në lidhje me mundësinë që Blerim Shala, nënkryetari i parë i kësaj partie, të ketë përkrahjen për t'u zgjedhur president i Kosovës.

---

## **Kusari Lila: Kusht për AKR-në, posti i presidentit**

---

**Pacolli "Zyrtarisht i emëruar për të vazhduar negociatat është presidenti i AKR-së, zoti Behgjet Pacolli, i cili aktualisht nuk gjendet në Kosovë", tha Kusari Lila.**

Kryeministri në dorëheqje, Hashim Thaçi, tha se partia që ai drejton, tashmë i ka numrat e duhur për të formuar qeverinë. Por, emrat e partive që kanë vendosur të hyjnë në koalicion vazhdojnë të jenë enigmë. Ndërsa, dy partitë tjera shqiptare, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Aleanca Kosova e Re, thonë se ende nuk ka ndonjë marrëveshje, madje as parimore për koalicion. Sekretari i përgjithshëm i AAK-së, Burim Ramadani, insiston se AAK-ja nuk hyn në koalicion qeverisës. "Nuk ka asnjë ndryshim në qëndrimin e AAK-së. Ne në të gjitha vlerësimet që i kemi bërë, kemi parë që gjatë këtyre tre vjetëve, Kosova është dëmtuar, sepse ka pasur udhëheqje të keqe, që do të thotë shef të qeverisë që e ka dëmtuar vendin", tha ai për Radio Evropën e Lirë. Por, kreu i PDK-së, Hashim Thaçi, ka bërë të qartë se nuk do t'ua lëshojë subjekteve tjera, e as ndonjë anëtar të partisë së tij, postin e kryeministrit. Aleanca Kosova e Re këmbëngul se nëse PDK-ja e do atë në koalicion, atëherë duhet t'ia rezervojë postin e presidentit. Nënkryetarja Mimoza Kusari-Lila shpjegon: "AKR-ja i ka prezantuar kushtet e veta. Në mesin e tyre është hapësira e veprimit për t'i bërë ndryshimet e domosdoshme, për të funksionalizuar jetën institucionale në Kosovë". "Në mesin e këtyre kushteve është pozita e presidentit, jo për të sistemuar një person, por për t'i bërë ndryshimet e duhura, për të pasur një stabilitet institucional", thotë Kusari-Lila. Burim Ramadani, nga AAK-ja, dyshon se PDK-ja i ka siguruar tashmë 61 votat. Në anën tjetër, Mimoza Kusari-Lila thotë se asnjë sinjal në AKR nuk është marrë për koalicionin e ardhshëm qeverisës. Sidoqoftë, ajo thotë se do të jetë kreu i AKR-së, Behgjet Pacolli, ai që do ta thotë fjalën përfundimtare. BS

---

## **Kosovës i duhet paqja dhe mirëkuptimi politik i të gjithëve**

---

**"Unë prej kohësh jam këshilltar në Qendrën për Studime Ndërkombëtare Strategjike së bashku me personalitete të shquara amerikane si Henry Kissinger, Zbigniew Brzezinski ...", thotë Pacolli.**

Kryetari i AKR-së Behgjet Pacolli ndodhet në një mision të ri humanitar. Kësaj here shkak u bënë, trazirat në Egjipt, të cilat po shkojnë drejt një konflikti, i cili rrezikon të marrë përmasa tragjike. Pjesë e kësaj tragjedie në të tilla raste më së lehti bëhen të huajt. Si çdo vend normal edhe Kosova do të duhej të merrte përsipër kthimin e qytetarëve të saj, duke shmangur rrezikimin e jetës së tyre. Në pamundësi që shteti këtë ta bënte në mënyrën më të duhur dhe të shpejt, pavarësisht angazhimit, meqë atje nuk ka një ambasadë të re këtë detyrë humanitare e ka marre përsipër edhe z. Pacolli i cili tashmë grupin e parë të qytetarëve e ka sjellë në Kosovë me shpenzimet e tija, ndërsa po vazhdon përpjekjet për të kthyer çdo shtetas tonin. Duke biseduar për këtë çështje, shfrytëzuam rastin të bisedojmë edhe për zhvillimet politike që po kalon vendi, veçanërisht për çështjen e krijimit të institucioneve, pjesë e të cilave diskutime është e partia që e drejton ai, AKR-ja.

### **Program presidencial**

**Unë kam programin tim personal për objektivat e mia në krye të Presidencës, realizimi i të cilit do ta çojë Kosovën shumë vjet përpara në zhvillim, në mirëqenie. Unë vetëm, apo bashkë me figurat e shquara të Koalicionit tonë, di si ta ndërtoj një model ekonomik të suksesshëm për Kosovën...**

### **Jam gati për Kosovën**

**Pyetja është: A e do Kosova kontributin tim sot? Unë besoj se po. Unë jam gati, por jo për veten, por për Kosovën, sepse mua s'më mungon asgjë. Unë s'jam politikan si të tjerët, sepse unë nuk merrem me politikë për të jetuar, por dua që me politikën time të jetojnë më mirë bashkatdhetarët e mi.**

**Bota sot: Koalicioni për Kosovën e Re asnjëherë nuk është deklaruar se nuk do të hyjë në koalicion me PDK-në, megjithatë është përfolur shumë se koalicioni juaj e ka kusht për të hyrë në koalicion me PDK-në, postin e presidentit. A keni biseduar me Thaçin për këtë çështje?**

**Pacolli:** Më duket e tepërt të përsërisë se ne kemi thënë vetëm se nuk kemi vija të kuqe për bashkëpunimin me ndonjë parti të Kosovës. Siç e keni vënë re, me ndonjë përjashtim, të gjitha partitë pas zgjedhjeve janë të gatshme me u përfshi në qeverisje, me kushtet e tyre. Është arritur ndërgjegjësimi i shumicës së forcave politike se situata e vendit, kërkon angazhimin e më të mirëve, për t'u përballë me sfida që janë bukur të vështira. E kam thënë edhe më herët, që unë kam biseduar me zotëri Thaçi ashtu siç kam biseduar dhe me përfaqësues të tjerë politikë në krahun tjetër. Kanë qenë biseda krejt normale midis liderëve politikë dhe në një vend demokratik ndodh kështu, si në situatat që po kalojmë. Negociatat janë diçka krejt tjetër. Por,



ajo që është më e rëndësishme, është të gjendet zgjidhja më e mirë, më e qëndrueshme për Kosovën, që t'i sjellë asaj përmirësim imazhi, forcim të kapaciteteve qeverisëse me personalitete të spikatura dhe të dëshmuara, qëndrueshmëri politike dhe institucionale, reforma, që do ta çonin Kosovën në një nivel më të lartë zhvillimi. Miqtë po presin nga ne dëshmi të reja shtetformimi, dhe ne si AKR do të kontribuojmë në këtë drejtim, sepse ne dimë dhe sepse ne mundemi do të thoshte një koleg i imi. Qytetarët presin që të rritet mirëqenia, të kenë më shumë punë, pavarësisht kush do të jetë në qeverisje, ne jemi gati.

## **Pa mburrje**

### **Bota sot: S'më sqaruar kushtin tuaj për Presidentin...**

**Pacolli:** Ju e quajtet kusht, ndërsa unë nuk do ta quaja të tillë. Shikoni, unë falë punës time të gjatë në vite, në të gjithë botën, në Perëndim apo në Lindje ku s'kam patur ndëshkimin më të vogël, as për parkim të gabuar, jam dikushi. Unë kam shumë vepra të mëdha dhe të vogla në favor të Kosovës, megjithëse nuk jam mburrur kurrë për këto vepra. Unë dua të bëj dhe më shumë vepra të tilla, dhe i kam të gjitha mundësitë, të cilat fatkeqësisht nuk i ka kush tjetër në Kosovë dhe për këtë më vjen keq. Unë dua të punoj për të sjellë më shumë njohje, deri në realizimin e qëllimit final - anëtarësimin të Kosovës në OKB. Unë kam programin tim personal për objektivat e mia në krye të Presidencës, realizimi i të cilit do ta çonte Kosovën shumë vite para në zhvillim, në mirëqenie. Unë vetëm, apo bashkë me figurat e shquara të Koalicionit tonë, di si ta ndërtoj një model ekonomik të suksesshëm për Kosovën, sepse ka shumë vjet që punoj për këtë model, duke filluar që nga rimëkëmbja e fabrikës më të vogël deri tek ajo më e madhja. Unë jam i dëshmuar në këtë punë. Pyetja është: a e do Kosova kontributin tim sot? Unë besoj se po. Unë jam gati, por jo për veten, por për Kosovën, sepse mua s'më mungon asgjë. Unë s'jam politikan si të tjerët, sepse unë nuk merrem me politikë për të jetuar, por dua që me politikën time të jetojnë më mirë bashkatdhetarët e mi. Unë s'di të bej armiq; unë di të pajtoj. Unë di të punoj dhe s'di të bëj fjalë. Unë kam miq të vërtetë, dhe s'do lodhem për të krijuar miqësi të vyeshme për Kosovën, etj. Është një dilemë e një fabule të vjetër: më mirë të dish, apo të kesh? Unë dhe di, edhe kam! Unë s'kam ndonjë padurim për pushtetin, siç e kam treguar me shembullin tim unik të durimit, të vetëpërmbajtjes, të konstruktivitetit, të sinqeritetit. Por, zgjedhësit tanë, populli i Kosovës pret shumë prej meje, siç e tregon në shumë komunikime edhe të mëhershme. Unë dua t'ia shpërblej popullit tim atë që ka bërë për mua dhe s'e shoh këtë post si shpërblim pragmatik interesash.

## **Në Lutjet e mëngjesit**

**Bota sot: Në anën tjetër ka pasur zëra që ju keni qenë i papranueshëm nga ndërkombëtarët për postin e presidentit, sipas një burimi anonim të një gazete të njohur opozicionale me ju, në anën tjetër ju ishit pjesëmarrës në Lutjet e mëngjesit në SHBA, si e komentoni këtë dhe cilat janë raportet tuaja me ndërkombëtarët?**

**Pacolli:** Shikoni, si njeri i punës që jam, unë nuk merrem me zëra, apo me fjalë, por me vepra. Kështu që unë nuk dua të komentoj zërat, nuk jam njeriu që i merr seriozisht zërat. Tash që po kryejmë këtë intervistë, siç është bërë e ditur, unë mora pjesë në Mëngjesin e Lutjeve, një ceremoni model ku liderë apo përfaqësues të shquar nga gjithë bota, takohen me homologë të tyre nga SHBA-të, të prirë nga Presidenti Obama. Unë kam një agjendë takimesh, dhe siç ju e dini, unë nuk e kam zakon të mburrem për agjendat e mia. Por, dua të saktësoj diçka. Unë kam miqësi të mëhershme në këtë vend, kampion i demokracisë. Unë kam patur prej kohësh

kontakte të nivelit më të lartë këtu, më intensivitet ishin gjatë lobimit tim për pavarësimin e Kosovës, para se Presidenti Bush të vinte në Tiranë e ta shpallte mbështetjen amerikane për këtë pavarësim. Kjo shpallje ishte fryt edhe i lobimit tim të fortë atëherë, dhe fitore mbi lobimin serb antipavarësi nëpërmjet kompanisë Venable. Unë prej kohësh jam këshilltar në Qendrën për Studime Ndërkombëtare Strategjike së bashku me personalitete të shquara amerikane si Henry Kissinger, Zbigniew Brzezinski, apo dhe personalitete të tjera nga gjithë bota. Amerika është vendi ku unë zhvilloj prej kohësh biznes, ashtu si dhe thuajse në të gjitha vendet perëndimore. Duke vlerësuar megjithatë gazetën në fjalë, unë dua megjithatë të bëj disa saktësime. Unë vazhdoj t'i mbetem pikëpamjes se mbështetja ndërkombëtare në paqe, ashtu si dhe në luftë, është jetike për shtetformimin tonë. Unë besoj shumë se prania ndërkombëtare ka shërbyer si shkollë qeverisjeje, si garanci stabiliteti në shtetin tonë të ri. Unë e vlerësoj shumë angazhimin e taksapaguesve perëndimorë në mbajtjen e një pranie të madhe në Kosovë, e cila do të na duhet shumë edhe në të ardhmen. Prandaj, kam vlerësuar gjithnjë iniciativat ndërkombëtare, qëllimi i të cilave është veçse në shërbim të Kosovës dhe të paqes në rajon.

**Bota sot: Përveç postit të presidentit, cilat janë kërkesat tjera të AKR-së për të hyrë në koalicion?**

**Pacoli:** Nuk do doja t'i përgjigjesha drejtpërdrejt kësaj pyetjeje, por do ta nisja me një pyetje timen për ju. A e ka luksin Kosova të injorojë kontributin qeverisës të personaliteteve të shquara që ka në gjirin e vet, Koalicioni për Kosovën e Re? A mund të mos vlerësohet programi i AKR-së, i cili është përgatitur nga ekspertët më të mirë të Kosovës? Unë besoj se jo. Sigurisht dhe partitë e tjera kanë plot figura të rëndësishme. Ndaj unë jam i bindur se mandatarin duke vlerësuar veçoritë e momentit historik që po kalon vendi, do të bëjë më të mirën. Unë vazhdoj të besoj se Kosovës dhe sot, njëjtë sikur në mandatin e parë i duhet njëlloj paqeje dhe mirëkuptimi politik; i duhet kontributi i të gjithëve në arritjen e disa objektivave themelore për jetesën tonë si shtet i pavarur.

**Bota sot: A ka ende AKR-ja qëndrim konkret për hyrjen në koalicion me PDK - në?**

**Pacoli:** Ne do të mbledhim forumet dhe do ta përcaktojmë saktësisht qëndrimin tonë sapo të kthehem.

**Angazhim mbarëkombëtar**

**Bota sot: AKR - ja do të jetë pjesë e Kuvendit të Kosovës, cili do të jetë qëndrimi juaj lidhur me bisedimet që pritet të zhvillohen në mes Kosovës dhe Serbisë?**

**Pacoli:** Qëndrimi jonë është bërë i njohur edhe më parë, kështu që e kam më të lehtë t'i përgjigjem pyetjes suaj. Që ne të ulemi në bisedime, duhet që Serbia t'i njohë në një mënyrë, ose në një tjetër institucionet tona dhe këto bisedime të zhvillohen në kushte barazie të plotë. E dimë që duhet gradualitet në imponimin e këtij realiteti, por ne do ta shkurtojmë kohën e pranimit të plotë të Kosovës si shtet i pavarur nga Serbia. Ndërkohë ju e keni vënë re, që në disa raste, unë i referohem konceptit të bashkimit, apo të bashkëpunimit të faktorit mbarëkombëtar. Kam kërkuar më së fundi, një tryezë mbarëkombëtare për rrëzimin e raportit të Dik Martit, por jo vetëm për atë qëllim. Ajo tryezë, ftesa për të cilën mbetet e hapur mund të diskutonte për sfidat e tjera që ka Shqipëria, Kosova apo faktori shqiptar në përgjithësi. Edhe në lidhje me bisedimet, apo me strategjinë e njohjeve, unë jam i mendimit dhe e kam bërë të njohur nëpërmjet artikujve të ndryshëm që duhet të funksionojë një Këshill koordinues ku do të bëjnë pjesë të gjitha partitë politike apo figura të shquara nga shoqëria civile. Atdheu është i

të gjithëve, jo vetëm i partive që bëjnë pjesë në qeverisje. Më bëri përshtypje intervista e një diplomati amerikan, njohës shumë i mirë i Ballkanit si Hooper: ai nënvizonte disa nga rreziqet e këtyre negociatave, por dhe shanset që shfaqen me këto bisedime nëse Kosova do të tregonte aftësi diplomatike gjatë tyre. Jam plotësisht dakord. Ne e kemi theksuar dhe në fushatë, se do të ulëshim për bisedime duke i kërkuar Bashkimit Evropian për të hapur procesin e negociatave për vizat për qytetarët e Kosovës, njërin prej kushteve që përmendte zoti Hooper. Po ashtu dhe kushti tjetër për arritjen e njohjeve të nevojshme për anëtarësimin e Kosovës në OKB, për të cilin qëllim fola më herët.

**Bota sot: Si e shihni vendimin e qeverisë për rritjen e pagave, a vlerësoni se do të ketë mjete buxhetore qeveria e ardhshme që të përmbush këtë vendim?**

**Pacolli:** Ne e bëmë të qartë që gjatë fushatës se jetësimi i atij premtimi do ishte i vështirë për shumë arsye, jo vetëm për shkak të autoriteteve financiare ndërkombëtare që na monitorojnë. Le të shpresojmë se qeveria do të mbajë premtimet, por mbi të gjitha ne i mbetemi pikëpamjes, se nxitja e zhvillimit të vendit, mund të prodhojë rritje ekonomike, punësim dhe rritje rrogash. Zhvillimi i vendit bëhet me njerëz të ditur dhe ekspertë, të cilët i prijnë proceseve. Ne i kemi ata njerëz dhe populli i Kosovës i ka të gjitha kapacitetet për të ecur me shpejtësi përpara.

**Intervistoi:** Marie Nikolla

---

## Interesimi i studentëve më vuri në lëvizje

---

**Bota sot:** Ju sapo keni ndërmarrë një hap humanitar, që të tërhiqni me shpenzimet e juaja nga Egjipti, më shumë se 100 qytetarë të Kosovës që ndodhen atje. Cili ishte motivi që ju shtyri për këtë hap, a jeni kontaktuar nga Ministria e Jashtme dhe nëse keni pasur koordinim për këtë çështje?

**Pacoli:** Ju e dini se unë nuk kam zakon të përmend veprat e mia të mira të solidaritetit apo të bamirësisë, një pjesë e të cilave mbetet e panjohur. Por, në respekt të atyre studentëve, që më kontaktuan në telefonin tim, do sqaroja se ishte pikërisht interesimi i tyre që më vuri në lëvizje. Unë e di se sa e vështirë, sa e rrezikshme është për qytetarët tanë të gjenden në mes të një konflikti si ai që ka nisur në Egjipt. Çdo vend normal ka organizuar ura ajrore për t'i sjellë qytetarët e vet dhe ne për fat të keq nuk kemi ambasadë atje. Kështu që pa u menduar gjatë, kam organizuar stafin tim që të sjellë në Kosovë të gjithë familjet, studentët, punonjësit, etj, që gjenden në Egjipt. Po punojmë që të koordinohemi me të gjithë ata që duan të ndihmojnë në një rast të tillë.

**Bota sot:** Sa keni informacione se sa janë të rrezikuar qytetarët tanë atje apo sa janë të sigurt në këto momente?

**Pacoli:** Është e tepërt të sqaroj këtë pikë. Siç shihet nga mediat, mungesa e autoritetit në atë territor po prodhon konfliktualitet të pakontrolluar, ku asnjë i huaj nuk është i sigurt.

---

## **PDK-ja vështirë të bashkëqeverisë me dy parti shqiptare**

---

**Ditën kur mes PDK - së dhe AAK - së është lidhur marrëveshja për qeverisje të Prizrenit, lideri i AKR - së, Behgjet Pacolli, i ka dërguar sinjale kreut të PDK - së se më përpara do të qëndrojë në opozitë, sesa të heqë dorë nga marrja e Presidencës. Pa AKR - në, LDK - në dhe "Vetëvendosjen", Thaçi mund të krijojë një koalicion me vetëm 67 ulëse në Kuvend**

Bile pas atij takimi, PDK - ja pati lëshuar një komunikatë, përmes së cilës njoftonte se liderët e të dy partive kishin shprehur vullnet politik që të punojnë së bashku për formimin e qeverisë së ardhshme, menjëherë pas certifikimit rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga KQZ - ja. Pacolli të shtunën ka konfirmuar se prej atij takimi nuk ka zhvilluar më ndonjë bisedë me Thaçin për punën e koalicionit. Ai pret që të takohet javën e ardhshme pasi ta ketë kryer misionin e kthimit të 160 shqiptarëve nga Egjipti në Kosovë. Por qysh tash ai e ka të prerë qëndrimin që do ta mbajë në atë takim. Nuk e ka ndërmend të heqë dorë nga posti i presidentit. **"Nëse nuk e marr postin e presidentit, nuk hyj fare në bashkëqeverisje. Ky është qëndrim i prerë. Ju garantoj"**, ka thënë ai, përmes një bisede të shkurtër telefonike. Veç këtij posti, Pacolli ka paralajmëruar se do të kërkojë hapësirë sa më të madhe veprimi të AKR-së në qeverisje. **"Ne kërkojmë hapësirë për të vepruar, sepse nuk jemi njerëz të fjalëve, por të punës. E nëse nuk na garantohet kjo hapësirë, ne nuk kemi pse të hyjmë në bashkëqeverisje"**, është shprehur ai. Negociatat për ndërtimin e koalicionit qeverisës pritet të nisnin në fillim të javës së ardhme, atëherë kur edhe KQZ - ja do t'i certifikojë mandatet e deputetëve.

## Thaçi e Pacolli pajtohen për bashkëqeverisje

**Burime të gazetës brenda PDK - së dhe AKR - së kanë bërë të ditur se krerët e PDK - së dhe ata të AKR - së janë dakorduar në një darkë pune të bashkëqeverisin në katër vjetët e ardhshme. Në AKR kanë thënë se pjesë e marrëveshjes në parim është që Pacollit t'i takojë Presidenca, ndërsa në PDK kanë thënë të mos jenë në dijeni për këtë**

PRISHTINË, 8 SHKURT - Hashim Thaçi e Behgjet Pacolli kanë realizuar të martën mbrëma një takim joformal, në të cilin kanë vendosur përfundimisht të bashkëqeverisin në mandatin e ardhshëm. Burime të gazetës brenda PDK - së dhe AKR- së kanë bërë të ditur se krerët e të dyja subjekteve politike këtë përfundim e kanë mbërritur gjatë një darke pune. Po kështu, edhe se brenda javës ekipet që do t'i caktojnë, do të vendosin për hisen që do të ketë secili subjekt në drejtimin e institucioneve. Megjithëkëtë, këto burime nuk kanë folur me një gjuhë sa i takon çështjes nëse Thaçi është dakorduar që pjesë e marrëveshjes për koalicion të jetë që Pacolli të bëhet president i shtetit, kusht ky i AKR - së për të hyrë në qeveri. "Unë nuk jam në dijeni për një marrëveshje të tillë", ka thënë një nga nënkryetarët e PDK - së, i cili paraprakisht ka konfirmuar takimin Thaçi - Pacolli. "Mbi bazën e fuqisë politike do t'i marrim edhe obligimet secili". Por, në AKR kanë thënë diçka tjetër. "Kushti për të hyrë në koalicion me PDK - në është përmbushur. Presidenti Pacolli ka marrë garanci se do ta drejtojë shtetin deri në momentin kur të krijohen rrethanat për të garuar secili për këtë post, sepse ai do që të jetë i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli", ka thënë një nënkryetar i AKR - së. Këta zyrtarë partiakë kanë folur në kushte anonimiteti, pasi kanë thënë se nuk mund të deklarohen publikisht për një takim joformal. Gazeta ka marrë konfirmimin për mbajtjen e takimit edhe nga burime të tjera, ndërkaq zyrtarisht ai nuk është konfirmuar. Blerand Stavileci nuk e ka mohuar mbajtjen e takimit, por ka thënë të mos jetë në dijeni për realizimin e tij. Ndërkaq, gjatë ditës ai ka theksuar për media se ajo që është e sigurt, është vetëm ftesa që do t'i bëhet AKR - së për bashkëqeverisje. "Besojmë se një ftesë do t'i bëhet AKR - së. Për të tjerat do të ketë vendime meritore", ka thënë Stavileci. Postet janë çështje të diskutueshme. Posti i kryeministrit i takon kryetarit Hashim Thaçi, postet e tjera janë të negociueshme". Takimi Thaçi - Pacolli dhe qëndrimi i PDK-së për t'i bërë ftesë AKR - së, pa mohuar mundësinë e lënies së postit të presidentit kësaj partie, kanë ardhur pak orë pasi dy forumet më të larta të AAK - së, Këshilli Drejtues dhe Kryesia, vendosën që pa LDK - në të mos hyjnë në koalicion me PDK - në. Ndërkaq, pati pasuar reagimi i LDK - së, e cila në mënyrë kategorike ka mohuar mundësinë e hyrjes në një koalicion të tillë çfarë e do AAK - ja. Në rast se PDK - ja përfundimisht vendos të lidhë koalicion vetëm me AKR - në dhe me subjektet parlamentare të komuniteteve pakicë, atëherë do të jetë fare e vogël diferenca midis ulëseve që do të zënë në Kuvend deputetë të kampit të pozitës dhe ata të opozitës. PDK - ja, AKR - ja dhe subjektet e komuniteteve bashkërisht mund të kenë 61-64 deputetë, ngaqë së paku 3-6 deputetë nga komunitetet pritet të mos e mbështesin një qeveri të drejtuar nga Thaçi.

---

## **AAK-ja i “bie vijë” Hashim Thaçit**

---

**Në AAK është forcuar edhe më tepër pozicioni refuzues ndaj Hashim Thaçit kryeministër. Koalicioni me PDK - në pranohet nga AAK - ja "vetëm nëse e çojnë Thaçin në shtëpi". Ndërkohë, qarkullimi i emrave për ministra të mundshëm tashmë po shkakton trazim edhe brenda vetë PDK - së**

Edhe zyrtarisht, zyrtarët e AAK-së kanë thënë se qëndrimi i tyre është kundër Thaçit kryeministër. I kontaktuar nga sekretari i përgjithshëm i partisë, Burim Ramadani, ka përsëritur se Aleanca nuk ka ndryshuar qëndrim. "Ne besojmë se zgjidhja më e mirë është koalicioni i gjerë. Në çfarëdo kombinimi, AAK - ja nuk do të jetë pjesë e një Qeverie kryeministër i së cilës është Hashim Thaçi". Pozicionin e AAK - së kundër Thaçit e kanë konfirmuar edhe disa burime tjera nga kreu i partisë së Haradinajt, një prej të cilëve u shpreh se në AAK, PDK - së i është "rënë vijë". Vetëm nëse e çojnë Thaçin në shtëpi, ndërro puna", tha ky burim nga AAK - ja.

### **Trazohen shpirtrat në PDK**

Ndërkohë, edhe në Partinë Demokratike të Kosovës, me gjithë fitoren zgjedhore, shpirtrat duket të jenë të trazuar. Qëndrimi kundërshtues i AAK - së, por edhe publikimi i një liste të ministrave të mundshëm nga një e përditshme e afërt me struktura të PDK së, nuk e ka lënë të qetë të hënën as partinë e Hashim Thaçit. Burime të gazetës kanë shpjeguar se publikimi i emrave për ministra, duke përfshirë edhe atë të ish shefit të SHIK - ut, Kadri Veseli, ka zgjuar pakënaqësi brenda dhe jashtë partisë, aq sa PDK - ja është detyruar që t'i mohojë informacionet e tilla edhe nëpërmjet një komunikate. Komunikatën për media, PDK - ja e ka përdorur për dy qëllime: ajo ka mohuar zërat për ministrat e rinj, por edhe ka qartësuar se ende nuk i ka bërë ofertë asnjë partie. "Deri më tani, Partia Demokratike e Kosovës nuk i ka bërë ofertë zyrtare asnjë partie parlamentare dhe nuk ka zhvilluar asnjë takim formal me cilëndo prej tyre për të diskutuar krijimin e koalicionit të ardhshëm qeverisës, thuhet në komunikatën e kësaj partie. Partia Demokratike e Kosovës njofton opinionin publik se duke respektuar të gjitha procedurat demokratike, të parapara me Kushtetutë dhe me ligjet në fuqi, si edhe pas çertifikimit të rezultateve zgjedhore, do të procedojë menjëherë me aktivitete konkrete në funksion të krijimit të Qeverisë së re dhe institucioneve të tjera të Republikës së Kosovës", thuhet në komunikatën e partisë së Thaçit, ku shtohet se takimet zyrtare do të ndodhin vetëm pas çertifikimit të rezultateve zgjedhore. Partia, megjithatë, është përkujdesur që në fund të deklaratës të kujtojë se mandatar për krijimin e Qeverisë së ardhshme është Hashim Thaçi, heqja e të cilit është vënë kusht nga AAK - ja. "Si gjithmonë, Partia Demokratike e Kosovës do të jetë e hapur dhe transparente në të gjitha veprimet e saj dhe me kohë do të njoftojë opinionin publik rreth hapave të ardhshëm të mandatarit për krijimin e Qeverisë së re, z. Hashim Thaçi, si edhe për zhvillimet konkrete për konsolidimin e institucioneve të reja, që pritet të ndodhin në ditët e ardhshme", thuhet në komunikatë. I nominuari nga PDK - ja për kryeministër, Hashim Thaçi, ditë më parë, ka deklaruar se i ka numrat e deputetëve për të qeverisur vendin dhe se Qeverinë e re do të krijojë që në javën e parë pas çertifikimit të rezultateve. KQZ - ja të hënën i ka çertifikuar rezultatet e zgjedhjeve, e Thaçi ka afat që 15 ditë pasi të mandatohet për kryeministër të arrijë marrëveshjen e koalicionit. Ajo që faktori ndërkombëtar tashmë ka deklaruar se nuk e preferon

është një koalicion mes PDK – së, AKR - së dhe komuniteteve me pakicë. Ndërkombëtarët duan të paktën edhe dy parti të tjera shqiptare në koalicion. Duke e pasur më të vështirë një koalicion me LDK - në apo "Vetëvendosjen", AAK - ja i ka mbetur opsioni i vetëm Thaçit. Por për të shprehur frymën në AAK kundër mandatarit për të krijuar Qeverinë në frymën e re, është perkujdesur zëdhënësi i kësaj partie, Ernest Luma. "S'ka koalicion me Pinokion, pinokiot dhe pinochetat", ka shkruar Luma në adresën tij të rrjetit social Facebook, duke iu referuar premtimit të Thaçit për ngritje të pagave, zbatimi i të cilit u shty javën e kaluar nën presionin ndërkombëtar.



---

## Shpresat e Thaçi, te Pacolli e minoritetet

---

**AAK-ja ia ka kufizuar mundësitë PDK-së që të llogarisë në numrat e deputetëve të saj. Ka thënë se do të hyj në Qeveri vetë nëse hyn LDK-ja. E kjo e fundit, sikur "Vetëvendosja", s'e ka ndërmend ta bëjë një gjë të tillë. Opsion ka mbetur vetëm AKR-ja dhe minoritetet. Por, edhe me AKR-në ekziston një kusht. Duhet bindur Pacolli që të mos zgjidhet president shteti**

PRISHTINË, 8 SHKURT - Të nominuarit të PDK-së për kryeministër të Kosovës, Hashim Thaçi, i ka mbetur qe t'i orientojë energjitë në drejtim të krijimit të partneritetit qeverisës me AKR - në dhe me minoritete, pasi partia e Ramush Haradinajt, përfundimisht, ka vendosur që të mos bëhet pjesë e pushtetit nëse aty nuk është edhe LDK - ja. E kjo e fundit tashmë është përcaktuar se do të qëndrojë në opozitë derisa të vijë zgjedhjet e ardhshme nacionale. Thaçi në fakt nuk do ta ketë të lehtë që ta konkretizojë as formulën PDK - AKR minoritete, pasi sipas disa burimeve të gazetës ai duhet ta bindë liderin e AKR - së, Behgjet Pacolli, që të heqë dorë nga zgjedhja president shteti. "Për PDK - në nuk do të jetë problem nëse Presidencën e merr AKR - ja. Puna është se një pjesë e faktorit ndërkombëtar sugjeron që Pacolli të mos jetë njeriu i parë i shtetit", ka thënë një zyrtar i lartë i PDK - së. Mirëpo Pacolli është shprehur në mënyrë të prerë se nuk e ka ndërmend të lëshojë pe kur është fjala te ky post. **"Nëse nuk e marr postin e presidentit nuk hyj fare në bashkëqeverisje. Ky është qëndrim i prerë. Ju garantoj"**, ka thënë ai për "Kohën Ditore". Për t'u vënë në krye të shtetit, ai e ka mbështetjen edhe të organeve drejtuese të partisë. Nuk besoj se ka njerëz në AKR që do të pranonin të bëheshin president derisa Pacolli e drejton partinë. Ai edhe ashtu është personi më adekuat për ta kryer këtë funksion, ka deklaruar nënkryetari i AKR - së, Ibrahim Makolli. Një Qeveri e krijuar nga PDK - ja, AKR - ja dhe minoritetet nuk do të ketë mbështetje të madhe parlamentare. Do të jenë në maksimum 63 deputetë, ata që do ti shtynin përpara projektet qeveritare. PDK-ja i ka 34 deputetë, AKR - ja tetë, kurse minoritetet pa JSL-në, e cila është deklaruar kundër hyrjes në koalicion, i kanë bashkërisht 21 deputetë. Drejtuesit e AKR - së, megjithatë, do të jenë të parët që do të marrin ftesë nga lideri i PDK se për të biseduar rreth krijimit të koalicionit qeverisës. Këtë fakt e ka bërë publik zëdhënësi i PDK - së, Blerand Stavileci, i cili ka njoftuar se për ftesat e partive të tjera do të vendoset në mbledhjen që do ta mbajë Kryesia e PDK - së, të mërkurën. Stavileci ka ripërsëritur qëndrimin e partisë që përveç postit të kryeministrit, të gjitha postet e tjera do të jenë të negociueshme me partnerët e ardhshëm qeverisës. Ai ka përjashtuar mundësinë që PDK - ja të hyjë në selektime të emrave që mund të propozohen në poste të caktuara nga partitë prej nga ata vijnë, duke përfshirë edhe emrin e Pacollit si president. Stavileci është shprehur i habitur me qëndrimin e AAK - së për të mos hyrë në qeverisje pa LDK - në. "Së pari na habit fakti se ata në një mënyrë e luajnë avokatin e LDK - së, e së dyti na habit fakti se ata nuk e kuptojnë se subjektet politike që kanë pasur tkurrje të elektoratit zgjedhor, nuk mund ta marrin primatin dhe të vënë rregulla dhe kushte për krijimin e Qeverisë", është shprehur Stavileci.

## **Brishtësia institucionale**

Për rrethanat aktuale një koalicion i tillë nuk mund të konsiderohet si i qëndrueshëm, mirëpo, PDK - së në fakt i janë kufizuar mundësitë e kalkulimeve shtesë. Partia që ka dalë fituese në zgjedhjet e 12 dhjetorit është duke u përballur edhe me tensione të brendshme, pasi një pjesë e zyrtarëve të lartë të saj, nuk dëshirojnë që të mbesin jashtë Qeverisë dhe institucioneve të tjera qendrore. Burime brenda kësaj partie kanë konfirmuar se tensionet në PDK vijnë si refleksion i "inJORIMIT", që po u bëhet nga Thaçi në këtë proces. "Disa figura qendrore të partisë ende nuk e kanë idenë se kush ku do të mbetet dhe natyrisht secili prej tyre ka arsye që të ndihet i shqetësuar për fatin e vet", ka thënë një nga anëtarët e Kryesisë së PDK - së. Një mbledhje e të zgjedhurve të PDK - së, megjithatë, është mbajtur të martën, ndonëse jo në seli të partisë. "Kemi drekë dhe asgjë tjetër", ka thënë nënkryetari i partisë, Hajredin Kuçi, duke mos dhënë asnjë shpjegim shtesë: Me të hapur për takimin e tyre janë treguar drejtuesit e AAK - së, Këshilli Drejtues dhe Kryesia e kësaj partie, në një mbledhje të përbashkët, që ka mbajtur një ditë pasi janë kthyer tre zyrtarët e kësaj partie nga vizita që i kanë bërë kryetarit Haradinaj në Hagë, ka dalë me vendimin se në interes të Kosovës, do të ishte sikur Qeveria të ndërtohej sipas formulës PDK LDK - AAK . Këtë ide për herë të parë e pati ngritur muajin e kaluar nënkryetari i kësaj partie, Blerim Shala. Këtë e ka ripërsëritur edhe anëtari i Kryesisë së AAK - së, Besnik Tahiri. "Këshilli Drejtues dhe Kryesia e AAK - së janë të bindur se rrugëdalja më e mirë në rrethanat e sotme në Kosovë, është krijimi i koalicionit të gjerë midis PDK - së, LDK - së dhe AAK - së, si mundësi e vetme për të tejkaluar situatën e rëndë në të cilën gjendet Kosova. Në një përbërje të tillë, AAK - ja do të jepte kontributin e vet për të stabilizuar shtetin e Kosovës, për të tejkaluar ngërçin politik, për të përmirësuar kornizën ligjore zgjedhore dhe për të vendosur sundimin e ligjit në prioritet të pashmangshëm", ka thënë ai. "Në rast të mos mbështetjes së këtij propozimi nga subjektet tjera politike, Këshilli Drejtues dhe Kryesia e AAK - së vendosin që AAK - ja përfundimisht të qëndrojë në opozitë parlamentare", ka shtuar ai. Tahiri e ka pranuar se ende nuk kanë marrë kurrfarë ftese nga PDK - ja, por ka thënë se AAK - ja është e gatshme që t'i tejkalojë interesat e ngushta, për hir të stabilitetit institucional të vendit. Ai ka rikujtuar se Kosova ka hyrë në muajin e dytë të vitit pa buxhet të miratuar, me bllokadë të investimeve kapitale dhe investimeve të jashtme, me telashe për ti siguruar pagat e punonjësve të sektorit publik, me imazh të dëmtuar, dhe me mbi të gjitha pret që të hyjë në bisedime me Serbin. "Kur i kemi parasysh këto probleme atëherë duhet të dalim përtej vetvetes..."

## **Feith: Nuk përzihehi në formimin e koalicionit qeverisës**

**Siç e dini, ka pritje për dialog me Beogradin dhe është edhe raporti i Martyt. Ky është një argument për një qeveri me përfshirje më të gjerë për të pasur një konsensus më të gjerë që do të reflektonte mbi këtë gjendje, duke përfaqësuar një bazë më të gjerë votuesish. Por mbetet të shihet se sa e gjerë do të mund të ishte një qeverisje e tillë. Pra, i takon për momentin liderit të partisë më të madhe politike që të gjejë partnerë. Nëse kjo nuk jep fryt, ndonjë zgjidhje tjetër duhet të kërkohet, thotë Feith**

BRUKSEL, 8 SHKURT - Përfaqësuesi civil ndërkombëtar në Kosovë, Peter Feith, mori pjesë të martën në takimin e 12 - të të Grupit Drejtues Ndërkombëtar në Bruksel, në të cilin u ripërsërit mbështetja e këtij grupi për punën e Zyrës së tij në mbështetje të forcimit të shtetit të Kosovës dhe implementimin e Pakos të Ahtisarit. Në një intervistë për "Kohën Ditore" pas këtij takimi Feith në fillim flet për rezultatet kryesore të këtij takimi në Bruksel të përfaqësuesve të vendeve të këtij Grupi.

**Feith:** Patëm së pari një raportim për punën e institucioneve të Kosovës të prezantuar nga zëvendësministrja në largim, Vlora Çitaku, dhe ky raport u mirëprit nga të pranishmit. U përsërit mbështetja e fuqishme që Grupi Drejtues Ndërkombëtar i jep pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës. Diskutuam edhe disa çështje të veçanta, njëra prej të cilave është e ardhmja e Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO) dhe e dyta si do t'i përshtatet ICO - ja pranisë se BE se në terren në Kosovë.

**KD:** BE - ja nuk e ka ndarë mendjen se çfarë pranie dëshiron të ketë në Kosovë. A ka ky Grup drejtues qëndrim të qartë se a duhet mbajtur postin përfaqësuesit civil ndërkombëtar lidhur me dy kapela apo tri me BE – në?

**Feith:** Po ky Grup ka thënë qartë që ICO - ja të vazhdojë të punojë në detyrat që kanë mbetur për t'u bërë. Unë përmenda se një prej detyrave parimore që shohim para vetes është veriu dhe mbajtja e zgjedhjeve në Mitrovicë. Ky Grup ka marrë në dijeni edhe qëllimin që të zvogëlohet prania e ICO - së, në njerëz dhe resurse, sepse shumë prej punëve tashmë janë kryer.

**KD:** Kur thoni zgjedhje në veri, në çfarë mendoni, në zgjedhje të veçanta në atë pjesë apo çfarë?

**Feith:** Jo, ajo që mendoj është vazhdimi i procesit të decentralizimit. Ajo që kishte filluar kohë më parë në Komunën e Mitrovicës së jugut me zgjedhjet lokale në një moment në të ardhmen duhet të zgjerohet edhe në veri.

**KD:** Cila ishte në këtë takim pozita e Grupit Drejtues Ndërkombëtar rreth dialogut mes Kosovës dhe Serbisë dhe rreth mundësisë që statusi apo ndarja të jenë në tryezë të dialogut?

**Feith:** Është e qartë se ka unanimitet mes vendeve të Grupit që këto të mos jenë tema të diskutimeve.

**Koha:** Po çfarë mendojnë vendet e BE -së për këtë, sepse në BE ka shtete që nuk e njohin Kosovën!

**Feith:** Nuk mund të flasë në emër të të gjitha vendeve të Bashkimit Evropian, sepse janë disa të cilat nuk janë pjesë e Grupit Drejtues Ndërkombëtar, sepse nuk e kanë njohur Kosovën. Nuk kam qëndrim rreth qëndrimit të tyre, sepse u takon atyre ta shprehin. Ajo që them është se anëtarët e këtij Grupi janë të qartë dhe të prerë në qëndrimin se integritetit territorial dhe sovraniteti i Kosovës duhet të respektohen dhe çështja e statusit nuk mund të hapet për negociim në dialog.

**KD:** Ka pasur paralajmërime se ju, si ICR, do të duhet të anuloni vendimin e qeverisë për rritjen e pagave. A është diskutuar kjo në këtë takim në Bruksel?

**Feith:** Nuk është diskutuar në detaje kjo, por të gjitha vendet anëtare të këtij grupi njëzëri ndajnë qëndrimin se disiplina fiskale duhet të ruhet dhe çfarëdo rritjeje e pagave duhet t'i nënshtrohet së pari konsultimeve me Fondin Monetar Ndërkombëtar e pastaj duhet të shqyrtohet nga Kuvendi. Pra kemi këtu një çështje fiskale por edhe ligjore, sepse ende kemi vetëm një qeveri në largim dhe çfarëdo vendimi buxhetor duhet të miratohet nga ana e Kuvendit të Kosovës.

**KD:** Duket se rreth formimit të qeverisë ka më shumë optimizëm në Bruksel sesa në Kosovë ku sot AAK -ja e Ramush Haradinajt ka hedhur poshtë mundësinë e lidhjes së koalicionit me PDK - në, nëse Hashim Thaçi do të ishte kryeminister?

**Feith:** Ky ishte një lajm i ri i sotëm. Por përsëri mendoj se më e rëndësishme është se Grupi shprehet se u takon partive politike në Kosovë të merren me këtë dhe të gjejnë një zgjidhje.

**KD:** Por duhet të gjejnë një zgjidhje përbrenda kornizave që faktori ndërkombëtar i ka caktuar, duke u shprehur se kush mund e kush jo të jetë në qeverinë e ardhshme?

**Feith:** Kjo nuk është thënë lidhur me atë se cilat parti politike mund të përfshihen. Është më shumë e lidhur me personalitete, ndërsa cilat parti mund të përfshihen kjo është çështje që liderët politikë duhet të vendosin.

**KD:** Duke marrë parasysh rrethanat, dialogun me Beogradin, raportin e Dick Martyt që keqësoi imazhin e Kosovës, a do të ishte më mirë që Kosova të kishte një qeveri me përfshirje më të gjerë apo një qeveri me një opozitë shumë të fortë?

**Feith:** Nuk dua të jem tepër përshkrues në këtë aspekt. Siç e dini, ka pritje për dialog me Beogradin dhe është edhe raporti i Martyt. Ky është një argument për një qeveri me përfshirje më të gjerë për të pasur një konsensus më të gjerë që do të reflektonte mbi këtë gjendje, duke përfaqësuar një bazë më të gjerë votuesish. Por mbetet të shihet sesa e gjerë do të mund të ishte një qeverisje e tillë. Pra, i takon liderit të partisë më të madhe politike që të gjejë partnerë. Nëse kjo nuk jep fryt, ndonjë zgjidhje tjetër duhet të kërkohet.

**KD:** - A do të përfshihen përfaqësuesit e pakicave në qeveri?

**Feith:** Sa di unë po

**KD:** Të gjitha?

**Feith:** Nuk e di a do të jenë të gjitha apo shumë prej tyre. Prapë duhet t'ju rikujtoj se ne qëndrojmë jashtë kësaj. Unë nuk jam UNMIK dhe marr një qëndrim më në distancë rreth kësaj.

**KD:** Si komentoni faktin se LDK - ja dhe AAK - ja kanë pranuar rezultatin e zgjedhjeve, edhe pse mendojnë se ka pasur manipulime në to?

**Feith:** Mendoj se kjo është një qasje pozitive dhe konstruktive. Por mund të ketë probleme të tjera. Pra, kur doni të formoni qeveri duhet të pajtoheni edhe rreth programit e jo vetëm rreth personave dhe çështjes se si të ndahen ministritë. Pra, partitë politike duhet të shohin programet e tyre dhe të shohin se çfarë i bashkon ato dhe çfarë i ndan në substancë e vetëm atëherë të mendojnë për ndarjen e posteve. Besoj se një gjë e tillë duhet të ndodhë sa më shpejt.

---

## Lëkundjet e Pacollit

---

**Pas zgjedhjeve të vitit 2007, Behgjet Pacolli thotë se nuk kishte pranuar të bëhej kryetar i Kosovës, për faktin se partia e tij kishte fituar vetëm 13 % të votave të përgjithshme. E tani, ai dëshiron të bëhet president me vetëm 8 % të mbështetjes së qytetarëve**

PRISHTINË, 9 SHKURT - Para tre vjetësh, biznesmenit Behgjet Pacolli i ishte ofruar shansi të bëhej president shteti. Nuk e kishte pranuar këtë post për një arsye të thjeshtë. Partia e tij nuk ishte ndarë mirë në zgjedhjet nacionale. Kishte marrë vetëm 13 % të votave të elektoratit. E për Pacollin, kjo kishte mjaftuar për t'i thënë: "Jo", pa asnjë mëdyshje, ofertës që i ishte bërë nga lideri i PDK - së, Hashim Thaçi. Këtë detaj, ai e shpalos në librin autobiografik "Nga sfida në sfidë, jeta Behgjet Pacolli", të cilën e ka botuar më 11 dhjetor të vitit të kaluar, pikërisht në ditën e heshtjes zgjedhore. Atë moment, ai e përshkruan kështu: "Thaçi më bëri një ofertë për koalicion, por unë kam refuzuar. I kam thënë decidivisht: -Harroje AKR - në, harroje Behgjet Pacollin, ti duhet të bësh koalicion të tillë për Kosoven, i cili favorizon stabilitetin dhe konsensusin sa më të madh rreth proceseve në Kosovë. Në këtë kuadër më është përmendur oferta që unë të bëhesha kryetar i Kosovës, por për mua kjo ishte diçka papranueshme, sepse me 13 % të votave nuk mund të bëhesha njeriu i parë në Kosovë", (lexo: faqe 422). Pacolli, aty e pranon se nuk do të sillej asisoj sikur partia tij të kishte fituar më shumë vota. "Po t'i kisha fituar, ta zëmë 30% atëherë do të kisha biseduar ndryshe. Këtë ia kam thënë kryeministrit Hashim Thaçi asokohe" shkruan më tej në libër. Por, Pacolli tash mendon ndryshe nga ajo që vullnetshëm e ka vënë në letër vetëm dy muaj më përpara. Tash ai dëshiron me çdo kusht që të bëhet president, ani se partia e tij ka pësuar rënie të fuqisë elektorale. Nga 13 % ka rënë në 8 %.

**"Nëse nuk e marr postin e presidentit nuk hy fare në bashkëqeverisje. Ky është qëndrim i prerë. Ju garantoj"**, ka thënë ai, në fund të javës së kaluar. E këmbëngulësia e tij, e ka vënë në pozicion të palakmueshëm Thaçin, i cili sërish pretendon të bëhet kryeministër i Kosovës. Atij, tani i duhet ta bindë Pacollin që të heqë dorë nga të zgjedhurit president, për faktin se një pjesë e faktorit ndërkombëtar, nuk e preferon atë në krye të Kosovës. Veç kësaj, Thaçi ka presion edhe nga struktura të caktuara të partisë së tij, që postin e presidentit ta mbajë PDK - ja.

### Dy takime

Thaçi e Pacolli, në fakt, janë takuar dy herë nëpër restorante të Prishtinës, për të biseduar rreth çështjes së ndërtimit të koalicionit qeverisës, por, nuk kanë arritur ndonjë rezultat konkret në kontekst të zgjedhjes së kandidatit për president. Zyrtaret e AKR - së e shohin shefin e tyre si njeriun e duhur për ta udhëhequr shtetin në këtë kohë. Ata as që e paramendojnë që dikush brenda AKR - së të mund të bëhej president, derisa Pacolli të jetë president partie. "Pacolli mund ta përfaqësoj Kosovën në mënyrë të denjë kudo nëpër botë. Ai si kryetar partie ka arritur të takohej me më shumë burrshtetas botë, sesa presidentët e zgjedhur", ka thënë një nga drejtuesit e AKR - së. Duke mos parapëlqyer t'i përmendej emri në gazetë, ai e ka arsyetuar lëkundjen e qëndrimeve të Pacollit, me vullnetin e strukturave drejtuese të partisë. "Ne jemi ata që kemi thënë se Pacolli duhet të zgjidhet president, nëse Thaçi dëshiron të ndërtojë koalicion me ne. Përndryshe, Pacolli, nuk ka insistuar vetë që të bëhet president, sepse, nuk i

konvenon shumë ky post", ka shtuar ky zyrtar. Por, lideri i AKR - së, ka bërë dhe lëkundje të tjera në qëndrime. Ai i ka rënë pishman një premtimi që ua kishte dhënë simpatizantëve të tij ditën përmbyllëse të fushatës elektorale për zgjedhjet e 12 dhjetorit. "Unë do të jem president i Kosovës vetëm atëherë kur do të zgjidhem nga vota e qytetarit, e kurrsesi nga pazarlleqet politike e partiake". E tash, biznesmeni – politikan dëshiron të marrë këtë post, pa pritur ndërrimin e sistemit sa i takon zgjedhjes së presidentit.

### **Ashtu kam thënë**

Pacolli e ka pranuar se e ka thënë këtë gjë, por ka insistuar të ketë thënë edhe të tjera fjali, që nënkuptojnë se ai do të zgjidhej president edhe nga Kuvendi, në mënyrë që menjëherë të iniciojë çështjen e ndryshimit të Kushtetutës. **"Ashtu kam thënë por e kam plotësuar se nëse do të jem president, për një kohë të shkurtër do të kërkoj ndryshimin e Kushtetutës dhe të rikthehem unë bashkë me të tjerët që populli të mund të zgjedhë presidentin e Kosovës me votën e vet"**, ka thënë ai për "Kohën Ditore", ditë më herët. Pacolli ka qenë i nominuar i AKR-së për president, parti të cilën e udhëheq prej 2006-s. Subjekti politik i tij, aktualisht shihet si partneri më i mundshëm i partisë që rezultatet preliminare e kanë nxjerrë fituese të zgjedhjeve PDK-në. Do të jetë partia e parë që do të marrë ftesë nga i nominuari i PDK - së për kryeministër, Hashim Thaçi, për të diskutuar rreth ndërtimit të koalicionit qeverisës. Në AKR janë të përgatitur për këtë takim, por nuk janë të gatshëm që të heqin dorë nga kërkesa që Pacolli të bëhet president.

---

## **AKR: Pacolli president, pastaj qeveria**

---

**Zyrtarë të AKR-së i kanë ashpërsuar kushtet për të hyrë në koalicion. Përpos që kërkojnë postin e presidentit për Behgjet Pacollin, thonë se ai duhet të mandatoj kandidatin për kryeministër**

PRISHTINË - Vetëm pak orë pasi Këshilli Drejtues i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i dha "shuplakë" Partisë Demokratike të Kosovës, duke ia bërë të qartë se ata në asnjë mënyrë nuk do të hyjnë në një qeveri, ku Thaçi do të jetë kryeministër, edhe partneri i vetëm potencial për të hyrë në koalicion, AKR-ja e Behgjet Pacollit i ka ashpërsuar kushtet e saj. Zyrtarë të lartë të kësaj partie kanë thënë se përveç kushtit që kreu i partisë, Behgjet Pacolli të jetë president i vendit, ata kërkojnë që pas konstituimit të Kuvendit të Kosovës, të zgjidhet presidenti, i cili pastaj do të mandatojë kandidatin për kryeministër. Ngase, sipas tyre, ushtruesi i detyrës së presidentit, Jakup Krasniqi nuk e ka mandatin që ta bëjë atë. Zëvendëspresidentja e Aleancës Kosova e Re, Mimoza Kuasri-Lila i ka thënë "Zërit" se kjo parti nuk ka bërë asnjë lëvizje sa u përket kushteve për koalicionin e ardhshëm qeverisës. "Kushtet tona janë ato që kanë qenë edhe më herët pavarësisht nëse në qeveri do të hynte apo jo AAK-ja. Kushtet kanë të bëjnë me hapësirën për zbatimin e programit qeverisës dhe me marrjen e postit të presidentit dhe të dikastereve që janë shumë të rëndësishme për ne si parti", ka thënë Kusari-Lila. Kushti tjetër i AKR-së, sipas saj, është që menjëherë pas konstituimit të Kuvendit, të zgjidhjet presidenti i ri, në këtë rast Pacolli, i cili edhe do ta nominonte mandatarin për formimin e qeverisë. "Ne e dimë se Jakup Krasniqi është ushtrues detyre i presidentit të Kosovës, dhe si u.d. nuk ka mandat që ta nominojë dikë për ta themeluar qeverinë e re", ka thënë ajo. Mirëpo, sipas Kushtetutës së Kosovës, thuhet se presidenti (pa e precizuar nëse këtë mund ta bëjë edhe ushtruesi i detyrës) i Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për kryeministër. "Pas zgjedhjeve, presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë", thuhet në nenin 95 pika 1 e Kushtetutës së Kosovës. E pyetur se nëse Pacolli nuk do të pranohet nga PDK-ja si kandidat për president, pasi në medie është apostrofuar së është i pa dëshiruar për disa nga vendet e Quint-it, a do të hyjë AKR-ja në qeveri, Kusari-Lila ka thënë se "kreu i partisë është njeriu më i duhur dhe më kredibil që ka Kosova për president të vendit". Partia Demokratike e Kosovës, si partia fituese e zgjedhjeve, pas refuzimit që i ka bërë AAK-ja e Ramush Haradinajt për të hyrë në koalicion, si partneri i vetëm që i ka mbetur për ta bërë koalicionin është AKR-ja. Ndërkohë, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje tashmë janë shprehur shumë qartë se nuk do të hyjnë në kurrfarë koalicioni me PDK-në. Ndryshe, sipas Kushtetutës së Kosovës, "zgjedhja e presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit". Po ashtu, sipas aktit më të lartë juridik në vend, nëse pas dy raundeve kandidati për president nuk i merr dy të tretat e votave, atëherë organizohet votimi i tretë. "Nëse në votimin e tretë, asnjëri kandidat nuk zgjidhet president i Republikës së Kosovës, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda dyzet e pesë ditësh", thuhet në nenin 86 pika 6 e Kushtetutës së Kosovës.



## **KRASNIQI S'KA MANDAT**

Kushti tjetër i AKR-së, sipas Kusarit është që menjëherë pas konstituimit të Kuvendit, të zgjidhjet presidenti ri, në këtë rast Pacolli, i cili edhe do ta nominonte mandatarin për formimin e qeverisë. "Ne e dimë se Jakup Krasniqi është ushtrues detyre i presidentit të Kosovës, dhe si u.d. nuk ka mandat që ta nominojë dikë për ta themeluar qeverinë e re", tha ajo.

---

## Tensione në PDK për postin e presidentit

---

**Burime të besueshme të "Kohës Ditore" kanë treguar se janë 8 deri në 10 deputetë të PDK-së që nuk do ta votonin Pacollin për president. Kjo, për shkak se duan që posti i kreut të shtetit t'i takojë Jakup Krasniqit. Ata llogarisin që kandidatura e Krasniqit do të merrte mbështetje edhe nga deputetët e LDK-së dhe të AAK-së, për faktin se ai është përpjekur që të jetë parimor gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare**

“Të gjitha këto çështje do të jenë të biseduara dhe të negociuara gjatë bisedave dhe negociatave zyrtare. Ne vazhdimisht kemi deklaruar se në këtë moment e vetmja gjë e sigurt është posti i kryeministrit, e të tjerat janë të diskutueshme dhe të negociuara". Pavarësisht këtyre qëndrimeve zyrtare, burime të gazetës brenda PDK-së kanë bërë të ditur të mërkurën se kjo parti llogarit në mbështetjen e 65 deputetëve. Kjo ngaqë, sipas këtij burimi, koalicioni qeverisës do të përbëhet nga 34 deputetë të PDK-së, 8 të AKR-së, 1 i listës "Dr. Ibrahim Rugova" dhe 22 të subjekteve të komuniteteve pakicë. Ky burim nuk ka qenë në gjendje të saktësojë se cila do të jetë pjesa në vendimmarrje për secilin subjekt që përbën koalicionin. Bazuar në qëndrime të mëhershme publike, AKR - ja ka kushtëzuar pjesëmarrjen në qeveri me garantimin e postit të presidentit të shtetit për Behgjet Pacollin dhe me disa ministri, SLS - ja ka shprehur synime për të pasur më shumë se dy ministri, ndërsa grupi parlamentar 6+ është deklaruar se do më shumë se një ministri. Por, problemi qëndron tek posti i presidentit. Zgjedhja e tij bëhet në mënyrë të fshehur dhe për t'u votuar një kandidat nevojiten minimum 61 vota, dhe madje në raundin e tretë të votimit. Burime të gazetës kanë bërë të ditur se AKR - ja po insiston që në marrëveshje të precizohet që së pari të zgjidhet presidenti e pastaj qeveria. Kjo ngaqë, sikur së paku 5 deputetë të PDK - së të mos e votojnë Pacollin për president, apo cilindo kandidat tjetër të AKR - së, atëherë ky subjekt mbetet pa njërin prej pozitave kryesore të udhëheqjes së shtetit. Po sipas këtyre burimeve, në PDK insistojnë që fillimisht të zgjidhet Qeveria, e zgjedhja e presidentit të lihet deri në mars. E megjithë këtë, në PDK llogarisin në votat e AKR - së. Zëdhënësi Blerand Stavileci ka thënë se prej ditës së publikimit të rezultateve e dinë se mund ta bëjnë shumicën në Kuvend. "Ne i kemi numrat e mjaftueshëm. Ka qenë një orientim tjetër për të pasur një qeveri me përfshirje më të madhe, por sido që të jetë, që nga dita e parë ne i kemi pasur numrat", ka thënë Stavileci. "Numrat i kemi nëse shikoni mirë, e shikoni përbërjen e Kuvendit, i shihni minoritarët, e shihni AKR-në dhe subjektet e tjera. Pra, shihet saktësisht cila do të jetë mazhoranca".

---

## **Pacolli ende s'lëshon pe për Presidencën**

---

**Menjëherë pasi Kryesia e PDK - së ka vendosur që AKR - së t'i bëhet ftesë për koalicion, kanë qenë Thaçi, Kuçi e Limaj që janë pritur në rezidencën e kreut të AKR - së nga Pacolli, Agani, Çeku e Mustafa. Nuk është nxjerrë ndonjë përfundim nga takimi, ngaqë zyrtarët e PDK - së i kanë ofruar AKR-së postin e kryetarit të Kuvendit, të zëvendëskryeministrit dhe katër ministri, por jo edhe shumë të dëshirueshmen nga Pacolli, Presidencën**

PRISHTINË, 10 SHKURT - Partia Demokratike ka vendosur të enjten pasdite t'i bëjë ftesë për bashkëqeverisje vetëm Koalicionit për Kosovë të Re, pa përfshirë në ofertë Presidencën. Vendimi është marrë nga Kryesia e PDK – së, e cila ka qenë e ndarë sa i takon çështjes se kujt duhet takuar Presidenca. Dallimet janë shfaqur midis kreut të PDK - së, Hashim Thaçi, që ka mbështetjen e shumicës së Kryesisë, dhe nënkryetarit të kësaj partie. Fatmir Limaj, i cili tok me 8-10 deputetë duan që presidenti t'i takojë PDK – së, më saktësisht Jakup Krasniqi. Megjithatë, Hashim Thaçi e Fatmir Limaj kanë hyrë bashkë në një veturë, pasi kanë dalë nga mbledhja e Kryesisë. As njëri e as tjetri nuk u janë përgjigjur pyetjeve të gazetareve rreth dallimeve në këtë pikë, e që Pacollit pastaj i është përcjellë ajo çfarë ka kërkuar kampi i Limajt. Kaloni mirë, kaloni mirë", ka përsëritur Thaçi, teksa ka hipur në pjesën e pasme të veturës me Hajredin Kuçin, ndërsa Limaj ka pritur derisa është liruar rruga nga gazetaret e shumtë për t'u vendosur në ulësen e përparme të së njëjtës veturë, përkrah shoferit. Burime të gazetës kanë bërë të ditur se kreu PDK - së, Thaçi, me dy nënkryetarët e partisë, Limajn e Kuçin, kanë udhëtuar menjëherë për në rezidencën e Pacollit. Pos kreut të AKR - së, aty zyrtarët e PDK - së janë pritur edhe nga liderët e subjekteve që përbejnë Koalicionin për Kosovë të Re, Ferid Agani. Agim Çeku e Muhamet Mustafa. Fundi i takimit nuk ka prodhuar rezultat, ngaqë zyrtarët e lartë të PDK - së nuk kanë arritur ta bindin Pacollin që të lëshojë pe për postin e presidentit. "Oferta nuk ka përmbajtur postin e presidentit, prandaj nuk është arritur në këtë takim finalizimi i marrëveshjes", ka thënë një zyrtar i PDK - së në kushte anonimiteti. Kreu i PDK - së, Hashim Thaçi, ia ka ofruar Pacollit postin e kryetarit të Kuvendit, të zëvendëskryeministrit dhe katër ministri, ofertë që është refuzuar nga AKR - ja. Në AKR ndërkaq nuk kanë thënë që Presidenca të mos i është ofruar Pacollit, që është kusht i këtij subjekti për të hyrë në parti, mirëpo kanë thënë se oferta ka qenë e papranueshme. "Ajo çfarë është prezantuar nuk ka qenë e mjaftueshme as për së afërmi për ta finalizuar marrëveshjen", ka thënë një nënkryetar i AKR - së. "Oferta tash për tash është e papranueshme". Kjo nuk është konfirmuar nga zyrtarë partiakë. I kontaktuar nga gazeta në orët e vona, anëtari i Kryesisë së PDK - së, Memli Krasniqi, nuk ka konfirmuar, por as mohuar, këto informacione jozyrtare. Ndërkaq Krasniqi ka qenë njeriu që ka kumtuar vendimin e PDK - së për nisjen e negociatave zyrtare me Pacollin, ani se nuk ka qenë në gjendje menjëherë pas mbledhjes së Kryesisë së PDK - së të thotë nëse negociatat do të nisnin që të enjten mbrëma. "Është e mundshme edhe sonte. Unë ju thashë se nga ky moment ne mund të procedojmë takime zyrtare", ka thënë Krasniqi. "Normalisht, kur kihet parasysh se ka kaluar një kohë e gjatë në mungesë të institucioneve të konsoliduara, ne nuk besojmë se ka kohë për të humbur, kështu që është e mundshme që të ketë takime, pse jo edhe sonte".

---

## **Pacollit i ofrohen dy poste në vend të presidentit**

---

**Liderit të AKR - së, Behgjet Pacolli, i janë ofruar dy funksione në ekzekutiv për t'i ushtruar njëkohësisht - të jetë zëvendëskryeministër dhe ministër i Jashtëm. Në pakon ofertuese për AKR - në, Thaçi ka futur edhe tri ministri dhe pozitën e kreut të Kuvendit. Mirëpo zyrtarët e AKR - së e kanë hedhur poshtë menjëherë këtë ofertë. Ata e duan postin e presidentit, një zëvendëskryeministër, gjashtë ministra dhe gjashtë zëvendësministra. Në të kundërtën, preferojnë të mbesin në opozitë**

PRISHTINË, 11 SHKURT - As në pakon e dytë ofertuese për AKR-në, PDK-ja nuk e ka përfshirë Presidencën. Për dallim nga oferta e parë, në këtë të fundit është futur një ofertë personale për Behgjet Pacollin. Atij i janë ofruar dy funksione në ekzekutiv për t'i ushtruar njëkohësisht - të jetë zëvendëskryeministër dhe ministër i Jashtëm. Burime të gazetës brenda PDK - së kanë bërë të ditur se ekipi negociues për koalicionin është autorizuar nga Kryesia e partisë që t'ia ofrojë këto poste Pacollit, më së largu gjatë ditës së shtunë. Mirëpo, zyrtarët e lartë të AKR - së e kanë hedhur poshtë këtë ofertë me të dëgjuar se në "pakon ofertuese" nuk është përfshirë edhe posti i presidentit. Nënkryetari i AKR - së, Ibrahim Makolli, ka garantuar se më përpara do të qëndrojnë në opozitë sesa të heqin dorë nga posti presidentit. Përveç Presidencës, ai ka paralajmëruar se AKR - ja do të kërkojë edhe gjashtë ministri dhe një zëvendëskryeministër. Kjo, megjithatë, nuk është e gjitha çka kërkon AKR - ja. "Ne insistojmë që të kemi edhe gjashtë zëvendësministra në ministritë që do t'i merrnim nën drejtim", ka bërë të ditur Makolli. Jozyrtarisht, burime të gazetës brenda kësaj partie kanë njoftuar se Pacolli i ka ftuar partnerët e koalicionit pak para mesnatës për të biseduar rreth çështjes së koalicionit me PDK - në, ndonëse gjatë ditës ai ka deklaruar se nuk e ka ndërmend që të heqë dorë nga qëndrimet e deritashme. "Nuk e kam ndërmend të lëkundem nga qëndrimet", ka thënë ai për "Kohën Ditore". Ndërkohë, Kryesia e PDK - së ka pasur një mbledhje që ka zgjatur rreth 3 orë, në të cilën është kundërshtuar mundësia që t'i përgjigjet pozitivisht kërkesës së Pacollit për postin e presidentit. "Ne do të vazhdojmë të negociojmë me AKR - në. Besojmë në ditët në vijim do të jemi pak më konkretë, e edhe ata", ka thënë pas mbledhjes së Kryesisë Hajredin Kuçi, nënkryetar në PDK. "Momentalisht PDK - ja e ka qëndrimin që e ka pasur", ka rikonfirmuar ai. Kryesia e PDK - së një ditë më parë ka vendosur që të zhvillojë negociata për koalicion vetëm me AKR - në, pas të cilit vendim menjëherë i nominuari për kryeministër i kësaj partie, Hashim Thaçi, me ekipin e tij ka takuar Pacollin për t'ia prezantuar ofertën.

---

## **PDK, ftesë vetëm për AKR-në**

---

**Zyrtar të Partisë Demokratike të Kosovës, më në fund u bënë të gjallë dhe dolën me vendimin e tyre se ofertën për koalicion t'a dorëzojnë vetëm me AKR-në, ndërkaq është konfirmuar nga ana e tyre se do të zhvillojnë biseda edhe me "Lista Ibrahim Rugova" duke përjashtuar bisedat me LDK-në, AAK dhe VV-në.**

Kryesia e Partisë Demokratike të Kosovës, e cila doli fituese e zgjedhjeve parlamentare të parakohshme në Kosovë, në mbledhjen e saj të mbajtur të enjten në mbrëmje, ka marrë vendim që ftesë zyrtare për të bërë marrëveshje koalicioni t'i bëjë vetëm AKR-së. Ndërkaq, që është konfirmuar që negociatat do t'i udhëheqë Hashim Thaçi, e të cilat do të fillojnë menjëherë nga dita e nesërme.

### **Përjashtohet LDK , AAK dhe VV**

Pas mbledhjes së kryesisë së PDK-së, në një konferencë me gazetarë anëtarë të kryesisë së PDK-së, Memli Krasniqi ka thënë se kryesia ka marrë vendim që AKR-së t'i bëhet një ofertë për koalicion, ndërkaq që në ditët në vijim veç do të fillojnë edhe bisedimet ndërmjet PDK-së e AKR- së për t'i konkretizuar hapat e mëtejshëm. "Kryesia e PDK-së ka marrë vendim që të procedojë me biseda formale për krijimin e koalicionit të mundshëm qeveritar. Si PDK, kemi vendosur që ofertë zyrtare të bëjmë AKR-së për të zhvilluar bisedime në funksion të arritjes së një marrëveshje për Qeverinë e ardhshme dhe për institucionet e reja. Ekipi i PDK-së i udhëhequr nga mandatarë për krijimin e qeverisë Hashim Thaçi do t'i udhëheqë këto bisedime. Besoj që shumë shpejt do të takohemi edhe me ekipin e AKR-së për t'i konkretizuar hapat e ardhshëm për krijimin e institucioneve të reja ", ka thënë Krasniqi.

### **PDK - ja në biseda për koalicion edhe me Listën Rugova**

Megjithatë, Krasniqi, nuk ka folur në detaje se çka përmban oferta e PDK-së e cila do t'i dorëzohet AKR-së, por ai ka thënë se kjo çështje do të diskutohet në takimet që do të zhvillohen mes tyre. "Se çka do të përmbajë oferta e PDK-së është çështje që do të diskutohet në këto takime zyrtare. Sot mund të konfirmoj që ne do të mbajmë bisedime me AKR-në për partitë e tjera, duke përfshirë edhe Listën Ibrahim Rugova dhe partitë minoritare, është një çështje e zhvillimeve të takimeve të ardhshme të bisedave të ardhshme, mund t'ju konfirmojmë tani se jemi në vija të përbashkëta për të pasur në Qeveri edhe një pjesëmarrje të ndonjë partie tjetër ", ka thënë Krasniqi. Krasniqi gjithashtu ka konfirmuar që PDK-ja nuk ka marrë vendim që në këto bisedime të ftohen LDK-ja, AAK-ja dhe Vetëvendosja.

## **AKR kusht presidencën, minoritetet disa ministri**

Ndërkaq, në anën tjetër kushtet e këtyre partive politike që do t'u bëhet ftesa nga ana e PDK - së tashmë janë të ditura, AKR - ja me çdo kusht e do funksionin e presidentit, ndërkaq gjatë ditës edhe Nenad Rashiq, i cili i ka të fituara 8 mandate në Kuvendin e Kosovës ka thënë se Partisë Liberale do të kërkojë që së paku të ketë dy ministri në rast se ajo do të jetë pjesë e koalicionit me PDK - në. " Kërkesa jonë do të jetë që të marrim ato ministri, përmes së cilave ndikojmë në përmirësimin e jetës së komunitetit serb si Ministrinë e Punës, apo të Kthimit, e cila edhe ka obligime ndaj komunitetit serb, meqë merret me kthimin e serbëve", ka thënë Rashiq.

---

## **Pacolli refuzoi negociatorët e PDK-së**

---

**Dy "negociatorët" e PDK - së, Limaj e Kuçi dhe shefi i tyre Thaçi, i shkuan në shtëpi Pacollit për t'i kumtuar lajmin se kanë vendosur që edhe postin e presidentit ta mbajnë për vete. Ky i fundit e refuzoi ofertën**

Ndërkohë, edhe Lista Ibrahim Rugova nëse ia del që pas vetës t'i mbledhë të paktën 5 deputetë do të përfshihej në marrëveshje po ashtu. PDK tashmë kushtet i ka të qarta, nëse dëshiron që të mos e humbë edhe AKR - në si partnere, duhet të sakrifikojë postin presidentit të Kosovës. Anëtari i kryesisë së PDK - së, Memli Krasniqi, pas përfundimit të mbledhjes ka thënë se partia nuk ka vendosur nëse do t'i bëhet ofertë ndonjë partie tjetër. "PDK nuk ka marrë asnjë vendim që t'i bëjë ftesë AAK - së, LDK - së apo Vetëvendosjes. Sa i përket Listës Dr. Ibrahim Rugova dhe minoriteteve, PDK ka pika të përbashkëta dhe do të bisedohet me këto gjatë ditëve të ardhshme", ka thënë Krasniqi. Gjatë ditës, Thaçi ishte takuar larg mediave dhe opinionit me përfaqësuesit e disa vendeve me ndikim në Kosovë, të cilët ai i kishte njoftuar për negociatat rreth formimit të koalicionit. Një interesim i shtuar i diplomatëve ndërkombëtarë, sipas burimeve të "Zërit", ka të bëjë me postin e presidentit, si dhe me qëndrueshmërinë e qeverisë së ardhshme, e cila do të jetë në limitin e ekzistencës nga dita e parë. Po ashtu, sipas këtyre burimeve, një pjesë e komunitetit ndërkombëtar ka drojën se një qeveri që ka në përbërje një numër kaq të madh të pakicave sa mund të jetë efikase dhe efektive në punën e vet. Nga 61 deri në 65 vota, sa po synon të arrijë Qeveria" Thaçi 2", hiq më pak se 18 vota të deputetëve që do ta mbështesin atë do të jenë vota nga mandatet e falura në bazë të Kushtetutës, e cila siguron 20 vende për komunitetet pakicë. Një fakt i tillë, edhe pse publikisht nuk përmendet, në takime të mbyllura thuhet se paraqet një shqetësim për faktorin ndërkombëtar, pasi që Qeveria e re edhe pse pritet të formohet mbi baza legale ka një mungesë legjitimiteti (me 18 mandate të rezervuara) krahasuar me opozitën nëse merren parasysh vetëm mandatet e fituara përmes votës së lirë të qytetarëve. Sidoqoftë, gjendja është e tillë dhe se më nuk ka kohë për rikuperime, ngase vendit tani i duhet një qeveri. Andaj, lideri i PDK - së dhe mandatar i ardhshëm për kryeministër, Thaçi, mbledhi mbrëmë Kryesinë e partisë për t'ua shpjeguar jo vetëm qëllimet e tij, por edhe pikëpamjet dhe pritjet ndërkombëtare. Përveç marrëveshjes për Qeverinë dhe ndarjen e ministrive, një çështje tjetër që pritet të përfshihet në të njëjtën marrëveshje është edhe posti i presidentit të vendit. Zëdhënësi i PDK - së, Blerand Stavileci, thotë se këto janë negociata dhe mund të diskutohet për çdo post, por jo edhe për postin e kryeministrit, i cili, sipas tij, i takon PDK - së si fituese e zgjedhjeve, dhe kandidati i vetëm për këtë pozitë është Hashim Thaçi. "Ne mbetemi akoma të qëndrimi ynë se i vetmi post i sigurt dhe i padiskutueshëm në këto biseda do të jetë posti i kryeministrit, ndërsa për postet e tjera ne do të bisedojmë dhe do t'i vlerësojmë të gjitha opsionet dhe alternativat", thotë Stavileci.

**PACOLLI E DO PRESIDENCËN, REFUZON OFERTËN E PDK-SË**

## **Kandidatët për president me rreth 4 përqind të votave**

**U.d. i presidentit të Kosovës, Jakup Krasniqi, po lobon fuqishëm për mbledhjen e votave të nevojshme për mandatin e plotë të presidentit të vendit. Jakup Krasniqi në zgjedhje ka arritur t'i sigurojë 35.379 vota, apo rreth 5 për qind të votuesve që e kanë votuar. Ndërkaq, edhe kreu i AKR-së, Behgjet Pacolli, i cili mbrëmë e refuzoi ofertën e PDK - së, duke e kushtëzuar me postin e presidentit, në zgjedhjet e 12 dhjetorit ka siguruar jo më shumë se 29.294 vota, apo diku rreth 4 përqind të votave të votuesve nga gjithsej 706.317 votues**

Ka përfunduar pa marrëveshje takimi ndërmjet krerëve të PDK-së, Hashim Thaçi dhe atij të AKR-së, Behgjet Pacolli në shtëpinë e këtij të fundit në orët e vona të mbrëmjes. Sipas burimeve jozyrtare, Pacolli është lutur nga Thaçi që të heqë dorë nga kërkesa për t'u bërë president. Megjithatë, ai nuk ka hequr dorë nga insistimi i tij për të marrë postin e të parit të vendit. Kreu i PDK-së Hashim Thaçi i ka ofruar Pacollit postin e kryetarit të Kuvendit, zëvendëskryeministrit dhe katër ministri, ofertë që është refuzuar nga AKR - ja. Merret vesh se marrja e presidencës nga AKR - ja mbetet kushti kryesor. Paralajmërojnë për raunde të tjera të bisedimeve në mënyre që të arrihet marrëveshja për krijimin e koalicionit qeverisës.

### **Ftesa për bashkëqeverisje**

Anëtari i kryesisë së PDK-së, Memli Krasniqi tha mbrëmë se PDK-ja ka vendosur t'i bëjë ofertë zyrtare Aleancës Kosova e Re për të zhvilluar bisedimet në funksion të arritjes së një marrëveshjeje për qeverinë e ardhshme dhe institucioneve të tjera. "Ekipi i PDK-së, i udhëhequr nga kryetari dhe mandatarin për krijimin e qeverisë së ardhshme, Hashim Thaçi, do t'i udhëheqë këto bisedime", ka thënë Krasniqi. Sipas tij, partitë të cilave nuk do t'u bëhet ftesë nga PDK-ja janë LDK-ja, AAK ja dhe Lëvizja "Vetëvendosje". "PDK - ja nuk ka marrë vendim që t'i bëjë ftesë AAK-së, LDK-së apo "Vetëvendosjes". Sa i përket "Listës LDK Ibrahim Rugova" dhe minoriteteve, PDK - ja ka pika të përbashkëta dhe do të bisedohet me ta gjatë ditëve të ardhshme", ka thënë anëtari i Kryesisë së PDK-së, Memli Krasniqi, duke shtuar se bisedimet zyrtare për koalicion me AKR - në mund të fillojnë qysh në këtë moment. "Besoj se shumë shpejt do të ketë takime edhe me ekipin e AKR-së në mënyrë që të konkretizohen hapat e ardhshëm në funksion të krijimit të institucioneve. Krasniqi tha se për bisedime pritet të ftojë edhe " Listën LDK-së Ibrahim Rugova dhe minoritetet.

### **Përballjet për presidentin e ardhshëm**

Gjatë ditës është raportuar se tensionet brenda PDK-së janë të larta, pasi, siç thuhet, një pjesë e kryesisë insiston që postin e presidentit ta mbaje Jakup Krasniqi. Këto pretendime nuk janë komentuar nga kryeministri Thaçi. "Se çka do të përmbajë oferta e PDK-së është çështje që do të diskutohet në këto takimet zyrtare që do të fillojnë tani", ka thënë anëtari i Kryesisë së PDK-së, Krasniqi. Ndërkohë, vetë Jakup Krasniqi gjatë një komunikimi me media, as nuk e ka pohuar e as mohuar pretendimin e tij për të qenë president me krijimin e institucioneve të reja. Ai tha se e pret zhvillimin e të gjitha procedurave paraprake që duhet të zhvillohen në një subjekt politik, që nënkupton nominimin e partisë për këtë post.



## **AKR-ja e do Presidencën**

Përfaqësues të AKR-së më herët kanë thënë se janë duke zhvilluar bisedime joformale, si në raport me partinë fituese, ashtu edhe me faktorin ndërkombëtar, por, sipas tyre, këto takime janë vetëm në nivel bisedimesh joformale. Nënkryetari i AKR-së, Ibrahim Gashi, në një konferencë për media, i pyetur se a kanë arritur marrëveshje për bashkëqeverisje me PDK-në, ka thënë se ende vazhdojnë të kenë bisedime joformale me faktorin ndërkombëtar dhe me PDK-në. Në këtë betejë për të parin e vendit, Krasniqi ka marrë mbështetjen edhe nga deputetët minoritarë që do të jenë pjesë e koalicionit kushtetues për partinë fituese të zgjedhjeve. Përveç votave të PDK-së dhe ndonjë deputeti që mendon dhe bën politike të pavarur nga pjesa e opozitës parlamentare, një shumicë votash për Krasniqin kryetar vendit mund t'ia siguroj edhe kreu i Partisë së Pavarur Liberale nga komuniteti serb, Slobodan Petroviq.

## **Për analistët zgjidhja më e mirë do të ishte një figurë konsensuale**

Derisa thyhet heshtja politike, me pazare për partneritet qeverisës, duke kushtëzuar postin e të parit të vendit, analistët politikë vendorë konsiderojnë se ky ngërç që mban peng krijimin e shpejtë të institucioneve të vendit ka mundur të zgjidhet më së miri, duke gjetur një figure konsensuale, mbipartiake, që do të ishte e pranueshme jo vetëm nga pozita dhe opozita parlamentare, por edhe nga subjektet politike jashtë parlamentare dhe shoqëria civile. "Më e mira zgjidhje do të ishte të ketë një kandidat konsensual, i cili do të pranohet madje jo vetëm nga partitë politike në Parlament, në pozitë dhe opozitë, por edhe nga shoqëria përgjithësisht. Pra, do të ishte zgjidhje një njeri i pranuar nga të gjithë, sepse vërtet i duhet edhe momentit aktual në të cilin jemi, në vakum institucional dhe në krizë institucionale, që po reflekton me vështirësi të mëdha të formimit të një koalicioni me shtrirje të gjerë që nënkupton përfshirjen e të gjitha strukturave, edhe partiake edhe shoqërore", tha analisti dhe eksperti për çështje kushtetuese, Mazllom Baraliu. " Kjo nuk është madje as në kundërshtim me Kushtetutën, ka mekanizëm që përputhet me të dhe kjo do të ishte njëra anë pozitive, derisa çdo formë tjetër e pretendimeve të depërtimit të personaliteteve të rrymave dhe të vizioneve të ndryshme vetëm sa për të qenë në institucione, pa e akuzuar këtu askënd. Vërtet nuk shkon në favor të askujt, e madje as të vetë atyre. E gjithësesi nuk shkon në favor të sfidave me të cilat do të ballafaqohemi menjëherë pas formimit të institucioneve", tha Baraliu. Ndërkaq, shefi i ICO-s, z. Piter Fejt në një intervistë ekskluzive për Kosova Sot ka deklaruar se sugjerimi i tij është që postin e presidentit ta marrë një femër, duke e arsyetuar me faktin se femrat në nivelet e larta shtetërore përçojnë mesazhin e harmonisë, të tolerancës, të çiltërsisë për afrim me të gjitha komunitetet dhe grupet, dhe mbase kjo do t'i nevojitej Kosovës në këtë fazë. S. AHMETI & I. KRASNIQI

---

## **PDK e do krejt pushtetin**

---

### **Partia e Thaçit i dëshiron dy postet kryesore. AKR refuzon ofertën “joserioze”**

Pra, PDK - ja ka vendosur që përveç postit të kryeministrit për Thaçin, ta rezervojë edhe karrigen e presidentit për sekretarin e përgjithshëm të partisë, Jakup Krasniqin. Ndërsa AKR - së, e cila do të ketë 8 deputetë në Kuvendin e ardhshëm të Kosovës, PDK - ja i ka ofruar postin e kryetarit të Kuvendit, një zëvendëskryeministër dhe katër ministri. Pak kohë para këtij vendimi, vetë lideri i PDK - së, Hashim Thaçi, gjatë takimit me Countryman, ka premtuar se qeverinë e re do ta formonte në koalicion me AKR - në, Listën "Rugova" dhe me minoritetet. Mirëpo, pas vendimit të PDK - së, lideri i AKR - së, Behgjet Pacolli ka thënë se nuk e pranonte ofertën e PDK - së, dhe se, siç po zhvillohen ngjarjet, sipas Pacollit, AKR - ja do të mbetet në opozitë. "S'ka marrëveshje. Oferta ka qenë joserioze dhe neve nuk na intereson, dhe me sa duket ne do të mbesim në opozitë me partitë tjera", ka thënë Pacolli. Sipas tij, pengesë për mos arritjen e një marrëveshjeje me PDK - në nuk është vetëm posti i presidentit, por edhe jo serioziteti i PDK - së. "Ajo ka përmbajtur disa ministri, kryeparlamentarin dhe ato neve nuk na interesojnë, pasi nuk janë fushë e veprimt tonë. Me këtë hapësirë që është ofruar, nuk e shohim veten aty", ka thënë Pacolli. Kurse zëvendës ndihmës sekretari amerikan i Shtetit, Thomas Countryman, pas takimit me Thaçin, duke folur rreth përbërjes së qeverisë, ka thënë se madhësia e koalicionit është më pak e rëndësishme, sesa efektiviteti i koalicionit. Ai nuk ka komentuar lidhur me mundësinë që Behgjet Pacolli të jetë president. Gjithsesi, tërë problemet rreth postit të presidentit lidhen me "barrikadimin" e disa deputetëve të PDK - së, të cilët insistojnë që ky post t'i takojë presidentit në detyrë, Jakup Krasniqit. Në të kundërtën, ky grup i deputetëve të PDK - së në Kuvend kërcënon se nuk do ta votojë asnjë propozim tjetër të koalicionit për president, përfshirë edhe Behgjet Pacollin. Mirëpo, duke pasur parasysh maksimumin prej 65 deputetëve që mund të sigurojë koalicioni PDK - AKR - minoritetet - Lista "Rugova", bojkotimi i një numri sado të vogël të deputetëve rrezikon shpërbërjen e koalicionit ende pa u konstituar qeveria e re. Jakup Krasniqi ka thënë të premtën se e ka përkrahjen e PDK - së për t'u zgjedhur president. "Nuk ka qenë propozim imi, por i partisë që të jem unë presidenti. Kam përkrahjen e drejtuesve të partisë, dhe besoj se vota do të marr edhe nga ndonjë deputet i partive opozitare", ka thënë Krasniqi për Klan Kosova. Kurse duke iu referuar Pacollit, ai ka thënë se nuk ka asgjë kundër tij, por se presidenti, sipas Krasniqit, duhet të jetë dikush i dëshmuar në proceset e ndryshme të vendit.

### **Ndërkombëtarët, pro formulës së Koalicionit**

Duket se koalicioni më i përfolur i ditëve të fundit, ai në mes të PDK - së, AKR - së, Listës Dr. Ibrahim Rugova dhe minoriteteve, është i pranueshëm edhe për ndërkombëtarët. Këtë informacion, bazuar në burime të sigurta, e transmeton RTK. Ky medium njofton se këto informacione për ta i ka konfirmuar një burim i sigurt që është afër procesit të arritjes së marrëveshjes për koalicionin e ri qeveritar. Ndërkohë, duket se posti i presidentit vazhdon të jetë pengesë për ndarjen e posteve të tjera midis partnerëve të koalicionit.

---

## **Thaçi në hall, çka të bëjë me Krasniqin dhe Pacollin**

---

**Burime të gazetës brenda takimit në PDK kanë thënë se pika kulmore e diskutimeve dhe mospajtimi esencjal ka qenë se kujt do t'i takojë posti i presidentit. Një pjesë e strukturave udhëheqëse të PDK - së ka kundërshtuar që presidenca t'i jepet AKR - së, konkretisht liderit të saj Behgjet Pacolli, ndërsa ka kërkuar me çdo kusht që president i ardhshëm i Kosovës të jetë sekretari i përgjithshëm i PDK – së, Jakup Krasniqi**

PRISHTINË, 13 SHKURT - Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës, të dielën, i janë dashur më shumë se tri orë negociata të brendshme për të harmonizuar një përgjigje kundruall partnerit potencial për të bashkëqeverisur, koalicionit të AKR - së, i cili është "barrikaduar" në kërkim të postit të presidentit për liderin e saj Behgjet Pacolli. Por, edhe pse mbledhja ka zgjatur më shumë se tri orë, Kryesia e PDK - së nuk ka arritur të harmonizojë ndonjë qëndrim. Burime të gazetës brenda takimit kanë thënë se pika kulmore e diskutimeve dhe mospajtimi esencjal ka qenë se kujt do t'i takojë posti i presidentit. Një pjesë e strukturave udhëheqëse të PDK - së ka kundërshtuar që presidenca ti jepet AKR - së, konkretisht liderit të saj Behgjet Pacolli, ndërsa ka kërkuar me çdo kusht që president i ardhshëm i Kosovës të jetë sekretari i përgjithshëm i PDK - se, Jakup Krasniqi. "Disa anëtare të Kryesisë sërisht kanë kundërshtuar propozimin që presidenca t'i jepet Pacollit", i ka thënë gazetës njëri nga zyrtarët e lartë të PDK - së, pjesëmarrës në takim. Me gjithë raportimet se të dielën është zhvilluar një takim në mes të Hashim Thaçit dhe Behgjet Pacollit, të dyja palët e kanë mohuar që takimi i tillë të ketë ndodhur. Anëtari i Kryesisë së PDK - së, pas mbledhjes së saj, në një prononcim për media ka thënë se bisedimet me partnerin potencial AKR - në do të vazhdojnë në ditët në vijim, duke filluar me takimin që pritet të ndodhë të hënën. E hëna e kësaj jave i 'bie të jetë 14 shkurt, apo si njihet ndryshe si "Dita e të Dashuruarve", takim për të cilin edhe Krasniqi ka shpresuar se do të përafrohen edhe më tej qëndrimet në mes dy partive, në mënyrë që të ndodhë edhe "kurorëzimi" dhe të "lindin" edhe institucionet. "Kryesia e PDK - së ka diskutuar çështjet që ndërlidhen me zhvillimet e institucioneve të reja, edhe bisedimet që po zhvillohen me partnerin potencial, koalicionin e AKR - së, ka deklaruar Krasniqi. Ai ka shtuar se pjesë e diskutimeve në Kryesi, kanë qenë edhe çështjet më konkrete, që ndërlidhen me fuzionimin edhe të programeve të PDK - së dhe partnerëve të tjerë, për të krijuar një program qeverisës të konsoliduar. "Në anën tjetër, ka pasur diskutime për mënyrën e vazhdimet të hapave të ardhshëm në këtë drejtim dhe po ashtu edhe për bisedimet që do të vazhdojnë me koalicionin e AKR - së dhe që ne besojmë që do të ketë nesër takime të reja", ka thënë ky zyrtar i PDK - së. Krasniqi ka treguar se takimet dhe diskutimet në mes vetë PDK - së do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim, duke filluar nga e hëna. "Takime këto që do të përfshijnë vendimmarrësit, duke përfshirë edhe Kryesinë dhe Këshillin Drejtues të PDK - së, në mënyrë që në ditët e ardhshme të kemi një finalizim edhe të marrëveshjes, edhe të hapave të mëtutjeshëm".

### **Krasniqi: Kemi përafrim të pozicioneve**

Anëtari i Kryesisë së PDK - së, ka thënë se nga takimet paraprake në mes të Thaçit dhe Pacollit, kanë ndodhur përafime të pozicioneve të të dyja palëve, megjithatë rezultatet përfundimtare do të dihen në ditët në vijim. "Në çdo negociatë, normalisht të dy palët kanë qëndrimet fillestare

dhe pastaj shkohet në drejtim të përafrimeve dhe të arritjes së hapësirës së përbashkët ku të dy palët e gjejnë vetveten dhe i realizojnë qëllimet dhe objektivat e tyre politike në radhë të parë në të mirën e qytetarëve dhe të vendit", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se "edhe ne jemi në atë drejtim me AKR - në dhe në të dy palët ka një besim se do të gjendet rruga e përbashkët për t'u arritur marrëveshja, por kjo i mbetet vazhdimit të bisedimeve të ditëve të ardhshme". Megjithëse ka përmendur përafrimin, Krasniqi ka thënë të mos jetë biseduar për emra konkretë sesi do të ndahen postet qeveritare dhe për çështjen më të vështirë në këto negociata se kush do të jetë president i vendit. "Ne nuk jemi koncentruar te çështja e emrave sa jemi koncentruar te çështja parimore e themelimit institucioneve", ka thënë ai, për të shtuar se "për çështjet e ofertës dhe kundëroftës po vazhdojnë bisedimet". Për fund, Krasniqi është shprehur i bindur se marrëveshja e koalicionit do të arrihet, para seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës të caktuar më 24 shkurt.

### **AKR - ja "barrikadon" presidentin**

Ndonëse të dyja këto subjekte kanë thënë se të dielën nuk kanë zhvilluar takime në mes vete, Memli Krasniqi i PDK - së ka thënë se ka pasur përafrim të qëndrimeve, në anën tjetër nënkryetari i AKR - së ka treguar se partia e tij nuk ka lëvizur asnjë milimetër nga qëndrimi i saj. "Nuk ka asnjë mundësi, ne e kemi bërë të qartë kaherë që pa postin e presidentit AKR - ja dhe Koalicioni për Kosovë të Re nuk janë të gatshëm që të hyjnë në një koalicion", i ka thënë Makolli gazetës. "Ne e kemi bërë të qartë që nuk zbrapsemi nga ato që kemi thënë kështu që po presim vendimin e PDK - së". Makolli është shprehur që të dielën të mos ketë pasur takime midis përfaqësuesve të subjektit të tij dhe të atyre të Hashim Thaçit. Jo, jo nuk jemi takuar sot, kurse nuk e di as për nesër se a do të takohemi", ka thënë ai. "Siç po shihet, PDK - ja është në konsultime të brendshme" Lideri i PDK - së, Hashim Thaçi, ia ka ofruar Koalicionit për Kosovë të Re postin e zëvendëskryeministrit, katër ministri dhe postin e kryetarit të Kuvendit, ndërsa Behgjet Pacolli ka kërkuar postin a presidentit, gjashtë ministri, një zëvendëskryeministër dhe gjashtë zëvendëskryeministra.

## Bisedimet për qeverinë e re, zbutet AKR-ja

**Pas takimit disa orësh në zyrën e kryeministrit në ikje Hashim Thaçi, burime nga brenda thanë se Behgjet Pacolli është zbutur pakëz nga kërkesa për postin e presidentit, por nuk është tërhequr përfundimisht**

Ka mbetur sërish pezull koalicioni që do të sillte dhe qeverinë e re në Kosovë. Bisedime të shumta janë bërë gjatë ditës së djeshme mes kreut të PDK-së, Hashim Thaçi dhe kreut të AKR-së, Behgjet Pacolli, por dhe pas përfundimit të tyre, asgjë nuk është vendosur. Burime pranë takimit thanë se, Pacolli nuk ka hequr dorë nga posti i presidentit, ndërkohë që Thaçi i ka ofruar poste të tjera, pasi për kreun e shtetit nga PDK - ja është caktuar të jetë, Jakup Krasniqi.

### Bisedime të shumta, pa rezultate

Bisedimet për modalitetet e ndërtimit të koalicionit qeverisës PDK-AKR, Listës Rugova dhe minoritet kanë vazhduar edhe gjatë ditës së djeshme, me takimin që janë zhvilluar në mes të Ekspertit të PDK-së, kryesuar nga Hashim Thaçi dhe ekipit të AKR - së, kryesuar nga Behgjet Pacolli, pa marrëveshje finale. "Nuk kemi marrëveshje deri tani. Absolutisht jo, dhe do të njoftoheni më vonë", tha Pacolli. Për t'i lënë mundësi një takimi të radhës gjatë ditës së sotme, e diel, edhe nënkryetari i PDK - së Hajredin Kuçi tha se negociatat vazhdojnë akoma, pa u ndalur në detajet konkrete. "Ne do të vazhdojmë të negociojmë me AKR - në. Besojmë se në ditët në vijim do të jenë pak më konkretë edhe ata. Mementalisht, PDK - ja e ka qëndrimin që e ka pasur. Do t'i bëjmë institucionet me kohë, edhe të mira", theksoi Kuçi. Takimi i djeshëm u tha se është fokusuar më shumë në modalitetet e shkrirjes së dy programeve politike në një program të përbashkët qeveritar, se sa për drejtimin e heshtave, se kush më fuqishëm do ta godasë postin e presidentit të Kosovës pas nominimit zyrtar të Jakup Krasniqit nga ana e PDK-së dy ditë më parë. I pyetur nga gazetarët, pse nuk është aq këmbëngulës në qëndrimin e tij që pa tjetër edhe nga takimi i djeshëm të përdore kusht parësor postin e presidentit, Pacolli tha: **"Presidenca është mundësi e fushëveprimit tim personal dhe nuk ka ndonjë arsye që të mos jem president i Kosovës"** deklaroi pas takimit, kreu i AKR - së, Behgjet Pacolli. Madje, ai tha se mos insistimi i tij i djeshëm, nuk do të thotë se e ka zbutur qëndrimin, sepse **"Unë asnjëherë nuk kam qenë as aq i fortë dhe as i butë"**, tha ai. Ndryshe, në një konferencë për shtyp pas këtij takimi, ku foli më gjerësisht nënkryetarja e AKR - së, Mimoza Kusari u tha se kërkesa e këtij subjekti politik, që lideri i saj të jetë president, më shumë ka të bëjë për imazhin e vendit dhe krijimin e besimit për respektimin reciprok të partneritetit, për një qëndrueshmëri afatgjatë, si për punën e ekzekutivit, për zbatimin e programit, por edhe për projektet konkrete. "Ne e kemi thënë shumë herë se kjo është për arsye se krijon një stabilitet institucional, për arsye se vetë fakti i tërheqjes së presidentit të kaluar Sejdiu solli deri te një krizë institucionale, për arsye se besojmë që pjesa e cila i takon një stabiliteti institucional, e që ka të bëjë me personalitetin që duhet të ketë mbi partiak dhe figurë unike, si president i Republikës së Kosovës është një atribut që e ka koalicioni për Kosovën e re në krye me liderin e saj, Behgjet Pacolli. Ajo tha se më këtë formulë do të vinin në shprehje edhe objektivat programore të AKR-së për ndryshimet kushtetuese, sipas të cilave në të ardhmen presidenti i vendit do të zgjidhej nga populli me votë të drejtpërdrejtë. Ndërsa, sa i përket stabilitetit direkt në qeveri, ajo tha se,

"Pjesëmarrja e liderit në një post të udhëheqësve të institucioneve të Kosovës do të garantonte suksesin edhe të përfaqësuesve të tjerë në dikasteret qeverisëse, të përfaqësuesve tjerë të koalicionit për Kosovë të re".

### **AAK-ja, nuk është pjesë e pazareve**

Raportimet që janë bërë nëpër disa medie, se po zhvillohen edhe takime të fshehta në mes të zyrtarëve të PDK-së dhe AAK-së për të gjetur një derë të re të bashkëpunimit për koalicion qeverisës, në rast të dështimit me AKR-në, dje i ka hedhur poshtë kategorikisht nënkryetari i AAK-së, Ahmet Isufi. Ai tha se pas qëndrimit të bërë publik nga AAK-ja, në të cilin ka propozuar koalicion trepalësh PDK - LDK - AAK, e që është refuzuar nga LDK-ja dhe PDK-ja, nuk ka pasur asnjë lëvizje drejt përafrimit të veçantë në mes të PDK-së dhe AAK-së. "Nuk ka asgjë të re në këtë drejtim. Pozicioni ynë është ai që ka qenë dhe ai nuk ndryshon. Ne jemi nisur nga interesi për shtetin e Kosovës, kur kemi dalë me propozimin tonë për koalicion të gjerë, edhe me LDK-në. Ne po të kishim dëshiruar që të nisemi vetëm nga interesat tonë të ngushta partiake, do ta kishim pasur shumë më lehtë dhe ndoshta do të ishte e kryer kjo punë. Pozicioni ynë mbetet akoma ai që ka qenë, që në asnjë variant tjetër, përveç qëndrimit publik zyrtar që e kemi dhënë nuk kemi, e ai nuk do të ndryshojë, që do të thotë se koalicion me PDK-në dhe me Hashim Thaçin kryeministër, nuk vjen në shprehje në asnjë rast. Në rast se në këtë pikë do të ketë ndryshim të pozicionit në PDK-së, atëherë edhe pozicioni ynë mund të ndryshojë", tha nënkryetari i AAK-së, Ahmet Isufi. S. AHMETI

---

## Lojë nervash mes PDK-së dhe AKR-së

---

### PDK dhe AKR nuk po gjejnë gjuhë të përbashkët rreth koalicionit qeverisës

AKR-ja, përmes udhëheqësve të saj, ka përsëritur qëndrimin se nuk do të hyjë në koalicionin qeverisës, nëse nuk i jepet posti i presidentit dhe pesë ministri.

### AKR - ja nuk lëshon pe

Lideri i AKR - së, Behgjet Pacolli, pas dy orësh negociata me kryetarin e PDK - së, Hashim Thaçi, në objektin e Qeverisë së Kosovës, ka thënë të shtunën se ende nuk ka kurrfarë marrëveshje rreth koalicionit të ardhshëm qeverisës. Ai ka thënë se bisedimet do të vazhdojnë në ditët e ardhshme, por ka rikonfirmuar qëndrimin e mëhershëm se nuk heq dorë nga posti i presidentit. **"Presidenca do të jetë pjesë e hapësirës së veprimit tonë, andaj bisedimet kanë qenë komunikative, me respekt reciprok dhe ne do të vazhdojmë. Nuk është lehtë të formohet një qeveri funksionale dhe ne insistojmë që të jetë funksionale që do të punojë për qytetaret e Kosovës"**, ka thënë Pacolli. Sipas tij, formimi i qeverisë mes PDK - së dhe AKR - së është vullnet i përbashkët i dy partive, dhe ka miratimin e plotë të bashkësisë ndërkombëtare. **"Kjo na jep një dëshmi tjetër që do të ketë një qeveri mes këtyre dy partive"**, ka thënë Pacolli. Por, lideri i AKR - së nuk e ka konsideruar punë të kryer koalicionin me PDK - në, duke thënë se nuk është kërkuar ndonjë emër tjetër brenda koalicionit të AKR - së, për postin e presidentit. Muhamet Mustafa, deputet i Koalicionit për Kosovë të Re, ka thënë se ky koalicion ka propozuar Pacollin për president dhe se nuk do të pranohet asnjë ofertë tjetër rreth kësaj çështjeje. "Në fushatë ne kemi kandiduar me z. Pacolli për president të Kosovës dhe i gjithë koalicioni mbetet në këtë kërkesë dhe në këtë qëndrim", ka thënë Mustafa. Kurse, zëvendëspresidentja e AKR - së, Mimoza Kusari - Lila, gjatë një konference për media ka prezantuar sërish kërkesat e Koalicionit për Kosovë të Re për hyrje në bashkëqeverisje me PDK - në. Ajo ka thënë se oferta e AKR - së është në kuadër të fushës së veprimit dhe parimeve të qeverisjes si dhe në përputhje me programin e promovuar gjatë fushatës elektorale. Kusari - Lila ka përsëritur kërkesën kryesore të AKR - së që posti i presidentit t'i takojë liderit të saj, Behgjet Pacollit. "Koalicioni për Kosovë të Re nuk do të hyjë në qeveri nëse e sheh se nuk ka hapësirë të veprimit, nëse e sheh se nuk ka parime të shkruara dhe të qëndrueshme, të cilat garantojnë një zhvillim të qëndrueshëm dhe të cilat synojnë të përmirësojnë imazhin e Kosovës dhe forcimin e institucioneve demokratike", ka thënë ajo. Oferta e Koalicionit për Kosovë të Re për PDK - në është që ky koalicion të marrë postin e presidentit, një zëvendëskryeministër, gjashtë ministri dhe gjashtë zëvendësministra.

### PDK zien rreth postit të presidentit

Partia kryesore në koalicionin e ardhshëm të qeverisës, vazhdon të ballafaqohet me probleme të brendshme për shkak të orekseve për të marrë maksimumin në qeverinë e ardhshme. Përkundër paralajmërimeve se të shtunën do të zhvillohej një takim i kryesisë së PDK së pas takimit me drejtuesit e AKR-së, ai është shtyrë për një ditë më vonë, kur edhe parashihet vazhdimi i bisedave të radhës me AKR-në. Nënkryetari i PDK-së, Hajredin Kuçi, ka thënë të shtunën se bisedimet me AKR - në po vazhdojnë, në ditët në vijim. "Ne do të vazhdojmë të negociojmë me AKR - në. Besojmë se në ditët në vijim do të jenë pak më konkrete edhe ata. Mementalisht, PDK - ja e ka qëndrimin që e ka pasur. Do të bëjmë institucionet me kohë edhe

të mira“, ka thënë Kuçi për REL. Kurse, Rrustem Mustafa, nënkryetar i PDK-së, nuk e ka përjashtuar mundësinë që partia e tij mund ta formojë qeverinë e ardhshme të Kosovës edhe pa Aleancën Kosova e Re. Zyrtarët tjerë të PDK - së kanë hezituuar të japin deklaratë për media, duke pasur parasysh qëndrimet e ndryshme që ekzistojnë në lidhshpin e PDK - së karshi çështjes së presidentit. Një pjesë e deputetëve të ardhshëm të PDK - së vazhdojnë të insistojnë që PDK - së i takon edhe posti i presidentit përveç atij të kryeministrit dhe se atë post duhet ta ushtrojë Jakup Krasniqi. Ndërsa, PDK ja do ta ketë më të lehtë të arrij marrëveshje me partitë minoritare dhe Listën "Ibrahim Rugova", të cilat pritet të jenë pjesë e koalicionit qeverisës.

### **Pacolli përgatitet për president**

Lideri i AKR - së, Behgjet Pacolli, tashmë ka filluar të përgatitet për të ushtruar pa probleme postin e presidentit të Kosovës. Mimoza Kusari - Lila ka thënë të shtunën se Pacolli, jo vetëm që i ka bërë të gjitha planet e domosdoshme në rastin e zgjedhjes së tij si president, por gjithashtu ka ndërmarrë dhe i ka bërë parapërgatitjet të cilat me Kushtetutë nuk i lejohet të ushtrojë asnjë post tjetër publik dhe të jetë i përkushtuar vetëm postit të presidentit. Sipas saj, Pacolli tashmë ka filluar të tërhiqet nga pozicionet e tij si në angazhimin politik dhe në atë afarist. "Konsiderojmë se është me të vërtetë njeriu më i duhur që i duhet Kosovës për të avancuar proceset si president i Republikës së Kosovës", ka thënë nënkryetarja e AKR - së.



---

## **Pacolli, i pasigurt në votat e PDK-së**

---

**Burime të gazetës kanë konfirmuar se aktualisht janë tetë deputetë të PDK - së, që nuk do ta votojnë Behgjet Pacollin për president. Dhe pa votat e tyre, lideri i AKR - së do ta ketë vështirë të vihet në krye të shtetit. PDK - ja nuk ka vullnet që AKR - së t'i japë më shumë se tri ministri, e aq më pak t'ia lërë në duar Ministrinë e Ekonomisë dhe atë të Punëve të Jashtme**

Por, ky burim ka thënë se AKR - ja ka gjasa që ta marrë në drejtim Ministrinë e Forcës së Sigurisë, e po ashtu edhe atë të Transportit dhe Postë - Telekomunikacionit. Veç tjerash, sipas tij, PDK - ja është e interesuar që ta sistemojë në qeveri, zëvendës-presidenten e AKR - së, Mimoza Kusari - Lilën, dhe atë në postin e zëvendëskryeministres. Nënkryetari i PDK - së, Enver Hoxhaj, ka folur shkurt për ndarjen e pushteteve, por ka thënë se "pjesëmarrja në qeveri do të varet nga numri i vendeve që i kanë në Kuvendin e Kosovës". Në fakt, AKR - ja është e përfaqësuar në Kuvend me tetë deputetë, aq sa do të jetë e përfaqësuar edhe SLS e Slobodan Petroviqit. Në AKR shpresojnë se pos Ministrisë për Ekonomi do ta marrin së paku edhe atë të Shëndetësisë dhe të FSK - së. Të parën do t'ia linin nën drejtim Muhamet Mustafës, të dytën, Agim Çekut dhe të tretën Ferid Aganit. AKR - ja, sipas një zyrtari të lartë, do të jetë e gatshme që t'i sistemojë në poste qeveritare edhe tre kandidatët e PD - së që janë në radhë për t'u bërë deputetë, pasi të lirohen mandatet nga të apostrofuarit, me qëllim të rritjes së fuqisë parlamentare me kuadro të saj. Megjithatë, nënkryetari Gashi ka mohuar që brenda partisë apo edhe gjatë bisedave me partnerin e koalicionit të jetë shtruar çështja e ndarjes së ministrive. "Nuk kemi biseduar ende për cilat ministri do të përcaktohet AKR - ja", ka thënë ai. "Bisedimet shpresoj se do të rezultojnë me marrëveshje edhe me këtë pjesë të koalicionit. Natyrisht AKR - ja ka kërkuar gjashtë ministri, postin e zv. kryeministrit dhe shtatë zv. ministra...", ka shtuar ai. Hise në Qeveri, pos partive që përfaqësojnë komunitetin serb dhe joserb, pritet të ketë edhe Ukë Rugova. Mirëpo, ky i fundit, sipas zyrtarëve të PDK - së do të duhet të sigurojë një grup parlamentar në mbështetje të qeverisë. Zyrtarët e PDK - së, presin që marrëveshja për koalicion qeverisës të formalizohet brenda pak ditësh. "Besojmë që dy - tri ditët e ardhshme pritet qartësim edhe për çështjet që ndërlidhen me përfaqësimin e AKR - së në numra të caktuar të ministrive, të PDK - së, por edhe të partnerëve tjerë", ka thënë anëtari i Kryesisë së PDK - së, Memli Krasniqi. Koalicioni të PDK - AKR - lista "Rugova" - minoritetet edhe pse mund të ketë numra mjaftueshëm për ta përbërë shumicën parlamentare, prapëseprapë do të jetë një koalicion por që do të ketë mbështetje me të vogël të fuqisë elektorale, kundruall opozitës për së paku 20 mijë vota.

---

## Presidenti, nyja gordiane e PDK-së

---

**Dështimi në arritjen e marrëveshjes brenda PDK - së, sipas burimeve të gazetës, ka bërë që të rritet presioni ndërkombëtar ndaj saj.**

PRISHTINË, 13 SHKURT - Me shumë se tri orë diskutime të Kryesisë së PDK-së të dielën dhe takime thuaja të përditshme në ditët e shkuara, nuk janë përmbyllur me marrëveshje për të hyrë në koalicion me AKR-në. Duket se përplasjet në PDK nuk janë tejkaluar, duke e vazhduar kështu krizën e filluar tashmë muaj më parë, konstitucionale dhe politike. Grupi që përkrah, kandidaturën e Jakup Krasniqit për tu zgjedhur president i vendit, duket të jetë shumë i fuqishëm, pavarësisht që detajet nga takimi nuk janë zbardhur. Ndërkohë, që ka pasur më shumë se 24 orë, që qarkullonte lajmi për arritjen e marrëveshjes për koalicion PDK-AKR, sipas të cilës posti i presidentit të vendit do t'i takonte Behgjet Pacollit, kreut të AKR-së.

### Presioni

Dështimi në arritjen e marrëveshjes brenda PDK-së, sipas burimeve të gazetës, ka bërë që të rritet presioni ndërkombëtar, kështu që në ditët në vijim do të merret vesh, se cila është zgjidhja. Por, pavarësisht të gjitha spekulimeve, është e qartë se PDK nuk mund të ketë dy postet kryesore, presidentin dhe kryeministrin. Dhe sipas burimeve të gazetës, ndërkombëtarët e kanë bërë këtë gjë të qartë, sikurse kërkesën për një qeveri me njerëz me duar të pastra apo të pakorruptuar, gjë që ka çuar në shartimin e një liste prej katër emrash, të cilët duken të kenë mbështetje nga PDK-ja, që të jenë sërish në pozita serioze në institucione. Këto kushte të vëna, duket se po e mbajnë "peng" edhe përgjigjen për koalicion. Mbase çështja do të merrë zgjidhje, të hënën, ku priten të takohet Këshilli Drejtues i PDK-së, për të diskutuar çështjen e koalicionit dhe të ndarjes së pozitave në institucione dhe se kush nga PDK-ja do të udhëheq me postet. Në takimin e kryesisë së PDK-së, të dielën pasdite, ndonëse ka zgjatur tri orë, nga ora 16.00 deri në 19.00, nuk ka rezultuar me një vendim konkret sa i përket ndarjes së posteve dhe pozitave udhëheqëse në qeverisjen e re me partnerin e koalicionit, AKR - në. Por, që të dyja partitë duken të palëkundura në qëndrimet e tyre.

### Pranimi në heshtje

Pavarësisht përplasjeve duket se Kryesia e PDK-së, megjithatë e pranon në heshtje, se shtegdalja nga situata, është hyrja në koalicion me AKR-në, para se të vihet përballë rrezikut për humbjen e të drejtës për krijimin e qeverisë, meqë tërheqja e AKR-së, do të mund t'i linte pa shanse përpjekjet e PDK-së, që të krijojë institucionet. Prandaj, zyrtarët e lartë të PDK-së, duket të kenë qenë konstruktiv për mënyrën e vazhdimit të bisedimeve për partneritet me AKR-në, derisa diskutimet në organet e larta të kësaj partie ishin të përqendruara jo në emra, por në fuzionimin e programeve të PDK-së dhe AKR-së, si dhe partnerëve, vetëm për një qeverisje të konsoliduar. Mirëpo, një gjë tashmë është qartësuar se bisedimet në mes të ekipit të PDK-së dhe AKR-së do të vazhdojnë të hënën, derisa një vendim përfundimtar parashihet të merret gjatë javës. " Pjesë e diskutimeve në Kryesi ishin edhe çështjet më praktike dhe konkrete që ndërliken me fuzionimin e programit të PDK-së me programet e partnerëve të tjerë për të krijuar një program qeverisës të konsoliduar", u shpreh Krasniqi për të shtuar se gjatë takimit ka pasur konstruktivitet për vazhdimin e bisedimeve me koalicionin e AKR-së. Sipas tij PDK-

ja do të vazhdojë bisedimet për koalicion me AKR-në nga dita e hënë, po këtë ditë siç tha Krasniqi do të takohet edhe Kryesia dhe Këshilli Drejtues i PDK-së. Të hënën do të takohen edhe ekipi i organeve vendimmarrëse të PDK-së, Kryesia dhe Këshilli Drejtues në mënyrë që në ditët e ardhshme të kemi një finalizim edhe të marrëveshjes dhe hapave të mëtejshëm", potencoi Krasniqi. Derisa Krasniqi nuk ka dhënë detaje nëse PDK-ja e ka pranuar kërkesën kyçe të AKR-së që president të jetë Behgjet Pacolli, burime të gazetës thanë se presioni ndërkombëtar ndaj PDK-së, është rritur. "Presioni ndërkombëtar ndaj PDK-së po rritet, dhe kërkesa është që marrëveshja të arrihet sa më parë", deklaroi një zyrtar i lartë, i afërt me negociatorët për koalicion. Zyrtarë të AKR-së kanë bërë të ditur se nuk do të ketë tërheqje nga kërkesat e saj, kjo parti. "Nuk lëshojmë pe, dhe s'kemi pse ta bëjmë këtë", thanë zyrtarë të kësaj partie. Ndërkohë, që Krasniqi është munduar të jap një tablo negociatash pa tensione, tha se është e natyrshme se në çdo negociim të dyja palët kanë qëllimet fillestare dhe pastaj shkohen në drejtim të përafërimeve dhe arritjes së hapësirës së përbashkët. "Edhe ne jemi në këtë drejtim me AKR-në dhe nga të dy palët ka një besim se do të gjendet rruga e përbashkët për të arritur marrëveshjen, por kjo i mbetet vazhdimi të bisedimeve në ditët e ardhshme", potencoi Krasniqi, duke përjashtuar kushtëzimet. I pyetur nëse zotëri Pacolli do të jetë president, anëtar i Kryesisë z.Krasniqi, tha se nuk jemi koncentruar në çështjen e emrave tani, sa jemi koncentruar tek çështja parimore e themelimit të institucioneve. "Do të ketë një moment që do të ketë vendime edhe për njerëzit që do ta përbëjnë qeverinë dhe institucionet tjera duke përfshirë presidencën, por më e rëndësishme se kjo është baza parimore politike mbi të cilën do të arrihet një marrëveshje", u shpreh Krasniqi. Ndërkohë Krasniqi ka reaguar edhe ndaj përdorimit të terminologjisë "kushtëzim" nga Pacolli për postin e presidentit, duke theksuar se një term i tillë nuk është përdorur në diskursin e komunikimit nga asnjëra palë.

### **Lista pa ofertë**

"Nuk ka qenë pjesë e bisedimeve çështja e emrave dhe personaliteteve sepse duam ta depersonalizojmë këtë proces", tha ai. Sipas Krasniqit në marrëveshjen për koalicion do të përfshihen edhe partnerët tjerë, duke theksuar se me "Listën Dr. Ibrahim Rugova" ka pajtim për bashkëqeverisje. Krasniqi ka mohuar se gjatë së dielës të ketë pasur takim në mes të liderit Thaçi dhe Pacolli. Ndonëse deri më tash nuk është arritur marrëveshja për koalicionin qeverisës ndërmjet Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe Aleancës Kosova e Re (AKR), Lista "LDK Dr. Ibrahim Rugova", për të cilën është thënë se do të jetë pjesë e këtij koalicioni, ende nuk ka marrë ofertë zyrtare nga PDK-ja për bisedime, ka thënë njëri ndër themeluesit e kësaj Liste, Astrit Haraqija. Sipas pohimeve të deritanishme, AKR-ja do të marrë Presidencën, postin e një zëvendëskryeministri dhe katër ministri për t'i udhëhequr. Ndërsa, PDK-ja do të merrte postin e kryeministrit dhe të kryetarit të Kuvendit, një post të zëvendëskryeministrit dhe tetë ministri. Edhe pse ende nuk dihet zyrtarisht, megjithatë thuhet se edhe Lista " Dr. Ibrahim Rugova" do të drejtonte një ministri, edhe pse kjo e fundit ende nuk ka marrë ofertë zyrtare nga PDK-ja për hyrje në koalicion. Përfolët, gjithashtu se tri ministri do t'i ketë komuniteti serb, kurse pakicat tjera do të kenë dy ministri.

**SOT VAZHDOJNË NEGOCIATAT**

---

**PDK: Krasniqi mbetet kandidati ynë  
AKR – Zgjidhja është president**

---

**PDK - ja dhe AKR - ja kanë shprehur vullnetin për të lidhur koalicion qeverisës ndërmjet vete, por që nga fillimi i negociatave kanë hasur në qëndrime të kundërta sa i përket postit të presidentit. Këtë post, AKR - ja e sheh si mundësinë e panegociueshme për ta realizuar programin e vet, ndërsa PDK - ja e do Jakup Krasniqin shef të shtetit**

PRISHTINË, 13 SHKURT - Sot (e hënë) pritet të vazhdojnë negociatat për krijimin e koalicionit qeverisës ndërmjet PDK-së së Hashim Thaçit dhe AKR-së së Behgjet Pacollit. Këto negociata do të vazhdojnë në po të njëjtën pikë dhe me po të njëjtat qëndrime. AKR - ja duke kërkuar postin e presidentit, ndërsa PDK - ja duke vazhduar të qëndrojë në pozicionet e veta, duke e ruajtur postin e të parit të shtetit për sekretarin e përgjithshëm, Jakup Krasniqi. Edhe pse gjatë ditës së diel nuk është zhvilluar ndonjë takim ndërmjet të dyja partive, në orët e mbrëmjes Kryesia e PDK-së është mbledhur në një takim treorësh. Anëtari i Kryesisë së PDK - së, Memli Krasniqi, ka mohuar që gjatë këtij takimi të jetë diskutuar për postin e presidentit. Sipas tij, për këtë çështje do të diskutohet në ditët në vijim. Por, të kundërtën e asaj që ka deklaruar Memli Krasniqi i ka thënë "Epokës së re" një burim brenda Kryesisë së PDK së. Sipas këtij burimi, gjatë këtij takimi është diskutuar edhe për postin e presidentit. "Është konfirmuar mbështetja për kandidatin e nominuar ditë më parë nga kryesia, Jakup Krasniqin. Në këtë takim jemi dakorduar për t'i vazhduar negociatat me AKR - në", ka thënë ky burim. Në anën tjetër, edhe AKR - ja ka shprehur vendosmërinë të qëndrojë në pozicionet e veta. Zëvendëspresidentja e AKR - së, Mimoza Kusari - Lila, ka thënë se pozicioni i AKR - së nuk ka ndryshuar. Këtë sipas saj e ka mjaft të qartë edhe PDK-ja. PDK - ja dhe AKR - ja kanë shprehur vullnetin për të lidhur koalicion qeverisës ndërmjet vete, por që nga fillimi i negociatave kanë hasur në qëndrime të kundërta sa i përket postit të presidentit. Këtë post AKR - ja e sheh si mundësinë e panegociueshme për ta realizuar programin e vet, ndërsa PDK - ja e do Jakup Krasniqin shef të shtetit. Oferta e fundit e PDK - së për AKR - në ka qenë, posti i kryeparlamentarit, katër ministri, duke përfshirë këtu edhe propozimin që lideri i AKR - së, Behgjet Pacolli, ta ushtrojë postin e zëvendëskryeministrit dhe atë të ministrit të Punëve të Jashtme. AKR - ja në anën tjetër ka kërkuar që pjesë e marrëveshjes për koalicion të jetë posti i presidentit, zëvendëskryeministri dhe pesë ministri në kabinetin qeveritar. - Jetlir ZYBERAJ

---

## **KD mbështet Pacollin**

---

**Këshilli Drejtues i PDK-së, me shumicë votash ka marrë vendim që të hyhet në koalicion me AKR-në, Listën “Ibrahim Rugova” dhe partitë e komuniteteve, ku Behgjet Pacolli do të jetë president. Megjithatë, në PDK vazhdon të ketë kundërshtime të fuqishme për këtë vendim. Një anëtar i Këshillit Drejtues të PDK-së, i ka thënë gazetës se ky vendim, është fatal për vendin, pasi ka shkelur mbi idealin e votuesve të saj, duke pranuar për president një njeri të dyshimtë.**

Hajredin Kuçi, nënkryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, pas mbledhjes së Këshillit Drejtues të PDK - së, i cili ka zgjatur për më shumë se tri orë, ka thënë se mbledhja është mbajtur në një atmosferë shumë pozitive, e në të cilën anëtarët e këtij këshilli kanë ndarë mendimet e tyre si dhe në fund është arritur deri tek vendimi që funksionin e presidentit të vendit ta ushtrojë partneri i koalicionit nga radhët e AKR-së, ndërkaq që ai i kryeministrit dhe kryetarit të Kuvendit t'i takojë PDK-së. "PDK-ja ka vendosur që të hyjë në koalicion me AKR-në, ka vendosur që pozitat kryesore të ndahen, natyrisht që pozita e presidentit t'i takojë AKR-së, ndërsa për vendime të tjera për ministri do të jenë ato biseda dhe diskutime që do të diskutohen përmes kryesisë së PDK-së dhe asaj të AKR-së. Këshilli drejtues e ka formalizuar këtë vendim nga ana e tij tash vetëm pritet që formalisht të bisedojnë të dy delegacionet", ka thënë Kuçi. Tani pas vendimit të PDK - së për t'u pajtuar me kërkesën e AKR-së, presidenti i kësaj të fundit, Behgjet Pacolli, pritet të propozohet për president të vendit.

### **Në koalicion: PDK-AKR-Lisa Rugova- Minoritetet**

Ai më tej ka shtuar se gjatë kësaj mbledhje është vendosur vetëm për tri funksionet më të larta të shtetit, ndërkaq sipas tij, në takimet që do të zhvillohen në mes PDK e AKR-së do të diskutohet edhe për ndarjen e ministrive dhe që ky vendim i marrë nga Këshilli pritet që shumë shpejt të formalizohet nga kryesia e partisë. "Me një diskutim të hapur të të gjithë anëtarëve të Këshillit Drejtues me diskutime të cilat kanë menduar në kuptimin më të mirë për vendin, por edhe për PDK-në për pozicionet eventuale që mund t'i kenë në ndërtimin e vendit është arritur deri tek ky vendim. "Është vendim i Këshillit Drejtues të PDK-së që të ndërtohen institucionet e Kosovës sa më shpejt që është e mundur, është vendim i Këshillit Drejtues të PDK-së që të hyhet në koalicion me AKR-në, Listën Ibrahim Rugova dhe me partitë tjera të komuniteteve, ndërkaq që ky vendim pritet që të implementohet nga kryesia e PDK-së", ka thënë Kuçi.

### **I kemi numrat**

I pyetur nga mediat në rast se do të ekzistojë ndonjë rrezik që një pjesë e deputetëve të PDK - së të mos e votojnë Pacollin për president, pasi që ka pasur kërkesa që Jakup Krasniqi ta ushtrojë këtë funksion, ai ka thënë se nga vetë fakti që është marrë ky vendim, atëherë nuk pritet të ketë ndonjë rrezik. "Jo unë mendoj që Krasniqin nuk e kanë kërkuar vetëm një grup, por e ka kërkuar e tërë partia, kështu që nuk ka asnjë dilemë në këtë drejtim dhe nuk është mirë ta vëni në baraspeshë personalitetin e z. Krasniqi me asnjë personalitet tjetër në Kosovë, në anën tjetër kjo është pjesë e negociatave. Ne kemi negociuar disa herë me AKR-në, kemi takuar disa herë Këshillin Drejtues, Kryesinë e partisë, dhe kemi ardhur në këtë vendim. Dhe çdokush që e di tabelën e shumëzimit e di që janë numrat", ka thënë Kuçi.

## **AKR mirëpret vendimin e PDK - së**

E në anën tjetër, Mimoza Kusari-Lila, nënkryetare e AKR-së, ka konfirmuar për gazetën se në mbremjen e së hënës nga PDK-ja nuk ka pranuar asnjë vendim të tillë apo ndonjë ftesë për megjithatë ajo tha se tani ekziston një gatishmëri nga ta lidhur me pozicionet të cilat i kanë diskutuar. "Në takime natyrisht që ne do të diskutojmë për ministrinë, do të diskutojmë për ndarjen e dikastereve, do të diskutojmë për kriteret e përcaktimit të personave, natyrisht secila palë t'i prezantojë kandidatët e vet. Ne kemi thënë se ne kemi interesim më shumë për atë që funksioni i presidentit t'i takojë AKR-së, andaj tash kërkesat tona do të jenë kryesisht ministrinë, të cilat ofrojnë ekspertizë dhe që të jemi ne më profesionistë në kontributin për një qeverisje më të mirë", ka thënë Kusari-Lila. Kusari, gjithashtu ka thënë se beson që me formimin e institucioneve të reja nga partneriteti me PDK-në do të kemi një qeveri të fuqishme dhe me njerëz kompetentë dhe kredibile.

---

## **PDK e bën Pacollin president**

---

### **Këshilli Drejtues i PDK-së vendosi që posti i presidentit t'i jepet AKR-së, respektivisht Behgjet Pacollit**

Madje të njëjtat burime, të frustruara me vendimin e KD, kanë thënë se me këtë vendim, PDK me dëshirë po vetë shkatërrohet. Nënkyetari i PDK - së, Hajredin Kuçi, ndërkaq, pas mbledhjes së Këshillit Drejtues tha se mbledhja është zhvilluar në një atmosferë jashtëzakonisht pozitive. Sipas tij, PDK - ja ka rivendosur që të hyjë në koalicion me AKR - në. "KD ka vendosur që pozitat kryesore të ndahen me AKR - në, natyrisht që pozita e presidentit t'i takojë AKR - së, ndërsa për vendime të tjera për ministri do të jenë ato biseda dhe diskutime që do të diskutohen përmes kryesisë së PDK - së dhe asaj të AKR-së", ka thënë Kuçi. Ky, sipas tij, është vendim i Këshillit Drejtues të PDK - së që të ndërtohen institucionet e Republikës së Kosovës sa më shpejt që është e mundur. "Pra është vendim i Këshillit Drejtues të PDK - së, që të hyhet në koalicion me AKR - në, Listën "Dr. Ibrahim Rugova" dhe me partitë tjera të komuniteteve dhe se ky vendim pritet që të implementohet nga kryesia e PDK - së", ka thënë Kuçi. Ai gjithashtu ka thënë se PDK-ja merr vendime në të mirën e institucioneve dhe në të mirë të vendit. Nënkyetari i PDK-së nuk e komentoi, ndërkaq, nëse president i Kosovës do të jetë Pacolli, duke thënë se PDK sikurse çdo parti politike, ka mendime individuale. "PDK silllet si parti e përgjegjshme dhe vendimet i merr në të mirë të vendit", tha ai. Ndërkaq, sa i përket presidentit në detyrë, Jakup Krasniqi, i cili brenda mbledhjes së Këshillit Drejtues kishte mbështetje nga një grup i fuqishëm për president të vendit, Kuçi ka thënë se nuk bëhet fjalë për grup, por për mbështetjen e gjithë PDK - së për Krasniqin. "Unë mendoj që Krasniqin nuk e ka kërkuar një grup, por e ka kërkuar tërë PDK - ja. Kështu që nuk ka asnjë dilemë në këtë drejtim dhe nuk është mirë ta vëni në baraspeshë personalitetin e Jakup Krasniqit me asnjë personalitet tjetër në Kosovë", ka thënë Kuçi, sipas të cilit' negociatat që në përgjithësi nuk janë të lehta". Gjithashtu siç tha Kuçi, PDK nuk frikësohet se në seancën kur do të zgjidhet presidenti, mund të mos i ketë numrat e nevojshëm. "Çdokush që e di tabelën e shumëzimit e di që janë numrat", tha Kuçi. Nga ana tjetër, zëvendës presidentja e AKR - së, Mimoza Kusari - Lila ka thënë se posti i presidentit për AKR është hapi i parë i lëvizjes nga pozicionet e krijuara mes dy subjekteve PDK dhe AKR. "Është edhe një hapësirë e veprimit dhe një garanci për tri pikat kryesore, të cilat koalicioni për Kosovë të Re i vlerëson të domosdoshme për Kosovën. Ne besojmë fuqishëm që të kemi një qeveri të fuqishme dhe me njerëz kompetentë dhe kredibil që do të ballafaqohet me krizat që është duke u ballafaquar sot Kosova", ka thënë Kusari Lila. Ndërsa sa u përket dikastereve të tjera qeverisëse, AKR nuk ka vënë kushte duke marrë parasysh se kabineti qeverisës ndahet edhe me subjektet tjera që do të përfshihen në qeveri. "Në raport me ndarjen e pozitave duhet të bisedohet edhe me partnerët të ardhshëm qeverisës. Ende nuk jemi takuar me PDK, presim takime me ta dhe se nuk kemi caktim për ndonjë takim të mundshëm. Ne jemi në pritje të tyre", ka thënë Kusari - Lila.

---

## **Pacolli – president dhe Thaçi kryeministër, drejtojnë shtetin**

---

PRISHTINË, 14 SHKURT - Më në fund drejtuesit e dy partive, dhe ithtarët e tyre, mund të marrin frymë të lehtësuar, pasi Hashim Thaçi më në fund ka arritur të bind kolegët e tij në parti, që të pranojnë kushtet e AKR-së, për ta drejtuar shtetin në katër vjetët e ardhshme, aq sa u jep mandat Kushtetuta. Sipas marrëveshjes, ende jo përfundimtare sa i përket ndarjes së ministrive, numerikisht dhe cilësisht, Presidencën e vendit do ta drejtojë, Behgjet Pacolli, kryetar i AKR-së, ndërsa kryeministrinë Hashim Thaçi, kryetar i PDK-së, dhe kryeministër aktual. Burime të gazetës sonë, bëjnë të ditur se AKR-ja do të drejtojë të paktën tri ministri, sipas ofertës që besohet t'i jetë bërë nga PDK-ja të hënën, ndërkohë, që AKR-ja do të kërkojë të paktën pesë ministri. Por, sidoqoftë, kjo çështje mbetet të zgjidhet në negociatat gjatë ditëve të ardhshme ndërmjet këtyre dy partive, të cilat pritet të mbyllën të mërkurën. Po ashtu kjo parti do të ketë edhe postin e një zëvendëskryeministri, nga katër sa pritet t'i ketë kjo qeveri. Po ashtu pjesë e koalicionit do të jetë "Lista Rugova" me një ministri, së cilës spekulohet t'i bashkohen edhe disa deputetë të LDK-së, dhe partitë minoritare, 11 serbë që do të kenë të paktën tri ministri dhe postin e një zëvendëskryeministri dhe pakicat tjera me të paktën 10 deputetë, që do të kenë një ose dy ministri.

### **Bisedimet**

Tri orë debat duket se mjaftuan të hënën në Këshillin Drejtues të PDK-së, që të marrë vendim që posti i presidentit t'i takojë AKR-së, përkatësisht liderit të saj Behgjet Pacollit. Nënkryetari i PDK-së, Hajredin Kuçi tha se vendimi i Këshillit Drejtues është marr me konsensus. Në këtë ndarje të posteve, PDK-së do t'i takojë posti i kryeministrit dhe kryetarit të Kuvendit, derisa, gjatë ditëve në vijim këto parti do të bisedojnë për ndarjen e ministrive. Kuçi më tej theksoi se vendimit është marr pas një diskutimi të hapur dhe në kuptimin për të mirën e vendit dhe të PDK-së. Është vendim i Këshillit Drejtues të PDK-së që të ndërtohen institucionet e Kosovës sa më shpejt që është e mundur, duke hyrë në koalicion me AKR-në me Listën Dr. Ibrahim Rugova dhe me partitë e komuniteteve", tha Kuçi duke theksuar kështu se ky vendim mbetet që të implementohet nga PDK-ja. Sipas tij PDK-ja ka vendosur që të hyjë në koalicion me AKR-në, duke bërë kështu edhe ndarjen e posteve udhëheqëse. "Natyrisht pozita e presidentit t'i takoj AKR-së, ndërsa për vendimet, përkatësisht ndarjen e ministrive do të jenë pjesë e negociatave në mes të Kryesisë së PDK-së dhe Kryesisë së AKR-së", bëri të ditur Kuçi. Ndërkohë që ai nuk ka dashur të merret me komentimin e personalitetit të liderit të AKR-së Behgjet Pacolli, por theksoi se PDK-ja merr vendime në të mirën e institucioneve në të mirën e vendit dhe nuk hyjmë në vlerësime të personaliteteve. "Natyrisht ne kemi mendime individuale për secilin individ në Kosovë, por në fund të fundit partia sillet si parti me përgjegjësi të plotë", shprehet Kuçi. Ai gjithashtu bëri të ditur se tashmë Këshilli Drejtues ka bërë formale vendimin për koalicion dhe në ditët në vazhdim sipas tij pritet që dy delegacionet të bisedojnë formalisht. I pyetur se a ekziston rreziku që deputetët e PDK-së të cilët kanë kërkuar që president të jetë, Jakup Krasniqi mos ta votojnë Behgjet Pacollin për president, Kuçi tha se Krasniqin nuk e kanë kërkuar vetëm disa deputetë, por e ka kërkuar tërë PDK-ja. "Nuk është mirë ta vëni në baraspeshë personalitetin e z. Krasniqi me asnjë personalitet tjetër në



Kosovë. Ne kemi negociuar me AKR-në e që nuk kanë qenë lehtë, ne jemi takuar disa herë me AKR-në me Këshillin Drejtues të Partisë dhe atë të përgjithshëm dhe kemi arritur deri tek ky vendim", tha Kuçi. Ndërkohë i pyetur se nëse ka koalicioni numrat e mjaftueshëm, Kuçi tha se secili që e di matematikën e din këtë gjë. Nënkryetari Kuçi bënë të ditur se PDK-ja bënë marrëveshje edhe me partitë e minoriteteve dhe me Listën e "Dr. Ibrahim Rugova" derisa për postin e kësaj të fundit ai tha se do të jetë pjesë e negociatave të mëtejme. Meqë posti i presidentit u shndërrua në "nyje", gjatë bisedimeve për marrëveshje për koalicion qeverisës në mes të PDK-së dhe AKR-së, lideri i partisë mandatare Hashim Thaçi, gjatë ditës së hënë kishte intensifikuar angazhimet e tij për të arritur konsensus brenda partisë për hyrje në koalicion qeverisës me AKR-në.

### **Vendimi i PDK-së hap rrugë për bisedime të mëtejme**

Përfaqësuesit e AKR-së, ndërkaq vendimin e Këshillit Drejtues të PDK-së e shohin si një lëvizje nga pozicionet e mëhershme të kësaj partie, dhe që i hap rrugë të plotë krijimit të institucioneve "Natyrishë se ky vendim i PDK-së, hap rrugët për bisedime të mëtutjeshme dhe vazhdimin e negociatave për formimin e koalicionit qeverisës në mes të PDK-së dhe koalicionit për Kosovë të Re" tha për "Bota sot", zëvendëspresidentja e AKR-së Mimoza Kusari Lila. Ajo nuk qartësoi se cila ka qenë përmbajtja e ofertës, derisa PDK ka marrë një vendim të tillë, por theksoi se kjo është një fazë fillestare për të biseduar përtej pozicionit të presidentit të Republikës së Kosovës. "Nuk janë biseduar detajet e koalicionit, por pritet që ditëve të tjera gradualisht do të qartësohen së bashku me PDK-në dhe partnerët e tjerë, të cilët do të përfshihen në këtë koalicion", theksoi Kusari. Kusari nuk dha ndonjë datë apo ditë të saktë se kur mund të përfundojnë negociatat edhe për ndarje të tjera, të dikastereve të qeverisë. "Krijimi i qeverisë së re varet nga rrjedha e bisedimeve. Procesi i krijimit të koalicionit dhe specifikimi i tij është një proces shumë i rëndësishëm për ne, për Kosovën. Besojmë se me vullnetin e mirë të të dyja palëve dhe me një marrëveshje e cila është marrëveshje parimore dhe e bazuar në principe dhe në qeverisje të mirë. Besoj se mund ta arrijmë një sukses në raport me lëvizjen e institucioneve në Kosovë", tha Kusari, duke konfirmuar se Pacolli do të jetë president. Kusari, e cila besohet se do të drejtojë një nga ministritë kryesore, nuk ka dhënë detaje të tjera se cilat do të jenë kërkesat e kësaj partie në ndarjen e posteve në dikasteret e qeverisë, derisa ka theksuar se posti i presidentit tashmë është i negociuar, kurse për postet tjera do të jenë subjekte të diskutimit. Megjithatë ajo nuk ka përjashtuar mundësinë e marrjes së ministrive për të cilat AKR-ja ka shprehur edhe më herët kërkesat, duke theksuar kështu se AKR-ja është deklaruar për mundësinë e udhëheqjes në të gjitha ministrit ku kjo parti mund të ofrojë kontribut, përmirësimit të imazhit të Kosovës dhe qëndrueshmëri të institucioneve. Ajo premtoi se gjatë bisedimeve AKR-ja do të jetë e hapur, derisa bëri të ditur se deri më tani nuk ka specifikim për ministritë dhe bartësit e institucioneve. Oferta e AKR-së për të hyrë në koalicion me PDK-në ishte, që përveç postit të presidentit të kishte edhe një pozitë të zëvendëskryeministrit, gjashtë ministri dhe gjashtë zëvendësministra, derisa gjatë ditës së hënë bisedat në mes të liderit të AKR-së Pacolli dhe atij të PDK-së Thaçi.

Merren Vesh

---

## **PDK-ja presidencën ia lë Pacollit**

---

**Një burim brenda PDK - së i ka thënë "Epokës së re" se koalicioni qeverisës pritet të formohet më së largu deri të mërkurën. Gazeta ka marrë vesh se AKR - së, përpos postit të presidentit, do t'i takojnë edhe katër ministri dhe një post i zëvendëskryeministrit. Listës "LDK - Dr. Ibrahim Rugova" një ministri, kurse minoriteve tri ministri. Ndërkaq, posti i kryeministrit dhe ai i kryetarit të Kuvendit të Kosovës do t'i takojnë PDK - së**

PRISHTINË, 14 SHKURT - Këshilli Drejtues i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) ka marrë vendim të hënën që posti i presidentit t'i takojë koalicionit Aleanca Kosova e Re (AKR). Ndërsa posti i kryeministrit dhe ai i kryetarit të Kuvendit të Kosovës do t'i takojnë PDK - së. Ky vendim është marrë pas një debati të gjatë treorësh. Një burim brenda PDK - së i ka thënë "Epokës së re" se AKR - së, përpos postit të presidentit, do t'i takojnë edhe katër ministri dhe një post i zëvendëskryeministrit. Listës "LDK - Dr. Ibrahim Rugova" një ministri kurse minoriteteteve tri ministri. Po ashtu, është vendim i Këshillit Drejtues që posti i kryeministrit dhe kryetarit të Kuvendit të Kosovës t'i takojnë PDK - së, ndërkaq posti i presidentit AKR - së", ka thënë Kuçi. Sa i përket ndarjes së pozitave dhe deputetëve të Kuvendit për ta votuar qeverinë e re, Kuçi ka thënë se tash për tash dihet vetëm mandatarin e qeverisë, Hashim Thaçi, kurse për pozitave të tjera do të vendoset në ditët në vijim. "Çdo kush që e di tabelën e shumëzimit e di se PDK - ja i ka numrat për formimin e qeverisë. Në kuadër të PDK - së ka vendim vetëm për mandatarin për kryeministër të Kosovës, z. Hashim Thaçi, ndërkaq për emrat dhe pozitave të tjera do të vendoset ditët e ardhshme", ka thënë Kuçi. Më tutje, Kuçi e ka përshkruar diskutim korrekt nga të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues të kësaj partie. "Ishte një mbledhje me një atmosferë jashtëzakonisht pozitive, me një diskutim të të gjithë anëtarëve të Këshillit të PDK - së, të cilët në diskutimet e tyre kanë folur për vendin dhe për PDK-në, për pozicionet eventuale që mund t'i kenë për ndërtimin e vendit", është shprehur Kuçi, duke shtuar se PDK - ja është parti demokratike, e cila merr vendime për të mirën e Kosovës dhe të ardhmën e saj. "Jemi parti demokratike, ka mendime individuale, por PDK - ja merr vendime në të mirë të institucioneve, në të mirën e vendit. Natyrisht se ne kemi mendime individuale për secilin individ në Kosovë, por në fund të fundit PDK - ja sillet me shumë përgjegjësi", ka thënë Kuçi. I pyetur nga gazetarët lidhur me përkrahjen që kishte Jakup Krasniqi për president brenda PDK - së, Kuçi është përgjigjur: Jakup Krasniqin për president nuk e ka kërkuar një grup në PDK, por e gjithë PDK - ja". Gjatë ditës së sotme (e martë) PDK - ja do të zhvillojë takime me partnerët e koalicionit qeverisës, me ç'rast do të diskutojë rreth ndarjes së posteve ministrore.

### **Fitou: Do të ishte më mirë një koalicion më i gjerë me një opozitë të fortë**

Ambasadori francez Jean Francua Fitou ka thënë të hënën se as bashkësia ndërkombëtare e as kori diplomatik në Kosovë nuk duhet të bëjnë presion në partitë politike për krijimin e koalicionit qeverisës sepse Kosova është shtet i pavarur. Fitou, po ashtu, ka deklaruar se nuk duhet ngutur shumë për krijimin e koalicionit. Sipas tij, në fazën kur Kosovën e pret dialogu me Beogradin, do të ishte më mirë të krijohet një koalicion më i gjerë dhe një opozitë e fortë.

---

## **PDK-ja dorëzohet para Pacollit**

---

Behgjet Pacolli nuk mund të krahasohet në asnjë rrafsh me Jakup Krasniqin, si në rrafshin politik, po ashtu as në atë intelektual këtë e thamë edhe në takimin e Këshillit Drejtues. Për këtë ne kemi faktet të cilat e argumentojnë angazhimin dhe rolin që zoti Krasniqi e ka pasur dhe vazhdon ta ketë në zhvillimet politike të rëndësishme për vendin", ka thënë njëri nga anëtarët e Këshillit Drejtues, i cili ka preferuar të mbetet anonim. Ai ka treguar se Krasniqi ishte përkrahur vazhdimisht gjatë takimit të Këshillit Drejtues, por pasi që përfaqësuesit e lartë të kësaj partie kishin shpjeguar para anëtarëve të Këshillit se PDK - ja do të duhej të tërhiqej nga posti i presidentit, pasi që Koalicioni për Kosovë të Re ishte partneri i vetëm shqiptar, që kishte pranuar të hynte me të në koalicionin qeverisës. "Përkrahja për Krasniqin ka qenë e madhe, por PDK - ja nuk ka pasur tjetër rrugëdalje, sepse qytetarët e kanë votuar këtë parti dhe ia kanë dhënë përgjegjësinë për krijimin e institucioneve. Dhe duke e parë se partitë tjera i vendosën vijat e kuqe, ne është dashur të jemi fleksibël sepse AKR - ja ka qenë partia e vetme në të cilën ne mund të llogarisnim", ka deklaruar i njëjti anëtar. Ai ka shtuar se AKR - ja e ka shfrytëzuar këtë situatë. "Ka pasur zëra të fuqishëm, të cilët kanë thënë se Behgjet Pacolli nuk e meriton ta marrë postin e presidentit dhe shihet se kërkesa e tij ka qenë një imponim", tha burimi i gazetës. "Thjesht, tërheqja e partive tjera nuk na ka mundësuar që të kemi një përzgjedhje më të mirë për të pasur një qeveri stabile sesa kjo që do të jetë tash", është shprehur anëtari Këshillit Drejtues. Por, vendimi i marrë nga Këshilli Drejtues i PDK - së është vetëm hapi i parë, por jo edhe përfundimtari që e afron Pacollin tek dyert e Presidencës së vendit. Ai duhet të marrë votat e nevojshme nga deputetët e Kuvendit të Kosovës për t'u zgjedhur president, ndërsa një burim nga PDK-ja tha se prej 34 deputetëve të kësaj partie, së paku 10 nuk është ë sigurtë se do ta votojnë Pacollin.

### **Krasniqi i nënshtrohet vendimit të partisë**

Ndërkohë që Krasniqi, i cili ishte përfolur si kandidat i mundshëm për president, sipas burimeve të gazetës është pajtuar me vendimin e Këshillit Drejtues dhe se ka hequr dorë përfundimisht nga ambicia për t'u bërë president. Në një deklaratë për "Kohën Ditore", Krasniqi ka thënë se do ta pranojë vendimin edhe pse është dukur i nervozuar derisa ka dalë nga takimi i Këshillit Drejtues. "Realisht ka qenë një vendim me konsensus për shkak të nevojës për të krijuar institucionet dhe unë do të respektoj këtë vendim të Këshillit Drejtues", është shprehur Krasniqi. Ai nuk ka dashur të komentojë fjalët e atyre anëtarëve të Këshillit Drejtues të PDK - së që kanë thënë se "Pacolli nuk e meriton të jetë president". "Realisht atë do të duhet ta vlerësojnë të tjerët, unë në këtë rast nuk do të doja ta vlerësoja", është përgjigjur Krasniqi. Nga ana tjetër, nënkryetari i PDK - së, Hajredin Kuçi, pas mbledhjes së KD të PDK - së, ka treguar para gazetarëve se kjo parti me një konsensus të përgjithshëm ka vendosur që posti i presidentit t'i takojë Aleancës Kosova e Re. "Partia Demokratike e Kosovës ka vendosur që të hyjë në koalicion me AKR - në, ka vendosur që pozitat kryesore të ndahen, natyrisht edhe pozita e presidentit t'i takojë AKR - së", ka thënë Kuçi, duke shtuar se nuk është diskutuar për emrat, por vetëm që posti t'i takojë AKR - së. Ai më tutje ka shtuar se koalicioni qeverisës do të përbëhet nga PDK-ja, AKR - ja, lista "Ibrahim Rugova" dhe minoritetet. "Eshtë vendim i Këshillit Drejtues të PDK - së që të hyhet në koalicion me Aleancën Kosova e Re, me listen

Ibrahim Rugova dhe me partitë tjera të komuniteteve. Ky vendim tani mbetet që të implementohet nga Kryesia e PDK - së", ka deklaruar nënkryetari i parë i PDK - së. Por, pas këtij njoftimi të Kuçit, me gjithë përpjekjet e gazetës ka qenë e pamundur të merret një qëndrim i zyrtarëve të listës "Ibrahim Rugova". Një ditë më parë, Bujar Bukoshi, ka deklaruar për mediet se Lista nuk ka asnjë ofertë zyrtare nga PDK - ja. Në anën tjetër, nënkryetari i PDK - së, gjatë kësaj paraqitjeje, ka përmendur se për të arritur deri te konsensusi që Presidenca t'i takojë AKR - së, ka pasur diskutime të gjata brenda Këshillit Drejtues të partisë. "Ka pasur biseda dhe mendime, por PDK - ja në fund është pajtuar për konsensus për vendimin që e thashë", ka thënë Kuçi, duke shtuar se "ne jemi parti demokratike, ka mendime individuale, por PDK - ja, merr vendime në të mirën e institucioneve, në të mirën e vendit dhe nuk hyjmë në vlerësime të personaliteteve". Duke u ndalur te propozimi brenda partisë që Presidenca t'i takoj PDK - së, konkretisht sekretarit të përgjithshëm Jakup Krasniqit dhe rrezikut që disa deputetë të PDK - së, përkrahës të Krasniqit, të mos e votojnë liderin e AKR - së, Behgjet Pacollin për president të Kosovës, Kuçi ka thënë se konsensusi brenda partisë është arritur për shkak se është dashur që të krijohet koalicioni qeverisës, ndërsa ka kërkuar që të mos bëhen krahasime në mes të Jakup Krasniqit dhe Behgjet Pacollit. "Nuk është mirë ta vëmë në baraspeshë personalitetin e zotit Krasniqi me asnjë personalitet tjetër në Kosovë. Në anën tjetër kjo është pjesë e negociatave, që negociatat s'janë të lehta", ka thënë Kuçi. Ky zyrtar i PDK - së, për fund, ka treguar që KD i partisë, nuk ka biseduar apo vendosur për postet e tjera që do të ndahen në mes të partnerëve të koalicionit, apo qoftë brenda vetë PDK - së.

### **"Sakrifikimi " i Jakupit**

Ndërkohë që vendimi i PDK - së për ta liruar postin e presidentit është vlerësuar si "sakrificë" e kësaj partie, nga nënkryetari tjetër i PDK - së, ish - kryeministri Bajram Rexhepi. Në një deklaratë për "Kohën Ditore", Rexhepi ka thënë se "shumica dërmuese e zyrtarëve kanë qenë për koalicion me AKR – në, pavarësisht se ka qenë e dhimbshme. Ne e vlerësojmë lart personalitetin e Jakup Krasniqit, të cilin e kemi propozuar për president. Mirëpo ne s'kemi pasur rrugdalje tjetër, është dashur të sakrifikohet posti i presidentit, të shkohet në koalicion ose të hyjmë pa koalicion edhe të shkojmë në zgjedhje të parakohshme prapë", ka thënë Bajram Rexhepi. Ai ka sqaruar se PDK - ja, në diskutimet e gjata, i ka përmendur të gjitha mundësitë që të mbahet edhe posti i presidentit për Krasniqin. "I kemi provuar, i kemi shterur të gjitha mundësitë që posti i presidentit duhet t'i takojë Jakup Krasniqit, por me këtë përqindje të numrave nuk ka pasur mundësi të tjera", ka deklaruar Rexhepi "Ne si parti fituese e kemi obligim edhe ndaj elektoratit, edhe për interes të Kosovës që sa më shpejt të formohen institucionet edhe të përballemi me sfidat që i kemi përpara" , ka thënë më tutje Rexhepi, duke shtuar se për asnjë moment gjatë diskutimeve Jakup Krasniqi nuk ka kundërshtuar vendimin e partisë. "Zoti Krasniqi është person unifikues dhe ai është pajtuar me këtë vendim". Edhe nënkryetari tjetër, Rustem Mustafa, ka thënë për gazetën se "pavarësisht se në parti ka pasur diskutime të vështira, vendimi i partisë ka dalë me një konsensus të përgjithshëm dhe ai duhet të respektohet nga të gjithë në PDK".

### **Kampi i Pacollit mirëpret ndryshimin në PDK**

Ky vendim i PDK - së është mirëpritur në partinë e Pacollit, i cili e kishte kushtëzuar PDK - në se nëse nuk do t'ia ofronte postin e presidentit AKR - ja do të mbetej në opozitë. Nënkryetari i kësaj partie, Ibrahim Makolli, ka thënë "AKR - ja e mirëpret vendimin e PDK - së që posti i presidentit t'i takojë zotit Pacolli, pasi që kërkesa e tij ka qenë e arsyeshme dhe se PDK - ja e

ka kuptuar këtë me vendimin të cilin e ka marrë", ka vlerësuar Makolli. Ai ka shtuar se ky vendim u ka hapur rrugë negociatave për dikasteret me të cilat do të udhëheqë AKR-ja. "Është shumë e rëndësishme që pjesa më e rëndësishme e negociatave është zgjidhur dhe në ditët në vijim do të zhvillohen diskutimet për ministritë të cilat do të na takojnë neve si koalicion", është shprehur Makolli. Kurse zv. presidentja e AKR - së, Mimoza Kusari - Lila, ka thënë se tash për tash Koalicioni Kosova e Re, synon që të udhëheqë ministritë të cilat sipas këtij koalicioni do të ndikonin në përmirësimin e imazhit të Kosovës. "Në bazë të prezantimit programor, Koalicioni për Kosovë Të Re, ka shprehur preferenca që të udhëheqë ministritë që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik të vendit dhe me ato ministri përmes të cilave koalicioni ynë do të mund të ndikonte në përmirësimin imazhit të Kosovës", ka deklaruar Kusari – Lila.

---

## PDK-ja lëshon pe, Pacolli President

---

**PDK - ja për Shën Valentin i ka ofruar "dhuratë" AKR-së postin e presidentit. Nënkryetari i PDK- së, Hajredin Kuçi, tha se ky vendim është arritur me konsensus. Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje thonë se nuk do ta votojnë Qeverinë, e as Pacollin për president. Seanca konstituive e Kuvendit mbledhet pas trevjetorit të pavarësisë**

### **Koalicioni në Ditën e të Dashuruarve**

Pikërisht në këtë ngjarje, Këshilli i Përgjithshëm i PDK - së, pas tri orë në mbledhje, ka vendosur që të hyjë në koalicion me Aleancën për Kosovë të Re. Ndërkohë, siç merret vesh seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës e parashikuar për 24 shkurt do të mbahet më herët. Kështu, burime tona theksojnë se u.d. i presidentit, Jakup Krasniqi pritet që të thërrasë, seancën e Kuvendit më 21 shkurt, ku veç pjesës konstituive do të votohet edhe pakoja e marrëveshjes për koalicion që përfshin presidentin dhe kabinetin qeveritar. Këshilli Drejtues vetëm sa e ka konfirmuar një publikim muaj më parë të gazetës se koalicioni do të ndërtohet në Ditën e Shën Valentinit, pavarësisht formulave që mund të jenë. Sipas kësaj marrëveshjeje, AKR-ja e merr postin e presidentit, kurse PDK - ja e mban atë të kryeministrit dhe kryetarit të Kuvendit. Kjo u bë e ditur nga numri dy i PDK - së, Hajredin Kuçi, gjatë një komunikimi me media. "Është vendim i Këshillit Drejtues të PDK - së që të ndërtohen institucionet e Republikës së Kosovës sa më shpejt që të jetë e mundur. Është vendim i Këshillit Drejtues të PDK - së që të hyhet në koalicion me AKR - në, me Listën "Ibrahim Rugova" dhe me partitë tjera të komuniteteve. Ky vendim tani mbetet të implementohet nga Kryesia e PDK - së, tha nënkryetari i PDK - së, Hajredin Kuçi.

### **Kuçi: Pajtëm me konsensus**

Si kusht i AKR - së për hyrje në koalicion me PDK - në ka qenë që postin e presidentit të Kosovës ta ketë Behgjet Pacolli. PDK - ja fillimisht ka dashur ta mbajë këtë post, të iniciuar nga një pjesë e madhe e anëtarësisë dhe atë ta udhëheqë Jakup Krasniqi. Numri dy i PDK - së, Kuçi , tha se ka pasur biseda dhe diskutime, por PDK - ja në fund është pajtuar me konsensus për këtë qëndrim. "PDK ja ka vendosur të hyjë në koalicion me AKR - në dhe që pozitë kryesore të ndahen. Natyrisht që pozita e presidentit do t'i takojë AKR - së, ndërsa vendimet tjera për ministri do të jenë ato që do të negociohen ndërmjet Kryesisë së PDK - së dhe Kryesisë së AKR - së", tha ai. Kuçi tha se PDK-ja ka vendim vetëm për mandatarin për kryeministër të Kosovës. Emrat e tjerë, sipas tij, do të diskutohen në ditët në vijim në Kryesi dhe organet kompetente marrin vendim. Më herët është thënë se AKR - së i janë ofruar posti i zëvendëskryeministrit dhe katër ministri tjera. Pavarësisht mendimeve kundër dhënies së postit të presidentit partnerit të koalicionit, Kuçi tha se PDK - ja në fund merr vendime konsensuale. "Ne jemi parti demokratike, ka mendime individuale, por PDK - ja merr vendime në të mirën e institucioneve, në të mirën e vendit. Natyrisht, ne kemi mendime individuale për secilin individ në Kosovë, por, në fund të fundit, partia sillet me përgjegjësi", tha ai.

## **Janë numrat**

E teksa pritet që këtë vendim ta formalizojnë dy delegacionet në ditët në vijim, ende mbetet e paqartë nëse Pacolli do të votohet nga të gjithë deputetët e PDK - së. Por, Kuçi i hoqi dilemat rreth mbështetjes që ka pasur Krasniqi. " Atë nuk e ka kërkuar një grup, por tërë PDK - ja, kështu që nuk ka asnjë dilemë në këtë drejtim. Në anën tjetër, kjo është pjesë e negociatave që nuk janë të lehta. Ne kemi negociuar disa herë me AKR - në, Kryesia e partisë disa herë është takuar, sikur grupi parlamentar dhe Këshilli Drejtues, për të arritur në këtë vendim", tha ai. Kuçi është shprehur i sigurt që do të ketë numra të mjaftueshëm për ta votuar Pacollin për president vendi. "Çdo njeri që e di tabelën e shumëzimit, i di numrat", ka thënë ai.

## **Opozita nuk e voton Qeverinë, e as Pacollin**

Pavarësisht marrëveshjes ndërpartiake në letër ndërmjet PDK - së dhe AKR - së për një koalicion qeverisës, duke marrë me vete edhe subjektet politike minoritare, nga dilemat mbetet sigurimi i votave, edhe pse zyrtarë të PDK - së pohuan se ka numra të mjaftueshëm që Pacolli të zgjidhet president. Mirëpo, mendim të kundërt kanë deputetët e opozitës, të cilët kanë theksuar se në rast të ndonjë krize në sigurimin e votave, ata nuk do ta mbështetin zgjedhjen e presidentit. Nëse PDK - ja dhe AKR - ja nuk arrijnë ta krijojnë shumicën e votave brendapërbrenda subjekteve të tyre politike dhe partnerëve minoritarë, votat e deputetëve të opozitës në përbërjen e tyre të plotë do të jenë kundër kandidaturës që e propozojnë partnerët e rinj në koalicion. Në Lidhjen Demokratike të Kosovës, pozicionimi për votim në seancën ku do të votohet pakjoja e koalicionit të ri qeverisës, përcaktimi i votës është qartësuar dhe ai do të jetë kundër, edhe për kabinetin qeveritar, por edhe për vetë kandidatin për president, që pritet të jetë, sipas të gjitha gjasave, kandidatura e Behgjet Pacollit. "Faktikisht, nga aspekti politik, ne kemi vendosur që të jemi opozitë. Në këtë rast, derisa presidenti është marrëveshje e koalicionit qeverisës që po ndërtohet, pa marrë parasysh që në këtë rast mund të jetë z. Pacolli, por kushdo që të jetë , është dhe do të jetë votë kundër", tha deputeti i LDK - së, Armend Zemaj. Përndryshe, ai tha se po të arrihej marrëveshje politike e gjerë për ta gjetur një figurë mbipartiake konsensuale, atëherë do t'ia vlente që të analizohej vetëm performansa dhe bagazhi i atij kandidati, për të cilin pastaj të gjithë deputetët do të mund të votonin sipas bindjeve të tyre individuale për atë figurë që do të kishte dalë si propozim gjithëpërfshirës nga spektri i gjerë i subjekteve politike pa dallim pozicioni, në pozitë apo opozitë.

## **Pacolli, e kundërta e programit të Lëvizjes "Vetëvendosje"**

Vota kundër kandidaturës së z. Pacolli për president duket se është siguruar edhe te grupi parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje". Këtë qëndrim të kristalizuar e ka paralajmëruar për gazetën deputeti i këtij grupi të ri politik, Glauk Konjufca. "Lëvizja Vetëvendosje" gjithçka që voton, e voton ose nuk e voton, vetëm duke vlerësuar nëse është apo nuk është në përputhje me programin e vet politik. Në këtë rast, z. Pacolli është e kundërta e programit tonë dhe për më tepër se kaq është edhe instrument i PDK - së", tha Konjufca, nga Lëvizja "Vetëvendosje". Rreth kësaj çështjeje, një qëndrim zyrtar nuk është finalizuar akoma në AAK, subjekti i tretë politik opozitar në Parlamentin e Kosovës, që ka 12 vende deputetësh. Deputetja Donika Kada - Bujupi thotë se kohët e fundit, imazhi i Kosovës është dëmtuar shumë nga mungesa e institucioneve funksionale, prandaj në momentin e fundit të ndërtimit të tyre duhet menduar seriozisht, duhet vepruar me maturi, duke e vlerësuar para së gjithash interesin e shtetit të

Kosovës. Vendimi final i AAK-së për mënyrën e votimit në Kuvend dhe për kabinetin qeveritar, por edhe për presidentin, do të merret pasi të këtë bërë gjithçka publike në marrëveshjen e partnerëve qeverisës, kushdo që do të jenë ata. "Unë konsideroj që leadershipi në Kosovë, në përgjithësi, duhet të tregojë një seriozitet të madh edhe gjatë marrjes së pushtetit apo përgjegjësi, qoftë për president, qoftë në pozitat legjislative, apo për ekzekutiv. Konsideroj që imazhi i Kosovës në periudhën e fundit ka degraduar shumë në arenën ndërkombëtare, prandaj veprimet e mëtutjeshme duhet të jenë veprime serioze, të mbështetura në një politikë institucionale, e cila ka munguar shumë në Kosovën e pasluftës. Ne si AAK dhe si grup parlamentar ende nuk kemi takuar as për të vendosur për të votuar për presidentin, për arsye se ende nuk ka një kandidaturë zyrtare të prezantuar nga koalicioni eventual që do të ndërtohet. Gjithçka edhe më tutje po duket si në mjegull dhe nuk ka informata të sakta, por deri në orët e fundit gjithçka ka qenë mbi bazën e spekulimeve", tha Donika Kada Bujupi. Gazeta ka provuar të marrë opinione edhe nga deputetët e rinj të PDK - së për të parë nëse ata janë të gatshëm të bëjnë ndonjë kompromis që ta nxjerrin situatën nga kriza, para së cilës mund të gjendet vendi, por ishte e pamundur që dikush prej tyre kontaktohej në telefon. Përndryshe, marrëveshja eventuale që do të arrihet nga krerët e partive politike shqiptare, për cilëndo pikë, do të jetë e pranueshme për të gjitha minoritetet që janë pjesë e partneritetit kushtetues në qeverisje, liberalët serbë dhe grupi parlamentar 6+, që tubon rreth vetes subjektet politike joshqiptare dhe jo serbe. Eksperti për çështje kushtetuese, Mazllum Bajraliu, thotë se PDK-ja e pati shansin e fundit që të arrijë marrëveshje politike brendapërbrenda subjektit të vet politik dhe partnerëve të vet për t'i bërë votat e kalimit të pakos së koalicionit, në të kundërtën LDK - ja dhe subjektet tjera mund ta krijonin, sipas Kushtetutës, Qeverinë e pakicës me marrëveshje politike deri në zgjedhjet e radhës. Ndryshe, ai thotë se çdo formë e mosmarrëveshjes në rend të parë brenda partnerëve të koalicionit, në mos numërimin e votave për ndonjërin nga pjesët e pakos, mund të sjellë krizë serioze për ndërtimin e Qeverisë së re dhe institucioneve të tjera. "Cilado mënyrë e veprimit ndryshe, përveç asaj që parashihet në marrëveshje, qoftë nga njëra, qoftë nga ana tjetër, nënkupton se ky është minimumi i minimumit i substancës që mund të krijojë një qeveri dhe një koalicion dhe kjo mund të prodhojë krizë", tha Bajraliu. L. KRASNIQI & S. AHMETI



---

## Koalicioni Zyrtarizohet pas 17 shkurtit

---

**Gazeta ka marrë vesh se kryetari i PDK - së, Hashim Thaçi, pritet t'i mbajë për vete këto ministri: Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, Ministrinë e Transportit dhe Postë - Telekomunikacionit, Ministrinë e Jashtme, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Energjetikës, Ministrinë e Integritimit Evropian si dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, kurse ministrinë e tjera do t'u takojnë partnerëve qeverisës. Lista "Dr. Ibrahim Rugova", përveç një ministrie, mund ta përfitojë edhe postin e një zëvendëskryeministri**

PRISHTINË, 15 SHKURT - Zyrtarizimi i koalicionit qeverisës ndërmjet Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Koalicionit Aleanca Kosova e Re (AKR), Listës "Dr. Ibrahim Rugova" dhe minoriteteve do të ndodhë pas datës 17 shkurt. Lajmin e ka konfirmuar për "Epokën e re" një burim brenda PDK - së. "Nuk është e domosdoshme që të formalizohet sot (e mërkurë) koalicioni qeverisës. Formalisht tashmë dihen partnerët e koalicionit. Nënshkrimi i koalicionit do të ndodhë gjatë kësaj jave, ndoshta të premtën apo të shtunën" ka thënë ky burim brenda PDK - së. Pavarësisht paralajmërimeve se gjatë së martës do të ketë takime ndërmjet partnerëve të koalicionit për të diskutuar rreth ndarjes së posteve ministrore, një gjë e tillë nuk ka ndodhur. "Takime do të ketë këto dy ditë me partnerët, me të cilët do të diskutohet për ndarjen e pozitive në qeveri", është shprehur i njëjti burim. Gazeta ka marrë vesh se kryetari i PDK - së, Hashim Thaçi, pritet t'i mbajë për vete këto ministri: Ministrinë e Ekonomisë dhe Ministrinë e Financave, Transportit dhe Postë e Telekomunikacionit, Ministrinë e Jashtme, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Energjetikës, Ministrinë e Integritimit Evropian si dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, kurse ministrinë e tjera do t'u takojnë partnerëve qeverisës. Lista "Dr. Ibrahim Rugova", përveç një ministrie, mund ta përfitojë edhe postin e një zëvendëskryeministri. I kontaktuar nga "Epoka e re" Astrit Haraqija, njëri nga themeluesit e kësaj liste, as nuk e ka mohuar e as pohuar një gjë të tillë. Haraqija ka thënë se Lista "Dr. Ibrahim Rugova" ka për qëllim ndërtimin e institucioneve të vendit, e jo postet brenda koalicionit qeverisës. "Për ne pak kanë rëndësi postet. Për ne rëndësi ka krijimi i institucioneve të vendit. Ne si Listë... nuk qesim kushte", ka thënë Haraqija. Kabineti i ardhshëm qeveritar pritet t'i ketë 16 ministri dhe katër zëvendëskryeministra.

---

## **Kush do të jenë ministrat e qeverisë së ardhshme të Kosovës**

---

Përderisa AKR-ja ka bërë gati listën me emra të mundshëm të ministrave, PDK-ja ende i mban "të fshehur" emrat e ministrave të mundshëm të kabinetit qeveritar. Në mbrëmjen e 14 shkurtit, Ditës Ndërkombëtare të të Dashuruarve, e njohur si "Valentine Day" është "kurorëzuar" koalicioni i shumëpritur i shumëpërfolur ndërmjet PDK-së dhe AKR-së. Kështu PDK-ja, pas shumë mos pajtimesh brenda partisë, më në fund është pajtuar që postin e presidentit t'ia japë liderit të Aleancës Kosova e Re, Behgjet Pacollit. Ky i fundit që nga themelimi i partisë dhe në vazhdimësi gjatë procesit zgjedhor në Kosovë, ka pasur për synim të marrë postin e të parit të shtetit. Përderisa Qeverinë e Kosovës do ta udhëheqë PDK-ja, lakmia për udhëheqjen e ministrive më të rëndësishme mbetet një çështje që siç duket do të jetë edhe "mollë" shërr për konsolidimin e institucioneve qeverisëse.

### **PDK-ja i mban "të fshehur" emrat e ministrave**

Partia Demokratike e Kosovës e cila është edhe "bajraktari" për formimin e institucioneve, shumë shpejt do të dalë me formulën qeverisëse, ndonëse zyrtarë të saj deri në marrjen e një vendimi nga kryeministri Thaçi nuk duan të spekulojnë rreth ndarjes së resorëve ministrorë. Sido që të jetë, mesi i kësaj jave mendohet se do të jetë dita kur Kosova do të "zbardhë" me qeveri dhe institucione të reja. Burime brenda PDK-së thonë se në poste aktuale do të mbeten ministri i Punëve të Brendshme Bajram Rexhepi dhe ai i Bujqësisë Blerand Stavileci, derisa ende nuk dihet cili do të jetë vendimi i kryeministrit për ministrat tjerë. Emri më i përfolur për të drejtuar Ministrinë e Kulturës është ai i Memli Krasniqit, por ky vendim do të merret në ditët në vijim. Pra, marrë në përgjithësi "marrëveshja" për krijimin e institucioneve është arritur, por ajo që është mbetur të dihet është ndarja e ministrive. Se kujt do t'i takojnë këto ministri ende nuk dihet, por me siguri PDK-ja nuk do të heqë dorë edhe aq lehtë nga to. Ndonëse ditëve të fundit spekulohet shumë për emra të caktuar të kandidatëve potencialë që do të udhëheqin ministri të caktuara, "befasia" do të ndodhë pas marrëveshjes që do të bëjnë kryeministri Thaçi dhe kandidati për president Behgjet Pacolli. Ndonëse oferta e PDK-së për partnerin e koalicioni ka qenë posti i presidentit dhe tri ministri, me këtë nuk pajtohen përfaqësuesit e ARK-së, të cilët pretendojnë të kenë më shumë hapësirë duke kërkuar kështu postin e zëvendëskryeministrit dhe gjashtë ministri. Flitet se nga 18 ministri, sa kanë qenë deri më tash, qeveria e re e Kosovës do të ketë 16 sosh, 4 zëvendëskryeministra, një nga ta do të jetë nga komuniteti serb. Ndër të tjera ata do të kenë për detyrë që të kontrollojnë punën e 4 ministrive, ka bërë të ditur ministri në largim i arsimit, Enver Hoxhaj. Ka gjasë që në qeverinë e ardhshme të mos ketë Ministri të Energjisë, të Transportit dhe të Pushtetit Lokal. Këto ministri do të fuzionohen në ministrinë e tjera përkatëse. Ndërkaq, në kuadër të 16 ministrive, tri sosh do të jenë pa portofol. Po ashtu bëhet e ditur se Ministria e Ekonomisë do të jetë një e përbashkët me atë të Energjetikës, derisa do të mbetet ministri në vete- Ministria e Financave.

## **Mimoza Kusari Lila, ministre e Ekonomisë dhe Energjetikës, Agim Çeku i FSK-së**

Nënkryetari i AKR-së, Ibrahim Makolli, i ka bërë të ditur gazetës sonë se partia përveç postit të presidentit ka kërkuar edhe postin e zëvendëskryeministrit dhe gjashtë ministri të tjera, por pa saktësuar se për cilat ministri është përcaktuar AKR-ja. "Ende nuk kemi përmendur me emra se cilat ministri do t'i drejtojmë. Nuk mund të spekuloj tani, por e vërteta është se kemi kërkuar 6 ministri, por nuk kemi caktuar cilat janë ato, meqë kemi thënë se përcaktimi i ministrive të mbetet çështje e bisedimeve të përbashkëta mes partnerëve", u shpreh Makolli. Ofertën e fundit të PDK-së që përveç postit të presidentit dhe tri ministrive, Makolli nuk e sheh të mjaftueshme duke thënë se vetëm tri ministri janë hapësirë e ngushtë për AKR-në dhe kjo ofertë do të jetë e papranueshme. "Tri ministri janë pak dhe nuk krijojnë hapësirë të punës dhe realizimin e programit tonë", tha Makolli. Mirëpo, Makolli shprehet i bindur se kërkesat e tyre do të gjejnë mbështetje nga partneri i koalicionit gjatë bisedimeve në ditët e ardhshme për ndarjen e dikastereve. Ndonëse i përmendur emri i tij si ministër i drejtësisë, Makolli nuk ka konfirmuar një gjë të tillë, duke thënë se nuk ka njohuri se kush do t'i drejtojë ministrinë e AKR-së, meqë, sipas tij, partia ende s'ka përcaktuar emrat e ministrave të ardhshëm. Por, burime brenda këtij subjekti politik mësojnë se AKR-ja tashmë është e përcaktuar për postet ministrore që do të udhëheqin në qeverinë Thaçi. Sipas këtij burimi, postin e zëvendëskryeministrit do ta ketë Muhamet Mustafa, atë të Ministrisë së Ekonomisë dhe Energjetikës Mimoza Kusari, Ministrinë e FSK-së Agim Çeku. Dikasterin e Shëndetësisë thuhet se do ta drejtojë Ferid Agani, ndërsa atë të Drejtësisë do ta menaxhojë Ibrahim Makolli. AKR - ja do ta ketë edhe një ministri pa portofol, të cilën do ta drejtojë Ibrahim Gashi. Edhe pse data e konstituimit të Kuvendit të Kosovës ishte caktuar nga Kryesia e Kuvendit të mbahej më 24 shkurt, me shpresën se shumë shpejt Kosova do t'i ketë institucionet pas vendimit të PDK-së për hyrjen në koalicion me AKR-në, kryesia e Kuvendit, e koordinuar edhe me partitë politike, të martën mori vendim që seanca e parë konstituive të jetë më 21 shkurt. Kryetari i Parlamentit të Kosovës, Jakup Krasniqi, tha se përfrimi i kësaj date është bërë për shkak të krijimit sa më të shpejtë të institucioneve. Edhe pse do të ishte me rëndësi që ditën konstituive të Kuvendit të votohej edhe presidenti dhe qeveria, ngase vendi ka humbur shumë kohë në formimin e institucioneve të reja, një gjë e tillë nuk do të ndodhë në këtë seancë. Këtë e ka konfirmuar edhe kryeparlamentari Jakup Krasniqi, meqë në këtë seancë do të zgjedhet vetëm kryetari dhe Kryesia e Kuvendit.

---

## **Pacolli i gatshëm të “braktisë” AKR-në**

---

### **Mimoza Kusari-Lila, kandidatja kryesore për të marrë kreun e partisë**

PRISHTINË - Posti i presidentit të Kosovës do t'i kushtojë me dorëheqje nga të gjitha funksionet në parti dhe nga aktivitetet afariste të shumëanshme kryetarit të AKR - së, biznesmenit Behgjet Pacolli. Ky i fundit tashmë ka filluar të përgatitet për këto "sakrifica", më qëllim që të ushtrijë pa probleme të mëdha postin e ëndërruar nga ai tash e sa kohë. Por, pamundësia e "ngrirjes" së postit, siç ka bërë ish presidenti Sejdiu në LDK, mund të fusë në krizë AKR - në e Pacollit, gjatë garës së brendshme për kreun e ri të saj, e cila do ta rrezikonte edhe më tej përkrahjen e elektoratit për këtë subjekt. Megjithatë, largimi i disa deputetëve të AKR - së drejt partive tjera, para zgjedhjeve të fundit nacionale, i ka zbehur kundërshtitë që e kanë karakterizuar këtë parti më herët. Kurse, Mimoza Kusari - Lila zëvendëspresidente aktuale, nga zyrtarë të kësaj partie por edhe analistë politikë, konsiderohet personi më adekuat për të zëvendësuar Pacollin në krye të AKR - së. Numri dy i AKR - së ka thënë të martën për “Zëri” se lideri i partisë së saj është i vetëdijshëm se duhet të heqë dorë nga të gjitha angazhimet e tij në parti, pas marrjes së postit të presidentit. Kurse, nga aktivitetet afariste, sipas saj, Pacolli ka filluar të tërhiqet kohë më parë. "Ndërsa tani, në momentin e votimit të tij në Kuvend si president i Republikës së Kosovës, ai automatikisht do të japë dorëheqje nga posti i presidentit të AKR - së", ka thënë Kusari - Lila. Ajo ka shprehur bindje se AKR - ja nuk do të përjetojë ndonjë traumë në fazën e ndërrimit të kryetarit. Sipas saj, brenda forumeve të AKR - së do të kalohet pa probleme të mëdha tranzicioni në lidhshirin e partisë. Lidhur me mundësinë që ajo të jetë kryetare e ardhshme e AKR - së, Kusari - Lila ka thënë se në këtë fazë nuk ka marrë vendim të prerë për këtë çështje, por se me kohë do të marrë vendimet e duhura rreth pozicionit të ardhshëm në këtë subjekt. Edhe Ibrahim Makolli, nënkryetar i AKR - së, ka thënë se Pacolli do të japë dorëheqje nga çdo funksion në AKR, posa të zgjidhet në postin e presidentit. Duke shprehur bindje se nuk do të ketë kurrfarë pengesash në procedurën e zgjedhjes së tij në Kuvend, për shkak të marrëveshjes me PDK në, Makolli ka thënë se lideri i AKR - së nuk do të lejojë hapësirë që nga dita e parë e punës, që në ndonjë formë të cenojë ligjet apo Kushtetutën e vendit. Sipas tij, Pacolli do të tërhiqet formalisht dhe realisht nga çdo lloj aktiviteti partiak dhe do të jetë simbol i vërtetë i unitetit të të gjithë qytetarëve. Kurse, lidhur me zëvendësimin e Pacollit në krye të AKR - së, Makolli ka shprehur bindje se ky proces nuk do të ballafaqohet me krizë brenda kësaj partie. "AKR - ja ka personalitete që mund ta çojnë përpara partinë duke u mbështetur në filozofinë e deritashme", ka thënë Makolli, duke mos përmendur emra konkretë në këtë drejtim. Analistët politikë shprehin dyshime nëse Behgjet Pacolli, në rast se do të zgjidhet president i Kosovës, do të shkëputet realisht nga dirigjimi i AKR-së, por edhe bizneset e tij. Imer Mushkolaj ka shprehur rezerva rreth shkëputjes totale të Pacollit nga AKR - ja, në rast se do të zgjidhet president. Sipas tij, fakti se Pacolli ka drejtuar bizneset e tij pas hyrjes në politikën aktive të Kosovës, e bën të vështirë të mendohet se ai tani do të heqë dorë realisht nga AKR - ja, por edhe veprimtaritë afariste. Por, Mushkolaj mendon se Pacolli mund të ballafaqohet me vështirësi edhe për t'u zgjedhur president.

## Mitet e rrejshme kundër Pacollit

Në këtë moment historik që po kalon Kosova, kur po kristalizohet koalicioni qeverisës, kur Kosova do të bëhet me institucione, është krejt normale që të intensifikohen kritikët apo sulmet personale rreth atyre që janë protagonistë të këtij koalicioni. Ato drejt presidentit të Aleancës Kosova e re, zotit Behgjet Pacolli po fitojnë njëfarë intensiteti, ani pse janë riciklime konstante. Ndaj ja vlen për t'u shqyrtuar nga një prizëm që synon t'i përbashkojë, apo t'i diferencojë këto kritika. Detyra është shumë e lehtë në të vërtetë. Thujse të gjithë kritikët kanë një bazament të përbashkët metodik ku i mbështesin kritikët e tyre. Ato mbështeten tek fjalët, nuk mbështeten tek veprat e tij. Nuk mbështeten tek veprat që ai ka bërë për Kosovën, por tek veprat që ata supozojnë (me ndihmën e do raportimeve mediatike edhe ndërkombëtare) se ai i ka bërë jashtë Kosovës. Nuk mbështeten tek mediat e Kosovës për shembull, por tek mediat serbe. Nuk mbështeten tek mediat serioze, por tek ato që ata vetë i quajnë media senzacionalistike, bulevardeske e serbe që prodhojnë tituj kuzhinash për pasojë mite të rreme. Nuk mbështeten tek realiteti objektiv, por tek mitologjia moderne e krijuar me art rreth një figure që për shkak të përmasave të mëdha, është lehtësisht e atakueshme. Nuk mbështeten tek njohja e Behgjet Pacollit, por tek mosnjohja e tij. Unë dua t'i justifikoj kritikët e tij, duke mos dyshuar në motivet e kritikës së tyre sepse jetojmë në një vend të lirë. Unë do mundohem t'i justifikoj ata, duke u munduar t'i kuptoj. Unë i mirëkuptoj kritikët e zotit Pacolli, pse pema që ka kokrra, gjuhet. Por, mendoj se në ndihmë të tyre, në ndihmë të opinionit publik kosovar, është mirë të sqarohen mitet që qarkullojnë rreth tij. Nëse ata nuk e njohin zotin Pacolli, dhe kur s'duan ta njohin, mund të jetë dhe faji i tij. I referohem pak një pjese të gazetarëve, që kanë një formim intelektual të caktuar. Zoti Pacolli duhet t'i kishte konsideruar pak më shumë ndjenjat e tij në Kosovë, apo jashtë saj. Kështu ata do ta njihnin më mirë. Do të mësonin për shembull dhe do të duhet ta pranonin ndershmërisht, duke hequr dorë nga miti i parë që ata kultivojnë me art kundër tij se zoti Pacolli ka një profil intelektual shumë të lartë. Ai është ndër të paktët politikanë të Kosovës me shkollim universitar, magjistrin, të kryer tërësisht jashtë vendit me rezultatet më të larta. Një mit i dytë që ata besojnë, apo amplifikojnë nga mosdija, apo nga ndonjë arsye tjetër, është ai që e barazon zotin Pacolli me një tregtar. Me gjithë respektin tim për tregtarët dhe ky është i rrejshëm si mit. Zoti Pacolli është ndërtimtar, themelues qytetesh, për pasojë dhe bashkëthemelues qytetërimesh të reja në Lindje. Ai nuk merret me tregti, por me një zeje që është shumëdisiplinore në tërësinë e vet si ndërtimi. Për nga përmasat e aktivitetit të tij ndërtimtar, historia do të flasë nesër për të, njëjtë me ndërtuesit e mëdhenj botërore. Edhe Arkitekt Sinani e ndërtoi Stambollin shekuj më parë, dhe askush nuk i thotë sot pse ndërtoi kryeqytetin e pushtuesve. Ndoshta kjo është sëmundja e bashkëkohësve dhe ne duhet t'i mirëkuptojmë ata. Shumë prej kritikëve, shumë prej nesh, për shkak të rrethanave, nuk arrijnë dot të krijojnë një vepër, një emër të përmasave të tij jashtë kufijve të vendit, të kombit dhe kjo sigurisht mund të jetë burim xhelozie, urrejtjeje, e cila diku thotë një filozof, të bën dhe strabik. Strabizmi është defekt që vjen prej moskonvergjimit të dy akteve të shikimit. Në rastin konkret kritikët e tij nuk konvergjojnë dot fjalët që thuhet rreth zotit Pacolli me veprat e tij në favor të Kosovës që s'duan me i pa. Miti i tretë kryesor se zoti Pacolli ka dhënë intervista skandaloze, antikombëtare në shtypin bulevardesk serb është miti më i lehtë për t'u rrëzuar. Njëpër një këtu, këta kritikë duan të argumentojnë se zoti Pacolli është një mik intim i serbëve. A dini ndonjë rast kur shtypi i një vendi, i denoncon miqtë e vendit të vet? A dini ndonjë rast kur një njeri që i shërbyeka dikujt e dekonspiron veten nëpër gazetë se i shërbyeka dikujt? Nëse do merrnim për referencë shtypin serb dhe vetëm atë, pse të mos marrim për

referencë shkrimet e pafundme të këtij shtypi se Behgjet Pacolli financon UÇK-në, se Behgjet Pacolli e bleu pavarësinë në Amerikë, në Maldive, apo gjetkë? Ky mit mbështetet megjithatë në një të vërtetë: zoti Pacolli ka një qasje të çlirët, të shpenguar ndaj shtypit. I jep intervista kujtdo, dhe atyre që e marrin në telefon, në një mungesë të imagjinueshme (ndoshta edhe duke mos i dhënë rëndësinë pyetjeve qëllimkëqija) përqendrimi, ndërsa administron shumë punë njëkohësisht. Ndaj intervistat e këtij njeriu, për më shumë prej një shtypi të tillë, janë lehtësisht të manipulueshme. Për më shumë kur ky Behgjet Pacolli s'po arrin të bëhet "politikan i vërtetë" që duhet të thotë vetëm fraza patriotike, që duhet të bërtasë, të thërrasë, të akuzojë, etj, etj. Por dhe në një rast të tillë, kritikët e tij do të gjenin diçka tjetër. Veçanërisht kritikët e të gjitha kohërave dhe stinëve. Ka një mit tjetër të katërt, se Behgjet Pacolli është njeri me të kaluar të errët, i hetuar, i akuzuar, etj, etj. Edhe ky është një mit lehtësisht i rrëzueshëm sepse në librin e vet zoti Pacolli ka prezantuar dokumente juridike që provojnë se ai e ka të pastër dosjen penale. Ka pasur hetime për Jelcinin që kanë përfshirë dhe Pacollin në cilësinë e njeriut që ka dijeni për do fakte mbi të. Por këto hetime që duhet të përfundonin me një akuzë për Pacollin të nisura nga prokuroria komuniste ruse me ndihmën e Del Pontes në Zvicër, kanë përfunduar me dështim. Zoti Pacolli as ka pasur frikë dje nga ato hetime, as nuk ka sot. Prokurori që i nisi, ka humbur një gjyq me të. Me zonzjën Del Ponte, apo me pasuesin e saj Dik Marti, zoti Pacolli s'ka frikë të ndeshet as sot siç u tregua në rastin e raportit të Dik Martit.

## **Behgjet Pacolli, do të respektoj Kushtetutën e Kosovës**

**AKR deri në Kuvendin e ardhshëm të partisë pritet të udhëhiqet nga nënkryetarët e partisë, në ndërkohë që Mimoza Kusari Lila ka shfaqur ambiciet për lidere të AKR-së.**

I nominuari për president të vendit, Behgjet Pacolli, nga koalicioni Kosova e Re, tashmë ka marrë "bekimin" edhe nga mandatarin e qeverisë Hashim Thaçi të jetë i kandiduar për postin e presidentit sipas marrëveshjes për koalicionin qeverisës. Lideri i AKR-së, Behgjet Pacolli, sipas të gjitha gjasave, do të jetë figura e tretë që merr postin e presidentit të vendit pas presidentit të ndjerë Dr. Ibrahim Rugova. Por duke pasur parasysh "fatin" e ish presidentit Fatmir Sejdiu, Behgjet Pacolli do të respektojë Kushtetutën duke dhënë dorëheqje nga posti i liderit të partisë që në momentin e zgjedhjes së tij si president i Kosovës. Nuk ka më "ngrirje" të postit Mimoza Kusari-Lila, nënkryetare e parë e AKR-së, theksoi se z. Pacolli është i vetëdijshëm se duhet të tërhiqet nga partia, menjëherë pas votimit të tij për president në Kuvendin e Kosovës. Sipas saj z. Pacolli nuk do të praktikojë veprimet e mbajtjes së dy posteve sikur z. Sejdiu, meqë ai nuk do të ushtrojë "ngrirjen" e postit të liderit partiak, por me tërë energjinë e tij do t'i përkushtohet forcimit të pozicionit të Presidencës. Mirëpo se kush do të jetë pasues i z. Pacollit në udhëheqjen e partisë, Kusari tha se në parti ende nuk ka filluar një dialog se kush do ta zërrë vendin e z. Pacollit si udhëheqës i ri i AKR-së. Ajo nuk mendon se partia do të ketë vakum udhëheqjeje deri në emërimin e udhëheqësit të ri të partisë, sepse ajo la strukturat udhëheqëse, të cilat edhe më herët kanë dëshmuar udhëheqjen e mirë të partisë edhe gjatë mungesës së z. Pacolli për shkak të obligimeve të tij jashtë Kosovës. E pyetur nëse do të jetë kandidat e potenciale e marrjes së timonit të partisë, Kusari një gjë të tillë as nuk e ka pohuar, as nuk e ka mohuar, por thotë se vendimet e tilla do të bëhen publike me kohë. Ibrahim Makolli, nënkryetar i AKR-së, bën të ditur se z. Pacolli pasi të emërohet president i Kosovës do të japë dorëheqje nga posti i kryetarit të partisë. "Nuk ka ngrirje" e "shkrirje" të postit në parti. Behgjet Pacolli është shumë i përkushtuar që detyrën e presidentit të vendit ta kryejë në pajtim me Kushtetutën. Ai do të japë dorëheqje nga të gjitha funksionet partiake, kështu që do t'i përkushtohet vetëm detyrës së presidentit", tha Makolli, derisa nuk përmendi ndonjë emër tjetër që do të ishte pasues i liderit të partisë.

### **Nënkryetarët e AKR-së drejtojnë partinë**

Sipas tij se kush do të jetë pasues i liderit të AKR-së është çështje që varet nga strukturat e partisë. "Strukturat e larta të partisë do të mblidhen dhe do të shqyrtojnë dhe do të marrin vendim se kush do të jetë pasues i kryetarit të partisë pas dorëheqjes së liderit Pacolli, bëri të ditur Makolli, i cili thekson se AKR-ja nuk do të mbetet me post vakant, por do të emërohet dikush në atë pozitë për të vazhduar kështu tradita e ndërtuar së bashku me liderin Pacolli. Sipas tij, strukturat e larta të partisë do të vendosin se kush do të jetë udhëheqësi i partisë, pasi Pacolli do të japë dorëheqjen nga lideri i partisë. Makolli tha se z. Pacolli në asnjë mënyrë nuk do jetë "viktimë" e mosrespektimit të Kushtetutës. Ibrahim Gashi gjithashtu pohoi se lideri i AKR-së, Behgjet Pacolli, do ta respektojë Kushtetutën dhe se në momentin e marrjes së postit të presidentit do të japë dorëheqje nga kryetari i partisë. "Sigurisht se ky është një veprim racional që z. Pacolli nuk do të hezitojë ta marrë, sepse ne nuk do ta përsërisim një gabim që

dikush e ka bërë me apo pa vetëdije në të kaluarën duke ushtruar të dy funksionet atë të presidentit të vendit dhe liderit të partisë, shprehet Gashi. Ai qartëson se pas dorëheqjes së z. Pacolli, kuvendi i partisë do të mblidhet dhe do të zgjidhet pasuesi i z. Pacolli, i cili do ta drejtojë partinë deri në përfundimin e mandatit të tij si president. Gashi poashtu theksoi se deri në mbledhjen e Kuvendit, AKR-ja pas dorëheqjes së z. Pacolli do të udhëhiqet nga kryesia dhe tre nënkryetarët aktualë. Ai nuk bëri të ditur se kur do të mblidhet kuvendi për emërimin e udhëheqësit të partisë, të propozuar nga Këshilli Drejtues i Partisë, mbase edhe nga vetë z. Pacolli, por theksoi se AKR-ja do të respektojë të gjitha procedurat statusore të partisë. Sipas tij nuk është çështje urgjente thirrja e kuvendit. Gashi nuk mendon se do të krijohet vakuum në parti pas dorëheqjes së z. Pacollit në të qenët lider, sepse punën e partisë do ta vazhdojnë sikur edhe herët e tjera, Kryesia dhe nënkryetarët, të cilët e kanë dëshmuar veten edhe në mungesat e herëpashershme të liderit të tyre për shkak të angazhimeve të tij edhe në arenën ndërkombëtare.



---

## **Behgjet Pacolli drejt Presidencës, Rrahim Pacolli drejt kreut të AKR-së**

---

**Behgjet Pacolli do të japë dorëheqjen brenda dy ditësh nga kreu i partisë për t'iu nënshtruar votës së deputetëve për president shteti. Ai pritet të japë dorëheqjen edhe nga bizneset e tij, të cilat i ka themeluar dhe i ka udhëhequr vetë për shumë vjet. Në AKR thonë se nuk kanë diskutuar se kush do të jetë kryetar i ri, mirëpo burime brenda kësaj partie kanë thënë se drejt këtij posti po ecën Rrahim Pacolli, djali i axhës së Behgjet Pacollit**

PRISHTINË, 17 SHKURT - Kur Behgjet Pacolli do të niset drejt Kuvendit për t'iu nënshtruar votës së deputetëve për president të shtetit, nuk do të ketë asnjë hipotekë partiake mbi vete. Kandidati për kreun e vendit do ta lërë postin e presidentit të Aleancës Kosova e Re për ta marrë atë të Republikës së Kosovës. Ai nuk do ta presë momentin e zgjedhjes në krye të shtetit për të dhënë dorëheqje, por këtë do ta bëjë të premtën ose të shtunën. Madje do ta lërë edhe biznesin milionësh, të cilën e ka themeluar dhe udhëhequr prej shumë vjetësh për pozitën e presidentit. Nënkryetari i AKR - së, Ibrahim Makolli, ka bërë të ditur të enjtën se kandidati i vetëm deri tash për kreun e shtetit, i dalë nga marrëveshja për bashkëqeverisje ndërmjet Partisë Demokratike të Kosovës së Hashim Thaçit dhe Aleancës Kosova e Re, nuk do të ketë asnjë pengesë ligjore, as kushtetuese, në momentin e votimit për president. "Pritet që z. Pacolli, kandidati për president të Kosovës, paraprakisht do të japë dorëheqjen nga të gjitha funksionet në parti dhe do të këpusë aty rrugën partiake", ka thënë Makolli për të shtuar se këtë do ta bëjë shumë shpejt. "Nuk përjashtohet mundësia, nesër (e premte v.j.) ose pasnesër (e shtunë), por e rëndësishme është se në seancë plenare do të shkojë i shkarkuar nga të gjitha funksionet partiake, d.m.th. do të shkojë tamam ashtu siç e parashih Kushtetuta. Do të thotë, të mos ketë asnjë lloj konflikti të mundshëm të interesit", ka thënë Makolli. Ai ka shtuar se Pacolli do të japë dorëheqjen edhe nga udhëheqja e biznesit të tij të madh si në Kosovë ashtu edhe jashtë vendit. "Do të jap dorëheqjen edhe nga biznesi. Po, absolutisht po. Ju e dini që me Ligjin për konfliktin e interesit të zyrtarëve të lartë publikë është e rregulluar se një person në jetën publike që udhëheq poste të larta shtetërore, në rast se ka aksione ose biznes, do të duhej ta zhvendosë prej vetes gjatë kohës sa e ushtron mandatin", ka thënë Makolli. Presidentit të Republikës së Kosovës Kushtetuta e vendit ia ndalon ushtrimin e funksioneve të tjera, përveç të parit të shtetit. Sipas Kushtetutës, presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës. Neni 88, që ka të bëjë me papajtueshmërinë, saktëson se presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik dhe se pas zgjedhjes nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike. Pikërisht me këtë nen pati rënë ndesh ish-presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu. Në shtator të vitit të shkuar, Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi se Sejdiu kishte bërë shkelje serioze të aktit më të lartë juridik të vendit. Në dhjetor u organizuan zgjedhjet e jashtëzakonshme, nga të cilat fituese doli Partia Demokratike e Kosovës. Tek e pesta me rezultat doli Aleanca Kosova e Re, me rreth tetë për qind të votave. Kjo nuk u pa si pengesë për arritjen e një marrëveshjeje koalicioni në mes të këtyre dy partive duke ia hapur rrugën Pacollit të niset drejt pozitës më të lartë të shtetit. Mirëpo dorëheqja e Pacollit nga kreu i AKR - së ia hap rrugën kësaj partie, e cila është udhëhequr që nga themelimi i saj, në vitin

2006, nga kryetari aktual, të mbajë kuvendin për të zgjedhur kryetarin e ri. Asnjë kandidat deri tash zyrtarisht nuk e ka paraqitur kandidaturën për këtë pozitë, mirëpo sipas burimeve brenda AKR - së, gjasat më të mëdha i ka një anëtar i familjes Pacolli, Rrahimi. Burimi i gazetës ka thënë se Rrahim Pacolli, i cili për një kohë ka qenë sekretar organizativ i partisë, do të kandidojë për të zënë vendin e Behgjet Pacollit, nëse kryetari i deritashëm i AKR - se zgjidhet kryetar i shtetit. "Rrahim Pacolli do të konkurrojë për ta marrë partinë. Ai ka mbështetjen më të madhe të anëtarësisë dhe të anëtarëve të lartë, edhe për faktin se është djali i axhës së Behgjet Pacollit", ka thënë burimi. Ky burim ka shtuar se AKR - ja nuk ka burim tjetër financiar, përveç financimit nga kreu i saj aktual dhe se deri tash në parti janë derdhur shumë mjete financiare për këto vjet të veprimtarisë së saj. Nga ana tjetër, Ibrahim Makolli ka thënë se brenda partisë deri tash nuk është diskutuar se kush do të jetë në krye të partisë pas Behgjet Pacollit. Ai i është referuar statutit të partisë, duke thënë se zgjedhja e presidentit të AKR - së bëhet nga kuvendi. Ndërsa deri atëherë Makolli ka shtuar se partia do të udhëhiqet nga nënkryetarët e saj. Si kandidate e mundshme për kreun e partisë përmendet edhe Mimoza Kusari - Lila, e cila në zgjedhjet e fundit ka dalë si femra më e votuar. Por burimi i gazetës ka thënë se partia nuk do të mbetet në dorën e saj pasi është inkuadruar shumë vonë në të, por edhe për shkak se ambicie tashmë ka edhe Rrahim Pacolli. Gazeta ka provuar të enjtën të flasë me Rrahim Pacollin dhe Mimoza Kusari - Lilën, por asnjëri prej tyre nuk e ka hapur telefonin. Ibrahim Makolli ndërkaq ka thënë se deri tash partia nuk ka qenë e preokupuar me këtë çështje. "Unë po them, as që kam qenë, as që kemi qenë të preokupuar me këtë sepse këto çështje janë të zgjidhura me statut të partisë.

---

## **Pacolli e ka ëndërr "pajtimin e serbëve dhe kosovarëve"**

---

**"Më vjen keq për serbët, ata janë popull i mrekullueshëm. Ata dhe ne jemi si dy vëllezër që përherë grindemi derisa nuk e ndajmë pasurinë dhe nuk e ndërtojnë shtëpinë e vet. Tek atëherë fillon dashuria e vërtetë vëllazërore", ka thënë Pacolli, duke folur edhe për dy takime me Milosheviqin, në vitin 1999**

PRISHTINË, 17 SHKURT - Në një intervistë që kandidati për kryetar të Kosovës, Behgjet Pacolli, ka dhënë për një gazetë kroate, disa ditë pas shpalljes së pavarësisë, ka thënë se ëndrra e tij është që t'i pajtojë serbët dhe kosovarët", ndërsa Serbinë e ka cilësuar si "nënë të Kosovës, por të keqe". Në intervistën që i kishte dhënë gazetës "Vecernji list", më 24 shkurt 2008, e cila ishte realizuar në rezidencën e tij në Lugano të Zvicrës, lideri i AKR - së kishte folur edhe për takimet që ai i kishte realizuar në vitin 1999 me Slobodan Milosheviqin, hetimet që i kishte nisur kundër tij ish - prokurorja, Carla del Ponte, si edhe për jetën e tij private, Gazeta kishte shkruar që "Pacolli nuk ka shumë fjalë të këqija për serbët, përkundër të gjitha krimeve që ia kanë bërë popullit të tij dhe se për të "Serbia ende është nënë e Kosovës, për fat të keq, nënë e keqe". "Kur prindërit nuk sillen si duhet me fëmijën, nëse e keqtrajtojnë, atëherë do të gjendet dikush që do t'ia marrë fëmijën. Ky është rasti me Kosovën". Mirëpo, Ibrahim Makolli, nënkryetar i AKR - së, të enjtën ka thënë se ky është interpretim i gazetës dhe se varet prej çfarë këndi interpretohen. I pyetur rreth misionit të Pacollit "për pajtimin e serbëve dhe kosovarëve", Makolli ka thënë se këta dy popuj kanë përgjegjësi për stabilitetin e rajonit. "Kjo varët se si dhe prej çfarë këndi e interpreton këtë. Veç diçka dua t'ju them, që besoj edhe z. Pacolli e ka pasur në mendjen e tij: "Shqiptarët dhe serbët në Ballkan kanë përgjegjësi si dy kombe për paqe e dhe stabilitet të këtij rajoni dhe kanë përgjegjësi që t'i largojnë hasmëritë për të shikuar nga e ardhmja. Natyrisht të dy si zot të vetvetes", ka thënë shkurt ai nëpërmjet telefonit. AKR- ja vazhdimisht është arsyetuar se deklaratat e Pacollit të dhëna për shtypin e huaj, kryesisht atë serb janë keqinterpretuar. Më vjen keq për serbët, ata janë popull i mrekullueshëm. Ata dhe ne jemi si dy vëllezër që përherë grindemi derisa nuk e ndajmë pasurinë dhe nuk e ndërtojnë shtëpinë e vet, tek atëherë fillon dashuria e vërtetë vëllazërore, ka thënë ai duke folur edhe për dy takime me Milosheviqin, në vitin 1999. "Kam dashur që edhe njëherë të përpiqemi të jetojmë së bashku, por ai tha se s'ka gjë nga kjo që unë propozova dhe se shqiptarët mirë ta mbajnë mend çfarë do t'ju ndodhë", ka thënë Pacolli.

---

## AKR-ja do më shumë

---

Partia Demokratike e Kosovës pritet t'i fillojë negociatat për ndarjen e resorëve qeveritarë me partnerët e koalicionit. Konsultimet e nisura janë duke vazhduar dhe sot pritet që të zbardhet skema e re e kabinetit qeverisës pas konsultave të gjëra. Vendimin e djeshëm të PDK - së, për t'ia dhënë postin e presidentit AKR - së në negociatat për krijimin e koalicionit qeverisës, për AKR-në konsiderohet si hapi i parë drejt përafrimit të qëndrimeve për një koalicion të mundshëm. Në AKR thonë se numri i ministrive që do të kërkojë kjo parti, varet nga rëndësia dhe hapësira për fushëveprim. Numri dy i këtij subjekti, Ibrahim Gashi ka prezantuar apetitet e kësaj partie, që në kabinetin qeveritar t'i ketë 1 zv. kryeministër, 6 ministri dhe 7 zv. ministra. Megjithatë, përtej kësaj, burime tona brenda zhvillimeve nuk pritet që kjo kërkesë të plotësohet.

### **Kusari - Lila , ministre e Jashtme ?**

Madje, caktimi i ministrave do të bëhet përmes një konsulte të gjerë, marrë parasysh objektivat që do t'i ketë qeveria e re. Disa nga ministratë pritet të pësojnë ndryshime. Kështu, një pjesë e ekonomisë dhe financave do t'i bashkohet Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Siç merret vesh nga burimet brenda zhvillimeve të AKR - ja, më së shumti mund të llogarisë në katër ministri dhe një post të zëvendësministrit.

### **Listës Ibrahim Rugova, një ministri dhe minoriteteve tri ministri.**

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, kryeministri, kryetari i Kuvendit dhe ministratë e tjera do t'i takojnë PDK-së. Ministratë që do të mund të udhëhiqen nga AKR-ja, tashmë janë duke u përfolur gjysmë zyrtarisht. Po ashtu, edhe emrat e bartësve të mundshëm, duke pasur parasysh marrëveshjen brenda koalicionit të AKR-së. Sipas një varianti, nëse AKR-së i ndahen katër ministri, atëherë skema do të dukej kështu. Ministrinë e Jashtme e udhëheq Mimoza Kusari Lila, atë të Forcës së Sigurisë, Agim Çeku, të Shëndetësisë, Ferid Agani dhe atë të Ekonomisë, Muhamet Mustafa ose postin e zëvendëskryeministrit. Një nga emrat e përmendur në këtë variant është edhe ai i Ibrahim Gashit. Burime tona nuk besojnë që AKR - së t'i dilet me kërkesën e djeshme për shumë ministri, marrë parasysh dhënien e postit të presidentit.

### **Listës Rugova një ministri**

Për sa u përket komuniteteve me pakicë, ata kanë kërkuar tre ministri, marrë parasysh numrin e ulëseve të rezervuara. Dy nga ministratë që do t'i udhëheqin, dhe për të cilat ka ambicie, do të jenë Ministria e Kthimit dhe Pushtetit Lokal, derisa ministria tjetër mendohet të lihet në vullnetin e partnerit kryesor të koalicionit. Gjithashtu, ata do të kenë edhe një post të zëvendëskryeministrit, ku gjasat më të mëdha janë që kreu liberalëve, Slobodan Petroviq ta marrë atë. Madje, brenda tyre flitet që kanë qenë të gatshëm të kenë edhe një ministri më pak, po që se koalicionit i bashkohet ndonjë nga partitë shumicë. Ndërkaq, ende nuk dihet se cili nga postet e mundshme do t'i jepej " Lista Rugova ", dhe cili do të jetë bartësi i mundshëm i saj. Edhe Grupi gjashtë plus i përbërë nga minoritetet ka kërkuar dy ministri.

## **Pacolli tërhiqet nga kryetari i AKR - së**

Sipas burimeve tona në AKR, bëhet e ditur se lideri i kësaj partie do të japë dorëheqjen nga partia deri në fund të javës, para se Kuvendi të vendosë për të. Për kreun e AKR - së përmenden: Mimoza Kusari dhe Ibrahim Makolli. I. KRASNIQI

---

## **Rrahim Pacolli merr timonin e AKR-së?**

---

**Përkrahja për Rrahim Pacollin, siç ka mësuar gazeta, vjen pas suksesit që ky i fundit ka treguar në zgjedhjet e 2007 - së, duke e renditur AKR - në partinë e tretë në vend, po ashtu edhe në zgjedhjet e fundit, kur në raundin e dytë të zgjedhjeve në Mitrovicë ishte shëf i shtabit zgjedhor**

PRISHTINË, 17 SHKURT - Rrahim Pacolli, njëri ndër themeluesit e AKR - se, aktualisht anëtar i Këshillit të Përgjithshëm, është i gatshëm ta marrë timonin e partisë në rast se Behgjet Pacolli zgjidhet president i Kosovës. Lajmin e ka konfirmuar për gazetë një burim brenda AKR - së. "Po, është e vertetë se zoti Rrahim Pacolli ka shprehur gatishmërinë për ta marrë partinë në drejtim", i ka thënë gazetës ky burim. Po sipas këtij burimi, Rrahim Pacolli gëzon përkrahjen e strukturave të AKR - së si në nivel qendror po ashtu edhe në: atë lokal. "Pacolli gëzon edhe mbështetjen e shumicës së anëtarëve të Këshillit Drejtues, Kryesisë dhe të bazës. Një fakt i rëndësishëm është se Rrahim Pacolli gëzon edhe mbështetje të faktorit ndërkombëtar në Kosovë", ka thënë ky burim. Përkrahja për Rrahim Pacollin, siç ka mësuar gazeta, vjen pas suksesit që ky i fundit ka treguar fillimisht në zgjedhjet e 2007 - së, duke e renditur AKR - në partinë e tretë në vend, po ashtu edhe në zgjedhjet e fundit, kur në raundin e dytë të zgjedhjeve në Mitrovicë ishte shëf i shtabit zgjedhor. Pretendenti për postin e presidentit të AKR - së, Rrahim Pacolli, njihet po ashtu si njëri ndër njerëzit që i ka kontribuar lidhjes së koalicionit ndërmjet PDK - së dhe AKR - së. "Epoka e re" ka mësuar se pretendenti tjetër të mundshëm për të qenë në krye të AKR - së janë edhe Mimoza Kusari - Lila, Ibrahim Makolli dhe Ibrahim Gashi. Kandidatura e Rrahim Pacollit për ta marrë postin e kreut të AKR - së pritet të bëhet zyrtare menjëherë pas dorëheqjes së Behgjet Pacollit, i cili është kandidat për president të Republikës së Kosovës.

---

## **Marrëveshja në xhepat e Thaçit e Pacollit**

---

**Thaçi pritet të mbajë afër vetes si zëvendëskryeministra, Hajredin Kuçin, Enver Hoxhajn, Mimoza Kusari - Lila dhe Sllobodan Petroviqin**

PRISHTINË - Kosova mund të bëhet me qeverinë e re që nga fillimi i javës së ardhshme. Zotime të tilla ka dhënë tashmë vetë kryeministri në largim dhe mandatarit për qeverinë e re, Hashim Thaçi. Skenari aktual është që të hënën fillimisht të konstituohet përbërja e re e Kuvendit dhe të zgjidhen kryetari dhe kryesia e re. Kurse pas një pauze të mblidhet Kryesia e re e Kuvendit dhe ta caktojë kohën e thirrjes së seancës për votimin e qeverisë. Mbetet ndërkaq diskutabile nëse në këtë seancë do të votohet edhe për presidentin. Burime nga PDK thonë se duhet sqaruar fillimisht deri në fund nëse Jakup Krasniqi, në cilësinë e ushtruesit të detyrës së presidentit ka legjitimitet që t'i japë mandatin Hashim Thaçit për propozimin e qeverisë, apo do të duhet që fillimisht të zgjidhet presidenti i ri dhe mandati do të merret nga ai. Kjo çështje, sipas këtij burimi, do të sqarohet përfundimisht të premtën apo të shtunën kur edhe pritet të finalizohet marrëveshja e koalicionit. Po ashtu, nga të njëjtat burime merret vesh se Hashim Thaçi dhe partneri i tij në koalicion Behgjet Pacolli, tashmë kanë caktuar edhe përbërjen e re të qeverisë dhe ndarjen e ministrive, por këtë ata nuk do ta bëjnë publike pa u formalizuar edhe një marrëveshje e shkruar. Sipas versionit më të ri, kryeministri Hashim Thaçi thuhet se do t'i ketë afër vetes katër zëvendëskryeministra, dy nga PDK, Hajredin Kuçin dhe Enver Hoxhajn, si dhe Mimoza Kusari - Lila nga AKR dhe Sllobodan Petroviqin nga SLS - ja. Propozimi i mëhershëm që edhe lista Ibrahim Rugova të japë një zëvendëskryeministër, sipas këtij burimi, nuk ka kaluar dhe se dy poste të zëvendëskryeminstreave do t'i mbajë për vete PDK - ja. Thaçi dhe Pacolli thuhet se e kanë edhe listën e emrave të ministrave të rinj. Ndonëse disa prej tyre tashmë janë përfolur, asnjëri prej tyre nuk është prezantuar zyrtarisht para strukturave të partive të koalicionit. Si emra më të përfolur për disa nga ministrat e ardhshëm janë, Hajredin Kuçi, Enver Hoxhaj, Besim Beqaj, Agim Çeku, Muhamet Mustafa, Ferid Agani, Ukë Rugova (Bujar Bukoshi), Sllobodan Petroviq, Nenad Rashiç, Mahir Jagxhilar e të tjerë. Nëse nuk i zemëron shumë strukturat e "vjetra" të partisë, Thaçi besohet se do t'i promovojë si ministra dhe zëvendësministra edhe disa nga prurjet e tij të reja në parti gjatë fushatës së fundit zgjedhore. Ministrat e mundshëm, sikur paragjykojnë edhe ndarjen e ministrive, ku AKR nuk e ka fshehur në disa raste se nga gjashtë ministratë sa ka kërkuar fillimisht e që besohet se në fund do t'i marrë nën drejtim katër, preferon sidomos Ministrinë e Shëndetësisë, atë të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Por, për këtë të fundit, burime nga PDK - ja thonë se do të jetë e rezervuar për partinë fituese. Kurse pakicat, përveç Ministrisë për Kthim dhe Komunitete mund të rikthejnë atë Bujqësisë dhe Pylltarisë si dhe ministrinë e Ambientit. Mbetet të shihet se cila ministri mund t'i ofrohet Listës Ibrahim Rugova, e cila si shpagim Thaçit do t'i garantojë vetëm një votë në Kuvend. Në cilësinë e mandatarit të ardhshëm, kryeministri në largim Hashim Thaçi është zotuar se Partia Demokratike e Kosovës, bashkë me partnerët në koalicion, ka arritur të krijojë një mazhorancë në Kuvend, që do të garantojë një qeverisje stabile për mandatin e ardhshëm katërvjeçar.

---

## **Bojkotohet Pacolli**

---

**Behgjet Pacolli mund të mos jetë i vetmi kandidat për president të Kosovës, pasi po shqyrtohet mundësia që edhe partitë opozitare ta paraqesin një kandidat konsensual të tyre. Pacolli, përveç kundër kandidatit, pritet të mos i marrë edhe një pjesë të votave të deputeteve të PDK-së, gjë e cila do t'ia mohonte mundësinë për t'u bërë president.**

Partitë opozitare janë duke shqyrtuar mundësinë e paraqitjes së një kandidati konsensual për postin e presidentit të Kosovës, që do ta sfidonte kreun e AKR-së, Behgjet Pacolli, i cili ka paraqitur edhe zyrtarisht kandidaturën e tij për president të vendit. Partitë opozitare nuk e kanë pohuar e as mohuar një mundësi të tillë. Pacolli, përveç, kundërkandidatit të cilin ka mundësi t'ia vendosin partitë opozitare, pritet të mos i marrë edhe një pjesë të votave të deputeteve të Partisë Demokratike të Kosovës, gjë e cila do t'ia mohonte mundësinë për t'u bërë president i vendit. Në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, thonë se nuk kanë ndonjë emër nga partia e tyre që e kanë caktuar për këtë kandidaturë, por nëse një gjë e tillë ndodh, do të preferonin një kandidat konsensual nga i gjithë kampi opozitar. Në media si kandidat i mundshëm, i cili do të sfidonte Behgjet Pacollin është përmendur emri i nënkryetarit të AAK-së, Ahmet Isufi. Ndërsa, në anën tjetër, anëtari i kryesisë së LDK-së, Kujtim Shala ka thënë se ata nuk e kanë shqyrtuar këtë mundësi.

### **Kandidat së bashku**

Anëtari i kryesisë së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik Tahiri ka thënë se ata si parti e vetme nuk e kanë shqyrtuar mundësinë që të paraqesin ndonjë kandidat për president. "Deri më tani nuk kemi pasur ndonjë takim as të kryesisë, as këshillit të drejtues për të vendosur për ndonjë kandidat që do të ishte kandidat për president. Do të thotë AAK-ja nuk ka kandidat zyrtar për president të Kosovës", ka thënë Tahiri. Por, ai ka thënë se nëse do të paraqesin ndonjë kandidat, është mundësia që ta paraqesin një kandidat të përbashkët si parti opozitare, edhe pse nuk kanë diskutuar për një gjë të tillë. "Nuk e besoj që do të ketë ndonjë kandidat nga partia jonë, mirëpo, që të jetë një kandidat, atëherë do të jetë një kandidat konsensual i partive opozitare. Por, nuk e di a do të ndodhë kjo, nuk ka diçka zyrtare dhe nuk ka ndonjë takim që do ta përcaktonte. Nuk kemi biseduar për këtë me asnjë parti opozitare", është shprehur Tahiri. Ndërsa, anëtari i kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës, Kujtim Shala ka thënë se nuk kanë pasur ndonjë takim rreth kandidimit të ndonjë kandidati të përbashkët të partive opozitare. "Jo, deri më tani nuk kemi pasur ndonjë kontakt, apo shqyrtim të një çështje të tillë, dhe s'ka diçka të tillë. Nuk kemi qëndrim tash për tash", ka thënë Shala.



## **Kandidatura e Pacollit për interesa politike**

Ndërsa, deri më tani kandidati i vetëm që ka shpallur zyrtarisht kandidaturën për president është Behgjet Pacolli, i cili edhe ka kushtëzuar partinë fituese të zgjedhjeve se nuk do të hyjë në koalicion me të, nëse nuk e merr presidencën. Por, partitë opozitare kanë rezerva ndaj kandidaturës së Pacollit dhe nuk janë shprehur të gatshme që ta votojnë për postin e të parit të vendit. Për këtë, Tahiri ka thënë se AAK-ja e kanë pasur një qëndrim dhe atë do ta mbrojnë. "Jo, nuk kemi pasur një qëndrim të qartë si AAK gjatë gjithë kohës dhe do ta mbajmë atë qëndrim", është shprehur Tahiri. Ndërsa anëtari i kryesisë së LDK-së, Shala ka thënë se as ata nuk kanë marrë ndonjë qëndrim nëse do ta votojnë Pacollin për president apo jo. Por, ai thotë se edhe me herët kanë shprehur rezervat e tyre rreth kandidaturës së Pacollit për president duke e vlerësuar atë si jo të mirë. "Po, për këtë duhet një qëndrim në Kuvend, ju e dini që për figurat e kandidimit apo siç kanë ardhur deri te kandidimi, ne e kemi vlerësuar si jo të mirë, sepse ajo lidhet më shumë me interesa personale, me interesat politike të partive, sesa me interesa të vendit", ka thënë Shala. Megjithatë sipas Shalës, edhe pse nuk kanë marrë ende një qëndrim, vlerësimet që i kanë dhënë në parim vendosin ashtu edhe siç vlerësojnë. "LDK-ja nuk e ka një qëndrim final por ju e dini që në parim ne zakonisht vendosim ashtu edhe siç vlerësojmë, por në ditën kur do të mbahet seanca ne do të jemi me një qëndrim të prerë", ka thënë Shala.

---

## **Pacollit i kërkohet publikimi i pasurisë**

---

**Agjencia Kundër Korrupsionit ka kërkuar nga presidenti Pacolli që ta publikojë pasurinë e tij. Këshilltari i tij, Shefki Abdullahu thotë se këtë do ta bëj**

"Me datën 18.02.2011, dy zyrtarë të Agjencisë Kundër Korrupsionit kanë pasur një takim me z. Pacolli dhe ia kanë bërë të qartë procesin e deklarimit të pasurisë për vitin 2011 dhe publikimin e pasurisë për të gjithë zyrtarët e lartë publikë", ka deklaruar për "Zërin" shefi i Divizionit për Mbikëqyrjen e Pasurisë dhe Dhuratave në AKK, Agron Behrami. Deklarimi i pasurisë për zyrtarët publikë do të fillojë më datën 1 mars të këtij viti dhe pritet të përfundojë me datën 31 të të njëjtit muaj, ndërsa për zyrtarët e rinj që për herë të parë e kanë obligim që të deklarojnë pasurinë, ky afat do të jetë 60 ditë. Behrami ka bërë me dije se pasuria e tashmë presidentit Pacolli, nuk ishte publikuar në të kaluarën, ngase vetë Pacolli kishte kërkuar një gjë të tillë. Në shkresën që Pacolli ia ka dërguar AKK - së në mars të vitit të kaluar, e që gjendet në faqen zyrtare të AKK - së , thuhet mes të tjerash se kohëve të fundit me të në Kosovë është duke jetuar familja e tij e ngushtë, për të cilët, sipas Pacollit, ekziston arsyeja reale që të jetë gjithmonë vigjilent për parandalimin e çdo rreziku, duke i parë rrethanat në Kosovë. "Publikimi i këtij raporti do të rrezikonte sigurinë time dhe të familjes dhe njëkohësisht do të binte në kundërshtim po ashtu edhe me ligjet që e rregullojnë funksionimin e kompanive me aksione anonime në Zvicër, ku ende jam pjesë e tyre në formë të aksionarit kryesor, edhe pse jam tërhequr nga udhëheqjet e tyre", thuhet mes të tjerash në arsyetimin e Pacollit. Pos kësaj, Pacolli i ka dhënë edhe një arsyetim tjetër, pas disa muajsh drejtorit të AKK - së, Hasan Preteni. Në letrën e shkruar më 19 maj të vitit të kaluar, Pacolli kishte pohuar se rasti i tij është i veçantë pasi që një pjesë e të ardhurave të tij, përbëhen nga shoqëri aksionare anonime, gjë që sipas tij, në Kosovë nuk rregullohen me ligj ndërsa në Perëndim, në vendet ku ka vepruar ai, janë të rregulluara. "Të dhënat e mia në shtetin origjinë ku ato janë gjeneruar, mbrohen nga ligji për privatësinë e informatave, të cilat publikohen në raste të një persekutimi gjyqësor, e kurrësi për konsum publik", thuhet në letrën e dytë të Pacollit. Kjo edhe është respektuar nga AKK, megjithatë pasurinë tashmë presidenti i Kosovës e ka deklaruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Ndryshe nga formularët shumëfaqësh të AKK-së, ata të KQZ - së kanë vetëm dy faqe. Në këto dy faqe, Behgjet Pacolli ka treguar se merr pagë vjetore si deputet në vlerë 22 mijë euro dhe se ka të ardhura vjetore në vlerë 500 mijë euro nga pasuria dhe biznesi dhe atë përmes kompanive të ndryshme biznesi. Por, ai nuk ka plotësuar hapësirën ku kërkohen të dhënat për paratë e gatshme që i ka deri më datën 11 dhjetor 2010. Ai në një rubrikë tjetër ka treguar se ka 210 mijë euro në një bankë dhe 190 mijë në një bankë tjetër. Pacolli po ashtu në këtë aplikacion ka treguar se ka në pronë si Bankën Ekonomike, vlera e së cilës është 15 milionë euro, si dhe kompaninë e sigurimeve Siguria me vlerë 22 milionë euro. Aksionet, letrat me vlerë, si dhe obligacionet e Pacollit deri më datën 11 dhjetor 2010 sipas formularit të plotësuar nga vetë ai kapin vlerën 100 milionë euro. Ai po ashtu ka deklaruar se ka pasuri të patundshme, troje e shtëpi, në vlerë 26 milionë euro. "Sikurse të gjithë zyrtarëve të tjerë, edhe pasurinë e z.Pacolli e kemi publikuar pa u sqaruar më askënd", ka thënë shkurt, drejtoresha e Zyrës për Regjistrimin e Partive politike në KQZ , Miradije Mavriqi

---

## Ëndrra e Behgjet Pacolli për president

---

**(Ata që mendojnë se paraja i bën të gjitha, pa dyshim janë gati të bëjnë çdo gjë për para)**  
**- E. Pjer Boshen**

Atë që askush nuk mundet t'ia ndalojë një njeriu në këtë realitet objektiv është prirja e natyrshme e vullnetit të tij të lirë, që ta ketë një ëndërr të vetin si synim jetësor. Sepse, ashtu sikur thotë një urtësi e lashtë indiane: "nëse gjatë jetës nuk je i përkushtuar që ta përmbushësh ëndrrën tënde, atëherë gjithnjë do të punosh në drejtim të realizimit të ëndrrave të të tjerëve". Por, sado që ne fuqishëm angazhohemi në këtë drejtim, shpesh ëndrrat tona nuk realizohen fare, ose së paku jo ashtu sikur i kemi ëndërruar. Edhe pse realiteti është diku tjetër, në këto raste dimë të inkurajohemi kinse nuk kemi fat në jetë. Në të vërtetë, faji qëndron diku tjetër. Në vetë cilësinë përmbajtjesore të ëndrrës sonë. Ëndrrat (synimet tona) si proces mental nuk kanë kurrfarë kufiri të kreativitetit përmbajtjesor, andaj edhe na shkaktojnë kënaqësinë e pritur të ushqyer nga shpresa. Por, gjatë realizimit të ëndrrave tona në praktikë, ne detyrimisht i nënshtrohemi edhe disa ligjeve të natyrshme psiko-operative. Pra, në rend të parë, në harmoni me rregullat e përsosura të realitetit objektiv, ato duhen të jenë të kapshme - Ligji i KAPSHMËRISË së dëshirës! Gjatë historisë, shpesh hasim në biografitë e shumë personaliteteve të pasur dhe me fuqi të pakufishme politike, të cilët, pa marrë parasysh pasojat dhe çamin që duhet sakrifikuar, me çdo kusht kanë tentuar që t'i realizojnë ëndrrat e tyre (të mbrapshta) jetësore. Por, kotë! Në fund, kanë dështuar me faqe të zezë. E, tani, në vazhdim, le të na "shkoj gjuha aty ku edhe po na dhemb dhëmbi". Tek aktualiteti jonë politik i kandidimit të mundshëm të z. Behgjet Pacolli për postin e presidentit të Kosovës. Tek një njeri, aktualisht me më shumë forcë financiare se sa politike, i cili, sipas disa paraqitjeve të tija publike, me çdo kusht dëshiron ta realizojë ëndrrën e vet jetësore - të bëhet president i Kosovës. Apo, siç ka deklaruar edhe vetë në një gazetë kroate: "Do të bëhem Tito i Kosovës". Me këtë rast, në shërbim të krahasimit metaforik të kësaj teme, përmes këtij shembulli në vijim, do të bëj një digresion: Adnan Khashoggi (një biznesmen dhe diler botëror i armëve), nga Arabia Saudite, njihej si njëri ndër më të pasurit në botë. Ai kishte edhe një vajzë të bukur, Soraya, e cila studionte në SHBA dhe ëndërronte që një ditë me çdo kusht të bëhet aktore e njohur e "HOLLIWOOD"- it. Meqë, babai i saj ishte në gjendje që vajzës së vetë të dashur, t'ia përmbushë çdo dëshirë në këtë jetë, i angazhoi shumë profesorë, regjisorë dhe producentë më të njohur që ta përgatisin dhe aftësojnë profesionalisht për këtë synim (ëndërr) të saj jetësore. Edhe pse, objektivisht, asgjë nuk kishte pengesë në këtë drejtim, pas shumë tentativave dhe vullnetit të mirë të ekspertëve eminentë të kinematografisë botërore, më në fund u konstatua se, fatkeqësisht, ajo nuk kish kurrfarë talenti për aktrim. Vajza e dëshpëruar me këtë mossukses, babait të vetë shumë të pasur tani ju drejtua me një dëshirë tjetër edhe më të çmendur: "Të lutem, baba! Blima "HOLLIWOOD" -in!". Kuptohet, as kjo dëshirë e çmendur e vajzës së Adnanit nuk do të realizohet kurrë, edhe pse materialisht, një gjë e tillë ka qenë e mundshme, por realisht kurrsesi e PAKAPSHME për dhënien e pëlqimit për shitje të këtij simboli të krenarisë amerikane. Për kureshtjen tonë, atëbotë, pasuria e Kashoggit vlerësohej sa 3 fish i vlerës së paragjykuar të gjithë "HOLLIWOOD - it". Po e shihni, pra! Diku - diku, kur nuk kemi talent të Zotit, as paraja nuk bën punë?! Dhe, aty ku është në pyetje krenaria kombëtare e një shteti, asgjë nuk negociohet për asnjë çmim të ofruar?! Tanimë, besoj se lexuesit e mijë të dashur e kanë kuptuar se ku dua të dal me këtë mesele të mësipërme të Kashoggit. Tupani bie

për ata që kanë vesh..." - thotë populli. Unë shpesh kësaj urtësie popullore di t'ia shtoj atë vazhdim timin satirik:"... ndërsa, VUVUZELAT, për ata që kanë edhe nerva!".

Me sa e di unë, z. Pacolli ka edhe vesh, edhe nerva, por këtyre shkathtësive normale të tij, në këto momente vendimtare, duhen edhe arsyeja e shëndosh dhe çiltërsia sa më racionale e gjykimit. Besa - besa, i duhen edhe sy të mbrehtë dhe nuhatje të stërholluar që, pas zyrtarizimit të kandidimit të tij të mundshëm për president, me gjakftohtësi të analizojë çdo reagim në opinion. Në këtë artikull, qëllimisht nuk desha të merrem me elemente tjera të natyrës politike, morale... etj., që nga biografia personale, për shumë kë, janë pengesa serioze të kandidimit të tij për president të Kosovës, sepse kundërshtime të fuqishme publike të mbështetura, në këto fakte të dëshmuara, veç kanë filluar të shpalosen në opinion. Nëpër shumë faqe shqiptare të internetit dhe nëpër media të ndryshme të shkruara dhe elektronike, me të madhe shprehet indinjata e opinionit publik ndaj zgjedhjes së tij të mundshme për president të Kosovës. Edhe unë duke iu bashkangjitur të gjithë atyre intelektualëve dhe njerëzve të arsyeshëm të popullit tim, këtë mospajtim të bazuar, desha ta shprehi pak më ndryshe dhe në mënyrë më origjinale. I catur ndoshta edhe nga një optimizëm i fshehur në brendinë e qenies sime, parandiej se sigurisht do të më vinte mirë edhe sikur Pacolli të bëhet president?! Kështu që, në njëfarë forme, ai pvetëdijshëm dhe në mënyrë indirekte do të kontribuonte në shpejtimin e disa proceseve drejt vetëdijësimit të vonshëm, por të pashmangshëm politik të popullit tonë. Sikur tek metafora e vajzës së Kashoggit, edhe nëse pas këtij dështimi politik për president të Kosovës, z. Pacolli do të "dëshirojë ta blejë Kosovën", ne e dimë shumë mirë se ai këtë punë kaheerë ka filluar ta bëjë në heshtje... Në fund, gjatë realizimit të synimeve (ëndrrave) tona jetësore, përveç ligjit të sipërpërmendur hyjnor të kapshmërisë objektive të dëshirës, në natyrë vepron edhe një ligj tjetër universal: "Asgjë nuk mund të pengojë diçka që kaheerë është nisur të ndodhe"! Andaj, krejt në fund: me apo pa Behgjet Pacollin president, në kokat e njerëzve tanë një diçka si proces për së mbari mbase veç ka filluar të ndodhë.

---

## Sot nënshkruhet marrëveshja

---

**Thaçi kryeministër, Pacolli president**

**PDK - së do t'i takojnë posti i kryeministrit, posti i kryetarit të Kuvendit, 8 ministri dhe një zëvendëskryeministër. AKR - së do t'i takojnë posti i presidentit, katër ministri dhe një zëvendëskryeministër (deri më tash dihet për Ministrinë e Shëndetësisë dhe atë të FSK - së), Listës "LDK - Dr. Ibrahim Rugova" një ministri dhe një zëvendëskryeministër, ndërsa minoriteteve së bashku 5 ministri dhe një zëvendëskryeministër**

PRISHTINË, 18 SHKURT – Sot (e shtune) pritet të formohet koalicioni, I cili do ta qeverisë Kosovën në mandatin e ardhshëm katërvjeçar. PDK, AKR, Lista "LDK - Dr. Ibrahim Rugova" dhe minoritetet do ta nënshkruajnë marrëveshjen e koalicionit, nëpërmjet së cilës do t'i ndajnë përgjegjësitë qeverisëse. Lajmin e ka konfirmuar nënkryetari i PDK - së, Hajredin Kuçi, i cili ka bërë me dije gjatë së premtes se mandatarit për formimin e qeverisë ka zhvilluar takime me të gjithë partnerët e koalicionit. "Mandatarit i qeverisë të premten ka pasur takime të njëpasnjëshme me partnerët e koalicionit, me të gjithë, me AKR - në, me partitë e komuniteteve joshqiptare. Patëm një konsultë edhe me Grupin Parlamentar të PDK - së. Jemi në përgatitjet finale për javën tjetër. Të shtunën pritet të bëhet nënshkrimi i marrëveshjes së koalicionit me partitë që do të jemi në koalicion, me AKR - në, Listën "LDK - Dr. Ibrahim Rugova" dhe me partitë e tjera të komuniteteve joshqiptare. Në këtë drejtim besoj se dita e shtunë do ta definojë saktësisht çështjen e koalicioneve dhe do të jemi të përgatitur që nga e hëna ta procedojmë zgjedhjen e qeverisë dhe të presidentit", ka theksuar Kuçi. Sipas marrëveshjes, e cila pritet të nënshkruhet, PDK - së do t'i takojnë: posti i kryeministrit, posti i kryetarit të Kuvendit, 8 ministri dhe një zëvendëskryeministër, AKR - së do t'i takojnë posti i presidentit, katër ministri dhe një zëvendëskryeministër (deri më tash dihet për Ministrinë e Shëndetësisë dhe atë të FSK - së), Listës "LDK - Dr. Ibrahim Rugova" një ministri dhe një zëvendëskryeministër, ndërsa minoriteteve së bashku 5 ministri dhe një zëvendëskryeministër. Pas përmbylljes së marrëveshjes ndërmjet partnerëve të koalicionit do të pasojë votimi i qeverisë dhe presidentit në Kuvendin e Kosovës. Përderisa për zgjedhjen e qeverisë nevojiten vetëm 61 nga 120 vota të deputetëve, Kushtetuta parasheh që për presidentin e Republikës në dy raundet e para nevojitet një shumicë prej 2 / 3 tash e deputetëve. Nëse edhe pas dy raundesh kjo shumicë nuk arrihet, atëherë në raundin e tretë zgjedhja e presidentit bëhet me 61 vota.

### **Kush nga AKR-ja mund të jetë ministër?**

"Epoka e re" jozyrtarisht ka mësuar se kandidatë për poste në kabinetin qeveritar nga radhët e koalicionit të udhëhequr nga AKR - ja janë: Mimoza Kusari - Lila, Muhamet Mustafa (zëvendëskryeministër), Ibrahim Gashi, Ferid Agani (ministër i Shëndetësisë) dhe Agim Çeku (ministër i FSK - së), ndërsa ende nuk dihet saktësisht se cilat ministri do t'i udhëheqin Kusari - Lila dhe Gashi. Ashtu siç është marrë vesh më herët, kandidat i përbashkët i koalicionit PDK, AKR, Lista "LDK - Ibrahim Rugova" dhe minoritetet për postin e presidentit të Republikës së

Kosovës është kryetari i AKR - së Behgjet Pacolli. Bazuar në vendimin konsensual të Këshillit Drejtues të PDK - së për dhënien e postit të presidentit partneres së koalicionit, AKR - së, zgjedhja e Behgjet Pacollit për president të Kosovës duhet të jetë punë e kryer.

---

## Pacolli, një burrë shteti

---

*Shkruan: William Walker*

Për herë të parë e takova Behgjet Pacollin në shtator 2004. Ishte koha kur udhëtova për në Lugano të Zvicrës si Kryetar i Bordit të Besimit, të të posalindurit Universitetit Amerikan në Kosovë (AUK), institucion që premntonte të ishte sfidues. Duhet të shikoja nëse ky biznesmen i suksesshëm ndërkombëtar, i lindur në Kosovë, kishte interes të merrte pjesë në përpjekjet tona për të krijuar një qendër ekselence të arsimit të lartë për Kosovën, dhe rajonin. Nuk kisha asnjë ide se çfarë më priste. Që nga momenti i paraqitjes, e kuptova se kisha të bëja me një njeri të jashtëzakonshëm. Së pari, ngrohtësia e mirëseardhjes dhe mikpritja e tij e pakufishme gjatë tre ditëve në vijim mund të përshkruhet si e jashtëzakonshme, dhe çka është më e rëndësishmja, si e sinqertë. Së dyti, fill sapo unë kisha përshkruar ato çka ishin ëndrrat tona për një Universitet Amerikan në Kosovë (AUK), dhe sapo i fola atij për nevojën e ngutshme për një kampus të ri, z. Pacolli ndali prezantimin tim duke më thënë se ai ishte tërësisht në mbështetje të konceptit tonë, dhe do të donte ta dëftente mbështetjen e vet me një dhurim personal të një madhësie të mjaftueshme për të ndërtuar një strukturë, të cilësisë më të lartë ku do të strehohej universiteti i ri. Brenda disa javësh, z. Pacolli mblodhi arkitektët, inxhinierët, krahun e punës, ekipin, i cili ndërtoi një kampus të bukur, funksional, shtëpia e Universitetit Amerikan në Kosovë dhe krenaria e Prishtinës sot, Vizioni i Behgjet Pacollit, bujaria dhe standardet e larta i dhanë vendlindjes së tij, Kosovës një strukturë mbështetëse reale për arsimim të klasit botëror. Vitet që pasuan nuk e kanë zvogëluar mbështetjen e tij për Universitetin Amerikan në Kosovë. Gjatë këtij takimi të parë si mysafir në hotelin e tij, ne gjithashtu shkëmbyem mendime mbi gjendjen problematike të asaj kohe në Kosovë. Në 2004, Kosova ishte në vitin e saj të katërt të administrimit nga UNMIK-u, misioni ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara, i krijuar nga Këshilli i Sigurimit, menjëherë pas konfliktit të NATO/ UÇK-së me Serbinë në 1999. Kishte pasiguri të madhe nga të gjitha anët, dhe mjaft ngurrim për të jetësuar plane afatgjatë - në drejtim të investimeve, të biznesit, të ndërtimit të kombit, në privatizimin e njësive joefikase të ekonomisë publike të periudhës komuniste, në rinovimin e industrisë më themelore dhe infrastrukturës, etj - duke marrë parasysh se statusi i ardhshëm legal i Kosovës ishte shumë në dyshim. Ishte pavarësia në horizont, si shpresonin shqiptarët e Kosovës? Apo Kombet e Bashkuara do insistonin në një mënyrë ose në një tjetër që Kosova të mbetet pjesë integrale e Serbisë? Prej 2004- së zhgënjimi dhe pakënaqësia ishte ulur këmbëkryq; pak ose askush prej kosovarëve ishin duke vendosur baste për të investuar në të ardhmen. Siç kam mësuar në bisedimet e para dhe të mëvonshme, Behgjet Pacolli nuk ishte në mesin e tyre. Në të kundërtën, gjatë diskutimeve tona të kahershme, mësova se ai ishte optimist ngaqë besonte se ditë më të mira pastaj do të vinin jo vetëm për Kosovën, por edhe për Evropën Qendrore dhe Jugore si një e tërë. Dhe ai kishte kushtuar kohën e tij, vëmendjen dhe burime në investime aq shumë të nevojshme në fushën e bankave, sigurimeve, projektet e infrastrukturës, dhe shumë më tepër se kaq. Në ato bisedime të para, Behgjet Pacolli e përshkruante vizionin e tij për një Ballkan të së ardhmes shumë të ndryshëm nga qoshja aktuale kaotike, e varfëruar e Evropës, një qoshe e shkatërruar nga lufta, që aq shpesh në të kaluarën shpërthente në konflikte të përgjakshme, ashtu siç ndodhi gjatë viteve 1990. Konfliktet në bazë etnike, dallimet gjuhësore, kulturore, fetare dhe armiqësitë, sipas mendimit të tij, nuk duhet të kenë vend në Evropën e shekullit të 21. Nëse Franca dhe Gjermania, Polonia dhe Gjermania, armiq të hidhur gjatë shekujsh, ja mbërrin të punojnë si partnerë në ndërtimin e një Bashkimi Evropian modern, pse jo shtetet e Ballkanit? Behgjet Pacolli ma tregoi germë për germë, ëndrrën e tij të integritimit

të Kosovës në një kuadër gjithnjë e më të ndërvarur të lidhjeve ekonomike dhe të tregtisë, të transportit të integruar dhe rrjeteve të tjera infrastrukture- një proces gradual, pa zarar, i cili në mënyrë të pashmangshme dhe në mënyrë paqësore, do të çonte në një ndërvarësi më të madhe ekonomike midis bashkësisë së këtyre ekonomive të vogla dhe të pambrojtura. Kështu Ballkani do të bëhej një tjetër qoshe moderne e Evropës, Behgjet Pacolli qe i bindur se kjo do të ndodhte, nëse udhëheqësit politike të vendeve të Ballkanit do të linin mënjatë interesat e tyre të vockla, dhe do të punonin për përfitime politike dhe ekonomike për të gjithë në rajon. Në vitet e mëpasme që e njoha Behgjet Pacollin, unë kam përjetuar në mënyrë të njëpasnjëshme shembuj të tjerë të shqetësimit të tij dhe pasionit për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve, qofshin ato të një individi, ose të një kombi të tërë. Kur ai merret me një kauzë, me një mision, ai është i gatshëm për të investuar kohën e tij, pasurinë e tij personale, mirëqenien e gjithçka duhet për të sjellë një zgjidhje të drejtë dhe praktike. Dy shembuj: Një mbrëmje, ndërsa unë isha sërish në Lugano, z. Pacolli u njoftua se disa ndërkombëtarë, në mesin e tyre një shqiptare, ishin rrëmbyer në Afganistan. Pa hezitim, Behgjeti vendosi të udhëtojë në rajon, në përpjekje për të gjetur rrëmbyesit e tyre dhe biseduar lirimin e tyre. Ai fluturoi jashtë vendit një ditë më pas. Perëndia e di atë që ai bëri për të përmbushur qëllimin e tij, se në çfarë rreziku e futi veten, dhe çfarë burimesh shpenzoi - por misioni i tij ishte tërësisht i suksesshëm. Me kalimin e kohës, në shkurt 2008, Kosova shpalli pavarësinë e saj pa pyetur Serbinë, Behgjeti u përfshi në politikën kombëtare, si kryetar i një partie të opozitës politike në Parlament. Kur qeveria e re u duk e pa zonja për të avancuar kërkesat e Kosovës për njohje diplomatike, Behgjet Pacolli u vu sërish në lëvizje. Unë u privilegjova të jem pjesë e një vizite të tillë në Salvador, ku kam qenë ambasadori amerikan gjatë katër viteve të fundit të luftës civile të viteve 1980 në këtë vend të vogël. Pagoi vetë të gjitha shpenzimet, ju drejtua rrjetit të tij të kontakteve në mbarë botën, duke shfaqur një talent të natyrshëm për protokollin diplomatik kur qe e nevojshme, si edhe qasje më të drejtpërdrejta kur duhej. Behgjet Pacolli ka qenë forca lëvizëse për njohjen e Kosovës nga një numër i caktuar vendesh. Kur të tjerët u përpoqën të merrnin merita për këto arritje, z.Pacolli , i la ata të mburreshin. Qëllimi i tij ishte pranimi i vendit të ri nga ana e bashkësisë botërore, asgjë tjetër përtej kësaj. Behgjet Pacolli është kështu një biznesmen i suksesshëm, një humanist i madh, një zgjidhës problemesh, një burrë shteti i cili dëshiron të kontribuojë me të gjitha cilësitë për një jetë më të mirë për bashkatdhetarë të tij kosovarë dhe të gjithë popujt e Ballkanit.



---

## **PDK-AKR në prag të “kurorëzimit”**

---

### **Të shtunën pritet që të nënshkruhet koalicioni i ri qeverisës, PDK-AKR- minoritetet**

PRISHTINË - Stërzgjatja e krizës institucionale, vështirësitë në ndarjen e posteve në qeveri dhe pakënaqësitë në PDK rreth postit të presidentit, kanë bërë që udhëheqësit e koalicionit të ardhshëm të kërkojnë forma të shpejta për konstatimin e institucioneve të reja. Tashmë, ka filluar të shqyrtohet mundësia që në seancën e 21 shkurtit, përveç organeve të Kuvendit, të zgjidhet edhe presidenti dhe qeveria e re. Megjithëse dy çështjet e fundit, nuk janë të parapara në agjendën e seancës të së hënës, ato mund të futen si pika të veçanta, shtesë, në rendin e ditës. Kësaj ngutjeje të PDK - së për të kryer sa më shpejt konstituimin e institucioneve duket se i ka shërbyer edhe vendimi i së premtes i u.d të presidentit, Jakup Krasniqi, i cili ka nominuar zyrtarisht Hashim Thaçin mandatar për formimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ky vendim i Krasniqit është marrë duke u bazuar në Kushtetutë dhe në vendimin e KQZ - së për çertifikimin e rezultateve të zgjedhjeve të fundit. Në të, mandatarin e nominuar, ftohet që të bëjë koalicionet e nevojshme me partitë politike në afatin më të shkurtër kohor, për të formuar koalicionin për Qeverinë e re dhe të dalë me propozim para Kuvendit të Kosovës. Ndërsa, rendi i ditës së seancës konstituive të legjislaturës së katërt të Kuvendit, e cila do të mbahet të hënën, aktualisht përmban vetëm formimin e Komisionit të përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve, dhënien e betimit të deputetëve, zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit, si dhe zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit. Kurse, votimi i Qeverisë së Kosovës nuk do të jetë në rend dite, megjithëse ka mundësi procedurale që rendi i ditës të plotësohet në rast se PDK - ja dhe AKR - ja të zyrtariojnë koalicionin mes tyre gjatë fundjavës. Zyrtarët e PDK - së tashmë kanë bërë të ditur se marrëveshja e koalicionit mes PDK - së, AKR - së dhe minoriteteve do të nënshkruhet të shtunën. Një mundësi e tillë, nuk është mohuar as nga përfaqësitë e AKR - së, të cilët, megjithatë deklarojnë se nuk janë konkretizuar detajet e marrëveshjes. Ibrahim Makolli, nga AKR - ja, ka thënë se gjatë natës të së premtes ose të shtunën mund të ketë bisedime të reja mes PDK - së dhe AKR - së, të cilat do të rezultojnë me konkretizimin e marrëveshjes së koalicionit. PDK - ja të premtën ka mbajtur një takim të Grupit parlamentar, pas të cilit, nënkryetari Hajredin Kuçi ka thënë se marrëveshja e koalicionit ndërmjet PDK-së, AKR - së dhe minoriteteve do të nënshkruhet të shtunën. Duke mos përmendur ministrinë të cilat do të udhëheqë PDK - ja, ai ka thënë se kjo parti do t'i mbajë gjysmën e ministrive të qeverisë së ardhshme. Sipas tij, janë siguruar votat edhe për zgjedhjen e Pacollit president. Kurse, Mimoza Kusari - Lila, zëvendës-presidente e AKR - së, është shprehur e bindur se përkundër opinionëve rreth mundësisë që një pjesë e deputetëve të PDK së të mos votojnë për Pacollin, ky i fundit do të marrë votat e mjaftueshme për t'u zgjedhur president i Kosovës. Në favor të konstituimit sa më të shpejtë të institucioneve të reja janë edhe përfaqësuesit e partive opozitare, të cilët, megjithatë kërkojnë respektimin e rregullave dhe ligjeve në këtë proces. Donika Kadaj - Bujupi nga AAK - ja ka thënë se partia e saj është e interesuar që sa më parë të konstituohen institucionet e reja, në mënyrë që t'i jepet fund krizës disa mujore. Duke iu referuar mundësive që të gjitha institucionet të konstituohen më 21 shkurt, ajo ka thënë se AAK - ja do të insistojë që institucionet të konstituohen vetëm në përputhje me rregulloren e punës së Kuvendit dhe Kushtetutën.

---

## Figura e dyshimtë e Pacollit

---

**Me të dëgjuar se Behgjet Pacolli do të jetë president i ardhshëm i Kosovës, në Rusi janë ngjallur reagime të shumta, duke e akuzuar atë për afera të shumta korruptive. Në opinionin vendor ka shumë kundërshtime për Pacollin president, por thuhet se kjo tanimë është punë e kryer, pasi ai ka blerë votat për t'u zgjedhur president.**

Përderisa në disa qarqe vendore, kandidatura e Behgjet Pacollit për president të Kosovës po shihet me skepticizëm, për shkak të siç thuhet lidhjeve të tij të ngushta me Rusinë; në Rusi, me të dëgjuar se Pacolli do të jetë president i ardhshëm i Kosovës janë ngjallur reagime të shumta. Mediat ruse, shkruajnë se e kaluara e Pacollit në shtetin rus është e turbullt, duke e akuzuar atë për një sërë aferash korruptive. E përditshmja në Moskë "Kommersant" shkruan se Pacolli është bërë figurë qendrore në Rusi nëpërmjet skandalit korruptiv me Yeltsinin. Sipas kësaj të përditshme, Pacolli ka dhënë shuma të mëdha ryshfeti në shkëmbim të punës për ta rikonstruktuar kompleksin e Kremlinit. "Kommersant" shkruan se zyrat e Mabetex - it në Lugano të Zvicrës ishin bastisur në janar të vitit 1999 me kërkesë të Rosisë, ndërsa Pacolli ishte marrë në pyetje nga prokurorja e atëhershme shtetërore e Zvicrës, Carla del Ponte. Gjithashtu, sipas kësaj të përditshmeje, thuhet se një konflikt personal në mes të Pacollit dhe prokurorit shtetëror rus, Yuri Skuratov, i cili kishte filluar hetimet kundër Mabetex-it ka rezultuar me lërimin e Skuratovit nga detyra e tij si prokuror i shtetit. Përveç akuzave të bazuara në të kaluarën, mediat paralajmërojnë se së afërmi, firma e Pacollit është ftuar për të ri-konstruktuar kompleksin e Kremlinit, rezidencën presidenciale Shuyskava Chupa, Zyrat e Qeverisë, Zyrat e Dumës Shtetërore, Këshillin Federativ dhe shumë projekte tjera.

### **Pacolli si president, dëm për Kosovën**

Akuza të tilla, të paraqitura në mediat ruse, pak ditë para se Pacolli të zgjidhet president i shtetit, nga njohësit e politikës në vend komentohet në mënyra të ndryshme. Nexhmedin Spahiu e arsyeton, veprimtarinë e Pacollit në Rusi si të lidhur me presidentllëkun e Boris Yeltsin-it, njeriut më perëndimor që ka pasur ndonjëherë Rusia në kreun e vet politik, ndërsa kjo situatë tani ka ndryshuar. Ndërsa, sipas analistit tjetër, Behxhet Shala, edhe pse të zgjedhurit e një personi siç është Pacolli nuk është e mirë për vendin; vendorët dhe ndërkombëtarët po e injorojnë këtë fakt. "Vet ideja që Pacolli të jetë president i ardhshëm i Kosovës është në dëm të Kosovës, dhe këtu s'ka asnjë dyshim. Mirëpo, me të gjitha këto reagime mediale nuk po çojnë peshë as te vendorët as te ndërkombëtarët sepse atyre thjesht po u duhen njerëz që thjesht iu kryejnë punë, dhe nuk u intereson shumë e kaluara e tyre", thotë Shala. Me tutje sipas tij, edhe përkundër të gjithë këtyre, fakti se Pacolli do të jetë president i radhës nuk ka asnjë dilemë pasi që ai ka arritur të sigurojë vota të mjaftueshme për këtë "Zoti Pacolli ka siguruar vota të mjaftueshme, i ka blerë votat, dhe për mua nuk do të ishte fare befasi nëse zoti Pacolli zgjidhet president", tha Shala.

### **Akuzat, punë e kryer**

Disa javë më parë, në raportin Martit u akuzua kryeministri i vendit. Ndërsa, frika se në një të ardhme të afërt mund të kemi akuza të reja edhe ndaj presidentit të ardhshëm të Kosovës dhe kështu të degradohet edhe më shumë imazhi i vendit në arenën ndërkombëtare, për analistët

vendorë është e paqëndrueshme. Për analistin Nexhmedin Spahiu, këto akuza tashmë janë punë e kryer për shkak se këto çështje janë hetuar nga prokuroria e Zvicrës, në bashkëpunim me organet kompetente ruse dhe është marrë vendim gjyqësor në lidhje me këtë, "Pacolli ka kaluar nëpër akuzat e Carla Del Pontes në Zvicër, dhe aty është marrë një vendim gjyqësor relevant prej një shteti të besueshëm siç është Zvicra, dhe kjo bën që këto shigjeta të tanishme të thyhen", tha Spahiu. Ndërsa, sipas analistit Behxhet Shala, Rusia nuk ka ndonjë interes të madh të merret me Pacollin, kështu që nuk besohet që do të ketë ndonjë akuzë serioze për të në lidhje me këto çështje; ndërsa sa i përket imazhit, nuk ka ku të shkon më poshtë. "Rusia nuk ka më interes të madh me shtrë çështje kundra Pacollit! Pastaj imazhi! Po çfarë imazhi kemi ne bre, ku ne i kemi 80 % të varfër, nuk jemi sovranë në krejt territorin, nuk mund vendosim për fatin tonë, çfarë imazhi kemi ne. Nuk ka pasur ndonjë imazh edhe më herët që do të shërbente si shembull për dikënd", tha Shala.

---

## I dërguari i Rusisë

---

Gazeta zvicerane 'NZZ Zeitung' i ka dhënë Pacollit epitetin e Kalit të Trojës, i cili sipas kësaj gazete është i dërguar nga Rusia, vend ky që është kundërshtar i madh i pavarësisë së Kosovës. "Behgjet Pacolli, një 60-vjeçar, i martuar me një ruse, i cili ka fituar shumë para në Rusi dhe në fillim të luftës në Kosovë madje u takua për negociata me kryetarin serb, Millosheviqin, me qëllim që t'i përjashtojnë fuqitë perëndimore (nga ndërmjetësimi dhe ndërhyrja në Kosovë) nuk është president i ëndrrave të shtetit të ri, shkruan kjo gazetë.

Përkundër kundërshtimeve dhe rrezikut për dëme të mundshme, ai do të bëhet president i Republikës së Kosovës. Dhe pa dyshim se do të bëhet, pasi që ai ka blerë votat, ka thënë një analist vendor në lidhje me kandidaturën e Behgjet Pacollit për president të shtetit të Kosovës. Mediat evropiane janë shumë kritike ndaj kandidaturës së Behgjet Pacollit për president të Kosovës. Një ndër to, gazeta zvicerane "NZZ am Sonntag", që është edicion për të dielën i gazetës së famshme "Neue Zürcher Zeitung" ka shkruar se Behgjet Pacolli nuk është president i ëndrrave për shtetin e ri të Kosovës.

### Pacolli "Kali i Trojës" për Kosovën

Përveç së kaluarës jo të mirë të Pacollit në Zvicër, që ashtu edhe siç është bërë e ditur në media, zyrat e tij të firmës "Mabetex" në këtë shtet janë bastisur disa herë, gazeta zvicerane "NZZ Zeitung" i ka dhënë Pacollit epitetin e Kalit të Trojës. Sipas kësaj gazete, Pacolli është Kali i Trojës i dërguar nga Rusia, vend ky që është kundërshtar i madh i pavarësisë së Kosovës, "Behgjet Pacolli, një 60-vjeçar, i martuar me një ruse, i cili ka fituar shumë para në Rusi dhe në fillim të luftës në Kosovë madje u takua për negociata me kryetarin serb, Millosheviqin, me qëllim që t'i përjashtojë fuqitë perëndimore (nga ndërmjetësimi dhe ndërhyrja në Kosovë) nuk është president i ëndrrave të shtetit të ri. Ai dyshohet se për shkak të lidhjeve të tij të mira me Moskën është Kali i Trojës i Rusisë, kundërshtares së pavarësisë së Kosovës", shkruan e përditshmja NZZ Zeitung. Gazeta më tutje shkruan se Pacolli deri në vitin 2008 ka qenë nën hetime në Zvicër për shkak të shpëlarjes së parave. Ndërsa, deputeti i Parlamentit të Zvicrës, Andreas Gross, i cili është po ashtu edhe anëtar i Këshillit të Evropës, ka thënë se një figurë kaq shumëgjyreshë dhe e diskutueshme gjithsesi nuk do t'i ndihmojë Kosovës në përmirësimin e imazhit të saj.

### Edhe pse fakt, duket si karikaturë

Reagime negative në lidhje me kandidimin e Pacollit për president të Kosovës kanë ardhur edhe nga disa qarqe gjermane. Analisti gjerman, Norbert Mappes Njedick, në një intervistë për Deutsche Wellen, ka thënë se ka dyshime të mëdha për figurën e Behgjet Pacollit, i cili sipas të gjitha gjasave do të jetë president i Kosovës. "Ky është kombinimi më i keq që ka mundur të bëhej, sepse këtu janë bërë bashkë klientelistët. Unë mendoj se kjo qeveri do të merret vetëm me ndarjen e pjesëve. Ata nuk po bëjnë as përpjekjen më të vogël për të treguar vullnetin e tyre për reforma politike. Pacolli njihet në perëndim si partner i ngushtë i demokaturave të Azisë Qendrore dhe i Boris Jelcinit, pra presidentit më të korruptuar që ka pasur Rusia. Fakti që ky

njeri do të bëhet president i Kosovës duket si karikaturë", ka thënë ndër tjerash analisti gjerman, Norber Mappes.

---

## **PDK pa konsensus për Pacollin president**

---

**Edhe publikisht, anëtarët e kryesisë së PDK-së janë deklaruar kundër koalicionit me AKR-në. Ata rrëfejnë se vendimi për hyrjen në koalicion dhe dhënies së postit të presidentit Behgjet Pacolli, është marrë pa konsensus brenda partiak.**

Anëtarë të kryesisë dhe Këshillit të Përgjithshëm të PDK - së, edhe publikisht kanë dalë me kundërshtimet e tyre rreth koalicionit me AKR-në dhe kandidaturës së Behgjet Pacollit për postin e presidentit. Kreu i PDK - së Hashim Thaçi pas nënshkrimit të marrëveshjes së koalicionit me AKR në deklaroi se ka mbështetjen e gjithë anëtarëve të partisë se tj. Por, jo të gjithë kanë dalë pro kësaj deklarate, pasi edhe publikisht anëtarë të kryesisë së PDK-së kanë thënë se vendimi për hyrjen në koalicion me AKR-në, nuk është marrë me konsensus. Sipas anëtarit të kryesisë së PDK-së, Xhevat Bislimit, vendimi është marrë pa konsensusin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të partisë, por vetëm me anë të disa diskutimeve që janë bërë nga anëtarët e Këshillit Drejtues (KD). Bislimi ka thënë se vendimi nuk është hedhur as në votim para anëtarëve e KD - së. “ Jo, është debatuar, por votim s'ka pasur, vendim me konsensus, vetëm kanë debatuar disa anëtarë të KD -së”, ka thënë Bislimi. Edhe anëtari tjetër i kryesisë së PDK-së, Ramadan Avdiu ka thënë se ka pasur mendime të ndryshme në debatin për hyrje në koalicion me AKR - në.

### **Konsensus vetëm për Krasniqin president**

Por, mospajtimet e anëtarëve të PDK - së kanë ardhur, pasi disa prej tyre kanë nominuar sekretarin e përgjithshëm të kësaj partie, Jakup Krasniqin, për president. Bislimi thotë se gjëja e vetme që kanë pasur të gjithë konsensus ka qenë që Krasniqi të bëhet president e jo Pacolli. "Me konsensus dhe pa asnjë votë kundër kemi pasur vetëm për kandidaturën e Jakup Krasniqit që të jetë president, ndërsa, rreth koalicionit me AKR në dhe Pacollin president nuk ka pasur konsensus dhe nuk është marrë asnjë vendim madje nuk është votuar fare. Madje as kryesia s'ka pasur konsensus për kandidaturën e Pacollit për president dhe është deklaruar kundër edhe pse as aty s'ka pasur votim", është shprehur Bislimi. Ndërsa, për ndarjen në qëndrime të anëtarëve të PDK- së rreth kandidaturës së Pacollit për president e konfirmon edhe anëtari tjetër i kryesisë së PDK - së, Shemsi Veseli, i cili thotë se ka pasur qëndrime të ndryshme rreth kësaj çështjeje. "Jo, vendimi është marrë me shumicë dhe në organizimet partiake, vendimi i shumicës është obligativ edhe për pakicën. Normal që ka pasur kolegë që kanë pasur qëndrime të ndryshme që është shumë e natyrshme, por qëllimi ka qenë që të ketë një koalicion të qëndrueshëm dhe që punon për interesat e Kosovës dhe qytetarëve", ka thënë Veseli.

### **Thirrje publike, të mos votohet Pacolli**

Mirëpo, Bislimi shprehet se ai ka qenë, është dhe do të jetë kundër këtij koalicioni dhe Pacollin president. "Unë mendoj sa i përket kandidaturës së Pacollit secili do të mbajë qëndrimin e vet, unë personalisht kam qenë, jam dhe do të jem edhe publikisht kundër këtij koalicioni dhe Pacolli të jetë president i Kosovës", ka thënë Bislimi. Sipas tij, konsensusi rreth kësaj çështjeje do ta bënte PDK në parti jodemokratike. "PDK - ja në momentin që do të kishte një konsensus të plotë për këtë koalicion, atëherë s'do të ishte më parti demokratike. Tamam puna me pas konsensus rreth kandidaturës së Pacollit për president", është shprehur Bislimi. Ai ka bërë

thirrje që mos të votohet Pacolli për president të vendit, edhe pse udhëheqësit e lartë të PDK - së kanë kërkuar që të votohet për president Pacolli. "Nuk e di ajo është çështje e secilit, unë publikisht ju kam bërë thirrje që të mos e votojnë. Sigurisht se ata kërkojnë m'u votuar derisa kanë bërë koalicion", ka thënë Bislimi.

## **Pse unë jo, e Pacolli mund të jetë president?!!**

**Veprimtari i çështjes kombëtare Adem Demaçi, thotë se nuk ka aspiruar të bëhet president, pasi këtë detyrë ai nuk e sheh si një përfitim siç tentojnë disa, si zoti Pacolli, i cili sipas tij ashiqare thotë: “unë dua të bëhem President”. Për Pacollin thotë se është njeri që më së paku i takon ai vend. “Si mund të bëhet dikush president me 7 për qind të votave pash Zotin. Ai mezi mori 7 për qind të votave dhe ato bashkë me disa parti tjera, dhe tani dëshiron të bëhet president i krejt shqiptarëve”, thotë Demaçi.**

Me Adem Demaçin, personalitetin e rrallë të letrave shqipe, pinjollin e të drejtave të njeriut në Kosovë, pishtarin e kauzës kombëtare shqiptare të pasluftës së II Botërore në Kosovë, fituesin e çmimit ndërkombëtar "Saharov", i cili para ca ditësh u shpall edhe "Doctor honoris causa" i Universitetit të Prishtinës, me kryetarin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, bisedojmë për lëvizjen kombëtare shqiptare në Kosovë, për kulturën, politikën, për shtet formimin e Kosovës dhe për çështje tjera të realitetit tonë. Në këtë numër Demaçi flet: Pse unë nuk mund të jem president e Pacolli po ? Cilat janë sfidat esenciale të shtetndërtimit të Kosovës dhe cilat janë shkaqet që Dik Marti bëri agresion mbi Kosovën?

**Qani Mehmedi: Zot Demaçi, më në fund, më 17 shkurt 2008 Kosova arrit të shpallte pavarësinë. Cilat janë sfidat e shtetit të ri të Kosovës që këto ditë mbush tre vjet?**

**Adem Demaçi:** Bota perëndimore, SHBA - ja dhe Evropa pritën që Serbia të sillej më ndryshe, priti që Serbia do të mblidhte mend dhe të hiqte dorë nga hegjemonizmi i vet, priti të dorëzonte Mlladiqin dhe të dënonte krimet e luftës të çetnikëve që kryen mizori dhe barbari në Kosovë dhe gjithkund. Por kjo nuk u doli. Serbët, jo vetëm që nuk ndryshuan, por filluan edhe të mos i binden bashkësisë ndërkombëtare, duke mos u distancuar fare nga krimi, gjenocidi, eksodi dhe të gjitha të zezat. Atëherë SHBA-ja nuk pa rrugë tjetër dhe na tha neve: shpalleni pavarësinë. U bë mirë sepse shpallja e pavarësisë ishte kundërshtim i rezolutës 1244 dhe kjo ishte një fitore e madhe falë ndihmës së amerikanëve dhe evropianëve. Kështu me pavarësinë u bë një kthesë e madhe për ata që e kuptojnë politikën pasi ne ngadalë po rrëshqasim drejt pavarësisë së plotë. Në momentin që neve do të na njohin dy të tretat e vendeve anëtare të OKB - së, ne do të pranohemi nga kjo organizatë e cila do ta njohë pavarësinë e Kosovës. Në atë moment do të bie rezoluta 1244 dhe ne do të kemi pavarësinë natyrale, juridike dhe faktike.

**Jo të gjithë liderët tanë janë burra të mirë**

**Qani Mehmedi: Që nga mbarimi i luftës, liderët që udhëhoqën luftën, drejtuesit e UÇK - së vazhdimisht gjenden në shënjestër të sulmeve që vijnë nga qarqe të ndryshme. Kjo po ndodh edhe këto ditë, siç është rasti me raportin e Dik Martit. Ku mendoni se është shkaku kryesor i kësaj lufte kundër ish-drejtuesve të UÇK-së?**

**Adem Demaçi:** Unë nuk mund të them se të gjithë liderët tanë janë burra të mirë, të ndershëm dhe janë për kurban. Nuk them se nuk kanë bërë gabime, sepse ishte lakmia pak e madhe, diku besa e kanë tepruar, sado që aty - këtu më shumë ka fjalë se vepra. Qëllimi kryesor është t'i bëhet qejfi Serbisë dhe Kosova ta paguajë faturën për shkëputjen e Serbisë nga sfera e interesit rus dhe t'i bashkohet BE-së si një vend që ka rëndësi strategjike për të kontrolluar Ballkanin.



Kështu edhe tani po paguajmë faturën ashtu si kemi paguar më 1878 , më 1912, në vitet 1918-19, edhe më 1939 edhe në vitin 1945. Kësaj here na kanë ngushtuar shumë, por kësaj here nuk kemi mundësi të paguajmë fatura të tilla. Dihet se organizimi i tërë kësaj fushate vjen nga Serbia dhe këtë e kanë thënë edhe vetë. E ka thënë ministri i Drejtësisë i Serbisë dhe ai i Policisë, se Marti të gjitha ato materiale i ka marrë nga Serbia, janë akuza të njohura të Serbisë ato të Dik Martit. Problemi është ky: Dik Marti po flet, por nuk ka dëshmitarë. Ku i ka dëshmitarët ai? Sepse, të akuzosh dikë duhen prova të prekshme. Ato prova po mungojnë. Gabimi ynë është ky: ne pushuam të sulmojmë Serbinë për të zezat dhe gjithë të keqen që na bëri, gjithë ato krime, vrasje barbare të grave e pleqve, e fëmijëve, që i dogjën nëpër shtëpia, i masakroi me thika ashtu siç dinë të bëjnë çetnikët serbë dhe kur Serbia e pa që ne pushuam, Serbia kaloi në aksion. Ne do të duhej që tani të kërkojmë që të hetohen krimet serbe. Ku janë ato 2000 kufoma që nuk po gjinden, çka ka ndodhur me ta? Pse në ditën kur ndodhi masakra e Srebrenicës, u bënë transplantime veshkash në Akademinë Mjekësore Ushtarake të Beogradit. Ne duhet të kërkojmë pse nuk po hetohen këto krime të Serbisë. Ne duhet të kërkojmë llogari pse po amnistohet Serbia. Këto, me këtë punë jemi vonuar. Unë jam i bindur se kur të kryhen hetimet për këto dyshime, do të vërtetohet se kjo është një absurditet i kurdisur nga Serbia. Është absurde, e pamundshme dhe e pakapshme. Edhe sot e kësaj dite në Shqipëri nuk ka mundësi të bëhet transplantimi i organeve, e lëre më në atë kohë. Këto që thotë Dik Marti janë përralla me tupan të Serbisë.

## **Pacollit më së paku i takon të bëhet president.**

**Qani Mehmedi: Z. Demaçi, kanë përfunduar zgjedhjet. Ndër emrat që janë lakuar për president ka qenë edhe juaji?**

**Adem Demaçi:** (Qesht) Unë nuk aspiroj të bëhem president për një arsye: Sepse sot të jesh president i ndërgjegjshëm, në këto kushte, në këto rrethana është një barrë shumë e rëndë. Nuk e kuptoj unë këtë detyrë si një përfitim siç e kuptojnë disa, si zoti Pacolli, i cili ashiqare thotë: "unë dua të bëhem President". Ai është njeriu që më së paku i takon ai vend. Si mund të bëhet dikush president me 7 për qind të votave pash Zotin. Ai mezi mori shtatë për qind të votave dhe ato bashkë me disa parti tjera, dhe tani dëshiron të bëhet president i krejt shqiptarëve. Kjo është një absurditet i madh, po ç't'i bësh kësaj lakmie të njeriut, nuk paska skaj. Pra, unë nuk aspiroj të bëhem president, sepse unë i kuptoj gjërat shumë seriozisht, por nuk mund ta ndalë zotin Pacolli. Unë jam për të marrë përsipër detyra të vështira dhe këtë e kam bërë kur ka qenë kombi në rrezik, ashtu siç pranova të bëhesha përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ku ka qenë zoti Pacolli atë kohë ??? !!!! Unë e bëra atë, isha në gojë të ujkut, por e bëra, sepse e kërkoi interesi kombëtar, e bëra atë detyrë me mish e me shpirt, ani pse njerëzit e UÇK-së kur nuk patën më nevojë për mua, më qitën e më lanë mënjanë, por unë mbeta ai Ademi që jam dhe që kam qenë gjithmonë, i ndërgjegjshëm dhe i pa thyeshëm. Dua të përsëris: unë nuk jam aspirant për një post të tillë. Nëse Kosovës i vjen situata dhe konsideron se unë duhet të jem aty, gjë që nuk e besoj se do të ndodhë, atëherë Demaçi është aty. Por unë jam i bindur se nuk do të vijë ai moment, kur të brendshmit e të jashtmit të pajtoheshin, të heqin dorë nga lakmitë e tyre, interesat e tyre e të vendosin ta bëjnë Adem Demaçin president. Prandaj, duke ditur këto, unë qeshem dhe i marr me tallje përfoljet e emrit tim për president.

---

## **Veteranët e UÇK - së i kërkojnë Pacollit t'i sqarojë deklaratat për mediumet e huaja**

---

**OVL e UÇK - së ka kërcënuar se nuk do ta njohë Pacollin si president po qe se ai nuk do të marrë mundin t'u përgjigjet pyetjeve sikundër që i është kërkuar. "Ne do t'i përcjellim me kujdes zhvillimet e ditëve në vijim dhe reagimi ynë do të jetë në përputhshmëri me Programin dhe Statutin e OVL të UÇK - së dhe nëse nuk do të ketë përgjigje në pyetjet e parashtruara, për ne do të jetë i papranueshëm dhe do t'i përdorim të gjitha mjetet demokratike për të kundërshtuar një president të tillë", kanë thënë veteranët nëpërmjet një letre**

PRISHTINË, 19 SHKURT - Organizata e Veteranëve të UÇK - së ka kërkuar përmes një letre të hapur që presidenti i AKR - së, Behgjet Pacolli, ta bëjë një gjë tjetër përpara se të zgjidhet presidenti i Kosovës, javën e ardhshme: "Të japë sqarime para deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe popullit të Kosovës lidhur me deklaratat e tija dhënë mediumeve të ndryshme të huaja të publikuara kohëve të fundit edhe në mediumet vendore". OVL e UÇK - së letrën e ka drejtuar në adresë të kryetarit, Kryesisë dhe të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilët do të zgjidhen më 21 shkurt. Duke përcjellë në vazhdimësi zhvillimet në skenën politike të Kosovës, krijimin e institucioneve të dala nga zgjedhjet e 12 dhjetorit, duke qenë të vetëdijshëm se është i domosdoshëm funksionalizimi i shtetit të Kosovës, ne jemi të detyruar që për hir të vlerave që përfaqësojmë t'u drejtohem kryetarit dhe Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës që do të zgjidhen të hënën, më 21 shkurt, njëkohësisht edhe deputetëve të këtij legjislacioni", ka shkruar OVL e UÇK - së. "Ne konsiderojmë se është e domosdoshme që në rend të ditës, para zgjedhjes së presidentit, kandidati për këtë post, Behgjet Pacolli, të japë sqarime para deputetëve dhe popullit të Kosovës në lidhje me deklaratat e tija dhënë mediumeve të ndryshme të huaja, të cilat kohëve të fundit janë duke u publikuar edhe në mediumet vendore". OVL e UÇK - së ka thënë se deklaratat e lexuara konsiderohen antikombëtare, të papërgjegjshme dhe të padenja për një njeri që pretendon të jetë përfaqësues i popullit. Kjo organizatë, e cila për kryetar e ka Muharrem Xhemaajlin, ka formuluar edhe pesë pyetjet, të cilave duhet t'u japë përgjigje Pacolli. "Kë e konsideron z. Pacolli nënë të Kosovës: Serbinë apo Shqipërinë? "është pyetja e parë për Pacollin. "Çfarë do të thotë z. Pacolli me fjalën: do të jem Tito i Kosovës? , në cilin kontest (kontekst v.j.) z. Pacolli e gjen vëllazërinë e popujve shqiptar dhe serb, në kontest etnik, fetar, kulturor apo gjuhësor? Cili është qëndrimi i tij (Pacollit v.j.) për luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe çfarë ishte roli i tij në takimet me Milosheviqin gjatë kohës së luftës? "dhe" çfarë u sugjeroi z. Pacolli politikanëve shqiptarë në shtëpinë e tij në Hajvali gjatë kohës së luftës, si zgjidhje të çështjes së Kosovës?", janë pyetjet e tjera. OVL e UÇK - së ka kërcënuar se nuk do ta njohë Pacollin si president po qe se ai nuk do të marrë mundin të përgjigjet në pyetje sikundër që i është kërkuar. "Ne do t'i përcjellim me kujdes zhvillimet e ditëve në vijim dhe reagimi ynë do të jetë në përputhshmëri me Programin dhe Statutin e OVL të UÇK - së, dhe nëse nuk do të ketë përgjigje në pyetjet e parashtruara, për ne do të jetë i papranueshëm dhe do t'i përdorim të gjitha mjetet demokratike për të kundërshtuar një president të tillë", ka mbaruar letra e OVL e UÇK - së. Presidenti i AKR - së, Pacolli, i cili pritet që të hënën e ardhshme të votohet për president të Kosovës në

Kuvendin e Kosovës, pas koalicionit me PDK - në e Hashim Thaçit, në një intervistë që i kishte dhënë gazetës kroate "Vecernji list" më 24 shkurt 2008, e cila ishte realizuar në rezidencën e tij në Lugano të Zvicrës, kishte thënë se ëndrra e tij është që "ti pajtojë serbët dhe kosovarët", ndërsa Serbinë e kishte cilësuar si "nënë të Kosovës, por të keqe". "Koha Ditore" ka botuar këtyre ditëve pjesë të intervistës së Pacollit dhënë gazetës "Vecernji list". Pacolli në atë intervistë kishte folur edhe për takimet që ai i kishte realizuar në vitin 1999 me Slobodan Milosheviqin, hetimet që i kishte nisur kundër tij ish - prokurorja, Carla del Ponte, si dhe për jetën e tij private. Gazeta kishte shkruar që "Pacolli nuk ka shumë fjalë të këqija për serbët, me gjithë krimet që ia kanë bërë popullit të tij" dhe se për të "Serbia ende është nënë e Kosovës, për fat të keq, nënë e keqe, Pacolli ishte cituar duke thënë: "Kur prindërit nuk sillen si duhet me fëmijën, nëse e keqtrajtojnë, atëherë do të gjendet dikush që do t'ia marrë fëmijën. Ky është rasti me Kosovën, jemi si dy vëllezër që përherë grinden derisa nuk e ndajnë pasurinë dhe nuk e ndërtojnë shtëpinë e vet. Tek atëherë fillon dashuria e vërtetë vëllazërore", ka thënë ai, duke folur edhe për dy takime me Millosheviqin në vitin 1999. "Kam dashur që edhe një herë të përpiqemi të jetojmë së bashku, por ai më tha se s'ka gjë nga kjo që unë i propozova dhe se shqiptarët mirë do ta mbajnë mend çfarë do t'ju ndodhë", ka thënë Pacolli. Kryetari i Aleancës Kosova e Re, Behgjet Pacolli, nuk ka dashur të shtunën të tregojë se a do ta sqarojë në Kuvendin e Kosovës punën e deklaratave të tij dhënë mediave të huaja ashtu sikundër që ka kërkuar nga ai Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK - së. Për çka është fjala? ", ka pyetur në fillim gazetën Pacolli përmes telefonit. Kur i është treguar se "fjala" është për kërkesën e veteranëve të UÇK - së që ai të sqarojë në Kuvendin e Kosovës deklaratat e tij dhënë mediave ndërkombëtare, Pacolli ka folur shkurt: "Unë nuk merrem me këtë punë. Natën e mirë", ka përshëndetur ai për ta mbyllur telefonin. Por më pas partia e tij, AKR - ja, ka lëshuar një reagim në emër të Pacollit. Aty janë akuzuar gazeta "Koha Ditore" dhe televizioni Kohavision për fushatë kundër Pacollit. "Unë nuk kisha ndërmend të reagoja ndaj kësaj fushate tendencioze, por një letër e dy organizatave të veteranëve lidhur me luftën, të cilën unë e respektoj shumë dhe për të cilën kam bërë shumë, më shtyu të përgjigjem si me poshtë", ka qenë e shkruar në letrën e AKR - së me emër të Pacollit. "Me përgjegjësinë time të plotë morale dhe politike deklaroj se unë asnjëherë nuk kam thënë, as nuk kam menduar që Serbia është nëna e Kosovës, se unë do të bëhem ndonjëherë Tito i Kosovës, se i kam quajtur serbet vëllezërit tanë".

## LISTA RUGOVA I BASHKOHET SOT KOALICIONIT

### ‘Kurorëzohet’ PDK – AKR dhe Minoritetet

**Koalicioni PDK - AKR dhe minoritetet është zyrtarizuar të shtunën. AKR - ja ka shpallur kandidatët për ministra në qeverinë e re të Kosovës. Ferid Agani, do të jetë ministër i Shëndetësisë së Kosovës, Agim Çeku, ministër i FSK - së, Mimoza Kusari - Lila, do ta drejtojë Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, kurse postin e zëvendëskryeministrit do ta marrë Muhamet Mustafa**

Kryetari i PDK-së, Hashim Thaçi dhe ai i AKR-së, Behgjet Pacolli e kanë zgjedhur ditën e shtunë, për të lidhur "kurorën" e koalicionit të ri qeverisës së bashku me partnerët e tjerë minoritar. Simbolika e së dielës së dasmave dhe lidhjes së fateve të reja solli zyrtarizmin e koalicionit shumë përfshirës në mes PDK - së, AKR - së, SLS - së, KDTP - së, derisa ky koalicion finalizohet sot edhe me Listën Ibrahim Rugova. Ceremonia e fillimit të nënshkrimit të marrëveshjes është bërë dje nga Kreu i PDK - së, Hashim Thaçi, kreu i AKR - së, Behgjet Pacolli, ai i SLS-së, Sllobodan Petroviq dhe në emër të Grupit 6 Plus nga Mahir Jaghillar, kryetar i KDTP - së. "Nënshkruam një marrëveshje për partneritet në ndërtimin e institucioneve të reja të Kosovës, të presidentit, qeverisë së re dhe dikastereve ministrore. Kjo marrëveshje është koalicion për Kosovën e Re për zhvillimin e Kosovës, për reforma demokratike, për krijimin e vendeve të reja të punës, për një Kosovë evropiane dhe bashkëpunim rajonal. Është marrëveshje për liberalizmin e vizave, për integrim në NATO dhe BE, si dhe rritjen e mirëqenies sociale të shtetit", tha Thaçi, kreu i PDK - së dhe mandatar për krijimin e qeverisë së re.

#### "Koalicioni për Kosovën e re"

Duke besuar në jetësimin e shpejtë të formulës së re qeverisëse, kreu i PDK - së tha se koalicioni ka legjitimitet dhe legalitet të plotë, pavarësisht përfshirjes politike dhe etnike në përbërjen e tij.

"Gjithçka do të mbyllet të hënën", ka thënë Thaçi, duke besuar se edhe ligjvënësit në seancën e ditës së hënë do të jenë në nivelin e përgjegjësisë për krijimin e institucioneve të reja të vendit. Gjithashtu, mandatarin për formimin e qeverisë tha se me Pacollin, që do të jetë i zgjedhur në postin e presidentit, do të bashkëpunojë si kryeministër dhe do të jenë të përkushtuar për shtetin dhe gjithë qytetarët e saj. "Do të punojmë bashkë si ekip, që të kemi një program - Programin e qeverisë së Kosovës", tha kreu i PDK - së, Hashim Thaçi. Edhe Behgjet Pacolli ka siguruar se bashkë me PDK - në, bashkë me ekspertët e Koalicionit për Kosovën e re, bashkë me anëtarët tjerë të koalicionit janë betuar për të punuar për interesat e qytetarëve të Kosovës dhe për ndërtimin një shteti dinjitoz. Edhe kreu i Partisë Demokratike Turke të Kosovës, Mahir Jaghillar, pas nënshkrimit të marrëveshjes për koalicion, u zotua se si Grup 6 Plus do të punojnë për të mirën e komuniteteve dhe gjithë popullit të Kosovës në një qeveri të përbashkët me partnerët qeverisës.

#### Ministrat e AKR - së

Sipas formulës së re qeverisëse në këtë partneritet, AKR - ja do të ketë, veç presidentit, tri ministri dhe një zëvendëskryeministër, i angazhuar për çështje ekonomike dhe pesë

zëvendësministra. Sipas nënkryetarit të AKR - së, Ibrahim Makollit, AKR-ja do ta drejtojë në qeverinë e ardhshme të Kosovës Ministrinë e Shëndetësisë Ferid Agani, Ministrinë e FSK - së, Agim Çeku, MTI-në Mimoza Kusari-Lila dhe postin e njërit nga zëvendëskryeministrat do ta ketë Muhamet Mustafa. Ndryshe, çmimi i koalicionit me minoritetet do të jetë një zëvendëskryeministër nga komuniteti serb, Slllobodan Petroviq nga SLS - ja, që do t'i ketë në udhëheqje edhe 3 ministri: Ministrinë e Pushtetit Lokal, Ministrinë e Kthimit dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe tre zëvendësministra. Marrëveshja e formalizuar nga deputetët e pakicave tjera që janë bërë bashkë në Grupin 6 Plus parashih që të gjitha së bashku të marrin Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, edhe gjashtë zëvendësministra në resorë të ndryshëm ministror. S. AHMETI

---

## Partitizmi i presidentit

---

**Në kohën e një jostabiliteti të vazhdueshëm politik, dhe pas një periudhe të gjatë të humbjes së besimit të qytetarëve në institucionet e tyre politike, emërimi i një figure partiake në pozitën e presidentit përbën edhe një goditje të rëndë në qëndrueshmërinë dhe autoritetin politik të institucioneve**

Kushtetuta e Republikës së Kosovës thotë se presidenti i Republikës "përfaqëson unitetin e popullit". Mbase, në realitet, Kushtetuta do të duhej të thoshte se presidenti ka pak lidhje me unitetin e popullit dhe përfaqëson hiç më shumë sesa unitetin e partive të koalicionit qeveritar. Është hera e katërt që nga themelimi i institucioneve të pasluftës që Kosova zgjedh presidentin e saj. Dhe është hera e katërt që politika kosovare në mënyrën më galopante dështon në përmbushjen e kërkesës kushtetuese për një president gjithëpërfshirës. Si pjesë e marrëveshjes së koalicionit, PDK - ja ka pranuar ultimatumin e AKR-së së Behgjet Pacollit që koalicioni shkon vetëm nëse ky i fundit përfiton postin e presidentit të vendit. Posti i presidentit është shndërruar në një post ordiner politik, i dhënë në pazare politike sikurse ndarja e ndonjë resorti ministror apo e ndonjë pozitë ambasadori ose këshilltari. Në kohën e një jostabiliteti të vazhdueshëm politik, dhe pas një periudhe të gjatë të humbjes së besimit të qytetarëve në institucionet e tyre politike, emërimi i një figure partiake në pozitën e presidentit përbën edhe një goditje të rëndë në qëndrueshmërinë dhe autoritetin politik të institucioneve. Në sistemet parlamentare, ndonëse përmban pushtete të caktuara, posti i presidentit është gjithashtu një post ceremonial, me funksion të përfaqësimit të shtetit dhe, siç thotë shprehimisht edhe Kushtetuta, të unitetit të popullit. Mu për këtë, Kushtetuta kërkon që kandidati fitues për president të marrë dy të tretat e votave në Kuvend. Asnjë president i deritanishëm i Kosovës nuk është zgjedhur me dy të tretat e votave të Kuvendit. Çdoherë procedura zgjedhore ka kaluar në variantin rezervë, atë të raundit të tretë, ku zgjedhja bëhet me një shumicë të thjeshtë të votave. Për fat të keq, kjo është një traditë e keqe që i ka ngelur Kosovës qysh nga viti 2001, me rastin e zgjedhjeve të para nacionale të pasluftës, kur Ibrahim Rugova u zgjodh në postin e presidentit pa arritur ta fitonte përkrahjen e PDK - së, asokohe në opozitë. Rugova dhe LDK - ja lëshuan pe vetëm atëherë kur e panë se presidenca e Rugovës po rrezikohej nga mungesa e votave dhe kryeadministratori i atëhershëm i UNMIK - ut arriti ta sajtojë një koalicion artificial në të cilën në këmbim të Presidencës, PDK - ja merrte kryeministrin, e udhëhequr atëherë nga Bajram Rexhepi. Me atë rast, Rugova inauguroi traditën e ndjekur më vonë nga pasardhësi i tij në LDK, Fatmir Sejdiu, të mos heqjes dorë nga udhëheqja e partisë derisa mbante postin e presidentit (megjithëse Rugova pati dhënë dorëheqje nga lidërshtipi i LDK - së gjatë mandatit të tij të dytë si president). Në zgjedhjet e vitit 2004, Rugova ndërroi pazarin dhe bëri hapin e papritur, atë të lidhjes së koalicionit LDK - AAK. Pazarit që i lartë, dhe partia që asokohe ishte e para në vota bëri të pazakonshmen dhe ia lëshoi postin e kryeministrisë partnerit të saj minoritar. Duket se apetitet për poste të larta janë shumë të mëdha dhe sërish, një parti fare e vogël me elektorat, përfiton ndër postet më të rëndësishme institucionale në Republikën e Kosovës. Kësaj radhe fajtoreshë është ambicia e Hashim Thaçit për ta formuar me çdo kusht qeverinë dhe për të qenë vetë kryeministër. Por edhe opozita e re në Kuvend qëndroi anash dhe nuk ngriti as kundërshtinë më të vogël në kohën kur PDK - ja bënte pazare politike me pozitën e kreut të

shtetit. Sikur PDK - ja, opozita nuk e pa zgjedhjen e presidentit si proces të ndarë nga pakoja e marrëveshjeve të koalicionit qeverisës. Ndërsa PDK - ja, e rrezikuar nga mundësia që të mos jetë në gjendje të gjejë partnerë për koalicion, ishte tepër e motivuar që Presidencën ta mbajë brenda lojës së pazareve politike. Atë ia ofroi si karrotë AAK - së, e cila me sa duket ngriti epshet brenda një pjese të kësaj partie që të shkelet premtimi parazgjedhor dhe të konsiderohet shumë seriozisht oferta e PDK - së për koalicion. Strategjia e drejtë për postin e presidentit, sidomos pas dëmit që i është shkaktuar legjitimitetit të institucioneve pas skandalit të vjedhjes së votave gjatë zgjedhjeve, do të kishte qenë që PDK - ja të merrte nismën për një tryezë me të gjitha partitë parlamentare, përfshirë ato të opozitës, për gjetjen e një figure konsensuale që do të emërohej në postin e presidentit. Një figurë e tillë do të ishte një figurë jopartiake, e respektuar, popullore, e njohur për kontributin e saj apo të tij politik dhe profesional, dhe e cila do të kishte mbështetjen e shumicës dërrmuese të partive në Kuvend. Kjo figurë, pavarësisht emrit, do të kishte qenë sidomos e rëndësishme tani kur institucionet kanë nevojë për riparimin e besimit dhe ndërtimin e legjitimitetit pas një krize të vazhdueshme politike që filloi qysh në gjysmën e dytë të vitit të kaluar. Një president i fuqishëm, i respektuar në popull dhe politikisht i pavarur do të ishte një kundërpeshë e rëndësishme ndaj një Kuvendi të fraksionalizuar dhe një qeverie të dobët, sidomos në kohën kur Kosovës i duhen një sërë reformash të rëndësishme, duke filluar nga ato të sistemit zgjedhor deri te ato ekonomike. Për të mos thënë se negociatat me Serbinë do të jenë një barrë e rëndë që gjithashtu rrezikojnë qëndrueshmërinë e institucioneve në periudhën që vjen. Një figurë e qëndrueshme dhe e besuar presidenciale, me një mandat pesëvjeçar, do të ishte garanci për qëndrueshmërinë dhe koherencën e bashkësisë politike dhe për integritetin e institucioneve, me gjithë krizat potenciale politike që mund të paraqiten në periudhën që po vjen. Një gjë e tillë duket shumë më pak e mundur me figurën e Behgjet Pacollit si president. Problemi nuk është vetëm i Pacollit si president. Problemi nuk është tek aktivitetet kundërtënëse të z. Pacolli gjatë njëzet vjetëve të fundit, të problemeve të tij të kaluara me skandalet e korrupsionit dhe me ligjin, por edhe faktit se z. Pacolli imponon veten si president nga pozita e një kryetari të një partie të vogël, si pasojë e një koniunkturë të caktuar politike. Z. Pacolli mbase mund edhe të dëshmohej si figurë e denjë për Presidencën, por mënyra e katapultimit të tij në postin e presidentit do të jetë një hije që do ta ndjekë atë gjatë gjithëkohës së tij në mandat. Si president, z. Pacolli do të jetë, ndër të tjera, komandat suprem i Forcave të Sigurisë, do të emërojë prokurorët dhe gjykatësit e Republikës në një kohë kur gjyqësia ende përpiqet të ndërtojë pavarësinë e saj, dhe do të emërojë postin e lënë bosh të guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës. Si president, z. Pacolli do të ketë rol të veçantë në udhëheqjen e politikës së jashtme të vendit dhe do t'i duhej të dijë të veprojë si kreu i shtetit në suaza të një diplomacie të hapur dhe publike, larg nga forma e tij e preferuar e takimeve të fshehta të aranzhuara përmes kanaleve joformale. Si president, z. Pacolli do të ketë shans të dëshmohej nëse është figurë politike udhëheqëse dhe e gatshme të marrë vendime të vështira dhe të pavarura dhe për të vepruar në situata të vështira. Por pavarësisht kësaj, politika jonë konfirmoi edhe një herë traditën e mbrapshtë të politizimit dhe partitizmit të figurës së presidentit, diçka që ka dhe do të vazhdojë të ketë pasoja negative në zhvillimin e institucioneve të qëndrueshme politike të shtetit tonë të ri.

Diçka mbi librin Autobiografik të Behgjet Pacollit

## Takimi im me Behgjetin në shtëpinë e Ramush Haradinajt

Në fillim të mandatit si kryetar shteti, në një nga sheshet e spitalit "Zonja e Këshillit të Mirë", u organizua një koncert sensibilizimi e bamirësie, me praninë e këngëtares italiane me origjinë shqiptare, Ana Oksa (Hoxha - Oxa). Aty, së bashku me Anën, në një transmetim të drejtpërdrejtë, iu drejtuam opinionit publik italian dhe donatorëve të ndryshëm, për mbështetjen dhe përfundimin e projektit të spitalit, të nxitur edhe nga vetë Nënë Tereza. Por, dhe ky projekt, si mjaft të tjerë, u paralizua përkohësisht pas ngjarjeve të 14 shtatorit dhe luftës së Kosovës... Në fakt, në atë veprimtari unë kam qëndruar pranë Anës dhe nga ana tjetër e saj ishte vajza ime, Adea. Aty duhet të jem përshëndetur me Behgjet Pacollin. Por, prania e tij në atë ngjarje është e fiksuar plotësisht në librin e tij autobiografik... "Nga sfida në sfidë, jeta, Behgjet Pacolli". Sidoqoftë, pa qenë shumë i sigurt, diçka më është thënë për martesën e pritshme të saj me një biznesmen shqiptar tepër të suksesshëm të Kosovës, me banim në Zvicër. Madje, pak më vonë kam mësuar dhe realizimin e kësaj lidhjeje martesore (1999-2002), që pengesë jo të vogël kishte edhe kohën e angazhimit të secilit. Po ashtu, aty nga fundi i asaj periudhe, kam lexuar rastësisht dhe një intervistë të dhënë prej Behgjetit, ose në shtypin zviceran ose diku tjetër, për mosfunksionimin e martesës së tij me Anën. Ishte një intervistë me të vërtetë dinjitoze e qytetare, me thellësi të dukshme shpirtërore dhe përkujdesje të veçantë njerëzore. Madje, ajo, me linjën e saj tepër njerëzore, më bëri të ndryshojë mendjen për këtë person të veçantë të botës shqiptare. Ai në sytë e mi po shihej ndryshe, të paktën në finesën e tij etike dhe estetike... Por le të kthehem tek perceptimi i sajuar kundër B. Pacollit. Në fakt, edhe media e kishte bërë punën e saj. "Kremlingate" i skenuar i Del Pontes (Carla del Ponte), si kryeprokurore e Zvicrës e kishte lënë gjurmën e pakëndshme edhe midis nesh. Ndoshta, në radhë të parë, edhe shtypi italian, i ushqyer ose jo prej saj, me "Corriere della Sera" në krye. Madje, në fundverën e vitit 1999, sulmi mediatik arriti kulmin me përfshirjen e Behgjet Pacollit në një aferë, ku ishin përfshirë personalitetet të tilla të larta si presidenti rus Jelcin, zëvendës-presidenti amerikan Al Gore apo presidenti i Bankës Botërore Camdesy !... Del Ponte, me emërimin e saj si Kryeprokurore e gjykatës për krime lufte në ish-Jugosllavi (ICTY), ia kaloi dosjen e "Kremlingate"-it për finalizim zëvendësuesit të saj. Kjo edhe pse ajo dosje ishte e mbushur me kontradikta, sajesa apo "evidenca" progandistike- mediatike, pjesë të "hobit fantazist" të ish-prokurores, të shfaqur akoma më dukshëm në librin "Gjuetia-unë dhe kriminelët e luftës", të bllokuar në promovim nga vetë Ministria e Jashtme e Zvicrës. Për këtë, jo pa të drejtë, B. Pacolli shpreh në libër dhe dyshimet e tij: "Mund të kenë qenë të shumta motivet që e nxitën Del Ponten të bëhej promotore e kësaj afere, por gjithsesi do të mbetet të sqarohen në të ardhmen më mirë shumë rrethana, përfshirë edhe ato që në ndonjë pikë të largët mund të lidhen me Kosovën dhe çështjen e saj, me Serbinë dhe luftën e saj në Kosovë, me Rusinë dhe me oligarkët e saj, me Italinë dhe me interesat e saj ekonomike". Edhe, unë, si shumë shqiptarë të tjerë që kanë pasur kontakte zyrtare me Del Ponten, kam shfaqur pakënaqësitë e mia për të, të pasqyruara në shtypin shqiptar apo në panele ndërkombëtare. Sidoqoftë, ndryshe prej saj, pas 3 vjet hetimesh intensive, Bertosa (Bernard Bertossa), Prokurori i Përgjithshëm i Konfederatës Zvicerane, që zëvendësoi Del Ponten, më 6 mars 2002, e mbylli zyrtarisht procesin, në favor të plotë të Behgjet Pacollit, presidentit të Mabetex Grup, kompani konstruksioni dhe inxhinierie civile, me qendër në Lugano-Zvicër. Në përgjithësi, nisur nga kjo ngjarje apo raste të ngjashme, krahas argumenteve të karakterit politik dhe gjeostrategjik të vetë B. Pacollit, nuk mund të harrohet se, në fund të fundit, edhe suksesi në



këtë botë ka "pagesën e vet", ai sjell shpërthimin e xhelozisë dhe të smirës, fut në funksion ekstrem armën e shpifjes, ndyrësisë e pseudoakuzës. Në këtë kuptim, sukcesi ka qenë dhe mbetet për fat të keq një bashkëqytetar i lakmisë dhe zilisë së të paaftit, të pazotit, të përtacit. Kush e arrin këtë sukses ndjehet jo rrallë i zhgënjyer nga kjo dobësi e ulet njerëzore, por, ama, ai që i reziston asaj me anë të punës, gatishmërisë, përfshirjes e humanizmit apo kapërcimit të pakënaqësive të vogla, kalon në një stad akoma më të lartë personaliteti, force shpirtërore e energjie njerëzore! Para disa vjetësh, gjatë një vizite të shkurtër në Kosovë, e kam takuar për herë të parë B. Pacollin (me rezervën e vitit 1998 !) në shtëpinë e Ramush Haradinajt. E kishim lënë të pinim një kafe me Ramushin dhe pastaj të shkonim së bashku në Akademinë përkujtimore kushtuar Luanit, vëllait të tij të vrarë nga serbët, në maj të vitit 1997, jo larg kufirit me Shqipërinë. Në atë kohë, Ramushi ishte ende në arrest shtëpie, por që nga marsi 2006 Dhoma e Apelit e ICTY i kishte dhënë atij të drejtën e pjesëmarrjes në veprimtari politike publike, me autorizimin konkret të UNMIK-ut (d.m.th. dhe "skorten policore" të tij). Sidoqoftë, në momentin që hyra në shtëpinë e tij, Ramushi, me zgjuarsinë e tij natyrore, ndjeu ndonjë stepje apo hezitim timin dhe ma prezantoi menjëherë bashkëbiseduesin. "Është Behgjet Pacolli, një mik i imi. Besoj se bëra mirë që i shpreha kërkesën dhe dëshirën për të qëndruar dhe biseduar së bashku"- tha ai me dinamizmin dhe thjeshtësinë e tij "rebele". Në fakt, kishte bërë shumë mirë! Aty bisedova gjatë me Behgjetin, bile aq sa duhej për të ndërtuar një lexim të drejtpërdrejtë, krejt tjetër, por dhe shumë më të ndryshëm nga ai i krijuar nga thashethemnat politike e mediatike. Sidomos duke pasur parasysh dhe momentin e vendimmarrjes së tij për të hyrë më konkretisht e gjerësisht në politikën kosovare fillimisht si lëvizje dhe pak më vonë si president i një partie kosovare të quajtur Aleanca Kosova e Re (AKR). Të njëjtin shikim pozitiv e bashkëkohore, të njëjtin konceptim pozitiv, etikë qytetare dhe estetike intelektuale i kam ndeshur tek ai dhe në emisionin "Déjà - vu" të Mustafa Nanos në Top Channel ... Sidoqoftë, duke qenë jo aq i lidhur sa më parë me politikën kosovare të ditës, e kuptova nga libri se marrëdhëniet me Behgjetin me Ramushin nuk ishin më si më parë. Unë vetë do të dëshiroja dhe uroja të kundërtën. Kjo, aq më tepër, se B. Pacolli për detyrat kryesore të politikës kosovare mendon pak a shumë si unë, në mënyrë më konkrete, më të fokusuar për çështjen fundamentale të anëtarësimit të Republikës së Kosovës në OKB! Të paktën këtë dëshmon ky libër. Nuk ka shumë ditë, në kthim nga Parisi, në sallën VIP të aeroportit të Tiranës "Nënë Tereza", takova papritur dhe B. Pacollin. Ky ishte një takim tjetër i yni. Por, ajo që më bëri më shumë përshtypje ishte fakti që ai aty po i bënte shoqëri ministrit të Jashtëm të Maldiveve, z. Ahmed Shaheed. Më erdhi shumë mirë për këtë sjellje miqësore e "detyrë" diplomatike të Behgjetit aq më tepër që aty nuk m'u duk se kishte ndonjë përfaqësues të protokollit tonë të shtetit, ndoshta dhe nuk i njihja, sepse edhe kanë ndryshuar, për arsye moshe, karriere apo "politike-partiake". Kjo sidomos, duke pasur parasysh kontributin e këtij ministri në njohjen e Republikës së Kosovës, që më 19 shkurt 2009. Madje, këto dy vende me shtysën e tij firmosën me shpejtësi marrëdhëniet diplomatike më 16 prill 2009. Dhe pjesë kryesore e këtij e procesi sa të shpejtë, po aq të domosdoshme ishte edhe vete Pacolli, si patriot, politikan e biznesmen. B. Pacolli nuk e ka shfrytëzuar dhe nuk e shfrytëzon politikën si "kalë beteje". Ai është lojal me idetë dhe vizionin e tij, pa e fyer apo diskretitur kundërshtarin, duke kritikuar në mënyrë qytetare, por dhe duke pranuar ose vlerësuar atë që, sipas tij, duhet pranuar ose vlerësuar. Kështu, ai, mbështetur në vokacionin properëndimor të shqiptarëve, jo vetëm çmon kontributin e politikës dhe të UÇK- së në këtë aspekt, por dhe kritikon në mënyrë paralele gabimet e bëra ... Problemi i vetëm mbetet përfshirja e tij dhe e partisë së tij në qeverisje. Atëherë mund të vërtetohet, ashtu si më parë në veprimtarinë ekonomike private, edhe sukcesi i tij, por tani në një veprimtari publike. Bile, shumë shpesh, flitet se angazhimi në këtë veprimtari të fundit, praktika konkrete qeverisëse të jep dhe notën reale. Dhe Pacolli me përvojën e tij të jashtëzakonshme duhet të bëhet pjesë e saj, për të shpalosur dhe ndikuar me pragmatizmin e tij. Por, ama, duke hedhur poshtë dictum-in e zakonshëm elektoral: "Fushatën e bëjmë në poezi, qeverisjen e bëjmë në

prozë" (we campaign in poetry, and we govern in prose) që diku i atribuohet dhe Mario Cuomo-s .....

Unë, pas leximit të librit dhe analizës së tij, pavarësisht aty-këtu pozicionimeve personale për ndonjë çështje të veçantë, ndoshta dhe për ndonjë shfaqje pragmatizmi të "induktuar", ai pasqyron, në bindjen time, një shembull, një mision, një mundësi, një realitet. Madje, në thelb, dërgimi i këtij mesazhi të librit tek lexuesi e bën shumë më të drejtpërdrejtë detyrën e tij, si në rrafshin intelektual individual-qytetar, ashtu dhe atë shoqëror-politik. Ai jo vetëm mund të nxisë suksesin dhe të frymëzojë karrierën, sakrificën e përpjekjen në gjeneratën e re, dëshirën për shkollim e punë, por dhe mundëson nëpërmjet jetës e veprës, përpjekjeve e angazhimit të vetë autorit, prekjen dhe përjetimin realist të botës individuale e shoqërore për rreth, ashtu siç është, me të mirat dhe të këqijat saj, me hallet e gëzimet, me dobësitë e fuqitë, me gabimet e përkujdesjet, me rastësitë e domosdoshmëritë, me hapësirat e pafundme e kufijtë e saj. Për më tepër, po e përsëris, shembulli i B. Pacollit, i cili pasqyron në këtë libër autobiografik e mëshiron më së miri një gjë të tillë.

**P.S. Autori është ish-Presidenti i Shqipërisë 1997- 2002**

---

## **Thaçi i bëri numrat?**

---

**PDK-ja ka nënshkruar marrëveshje për koalicion qeverisës me AKR-në dhe minoritetet. Emrat e ministrave të PDK-së vazhdojnë të jenë enigmë**

### **Thaçi premton qeveri efektive**

Mandatarin për formimin e qeverisë së re të Kosovës, Hashim Thaçi, ka nënshkruar të shtunën marrëveshjet e koalicionit me tri grupime politike në Kuvendin e Kosovës. Marrëveshja e parë është nënshkruar mes kreut të PDK - së dhe atij të AKR - së, Behgjet Pacolli. Sipas kësaj marrëveshjeje, AKR - ja në koalicionin e ardhshëm qeverisës do të ketë postin e presidentit, do të udhëheqë tri ministri, si dhe do të ketë një zëvendëskryeministër dhe tre zëvendësministra. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, Thaçi dhe Pacolli janë zotuar se do të punojnë si një ekip duke shprehur besim se do të ndërtojnë një qeveri me program të përbashkët, i cili, sipas tyre, do të përmirësojë të gjitha aspektet e zhvillimeve në Kosovë. Lideri i PDK - së ka thënë se koalicioni i ri do të punojë për zhvillimin e Kosovës, ngritjen e mirëqenies sociale, ndërtimin e shoqërisë shumëetnike, krijimin e vendeve të reja të punës, integrimin e vendit në strukturat euro atlantike, liberalizimin e vizave. Ai ka thënë se koalicioni i ri do të ketë një program unik duke premtuar realizimin e plotë të tij. Thaçi, po ashtu ka shprehur bindjen se formula e re e qeverisë do të jetë shumë e qëndrueshme dhe se ky koalicion do të ketë legjitimitet dhe legalitet të plotë, por edhe bekimin e faktorëve ndërkombëtarë. Sipas tij, votimi në Kuvend i Qeverisë dhe presidentit të ri do të zhvillohet të hënën, dhe në përputhje të plotë me Kushtetutën. Kurse lideri i AKR - së, Behgjet Pacolli, i cili do të jetë kandidat i koalicionit për president të Kosovës, është zotuar se qeveria e re e ka forcën, energjinë, diturinë dhe vullnetin për të punuar në shërbim të qytetarëve. "Jemi betuar që të punojmë vetëm për interesat e qytetarit të Kosovës, për interesat e ndërtimit të një shteti dinjitoz dhe të një shteti për të gjithë qytetarët", ka thënë Pacolli.

### **Rekord minoritarësh në qeveri**

Kreu i PDK - së, Hashim Thaçi, të shtunën ka nënshkruar marrëveshje koalicioni edhe me Partinë Liberale Serbe (SLS), dhe Grupin Parlamentar 6+, i cili përbëhet nga deputetë të komunitetit turk, romë dhe atij boshnjak në Kuvendin e Kosovës. Pas nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve, Thaçi ka thënë se Qeveria e re e Kosovës do të jetë qeveria më efektive e Kosovës deri më tani, përkundër numrit më të kufizuar të deputetëve që do të ketë në Kuvend. Ai ka premtuar se qeveria e re do të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve. Kurse rreth bisedimeve të ardhshme Prishtinë - Beograd, Thaçi ka thënë se ky dialog do të zhvillohet në përputhje me agjendën e integritetit të të dyja vendeve në strukturat euroatlantike. Edhe lideri i SLS - së, Slobodan Petroviq, dhe ai i KTD - së, Mahir Jagcillar, janë zotuar se në kuadër të qeverisë së re do të angazhohen maksimalisht për avancimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe përmirësimin e kushteve të jetës të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Qeveria e re e Kosovës, përveç të tjerave, ka shënuar edhe ndarjen më të madhe të pushtetit për partitë minoritare që nga paslufta.

## **PDK - ja ende pa emra të ministrave**

Përkundër nënshkrimit të marrëveshjeve të koalicionit për ndarjen e ministrave mes katër subjekteve në Kuvendin e Kosovës, jo të gjitha partitë kanë caktuar emrat e ministrave të rinj. Tashmë me saktësi dihen vetëm emrat e tre ministrave të AKR - së, të cilët janë: Mimoza Kusari - Lila ministre a MTI - se, Ferid Agani, ministër i Shëndetësisë, dhe Agim Çeku, ministër i FSK - së. Edhe nga Grupi 6+, ministër i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor do të vazhdojë të jetë Mahir Jagcillar. Kurse, emrat e ministrave serbë të SLS - së nuk dihen ende, kurse zëvendëskryeministër do të jetë lideri i saj, Sllobodan Petroviq. Ndërsa partia më e madhe në qeverinë e re vazhdon të mos i publikojë emrat definitivë të ministrave të saj. Disa zyrtarë të PDK - së të kontaktuar gjatë ditës së shtunë kanë deklaruar se për këtë çështje do të vendoset në takimet që do të zhvilloheshin të shtunën në mbrëmje apo edhe të dielën. Gjithsesi, tashmë dihet se qeveria e re do të jetë edhe më e fryrë për nga përbërja pasi që përveç dy zëvendëskryeminstre më tepër, pritet të ketë edhe ndonjë resor më shumë gjatë mandatit. Marrëveshja mes PDK - së dhe Listës "Ibrahim Rugova" pritet të zyrtarizohet të dielën, ndërsa që ende nuk dihet se çfarë postesh mund të kenë zyrtarët e saj në qeverinë e re. Emrat e mundshëm për ministria të PDK - së sipas burimeve të "Zërit" janë: Hajredin Kuçi, Enver Hoxhaj, Bajram Rexhepi, Bedri Hamza, Bekim Çollaku, Vlora Çitaku, Justina Pula - Shiroka, Ramë Buja, Memli Krasniqi dhe Blerand Stavileci.

## **Opozita: Koalicioni interesave të Thaçit e Pacollit**

Partitë opozitare kanë filluar sulmet ndaj koalicionit të ardhshëm qeverisës ende pa u votuar në Kuvendin e Kosovës. Arben Gashi nga LDK - ja ka thënë se nga e hëna Kosova do të ketë institucione të cilat nuk do të jenë përfaqësuese të vullnetit të qytetarëve. Avni Arifi nga AAK - ja e ka cilësuar koalicion të zorit dhe të interesave të Thaçit e Pacollit, koalicionin mes PDK - së dhe AKR - së. "Përkundër respektit për njerëzit që mund të jenë pjesë e qeverisë, problemi i këtij koalicioni qëndron te koncepti i gabuar qeverisës", ka thënë Arifi. Visar Imeri, nga Lëvizja "Vetëvendosje" ka thënë se ky koalicion do të jetë koalicion i fillimit të vazhdimit të negociatave të reja me Serbinë.

## **Ndarja e Ministrive**

AKR - ja do të ketë tri ministri: Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, të FSK - së dhe të Shëndetësisë, postin e zëvendëskryeministrit dhe tri poste zëvendësministrash. Partia Liberale Serbe (SLS) do të drejtojë tri ministri: Ministrinë e Kthimit dhe Komuniteteve, të Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe të Punës dhe Mirëqenies Sociale, postin e zëvendëskryeministrit dhe tre zëvendësministra. Grupi Parlamentar 6+ do të drejtojë Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor dhe gjashtë poste zëvendësministrash. Kurse PDK - ja në qeverinë e re do të udhëheqë me dhjetë ose 11 ministritë e tjera, varësisht nga fakti se a do t'i jepet ndonjë post ministror listës Ibrahim Rugova apo jo.

---

## **Thaçi e ndan Qeverinë me Pacollin dhe minoritetet**

---

**PDK - ja ka mbajtur 10 ministri, por ende nuk është përcaktuar se sa zëvendësministra do t'i ketë. Koalicioni për Kosovën e Re është siguruar se do ta ketë presidentin, një zv. kryeministër, tre ministra dhe tre zv. ministra. Pjesëmarrje të njëjtë në Qeveri ka fituar edhe SLS - ja. Kurse Grupi 6+ dhe Lista Rugova kanë mbetur me nga një ministri**

PRISHTINË, 19 SHKURT - Mandatari për krijimin e Qeverisë së re, Hashim Thaçi, të shtunën i ka zyrtarizuar marrëveshjet për koalicion me shumicën e partnerëve qeverisës, me përjashtim të Ukë Rugovës, me të cilin pritet ta bëjë të njëjtën gjë të dielën (sot). Ai është dakorduar me partnerët, që më shumë se gjysmën e ministrive ti mbajë për PDK - në, kurse tetë ministrinë e tjera t'ua ndajë atyre, ndonëse jo mbi bazën e fuqisë parlamentare. Derisa PDK ja, e cila do të përfaqësohet në Kuvend me 34 deputetë, ka marrë nën drejtim 10 ministri, Koalicioni për Kosovën e Re dhe SLS ja kanë fituar nga tri sosh. Një ministri e ka marrë koalicioni i partive të komuniteteve pakicë joserbe dhe një ministri tjetër pret ta marrë lista "Ibrahim Rugova". Koalicioni për Kosovën e Re ka marrë përgjegjësi institucionale që gjatë mandatit të ardhshëm katërvjeçar t'i udhëheqë Presidencën, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Forcës së Sigurisë dhe Ministrinë Tregtisë. Kandidat për president do të jetë Behgjet Pacolli, ndërsa Ferid Agani, Agim Çeku dhe Mimoza Kusari- Lila do të jenë në krye të MSH - së, MFSK - së dhe MTI - së. KKR - ja do ta ketë në Qeveri edhe Muhamet Mustafën, por atë në cilësinë e zëvendëskryeministrit. Pos tyre, KKR - ja do t'i ketë edhe tre zëvendësministra. Fuqi të njëjtë në pushtetin ekzekutiv do të ketë edhe SLS - ja. Kjo parti e komunitetit serb do ta ketë një zëvendëskryeministër dhe tre ministra, që do t'i drejtojnë: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë e Kthimit dhe Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale. Krahas kësaj, SLS - ja do t'i ketë edhe tre zv. ministra. Në postin e zv. Kryeministrit pritet të vijë ish - anëtari i Kryesisë së Kuvendit, Slobodan Petroviq. Ministrinë e Kthimit dhe atë të Punës, sipas burimeve të gazetës, ka gjasa që t'i drejtojnë prapë Nenad Rashiq dhe Sasha Rashiq. Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, e cila i ka mbetur Grupit 6+, pritet ta udhëheqë i njëjti ministër, Mahir Yakčilar. Për dallim nga KKR - ja dhe SLS - ja, ky koalicion partish ka fituar më shumë poste të zëvendësministrave gjithsej gjashtë, çka do të marrë Lista Rugova ende nuk është definuar. Një ditë më herët përfaqësues të kësaj liste kanë deklaruar se janë duke pritur që të marrin Ministrinë e Planifikimit Hapësinor dhe në krye të saj ta vënë Dardan Gashin. Të njëjtët kanë thënë se do të insistojnë që edhe Bujar Bukoshin ta sistemojnë në pozitën e zv. kryeministrit.

### **Shpresat e Pacollit**

Marrëveshja e parë për koalicion qeverisës është nënshkruar mes Thaçit dhe Pacollit Lideri i PDK - së është shprehur optimist se qeveria e re, edhe pse nuk ka shumë numra në Kuvend, do të jetë më efikas se qeveritë e mëparshme. Ky koalicion është një koalicion për Kosovën e re, për zhvillimin e Kosovës, për reformat demokratike, për ndërtimin e shoqërisë shumëetnike, për krijimin e vendeve të reja të punës, për Kosovën evropiane, për Kosovën në paqe, stabilitet, bashkëpunim rajonal dhe perspektivë evropiane, për Kosovën që do të ndodhë liberalizimi i vizave, e gjithashtu për Kosovën për t'u anëtarësuar në NATO dhe në BE, dhe për rritjen e

mirëqenies sociale të qytetarëve”, ka deklaruar Thaçi. Bashkë me Pacollin president, ai ka thënë se do të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve. Thaçi ka paralajmëruar se Qeveria e re do të ketë një program të avancuar ekonomik, të cilin është duke e përgatitur një ekip i përbashkët i partnerëve të koalicionit. Ai është zotuar se prioritet të parë do ta ketë procedimin e Ligjit për buxhet në Kuvendin e Kosovës, për ç’gjë u ka bërë apel edhe partive të tjera parlamentare që t’i japin mbështetje. Lideri i PDK - së nuk ka pranuar që brenda partisë së tij ka deputetë që mund të mos e votojnë Pacollin për president, duke thënë se çdo qëndrim që është marrë në PDK për ndërtimin e koalicionit qeverisës dhe për votimin e presidentit ka qenë konsensual. Mirëpo, zyrtarë të lartë të kësaj partie kanë rikonfirmuar qëndrimin e tyre se nuk do të votojnë që Pacolli të bëhet president. Ata kanë bërë të ditur se Thaçi personalisht është duke lobuar që t’i sigurojë mbështetje Pacollit. Në aksion, sipas burimeve të gazetës, është vënë edhe vetë Pacolli. "Pacolli ka takuar edhe deputetë të LDK - së, për ta marrë përkrahjen e tyre", ka thënë një zyrtar i lartë. Personalisht Pacolli është shprehur i bindur se do t’i marrë votat e mjaftueshme për t’u bërë president. "Unë besoj se përfaqësuesit e popullit të Kosovës do të votojnë për zgjedhjen time si president të Kosovës dhe unë prej momentit që ia filloj punës do të filloj implementimin e të gjitha obligimeve që parashihen me Kushtetutë", ka thënë Pacolli.

### **Qeveri "me njerëz kredibilë"**

Presidenti i AKR - së ka deklaruar se Kosova nuk mund ta durojë luksin që të stagnojë çdo gjë. **"Ne këtu kemi forcën, energjinë, kemi diturinë dhe vullnetin shumë të madh për të vepruar, prandaj që nga tani, së bashku me PDK - në, bashkë me ekspertët e Koalicionit për një Kosovë të Re, bashkë me anëtarët e tjerë të koalicionit, jemi betuar që të punojmë vetëm për interesat e qytetarit të Kosovës, për interesat e ndërtimit të një shteti dinjitoz dhe të një shteti për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe shtetit të Kosovës"**, ka thënë ai. Pacolli është zotuar se do t’i tejkalojë interesat personale, partiake dhe grupore, dhe do të vihet në shërbim të interesave të qytetarëve dhe në shërbim të bërjes së Kosovës shtet i civilizuar. **"Do ta integrojmë Kosovën në rajon, do ta integrojmë Kosovën në Evropë, sepse qytetarët e Kosovës e meritojnë atë"**, është shprehur Pacolli. Të njëjtën bindje e ka reflektuar edhe Thaçi. Ai ka shfaqur besimin se formula e re qeverisëse do të jetë më efikasja në tërë historinë politike të Kosovës. "Ka pasur koalicione më herët me numra më tepër, mirëpo nuk ka pasur efektivitet në punë. Nga numrat në Kuvend nuk varen efektiviteti dhe suksesi i institucioneve, por nga agjenda dhe programi, dhe kjo qeveri është qeveri e vazhdimësisë programore, zhvillimore dhe integruese.

## **Deklaratat e Pacollit**

### **Pacolli: "Srbija [je] još majka Kosova, nažalost, zla majka"**

Behgjet Pacolli, njeriu që pritet të zgjidhet kryetar i Kosovës, ishte përballur këtë javë me disa nga deklaratat e tij të dhëna në medime të ndryshme botërore, por tani që është vënë nën presion mediatik ka mohuar thëniet e tij dhe është hedhur të sulmojë medimet kosovare, të cilat i kanë transmetuar deklaratat e tij të dhëna në medime të ndryshme, të jashtme. Në një intervistë që kandidati për kryetar të Kosovës, Behgjet Pacolli ka dhënë për një gazetë kroate, disa ditë pas shpalljes së pavarësisë ka thënë se ëndrra e tij është që t'i pajtojë serbët dhe kosovaret", ndërsa Serbinë e ka cilësuar si "nënë të Kosovës, por të keqe". Në intervistën që i kishte dhënë gazetës "Vecernji list", më 24 shkurti 2008, e cila ishte realizuar në rezidencën e tij në Lugano të Zvicrës lideri i AKR - së kishte folur edhe për takimet që ai i kishte realizuar në vitin 1999 me Slobodan Milosheviqin, hetimet që i kishte nisur kundër tij ish - prokurorja, Carla del Ponte, si edhe për jetën e tij private. Gazeta kishte shkruar që "Pacolli nuk ka shumë fjalë të këqija për serbët, përkundër të gjitha krimeve që ia kanë bërë popullit të tij dhe se për të "Srbija [je] još majka Kosova, nažalost, zla majka" (Serbia ende është nënë e Kosovës, për fat të keq, nënë e keqe)". Në "Nedeljni telegraf" me 2006 Pacolli citohet të ketë thënë se fati i rajonit është në duart e Beogradit", se "Kosova s'mundet pa Serbinë". ("Kosovo ne može bez Srbije"), se "është koha që ai (presidenti Ibrahim Rugova, vj) të tërhiqet", se përgjegjës për gjakderdhjen në Ballkan dhe luftërat në Ballkan është Richard Holbrooke. Menjëherë pas botimit Pacolli është ngutur t'i përgënjeshtrojë të gjitha këto, por vetëm në një gazetë të Prishtinës, jo në "Nedeljni Telegraf". Në fund të dhjetorit 2010 Pacolli i dha një intervistë gazetës serbe "Politika". Ende pa filluar negociatat, siç po thuhet, "teknike" ai paralajmëron kapitullimin preventiv të Kosovës, kur thotë: "Veriu (i Kosovës, v.j) do të kishte autonomi ekonomike". Pak para zgjedhjeve të vitit 2007 Pacolli i dha një intervistë "Zërit të Amerikës" ku akuzoi bashkësinë ndërkombëtare pse i kishte zhvilluar negociatat për Kosovën në "Vjenë e Londër". Këto negociata, sipas tij, është dashur të zhvillohen në Beograd, Kragujevë, në Prishtinë, Prizren. Ai kishte kërkuar që bisedimet të bëhen pa përkthyes, sepse "secili prej nesh e njih gjuhën, mentalitetin (serb, vj)". Para disa muajsh Pacolli i dha intervistë revistës kroate "Globus". Citohej të ketë thënë se dëshiron të jetë Tito i Kosovës. Sikur në rastin e "Nedeljni Telegrafit" edhe kësaj radhe ai u ngut ta demantojë këtë, por jo në "Globus"; e dërgoi një reagim të "Koha Ditore". Në një shkrim të botuar në nëntor 2007 në gazetën gjermane "Frankfurter Allgemeine Zeitung" Pacolli e kishte lënë gojëhapur gazetarin kur i kishte thënë se në vitet 70 - të kishte punuar shumë afër Titos. Në pyetjen se a e kishte parë ndonjëherë personalisht liderin jugosllav, Pacolli ishte përgjigjur: " Po, madje edhe cullak". Dhe vazhdon: "Unë kam qenë adjutant i tij. I kam ndihmuar në gardërobë dhe ia kam bartur valixhet". Sipas "Frankfurter Allgemeine Zeitung" Pacolli nuk është orator i mirë, se për herë të parë në historinë e Kosovës e ka thyer një tabu, duke bërë aleancë me dijetarë myslimanë. Pacolli nuk e ka demantuar gazetën "Nedeljni Telegraf", as gazetën "Politika", as revisten "Globus" të Zagrebit, as "Frankfurter Allgemeine Zeitung".

---

## **Përmbyllen marrëveshjet e koalicionit**

---

**Partia Demokratike e Kosovës, ka përmbyllur marrëveshjet për ndarjen e resorëve qeveritare, duke nënshkruar marrëveshje koalicioni edhe me Listën Ibrahim Rugova, pasi një ditë më parë marrëveshje të tillë kishte nënshkruar edhe me AKR-në dhe minoritetet**

Partia Demokratike e Kosovës, të dielën ka nënshkruar marrëveshjen e koalicionit edhe me Listën Ibrahim Rugova, pasi një ditë më parë kishte nënshkruar marrëveshje të tilla me AKR-në dhe minoritetet. Lista Ibrahim Rugova, në qeveri do të ketë postin e zëvendëskryeministrit, një ministri, dhe dy zëvendësministra. Memli Krasniqi, anëtar i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës, pas mbledhjes së Kryesisë së PDK-së, ka konfirmuar se është zyrtarizuar edhe marrëveshja për bashkëqeverisjen e ardhshme edhe me Listën Rugova, ndërkaq ai ka thënë se gjatë ditës së nesërme do të bëhen të ditura edhe emrat e ministrave përkatës, si të atyre të PDK-së ashtu edhe të atyre të koalicionit. "Sa u përket emrave të ministrave, besoj që kjo është një çështje e cila nesër do të publikohet, është në kompetencat e mandatarit, të kryeministrit Thaçi, por gjithsesi që kjo çështje tashmë është përmbyllur në forumet e PDK-së. Tashmë të gjitha marrëveshjet janë përfunduar, mund të ju them se me koalicionin i cili është shumë stabil, shumë i qëndrueshëm me numra më se të mjaftueshëm tashmë e kemi bërë edhe nënshkrimin e marrëveshjes, gjërat kanë përfunduar, pa dyshim gjërat mbeten për t'u definuar, por në kuptimin e përgjithshëm gjithçka është sipas marrëveshjeve të cilat i keni parë edhe vet dhe që pa dyshim që nesër do t'i keni në detaje të gjithë emrat edhe të ministrave edhe të emrave që do të na përfaqësojnë në Kuvend", ka thënë Krasniqi.

### **PDK: Jemi treguar duarlibër edhe me LDK - në**

I pyetur nga gazetarët nëse PDK-ja është treguar më duarlibër me Listën Rugova, duke marrë parasysh që ajo ka vetëm një deputet në Kuvendin e Kosovës, Krasniqi ka kujtuar kohën kur kanë qenë në bashkëqeverisje me LDK-në, e që sipas tij, PDK-ja edhe në atë kohë është treguar tejet duarlibër me ta. "Në radhë të parë ju tash që të gjitha detajet për pozicionet do t'i mësoni të plota nesër, në momentin kur votohet ekzekutivi i ri, ndërsa sa i përket dorëlibrësisë, ne kemi qenë dorëlibër edhe me LDK-në herën e kaluar, është në natyrën e PDK-së që të jetë zemërgjerë, ofruese, integruese dhe që të ndajë përgjegjësinë bashkë me ata që iu janë bashkuar vizionit tonë", ka thënë Krasniqi.

### **Bukoshi, zëvendës i Thaçit**

Sipas marrëveshjes së nënshkruar për bashkëqeverisjen katërvjeçare në mes PDK-së e Listës Rugova, kësaj të fundit është paraparë që t'i takojë një ministri e cila sipas edhe konfirmimit të zyrtarëve të Listës Rugova do të jetë Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, në krye të së cilës do të jetë Dardan Gashi, një zëvendëskryeministër që do ta ushtrojë Bujar Bukoshi si dhe dy zëvendësministra, Fadil Kryeziu, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Dardan Stublla, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ndërkaq Ukë Rugova nga kjo Listë do të mbetet deputet në Kuvendin e Kosovës. Në bazë të marrëveshjes midis PDK-së dhe AKR-së, ndarjes së posteve, kjo e fundit do të ketë postin e presidentit që do ta ushtrojë Behgjet Pacolli, një zëvendëskryeministër Mimoza Kusari, 3 ministri ajo e Tregtisë që do ta drejtojë Muhamet



Mustafa, Ministria e Shëndetësisë në krye me Ferid Aganin, Ministria e Forcës së Sigurisë do t'i takojë Agim Çekut, ndërkaq AKR-së gjithashtu do t'i takojnë edhe pesë zëvendësministra. SLS do të ketë një zëvendëskryeministër, tre ministri dhe tre zëvendësministra. Megjithatë, ndonëse me nënshkrimin e marrëveshjes së koalicionit që u bë dje nga PDK-ja me 6+, Ministria e Ambientit iu ishte dhënë kësaj të fundit, por tash pas kësaj të fundit sipas të gjitha gjasave do t'i takojë Ministria e Administratës Publike, e cila do të udhëhiqet nga Mahir Yagcillar. Në anën tjetër, anëtari i Kryesisë së PDK-së, Memli Krasniqi beson që nesër në Kuvendin e Kosovës me vullnetin edhe të deputetëve të votohet edhe për të parin e vendit, pasi siç tha ai Kosova ka kohë të gjatë që është pa institucione dhe për këtë qëllim duhet që të mos vonohet edhe më shumë krijimi i tyre. "Ne kemi thënë që është qëllimi ynë që sa më shpejt që të jetë e mundur të konstituohen të gjitha institucionet, ne do të respektojmë pa dyshim ligjet, procedurat ato që parashihen duke filluar nga Kushtetuta deri të rregullorja e Kuvendit të Kosovës, në mënyrë që të gjejmë hapësirën legale për të proceduar dhe besoj që hapësirat ekzistojnë, por do të mbetet që Kuvendi dhe deputetët të marrin vendimin e duhur", ka thënë Krasniqi.

---

## Populli zgjodhi Pacollin, jo Surroin

---

Veton Surroi nuk arriti ta mund dot Behgjet Pacollin as kur ishte vet aktiv në politikë, ndërkohë që shfrytëzonte edhe mediet e tij kundër Pacollit. Në mes të dy politikanëve, z. Behgjet Pacolli, Kryetar i Aleancës Kosova e Re dhe z. Veton Surroi, Kryetar i ORA-s, në zgjedhjet e vitit 2007, votuesit vendosën për z. Pacolli, duke e flakur jashtë politikës përfundimisht z. Surroi. Ky ishte vullneti i qytetarëve që nuk gabojnë asnjëherë, z. Surroi, këtë s'do ia fal kurrë z. Pacolli. Veton Surroi e sheh Presidentin e AKR-së Behgjet Pacollin dhe Aleancën Kosova e Re, si arsye kryesore pse ai sot gjendet askund, larg nga politika dhe politikbërja. Ëndrrat e Veton Surroit për t'u bërë politikani më "qytetarë" i Kosovës ishin vënë thellësisht në rrezik me hyrjen në politikë të Behgjet Pacollit. Sigurisht z. Pacolli as që e kishte menduar që do t'i bënte këtë dëm ORA-s. Ai kishte hyrë në politikë për të fituar zgjedhjet dhe për ta zhvilluar ekonomikisht Kosovën. Të paktën kështu thoshte ai gjatë gjithë kohës. Iu kujtohet viti 2007 ishin zgjedhje të ashpra, kompania "Koha" shpikte çdo ditë diçka të re kundër z. Pacolli dhe në mbremje Kryetari i ORA-s, z. Surroi jepte një prononcim për Televizionin e tij KTV dhe i vërtetonte shpifjet. Ky skenar përsëritej shpesh gjatë fushatës zgjedhore. Veton Surroi është i zgjuar, e ndjente se në mes atij dhe z. Behgjet Pacolli kishte shanse serioze që populli të vendoste për AKR-në e z. Pacolli dhe jo për Lëvizjen Qytetare ORA të z. Surroi. Surroi këtë nuk ia fal kurrë Pacollit. Sulmet kundër Liderit të AKR-së gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2007 vinin vetëm nga Mediat e Veton Surroit. Ato kishin urdhër të bënin gjithçka për ta dobësuar politikisht Behgjet Pacollin. Jam i bindur se kjo për Aleancën Kosova e Re si parti që garonte për herë të parë në zgjedhje ishte e vështirë. Z. Surroi kishte mekanizmin më të fuqishëm opinion krijues, kishte TV në dhe Gazetën. Ndërkohë që AKR-ja dukej e papërgatitur t'i përballonte sulmet e pandershme që vinin pandërprerë. Presidenti i AKR-së, kishte gjetur madhështinë e reagimit. Ai i lavdëronte kundërshtarët e tij derisa ata e fyenin. Kështu bëri edhe me z. Surroi. Qytetarët e Kosovës e vlerësuan këtë qëndrim konstruktiv të z. Pacolli dhe votuan ashtu siç votuan. Kosova ka përjetuar momente interesante në politikë gjatë dekadës së fundit. Aventuristë politikë i janë qasur votuesve kosovarë në forma të ndryshme. Populli asnjëherë nuk ka gabuar. Janë themeluar parti shpejt e shpejt, po edhe më shpejt e shpejt janë mbyllur. Ndër qasjet interesante ka qenë qasja "qytetare" e ORA-s e tretur tashmë në LDK. Pasi provuan një herë me qasje qytetare suedeze dhe nuk arritën suksese, kjo lëvizje ndryshoi strategji duke ua mësyre fshatrave, derisa përgatitej për zgjedhjet e vitit 2007. Atë botë ishte krijuar edhe një subjekt i ri politikë, Aleanca Kosova e Re, në krye me z. Behgjet Pacolli. Qytetarët tanë i thanë edhe akademikut Rexhep Qosja se vendin e kishte në shkencë e jo në politikë. Dhe besoj ky ishte një gjykim i drejtë i votuesve. Kryetari i ORA-s, Veton Surroi, duke e ndjerë rrezikun që i vinte pas themelimit të AKR-së dhe duke parë edhe faktin që struktura e partisë së tij po kalonte në partinë e z. Pacolli atë botë kishte marre një nga vendimet më të rëndësishme të jetës së tij. Ai do ta "katunarizonte" partinë "qytetare" siç e quante ai Lëvizjen Qytetare ORA. Projekti ishte ecja katundare, neper fshatra e Kosovës. Një përpjekje e dështuara kjo për të fituar votat e fshatarëve të ndershëm të Kosovës. Vetëm Surroi eci shumë nëpër katunde. Në disa raste edhe kishte filluar t'iu tregoj fshatarëve se si të jenë edhe më fshatarë se ç'ishin. Ndërkohë që kishte marr një përgjigje interesante: "Veton, tregona ti qysh ki me ndërto shtetin se qysh i mbjellim na kastravecat e specTerrat e dimë vet", - ishte shprehur një nga fshatarët e fshatit Trakaniq. Me fjalë të tjera ky projekt katundar i qytetarit Surroi nuk kishte pasur sukses. Qytetarët e shihnin një alternativë më shpresëdhënëse ofertën e z. Behgjet Pacolli dhe Aleancës Kosova e Re. Lëvizja qytetare ORA nuk arriti ta kaloj pragun për të hyrë në Parlament në

zgjedhjet e vitit 2007. Kjo Lëvizje mori 4.7 % të votave. Për këtë 0.3 % të votave që i mungonin për ta kaluar pragun, Veton Surroi shihte vetëm një fajtor, ai ishte Behgjet Pacolli. Në fakt atij dhe kompanisë "Koha" i dolën parashikimet. Ndjenja e frikës se qytetarët do të vendosin për Behgjet Pacollin përballë Veton Surroit doli e saktë. Surroi nuk do ia fal kurrë këtë Pacollit. Pasi Veton Surroi nuk ishte më pjesë e politikës në Kosovë dhe nuk u ndjente i gjallë, a thua ambiciet e tij ishin shuar? Befas shpërtheu sërish kompania "Koha" kundër Behgjet Pacollit. Ata që e përcjellin pak politikën në vend mund ta kuptonin se mbrapa kësaj qëndron Veton Surroi dhe ndonjë ambicie e re e tij. Lideri i AKR-së z. Behgjet Pacolli kishte kandiduar për President të Republikës çka ishte kusht për të hyrë në koalicion. Kusht që i qëndroi deri në fund.

Të frustruar nga ky lajm mediet e z. Surroi filluan sulmet kundër z. Pacolli. Dolën edhe njëherë lidhjet e vjetra me mediet serbe, të cilat u vunë në shërbim të "Kohës Ditore". Një aleancë e vjetër kjo. Ky medium nuk linte asnjë gur pa lëvizur për të nxjerr Presidentin e AKR-së si të papranueshëm për President të Kosovës. Por, çka fshihej pas kësaj, ishte, kandidimi i Veton Surroit për President të Kosovës. Z.Surroi ende i frustruar nga disfata politike që pësoi atëbotë nga z. Pacolli, kishte vendosur ta sfidonte edhe një herë Liderin e AKR-së. Në një shkrim, "Koha Ditore" fliste hapur se si kinse z. Pacolli është i papranueshëm për ndërkombëtarë, ndërkohë që si propozim serioz për President dhe shumë të pranueshëm për bashkësinë ndërkombëtare e nxirrte z.Veton Surroi. Në atë shkrim thotë se burime të besueshme e nxjerrin emrin e z. Surroi si një ndër emrat kryesorë që po përflitej për President. Kjo ishte arsyeja pse luftohej Behgjet Pacolli. Z. Surroi donte të bëhej vet President. Se ku e gjente mbështetjen mbetet tek burimet anonime të "Kohës Ditore". Por, kjo u kuptua shpejt, pasi këtë tezë e rrëzoi "Bota sot" duke i vënë në kundërpeshë, "legjitimitetin e të pranueshmëve". Pasi u kuptua se kjo ishte vetëm një ambicie e lajthitur e z. Surroi dhe kompanisë së tij "Koha", filloi intensifikimi i sulmeve kundër kandidatit për President Behgjet Pacolli, me shpifje, trillime, citime të gazetave serbe, tituj të krijuar nga redaksitë në Serbi e kështu me radhë. Mërzia e këtij mediumi që z. Pacolli do të bëhej President s'të lë vend për ngushëllim. Unë jam i bindur se Surroi nuk do ia fal kurrë Pacollit, faktin që ky i shkatërroj karrierën politike, veçanërisht s'do ia fal mundin që ka bërë ai duke ecur nëpër fshatrat e Kosovës, gjë që qytetari Surroi e bënte për herë të parë në jetën e tij. Populli nuk i ha këto, i kishin të dytë kabinat e votimit në 2007, ata e zgjedhën Pacollin përball Surroit. Votat e të njëjtëve qytetarë do ta zgjedhin edhe Presidentin të Kosovës.

Në shkrimin e ardhshëm jeta e Veton Surroit në vitet e '90-ta...

---

## **Pacolli: Nuk kam thënë se Serbia është nëna e Kosovës**

---

Gazeta KOHA Ditore edhe televizioni "Kohavizion", ditëve të fundit janë duke e zhvilluar një fushatë intensive dhe tendencioze kundër personalitetit tim, bile duke shkuar edhe më tutje me përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Kjo pos që tenton të denigrojë personalitetin tim, nxit urrejtje duke rrezikuar jetën time dhe të familjes sime. Publikimet e përdorura në mediumet e lart përmendura janë të montuara dhe të shtrembëruara tërësisht. Unë nuk kisha ndërmend të reagoja ndaj kësaj fushate tendencioze, por një letër e dy organizatave të veteranëve të lidhura me luftën, të cilën unë e respektoj shumë dhe për të cilën kam bërë shumë, më shtyu të përgjigjem sa më poshtë. **Me përgjegjësinë time të plotë morale dhe politike deklaroj se unë asnjëherë nuk kam thënë, as nuk kam menduar që: Serbia është nëna e Kosovës!** "Se unë do të bëhem ndonjëherë Tito i Kosovës! Se i kam quajtur serbët vëllezërit tanë! Siç opinioni është sqaruar shumë herë për takimin me Millosheviqin, ai takim është pasuar me takimin me udhëheqësin më të lartë të Kosovës. Në atë takim jam dakorduar me udhëheqësit prezentë dhe qasjen e tyre lidhur me çështjen e Kosovës dhe lidhur me proceset që do të zhvilloheshin rreth Kosovës. Unë nuk kam kërkuar nga Millosheviqi bashkëjetesë, por ndarje. Ditët e ardhshme intervistat origjinale do t'i ofrohen opinionit publik, dhe të gjithë të interesuarve.

**Behgjet Pacolli, AKR**

**Analiza gjymtuese dhe fushatë jo e ndershme ndaj z. Behgjet Pacolli****Misioni në shërbim të qarqeve sllave**

Në prag të konstituimit dhe të funksionalizimit të institucione shtetërore të Kosovës, pas procesit zgjedhor të dhjetorit të vitit të shkuar dhe janarit të këtij viti, ka filluar një fushatë historike ndaj mandatarëve të institucioneve të Kosovës, të cilët pritet ta udhëheqin shtetin së shpejti, z. Hashim Thaçit, i cili do të jetë kryeministër i Qeverisë dhe ndaj z. Behgjet Pacollit, i cili pritet që të zgjidhet në postin e presidentit të Kosovës. Disa media kosovare, - sidomos pas bërjes publike që koalicioni i ardhshëm qeverisës do të bëhet në mes të PDK-së dhe AKR-së, e posaçërisht pas marrëveshjes së këtyre dy partive që posti i presidentit t'i takoj Behgjet Pacollit, - kanë ndërmarrë një fushatë denigruese, të pandershme dhe, shih çudinë, në koordinim të plotë me shtypin serb dhe përgjithësisht sllav (edhe rusë e kroat).

Fushata ndaj Pacollit është ngritur në bazë të gjoja disa intervistave që ky i paskësh dhënë për shtypin e këtyre vendeve vite më parë, e që tani, për nevojat e dikujt, (ri) sillen me tituj bombastikë që në themel kanë denigrimin e personalitet të pretendentit për president të Kosovës z. Behgjet Pacolli. Është krejt e ligjshme dhe demokratike që shtypi i një vendi t'i kushtoj kujdes meritore të gjithanshëm një personi që pretendon postin reprezentativ të të parit të popullit dhe të shtetit, ngase ai është pasqyrë e tij, por kjo duhet bërë pa paragjykime dhe e bazuar në realitete dhe në të vërteta dhe jo në konstruksione e matrapazllëqe nga më të ulëtat. Si mund që të ngritet një fushatë e tërë ndaj një personaliteti shqiptarë e bazuar thjeshtë në gazetatat bulevardeske sllave, e nga të cilat dihet që historikisht shqiptarët kurrë nuk kanë pritur ndonjë gjë të mirë! Kjo nuk është parë dhe as dëgjuar ndonjëherë deri më sot!

Si ta kuptojmë një pjesë të shtypit tonë apo gjoja disa publicistë të tipit të Enver Robellit që mbase jeton e vepron në Kroaci, që fushatën ndaj Pacollit ta ngrehin mbi bazën e disa titujve bombastik të medieeve serbe e ruse, pa u analizuar ato, pa u marrë fare me vërtetësinë dhe korrektësinë e atyre shkrimeve dhe duke nxjerrë pjesë, sipas nevojës, nga konteksti, duke gjymtuar mesazhet origjinale. Një analist i mirë, i paanshëm dhe që nuk i shërben ndonjë grupi të interesit a klani të caktuar, analizën apo opinionin e tij e bazon në fakte dhe argumente, në të dhëna konkrete dhe me qasje reale, e jo të bëjë "analiza" të porositura të bazuar në thashetheme e konstruksione sipas tekeve dhe nevojave të dikujt. Madje shkrimi me inercion dhe gjuha denigruese e poshtëruese e "analistit" Robelli ndaj z.Pacolli, po edhe Thaçit, s'ka se si të kuptohet ndryshe veçse si një mision që bënë në shërbim të qarqeve të caktuara, e që i di Robelli & co. Sepse për z. Pacolli apo z. Thaçi, më shumë se në shtypin sllav, duhet të bazohemi në veprat konkrete që kanë bërë këta dy liderë për Kosovë, e madje edhe për shqiptarët në përgjithësi, si dhe në Evropë dhe në vendet mike. Është krejt legjitime dhe normale që qytetarët e Kosovës të zgjedhin dhe të zgjidhen, dhe kjo e drejt e tyre është kategori kushtetuese, jo vetëm e Kosovës por edhe në vendet e botës demokratike. Kjo vlen edhe për z. Thaçi e z. Pacolli, të cilët përfaqësojnë subjekte të respektuara politike dhe të cilët kanë kaluar përmes sistemit të zgjedhjeve të lira, që tashmë janë pranuar dhe janë çertifikuar. Kurse bërja e koalicioneve është një praktik e njohur në vendet demokratike dhe të lira. Është përgjegjësi e spektrit politik në Kosovës që votat e marra nga qytetarët t'i vënë në funksion të stabilizimit të shtetit, e jo për teke e interesa personale dhe duke abuzuar me to, të bllokojnë formimin e institucioneve të vendit. Andaj në këtë kontekst duhet parë edhe arritjen e marrëveshjes për koalicion në mes dy subjekteve politike, në këtë rast në mes të PDK-së dhe AKR-së. Nga kjo që thamë, gjithçka është bërë në baza të shëndosha, e demokratike në pajtim të plotë me

Kushtetutën dhe ligjet e vendit. Andaj është e çuditshme pse është ngritur kjo fushatë denigruese ndaj partnerëve të koalicionet e posaçërisht nga z. Pacolli. Me këtë rast, për Robellin, kompaninë dhe bashkëpunuesit e tij, dua të them se koalicioni në mes Thaçit e Pacollit ka marrë edhe miratimin e miqve më të mëdhenj të shqiptarëve, pikësisht të SHBA-ve, pastaj të Londrës, Parisit, Berlinit, Brukselit e kështu me radhë. Koalicioni ka marrë përkrahjen edhe të spektrit politik në Shqipëri, përveç z. Robelli, bashkëpunuesit të tij, dhe qendrave sllave si në Beograd e Moskë, të cilat janë alarmuar dhe janë vënë në sulm ndaj bartësve kryesor të këtij koalicioni. Në shkrimet e tij, z. Robeli në të përditshmen "Koha Ditore", me një gjuhë të fëlliqur e të kontaminuar, përbaltë figurën e z. Pacolli, pa fakte e argumente. Gjuha e përdorur në shkarravinat dhe broçkullat e Robellit, të cilat ai i quan analiza (!), tregojnë qartë për hipokrizinë e tij së pari ndaj profesionit të tij dhe së dyti vë në lajthitje dhe luan me ndjenjat dhe me votat e qytetarëve të Kosovës. Një gjuhë e tillë, që ka për qëllim damkosjen dhe linçimin e njerëzve, për të vetmen arsye se nuk mendojnë si ai, apo nuk janë pjesë e klanit të tij, mund të themi me përgjegjësi se është ves i trashëguar nga sistemi monist, nga i cili pësoi rënd populli ynë, sidomos njerëzit me prirje atdhetare. Z. Robelli, nëse lexohet me kujdes, në shkrimet e tij, dhe jo vetëm në këtë rast, po edhe herë të tjera, në emër të fjalës së lirë, dhe gazetarisë së lirë, të kujtojnë shkrimet dhe linçimet, që i përgatiste shtypi monist i ish-Jugosllavisë në proceset e diferencimeve ideopolitike, me një fjalë të kujtojnë partinë-shtet, shtetin parti. Ata që kanë përcjellë me vëmendje shkrimet e z. Robellit, e dinë fort mirë se ky i ashtuquajtur analist, nuk di të shkruaj ndryshe veçse kështu siç u tha më lartë.

Për të mos u marrë më tepër me Robellin dhe sojin e tij, me pak rreshta do të paraqesim disa pikëpamje tona që zhveshin lakuriq Robellin, kur është në pyetje personaliteti i Behgjet Pacollit dhe kontributi i tij për Kosovën. - Tanimë s'ka dyshim që z. Behgjet Pacolli, është një ndër biznesmenët më të njohur shqiptarë në përmasa ndërkombëtare, i cili me punën dhe angazhimin e tij ka bërë emër në tregun ndërkombëtar dhe këtë në kushtet e një ekonomie të lirë dhe në një konkurrencë të denjë e me kritere. - Behgjet Pacolli, populli i Kosovës e njeh nga afër si një njeri human, që është shquar si humanist i vërtet. Këtë më së miri e dinë mijëra familje që ky i ka ndihmuar në mënyra të ndryshme, si në aspektin shëndetësor, atë të banimit, atë të përkrahjes etj. Behgjet Pacolli, është treguar përkrahës i institucioneve të njohura si paralele, të Republikës së Kosovës në vitet '90 -'99, kur financoi e përkrahu materialisht institucionet e Kosovës. Po ashtu, Pacolli përkrahu fuqishëm edhe luftën për çlirimin e vendit.

-Behgjet Pacolli dhe kompania e tij "Mabetex" në Kosovë ka ardhur me kapital të krijuar jashtë Kosovës, në botën perëndimore, e ndërtuar në filozofinë, traditën dhe shkollën e Perëndimit. Z. Pacolli në Kosovë ka krijuar me mijëra vende pune, që ka ndikuar në rritjen e mirëqenies ekonomike në Kosovë dhe në zbutjen e papunësisë. Me një fjalë, z. Pacolli më shumë i dha Kosovës se sa që i mori.

-Z. Behgjet Pacolli, me hyrjen e tij në politikë ka sjellë një gjuhë, kulturë e shpirt unifikues. Çdo kush që ka përcjellë fushatën e tij ka parë që z. Pacolli ka pasur një qasje pozitive. Fushatën e tij ai e ka bazuar në projekte konkrete, në zgjidhje konkrete me plane të qarta, e jo në sharje, fyerje e degradime të stilit ballkanas.

-Z. Behgjet Pacolli si deputet dhe opozitarë në Kuvendin e Kosovës, ka vënë gjithë interesin e popullit të Kosovës para interesit të tij personal a partiak, duke u treguar si një institucionalist i vërtetë dhe jo si i tillë që e lë shtetin në baltë pse nuk është pjesë e pushtetit. Kontributi i z.Pacolli në arenën ndërkombëtare për përkrahjen e Kosovës është i jashtëzakonshëm, sidomos kjo është parë katërçipërisht pas shpalljes së pavarësisë, kur z. Pacolli nuk ka kursyer asgjë për të sjellë njohje për Kosovën, dhe rezultatet e tij në këtë fushë

janë të prekshme dhe konkrete. Me gjithë mospërkrahjen dhe pengesat nga ana e MPJ-së e Kosovës, z. Pacolli, Kosovës i solli 24 njohje dhe tërë këtë aktivitet e ka bërë me fonde të tij personale, e jo me kuletën e shtetit. Kjo tregon më së miri formatin prej burrështetasi të z. Pacollit në njërin anë, dhe në anën tjetër shpreh qartë, - për ata që duan të kuptojnë dhe kanë arsye, - për dashurinë dhe sakrifikimin e tij për vendin dhe popullin e tij. Këto që u thanë më lartë dhe shumë të tjera që nuk u përmenden, e bëjnë z. Behgjet Pacolli si një personalitet shumë meritor, kredibil dhe të qëlluar për të qenë i pari i vendit. Në fund shtrohet një pyetje e ligjshme dhe logjike: A thua shtypi sllav do të ishte marrë dhe do të kishte qenë kaq i alarmuar sikur zgjedhja e z. Pacolli për president të kishte qenë në favorin e tyre ?! Dhe fare në fund, pyesim qetësisht z. Robelli se ku është ky në raport me kontributet që z. Pacolli ka dhënë për Kosovën? Pa na përmendur faktin se ju z. Robelli keni kontribuar për Kosovën duke na shitur mend dhe duke bërë "analiza" duke jetuar më shumë jashtë Kosovës.

**Behgjet Pacolli, njeriu i Kosovës**

---

**Personalitet i përmasave botërore, e mira e Kosovës dhe kombit!**

---

**(Shkruan: Myzejene Selmani)**

Këtë shkrim po e nisi disi e irrituar nga shkrimet e fundit nëpër disa medime kosovare, jo pse i urrej apo kam ndonjë antipati, por për faktin se kur është fjala për z. Behgjet Pacolli me të cilin kam bashkëpunuar vite me radhë, po më lëndojnë ato shkrime shpifëse me tentim denigrimi ndaj tij. Kosova do të fitojë shumë me zgjedhjen e tij president, siç ka fituar shumë nga ai edhe hiq pa qenë bartës i ndonjë institucioni të Kosovës. Ishte Behgjet Pacolli ai që deri sa politika kosovare, e përbëre prej pak a shumë nga e njëjta strukturë, kishte mbetur dhe sillej vërdallë në "standardet para statusit", kur Pacolli kishte angazhuar ekipe lobuese në SHBA, ekipe të përbëra nga ajka e diplomacisë amerikane, të cilat ekipet nuk ndaluan kurrë që t'i kundërvihen fushatës së Artemies në Uashington DC, fushatë e cila Kosovën po e paraqiste si çerdhe talebanësh nëpër korridoret e Capitol Hill-it, duke shfrytëzuar ngjarjet e marsit 2004. Pacolli lëre që i mposhti Artemien dhe lobin serb atje, por edhe i përshpejtojë gjërat që edhe kulminuan me përshpejtimin e procesit rreth shpalljes së pavarësisë. Në Kosovë askush nuk ka dyshime se SHBA na ka përkrahur dhe ua kemi borxh, mirëpo kush ka qenë në Uashington në vitin 2004 e deri me 2006 e ka vërejtur se lobi serb me "kisha të djegura" e duke i prekur amerikanët në vendin ku u dhemb, duke e paraqitur Kosovën si vend talebenësh, që djegin kisha, deri diku kishin arritur të kthenin në dobi të tyre senatorë e kongresmenë, duke qenë se veç kishte senatorë me origjinë serbe, të cilët i morën krahët pasi fushatës së peshkopit Artemie dhe lobit të tij. Po e bëj një kërcim të madh në kohë dhe po dal menjëherë tek shpallja e Pavarësisë dhe pas shpalljes, çka ndodhi, e nisem me eufori, na njohën disa shtete dhe pastaj ndodhi stagnimi, miqtë tanë të preokupuar me telashet dhe prioritetet e tyre na qiten në "ligë të dytë" të prioriteteve e neve mbetem të merremi vete me punët tona, gjë që edhe e bëmë, por na eci shumë ngadalë dhe se rezultatet çalonin, e mu këtu vlen të përmendet qasja e Behgjet Pacollit i cili edhe në këtë fazë veç ishte i kyçur dhe filloi të kompensojë ngecjet e diplomacisë kosovare, ngecjet që ishin të mëdha, pasi që njohjet u stopuan. Serbia na e imponoj agjendën e vet, kurse ne veç vraponim pas hapave të tyre. Derisa Kosova ngeci, Pacolli e aktivizoi makinerinë e tij lobuese dhe njohjet nuk ndaluan (janë mbi 20 njohje që i ka sjellë Kosovës), Pacolli nuk hezitoi që ti bie me dhjetëra herë rreth e përçark globit në fushatën e tij të gjatë lobuese, e la familjen anash për hir të Kosovës, bëri shumë por prapë se prapë në Kosovë nga xhelozët dhe konkurrentët që e shihnin vetën të vogël pranë tij, ai u shantazhua, u tentua t'i mohohen shumë merita. Fatmirësisht nuk arritën tërësisht ta neutralizojnë veprimtarinë e tij pasi që burrëshetësit nëpër botë filluan t'ia nënshkruajnë "LIVE" njohjet dhe kosovarëve iu hoqën dilemat se kush po i sjellë ato, kush po shpenzon buxhetin privat në fushatat lobuese në dobi të Kosovës. Behgjet Pacolli edhe pse u injorua nga paria e Kosovës ai prapëseprapë privatisht funksionoi më mirë se një ministri e punëve të jashtme, angazhoi shumë njerëz në atë proces, rezultatet nuk i munguan. Gjërat rrodhën si rrodhën, Kosova u gjend para divorcitet të partnerëve qeverisës, dhe aty Pacolli si lideri një subjekti (ish subjekti i tretë në Kosovë, sipas zgjedhjeve të 2007) e kreu pjesën që i takon të bëjë një partie opozitare, erdhën zgjedhjet, filloi fushata, rrodhi si rrodhi, u dhanë vija të kuqe nga shumëkush për gjithkënd, edhe aty Behgjet Pacolli u shpreh se nuk përdorë marker për t'i dhënë vijë të kuqe askujt. Përfundoi procesi i stërzgjatur, dolën rezultatet, filluan kombinatorikat kush me kënd, disa e eliminuan



vetveten nga kombinimet, disa mbrojtën qëndrimet e tyre, siç bëri edhe Behgjet Pacolli, i cili vi të kuqe s'i kishte rënë askujt as gjatë fushatës e as mbas fushatës, u bë oferta, u paraqitën kërkesat, disa u pranuan disa jo, u arrit një kompromis dhe si rezultat final doli që Behgjet Pacollit t'i ofrohet posti i presidentit, ndërsa subjektit që ai e drejtonte t'i ofrohen disa ministri. Fushata ndaj tij u ashpërsua dhe thuajse çdo gjë e keqe që i ka ndodhë Kosovës fajin e paska ai, edhe për periudhën kur nuk ishte në skenën politike bile. Iu përmend shumë fraza se ai vetë ka thënë se duhet të zgjidhet presidentin direkt nga elektorati e jo nga pazaret politike, gjë që pajtohem edhe unë e pajtohet edhe ai, duke qenë se është i vetmi që tash e 4 vjet ka kërkuar që të amendamentohet Kushtetuta dhe që presidenti të zgjidhet direkt nga populli, por askush nuk ia varte veshin, sepse nuk ishte ai president asokohe dhe nuk iu konvenonte, ndërsa tash po vjellin zjarr për goje, duke tentuar që t'i kapen për çdo fjale që mund ta ketë thënë apo mund t'i është mvëshur se kinse e ka thënë ndokund. Nëse gjërat rrjedhin sipas planit dhe nëse Kosova e ka fatin që ta ketë President Behgjet Pacollin, dhashtë Zoti që kjo të ndodhë sa më shpejt, atëherë një gjë mund t'i siguroj qytetarët e Kosovës se do t'ia shohin hairin ata dhe e tërë Kosova, sepse hairin e tij e kanë parë dhe e kanë shijuar shumë herë deri tash (të fundit janë të evakuuarit nga Egjipti), ku dora e mirësisë dhe angazhimi i Behgjet Pacollit iu mundësoi që të kthehen shëndosh e mirë në Kosovë, Shqipëri e Maqedoni ata që kishin ngelur në Egjipt dhe që përballeshin me situata të rrezikshme atje. Këtu po kthehem pakëz mbrapa se nuk bën pa e përmend ndërmjetësimin dhe lirin e Shqipe Hebibit me shokë të kidnapuar nga talebanët në Afganistan, e të liruar tek pas angazhimit maratonik të Behgjet Pacollit i cili nuk kurseu asgjë duke rrezikuar edhe jetën e tij personale duke u futur në çerdhe të talebanëve për të shpëtuar jetë njerëzish pasi që Kosova zyrtare nuk e kishte bërë asnjë hap për këtë shpëtim. Rasti i negociimit e liritimit të robërve u përsëritë, por jo më me shtetas kosovarë, por me shtetas të tjerë pasi që duke parë zotësinë e Behgjet Pacollit edhe shtete si Korea e Jugut dhe Qeveria italiane e angazhuan të ndërmjetësojë në lirin e qytetarëve të tyre ( për më shumë shih librin " Nga Sfida në Sfidë Jeta e Behgjet Pacollit). Është më se e vërtetë se mrekullitë nuk do të ndodhin shpejt, por se gjërat do të marrin kahjen e duhur, do të shihet pak dritë në fund të tunelit e nëse punohet mirë në të gjithë sektorët dhe nga të gjithë, atëherë edhe tuneli do të kapërcehet. Jam më se e sigurt se aty ku shtrihet dora e influencës së pushtetit të Behgjet Pacollit, aty do të ketë vetëm trende pozitive, dhe në situatën dhe në çastin ku jemi tash, njeri më të duhur e më të qëlluar për president nuk ka, sepse ai me qasjen e tij garanton se rezultatet pozitive në dobi të Kosovës nuk do të mungojnë. Është më se e vërtetë se në qeverisjen e ardhshme numrat apo dikasteret që do të drejtojnë bashkëpunëtorët e tij të deritashëm nuk janë të shumtë, por edhe atje nuk do të mungojnë rezultatet pozitive pasi që të gjithë ne që jemi pjesë e institucioneve publike kemi qenë nën ombrellën e Behgjet Pacollit dhe se ai na ka frymëzuar dhe vazhdon të na frymëzojë edhe me tutje, bile tash na inkurajon edhe më shumë që të punojmë pandërprerë që të jemi sa më të dobishëm për Kosovën dhe qytetarët e saj. Këtë ia kemi borxh këtë Kosovës siç ia kemi borxh edhe Behgjet Pacollit, i cili nuk kurseu asgjë për të mirën e Kosovës dhe qytetarëve të saj dhe gjëja më pozitive në tërë këtë është se ai ende vazhdon të jetë aktiv dhe të jetë udhërrëfyes për të gjithë ne. Nuk kam dyshime se disa e xhelozojnë, e kritikojnë edhe e ofendojnë pa të drejtë, mirëpo kjo le tu mbetet atyre në ndërgjegje. Karvani (Kosova) vazhdon të ecën përpara dhe se këtë rrugëtim e bën më të mbarë fakti se Behgjet Pacolli do të na prijë, ai është prijës ngadhënjimtar, i dëshmuar dhe prapë do ta dëshmojë këtë edhe nga pozita e presidentit të Republikës së Kosovës. Pas bërjes president të Behgjet Pacollit, Kosova do të ketë një president, i cili i ka dyert e hapura kudo në botë, do të ketë një njeri, i cili numrin e njohjeve për Kosovën do ta rritë sepse e ka dëshmuar se mund ta bëjë këtë, e ka një njeri për president i cili e ka gjendjen e mirë ekonomike dhe se është më se e sigurt se paraja publike nuk do të jetë caku i tij, do ta ketë për president një njeri që do të sjellë investitorë serioz në Kosovë për të tentuar ta zbutë mjerimin që e ka kapluar Kosovën.

(Autorja është anëtare e Kryesisë së AKR-së dhe deputete në Kuvendin e Kosovës)

## **Pacolli dyshohet se është "Kali i Trojës i Ruisë"**

**"60 - vjeçar, i martuar me një ruse, Pacolli, i cili ka fituar shumë para në Rusi dhe në fillim të luftës së Kosovës madje u takua për negociata me kryetarin serb, Milosheviqin, me qëllim që t'i përjashtojë fuqitë perëndimore (nga ndërmjetësimi dhe ndërhyrja në Kosovë), nuk është president i ëndrrave të shtetit të ri", shkruan gazeta zvicerane**

Gazeta zvicerane "NZZ am Sonntag", që është edicioni i së dielës i gazetës së famshme "Neue Zürcher Zeitung", shkruan se Behgjet Pacolli nuk është president i ëndrrave për shtetin e ri të Kosovës. Në numrin e së dielës kjo gazetë shkruan: "Ndërkohë 60-vjeçar, i martuar me një ruse, Pacolli, i cili ka fituar shumë para në Rusi dhe në fillim të luftës së Kosovës madje u takua për negociata me kryetarin serb, Milosheviqin, me qëllim që t'i përjashtojë fuqitë perëndimore (nga ndërmjetësimi dhe ndërhyrja në Kosovë), nuk është president i ëndrrave të shtetit të ri. Ai dyshohet se për shkak të lidhjeve të tij të mira me Moskën është 'Kali i Trojës i Ruisë', kundërshtares së pavarësisë së Kosovës".

"NZZ am Sonntag" njofton se në shkurt të vitit 2008 Pacolli në një gazetë kroate u citua me deklaratën se Serbia na qenka nënë e Kosovës. Këtë mendim mbase nuk e ndajnë të gjithë në Kosovë. Vëzhgues në vend dhe në botën e jashtme janë të shqetësuar me "Një figurë kaq e shumëgjyreshe dhe diskutueshme gjithsesi nuk do në ndihmojë në përmirësimin e imazhit të shtetit të ri", thotë deputetit i parlamentit të Zvicrës, Andreas Gros, i cili është njohës i zhvillimeve në Kosovë. Gros është po ashtu anëtar i Këshillit të Evropës. Pasi përshkruan karrierën e Pacollit gazeta zvicerane nënvizon se në kantonin e Tiçinos, ku gjendet selia e firmës së tij 'Mabetex', ai përmes një fondacioni bamirës ka organizuar pushime dhe programe ndihmëse për fëmijët nga Lindja. Më tutje gazeta shton: "Ai ( Pacolli, v.j.) mban lidhje të mira me kryeministrin Hashim Thaçi, i cili ia ka dhënë një tender disa milionësh. Pacolli dhe Thaçi e kanë një armike të përbashkët: Karla Del Ponten. Ajo dyshon se Thaçi prej vitesh është i involvuar në tregti me organe në kuadër të krimit të organizuar - një akuzë që së fundi u ngrit edhe nga Dik Marti.( ... ) Del Ponte e ka ndjekur Pacollin për shkak të dyshimit për korrupsion dhe spastrim parash". Gazeta shkruan se Pacolli deri në vitin 2008 ka qenë nën hetime në Zvicër për shkak të shpëlarjes së parave.

---

## Thaçi e Pacolli "të përshtatshëm" për dialogim me Serbinë

---

**Pas nënshkrimit të marrëveshjes për koalicion midis Hashim Thaçit e Behgjet Pacollit, mandatar i Qeverisë ka paralajmëruar krijimin e shpejtë të ekipit kosovar që do t'i bëjë bisedat me Beogradin. Diplomata evropiane kanë thënë se tandemi Pacolli - Thaçi do të mund të jetë i përshtatshëm për të nisur dialogun, ndërkaq në Beograd kanë vlerësuar se Pacolli mund të jetë një kanal shumë i mirë në mes të Kosovës dhe Serbisë në raste të krizave dhe kërkesave për zgjidhje të ndryshme**

PRISHTINË, 20 SHKURT - Lidërsipin në ardhje i Kosovës, që po shihet si i përshtatshëm në Bruksel e Beograd për të realizuar dialogun me Serbinë, ka treguar të shtunën se ka top - prioritet themelimin e grupit që do ta përfaqësojë vendin në këtë dialog. Këtë e ka bërë të ditur Hashim Thaçi, mandatar për formimin e qeverisë së re, vetëm disa minuta pasi ka nënshkruar marrëveshje partneriteti me partinë e Behgjet Pacollit, njeriut që është kandidat për president. Madje, Thaçi ka thënë se ekipi do të formohet para se të qitet në votim Buxheti për 2011 - ën, një çështje me emergjencë për Kosovën. "Dialogu është një agjendë evropiane, një agjendë euroatlantike për Kosovën, por edhe për Serbinë, që do të jetë në interesin e të dy vendeve dhe të dy popujve tanë, që do të jetë në shërbim të qytetarëve për një jetë më të mirë, për çështje praktike, që do të përmbillet si një proces me anëtarësimin e Kosovës dhe të Serbisë në NATO dhe BE", ka thënë Thaçi. "Ne do të formojmë ekipin e dialogut, një ekip jashtëzakonisht të përgatitur, ndërsa menjëherë do të procedojmë me buxhetin e Kosovës". Dialogu do të nisë së shpejti, ngaqë kjo është kërkuar nga një rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Nisja e tij është shtyrë pas krizës institucionale në Kosovë, të cilën e prodhoi dorëheqja e presidentit pesë muaj më parë, e më pastaj shkarkimi i Qeverisë. Zgjedhjet e parakohshme që u mbajtën nxorën fitues PDK - në e Thaçit, e cila, pos subjektit politik që drejton Pacolli, në koalicion ka përfshirë 22 prej 25 deputetëve të pakicave. Disa diplomatë të vendeve të BE - së kanë pohuar për gazetën se tandemi i ardhshëm në krye të Kosovës Pacolli Thaçi, të mbështetur gati nga të gjithë deputetët e pakicave, do të mund të jetë ndoshta i përshtatshëm për të nisur dialogun me Beogradin. Përderisa Pacolli duket të jetë jo shumë i njohur për diplomatët në BE sa u përket qëndrimeve të tija politike (dinë vetëm atë që ka thënë nëpër media), për Thaçin diplomatë të BE - së pohojnë se ai edhe më parë ishte konsideruar si figurë e përshtatshme për të nisur dialogun. Madje, disa kanë thënë se Thaçi ka edhe "qëndrime fleksibile rreth dhënies së një statusi special për veriun e Kosovës, me kusht që të garantohet integriteti territorial i saj". Më herët, kur flisnin për dialogun, zyrtarë të BE - së pohonin privatisht se "Thaçi është lider i duhur në kohën e duhur dhe në vendin e duhur", dhe preferonin që ai ta emërojë për dialog një të afërt të tij (të afërt politikisht) si shef delegacioni, i cili do ta kishte mandatin e plotë nga Thaçi për ta përfaqësuar Kosovën, por edhe që do të garantonte se Kosova do të zbatojë atë që del si rezultat. Por, Thaçi jo gjithaq sa Pacolli është i pranueshëm në Beograd. Për sa kohë kanë zgjatur zgjedhjet në Kosovë, negociatat për krijimin e qeverisë, vonesat dhe ndikimi i tyre në proceset që priten të ndodhin, kanë qenë ndër lajmet kryesore në mediat në Serbi. Një nga elementet që ka zgjuar kureshtjen e madhe të mediave, por edhe të qytetarëve, ka qenë fakti se Pacolli do të jetë president i Kosovës. Analisti serb Dashan Janjiq

ka vlerësuar se nuk ka qenë një befasi e madhe fakti që Pacolli është futur në koalicion me Thaçin, ndonëse në Serbi ka pasur edhe pritje të tjera. Por, sipas tij, Pacolli mund të jetë një kanal shumë i mirë në mes të Kosovës dhe Serbisë në raste të krizave dhe kërkesave për zgjidhje të ndryshme. "Ekzistojnë disa probleme për marrëdhëniet në të ardhmen pasi me gjasë Thaçi do të jetë kryeministër, ndërkaq edhe Agim Çeku mund të jetë një nga ministrat e Qeverisë së Kosovës dhe për të dy ekzistojnë disa aktakuza në Serbi", ka theksuar Janjiq, ani se vetë presidenti serb, Boris Tadiq, ka shprehur gatishmërinë ta takojë Thaçin. "Pacolli ka një imazh të dyfishtë në Serbi. Një pjesë e njohin si biznesmen të famshëm, të pasur, kontrovers, si i afërt me shumë shërbime sekrete, afera të ndryshme, krime. Por, ekziston një grup i mirë i njerëzve, i kompanive, i agjencive të ndryshme të konsultimit dhe biznesmenëve që kanë dëshirë dhe pëlqejnë të punojnë me Pacollin në Serbi", ka shtuar ai. Edhe Oliver Ivanoviq, sekretar shteti në Ministrinë e Serbisë për Kosovën, i ka thënë gazetës se shpreson se do të jenë, siç ka thënë, më konstruktivë lidhshipi i ri kosovar. "Nuk është mirë që dikush: prej anës së serbëve ta komentojë lidhshipin e Kosovës. Kushdo që është lider në Kosovë për ne është pala në negociatë. Por, shpresa ime është që do ta kemi palën konstruktive, e cila do të mundohet gjithashtu sikurse edhe pala serbe për të gjetur diçka të përbashkët", ka thënë Ivanoviq. "Lidhshipi i ri besoj se e kupton që stabiliteti është i pamundshëm pa e pasur këtë dialogun dhe negociatat". Autoritetet kosovare më herët kanë thënë se me Serbinë do të bisedojnë vetëm për aspekte ndërfqinjësore, si dy shtete. Por, autoritetet ndërkombëtare kanë qëndrimin se me dialog do të duhej dhënë zgjidhje edhe çështjeve të brendshme të Kosovës. Kësisoj, përfaqësues të ICO - së kanë shprehur pritjen që zgjidhja për veriun e Kosovës, të banuar nga serbë, të vijë nga bisedimet Prishtinë - Beograd. "Situata është mjaft e ndërlikuar, por bisedimet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, sipas nesh, sa i përket veriut të Mitrovicës, do të paraqitnin një zgjidhje dhe ne dëshirojmë ta përmirësojmë jetën e njerëzve përmes një zinxhiri të qëndrueshëm në partneritet me popullatën lokale, pa i imponuar çështjet", ka thënë udhëheqësja e Zyrës së ICO - së për Mitrovicë, Kate Fearon. Përfaqësuesit e serbëve në Kuvendin e Kosovës kanë shprehur qëndrimin se ata duhet të jenë të përfshirë në dialog, ngaqë shumë tema presin të ndërliken me aspekte që ndikojnë në jetën e njerëzve që përfaqësojnë. Sekretari i përgjithshëm i partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, SLS - së, Petar Miletiq, ka thënë që liberalët me pjesëmarrje në zgjedhjet parlamentare do të kenë mundësi që ta ngrenë cilësinë e jetesës së serbëve të Kosovës. E, duke folur për bisedimet që do të ndodhin mes Beogradi e Prishtinës, ai ka shprehur pritjet që serbët e Kosovës të kenë rolin më të rëndësishëm në këtë proces. "Unë shpresoj që serbët nga Kosova do ta kenë rolin më të rëndësishëm, sepse praktikisht bëhet fjalë për lëkurën tonë", ka theksuar Miletiq. "Bëhet fjalë më së shumti për problemet që prekin komunitetin serb në Kosovë". Edhe pse përfaqësuesit e SLS - së ende nuk kanë biseduar me kolegët e tyre shqiptarë në Parlament për dialogun mes Prishtinës e Beogradit, Miletiq ka paralajmëruar që partia e tij do të kërkojë që në këtë proces të marrë pjesë në mënyrë aktive. Grupi parlamentar i SLS - së ka 12 deputetë dhe largimi i tyre i mundshëm nga koalicioni qeverisës do t'ia humbte qeverisë shumicën në Kuvend. Mandatari për formimin Qeverisë, Hashim Thaçi, ka thënë se nuk pret humbjen e mbështetjes të deputetëve serb, pas ndonjë aspekti negociues me Beogradin me të cilin serbët e Kosovës nuk do të kënaqeshin. "Ne nuk jemi në garë por jemi partnerë. Do të punojmë për vendin tonë, për Kosovën, të gjithë, pa dallim etnie", ka thënë Thaçi. "Do të punojmë si një ekip i institucioneve të reja të Kosovës të dala nga zgjedhjet legjitime, të ndërtuara në mënyrë shumë të rregullt dhe të pranuar e të mbështetura plotësisht prej të gjithë partnerëve ndërkombëtarë, SHBA - së dhe BE-së dhe zyrtari serb Oliver Ivanoviq ka vlerësuar se përfaqësuesit e serbëve në Parlament dhe Qeveri

kanë në dorë të imponojnë gjëra. Kjo për shkak të fuqisë që do të kenë në koalicion. "Në rast se donë deputetët serbë, do të kenë mundësi ta diktojnë dialogun, por nuk jam i sigurt a kanë ata pjekuri politike për ta kuptuar situatën dhe fuqinë që kanë", ka thënë Ivanoviq. "Respekti i komunitetit ndaj tyre varet se sa do të jenë të fortë për përfaqësimin e interesave të serbëve". Janë pikërisht diplomatët evropianë që po i druhen mbështetjes së vogël që Thaçi do të ketë në Kuvend. Disa diplomatë të BE - së kanë thënë se Qeveria e ardhshme, nëse realizohet në tërësi marrëveshja midis Thaçit e Pacollit, nuk do të jetë stabile dhe nuk do ta ketë lehtë të zbatojë në terren rezultatet eventuale të dialogut me Beogradin, nëse kjo Qeveri nuk do të ketë mbështetjen e shumicës së deputetëve shqiptarë në Kuvendin e Kosovës. Edhe më të vështirë e bën situatën fakti se, nëse krijohet Qeveria vetëm me PDK - në, AKR në dhe pakicat, atëherë do të jetë opozita ajo që do të mund të thoshte se përfaqëson vullnetin e shumicës së popullit të Kosovës të shprehur në zgjedhje, edhe pse votat u janë dhënë partive politike në mënyrë individuale. E gjithë kjo nga disa diplomatë të shteteve anëtare të BE - së shihet si një "rrethanë jo shumë e kënaqshme" në Kosovë dhe nuk mund të parashikojnë sa do të zgjasë një koalicion i tillë.

---

## Zvicra demanton pohimet e Pacollit se është konsull nderi i Liberisë

---

PRISHTINË, 21 SHKURT (KD) - Kandidati i vetëm për president të Kosovës, Behgjet Pacolli, rezulton të mos jetë konsull nderi i Republikës së Liberisë në Zvicër, siç kishte deklaruar në një intervistë për të përditshmen "Express", më 2 shtator të vitit të kaluar. Këtë e ka konfirmuar zyrtari për informim në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Zvicrës, Georg Farago, të martën për "Kohën Ditore". Zoti Pacolli nuk gjendet në listën e korit konsullor në Zvicër", ka thënë Farago. Në intervistën dhënë gazetës "Express", më 2 shtator të vitit të kaluar. Pacolli pretendon të kundërtën. I pyetur nga gazetari se si është akredituar ai në OKB dhe në çfarë mënyre. Pacolli ishte përgjigjur kështu: **"Unë jam konsull nderi i Republikës së Liberisë në Zvicër. Në bazë të këtij statuti diplomatik, unë e kam akreditimin në Kombet e Bashkuara. Unë do të jem atje pasi që nga data 5 shtator e deri në mëngjesin e datës 9 shtator, kam shumë takime me shumë krerë misionesh të shteteve të ndryshme në OKB. Qëllimi im është që sa më tepër të marr dëshmi kundër rezolutës (serbe vj.) para fillimit të sesionit, ku do të diskutohet për Kosovën"**. Kryetari i AKR - së, tash kandidat për president të Kosovës, pak ditë para mbajtjes së punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB - së, në muajin shtator të vitit të kaluar, pati deklaruar se do të marrë pjesë atje dhe do të llojë për Kosovën në OKB, si konsull nderi i Liberisë në Zvicër. Zyrtari i MPJ - së zvicerane, Farago, tha se Pacolli nuk është në regjistër si konsull nderi i asnjë shteti në Zvicër. Në anën tjetër, nënkryetari i AKR së, Ibrahim Makolli, ka thënë të mos jetë në dijeni për sa u takon akreditimeve apo pozitive si konsull në ndonjë shtet të kryetarit të partisë së tij, Behgjet Pacollit. "Unë nuk jam në dijeni sa i takon kësaj pune dhe do të duhej të kontaktonit me Pacollin", ka thënë Makolli përmes telefonit. "Edhe ju e keni parë se ai ka qenë i pranishëm në seancën e OKB - së, në atë kohë. Tash nuk po e di sa i përket kësaj pozitës së konsullit", ka thënë Makolli. Thirrjet e gazetës në telefonin e kreut të AKR - së, Pacolli, për të marrë komentimin rreth çështjes ishin të pasuksesshme.

## Limaj kundër Pacollit për president

**"Çdokush e di se vullneti i Partisë Demokratike të Kosovës dhe i votuesve të saj nuk ka qenë që Behgjet Pacolli të bëhet president i Kosovës. Unë dhe të gjithë deputetët duhet të reflektojmë për ata që na kanë votuar. Duhet të përpiqemi cili është vullneti dhe dëshira e tyre", ka thënë Limaj, duke folur sesi do të votojë për presidentin e Kosovës**

PRISHTINË, 21 SHKURT - Fatmir Limaj dhe përkrahësit e tij brenda Partisë Demokratike të Kosovës nuk do të votojnë që Behgjet Pacolli të zgjidhet president i Kosovës. Kjo rezulton nga qëndrimi që Limaj e ka shprehur të hënën mbrëma, në një emision në TV - në kabllor "Klan Kosova". "Çdokush e di se vullneti i Partisë Demokratike të Kosovës dhe i votuesve të saj nuk ka qenë që Behgjet Pacolli të bëhet president i Kosovës. Nuk është mirë me u pa si president i imponuar me dy për qind të votave", ka thënë nënkryetari i PDK - së, Fatmir Limaj, në emisionin Zona e debatit". "Unë dhe të gjithë deputetët duhet të reflektojmë për ata që na kanë votuar. Duhet të përpiqemi cili është vullneti dhe dëshira e tyre", ka thënë ai, duke folur sesi do të votojë presidentin e Kosovës. "Unë e respektoj vendimin e Partisë Demokratike të Kosovës. Po unë e ndaj mendimin tim, mendimin ndryshe", ka thënë Limaj, duke përsëritur se "respektojmë marrëveshjen, por te çështja e votës është qëndrim individual". Këtë vendim të tij ai ka thënë t'ia ketë bërë të ditur edhe Këshillit Drejtues të PDK - së, në ditën kur u mor vendimi që Presidenca t'i takojë AKR - së. Njeriu i dytë më i votuar në PDK. Fatmir Limaj, gjatë kësaj interviste është shprehur haptazi kundër marrëveshjes së arritur nga partia e tij me Behgjet Pacollin. "Unë mendoj se Behgjet Pacolli në këtë moment nuk është dashur të jetë president i Kosovës, as nuk është dashur që Behgjet Pacolli të kërkojë që të jetë president i Kosovës, ka pasur hapësirë të mjaftueshme për të në Qeveri", ka thënë mes tjerash ai, duke shtuar se Pacolli ende nuk ka pasur rast që ta dëshmojë veten për Kosovën dhe është dashur që atë ta bëjë së pari në Qeveri. Limaj, që po të hënën ka njoftuar se nuk do të jetë në përbërjen e re të Qeverisë, ende beson se Jakup Krasniqi është dashur të jetë president i Kosovës. Arsyen për këtë ai ka thënë se e ka nga rezultati që ka treguar Krasniqi si ushtrues detyre i presidentit. Për më tepër, vendimin e partisë së tij për koalicion me AKR - në e ka quajtur "gabim strategjik" dhe "të rrezikshëm", pasi, sipas tij, Koalicioni i AKR - së është përbërë nga grupe partish dhe në momentin që Pacolli shkon si president disa nga deputetët e koalicionit të tij mund të mos e mbështesin më koalicionin qeverisës. Për këtë ai ka marrë shembull veprimin e Muhamet Mustafës, i cili të hënën është tërhequr nga kandidatura për zëvendëskryeministër të Kosovës, arsyetimin se i mungon hapësira politike për realizim të programit ekonomik. "I kemi thënë Pacollit që posti i presidentit është politik dhe nuk zbatohet programi juaj ekonomik. Kemi qenë fleksibil, i kemi ofruar ministri, tri, katër, deri në gjashtë", ka thënë ai. Për më tepër, Limaj i ka dhënë të drejtë deklarimit të Mustafës se i mungon hapësira. "Këtë e kam thënë unë në takimin e dytë (me Koalicionin rreth AKR - së v.j). Ju po thirrreni në programin ekonomik, po me presidentin s'ka program ekonomik. Presidenti është një post krejt politik", ka thënë ai, dhe ka treguar për fjalët tjera që i ka thënë Pacollit gjatë negociatave: "Motoja juaj kryesore ka qenë programi ekonomik zoti Pacolli ... me çfarë programi ekonomik mund të bëni tregti edhe industri". Kurse, për rrezikun e qëndrueshmërisë së këtij koalicioni, Limaj ka thënë se "nëse Pacolli merr postin e presidentit, ai jep dorëheqje prej partisë dhe na shkojmë edhe i themi' zoti

Pacolli shkuan dy njerëz 'dhe ai ka me thënë' po mua më kanë shkuar edhe kur kam qenë unë kryetar i partisë. Ju e dini se gati çdo muaj në Parlamentin e kaluar iu ka larguar nga një deputet". Gjatë intervistës, nënkryetari PDK - së, Fatmir Limaj, ka deklaruar se përgjegjësia si për presidentin, ashtu edhe për Qeverinë mbetet mbi kryetarin e PDK - së njëherësh mandatar i Qeverisë, Hashim Thaçi.



---

## **Konstituohet Kuvendi, presin Qeveria dhe presidenti**

---

**Deputetët e legjislaturës së katërt kanë dhënë betimin dhe kanë zgjedhur organin drejtues të Kuvendit. Kanë vendosur që Jakup Krasniqi të jetë sërish kryeparlamentar. Por për t'u votuar të martën kabineti qeverisës dhe presidenti, duhet që Kryesia e re ta mbështesë kërkesën e Hashim Thaçit për seancë të jashtëzakonshme**

PRISHTINË, 21 SHKURT - Kosova, të hënën, është bërë me Kuvend të ri, por jo edhe me president dhe me Qeveri. Kjo për faktin se Kryesia e re e Kuvendit e ka hedhur poshtë kërkesën e liderit të PDK - së, Hashim Thaçi, që brenda së njëjtës seancë të votohej kabineti qeveritar dhe të zgjidhej presidenti. Ata i kanë sugjeruar Thaçit që të bëjë kërkesë për seancë të jashtëzakonshme nëse dëshiron që kompletimi institucioneve qendrore të shtetit të bëhet sa më shpejt. Më këtë qëndrim të Kuvendit janë pajtuar partnerët e koalicionit qeverisës dhe menjëherë kanë deponuar kërkesë për seance urgjente. Tash ka mbetur në dorë të Kryesisë që të vendosë nëse Qeveria dhe presidenti të votohen të martën pasdite, apo në ndonjë ditë tjetër. Deputetët e legjislaturës së katërt, në seancën e rregullt, kanë dhënë betimin, dhe kanë zgjedhur vetëm organin drejtues të Kuvendit të Kosovës. Me shumicë votash, ata kanë vendosur që Jakup Krasniqi të jetë kryeparlamentar edhe në mandatin e ardhshëm katërvjeçar, kurse Xhavit Haliti i PDK - së, Sabri Hamiti i LDK - së. Glauk Konjufca i Vetëvendosjes, Petar Miletiq i komunitetit serb dhe Enis Kervan i komunitetit turk, janë zgjedhur nënkryetarë të Kuvendit. Seanca konstituive e Kuvendit është drejtuar nga deputetja Flora Brovina, e ndihmuar nga deputetja Biserka Kostiq. Me Rregulloren e Punës së Kuvendit këtë gjë është dashur ta bënin Nekibe Kelmendi e LDK - së dhe Albana Fetoshi e lëvizjes Vetëvendosje". Mirëpo, e para nuk ka mundur ta kryejë këtë obligim për shkaqe objektive, kurse e dyta, siç ka mësuar gazeta, nuk ka shprehur vullnet për të qenë në udhëheqje të seancës. Të 14 deputetët e "Vetëvendosjes", të cilët për herë të parë kanë marrë besimin e qytetarëve për t'i përfaqësuar interesat e tyre në Kuvend, në fakt kanë bërë edhe befasinë e parë Brenda institucionale. Në momentin e dhënies së betimit të deputetit, secili prej tyre ka vendosur para vetes flamurin kombëtar. Përbërja e re e legjislativit ka sjellë risi edhe në mënyrën e të votuarit. Deputetja Rada Trajković ka votuar gjatë gjithë kohës me tre gishtërinj. Ngritja e tre gishtërinjve është simbol i ortodoksizmit serb, që nënkuptonin trininë: ati, i biri dhe shpirti shenjtë. Ndërkohë, disa prej deputetëve janë treguar të luhatsëm, sidomos gjatë votimit për kryetar të Kuvendit. Kjo ia ka vështirësuar punën kryesueses së seancës gjatë deklarimit të rezultateve të votimit. Herën e parë asaj i kanë dalë 128 deputetë, kurse herën e dytë 110, ndonëse në Kuvend kanë qenë të pranishëm 118 deputetë. Për Krasniqin kryetar kanë votuar 90 deputetë për, 17 kundër dhe 3 kanë abstenuar. Plotësisht kundër kanë qenë deputetët e "Vetëvendosjes". Më 20 korrik 2004, Jakup Krasniqi, së bashku me drejtorin e Zyrës së Çështjeve Politike të UNMIK - ut, rusin Petar Ivantsov, e nënshkruan draftin e parë njëzetfaqësh të decentralizimit. Ky proces pastaj evoluoi në atë që sot po e shohim: 5 komuna të reja me shumicë serbe, dyfishimi i territorit të Artanës përmes përfshirjes së fshatrave me shumicë serbe në të, krijimi në letër i Komunës së Mitrovicës pas spastrimit etnik të kryer nga strukturat paralele të Serbisë atje", kanë thënë ata, përmes një komunikate për shtyp. Lëvizja Vetëvendosje "ka votuar edhe kundër dy nënkryetarëve që vijnë nga komunitetet pakicë, jo pse ata nuk janë shqiptarë, por për shkak se është kundër vendeve

të rezervuara në të gjitha instancat e pushtetit në Kosovë. Në përbërjen e re të Kryesisë së Kuvendit nuk është zgjedhur asnjë deputetë. Kështu ka qenë edhe në legjislaturat e kaluara, prej vitit 2001 e këndej. Të gjithë meshkuj. Nuk më erdhi mirë", ka thënë deputetja Brovina, e cila për një kohë ka qenë në krye të grupit joformal të grave deputete. Kryetari i rizgjedhur, Jakup Kransiqi, nga ana e tij është zotuar para deputetëve se do të punojë në fuqizimin e rolit përfaqësues dhe kontrollues të Kuvendit. "Gjatë udhëheqjes së Kuvendit në mandatin e katërt ju siguroj juve dhe qytetarët e Republikës së Kosovës se gjithçka do të jetë mbi bazën Kushtetutës dhe Rregullores së punës së Kuvendit ... Rëndësia e Kuvendit, në sistemin demokratik të Kosovës, konsiston në rolin e tij legjislativ, përfaqësues dhe në atë të kontrollit mbi institucionet që i zgjedh", ka deklaruar Krasniqi, duke iu uruar punë të suksesshme të gjithë deputetëve të rinj. Kuvendi i Kosovës ka qenë pa deputetë që nga nëntori i vitit të kaluar, kur edhe u pati shpërbërë, si rrjedhojë e rënies së Qeverisë së parë të pavarësisë. Rënia e Qeverisë ishte përkrahur nga vetë kryeministri, Hashim Thaçi, i cili, ndonëse nuk pati ofruar dorëheqje, u pati bërë apel të gjithë deputetëve që ta mbështesin mocionin e mosbesimit të Qeverisë, të ngritur nga Aleanca Kosova e Re. U pati arsyetuar se këtë veprim po e bënte për shkak të nevojës për shkurtrim të krizës institucionale në të cilën kishte rënë vendi, pas dorëheqjes së ish – presidentit, Fatmir Sejdiu, dhe largimit të LDK - së nga koalicioni qeverisës. Legjislatura e katërt ka sjellë një frymë pothuajse të re në Kuvend. Vetëm 26 deputetë shqiptarë kanë mundur t'i ruanin ulëset nga mandati i shkuar. Të tjerët që janë 69, në fund të mandatit të legjislaturës së tretë nuk kanë qenë pjesë e Kuvendit.

## DPA: Miliarderi i diskutueshëm për President të Kosovës

**"Nëse zgjidhet, Pacolli do të mund të jetë objekt i rrjedhjeve të 'vendosura me kujdes' në lidhje me bizneset e errëta të kompanisë së tij 'Mabetex' të kryera në Rusi, në kohën e Boris Jelcinit, kanë thënë diplomatë perëndimorë në Prishtinë", raporton DPA**

Diplomatë perëndimorë kanë paralajmëruar për rreziqet nga zgjedhja e Behgjet Pacollit për President të Kosovës, raporton agjencia gjermane e lajmeve DPA. "E kaluara kundërthënëse e Pacollit ka nxitur brengosje, jo vetëm në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Bashkimin Evropian, por edhe brenda vetë partisë së Thaçit", shkruan agjencia gjermane në raportin e saj për mbledhjen e së hënës të Kuvendit të Kosovës. "Nëse zgjidhet, Pacolli do të mund të jetë objekt i rrjedhjeve 'të vendosura me kujdes' në lidhje me bizneset e errëta të kompanisë së tij 'Mabetex', të kryera në Rusi në kohën e Boris Jelcinit" kanë thënë diplomatë perëndimorë në Prishtinë", raporton DPA. Sipas kësaj agjencie, votimi i Pacollit për President është pjesë më sfiduese për koalicionin e ri qeverisës se sa miratimi i Qeverisë së re. Edhe pse i vetëpasuruari për vite të tëra ka deklaruar se pasuria e tij arrin "vetëm" 450 milionë euro, ai është një miliarder dhe shqiptari më i pasur në botë. Tani pesë vjet pas hyrjes së tij në politikë, ëndrra e tij është realizuar dhe ai do të gjendet në kulm të shtetit më të ri evropian", shkruan DPA.

"Pa ujë dhe energji elektrike, ai është rritur në kushte të vështira në Kosovë, e pranon Pacolli, sipas protokollit. Si 17 - vjeçar ai ia del të shkojë në Hamburg, ku punon tre vjet në port. Pas një qëndrimi në Austri, ai shkon në Zvicër, dhe e themelon kompaninë ndërtimore "Mabetex". Për shkak të kërkesave të mëdha të "viteve të egra '90", ai e bën shpejt një pasuri përrallore, e cila te vendësit e tij e bën atë bamirës dhe ndihmës zemërgjerë të të varfërve", shkruan kjo agjenci. Agjencia shkruan se në Rusinë e Boris Jelcinit ai nënshkroi kontrata spektakulare sikur renovimin e Parlamentit, Operës dhe pothuajse të gjitha punët e Kremlinit. "Gjithashtu hotelet e para luksoze janë ndërtuar nga Pacolli. Mediat ruse njoftuan ditëve të fundit se si sipërmarrësi ka tërhequr vëmendjen e autoriteteve për zbatimin e ligjit, për korrupsion në shkallë të gjerë, shkruan kjo agjenci gjermane. Në shkrimin e DPA - së thuhet se në Rusi, e më vonë edhe në Zvicër, kushdo që hetonte shpëlarjen e të hollave të tij, gjithmonë arrinte vetëm një rezultat. "Edhe më mbresëlënëse ka qenë biznesi i Pacollit në Kazakistan, ku ai në masë të konsiderueshme ka bashkëpunuar në ndërtimin e kryeqytetit të Astanës. Me presidentin Nursulltan Nasarbajev, ai është mik i mirë, që nga koha kur ai e ka ndërtuar pallatin e tij. Që nga kjo kohë, thuhet se Pacolli ka marrëdhënie shumë të mira me njerëzit e industrisë së naftës. Ndërkombëtarisht u bë i njohur kur pothuajse i vetëm liroi 3 punëtorë të kidnapuar të OKB - së, në vitin 2004. Në vendlindjen e tij në Kosovë, babai i martuar dy herë, i katër vajzave dhe një djali, ka bërë emër duke i mbështetur financiarisht më të varfrit. Megjithatë, thuhet se ai nuk i ka bërë këto gjëra vetëm si altruist. Kritikët thonë se ka pasur parregullsi gjatë renovimit të ndërtesës së Qeverisë në vitin 2010 si dhe të Parlamentit shtatë vjet më parë", shkruan DPA.

Kuvendi ka zgjedhur Presidentin e vendit

---

## Pacolli President, shkelet Kushtetuta

---

**Behgjet Pacolli është zgjedhur President i Kosovës, në një seancë të jashtëzakonshme parlamentare, me kundërshtime të shumta, jo vetëm opozita, por edhe nga deputetët e partnerit të madh të koalicionit, PDK - së. Zgjedhja e tij President, gati se e ka çuar vendin edhe në një palë zgjedhje të jashtëzakonshme.**

Kuvendi i Kosovës, me praninë e vetëm 67 deputetëve në sallë, me 62 vota për, 7 kundër dhe 1 votë të pavlefshme, në raundin e tretë të votimit, ka zgjedhur për President të Republikës së Kosovës, Behgjet Pacollin, për një mandat pesëvjeçar. Në seancën parlamentare me sallë gjysmë të boshatisur, pasi opozita e kishte braktisur atë, në dy raundet e para të votimit, Pacolli, ka arritur të marrë vetëm 54 vota për, përkatësisht 58. Por duke parë se zgjedhja e presidentit po shkonte drejt dështimit, Partia Demokratike dhe kryetari i saj Hashim Thaçi, kërkuan ndërprerjen e seancës, për një konsultim pesë minutash, i cili zgjati për rreth një orë.

### Veprim kundërkushtetues

Ndërprerja e seancës në mes të raundeve të votimit, e ka nervozuar tej mase kryetarin e Kuvendit, Jakup Krasniqi, i cili ka thënë se kjo gjendje nuk i bën nder askujt dhe se ishte në kundërshtim me Kushtetutën e vendit, pasi po tentohej të bëhej presion mbi deputetët. Ta dini kërkesa për pauzë gjatë votimit të presidentit është shkelje e Kushtetutës dhe rregullores së Kuvendit, sepse kjo është një presion mbi deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe çdo ndryshim i rezultatit është i pa pranueshëm”, ka thënë Krasniqi. Në takimin e grupit parlamentar të PDK-së, gjatë pauzës në mes raundeve të votimit, është parë të hyjë edhe ambasadori i SHBA-ve në Kosovë, Christofer Dell dhe shefin e ICO-së Pieter Feith. Dhe kjo doli të kishte rezultate pasi pas kësaj pauze deputetët votuan në raundin e tretë dhe zgjodhën Behgjet Pacollin President të Kosovës. Me t'u zgjedhur Pacolli President, kryetari i Kuvendit uroi zgjedhjen e tij në krye të vendit, duke thënë se pauza ishte e suksesshme. "Pauza ishte e suksesshme", tha Krasniqi. Por, nuk ishte vetëm Krasniqi që reagoi ndaj kësaj pauze, pasi edhe shoqëria civile që monitoron punën e Kuvendit, ka shprehur shqetësimin e saj, duke thënë se gjatë votimit për president u shkel Kushtetuta dhe rregullorja e Kuvendit. Përfaqësuesi i KDI së që monitoron Kuvendin, Driton Selmanaj e ka quajtur shkelje daljen e deputetëve të PDK-së nga salla pa u dhënë leja nga kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, personi i autorizuar për zbatimin dhe interpretimin e Rregullores së punës të Kuvendit. "Vetë ndërprerja e mbledhjes është cenimi i lirisë së deputetit që të vendosë i papenguar dhe të përfaqësojë interesat e zgjedhësve", ka thënë Selmanaj.

## **Pacolli betohet, premton angazhim**

Ndërsa, me t'u zgjedhur President i Kosovës, Pacolli ka bërë edhe betimin para deputetëve të Kuvendit, dhe një fjalë rasti. Pacolli me këtë rast ka thënë se do të angazhohet fuqishëm në të gjitha fushat për të përmirësuar jetën e qytetarëve të Kosovës. **"Sot, unë kam marrë një detyrë jo të lehtë. Kam zgjedhur pajtimin dhe angazhimin kundrejt konfliktit dhe pasivitetit. Kam zgjedhur të punoj dhe angazhohem në këtë rrugë të domosdoshme për Kosovën dhe të ardhmen e saj"**, ka thënë Pacolli. Ai ka thënë se në këtë post do të përfaqësojë unitetin e qytetarëve. **"Unë ju garantoj se do të përfaqësoj interesat e të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa marrë parasysh bindjet politike. Institucioni të cilin përfaqësoj, do të garantojë unitet, stabilitet dhe jam tërësisht i dedikuar t'i shërbejë atij funksioni"**, është shprehur Pacolli.



*Fjalimi i Presidentit Behgjet Pacolli para antarëve të Kuvendit*

---

## Kaloi Krasniqi, sfidon Thaçi e Pacolli

---

**Jakup Krasniqi u rizgjedh kryetar i Legjislativit, ndërsa dy “arkitektët” e bashkëqeverisjes, Thaçi e Pacolli sfidohen sot para ligjvënësve e kosovarëve. Zgjedhja e presidentit, megjithatë është vënë në dilemë**

Sidoqoftë, pjesa e parë e seancës konstituive është drejtuar nga Flora Brovina, si deputetja më e moshuar e asistuar edhe nga deputetja më e re nga mosha, Biserka Kostiq. Pas verifikimit të mandateve, deputetët dhanë betimin, pastaj zgjodhën Jakup Krasniqin sërish për kryetar të Kuvendit, si dhe pesë nënkryetarët: Xhavit Halitin e PDK - së, Sabri Hamitin e LDK - së, Glauk Konjufcën nga Vetëvendosje, si dhe Petar Miletiq nga pakica serbe dhe Enis Kerman nga komunitetet joserbe. Gjatë betimit, deputetët e Vetëvendosjes kanë mbajtur mbi tavolinë nga një flamur kombëtar. Sidoqoftë, ata kanë pranuar të betohen dhe nënshkruajnë deklaratën. Në adresimin e tij të parë para legjislaturës së re, kryetari i rizgjedhur, Jakup Krasniqi, tha se Kuvendi do të ketë para vetes detyra dhe objektiva të cilat duhet realizuar gjatë mandatit të ardhshëm katërvjeçar. "Gjatë kësaj udhëheqjeje të Kuvendit në mandatin e katërt, ju siguroj juve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës se gjithçka do të jetë mbi bazën e Kushtetutës së Republikës dhe rregullores së punës të Kuvendit", tha Krasniqi. Menjëherë pas seancës së parë konstituive, Jakup Krasniqi thirri në mbledhje kryesinë e re të Kuvendit. Ai fillimisht paralajmëroi edhe mundësinë që pasdite të thirrej një seancë tjetër, në të cilën do të zgjidheshin presidenti dhe Qeveria e re e Kosovës. Por, doli që partitë e koalicionit, sidomos PDK - ja, si partia më e madhe, ende nuk ishte gati që të hynte në procedurat e votimit. Pas mbledhjes së Kryesisë, Krasniqi tha se PDK kishte kërkuar vazhdimin e seancës konstituive, por ajo tashmë ishte shpallur e mbyllur. Në pamundësi që të bëjë më shumë, Krasniqi i shpjegoi partisë se nga vjen zgjidhja tani mbetet tek thirrja e seancës së jashtëzakonshme. Nga ora 12:10 deri në 15:00 deputetët po prisnin hapat në vijim të PDK - së dhe partive partnere. Kryeparlamentari Krasniqi iu drejtua atyre duke u thënë se nuk ka kërkesë nga koalicioni për seancë plenare në të cilën do të votohej për presidentin dhe qeverinë e re. Por, më pas për sqarime para Kuvendit fjalën e mori nënkryetari i PDK - së, Hajredin Kuçi. Ai tha se PDK do të thërrasë seancën e jashtëzakonshme për të martën. "Ne kemi deponuar sot një kërkesë për mbledhje të jashtëzakonshme për të martën në ora 15:00 me këtë rend dite: zgjedhja e presidentit të Republikës së Kosovës dhe zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës", tha Kuçi. Në anën tjetër, opozita nga dita e parë e ka cilësuar këtë koalicion ende të pazyrtaizuar si qeveri në Kuvend, si koalicion të pakicës. Deputeti i LDK - së, Lutfi Haziri, tha se i propozuari për president, Behgjet Pacolli dhe qeveria e re Thaçi nuk do t'i kenë votat e LDK - së ngase ballafaqohen me krizë legjitimiteti. "Ne nuk do të bëjmë sehir në Parlament, ose votojmë kundër ose dalim jashtë, ky është qëndrimi ynë politik. Por, qeveria e pakicës dhe presidenti i pakicës sot e tutje do të kenë problem me legjitimitet dhe kjo ka me i përcjellë si hije", theksoi Haziri. Kundër mbështetjes së kandidaturës së Behgjet Pacollit për president dhe qeverisë së re Thaçi shprehet edhe Ardian Gjini, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. "Qëndrim i AAK - së është se nuk do të votojmë për president të Kosovës dhe definitivisht nuk do të votojmë për qeverinë e ardhshme të Kosovës. Nuk do të marrim pjesë fare në votim", tha Gjini.

## **Prokuroria e Zvicrës: Pacolli i pastër juridikisht**

Gazetarja e gazetës zvicerane "NZZ", Barbara Hofman, e cila në artikullin e saj në ditën e diel, 20 shkurt, kishte shkruar se Behgjet Pacolli ka qenë nën hetime deri në vitin 2008, shkrim të cilit i janë referuar disa medie në Kosovë, ka pranuar "gabimin e saj të madh në artikullin që ka shkruar. Por, sipas burimeve të "Epokës së re", Hofman, pas verifikimit të informacioneve (edhe pse pas botimit të artikullit), ka kuptuar se gjithçka që i përket punës së Prokurorisë ndaj Pacollit ka përfunduar në vitin 2001 dhe jo në vitin 2008 siç ka shkruar të dielën. Hofman nuk ka ndonjë shpjegim për këto gabime, ndërsa "Epoka e re" ka marrë vesh se Hofman ka shprehur keqardhjen ndaj, së paku, një mediumi kosovar që i është referuar artikullit të saj

PRISHTINË, 21 SHKURT - Kandidati i koalicionit qeverisës për president të Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, asnjëherë nuk ka qenë zyrtarisht nën hetime nga autoritetet e drejtësisë zvicerane. As bizneset e tij asnjëherë nuk kanë pasur ndonjë kufizim ligjor në kryerjen e aktiviteteve biznesore. Këtë e ka konfirmuar vetë Pacolli duke ofruar si dëshmi dy zyrtarë që autoritetet zvicerane i kanë dërguar Pacollit, të cilat i përgënjeshtrojnë shkrimet e shumta nëpër medie të ndryshme, kinse hetime ndaj Pacollit ka pasur deri në vitin 2008. Dokumenti i parë që vërteton pastërtinë juridike të Pacollit i takon datës 14 mars të vitit 2000 (shih faksimilen 1). Sipas këtij dokumenti, të nënshkruar nga zëvendësprokurori i përgjithshëm i Zvicrës, Felix Banziger, Pacollit dhe firmës së tij. "Mabetex nuk ka pasur asnjëherë ndonjë çështje të hapur kriminale. Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm të Zvicrës nuk ka ndonjë çështje të hapur kriminale ndaj Mabetex - it e as ndaj zotit Behgjet Pacolli. Po ashtu ne konfirmojmë se, sipas dijenisë sonë, kjo kompani nuk ka ndonjë ndalesë në zhvillimin e bizneseve", thuhet në letrën e organizimit më të lartë të ndjekjes në shtetin zviceran. Ndërsa në letrën e dytë, të cilën Pacollit ia dërgon vetë prokurori i përgjithshëm, Bernard Bertossa, konfirmohet fakti se "Mabetex" -i asnjëherë nuk ka përbërë objekt hetimi për hetuesinë zvicerane (shih faksimilen 2). "Shoqëria juaj nuk ka përbërë kurrë objekt hetimi penal sepse, sipas ligjit zviceran, personat moralë nuk mund të përbëjnë objekt hetimi", thuhet në letrën e prokurorit të përgjithshëm të Zvicrës, Bertossa. Sa i përket Pacollit, prokurori i përgjithshëm nëpërmjet kësaj letre konfirmon se: "Për sa i takon presidentit tuaj, Pacollit, ju konfirmoj se veprimet hetimore ndaj tij janë mbyllur me urdhëresën e 4 marsit të vitit të shkuar (2001 vj) për motivet që parashtrohen në atë vendim. Kjo do të thotë se i lartpërmenduri nuk përbën më objekt veprimesh hetimore dhe se çështja që lidhet me të është përmbyllur", thuhet në fund të letrës së Prokurorisë së Përgjithshme helveteke.

### **Gazetarja zvicerane: Kam gabuar për Pacollin**

Gazetarja e gazetës zvicerane "NZZ", Barbara Hofman, e cila në artikullin e saj në ditën e diel, 20 shkurt, kishte shkruar se Behgjet Pacolli ka qenë nën hetime deri në vitin 2008, shkrim të cilit i janë referuar disa medie në Kosovë, ka pranuar "gabimin e saj të madh në artikullin që ka shkruar. Por, sipas burimeve të "Epokës së re", Hofman, pas verifikimit të informacioneve (edhe pse pas botimit të artikullit), ka kuptuar se gjithçka që i përket punës së Prokurorisë ndaj

Pacollit ka përfunduar në vitin 2001 dhe jo në vitin 2008 siç ka shkruar të dielën. Hofman nuk ka ndonjë shpjegim për këto gabime, ndërsa "Epoka e re" ka marrë vesh se Hofman ka shprehur keqardhjen ndaj, së paku, një mediumi kosovar që i është referuar artikullit të saj.



---

## **PDK - ja s'është unike për Pacollin**

---

**Behgjet Pacolli ka marrë mbështetjen e 64 deputetëve për t'u bërë president shteti. Mirëpo, burime brenda PDK - së, nuk e përjashtojnë mundësinë që disa prej deputetëve, edhe pse e kanë nënshkruar nominimin e tij për president, do të votojnë kundër zgjedhjes së tij në këtë post. Në fakt, as vetë Pacolli nuk është i sigurt nëse do të marrë mbështetje të mjaftueshme për t'u vënë në krye të shtetit**

Edhe vetë Pacolli është deklaruar të mos jetë në dijeni nëse i ka votat e mjaftueshme për t'u vënë në krye të shtetit. "Nuk e di. Po ta dija edhe do t'ju tregoja", ka thënë ai, pak kohë pasi ka dhënë betimin për deputet. Lideri i PDK - së, Hashim Thaçi, para dy ditësh ka mohuar që brenda partisë së tij ka deputetë që mund të mos e votojnë Pacollin për president, duke thënë se çdo qëndrim që është marrë në PDK për ndërtimin e koalicionit qeverisës dhe për votimin e presidentit, ka qenë konsensual. Atë ditë edhe Pacolli qe treguar më optimist. "Unë besoj se përfaqësuesit e popullit të Kosovës do të votojnë për zgjedhjen time si president të Kosovës dhe unë prej momentit që ia filloj punës do të filloj implementimin e të gjitha obligimeve që parashihen me Kushtetutë", ka thënë Pacolli. Në bazë të Kushtetutës, parashihet që votimi për presidentin të jetë i fshehtë dhe të zhvillohet deri në tri raunde. Në dy raundet e para kërkohet që kandidati për president t'i marre 81 vota për t'u konsideruar i zgjedhur. Dhe nëse nuk arrin ta marrë mbështetjen e 2/3 së Kuvendit, atëherë kalon në raundin e tretë, ku i nevojitet të marrë së paku 61 vota. Dështimi në raundin e tretë, e dërgon vendin në zgjedhje të parakohshme. Ato duhet të organizohen brenda afatit 45 ditësh. Sipas burimeve të gazetës, partnerët e koalicionit e kanë parasysh rrezikun e dështimit të Pacollit në dy raundet e para, dhe për këtë shkak janë duke e përgatitur skenarin për t'iu shmangur zgjedhjeve të reja. "Nëse në dy raundet e para shihet se Pacolli nuk është duke e marrë mbështetjen e shumicës parlamentare, atëherë ka gjasa që të ndërpritet procesi i votimit në raundin e tretë", ka thënë burimi i gazetës. Në këso rrethanash, sipas tij, partnerët e koalicionit do të duhet të shqyrtojnë mundësitë e ofrimit të një kandidati tjetër. Pacolli aktualisht është i vetmi kandidat që zyrtarisht është nominuar për president. Por për t'u pranuar kandidatura e tij në Kuvend, do të duhej të sillte dëshmi se i plotëson kriteret për të qenë kryetar shteti. Ligji për presidentin e parasheh që kandidati për president të jetë shtetas i Kosovës, të ketë së paku 35 vjet, si dhe të ketë pasur banim të përhershëm në Kosovë për së paku dhjetë vjet. Pretendenti për president ka nënshtetesi të dyfishtë: zvicerane dhe kosovare. As me Kushtetutë e as me ligj nuk është e definuar nëse presidenti mund të jetë qytetar lojal" i dy shteteve njëkohësisht, ndonëse, Ligji për shtetësinë, nuk paraqet pengesa që qytetari i Kosovës të ketë një e më shumë nënshtetësi. Pacolli do të duhej së paku që të ofronte dëshmi se është mbi 35 vjeç dhe se ka pasur banim të përhershëm në Kosovë, aq sa kërkohet me ligj. Fillimisht në seancën e së martës duhet të bëhet zgjedhja e presidentit, në mënyrë që t'i hapet rruga votimit të Qeverisë së re. Partitë politike opozitare, të hënën, veç janë deklaruar se nuk do ta votojnë as presidentin e as Qeverinë. Nga subjekti më i madh opozitar, Lidhja Demokratike e Kosovës, është thënë se Grupi parlamentar i kësaj partie e konsideron këtë Qeveri si "qeveri të pakicës" dhe me këtë nuk do ta votojë atë. Zyrtari lartë i LDK - së, Lutfi Haziri, gjatë një paraqitjeje për medie nga Kuvendi i Kosovës, ka vlerësuar se Qeveria që pritet të formohet nga PDK - AKR- lista "Dr. Ibrahim Rugova" dhe parti të

pakicave, "është Qeveri e pakicës politike, madje më keq, edhe e pakicës etnike". "Në këtë mënyrë do të jenë pakicë edhe në popullatë", ka thënë Haziri. Kundër votimit të Qeverisë dhe presidentit është shprehur edhe Ardian Gjini i AAK - së. "Qëndrimi i AAK - së është se nuk do të votojmë për president të Kosovës dhe definitivisht nuk do të votojmë për Qeverinë e ardhshme të Kosovës. Ne nuk do të marrim pjesë fare në votim", ka deklaruar Gjini. Ai ka përjashtuar edhe mundësinë që AAK - ja të dalë me një kundërkandidat për president. "Me siguri se jo", ka thënë shkurt Gjini. Kundër zgjedhjes së Pacollit president, janë deklaruar edhe deputetët e lëvizjes "Vetëvendosje". "Ne e kemi bërë të qartë edhe më herët se zoti Pacolli, si kryetar i AKR - së, por edhe si Behgjet Pacolli, në deklaratimet e tij publike ka treguar se do të angazhohet për një program politik dhe për një të ardhme politike të Kosovës për të cilën ne jemi absolutisht kundër. Prandaj, meqenëse jemi kundër programit që ai e përfaqëson dhe meqenëse jemi kundër proceseve politike, të cilat ai i ka përfaqëuar ne natyrisht se jemi edhe kundër tij dhe nuk do ta votojmë", ka thënë deputeti Visar Ymeri. Pavarësisht qëndrimeve të opozitës, nënkryetari i Aleancës Kosova e Re, Ibrahim Makolli, është shprehur optimist se Kosova do të bëhet me institucione të martën. "Mbledhja e nesërme do të rezultojë me krijimin e institucioneve të reja", ka thënë ai.

---

## **Biznesmeni që realizoi ëndrrën të bëhet president**

---

**Shqiptari për të cilin thuhet se është më i pasuri, ka një biografi të bujshme të përshkruar me episode kontradiktore - prej të qenit humanitar dhe filantrop, deri te dyshimet për korrupsion e shpëlarje parash, në një miqësi të fortë me shtetin armiqësor të Kosovës - Rusinë**

PRISHTINË, 22 SHKURT - (KTV) Nga Mareci, nëpërmjet Hamburgut, Luganos, Moskës dhe Astanas, Behgjet Pacolli ka realizuar të martën ëndrrën e tij të madhe - është bërë president i Kosovës. Por, shqiptari për të cilin thuhet se është më i pasuri, ka një biografi të bujshme të përshkruar me episode kontradiktore - prej të qenit humanitar dhe filantrop, deri tek dyshimet për korrupsion e shpëlarje parash, në një miqësi të fortë me shtetin armiqësor, të Kosovës – Rusinë. Në shumë intervista ka thënë se si 17 - vjeçar ka shkuar në Hamburg të Gjermanisë, ku ka fjetur në stacion treni, dhe nuk ka pasur bukë për të ngrënë. Pastaj ka larë pjata e ka pastruar për tu kthyer sërish në Jugosllavi, për të shërbyer në ushtri, dhe pranë Titos, për të cilën kohë krenohet. Pastaj shkon në Austri, ku punoi si shitës në një kompani tekstili. Pasi thotë të ketë pasur sukses atje, shkoi në Rusi për të punuar në një kompani zvicerane, dhe për pak kohë u bë drejtor i përgjithshëm deri në vitin 1990, prej nga thotë se u largua për shkak të xhelozisë së gruas së shefit të madh. Dhe, kështu lindi kompania "Mabetex" - një kombinim fjalësh për Marec - Behgjet dhe Textil. E nisur si kompani e vogël, Behgjet Pacolli me "Mabetex" -in arriti të bëhet miliarder me investimet e bëra kryesisht në ish Bashkimin Sovjetik, në Rusinë e tashme. Lidhur me shpejtësinë në të cilën ai u pasurua, u hap edhe hetimi nga prokuroria e Gjenevës, e cila deri në vitin 2000 bëri hetime ndaj tij. Hetimet u ndërprejnë për shkak të mosbashkëpunimit të prokurorisë së Rusisë me atë zvicerane. Pacolli bëri bujë edhe me lidhjet e tij martesore. Ishte i martuar për tre vjet me këngëtareshen e njohur italiane, Anna Oxa. Ka 5 fëmijë, 2 nga martesja e parë (me Ana Oxën nuk pati fëmijë), dhe tre fëmijë i ka me gruan Mashën. Në vitin 2004 ai, personalisht udhëtoi për në Afganistan, ku ndihmoi në lirin e kosovares së rrëmbyer Shqipe Hebibi. Pacolli gjithashtu është themelues i shumë fondacioneve humanitare. Në vitin 2006 u kthye në Kosovë për të nisur karrierën politike për të formuar Aleancën Kosova e Re e cila e bëri president të Kosovës. Gjatë kohës së tij në opozitë, më shumë u cilësua si ndihmës i planeve qeveritare sesa zë i fuqishëm opozitë. Po kundër kësaj Qeverie ngriti mocion mosbesimi, duke e rrëzuar në fund të vitit të kaluar. Lidhi koalicion me PDK - në e Hashim Thaçit për ta sjellë në krye të shtetit të Kosovës. Opozita hiç më larg se pas zgjedhjes president e akuzoi se e ka blerë postin e presidentit, ndërsa akuzoi edhe Hashim Thaçin se ka bërë pazare me Pacollin për ta bërë Qeverinë. Behgjet Pacolli do të përfaqësojë unitetin e popullit të Kosovës për 5 vjetët e ardhshëm, ashtu siç e përcakton Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

---

## **Pacolli President, festë në Rrugët e Prishtinës**

---

Me të marr postin e presidentit të Republikës së Kosovës nga Kuvendi, përkrahësit e Behgjet Pacollit ia kanë mësyre veturave të tyre, duke shfaqur haptazi gëzimin nëpër rrugët e Prishtinës që Pacolli do të jetë në krye të shtetit për 5 vitet e ardhshme. Përveç lëvizjeve me vetura, në selinë e AKR-së janë hedhur edhe një numër i madh i fishekzjarreve. Behgjet Pacolli është zgjedhur president i Kosovës, pasi mori 62 vota të deputetëve pas raundit të tretë të votimit.

---

## Votova kundër Pacollit

---

**Fatmir Limaj, nënkryetar i Partisë Demokratike të Kosovës ashtu edhe sikur premtoi një ditë më parë, ka bërë publike votën e tij për kandidatin për president të Kosovës, Behgjet Pacollin. Ai tha se ka votuar kundër, pasi kjo zgjedhje sipas tij, është bërë pa vullnetin e qytetarëve të Kosovës**

Fatmir Limaj, numri dy i Partisë Demokratike të Kosovës, ka bërë publike votën e tij të dhënë kundër kandidaturës së Behgjet Pacollit për president të Republikës së Kosovës. "Ashtu si edhe ju premtova, që thashë që votën time do ta bëj publike pasi të përfundojë i gjithë procesi, po e ndiej për obligim që edhe para jush, por edhe para qytetarëve të Republikës, para votuesve të mi, unë nuk kam votuar për Behgjet Pacollin për president, kjo është ajo që kam premtuar që do ta them, unë nuk kam abstenuar, por kam votuar kundër ka thënë Limaj.

### **E kanë ditur qëndrimin tim**

Ai me këtë rast ka konfirmuar që vota e tij e cila ka qenë kundër Pacollit, nuk ka qenë e ndikuar nga askush dhe se për këtë nuk ka pasur asnjë presion nga dikush që të ndryshojë mendim. "Për hir të sinqeritetit po ju them që absolutisht nuk ka kërkuar askush që të ndryshojë mendimin për të votuar, pasi sigurisht e kanë ditur që unë nuk tërhiqem, nuk ka kërkuar askush për një gjë të tillë nga unë", ka thënë Limaj. Ndërkaq, ai tha se as edhe gjatë takimit 5 minutash të kërkuar pas votimit të dytë për president nga ana e grupit parlamentar të PDK-së nuk ka pasur presion, por Limaj nuk ka dashur që të komentojë nëse në takim ka pasur presione ndaj të tjerëve. "Këtu nuk kam koment" është shprehur Limaj. Limaj gjithashtu konfirmoi që presion nuk ka pasur as edhe nga ndërkombëtarët, pasi siç tha ai as që ka pasur ndonjë komunikim me ta sa i përket kësaj çështjeje. "Jo nuk kemi pasur presion. Absolutisht dhe as që kam komunikuar për këtë punë. Vota është e shenjtë, ju e dini se ne kemi obligim ndaj atyre që na kanë votuar, nga askush nuk ka pasur presion, prandaj edhe unë ju shpalosi votën time", ka thënë ai. Sa i përket deklaratës së kryeparlamentarit Krasniqi, që kërkesa për pauzë nga grupi Parlamentar i PDK-së është akt kundër kushtetues, Limaj nuk ka dashur që të komentojë asgjë, duke thënë se kjo i përket vetëm kryetarit të Parlamentit, i cili duhet të japë një sqarim lidhur me këtë çështje.

### **Ky s'ka qenë vullnet i qytetarëve**

I pyetur nga gazetarët se a ndihet krenar me të gjitha ato që ndodhën gjatë seancës dhe votimi i presidentit Behgjet Pacolli, Limaj ka thënë se ky nuk ka qenë vullnet i qytetarëve të Kosovës dhe se ka qenë kjo njëra ndër arsytet që ia ka dhënë votën kundër. "Nuk është me rëndësi a jam unë, por unë e di një gjë, ky nuk ka qenë vullneti i qytetarëve të Kosovës. Jam tërësisht i bindur se kjo është jashtë vullnetit të qytetarëve të Kosovës dhe duke qenë i bindur në këtë, për këtë edhe kam dhënë votën time kundër zgjedhjes së presidentit", tha Limaj. Ndërkaq, i pyetur nga ajo që u pa sot a kanë filluar përçarjet brenda PDK-së për mënyrën se si u votua, Limaj ka thënë se ajo ishte një shprehje e demokracisë. "Kjo është demokracia në Kosovë, për mendimin tim, ju sot keni parë, bile sot jam ndier sigurisht shumë mirë që ka pasur një zhvillim demokratik brenda për brenda, me thënë të drejtën unë jam pak i befasuar në kuptimin pozitiv dhe nga demokracia nga mendimi ndryshe nuk guxon askush të obligohet, ajo pasuron dhe ndihmon

zhvillimin e vendin tonë, kushdo që frikësohet ose ndihet i kërcënuar nga demokracia, atëherë e ka gabim", ka thënë Limaj.

---

## Për 5 minuta

---

**Pas dy rrethanave të votimit, Pacolli nuk kishte gjasa të bëhej president. Por, ishte Hashim Thaçi, ai cili disiplinoi deputetët e PDK gjatë një pauze me dyer të mbyllura dhe ndikoi që të zgjidhet presidenti dhe qeveria e re.**

PRISHTINË - Me shumicë minimale të votave, Kuvendi i Kosovës ka zgjedhur presidentin dhe qeverinë e re. Pas tre rrathëve të votimit dhe me ndërhyrjen e Hashim Thaçit, që nga Jakup Krasniqi u interpretua si antikushtetuese dhe ndikim në votim, Behgjet Pacolli mori mandatin pesëvjeçar në postin e presidentit të Kosovës, përdërisa qeveria e koalicionit PDK - AKR, Lista "Ibrahim Rugova" dhe pakicat, mori mandatin qeverisës për katër vjetët e ardhshme. Presidenti i ri Pacolli, u betua se do të ruajë tërësinë territoriale dhe sovranitetin e Kosovës. Nga posti i presidentit, Pacolli tha se do të vazhdojë vizionin e presidentit të ndjerë Ibrahim Rugova dhe komandantit të UÇK - së, Adem Jashari. Ai u zotua se do të jetë president i të gjithë qytetarëve pavarësisht përkatësisë etnike duke garantuar të drejtat dhe liritë e njeriut. "Do të punoj për ruajtjen e integritetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës, për barazinë mes shqiptarëve dhe komuniteteve tjera etnike si dhe respektimin e të drejtave të të gjithë kosovarëve pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fetare, gjinore apo racore", tha Pacolli .

### **Krasniqi akuzon Thaçin për shkelje të Kushtetutës**

Votimi, për presidentin dhe qeverinë e re është përcjellë me bojkotimin e opozitës. LDK, "Vetëvendosje" dhe AAK lëshuan seancën duke e cilësuar Pacollin si një personalitet jo të denjë për presidentin e Kosovës, kurse koalicionin e ri qeverisës si koalicion i interesave të liderëve të PDK - së dhe AKR - së. Po ashtu, votimi nuk kaloi pa tensione as te partitë partnere, sidomos te Partia Demokratike e Kosovës. Në dy raundet e para të votimit, nga 67 deputetët sa ishin të pranishëm, Pacolli mori 54, përkatësisht 58 vota. Këto vota nuk i mjaftonin atij që të zgjidhej president. Atëherë, ka ndërhyrë kryeministri Hashim Thaçi dhe zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi. Ky i fundit kërkoi pauzë, ndërsa votimi po vazhdonte. "Grupi parlamentar i PDK - së ka nevojë për një pauzë pesëminutëshe", tha Kuçi. Kjo ndërhyrje, u cilësua nga kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi si antikushtetuese, në kundërshtim me rregulloren e punës së Kuvendit dhe presion ndaj deputetëve për të votuar lirshëm. "Unë po i jap pesë minuta pauzë, por ta dini që kjo është shkelje e rezultatit, e kushtetutës dhe e rregullores së punës së Kuvendit. Çdo ndryshim i rezultatit është i papranueshëm dhe është thjesht presion mbi deputetët", tha Krasniqi. Pesë minutat e kërkuar nga Thaçi kanë zgjatur rreth 50 minuta pauzë ku Thaçi mblodhi deputetët e PDK - së në një takim urgjent prapa dyerve të mbyllura. Pas pauzës, pasoi votimi në rrethin e tretë, i cili rezultoi me zgjedhjen e Pacollit në postin e presidentit të Kosovës. Rezultati u lexua nga deputeti i PDK - së, Memli Krasniqi. "Në votim kanë marrë pjesë 67 deputetë. Por kanë votuar 62 deputetë. Kundër kanë votuar 4 deputetë dhe një fletëvotim është i pavlefshëm. Në bazë të rezultateve të votimit konstatohet se Behgjet Pacolli është zgjedhur president i Republikës së Kosovës", tha Memli Krasniqi. I pakënaqur me ndërhyrjet në procesin e votimit nga ana e partisë të cilës i përket, kryeparlamentari Jakup Krasniqi ka përdorur edhe ironinë pas shpalljes së rezultatit, i cili kësaj radhe dallonte nga dy raundet e para. "Pauza ishte e suksesshme", u shpreh kryetari i Kuvendit.

## **Qeveria mandatohet me 65 vota**

Zgjedhja e presidentit u pasua me votimin e qeverisë së re të kryeministrit Hashim Thaçi. Qeveria e re u zgjodh me 65 vota për dhe një kundër. I rizgjedhuri në postin e kryeministrit, Hashim Thaçi u zotua për një qeverisje të mirë, që do t'i sjellë Kosovës zhvillim ekonomik, demokratizim të brendshëm dhe perspektivë euroatlantike. "Nëse mandati ynë i parë ishte shpallja e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran, njohjet që arritën numrin 75, konsolidimi dhe forcimi i shtetit tonë, ne do të vazhdojmë tani me reformat e thella demokratike. Mandati i parë pra ishte mandati i pavarësisë e mandati i dytë do të jetë mandati i Kosovës evropiane" tha Thaçi. Ndryshe, mbledhja e djeshme ka filluar me 93 deputetë dhe ka përfunduar me 67 të pranishëm, pasi që në sallë mungonin deputetët e LDK - së, të cilëve më pas iu bashkuan edhe ata të "Vetë vendosjes" dhe AAK - së. Në emër të LDK - së, deputeti i vetëm në sallë nga ky subjekt, Ismet Beqiri tha se partia e tij ka vendosur që të mos marrë pjesë në votim pasi zgjedhjet ishin të manipuluar dhe nuk krijojnë legjitimitet për institucionet e reja. Manipulimet, sipas tij, kishin si adresë Partinë Demokratike të Kosovës. Kurse marrëveshja për koalicionin, sipas Beqirit, nuk është në interes të Kosovës, por në interes të liderëve të të dyja partive të këtij koalicioni. Pas arsytimit, edhe ai lëshoi sallën. Më pas ngjashëm vepruan edhe partitë tjera opozitare. Në emër të "Vetëvendosjes" foli deputeti Visar Ymeri. Sipas tij, Pacolli nuk është personalitet i përshtatshëm për postin e presidentit. Ai tha se Pacolli dhe partia e tij kanë qenë instrument në duart e Hashim Thaçit. Pacolli ndihmon Thaçin në politikë, kurse Thaçi e shpërblen Pacollin me tenderë, tha Ymeri. Ndërkaq, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini tha se edhe kjo parti politike nuk do ta votojë as presidentin dhe as koalicionin qeverisës, pasi që ky koalicion është vlerësuar se nuk është në interes të Kosovës. Me arsytimet e dhëna, LDK, "Vetëvendosje" dhe AAK, lëshuan seancën dhe u larguan nga Kuvendi. Sidoqoftë, Kuvendi vazhdoi punimet pasi që kishte kuorum dhe se në sallë kishte 67 deputetë. Pas konstituimit të Kuvendit një ditë më herët, me zgjedhjen e presidentit dhe qeverisë përmbillet cikli i konstituimit të institucioneve të reja të Kosovës, të dala nga zgjedhjet e 12 dhjetorit.

## **Thaçi: Konstituim demokratik i Institucioneve**

Pas përfundimit të seancës maratonike, kryeministri i rizgjedhur Hashim Thaçi ka mbajtur një konferencë për media, në të cilën e ka konsideruar triumf të demokracisë atë që ka ndodhur të martën në Kuvendin e Kosovës. Thaçi ka thënë se kjo ka qenë një kthesë e rrugëtimit të Kosovës evropiane dhe demokratike. Ai ka mohuar pretendimet se ka pasur presion ndaj deputetëve për të votuar për zgjedhjen e Behgjet Pacollit për president. Ai ka thënë se kjo zgjedhje është produkt i votës së fshehtë dhe vendim i vetë deputetëve të Kuvendit. "Sot të gjithë deputetët që kanë marrë pjesë në Kuvend iu kanë përgjigjur vullnetit të qytetarëve të Kosovës për ta nxjerrë vendin nga kaosi, ku të tjerët e futën në zgjedhjet e parakohshme e që i humbën pastaj edhe zgjedhjet", ka thënë ai. Rreth mënyrës së zgjedhjes së Pacollit, Thaçi ka thënë se çdo zgjedhje e përfaqësuesve legjitim të popullit, i kaluar në një proces transparent është legjitim dhe legal. "Ky vend është qeverisur më herët nga njerëz që nuk e kanë fituar as edhe një votë", ka thënë Thaçi. Kurse, rreth presioneve ndërkombëtare, Thaçi ka falënderuar Shtetet Bashkuara të Amerikës dhe të gjitha vendet e Bashkimit Evropian në procesin e tyre mbështetës për konsolidimin dhe forcimin e shtetit tonë. Ndërsa, më pas, një konferencë për media e ka zhvilluar edhe nënkryetari i PDK - së , Fatmir Limaj, i cili ka bërë publike votën e tij kundër zgjedhjes së Behgjet Pacollit, për president të Kosovës. Ai ka mohuar të jetë përballur me presione nga Thaçi dhe faktorët ndërkombëtarë për të ndryshuar qëndrimin. Kurse, rreth qëndrimeve të ndryshme brenda PDK - së, rreth zgjedhjes së Pacollit, Limaj ka thënë se



mendimi ndryshe brenda PDK - së është pjesë e demokracisë dhe askush nuk duhet të frikësohet nga kjo. Por, ai ka insistuar se zgjedhja e Pacollit për president nuk është në përputhje me vullnetin e qytetarëve të Kosovës. "Ky nuk ka qenë vullneti i qytetarëve të Kosovës. Jam tërësisht i bindur se kjo është jashtë vullnetit të qytetarëve dhe duke qenë i bindur në këtë, kam dhënë votën time kundër zgjedhjes së presidentit", ka thënë ai.

### **Shoqëria civile i quan antikushtetuese zhvillimet në Kuvend**

Përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, të cilat monitorojnë punën e Kuvendit, e kanë quajtur antidemokratike mënyrën se si është zhvilluar seanca, ku janë zgjedhur presidenti dhe Qeveria e Kosovës. Zyrtarë të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), të cilët gjatë ditës së martë kanë monitoruar punën e Kuvendit në një konferencë për media vlerësuan se në seancën e jashtëzakonshme, ku është paraparë zgjedhja e presidentit është shkelur Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit. Driton Selmanaj nga KDI - ja ka thënë se dalja nga salla e Kuvendit, e deputetëve PDK - së pa lejen e kryeparlamentarit Jakup Krasniqi, është shkelje e rregullores. Por, sipas tij, gjatë procesit të votimit për presidentin janë bërë dy lloj shkeljesh. "E para ka të bëjë me shkeljen e rregullores së punës, sepse kryetari i Kuvendit është autoriteti i fundit që interpreton rregulloren e punës së kuvendit dhe i cili kujdeset për mbarëvajtjen e tërë procesit brenda seancës. Ndërkohë që patëm një sjellje jo të mirë nga ana e Grupit parlamentar të PDK - së, e cila në mënyrë demonstrative del nga salla dhe e lëshon mbledhjen duke thënë se kërkon pauzë", ka thënë Selmanaj. Kurse, sipas tij, aspekti tjetër ka të bëjë me shkeljen e Kushtetutës së Kosovës, për shkak të presioneve që mendohet se janë bërë mbi deputetët e PDK - së, disa prej të cilëve më pas votuan pro zgjedhjes së Pacollit. Avni Zogiani nga Organizata "Çohu" e ka konsideruar dhunim të Kuvendit të Kosovës, mënyrën se si kryeministri Thaçi e ka imponuar rrjedhën e seancës të së martës. Sipas tij, ky veprim është në vazhden e Thaçit në dhunimin e institucioneve. "Këtë po e arrin para së gjithash me përkrahjen e ndërkombëtarëve, të cilët mezi po presin që ai të marrë vulën e qeverisë në dorë dhe t'iu nënshkruajë kontratat që i ka lënë nëpër tavolina. Me këtë përkrahje Thaçi po i dhunon institucionet, votën e popullit dhe demokracinë në Kosovë, ka thënë Zogiani.

### **Pacolli merr urimet e para**

Sapo parlamenti e votoi për president Behgjet Pacollin, ai mori telefonatat e para të urimit nga homologë apo personalitete ndërkombëtare. I pari që e ka telefonuar atë, ka qenë presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi. Kurse, në zyrën e tij, Pacolli mori urimet më të mira për detyrën e tij të re dhe nga shefi i ICO - së, Pieter Feith. Ai ka marrë urime edhe nga ish - presidenti kroat Stipe Mesiç, ish - presidenti i Shqipërisë, Rexhep Meidani dhe shumë personalitete të tjera publike nga vendi dhe bota. Kurse, menjëherë pasi u votua nga Kuvendi, Behgjet Pacolli dha dorëheqjen nga të gjitha detyrat partiake në krye të AKR - së dhe anëtarësia në këtë parti.

---

## Pacolli: Do të fitoj si president

---

"Unë që nga ky moment mendoj ndryshe. Karvani im do të ecë përpara dhe kjo që nuk është sfida e parë por sfida e radhës, do ta kaloj në mënyrë brilante dhe nga posti i presidentit do t'ia filloj ose do të vazhdoj kontributin tim për qytetarin tim, për popullin tim".

### Behgjet Pacolli

Biznesmeni më i njohur i Kosovës dhe kryetari AKR-së, Behgjet Pacolli, në një intervistë ekskluzive për BBC-në thotë se është befasuar me sulmet dhe shpifjet që i janë bërë atij, menjëherë pas kandidaturës për president të vendit. Ai thotë se grupe të caktuara, me gjasë për interesa të veta, kanë filluar një fushatë shpifjesh. Pacolli shpreh shpresën se sot do të votohet për president të vendit dhe thotë se është i përcaktuar të punojë për interesat e Kosovës dhe të qytetarëve të saj. I pyetur për ndjenjat që e përshkojnë para procesit të votimit, Pacolli tha: **Për mua sot është një ditë e mrekullueshme. E mrekullueshme sepse po më jepet një rast shumë i madh që t'i dal në krahë popullit tim, që edhe më tepër të kujdesem për popullin tim. Kjo duke e ditur që si përfaqësues i këtij institucioni shumë të lartë do të më hapen mundësi të reja për ta bërë një gjë të tillë.** Ai tha më pas se është jashtëzakonisht krenar, pse është i përzgjedhur dhe i nominuar si kandidat për president të ardhshëm të Kosovës. **"Së pari jam me fat dhe i falënderoj miqtë e mi, falënderoj votuesit e Kosovës, bashkëmendimtarët që mendojnë si unë, por edhe njerëzit të cilët më kanë vlerësuar dhe më kanë gjykuar drejt, i tillë çfarë jam. Të kandidosh për postin e presidentit të shtetit më të ri në botë, është një gjë e mrekullueshme"**, tha Pacolli. I pyetur për akuzat e bëra në adresë të tij në disa media dhe kritika nga disa parti, Pacolli tha se çdo herë kur ndodhin ngjarje të tilla, ato shoqërohen edhe me disa histori ose storie. **"Nëse është storie e suksesit, edhe në botën moderne, ai shpesh herë nuk falet. Prandaj jam i bindur se në rastin tim, opinionin publik është i ndarë në dy kampe. Një kamp që më mbështet fuqishëm e që përbëhet nga njerëzit që më njohin, njerëzit me të cilët kontaktoj dhe njerëzit të cilët m'i njohin veprat, shpirtin dhe mënyrën e jetës sime. Kurse kampi tjetër mund të përbëhet nga njerëz të cilëve ndoshta iu pengon prezenca ime, të cilëve mund t'iu kem zënë rrugën, ose mund t'iu kem marrë atë që ata mund ta konsiderojnë hisë të tyre, ose më në fund ata të cilët nuk më njohin"**. Ai tha se është i bindur se ky proces do të përmbyllet në favor të drejtësisë dhe do të zgjidhet president. I pyetur nëse z. Pacolli e ka imagjinuar një përballje me kritika të ashpra dhe me akuza përfshirë "një lloj afrie edhe me Serbinë dhe me Rusinë", ai tha se këtu po ndodhë një ngjarje që nuk është e vogël hiç. **"Këtu janë rreshtuar njerëzit "pro dhe kundra". Unë sigurisht se nuk e kam paraparë se kundërshtimet mund të jenë edhe të këtij intensiteti"**, tha ai. Pacolli tha se në filozofinë e tij ka një parim sipas të cilit sa më e madhe të jetë rezistenca aq më i madh është inkurajimi i tij, që ta kapërcej këtë dhe të gjitha sfidat tjera. **"Pse? Sepse e di që e drejta është në anën time. E di se të gjitha këto thashetheme janë thashetheme të cilat gatuhen nëpër kuzhina të ndryshme, që për mua nuk janë të drejta. Por besoni se jam shumë i përgatitur që t'i tejkalojë edhe këto sfida, ashtu siç kam bërë shumë herë në jetën time"**, tha Pacolli. BS

## **Behgjet Pacolli, presidenti i tretë i Republikës së Kosovës**

**Behgjet Pacolli, pason Fatmir Sejdiu dhe presidenti historik Dr.Ibrahim Rugova, pasi Kuvendi i Republikës në raundin e tretë e zgjodhi me 62 vota për, 4 kundër dhe një abstenim.**

PRISHTINË, 22 SHKURT - Në një sfidë të përshkruar me shumë tensione, debate, dhe akuza ngadhënjeu kryetari i deritanishëm i AKR-së, Behgjet Pacolli, duke u bërë numri një në vend. Pacolli në raundin e tretët të votimit ua mbylli gojët të gjithë kundërshtarëve të tij, një pjesë të të cilëve e la gojëhapur, kur shumica e deputetëve të Kuvendit të Republikës, ia dhanë besimin që ta udhëheq vendin në pesë vjetët e ardhshme. Në raundin tretë të votimit për president të Kosovës, kandidati i AKR - së Behgjet Pacolli u zgjodh President i Republikës së Kosovës me 62 vota për, katër kundër dhe një fletëvotim të pavlefshëm.

Pas një pauze më shumë se një orë, pas dështimit që presidenti të zgjidhet në dy raundet e para, ka nisur procedura për raundin e tretë të votimit për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës. Partive të koalicionit i është dashur të zhvillojnë tri raunde për të zgjedhur presidentin e vendit, pasi në dy raundet e para nuk kishin arritur votat e mjaftueshme që do të bënin vendin me president. Në raundin e parë Behgjet Pacolli mori 54 vota pro, 11 kundër dhe 2 abstenime, ndërkaq në raundin e dytë mori 58 për, 7 kundër dhe 2 të pavlefshme. Kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, i është përgjigjur kërkesës së PDK-së duke ofruar një pauzë të shkurtër, ndonëse e ka cilësuar shtyrjen e seancës si "veprim antikushtetues dhe presion mbi deputetët".

### **Pacolli betohet para deputetëve**

Pas zgjedhjes presidenti, Pacolli ka dhënë betimin para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me zotimin se me përgjegjësi të lartë do t'i kryej të gjitha detyrimet e tij në respektimin e mbrojtjes së Kushtetutës dhe ligjeve, ruajtjes së paqes dhe mirëqenies së qytetarëve. Pas betimit, presidenti Pacolli, ka mbajtur një fjalim para deputetëve, duke e konsideruar këtë si ditë të madhe, por me sfida dhe përgjegjësi. **"Ju të dashur deputetë, më zgjodhët mua për të vazhduar rrugën për përkryerjen e vizionit të Presidentit historik, Dr. Ibrahim Rugovës, për të plotësuar amanetin e heronjve tanë, komandantit historik Adem Jasharit dhe gjithë të tjerëve që ranë për shtetin e pavarur të Kosovës"**, tha në fillim të fjalimit presidenti Pacolli. Duke konsideruar këtë si një moment të rëndësishëm, Pacolli tha se nuk ekziston ndjenjë më e mirë se të fitosh besimin e përfaqësuesve të popullit, që t'i shërbesh popullit dhe vendit tënd. Ai me emocione premtoi se besimin që ka marrë do ta arsyetoj me dinjitet dhe përgjegjësi, derisa përshkroi kështu sfidat e jetës së tij me rënie dhe ngritje. Duke folur për të arriturat e tij, Pacolli tha se gjithçka e ka arritur me punë të përbashkët me bashkëpunëtorët dhe fafesisin e tij. **"Unë u ktheva në Kosovë dhe e kuptova se këtu e kam vendin, në mesin e njerëzve të mi. Këtu zemra ime rreh ndryshe. Këtu i gëzohem tokës dhe diellit, më gëzon çdo gjë këtu dhe më fascionon perëndimi. Perëndimi është prej nga erdha unë dhe perëndimi është rruga të cilën e synon Kosova"**, tha ai, duke falënderuar SHBA-të dhe vendet e BE-së për ndihmën e madhe që kontribuuan dhe vazhdojnë të kontribuojnë në ndërtimin dhe forcimin e shtetit demokratik të Kosovës. **"Kosova ka fituar pavarësinë, lirinë dhe ndërton barazinë. Tani po ndërtojmë shtetin. Këto arritje i synuam**

të gjithë dhe punuam me aq sa ditëm dhe mundëm, por ende jemi larg prej të qenit të kënaqur me arritjet tona. E arritur e veçantë e shtetit të ri të Kosovës, është njohja nga 75 shtete të botës, të cilat i falënderoj në emër të popullit të Kosovës", tha Pacolli. Presidenti i sapo zgjedhur përkujtoi sfidat me të cilat është ballafaquar dhe po ballafaqohet Kosova, duke theksuar se këto janë sfida të shumta dhe do të jenë përgjegjësi e funksionit të tij. "Asnjëherë nuk iu jemi dorëzuar sfidave dhe vështirësive, prandaj, përpjekjet tona për të forcuar institucionet dhe një Kosovë ndryshe, duhet të trajtohen si virtyt dhe domosdoshmëri e kohës në të cilën jetojmë", tha Pacolli, derisa akuzat ndaj tij i ka quajtur të zakonshme, të cilat ndodhin edhe diku tjetër. Detyrën e re ai e quan jo të lehtë, por tha se ka zgjedhur pajtimin dhe angazhimin kundrejt konfliktit dhe pasivitetit. "**Kam zgjedhur të punoj dhe angazhohem në këtë rrugë të domosdoshme për Kosovën dhe të ardhmen e saj. Nuk e them se dikush tjetër do ta kishte më të lehtë, sfidat janë për t'u tejkaluar, e detyra ime e re është sfida e radhës. Institucionet demokratike forcohen me angazhimin e pozitës, opozitës dhe shoqërisë civile**", tha ai, duke garantuar qytetarët se do të përfaqësoj interesat e të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa marrë parasysh bindjet politike. Ai u zotua se do të jetë gjithmonë me qytetarët dhe hallet e tyre, dhe do të angazhohet në zgjidhjen e atyre problemeve. "**Do të punoj për të sotmen dhe të ardhmen e të gjithë qytetarëve të Kosovës, fëmijëve, të rinjve, prindërve dhe veteranëve të të gjitha kategorive. Do të angazhohem me mundësitë dhe kompetencat e mia, për mirëqenie më të mirë dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Kosova ka mundësi për më shumë dhe më mirë. Do të punoj për ruajtjen e integritetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës, për barazinë në mes të shqiptarëve dhe komuniteteve tjera etnike**", u shpreh ai, duke shtuar se po ashtu do të angazhohet edhe të ndërtimin e shtetit të së drejtës duke mbështet fuqishëm luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Presidenti i sapo zgjedhur i shtetit potencoi se çështje e rëndësishme mbetet dialogu me Serbinë, në të cilin proces Kosova do të prezantojë vlerat, idenë dhe vizionin për një fqinjësi të mirë, ku të drejtat e njeriut respektohen dhe vlerësohen në mënyrë reciproke.

### **Ligjvënësit i dhanë besimin edhe qeverisë së re**

Pas zgjedhjes së presidentit, Kuvendi vazhdoi punimet për të votuar kabinetin e ri qeveritar, derisa para deputetëve i nominuari për kryeministër Hashim Thaçi prezantoi përbërjen e kabinetit të tij. Me 65 vota pro dhe 1 kundër, Kuvendi zgjodhi kabinetin e ri të qeverisë së Kosovës me Hashim Thaçin kryeministër. Qeveria e re, do të ketë këtë përbërje: 5 zëvendëskryeministra: Hajredin Kuçi, Mimoza Kusari Lila, Slobodan Petkoviç, Edita Tahiri dhe Bujar Bukoshi. Hajredin Kuçi do të drejtoj edhe Ministrinë e Drejtësisë, atë të MPB-së Bajram Rexhepi, Vlora Çitaku - ministre e Integritetit, Enver Hoxhaj- ministër e Punëve të Jashtme, Fehmi Mujota ministër i Infrastrukturës, Bedri Hamza ministër i Financave, Besim Beqaj- ministër i Zhvillimit Ekonomik, Memli Krasniqi - ministër i Kulturës, Rinisë dhe i Sporteve, Ramë Buja- ministër i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Blerand Stavileci- ministër i Bujqësisë. Agim Çeku- ministër i Forcës së Sigurisë, Ferid Agani - ministër i Shëndetësisë, Mimoza Kusari - Lila- ministre e Tregtisë dhe e Industrisë, Tomiq Radoica - ministër i Kthimit dhe i Komuniteteve, Nenad Rashiç - ministër i Punës dhe i Mirëqenies sociale, Mahir Yagcilar - ministër i Administratës Publike, Dardan Gashi- ministër i Mjedisit dhe i Planifikimit Hapësinor, Slobodan Petkovic - ministër për Qeverisje Lokale. Me të marrë besimin, kryeministri Thaçi u zotua se së bashku do të punojnë me nder, përkushtim dhe profesionalizëm për interesat e vendit dhe të gjithë qytetarëve. Duke marrë privilegj të qenit në krye të një shteti, kryeministri Thaçi tha se kjo përveç privilegjit është një përgjegjësi të cilën e kanë pranuar duke u betuar për respektimin e Kushtetutës së Kosovës. "Jemi të përkushtuar të ndërtojmë shtet demokratik dhe multietnik dhe për më tepër vetë legjitimiteti i qeverisë sonë buron nga pajtueshmëria e qytetarit për të qeverisur në mënyrë demokratike", tha ai, duke

përsëritur pasojat e zhvillimeve të fundit të mos përfundimit të mandatit të plotë qeverisës. Ai u zotua për bashkëpunim me të gjithë deputetët pozitivë dhe opozitë, duke thënë se qytetarët duan participim në demokraci dhe jo bojkot të demokracisë. "Mbi çdo interes tjetër së pari do të vë interesin e Kosovës dhe qytetarëve të saj dhe jam i bindur se këtë mendim e ndani edhe ju u shpreh ai. Thaçi ftoi partitë edhe ato opozitare të cilat i quan vlerë, që të punojnë së bashku për interes të Kosovës dhe qytetarëve tanë. Kryeministri Thaçi para deputetëve shpalosi edhe programin qeveritar për periudhën 2011-2014, duke thënë se në këtë projekt janë përfshirë zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe investimet në të gjitha fushat, duke i dhënë hapësirë edhe tërheqjeve të investitorëve të huaj.

---

## Kosova sot ballafaqohet me sfida të mëdha

---

### E meritojmë të jetojmë në këtë vend me të ardhmën e ndritur

Sot është një ditë e madhe, për mua fillon sfida e radhës me plot përgjegjësi. Ju të dashur deputetë, më zgjodhët mua për të vazhduar rrugën për përkryerjen e vizionit të Presidentit historik, Dr. Ibrahim Rugovës, për të plotësuar amanetin e heronjve tanë, komandantit historik Adem Jasharit dhe gjithë të tjerëve që ranë për shtetin e pavarur të Kosovës. Falënderoj presidentin e Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiun dhe ushtruesin e këtij posti z. Jakup Krasniqin, për angazhimin dhe përkushtimin e tyre në këtë detyrë. Sot ndihemi të përulur para jush dhe ndiej se nuk më mjaftojnë fjalët që të përshkruaj këtë moment. Nuk ekziston ndjenjë më e mirë se të fitosh besimin e përfaqësuesve të popullit, që t'i shërbesh popullit dhe vendit tënd. Unë jam i emocionuar, por nga ana tjetër shumë i përgatitur që këtë besim që mu dha sot, ta arsyetoj me dinjitet dhe përgjegjësi me gjithë energjinë, dijen dhe qenien time. Jam krenar që jam një nga ju. I lindur dhe i rritur në mjediset e një familje tipike të Kosovës, domosdoshmëria me shtyu të ballafaqohem me sfidat e jetës së civilizuar të Perëndimit, jetë kjo jo e lehtë për një kosovar të thjeshtë. Gjatë rrugëtimit tim, shpeshherë jam rrëzuar, por gjithmonë jam ngritur dhe kam vazhduar ende më i fortë. Ky rrugëtim më solli edhe suksese me të cilat unë krenohem pasi ato i kam arritur me punë. Ato suksese janë sukseset e mia dhe të bashkëpunëtorëve e farefisit tim. Këto sfida dhe suksese të arritura në Perëndim duhej të plotësoheshin me arritjet e vendit tim. Unë u ktheva në Kosovë dhe e kuptova se këtu e kam vendin, në mesin e njerëzve të mi. Këtu zemra ime rreh ndryshe. Këtu i gëzohem tokës dhe diellit, më gëzon çdo gjë këtu dhe më fascionon perëndimi. Perëndimi është prej nga erdha unë dhe perëndimi është rruga të cilën e synon Kosova. I falënderoj miqtë tanë perëndimor, në veçanti Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkësinë Evropiane për ndihmën e madhe që kontribuan dhe vazhdojnë ta kontribuojnë në ndërtimin dhe forcimin e shtetit demokratik të Kosovës për të gjithë qytetarët e saj, për shqiptarët, serbët, turqit, boshnjakët, malazezët, për romët, ashkalinjtë, dhe gjithë të tjerët. Kosova ka fituar Pavarësinë, Lirinë dhe ndërton Barazinë. Tani po ndërtojmë shtetin. Këto arritje i synuam të gjithë dhe punuam, me aq sa ditëm dhe mundëm, por ende jemi larg prej të qenurit të kënaqur me arritjet tona. E arritur e veçantë e shtetit të ri të Kosovës, është njohja nga 75 shtete të botës, të cilat i falënderoj në emër të popullit të Kosovës. Kosova sot po ballafaqohet me sfidat më të mëdha që nga çlirimi i saj. Ato janë të shumta dhe do të jenë përgjegjësi e funksionit tim që ma besuat sot. Përpjekjet e kosovarëve për një të ardhme më të mirë janë virtyt i kosovarëve, jo dobësi. Asnjëherë nuk iu jemi dorëzuar sfidave dhe vështirësive, prandaj, përpjekjet tona për të forcuar institucionet dhe një Kosovë ndryshe, duhet të trajtohen si virtyt dhe domosdoshmëri e kohës në të cilën jetojmë. Ishim dëshmitarë të përfoljeve, akuzave, etiketimeve të përmasave globale të drejtuara shtetit të Kosovës dhe njerëzve të saj. Por ju garantoj të dashur deputetë, se kjo nuk është asgjë e jashtëzakonshme - e njëjta ka ndodhë edhe diku tjetër. Në procesin e pavarësimit të Kosovës, ndodhen veprime të jashtëzakonshme, si të njerëzve të Kosovës, ashtu edhe të ndërkombëtarëve, veprime këto në të cilat u përqendrua edhe opinioni botëror. Pavarësia e Kosovës, ishte një histori e suksesit; përvoja ime më ka bindur se suksesi mund edhe të mos falet. Kosova dhe njerëzit e saj, shënuan një sukses, shënuan, historinë e shtetit më të ri. Sot, unë kam marrë një detyrë jo të lehtë. Kam zgjedhur pajtimin dhe angazhimin kundrejt konfliktit dhe pasivitetit. Kam zgjedhur të punoj dhe angazhohem në këtë rrugë të domosdoshme për Kosovën dhe të ardhmen e saj. Nuk e them se dikush tjetër do ta kishte më të lehtë, sfidat janë për t'u tejkaluar, e detyra ime e re është sfida e radhës. Institucionet demokratike forcohen me

angazhimin e pozitës, opozitës dhe shoqërisë civile. Unë ju garantoj se do të përfaqësoj interesat e të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa marrë parasysh bindjet politike. Institucioni të cilin përfaqësoj, do të garantojë unitet, stabilitet dhe jam tërësisht i dedikuar t'i shërbej atij funksioni. Unë si President i Republikës së Kosovës, do të jem gjithmonë me ju, pjesë e juaja dhe halleve tuaja, do të punoj dhe angazhohem që të jem pjesë e zgjidhjeve tuaja. Do të punoj për të sotmen dhe të ardhmen e të gjithë qytetarëve të Kosovës, fëmijëve, të rinjve, prindërve dhe veteranëve të të gjitha kategorive. Do të angazhohem me mundësitë dhe kompetencat e mia, për mirëqenie më të mirë dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Kosova ka mundësi për më shumë dhe më mirë. Do të punoj për ruajtjen e integritetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës, për barazinë në mes të shqiptarëve dhe komuniteteve tjera etnike si dhe respektimin e të drejtave të të gjithë kosovarëve pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fetare, gjinore apo racore - na kraju svi smo rav nopravni gradjani Republike Kosova. Do të punoj për një shtet të së drejtës dhe për një shtet ku askush nuk është mbi ligjin. Do të mbështes fuqishëm luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar duke siguruar pavarësinë e plotë të sistemit gjyqësor dhe kushtet optimale për punën e tyre. Do të promovoj idenë për një Kosovë të hapur e cila garanton lëvizje të lirë të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve, për një Kosovë të integruar plotësisht në shtëpinë e madhe evropiane, në NATO dhe në organizatat e tjera botërore. Do të promovoj idenë për plotësimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës në mënyre që në të ardhmen Presidenti i Kosovës të zgjidhet me votën e lirë të qytetarëve. Do të promovoj idenë e funksionalizimit të referendumit - referendumi është qelizë e rëndësishme e demokracisë. Do të promovoj idenë e ndryshimit të Ligjit zgjedhor në mënyre që të kemi zgjedhje të lira, të drejta, fer dhe korrekte. Kosova ka qenë dhe mbetet vend i cili respekton fqinjët dhe kryen obligimet e saj për marrëdhënie sa më të mira fqinjësore me të gjithë fqinjët e saj. E falënderoj shumë Republikën e Shqipërisë dhe institucionet e saj, për kontributin e jashtëzakonshëm dhënë afirmimit të shtetit të Kosovës. E çmojmë lart gatishmërinë e Malit të Zi dhe Maqedonisë, për avancimin e raporteve të mira fqinjësore. Për të gjithë strukturën politike në Kosovë është i rëndësishëm dialogu me Serbinë. Në këtë proces, Kosova do të prezantojë vlerat, idenë dhe vizionin për një fqinjësi të mirë, ku të drejtat e njeriut respektohen dhe vlerësohen në mënyrë reciproke. Parimet e fqinjësisë së mirë janë bazë për integritet rajonale dhe globale. Do të punoj me gjithë qenien time që ta ngre Kosovën në mesin e shteteve të respektuara dhe të vlerësuara të botës. Në mesin e shteteve të respektuara me të ardhme të ndritur, atje ku qytetari është në qendër të vendimmarrjes dhe është esenca e qeverisjes. Kosova e meriton këtë, kosovarët e meritojnë të jetojnë në vend me një të ardhme të ndritur dhe këtë mund ta arrijmë vetëm me punë të madhe dhe përkushtim të sinqertë. Rol të veçantë në këtë proces ka rinia jonë. Për rininë ne duhet të krijojmë kushte më të mira jetësore dhe perspektivë të sigurt. Me këtë mandat po hyjmë në fazën e re të shtet - ndërtimit të Kosovës, në fazën kur duhet të forcojmë fundamentet e shtetit të Kosovës, me vizion të qartë dhe pa frikë nga e ardhmja. Ne do të korrim sukses sepse jemi të përkushtuar që suksesin ta arrijmë vetëm me punë profesionale dhe të ndershme. Prandaj, të dashur qytetarë të Kosovës dhe deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, së bashku t'ia fillojmë punës, jemi vonuar.



*Fjalimi i z.Behgjet Pacolli pas zgjedhjes President i Republikës së Kosovës*



---

## Thaçi e Pacolli Fitimtarë

---

**LDK-ja, AAK-ja dhe Vetëvendosja, dështuan!**

**Raundi i tretë i votimit ka qenë triumfues për Pacollin, pasi për të, presidentin e Kosovës kanë votuar 62 deputetë, 4 kundër dhe një fletëvotim ka qenë i pavlefshëm. Pas zgjedhjes së Behgjet Pacollit president radha i ka ardhur Hashim Thaçit, përkatësisht votimit të Qeverisë. Thaçi, ashtu siç pritej, ka kaluar shumë më lehtë sesa Pacolli. Me 65 vota për, 1 kundër është votuar Qeveria e Kosovës në krye me Hashim Thaçin, i cili për të dytën herë para deputetëve ka paraqitur programin qeveritar për vitet 2011-2014, i cili, sipas tij, do të bazohet në qeverisje të mirë, fuqizim të ligjit dhe mirëqenie sociale**

PRISHTINË, 22 SHKURT - Hashim Thaçi dhe Behgjet Pacolli e kanë përmyllur me sukses ditën e martë. I pari është zgjedhur për herë të dytë kryeministër, kurse i dyti president i Republikës së Kosovës. Edhe pse Behgjet Pacolli ka qenë kandidati i vetëm për president, atij i është dashur që tek në raundin e tretë t'i marrë votat e mjaftueshme për t'u bërë president i Kosovës. Pacolli ka ndenjur nën ethe për rreth tri orë. Për gjatë tri orëve kushedi se çka i ka shkuar në mendje. Në raundin e parë nga 67 deputetë, 54 prej tyre kanë votuar për Pacollin, 7 kundër dhe dy fletëvotime kanë qenë të pavlefshme. Në raundin e dytë të votimit Pacolli ka marrë 4 vota më shumë sesa në raundin e parë, gjithsej 58. Pas përfundimit të gjithsej 58. Pas përfundimit të raundit të dytë të votimit për presidentin, Grupi Parlamentar i PDK së ka kërkuar nga kryeparlamentari Krasniqi një pauzë prej pesë minutash. Kjo kërkesë është kundërshtuar nga Krasniqi, duke u quajtur e kundërligjshme, megjithatë është bërë. "Ju mund të kërkonit pauzë, por kjo është shkelje e Kushtetutës dhe Rregullores së Punës së Kuvendit. Ky rezultat është i verifikuar dhe çdo ndryshim i rezultatit është i papranueshëm dhe presion mbi deputetët", ka thënë Krasniqi, i cili më pas ka urdhëruar për një pauzë. Pas kësaj pauze ka vazhduar procedura e votimit. Raundi i tretë i votimit ka qenë triumfues për Pacollin, pasi për të president të Kosovës kanë votuar 62 deputetë, 4 kundër dhe një fletëvotim ka qenë i pavlefshëm. Behgjet Pacolli, pasi është betuar para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, në adresimin e tij të parë si president i vendit ka premtuar se do të jetë president që do t'i përfaqësojë interesat e të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe do të garantojë unitet të plotë. "Institucionin të cilin e përfaqësoj do të garantoj unitet, stabilitet dhe jam tërësisht i dedikuar t'i shërbej atij funksioni. Do të punoj për një shtet të së drejtës dhe për një shtet ku askush nuk është mbi ligjin. Do ta mbështes fuqishëm luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar duke siguruar pavarësinë e plotë të sistemit gjyqësor dhe kushtet optimale për punën e tyre", ka premtuar Pacolli. Ai ka thënë se do ta promovojë idenë për një Kosovë të hapur, e cila garanton lëvizje të lirë të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve. "Për një Kosovë të integruar plotësisht në shtëpinë e madhe evropiane, në NATO dhe në organizatat e tjera botërore", është shprehur Pacolli. Disa orë pasi u votua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe u zgjodh president i vendit, Behgjet Pacolli ka dhënë dorëheqjen nga të gjitha detyrat partiake në krye të Aleancës Kosova e Re. Dhe pas zgjedhjes së Behgjet Pacollit president, radha i ka ardhur Hashim Thaçit, përkatësisht votimit të Qeverisë. Thaçi, ashtu siç pritej, ka kaluar shumë më lehtë sesa Pacolli. Me 65 vota për, 1 kundër është votuar Qeveria e Kosovës në krye me Hashim Thaçin, i cili për të dytën herë para deputetëve ka paraqitur programin qeveritar për vitet 2011-

2014, i cili, sipas tij, do të bazohet në qeverisje të mirë, fuqizim të ligjit dhe mirëqenie sociale. Kryeministri Thaçi e ka quajtur ditë kthese për Kosovën zgjedhjen e presidentit dhe kabinetit qeveritar. Ai ka thënë se për Kosovën po fillon një kapitull i ri, ai i integrimëve euroatlantike dhe i reformave të thella ekonomike dhe politike. "Për Kosovën krijimi i institucioneve është ditë kthese në rrugëtimin tonë për Kosovën evropiane, demokratike, shumetnike dhe për reforma të thella demokratike në ekonomi, legjislacion dhe politikë. Si Qeveri e Republikës së Kosovës do të jemi në shërbim të qytetarëve pa dallim etnie. Sot Kosova dëshmoi demokraci, rend demokratik, transparencë dhe përgjegjësi të lartë. Tani do ta procedojmë menjëherë buxhetin e Kosovës pasi ka qenë i pavlefshëm vonimi i krijimit të institucioneve të dala nga vota", ka thënë Thaçi pas përfundimit të punimeve në Kuvendin e Kosovës. Më tutje, Thaçi ka thënë se të gjithë deputetët që kanë marrë pjesë në votim, u janë përgjigjur vullnetit të qytetarëve të Kosovës në mënyrë që ta nxjerrin vendin nga problemet që të tjerët e kishin futur. "Të gjithë deputetët të cilët kanë marrë pjesë në punimet e Kuvendit i janë përgjigjur vullnetit të qytetarëve të Kosovës për ta nxjerrë vendin nga kaosi që të tjerët na futën", është shprehur Thaçi, duke u zotuar se do të punojë me spektrin politik e civil në Kosovë si dhe me faktorët ndërkombëtarë. Pas votimit të Qeverisë në foltoren e Kuvendit ka dalë deputetja Rada Trajkoviq, e cila ka votuar kundër kësaj qeverie. Ajo ka dalë haptas kundër Qeverisë së re. Në fjalimin e saj Kosovën e ka thirrur "Kosovo Metohi", kurse ka thënë se kryeministri Thaçi është i akuzuar nga Dick Marty për kryerjen e krimeve. Pas Trajkoviqit në foltore ka dalë edhe deputeti i AKR - së, Muhamet Mustafa, i cili ka kërkuar që programi qeveritar të harmonizohet më mirë në mënyrë që ky program të jetë më përmbajtjesor". Programi qeveritar do të duhej të diskutohej në një mbledhje të Qeverisë, ku do të harmonizohej më mirë, ndonëse në program shkruan se partnerët e koalicionit janë pajtuar. Mendoj se partnerët e këtij koalicioni nuk kanë pasur mjaft kohë ta diskutojnë dhe pajtohen me të gjitha pikat që ky program të jetë konsistent", ka thënë Mustafa.

### **Opozita braktis seancën**

Tri partitë opozitare, LDK-ja, Lëvizja Vetëvendosje dhe AAK-ja nuk kanë marrë pjesë në procesin e votimit të presidentit dhe të kabinetit qeveritar. Për dallim nga deputetët e LDK - së, të cilët nuk kanë marrë pjesë fare në seancë, deputetët e Vetëvendosje! -s dhe të AAK - së kanë qenë të pranishëm deri në çastet kur ka filluar procesi i votimit. I vetmi në Kuvend nga LDK-ja ka qenë shefi i grupit Parlamentar, Ismet Beqiri, i cili ka dhënë arsytjen për mospjesëmarrje të deputetëve të kësaj partie në seance. "LDK - ja ka vendosur të mos marrë pjesë gjatë votimit për president të Kosovës dhe të kabinetit qeveritar pasi nga zgjedhjet e 12 dhjetorit nuk mund të dalë një president dhe një qeveri me mandat të plotë, sepse zgjedhjet kanë qenë tërësisht të manipuluar. Konsiderojmë se as KQZ - ja, PZAP - i dhe Gjykata Supreme nuk kanë arritur ta krijojnë legjitimitetin e këtyre zgjedhjeve, duke pasur parasysh përmasat e manipulimeve", ka thënë Beqiri, duke shtuar se burimi i këtyre problemeve dhe dobësive, përpos manipulimeve të PDK - së, ka qenë edhe sistemi zgjedhor dhe Ligji për Zgjedhje, i cili duhet të ndryshohet që t'i hapet rrugë mbajtjes së zgjedhjeve të reja. "LDK - ja konsideron se mundësia më e mirë për daljen nga kjo situatë është një marrëveshje politike ndërmjet partive politike me një agjendë të qartë pune që do të bëhet deri në zgjedhjet e ardhshme", ka thënë Beqiri. Ai ka vlerësuar se marrëveshja e koalicionit për president dhe Qeveri nuk është bërë mbi bazën e interesit të vendit, por mbi bazë të kërkesave dhe ambicieve personale. Ndërkaq, shefi i Grupit Parlamentar të Vetëvendosje-s, Visar Ymeri, ka thënë se deputetët e Vetëvendosje! - s nuk do të marrin pjesë në votimin e presidentit pasi kandidati për president nuk është i papërshtatshëm politikisht dhe personalisht për ta udhëhequr Kosovën. "Ky duet politik Thaçi - Pacolli është i

përkryer për njëri - tjetrin. Njëri e përdor politikën për t'u pasuruar, tjetri e përdor pasurinë për t'u bërë politikan. Meqenëse asnjëri prej tyre nuk janë në politikë për të mirën e Kosovës, këta të dy së bashku janë e keqja e Kosovës në rrafshin politik e ekonomik", ka thënë Ymeri. Ai ka vlerësuar se koalicioni qeveritar me Pacollin president është koalicioni i negociatave me Serbinë dhe koalicioni i vazhimit të privatizimit shumë të dëmshëm të ndërmarrjeve publike dhe keqpërdorimit të parasë publike. "Negociatat me Serbinë janë të padrejta për Kosovën, të dëmshme për të tashmen e saj, të rrezikshme për të ardhmen e saj dhe gjithsesi të pabarabarta. Ato do ta thellojnë edhe më tutje ndarjen e brendshme të Kosovës në vija etnike, duke e avancuar dhe forcuar nëpërmjet legalizimit ndërhyrjen e Serbisë në Kosovë, ndërkohë që privatizimi e projektet e tjera kapitale të qeverisë së kaluar e të këtij koalicioni do ta vazhdojnë stërkeqen dhe mjerimin ekonomik e social të vendit. Për të gjitha këto përgjegjës do të jenë Thaçi e Pacolli", ka deklaruar Ymeri. Të njëjtin qëndrim me LDK - në e ka mbajtur edhe AAK - ja. Shefi i Grupit Parlamentar të AAK - së, Ardian Gjini, ka thënë se deputetët e AAK-së nuk do të marrin pjesë fare në procesin e votimit të presidentit dhe të Qeverisë. "Deputetët e AAK-së nuk do të jenë dëshmitar të një marrëveshje të tillë. Ky koalicion, ky president dhe kjo Qeveri janë të papranueshme për AAK - në, sepse nuk janë për të mirën e vendit, ka deklaruar Gjini, i cili së bashku me deputetët e tjerë të AAK - së e kanë lëshuar sallën e Kuvendit. Pas deputetëve të AAK - së sallën e Kuvendit e kanë lëshuar edhe deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje.

#### **Petroviq: Kosovës i duhen institucionet**

Qëndrim parimor në këtë seancë ka mbajtur kryetari i SLS - së, Slllobodan Petroviq, i cili ka thënë se zgjedhja e institucioneve të reja është e domosdoshme që Kosova të vazhdojë me hapa drejt zhvillimit. "E përkrahim Behgjet Pacollin për president dhe Hashim Thaçin për kryeministër sepse Kosovës i duhen sa më shpejt institucionet", ka thënë Petroviq. Edhe Mahir Jagjilar në emër të Grupit Gjashtë Plus i ka dhënë mbështetje zgjedhjes së Pacollit president të Kosovës.

---

## Perëndimi është rruga jonë

---

Të nderuar qytetarë të Kosovës, i nderuari Kryetar i Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi, i nderuari kandidat për Kryeministër, z. Hashim Thaçi, Të nderuar deputetë, E nderuara familje Rugova, E nderuara familje Jashari, Të nderuara familje Haradinaj, Pajaziti dhe të gjitha familjet e tjera të çmuara të dëshmorëve, Të nderuar përfaqësues të korit diplomatik në Kosovë, Të nderuar pjesëmarrës: Sot është një ditë e madhe. Për mua fillon sfida e radhës me plot përgjegjësi. Ju të dashur deputetë më zgjidhet mua për ta vazhduar rrugën për kryerjen e vizionit të presidentit historik, Dr. Ibrahim Rugovës, për ta plotësuar amanetin e heronjve tanë, komandantit historik Adem Jasharit dhe gjithë të tjerëve që ranë për shtetin e pavarur të Kosovës. Të dashur qytetarë, Sot ndihem i përlotur para jush dhe ndiej se nuk më mjaftojnë fjalët që të përshkruaj këtë çast. Nuk ekziston ndjenjë më e mirë se ta fitosh besimin e përfaqësuesve të popullit, që t'i shërbesh popullit dhe vendit tënd. Unë jam i emocionuar, por nga ana tjetër shumë i përgatitur që këtë besim që mu dha sot, ta arsyetoj me dinjitet dhe përgjegjësi me gjithë energjinë, dijen dhe qenien time. Jam krenar që jam një nga ju. I lindur dhe i rritur në mjediset e një familje tipike të Kosovës, domosdoshmëria me shtyu të ballafaqohem me sfidat e jetës së civilizuar të Perëndimit, jetë kjo jo e lehtë për një kosovar të thjeshtë. Gjatë rrugëtimit tim shpeshherë jam rrëzuar, por gjithmonë jam ngritur dhe kam vazhduar ende më i fortë. Ky rrugëtim më solli edhe suksese me të cilat krenohem pasi ato i kam arritur me punë. Ato janë sukseset e mia dhe të bashkëpunëtorëve të fafësisit tim. Këto sfida dhe suksese të arritura në Perëndim duhej të plotësoheshin me arritjet e vendit tim. Unë u ktheva në Kosovë dhe e kuptova se këtu e kam vendin, në mesin e njerëzve të mi. Këtu zemra ime rreh ndryshe. Këtu i gëzohem tokës dhe diellit, më gëzon çdo gjë këtu dhe më fascinon Perëndimi. Perëndimi është prej nga erdha unë dhe Perëndimi është rruga të cilën shkon Kosova. I falënderoj shumë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkësinë Evropiane për ndihmën e madhe që kontribuan dhe vazhdojnë të kontribuojnë në ndërtimin dhe forcimin e shtetit demokratik të Kosovës për të gjithë qytetarët e saj, për shqiptarët, za serbe, tyrkler için, za bosnjake i crnogorce, për romët, ashkalinjtë, dhe gjithë të tjerët. Kosova ka fituar Pavarësinë, lirinë dhe ndërton barazinë. Tani po ndërtojmë shtetin. Këto arritje i synuam të gjithë dhe punuam me aq sa ditëm dhe mundëm, por ende jemi larg prej të qenit të kënaqur me arritjet tona. E arritur e veçantë e shtetit të ri të Kosovës është njohja nga 75 shtete të botës, të cilat i falënderoj në emër të popullit të Kosovës. Kosova sot po ballafaqohet me sfidat më të mëdha që nga çlirimi i saj. Ato janë të shumta dhe do të jenë përgjegjësi e funksionit tim që ma besuat sot. Përpjekjet e kosovarëve për një të ardhme më të mirë janë virtyt i kosovarëve, jo dobësi. Asnjëherë nuk i'u jemi dorëzuar sfidave dhe vështirësive, prandaj përpjekjet tona për t'i forcuar institucionet dhe një Kosovë ndryshe, duhet të trajtohen si virtyt dhe domosdoshmëri e kohës në të cilën jetojmë. Ishim dëshmitarë të përfoljeve, akuzave, etiketimeve të saj. Por ju garantoj, të dashur deputetë, se kjo nuk është asgjë e jashtëzakonshme - e njëjta ka ndodhur edhe diku tjetër. Në procesin e pavarësimit të Kosovës ndodhen veprime të jashtëzakonshme, si të njerëzve të Kosovës, ashtu edhe të ndërkombëtarëve, veprime këto në të cilat përqendruan edhe opinionin botëror. Pavarësia e Kosovës ishte një histori e suksesit; përvoja ime më ka bindur se suksesi mund edhe të mos falet. Kosova dhe njerëzit e saj shënuan një sukses, shënuan historinë e shtetit më të ri. Sot unë kam marrë një detyrë jo të lehtë. Kam zgjedhur pajtimin dhe

angazhimin kundrejt konfliktit dhe pasivitetit. Kam zgjedhur të punoj dhe angazhohem në këtë rrugë të domosdoshme për Kosovën dhe të ardhmen e saj. Nuk e them se dikush tjetër do ta kishte më të lehtë, sfidat janë për t'u tejkaluar, e detyra ime e re është sfida e radhës. Institucionet demokratike forcohen me angazhimin e pozitës, opozitës dhe shoqërisë civile. Unë ju garantoj se do t'i përfaqësoj interesat e të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa marrë parasysh bindjet politike. Institucioni të cilin përfaqësoj do të garantojë unitet, stabilitet dhe jam tërësisht i dedikuar t'i shërbej atij funksioni. Kosovës, do të jem gjithmonë me ju, pjesë e juaja dhe halleve tuaja. Do të punoj dhe angazhohem që të jem pjesë e zgjidhjeve tuaja. Do të punoj për të sotmen dhe të ardhmen e të gjithë qytetarëve të Kosovës, fëmijëve, të rinjve, prindërve dhe veteranëve të të gjitha kategorive. Do të angazhohem me mundësitë dhe kompetencat e mia për mirëqenie më të mirë dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Kosova ka mundësi për më shumë dhe më mirë. Do të punoj për ruajtjen e integritetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës, për barazinë në mes të shqiptarëve dhe komuniteteve të tjera etnike si dhe respektimin e të drejtave të të gjithë kosovarëve pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fetare, gjinore apo racore kraju svi smo ravnopravni grad jani Republike Kosova. Do të punoj për një shtet të së drejtës dhe për një shtet ku askush nuk është mbi ligjin. Do ta mbështes fuqishëm luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar duke siguruar pavarësinë e plotë të sistemit gjyqësor dhe kushtet optimale për punën e tyre. Do ta promovoj idenë për një Kosovë të hapur, e cila garanton lëvizje të lirë të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve. Do ta promovoj idenë për plotësimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës në mënyrë që në të ardhmen presidenti i Kosovës të zgjidhet me votën e lirë të qytetarëve. Do ta promovoj idenë e funksionalizimit të referendumit, referendumi është qelizë e rëndësishme e demokracisë. Do ta promovoj idenë e ndryshimit të Ligjit Zgjedhor në mënyrë që të kemi zgjedhje të lira, të drejta, fer dhe korrekte. Kosova ka qenë dhe mbetet vend i cili respekton fqinjët dhe kryen obligimet e saj për marrëdhënie sa më të mira fqinjësore me të gjithë fqinjët e saj. E falënderoj shumë Republikën e Shqipërisë dhe institucionet e saj për kontributin e jashtëzakonshëm dhënë afirmimit të shtetit të Kosovës. E çmojmë lart gatishmërinë e Malit të Zi dhe Maqedonisë për avancimin e raporteve të mira fqinjësore. Për të gjithë strukturën politike në Kosovë është i rëndësishëm dialogu me Serbinë. Në këtë proces Kosova do t'i prezantojë vlerat, idenë dhe vizionin për një fqinjësi të mirë, ku të drejtat e njeriut respektohen dhe vlerësohen në mënyrë reciproke. Parimet e fqinjësisë së mirë janë bazë për integritet rajonale dhe globale. Do të punoj me gjithë qenien time që ta ngreh Kosovën në mesin e shteteve të respektuara dhe të vlerësuara të botës. Në mesin e shteteve të respektuara me të ardhme të ndritur, atje ku qytetari është në qendër të vendimmarrjes dhe është esenca e qeverisjes. Kosova e meriton këtë, kosovarët e meritojnë të jetojnë në vend me një të ardhme të ndritur dhe këtë mund ta arrijmë vetëm me punë të madhe dhe përkushtim të sinqetë. Rol të veçantë në këtë proces ka rinia jonë. Për rininë ne duhet të krijojmë kushte më të mira jetësore dhe perspektivë të sigurt. Me këtë mandat po hyjmë në fazën e re të shtetndërtimit të Kosovës, në fazën kur duhet t'i forcojmë fundamentet e shtetit të Kosovës, me vizion të qartë dhe pa frikë nga e ardhmja. Ne do të korrim sukses sepse jemi të përkushtuar që suksesin ta arrijmë vetëm me punë profesionale dhe të ndershme. Prandaj, të dashur qytetarë të Kosovës dhe deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, së bashku t'ia fillojmë punës: jemi vonuar. Faleminderit edhe një herë, Zoti na ndihmoftë.



*Fjalimi i parë në Kuvend i z.Behgjet Pacolli si President*

### Kontestohet zgjedhja e Pacollit

**KDI-ja, ekspertë juridik dhe analistë politikë e kanë cilësuar si jo të rregullt dhe antikushtetuese procedurën e zgjedhjes së Behgjet Pacollit president të Republikës së Kosovës. Lideri i partisë së vogël parlamentare, AKR - së, u zgjodh në raundin e tretë me 62 vota pas një pauze një orëshe, që u cilësua nga kryeparlamentari Krasniqi "jokushtetuese"**

Tri raunde votimi i janë dashur kuvendit, me përjashtim të opozitës, për zgjedhjen e të nominuarit për president të Kosovës, Behgjet Pacolli. Në raundin e parë të votimit, kandidati i vetëm për president, Behgjet Pacolli, ka marrë vetëm 54 vota nga 67 sa kanë votuar gjithsej. 11 vota ishin kundër, ndërsa dy fletëvotime të pavlefshme. Edhe pas rrethit të dytë të votimit në Parlamentin e Kosovës, vetëm 58 vota u siguruan nga 61 sa është dashur. Por nga mos zgjedhja e presidentit në raundin e dytë janë vërejtur fërkime mes kryeparlamentarit Jakup Krasniqi dhe liderit të PDK-së, Hashim Thaçi. Pasi ishte bërë numërimi nga komisioni votues pranë Krasniqit ishte afruar kryetari i PDK-së. Si duket ai ka kërkuar të bëhet një pauzë. Por kryeparlamentari Krasniqi tha se seanca duhet të vazhdojë dhe se lëshimi i sallës pa urdhrin e tij përbën shkelje kushtetuese dhe të rregullores së punës të Kuvendit të Kosovës. Por Hajredin Kuçi ka dalë në foltore duke i kërkuar Krasniqit që të japë pesë minuta pushim. Krasniqi tha se mund të ketë edhe pauzë më të gjatë, por ai ka tërhequr vërejtjen që të mos bëhet presion mbi deputetët. "Mund të shkohet në pauzë 5 minutëshe, mund të shkohet edhe dy ditë po deshët, por rezultatet e këtij votimi janë këto që u panë dhe u verifikuan. Ato nuk mund të ndryshohen dhe çdo presion i mundshëm ndaj deputetëve përbën shkelje të kushtetutës tha Krasniqi. Rreth një orë iu deshën" deputetëve për t'u kthyer në sallë, ndërsa kësaj here 62 deputetë kanë votuar në favor të Pacollit, 4 kundër dhe 1 e pavlefshme.

#### **KDI: U shkelën kushtetuta dhe procedurat**

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka reaguar ndaj zhvillimeve në Kuvendin e Kosovës , duke vlerësuar se në seancën e jashtëzakonshme ku është paraparë zgjedhja e presidentit janë shkelur kushtetuta dhe rregullorja e kuvendit. Përfaqësues të KDI - së kanë theksuar se një grup parlamentar ka të drejtë të kërkojë shtyrjen e debatit dhe një gjë e tillë duhet të hidhet në votim, por në këtë rast nuk kishte debat dhe nuk u respektuan procedurat. Sipas KDI-së, kryetari i kuvendit është ai që e interpreton rregulloren, mirëpo ai nuk është pyetur nga grupi parlamentar i PDK - së, i cili e lëshoi seancën. Driton Selmanaj nga KDI - ja e quajti shkelje daljen nga salla të deputetëve të PDK-së pa u dhënë leja nga kryeparlamentari, Jakup Krasniqi, personi i autorizuar për këtë punë. KDI - ja ka vlerësuar se një sjellje e tillë mund të shihet si presion në vullnetin e deputetëve dhe shkelje e procedurave. "Vetë ndërprerja e mbledhjes është cenim i lirisë së deputetit që të vendosë i papenguar dhe të përfaqësojë interesat e zgjedhësve", ka thënë ai. Sipas Selmanajt, një grup parlamentar ka të drejtë të kërkojë shtyrjen e debatit dhe një gjë e tillë duhet të hidhet në votim, por në këtë rast nuk kishte debat dhe nuk u respektuan procedurat. Pacolli ka arritur të marrë votat e mjaftueshme për president tek në raundin e tretë me 62 vota nga 67 sa kanë votuar. Edhe juristi Riza Smaka tha se ka pasur shkelje kushtetuese, pasi është dhënë pauzë e cila jo vetëm që zgjati shumë, por aty në njëfarë mënyrë sikur u " blenë " votat dhe u bënë pazaret. "Dy raunde votimesh kanë dështuar, ndërsa para raundit të tretë nuk ka

mundur të ketë pauzë gjatë votimit të presidentit. Kjo përbën një shkelje kushtetuese, gjë për të cilën edhe vetë kryeparlamentari Krasniqi tërhoqi vërejtjen. Po ashtu nuk ka kuorum në zgjedhjen e presidentit. Ne nuk jemi shtet presidencial, por parlamentar, tha Smaka. Ndërsa analisti Ramush Tahiri tha se proceduralisht ka pasur shkelje dhe nuk janë shtetur të gjithë mekanizmat në planin politik. Ai rikujtoi se në raundin e parë është dashur të jenë prezentë dy të tretat dhe që nuk ndodhi dhe aty është dashur të ndërpritet. "Zgjedhja e presidentit bëhet me dy të tretat ( 2/3 ) e votave të të gjithë deputetëve të kuvendit", tha Tahiri. Po ashtu nuk ka pasur kundërkandidat në votimet e para që do t'i siguronin votimin e tretë, e ku do të përcaktohej kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve. Marrë parasysh largimin e forcave opozitare në gjykimin e tij është dashur që të shtyhej për ndonjë ditë zgjedhja e presidentit, derisa nuk do të arrihej një konsensus në mes të gjitha partive, duke qenë që presidenti duhet të paraqesë unifikim të spektrit politik. Megjithatë, ai e cilësoi si të rëndësishme përmbylljen e këtij procesi me të cilin tejkalohet vakumi institucional.

### **Betohet presidenti i ri**

Presidenti i sapo zgjedhur, Pacolli, është betuar para Kuvendit të Kosovës se do të kryejë me përgjegjësi detyrën. Ai është zotuar se do ta mbrojë sovranitetin e vendit. Ai tha se presidencën e merr si një sfidë të madhe. "I falënderoj miqtë tanë perëndimorë, SHBA - në dhe BE - në për ndihmën në rrugën e shtetit demokratik të Kosovës. Betohem se do të respektoj kushtetutën dhe ligjin, tani që jemi të gjithë në rrugën e ndërtimit të shtetit", theksoi Pacolli para deputetëve. Lidhur me njohjen e Kosovës së pavarur, Pacolli deklaroi se do të bëjë të pamundurën që ato të shtohen në të ardhmen dhe se shifra prej 75 është bindëse për rrugën e nisur. "Në Kosovë duhet të arrijmë edhe më shumë suksese. Përpjekjet për një të ardhme më të mirë janë virtyti ynë. Sot unë kam marr një detyrim jo të lehtë, kundrejt konfliktit dhe pasivitetit", tha presidenti i ri i Kosovës, i cili ka përshëndetur edhe në gjuhën serbe, turke dhe të komuniteteve të tjera. Ai përcolli mesazhe falënderimi deputetëve për zgjedhjen e tij për të vazhduar siç tha rrugën për përkryerjen e vizionit të presidentit historik Ibrahim Rugova për të plotësuar amanetin e heronjve tanë, komandantit historik Adem Jashari dhe gjithë të tjerëve që ranë për shtetin e pavarur të Kosovës. "Falënderoj presidentin e Republikës së Kosovës, Fatmir Sejdiu dhe ushtruesin e këtij posti z. Jakup Krasniqi për angazhimin dhe përkushtimin e tyre në këtë detyrë. Do të punoj për ruajtjen e integritetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës, për barazinë në mes të shqiptarëve dhe komuniteteve të tjera etnike, si dhe respektimin e të drejtave të të gjithë kosovarëve pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fetare, gjinore apo racore. "Na kraju svi smo ravno pravni gradjani Republike Kosova", tha ai. Në vijim ai tha se do të promovojë idenë për plotësimin e kushtetutës së Republikës së Kosovës në mënyrë që në të ardhmen presidenti i Kosovës të zgjidhet me votën e lirë të qytetarëve. "Do të promovoj idenë e funksionalizimit të referendumit. Referendumi është qelizë e rëndësishme e demokracisë. Do të promovoj idenë e ndryshimit të Ligjit zgjedhor, në mënyrë që të kemi zgjedhje të lira, të drejta dhe korrekte", tha ai, Pacolli ia ka propozuar Kuvendit kandidatin për kryeministër të Republikës, Hashim Thaçi.



---

## Presidenti i Kosovës i hetuar nga prokuroria zvicerane

---

**Prokuroria e Gjenevës kishte bërë hetime ndaj shefit të MABETEX- it Behgjet Pacollit me akuza për dhënie ryshfeti politikanëve dhe funksionarëve rusë, pastrim parash dhe zhvatje**

Në televizionin publik zviceran janë transmetuar lajme të kundërta me ato të AKR-së lidhur me hetimet që janë bërë ndaj Behgjet Pacollit dhe kompanisë së tij MABETEX në Zvicër. Më herët në një faksimil të ofruar nga AKR-ja të datës 25 mars 2000, e prokurorit të përgjithshëm të Zvicrës, Bernard Bertosa, thuhet se nuk ka pasur hetim nga Prokuroria Federale e Zvicrës për Pacollin. Ndërsa siç raporton televizioni publik zviceran, në qershor të 2000-s. Prokuroria e Gjenevës kishte bërë hetime ndaj shefit të MABETEX-it Behgjet Pacollit me akuza dhënie ryshfeti politikanëve dhe funksionarëve rusë, pastrim parash dhe zhvatje. Gjithnjë sipas televizionit zviceran shefi i MABETEX-it akuzohet për shpëlarje parash, si dhe për pjesëmarrje në një organizatë kriminale. Shefi i kompanisë ndërtimore në Lugano së bashku me presona të tjerë është i dyshuar në dhënie ryshfetes ndaj zyrtarëve të lartë rusë dhe familjarëve të Jelcinit. MABETEX-i kishte marrë tenderë shumë fitimprurës në renovimin e Kremlinit, thuhet më tutje. Ndërsa në faksimilen e dytë, të prezantuar nga AKR - ja, është një deklaratë e zëvendësprokurorit të përgjithshëm të Zvicrës, Feliks Benziger, ndaj zotit Pacolli dhe kompanisë së tij aktualisht nuk ka asnjë hetim kriminal dhe nuk ka asnjë kufizim në kryerjen e biznesit. Ndërkaq gjithnjë sipas lajmeve të publikuara në televizionin publik zviceran vazhdohet të deklarohet se Pacolli duhet të arsyetohet para prokurorisë. Gjithnjë sipas këtij mediumi ndaj Pacollit është ngritur aktakuzë zyrtare. Prokuroria federale është duke e akuzuar Pacollin për shpëlarje parash, anëtarësim në një organizatë kriminale. Sipas kësaj aktakuze Pacolli i ka dhënë ryshfet milionëshe ish-presidentit rus Boris Jelcin, si dhe funksionarëve të lartë të Kremlinit. Në këmbim të këtyre ryshfeteve ai ka marrë tenderë për renovime, thuhet në raportin e televizioni publik zviceran. Faksimilet e AKR-së janë të marsit të vitit 2000. Ndërsa Prokuroria e Gjenevës kishte ngritur akuzën ndaj Pacollit tre muaj më vonë. Ky proces nuk përfundoi kurrë për shkak, siç thuhet në medie zvicerane, se pala ruse kishte bllokuar hetimet dhe prokuroria ishte detyruar të mbyllë rastin.


## **Pacolli e nis ditën me homazhe e premtime**

**“Isha në rezidencën e presidentit historik të Kosovës edhe njëherë të dëshmoj se jam më se i përgatitur ta çoj përpara idenë e tij për forcimin e shtetit të pavarur të Kosovës: ka thënë Behgjet Pacolli.**

PRISHTINË, 23 SHKURT - Presidenti i Ri i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli ka nisur ditën e parë të punës me homazhe të varri të ish - presidentit Ibrahim Rugova dhe me pastaj ka vizituar familjen e tij. Pacolli ka vazhduar vizitën në Kompleksin Memorial në Prekaz dhe në familjen Jashari, pastaj ka shkuar te familja Haradinaj në Gllogjan dhe e ka përmbyllur ditën me vizitë të varri të Zahir Pajazitit, në Orllan. Në vizitën e parë ka premtuar se do ta vazhdojë rrugën e nisur nga ish – presidenti Rugova **“Isha në rezidencën e presidentit historik të Kosovës edhe njëherë të dëshmoj se jam më se i përgatitur ta çoj përpara idenë e tij për forcimin e shtetit të pavarur të Kosovës. Ka shumë punë për t'u bërë dhe i jam i gatshëm tani më shumë se asnjëherë për të vepruar”**, ka deklaruar Pacolli. I pyetur nga gazetarët nëse do të mund ta luaj rolin unifikues, Pacolli në ecje e sipër ka thënë se populli është i unifikuar. **“Sigurisht populli i Kosovës është i unifikuar dhe do të jetë i unifikuar”**, ka thënë ai. Eskorta e presidentit të sapozgjedhur ka vazhduar rrugën për në Prekaz. Aty është ndalur te Kompleksi Memorial për të bërë homazhe. Ka hyrë në kullën e Jasharëve, nga ku ka premtuar se familja Jashari do të ketë përfaqësinë e saj në Prishtinë. Ai është pritur nga Rifat Jashari, i cili i ka uruar suksese në drejtimin e vendit. **“Isha në familjen Jashari dhe premtova se do të punoj me çdo gjë që kam në dispozicion, që idenë e heroit kombëtar, Adem Jashari, ta çoj deri në fund. Ideja e tij ka qenë ndërtimi i një shteti të pavarur, ku qytetarët e Kosovës do të jetojnë me një mirëqenie të mirë, të qetë dhe të pavarur”**, ka deklaruar Pacolli. Eskorta e veturave të zeza e ka vazhduar rrugën për në Gllogjan të Deçanit, ku fillimisht, Pacolli ka bërë homazhe dhe ka vendosur kuror lulesh në Kompleksin Memorial Dëshmorët e Kombit. Gjatë vizitës në familjen Haradinaj, Pacolli është pritur nga Ilmi Haradinaj, baba i dëshmoreve Shkelzen e Luan Haradinaj. **“Kjo familje ka vlerë shumë të madhe për Kosovën. Këta dëshmorë që kanë rënë këtu, djemtë e tij që kanë rënë këtu e kanë vulosur pavarësinë e Kosoves. Është obligim yni që këtë pavarësi ta dekorojmë me një ndërtim të një shteti të sinqertë, ku të gjithë qytetarët e Kosovës do ta gjejnë veten, do të jetojnë në qetësi dhe mirëqenie”**, ka thënë Pacolli. Në anën tjetër, Ilmi Haradinaj ka thënë është i pajtimit dhe i kënaqur (me Presidentin v.j), veç i uroj punë të mbarë e me nder t’u shkoj punëve përpara”. Terri, kryetarin e ri të kosovarëve e ka gjetur në Orllan. Aty, ai ka vendosur kurora lulesh pranë varrit të dëshmorit Zahir Pajaziti, vëllanë e dëshmorit tonë Zahir Pajaziti. **“Vëllanë e dëshmorit e inkurajova dhe i premtova se do të punoj për ta çuar idenë dhe dëshirën e dëshmorit Zahir Pajaziti deri në fund, të krijoj dhe të forcoj një shtet që garanton të drejtat e barabarta për çdo qytetar dhe një shtet që krijon mirëqenie për çdo qytetar”**, ka thënë Pacolli. Ndërsa, Bajram Pajaziti ka thënë se beson që “presidenti i tanishëm do t’i çojë të gjitha proceset përpara”.



*President i Ri i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli ka nisur ditën e parë të punës me homazhe te varri i ish - presidentit Ibrahim Rugova*



*Pacolli ka vazhduar vizitën në Kompleksin Memorial në Prekaz*

## Presioni i Thaçit e nxjerr Pacollin president

Të dy kanë ndenjtur ulur afër gjatë gjithë kohës. E, Krasniqi ka qenë ai që edhe pas konstatimit të rezultatit të votimit nuk ka kumtuar urimin për Pacollin. Por, ky i fundit ka shkuar te kryeparlamentari për t'ia zgjatur dorën. Dikujt si Myzejene Selmanit i kanë shpëtuar lot gëzimi pas këtij lajmi, e ka pasur të tillë si Fatmir Limaj që në këtë moment është parë nervoz duke komunikuar me Thaçin, dhe duke tundur kokën. Pas seancës Limaj pastaj bëri publike votën e tij para gazetarëve. Unë e di një fakt - ky nuk ka qenë vullneti i qytetarëve të Kosovës. Jam thellësisht i bindur se kjo është jashtë vullnetit të qytetarëve të Kosovës dhe duke qenë i bindur në këtë, kam dhënë votën time kundër zgjedhjes së presidentit", ka deklaruar Limaj. Megjithëkëtë, e ka konsideruar si formë demokratike rrjedhën e procesit të votimit, ani se kreu i PDK se, Thaçi, ngujoi deputetët e tij për t'i bindur se duhej votuar për Pacollin. Kur është pyetur nëse kjo është kuptuar si presion nga Thaçi, Limaj ka thënë se këtu nuk ka koment. "Kjo është demokracia në Kosovë. Bile sot jam ndier jashtëzakonisht mirë që ka pasur një zhvillim demokratik brendapërbrenda. T'ju them të drejtën unë jam i befasuar pak në kuptimin pozitiv", ka thënë Limaj. "Nga demokracia dhe nga mendimi ndryshe nuk bën askush të frikohet". Normalisht, edhe për Thaçin ky ishte një proces demokratik. Sipas tij, procesi i votimit ka dëshmuar demokraci, rend demokratik, transparencë e përgjegjësi të lartë. Madje, i është kundërpërgjigjur Krasniqit, që e kishte kualifikuar ndërprerjen e seancës si shmangie nga normat. Krasniqi deri vonë ishte i propozuar i PDK - së për president. "Ne duhet të gjithë të mësojmë nga e kaluara që mbi të gjitha është interesi i Kosovës, interesi i të gjithë qytetarëve të saj, respektimi i kushtetutës dhe i ligjeve", ka thënë Thaçi. "Çdo zgjedhje nga përfaqësuesit legjitim të popullit të Kosovës ka kaluar nëpër një process legal dhe transparent nga Kuvendi, është legjitime dhe legale.

### Zotimet e Pacollit

Kështu e ka thënë edhe Pacolli, në fjalën e tij para deputetëve. Kapërcimi i "ankthit" në raundin e tretë të votimit, e ka bërë Pacollin të ndihet i lumtur që ka arritur ta realizojë ëndrrën shumëvjeçare për ta marr në duar timonin e shtetit. E ka pranuar se detyra e re, është sfidë për të, por është zotuar se do të vazhdojë rrugën për kryerjen e vizionit të presidentit, Ibrahim Rugova, si dhe për ta plotësuar amanetin e komandantit Adem Jasharit dhe gjithë të tjerëve që ranë për shtetin e pavarur të Kosovës. **"Nuk ekziston ndjenjë më e mirë të fitosh besimin e përfaqësuesve të popullit, që t'i shërbesh popullit dhe vendit tënd. Unë jam emocionuar, por nga ana tjetër shumë i përgatitur që këtë besim që m'u dha sot, ta arsyetoj me dinjitet dhe përgjegjësi me gjithë energjinë, dijen dhe qenien time"**, ka thënë ai në fjalimin e tij të parë si president. Të pranishmëve në sallë, u ka treguar se gjatë jetës së tij është ballafaquar me sfidat e jetës së civilizuar të perëndimit. **"Gjatë rrugëtimit tim, shpeshherë jam rrëzuar, por gjithmonë jam ngritur dhe kam vazhduar ende më i fortë"**, është shprehur ai. Tek kur është kthyer në Kosovë, ai e ka kuptuar se këtu edhe e ka vendin. **"Këtu zemra ime rreh ndryshe. Këtu i gëzohem tokës dhe diellit, më gëzon çdo gjë këtu dhe më fascionon perëndimi"**, ka thënë ai në mënyrë poetike. **"Perëndimi është prej nga erdha unë dhe perëndimi është rruga të cilën e synon Kosova"**. Si njeriu i parë i shtetit, ai e ka ndierë të nevojshme që t'i falënderojë miqtë e Kosovës, në veçanti Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkësinë

Evropiane për ndihmën e madhe që kanë dhënë në ndërtimin dhe forcimin e shtetit demokratik të Kosovës. Marrja e përgjegjësisë për ta drejtuar shtetin, është konsideruar prej tij, si një detyrë jo e lehtë. **"Kam zgjedhur pajtimin dhe angazhimin kundrejt konfliktit dhe pasivitetit"**, ka potencuar ai. Në këtë kontekst, ai ka garantuar se do të përfaqësojë interesat e të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa marrë parasysh bindjet politike, ani se zgjedhja e tij është kontestuar pikërisht për shkak të mungesës së bagazhit për të përfaqësuar këtë unitet. Është zotuar se do të punojë për një shtet të së drejtës dhe për një shtet ku askush nuk është mbi ligjin. Ka thënë se do ta mbështesë fuqishëm luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar duke siguruar pavarësinë e plotë të sistemit gjyqësor dhe kushtet optimale për punën e tyre. Ka premtuar se do ta promovojë idenë për një Kosovë të hapur e cila garanton lëvizje të lirë të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve, për një Kosovë të integruar plotësisht në shtëpinë e madhe evropiane, në NATO dhe në organizatat e tjera botërore. Nuk ka harruar të japë garanci se gjatë mandatit të tij do ta promovojë idenë për plotësimin e Kushtetutës në mënyrë që në të ardhmen Presidenti të zgjidhet me votën e lirë të qytetarëve. Para së gjithash, ai është zotuar se do ta promovojë idenë e funksionalizimit të referendumit si dhe idenë e ndryshimit të Ligjit zgjedhor. Pacolli, ndërkohë, e ka konsideruar të rëndësishëm dialogun me Serbinë. "Në këtë proces, Kosova do të prezantojë vlerat, idenë dhe vizionin për një fqinjësi të mirë, ku të drejtat e njeriut respektohen dhe vlerësohen në mënyrë reciproke, parimet e fqinjësisë së mirë janë bazë për integritet rajonale dhe globale", ka thënë ai. Fjalimin nuk e ka përmbyllur pa i thënë edhe dy - tri fjalë në gjuhën serbe. **"Na kraju svi smo ravno pravni gradjani Republike Kosova (Në fund të gjithë jemi qytetarë të Republikës së Kosovës)"**, ka thënë ai.

### **Synimet e Thaçit**

Zgjedhja e Pacollit president, i ka hapur rrugë votimit të kabinetit qeveritar. E ky votim ka kaluar pa asnjë telash. Nga 67 deputetët e pranishëm në sallë, vetëm deputetja serbe Rada Trajkovqi është deklaruar kundër. Kryeministri i rizgjedhur, Hashim Thaçi, ka shpallur në pika të shkurtëra pikat kryesore të programit qeverisës në mandatin katërvjeçar, ndonëse jo të gjithë janë pajtuar me atë që ai e ka proklamuar. Thaçi ka deklaruar se partnerët e koalicionit qeverisës janë të përkushtuar që të zbatojnë programin e përbashkët qeveritar i cili është përpiluar duke marrë në konsideratë nevojat e vendit dhe interesat e qytetarëve. Program qeveritar, sipas tij, është një kondensim i prioriteteve dhe programeve të partive politike që janë përbërës të koalicionit qeverisës. Qeveria Kosovës, sipas tij, do të zotohet se do të ndjekë politika të cilat: avancojnë integrimin euroatlantik të Kosovës dhe promovojnë raporte më të mira me shtetet fqinje; avancojnë përmbylljen e Planit Gjithëpërfshirës të Ahtisarit duke përfshirë decentralizimin efektiv të qeverisjes si dhe politika që promovojnë mirëqenien më të lartë ekonomike të të gjithë qytetarëve të Kosovës bazuar në rritjen ekonomike të orientuar nga sektori privat i tregut të lirë me përqendrim në krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e të hyrave. Sipas tij, Qeveria do të jetë e përkushtuar për privatizimin asetëve të caktuara shtetërore në mënyrë transparente; për zvogëlimin e rregullimit të tepërt qeveritar të aktivitetit privat ekonomik; implementimin e politikave tërheqëse investive; modernizimin e sektorëve të telekomunikimit dhe energjetik të vendit dhe revitalizimin e hovshëm të bujqësisë, teknologjisë dhe minierave duke e zhvilluar më tej infrastrukturën e tyre. Pjesë e programit qeverisës, Thaçi ka thënë se do të jetë edhe: forcimi i sundimit të ligjit; mostoleranca ndaj korrupsionit dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare për qëllime të përfimit personal; zvogëlimi i lëndëve të mbetura në gjykata; përmirësimi i qasjes në drejtësi për qytetarët; zhvillimi i mekanizmave alternativë për zgjidhjen e shpejtë të lëndëve civile si dhe përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe

i shëndetësisë. Thaçi është zotuar se do të jetë i hapur që të punojë me të gjitha partitë politike parlamentare, por edhe me ato që nuk janë pjesë e parlamentit. Ka thënë se do të bashkëpunojë edhe me përfaqësuesit e shoqërisë civile, me partitë politike në opozitë dhe me të gjithë ata që janë të gatshëm për të punuar për të mirën e Kosovës.

### **Bojkoti i opozitës**

Të tri partitë opozitare, para se ta bojkotojnë seancën i kanë dhënë arsyetimet pse janë kundër zgjedhjes së Behgjet Pacollit president dhe pse nuk duan ta votojnë kabinetin qeveritar. Ismet Beqiri ka deklaruar se Grupi parlamentar i LDK - së konsideron se zgjedhjet e fundit nuk mund të prodhojnë një qeveri dhe president legjitim, pasi ato kanë qenë të manipuluar. Marrëveshja e koalicionit për qeveri dhe president, sipas tij, nuk është bërë mbi bazën e interesave të vendit, por mbi bazën e interesave personale. "Dobësitë e manifestuara në këto zgjedhje e vënë në dyshim legjitimitetin, qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e plotë të institucioneve nga këto zgjedhje", ka theksuar Beqiri. LDK, sipas tij, konsideron se mundësia më e mirë për daljen nga kjo situatë është një marrëveshje politike ndërmjet subjekteve politike parlamentare në një atmosferë të qartë pune për t'u bërë gati për zgjedhje ardhshme, për ta kryer regjistrimin e popullsisë, për t'i pastruar listat zgjedhore si dhe për ta ndryshuar sistemin zgjedhor. Atëherë do të organizoheshin zgjedhjet parlamentare demokratike vitin e ardhshëm të cilat do të garantonin legjitimitetin demokratik të brendshëm dhe ndërkombëtar të institucioneve të dala nga vota e qytetarit", është shprehur Beqiri. Më i gjatë në dhënien e arsyes për bojkot të votimit të presidentit dhe të qeverisë, ka qenë deputeti i "Vetëvendosjes", Visar Ymeri. Në emër të subjektit politik, ai e ka cilësuar Behgjet Pacollin të papërshtatshëm edhe politikisht edhe personalisht për të shërbyer si president i vendit. Së pari, Ymeri e ka fajësuar atë për mbështetje të Planit të Ahtisaarit e pastaj edhe për moskundërshtim të procedurave të miratimit të simboleve të shtetit. "Ky moskundërshtim e bënë Pacollin dhe të tjerët si ai, një njeri joparimor, që nuk e çan kokën fare për zhvillimin politik të vendit. Pra, që e çan kokën vetëm për interesat e ngushta personale", ka thënë Ymeri. Behgjet Pacolli dhe AKR - ja, sipas tij, gjatë tërë legjislaturës së kaluar kanë funksionuar më shumë si shërbim i Hashim Thaçit dhe i qëllimeve të tij politike, se sa si opozitë çfarë formalisht ka qenë. "Pacolli e ndihmonte politikisht Thaçin, e Thaçi e shpërblente Pacollin me tenderë (p.sh. Pacolli i mori nga Thaçi 15 milionë euro për renovimin e Pallatit të Shtypit). Ishte ky Pacolli ai që ia mundësoi Hashim Thaçit zgjedhjet e jashtëzakonshme në një mot të keq, zgjedhje këto të përshpejtuara dhe të organizuara si mos më keq.

## Presidenti "kazanovë", zonja e parë ruse

**Presidenti i ri i Kosovës, Behgjet Pacolli, ka pasur lidhje martesore dhe jashtëmartesore me së paku katër gra. Me tri prej tyre ka edhe fëmijë. Gruaja e tij aktuale është Masha, e cila është nga Rusia. Ajo tash është edhe zonja e parë e shtetit të Kosovës**

PRISHTINË, 22 SHKURT - Biznesmeni që i hyri në mënyrë aktive politikës në vitin 2006, me krijimin e Aleancës Kosova e Re, nuk e fsheh të vërtetën se në të kaluarën e tij nuk ka bërë jetë të qetë familjare. E pranon që ka pasur lidhje martesore dhe jashtëmartesore me së paku katër gra. Me tri prej tyre, ka edhe fëmijë. Në librin autobiografik "Nga sfida në sfidë", të cilën e ka botuar në dhjetor të vitit të kaluar, Pacolli thotë të mos e ketë dëshiruar një rrjedhë të tillë të jetës, por ja që nuk kishte mundur ta ndryshonte atë. "Nuk është se nuk e dëshiroja, nuk është se nuk isha i gatuar për këtë, por thjesht e kisha të pamundur. Puna e pandërprerë, udhëtimet e shumta, ndërrimet e shpeshta të vendbanimit, të gjitha këto krijojnë rrethana që të mos mund t'i kushtohesh familjes, asaj që quhet familje e ngushtë", shpjegon ai. Martesa e tij e fundit, është e lidhur me Mashën. Tash, ajo është zonja e parë e Kosovës. Është nga Rusia, por Pacolli thotë të ketë prejardhje burjate. Ky është një popull mongol që kryesisht jeton në Rusi. Ndonëse nuk janë popull i madh në numër, as gjysmë milioni, ata flasin gjuhën e tyre "burjate". Masha, siç tregon Pacolli, është në moshën 30 vjeçare dhe i pëlqen të merret me art. Aktualisht, ajo udhëheq fondacionin "Ibrahim Kodra" dhe ekspozita dhe organizon vernisazhe të ndryshme. Veç kësaj, Masha e udhëheq edhe galerinë e përhershme të arteve, e cila gjendet në hotelin e të shoqit "Diamond gallery", Pacolli thotë se ajo flet rrjedhshëm pesë gjuhë përfshirë këtu edhe gjuhën shqipe. Me Mashën, Pacolli i ka tre fëmijë: Hanën pesëvjeçare, Isën trevjeçar dhe Diarin, i cili ende s'i ka mbushur një muaj. Hana ia ka ripërtërirë emrin e hallës së madhe të Pacollit, Mihanës, kurse Isa, bart emrin e gjyshit të tij. Përveç fëmijëve që i ka me Mashën, Pacolli i ka edhe dy vajza të tjera, nga lidhjet jashtëmartesore. E madhja është Arbëresha, e lindur më 1977, e që jeton në Austri, dhe tjetra është Selena, 24 vjeçare. Të parën e ka me një austriake, kurse të dytën me një sllovene. Arbëresha, siç thotë Pacolli, ka studiuar në SHBA, dhe tani punon për një bankë të madhe austriake. Ndërsa Selena, emri i së cilës po të përkthehet nga greqishtja i bie "Hana", thuhet se ka studiuar dhe ende studion në Lugano, Cyrih dhe në Londër. Pacolli tregon për të se i pëlqen të udhëtojë dhe të kalërojë. Thotë se ajo ka qenë shpesh edhe në Shqipëri ku edhe ka zënë miq. Më dëshirë të Pacollit, ajo do të martohej për ndonjë shqiptar, megjithatë, ai nuk dëshiron të ndërhyjë në fatin e jetës së saj. Për të Pacolli thotë se është ekonomiste e mirë dhe se i pëlqen arti. Presidenti ka dëshirë që t'i lidhë sa më shumë fëmijët me Kosovë. Beson se deri diku edhe ia ka arritur ta bëjë këtë. **"(Fëmijët v.j) flasin shqip shumë mirë, vijnë shpesh në Kosovë, ku kënaqen shumë dhe më çlodhin me lodrimet e tyre"**, shkruan ai. Pacolli, nuk ka arritur ta ketë së paku një trashëgimtar me ish këngëtaren e njohur italo-shqiptare Ana Oxa, edhe pse më të ishte i martuar për pak vite. Ai konsideron se ka qenë mjaft i hapur për të kaluarën e tij dhe për familjen në librin autobiografik. Prandaj, ai u rekomandon të gjithë kureshtarëve, që të kaluarën e tij, ta kërkojnë aty. **"Për ata që dojnë të dinë më shumë për mua ju lus që ta lexoni librin tim autobiografik. Aty jam rrefyer, aty do ti gjeni ramjet dhe ngritjet e mia, të mirat e të keqijat, aty jam unë"**, ka thënë Pacolli para disa ditësh në murin e tij në Facebook. Pararendëse të Mashës, në cilësinë e



zonjave të para të shtetit kanë qenë Fanë Rugova, kanë qenë bashkëshortja e presidentit të parë të Kosovës, Ibrahim Rugova, pastaj Nezafete Sejdiu, bashkëshortja e presidentit Fatmir Sejdiu dhe Sevdije Krasniqi, fundmi, bashkëshortja e Jakup Krasniqit. Statusi i zonjës së parë të shtetit, është i rregulluar me Ligjin për presidentin, kurse funksionet ceremoniale dhe protokollare të saj janë të definuara me Ligjin mbi protokollin shtetëror.

---

## **1/Zoti na ndihmoftë në rrugëtimin tonë të përbashkët!**

## **2/Koalicioni PDK-AKR**

---

### **Behgjet Pacolli**

**“Sot ndihem i përrulur para jush dhe ndjej se nuk më mjaftojnë fjalët që të përshkruaj këtë moment. Nuk ekziston ndjenjë më e mirë se të fitosh besimin e përfaqësuesve të popullit, që t'i shërbesh popullit dhe vendit tënd”**

Sot është një ditë e madhe, për mua fillon sfida e radhës me plot përgjegjësi. Ju, të dashur deputetë, më zgjodhët mua për të vazhduar rrugën për përkryerjen e vizionit të Presidentit historik, dr. Ibrahim Rugovës, për të plotësuar amanetin e heronjve tanë, komandantit historik Adem Jasharit dhe gjithë të tjerëve që ranë për shtetin e pavarur të Kosovës. Falënderoj presidentin e Republikës së Kosovës, dr. Fatmir Sejdiun, dhe ushtruesin e këtij posti z. Jakup Krasniqin, për angazhimin dhe përkushtimin e tyre në këtë detyrë. Të dashur qytetarë, sot ndihem i përrulur para jush dhe ndjej se nuk më mjaftojnë fjalët që të përshkruaj këtë moment. Nuk ekziston ndjenjë më e mirë se të fitosh besimin e përfaqësuesve të popullit, që t'i shërbesh popullit dhe vendit tënd. Unë jam i emocionuar, por nga ana tjetër shumë i përgatitur që këtë besim që m'u dha sot, ta arsyetoj me dinjitet dhe përgjegjësi me gjithë energjinë, dijen dhe qenien time. Jam krenar që jam një nga ju. I lindur dhe i rritur në mjediset e një familjeje tipike të Kosovës, domosdoshmëria më shtyu të ballafaqohem me sfidat e jetës së civilizuar të Perëndimit, jetë kjo jo e lehtë për një kosovar të thjeshtë. Gjatë rrugëtimit tim, shpesh herë jam rrëzuar, por gjithmonë jam ngritur dhe kam vazhduar ende më i fortë. Ky rrugëtim më solli edhe suksese me të cilat unë krenohem pasi ato i kam arritur me punë. Ato suksese janë sukseset e mia dhe bashkëpunëtorëve e fafesisit tim. Këto sfida dhe suksese të arritura në Perëndim duhej të plotësoheshin me arritjet e vendit tim. Unë u ktheva në Kosovë dhe e kuptova se këtu e kam vendin, në mesin e njerëzve të mi. Këtu zemra ime rrah ndryshe. Këtu i gëzohem tokës dhe diellit, më gëzon çdo gjë këtu dhe më fascinon Perëndimi. Perëndimi është prej nga erdha unë dhe Perëndimi është rruga të cilën e synon Kosova. I falënderoj miqtë tanë perëndimorë, në veçanti Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkësinë Evropiane, për ndihmën e madhe që kontribuon dhe vazhdojnë të kontribuojnë në ndërtimin dhe forcimin e shtetit demokratik të Kosovës për të gjithë qytetarët e saj, për shqiptarët, za serbe, tyrkler için, za bosnjake i crnogorce“, për romët, ashkalinjtë, dhe gjithë të tjerët. Kosova ka fituar pavarësinë, lirinë dhe ndërton barazinë. Tani po ndërtojmë shtetin. Këto arritje i synuam të gjithë dhe punuam me aq sa ditëm dhe mundëm, por ende jemi larg prej të qenit të kënaqur me arritjet tona. E arritur e veçantë e shtetit të ri të Kosovës është njohja nga 75 shtete të botës, të cilat i falënderoj në emër të popullit të Kosovës. Kosova sot po ballafaqohet me sfidat më të mëdha që nga çlirimi i saj. Ato janë të shumta dhe do të jenë përgjegjësi e funksionit tim që ma besuat sot. Përpjekjet e kosovarëve për një të ardhme më të mirë janë virtyt i kosovarëve, jo dobësi. Asnjëherë nuk iu jemi dorëzuar sfidave dhe vështirësive, prandaj, përpjekjet tona për të forcuar institucionet dhe një Kosovë ndryshe, duhet të trajtohen si virtyt dhe domosdoshmëri e kohës në të cilën jetojmë. Ishim dëshmitarë të përflitjeve, akuzave, etiketimeve të përmasave globale të drejtuara kundër shtetit të Kosovës dhe njerëzve të saj. Por, ju garantoj të dashur deputetë, se kjo nuk është asgjë e jashtëzakonshme - e njëjta ka ndodhur edhe diku tjetër. Partia Demokratike e Kosovës, duket se i kishte arritur të gjitha marrëveshjet e nevojshme për të ndërtuar institucionet e reja të vendit, me përjashtim të atij më kryesorit, PDK - PDK. E gjitha ajo që ndodhi brenda seancës

së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës, tregon se partia më e madhe në vend ka kalkuluar deri në sekondat e fundit, apo, më saktë, siç e konfirmoi edhe kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, deri në shkeljen e radhës së Kushtetutës, kur Hajredin Kuçi kërkoi 5 minuta pushim për konsultim të brendshëm. Presidenti i AKR - së, Behgjet Pacolli, nuk është as për së afërmi problemi kryesor i Fatmir Limajt e as i Jakup Krasniqit. Para tre vjetësh, nëse kishte zyrtar të lartë të PDK - së që preferonte shumë më shumë koalicionin me AKR - në e Pacollit, ishte nënkryetari i PDK - së, Limaj. Bile, atë kohë, ndonëse kishte shumë më tepër presion nga ndërkombëtarët për një koalicion me LDK - në, brenda PDK - së, kundërshtari më i madh i këtij koalicioni ishte z. Limaj. Problemi i vazhdueshëm i kësaj partie është rivaliteti i skajshëm i cili përfundimisht nuk mund të hidhet më poshtë, mes Hashim Thaçit dhe Fatmir Limajt. Intervista e Limajt në Klan Kosova, para një Baton Haxhiu të shastisur për atë se çka thoshte ish - ministri, nëse u bë me ndonjë qëllim, ishte thjesht dhe vetëm me qëllim që të dërgojë mesazhe drejt kryetarit të PDK-së, Hashim Thaçi. Nxjerrja në shesh e jo pak çështjeve, si shkarkimi i një shefi të një agjencie me dyshimin për korrupsion nga Thaçi dhe rikthimi në punë i të njëjtit me "urdhër" nga ndërkombëtarët, tregon se ku i dhemb më shumë Limajt. Pamundësimi për të hyrë në qeveri, me "urdhër" të atyre ndërkombëtarëve që e përkrahën dikur dhe shfrytëzimi i këtij presioni nga ana e Thaçit për të eliminuar Limajn, përbën problemin kryesor, e jo zgjedhja e Pacollit si president.

---

## **Biografia e Presidentit të Kosovës, Behgjet Pacollit**

---

**Behgjet Pacolli u lind në Marec, është i biri i Isa dhe Nazmije Pacollit. Pas shkollës fillore dhe të mesme, Pacolli kaloi në Prishtinë që të vazhdonte shkollimin e tij. Pas katër viteve ai përfundoi nivelin e Gjimnazit dhe Pedagogjisë. Në vitin 1970 Pacolli shkoi në Hamburg ku diplomoi në Ekonomi-Marketing dhe Menaxhim.**

### **Karriera në biznes**

Në vitin 1974, Pacolli përfundoi shërbimin ushtarak dhe u kthye në Kosovë. Në vitin 1976 Pacolli shkoi nga Kosova për të punuar si menaxher i shitjes për kompaninë Austriake Peter Zimmer. Prej vitit 1977 deri në vitin 1990 Pacolli ka punuar ne Interplastica Engineering si menaxher i lartë. Në vitin 1982 Pacolli specializoi në Marketing dhe Menaxhim në Moessinger Institute, Cyrih. Në vitin 1990, pas një marrëveshjeje paqësore me shokun dhe ish shefin e tij Max Gygax, Pacolli la Interplastikën që ta krijonte Mabetex Project Management (më vonë e njohur si Mabetex Group). Pacolli sot është kryetar dhe CEO i Mabetex Group, një kompani që si aktivitet themelor ka studimin, planifikimin, projektimin dhe ndërtimtarinë globale dhe e cila ka 19 përfaqësi anembanë botës, duke përfshirë Amerikën, Evropën, Afrikën dhe Azinë. Më 1992, gjatë realizimit të projekteve ndërtimore në Yakutsk, Rusi, Pacolli bashkëpunoi me kryetarin e komunës të Yakutsk Pavel Borodin. Më 1993 pasi Borodini u emërua menaxher i pronave presidenciale, Mabetex-it iu ofrua një kontratë ndërtimore për rinovimin e Kremlinit të Moskës. Gjatë viteve 1998-1999 prokurori i përgjithshëm i Rusisë Yury Skuratov filloi një hetim kundër anëtarëve të familjes së Presidentit Boris Jelcin për të cilët dyshohej për marrje të mitos edhe nga Mabetex-i. Ky hetim u hodh poshtë pas mandatit të tij. Në vitin 2000, Pacolli paditi Skuratovin për shpifje dhe fitoi gjyqin. Gjatë viteve 2000-2001, përderisa hetohej rasti i shpërlarjes së parave ndaj Borodinit, i cili u arrestua në SHBA, Pacolli u përfol për dhënie të mitos zyrtarëve të lartë rusë dhe vetëm njëherë u thirr në bisedë në hetuesinë Zvicerane. Akuzat u tërhoqen në mungesë të dëshmive.

### **Inkuadrimi në politikë**

Më 17 Mars 2007 ai themeloi partinë Aleanca Kosova e Re, e cila në zgjedhjet parlamentare të vitit 2007 u radhit si partia e tretë më e votuar. Ajo fitoi 13 vende në Parlamentin e Kosovës.

### **Jeta personale**

Në vitin 1996 Pacolli u martua me këngëtaren italiane me prejardhje shqiptare Anna Oxa. Kjo martesë zgjati deri në vitin 2002. Pacolli është baba i një djali dhe tri vajzave. Ai posedon dy nënshtetësi, zvicerane dhe kosovare.

### **Aktivitetet kryesore**

Pacolli punoi në ndërtimin e qytetit verior të Rusisë, Yakutsk. Në vitin 1992 ai shkoi në Yakutsk në republikën më të madhe veriore të Federatës Ruse që të merrej me aktivitetet e ndërtimit, duke filluar nga spitali më i madh modern Qendra Shëndetësore për Nëna dhe Fëmijë (Yakutsk). Në këtë mënyrë ai ra në kontakt me Pavel Borodinin, i cili u emërua menaxher i pronave presidenciale ai kontaktoi Pacollin për fillimin e punëve ndërtimore në Moskë, duke

filluar me renovimin komplet të ish Parlamentit të Federatës Ruse “Shtëpia e Bardhë”, pas bombardimit në Moskë (Shtator 1993 – Qershor 1994), renovimin e Ndërtesës së Këshillit Federativ të Rosisë dhe të Dumës Shtetërore (Shtator 1993 – deri në fund të 1994), renovimin e hotelit të parë luksoz në epokën e re ruse, Swiss Diamond Hotel Moscow (1995 – 1997), si dhe renovimin e kompleksit të ndërtesave historike në Kremlin (1995 – 1996). Në Norilsk dhe Sary Oskol ai ndërtoi spitalet e përgjithshme. Përpos Rosisë, aktivitetet e tij ndërtuese u zhvilluan edhe në Itali, Kazakistan dhe Uzbekistan. Pacolli bëri projektin për renovimin e teatrit La Fenice pas djegies së tij. Në Kazakistan, ai bëri ndërtimin e qendrave kryesore qeveritare të kryeqytetit të ri, Astana. Projekti i tij, pallati presidencial “Akkorda” u shpërblye nga Qeveria e Kazakistanit. Në Kazakistan Pacolli gjithashtu bëri ndërtimin e disa qendrave spitalore, universitare dhe sportive. Në Uzbekistan Pacolli u shpërblye për ndërtimin cilësor të ndërtesës së Komunës së Tashkentit.

### **Aktivitetet tjera**

Pacolli dha ndihmën humanitare në kampin e refugjatëve në Mal të Zi dhe në Kukës si dhe ndihmën e koordinuar në Kosovë pas mbarimit të luftës. Përveq kësaj, Pacolli dhuroi 5.1 milion euro për ndërtimin dhe furnizimin komplet të Universitetit Amerikan në Prishtinë [8]. Në vitin 2004, Pacolli bëri të mundur lirimin e tre punëtorëve të OKB-së të marrur peng në Afganistan (Shqipe Hebibi, Annette Flannigan dhe Angelitoo Nayan) [9]. Në vitin 2006 ai gjithashtu ndihmoi në lirimin e korrespondentit italian Gabriele Torsellos i cili ishte rrëmbyer në Afganistan [10] [11]. Pacolli kontribuoi në zgjerimin e ndërtesës qendrore të Universitetit të Prishtinës. Ai bëri edhe restaurimin e Xhamisë së Llapit, monument ky i shekullit XIV.

### **Fondacionet e Behgjet Pacollit**

- Fondacioni Humanitar Behgjet Pacolli
- Fork (Fondacioni për Organizimin dhe Ristrukturimin e Kosovës)
- Fondacioni Ibrahim Kodra
- Fondacioni SEED (Fondacioni për zhvillim të Evropës Juglindore) financim dhe mbështetje për Konferencat Ndërkombëtare dhe Logjistikë
- AKR – Aleanca Kosova e Re, Organizata për lobim (Alliance For New Kosovo) në Washington D.C. Deri 2007 veproi për lobim për pavarësinë e Kosovës



---

## **Pacolli në Kushtetuese**

---

**LDK-ja dhe AAK-ja kanë paralajmëruar se do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, sa më shpejt që të jetë e mundur, për mënyrën e votimit të presidentit. Këto dy parti konsiderojnë se gjatë votimit për president është shkelur Kushtetuta e Kosovës.**

Partitë politike opozitare në Kosovës, zgjedhjen e presidentit të Kosovës dhe votimin në Kuvendin e Kosovës të kabinetit të ri qeveritar e kanë cilësuar shkelje të kushtetutës, dhe se kjo është bërë për interesa personale dhe jo për interesat e qytetarëve të vendit. Kështu, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës kanë marrë vendim që seancën e zgjedhjes së presidentit të Kosovës ta dërgojnë në Gjykatën Kushtetuese. Ndërsa një vendim të tillë Lëvizja "Vetëvendosje" nuk e ka marrë ende. Kështu zyrtarë të AAK-së kanë thënë se ngjarja e djeshme në Kuvendin e Kosovës i ka dhënë një hije të keqe brenda popullit të Kosovës dhe e ka zbehur imazhin e saj në Bashkësinë Ndërkombëtare. Ahmet Isufi, nënkryetar i AAK-së, ka thënë se AAK-ja, rastin e zgjedhjes së presidentit dhe qeverisë së Kosovës do ta dërgojë në Gjykatën Kushtetuese, sa më shpejt që është e mundur.

### **Kundër diktaturës**

"Ajo që ndodhi dje në Kuvendin e Kosovës është një tmerr i vërtetë. Dje është parë se si është dhunuar demokracia në Kuvendin e Kosovës dhe është shkelur vullneti i qytetarëve të Kosovës. Kështu që AAK-ja ka vendosur që rastin ta procedojë në Gjykatës Kushtetuese, sa më shpejt që është e mundur", - ka thënë Isufi, i cili ka shtuar se ky veprim do të mbahet në mend për të keq. Isufi ka thënë se duke u bazuar në këtë, AAK do t'i përdorë të gjitha metodat demokratike para qytetarëve dhe botës demokratike se nuk lejon diktaturë në vend, nuk lejon imponime në Kuvend. "AAK-ja, duke ditur se ka pasur degradim edhe gjatë procesit të zgjedhjeve, por edhe trysni mbi deputetë gjatë votimit në seancën e së martës, për ne kjo është e papranueshme dhe nuk duhet të lejohet në Kosovë. AAK-ja do t'i përdorë të gjitha metodat demokratike para qytetarëve dhe botës demokratike se nuk lejon imponime në Kuvend, sepse për tri vite me radhë e ka dirigjuar dikush nga prapaskena, dhe kjo u pa dje nëpërmjet mesazheve telefonike", - ka thënë ndër të tjerash Isufi.

### **Votimi Jokushtetues**

Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës ka vlerësuar se në bazë të zhvillimit të seancës së djeshme të Kuvendit të Kosovës, ku është votuar për president, është shkelur Kushtetuta e Kosovës. "LDK-ja, institucionet e dala nga seanca e djeshme, i konsideroj jolegjitime. Për këtë ne do t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, për të kërkuar mendimin e kësaj gjykate se a është shkelur kushtetuta apo jo", - ka thënë përgjegjësi për informim i LDK-së, Kujtim Shala. Në anën tjetër, Lëvizja "Vetëvendosje" ende nuk ka marrë vendim nëse seancën e djeshme do ta dërgojmë ose jo në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. "Ende nuk kemi vendosur nëse do ta bëjmë apo jo një gjë të tillë", - ka thënë aktivisti i Lëvizjes "Vetëvendosje" Glauk Konjufca.

## Pacolli e nis me homazhe

**Një ditë pasi mori bekimin e Kuvendit për postin e presidentit, Behgjet Pacolli ka filluar punën me homazhe dhe zotime për ndërtimin e shtetit**

PRISHTINË - Ditën e parë të punës, presidenti i sapo zgjedhur i Kosovës, Behgjet Pacolli, e ka nisur me homazhe të familjet që kanë dhënë më së shumti për lirinë e vendit. Ai ka vizituar fillimisht varrin dhe familjen e presidentit të ndjerë Ibrahim Rugova, për të vazhduar më pastaj te kompleksi memorial Adem Jashari në Prekaz, te varrezat e dëshmorëve në Glllogjan, si dhe te familja e Zahir Pajazitit në Orllan të Gallapit. Para varreve të dëshmorëve dhe para familjarëve të tyre, presidenti i kontestuar nga opozita kosovare u betua se do të punojë për forcimin e shtetit të pavarur të Kosovës. I bindur se do të luajë rol unifikues, ashtu sikurse e parasheh edhe Kushtetuta, Pacolli gjatë vizitës në shtëpinë e ish - presidentit Rugova tha se do të ndjekë me besnikëri rrugën e nisur nga presidenti i ndjerë. **"Isha në rezidencën e presidentit historik të Kosovës edhe njëherë që të dëshmoj se jam i përgatitur ta çoj përpara idenë e tij për forcimin e shtetit të pavarur të Kosovës. Ka shumë punë për t'u bërë, dhe asnjëherë nuk kam qenë më i gatshëm se tani për të vepruar"**, tha Pacolli. Eskorta e presidentit të ri më pastaj është nisur në drejtim të Prekazit, i cili fillimisht ka vendosur kurora lulesh mbi varrin e komandantit legjendar Adem Jashari, ndërkaq ka nderuar edhe dëshmorët e tjerë. Në Kullën e Jasharëve, presidenti Pacolli është pritur nga Rifat Jashari, i cili i ka dëshiruar suksese në drejtimin e vendit, ndërsa Pacolli premtoi se do të punojë për konkretizimin e amanetit të dëshmorëve për ndërtimin e shtetit të pavarur, sovran dhe demokratik. Madje, Pacolli i premtoi familjes Jashari se do ta ketë përfaqësinë në Prishtinë. **"E sigurova familjen Jashari se do të punoj me çdo gjë që kam në dispozicion, që idenë e heroit kombëtar, Adem Jashari, ta çoj deri në fund... Jam krenar që isha këtu... kjo familje është e shenjtë"**, ka thënë Pacolli gjatë vizitës së tij në Prekaz. **"Do të mundohem që në mandatin tim pesëvjeçar si president i Kosovës të krijohen kushte që kjo familje të ketë në Prishtinë një përfaqësi institucionale, aty ku njerëzit do të shkojnë, do ta shohin dhe do të takohen. Këtë unë do ta bëj brenda mandatit pesëvjeçar"**, premtoi i pari i vendit. Ndërkaq, në pyetjen e gazetarëve se nëse zgjedhja e tij si president është në kundërshtim me Kushtetutën e vendit, Pacolli duke u paraqitur se nuk dëgjonte asgjë, me një buzëqeshje, vetëm ka nxituar të largohet nga gazetarët dhe është futur në veturë. Ndërkaq më i vjetri i Jasharëve, Rifati, duke uruar Pacollin për postin që ka marrë, i dëshiroi atij suksese në punën e tij. Ndërkaq, në një konstatim të gazetarëve se familja Jashari më shumë e ka përkrahur Jakup Krasniqin për president të vendit, Rifat Jashari është përgjigjur shkurt: "Atë nuk e di askush. Veç Zoti i di ato sene". Pas Prekazit, cak i vizitës së presidentit të ri ka qenë edhe familja Haradinaj në Glllogjan të Deçanit dhe më pastaj Orllani i heroit kombëtar Zahir Pajziti. Zgjedhja e Behgjet Pacollit president i Kosovës ka zgjuar reagime të ashpra te subjektet politike opozitare, por edhe te shoqatat e dala nga lufta e UÇK - së , të cilat thonë se nuk do ta njohin Pacollin për president të Kosovës.

---

## **Pacolli drejt Kushtetueses**

---

**Qysh në ditën e parë të punës, Behgjet Pacolli ka marrë sinjale nga partitë opozitare dhe nga një pjesë e madhe e shoqërisë civile se brenda pak kohësh do të përballet me “gardianin” e Kushtetutës, për të parë nëse zgjedhja e tij në postin e presidentit ka qenë në harmoni me aktin më të lartë juridik të shtetit dhe me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Nëse opozita nuk e çon përpara këtë çështje, atëherë shoqëria civile paralajmëron se do të ketë protesta.**

Mirëpo, siç ishte parë, as në raundin e parë e as në atë të dytin nuk kanë qenë prezentë 81 deputetë. Prandaj, ne si parti mund të kërkojmë nga Gjykata Kushtetuese që ta japë interpretimin nëse ka qenë gjithçka në rregull me kuorumin", ka thënë ai përmes një bisede telefonike. Në Rregulloren e Punës së Kuvendit, kuorumi llogaritet nëse në sallë janë të pranishëm shumica e deputetëve, që i bie së paku 61 deputetë, megjithatë në nenin për zgjedhjen e presidentit kërkohen votat e minimum 81 deputetëve në dy raundet e para, por nuk përmendet çështja e kuorumit. E në rastin e zgjedhjes së Pacollit president, të pranishëm në të tria raundet e votimit kanë qenë 67 deputetë. Shala bazohet edhe në fjalët e kryetarit të Kuvendit, Jakup Krasniqi, i cili, gjatë kohës së tërheqjes së grupit parlamentar të PDK - së nga salla, para futjes në raundin e tretë të votimit, ka deklaruar se çdo ndërhyrje në ndryshim të rezultatit të votimit është antikushtetuese. “Ta dini se kjo ishte shkelje e Kushtetutës dhe e Rregullores së Kuvendit, sepse ky është një presion mbi deputetët e Kuvendit të Kosovës. Dhe çdo ndryshim i rezultatit është i papranueshem”, ka thënë Krasniqi të martën. Se kur mund ta ngrejë në Gjykatë çështjen e presidentit Shala, nuk ka qenë i sigurtë. Por ka thënë aktualisht këtë materie janë duke e trajtuar ekspertit juridikë të partisë.

### **Proces i Shantazhuar**

Linjë të njëjtë kanë mbajtur edhe drejtuesit e AAK - së. Edhe ata kanë paralajmëruar se do të kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese interpretimin nëse zgjedhja e institucioneve të reja është në pajtim me aktin më të lartë juridik të Kosovës. Sipas nënkryetarit të AAK - së, Ahmet Isufi, ngjarja e së martës në Kuvendin e Republikës së Kosovës i ka dhënë një hije të keqe jo vetëm institucionit, mirëpo edhe asaj për çka ka punuar qe një dekadë. Sipas kësaj partie, të martën është dhunuar demokracia në Kuvendin e Kosovës, para syve të qytetarëve të Kosovës dhe para bashkësisë ndërkombëtare. "U shkel Kushtetuta e Republikës Kosovës. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në ditët në vijim, do t'i përdorë të gjitha instrumentet demokratike për t'i dalë në ballë kësaj të keqeje që po i vjen vendit dhe për ta parandaluar degradimin e lirisë dhe të shtetit të Kosovës", ka thënë Isufi. Deputetët, sipas tij, kanë rënë nën presionin e tendencës që dikush ta marri pushtetin me çdo kusht. Të zgjedhurit e popullit u shantazhuan dhe u manipuluan që vetëm brenda 5 minutash ta ndërrojnë qëndrimin e tyre parimor. Ky veprim është dëshmia më e mirë se ky koalicion dhe kjo qeveri nuk janë legjitime. Ky president nuk e përfaqëson popullin e Kosovës, ndërsa kjo qeveri është qeveri interesash e dy individëve, të cilët vepruan për t'i shkatërruar institucionet, e tani po bashkohen për ta rrënuar gjithë atë që është arritur nga sakrificat dhe gjaku i dëshmorëve", ka thënë Isufi. Nënkryetari i AAK - së ka thënë se edhe reagimi i kryetarit të Kuvendit të Kosovës për ta ndaluar degradimin" u injorua



nga ata që nuk njohin asnjë normë demokratike në shoqëri, por mbi të gjitha e kanë epshin për pushtet". Isufi ka paralajmëruar se do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për të interpretuar rastin, pas një konsultimi me partitë e tjera opozitare. Sipas Isufit, për AAK - në zgjedhja e Pacollit është e kontestueshme. "Nuk e përfaqëson unitetin e popullit. Zgjedhja është e kontestuar" ka thënë Isufi, i pyetur nëse e pranojnë Pacollin për president të Kosovës. Nënkryetari i AAK nuk e ka përjashtuar mundësinë e AAK - së të organizojë edhe protesta kundër zhvillimeve që kanë ndodhur me zgjedhjen e presidentit dhe të Qeverisë së re. Sipas tij, AAK - ja do t'i shqyrtojë të gjitha mjetet demokratike. Se gjatë procesit të zgjedhjes së presidentit ka pasur shkelje kushtetuese, janë të bindur dhe deputetët e Vetëvendosjes. Nënkryetari i Kuvendit nga ky subjekt politik, Glauk Konjufca, ka thënë se shkelja e Kushtetutës është bërë nga vetë kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, që i ka lejuar deputetët të dalin nga salla pas raundit të dytë të votimit.

### **Paralajmërim i protestave**

Drejtori i "Rockerfeller Brothers Fund" për Ballkanin Perëndimor, Haki Abazi, një ditë më herët ka thënë se të martën ka përfunduar cikli i dhunimit të institucioneve, të Kushtetutës dhe krijimit të institucioneve shtetërore të Kosovës. Zgjedhja e presidentit si proces, e sidomos radha e tretë e votimit, sipas tij, lë hapësirë për interpretim dhe presion mbi deputetë në vendimmarrje. "Është shumë e qartë që me largimin e opozitës, që përbën shumicën e përfaqësuesve shqiptarë, është gjithashtu i limituar legjitimiteti i presidentit dhe i Qeverisë, nuk i përfaqëson interesat e Kosovës në përgjithësi e më së paku presidenti, i cili duhet të jetë institucioni unifikues", ka thënë Abazi. Të shqetësuara me mbarëvajtjen e procesit të zgjedhjes së presidentit, të mërkurën janë shprehur edhe nëntëmbëdhjetë organizata joqeveritare që përfaqësojnë shoqërinë civile në Kosovë. Sipas këtyre organizatave, procesi është shoqëruar me shkelje të dispozitave kushtetuese, ligjore dhe të Rregullores së Kuvendit të Kosovës. Në një deklaratë të përbashkët, OJQ - të kanë konstatuar se mënyra e zgjedhjes së Behgjet Pacollit president nuk e përfaqëson unitetin e popullit që e kërkon Kushtetuta. OJQ - të kanë shprehur shqetësim edhe për atë që ata e kanë quajtur fenomeni i "pauzës". Sipas tyre, rezultati i treguar pas pauzes ka verifikuar shqetësimet e shprehura publikisht nga kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, se pauza do të përdorej për të ushtruar presion ndaj deputetëve. OJQ - të kanë kërkuar që mënyra e zgjedhjes së presidentit të adresohet medoemos në Gjykatën Kushtetuese. Yll Hoxha, drejtor i Klubit për Politikë të Jashtme, pjesë e këtij koalicioni të OJQ - ve, ka shpjeguar se shoqëria civile do të presë nga partitë opozitare që ta procedojnë çështjen në Gjykatën Kushtetuese. Nëse partitë opozitare nuk e bëjnë një gjë të tillë, sipas Hoxhës, OJQ të do të kërkojnë që çështjen ta procedojnë te Avokati i Popullit. Hoxha ka shpjeguar se 19 organizata janë në proces të diskutimit edhe të formave të tjera të kundërshtimit të zgjedhjes së Pacollit president, duke mos përjashtuar protestat. Pavarësisht nga shqetësimet e partive opozitare dhe të OJQ - ve, se zgjedhja e presidentit ka qenë antikushtetuese, një prej njohësve të Kushtetutës dhe Rregullores së punës së Kuvendit e mohon një gjë të tillë. Gjithkush ka të drejtë të shqetësohet për mënyrën e zgjedhjes së presidentit, mirëpo në rastin konkret nuk ka asnjë bazë për t'u ngritur lëndë në Kushtetuese. Duhet ditur se votimi për presidentin është specifik dhe nuk matet prania e deputetëve në sallë, pasi ata thirren një nga një, si qe present, si nuk qe. Kjo edhe ka ndodhur", ka thënë ai, duke mos dashur të identifikohet me emër. Edhe nënkryetari i PDK-së, Hajredin Kuçi, gjatë një interviste në televizionin publik ka hedhur poshtë akuzat se "pauza" e kërkuar para raundit të tretë nga vetë ai ka paraqitur shkelje të kushtetutës. Ai ka thënë se njejtë ka ndodhur edhe kur është votuar për presidentin Fatmir Sejdiu. Bile edhe

atëherë, sipas tij ka qenë vetë ai që ka propozuar pauzë. Kryesuesi i seancës, siç ka thënë ai ka mundur të jap pauzë edhe pas raundit të parë, pasi është dashur të bëhen përgatitje për të filluar raundin tjetër të votimit. Por nëse partitë opozitare vendosin ta çojnë çështjen në Kushtetuese, ato duhet t'i mbledhin së paku 30 nënshkrime të deputetëve. Kjo imponon mobilizimin e LDK-së dhe të një partie tjetër, apo të tri partive opozitare njëkohësisht.

---

## **Të vjetrit i dorëzojnë detyrat, të rinjtë i pranojnë**

---

**Behgjet Pacollit janë duke i pëlqyer ditët e para të tij të punës si i pari i vendit. “Sot ishte një fillim shumë i mirë, i mbarë i ditës së punës. Me zotin Krasniqi, kryetar i Kuvendit të Kosovës, do të vazhdojmë të bashkëpunojmë në të ardhmën”, ka theksuar Pacolli.**

Që Behgjet Pacolli është zgjedhur president i Kosovës nuk do të thotë që ai tash e tutje nuk do të bashkëpunoj me ish - presidentin në detyrë Jakup Krasniqin. Vetë Pacolli ka premtuar bashkëpunim me Krasniqin. E ka bërë atë të enjtën në ceremonin e dorëzim - pranimi të detyrës. Pacollit janë duke i pëlqyer ditët e para të tij të punës si pari i vendit. **"Sot ishte një fillim shumë i mirë, i mbarë i ditës së punës. Me zotin Krasniqi, kryetar i Kuvendit të Kosovës, do të vazhdojmë të bashkëpunojmë në të ardhmën"**, ka thënë ai. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Krasniqi, ka kujtuar që legjislativi me votat e tij ta ketë bërë Pacollin president. "Kuvendi i Kosovës, me votat e veta, i ka dhënë besimin zotit Pacolli për të qenë president i Kosovës dhe unë jam sot këtu për t'ia uruar detyrën. Pushtetet janë të ndara dhe ne do t'i kryejmë detyrat tamam ashtu siç e jep Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet me të cilat punojnë dy institucionet", ka thënë ai. Veç Presidences, të enjten, organizimi i ceremonisë së dorëzim - pranimi të detyrës ka ndodhur edhe nëpër disa ministri të Qeverisë së Kosovës. Besim Beqaj i'a ka dhënë timonin e Ministrisë së Integriteteve Evropiane, Vlera Çitaku, Agim Çeku e ka pranuar udhëheqjen e Ministrisë së Forcës të Sigurisë nga Fehmi Mujota, Vlera Çitaku ia ka dhënë drejtimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme Enver Hoxhajt, Memli Krasniqi e ka pranuar udhëheqjen e Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport nga Gani Elshani. Raif Elezi ia ka dhënë Slobodan Petroviqit drejtimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Ramë Buja e ka marrë drejtimin e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjinë nga Enver Hoxhaj dhe Ahmet Shala i ka dorëzuar Bedri Hamzës detyrën e ministrit të Financave.

## **Opozita e dërgon Pacollin në Gjykatën Kushtetuese**

Deklarimi i hapur i kryetarit të Kuvendit të Kosovës gjatë votimit të kandidatit për president në seancën e 22 shkurtit, se po imponohet shkelja e Kushtetutës së Kosovës, duke ndërprerë procesin e votimit me një pauzë prej 5 minutash, që pastaj u shndërrua në pauzë njëorëshe, i ka bërë subjektet politike opozitare, ekspertët dhe shoqërinë civile, të mendojnë seriozisht që, pas një analize të hollësishme me administratën e Kuvendit dhe ekspertët juridikë, të trokasin edhe në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar një veprim të tillë dhe nivelin e shkeljeve që janë bërë me këtë rast. Vetë anëtari i Komisionit për verifikimin e mandateve të deputetëve nga radhët e LDK - së, Armend Zemaj, që në legjislaturën e kaluar ishte edhe në Komisionin për Legjislacion dhe Kushtetutë i tha gazetës se LDK-ja është duke i bërë të gjitha analizat e situatës dhe në momentin kur të konstatohet niveli i shkeljes së Kushtetues në procedurën e votimit do të jetë gati për ta dërguar çështjen edhe në Gjykatën Kushtetuese. Ai tha se grupet parlamentare kanë të drejtë të kërkojnë pauzë në raste të caktuara në kohën e punimeve të seancave parlamentare, por gjithmonë ato kërkesa duhet të miratohen dhe të interpretohen nga vetë kryetari i Kuvendit të Kosovës, respektivisht drejtuesi i seancës, që mund të jetë edhe një nga nënkryetarët. " Mënyra se si ka ndodhur pauza ka qenë kundër Rregullores së Kuvendit, që është rregullore në harmoni me Kushtetutën e Kosovës, dhe e dyta shkelje është se në momentin e futjes në procesin e votimit është thënë se janë 65 deputetë dhe asnjëherë gjatë votimit nuk është deklaruar se numri i deputetëve në sallë është 67. Kjo ka krijuar edhe huti, edhe konfuzion e dilema rreth rezultatit, i cili ka dalë në fund të procesit të votimit", tha deputeti Zemaj. Megjithatë, ai tha se rruga deri në Gjykatën Kushtetuese duhet të përgatitet mirë. "Nga ana juridike duhet të ketë një vlerësim të tillë fillimisht, të shkohet në Gjykatën Kushtetuese, për çka ne jemi të gatshëm, ose paraprakisht duhet që administrata e Kuvendit të ketë një deklaram rreth mënyrës së votimit, lëvizjes së deputetëve, numrit të tyre dhe kohës e cila është deklaruar për pauzë me tejkalimin e saj. Këto të fundit duhet fillimisht të faktohen dhe pastaj të shikohet se de-fakto ka hapësirë ligjore që të iniciohet çështja për vlerësim edhe në Gjykatën Kushtetuese", tha deputeti Zemaj.

### **"Vetëvendosje" bëhet gati**

Përgatitjet për t'u bashkuar në një iniciativë të përbashkët opozitare, që çështja e shkeljes së Kushtetues me rastin e zgjedhjes së presidentit në seancën e 22 shkurtit të shkojë në Kushtetuese është duke i bërë edhe Lëvizja "Vetëvendosje". Këtë e tha nënkryetari i Kuvendit të Kosovës nga radhët e kësaj lëvizje politike, Glauk Konjufca. "Mendoj që shkelja kushtetuese që është konstatuar edhe prej vetë kryetarit të Kuvendit, nuk ka kurrfarë dileme, se kjo në fakt ka qenë për arsye se Rregullorja e Kuvendit të Kosovës është e derivuar drejtpërdrejt prej Kushtetutës së Kosovës. Ne si rrjedhim i kësaj konstatojmë se ka pasur shkelje, sidomos në atë pauzën e cila u mor si vendim të zhvillohet në mes të dy votimeve, që është e padrejtë dhe ne jemi në procesin e mbledhjes së të gjitha shkeljeve, sepse nuk mendojmë që ka qenë vetëm një shkelje kushtetuese, por të tilla ka pasur prej 18 shkurtit, duke filluar nga mandatimi i ushtruesit të detyrës, z. Thaçi, për ta krijuar koalicionin. Ne mendojmë që, sipas interpretimit kushtetues, mandatimi duhet të bëhet pas marrëveshjes që arrijnë subjektet dhe mandatohen për ta prezantuar në Parlament këtë koalicion që është arritur. Krasniqi e ka mandatuar Thaçin para se të arrihen numrat, e ka mandatuar vetëm si parti. Ne tash do të shohim se si do të procedojmë,

nëse do të procedojmë në Gjykatën Kushtetuese për kërkimin e mendimit të tyre, nëse ka qenë shkelje kushtetuese", tha Konjufca.

## **Gjini: U dhunua demokracia**

Ardian Gjini nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës tha shumë i bindur se pas këtij rasti opozita nuk do të heshtë aspak dhe do të krijojë shumë mundësi që me mënyrën e procedimit në Kuvend të merret vetë Gjykata Kushtetuese. "Unë mendoj se do të ketë shumë problem Gjykata Kushtetuese më këtë që ka ndodhur dje. Ne mund të themi që dje në Kosovë është dhunuar demokracia, është dhunuar vullneti i njerëzve dhe është dhunuar historia e Kosovës, kjo është shkelje e rëndë e Kushtetutës", tha Ardian Gjini, nënkryetar i AAK - së. "Ky veprim është dëshmia më e mirë se ky koalicion dhe kjo Qeveri nuk janë legjitimë. Ky president nuk e përfaqëson popullin e Kosovës, ndërsa kjo Qeveri është qeveri interesash e dy individëve, të cilët vepruan për t'i shkatërruar institucionet, e tani po bashkohen për ta rënuar gjithë atë që është arritur nga sakrificat dhe gjaku i dëshmorëve. Reagimi i kryetarit të Kuvendit të Kosovës për ta ndaluar këtë degradim u injorua nga ata që nuk njohin asnjë normë demokratike në shoqëri, por mbi të gjitha e kanë epshin për pushtet", tha Gjini.

## **Shkelje flagrante**

Ekspertët juridike dhe të çështjeve kushtetuese mendojnë se në procedurën e votimit ka pasur shkelje të Rregullores dhe të Kushtetutës, por kjo ka ardhur si rezultat i vetë zbrastësive ekzistuese që kanë mbetur në aktin më të lartë juridik të vendit, i cili ka plot mangësi që krijojnë mundësi të ndryshme interpretimi. "Fatkeqësia kryesore është që Kushtetuta nuk i parashihet të gjitha këto procedura, e në fakt ajo duhet t'i parashohet ato, ose të njëjtat duhet t'i parashohet vetë Rregullorja e Kuvendit, por që në këtë rast asnjëra dhe as tjetra nuk i parashohin, por lë hapësirë të shkeljes procedurale. Këtë e ka thënë edhe vetë kryetari me të drejtë. Ai tha se kjo është presion dhe është shkelje e Kushtetutës, që mandej ajo pauzë zgjati gati një orë dhe kur u kthyen deputetët nuk e ngriti më zërin për të thënë se kjo është de-fakto shkelje e re e Kushtetutës", tha eksperti për çështje kushtetuese, Mazllom Baraliu. Ai shtoi se në këtë rast ka pasur bazë të fuqishme ligjore e kushtetuese që të vendoset edhe për ndërprerjen e seancës, për shkak të tejkalimit të kohës së pauzës, të cilësuar si presion ndaj deputetëve. Baraliu shtoi se edhe ky rast i fundit është një argument plus, i cili flet për nevojën urgjente të rishikimit të plotë dhe ndryshimit të Kushtetutës së Kosovës. Eksperti Riza Smaka thotë se derisa edhe vetë kryetari e pranon shkeljen e bërë në procedurë votimi, adresimi për në Gjykatën Kushtetuese është i pashmangshëm dhe ai duhet të drejtohet atje. "Padyshim që çdo rast kur shkelet Kushtetuta janë subjektet e caktuara edhe me Kushtetutë se kush mund ta iniciojnë atë procedurë para Gjykatës Kushtetuese. Aty shihet qartë se është bërë një shkelje flagrante e Kushtetutës", tha Smaka. Me qëndrimin se ky rast duhet të shkojë përfundimisht në Gjykatën Kushtetuese doli edhe Instituti Demokratik i Kosovës nëpërmes përfaqësuesit të vetë. "KDI - ja vlerëson se, me qëllim që të mos vihet në dyshim legjitimiteti i institucioneve të dala nga zgjedhjet e fundit parlamentare, me theks të veçantë procesi i zgjedhjes së presidentit, kjo çështje duhet të procedohet për Interpretim në Gjykatën Kushtetuese, si autoritet vendimtar për interpretim të Kushtetutës", tha Driton Selmanaj nga ky institut. S. AHMETI

---

## **Franca uron Presidentin Pacolli dhe kryeministrin Thaçi**

---

Ambasada e Francës vlerëson se krijimi i institucioneve të reja i hapi rrugën një etape të re në Kosovë. "Ambasada e Francës në Kosovë uron Presidentin e sapo zgjedhur të Republikës së Kosovës dhe Qeverinë e formuar nga besimi i Parlamentit, po ashtu dhe Kryetarin e Kuvendit të Kosovës. Themelimi i institucioneve hap një etapë të re për Kosovën, ku nuk do të mungojnë sfidat dhe vështirësitë. Presidenti i Republikës, Qeveria dhe Kuvendi do të përballen me detyra të vështira dhe të shumta. Në këtë periudhë të re, Franca ripërtëritë mbështetjen e saj për Kosovën, popullin e saj dhe udhëheqësit që ka zgjedhur për ta çuar drejt integritimit evropian. Me urimet më të mira për sukses për të gjithë kosovarët, Franca përgëzon të gjithë ata që do ta kenë detyrën e vështirë të udhëheqjes së shtetit gjatë viteve të ardhshme", thuhet në komunikatën e kësaj ambasade.

---

## **Presidenti Pacolli: Do të ndjekë rrugën e Ibrahim Rugovës e të Adem Jasharit**

---

**Ditën e parë si president Behgjet Pacolli bëri nderime te varri i presidentit Rugova, në Kompleksin Memorial në Prekaz, në Varrezat e Dëshmorëve në Glllogjan, si dhe te varri i Heroit të Kosovës, Zahir Pajaziti, në Orllan.**

PRISHTINË, 23 SHKURT - Ditën e parë të punës si president i sapo zgjedhur i Kosovës Behgjet Pacolli e nisi me vizita. Kreu i shtetit gjatë gjithë ditës së mërkurë vizitoi familjet e dëshmuara të Kosovës dhe bëri nderime në varrezat e atyre që kontribuuan më së shumti në krijimin e shtetit të Kosovës dhe të atyre që flijuan jetën për Kosovën, për shtetin i pari i të cilit është bërë vete Pacolli një ditë më parë. Mëngjesin e ditës së parë të punës së tij dhe turneun e vizitave presidenti Pacolli e nisi me vizitën në rezidencën e presidentit Ibrahim Rugova në Velani, ku më pas bëri edhe nderime të varri i presidentit Rugova. Gjithashtu presidenti Pacolli gjatë të mërkurës bëri homazhe edhe në Kompleksin Memorial në Prekaz, në Varrezat e Dëshmorëve në Glllogjan, si dhe para varrit të Heroit të Kosovës, Zahir Pajaziti në Orllan. Gjatë vizitës së tij të parë si president, në rezidencën e presidentit Rugova, presidenti Pacolli tha se kishte zgjedhur të vizitonte familjen Rugova për të treguar përkushtimin e tij për të vazhduar rrugën e nisur nga Rugova për forcimin e shtetit të pavarur të Kosovës. Ai u zotua se do të vazhdojë rrugën e presidentit Rugova për forcimin e shtetit të Kosovës dhe asnjëherë nuk ka qenë më i gatshëm se tani për të punuar dhe vepruar. "Isha në rezidencën e Presidentit Historik të Kosovës edhe një herë të dëshmoj se jam më se i përgatitur ta çoj përpara idenë e tij për forcimin e shtetit të pavarur të Kosovës. Ka shumë punë për t'u bërë dhe asnjëherë nuk kam qenë më i gatshëm se tani për të vepruar", tha Pacolli. Ai theksoi se më shumë se kurrë është koha për të punuar për Kosovën, duke shprehur gatishmërinë për të punuar për shtetin që tashmë do ta drejtojë si president. Gjithashtu ai shprehu bindjen e tij se do të mund të luajë rolin unifikues, ashtu siç edhe e kërkon detyra e Presidentit, ngase, siç pohoi ai vetë, populli është i unifikuar. "Sigurisht populli i Kosovës është i unifikuar dhe do të jetë i unifikuar", theksoi presidenti i sapo zgjedhur.

### **Të rënët vulosën Pavarësinë e Kosovës**

Pas vizitës në rezidencën e presidentit Rugova, presidential Pacolli vazhdoi vizitat nëpër familjet e dëshmuara të Kosovës. Ai vuri lule tek Kompleksi Memorial i Jasharëve në Prekaz, nga ku u zotua se do të vazhdojë idenë e komandantit legjendar Adem Jashari. Pasi bëri nderime te varrezat dhe pas vizitës në Familjen Jashari, Pacolli shprehu krenarinë e tij, siç tha, që viziton këtë familje të madhe edhe në cilësinë e presidentit, ndërsa shprehu gatishmërinë për të vazhduar punën për ndërtimin e Kosovës. **"Isha dhe premtova që do të punoj me çdo gjë që kam në dispozicion që idenë e Heroit Legjendar Adem Jashari ta çoj deri në fund. Ideja e tij ka qenë ndërtimi i një shteti të pavarur ku Kosova dhe qytetarët e saj do të jetojnë me një mirëqenie të mirë, të qetë dhe të pavarur"**, tha kreu i sapo zgjedhur i shtetit. Pacolli i premtoi Familjes Jashari në Prekaz se gjatë mandatit të tij pesëvjeçar si President, do të angazhohet për të krijuar kushte që Familja Jashari në Prishtinë të ketë një përfaqësi institucionale, ku njerëzit do të shkojnë të shohin dhe të takojnë përfaqësuesit e kësaj familjeje. Rifat Jashari, në emër të Familjes Jashari, i uroi Pacollit postin e Presidentit, ndërsa kujtoi se Pacollit nuk po e viziton Prekazin për herë të parë, pasi, sipas tij, Presidenti i sapo zgjedhur,

edhe më herët kishte bërë vizita në këtë vend, në cilësinë e kryetarit të AKR-së. Jashari tha me këtë rast se Pacolli vizitoi Prekazin në cilësinë e Kryetarit të shtetit, dhe se ai është munduar ta presë si Kryetar të Kosovës.

### **Nderohet edhe familja Haradinaj.**

Pas vizitës në Prekaz Pacolli vizitoi edhe familjen Haradinaj dhe vuri kurora lulësh në kompleksin memorial Dëshmorët e Kombit në Gllogjan. Presidenti Pacolli gjatë vizitës në familjen Haradinaj u prit nga Ilmi Haradinaj, babai dëshmorëve Shkëlzen e Luan Haradinaj. Pacolli me këtë rast tha se njihet shumë moti me këtë familje dhe e viziton shpesh, duke vlerësuar lart vlerat dhe kontributin e kësaj familjeje që i kanë dhënë Kosovës. Sipas Pacollit, të rënë e kanë vulosur Pavarësinë e Kosovës. **"Kjo familje ka vlerë shumë të madhe për Kosovën. Këta dëshmorë që kanë rënë këtu, djemtë e tij që kanë rënë këtu, e kanë vulosur Pavarësinë e Kosovës. Është obligim yni që këtë Pavarësi ta dekorojmë me një ndërtim të një shteti të sinqertë, ku gjithë qytetarët e Kosovës do ta gjejnë veten, do të jetojnë në qetësi dhe në mirëqenie"**, theksoi Pacolli. Ndërkaq Ilmi Haradinaj zgjedhjen e Pacollit për president të vendit e quajti si zgjedhje të qëlluar. **"Ne njihemi shumë kohë më përpara dhe jam i pajtimit dhe i kënaqur, veç i uroj punë të mbarë e me nder t'u prijë punëve përpara"**, tha ai.



*Pas vizitës në Prekaz Pacolli vizitoi edhe familjen Haradinaj dhe vuri kurora lulësh në kompleksin memorial Dëshmorët e Kombit në Gllogjan*





*Presidenti Pacolli gjatë vizitës në familjen Haradinaj u prit nga Ilmi Haradinaj, babai dëshmorëve Shkëlzen e Luan Haradinaj*

---

## Presidenti i ri në Gjykatë

---

Gjykata Kushtetuese është destinacioni i partive opozitare për të interpretuar mënyrën e zgjedhjes së presidentit të kontestuar Behgjet Pacolli në seancën e jashtëzakonshme të së martës. Gjatë procesit të votimit, gjegjësisht pas dy raundeve, ku Pacolli nuk kishte arritur të merrte as shumicën e thjeshtë, dhunshëm dhe pa përfillur procedurat kushtetuese dhe rregulloren e Kuvendit, u kërkua pauzë pesë minutëshe, e cila zgjati rreth 45 minuta. Por, nuk ishte vetëm kjo, pasi u pa se zgjedhja e presidentit u bë edhe përmes SMS-ve, që i thoshin që të mos tërhiqej se në raundin e tretë do të merrte votat e mjaftueshme. Ndërsa, këtë parti të opozitare e kanë quajtur skandaloze që nuk përfaqëson unitetin e popullit dhe është president i kontestuar.

### U shkel Kushtetuta, demokracia dhe liria

Nënkryetari i AAK-së, Ahmet Isufi ka thënë në një konferencë për media se ngjarja e së martës në Kuvendin e Kosovës i ka dhënë një hije të keqe popullit të Kosovës, dhe ka zbehur imazhin e Kosovës në Bashkësinë ndërkombëtare. "Të martën është dhunuar demokracia në Kuvendin e Kosovës dhe është shkelur vullneti i qytetarëve të Kosovës përmes ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të atyre që më përpara kanë interesin për pushtet dhe po ashtu është bërë një veprim i cili do të mbahet mend për keq kur edhe në Kuvend para gjithë opinionit bëjnë veprime në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe me rregulloren e Kuvendit", ka thënë Isufi. Ai ka thënë se veprimet e tilla dhe presionit ndaj deputetëve, duke kërkuar pauzë pa u përfillur procedurat në Kuvendin e Kosovës edhe pas reagimit të kryetarit të Kuvendit është treguesi më i mirë, se dikush për egon e vet për pushtet është në gjendje të bëjë shkatërrimin institucional të vendit. "Presioni që iu bë deputetëve për pesë minutat e "furraxhisë" siç thuhet, sepse pauza zgjati më shumë se 45 minuta. As reagimi i kryetarit të Kuvendit, e as pakënaqësia e deputetëve brenda koalicionit i cili u formua mbi interesat e tyre, nuk pati ndikim që të ndalet ky trend negativ", është shprehur Isufi.

### I drejtohem i Gjykatës Kushtetuese

Isufi ka thënë se do t'i drejtohen sa më shpejt Gjykatës. "Këtë do ta bëjmë në GJK, sepse me këtë ne mendojmë se i shërbejmë vendit dhe demokracisë të cilën duhet ta kenë qytetarët e Kosovës", ka thënë Isufi. Për këtë ai është shprehur se do ta bëjnë sa më shpejt që është e mundur. Edhe partia e dytë në vend LDK-ja ka bërë të ditur se do t'i drejtohet Kushtetueses lidhur me mënyrën e zgjedhjes së presidentit. Anëtari i kryesisë së LDK-së, Kujtim Shala ka thënë se ajo që është parë në seancë duhet të shkojë në Gjykatën Kushtetuese. "Po nga ajo që pamë edhe nga deklaratimet e Krasniqit se po shkelet kushtetuta dhe rregullorja, LDK-ja ka dyshime të thella për kushtetutshmërinë e këtij procesi. Por, nuk kemi një qëndrim final, do të vazhdojnë konsultat, por realisht do të duhet që kjo çështje të shkojë në Gjykatë", ka thënë Shala.

### Presidenti i SMS-ve

Ndërsa, reagime ka pasur edhe rreth SMS-ve që janë publikuar në media e të cilat tregojnë se ka pasur imponim për t'u zgjedhur Pacolli në postin e presidentit. Isufi ka thënë se kjo është

skandaloze dhe tregon qartë se kjo është bërë me direktivë. Edhe drejtues të partisë së tretë në vend, Vetëvendosjes, përmes një komunikate kanë reaguar ashpër lidhur me SMS-të, duke thënë se shtypi nxori në pah arsyet pse u zgjodh Pacolli president i vendit. "Kjo arsye në këtë rast quhet Esad Puskar, një boshnjakoamerikan, i cili kishte punuar një kohë në USAID në Kosovë dhe është aktualisht kryetar i "D'ascc Equity Group". Një lloj Damir Fazliqi në Kosovë", thuhet në komunikatën e VV-së. Madje në këtë komunikatë drejtues të VV-së kanë kërkuar edhe publikisht sqarime nga ambasadori amerikan në Kosovë, Christofer Dell lidhur me SMS-të e dërguar gjatë zgjedhjes së Pacollit President: "Ne kërkojmë nga ambasadori i SHBA-ve, Christopher Dell të tregojë publikisht se çfarë ndodhi dje. Në SMS-të e botuar në gazeta shihej qartë se edhe ai ishte i përfshirë në këtë inxhiniering zgjedhor të presidentit", thuhet në reagimin e VV-së.

---

## Përkulet para familjeve të shenjta

---

**Pacolli: Familja Jashari, gjatë mandatit tim pesëvjeçar do të ketë përfaqësues institucional në Prishtinë**

SKENDERAJ, 23 SHKURT - Ditën e parë si president i Republikës së Kosovës Behgjet Pacolli ua ka kushtuar homazheve te varri i ish - presidentit Ibrahim Rugova, komandanti legjendar i UÇK - së, Adem Jashari, në Varrezat Dëshmorëve në Gllogjan dhe te varri i heroit Zahir Pajaziti. Pas homazheve në lagjen Velania të Prishtinës, tek varri i ish - presidentit Ibrahim Rugova, presidenti i sapozgjedhur i Kosovës, Behgjet Pacolli, ka vizituar Kompleksin Përkujtimor "Adem Jashari" në Prekaz të Skenderajt, me ç'rast ka bërë homazhe te varri i komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari, familjes së tij dhe dëshmorëve të tjerë në këtë vend. Kreu i shtetit, pas homazheve, ka qëndruar në kullën e familjes Jashari. Para kullës dykatëshe në pritje kishte dalë vëllai i madh i Ademit, Rifat Jashari, i cili e ka përqafuar mysafirin e tij, duke ia uruar postin e të parit të shtetit, por këtë herë duke u ngritur në këmbë midis kullës. Pas takimit, që zgjati afërsisht 30 minuta dhe me dyer të mbyllura, i pari që iu drejtua gazetarëve ishte presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli. Ai njoftoi për atë që është diskutuar brenda, duke theksuar premtimin e tij se do të punojë brenda kompetencave ligjore, që idetë e heroit kombëtar, Adem Jashari, t'i çojë deri në fund. **"Isha në familjen Jashari dhe premtova se do të punoj me çdo gjë që kam në dispozicion, që idetë e heroit kombëtar, Adem Jashari, ta çojmë deri në fund. Ideja e tij ka qenë ndërtimi i një shteti të pavarur, ku qytetarët e Kosovës do të jetojnë me një mirëqenie të mirë, të qetë dhe të pavarur"**, ka thënë kreu i shtetit kosovar. Ai ka shtuar se është krenar që e viziton këtë familje, megjithëse, siç ka thënë ai, nuk është hera e parë që ndodhet në Prekaz, pasi këtë e ka bërë edhe në të kaluarën, në cilësinë e kryetarit të partisë. **"Do të vijë edhe në të ardhmen për ta konfirmuar vullnetin tim shumë të madh për të punuar për Kosovën"**, ka thënë presidenti Pacolli. Presidenti i Republikës ka premtuar se brenda mandatit pesëvjeçar do të punojë që familja Jashari ta ketë në kryeqytetin e Kosovës një përfaqësi institucionale. "Do të përpiqem, në mandatin tim pesëvjeçar si president i Kosovës, të krijohen kushtet që kjo familje të ketë në Prishtinë një përfaqësi institucionale, aty ku njerëzit do të shkojnë, do ta shohin dhe do të takohen me të. Këtë do ta bëj brenda mandatit pesëvjeçar", ka premtuar presidenti Pacolli. Në anën tjetër, mikpritësi Rifat Jashari i uroi presidentit të ri shëndet dhe punë të mbarë. "Ai ka qenë këtu edhe në të kaluarën, mirëpo si kryetar i partisë, ndërsa sot erdhi si kryetar i Kosovës, dhe ne u munduam ta presim si kryetar. I uroj shëndet dhe punë të mbarë në të ardhmen!", ka uruar Rifat Jashari. Insistimit të gazetarëve për t'i komentuar deklaratat e një përfaqësuesi të familjes Jashari, se më shumë e kanë përkrahur Jakup Krasniqin për president të vendit sesa Pacollin, Rifat Jashari është përgjigjur: "Atë nuk e di askush përpos Zotit". Edhe presidenti i sapozgjedhur është pyetur se a është shkelur Kushtetuta me rastin e zgjedhjes së tij në këtë post, por ai nuk është përgjigjur. Presidenti ka vazhduar agjenden zyrtare me vizita në vende të tjera të paralajmëruara. Po gjatë ditës presidenti i Republikës, Behgjet Pacolli, ka vizituar edhe Varrezat e Dëshmorëve në Gllogjan dhe ka bërë homazhe para varrit te heroit kombëtar Zahir Pajaziti.



*Ditën e parë si president i Republikës së Kosovës Behgjet Pacolli ua ka kushtuar homazheve për komandantin legjendar të UÇK - së, Adem Jashari, Presidenti është pritur nga Rifat Jashari*

---

## **Do të ndihmoj aq sa mundem!**

---

**Legjenda e futbollit botëror, Franc Bekenbauer, realizoi vizitën e tij, me ftesë të presidentit të Kosovës, Behgjet Pacolli. Ai, në takim me të parin e shtetit, tha se është i njoftuar me situatën e vështirë nëpër të cilën po kalon futbolla i Kosovës dhe se do të angazhohet për ta ndërkombëtarizuar atë. Bekenbauer vizitoi edhe stadiumin e Prishtinës, ku u prit nga kreu i klubit kryeqytetas, futbollistë dhe dashamirë e qytetarë prishtinas.**

### **Kajzer merr çmimin Ambasador Nderi i Kosovës!**

Franc Bekenbauer, i njohur me nofkën Kajzer, ish-futbollisti spikatur Bajernit aktualisht president, ish-përfaqësues i kombëtares gjermane titullar dhe kampion bote, seleksionues, i cili më 1990, në Itali, riktheu Gjermaninë në fronin e më të mirit në botë dhe një nga figurat më të shquara dhe me më ndikim në futbollin gjerman dhe në atë botëror, është një nga personalitetet më karizmatike, që ka vizituar ndonjëherë Kosovën. Ai erdhi në Prishtinë, me ftesën e presidentit të Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, për të qenë edhe një veprim i tij aktual dhe tejet me interes sidomos për sportin dhe për imazhin e Kosovës. Një ditë e ligë, nëpër të cilën po kalon Kosova, sidomos pas tragjedisë së ndodhur në Frankfurt por Bekenbauer nuk e reflektoi këtë, duke pohuar se nuk është njëri i politikës, por i sportit për t'ju përmbajtur kësaj vie dhe misionit të tij strikt lidhur me këtë vizitë. Kajzer dha të kuptojmë dashamirësinë tij të madhe, por edhe respektin për të parin e shtetit dhe simpatinë që e tregoi me kënd që u takua. Në presidencë, në takim me presidentin, në praninë e medimeve dhe suitës mikpritëse, zoti Pacolli, duke i shprehur mirëseardhje legjendës së gjallë, tha ndër të tjera se Kosova ka potencialin e madh në zhvillimin e sportit dhe se një pjesë e tyre bukur e madhe është e shtrënguar që të garojnë dhe të përfshihen në arenën ndërkombëtare për shtete e flamuj të tjerë. Zoti, Pacolli i tha mysafirit të lartë se Kosova padrejtësisht është duke u mbajtur peng dhe i kërkoi ndihmë dhe të ushtrojë ndikim për ta pranuar futbollin e Kosovës në asociacione ndërkombëtare, duke ia bërë më dije edhe vendimin e fundit të FIFA-s, që për ndërkombëtarizim vendosë vetëm UEFA. Në anën tjetër, Bekenbauer tha se është i njohur me situatën e futbollit të Kosovës, me getoizimin e tij dhe premtoi se do të ndihmojë aq sa ka mundësi për të kontribuar në afirmimin dhe në ndërkombëtarizimin e tij. Bekenbauer hasi edhe në mikpritje të ngrohtë me rastin e vizitës së tij në stadiumin e Prishtinës, i shoqëruar nga ministri Memli Krasniqi, kishin dalë për ta përshëndetur anëtarë të kryesisë së klubit, futbollistë dhe dhjetëra dashamirë e qytetarë të Prishtinës. Ai, pasi shkëmbeu disa fjalë, kryesisht miradie me kryetarin Remzi Ejupi, mori një buqetë lulesh, një fanellë dhe një shall të klubit Prishtina, u fotografua dhe la kujtimin e tij të vizitës në këtë tempull! Bekenbauer gjatë një dreke solemne u takua edhe me zyrtarë të institucioneve tona sportive si dhe me sekretarin e Federatës së Futbollit të Kosovës, Eroll Salihu. Ndonëse, vizita e tij ishte e shkurtër, nga ajo që u pa, kemi bindjen se u kthye i kënaqur me pritjen, por edhe me brengën se si ta ndihmojë futbollin e Kosovës, kurse për gazetarë i largët dhe i pamundshëm për të zhvilluar intervistë!



*Presidenti Pacoli pret në takim legjendën e futbollit botëror Franc Bekenbauer*

---

## Presidenti Pacolli mori urime

---

Presidentin e posazgjedhur të Kosovës, Behgjet Pacolli, për zgjedhjen e tij në krye të shtetit e ka uruar presidentja e Konfederatës së Zvicrrës, znj. Micheline Calmy Rey. “Me rastin e zgjedhjes President i Republikës së Kosovës, kam kënaqësinë që, në emër të Këshillit Federal Zvicëran, t’ju shpreh përgëzimet e mia të ngrohta dhe dëshirat më të mira për suksesin e misionit tuaj të lartë dhe për prosperitetin e popullit Kosovë. Lidhjet tona të miqësisë dhe të bashkëpunimit të tashëm do të intensifikohen edhe më në të ardhmën”, thuhet në urim. Edhe presidenti i Republikës së Italisë, Giorgio Napolitano, i ka dërguar një mesazh urimi Presidentit të ri të Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli. “Dëshiroj t’ju shpreh urimet e mia më të përzemërta për zgjedhjen Tuaj si President të ri të Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli”. Thuhet në urim, në të cilin më tej thuhet se “Italia është shumë e angazhuar në Kosovë, qoftë në planin dypalësh, poashtu edhe përmes pjesëmarrjes në misionet ndërkombëtare, në mbështetje të sigurisë, të forcimit të rendit dhe të ligjit, si dhe të zhvillimit ekonomik. Dëshiroj shumë që marrëdhëniet tona dypalëshe të vazhdojnë me intensifikimin dhe thellimin e tyre”. Presidenti i Republikës së Maqedonisë, Gjorgji Ivanov, i ka dërguar një mesazh urimi presidentit të ri të Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli. Përfaqësuesi i OKB-së në Kosovë, Lamberto Zannier, e uroi presidentin e ri të Kosovës Behgjet Pacolli, me rastin e zgjedhjes së tij në këtë detyrë.



---

## **Pacolli ftohet ta vizitojë Shkupin**

---

**Presidenti i Kosovës, nikoqir i një sërë takimeve në ditën e dytë të punës.**

Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, ka pasur agjendë të ngjeshur në ditën e tij të dytë si president. Ai ka zhvilluar tri takime të enjtën. Me ambasadorin e Republikës së Maqedonisë në Kosovë, Stojan Karajanov, me shefin e Zyrës Diplomatike të Belgjikës në Kosovë, Alan Van Gucht dhe me kryeministrin e Kosovës, Hashim Thaçin. Në adresë të medieve nuk ka pasur ftesë për t'i përcjellë takimet e presidentit Pacolli, por pas përfundimit të tyre. Presidenca e Kosovës ka lëshuar kumtesa lidhur me përmbajtjen e tyre. Takimi me ambasadorin e Republikës së Maqedonisë në Kosovë, Stojan Karajanov, i ka sjellë presidentit Pacolli, ftesën e parë për vizitë jashtë vendit si president. Është pikërisht presidenti i Maqedonisë, Gjorgji Ivanov, ai që e ka ftuar presidentin e Kosovës për vizitë në Maqedoni dhe kjo do të mund të realizohej në një të ardhme të afërt. Presidenca ka komunikuar që presidenti Pacolli t'i ketë thënë ambasadorit Karajanov se marrëdhëniet mes Kosovës e Maqedonisë, të cilat janë shumë të mira të duhet të njohin zgjerimin në të gjitha fushat. Pacolli i ka kujtuar mysafirët të tij qëndrimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për marrëdhënie të mira me të gjitha shtetet fqinje dhe me vendet e rajonit, në të mirë të stabilitetit, zhvillimit, mirëqenies së të gjithë qytetarëve dhe integritetit sa më të shpejtë të tërë rajonit në institucionet euroatlantike. Në takim me presidentin e Kosovës, Pacollin, shefi i Zyrës Diplomatike të Belgjikës në Kosovë, Alan Van Gucht, ka thënë se Belgjika e ka ndihmuar dhe do të vazhdojë ta ndihmojë Republikën e Kosovës në vazhdimësi, duke ofruar përvojat e saj në të gjitha fushat. Presidenca ka komunikuar se presidenti Pacolli ka falënderuar shefin e Zyrës Diplomatike të Belgjikës për ndihmën e pakursyer që vendi i tij i ka dhënë në të gjitha periudhat për Republikën e Kosovës. "Institucionet e vendit tonë mirëpresin këtë ndihmë, e çmojnë shumë atë dhe janë të përkushtuara për vazhdimin e bashkëpunimit dhe zgjerimin e tij", është cituar t'i ketë thënë Pacolli Van Gucht. Veç për takimet me zyrtarët ndërkombëtarë, presidenti Pacolli ka realizuar edhe takimin e parë zyrtar me kryeministrin e Kosovës, Hashim Thaçin. Sipas Presidencës, Pacolli dhe Thaçi kanë diskutuar për një varg çështjesh të rëndësishme dhe detyrat që i presin institucionet e vendit në të ardhmën. "Të dy liderët më të lartë institucionale të vendit u shprehën shumë të përkushtuar për të bashkëpunuar në të gjitha fushat që janë të ndërlidhura me kushtetutë mes këtyre dy institucioneve, në të mirë të interesit të Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve të saj", ka komunikuar Presidenca.

---

## **Pacolli: “Do ta bëjë Kosovën komb multietnik”**

---

**Kryetari i Kosovës, Behgjet Pacolli, në një intervistë për “Swissinfo” tha: “Dua që bashkëkombësit e mi të harrojnë të kaluarën dhe urrejtjen kundër serbëve dhe të pranojnë multietnicitetin”. Pa dhënë ndonjë sqarim mbi historinë e konfliktit të Kosovës, Pacolli deklaroi: “Lufta ka shkaktuar krime në të dyja anët”**

BERN - Në ditën kur mori zyrtarisht pozitën e kryetarit të shtetit të Kosovës Behgjet Pacolli zgjodhi portalin e internetit "Swissinfo" për t'i dhënë intervistën e parë. Në bisedë me gazetaren Gemma d'Urso 59 vjeçari Pacolli, i cili është shtetas zviceran dhe kosovar, theksoi se dëshiron të punojë shumë për të siguruar mirëqenien e vendit të tij dhe synon që Kosovën "ta bëjë një komb modern dhe multietnik", për të mbyllur kapitullin e krimeve të luftës. Në pyetjen e gazetares se si do ta fitojë ai besimin e kosovarëve, kur dihet se të martën është zgjedhur me zor në post dhe se më gjatë ka jetuar në botën e jashtme se sa në Kosovë, Pacolli u përgjigj: **"Ekzistojnë shumë pengesa, por do t'i tejkaloj. Dua që bashkëkombësit e mi të harrojnë të kaluarën dhe urrejtjen kundër serbëve dhe të pranojnë multietnicitetin. Kjo do të jetë vështirë, për këtë jam i vetëdijshëm, por në bashkëpunim me kryeministrin dhe Qeverinë unë, do ta arrij këtë"**.

### **Pacolli e sheh veten si profet**

Pacolli foli edhe për prioritetet e tij si president. **"Unë kryesisht do t'u përkushtohem marrëdhënieve tona me pjesën tjetër të botës dhe do të bëj një sërë vizitash në botën e jashtme. Deri më sot 75 shtete e kanë pranuar Republikën e Kosovës. Dëshiroj që deri në fund të vitit të jenë 100 "**. Pacolli shtoi se synon ta bëjë Kosovën një vend të ngjashëm me imazhin e tij (Pacollit): atë të kozmopolitit, të hapur për realitete të tjera, për kultura të tjera. Duke folur për mosbesimin ndaj tij në opinionin kosovar, Pacolli e krahasoi veten me një profet. Ai tha se ekziston një fjalë e urtë që thotë se **"profeti nuk vlen asgjë në vendin e tij"**. Pacolli pranoi për "Swissinfo" se për shkak të "hetimeve të Prokurorisë Federale të Zvicrës në fund të viteve 90 - të në kuadër të aferës “Russiagate” imazhi i tij është i dëmtuar. Pacolli deklaroi se do të hapë një Konsullatë të Kosovës në Lugano, ku ai kishte jetuar gjatë. Ai premtoi se do t'i bëjë Luganon dhe Prishtinën qytete partnere. Biznesmeni me disa pasaporta, që tani gjendet në krye të shtetit të Kosovës, tha se nuk kanë asnjë bazë fajësimet e ngritura nga Carla del Ponte dhe Dick Marty kundër kryeministrit Hashim Thaçi, se ai nuk kishte ndërmarrë asgjë për të ndërprerë tregtinë ilegale me organe të serbëve.

### **Masha nuk vjen në Kosovë**

Pa dhënë ndonjë sqarim mbi historinë e konfliktit të Kosovës. Pacolli deklaroi: "Lufta ka shkaktuar krime në të dyja anët". Ai tha se "kemi kërkuar një hetim të gjithanshëm të këtij rasti (për të cilin flet Dick Marty, v.j.), i cili ka nxitur një polemikë ndërkombëtare". Në fund të intervistës gazetarja e "Swissinfo" Gemma d'Urso e pyeti Pacollin edhe mbi ndryshimet në jetën e tij private, pasi është bërë president. Ai theksoi se para tri javësh është bërë baba dhe tregoi se me Mashën, gruan e tij, ka edhe një djalë tjetër dhe një vajzë. **“Familja ime do të qëndrojë për momentin në Tiçino (në Zvicër, v.j.). Unë po ashtu kam një vajzë, e cila**

**studion në Zürich, dhe një vajzë të rritur, e cila jeton në Austri. Familja ime do të udhëtojë shpesh, unë po ashtu", tha Pacolli për "Swissinfo".**

---

## **AKR-ja javën e ardhshme vendos për Kuvendin që do ta bëjë me president**

---

**Nënpresidenti i AKR-së, Ibrahim Makolli, ka thënë se delegatët e Kuvendit të Jashtëzakonshëm të AKR-së do të vendosin se kush do ta drejtoj këtë parti në të ardhmën**

Ibrahim Makollit i ka rënë barra më e madhe në Aleancën Kosova e Re qëkur Behgjet Pacolli është bërë president i Kosovës. Makolli de facto momentalisht po e udhëheq AKR - në. - Por "fjala prej lideri" e Makollit në AKR nuk është edhe aq jetëgjatë. Është vetëm deri në Kuvendin e jashtëzakonshëm të partisë, kur pritet që të zgjidhet presidenti i ri. Këtë edhe e ka thënë vetë nënpresidenti i AKR - së të premtën për gazetën. Makolli ka kujtuar që për situatat sikur kjo aktualja, kur AKR - ja ka mbetur pa president të partisë, të jetë statuti ai që udhëzon për organizim të Kuvendit të jashtëzakonshëm. "Tash presidenti ka dhënë dorëheqje prej partisë dhe me statut të partisë presidenti zëvendësohet nga nënpresidentët. Aktualisht unë jam ai që po e udhëheq partinë deri në Kuvendin zgjedhor", është shprehur ai. "Këshilli drejtues i partisë javën e ardhshme do të vendosë për kohën kur do të mbahet Kuvendi i jashtëzakonshëm zgjedhor me të vetmen pikë të rendit të ditës: zgjedhjen e presidentit". Behgjet Pacolli ka dhënë dorëheqje nga posti i presidentit të AKR - së me t'u zgjedhur president i Kosovës të martën e kësaj jave. Presidentit të Republikës së Kosovës Kushtetuta e vendit ia ndalon ushtrimin e funksioneve të tjera, përveç të parit të shtetit. Sipas Kushtetutës, presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës. Neni 88 që ka të bëjë me papajtueshmërinë, saktëson se presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik dhe se pas zgjedhjes nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politik. Pikërisht me këtë nen pati rënë ndesh ish - presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu. Në shtator të vitit të shkuar, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar se Sejdiu kishte bërë shkelje serioze të aktit më të lartë juridik të vendit. Pas kësaj ai dha dorëheqjen dhe pak ditë më vonë tërhoqi edhe ministrat nga koalicioni dhe për pasojë vendi shkoi në zgjedhje të parakohshme. Në dhjetor u organizuan zgjedhjet e jashtëzakonshme, nga të cilat fituese doli Partia Demokratike e Kosovës. Tek e pesta me rezultat doli Aleanca Kosova e Re, me rreth tetë përqind të votave. Kjo nuk u pa si pengesë për arritjen e një marrëveshjeje koalicioni në mes të këtyre dy partive duke ia hapur rrugën Pacollit të niset drejt pozitës më të lartë të shtetit. Mirëpo, dorëheqja e Pacollit nga kreu i AKR - së ia hap rrugën kësaj partie të mbajë kuvendin për të zgjedhur kryetarin e ri. Deri më tash. "Cilido qoftë ai ose ajo, nuk do të jetë i privilegjuar. Në bazë të statutit të partisë, secili anëtar ka të drejtë që të kandidohet ose të zgjidhet", ka thënë Makolli. "Për këtë do të vendosin delegatët e partisë". Gazeta ka provuar të premtën të flasë me Rrahim Pacollin, por nuk ka arritur ta marrë atë në telefon. AKR - ja ekziston si parti politike që nga viti 2006. Prej atëherë atë e ka udhëhequr themeluesi kryesor i saj, Behgjet Pacolli. Ai ishte zgjedhur president i AKR - së në tri kuvendet që kjo parti i kishte mbajtur më herët: në tetor të vitit 2006, në maj të vitit 2007 dhe në korrik të viti 2009. Në Kuvendin e fundit, Behgjet Pacolli ishte zgjedhur president i AKR - së në një mandat trevjeçar. Sikur të mos zgjidhej Pacolli tash president i Kosovës, AKR - ja nuk do të kishte nevojë që të organizonte Kuvend të jashtëzakonshëm, por do ta mbante kuvendin e rregullt vitin e ardhshëm me 2012.

---

## Presidenti Pacolli merr detyrën zyrtarisht, dorëzohet Krasniqi

---

**"Kuvendi i Kosovës, me votat e veta, i ka dhënë besimin zotit Pacolli për të qenë President i Kosovës dhe unë jam sot këtu për t'ia uruar detyrën. Pushtetet janë të ndara dhe ne do t'i kryejmë detyrat tamam ashtu siç e jep Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet me të cilat punojnë dy institucionet", tha Krasniqi.**

Presidenti Behgjet Pacolli, të enjten mori edhe zyrtarisht detyrën e presidentit të vendit nga Jakup Krasniqi, i cili këtë funksion e ushtroi për pesë muaj. Me këtë rast Krasniqi i uroi detyrën duke i uruar sukses në kryerjen e saj, Presidentit Pacolli. Presidenti Pacolli premtoi se me Krasniqin, si kryetari Kuvendit, do të ketë bashkëpunim të vazhdueshëm, në interes të ndërtimit të një shteti të sinqertë për të gjithë qytetarët e Kosovës. **"Sot ishte një fillim shumë i mirë, i mbarë i ditës së punës. Me zotin Krasniqi, kryetar i Kuvendit të Kosovës, do të vazhdojmë të bashkëpunojmë në të ardhmen"**, tha presidenti Pacolli pas takimit. Ndërsa, Krasniqi pohoi se ishte Kuvendi i Kosovës ai që i dha besimin Pacollit, duke premtuar se do t'i kryejnë detyrat bazuar në Kushtetutën e Kosovës dhe në ligjet. Krasniqi si duket kishte hezitur ta dorëzonte detyrën e ushtruesit të detyrës, duke e vonuar të paktën për 24 orë dorëzimin e saj. Gjatë kësaj dite presidenti Pacolli priti shefin e Zyrës diplomatike të Belgjikës në Kosovë, Alan Van Gucht. Gucht pasi uroi Pacolli për zgjedhjen e tij në postin e presidentit të Republikës i ofroi gjithë bashkëpunimin e tij dhe të shtetit belg. Ai theksoi se Belgjika e ka ndihmuar dhe do të vazhdojë ta ndihmojë Kosovën me përvojat e saj. Presidenti Pacolli falënderoi z. Gucht për ndihmën e pakursyeshme që vendi i tij ka dhënë në të gjitha periudhat për Republikën dhe theksoi se institucionet e vendit tonë e çmojnë shumë kontributin e Belgjikës, dhe janë të përkushtuara për vazhdimin e bashkëpunimit dhe zgjerimin e tij. M. Nikolla



*Presidenti Behgjet Pacolli merr zyrtarisht detyrën e presidentit të vendit nga Jakup Krasniqi*

## Presidenti Pacolli takoi kryeministrin Thaçi

Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli është takuar të enjten në kabinetin e tij me kryeministrin e Republikës së Kosovës, z.Hashim Thaçi. Në takim të tyre të parë zyrtar, pas krijimit të institucioneve të reja të vendit, Presidenti Pacolli dhe Kryeministri Thaçi diskutuan për një varg çështjesh të rëndësishme dhe detyrat që i presin institucionet e vendit në të ardhmen. Të dy liderët më të lartë institucionalë të vendit u shprehën shumë të përkushtuar për të bashkëpunuar në të gjitha fushat që janë të ndërlidhura me kushtetutë mes këtyre dy institucioneve, në të mirë të interesit të Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve të saj. BS



*Takimi i parë zyrtar në mes të Presidentit Behgjet Pacolli dhe Kryeministrit Hashim Thaçi*

---

## Në cilin shtet Presidenti do të fillojë vizitat diplomatike?

---

### Presidenti Pacolli pranon ftesën për vizitë zyrtare në Maqedoni

PRISHTINË , 24 SHKURT - Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli priti të enjten në një takim ambasadorin e Republikës së Maqedonisë në vendin tonë, Stojan Karajanov. Z. Karajanov e uroi Presidentin Pacolli për zgjedhjen në detyrën e re, duke i dëshiruar sukses në kryerjen e saj. Ai gjithashtu theksoi bashkëpunimin shumë të mirë mes dy vendeve tona fqinje dhe synimin për zgjerimin e mëtejme të këtij bashkëpunimi. Ambasadori Karajanov i përcolli Presidentit Pacolli ftesën e Presidentit të Republikës së Maqedonisë, Gjorgji Ivanov për një vizitë zyrtare në Republikën e Maqedonisë. Presidenti Pacolli e falënderoi Presidentin Ivanov për ftesën për vizitë, e cila do të realizohet në një të ardhme shumë të afërt. Nga ana e tij, Presidenti Pacolli falënderoi ambasadorin Karajanov për vizitën dhe urimet e tij. Gjithashtu, ai vuri theksin tek marrëdhëniet mes Kosovës e Maqedonisë, të cilat janë shumë të mira dhe të cilat duhet të njohin zgjerim në të gjitha fushat. Z. Pacolli perkujtoi me këtë rast qëndrimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për marrëdhënie të mira me të gjitha shtetet fqinje dhe me vendet e rajonit, në të mirë të stabilitetit, zhvillimit, mirëqenies së të gjithë qytetarëve dhe integritimit sa më të shpejtë të tërë rajonit në institucionet euroatlantike. BS



---

## **Britania e Madhe afirmon përkrahjen për integrimin euro-atlantik**

---

Presidentja e Konfederatës së Zvicrës, znj. Micheline Calmy-Rey e ka uruar Presidentin e sapo zgjedhur të Republikës së Kosovës, Shkëlqesinë e Tij, z. Behgjet Pacolli. "Me rastin e zgjedhjes President i Republikës së Kosovës, kam kënaqësinë që, në emër të Këshillit Federal Zviceran, t'ju shpreh përgëzimet e mia të ngrohta dhe dëshirat më të mira për suksesin e misionit tuaj të lartë dhe për prosperitetin e popullit kosovar. Lidhjet tona të miqësisë dhe bashkëpunimit të tashëm do të intensifikohen edhe më në të ardhmen", thuhet në urimin e Presidentes së Zvicrës. Ministri britanik për Evropë, David Lidington, ka mirëpritur krijimin e koalicionit qeverisës dhe zgjedhjen e presidentit. "Ky është një moment historik për Kosovën, e cila sapo festoi përvjetorin e tretë të pavarësisë së Kosovës", thuhet në urimin e ministrit Lidington. Ai po ashtu konfirmon mbështetjen britanike për vendin. "Britania e Madhe afirmon përkrahjen për integrimin euro-atlantik të Kosovës dhe mbështet plotësisht përcaktimin e qeverisë për të zhvilluar më tej relacionet me BE-në", thotë ai. "Ne shpresojmë që të punojnë me qeverinë në detyrat e rëndësishme që gjenden përpara, në veçanti forcimin e sundimit të ligjit, ndërtimin e rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe vazhdimin e decentralizimit të shërbimeve për komunitetet lokale". "Unë gjithashtu mirëpres angazhimin e Kosovës në dialogun Prishtinë-Beograd, që pritet ta lehtësojë BE-ja, e cila do të nxis bashkëpunimin, të bëhen hapa praktik për të përmirësuar jetën e njerëzve dhe për të arritur përparim në rrugën për në Evropë", përfundon letrën Ministri britanik për Evropë David Lidington. Përfaqësuesi i OKB-së në Kosovë Lamberto Zannier e uroi Presidentin e ri të Kosovës, Behgjet Pacolli, me rastin e zgjedhjes së tij në këtë detyrë. Më lejoni t'ju shpreh urimet e mia më të sinqerta me rastin e zgjedhjes suaj si President i Republikës së Kosovës. U ndjeva i kënaqur me zgjedhjen e Juaj, ngase kam bindje të fortë se si President do të jepni maksimumin për t'i sjellë komunitetet e ndryshme të Kosovës së bashku dhe, ashtu siç e keni cekur edhe në fjalimin përurues, do të fokusoheni në bashkëpunimin rajonal, dialog, prosperitet dhe integrimin evropian. Respektimi i diversitetit, bashkëpunimi rajonal dhe angazhimi për paqe janë vlerat themelore të Kombeve të Bashkuara", thotë Zanieri. Presidenti i Republikës së Maqedonisë, Gjorgji Ivanov i ka dërguar një mesazh urimi Presidentit të ri të Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli. "Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë t'ju shpreh urimet e mia më të sinqerta me rastin e zgjedhjes Suaj si President i Republikës së Kosovës. Gjithashtu, më lejoni të përfitoj nga rasti dhe t'ju uroj sukses në kryerjen e funksionit tuaj përgjegjës, shëndet të mirë dhe lumturi personale", shkruan në telegramin e tij Presidenti Ivanov. "Jam plotësisht i bindur që, në një kohë të shkurtër, me forca të përbashkëta, do të nxisim dhe forcojmë marrëdhëniet mes dy shteteve tona dhe me këtë do të kontribuojmë në thellimin dhe intensifikimin e bashkëpunimit të ndërsjellë mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës, përfshirë fushën e marrëdhënieve bilaterale dhe shumëpalëshe me interes të përbashkët. Për këtë qëllim, ne do të japin kontributin tonë për vizionin që ne të gjithë e ndajmë për rajon të qëndrueshëm dhe të begatë me perspektivë Euro-Atlantike", thekson, mes të tjerash, në urimin e tij Presidenti i Maqedonisë, Dr. Gjorge Ivanov. BS

---

## **Pacolli merr detyrën**

---

PRISHTINË - Presidentit i ri i Kosovës, Behgjet Pacolli, ka marrë të enjtën zyrtarisht detyrën e re nga u.d. i presidentit të deritashëm, Jakup Krasniqi. Në ceremoninë e dorëzimit pranimit të detyrës, Krasniqi i ka uruar sukses Pacollit në kryerjen e detyrave, kurse presidenti i ri ka thënë se me kryetarin e Kuvendit do të ketë bashkëpunim të vazhdueshëm, në interes të ndërtimit të një shteti të sinqertë për të gjithë qytetarët. Krasniqi ka thënë po ashtu se Kuvendi i Kosovës, me votat e veta, i ka dhënë besimin Pacollit për të qenë president. "Pushtetet janë të ndara dhe ne do t'i kryejmë detyrat tamam ashtu siç e jep Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet me të cilat punojnë dy institucionet", ka thënë kryeparlamentari. Presidenti Behgjet Pacolli, të enjtën është takuar edhe me kryeministrin Hashim Thaçi. Në takim të tyre të parë zyrtar, pas krijimit të institucioneve të reja, presidenti dhe kryeministri diskutuan për detyrat që i presin institucionet e vendit. "Të dy liderët më të lartë institucionalë të vendit u shprehën shumë të përkushtuar për të bashkëpunuar në të gjitha fushat që janë të ndërlidhura me kushtetutë mes këtyre dy institucioneve, në të mirë të interesit të Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve të saj", thuhet në një njoftim të zyrës për informim të Presidencës. Kurse gjatë ditës, presidenti ka pritur ambasadorin e Maqedonisë, Stojan Karajanov. Ky i fundit i ka përcjell Pacollit ftesën e presidentit maqedonas, Gjorgji Ivanov për vizitë zyrtare në Maqedoni. Kurse, presidenti i Kosovës ka falënderuar homologun Ivanov për ftesën, e cila do të realizohet në një të ardhme shumë të afërt. Pacolli ka pritur të enjten edhe shefin e Zyrës Diplomatike të Belgjikës në Kosovë, Alan Van Gucht. (D. Z.)

---

## **Pacolli i gatshëm të përballet me Kushtetuesen**

---

**"Nëse kërkohet nga unë, sigurisht se do t'i përgjigjem Gjykatës Kushtetuese të Kosovës", ka shprehur gatishmëri presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli**

PRISHTINË, 25 SHKURT - Behgjet Pacolli është shprehur i gatshëm të përballet me Gjykatën Kushtetuese nëse është e nevojshme për ta qartësuar mënyrën se si është zgjedhur presidenti i vendit më 22 shkurt të këtij viti. **"Nëse kërkohet nga unë, sigurisht se do t'i përgjigjem Gjykatës Kushtetuese të Kosovës"**, ka thënë Pacolli të premten pas takimit që ka pasur me ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ), Enver Hoxhaj. Në këtë kontekst, Pacolli ka mohuar deklaratën e kryeparlamentarit të Kosovës, Jakup Krasniqi, i cili vazhdon të insistoj se presidenti është zgjedhur me 54 vota të deputetëve të Kuvendit. **"Jam zgjedhur president i Kosovës me 90 përqind të votave të deputetëve të Kosovës të cilët ishin të pranishëm në sallë"**, është shprehur Pacolli, duke shtuar se si president do ta luajë rol unifikues ndaj qytetarëve të Kosovës. Të premten Pacolli për herë të parë ka folur edhe për mesazhet telefonike të cilat ishin shkëmbyer në ditën kur është votuar për president. Ai ka thënë se "sms" - at kanë qenë çështje private ndërmjet tij dhe këshilltarit të tij, Esad Pushkar. **"Mesazhet telefonike kanë qenë çështje private ndërmjet meje dhe këshilltarit tim. Sms - të janë krejt të karakterit privat"**, ka thënë Pacolli.

Ndërkohë, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, nuk ka lëvizur as të premten nga qëndrimi i tij lidhur me zgjedhjen e Pacollit president. Ai ka insistuar se Pacolli është zgjedhur president me 54 vota aq sa ka marrë në raundin e parë, pasi, sipas tij, votat e tjera janë bërë pas ndikimeve politike mbi deputetët. Por, pavarësisht këtij qëndrimi, Krasniqi e konsideron të mbyllur këtë proces. Ai ka thënë se i mbetet Gjykatës Kushtetuese të vendosë për këtë çështje. "Si Kuvend e kemi përmbyllur këtë proces. Ne nuk mund ta korrigjojmë vetveten në këtë drejtim. Është e drejtë legjitime vetëm e Gjykatës Kushtetuese për ta përcaktuar parregullsinë ose rregullsinë e asaj seance", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se Kushtetuta e Kosovës u jep të drejtë 30 deputetëve që të kërkojnë interpretim juridik lidhur me zgjedhjen e presidentit. Kushtetuta e Kosovës u jep të drejtë 30 deputetëve të Kuvendit që të bëjnë kërkesë ose ankimim në Gjykatën Kushtetuese për çështje të caktuara. Për këtë çështje kryetari i Kuvendit nuk e ka të drejtën të kërkojë një gjë të tillë", është shprehur Krasniqi. Në vazhdim kryeparlamentari Krasniqi ka kërkuar edhe nga mediet që mos ta keqinterpretojnë qëndrimin e tij zyrtar dhe atë politik në rastin Pacolli. "Duhet ta bëjmë një dallim ndërmjet dorëzimit të detyrës zyrtare dhe qëndrimit tim politik. Konsideroj dhe kërkoj nga ju që vërtet t'i bëni këto dallime. Kam pasur obligim, nga detyra që kam ushtruar dhe nga përzgjedhja që ka bërë Kuvendi i Kosovës, t'ia dorëzoj detyrën Pacollit ashtu siç është e paraparë me Kushtetutë. Por, qëndrimi im politik se si është zgjedhur Pacolli kryetar është i natyrës tjetër", ka deklaruar.

---

## Zyrtarisht President, s'i komenton SMS-at

---

**Presidenti i deritanishëm në detyrë, Jakup Krasniqi i ka dorëzuar edhe zyrtarisht detyrën e Presidentit të sapo zgjedhur Behgjet Pacolli. Krasniqi e Pacolli janë shprehur të gatshëm të bashkëpunojnë si dy institucionet më të larta të vendit.**

Presidenti i ri Behgjet Pacolli edhe zyrtarisht ka marrë detyrën e kreut të vendit nga Presidenti në detyrë, Jakup Krasniqi. Pas pranimit të detyrës nga Krasniqi, Pacolli është shprehur i gatshëm për të bashkëpunuar me kreun e legjislativit. Ndërsa, vet Krasniqi nuk ka kundërshtuar Presidentin e ri, duke thënë se vetë deputetët e kanë votuar dhe ai është President i Kosovës. "Jo unë nuk vazhdoj. Kuvendi i Kosovës me votat e veta i ka dhënë besimin Pacollit për të qenë President i Kosovës dhe unë sot jam këtu për t'i uruar detyrën. Pushtetet janë të ndara dhe ne do t'i kryejmë detyrat tamam ashtu siç e jep Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet, me të cilat punojnë institucionet", ka thënë Krasniqi. Ndërsa, Presidenti i ri është shprehur i kënaqur që ka marrë një urim nga Krasniqi. **"Urimet më të mira i kam marrë sot. Me z. Krasniqi jo që jemi përfaqësues të dy institucioneve të rëndësishme të Kosovës, por ne jemi edhe miq të vjetër dhe sot ishte një fillim i kësaj dite të punës shumë i bukur, shumë i mirë, shumë i mbarë. Me z. Krasniqi, Kryetarin e Kuvendit të Kosovës, do të bashkëpunojmë në të ardhmen"**, ka thënë Pacolli.

### **Gjykata Kushtetuese mund të merret me rastin**

Ndërsa, Presidenti i ri në këtë fillim të punës së tij nuk do të kalojë edhe lehtë, pasi mund të përballet me Gjykatën Kushtetuese, meqë partitë opozitare kanë paralajmëruar se do të kërkojnë interpretim nga gardiani i Kushtetutës për mënyrën e zgjedhjes së tij në krye të vendit. Një gjë të tillë e ka lënë të kuptohet edhe vet kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, i cili ka thënë se ai nuk e konteston atë, por janë organet kompetente që mund ta kontestojnë vendimin e Kuvendit. "Unë nuk e kontestoj dhe nuk e kam detyrën e as përgjegjësinë për ta kontestuar vendimin e Kuvendit. Është çështje e institucioneve tjera të pavarura t'i kryejnë detyrat e veta konform ligjeve dhe Kushtetutës", ka thënë, Krasniqi.

### **Nuk i dërgova askujt SMS - a, Pacolli s'i komenton**

Ndërsa, çështje shumë e diskutueshme gjatë votimit të Pacollit President ishte edhe dërgimi i shumë SMS-ve, nga këshilltari i tij, Esad Pushkar, në të cilin ishte i përfshirë edhe ambasadori i SHBA - ve, Christopher Dell. Krasniqi ka thënë se ai nuk ka dërguar asnjë SMS. "Unë nuk merrem me çështje private të individëve, është çështje tjetër. Për mu ajo është krejt një çështje private". Pyetni ata që i kanë shkruar SMS - at. Unë atë ditë nuk kam shkruar SMS - a", ka thënë Krasniqi. E Pacolli nuk ka pranuar të komentojë rreth aferës së SMS - ve, e cila përfshin atë, këshilltarin e tij dhe ambasadorin e SHBA - ve, Christopher Dell.

---

## Pacolli President, 'fajtor' Haradinaj

---

**Nëse dikush është fajtor pse President është Behgjet Pacolli, ai është Ramush Haradinaj.**

**Ambasadori amerikan në Kosovë, Christopher Dell, në një intervistë për Evropa e Lirë, ka thënë se nuk ka pasur asnjë rol në zgjedhjen e Presidentit të Kosovës". Sipas tij, personi që mbase është më përgjegjësi pse Behgjet Pacolli është President sot, është duke ndenjur në qelinë e burgut në Hagë.**

**Zoti ambasador, institucionet e reja të Kosovës tashmë janë zgjedhur. Ju keni ftuar elitën politike të formojë një qeveri me "duar të pastra". A jeni i kënaqur ?**

**Dell:** Po, shumë. Unë mendoj se mediat këtu, me përqendrimin e tyre në raportimet sensacionale të ditëve të fundit, me të madhe e kanë anashkaluar transformimin e jashtëzakonshëm që ka zënë vend. Mendoj se është shumë e dobishme të kthehemi prapa dhe të shikojmë fotografitë e kabinetit që mori pushtetin me rastin e pavarësisë, në vitin 2008. Po të bëjmë krahasimin me sot, do të jemi dëshmitarë të një lëvizjeje në gjenerata. Ka ndryshime të shquara në fytyrat e kësaj qeverie, në fakt janë shumë pak që kanë mbetur nga qeveria e kaluar, kryeministri, zëvendëskryeministri Kuçi dhe njëri nga ministrat serb, janë personat e vetëm të cilët mendoj se kanë qenë në kabinetin e kaluar. Siç thashë, një transformim i jashtëzakonshëm ka ndodhur dhe mendoj se kjo jo vetëm që përfaqëson një qeveri me duar të pastra, por gjithashtu një qeveri që pasqyron ndryshim realitetesh në Kosovë; është një lëvizje më tej nga politika e gjeneratës së luftës deri një gjeneratë njerëzish të rinj, të cilët janë duke zënë vendin e tyre të duhur në këtë shoqëri.

**Megjithatë, partitë politike në opozitë kanë reaguuar ndaj zgjedhjes së Presidentit në veçanti, duke thënë se nuk e njohin legjitimitetin e institucioneve të zgjedhura, për shkak të, siç kanë thënë, shkeljeve kushtetuese. Si do ta komentoni këtë çështje ?**

**Dell:** Nuk më takon mua t'i gjykoj çështjet kushtetuese. Nëse ka ndonjë problem në këtë drejtim, atëherë do të jetë Gjykata Kushtetuese ajo që vendos për këtë çështje. Deri diku, nuk jam edhe aq i befasuar, sepse puna e opozitës është të kundërshtojë. Sidoqoftë, jam i zhgënjyer më shumë me natyrën mendjehetë të kundërshtimeve ndaj kësaj qeverie. Ka baza legjitime për të debatuar çështjet e vërteta, me të cilat Kosova përballlet; agjenda e Qeverisë ndërkohë që po definohet dhe artikulohet nga kryeministri. Gjithashtu, mendoj se opozita do t'i bënte nder vetes dhe Kosovës nëse vëmendjen e përqendron më pak te loja me fjalë për procedurat, e më shumë te sfidat e vërteta, me të cilat ky shtet duhet të përballlet: sundimi i ligjit, korrupsioni, zhvillimi ekonomik dhe prodhimi, krijimi i vendeve të punës për njerëzit, kujdes më të mirë shëndetësor për të moshuarit, arsimit për fëmijët e Kosovës. Këto janë çështjet e vërteta, për të cilat njerëzit do të donin të bisedonin, kur kërkojnë ndryshime. Nuk besoj se opozita po i bën vetes ndonjë nder, duke vazhduar të luajë një politikë të brendshme, me përqendrim te çështjet procedurale.

---

## **Pacolli: Presidenca do të bashkëpunojë me Kuvendin dhe Qeverinë**

---

**Pacolli ka thënë se me kryetarin e Kuvendit, Jakup Krasniqin, do të kenë bashkëpunim si miq dhe si përfaqësues të dy institucioneve të rëndësishme**

PRISHTINË, 24 SHKURT - Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, të enjten, gjatë një ceremonie të dorëzimpranimit, zyrtarisht e ka pranuar detyrën e presidentit nga ish - ushtruesi i deritanishëm i detyrës së presidentit, Jakup Krasniqi. Me këtë rast Pacolli ka thënë se me kryetarin e Kuvendit, Jakup Krasniqin, do të kenë bashkëpunim si miq dhe si përfaqësues të dy institucioneve të rëndësishme. **"Urimet më të mira i kam marr sot. Me zotin Krasniqi jo që jemi përfaqësues të dy institucioneve të rëndësishme të Kosovës, por jemi edhe miq të vjetër. Sot ishte një fillim i mirë i punës, një fillim i mbarë dhe ne me kryetarin e Kuvendit të Kosovës do të bashkëpunojmë në të ardhmen"**, ka thënë Pacolli në një prononcim të shkurtër për mediet. Ndërkaq, ushtruesi i deritanishëm i presidentit, njëherësh kryetar i Kuvendit, Jakup Krasniqi, e ka uruar presidentin Pacolli për detyrën e re. Ai ka thënë se Pacolli është zgjedhur president me votën e deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe do ta ketë mbështetjen ashtu siç parasheh edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës. "Kuvendi i Kosovës, me votat e veta, i ka dhënë besimin z. Pacolli për të qenë president i Kosovës. Unë jam sot këtu për t'ia uruar detyrën. Pushtetet janë të ndara dhe ne do t'i kryejmë detyrat tamam ashtu siç na japin Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet me të cilat punojnë dy institucionet", është shprehur i rizgjedhuri për kryetar të Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi. I pyetur rreth SMS - ve të ambasadorit amerikan Christopher Dell dhe presidentit Pacolli, Krasniqi nuk ka dashur të komentojë, duke e konsideruar këtë çështje të tyre private. "Për mua ajo është çështje private. Pyetni ata që kanë shkruar SMS. Unë atë ditë nuk kam shkruar SMS", ka thënë Krasniqi. Presidenti Behgjet Pacolli pritet që shumë shpejt të përballet me Gjykatën Kushtetuese, pasi partitë opozitare kanë thënë se do të dërgojnë ankesa, që Gjykata të interpretojë nëse janë shkelur Kushtetuta dhe Rregullorja e Punës së Kuvendit me rastin e votimit të presidentit. Gjatë ditës presidenti Behgjet Pacolli ka pritur në një takim të mbyllur edhe kryeministrin Hashim Thaçi, me të cilin kanë biseduar për detyrat që i presin institucionet e vendit. "Në takimin e tyre të parë zyrtar, pas krijimit të institucioneve të reja të vendit, presidenti Pacolli dhe kryeministri Thaçi diskutuan për një varg çështjesh të rëndësishme dhe detyrat që i presin institucionet e vendit në të ardhmen", është thënë në një komunikatë të lëshuar nga presidenca. Sipas komunikatës, presidenti Pacolli dhe kryeministri Thaçi kanë shprehur përkushtimin e tyre për të bashkëpunuar në të gjitha fushat që janë të ndërlidhura me Kushtetutë mes këtyre dy Institucioneve, në të mirë të interesit të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj.

### **Presidenti Pacolli pranon ftesën për vizitë zyrtare në Maqedoni**

Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, gjatë të enjtes është takuar edhe me ambasadorin e Republikës së Maqedonisë në vendin tonë, Stojan Karajanov. Pacolli e ka falënderuar ambasadorin Karajanov për mbështetjen që shteti i tij ka dhënë Kosovës, duke thënë se marrëdhëniet mes Kosovës e Maqedonisë janë shumë të mira dhe duhet të zgjerohen edhe më shumë në të gjitha fushat. Sipas tij, institucionet e Kosovës janë të përqendruara të kenë marrëdhënie të mira me të gjitha vendet fqinje në mënyrë që të ketë stabilitet, zhvillim dhe mirëqenie për të gjithë qytetarët dhe integrim sa më të shpejtë të tërë rajonit në institucionet euroatlantike. Presidenti Pacolli ka pranuar ftesën e homologut të tij maqedonas Gjorgji Ivanov për vizitë në Maqedoni, duke premtuar se vizitën do ta bëjë shumë shpejtë.

### **Pacolli falënderon Belgjikën**

Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, ka pritur në një takim të enjten shefin e Zyrës Diplomatike të Belgjikës në Kosovë, Alan Van Gucht. Me këtë rast Pacolli ka falënderuar shefin e Zyrës Diplomatike të Belgjikës, Van Gucht, për ndihmën e pakursyer që vendi i tij ka dhënë në të gjitha periudhat për Republikën e Kosovës. Sipas tij, institucionet e Kosovës janë të përkushtuara ta vazhdojnë bashkëpunimin me shtetin belg. Ndërkaq, shefi i Zyrës Diplomatike të Belgjikës, Van Gucht, e ka urre presidentin Pacolli për zgjedhjen e tij president i Republikës së Kosovës, duke i ofruar gjithë bashkëpunimin e tij dhe të shtetit belg. Van Gucht ka theksuar se Belgjika e ka ndihmuar dhe do të vazhdoje ta ndihmojë Republikën e Kosovës në të gjitha fushat.

---

## Jam President i pa kontestuar

---

**Vetëm një ditë pas marrjes së detyrës edhe zyrtarisht si President i vendit Behgjet Pacolli ka kundërshtuar deklaratën e kryetarit të Kuvendit, Jakup Krasniqi, se ai është zgjedhur president si rezultati presionit ndaj deputetëve**

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi ka vazhduar të shprehë besimin se zgjidhja e Behgjet Pacollit si President i vendit është bërë me 54 vota të deputetëve, dhe se votat tjera në atë rast kanë qenë të dhëna nën presion. Mirëpo, ndaj këtyre deklaratave ka reaguar Presidenti Behgjet Pacolli duke thënë se ai ka marrë mbi 90 përqind të votave nga deputetët e Kuvendit. Megjithatë, Presidenti Pacolli vazhdon të kontestohet për mënyrën se si është zgjedhur, duke e përfshirë në këtë edhe ambasadorin amerikan në Kosovë, Christopher Dell përmes disa mesazheve në telefon.

### U zgjedha me 90 përqind të votave

Por, megjithatë Presidenti Behgjet Pacolli shprehet se deputetët e Kuvendit e kanë votuar pa presion. "**Jam zgjedhur President i vendit me 90 përqind të deputetëve të pranishëm në sallë**", ka thënë Pacolli. Ndërsa, në anën tjetër kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi ka thënë se nuk e ka ndërruar qëndrimin e tij politik ndaj Pacollit, pavarësisht dorëzimit të detyrës së Presidentit. "Mendoj që duhet ta bëjmë një dallim mes dorëzimit të detyrës zyrtare dhe qëndrimit tim politik. Unë kam pasur obligim nga detyra që e kam pasur dhe nga përzgjedhja që ka bërë Kuvendi i Kosovës ta dorëzojë detyrën dhe ia kam dorëzuar detyrën. Qëndrimi, im politik se si është zgjedhur është i natyrës tjetër. Unë e kam pasur obligim kushtetues ta dorëzoj detyrën dhe e kam bërë këtë siç e parashikon Kushtetuta dhe ligji", ka thënë Krasniqi.

### I përgjigjem pozitivisht Gjykatës

Ndërsa, Pacollit mund të përballet edhe me Gjykatën Kushtetuese, pasi partitë opozitare e kanë paralajmëruar që do të kërkojnë nga gardiani i aktit me të lartë juridik që ta bëjë interpretimin e mënyrës së zgjedhjes së Pacollit në krye të Kosovës. Por, Presidenti Pacolli është shprehur i gatshëm t'i përgjigjet pozitivisht Gjykatës nëse ajo kërkon sqarime nga ai. "**Unë do t'i përgjigjem pozitivisht kërkesës nga Gjykata Kushtetuese nëse një gjë e tillë bëhet për ta qartësuar përfundimisht mënyrën se si jam zgjedhur President i Kosovës**", ka thënë Pacolli. Por, një mundësi të hapur se kjo mund të ndodhë e ka paralajmëruar edhe Krasniqi, duke thënë se kanë të drejtë që nga 30 nënshkrime të deputetëve të Kuvendit dhe kjo mund të ndodhë. "Ne e kemi përmbyllë si Kuvend një proces dhe ne s'mund ta korrigjojmë vetveten. Është e drejtë legjitime vetëm e Gjykatës Kushtetuese për të përcaktuar parregullsinë ose rregullsinë e asaj seance. Ajo i jep të drejtë 30 deputetëve të Kuvendit që të bëjnë kërkesë ose ankimim në Gjykatën Kushtetuese për çështje të caktuara", ka thënë Krasniqi.



---

## Punë për Enver Hasanin

---

**Jo vetëm opozita, por edhe kryeparlamentari Krasniqi pajtohet që Gjykata Kushtetuese duhet të vendosë rreth rregullsisë apo parregullsisë së zgjedhjes së presidentit dhe qeverisë**

PRISHTINË, Presidenti Behgjet Pacolli mund ta ketë fatin e ish - presidentit Fatmir Sejdiu, nëse Gjykata Kushtetuese se nxjerr interpretimin se ai ka ardhur në këtë post duke mos respektuar procedurat kushtetuese dhe vetë Kushtetutën. Dallimi, megjithatë, ekziston, pasi që te Sejdiu ishte konstatuar shkelje e Kushtetutës, kurse Pacolli në rast se vërtetohen dyshimet e kryetarit të Kuvendit dhe të opozitës, do të binte "viktimë" e procedurave dhe parregullsive që i ka shkaktuar partia partnere në qeverinë ekzistuese. Ndonëse ende ka vetëm paralajmërime dhe jo edhe adresim, kërkesë tek Gjykata Kushtetuese, nëse vjen deri te procedimi, atëherë del se interpretimi i kësaj gjykate do të jetë përcaktues rreth çështjeve procedurale dhe të rregullsisë së zgjedhjes së presidentit. Nisur nga deklaratat e kryetarit të Kuvendit, Jakup Krasniqi, dhe tri partive opozitare, çështja Pacolli duket të mos jetë e mbyllur ende. Kryeparlamentari Krasniqi ka thënë se presidenti Pacolli është zgjedhur me 54 vota, pasi votat që janë dhënë për të pas pauzës gjatë tre raundeve të votimit, sipas tij, ishin vota të presionit. Krasniqi sqaron se ai i ka dorëzuar detyrën presidentit Pacolli, në ceremoninë e dorëzimit - pranimit, pasi që këtë e ndiente obligim kushtetues. Kurse qëndrimi i tij personal mbetet se për zgjedhjen e Pacollit, fjalën e fundit duhet ta japë Gjykata Kushtetuese. I bindur se çështja po drejtohet tek Gjykata Kushtetuese, presidenti Behgjet Pacolli thotë se do t'i përgjigjet pozitivisht çdo kërkesë të kësaj gjykate. Mirëpo, ai ka kundërshtuar deklaratat e Jakup Krasniqit rreth votave në Kuvend, duke i interpretuar 62 votat e fituara në rrethin e tretë, si 90 përqind të votave të deputetëve të pranishëm atë ditë në sallë. "Unë përfaqësoj dhe do të përfaqësoj unitetin e qytetarëve të Kosovës. Unë kam kalu me mbi 90 përqind të votave të deputetëve që ishin të pranishëm në sallë", tha Pacolli, duke aluduar në votat e koalicionit. Për herë të parë Pacolli foli edhe për mesazhet telefonike që ai ka shkëmbyer në ditën kur u zgjodh president me një nga këshilltarët e tij dhe ambasadorin amerikan në Prishtinë. Ai i cilësoi këto si mesazhe private. "Është një çështje private mes meje dhe këshilltarit tim. Janë 'SMS' krejt privat dhe për atë ekzistojnë këshilltarët", u shpreh Pacolli. Në anën tjetër, Lidhja Demokratike e Kosovës paralajmëron sërish procedimin e kërkesës për Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar interpretimin në lidhje me zgjedhjen e Pacollit president. Deputeti i LDK - së, Ismet Beqiri, thotë se kjo kërkesë mund të jetë gati për procedim qysh javën e ardhshme. Kjo mund të jetë hera e dytë që vendimi i Gjykatës Kushtetuese të jetë vendimtar në çështjen e postit të presidentit të Kosovës. Në vjeshtën e vitit të kaluar kjo Gjykatë pati interpretuar si shkelje të Kushtetutës mbajtjen e dy posteve nga ana e ish - presidentit Fatmir Sejdiu, çka nuk i pati lënë rrugë tjetër Sejdiut, pos të jepte dorëheqje. Dilemat dhe dyshimet rreth zgjedhjes së Pacollit nisen nga ato procedurale deri tek shkeljet e rregullores së punës të Kuvendit dhe Kushtetutës. Dyshimet procedurale kanë të bëjnë me atë nëse kryetari i Kuvendit, Krasniqi është dashur apo jo të procedojë me votimin qysh në rrethin e parë, pasi që nuk i kishte dy të tretat e deputetëve të pranishëm në sallë. Pavarësisht këtij fakti, votimi u zhvillua dhe si paradoks, nga 67 deputetët e pranishëm kërkoheshin 80 vota për presidentin. Nëse kërkohen dy të tretat e votave në Kuvend, në sallë duhet të ketë dy të tretat e deputetëve të pranishëm, ka pohuar një burim nga LDK - ja, parti kjo e cila po përgatit kërkesën për Gjykatën Kushtetuese.

### **Dell: S'kam pasur rol në zgjedhjen e presidentit**

Nuk kam pasur asnjë rol në zgjedhjen e presidentit të Kosovës, ka thënë ambasadori amerikan në Prishtinë, Christofer Dell, në intervistën dhënë Radios Evropa e Lirë. "Sa për tekstet e sms-ëve, ato janë tekste midis dy individëve të tjerë, të cilët natyrisht janë të lirë të shkruajnë, komentojnë dhe të thonë ç'të duan, pavarësisht nëse ato e pasqyrojnë realitetin", është shprehur Dell.

---

## **Presidenti Pacolli dhe De Marnak premtojnë bashkëpunim për sundim të ligjit**

---

**Presidenti i Kosovës u shpreh i gatshëm ta ndihmojë EULEX-in në punën që bënë në Kosovë.**

PRISHTINË, 25 SHKURT - Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli priti në takim të premtën shefin e EULEX-it, Xavier Bout de Marnak, ku pas këtij takimi presidenti Pacolli dhe De Marnak shprehën gatishmërinë e tyre për bashkëpunim në mes tyre dhe për punë më të madhe në fushën e sundimit të ligjit. Presidenti i Kosovës u shpreh i gatshëm ta ndihmojë EULEX-in në punën që bënë në Kosovë. Ndërkaq, shefi i EULEX-it tha me këtë rast se do të vazhdojë të punojë në vënien në jetë të sundimit të ligjit në Kosovë. De Marnak foli për angazhimin e misionit që udhëheq, ku siç u shpreh ai EULEX-i do të vazhdojë të punojë në drejtim të vënies në jetë të sundimit të ligjit në Kosovë. Po ashtu, shefi i EULEX-it tha ky mision do të ndihmojë edhe institucionet e Kosovës që të punojnë më shumë rreth sundimit të ligjit. Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli priti gjatë ditës edhe ambasadorin e Republikës së Gjermanisë në Kosovë, Hans Dieter - Steinbah, i cili i përcolli z.Pacolli urimet e tij dhe të shtetit gjerman për zgjedhjen në postin e presidentit të vendit. Ambasadori Steinbah tha se Gjermania e ka përkrahur në vazhdimësi Republikën e Kosovës, në të gjitha periudhat dhe do të vazhdojë ta përkrahë edhe në vazhdim. Ai u fokusua në ndihmën që ka dhënë Gjermania në planin e lobimit për njohjen e shtetit të Kosovës, për anëtarësimin në Bankën Botërore dhe në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe theksoi se Gjermania do të vazhdojë aktivitetin e saj për të siguruar njohje të reja për Kosovën, si dhe për integrimin e saj sa më të shpejtë në institucionet ndërkombëtare. Ai gjithashtu theksoi se Kosova dhe Gjermania kanë shumë fusha në të cilat do ta shtrijnë bashkëpunimin e tyre, ndërsa bashkëpunimi në planin ekonomik është një nga më të rëndësishmit, krahas bashkëpunimit dhe përkrahjes që Gjermania do t'i ofrojë Kosovës në fushat e tjera me interes. Duke u ndërlidhur te dialogu i paralajmëruar mes Prishtinës e Beogradit, ambasadori Steinbah theksoi edhe një herë qëndrimin se statusi i Kosovës dhe integriteti i saj territorial nuk do të jenë tema që do të diskutohen, duke përkujtuar se këtë deklaratë e ka bërë edhe ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Westerwelle, gjatë një vizite më herët në Kosovë. Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli e ka vlerësuar lart angazhimin e ambasadorit Steinbah dhe bashkëpunimin e tij me institucionet e Republikës së Kosovës. Ai gjithashtu çmoi lart përkrahjen e vazhdueshme të Gjermanisë për Kosovën, duke shtuar se kjo përkrahje ka qenë dhe është me një interes të veçantë për institucionet dhe popullin e Kosovës, i cili ka shumëçka të mësojë nga eksperiencia gjermane. Presidenti Pacolli vlerësoi angazhimin e Gjermanisë për ndihmë në lobimin për njohje të reja të Republikës së Kosovës, si dhe në rrugën e integritimeve euroatlantike. Njëkohësisht, ai tha se Kosova dhe Gjermania kanë hapësira të mëdha bashkëpunimi, në të gjitha fushat, bashkëpunim ky që duhet të shkojë gjithnjë e më shumë kah intensifikimi dhe zgjerimi i tij. M. Nikolla

Intervistë ekskluzive me presidentin e Republikës së Kosovës, z. Behgjet Pacolli

---

## Prioriteti ynë është Shqipëria

---

**"Kur them Kosova, e mendoj atë brenda kufijve të saj, me tërësinë territoriale të shtetit konfirmuar me Kushtetutën tonë. Nuk do të ketë të drejtë askush që për këto gjëra të diskutojë me askënd", thotë presidenti Pacolli.**

Çfarë mund t'i ofrojë vendit në politikë dhe ekonomi numri një i vendit, presidenti i Republikës Behgjet Pacolli, çfarë mund të ofrojë Presidenti në integrimin e vendit dhe në marrjen e më shumë njohjeve, një vokacion ky i përmbushur me përkushtim dhe gjatë qëndrimit në opozitë dhe pa asnjë përkrahje institucionale!? Por, cilat janë të vërtetat për dyshimet e ngritura nga skeptikët dhe kundërshtarët e tij? A ishte e vërtetë se kishte deklaruar se Serbia ishte nëna e Kosovës, apo se do të donte të ishte një lloj marshalli i Kosovës? Këtyre dilemave që prej kohësh po e shqetësojnë opinionin dhe të tjerave u përgjigjet Presidenti i vendit, përfshirë edhe dilemën e ngritur së fundi nëse kishte shkelje të procedurave gjatë zgjedhjes së Presidentit, u përgjigjet vetë presidenti i vendit, Behgjet Pacolli.

### KOSOVA ËSHTË PARTIA IME

**Bota sot: Imazhi i juaj më i njohur z. President është i një biznesmeni të suksesshëm, dhe pritjet e opinionit pas zgjedhjes suaj në këtë post, janë se vendi mund të ketë përfitime ekonomike, edhe nga programi i partisë, që e keni udhëhequr deri më tash, AKR-së. Sa mund t'ia arrini meqë tani jeni president, kurse partia e juaj tashmë është në koalicion?**

**Presidenti Pacolli:** Unë së pari nuk kam parti më, jam apartiak. Partia ime është Kosova. Së dyti unë jam në një post presidencial dhe asnjëherë nuk do të bëj një ndarje artificiale mes presidentit dhe qeverisë sepse unë e konsideroj si një tërësi institucionale që punon për të mirën e vendit dhe qytetarit. Normalisht se veprimet e mia janë të kufizuara brenda kornizave ligjore, por edhe kushtetuese, por askush nuk mund të më ndalë që të punoj edhe në cilësinë e qytetarit të parë të Kosovës, kur është në pyetje interesi i popullit dhe shtetit të Kosovës. Këtë do ta bëj! Askush nuk më ndal nëse jam në një udhëtim zyrtar, që unë mos të marr me vete grup biznesmenësh kosovarë, dhe të vizitojmë edhe ndonjë investitor potencial që e shoh se është i gatshëm të vijë në Kosovë. Mundësia për të komunikuar me investitorët më të mëdhenj, pa barriera është një ndër vlerat e mia të shtuara kryesore si President i Kosovës. Shikoni, kur miqtë kanë shqetësimin se Kosova mund të jetë vend i dështuar, e kanë drojën se për një farë kohe vendi ynë mund të ketë rritje ekonomike të kufizuar, shtim të papunësisë, një lloj falimentimi i zgjatur i shtetit. Ky lloj dështimi shmanget vetëm nëse ne sjellim investime të mëdha, që krijojnë vende pune për rininë e mrekullueshme të Kosovës që kanë talent për informatikën, internetin, dizajnin, biznesin, dhe përgjithësisht ato që ofron shkollimi. Këto investime në shtetin më të ri të Evropës, në njërin nga vendet me popullsinë më të re në botë, janë rrugët kryesore për të sjellë zhvillim. Pra, unë do të bisedoj me investitorët e ndryshëm, nëpër forume të ndryshme biznesi dhe do ta garantoj suksesin e tyre. Jam i prirur që të komunikoj me ta e t'u tregoj se ekziston edhe shteti i Kosovës, që ka një infrastrukturë ligjore mbështetëse për biznesin. Po ashtu nuk do të më ndal askush që unë të jem promovues i ideve qofshin ato dhe ekonomike, e që janë të realizueshme, e të cilat do të jenë në të mirë të vendit.

E kam parë nga një ditë eksperience si presidenti vendit se do të ketë hapësirë, që gjatë atyre orëve të punës, që unë të mendoj edhe për zhvillimin ekonomik dhe unë t'i propozoj qeverisë e ato t'i implementojmë. Unë e kam detyrim që të mendoj për zhvillimin ekonomik të Kosovës, të krijojmë mirëqenie për të gjithë.

**Bota sot: Kosovën e presin sfida të mëdha përveç atyre ekonomike. Vendi së paku sipas kërkesave europiane po shkon drejt dialogut me Serbinë. Cili do të jetë pozicioni i juaj dhe i Kosovës në këtë dialog?**

**Presidenti Pacolli:** Unë mendoj se Kosova do t'i përmbahet parimeve të bisedimeve të koordinuara me Bashkimin Europian dhe me mbështetjen e fuqishme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dy partnerëve tanë. Unë nuk mendoj se ne duhet të pranojmë të bisedojmë jashtë atyre kornizave. Ndërkohë, unë e kam thënë dhe në fushatë se ne duhet të trajtohem në mënyrë simetrike me Serbinë. Nëse ajo prej fillimit të bisedimeve përfiton statusin e kandidatit në Bashkimin Europian, edhe Kosova të paktën duhet të marrë prej Bashkimit Europian, ftesën për fillimin e negociatave për liberalizimin e vizave. Unë Kosovën e konsideroj si një shtet që është krijuar tashmë, me një agjendë shtetformuese të përmbyllur sa i përket sovranitetit brenda kufijve të njohur të Kosovës nga shtetet më të fuqishme të botës anëtare të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të Bashkimit Europian, etj. Këto janë të vulosura tashmë: kur them Kosova, e mendoj atë brenda kufijve të saj, me tërësinë territoriale të shtetit konfirmuar me Kushtetutën tonë. Nuk do të ketë të drejtë askush që për këto gjëra të diskutojë me askënd. Nëse diskutojmë me Serbinë, do të diskutojmë si dy shtete të pavarura, si dy shtete sovrane. E respektojmë sovranitetin e Serbisë, nëse Serbia respekton sovranitetin e Kosovës. Interesi kyç është që të ruhet gjithmonë sovraniteti. Kosova nuk ka pretendime territoriale te Serbia dhe Serbia duhet të mos ketë pretendime territoriale tek Kosova. Nëse Serbia mendon të shpallë pretendime territoriale në Kosovë, ne jo vetëm do t'i hedhim poshtë, por do të ngremë me forcë dhe legjitimitet të shtuar çështjen e statusit të shqiptarëve në Luginën e Preshevës, në Bujanoc , Medvegjë e gjetiu. Vetëm pasi të zgjidhim problemet tona, në kuadër të një bashkëpunimi rajonal që privilegjon krijimin e një tregu kombëtar të përbashkët, të ndërlidhur me tregun rajonal, atëherë ne mund të flasim edhe për bashkëpunim ekonomik me Serbinë. Por, prioriteti ynë është Shqipëria. Jo vetëm për shkak se popullsia e Kosovës në shumicë dërrmuese është e një gjaku me vëllezërit tanë të Shqipërisë, por dhe për arsye ngushtësisht ekonomike. Shqipëria ka një pozitë strategjike të jashtëzakonshme dhe është interesi ynë, të përfitojmë prej kësaj pozite strategjike. Madje është dhe interesi i Serbisë të ketë marrëdhënie të mira me të.

## **NJË ZONË TË LIRË TË PËRBASHKËT EKONOMIKE**

**Bota sot: Vetë Piter Feith ka deklaruar së fundi se duhet të bisedohet për Veriun në kuptimin e një statusi të veçantë, jeni të gatshëm që kjo pjesë të bëhet me status special?**

**Presidenti Pacolli:** Vija e kuqe që nuk duhet shkelur është ruajtja e integritetit territorial të Kosovës. Ne mund të flasim për një zonë të lirë ekonomike, por jo në ata kufijtë që flitet sot. Kur flas për zonë ekonomike nuk flas se në atë pjesë duhet të përfshihet vetëm një pjesë përtej apo këtej Ibrit, por zona e lirë ekonomike duhet të përfshijë një gjerësi më të madhe gjeografike pse jo deri në Vushtrri dhe në bjeshkë të Bajgores. Kështu një pjesë e këtyre njerëzve të veriut do të përfitonte ekonomikisht së bashku me popullsinë shqiptare të zonave afër tyre, por kurrësesi nuk do të ketë ndarje politike, nuk do të ketë bisedime asnjëherë për ndonjë ndarje ose diferencim politik brenda kufijve të Kosovës. Nëse ne mund të flasim për një zonë të lirë ekonomike në komunën e Gjakovës, pse mos të flasim edhe për një zonë të tillë edhe në komunën e Mitrovicës? Kjo është normale. Pra, një zonë e lirë ekonomike do të përfshinte një

tërësi të gjerë gjeografike ku do të ketë ligje speciale, që promovojnë idenë e tërheqjes së investitorëve të huaj. Unë e di se një zonë e tillë e lirë ekonomike është në Dubai, është një pjesë e territorit në brendësi, në Gjaballazi. Brenda saj janë bërë investime të shumta nga gjitha vendet. E dimë se në perëndim, që të prodhohet diçka një inxhinier paguhet 6-7 apo tetë mijë euro, ndërsa ne në Kosovë mund t'ju ofrojmë të njëjtat kushte për prodhim, por kostoja do të ishte më e ulët, pasi në Kosovë paga për një inxhinier do të kushtonte shumë më pak, mund të paguhet me 2 mijë euro. Pra, kursimi është i madh, është 200 përqind më lirë se diku tjetër. Ndërkohë ne në Kosovë, investitorët do t'i lironim edhe nga pagesa e TVSH-së. Mallrat do të hynin në Kosovë pa kurrfarë takse, por gjithçka që procedohet në këtë zonë do t'i nënshtrohej taksave doganore në bazë të ligjit. Për mallrat që dalin nga zona e lirë ekonomike në Kosovë taksat i merr shteti i Kosovës, për ato që shkojnë në Serbi, taksat i paguajnë në doganat e Serbisë. Nuk e njoh askënd në Veri që refuzon të jetojë në një vend ku do të ketë një rritje të shpejtë ekonomike, e ku do të përmirësohej shpejt mirëqenia e qytetarëve. Së dyti do të bëjmë kthimin e atyre, që kanë shkuar nga ai vend. Ne do të duhet të bënim edhe veprime për ta luftuar krimin e organizuar, për arsye se për çdo mall që hyn do të paguheshin taksat doganore, me këtë edhe do të rrisim punësimin. Nëse zhvillohet ekonomia, aty nuk do të ketë problem politike as etnik, sepse veprimet ekonomike, progresi ekonomik përmbys çdo pakënaqësi. Kështu ka ndodhur edhe në Hong Kong, ku njerëzit e racës së verdhë kanë jetuar me njerëzit e bardhë nga Evropa e kjo është bërë edhe në Afrikën e Jugut, ku sot nuk kemi diferenca të racizmit. Është shumë e mundur kjo të bëhet edhe tek ne.

**Bota sot: Në kuptimin politik thoni se nuk do të ketë tejkalim të Pakos Ahtisari, duke përjashtuar ato zgjidhje ekonomike që mund të bëhen kur është fjala për Veriun...**

**Presidenti Pacolli:** Nuk kemi nevojë që në këto bisedime të rishikohet Pakoja e Ahtisari. Ajo në mënyrë të pjesshme do të bjerë gradualisht, sepse disa mandate janë me afat të kufizuar. Për shkak të kohës, shumë ligje të Ahtisarit do të konsumohen, pjesa tjetër nuk do ta dëmtojë zhvillimin e shoqërisë në Kosovë. Jemi dëshmitarë se çdo ditë e më tepër se qytetarët serbë të Kosovës po shprehen se ardhmëria e tyre është brenda Kosovës dhe institucioneve të saj dhe sa më mirë të jetë integrimi i tyre me institucionet e Kosovës aq më i lehtë do të jetë edhe tejkalimi i problemeve.

**Bota sot: Ju jeni i njohur për veprimtarin lobuese, për sjelljen e njohjeve shtetit të Kosovës. Çfarë dinamizmi, ndoshta edhe në numër nëse mund ta shprehni, se sa njohje do të mund t'i realizoni deri në fund të vitit?**

**Presidenti Pacolli:** Njohjet do të vijnë shumë shpejt dhe jam i bindur se duke patur një bashkëpunim shumë të mirë me qeverinë, me koalicionin, ne do të kemi shumë njohje, sepse unë jam shumë konstruktiv me veprimet e mija. Ne sot folëm me Ministrin e Jashtëm dhe përcaktuam disa hapa të përbashkët. Siç e dini, jam i përkushtuar shumë, që të punoj vetëm për interesat e qytetarit, që të kontribuoj për shtetin tonë të shenjtë, Kushtetutën e Kosovës dhe sa kohë të lirë dhe energji të kem do ta harxhojë për lobimin. Tash unë do të veproj institucionalisht dhe prapë lobimi është një përparësi për mua.

## **E RESPEKTOJMË SOVRANITETIN E SERBISË, NËSE AJO E RESPEKTON SOVRANITETIN E KOSOVËS**

**Bota sot: Ju z. President po vazhdoni të përballeni me shumë akuza nga më të ndryshmet, si ajo se keni deklaruar se nëna e Kosovës është Serbia dhe krahasime të tjera të rënda. Cila është e vërteta?**

**Presidenti Pacolli:** Siç e kuptoni edhe nga kjo intervistë unë jam një njeri i ndjeshëm dhe më shqetëson gënjeshtria. Kur filluan këto shkrime u shqetësova dhe kisha ndrojtjen se dikush do t'ia dilte që të prishë qetësinë shpirtërore time. Por, kur pashë se intensiteti i shkrimeve shkonte në rritje, vura re se sa më i madh ishte ky intensitet aq më tepër kthehesha në qetësinë time, duke u mbështetur edhe në vullnetin tim të madh për të shkuar përpara. Ishte një fushatë e vërtetë, e personalizuar, që në mënyrë jo korrekte gërmonte kryesisht në deklarime të marra nga shtypi serb, të cilat në shumë raste unë i kisha demantuar, por pa sukses. Ishin fjali të nxjerra nga artikujt, të shkëputura jashtë çdo konteksti, dhe jo të thëna nga unë në ligjëratë të drejtë. Ishin tituj gazetash, dhe asnjë citim i imi. Më thoni a ka qëllime të mira në ndërtimin e imazhit të dikujt duke u mbështetur mbi këtë prodhimtari sensacionesh dhe duke manipuluar me emocionet e njerëzve? Pse gjatë kësaj fushate, asnjëherë nuk u botuan demantimet e mia, opinionet që më mbronin, por u sulmuan personalitete të shquara që më vlerësuan në komentet e tyre? Çfarë fituan sulmuesit prej kësaj fushate? Unë prapë nuk kam kurrgjë të keqe për ta, por veç keqardhje për frymën jo të mirë që krijohet rreth njerëzve si unë që punojnë dhe nuk merren me fjalë. Unë ju garantoj sot qytetarëve të Kosovës dhe veçanërisht shoqatat e veteranëve të UÇK-së, që jo për fajin e tyre besojnë artikujt të tillë shpifës dhe tendencioz se: Unë asnjëherë në jetën time nuk kam thënë se nëna e Kosovës është Serbia; Unë asnjëherë nuk kam thënë se unë jam Tito i Kosovës dhe këtë mund t'ia konfirmoj me përgënjeshttrimin e gazetarit të revistës kroate Globus Boris Oresić, dhe do t'i lutesha shpifësve ta verifikojnë tek ai gazetar singeritetin tim: i ftoj të gjithë të interesuarit të shohin transkriptet e intervistave të mia dhe të verifikojnë në kontakte të drejtpërdrejta me gazetarët, nëse unë kam të drejtë apo jo. Unë asnjëherë nuk kam thënë asnjëherë asgjë, e cila kishte me e dëmtuar interesin, disponimin, moralin, etiken apo edhe historinë e kombit tim. Jam pjesë e këtij kombi, dhe do të jem pjesë e tij dhe krenohem me të. Por, krenaria ime, e jotja, e çdo qytetari do të ishte edhe më e madhe nëse kombi im do të jetë i respektuar dhe i pranuar nga të tjerët. Nëse dikush respekton kombin tim do të ketë respektin edhe më të madh nga unë, por nuk do të ndalem që ta shtrij dorën. Jam i bindur se gjatë rrugëtimit tim, unë do të gjej respekt. Kjo është qasja jonë si komb në Kosovë, sepse ne kemi tejkalar shumë sfida, kemi pasur shumë sakrifica. Duhet ta bëjmë një ndarje nga e kaluara dhe të ruajmë si trashëgimi tonën, atë pjesë të kësaj të kaluarë me të cilën ne krenohemi, të cilën duhet ta marrim shembull për të mirë. Të përdorim traditat tona të së kaluarës dhe në bazë të këtij respekti për të kaluarën të ndërtojmë ardhmërinë. Ardhmëria është pak më ndryshe, ajo kërkon disa kushte, tolerancë, tolerancë, tolerancë, që të jetojmë në një botë të hapur, pa kufij. Ne duhet të respektojmë, ta ruajmë traditën dhe të respektojmë atë që u përket të tjerëve. Të gjitha këto që thashë janë rregulla kozmopolite dhe parakushte të përmbushjes së standardeve për integrimin e Kosovës. Të gjitha këto kryhen me një perspektivë të tolerancës, barazisë, transparencës dhe normalitetit. Secili duhet të jetë përgjegjës për veprimet e tija. Nëse nisemi nga këto parime, do ta kemi lehtë të integrohemi kudo që synojmë. Në kontekstin e bisedimeve me Serbinë, është absurde që në shekullin e 21-të, derisa Evropa shkatërron kufij që Serbia synon të shtrëngojë kufijtë. Shpresoj që në Beograd do të ketë njerëz që mendojnë, që do të logjikojnë në të njëjtën mënyrë. Sepse kështu një ditë do të takohemi në shtëpinë e madhe evropiane, si i them unë BE-së, në të cilën do të na imponohen këto vlera. Serbia do ta ketë lehtë të bisedojë me Kosovën për çështje teknike, nëse ato bisedime do të jenë të sinqerta dhe nuk synojnë të prekin integritetin dhe tërësinë territoriale të vendit. Do të ketë

shumë tema për të cilat do të mund të bisedohet me Serbinë, është interes i Kosovës, që të ulet dhe të bisedojë për këto çështje, që ne do t'i quajmë teknike, pasi do të jenë parakushte për përmbushjen e standardeve për integrim në BE.

## **NUK KISHTE SHKELJE TË KUSHTETUTES**

**Bota sot: Si i vlerësoni pretendimet e disa partive opozitare, që ta dërgojnë në Gjykatë Kushtetuese, çështjen e votimit të vazhduar me pauzë gjatë zgjedhjes së Presidentit?**

**Presidenti Pacolli:** Unë nuk jam jurist, por me ata që jam konsultuar më kanë thënë se gjatë zgjedhjes sime nuk kishte kurrfarë shkeljeje. Ndaj jam i bindur se dhe kolegët e partive të opozitës, ndërsa do flasin me konstitucionalistët do ta kuptojnë se nuk ka pasur parregullsi dhe nuk do t'i hyjnë një nisme të tillë. Ndërkohë unë jam i bindur në nevojën e bashkëpunimit të qeverisë me opozitën për sfidat e mëdha që ka Kosova, për reformën zgjedhore, për ndryshimet e Kushtetutës, për zgjedhjen e Presidentit nga populli, një ide e hershme e imja, për të cilën sot ka konsensus dhe që miqtë tanë amerikanë e mbështetën me të drejtë. Unë jam i gatshëm të jap kontributin tim në vendosjen e këtij dialogu midis partive politike në Kosovë. Unë mendoj se ende në Kosovë ka nevojë për një frymë konstruktiviteti, pse ne nuk kemi luksin të kemi luftë të egër politike. Kam parë shenja të mira në politikanët me të cilët kam folur dhe jam i bindur se më në fund do të mbretërojë arsyeja.

**Bota sot: Së fundi kryeministri Thaçi e ka emëruar znj. Edita Tahiri kryenegociatore të Kosovës në dialogun me Serbinë. Si e vlerësoni emërimin e saj?**

**Presidenti Pacolli:** Unë e vlerësoj shumë zonjën Tahiri, që është një nga gratë më të njohura të Kosovës, për eksperiencën e saj të madhe në procese të ngjashme, për urtësinë e saj, për marrëdhëniet e shkëlqyera që ka me bashkësinë ndërkombëtare. E konsideroj atë si një zgjidhje të duhur dhe dinjitoze.

## **Agjenda e shtetformimit është përmyllur**

"Unë Kosovën e konsideroj si një shtet që është krijuar tashmë, me një agjendë shtetformuese të përmyllur sa i përket sovranitetit brenda kufijve të njohur të Kosovës nga shtetet më të fuqishme të botës, anëtarë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të Bashkimit European, etj. Këto janë të vulosura tashmë: kur them Kosova, e mendoj atë brenda kufijve të saj, me tërësinë territoriale të shtetit të konfirmuar me Kushtetutën tonë. Kurrë nuk kam thënë, Serbia është nëna e Kosovës "Unë ju garantoj sot qytetarëve të Kosovës dhe veçanërisht shoqatat e veteranëve të UÇK-së, që jo për fajin e tyre besojnë artikuj të tillë shpifës dhe tendencioz se: Unë asnjëherë në jetën time nuk kam thënë se nëna e Kosovës është Serbia; Unë asnjëherë nuk kam thënë se unë jam Tito i Kosovës dhe këtë mund t'ua konfirmojë me përgënjeshtimin e gazetarit të revistës kroate Globus Boris Oresiq, dhe do i lutesha shpifësve ta verifikojnë tek ai gazetar sinqeritetin tim".



---

## **Pacolli premtan për një diplomaci moderne dhe të përfaqësuar me dinjitet**

---

### **Presidenti e Ministri i Jashtëm akordojnë angazhimin për diplomaci**

Presidenti Behgjet Pacolli, pas takimit me ministrin Hoxhaj, shprehet inkurajues për sukseset e diplomacisë së Kosovës në të ardhmen

PRISHTINË , 25 SHKURT - Presidenti i sapo zgjedhur i Kosovës, priti sot në rezidencën e tij, ministrin e Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, takim ky i cili u zhvillua në frymën e bashkëpunimit në çështjen e njohjeve të Kosovës dhe në përfaqësimin e plotë të diplomacisë së Kosovës në botë. Presidenti Behgjet Pacolli, pas takimit me ministrin Hoxhaj shprehet inkurajues për sukseset e diplomacisë së Kosovës në të ardhmen, për faktin siç u shpreh ai se ministri Hoxhaj, është njeri me shumë dinjitet, profesional dhe me vullnet dhe do të kryejë funksionin e diplomatit të vërtet. "Kishim një bisedë konstruktive dhe jemi dakorduar për veprimet tona në të ardhmen.

### **Përmirësohen relacionet me Ministrinë e Jashtëm**

**"Kemi shumë punë për të bërë në fushën diplomatike dhe së bashku do të punojmë për t'i sjellë Kosovës sa më tepër njohje dhe respekt nga miqtë tanë të jashtëm dhe që Kosovën ta qojmë me hapa të shpejtë drejt integriteteve globale",** është shprehur presidenti Pacolli. Ai, takimin me shefin e diplomacisë së vendit e quan fillim të një ere të re të trajtimit të diplomacisë së Kosovës si një diplomaci moderne e gjithëpërfshirëse. **"Jam i bindur se me ministrin do të krijojmë përfaqësim dinjitoze që në mënyrë dinjitoze ta përfaqësojmë Kosovën jashtë, gjithmonë duke i vlerësuar edhe ata që i kemi sot, që janë ambasador e konsuj të spikatur",** tha presidenti i vendit. Ai bëri të ditur se Kosova do të ketë konsull nderi dhe emërimet e reja, mbase edhe hapje të konsullatave të reja. Presidenti Pacolli beson se diplomacia e Kosovës do të jetë e suksesshme, meqë thekson ai se koordinimi i veprimeve me qeverinë dhe pozicioni i tij i tanishëm do të jetë më frytdhënëse nga koha kur ai kishte lobuar jashtë institucioneve. I pyetur për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë presidenti Pacolli, tha se Qeveria ka filluar të formojë grupin negociator dhe është emëruar kryenegociatorja. **"Edhe presidenca do ta ketë përfaqësuesin e vetë në këtë grup dhe inkurajoj edhe mëtutje shefin e qeverisë që të punoj edhe më tutje në këtë drejtim dhe të formoj një grup ekspertësh me njerëz dinjitoz që të përfaqësojnë interesat e Kosovës në këtë dialog, gjithmonë, duke respektuar partnerin tonë dhe duke kërkuar respekt të njëjtë nga partneri i ynë i bisedimeve",** tha z.Pacolli. Presidenti i sapo zgjedhur Pacolli nuk ka dashur të komentojë deklaratat e z. kryekuvendarit Jakup Krasniqi se ai është zgjedhur president me 54 vota, por është përgjigjur se ai është zgjedhur me 90 përqind të votove të deputetëve. **"Unë përfaqësoj unitetin e qytetarëve të Kosovës. Unë kam kaluar me 90 përqind të votove të deputetëve të cilët ishin në sallë",** është shprehur presidenti Pacolli, derisa deklaroi se do të jetë i hapur dhe do t'i përgjigjet Gjykatës Kushtetuese nëse një gjë e tillë kërkohet nga ai. Ndërkohë që çështjen e mesazheve telefonike presidenti e quan çështje private dhe se është e drejtë e tij të komunikoj me këshilltarët e tij. **"Është një çështje private në mes meje dhe këshilltarit tim. Janë mesazhe krejt të karakterit privat dhe se për ata ekzistojnë edhe këshilltarët"** tha z. Pacolli. Hoxhaj çmon angazhimin e presidentit Pacolli. Ndërkaq ministri

i Punëve të Jashtme të Kosovës Enver Hoxhaj, duke përkujtuar se Kushtetuta ka përcaktuar që politika e jashtme e Kosovës të udhëhiqet nga presidenti i vendit, theksoi se presidenti dhe ai si ministër do të jenë të koordinuar në veprimet për përfaqësim të fuqishëm dhe të denjë të Kosovës në arenën ndërkombëtare. "Jemi dakorduar që të hartojmë një plan të përbashkët të punës me një agjendë shumë dinamike dhe intensive e cila do t'i sjell Kosovës sa më shumë njohje dhe agjenda e cila do të prezantoj dhe përfaqësoj shtetin e Kosovës në botë", tha Hoxhaj, duke theksuar se shumë shpejt do të dilet më një plan të punës i cili do të jetë plan i qeverisë së Kosovës. Hoxhaj këtë herë nuk hezitoj të paraqes angazhimin e z. Pacollit si lider partie për aktivitetet e tij për njohjet e Kosovës duke theksuar se në këtë drejtim z. Pacolli ka dhënë një kontribut të madh. "Z.Pacolli në të kaluarën ka dhënë një kontribut shumë të madh që Kosovës ti siguroj sa më shumë njohje. Ka një profili cili i siguron një prezantim të fuqishëm të shtetit tonë, prandaj edhe takimi i sotëm ishte që të dakordojmë veprimet për lëvizjet në fushën e diplomacisë gjatë javëve të ardhshme", shprehet Hoxhaj. Përfaqësuesit e diplomacisë së Kosovës, bënë të ditur se aktivitetet e tyre do të jenë të koncentruara më shumë jashtë vendit e më pak do të jenë në Kosovë.

*“Unë kam kaluar me 90 përqind të votove të deputetëve të cilët ishin në sallë”, është shprehur presidenti Pacolli*

---

## **Presidentit Pacolli vazhdojnë t'i mbërrijnë urime për zgjedhjen në detyrën e re**

---

Ndërsa, Osnat Lubrani, koordinator i UNDP-së i përcjell urimet në emër të agjencive zhvilluese të Unionit Evropian që veprojnë në Kosovë. "Si koordinator Zhvillues i Kombeve të Bashkuara, unë dëshiroj ta ripohoj angazhimin e fortë të agjencive të KB që t'i mbështesim përpjekjet Tuaja dhe të Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës në drejtimin e Kosovës në një rrugë që dërgon në stabilitet dhe prosperitet. Jemi të vetëdijshëm që së bashku me të arritura të rëndësishme që janë parë në vitet e fundit, ende mbetet punë serioze për t'u bërë për ta avancuar agjendën zhvilluese të Kosovës në përputhje me aspiratat e saj drejt integritit evropian. Ne ju urojmë suksese në trajtimin e sfidave që shtrihen përpara, dhe jemi të gatshëm që sipas nevojës ta ndajmë me ju përvojën dhe ekspertizën tonë. Në partneritet të ngushtë me qeverinë, shoqërinë civile dhe anëtarët e tjerë të komunitetit ndërkombëtar, ne presim që të bashkëpunojmë me ju, për mirëqenien e popullit të Kosovës", thekson në urim Osnat Lubrani. Presidenti Pacolli ka marrë edhe një varg urimesh të tjera nga drejtues partish e institucionesh të ndryshme, si dhe nga shumë miq të Kosovës e qytetarë të shumtë të vendit.

---

## **Presidenti i Turqisë Abdullah Gyl uroi Presidentin Pacolli**

---

Presidenti i Republikës së Turqisë, Abdullah Gyl i dërgoi një mesazh urimi Presidentit të Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, me rastin e zgjedhjes së tij në detyrën e re. Në mesazh thuhet: "I nderuar President, Në emër të popullit turk dhe në emrin tim personal, Ekselencën e juaj e përgëzoj për zemërsisht për zgjedhjen në postin e Presidentit të Republikës së Kosovës. Kam bindjen se bashkëpunimi ynë, i cili krahas vëllazërisë dhe miqësisë historike mes vendeve tona, është i rëndësishëm edhe për paqen dhe stabilitetin në Ballkan, me angazhimet tuaja të çmueshme do të zhvillohet edhe më tutje. Turqia do të vazhdojë ta mbështesë orientimin euroatlantik të Kosovës, si dhe pavarësinë e saj dhe integritetin territorial, që është më se i nevojshëm për stabilitetin dhe paqen në rajon. Në kuadër të përpjekjeve tuaja për t'ia lënë gjeneratave të ardhshme një Kosovë shumetnike, shumë kulturore, demokratike, të fuqishme dhe të prosperuar, dhe e cila bazohet në mbizotërimin e ligjit, populli turk do të vazhdojë të jetë pranë popullit të Kosovës. Me këtë rast, i përsëris urimet më të mira për shëndetin dhe lumturinë personale të Shkëlqesisë suaj dhe për prosperitetin dhe mirëqenien e popullit mik dhe vëlla të Kosovës", thuhet në urimin e presidentit të Turqisë Abdullah Gyl.

---

## **Pacolli e Hoxhaj, plan të përbashkët diplomatik**

---

**"Me ministrin Hoxhaj jemi dakorduar për koordinimin e veprimeve tona. Kemi shumë punë për të bërë në fushën diplomatike. Edhe sot biseduam për koordinimin e gjërave në mënyrë që t'i sjellim Kosovës sa më shumë njohje", ka thënë presidenti Pacolli**

PRISHTINË, 25 SHKURT - Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, ka thënë të premten se në bashkëpunim me Ministrinë e Jashtme do t'i koordinojnë veprimet në fushën ndërkombëtare për t'i sjellë Republikës së Kosovës sa më shumë njohje. **"Me ministrin Hoxhaj jemi dakorduar për koordinimin e veprimeve tona. Kemi shumë punë për të bërë në fushën diplomatike. Edhe sot biseduam për koordinimin e gjërave në mënyrë që t'i sjellim Kosovës sa më shumë njohje"**, ka thënë presidenti Pacolli pas takimit të parë me ministrin e Jashtëm, Enver Hoxhaj. Ai ka thënë se institucionet e Kosovës do të krijojnë diplomaci moderne në mënyrë që vendi të ketë një përfaqësim sa më të denjë. **"Do të kemi një diplomaci moderne dhe gjithëpërfshirëse. Jam i bindur se bashkë me ministrin Hoxhaj do të krijojmë përfaqësim dinjitoz të vendit. E vlerësojmë lart punën e ambasadorëve të Kosovës dhe do të vazhdojmë të dekretojmë edhe fytyra të reja"**, ka thënë Pacolli, duke premtuar intensitet të shtuar diplomatik të Kosovës. I pari i vendit ka lëvdur përzgjedhjen e ministrit Hoxhaj në këtë detyrë duke thënë se: **"Ministri Hoxhaj është një njeri i cili ka shumë dinjitet, profesionalizëm dhe me shumë vullnet do ta kryejë funksionin e diplomatit të vërtetë"**. Edhe ministri i Jashtëm Enver Hoxhaj ka premtuar se do të intensifikohen veprimet diplomatike në mënyrë që Kosovës t'i shtohen sa më shumë njohje. "Politika e Jashtme udhëhiqet nga presidenti i vendit, prandaj ne u dakorduam me të që të hartojmë një plan të përbashkët të punës, një agjendë shumë dinamike, e cila do t'i sjellë Kosovës sa më shumë njohje dhe e cila do ta përfaqësojë, ta prezantojë dhe ta promovojë shtetin e Kosovës në botë sa më mirë", ka thënë Hoxhaj, duke premtuar se shumë shpejtë do të jetë i gatshëm edhe plani diplomatik i Kosovës. Hoxhaj ka çmuar lart punën e deritanishme të presidentit Behgjet Pacolli në fushën e lobimit, duke premtuar se bashkë me të do të arrijnë të bëjnë shumë për Kosovën. "Presidenti Pacolli në të kaluarën ka dhënë kontribut shumë të madh që Kosovës t'i sigurojë sa më shumë njohje. Edhe qëllimi i takimit ishte që unë si ministër i Punëve të Jashtme të bisedoj me presidentin dhe të shohim se në çfarë drejtimi duhet të lëvizim", është shprehur i pari i diplomacisë, Enver Hoxhaj. - Muhamet JAHIRI

## ‘Freskohen’ ambasadat

---

**Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, gjatë një takimi me ministrin e Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, paralajmëroi se do të ketë risi në rrjetin diplomatik dhe një plan të ri të punës**

Politika e jashtme e Kosovës së shpejti do të dalë me një plan veprimi, me një agjendë më dinamike, e cila përfshin edhe lëvizjet që do të mund të bëhen në rrjetin e diplomacisë së vendit. Një paralajmërim i tillë ka dalë gjatë një takimi të presidentit të Kosovës, Behgjet Pacollit, me kreun e diplomacisë së Kosovës, Enver Hoxhaj. Ky takim për kryefjalë ka pasur angazhimin dhe koordinimin e punës së këtyre dy institucioneve kyçe të politikës së jashtme të vendit, me theks të veçantë në aktivitetin për sigurimin e njohjeve të reja të shtetit tonë. **"Kemi shumë punë për të bërë në fushën diplomatike dhe që nga sot kemi biseduar që t'i koordinojmë gjërat dhe së bashku të punojmë dhe t'i sjellim Kosovës sa më tepër njohje, sa më tepër respekt nga miqtë tanë të jashtëm dhe Kosovën ta çojmë me hapa sa më të shpejtë drejt inkuadrimeve globale"**, theksoi presidenti Pacolli. Duke qenë se sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës politika e jashtme udhëhiqet nga presidenti i vendit, ministri Hoxhaj tha se janë dakorduar që ta hartojnë një plan të përbashkët të punës. "Së shpejti do të dalim në formë publike me këtë plan të punës dhe ky plan do të jetë plan i punës i Qeverisë së Republikës së Kosovës", tha Hoxhaj, teksa vlerësoi kontributin e presidentit Pacolli në sigurimin e njohjeve. "Prandaj, edhe qëllimi i takimit ishte që unë si ministër i punëve të Jashtme me presidentin të bisedojmë për atë se në çfarë drejtimi të lëvizim gjatë javëve të ardhshme në vijim dhe sigurisht që më pak do të jemi të pranishëm në Kosovë dhe më shumë do të lëvizim në pjesë të tjera të botës, me qëllim që Republika e Kosovës të jetë e pranishme në çdo pjesë të botës", theksoi Hoxhaj.

### Stafi diplomatik

Me ndryshimet e Ligjit për misionet e jashtme parashihet mundësia që ambasadorët të emërohen nga partitë politike. Ministria e Jashtme në fund të vitit të kaluar ka bërë një analizë të punës së misioneve diplomatike, për të cilën nuk ka pasur një raportim për shkak të vakumit institucional. Ende mbetet e paqartë nëse do të ketë ndryshime brenda stafit të ambasadave në vendet e jashtme, duke filluar nga ambasadorët e deri te konsujt. Pacolli paralajmëroi një erë të re të trajtimit të diplomacisë. **"Ne do të krijojmë një diplomaci moderne, gjithëpërfshirëse dhe në bashkërendim me ministrin do të krijojmë përfaqësim dinjitoz të jashtëm të Kosovës. Gjithmonë duke i vlerësuar edhe ata ambasadorë dhe konsuj të spikatur që i kemi sot"**, tha Pacolli. Mirëpo, ai nuk e përjashtoi mundësinë që të ketë lëvizje brenda rrjetit diplomatik të Kosovës. "Por ne do t'i plotësojmë edhe me figura të tjera normalisht. Ne me ministrin biseduam po ashtu që të fillojmë të hapim edhe konsullata dhe do të kemi konsuj të nderit. Kështu që do të kemi një punë shumë intensive në diplomaci dhe besoj se kjo do të ketë efekt", tha Pacolli, i pyetur nëse do të ketë lëvizje të reja. Veç imazhit të dëmtuar nga raporti i Dik Martit, sigurimi i njohjeve të reja, që i siguron vendit forcim të pozitës në arenën ndërkombëtare, mbetet një nga sfidat kryesore të diplomacisë kosovare. - I. KRASNIQI

---

## Plane për njohje të reja

---

PRISHTINË - Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, ka marrë mbështetjen e EULEX - it në kryerjen e detyrës së tij. Gjatë takimit me shefin e këtij misioni, Xavier Bout de Marnhac, Pacolli çmoi lart rolin dhe punën e EULEX - ut dhe shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucioneve të Kosovës për bashkëpunim me këtë mision. Pas takimit, presidenti është angazhuar për intensifikimin e bashkëpunimit me misionin e BE - së në Kosovë. Ndërsa shefi i EULEX - it, Xavier Bout de Marnhac, e ka siguruar presidentin Pacolli që EULEX - i është i dedikuar të promovojë sundimin e ligjit në Kosovë. "Jemi ngushtë të lidhur në fushën e politikës, sidomos t'i mbështesim institucionet e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit", ka thënë ai. Presidenti Pacolli të premten është takuar edhe me ministrin e Punëve të Jashtme të Kosovës, Enver Hoxhaj, gjatë të cilit takim është diskutuar për angazhimin dhe koordinimin e punës së këtyre dy institucioneve kyçe të politikës së jashtme të vendit, me theks të veçantë në aktivitetin për sigurimin e njohjeve të reja të shtetit tonë. Ndërsa ministri i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, ka thënë se gjatë takimit të punës me presidentin janë dakorduar që ta hartojnë një plan të përbashkët, një agjendë dinamike, agresive e cila do t'i sjellë Kosovës sa më shumë njohje. "E cila do ta përfaqësojë, prezantojë dhe promovojë shtetin e Kosovës në botë", tha ai. Së shpejti, sipas Hoxhajt, do të publikohet ky plan i punës dhe ai do të jetë plan i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

## **Pacolli: Do t'i luftojmë grupet kriminale në veri**

**“Unë po ju premtoj se në këtë mandat pesëvjeçar, bashkë me njerëzit e Qeverisë së Kosovës, me njerëzit e Kosovës dhe që ia duan të mirën Kosovës, edhe në këtë anë do t'i kthejmë rendin dhe ligjin”, ka thënë Pacolli.**

I përcjellë e i paraprirë nga njësitë elite të Policisë së Kosovës dhe nga policët e armatosur të EULEX - it, presidenti i ri kosovar, Behgjet Pacolli, bashkë me ministrin e Brendshëm, Bajram Rexhepi, e kanë kaluar në këmbë urën e lumit Ibër, për të takuar banorët shqiptarë të veriut të Mitrovicës. Pasi kanë kaluar në cepin verior të urës, Pacolli e Rexhepi janë drejtuar për te "Tre Rrokaqiejt", të cilët gjenden në rrugën e Suhadollit. Rexhepi tërë rrugës i ka folur Pacollit për veriun, duke ia treguar atij edhe kafenenë e famshme "Dolcevita". Banorët shqiptarë të "Tre Rrokaqiejt" me duartrokitje pritën ardhjen e dy udhëheqësve të institucioneve kosovare. Elhame Bala, banore e "Tre Rrokaqiejve", ka theksuar se popullata shqiptare në veri është lënë në mëshirën e fatit. "Ju jeni njeriu i vetëm (udhëheqësi v.j) përpos Bajram Rexhepit që na keni vizituar", i ka thënë ajo Pacollit. Në anën tjetër, presidenti i sapozgjedhurar i Kosovës, Behgjet Pacolli, iu ka premtuar banorëve të veriut të Mitrovicës se do t'i luftoj grupet kriminale në këto pjesë të vendit, "Qytetarët e kësaj pjese veriore të Mitrovicës do të ndihen si qytetarë të Republikës së Kosovës e kurrësi ndryshe", ka thënë ai. Derisa Pacolli po ecte në rrugët e veriut të Mitrovicës, qytetarët serbë të hutuar vëzhgonin përskaaj rruges ndërsa disa të tjerë vazhdonin punët e tyre pa e çarë shumë kokën se kush po kalonte andejpari. Derisa po bisedonin me banorët e "Tre Rrokaqiejve", dikush nga hyrja e komunës së UNMIK - ut madje brohoriste "Serbia". Pacolli ka vizituar edhe shtëpinë e ministrit Rexhepi, që ndodhet në Suhadoll, me të cilin kanë biseduar pa praninë e mediave, ndërkohë që pas këtij takimi ata janë prononcuar. **"Për mua nuk ekziston termi veri apo jug, ekziston si term gjeografik dhe jo politik e administrativ",** ka thënë ai. **"Ishim në këtë anë t'i kontaktonim banorët, pa marrë parasysh se cilës kombësi apo fe i përkasin, t'u tregojmë se janë pjesë përbërëse e Kosovës, se janë qytetarë të Kosovës, të ndihen mirë dhe të themi se edhe në këtë anë mbreteron ligji dhe jam përkushtuar që t'ua përmirësojmë jetën edhe këtyre qytetarëve në këtë anë",** Pacolli ka ngatërruar, ndërkaq postin e ministrit Rexhepi, duke e quajtur atë ministër të Mbrojtjes. Në anën tjetër ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, në shtëpinë e tij në Suhadoll ka thënë se me një punë të përbashkët krejt territori i Kosovës do të jetë unik, ku do të vlejnjë ligjet e Kosovës. Ky është një proces, ku me një përkushtim dhe ide që edhe presidenti i ka shpalosur dje në një bisedim të përbashkët, këto janë dy çështje, në rend të parë sundimi i rendit dhe i ligjit, dhe zhvillimi ekonomik", ka thënë Rexhepi. Sipas tij, këto do të jenë, si synime strategjike në të ardhmën që të bëhet integrimi i mirëfilltë edhe i qytetarëve, jo vetëm integrimi administrativ". Ndërsa sa i përket bisedimeve Kosovë - Serbi, dhe se a do të jetë veri pjesë e bisedimeve, Pacolli ka theksuar se grupi i bisedimeve është në përgatitje e sipër dhe ata kanë agjendën e vet, e cila është mbështetur nga miqtë tanë ndërkombëtarë, Qeveria e Kosovës dhe nga Presidenca". Rreth mënyrës sesi do ta luftojë krimin e organizuar në veri, ai ka theksuar se **"unë (Pacolli v.j) po ju premtoj se në këtë mandat pesëvjeçar, bashkë me njerëzit e Qeverisë së Kosovës, me njerëzit e Kosovës dhe që ia duan të mirën Kosovës, edhe në këtë anë do ta kthejmë rendin dhe ligjin. Ligji do të**



**jetë mbi të gjithë dhe qytetarët e kësaj pjese do të ndihen si pjesë plotësisht përbërëse e Kosovës".** Ai ka premtuar se edhe shumë herë do ta kalojë këtë urë, sepse qytetarët e kësaj ane e meritojnë që institucionet e vendit të jenë pjesë e halleve të tyre këtu. Ai është pyetur edhe për qëndrimin e tij në lidhje me krizën në Libi, me ç'rast ka thënë se perkrahe popullin libian e jo mikun e tij, diktatorin e këtij shteti, Muhamer Gadafi.





*I përcjellë nga njësitë elite të Policisë së Kosovës dhe nga policët e armatosur të EULEX - it, presidenti Behgjet Pacolli, bashkë me ministrin e Brendshëm, Bajram Rexhepi, e kanë kaluar në këmbë urën e lumit Ibër*

---

## **Pritet Definimi i agjendës dhe datës së dialogut**

---

**Robert Cooper ka takuar kryeministrin Thaçi dhe zëvendësministren Tahiri. Brukseli do ta publikojë së shpejti një agjendë paraprake të dialogut Kosovë-Serbi dhe do të caktojë një datë të shpejtë për takimin e parë. Presidentit Pacolli i kanë mjaftuar tri fjali adresimi para medieeve, për të bërë dy gafa në raport me dialogun. Ai i është referuar procesit si “negociata” dhe e ka vlerësuar Serbinë si “partnere” të Kosovës.**

PRISHTINË, 25 SHKURT - Procesi që po proklamohet si dialog teknik mes Prishtinës e Beogradit, për presidentin e Kosovës, Behgjet Pacolli, është proces negociatash. Presidentit të zgjedhur së fundi i kanë mjaftuar tri fjali adresimi para medieeve, për të bërë dy gafa në raport me dialogun. Ai i është referuar procesit si negociata dhe e ka vlerësuar Serbinë si partnere të Kosovës. Komentet kreut i Presidencës i ka bërë në takimin e parë zyrtar me ministrin e jashtëm, Enver Hoxha. Kryediplomati i ri kosovar ka preferuar që të heshtë dhe të mos flasë fare para medieeve, pasi që i ka dëgjuar gafat e presidentit. Që të dy janë takuar të premten, ditën kur e ka përmbyllur vizitën e tij në Kosovë, diplomati që do të fasilitojë bisedimet, Robert Cooper. Ne mesditën e së premtes Cooper ka qëndruar në Qeverinë e Kosovës. Ai, larg vëmendjes së publikut, ka zhvilluar një takim me kryeministrin e Kosovës, Hashim Thaçi dhe zëvendëskryeministrin që do të udhëheq ekipin kosovar të bisedimeve, Edita Tahiri. Cooper diplomati që nga përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Europian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, baronesha Catherine Ashton, është emëruar si lehtësues i dialogut, pas takimit me Thaçin e Tahirin ka udhëtar për në Bruksel, por do të kthehet në rajon brenda pak ditësh për të vizituar edhe Beogradin. Konsultimet kanë për qëllim caktimin e datës dhe vendit të takimit të parë mes përfaqësuesve kosovare e serbë, por edhe për të vendosur një agjendë paraprake të temave që do të diskutohen. Zyrtarë të lartë evropianë i kanë thënë gazetës në kushte anonimiteti se deri nga mesi i javës së ardhshme pritet të përpilohet një agjendë, por edhe të caktohet një datë. Siç ka raportuar gazeta, procesi i vetëm që mund ta shtyjë dialogun edhe për ndonjë javë do të ishte ndonjë kërkesë që partitë opozitare kosovare mund të deponojnë në Gjykatën Kushtetuese, për të kërkuar interpretimin e saj për mënyrën e zgjedhjes së Pacollit president i Kosovës. Përfaqësitë e BE - së në Kosovë, e as zyra e baroneshës Ashton nuk kanë preferuar që për qëndrimin dyditor në Kosovë, Cooper të lëshojnë ndonjë njoftim për media. Njoftim ka lëshuar vetëm zyra e kryeministrit. Në të thuhet se kryeministri Thaçi ka pritur Robert Cooperin dhe se në takim është diskutuar për çështjen e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë "si dy shtete të pavarura, në kontekst të integriteteve evropiane dhe përmirësimit të raporteve ndërfqinjësore". "Në këtë kuadër, në takim u potencua se dialogu për çështje praktike do të fokusohet në çështjet, të cilat do të lehtësojnë jetën e qytetarëve të të dyjave vendeve, siç janë lëvizja e lirë, shkëmbimi tregtar dhe bashkëpunimi rajonal", thuhet në njoftimin e Kryeministrit. "Nga ana e tij, kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, theksoi se institucionet e reja të Republikës së Kosovës janë të përkushtuara plotësisht për agjendën evropiane, zhvillimin ekonomik, sundimin e ligjit, mirëqenien e qytetarëve, raportet e mira me të gjithë fqinjët, të cilat do të çojnë në afat sa më të shpejt tek integrimi euroatlantik i Kosovës", thuhet në këtë njoftim. Komunikata është në frymën e deritanishme të deklarimeve të kryeministrit Thaçi, që procesin e ardhshëm me Serbinë e Kosovën e ka vlerësuar si dialog mes

shteteve fqinje, por është në kundërtënie me deklaratimet e presidentit të vendit, Behgjet Pacolli. **"Qeveria e Kosovës ka filluar dje që të formojë grupin negociues dhe po më duket është zgjedhur shefi për negociata. Presidenca do ta ketë përfaqësuesin e vet në këtë grup dhe e inkurajoj edhe më tutje shefin e Qeverisë së Kosovës që të punojë në këtë drejtim, të formojë një grup ekspertësh me njerëz dinjitozë që përfaqësojnë interesat e Kosovës në këtë dialog, gjithmonë duke respektuar partnerin tonë dhe duke kërkuar respekt të njëjtë nga partneri ynë i bisedimeve"**, ka thënë presidenti Pacolli, duke vlerësuar se Kosova duhet ta trajtojë si partnere Serbinë.

---

## **Pacolli lobi t'ia jepte PTK-në partnerit të tij të biznesit**

---

**Kompania LCM, të cilën e përfaqëson biznesmeni Esad Pushkar, synonte ta merrte në menaxhim për gjashtë vjet korporatën publike të Postë-Telekomit të Kosovës. Vitin e kaluar si ndërmjetës mes tij e Qeverisë kishte qenë presidenti Pacolli, për të cilin biznesmeni Puscar ndërmjetësoi me SMS-a me ambasadorin amerikan Dell**

Po ashtu, sipas tij, është i lidhur ngushtë edhe me "Taçi Oil", njërën prej korporatave më të mëdha të naftës në rajon, e cila operon në Shqipëri. Puscar në ueb faqen përveç fotove me Pacollin ka publikuar edhe një me kryeministrin Thaçi, si dhe një "foto shoqërore" me ministrin e Punëve të Brendshme e ish - kryeministrin Bajram Rexhepi. Gazeta e ka pasur të pamundur kontaktin me Puscarin, edhe pse ka provuar ta bëjë këtë përmes zëdhënësit të partisë, i cili ka deklaruar se nuk ka kontakte me këshilltarin e shefit. Ndërkaq zv. kryeministrja Kusari - Lila, e cila vitin e kaluar e kishte prezantuar ofertën e LCM së për menaxhimin e PTK - së, ka deklaruar për gazetën se atëkohë AKR - ja vetëm ka dhënë një alternativë më të mirë për mbledhjen e fondeve për buxhetin e vendit nëpërmjet PTK - së. "Ata (LCM) e kanë kontaktin me Puscarin për mundësitë në Kosovë dhe e kanë dërguar letrën, të cilën e kemi prezantuar. Këtu nuk ka diçka që mundet me qenë konflikt interesi, ka thënë Kusari - Lila sipas së cilës e njëjta letër nga kryetari Pacolli i është dërguar Qeverisë. Sipas saj, ajo që ka bërë AKR - ja nuk mund të quhet lobim për Esad Puscarin, edhe pse ne ueb faqen e tij këshilltari i Pacollit e përshkruan veten si përfaqësues i "London Capital Market" për tregjet ndërkombëtare.

---

## **Pacolli: Ideali i lirisë është ujitur me gjakun e dëshmorëve tanë**

---

### **Rifat Jashari u bëri thirrje liderëve që t'i lënë anash grindjet**

Me përkujdesjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës ka filluar manifestimi tradicional "Epopeja e UÇK-së" e 5, 6 dhe 7 marsit, me rastin e trembëdhjete vjetorit të rënies heroike të komandantit legjendar të UÇK-së - Adem Jasharit dhe familjes së tij. Me këtë rast Forca e Sigurisë së Kosovës organizoi manifestimin qendror me moton "Nderojmë Historinë-Ndërtojmë të Ardhmen", në kazermën "Adem Jashari", në të cilën morën pjesë drejtues të institucioneve shtetërore të Kosovës, ministra të kabinetit qeveritar, deputetë, anëtarë të familjes Jashari, përfaqësues të komuniteteve fetare etj. Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli dhe komandanti i FSK-së, gjeneral lejtënant Sylejman Selimi bënë inspektimin e trupave dhe të kapaciteteve të FSK-së.

### **Nderim për familjet e dëshmorëve**

Presidenti i Republikës së Kosovës Behgjet Pacolli, fillimisht vizitoi Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, i shoqëruar edhe nga komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneral lejtënant Sylejman Selimi, ku parakaloi para Gardës së FSK-së. Më pas Pacolli u prit në një takim nga ministri i Forcës së Sigurisë, Agim Çeku dhe bashkëpunëtorët e tij. Presidenti Pacolli, i cili është edhe komandant suprem i Forcës së Sigurisë së Kosovës, ofroi gjithë mbështetjen e tij për zhvillimin e kësaj force. Ai lavdëroi punën e bërë nga pjesëtarët e FSK-së, në të gjitha angazhimet e tyre, si dhe u shpreh se do të punohet që pjesëtarët e FSK-së, qoftë edhe në mënyrë simbolike, të jenë pjesë e misionëve të ndryshme ndërkombëtare, në shërbim të paqes në botë. Pas takimit presidenti Pacolli mori pjesë në manifestimin qendror të shënimit të 13-vjetorit të rënies heroike të Komandantit Legjendar-Adem Jashari, organizuar në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, ku ishin të pranishëm edhe kryeministri i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi, kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi, ministra të kabinetit qeveritar të Kosovës, përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme, përfaqësuesit diplomatikë të akredituar në vendin tonë, udhëheqësit e KFOR-it, si dhe qytetarë të shumtë, të ardhur për të përcjellë këtë ceremoni që shënon fillimin e manifestimit tregor në shënim të përvjetorit të rënies së komandantit Adem Jashari dhe luftës heroike të familjes Jashari. **"Jam i prekur dhe i nderuar njëkohësisht që të marr pjesë në përkujtimin e Epopesë së ndritur të Luftës Çlirimtare të Kosovës. Ndiem shumë i vlerësuar që, bashkë me ju, po kujtojmë heronjtë e kësaj lufte, që sakrifikuan jetën, gjëja më e shtrenjtë që Perëndia i jep njeriut, për çlirimin e vendit dhe ndërtimin e shtetit të Kosovës. Po ashtu jam thellë i emocionuar që, së bashku me ju, po përkulemi me respekt para familjes heroike të Jasharëve, shembullit më të ndritur të kësaj epopeje. Në zemrat tona i mbajmë edhe familjet e tjera të dëshmorëve që ranë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës... Kontributi juaj është kontribut për të ardhmen e ndritur të vendit tonë, të Kosovës sonë të dashur. Ajo është themeluar mbi veprën e shkëlqyer të pararendësve të luftës çlirimtare të popullit tonë. Kjo luftë i tregoi mbarë botës se ideali i lirisë nuk vdes kurrë në viset tona, i tregoi botës së pema e lirisë ndër ne është gjithmonë e gjelbër dhe nuk thahet kurrë, ajo është e ujitur me gjakun e dëshmorëve tanë. Ndaj sot me lejoni që, duke ju nderuar juve, të përkujtojmë edhe**

**njëherë ata që u sakrifikuan për lirinë dhe pavarësinë e vendit tonë”,** tha ndër të tjera presidenti Behgjet Pacolli.



*Presidenti Pacolli i shoqëruar nga komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneral lejtënant Sylejman Selimi, parakaloji para Gardës së FSK-së. Presidenti Pacolli, ishte edhe komandant suprem i Forcës së Sigurisë së Kosovës*



*Presidenti Pacolli më pas u prit në një takim nga ministri i Forcës së Sigurisë, Agim Çeku dhe bashkëpunëtorët e tij*





*Pas takimit presidenti Pacolli mori pjesë në manifestimin qendror të shënimit të 13-vjetorit të rënies heroike të Komandantit Legjendar-Adem Jashari, organizuar në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, ku ishin të pranishëm edhe kryeministri i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi, kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi, ministra të kabinetit qeveritar të Kosovës, përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme, përfaqësuesit diplomatikë të akredituar në vendin tonë , udhëheqësit e KFOR-it, si dhe qytetarë të shumtë, të ardhur për të përcjellë këtë ceremoni që shënon fillimin e manifestimit treditor në shënim të përvjetorit të rënies së komandantit Adem Jashari dhe luftës heroike të familjes Jashari*

## **5 marsi ishte dita e bashkimit të shqiptarëve**

Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, theksoi se 5 marsi është dita e bashkimit të të gjithë shqiptarëve, por kjo është edhe dita e zgjimit të ndërgjegjes së bashkësisë ndërkombëtare për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. "13 vjet më parë Familja Jashari, komandanti Adem Jashari, e gjithë Kosova u zgjua me një betejë për liri për shtet, për bashkim. Atë ditë pushka e Komandantit Legjendar Adem Jashari, familjes së tij, bashkëluftëtarëve të tij, bashkoi gjithë Kosovën, bashkoi gjithë shqiptarët kudo që jetojnë, në Shqipëri, në Maqedoni, në Preshevë, në Medvegjë e në Bujanovc, në Ulqin, në diasporën shqiptare në Evropë dhe në SHBA. Në këtë ditë u bashkua Kosova, u bashkuan shqiptarët, por edhe u zgjua vëmendja e gjithë komunitetit ndërkombëtar për Kosovën si kurrë ndonjëherë më parë në historinë e saj. Prandaj 5 marsi është dita e bashkimit e të gjithë shqiptarëve. Por është edhe dita e zgjimit të ndërgjegjes së bashkësisë ndërkombëtare për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës", tha kryeministri Thaçi, duke theksuar se për 13 vite janë realizuar synime shkallore për Kosovën e lirë dhe ta pavarur. "Sot kur jemi të pavarur dhe shtet sovran, të njohur nga 75 vende të botës, për këto 13 vite realizuam synimet tona shekullore për Kosovën e lirë e të pavarur. Tani si kurrë ndonjëherë më parë jemi

të bashkuar për synimin tonë drejt integritit të vlerave euroatlantike, për të integruar shtetin e Kosovës në NATO dhe në BE. Edhe njëherë lavdi i jetës dhe veprës së Komandantit legjendar Adem Jashari", theksoi Thaçi. Në anën tjetër, ministri i Forcës së Sigurisë (MFSK), Agim Çeku, theksoi se 5 marsi është një ditë e madhe e cila na bënë të ndihemi krenar që jemi qytetarë dhe bashkëkombës të komandantit Adem Jashari dhe familjes Jashari që me aktin e tyre nderuan historinë dhe fatin e popullit tonë. "Në këtë ditë ne shohim lavdinë tonë, i shohim të arriturat tona dhe të ardhmen tonë. Është dashur të bëjmë sakrifica të ndryshme për të arritur qëllimin tonë, krijimin e shtetit, tani është koha ta çojmë përpara këtë qëllim. Dhe këtë qëllim mund ta çojmë përpara duke ndërtuar shtet dhe institucione të fuqishme dhe me kredibilitet", theksoi ai. Ministri Çeku duke u zotuar se do të vazhdojë punën për krijimin e FSK si forcë profesionale në përputhje me standardet më të larta të NATO-së, theksoi se do punohet për integrimin e vendit në strukturat euroatlantike. Ndërkaq në emër të familjes Jashari, të pranishmit me një fjalë rasti i përshëndeti Bekim Jashari, i cili uroi që FSK-ja sa më shpejt të jetë partnere e NATO-së. "Uroi që festat e ardhshme t'i festojmë ashtu siç duhet, por njëkohësisht, ushtria jonë, Forcat e Sigurisë së Kosovës, ashtu siç duket sot në një ditë sa më të afërt të jetë partnere e NATO-s" theksoi Jashari.

### **Vizitat në familjen Jashari**

Në përvjetorin e 13 të luftës së Jasharëve, Kompleksi dhe familja Jashari është vizituar nga shumë qytetare dhe nga pak delegacione të institucioneve qeveritare, partiake e joqeveritare. Me rastin e 13 vjetorit të luftës dhe sakrificës së familjes Jashari në krye me Komandantin Legjendar Adem Jashari, Kompleksin Përkujtimor dhe Kalanë e Pamposhtur të kësaj familjeje e vizituan përfaqësuesit e komunave, të partive politike të shoqatave dhe të institucioneve arsimore të Kosovës. Delegacioni i parë që bëri homazhe të varrezat e familjes Jashari që ai i Rektoratit të Universitetit të Prishtinës. Më këtë rast rektori i Universitetit të Prishtinës, Mujë Rugova, uroi që kjo familje të zgjerohet sa më shumë dhe nga një të bëhen një milion. Kam ardhur për të shprehur respektin e përjetshëm për familjen Jashari dhe të gjithë dëshmorët e tjerë. Jasharët nga një u bëfshin një milion!", theksoi Rugova. Ai vizitoi edhe familjen Jashari, të cilës i dorëzoi bustin e Adem Jasharit, të punuar në bronz nga një studenti Akademisë së Arteve. Ndërkaq lideri i lëvizjes "Vetëvendosje", Albin Kurti, gjatë vizitës së tij që i bëri familjes Jashari në Prekaz, theksoi se rënia heroike në krye me Komandantin Legjendar Adem Jashari i dha një hov të jashtëzakonshëm luftës çlirimtare të Kosovës. "Është kjo ditë e cila na kthen në kohën e Luftës Çlirimtare, atëherë kur vetëdija kombëtare u ngrre si asnjëherë më parë dhe mundësoi që lufta çlirimtare të përhapet anekënd Kosovës. Prekazi është vendi në të cilin janë filllet e organizimit të forcave të armatosura, por njëkohësisht është edhe vend ku lufta çlirimtare është e fuqishme dhe Adem Jasharit dhe familjes së tij iu bashkuan edhe qindra e qindra dëshmorë të tjerë të cilët dhanë jetën për lirinë e Kosovës. Prekazi është vendi në të cilin janë filllet e organizimit të forcave të armatosura, por njëkohësisht është vendi ku lufta çlirimtare është fuqizuar dhe Adem Jasharit dhe familjes së tij iu bashkuan edhe qindra dëshmorë të tjerë që dhanë jetën për lirinë e Kosovës, theksoi Kurti. Familjen Jashari të shtunën e vizituan përfaqësuesit e komunave nga Vushtrrisë dhe nga Malisheva.

---

## **Pacolli zgjedh variantin e Sejdiut**

---

**“Unë nuk jam kompetent të vendos për vendimet e kushtetutës, për atë është gjyqi më i lartë, i cili vedos për këto raste, t’i lëmë ata, të mos ndërhyjmë në punët e tyre a është shkelur kushtetuta a jo, t’ia lëmë Gjykatës Kushtetuese”, ka thënë Pacolli të dielën.**

### **LDK - ja paralajmëron se javën që vjen e dërgon Pacollin në gjyq**

Lidhja Demokratike e Kosovës e ka marrë me shumë seriozisht sesa dy subjektet e tjera në opozitë: lëvizja "Vetëvendosje dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës - dërgimin e rastit Pacolli në Gjykatën Kushtetuese. Në LDK kanë thënë se ekspertet ligjor të jenë duke punuar në lëndën Pacolli dhe se ajo do të finalizohet javën që vjen. Duket se është e qartë që është shkelur Kushtetuta, sepse presidenti ka votuar si deputet dhe ne kemi vendosur që të kërkojmë interpretim prej Gjykatës Kushtetuese. E kemi një grup të ekspertëve ligjorë të cilët po merren me përgatitjen e lëndës, ne nuk kemi ende lëndë finale, por janë disa çështje që do të ngrihen", ka thënë anëtari i Kryesise se LDK – së, Kujtim Shala. "Besoj që javën që vjen gjithçka do të finalizohet". Në lëvizjen "Vetëvendosje" kanë thënë se mund të ndodhë që ky subjekt të kërkojë interpretim nga Kushtetuesja. "Kjo që është gjetur së fundmi është shkelja me e pakontestueshme. Mund të procedojmë, ne s'kemi marrë ende vendim, por mund ta bëjmë këtë punë", ka thënë anëtari i udhëheqjes qendrore të lëvizjes Vetëvendosje Glauk Konjufca. "Gjykata Kushtetuese nuk është plotësisht e pavarur dhe ne frikesohemi se ajo nuk do ta shpallë këtë shkelje të rëndë, por vetem të lehtë me ç'rast nuk do të ketë kurrfarë pasoje juridike mbi presidentin". Në AAK e kanë lënë për javën që vjen për të parë se çka do të mund të bëjnë për dërgimin e presidentit në Gjykatën Kushtetuese. Kjo është shkelje flagrante e Kushtetutës, sepse njeriu...e ka bërë me qëllim sepse ishte dashur t’ia kthente borxhin Hashim Thaçit, i cili në mënyrë poashtu kushtetuese e votoi si president”. Është shprehur sekretari i përgjithshëm i AAK-së Burim Ramadani. "Ne do ti shyrtojmë mundësitë për marrjen e masave ligjore dhe kushtetuese”.

### **Ekspertët thonë se Pacolli s'ka pasur të drejtë të votonte**

Profesori i së drejtës kushtetuese, Arsim Bajrami, ka thënë se presidenti nuk ka mundur të votojë në Kuvend, pas dhënies së betimit. "Prej momentit, kur ai (presidenti vj) e jep betimin, fillon t'i rrjedhë mandati. Dhe, në bazë të Kushtetutës, ai nuk mund të ketë asnjë funksion në parti politike e as ndonjë funksion tjetër publik, ka deklaruar ai, nëpërmjet një bisede telefonike. Bajrami ka sqaruar se momenti i betimit të presidentit, shënon edhe fillimin e kufizimeve kushtetuese për njeriun e parë të shtetit. Edhe pse ka qenë njëri nga anëtarët e Komisionit, hartimin e Kushtetutës, Bajrami nuk parapëlqen që ta bëjë vetë kualifikimin e shkeljes që ka bërë Pacolli. "Unë vetëm mund t'ju garantoj se nga momenti kur e jep betimin, ai është president i zgjedhur. Kualifikimin zyrtar, në bazë të Kushtetutës, e bënë Gjykata Kushtetuese", ka thënë ai. Një njohës tjetër i çështjeve juridike kushtetuese, duke mos dashur t'i përmendet emri në gazetë, e ka ndërlidhur rastin e Pacollit me atë të pararendesit të tij, Fatmir Sejdiu. "Nëse ish - presidenti Fatmir Sejdiu e ka shkelur pikën 2 të nenit 88 të Kushtetutës së Kosovës, Behgjet Pacolli e ka shkelur pikën 1 të po të njejtit nen. Pasi Sejdiu, ka bërë shkelje duke kryer

funkcionin e kryetarit të LDK - së, Pacolli ka bërë shkelje duke e mbajtur postin e deputetit. Prandaj, nëse ngrihet ky rast në Gjykatë Kushtetuese, atëherë dhe verdikti i kësaj gjykate do të ishte i njëjtë si në rastin e Sejdiut", ka thënë ky ekspert kushtetues. LDK - ja dhe AAK - ja dhe më heret kishin paralajmëruar se do të kërkojnë interpretimin e Gjykatës Kushtetuese, nëse zgjedhja e presidentit që bërë konform Kushtetutës dhe Rregullores së punës së Kuvendit. Si çështje kontestuese, këto dy parti i kishin marrë: mungesën e kuorumit në dy raundet e para të votimit si dhe ndërprerjen e procesit të votimit para raundit të tretë. Mirëpo, Pacolli ditë më parë ishte shprehur i gatshëm që të përballet me Kushtetuesen. "Unë kam kaluar me 90 për qind të votove të deputetëve të cilët ishin në sallë", kishte thënë ai.

### **Varianti i Sejdiut**

Presidenti i ri i Kosovës, Behgjet Pacolli, pos që ka vendosur ta zgjedhë variantin e kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi, për t'i injoruar pyetjet e gazetarëve, ai për çështjen e shkeljes së Kushtetutës ka vendosur që ta zgjedhë variantin e ish - presidentit të Kosovës, Fatmir Sejdiu. Sejdiu kur ishte zgjedhur president i Kosovës në janarin e vitit 2008 nuk kishte dhënë fare dorëheqje nga kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Më shumë se dy vjet ai nuk kishte dhënë dorëheqje, duke thënë se postin e kryetarit të LDK - së e kishte ngrirë. Në qershor të vitit 2010 dy deputetët e pavarur të legjislaturës së atëhershme, Naim Rrustemi dhe Driton Tali, ia patën vendosur një "pykë" Sejdiut duke i kërkuar Kushtetueses të jepte interpretim nëse ai e ka shkelur aktin më të lartë juridik të shtetit me mbajtjen e dy funksioneve. Vendimi i Kushtetueses se presidenti e ka shkelur Kushtetutën pati ardhur në shtator, gjë e cila e pati dhënë për produkt dorëheqjen e Sejdiut në të njëjtin muaj. Mirëpo, dorëheqja nuk që akti i vetëm që pati bërë ish - kryetari i LDK - së: Sejdiu pati vendosur në tetor që ta tërheqë partinë e tij nga koalicioni me Partinë Demokratike të Kosovës pas dy vjet e gjysmë qeverisjeje. Kjo gjë pati bërë që AKR - ja e Behgjet Pacollit ta procedojë në Kuvendin e Kosovës mocionin për mosbesimin e qeverisë së mbetur që ishte votuar në të njëjtin muaj duke e detyruar ushtruesin e atëhershëm të detyrës së presidentit, Jakup Krasniqi, që të shpërndante Kuvendin dhe të caktonte datën e zgjedhjeve më 12 dhjetor.

## Pacolli, këmbë në veri

MITROVICË - Në prani të shtuar të Policisë së Kosovës, EULEX - it dhe KFOR - it, presidenti i porsazgjedhur i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, i shoqëruar nga ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, kanë vizituar të shtunën zonën e "Tre Rrokaqiejve", në pjesën veriore të Mitrovicës, në të cilën janë pritur ngrohtësisht nga banorët shqiptarë. Kreu i Kosovës, me këtë rast u ka premtuar qytetarëve se do t'i luftojnë grupet kriminale në këtë pjesë të vendit. Ai ka thënë se qytetarët e pjesës veriore të Mitrovicës do të ndihen si qytetarë të lirë të Republikës së Kosovës. **"Për mua nuk ekziston termi veri apo jug, ekziston si term gjeografik dhe jo politik e administrativ"**, tha Pacolli. Ai ka thënë se në këtë pjesë të vendit ka shkuar për t'i takuar dhe kontaktuar banorët e kësaj ane, pa marrë parasysh cilës kombësi apo fe i përkasin ata. **"Ne kemi ardhur t'u tregojmë atyre se janë pjesë përbërëse e Republikës së Kosovës, janë qytetarë të Kosovës, të ndihen mirë dhe të themi se edhe në këtë anë mbretëron ligji, dhe jam përkushtuar që t'ua përmirësojmë jetën edhe këtyre qytetarëve"**, është shprehur Pacolli. I pyetur se a do të përfshihet veriu si temë e bisedimeve ndërmjet Prishtinës e Beogradit, Pacolli nuk ka dashur që të komentojë, por vetëm ka thënë se grupi i bisedimeve është në përgatitje e sipër dhe ata kanë agjendën e vet, e cila është e mbështetur nga, siç është shprehur ai, **"miqtë tanë ndërkombëtarë, Qeveria e Kosovës dhe Presidenca"**. Ai ka premtuar se gjatë mandatit të tij si president, ai do ta kthejë rendin dhe ligjin në atë pjesë të vendit. **"Unë po ju premtoj se në këtë mandat pesëvjeçar, bashkë me njerëzit e qeverisë, me njerëzit e Kosovës dhe që ia duan të mirën Kosovës edhe në këtë anë do ta kthejmë sundimin e rendit dhe ligjit"**, tha Pacolli. Ai poashtu premtoi se edhe shumë herë do ta kalojë këtë urë, sepse siç tha ai, qytetarët e kësaj ane meritojnë që institucionet e vendit të jenë pjesë e halleve të tyre edhe këtu. I pyetur ndërkaq, se a e përkrah popullin e Libisë, në ngjarjet e undit, kryetari Paciolli u përgjigj me po. Ndërsa, ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi ka thënë se ai për çdo vikend viziton këtë pjesë të territorit. **"Me një punë të përbashkët gjithë territori i Kosovës do të jetë unik, ku do të vlejnjë ligjet e Kosovës"**, tha Rexhepi. Pacolli, gjatë qëndrimit në Mitrovicë, ka vizituar edhe shtëpinë e ministrit Rexhepi që ndodhet në fshatin Suhadoll, me të cilin kanë biseduar pa praninë e mediave. **"Unë po ju premtoj se në këtë mandat pesëvjeçar, bashkë me njerëzit e qeverisë, me njerëzit e Kosovës dhe që ia duan të mirën Kosovës edhe në këtë anë do ta kthejmë sundimin e rendit dhe ligjit"**, tha Pacolli.



*Behgjet Pacolli, i shoqëruar nga ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, kanë vizituar zonën e "Tre Rrokaqiejve" në pjesën veriore të Mitrovicës*

---

## **Kusari-Lila: Qeveri e pastër**

---

**Nënkryetarja e AKR-së, Mimoza Kusari Lila, thotë se kushti i tyre “qeveri me duar të pastra” është përmbushur, ndërsa qeveria e re e pastër “si loti”**

PRISHTINË- Kushti i Aleancës Kosova e Re për Partinë Demokratike të Kosovës, që koalicioni qeverisës mund të bëhet vetëm nëse qeveria e re përbëhet nga persona me duar të pastra, ka pasur sukses. Në qeverinë “Thaçi 2” nuk 'frekuentojnë' ministra të korruptuar ose që kanë keqpërdorur paranë publike. Kështu ka thënë zëvendëskryeministrja e Kosovës, Mimoza Kusari - Lila, e cila gjatë një interviste për "Zërin" është shprehur e bindur se Koalicioni për Kosovë të Re nuk do të dalë jashtë kornizave të programit të saj për t'i shërbyer partisë së kryeministrit, Hashim Thaçi.

**Zëri: Zonja Kusari, kohë më parë ju jeni deklaruar se nuk do të jeni në një qeveri ku do të jetë edhe Fatmir Limaj. A mendoni se ia keni arritur qëllimit tuaj për të ndërtuar qeveri me persona "të pastër"?**

**Kusari:** Nuk kam njohuri, ose të paktën nuk jam njeri kompetent të flas se kush mund të jetë tani në kabinetin qeveritar nën hetime, ose a është dikush nën hetime. Unë në fakt kam folur për një parim, i cili qëndron dhe i cili ka qenë parim i Koalicionit për Kosovë të Re gjatë gjithë fushatës dhe pas fushatës, që ne do të jemi pjesë e qeverisë, vetëm në një qeveri me njerëz profesionistë, kompetentë dhe njerëz të pastër. Do të thotë, ky ka qenë një qëndrim i yni, ai qëndrim është prezantuar edhe nga ana ime dhe ai qëndrim është ai i cili mbetet dhe të paktën, me aq sa jemi në dijëni është aplikuar në rastin e zgjedhjes së kabinetit qeverisës së ri.

**Zëri: Gjatë kohës sa keni qenë në opozitë vazhdimisht e keni kritikuar kryeministrin Hashim Thaçi për keqeverisje. Mirëpo, me të hyrë në koalicion jeni përafuar për së tepërmi. Pse ky ndryshim?**

**Kusari:** Parimet mbesin parime, pa marrë parasysh a është kryeministri Thaçi, apo ministra të caktuar. Nëse një parim qëndron dhe është parimi që duhet të qeveriset drejt dhe nuk duhet të keqkeqveriset, atëherë ai parim duhet të vlejë dhe do të mbetet me ne, flas edhe për veten, edhe gjatë këtij mandati. Ne natyrisht se i kemi vendosur disa parime kur kemi negociuar koalicionin me Partinë Demokratike të Kosovës, kemi marrë konfirmimin se ato parime do të zbatohen për qeverisje, kemi besuar se duke qenë pjesë e qeverisë do të japim shembull për parime të drejta, për qeverisje të mirë dhe qeverisje me profesionalizëm, së bashku me ministra tjerë të cilët besojmë se i kanë kualifikimet e duhura për të qenë në krye të dikastereve të veta.

**Ka alternativa tjera për privatizimin e PTK - së**

**Zëri: Një çështje tjetër që e keni kritikuar qeverinë e kaluar ka qenë forma e privatizimit të PTK - së , madje keni propozuar edhe ajo të jepej në menaxhim për një periudhë disavjeçare. Çfarë qëndrimi keni tani për privatizimin e PTK - së?**

**Kusari:** Ndonëse prapë do të ketë debat për privatizimin e PTK - së, konsiderojmë se ajo formë e cila është prezantuar, është prezantuar në mënyrë jo transparente dhe në mënyrë shumë të shpejtë para opinionit publik që nuk ka pasur biseda dhe diskutime me njerëz dhe grupe të interesit në kuadër të PTK - së. PTK - ja është e vërtetë që mbetet një ndërmarrje shumë e rëndësishme për buxhetin e Kosovës dhe një aset me vlerë për qytetarët e Republikës së Kosovës, ndërsa ne do të vazhdojmë të shikojmë mundësitë dhe alternativat tjera për privatizimin e PTK - së. Dihet se ne gjithmonë kemi thënë se nuk jemi kundër privatizimit, por jemi kundër kësaj forme të privatizimit, e cila në një farë forme është prezantuar shpejt e shpejt në opinionin publik dhe nuk ka pasur kohë për një debat më të gjerë dhe për mundësinë e prezantimit dhe promovimit më të mirë të vlerës së PTK - së. Kemi qenë gjithashtu kundër prezantimit të një vlere nga ana e qeverisë. Ju e dini se në buxhetin e Kosovës ka qenë një hyrje prej treqind milionëve si shitje nga PTK - ja, për arsye se kemi thënë se ata që shesin gjithmonë duhet të synojnë të shesin më shtrenjtë, ndërsa ata që e blejnë do të mundohen t'ia ulin vlerën. Nuk ka nevojë ne t'ia ulim vlerën. Prandaj, këto do të jenë disa parime që prapë do t'i arsyetojmë, që edhe në rastin e shtyrjes së privatizimit, që një pjesë të mbetet prapë aksionare Qeveria e Republikës së Kosovës, qytetarët e Kosovës, por edhe që vlera për shitje të përcaktohet nga tregu dhe jo nga qeveria.

**Zëri: Mediet kanë raportuar se presidenti Pacolli kishte lobuar që PTK - në t'ia jepte në menaxhim këshilltarit të tij, Esad Pusckar. Çka ka të vërtetë rreth kësaj çështjeje?**

**Kusari:** Nuk ka asgjë të vërtetë ... Krejt çka ka ndodhur është se presidenti Pacolli sa ka qenë kryetar i Aleancës Kosova e Re, ka prezantuar një formë tjetër alternative të financimit dhe të thithjes së mjeteve, të arkëtimit të mjeteve nga PTK - ja për buxhetin e Kosovës. Për ato mjete është gjetur një formë e konsensionimit dhe ne në asnjë formë nuk jemi shtyrë që kompania me të cilin ka pasur një kontakt Pacolli të jetë ajo kompani, por e kemi prezantuar si mundësi. E njëjta letër, me të gjitha kontaktet i është drejtuar Qeverisë së Kosovës dhe iu ka mbetur atyre të vazhdojnë nëse kanë dashur të kenë ndonjë informatë shtesë nga kjo kompani. Ne e dimë se si është bërë në rastin e koncensionimit, që nuk mund të bëhet në raste një burimore, që për koncensionim në kesi rasti do të kërkohen oferta dhe mund të kishte kompani tjera të cilat do të ofronin shuma të caktuara të hollave për PTK - në, për ta menaxhuar atë. Por, ka qenë një mundësi e mirë që të mbetet PTK - ja në pronësi të qeverisë por të arkëtohen mjetet, të cilat në këtë rast janë parë si mjete që shitet PTK - ja dhe që qeveria më nuk ka aksione në të. Është keqkuptuar, është prezantuar në vazhden e një fushate mediatike kundër presidentit Pacolli, nuk ka asnjë risi në këtë lajm, të them sinqerisht.

**E pavendosur për ta drejtuar partinë**

**Zëri: Njëri nga figurat kyçe të Koalicionit për Kosovë të Re, Muhamet Mustafa, nuk ka pranuar të jetë zëvendëskryeministër i Thaçit. A flet kjo për përçarje të këtij koalicioni?**

**Kusari:** Jo, në asnjë mënyrë. Koalicioni vazhdon të jetë i fortë, ashtu siç ka qenë. Koalicioni ka mbajtur konsistencën edhe në periudha do të thotë të vështira, kur nuk është ditur se a do të jemi a nuk do të jemi pjesë e qeverisjes. Për arsyet e tërheqjes duhet ta pyesni profesor Muhamet Mustafën, par ai shumë qartë ka deklaruar se do të mbetet pjesë e deputetëve të Koalicionit për Kosovë të Re dhe do të kontribuojë si deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës.



**Zëri: Kur pritet që të zgjidhet kryetari i ri i AKR - së dhe a keni në plan të kandidoheni për kryetare të kësaj partie?**

**Kusari:** Kryetari i ri i AKR së do të zgjidhet sipas afateve kohore të prezantuara në statusin e partisë. Në fakt, tani pas tërheqjes së z. Pacolli do të fillojmë me organizimin e kuvendeve nëpër degë dhe pastaj me organizimin e një kuvendi të përgjithshëm të partisë, ku do të zgjidhet drejtuesi i ri. Unë personalisht nuk kam vendosur a do të kandidoj apo jo për kreun e partisë. Kjo çështje mbetet e hapur, por gjithsesi që do të jem e angazhuar në subjektin tim për një demokraci të brendshme dhe për një proces sa më të shpejtë të përzgjedhjes së udhëheqësisë së re.

**Është koha e Pacollit**

Unë nuk jam eksperte e të Drejtës Kushtetuese, për këto gjëra duhet t'i pyesni ekspertët. Por, mendoj se ajo çfarë është parë kemi të bëjmë me një çështje e cila prezanton shkelje të Kushtetutës. Nuk është hera e parë, në fakt në secilën zgjedhje të presidentit ka pasur ndërprerje prej votimit të dytë dhe të tretë, bile edhe disa ditësh. Mendoj që koha është në anën e zotit Pacolli dhe angazhimi, veprimtaria dhe e gjithë puna e tij si president i Republikës së Kosovës do të jetë argumenti më i fortë për të gjithë këta zëra skeptikë lidhur me zgjedhjen e tij si president i Republikës së Kosovës .

---

## Pacolli, presidenti i parë i Kosovës që kalon përtej urës së Mitrovicës

---

**Kjo ishte hera e parë në periudhën e pas luftës që në këmbë një president i Republikës së Kosovës ka kaluar urën dhe ka qëndruar në atë pjesë të veriut të vendit.**

MITROVICË, 26 SHKURT - Vizitën e parë zyrtare jashtë kryeqytetit presidenti i Kosovës Behgjet Pacolli e bëri në Mitrovicë, përkatësisht në pjesën matanë Ibrit, ku u mirëprit përzierisht nga banorët e lagjes së boshnjakëve, të tre rrokaqiejve dhe në shtëpinë e ministrit të Punëve të Brendshme Bajram Rexhepi. Vizita u krye në prani të shtuar të Policisë së Kosovës, EULEX-it dhe KFOR-it, ndërkohë që ishte hera e parë në periudhën e pasluftës që këmbë një president i Republikës së Kosovës ka kaluar urën dhe qëndruar në atë pjesë. Presidenti Behgjet Pacolli, i shoqëruar nga ministri i Punëve të Brendshme Bajram Rexhepi, kanë vizituar të shtunën zonën e "Tre Rrokaqiejve" në pjesën veriore të Mitrovicës, në të cilën janë pritur ngrohtësisht nga banorët shqiptarë. Gjatë rrugës në pjesën veriore të qytetit janë vërejtur qytetarë serb që nuk mirëpritën këtë vizitë por vendosmëria e organeve të sigurisë për t'iu përgjigjur çdo provokimi sikur bëri të veten dhe nuk u shkaktua kurrfarë incidenti. Kreu i Kosovës me këtë rast u ka premtuar qytetarëve se do të luftojë grupet kriminale në këtë pjesë të vendit. Ai ka thënë se qytetarët e pjesës veriore të Mitrovicës do të ndihen si qytetarë të lirë të Republikës së Kosovës. Pacolli ka vizituar edhe shtëpinë e ministrit Rexhepi që ndodhet në Suhadoll në veri të vendit, me të cilin kanë biseduar pa praninë e medieve, kurse pas këtij takimi ata janë prononcuar para mediave. **"Për mua nuk ekziston termi veri apo jug, ekziston si term gjeografik dhe jo politik e administrativ"**, tha Pacolli, i cili shtoi se ishim ne këtu për t'i kontaktuar banorët e kësaj ane, pa marrë parasysh cilës kombësi apo fe i përkasin ata, t'u tregojmë se janë pjesë përbërëse e Republikës së Kosovës, janë qytetarë të Kosovës, të ndihen mirë dhe të themi se edhe në këtë anë mbretëron ligji, dhe jam përkushtuar që t'ua përmirësojmë jetën edhe këtyre qytetarëve. Ministri i Punëve të Brendshme Bajram Rexhepi, ka thënë se ai për çdo vikend viziton këtë pjesë të territorit. Me një punë të përbashkët krejt territori i Kosovës do të jetë unik, ku do të vlejnjë ligjet e Kosovës", tha Rexhepi, sipas të cilit ky është një proces, ku me një përkushtim dhe ide që edhe presidenti i ka shpalosur dje në një bisedim të përbashkët, këto janë dy çështje, në rend të parë sundimi i rendit dhe ligjit, dhe zhvillimi ekonomik. Këto do të jenë si synime strategjike në të ardhmen që të bëhet integrimi i mirëfilltë edhe i qytetarëve, jo vetëm integrimi administrativ", ka thënë Rexhepi. Në pyetjen se a do të përfshihet veriu si temë e bisedimeve në mes të Prishtinës e Beogradit, Pacolli tha se grupi i bisedimeve është në përgatitje e sipër dhe ata kanë agjendën e vet e cila është e mbështetur nga miqtë tanë ndërkombëtarë, qeveria e Kosovës dhe presidenca.

**"Unë po ju premtoj se në këtë mandat pesë vjeçar, bashkë me njerëzit e qeverisë, me njerëzit e Kosovës dhe që ia duan të mirën Kosovës, edhe në këtë anë do ta kthejmë rendin dhe ligjin. Ligji do të jetë mbi të gjithë e me ata edhe për ata të kësaj pjese të Kosovës do të ndihen si një pjesë plotësisht përbërëse të këtij vendi ",** tha presidenti Pacolli.



*Vizitën e parë zyrtare jashtë kryeqytetit presidenti i Kosovës Behgjet Pacolli e bëri në Mitrovicë, përkatësisht në pjesën matanë Ibrit, ku u mirëprit për zemërsisht nga banorët e lagjes së boshnjakëve*

---

## Presidenti votoi qeverinë, shkeli Kushtetutën

---

**Behgjet Pacolli ka votuar kabinetin qeveritar, pasi ka dhënë betimin për president. Më këtë rast, presidenti i ri ka rënë ndesh me nenin 88, pika 1 të Kushtetutës, i cili ia ndalon kryerjen e ndonjë funksioni tjetër publik. Ekspertët juridikë thonë se rasti i Pacollit është njëjtë me rastin e pararendësit të tij, Fatmir Sejdiu, i cili në shtator të vitit të kaluar, ka marr vulën e shkelësit të Kushtetutës.**

Bajrami ka sqaruar se momenti i betimit të presidentit shënon edhe fillimin e kufizimeve kushtetuese për njeriun e parë të shtetit. Edhe pse ka qenë njëri nga anëtarët e Komisionit për hartimin e Kushtetutës, Bajrami nuk ka parapëlqyer që ta bënte vetë kualifikimin e shkeljes që ka bërë Pacolli. "Unë vetëm mund t'ju garantoj se nga momenti kur e jep betimin, ai është president i zgjedhur. Kualifikimin zyrtar, në bazë të Kushtetutës, e bën Gjykata Kushtetuese", ka thënë ai. Një njohës tjetër i çështjeve juridike - kushtetuese, duke mos dashur t'i përmendet emri në gazetë, e ka ndërlidhur rastin e Pacollit me atë të pararendësit të tij, Fatmir Sejdiu. "Nese ish - presidenti Fatmir Sejdiu e ka shkelur pikën 2 të nenit 88 të Kushtetutës së Kosoves, Behgjet Pacolli e ka shkelur pikën 1 të po të njëjtit nen. Pasi Sejdiu, ka bërë shkelje duke kryer funksionin e kryetarit të LDK - së, Pacolli ka bërë shkelje duke e mbajtur postin e deputetit. Prandaj, nëse ngrihet ky rast në Gjykatë Kushtetuese, atëherë edhe verdikti i kësaj gjykate do të ishte i njëjtë si në rastin e Sejdiut", ka thënë ky ekspert kushtetues. Në nenin 88, pika 1 të Kushtetutes thuhet në mënyre decisive: "Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik". Ndërsa pika 2 e të njëjtit nen, precizon: "Pas zgjedhjes, Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike". Ndryshe prej Sejdiut, Pacolli ka dhënë dorëheqjen nga anëtarësia dhe nga të gjitha funksionet në Aleancën Kosova e Re, brenda pak orësh pasi është zgjedhur president. Mirëpo, në momentin kur ka votuar për zgjedhjen e qeverisë ai ende ka qenë president i AKR-së. Atë ditë ai e ka pranuar se po merrte një detyrë sa të rëndë, po aq edhe sfiduese. **"Nuk e them se dikush tjetër do ta kishte më të lehtë, sfidat janë për t'u tejkaluar, e detyra ime e re është sfida e radhës"**, ka thënë Pacolli gjatë fjalimit në Kuvend.. Zgjedhja e Pacollit president është duke u përcjellë me reagime negative, jo vetëm **"Institucioni të cilin përfaqësoj do të garantojë unitet, stabilitet dhe jam tërësisht i dedikuar t'i shërbej atij funksioni"** nga partitë opozitare dhe një pjesë e madhe e shoqërisë civile, por edhe nga personalitete që kanë ndikim në PDK. Kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, dhe nënkryetari i PDK së, Fatmir Limaj, edhe publikisht kanë deklaruar se kanë votuar kundër tij. Krasniqi ka bërë të ditur se kryetari i PDK - së, Hashim Thaçi, u ka bërë presion deputetëve që t'ia jepnin votën Pacollit, duke u thënë se, nëse votojnë kundër tij dhe vendi shkon në zgjedhje te parakohshme, ata nuk do të futeshin në listat e kandidatëve për deputetë. Nisur nga kjo, ai ka thënë se vota reale per Pacollin ka qenë ajo e raundit të parë. E në atë raund, Pacollin e kanë mbështetur vetëm 54 deputete. Ndërkohë. LDK - ja dhe AAK - ja kanë paralajmëruar se do të kërkojnë interpretimin e Gjykatës Kushtetuese, nëse zgjedhja e presidentit është bërë konform Kushtetutës dhe Rregullores së punës së Kuvendit. Si çështje kontestuese, këto dy parti i marrin: mungesën e kuorumit në dy raundet e para të votimit si dhe ndërprerjen e procesit të votimit para raundit të tretë. Sekretari i përgjithshëm i LDK së, Ismet Beqiri, ka paralajmëruar se "rasti Pacolli", do të përcillet në Kushtetuese javën e ardhshme. Mirëpo, Pacolli një ditë më

herët është shprehur i gatshëm që të përballet me Kushtetuesen. **"Unë kam kaluar me 90 për qind të votave të deputetëve, të cilët ishin në sallë"**, ka thënë ai, të premtën. Por, ato ditë, ai nuk e ka pasur parasysh faktin se ka votuar në cilësinë e presidentit.

## **Dhjetë familje skamnore ndajnë pagën e presidentit Pacolli**

PRISHTINË, 27 SHKURT - Presidenti i sapo zgjedhur i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, edhe tani kur është në krye të shtetit, vazhdon traditën humanitare që e ka trasuar me vite e dekada si biznesmen i suksesshëm, dhe tani vazhdon humanitetin e tij, duke hequr kështu dorë nga paga e tij mujore si president për t'ua ndarë kështu 10 familjeve skamnore në rajone të ndryshme të Kosovës. Presidenti i Kosovës, z. Pacolli të dielën edhe pse ishte ditë pushimi ai vizitoi familjen e Naim Bunjakut në lagjen Dodona të Prishtinës, e cila jeton në kushte të rënda sociale me gruan dhe katër fëmijët e tij. Pas vizitës presidenti i vendit deklaroi se familja e Naim Bunjakut tash e mbas do të ketë një pagë mujore e ndarë nga paga e tij për punën si president. **"Isha në këtë familje dhe e di se në Kosovë ka shumë familje që kanë të njëjtin fat dhe unë me mundësit e mia sot isha këtu që t'i inkurajoj dhe të mos humbin shpresën këta njerëz, sepse Kosova është duke bërë çdo gjë që të ketë rritje ekonomike dhe të krijohen mundësi të reja për familjet që kanë nevojë. Vizitova këtë familjen dhe ndaj të dhjetën e pagës sime mujore. Paga ime do të ndahet proporcionalisht për dhjetë familje"**, shprehet Presidenti, derisa thekson se këto janë mundësit e tij personale. Ndërkohë nikoqiri, Bunjaku, shprehet falënderues për vizitën e presidentit Pacolli dhe ndihmën e ofruar për çdo muaj, duke theksuar se ndjehet i lumtur se Kosova ka njerëz të tillë. I pyetur nëse ka bërë shkelje ligjore me rastin e votimit të qeverisë, ai tha se kjo i përket Gjykatës të vendosë. - Sh. Osmani

### **Shpresa**

**Isha në këtë familje dhe e di se në Kosovë ka shumë familje që kanë të njëjtin fat dhe unë me mundësitë e mia sot isha këtu që t'i inkurajoj dhe të mos humbin shpresën këta njerëz, tha presidenti Pacolli.**



*Presidenti i Republikës së Kosovës vazhdon traditën humanitare që e ka trasuar me vite e dekada si biznesmen i suksesshëm, dhe tani vazhdon humanitetin e tij, duke hequr kështu dorë nga paga e tij mujore si president për t'ua ndarë kështu 10 familjeve skamnore në rajone të ndryshme të Kosovës.*



*“Isha në këtë familje dhe e di se në Kosovë ka shumë familje që kanë të njëjtin fat dhe unë me mundësit e mia sot isha këtu që t’i inkurajoj dhe të mos humbin shpresën këta njerëz, sepse Kosova është duke bërë çdo gjë që të ketë rritje ekonomike dhe të krijohen mundësi të reja për familjet që kanë nevojë. Vizitova këtë familjen dhe ndaj të dhjetën e pagës sime mujore. Paga ime do të ndahet proporcionalisht për dhjetë familje” shtoi Presidenti i Kosovës z.Behgjet Pacolli*





## Këshilltarët e Pacollit

**Behgjet Pacolli gjatë kësaj jave do ta kompletojë stafin e tij politik. Burime të Expressit kanë thënë se Nënkrjetari i AAK'së, Naim Maloku pritet të emërohet këshilltar për siguri. Pjesë e ekipit do të jenë edhe ish-ambasadori Blerim Reka dhe politikologu Behlul Beqaj. Ndërkaq, këshilltar i parë do të emërohet Ibrahim Gashi.**

Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli këtë javë pritet t'i emërtojë këshilltarët kryesorë politikë që do jenë afër tij gjatë kësaj mandate. Burime të gazetës Express kanë thënë se Pacolli është në fazën finale për të angazhuar në ekipin e këshilltarëve emra të njohur në Kosovë dhe rajon. Sipas burimeve, nënkryetari aktual i AAK'së Naim Maloku pritet të emërohet këshilltar për çështje të sigurisë në kabinetin e Pacollit. Këshilltar për integrimet në BE dhe NATO do të jetë Blerim Reka, ish-ambasadori i Maqedonisë në Bruksel dhe profesor i së Drejtës Ndërkombëtare. Për bisedimet me Serbinë-Pacollin do ta këshillojë politikologu Behlul Beqaj, i cili ka qenë edhe këshilltar i Hashim Thaçit, gjatë kohës së Qeverisë së Përkohshme. Burime të tjera brenda Presidencës kanë treguar se këshilltar tjetër i Presidentit do të emërohet Faton Bislimi, i cili është shkolluar për administratë publike në Universitetin e Harvardit. Në zgjedhjet e fundit lokale, Bislimi ka konkurruar si kandidat i pavarur për kryetar të Gjilanit. Ndërkaq, nënkryetari i deridjeshëm i AKR-së, Ibrahim Gashi do të emërohet si këshilltar i parë i Presidentit. Këtë e ka konfirmuar vetë Gashi në një bisedë për Express, duke paralajmëruar se gjatë kësaj jave do të publikohen edhe emrat tjerë që do të jenë në kabinetin e shefit të Shtetit. "Një pjesë e kabinetit do të kompletohet gjatë javës që po hyjmë, që i bie prej nesër e tutje", ka thënë Ibrahim Gashi, të dielën, i cili që nga zgjedhja e Pacollit si president, është i angazhuar në Presidencë. Ai nuk ka pranuar të përmend asnjë emër të këshilltarëve të Pacollit, por Gashi ka thënë se njëri prej tyre që do ta këshillojë Pacollin do të jenë edhe nga partitë e tjera dhe nga shoqëria civile. "Do të ketë edhe prej partive të tjera politike, edhe prej shoqërisë civile, do të ketë edhe prej botës akademike. Do të jenë këshilltarë që edhe në opinionin publik njihen si personalitete me autoritet profesional, akademik, por edhe moral", ka thënë Gashi. Aleanca Kosova e Re ka njoftuar të dielën pasditë se nënkryetari i saj Ibrahim Gashi ka dhënë dorëheqje nga të gjitha pozitat partiake. Ai do të ushtrojë postin e Këshilltarit të Parë të Presidentit të Kosovës. "Dorëheqja është bërë në përputhje me statutin e AKR'së, ku thuhet që secili zyrtar i partisë që merr një post publik që simbolizon unitetin e popullit, duhet të heq dorë nga përkatësia e tij partiake. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë", thuhet në njoftimin e AKR'së. Pastaj sqarohet për postin e ri të ish-zyrtarit të AKR'së. "Me sugjerimin e Presidentit të Republikës së Kosovës, z. Behgjet Pacolli, ish nën-kryetari i AKR'së, tani e tutje do të mbajë postin e këshilltarit të parë të Presidentit". Ndryshe, Behgjet Pacolli është zgjedhur President i Kosovës në një votim të kontestuar nga partitë opozitare dhe nga një pjesë e PDK'së. Madje, LDK'ja dhe AAK'ja kanë paralajmëruar se mënyrën e zgjedhjes së Presidentit do ta dergojnë për interpretim ligjor në Gjykatën Kushtetuese.

## Lunaçek nuk mendon se është shkelur Kushtetuta

**"Mendoj se shenjë pozitive është ajo, që siç më është thënë, në Qeverinë e re nuk është askush ndaj të cilit po zhvillohet proces hetimi nga ana EULEX - i, apo... Kjo është një shenjë pozitive që dua ta përmend për Qeverinë e re ", thotë Lunaçek.**

Të gjithë ata komisionarë që janë akuzuar për mashtrime gjatë zgjedhjeve, të sillen para gjykatës, vlerëson Lunaçek. Raportuesja për Kosovën e Parlamentit Evropian, Ulrike Lunacek, nuk ka ndonjë opinion të saj nëse ishte shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Presidentit në ditën e votimit. E pyetur në një intervistë për Radio Evropën e Lirë, nëse ka pasur shkelje të Kushtetutës, ajo tha se nuk ishte e gatshme të gjykonte një dyshim të tillë. "Nuk mund të gjykoj, sepse nuk i di detajet e Kushtetutës, e as rregullat e procedurave se si zgjidhet presidenti. Këtë duhet ta qartësojnë institucionet e Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese. Unë më shumë kam qenë e shqetësuar për mënyrën se si janë zhvilluar procedurat. Por, nuk mund t'i gjykoj detajet e procedurave, sepse nuk e di se çka thotë statuti, çka thonë rregullat e procedurave për zgjedhjen e presidentit. Për këtë u takon institucioneve të Kosovës të vendosin", deklaroi Lunaçek.

Ndërsa, e pyetur për shqetësimet e ngrehura, Lunaçek thotë: "Isha atje. Mori shumë kohë. Nganjëherë nuk kishte qartësi se si duhet të ecë procesi dhe pastaj mendoj se do të duhej të kishte qartësi para se të niste i tërë procesi. Duhej të kishte qartësi se si do të rridhte procesi. Kam qenë në Parlament për 10 apo 12 vjet deri më tash, por nganjëherë janë disa gjëra që nuk janë të qarta. Kisha ndjenjën se kishte konfuzion, prandaj për të ardhmen duhet të ketë qartësi. Mendoj se gjëja më e rëndësishme është, dhe secili e ka thënë edhe në Kosovë, se duhet të ndryshohet ligji dhe se presidenti duhet të zgjidhet nga populli, me qëllim që të evitohet çdo lloj presioni, apo loje në Parlament lidhur me këtë. Mendoj se do të ishte hap shumë i rëndësishëm dhe mendoj se duhet të jetë ndër hapat e parë që duhet të ndërmerret koalicioni dhe Parlamenti i ri ", thotë ajo. Ndërsa, e pyetur të vlerësojë institucionet e zgjedhura, ajo tha se ishte në Kosovë kur u mbajtën edhe zgjedhjet, dhe se është e mendimit edhe tani se kishte parregullsi, por gjërat tani duhet të shkojnë drejt përmirësimit të kodit zgjedhor. "Tash kemi Qeveri të re dhe mendoj se do jetë shumë e rëndësishme që kjo Qeveri dhe koalicioni në Parlament të ecë shumë me shpejt me miratimin e Ligjit të ri zgjedhor, i cili do të siguronte se në të ardhmen, gjatë zgjedhjeve, nuk do të përsëriteshin parregullsitë që i kemi parë. Për shembull, të ndryshohet mënyra se si është hartuar lista e hapur, meqë kjo ka shkaktuar shumë konfuzione për votuesit, po ashtu edhe gjatë numërimit, ku isha edhe vetë e pranishme. Kjo duhet të ndryshohet në zgjedhjet e ardhshme", thotë ajo. Lunaçek thotë se Kosova nuk duhet të jetë më një zonë zgjedhore. "Gjithashtu, duhet të sigurohet se të gjitha ata komisionarë që janë akuzuar për mashtrime gjatë zgjedhjeve, të sillen para gjykatës", thotë ajo. Lunaçek mendon se ka shumë punë me të cilat duhet të merret menjëherë qeveria dhe të dëshmojë se është e gatshme që vendin ta çojë përpara. "Ajo duhet t'iu dëshmojë njerëzve se e ka seriozisht përparimin ekonomik, që të krijojë vende të reja pune për të rinjtë. Po ashtu, mendoj se do të ishte me rëndësi të investonte në energji, në energjinë e ripërtërishme, që do të jetë një gjë e re", thotë Lunaçek. B.S

## **LDK-ja vendos ta çojë Pacollin në gjykatë**

**“Po, kemi vendosur ta dërgojmë lëndën në gjykatë. Tani ajo lëndë është në duar të ekspertëve ligjorë të LDK-së, të cilët po merren me të dhe po e bëjnë gati për gjykatë”, ka deklaruar Kujtim Shala për “Epokën e re”**

PRISHTINË, 27 SHKURT - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) perfundimisht ka vendosur ta çojë në Gjykatën Kushtetuese presidentin e sapozgjedhur të Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli. Anëtari i kryesisë së kësaj partie, Kujtim Shala, ka thënë të dielën për "Epokën e re" se tashmë ekspertët ligjorë të LDK - së janë duke e bërë gati lëndën lidhur me shkëljet e pretenduara kushtetuese në Kuvendin e Kosovës ditën e zgjedhjes së presidentit të ri. "Po, kemi vendosur ta dërgojmë lëndën në gjykatë. Tani ajo lëndë është në duar të ekspertëve ligjorë të LDK - së, të cilët po merren me të dhe po e bëjnë gati për gjykatë", ka thënë Shala. Sipas tij, lënda që do t'i dorëzohet gjykatës përmban një numër çështjesh. "Kushtetuta është dokumenti që garanton funksionimin e lirë demokratik, ushtrimin e vullnetit të lirë të të gjitha kategorive kushtetuese. Dhe një kategori e madhe kushtetuese është Kuvendi i Kosovës, që atë ditë iu pamundësua ta manifestojë vullnetin e vet dhe nëpërmjet deputetëve ta manifestojë edhe vullnetin e qytetarëve të Kosovës, sepse pati ndërhyrje", është shprehur ai, duke shtuar se ditën e zgjedhjes së presidentit, kryetarit të Kuvendit iu mor seanca nga drejtimi nëpërmjet pauzës pesëminutëshe. "Arsyeje tjetër është se ne kemi dyshime të thella për çështjen e kuorumit, meqë Kushtetuta e ka saktësuar se presidenti i vendit zgjidhet me dy të tretat e votave në dy raundet e para të votimit, ndërsa me një shumicë elementare në raundin e tretë. Ndërkaq në atë ditë në dy raundet e para janë kërkuar 81 vota, kur në sallë ishin vetëm 67 deputetë, Kuvendi nuk ka pasur kuorum. Nuk është dashur të procedohet me kuorumin standard 61 deputetë, sepse ai është për çështje standarde e jo për çështje të kësaj rëndësie. Këto janë dy prej çështjeve që do t'i përmbajë lënda", ka deklaruar Shala. Por, si duket, lënda e LDK - së për Gjykatën Kushtetuese do të përmbajë edhe elemente të tjera. Shala ka bërë me dije se çfarë do të përmbajë lënda ndaj presidentit do të dihet saktësisht vetëm në lëndën e finalizuar nga ekspertët e LDK - së. Me tutje, Shala ka treguar se LDK - ja ka mundësi të kërkojë sqarim nga Gjykata Kushtetuese edhe sa i përket votës së Pacollit që i ka dhënë Qeverisë, pasi e ka bërë betimin si president i vendit ditën e zgjedhjes. "Me siguri po. Unë po deklarohej politikisht, sepse kjo është çështje e ekspertëve. Unë nuk jam jurist dhe nuk e di se si formulohet saktë kjo çështje", ka thënë ai. Anëtari i Kryesisë së LDK - së ka sqaruar se LDK - ja nuk ka kontest as me presidentin Pacolli e as me institucionet e tjera të Kosovës. "Ajo që synojmë ne është elementare. Duam ta sqarojmë legalitetin e zgjedhjes, asgjë më shumë. Nëse ato institucione nuk janë legale dhe ne bashkëpunojmë me to, i bie që ne bashkëpunojmë me institucione jolegale. Nëse ato janë legale do të na lehtësojnë punët që ne të funksionojmë si opozitë normale", ka thënë ai. Shala nuk ka përmendur ndonjë datë se kur do të dorëzohet lënda në Gjykatë Kushtetuese, por ka thënë se kjo do të varet prej dinamikës së punës së njerëzve që po merren me këtë çështje. "Ne ende nuk jemi marrë me sigurimin e nënshkrimeve të deputetëve për këtë lëndë për shkak se mendojmë se njëherë duhet ta kemi lëndën gati. Kur ia kërkon tjetrit (deputetit) nënshkrimin duhet t'ia japësh edhe argumentin", ka deklaruar Shala.

## **Pacolli: Gjykata vendos nëse e kam shkelur Kushtetutën**

Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, nuk ka dashur të komentojë nëse ka bërë shkelje të Kushtetutës me rastin e votimit të Qeverisë së Kosovës, duke thënë se për këtë çështje do të vendosë Gjykata Kushtetuese. Ai këtë koment e ka bërë të dielën pas vizitës që i ka bërë familjes së Naim Bunjakut në Prishtinë, duke iu përgjigjur në këtë mënyrë interesimit të medieve lidhur me atë nëse e ka shkelur aktin më të lartë juridik të vendit me rastin e votimit të Qeverisë pas zgjedhjes në postin e presidentit. **"Unë nuk jam kompetent për vendimet e Kushtetutes. Eshhtë ajo që vendos për këso raste"**, ka thënë Pacolli.

---

## Paga humanitare e presidentit

---

Presidenti i sapozgjedhur i Kosovës, Behgjet Pacolli, përveç që u bë i pari president i vendit që kaloi urën e Ibrit në këmbë, ai u bë i pari që refuzoi të marr edhe pagën e buxhetit të Kosovës. Paga në vlerë rreth tre mijë euro që i takon atij si president, do t'u ndahet dhjetë familjeve skamnore të Kosovës. Kështu ka vendosur presidenti Pacolli gjatë dy vizitave që ai u bëri të dielën familjes së Naim Bunjakut në Prishtinë dhe asaj të Shaban Avdylit në Fshatin Pojatishtë të Ferizajit.

“Sot isha këtu që t'i inkurajoj që të mos humbin shpresën. Kosova është duke bërë çdo gjë që të ketë një rritje ekonomike, që të krijohen mundësi të reja për këto familje që kanë nevojë për mbështetje. Një të dhjetën e pagës sime mujore do t'ua lë dhe paga ime mujore do të shkojë në të ardhmën për dhjetë familje”, është shprehur ai, teksa ka vizituar familjen Bunjaku. Pacolli ka thënë se e ka të pamundur që të ndajë para nga buxheti i vendit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, prandaj ka vendosur që pagën që i takon si president ta ndajë në dhjetë pjesë dhe t'ua dhurojë dhjetë familjeve. Pasi ka pritur të parin e shtetit, kryefamiljari Naim Bunjaku ka falënderuar Pacollin duke e çmuar këtë hap të tij. Ndërkaq, pas vizitës së familjes Avdyli, presidenti i porsazgjedhur i Kosovës ka premtuar se do të shfrytëzoj çdo mundësi që t'iu ndihmojë këtyre familjeve. **“Unë sot prej këtyre familjeve shkoj jashtëzakonisht i hidhëruar me gjendjen e tyre. Më dhimbsen. Shpirti po më dhemb. Unë atë çfarë mundem ta bëj, do ta bëj për këto familje”**, ka thënë ai. Presidenti ka theksuar se hapi i tij është hap që nuk do të ndërrojë situatën në Kosovë, pasi që kjo, siç tha ai, duhet të ndërrohet me punë të sinqertë dhe të pandalshme. **“Ne duhet të ngrihemi Ekonomikisht, të krijojmë mundësi të reja për njerëzit, për familjet, për arsye se situata është alarmante dhe t'ju them se jam shumë i hidhëruar sot”**, tha presidenti Pacolli. Ai ka bërë thirrje që secili person që ka mundësi t'i ndihmojë bashkatdhetarët e tij, në mënyrë që të kontribuojnë që Kosovës t'i ndërrohet “fytyra” e varfër, të cilën e ka aktualisht.

## **Opozita i duartroket vizitës së Pacollit në veri**

**Presidenti pagën e vet mujore prej 3000 eurosh ua jep 10 familjeve**

**Përfaqësuesit e partive opozitare dhe analistë politikë e kanë vlerësuar pozitivisht vizitën e presidentit të Kosovës, Behgjet Pacolli, në pjesën veriore të Mitrovicës. Ata kanë thënë se një vizitë e tillë është mesazh i mirë se presidenca dhe institucionet e tjera të Kosovës janë të interesuara ta shtrijnë autoritetin e tyre kushtetues në tërë territorin e vendit. Por, me një konstatim të tillë nuk është pajtuar vetëm Lëvizja Vetëvendosje! e cila këtë vizitë e ka quajtur mediale dhe kozmetike**

PRISHTINË, 27 SHKURT - Përfaqësuesit e partive opozitare, përpos Lëvizjes Vetëvendosje!, dhe analistë politikë e kanë vlerësuar lart vizitën e presidentit të Kosovës, Behgjet Pacolli, në pjesën veriore të Mitrovicës, duke e quajtur sinjal të mirë për kthimin e normalitetit edhe në atë pjesë të Kosovës. Anëtari i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Kujtim Shala, vizitën e presidentit Pacolli në veri të Mitrovicës e ka klasifikuar simbolike dhe të vullnetit të mirë. "E konsiderojmë vizitë simbolike. Por, mbetet të shihet në të ardhmen nëse do të jetë vetëm simbolike. Nuk dëshirojmë të paragjykojmë, por si vullnet të mirë e përkrahim gjithsesi", ka thënë Shala për "Epokën e re". Edhe nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Naim Maloku, e ka vlerësuar lart vizitën e presidentit në veri të vendit. Ai është shprehur i impresionuar me vizitën e presidentit të Kosovës në pjesën veriore të Mitrovicës. Maloku ka thënë për "Epokën e re" se Pacolli është presidenti i parë Kosovës i cili menjëherë, pasi ka marrë detyrën, i bën vizitë asaj pjese të vendit. "Jam i impresionuar me vizitën e presidentit Pacolli në Mitrovicë. Këtë vizitë e shoh në dy rrafshje. E para: është presidenti i parë i Kosovës që nga përfundimi i luftës që demonstroi një qasje të njëjtë për tërë territorin e vendit duke dhënë mesazhe të mira për qytetarët dhe gjithë faktorët ndërkombtarë. Dhe, e dyta: fjalimi i tij ishte gjithashtu mbresëlënës, pra ishte shumë me vend. Edhe unë pajtohem se nuk ka ndarje jug veri në terma politikë, por vetëm gjeografikë", ka thënë Maloku, duke shtuar se edhe Policia e Kosovës (PK) ishte në nivel të detyrës. Mendim të kundërt me Shalën e Malokun ka paraqitur anëtari i Lëvizjes Vetëvendosje!, Glauk Konjufca. Vizitën e Pacollit e ka konsideruar krejtësisht mediale dhe kozmetike, "Vizita e Pacollit në Mitrovicë ishte sa për sy e faqe. Ishte vizitë mediale dhe kozmetike për rregullimin e imazhit të tij tashmë të pariparueshëm sesa e një rëndësie tjetër. Koncepti i tij politik është ai i planit të Ahtisarit, i cili ka çuar në krijimin e një situatë të tillë, e cila mbretëron në atë pjesë të Kosovës. Për ta ndryshuar atë situatë nuk mjafton vetëm ta kalojmë urën e Ibrit me medie dhe polici të EULEX - it, por duke ushtruar kompetencat shtetërore, pra ato të integritetit dhe sovranitetit të vendit", ka thënë për "Epokën e re", Konjufca. Vizitën e Pacollit në veri e ka vlerësuar edhe analisti politik Haqif Mulliqi, i cili ka thënë për Epokën e re "se një vizitë e tillë është sinjal i mirë, sepse presidenca dhe Qeveria e Kosovës janë duke i harmonizuar qëndrimet e tyre politike në të mirë të të gjithë qytetarëve. "Vizita e presidentit Pacolli në pjesën veriore të Mitrovicës është një prej veprimeve pozitive dhe paralajmëruese, e cila përçon mesazh se presidenti dhe institucionet janë të interesuara për normalizimin e situatës atje dhe se janë duke ardhur ditë të mira edhe për banorët e asaj ane. Kalimi i urës nga ana e presidentit dhe ministrit të MPB - së, Bajram Rexhepi. është një sinjal i mirë që presidenca dhe qeveria e drejtuar nga Thaçi do të

shkojnë krah për krah në sendërtimin e një synimi të përbashkët për një Kosovë më të mirë dhe më të sigurt për të gjithë qytetarët”, ka deklaruar Mulliqi.



Presidenti Behgjet Pacolli priti ambasadorin e Turqisë, Songul Ozan

---

## **Pacolli: Do të hapim dyert edhe më shumë për biznesin turk**

---

Mbështetje

**"E mbështesim pavarësinë dhe integritetin territorial të Kosovës dhe synimin e saj për integritime euroatlantike", theksoi Ambasadorja Ozan.**

Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli priti sot në një takim ambasadorin e Republikës së Turqisë në vendin tonë, zonjën Songul Ozan, e cila e uroi për detyrën e re si dhe i dorëzoi urimin që Presidentit Pacolli ia ka dërguar Presidenti i Turqisë, Abdullah Gyl. Pasi theksoi se Kosova dhe Turqia janë dy vende mike dhe me marrëdhënie shumë të mira mes veti, Presidenti Pacolli falënderoi ambasadorin Ozan për punën e saj dhe kontributin e çmueshëm dhe në vazhdimësi të Turqisë për vendin tonë. **"Kontributi i madh i Turqisë gjatë periudhës së shtetbërjes së Kosovës ka qenë i një rëndësie të veçantë dhe shumë të madhe"**, tha Presidenti Pacolli. Ai gjithashtu përkujtoi faktin se Turqia ka qenë ndër shtetet e para që e ka njohur Republikën e Kosovës, si dhe ka kontribuar dhe vazhdon të kontribuojë në sigurimin e njohjeve të reja për vendin tonë. Presidenti Pacolli theksoi se Kosova duhet të mësojë sa më shumë nga eksperiencat e Turqisë, ndërsa një theks të veçantë e vuri te bashkëpunimi ekonomik mes të dy vendeve, bashkëpunim ky që duhet të intensifikohet, duke krijuar mundësi më të mëdha për investime të investitorëve nga Turqia në Kosovë. **"Do të hapim dyert edhe më shumë për biznesin turk. Jemi një vend i vogël, vend në tranzicion që ka nevojë për ndihmë logjistike, pasi Turqia ka një traditë të gjatë të shtetbërjes"** theksoi Presidenti Pacolli. Nga ana e saj, Ambasadorja Ozan, pasi përkujtoi lidhjet shumë të forta dhe bashkëpunimin shumë të mirë mes Turqisë dhe Kosovës, u shpreh se këto lidhje dhe ky bashkëpunim do të vazhdojnë dhe do të thellohen edhe më tutje, duke qenë edhe një faktor i rëndësishëm i zhvillimit dhe stabilitetit në rajon. "E mbështesim pavarësinë dhe integritetin territorial të Kosovës dhe synimin e saj për integritime euroatlantike", theksoi Ambasadorja Ozan. Duke folur për përkrahjen që Turqia i jep Kosovës, Ambasadorja Ozan tha se kjo përkrahje përfshin të gjitha fushat, që nga prezenca e ushtarëve turq në Kosovë, prezenca e policëve në kuadër të misionit ndërkombëtar këtu, si dhe në shumë sfera të tjera. "Institucionet e Turqisë janë të gatshme që të japin të gjithë eksperiencën e tyre për zhvillimin e Republikës së Kosovës", tha Ambasadorja Ozan. Duke përkujtuar se ndërmarrje të fuqishme të Turqisë janë prezentë në Kosovë, si në ndërtimin e autostradës Vermicë Merdar, në Aeroportin e Prishtinës e të tjera, Ambasadorja Ozan theksoi biznesmenët e vendit të saj janë shumë të interesuar që të investojnë në Kosovë.

---

## **Pacolli u zgjodh sipas Kornizës Kushtetuese të UNMIKU-ut**

---

**Sipas ekspertëve, Korniza Kushtetuese e UNMIK-ut ka mundësuar që të mbahet raundi i tretë i votimit edhe vetëm me një kandidat për president, por Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk e lejon një gjë të tillë**

Këta ekspertë vlerësojnë se procesi i zgjedhjes së presidentit të Kosovës, që përshkruhet në Kushtetutën e Kosovës, nuk është procesi më i mirë, por ai përdoret në shumë vende të botës dhe rezulton të jetë i suksesshem. Model të ngjashëm sipas tyre përdor Estonia. Sipas ekspertëve, Kushtetuta e Kosovës nuk ka mundësuar raund të dytë për zgjedhjen e Pacollit sepse ka qenë kandidati i vetëm. Raundi dyte dhe i tretë, sipas të njëjtës analizë, do të mund të organizohej vetëm nëse do të kishte më shumë se një kandidat për president. Sipas këtyre ekspertëve, shkelja e Kushtetutës ka mundur të evitohet duke u zgjedhur Pacolli president edhe me 67 deputetë prezent në sallë, pas daljes së opozites. Sipas tyre, në rastin më të keq, në raundin e dytë të votimit do të duhej të kishte të paktën dy candidate për president. "Po të kishin marrë pjesë dy kandidatë, atëherë ai që do të merrte më shumë vota në raundin e tretë dhe do të zgjidhej president. Për shembull, zoti Pacolli do të duhej të nominohej si kandidat vetëm nga 30 deputetë prezent në sallë. Tridhjetë të tjerë do të nominonin një kandidat tjetër. Një gjë e tillë do të mundësonte garën deri në fund", shkruajnë ekspertët. Sipas tyre, një gjë e tillë është pamundësuar, për shkak se 67 deputetë kanë nënshkruar më herët nominimin e Pacollit, dhe si pasojë ata nuk kanë mundur të nominojnë pastaj ndonjë kandidat tjetër.

### **Shkelet statusi i presidentit dhe katër nga gjashtë pikat e zgjedhjes së tij**

Duke i analizuar veç e veç, të gjitha pikat e nenit 68 të Kushtetutes, nen që në gjashtë pika definojnë mënyrën e zgjedhjes së presidentit, ekspertët konstatojnë se janë shkelur katër nga gjashtë pika të këtij neni, si dhe statusi i presidentit. "Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës", shkruhet në statusin kushtetues të presidentit. Sipas ekspertëve ndërkombëtarë, fakti që është kundërshtuar nga e tërë opozita dhe një numër aq i madh deputetësh, Pacolli nuk mund të jetë presidenti që kërkohet sipas këtij statusi të përshkruar në Kushtetutë. Në pikën e parë të këtij neni thuhet: "Presidenti i Republikës së Kosovës zgjidhet nga Kuvendi me votim të fshehtë". Sipas ekspertëve, SMS - të e publikuara në gazeta që i janë dërguar Pacollit nga këshilltari i tij Esad Pushkar, i cili thuhet se nuk ka qenë as në listën e mysafirëve për këtë seancë, tregon se ky kriter kushtetues për votim të fshehtë nuk është plotësuar gjatë votimit për Pacollin. Sipas ekspertëve, SMS -ët, përveç urimit për president kanë treguar edhe për ndërhyrje në rezultat, që "përveç shkeljes kushtetuese paraqesin edhe vepra penale që duhet të hetohen". Edhe pauza peseminutëshe që ka zgjatur sipas ekspertëve ndërkombëtare, tregon se ky kriter nuk është plotësuar. Ekspertët vlerësojnë se "deputeti z. Hashim Thaçi nuk ka treguar respekt ndaj kryetarit të Kuvendit të Kosovës, duke u larguar nga Kuvendi pa u dhënë pauza", gjë që sipas ekspertëve tregon edhe për presion ndaj vetë kryetarit. Pika kulminante që dëshmon se kriteri mbi votimin e fshehtë nuk është plotësuar, sipas ekspertëve ndërkombëtarë, është fakti se anëtarë që nuk janë pjesë e

Kuvendit të Kosovës, janë lejuar që gjatë pauzës të ndërhyjnë në vullnetin e deputetëve. Duke e bërë një krahasim me procesin e rregullt zgjedhor, ekspertët përkujtojnë se SMS - të dhe videot e marra nga telefonat mobile në vendvotime kanë shërbyer si bazë e mjaftueshme që të merren disa vendime për parregullsitë e zgjedhjeve. Po ashtu, telefonat nuk janë lejuar të përdoren në procesin e votimit, ndërsa prezenca e personave të paautorizuar në vendvotime ka qenë e parregullt. E njëjta gjë, sipas këtyre ekspertëve, ka ndodhur edhe në Kuvend, në institucionin më të lartë shtetëror. Pika dy e këtij neni, që tregon se presidenti duhet të zgjidhet 30 ditë nga përfundimi i mandatit të presidentit të kaluar, sipas ekspertëve nuk është shkelur. Nuk është shkelur as pika tre e këtij neni që flet se cili shtetas i Republikës ka të drejtë të kandidohet për president. Mirëpo ekspertët tërheqin vërejtjen, se fakti se në këtë pikë thuhet se mund të kandidojë secili shtetas që i ka siguruar "nënshkrimet e të paktën 30 deputetëve të Kuvendit të Kosovës", tregon për frymën e Kushtetutës, që kërkon më shumë se një kandidat. Të tria pikat tjera, ajo katër, pesë dhe gjashtë janë shkelur. Pika katër e këtij neni thotë: "Zgjedhja e presidentit bëhet me 2/3 e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës", "Kjo pikë përcakton dhe definon në mënyrë shumë të qartë se për zgjedhjen e presidentit kërkohet 2/3 e të gjithë deputetëve, pra e 80 prej tyre, sipas ekspertëve, në dy raundet tjera do të mund të procedohej, po të kishte edhe një kandidat, por në këtë rast ka pasur vetëm, një", thuhet në vlerësimin e ekspertëve. Pika pesë e këtij neni thotë: "Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë mes të dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të lartë të votave në raundin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputeteve zgjidhet president i Kosoves. Në këtë pikë, sipas ekspertëve, janë edhe shkeljet më të mëdha të Kushtetutes. "Votimi i tretë është bërë sipas Kornizës Kushtetuese të UNMIK - ut. Kjo pikë me sa duket është keqkuptuar apo u është keqinterpretuar paraprakisht deputetëve. Kjo pikë, në mënyrë recidive e përcakton se raundi i tretë duhet të zbatohet vetëm në rastin kur ka dy apo më shumë kandidatë", vlerësojnë ekspertët. Sipas tyre nëse nuk do të ishte kjo pikë kushtetuese, neni që flet për shkarkimin e presidentit e që kërkon 2/3 e votave do të ishte i pakuptimtë. Ekspertët vlerësojnë se moszgjedhja e Pacollit nuk do të çonte vendin në zgjedhje të parakohshme. Pika e gjashtë që flet për këtë çështje thotë: "Nëse në votimin e tretë, asnjëri nga kandidatët nuk zgjidhet president i Republikës së Kosovës, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda 45 ditëve". Sipas ekspertëve, edhe ky nen flet për rastet kur ka më shumë se një kandidat, dhe jo për rastin në fjalë, ku Pacolli ka qenë kandidat i vetëm. Ekspertët kanë shpjeguar se shkelje ka, pauza dhe presioni ka bërë që të shkelen edhe dy nene të Kushtetutës. Është shkelur neni 70, që flet për mandatin e deputeteve dhe neni 74 i Kushtetutës, që flet për ushtrimin e funksionit.

---

## Sot, ankesa kundër Pacollit në Gjykatën Kushtetuese

---

**LDK - ja dhe AAK - ja i kanë harmonizuar qëndrimet e tyre për zgjedhjen e Presidentit të Republikës. Ato do ta depozitojnë sot në Gjykatën Kushtetuese ankesën me argumentet përkatëse, në të cilën konstatohen shkeljet e procedurës dhe të Kushtetutës nga Presidenti i Kosovës**

Sot është afati i fundit kur subjektet politike të opozitës duhet ta dërgojnë ankesën e tyre për shkeljet kushtetuese dhe procedurale me rastin e zgjedhjes së Presidentit të vendit në Gjykatën Kushtetuese. Nënkrjetari i AAK-së, që njëkohësisht është shef i grupit parlamentar në Kuvendin e Kosovës, z. Ardian Gjini, siguroi të hënën së ky subjekt politik është duke bashkëpunuar ngushtë me LDK-në, në nivel ekspertësh, për të gjetur të gjitha detajet sipas të cilave do të argumentohet para Gjykatës Kushtetuese shkeljet e Kushtetutës dhe procedurave të tjera parlamentare me rastin e zgjedhjes së Presidentit të Kosovës, z. Behgjet Pacolli, në seancën e 22 shkurtit. Gjini tha se personalisht ka biseduar me grupin parlamentar të LDK së që të mos shkohet me dy kërkesa, por pasi substanca e kërkesave të këtyre dy partive është e njëjtë, atëherë të shkohet me një kërkesë të përbashkët. "Ne kemi pasur konsulta me grupin parlamentar të LDK - së, personalisht kam pasur konsulta dhe mendoj se në këtë drejtim mendojmë njëjtë. Me siguri që nuk do të ketë nevojë që të shkojnë dy kërkesa nëse mund t'i harmonizojmë të gjitha elementet, të cilat mund të jenë në letër. Besoj se jemi në rrugë të mirë dhe ka hapësirë të madhe të harmonizimit dhe mund të kemi një kërkesë të përbashkët", tha Ardian Gjini. Ai nuk e saktësoi ditën se kur do të dorëzohet kjo të kërkesë në Kushtetuesen, por tha se kjo do të ndodhë brenda afatit të duhur, pasi ekspertët përkatës ta kenë kryer punën e tyre në të gjitha detajet, por që kjo normalisht edhe nënkupton ditën e sotme deri në fund të orarit ditor të punës në gjykatë. Ai tha se krejt puna në finale është duke u shpenzuar në formulimin e ankesës. "Ne si deputetë më pak mund ta dimë se si t'i formulojmë këto tekste, por kur ta përfundojnë punën ekspertët ligjorë, shumë shpejt do ta procedojmë", tha Gjini. Ai nuk ka folur për detajet e përmbajtjes së lëndës që do të deponohet, por tha se tashmë shkeljet e bëra mbi bazën e Kushtetutës dhe procedurave të tjera janë të njohura, ndonëse mbi të gjitha është shkelur vullneti i shumicës së qytetarëve të Kosovës.

### "Vetëvendosje" pa kërkesë

Sipas të gjitha, gjasave Lëvizja "Vetëvendosje" nuk do të jetë pjesë e një peticioni dhe ankese të nënshkruar nga deputetët e LDK - së dhe AAK - së, edhe pse ky subjekt i ri politik konsideron që shkeljet kanë qenë të rënda dhe është i hapur për bashkëpunim nëse i ofrohet kërkesa. Visar Ymeri, nga Lëvizja "Vetëvendosje", tha dje se këtij subjekti politik nuk i është bërë kërkesë që ta mbështesë një ankesë për Gjykatën Kushtetuese rreth shkeljeve që janë bërë me rastin e zgjedhjes së Presidentit, as nga subjekti politik LDK, e as nga AAK - ja. "Ne si 'Vetëvendosje' e kemi konsideruar që mënyra se si është zgjedhur Presidenti, pavarësisht se a ka qenë shkelje e drejtpërdrejtë e klauzolave kushtetuese, ka qenë shkelje ndoshta më e madhe, dhe ka qenë shkelje në frymën e kushtetutshmërisë, për të cilën ne angazhohemi ta ndërtojmë në Kosovë", tha Ymeri. "Kjo frymë e kushtetutshmërisë është fryma republikane dhe ne kemi parë se fryma e zgjedhjes së Presidentit të Kosovës ka qenë diçka absolutisht në kundërshtim me rregullat e një republikanizmi modern për shkak se Presidenti i Kosovës u zgjodh, jo nëpërmjet votave, as

nëpërmjet votave të popullit, por as nëpërmjet votave të deputetëve, por nëpërmjet SMS - vë të dërguar nga persona për të cilët dëgjuam për herë të parë se ekzistojnë dhe për të cilët dëgjuam për herë të parë se ishin në Kosovë. Pra, këshilltarët e tash presidentit Behgjet Pacolli, si dhe ndërlidhja e atyre këshilltarëve me ambasadorin amerikan në Kosovë ia mundësuan atij zgjedhjen i president. Konsiderojmë se kjo është shkelje e asaj fryme për të cilën është angazhuar Lëvizja "Vetëvendosje" në aspektin e kushtetutshmërisë dhe në aspektin e respektimit të vullnetit të popullit. Si e tillë, kjo shkelje paraqet një lloj demaskimi të një shkeljeje më të madhe që i bëhet këtij populli dhe interesave të tij, e ky koncept politik që përfaqohet nga Thaçi dhe Pacolli", tha Visar Ymeri.

### **Kryeparlamentari Krasniqi abstenon**

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, i pyetur dje nëse edhe ai do ta mbështesë ankesën e opozitës, nga fakti që publikisht është ankuar për presionin e bërë dhe ka deklaruar shkeljet e bëra në procedurë dhe në baza kushtetuese, tha se personalisht as nuk e mbështet, por as nuk e kundërshton kërkesën e LDK-së dhe AAK-së për interpretimin nga Gjykata Kushtetuese. "Kjo është e drejtë e 30 apo më shumë deputetëve për ta procesuar një lëndë në gjykatë, e unë as nuk e përkrah, as nuk e kundërshtoj", tha Krasniqi, pas mbledhjes së djeshme të Kryesisë së Kuvendit. Ai e ka komentuar edhe një deklaratë të Pacollit, sipas të cilit fajtor pse ai ka votuar për Kabinetin qeveritar në seancën e 22 shkurtit është kryeparlamentari Krasniqi, që nuk e ka udhëzuar si të veprojnë. "Ju e keni parë seancën, për interpretimin nga Gjykata Kushtetuese. "Kjo është e drejtë e 30 apo më shumë deputetëve për ta pronësuar një lëndë në gjykatë, e unë as nuk e përkrah, as nuk e kundërshtoj", tha Krasniqi, pas mbledhjes së djeshme të Kryesisë së Kuvendit. Ai e ka komentuar edhe një deklaratë të Pacollit, sipas të cilit fajtor pse ai ka votuar për Kabinetin qeveritar në seancën e 22 shkurtit është kryeparlamentari Krasniqi, që nuk e ka udhëzuar si të veprojnë. "Ju e keni parë seancën, seanca ka qenë publike, realisht pak a shumë seancë dhe me tensione. Megjithatë, unë nuk kam shikuar se kush individualisht do të votojë dhe si do të votojë. Votimi ka qenë i përgjithshëm dhe, në fund të fundit, ka qenë përgjegjësi individuale e secilit deputet që ka qenë në sallë. Realisht unë konsideroj se e kam kryer detyrën time, e kam ftuar për fjalë, ia kam uruar detyrën dhe një çështje tjetër që duhet ta them këtu, sa i përket praktikës së vendosjes së karriges para deputetëve, unë mendoj që ajo praktikë duhet t'i përkasë së kaluarës", tha kryeparlamentari Jakup Krasniqi. S. AHMETI

---

## **Pacolli: Franca është mike e madhe e Kosovës**

---

Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli priti sot në një takim ambasadorin e Francës në Prishtinë, zotin Jean François Fitou, me të cilin zhvilloi një bisedë të gjatë dhe miqësore. Duke pranuar urimet e Ambasadorit Fitou dhe institucioneve të Francës për zgjedhjen në detyrën e re, Presidenti Pacolli theksoi se **“Franca është mike e madhe e Kosovës dhe ambasadori Fitou gjithashtu është mik i madh i Kosovës”**. “Neve na nevojiten këshillat e Francës, në mënyrë që të mësojmë nga eksperiencia juaj dhe të rrugëtojmë më shpejt drejt shtëpisë së madhe evropiane”, tha Presidenti Pacolli. Duke përmendur se Kosova ka një gjendje shumë të rëndë ekonomike, Presidenti Pacolli theksoi se vendi ynë ka nevojë shumë të madhe për zhvillim ekonomik dhe në këtë plan institucionet e Kosovës do të krijojnë një klimë sa më të favorshme për nxitjen e investimeve të huaja. Nga ana e tij, ambasadori Jean François Fitou tha se Franca është e gëzuar që Kosova krijoi institucionet që do të udhëheqin shtetin.

---

## Nuk është qëndrim i Zvicrës

---

Ambasadori i Kosovës në Zvicër, Naim Malaj ka deklaruar se raporti i Dick Martyt nuk është edhe qëndrim zyrtar i qeveriës zvicerane. “Këtë mund ta konfirmojë dhe këtë konfirmim e ka marrë edhe nga autoritetet zvicerane, megjithatë, nuk mund të thuhet që ky raport nuk ka një impakt në opinionin publik këtu në Zvicër”, ka thënë ambasadori Malaj. Ai ka thënë se është një punë e mirë që është bërë nga Ambasada, shoqatat, mërgimtarët shqiptarë nëpër përmirësimin dhe në ndryshimin e imazhit të Kosovës. “Por duhet pranuar gjithashtu që ky raport ka ndikuar ndoshta negativisht në imazhin e Kosovës këtu në Zvicër dhe jashtë Zvicrës. Ne si ambasadë që në fillim kemi reaguar ndaj këtij raporti, kemi qenë të pranishëm, personalisht kam qenë i pranishëm në të gjitha mediet zvicerane, në televizionet qendrore, në radio, në gazetat kryesore, për të dhënë atë pikëpamjen tonë, e cila sigurisht që është në kundërshtim me këtë raport”, ka thënë Malaj.

---

## Ambasadorët në “Odën” e Pacollit

---

**Presidenti Behgjet Pacolli shprehet mirënjohës për Francën, Turqinë e Italinë**

**Presidenti Pacolli me këtë rast ka thënë se Franca dhe Turqia janë dy shtete mike që kanë dhënë kontribut të madh për çlirimin dhe zhvillimin e Kosovës.**

PRISHTINË - Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, ka takuar disa nga ambasadorët e huaj të akredituar në Prishtinë, përfshirë këtu, ambasadorin e Francës, Jean François Fitou, ambasadoren e Republikës së Turqisë, Songul Ozan, atë të Italisë, Michael Giffoni dhe ambasadorin e Shqipërisë, Islam Lauka. Presidenti Pacolli me këtë rast ka thënë se Franca dhe Turqia janë dy shtete mike që kanë dhënë kontribut të madh për çlirimin dhe zhvillimin e Kosovës. Pacolli ka thënë se Kosovës i nevojiten këshillat e Francës, në mënyrë që të mësojë nga eksperiencia e saj dhe të rrugëtojë më shpejt drejt shtëpisë së madhe evropiane. Nga ana e tij, ambasadori Jean François Fitou tha se Franca është e gëzuar që Kosova krijoi institucionet që do të udhëheqin shtetin. "Kosova do ta gjejë vendin e saj në Evropë", tha ambasadori Fitou, duke shtuar se ky realitet duhet të jetësohet, sepse nuk ka rrugëzgjdhje tjetër dhe se Franca është e gatshme t'i ndihmojë Kosovës në realizimin e këtij misioni. Ndërkaq, në takim me ambasadoren e Turqisë, Pacolli ka thënë se Kosova dhe Turqia janë dy vende mike dhe me marrëdhënie shumë të mira mes vete. **"Kontributi i madh i Turqisë gjatë periudhës së shtetbërjes së Kosovës ka qenë i një rëndësie të veçantë dhe shumë të madhe"**, tha Pacolli, duke rikujtuar faktin se Turqia ka qenë ndër shtetet e para që e ka njohur Republikën e Kosovës. "Kosova duhet të mësojë sa më shumë nga eksperiencat e Turqisë. Bashkëpunimi ekonomik mes të dy vendeve duhet të intensifikohet, duke krijuar mundësi më të mëdha për investime të investitorëve nga Turqia në Kosovë", ka thënë Pacolli, duke shtuar se Kosova do t'i hapë dyert edhe më shumë për biznesin turk. Nga ana e saj, ambasadorja Ozan tha se lidhja e ngushtë dhe bashkëpunimi mes dy vendeve do të vazhdojë dhe do të shënohet edhe me tutje, duke qenë edhe një faktor i rëndësishëm i zhvillimit dhe stabilitetit në rajon. "Institucionet e Turqisë janë të gatshme që të japin të gjithë eksperiencën e tyre për zhvillimin e Republikës së Kosovës", tha ambasadorja Ozan, duke shtuar se biznesmenët e vendit të saj janë shumë të interesuar të investojnë në Kosovë. Presidenti Pacolli priti po ashtu edhe ambasadorin e Republikës së Italisë në Kosovë Michael Giffoni. Ky i fundit ia ka përcjellë atij urimet e presidentit Giorgio Napolitano, me rastin e zgjedhjes president i Kosovës. Pacolli falënderoi Italinë për ndihmën e dhënë Kosovës, ndërsa ia përkujtoi Giffonit ndihmën e madhe dhe të vazhdueshme të shtetit italian për Kosovën. Nga ana e tij, ambasadori Giffoni shprehu edhe një herë përkushtimin e vendit të tij për t'u gjendur pranë qytetarëve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës, për t'i mbështetur ato në të gjitha proceset drejt hapjes së perspektivës së integrimi euroatlantike. Presidenti Pacolli po ashtu takoi edhe ambasadorin e Shqipërisë, Lauka, nga i cili mori mbështetjen e Tiranës zyrtare për integrimin dhe zhvillimin e Kosovës



---

## **Pacolli përfundimisht në Gjykatë**

---

**Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli përfundimisht do të përballet me Gjykatën Kushtetuese, pasi në ditën e zgjedhjes së tij në postin e kreut të vendit, ka shkelur Kushtetutën duke votuar qeverinë, pasi kishte bërë betimin si President**

Vetëm një javë pasi mori detyrën e Presidentit, Behgjet Pacolli do të përballet me Gjykatën e Kushtetutës. Kjo pasi vetëm pak minuta pasi ishte zgjedhur në postin e Presidentit dhe kishte bërë betimin para deputetëve, kishte votuar qeverinë e partnerit të tij në koalicion, Hashim Thaçit. Tashmë përfundimisht partitë opozitare kanë vendosur që këtë rast, por edhe mënyrën e zgjedhjes së Pacollit në postin e Presidentit, ta dërgojnë për interpretim në Gjykatën Kushtetuese. LDK-ja e AAK-ja këtë do ta bëjnë së bashku, derisa partia tjetër opozitare Vetëvendosje nuk do t'i bashkëngjitet këtyre dy partive edhe pse vlerëson se kjo është shkelje e Kushtetutës. Sipas tyre kjo mund të bëhet edhe pa VV-në, sepse janë numrat prej 30 nënshkrimeve të deputetëve, por në rast se ka nevojë për nënshkrime, atëherë edhe VV-ja është e gatshme t'i bashkëngjitet kësaj nisme.

### **Për shkeljen e Kushtetutës e di Gjykata**

Ndërsa, as pro, as kundër kësaj çështjeje, është shprehur edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, duke thënë se ai nuk e ka injoruar Pacollin, pasi ky i fundit ishte zgjedhur President i vendit. Mirëpo, në çastin kur Pacolli ka votuar Qeverinë, Krasniqi thotë se vetëm Gjykata Kushtetuese e di nëse Presidenti e ka shkelur Kushtetutën apo jo. Krasniqi ka thënë se ka kryer punën e tij si kryekuvendar dhe se votimi për qeverinë, ka qenë i përgjithshëm dhe se vota e secilit prej atyre që kanë votuar për kabinetin qeveritar është përgjegjësi vetëm e tyre. I pari i Kuvendit është shprehur se vendosja e karriges se presidentit, siç kërkohet, i takon mentalitetit të së kaluarës. "Se a e ka shkelur Kushtetutën Pacolli, këtë mund ta dijë dhe përcaktojë vetëm Gjykata Kushtetuese", është shprehur Krasniqi. Por, Krasniqi nuk e përkrah dhe as nuk e kundërshton kërkesën e dy partive opozitare, LDK-së dhe të AAK-së, që pritet të deponojnë në Kushtetuese një kërkesë, nëse është shkelur Kushtetuta në seancën e jashtëzakonshme parlamentare të 22 shkurtit, kur është votuar për Presidentin dhe Qeverinë.

### **Përfundimisht kërkesa shkon në Gjykatë**

Por, se Pacolli do të përballet me Gjykatën Kushtetuese qysh në fillim të mandatit të tij, nuk ka dilemë, pasi nënkryetari i AAK-së, Ardian Gjini, ka deklaruar se tashmë kanë ndodhur edhe konsultat me LDK-në në mënyrë që kërkesën ta dërgojnë së bashku në Gjykatë. "Ne kemi pasur konsulta me Grupin Parlamentar të LDK-së, unë personalisht kam pasur konsulta dhe mendoj se në këtë drejtim mendojmë njëjtë. Me siguri nuk do të ketë nevojë që të shkojnë dy kërkesa nëse mund t'i harmonizojmë të gjitha elementet, të cilat mund të shkojnë me një kërkesë dhe besoj se jemi në rrugë dhe ka hapësirë të madhe të harmonizimit dhe mund të kemi një kërkesë të përbashkët", ka thënë Gjini. Mirëpo, në këtë kërkesë të këtyre dy partive opozitare nuk do t'i bashkëngjitet partia e tretë momentalisht në vend, VV-ja, pasi sipas udhëheqësve të saj, LDK-ja dhe AAK-ja nuk kanë nevojë për numra që ta dërgojnë këtë kërkesë shumë të qëlluar. Mirëpo, sipas Glauk Konjufcës, nëse kërkesa mbetet për shkak të numrave, atëherë ata janë të gatshëm t'i bashkohen dhe ta nënshkruajnë petitionin për ta dërguar Presidentin në Gjykatë.


"Po është marrë kjo iniciativë prej LDK-së dhe AAK-së dhe numrat i kanë dhe teknikisht nuk ka nevojë dhe është e realizueshme. Po nëse nuk mundet pa neve, atëherë ne do t'i bashkohemi, por nuk po më duket se kjo është e domosdoshme. Mirëpo, kjo është shkelje e nenit 88 të Kushtetutës së Kosovës", ka thënë Konjufca.

---

## **Pacolli u takua me Buhlerin**

---

PRISHTINË - Presidenti Behgjet Pacolli zhvilloi të martën një takim me komandantin e KFOR - it në Kosovë, gjeneralin Erhard Buhler. Në takimin e tij të parë me presidentin Pacolli, gjenerali Buhler theksoi gatishmërinë e tij dhe të KFOR - it për bashkëpunim të vazhdueshëm me presidentin dhe institucionet e vendit tonë. Presidenti Behgjet Pacolli shprehu gatishmërinë e vazhdueshme për bashkëpunim, duke çmuar lart kontributin që forcat e KFOR - it kanë dhënë dhe po japin në vazhdimësi për shtetin dhe qytetarët e Kosovës.



*Presidenti Behgjet Pacolli pret në takim komandantin e KFOR - it në Kosovë, gjeneralin Erhard Buhler*



---

## Kontestojnë zgjedhjen e presidentit

---

**LDK e AAK kërkojnë drejtësi në Gjykatën Kushtetuese**

**Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese në lidhje me procedurat e aplikuara në seancën e 22 shkurtit, kur Kuvendi zgjodhi presidentin dhe Qeverinë e re të Kosovës. Ekspertët e çështjeve kushtetuese presin që interpretimi i Gjykatës të jetë në favor të partive opozitare, por nuk besojnë se do të përsëritet rasti i vitit të kaluar me presidentin Fatmir Sejdiu. Dy parti opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, i kanë deponuar kërkesat e tyre te Gjykata Kushtetuese, nga e cila kërkojnë interpretimin në lidhje me procedurat e zgjedhjes së presidentit dhe Qeverisë së Kosovës, në seancën e 22 shkurtit**

### Argumentet

Të dyja subjektet opozitare pretendojnë se atë ditë kishte shkelje të procedurave e të Kushtetutës dhe kërkojnë një vendim nga Gjykata në lidhje me këto dyshime. Deputetja e LDK-së, Vjosa Osmani, tha se LDK-ja kërkon interpretimin e Gjykatës në lidhje me procedurat e zgjedhjes së institucioneve në Kuvend, më 22 shkurt. Thellim i krizës " Kërkesa jonë konteston procedurën, me të cilën është zgjedhur presidenti Pacolli më datën 22 shkurt në seancën e jashtëzakonshme. Natyrisht, ne i kemi paraqitur argumentet kryesore dhe tani i takon Gjykatës që të vlerësojë nëse ajo procedurë me të vërtetë ka qenë apo jo kushtetuese", thekson Osmani. Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës konfirmon se i ka proceduar Gjykatës Kushtetuese ankesën e saj në lidhje me procedurat e zbatuara në seancën e 22 shkurtit. Nënkryetari i AAK-së, Ahmet Isufi, tha se AAK-ja pret një interpretim meritor nga Gjykata, duke besuar se atë ditë në Kuvend janë bërë shkelje të Kushtetutës, "Besojmë se Gjykata Kushtetuese do të marrë vendim, sepse është përkrahje e iniciativës për kontestimin e atyre veprimeve, të cilat janë bërë në Parlament", tha Isufi. Ditën e zgjedhjes së presidentit të Kosovës janë shënuar të paktën katër shkelje kushtetuese, tha profesori Riza Smaka, ekspert i çështjeve kushtetuese –juridike. Ai tha se fillimisht Kushtetuta parasheh jo një, por më shumë kandidatë që i nënshtrohen votimit për president në Kuvend. Shkelja e dytë, nënvizoi Smaka, ka të bëjë me numrin e deputetëve të pranishëm në sallë, kur kërkohen dy të tretat apo 80 deputetë, ndërsa në seancë ishin të pranishëm vetëm 67. Shkelja e tretë, shtoi ai ka të bëjë me thirrjen e pazës në mes të votimit.

Profesor Smaka: Pacolli nuk ka shkelur Kushtetutën. Këto shkelje, sipas profesorit Smaka, nuk e ngarkojnë presidentin aktual, Behgjet Pacolli, pasi që ai ishte vetëm kandidat që synonte postin e presidentit dhe nuk ishte ai që organizoi procedurat dhe votimin. Por, ajo për të cilën Pacolli dyshohet se ka bërë shkelje është vota e tij për qeverinë e re. Në momentin që Pacolli është betuar si president, atij me Kushtetutë i ndalohet të ushtrojë edhe ndonjë funksion publik, si posti i deputetit. Mirëpo, përkundër këtij fakti, Pacolli thuhet se ka votuar për qeverinë. "Mund të jetë që edhe spontanisht ka votuar. Gjithsesi, opozita, e cila ka ngritur peticionin, vetëm në këtë pikë, mund të synojë për ta argumentuar tezën e vet, se këto tjerat nuk i ka bërë shkelje presidenti, i kanë bërë të tjerët", theksoi Smaka. Sipas tij, edhe nëse Gjykata Kushtetuese konstaton shkelje lidhur me çështjen e votës së Pacollit si deputet dhe president,

duhet bërë dallimi ndërmjet shkeljes së rëndë të Kushtetutës dhe shkeljes spontane, siç besohet se e ka bërë Pacolli në këtë rast. Andaj, interpretimi i Gjykatës Kushtetuese, sipas profesorit Smaka, konsiderohet si vendimtar nëse Kuvendi do t'i iniciojë apo jo më pas procedurat e shkarkimit të presidentit Pacolli.

### **Paprekshmëria e mandatit të presidentit**

"Për t'u shkarkuar presidenti kërkohet që të ketë bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës e këtë duhet që ta formulojë, ta miratojë Gjykata Kushtetuese. Por, edhe kjo nuk do të ishte e suficiente që të konstatonte Gjykata dhe ai të shkarkohej, ngase do të duhej që në Kuvend, edhe atje me shumicën prej së paku 80 votave për shkarkim, të shkarkohej. Por, prapëseprapë, opozita nuk i ka këto vota", u shpreh Smaka. Kjo është hera e dytë që deputetët e Kuvendit të Kosovës iniciojnë shkeljet e Kushtetutës nga ana e presidentit të Kosovës në Gjykatën Kushtetuese. Vitin e kaluar, Gjykata Kushtetuese interpretoi si shkelje të rëndë të Kushtetutës rastin e ish-presidentit Fatmir Sejdiu me mbajtjen e dy posteve. Mirëpo, kësaj radhe, Pacolli, sipas ekspertëve, mund të shpëtojë pa u shkarkuar nëse Gjykata konstaton se ai ka bërë shkelje spontane dhe jo shkelje të rëndë të Kushtetutës.

---

## Posti i Pacollit në Kushtetuese

---

**LDK dhe AAK bënë punën e vet, dërguan Pacollin në Kushtetuese. Gjykata tani vendos se si do ta interpretojë procedurën e zgjedhjes së presidentit. Lënda pritet të ngarkohet edhe me votën e tij për qeverinë**

**“Kjo është hera e dytë që deputetët e Kuvendit të Kosovës iniciojnë shkeljen e Kushtetueses nga ana e presidentit të Kosovës në Gjykatën Kushtetuese.**

Proceduralisht, të martën dy parti opozitare, LDK dhe AAK i kanë deponuar kërkesat e tyre tek Gjykata Kushtetuese, nga e cila kërkojnë interpretimin në lidhje me procedurat e zgjedhjes së presidentit në seancën e 22 shkurtit. Të dyja subjektet opozitare pretendojnë se atë ditë kishte shkelje të procedurave dhe të Kushtetutës dhe kërkojnë një vendim nga Gjykata në lidhje me këto dyshime. Deputetja e LDK - së, Vjosa Osmani, tha se kjo parti kërkon interpretimin e Gjykatës në lidhje me procedurat e zgjedhjes së institucioneve në Kuvend, më 22 shkurt. "Kërkesa jonë konteston procedurën me të cilën është zgjedhur presidenti Pacolli më datën 22 shkurt në seancën e jashtëzakonshme dhe natyrisht ne i kemi paraqitur argumentet kryesore, dhe tani i takon Gjykatës që të vlerësojë nëse ajo procedurë me të vërtetë ka qenë apo jo kushtetuese", thekson Osmani. Lidhur me kohën kur Gjykata pritet të marrë një vendim, Osmani tha se kjo përcaktohet me nenin 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Në këtë nen thuhet se Gjykata Kushtetuese duhet të nxjerrë vendim mbi kontestin jo më larg se 60 ditë nga paraqitja e kërkesës. LDK ka ndarë procedurën e zgjedhjes së Pacollit dhe aktin e asaj që konsiderohet si shkelje e Kushtetutës nga Pacolli, vetëm pak minuta pas betimit kur ai votoi për qeverinë e re. Sipas zyrtarëve të LDK - së, për veprimet e Pacollit pas zgjedhjes, mund të ketë një lëndë shtesë e cila do t'i adresohet po ashtu Gjykatës Kushtetuese. Ndërkohë, edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës konfirmon se i ka proceduar Gjykatës Kushtetuese ankesën e saj në lidhje me procedurat e zbatuara në seancën e 22 shkurtit. Nënkryetari i AAK - së, Ahmet Isufi, thotë se AAK pret një interpretim meritore nga kjo gjykatë, duke besuar se atë ditë në Kuvend janë bërë shkelje të Kushtetutës. "Gjatë ditës është proceduar dhe besojmë se Gjykata Kushtetuese do të marrë vendim, sepse është përkrahje e iniciativës për kontestimin e atyre veprimeve të cilat janë bërë në Parlament", thotë Isufi. Shkeljet e procedurave dhe të Kushtetutës në seancën e 22 shkurtit vërtetohen edhe nga ana e ekspertëve. Ditën e zgjedhjes së presidentit të Kosovës janë shënuar të paktën katër shkelje kushtetuese, thotë profesori Riza Smaka, ekspert i çështjeve kushtetuese - juridike. Ai thotë se fillimisht Kushtetuta parasheh jo një, por më shumë kandidatë që i nënshtrohen votimit për president në Kuvend. Shkelja e dytë, nënvizon Smaka, ka të bëjë me numrin e deputetëve të pranishëm në sallë, kur kërkohen dy të tretat apo 80 deputetë, kurse në seancë ishin të pranishëm vetëm 67. Si dhe shkelja e tretë, ajo e thirrjes së pauzës në mes të votimit. Të tria këto shkelje, sipas profesorit Smaka, nuk e ngarkojnë presidentin aktual, Behgjet Pacolli, pasi që ai ishte vetëm kandidat që synonte postin e presidentit dhe nuk ishte ai që organizoi procedurat dhe votimin. Por, ajo që Pacolli dyshohet se ka bërë shkelje është vota e tij për qeverinë e re. Në momentin që është betuar si president, atij me Kushtetutë i ndalohet të ushtroj edhe funksion publik si post i deputetit. Mirëpo, përkundër këtij fakti, Pacolli thuhet se ka votuar për qeverinë. "Mund të jetë që edhe spontanisht ka votuar. Gjithsesi, opozita e cila ka ngritur peticionin vetëm në këtë pikë

eventualisht mund të synojë për ta argumentuar tezën e vet, se këto tjerat nuk i ka bërë shkelje presidenti, i kanë bërë të tjerët", thekson Smaka. Sipas profesorit Riza Smaka, edhe nëse Gjykata Kushtetuese konstaton shkelje çështjen e votës së Pacollit si deputet dhe president, duhet bërë dallimi ndërmjet shkeljes së rëndë të Kushtetutës dhe shkeljes spontane, siç besohet se e ka bërë Pacolli në këtë rast. Andaj, interpretimi i Gjykatës Kushtetuese, sipas Smakës, konsiderohet si vendimtar nëse Kuvendi do t'i iniciojë apo jo më pas procedurat e shkarkimit të presidentit Pacolli. "Për t'u shkarkuar presidenti kërkohet që të ketë bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës e këtë duhet që ta formulojë, ta miratojë, Gjykata Kushtetuese", thotë ai. "Por, edhe kjo nuk do të ishte e suficiente që të konstatonte Gjykata dhe ai të shkarkohej, ngase do të duhej që në Kuvend, edhe atje me shumicën prej së paku 80 votave për shkarkim, dhe tek atëherë do të mund të shkarkohej. Por, prapëseprapë opozita nuk i ka këto vota", thotë Smaka. Kjo është hera e dytë që deputetët e Kuvendit të Kosovës iniciojnë shkeljet e Kushtetutës nga ana e presidentit të Kosovës në Gjykatën Kushtetuese. Vitin e kaluar, Gjykata Kushtetuese interpretoi si shkelje të rëndë të Kushtetutës rastin e ish - presidentit Fatmir Sejdiu me mbajtjen e dy posteve. Mirëpo, kësaj radhe, Pacolli sipas ekspertëve mund të shpëtojë pa u shkarkuar nëse Gjykata konstaton se ai ka bërë shkelje spontane të Kushtetutës dhe jo shkelje të rëndë të Kushtetueses.



---

## Presidenti u dërgua në Gjykatë

---

**Dy deputetë të LDK-së dhe AAK-së kanë dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese ankesën me 34 nënshkrimet e deputetëve, për ta interpretuar mënyrën e zgjedhjes së Presidentit në seancën e jashtëzakonshme të 22 shkurtit**

Deputetët e dy partive opozitare, LDK-së dhe AAK-së kanë dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese ankesën rreth mënyrës së zgjedhjes së Behgjet Pacollit në postin e Presidentit në seancën e jashtëzakonshme të 22 shkurtit. Pas deponimit të kësaj kërkesë, deputetja e LDK-së, Vjosa Osmani ka thënë se ata me këtë kërkesë të nënshkruar nga 34 deputetë kanë kërkuar të saktësohet nëse Kuvendi ka përfillur procedurat gjatë zgjedhjes së Behgjet Pacollit për President të Kosovës. "Sapo e dorëzuar lëndën në emër të 34 deputetëve, që kanë nënshkruar kërkesën me të cilën kontestohet procedura përmes të cilës është përzgjedhur Presidenti Pacolli. Tani i takon Gjykatës Kushtetuese të vendosë në këtë çështje dhe natyrisht çdo vendim që do të merret nga Gjykata do të respektohet nga deputetët që e kanë iniciuar këtë çështje", ka thënë Osmani. Ndërsa, ekspertët e së drejtës kushtetuese thonë se këtu janë dy mënyra të interpretimit, që ose hedh poshtë ankesën e partive opozitare ose vendos pro kësaj kërkesë, që do të ishte vendim që duhet të zbatohet patjetër, pasi që GJK-ja është instanca e fundit për interpretimin nëse është shkelur Kushtetuta apo jo. Por sipas Mazllum Baraliut nuk mund të ketë vendim të GJK-së se ka vetëm shkelje të lehtë, pasi atëherë do të duhej që të vendosë në favor të Pacollit.

### Gjykata vendos

Osmani më tutje ka thënë se është gardiani i aktit më të lartë juridik që vendos nëse procedurat e zgjedhjes së presidentit kanë qenë në përputhje me Kushtetutën apo jo. "Gjykata do të vendosë a ka qenë procedura kushtetuese apo jo, sepse ne sipas nenit 113.5 kemi të drejtë të iniciojmë apo të kontestojmë procedurat apo aktet që miratohen nga Kuvendi, në qoftë se mendojmë që ato nuk kanë qenë në përputhje me Kushtetutën. Në këtë rast ne mendojmë që është shkelur neni 86 i Kushtetutës dhe mbi këtë bazë e kemi ndërtuar argumentet tona", ka thënë Osmani. Ndërsa, nënkryetari i AAK-së, Ahmet Isufi ka shprehur besimin se Gjykata me autoritetin që e ka, t'i konstatojë shkeljet që kanë ndodhur në Parlamentin e Kosovës me rastin e zgjedhjes së Presidentit. "Ne kemi përkrahur atë çka ka qenë veprime të cilat kanë rënë ndesh me Kushtetutën e Kosovës, prandaj të gjitha shkeljet që kanë ndodhur janë përmbledhur, janë dërguar në Gjykatë", ka thënë Isufi.

### S'ka vendim të lehtë, pozitiv ose negativ

Por, eksperti i së drejtës kushtetuese, Mazllum Baraliu thotë se janë dy forma të shprehjes nga GJK-ja ndaj kësaj kërkesë të parashtruar nga dy partitë opozitare. "Njëra është që mund të jetë pozitive, dhe tjetra mund të jetë refuzuese ose negative. Kjo çështje është absolutisht çështje ekskluzive e Gjykatës Kushtetuese e cila është kompetente që ta ruajë Kushtetutën dhe të vendosë për këtë", ka thënë Baraliu. Mirëpo, sipas tij vendimet e GJK-së janë të pakontestueshme dhe se duhet të respektohen menjëherë. "Vendimet e GJK-së janë përfundimtare, të instancës së fundit, prandaj janë të obligueshme për t'u zbatuar dhe nuk mbetet alternative tjetër veçse të zbatohet ashtu siç vendos ajo, është shprehur Baraliu. Ndërsa,

për këtë Pacolli ka fajësuar edhe protokollin e Kuvendit pasi nuk i është treguar atij se si të veprojë kur është zgjedhur President. Mirëpo, sipas Baraliut Gjykata nuk mund të konstatojë se ka pasur shkelje të lehtë të Kushtetutës me arsyetimin se s'ka qenë në dijeni se si të veprojë. "Jo s'ka shkelje të lehtë, sepse nëse ndodh që është shkelje e lehtë, atëherë duhet të vendosë pozitivisht në favor të Presidentit, dhe refuzon ankesën e dy partive, por në qoftë se konstaton shkelje të rëndë ose serioze, atëherë do të duhej të ishte një verdikt tjetër i kësaj Gjykate", ka thënë Baraliu. Sipas tij, me këtë rast atij që i drejtohet ky vendim atëherë duhet ta zbatojë atë, sepse nuk ka alternativë tjetër.

**LDK dhe AAK Dorëzojnë Ankesën Në Gjykatën Kushtetuese**

## **“Pacolli” deponohet në Kushtetuese**

**LDK dhe AAK i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese në lidhje me procedurat e aplikuar në seancën e 22 shkurtit, kur Kuvendi zgjodhi presidentin dhe Qeverinë e re të Kosovës. Interpretimi i Gjykatës pritet të jetë në favor të partive opozitare, por besohet se nuk do të përsëritet rasti i vitit të kaluar me presidentin Fatmir Sejdiu**

Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e kanë dorëzuar të martën lëndën në Gjykatën Kushtetuese, lëndë kjo e cila konteston procedurën e zgjedhjes së presidentit Behgjet Pacolli në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit. Me këtë rast, deputetja e LDK-së Vjosa Osmani, e cila e ka dorëzuar lëndën në gjykatë, ka thënë se të dy partitë opozitare LDK dhe AAK dyshojnë në mënyrën se si është zgjedhur Pacolli president, prandaj kërkojnë interpretim ligjor nga Gjykata Kushtetuese. Osmani ka thënë se lënda e cila është dërguar në Kushtetuese e ka nënshkrimin e 34 deputetëve të të dy partive, ku, sipas Osmanit, çdo vendim i Gjykatës Kushtetuese do të jetë i pranueshëm për LDK-në. “Sapo e dorëzuar lëndën në emër të 34 deputetëve, që kanë nënshkruar kërkesën me të cilën kontestohet procedura nëpërmjet të cilës është përzgjedhur presidenti Pacolli. Tash i takon Gjykatës Kushtetuese të vendosë në këtë çështje dhe natyrisht çdo vendim që do të merret nga Gjykata, do të respektohet nga deputetët, të cilët e kanë iniciuar këtë çështje”, - ka thënë Osmani.

### **Tash vendos gjykata**

“Gjykata do të vendosë nëse ka qenë procedura kushtetuese, sepse ne, sipas nenit 113.5 kemi të drejtë të iniciojmë apo kontestojmë procedurat apo aktet që miratohen nga Kuvendi, në qoftë se mendojmë që ato nuk kanë qenë në përputhje me Kushtetutën. Në këtë rast ne mendojmë që është shkelur neni 86 i Kushtetutës dhe mbi këtë bazë i kemi ndërtuar argumentet tona”, - ka thënë Osmani. Sipas saj, nuk përjashtohet mundësia që një kërkesë tjetër të adresohet në Kushtetuese, e që lidhet me shkeljen e Kushtetutës nga presidenti Pacolli me rastin e votimit të tij të Qeverisë në cilësinë e deputetit. Kjo, sipas saj, do të jetë pikë e veçantë që do të dorëzohet në Gjykatën Kushtetuese.

### **Tri shkeljet e Kushtetutës**

Në anën tjetër, nënkryetari i AAK-së, Ahmet Isufi, ka thënë se kjo parti pas dorëzimit të ankesës, tash pret një interpretim meritor nga gjykata, duke theksuar se atë ditë në Kuvend janë bërë shkelje të Kushtetutës. “Besojmë se Gjykata Kushtetuese do të marrë vendim, sepse është përkrahje e iniciativës për kontestimin e atyre veprimeve, të cilat janë bërë në Parlament”, - ka thënë Isufi. Në anën tjetër eksperti i çështjeve kushtetuese-juridike Riza Smaka, ka thënë se ditën e zgjedhjes së presidentit të Kosovës, ka pasur të paktën tri shkelje. Smaka me këtë rast ka thënë se Kushtetuta parasheh jo vetëm një por më shumë kandidat që i nënshtrohen votimit për president në Kuvend. Pastaj numri i deputetëve të pranishëm në sallë sipas Smakës duhet

të jetë dy të tretat apo 80 deputetë, ndërsa në seancë ishin të pranishëm vetëm 67. Smaka po ashtu ka theksuar se shkelja e tretë është pauza e cila është bërë në mes të votimit. Mirëpo, me këtë rast, Smaka nuk e ka fajësuar presidentin, Behgjet Pacolli, për shkelje të kushtetutës, pasi që sipas Smakës Pacolli ishte vetëm kandidat që synonte postin e presidentit dhe nuk ishte ai që organizoi procedurat dhe votimin. Andaj, interpretimi i Gjykatës Kushtetuese, sipas profesorit Smaka, konsiderohet si vendimtar nëse Kuvendi do t'i iniciojë apo jo më pas procedurat e shkarkimit të presidentit Pacolli.

Donjeta Bytyqi

---

## Presidenti: Nuk mund të na pengojnë të aplikojmë ligje dhe standarde të njëjta

---

Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli priti të mërkurën një delegacion të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të Shqipërisë, të kryesuar nga zëvendëskryetari z. Kreshnik Spahiu. Z. Spahiu uroi z.Pacolli për zgjedhjen në postin e Presidentit të Republikës së Kosovës, duke i përcjellë edhe përshëndetjet e Presidentit Bamir Topi. Presidenti Pacolli theksoi në takim se funksionimi i sistemit të drejtësisë është me rëndësi shumë të madhe për zhvillimin e një shoqërie, një shteti dhe për imazhin e tij në përgjithësi. Në këtë plan, ai theksoi nevojën e krijimit të kushteve sa më të mira për punën e të gjithë atyre që janë pjesë e këtij sistemi shumë të rëndësishëm për shtetin, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri. Ai gjithashtu e çmoi shumë të rëndësishëm bashkëpunimin mes dy shteteve, me qëllim të shkëmbimit të përvojave, por edhe të arritjes së rezultateve në drejtim të përmirësimit të përgjithshëm të imazhit të shqiptarëve në botë, imazh, i cili mund të përmirësohet me shumë punë e jo me shumë fjalë, me një funksionim të tërësishëm të të gjitha segmenteve të shoqërisë sonë. Presidenti Pacolli, krahas bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave për aplikimin e standardeve të njëjta. **"Askush nuk mund të na pengojë të aplikojmë ligje dhe standarde të njëjta", tha presidenti Pacolli.** Ndërsa, Spahiu u shpreh se bashkëpunimi mes Kosovës dhe Shqipërisë në fushën e drejtësisë mund të intensifikohet dhe të zhvillohet edhe më tej. Spahiu gjithashtu shtroi nevojën e përmirësimit të sistemit të drejtësisë, duke e mbajtur atë larg ndikimeve politike, duke shtuar se vetëm sistemi i mirë i drejtësisë e pastron politikën. BS

### *Imazhi*

*Z. Spahiu shtroi gjithashtu çështjen e imazhit të shqiptarëve, për ngritjen e të cilit duhet dhe mund të bëhet shumë më shumë si nga politika ashtu edhe nga të gjitha fushat e tjera të funksionimit të shtetit.*

---

## **Presidenti Pacolli takon përfaqësuesit e tri shteteve afrikane**

---

Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli priti të mërkurën një delegacion të përfaqësuesve të tri shteteve afrikane: Republika e Afrikës Qendrore, Cape Verde ( Kepi i Gjelbër) dhe Kongo-Brazzavile, të kryesuar nga diplomati Dominique N'Gouabi Osser. Në një bisedë miqësore, Presidenti Pacolli i njoftoi ata për zhvillimet aktuale në vendin tonë, krijimin e institucioneve, si dhe sfidat që e presin Republikën e Kosovës në të ardhmen. Presidenti Pacolli theksoi se Kosova, si shtet i ri, ka nevojë për shumë miq dhe në këtë prizëm ajo ka një respekt të veçantë për popujt e Afrikës dhe dëshiron bashkëpunimin sa më të mirë me shtetet e këtij kontinenti. Temë dominuese e takimit ishte sigurimi i sa më shumë njohjeve për Kosovën. Presidenti Pacolli shprehu synimin e institucioneve të vendit tonë që sa më shumë shtete të Afrikës ta njohin vendin tonë. Ai gjithashtu u shpreh në të mirë të intensifikimit të marrëdhënieve me ato shtete që e kanë njohur vendin tonë, duke shkëmbyer vizita në nivelin politik, por edhe duke i hapur rrugë bashkëpunimit në fushën ekonomike dhe në fusha të tjera me rëndësi dhe me interes. BS

---

## **Pacolli -Wall: Të tejkalohet kriza ekonomike**

---

Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli priti të enjten në një takim Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Britanike, Gjeneralin Sir Peter Wall. "Mbretëria e Bashkuar është mike e madhe e Kosovës, është pjesë e suksesit të Kosovës, ndaj dhe gëzon respektin dhe falënderimet më të mëdha të popullit dhe të institucioneve të Republikës së Kosovës. Prezenca juaj në vendin tonë është shumë me rëndësi për ne", tha Presidenti Pacolli. Presidenti e njoftoi gjeneralin Wall dhe delegacionin që e shoqëronte me zhvillimet aktuale në vendin tonë, përmbylljen e procesit zgjedhor dhe krijimin e institucioneve të reja, por edhe për sfidat që i presin popullin dhe institucionet e vendit tonë në të ardhmen, sfida të cilat kërkojnë shumë punë dhe angazhimin e të gjithëve. Përveç aspektit politik, Presidenti Pacolli theksoi se Kosova është në gjendje shumë të vështirë ekonomike dhe duhet shtuar përpjekjet për tejkalimin e kësaj gjendjeje, me qëllim të përmirësimit sa më të shpejtë të jetës së qytetarëve. Një falënderim të veçantë Presidenti Pacolli i dedikoi ndihmës së vazhdueshme dhe shumë të madhe të ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), një ndihmë kjo shumë domethënëse dhe që vlerësohet shumë lart nga institucionet e vendit tonë. Gjeneralin Sir Peter Wall, pasi uroi Presidentin Pacolli për zgjedhjen në detyrën e re, tha se Mbretëria e Bashkuar e ka ndihmuar Kosovën që nga viti 1999 në të gjitha fushat. Ai tha se këtë e kanë bërë në bashkëpunim me kolegët nga NATO-ja, nga BE-ja, EULEX-i dhe kjo ndihmë do të vazhdojë edhe në të ardhmen, në të gjitha fushat. BS

### *Sfidat*

*Edhe gjenerali Wall theksoi se sfidat që ka përpara Kosova, janë sfidat ekonomike dhe Mbretëria e Bashkuar do të ofrojë ndihmën e saj në përballimin e këtyre sfidave.*

---

## Presidenti Pacolli ngushëlloi presidentin Barack Obama

---

Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli i ka dërguar një telegram ngushëllimi shkëlqesisë së tij Barack Obama, Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me rastin e vrasjes së dy pjesëtarëve të ushtrisë amerikane dhe plagosjes së dy të tjerëve, në aktin vrastar, të mërkurën në Frankfurt të Gjermanisë. **“Në emër të popullit dhe institucioneve të Republikës së Kosovës, ju shpreh ngushëllimet e mia më të thella familjeve dhe miqëve të viktimave, si dhe popullit të Shteteve të Bashkuara, përderisa ju vajtoni vdekjen e dy pilotëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës me 2 Mars. Jam i pikëlluar dhe i zemëruar nga ky sulm, i cili ua mori jetën dy amerikanëve dhe i plagosi dy të tjerë, dhe po lutemi për shërimin e shpejtë të atyre që janë plagosur. I tërë populli i Republikës së Kosovës shpreh njëzëri dhimbjen e tij për ata që e kanë humbur jetën”,** shkruan Presidenti Pacolli. “Këtë akt të tmerrshëm dhe të dhunës e dënoj në mënyrën më të fuqishme. Të dy ushtarët kanë luftuar dhe e kanë sakrifikuar jetën e tyre për vlerat universale të amerikanëve dhe të kombeve demokratike të tjera të botës, përfshirë Kosovën. Populli i Kosovës e kupton shumë mirë sakrificën dhe përkushtimin e ushtarakëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës që kanë shërbyer në Kosovë që nga viti 1999. Ekzistenca dhe siguria jonë është varur shumë nga këta trima, të cilët e kanë lënë jetën e tyre të rehatshme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të ndihmuar sigurinë dhe rindërtimin e Kosovës”, shkruan ndër të tjera në telegramin e ngushëllimit Presidenti Pacolli, përcjellë zyra për informim e Presidencës. Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli u nënshkrua të enjten në librin e zisë, të hapur në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, në përkujtim të dy pilotëve të SHBA-së, të cilët humbën jetën më 2 mars në Frankfurt. Në librin e zisë, Presidenti Pacolli, në emër të popullit të Kosovës, u shprehu ngushëllimet më të thella familjeve dhe popullit amerikan për jetët e humbura të dy pilotëve të vrarë në një akt makabër.



---

## **Presidenti Pacolli i shkroi presidentit të Gjermanisë, z. Wulff**

---


Me rastin e aktit vrastar që ndodhi të mërkurën në Frankfurt, Presidenti i Republikës së Kosovës iu drejtua me një letër Shkëlqesisë së Tij, z. Christian Wulff, President Federal i Gjermanisë. Në telegram, pasi shpreh ndjenjat e dhimbjes së popullit dhe të institucioneve të Republikës së Kosovës lidhur me aktin e rëndë që la dy të vdekur dhe dy të plagosur rëndë, Presidenti Pacolli thekson respektin e madh që qytetarët dhe institucionet e vendit tonë kanë për ushtarët dhe gjithë SHBA-në, për ndihmën që kanë dhënë për Republikën e Kosovës. "Ne u bashkohemi përpjekjeve për t'u ndihmuar autoriteteve gjermane që të kuptojnë si ka ndodhur ky akt mizor, në mënyrë që të gjithë autorët e krimit të sillen para drejtësisë ", shkruan, mes të tjerash, në letrën e tij, Presidenti Pacolli.

---

## Presidenti Pacolli priti Imzot Vincenzo Paglian, president i komunitetit “Shën Egjidio”

---

Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli priti sot në një takim Imzot Vincenzo Paglia, president i Komunitetit "Shën Egjidio" nga Italia, që ka qenë i pranishëm në Kosovë që nga viti 1994, me projektet e shumta në ndihmë popullit të Kosovës. Imzot Vincenzo Paglia përgëzoi fillimisht Presidentin Pacolli për zgjedhjen në krye të vendit. "Jam i lumtur që jam në Kosovën e lirë, të pavarur dhe me një president të ri", theksoi z. Paglia, gjithashtu përkujtoi miqësinë madhe që ka pasur me Presidentin historik të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, takimet e shumta me të, dhe shprehu gjithë admirimin për figurën e madhe prej politikani dhe intelektualit të Dr. Rugovës. Z. Paglia tha se komuniteti që ai drejton do të japë gjithë ndihmesën e tij në rrugën e integritit të Kosovës në Evropë. Duke u shprehur në të mirë të integritit dhe krijimit të kushteve për lëvizjen e lirë të ideve, qytetarëve e kapitalit, ai u shpreh se "aty ku kalojnë njerëzit, autobusët, kamionët, aty tanket nuk kanë vend". Në takim, edhe Presidenti Pacolli ka shprehur respektin e madh të tij për Presidentin historik, Dr. Ibrahim Rugova: **"Ne u kemi borxh Presidentit historik, Dr. Ibrahim Rugova dhe gjithë dëshmorëve që ranë për liri. Të gjithë e kanë ëndërruar një shtet të pavarur të Kosovës. Unë dua ta çoj në vend dëshirën e tyre"**, tha ai. Duke folur për punën e Komunitetit "Shën Egjidio", Presidenti Pacolli tha se ky fondacion dhe Imzot Paglia janë të njohur dhe të mirëpritur gjithnjë në Kosovë. **"Shën Egjidio" i ka ndihmuar popullit të Kosovës atëherë kur ai ka pasur nevojë më së shumti. Populli i Kosovës nuk e harron mbështetjen e fuqishme që i kanë dhënë kauzës së drejtë të Kosovës para dhe pas luftës"**, tha ai. Presidenti Pacolli ka folur në takim edhe për sfidat që e presin popullin dhe institucionet e Kosovës në ardhmen, ndërsa e quajti detyrë imediate zhvillimin ekonomik me qëllim të nxjerrjes së vendit nga pozita shumë e rëndë ekonomike në të cilën gjendet.



*Presidenti i Republikës së Kosovës Behgjet Pacolli pret në takim Imzot Vincenzo Paglia, president i Komunitetit "Shën Egjidio" nga Italia*

---

## Pasuria e Pacollit do të Publikohet

---

**Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit nuk është i kënaqur me gjykimin e korrupsionit, pasi që thotë se ende nuk është kapur asnjë "peshk i madh". Hasan Preteni e vlerëson domosdoshmëri ligjin për konfiskimin e pasurisë dhe ligjin antimafi, ndërsa thotë se pasuria e presidentit Behgjet Pacolli do të jetë publike**

Drejtori i Agjencisë, Hasan Preteni, në intervistë për "Tribuna Shqiptare", thotë se deklarimi i rregullt i pasurisë duhet të bëhet më së largu deri më 31 mars, ndërsa deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të rinjë shtetëror duhet të bëhet më së largu 60 ditë nga dita kur kanë marrë detyrën. Ai thotë se diku 20 për qind të deklarimit të pasurisë të vitit të kaluar janë kontrolluar detajisht, ndërsa janë gjetur shpërpjestime, papërputhshmëri dhe disa rritje jologjike. Nuk është i kënaqur për gjykimin e korrupsionit, pasi që thotë se ende nuk është kapur asnjë "peshk" i madh. Preteni e vlerëson dosmosdoshmëri ligjin për konfiskimin e pasurisë dhe ligjin antimafi, ndërsa thotë se pasuria e presidentit Behgjet Pacolli do të jetë publike.

**Tribuna Shqiptare: Kur është afati i fundit që zyrtarët publikë ta paraqesin pasurinë e tyre?**

**Hasan Preteni:** Ka katër lloje të deklarimit të pasurisë. Prej tyre është deklarimi i rregullt i pasurisë, që duhet të realizohet çdo vit deri më 31 mars. Pastaj kemi deklarimin e pasurisë pas marrjes së detyrës. Prej momentit kur e marrim detyrën dhe deri në momentin kur e deklarojnë pasurinë nuk guxojnë të kalojnë më shumë se 60 ditë. Kemi deklarimin e pasurisë pas largimit nga detyra dhe ai ka kohë një vit, prej atij momenti që është larguar nga pozicioni. Dhe deklarimi i katërt është sipas kërkesës së agjencisë. Kur diçka dyshojmë, është pjesë e hetimeve ose nuk e ka plotësuar formularin e pasurisë mirë, atëherë kërkojmë informacione shtesë. Tash jemi në këtë fazën kur konstituimi i institucioneve qendrore, parlamentit dhe qeverisë dhe të gjithë ata që kanë deklaruar vitin e kaluar pasurinë, kanë obligim ta deklarojnë deri më 31 mars. Të gjithë ata që e deklarojnë për herë të parë pasurinë është afat prej 60 ditësh. Sidoqoftë kemi mbajtur trajnime me pika të kontaktit të të gjitha institucioneve dhe jemi në kontakt me ta. Edhe nëpërmjet jush do të bëjmë publike edhe një herë një njoftim që këtë obligim ligjor ta kryejnë në afat të caktuar me ligj.

**Tribuna Shqiptare: A keni vërejtur se sa zyrtarë të rinj duhet këtë vit t'i paraqesin pasuritë e tyre?**

**Hasan Preteni:** Kjo është fazë e re, jemi në fazën e konsolidimit të listave. Javën e kaluar kemi mbajtur katër ditë trajnime me pikat e kontaktit. Janë më shumë se 130 institucione, prej nga të cilat zyrtarët më të lartë duhet ta deklarojnë pasurinë. Ne i kemi ato kontakte dhe trajnime dhe tani jemi në fazat e pritjes së emrave të tyre. Listat do të jenë gati në fillim të javës së ardhshme.

### **Tribuna Shqiptare: Sa janë reale pasuritë e paraqitura nga zyrtarët publikë?**

**Hasan Preteni:** Është një problem tjetër të cilin e kishim me zyrtarët nga viti 2007. Diferenca është që vetëm në vitin e kaluar janë bërë publike, kurse herave tjera kanë mbetur të mbyllura, kanë mbetur të njohura vetëm për agjencinë dhe mekanizmat tjerë që kanë për mision luftën kundër korrupsionit, sepse ne i japim ato, dhe nuk i mbajmë për vete, por në qoftë se janë pjesë e hetimeve ose objekt i interesimit të dikujt tjetër, ne i përcjellim. Në anën tjetër kam pritur shumë më shumë që qytetarët të bashkëpunojnë me agjencinë, dhe të reagojnë. Diku 20 përqind të deklaramit të pasurisë të vitit të kaluar i kemi kontrolluar në aspektin detaj, duke i krahasuar me të dhënat nga viti i kaluar ose disa të dhëna që i kanë paraqitur në Komisionin Qendror Zgjedhor. Aty na dalin disa shpërpjestime, disa papërputhshëmri, ka edhe disa rritje jologjike, mirëpo në mungesë të kodit të ligjeve dhe kodit penal, se kodi penal nuk sanksionon deklarimin e rrem, por disa informacione ne i kemi përcjellë edhe në qendrën e inteligjencës financiare por edhe disa raste i kemi përcjellë edhe në prokurorinë disiplinore që vepron pranë këshillit gjyqësorë të Kosovës.

### **Tribuna Shqiptare: Sa raste të korrupsionit janë paraqitur deri tash, po flasim për këta dy muaj të këtij viti?**

**Hasan Preteni:** Në këtë vit nuk kemi një evidencë, por do të jetë raporti që e kemi si obligim ligjor që do të dalë më 31 mars dhe këtë raport do ta përcjellim në kuvend. Në momentin kur e përcjellim raportin në Kuvend, po atë ditë ne e bëjmë publike dhe i thërrasim mediet dhe e publikojmë. Është çështje ditësh, ndoshta pas dy javësh do ta publikojmë. Mund të them se informacionet janë në rritje të vazhdueshme. Qytetarët po besojnë tek agjencia, po bashkëpunojnë me ne, po i përcjellim informacionet, ne po i përcjellim ato arsyetimet paraprake e kështu me radhë. Qytetarët në Kosovë po informohen për korrupsionin, por ai pak po hetohet, ndërsa nuk po gjykohet. Shpresoj që të kemi rezultatet më të mira edhe në atë drejtim, por sidoqoftë çështja e numrave do të bëhet publike ndërmjet 15 dhe 20 marsit.

### **Tribuna Shqiptare: Në vazhdimësi jeni ankuar në gjykata për shkak të neglizhencës në rastet e korrupsionit që ju i keni deponuar, si dhe lirimet që gjykata ju ka bërë presion personave të akuzuar për korrupsion. Si e vlerësoni këtë?**

**Hasan Preteni:** Jo, ne kemi atakuar prokurorinë vazhdimisht se mes gjykatave dhe agjencisë është prokuroria. Prokuroria është ajo që i trajton informacionet që ne i përcjellim. Në periudhën e kaluar i kemi pasur disa ankesa në bashkëpunim joreal dhe jokorrekt, duke mos na i kthyer përgjigjet, duke mos pasur atë "fidbekun", e çka po ndodh me fatin e informacioneve tjera. Në këtë strukturën e re, me emërimin e kryeprokurorit dhe kryegjykatësit dhe risitë tjera që i bënë Këshilli Gjyqësor i Kosovës, shihet një progres. Prokuroria ka përcaktuar një prokuror i cili do të jetë një koordinator në mes të prokurorisë dhe agjencisë. Edhe prokuroritë e qarqeve e kanë përcaktuar një prokuror i cili do të merret ekskluzivisht me veprimet dhe lëndët që kanë të bëjnë me korrupsionin. Nuk po caktoj shifra, por ne do të publikojmë se sa raste saktësisht i kemi përcjellë në prokurori edhe sa informata kthyese i kemi marrë. Ka një progres, ne e vlerësojmë një pozitivitet në këtë drejtim, angazhim më i mirë i prokurorisë dhe pastaj do të shohim se cka do të bëhet gjykata. Sa po gjykohet, kjo është vetë fakti, që me këtë korrupsion,

me këtë prani të korrupsionit në masë shqetësuese, ende nuk është trajtuar asnjë rast i zyrtarëve të lartë ose më mirë të themi nuk është zënë asnjë "pëshk i madh". Kështu që nuk jemi të kënaqur as ne, e as qytetarët e Kosovës. Askush prej institucioneve nuk mund të mburret për rezultatet dhe sukseset në këtë drejtim, por gjithsesi ne nuk duhet të dalim vetëm me konstatime, do të punojmë që shifrat të dëshmojnë të kundërtën. Një prej rekomandimeve të vazhdueshme të cilin jam duke e bërë dhe do ta rekomandoj edhe në raportin përfundimtar, është që të kemi edhe disa ligje tjera. Në rend të parë, flas për ligjin për konfiskim të pasurisë, pastaj ligjin antimafia, etj.

**Tribuna Shqiptare: Ne kemi agjencinë kundër korrupsionit dhe ligjin për deklarimin e pasurisë, por nuk e kemi ligjin për konfiskim të pasurisë. Sa është efikase AKK dhe ligji për deklarim të pasurisë pa ligjin për konfiskim?**

**Hasan Preteni:** Një prej rekomandimeve të vazhdueshme të cilin jam duke e bërë dhe do të rekomandoj edhe në raportin përfundimtar, është që të kemi edhe disa ligje tjera. Në rend të parë, flas për ligjin për konfiskim të pasurisë. Është e vërtetë që në kodin penal në disa nene është përcaktuar, mirëpo e jetësuar kurrë. Unë vlerësoj se duhet të ketë ligj të veçantë për konfiskim të pasurisë, pastaj ligji antimafia i cili është folur se do të procedohet. Është shumë me rëndësi një element për të cilin nuk ka nevojë të krijohen ligje të reja, por kodi penal të begatohet me disa nene të tjera, ku kemi të bëjmë për barrën e provës. Kemi shumë raste kur kemi prova që e deklarojnë pasurinë ose nuk e deklarojnë pasurinë shumë titullare, sepse e bartin në emra të tjerë dhe me legjislacionin në fuqi duhet që institucionet e shtetit të dëshmojnë që ajo pasuri u krijua në mënyrë të paligjshme. Mendoj se duhet të marrim praktika nga shtetet përreth që barra e provës të jetë te qytetarët. Praktikisht që në institucionet e shtetit të largohemi prej asaj dhe të bindemi që ajo pasuri nuk është krijuar në mënyrë të paligjshme, por në anën tjetër zyrtari duhet të dëshmon se si e ka fituar atë pasuri. Kjo do të ndihmonte që lufta kundër korrupsionit të jetë më e suksesshme. Në vitet në vijim do të tentojmë që kjo pjesë të fuqizohet. Duhet të them se Maqedonia me asnjë strukturë nuk i afrohet Kosovës, vetëm vitin e kaluar nga kolegët e mi kam dëgjuar që diku kanë konfiskuar rreth 30 milion euro pasuri që është krijuar në mënyrë të paligjshme. Ne këtu e shohim që zyrtarët po pasurohen brenda natës, por sanksione nuk po ka.

**Tribuna Shqiptare: Si e vlerësoni luftën kundër korrupsionit që nga themelimi i AKK-së?**

**Hasan Preteni:** Para pes vjetësh lufta kundër korrupsionit shihej si tabu-temë, tash përfundimisht nuk është. Janë bërë disa lëvizje, është krijuar agjencia dhe të gjitha mekanizmat tjerë përcjellës, por këto institucione duhet të fuqizohen. Së pari si prioritet duhet të forcohen ligjet, mëpastaj mekanizmat të pavarësohen, të kenë buxhet të mjaftueshëm dhe në fund të kërkohet llogaridhënie nga këto institucione. Nuk mjafton të pranosh që të kryesh një detyrë më pastaj të heshtësh, por parlamenti duhet të jetë ai që i detyron udhëheqësit e institucioneve që të raportojnë për punën e vet dhe përfundimisht ata që punojnë të vazhdojnë më tej e ata që nuk sjellin rezultatet të ndërrohen.

**Tribuna Shqiptare: A do të duhet që presidenti Behgjet Pacolli ta paraqesë këtë vit pasurinë e tij, kur dihet se në vitin e kaluar nuk e ka bërë këtë?**

**Hasan Preteni:** Presidenti i tanishëm e ka deklaruar rregullisht pasurinë e vet, mirëpo kërkesa e tij në vitin e kaluar ka qenë që të mos publikohet. Se a është me ligj apo jo, kjo është një konfuzion i krijuar. Atëherë është kërkuar që të mos publikohet pasuria e Pacollit, duke u kthyer në ligjin për qasje në dokumentet zyrtare, i cili shkon në favor të mospublikimit, kurse ligji për deklarimin e pasurisë e obligon. Të gjitha ato shkresa që kemi bërë me Pacollin kanë qenë publike dhe janë në uebfaqen tonë, mirëpo këtë vit kjo nuk do të ndodhë. Zyrtarët e agjencisë kanë takuar edhe presidentin Pacolli dhe i kanë ofruar mundësitë ligjore ose i kanë interpretuar se cilat do të jenë aktivitetet e tij. Mendoj se një gjë e tillë do të evitohet për këtë vit dhe sinjalet e para janë që nuk do të kemi probleme me këtë.

---

## Nëse shkon Pacolli, bie Qeveria

---


**Nëse vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk i lë derë tjetër Pacollit, pos që të ikë nga presidenca, ai do të largojë nga qeveria edhe AKR-në. Por, dialogu me Serbinë, duket të jetë drita në fund të tunelit për mbijetesën e këtyre institucioneve**

Në rastin Pacolli, PDK, do të pajtohej që AKR - ja të vazhdonte të drejtonte postin e presidentit me një kandidat tjetër vetëm që kjo parti të mos tërhiqej nga qeveria. Madje, edhe Pacollit, thuhet se do t'i ofrohej posti i zëvendëskryeministrit vetëm e vetëm që qeveria dhe koalicioni të mbeten të paprekura. Përkah ana legale e legjitime, gjërat nuk shkojnë në favor të Pacollit, pavarësisht se për procedurat e zgjedhjes së tij besohet se do të fajësohet kreu i Kuvendit, i cili mban përgjegjësinë për drejtimin e seancave. Ndërkaq, shkelja e Pacollit ka të bëjë me votën e tij për qeverinë pas betimit si president, ndonëse për këtë çështje ai nuk ka ende ndonjë padi në Gjykatën Kushtetuese nga ana e opozitës. Gjithashtu, te rasti Pacolli thuhet se nuk do të ishte mirë që në çdo rrethanë dhe në çdo rast të përsëritet forma e largimit si në rastin e Sejdiut. Të njëjtat burime besojnë se opozita tani është më e fuqishme dhe do të insistojë që Pacolli në rast se duhet të përballet me këtë sfidë, të mos e ofrojë dorëheqjen siç bëri Sejdiu, por t'i nënshtrohet shkarkimit në Kuvend. E shkarkimi i një presidenti mund të bëhet vetëm me dy të tretat e votave. Por, për Pacollin duket se ende ka një dritë në fund të tunelit. Të njëjtat burime kanë thënë po ashtu se ai dhe koalicioni kanë mbështetjen politike ndërkombëtare që të vazhdojnë tutje mandatin. Komuniteti ndërkombëtar, është lodhur tashmë me krizën institucionale dhe paqëndrueshmërinë e institucioneve të shtetit më të ri. Gjithashtu, pjesa evropiane e këtij komuniteti pret me padurim diplomacinë e vet, duke nisur njërin që të dëshmojë një sukses në procesin e dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, me shpresën se do t'i arrijë disa efekte politike. Së pari, duke i ruajtur qëndrueshmërinë sado të brishtë të institucioneve të Kosovës, një pjesë e komunitetit ndërkombëtar, synon që të ulë në tavolinë Prishtinën dhe Beogradin dhe nga dy vende me raporte armiqësore të arrijë një paqe çfarëdo qoftë ajo, por që siguron të paktën një bashkëpunim tej kufitar në fushën e luftimit të krimit të organizuar, ku implikohen të dyja shtetet. Kurse premia e këtij dialogu, besohet të jetë çështja e veriut dhe ajo që komuniteti ndërkombëtar e cilëson si ofertë atraktive për veriun, e që për kosovarët po nënkuptohet si një status special për këtë pjesë. Duke e nxjerrë një autonomi për veriun, Brukseli besohet se do ta ndihmonte në radhë të parë Beogradin në rrugën e vet drejt BE - së dhe forcat politike përreth presidentit Tadiq, i cili duket të jetë ende i vetmi politikan serb që preferohet sado pak nga ndërkombëtarët, pasi që pjesa tjetër e spektrit politik serb është e zhytur në nacionalizëm dhe ka një orientim pro rus. Duke i vërejtur tendencat e një pjese të faktorit ndërkombëtar që Tadiq dhe forcat rreth tij që duke u fshehur pas dialogut me Kosovën dhe në krah të statusit të pjesës veriore të sigurojnë perspektivën evropiane dhe një mandat të ri qeverisës në Serbi, i kanë cilësuar këto bisedime si të dëmshme për Kosovën dhe ekskluzivisht të përgatitura vetëm për interesa të Serbisë.



## Pacolli i fton vendet afrikane të na njohin

Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli priti sot një delegacion të përfaqësuesve të tri shteteve afrikane: Republika e Afrikës Qendrore, Cape Verde (Kepi i Gjelbër) dhe Kongo-Brazavile, të kryesuar nga diplomati Dominique N'Gouabi Osser. Presidenti Pacolli i njoftoi ata për zhvillimet aktuale në vendin tonë, krijimin e institucioneve, si dhe sfidat që e presin Republikën e Kosovës në të ardhmen. Ai theksoi se Kosova, si shtet i ri, ka nevojë për shumë miq dhe në këtë prizëm ajo ka një respekt të veçantë për popujt e Afrikës dhe dëshiron bashkëpunimin sa më të mirë me shtetet e këtij kontinenti. Temë dominuese e takimit të sotëm ishte sigurimi i sa më shumë njohjeve për Republikën e Kosovën. Presidenti Pacolli shprehu synimin e institucioneve të vendit tonë që sa më shumë shtete të Afrikës ta njohin vendin tonë. Ai gjithashtu u shpreh në të mirë të intensifikimit të marrëdhënieve me ato shtete që e kanë njohur vendin tonë, duke shkëmbyer vizita në nivelin politik, por edhe duke i hapur rrugë bashkëpunimit në fushën ekonomike dhe në fusha të tjera me rëndësi dhe me interes.



*Behgjet Pacolli pret në takim një delegacion të përfaqësuesve të tri shteteve afrikane: Republika e Afrikës Qendrore, Cape Verde (Kepi i Gjelbër) dhe Kongo- Brazavile, të kryesuar nga diplomati Dominique N'Gouabi Osser*

---

## Zgjedhja e Pacollit mund të anulohet

---

Gjykata Kushtetues e Kosovës ka nisur në drejtim të krerëve të shtetit, Behgjet Pacolli e Jakup Krasniqi, kërkesën që brenda 15 ditësh t'i dorëzojnë Kushtetueses versionet e tyre lidhur me procedurat e votimit për zgjedhjen e presidentit më 22 shkurt. Kryetari i Gjykatës Kushtetueses, Enver Hasani ka thënë nuk do të paragjykojë për vendimin, por sipas tij, Gjykata ka para vetes dy opsione: të thotë se ka shkelje për këtë arsye apo atë ta hedhë poshtë për shkak të vakumit të mundshëm ligjor. "Nëse vërtetohet se ka pasur shkelje të Kushtetutës, atëherë procedura duhet të kthehet nga pika zero. Me këtë nënkuptohet se presidenti nuk ka nevojë të japë dorëheqje, por duhet t'i kthehet edhe një herë garës në Kuvend", është shprehur kryetari i Gjykatës Kushtetueses për KTV-në.

## Vota antikushtetuese e Pacollit mbetet në procesverbal

**Një tentativë e partnerëve të koalicionit për të "shlyer" votën antikushtetuese të presidentit Pacolli për Qeverinë e Kosovës ka dështuar, pas kundërshtimit të deputetëve dhe kryetarit të Kuvendit**

Grupi parlamentar i AKR-së, nëpërmes kryetarit Ibrahim Makolli, në seancën e parë të rregullt të legjislaturës së katërt, që i zhvilloi punimet të enjten, ka provuar që me një votë formale të deputetëve ta korrigjojë dhe ta bëjë të paqenë shkeljen Kushtetuese të ish kreut të AKR-së, Behgjet Pacollit, i cili në seancën e 22 shkurtit, ndonëse i zgjedhur për president të Kosovës, kishte shfrytëzuar edhe një mundësi joligjore të votimit për kabinetin qeveritar. Shefi i grupit parlamentar të AKR-së kërkoi në fillim të seancës së djeshme që nga transkripti i seancës së kaluar dhe nga procesverbali të shlyhet konstatimi, sipas të cilit Qeveria e Kosovës është zgjedhur me 65 vota, por në vend të këtij konstatimi të dalë formulimi tjetër, sipas të cilit kabineti qeveritar të konsiderohet i zgjedhur me 64 vota, kurse vota e presidentit Pacolli, që është votë në kundërshtim me Kushtetutën, të shpallet si votë e pavlefshme. Kjo kërkesë e Makollit është pritur me habi dhe me kundërshtim të fuqishëm edhe nga kryeparlamentari Krasniqi, por edhe nga deputetët e opozitës, AAK-së dhe LDK-së, të cilët nuk hezituan të polemizojnë me Makollin. "Nëse dikush dëshiron me ia përkthyer se çka tha z. Makolli, është kështu: Ne e kemi bërë, por po e shkruajmë që se kemi bërë, publikisht dhe para kamerave, në transmetim të drejtpërdrejtë! Z. Makolli çka kishe bërë t'i sikur personi në fjalë të mos ishte bërë president, si do të kishe reaguuar. Nuk guxon Kuvendi që në mbledhjen e vet të dytë të thotë se po e shkruajmë që nuk e kemi bërë, edhe pse e kemi bërë, sepse e ka parë krejt populli, sepse ka qenë në transmetim të drejtpërdrejtë", tha Gjini, duke reaguuar ndaj një insistimi të tillë. Ky reagim i Gjinit ka provokuar replikën e Makollit, i cili përsëri provoi ta arsyetojë kërkesën. "Faleminderit shumë për përkthimin kolegë. Nuk e kam ditur që po flas me përkthyes, por faleminderit shumë. Nuk e thash që të mos numërohet, por që të mos numërohet si votë e vlefshme, që ka shumë dallim prej asaj që u interpretua, që të mos jetë votë e vlefshme, sepse nuk mund të jetë votë e vlefshme", tha Makolli. Mirëpo, më këtë ndërhyrje sqaruese përsëri nuk është pajtuar Gjini, i cili tha se shefi i grupit parlamentar po flet krejtësisht përçartë në këtë kërkesë të tijën. "Kur flitet përçartë ka nevojë për përkthim. Z. Makolli kërkoi të ndërrohet transkripti dhe procesverbali. Z. Makolli nuk tha që ne po themi se nuk bën të përdoret e vlefshme vota e zotit Pacolli, kërkoi me ndërruar transkriptin. Ndryshimi i transkriptit është me shkruar çka nuk ka qenë. Transkripti e transmeton atë që ka ndodhur në Kuvendin e Kosovës dhe ndërrimi i transkriptim, nganjëherë po më duket se ka nevojë për përkthim, është që të themi ne hajde të themi çka nuk ka qenë", është kundërpërgjigjur Gjini.

## **Krasniqi kundërshton Kuçin**

Në këtë mes ka ndërhyrë që ta sqarojë pozicionin edhe kryeparlamentari Krasniqi, i cili tha se ajo vërejtje nuk ia vlen të përfillet. "Konstatoj se vërejtja nuk ishte për ta ndryshuar, prandaj konstatoj se procesverballi mbetet ai i mbledhjes së 21 dhe 22 shkurtit 2011... jeni dakord?". Me konstatimin e kryeparlamentarit Krasniqi nuk është pajtuar as Qeveria e Kosovës, e cila nëpërmes zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Drejtësisë, Hajredin Kuçit, ka provuar ta mbështesë kërkesën e Makollit, për të cilën paraprakisht Krasniqi bëri me dije se është një tentativë e kotë. "Qeveria urdhëro. Mund ta japë një sqarim, por procesi nuk mund të ndryshohet", tha Krasniqi. Kuçi provoi ta thotë atë që pastaj nuk kaloi me votat e deputetëve. "Mendoj që sqarimi është në këtë drejtim. Besoj që së pari Kuvendi nuk e ka kompetencën për të miratuar transkriptin dhe nuk po kërkon askush për ta ndryshuar transkriptin dhe nuk është pikë e rendit të ditës. Sa i përket procesverballit, askush nuk do të kërkojë që të thuhet se nuk kanë votuar 65 veta, por administrata e Kuvendit është dashur ta thotë 64 janë të vlefshme. Ky është ndryshimi që duhet të jetë. Dhe, tek e fundit, miratimi i procesverballit në fund shkohet me vota", tha Kuçi. Pas këtij sqarimi ndërhyrës nga z. Kuçi kryeparlamentari Krasniqi e vendosi në votim kërkesën e Makollit me sqarimin e Kuçit që t'i hapet rrugë administratës ta bëjë një ndërhyrje të tillë, por deputetët nuk e votuan këtë kërkesë. "Konsideroj që shumica ishte kundër dhe procesverballi mbetet ashtu sikur që ka qenë", tha Krasniqi. I kontaktuar nga gazeta, edhe shefi i grupit parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, tha se ky insistim i partnerëve të koalicionit qeverisës, që ta bëjnë të paqenë votën antikushtetuese të Pacollit për Qeverinë e Kosovës, që është një shkelje e Kushtetutës, është edhe një veprim joserioz i radhës, për të cilin nuk dëshiron të bëjë komente të thella, pasi që shumë shkelje kushtetuese procedurale janë në dorë të Gjykatës Kushtetuese, në dosjen e dorëzuar ditë më parë. "Unë nuk dëshiroj sinqerisht që të komentoj asgjë rreth procedurave, rreth kushtetutshmërisë apo rreth ligjshmërisë së zgjedhjes së institucioneve. Atë që LDK - ja ka pasur për ta thënë e ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese. Kjo po vërehet se ishte një veprim joserioz, por ne tash po ia lëmë Gjykatës Kushtetuese. Duhet të merret kjo gjykatë tash dhe jo ne si LDK ", tha Ismet Beqiri. S. AHMETI

---

## President të ri për Kosovën

---

**Derisa njeriu më i pasur i vendit merr detyrën, rrëmuja politike u shtohet mjerimeve të vendit më të varfër në Europë.**

Muajt e fundit kanë qenë një katastrofë për Kosovën. Vërshuan akuzat për mashtrim të zgjedhjeve të përgjithshme të dhjetorit, pjesa më e madhe në sy të monitoruesve evropianë. Negociatat me Serbinë janë shtyrë. Duke konkluduar një hetim, raportuesi i Këshillit të Evropës, Dick Marty, bëri bashkë një mal kritikizmi për lideret e vendit dhe solli besim të ri ndaj pretendimeve se luftëtarët shqiptarë ishin të përfshirë në trafikim të organeve gjatë konfliktit në vitin 1999. Kjo rrëmuje e ditëve të fundit nuk ndihmon. Kosova, vendi më i varfër në Evropë, ka një president të ri, i cili është edhe qytetari më i pasur. Behgjet Pacolli një magnat i industrisë së ndërtimit, ka pritur për një kohë të gjatë për arritjen e këtij qëllimi. Por parlamenti ka arritur ta aprovonte emërimin e tij në përpjekjen e tretë gjatë javës së kaluar, pasi partitë opozitare vendosën ta bojkotonin votimin. Ai më në fund ia doli me sukses pas një marrëveshjeje ndërmjet partisë së tij të vogël, Aleancës për Kosovë të Re (AKR), dhe Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), e prirë nga kryeministri Hashim Thaçi, i cili do të shërbejë në katër vjetët e ardhshëm. Qeveria është aprovuar me një shumicë të ngushtë, me 65 vota prej 120 ulëseve të Parlamentit. "Pa këtë marrëveshje do të kishte një problem real, ku do të mbaheshin zgjedhje brenda gjashtë javësh", ka deklaruar një zyrtar i lartë evropian. "Nuk kishte entuziazëm për këtë zgjidhje". Nën presion të konsiderueshëm nga Brukseli për t'i dhënë fund krizës politike në Kosovë, Thaçi ishte i detyruar të bënte koncesione. Përveç postit presidencial, ai po ashtu ia dha AKR - së edhe tri poste ministrore dhe postin e zëvendëskryeministrit. Për shkak të largimit, një serb do të emërohet si zëvendësim në këtë pozitë. Marrëveshja politike shkaktoi një tension të konsiderueshëm në mes të përkrahësve të kryeministrit. Pacolli është "zgjedhja më e keqe e mundshme", tha Fatmir Limaj, nënkryetar i PDK - së dhe ish - ministër i Transportit dhe Telekomunikacionit. Ai kohëve të fundit është duke u hetuar nga misioni i EULEX - it, i cili po konsolidon sundimin e rendit dhe ligjit në Kosovë. Pacolli, i cili i prin konglomeratit ndërtimor "Mabetex", me bazë në Lugano të Zvicrës, ishte në krye të lajmeve në Rusi në fund të viteve nëntëdhjetë. Grupi kishte fituar një kontratë për ta rinovuar Kremlinin dhe ndërtesat e tjera qeveritare nga Departamenti i çështjeve presidenciale, por ishte akuzuar për korrupsion të zyrtarëve të lartë rusë. Ishte skandali më i madh i viteve përmbyllëse të regjimit të Yeltsinit. "Mabetex" për këtë arsye filloi që të kërkonte punë jashtë, në veçanti në Kazakistan, ku punoi në disa projekte të mëdha publike. Në vitet e kaluara, një nga sponsorizuesit kryesorë të saj ishte koloneli Gaddafi. Më 2006, Pacolli vendosi të kthehej në shtëpi dhe të marrë pjesë në politikën kosovare. Ai beson në fuqinë e ekonomisë, duke e vënë në pah suksesin e vet në biznes. Megjithatë, insistimi i tij në promovimin e dialogut të drejtpërdrejtë midis Kosovës dhe Serbisë rreth çështjes së statusit të kësaj të parës, pa ndërmjetësimin e jashtëm, ka ngritur dyshime. "Pacolli konsiderohet një rrëfim i gjallë suksesi, një njeri që vetë ka arritur aty ku është, mirëpo qytetarët nuk janë të lumtur rreth lidhjeve të tij me Rusinë", sqaron një burim evropian në Prishtinë. Disa analistë janë të dyshimtë se sa do të zgjasë dyshja Pacolli - Thaçi, posaçërisht pasi që reputacioni i kryeministrit në bashkësinë ndërkombëtare është njollosur nga raporti i Këshillit të Evropës. Beogradi është duke kërkuar hetim ndërkombëtar, nën ombrellën e OKB - së. "Tani për tani ato janë vetëm akuza, mirëpo

për kryeqytetet evropiane gjendja është shumë e qartë”, thotë Verena Knaus, specialiste për Kosovën. "Ata janë skeptikë sa i përket mbështetjes së Thaçit. Kjo vjen në një kohë shumë të papërshtatshme, pak para fillimit të bisedimeve me Serbinë, në të cilat besueshmëria do të jetë faktor i rëndësishëm". Negociatat e para direkte midis –Prishtinës dhe Beogradit, të shumëpritura nga Brukseli, mund të fillojnë kah mesi i marsit. Gjatë bisedimeve do të trajtohen aspektet e rëndësishme të përditshmërisë së shqiptarëve dhe serbëve të veriut të Kosovës, si rryma e uji. Serbia, e cila shpreson që këtë vit ta sigurojë pranimin zyrtar për përpjekjet rreth anëtarësimit në BE, e di se Brukseli është duke insistuar rreth dialogut. Megjithatë, ky shtet ka probleme të tjera serioze, derisa është rritur pakënaqësia prej së cilës mund të përfitojnë forcat nacionaliste.

---

## Në rivotimin e mundshëm, Pacolli s'i ka të 62 votat

---

**Deputetët e PDK-së, Hydajet Hyseni e Nait Hasani, të cilët kanë zëvendësuar në Kuvend ata që kanë shkuar në ekzekutiv, nuk do ta mbështesin Pacollin në rast të Rivotimit për president, kanë thënë burime të gazetës. Në rast se Kushtetuesja thotë që është shkelur Kushtetuta, sipas kreut të Gjykatës, rivotimi është i pashmangshëm.**

Behgjet Pacolli ka dy mbështetës më pak në Kuvendin e Kosovës sesa që kishte në raundin e tretë të seancës së 22 shkurtit, kur është zgjedhur president. Deputetët e PDK - së, Hydajet Hyseni e Nait Hasani, të cilët kanë zëvendësuar në Kuvend deputetët që kanë shkuar në ekzekutiv, nuk do ta mbështesin Pacollin në rast të rivotimit për president, kanë thënë të premtën burime të gazetës. Prandaj, sipas këtyre burimeve, edhe nuk mund të llogarisë në votën e tyre në rast se Gjykata Kushtetuese jep verdiktin për përsëritje të votimit të presidentit për shkak të shkeljes së procedurave, siç kanë pretenduar 34 deputetë të opozitës. Ndërkohë, kryetari i kësaj Gjykate, Enver Hasani, ka paralajmëruar të enjten në KTV që "nëse themi është shkelur (Kushtetuta v.j.) përsëriten procedurat e zgjedhjes së presidentit". Kushtetuesja do të japë përgjigje brenda shtatë javësh. Hydajet Hyseni nuk ka thënë troç se nuk do ta jepte votën për Pacollin, nëse procedura e zgjedhjes së presidentit kthehet në rivotim, por këtë e ka lënë të nënkuptueshme. Ai ka shtruar nevojën që presidenti të jetë personalitet që gëzon mbështetje të gjerë dhe që përfaqëson unitetin e popullit, e që nuk ka qenë rasti me Pacollin. "Nuk kam ndonjë opinion të veçantë të (për z. Pacolli v.j.). Për mendimin tim ajo që është thënë edhe me Kushtetutë që presidenti i vendit duhet të jetë faktor uniteti i popullit, nënkupton që të ketë edhe besimin e gjerë. Presidenti në vende të ndryshme zakonisht është figurë konsensuale që zgjidhet me konsensus edhe të pozitës e edhe të opozitës", ka thënë Hyseni. "Mendoj që Kosova nuk duhet të jetë përjashtim". Të martën Pacolli është konfirmuar president nëpërmjet një procesi votimi në Kuvend që e ka bojkotuar opozita dhe që mezi është mbështetur nga të gjithë deputetët e partive në pushtet. Ai është vënë në krye të shtetit me votat e vetëm 62 prej 120 deputetëve. Këtë mbështetje e ka fituar tek në raundin e fundit, pasi që në të parin kishte marrë 54 vota, kurse në të dytin vetëm 58 sosh. Deputeti Hyseni ka thënë se nuk do t'i bindej kurrfarë presioni sa i takon orientimit të votës së tij. Ai ka theksuar të jetë betuar për të katërtën herë që në misionin e deputetit të popullit t'i përmbahet asaj që është interes i popullit, që është interes i vendit dhe që është edhe obligim kushtetues. Kjo, sipas tij, nënkupton që deputeti të jetë i pavarur në vendimmarrjen e tij dhe, siç thuhet shprehimisht në Kushtetutë, të mos i nënshtrohet asnjë mandati detyrues. "Prandaj edhe unë jam i bindur që në vendimmarrjen time do të jem i pavarur dhe pa iu nënshtruar kurrfarë ndikimi", ka shpjeguar Hyseni. "Konform këtij obligimi do të ishte edhe votimi im për këtë çështje dhe për të gjitha çështjet". Deputetët e PDK - së i janë nënshtruar presionit të kryeministrit për të votuar Pacollin, pas dy raundesh që hezitonin ta bënin një gjë të tillë. Kryeparlamentari Jakup Krasniqi, që është sekretar i përgjithshëm në PDK, ka treguar publikisht se deputetëve u ishte thënë se po s'e votuan nuk do të futeshin në listën e kandidatëve për deputetë në zgjedhjet e reja të parakohshme që do të impononte mosvotimi. Vetë Krasniqi ka deklaruar se ka qenë midis 4 deputetëve të PDK - së që s'ia ka besuar votën Pacollit. Ngjashëm ka thënë edhe Fatmir Limaj, nënkryetar i PDK - së dhe njeriu më i votuar, pas Thaçit në këtë parti. Nait Hasani, ndonëse nuk ishte deputet me rastin e votimit

të presidentit, kishte kundërshtuar zgjedhjen e bërë. Ky anëtar i Kryesisë së PDK - së, që tash është bërë deputet, ka deklaruar se Pacolli nuk e përfaqëson unitetin e qytetarëve të Kosovës dhe se fuqia e AKR - së në Kuvend do të jetë shumë e dobët. Edhe ai pati pranuar se kryeministri Thaçi ka insistuar të deputetët e PDK - së të ndryshonin qëndrimin e tyre dhe ta votonin Pacollin për president në rundin e tretë të votimit. E deputetët që votuan për Pacollin, sipas Hasanit, nuk kanë as dinjitet të mirëfilltë. Tash, kur është ngritur dilema se procedura e zgjedhjes së presidentit mund të përsëritet, Hasani ka thënë se mban qëndrimin e mëhershëm. Megjithatë, ai ka shprehur besimin se votimi për presidentin nuk do të përsëritet, pasi ka konsideruar që kjo do të përbënte një shkelje tjetër. "Nuk ka, mundësi që Gjykata Kushtetuese ta kthejë çështjen në Kuvend. Nëse kjo ndodh, ajo e bën një shkelje të dytë, që ata që e kanë zgjedhur nuk janë aty që ta zgjedhin prapë. Nëse e kthen çështjen në Kuvend, duhet të shkohet në zgjedhje të reja", ka thënë deputeti Hasani. "Megjithatë, unë e kam dhënë deklaratën time dhe nuk kam ndërruar dhe nuk ndërroj qëndrim". Mirëpo, në rast se Kushtetuesja konstaton se në këtë rast nuk ka pasur shkelje të procedurave, atëherë është edhe një çështje tjetër që pritet ta adresojë opozita-shkeljen e Kushtetutës nga presidenti Pacolli, i cili kishte votuar për Qeverinë në cilësinë e deputetit, pasi kishte filluar ti rrjedhë atij funksioni i presidentit. Ushtrimi i dy funksioneve publike nga presidenti kualifikohet si shkelje e rëndë e Kushtetutës, për çka Kuvendi obligohet ta shkarkojë presidentin. Qeveria e Kosovës s'ia ka dalë të enjten në tentativën e saj për ta zhvlerësuar votën që ka marrë nga ai. Shumica e deputetëve votuan kundër propozimit të deputetit të AKR - së, Ibrahim Makolli, për të zhvlerësuar votën e Pacollit. Madje propozimi nuk ka gjetur përkrahje as te deputetët e partive në pushtet, ani se propozimi kishte mbështetjen e Qeverisë. Propozimin Makolli e ka arsyetuar në këtë formë: "Në faqen 33 të transkriptimit, ose në vendimin për votimin për Qeverinë, nëse nuk gaboj dhe do të duhej të konsultohesh mirë kjo pjesë, më duket që kryesuesi i seancës e ka ftuar presidentin ose është deklaruar që presidenti nuk është në sallë, dhe po ashtu kemi 65 vota për Qeverinë". Kryeparlamentari Krasniqi i është kundërpërgjigjur të premtën deputetit Makolli. Ka thënë se përmbajtja e arsyetimit që ka dhënë Makolli në seancë nuk është e vërtetë. "(Nuk është e vërtetë v.j.) as njëra e .. as tjetra. Unë nuk e kam ftuar. Në fund të seancës, kur kam dashur t'ia uroja presidentit detyrën dhe kabinetit qeveritar bashkë, nuk ka qenë. Kjo ka qenë ajo që e kam thënë emrin e presidentit, por jo pse e kam ftuar për të votuar", ka thënë Krasniqi. "Kjo është e vërteta. Mund të shikohet. Edhe në transmetim ka qenë ajo".



---

## Kuvendi “legalizon” votën e presidentit

---

**Vota e presidentit Behgjet Pacolli për qeverinë e re është kërkuar që të shpallet e pavlefshme nga AKR-ja. Ata kanë kërkuar që të ndryshohet procesverbali i seancës kur është votuar qeveria dhe të thuhet që kanë qenë 64 vota për Qeverinë, e jo 65, siç është votuar në seancën e Kuvendit të 22 shkurtit. Por një gjë e tillë nuk u miratua nga deputetët.**

Aleanca Kosova e re ka kërkuar nga Kuvendi i Kosovës që vota e presidentit të Kosovës Behgjet Pacolli për Qeverinë “Thaçi 2” të shpallet e pavlefshme. Kjo parti ka kërkuar të ndryshohet procesverbali i seancës kur është votuar qeveria e re. Shefi i Grupit Parlamentar të AKR-së Ibrahim Makolli, ka thënë se në procesverbal duhet të thuhet që kanë qenë 64 vota për Qeverinë, e jo 65, siç është votuar në seancën e Kuvendit të 22 shkurtit, për shkak se vota e Pacollit si president ka qenë e pavlefshme. Por, në anën tjetër, shefi i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini, ka thënë se kjo që po kërkohet është ‘nonsens’, ngase nuk mund të thuhet se nuk ka ndodhur diçka që në fakt ka ndodhur dhe e kanë parë edhe qytetarët direkt nëpërmjet televizorit. Replika në mes të Ibrahim Makollit e Ardian Gjinit ka vazhduar disa herë, derisa edhe kryeparlamentari Jakup Krasniqi ka pasur replikë të vogël me Zv /kryeministrin Kuçi ka thënë se nuk po kërkohet që të ndryshohet transkripti, por procesverbali dhe se një gjë e tillë duhet të bëhet përmes votës së deputetëve. Megjithatë, votat e shumicës së deputetëve kanë rezultuar të mos jenë në favor të kërkesës së Kuçit e Makollit, ngase me shumicë votash në procesverbalin e seancës së 22 shkurtit ka mbetur edhe Vota e Behgjet Pacollit për Qeverinë e Kosovës. Kjo mund të përdoret si një fakt shtesë i legjitimuar nga Kuvendi, për dyshimet për shkeljen e Kushtetutës nga ana e presidentit Pacolli, i cili me të dhënë betimin e deputetit, është dashur që t’i pushojnë të gjitha funksionet tjera. Por Pacolli ka ngritur dorën kur është votuar për Qeverinë “Thaçi 2”, pasi që kishte dhënë betimin e presidentit. Ndryshe, Partitë opozitare kanë paralajmëruar se mund ta dorëzojnë në Gjykatën Kushtetuese edhe çështjen e votimit të presidentit Pacolli për interpretim.

---

## **FOL i kërkon Pacollit që t'i kërkojë AKK-së që t'ia publikoj pasurinë**

---

**Drejtori i FOL - it, Ramadan Ilazi, ka theksuar se në rastin e Pacollit, lëvizja e tij konsideron se është joetike që ai të ketë interesa ekonomike, përderisa ushtron funksionin më të lartë në vend. "Prandaj është në interesin publik që z. Pacolli të sqarojë raportin që ka me bizneset e tij brenda dhe jashtë Kosovës. Kjo do t'i ndihmojë në funksionimin e këtij institucioni, si dhe do të krijojë një standard të mirë për zyrtarët e lartë publikë", ka thënë ai**

Lëvizja FOL i ka kërkuar presidentit të Kosovës, Behgjet Pacolli, që ti bëjë publike pasurinë dhe interesat ekonomike. Kërkesën kundrejt presidentit Pacolli e ka artikuluar drejtori ekzekutiv i FOL - it, Ramadan Ilazi, të premtën, në një konferencë shtypi. Drejtori i FOL - it ka lypur nga Pacolli që të kërkojë vetë nga Agjencia Kundër Korrupsion, (AKK) që t'ia bëjë publike pasurinë e tij. Vitin e kaluar Behgjet Pacolli, me cilësinë e presidentit të Aleancës Kosova e Re, kishte kërkuar nga AKK - ja që të mos e bënte publike pasurinë e tij. Ligji për prejardhjen, kontrollin dhe deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë nuk e parasheh mospublikimin e pasurisë mbi bazë të kërkesës së një zyrtari. Në Presidencën e Kosovës nuk kanë dashur që të komentojnë të premtën lidhur me kërkesën e FOL - it për shëfën e tyre. Me AKK - në nuk ka qenë e mundur që të kontaktohet. Drejtori i FOL - it ka lypur nga Pacolli që të kërkojë nga Agjencia Kundër Korrupsion (AKK) që t'ia bëjë publike pasurinë e tij. Drejtori i FOL - it, Ilazi, ka kërkuar që në përputhje me nenin 15, pika 1 e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, presidenti i vendit të zgjidhë vetë sa më parë dhe në mënyrën sa më efektive të mundshme çdo situatë të konfliktit të tij të interesit, ndërkaq nga AKK - ja ka lypur që në përputhje me nenin 14 të verifikojë pasurinë e kryetarit Pacolli në përputhje me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, si dhe Ligjit për presidentin. "Legjislacioni aktual nuk ua lejon zyrtarëve publike të menaxhojnë aksione më shumë se 20 për qind të vlerës në një kompani si dhe të bartin këto aksionesh tek persona të afërt me zotin Pacolli sipas nenit 6 të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit", ka thënë Ilazi. Drejtori i FOL - it, Ramadan Ilazi, ka theksuar se në rastin e Pacollit, lëvizja e tij konsideron se është joetike që ai të ketë interesa ekonomike, përderisa ushtron funksionin më të lartë në vend. "Prandaj është në interesin publik që z. Pacolli të sqarojë raportin që ka me bizneset e tij brenda dhe jashtë Kosovës. Kjo do t'i ndihmojë në funksionimin e këtij institucioni, si dhe do të krijojë një standard të mirë për zyrtarët e lartë publikë", ka thënë ai. Ilazi është shprehur se mosgatishmëria e presidentit Pacolli për publikim të pasurisë ngre pikëpyetje në përkushtimin e tij për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, që janë problemet kryesore të vendit. "Presidenti Pacolli e ka marrë detyrën e presidentit të vendit pas një dëmtimi që i është bërë institucionit të presidentit nga presidenti paraprak dhe më e pakta e mundshme që zoti Pacolli mund të bëjë është që së paku të vendosë një kriter të llogaridhënies dhe transparencës në këtë institucion", ka thënë ai. "Qytetarët e Kosovës kanë të drejtë kushtetuese ta dinë pasurinë, prejardhjen dhe gjithçka tjetër që lidhet me presidentin e vendit dhe unë besoj që një veprim i kundërt nga kjo do të dëshmonte që nuk ka përkushtim për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar". Ilazi ka theksuar se presidenti i vendit ka një rol të rëndësishëm në luftën kundër krimin dhe

korrupsionit sepse është personi që emëron gjyqtarët dhe prokurorët dhe është personi që siguron ose garanton sipas Kushtetutës funksionimin demokratik të institucioneve të tjera. "Prandaj një person që nuk ka integritet në vete, nuk mund të sigurojë integritetin e institucioneve të tjera", ka thënë ai. Drejtori i FOL - it nuk ia ka falur as AKK - së për "zbatimin" e urdhrin të Pacollit për mospublikim të pasurisë. "AKK - ja e ka bërë gabimin kur e ka respektuar kërkesën e zotit Pacolli, sepse nuk ka bazë ligjore për të mos bërë publik deklarin e pasurisë. Ne besojmë se AKK - ja si institucion i pavarur nuk duhet t'i nënshtrohet asnjë lloj presioni nga zyrtarët publike", ka thënë Ilazi. "Çdo veprim i tillë do të ishte i kundërligjshëm dhe do të konsistonte në shkelje të autoritetit të AKK - së, respektivisht statusin që kjo agjenci e ka në Kosovë". Në Presidencën e Kosovës nuk kanë dashur të deklaroreshin për disponimin e Pacollit në raport me kërkesën e FOL - it. "Çështja e pasurisë së tij (Pacollit vj.) është çështje ekskluzivisht e tij dhe unë nuk mund të japë një qëndrim lidhur me këtë", ka thënë Ibrahim Gashi, këshilltari kryesor i Pacollit. Gazeta është munduar që të marrë një qëndrim edhe nga AKK - ja, por drejtori i këtij institucioni, Hasan Preteni, dhe zëdhënësi Mufail Bajçinovci nuk janë përgjigjur në telefon.

---

## Gati për përballje

---

**Presidenca tashmë është duke i përgatitur të gjitha dokumentacionet e kërkuara nga Gjykata Kushtetuese rreth zgjedhjes së Behgjet Pacollit në postin e Presidentit më 22 shkurt në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit. Derisa njohësit e Kushtetutës kanë thënë se nëse deklarohet se Pacolli ka shkelur Kushtetutën, atëherë mund të rrezikohet koalicioni qeverisës**

Presidenca e vendit dhe Kuvendi i Kosovës brenda 15 ditëve do të duhet të dërgojnë të gjitha procedurat e zgjedhjes së Presidentit në seancën e 22 shkurtit. Kjo për shkak të deponimit të një ankese nga dy partitë opozitare LDK dhe AAK, se në seancën kur u zgjodh Presidenti pati shkelje të Kushtetutës dhe të procedurave të zgjedhjes së Presidentit. Ndërsa, njohësit e Kushtetutës e shohin këtë si një çështje që do të mund ta rrezikonte edhe koalicionin qeverisës nëse do të mund të konstatohej nga GJK-ja se gjatë zgjedhjes së Presidentit ka pasur shkelje të Kushtetutës. Mirëpo, zyrtarë të Presidencës thonë se ata janë duke i përgatitur të gjitha materialet e kërkuara nga GJK - ja dhe do t'ia dërgojnë brenda afatit të paraparë. Ndërsa, në anën tjetër zyrtarë të administratës së Kuvendit kanë thënë se kërkesa ka shkuar në drejtim të kryetarit dhe se nuk janë në dijeni me kërkesat e bëra nga GJK-ja.

### Të gatshëm për t'u përballur

Por, këshilltari i parë i Presidentit Behgjet Pacolli, Ibrahim Gashi ka thënë se ata janë duke e përgatitur një përgjigje në ato që kanë ngritur grupi i deputetëve në kërkesën e dërguar në GJK, dhe se brenda afatit, kushtetueses do t'i japin përgjigjen e tyre. "Brenda afatit ne do t'i dërgojmë të gjitha përgjigjet tona në krejt çështjet që janë ngritur si çështje kontestuese në zgjedhjen e Presidentit, ne do të japim përgjigje në afatin ligjor dhe pastaj do të kemi një ekip që në krye me këshilltarin ligjor të Presidentit Ilir Shala do të përballen me Gjykatën Kushtetuese", ka thënë Gashi. Tutje, sipas tij, në ekipin e tyre do të ketë edhe ekspertë tjerë ligjorë që do të angazhohen për këtë rast. "Po, po, do të jenë edhe të tjerë, por kjo do të bëhet sipas sugjerimit të këshilltarit ligjor të Presidentit, mund të ketë edhe ndonjë ekip tjetër", është shprehur Gashi. Ndërsa, në anën tjetër një kërkesë për t'ia dërguar GJK-së të gjitha procedurat e zgjedhjes së Presidentit ka shkuar edhe në drejtim të kryetarit të Kuvendit. Por, sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi ka thënë se kërkesa ka shkuar në emër të kryetarit të Kuvendit dhe në atë kërkesë nuk ka qasje dhe nuk ka dijeni për përmbajtjen e saj. "Kërkesa ka shkuar në adresë të kryetarit dhe më tutje nuk kam dijeni. Vetëm kryetari e di sepse kërkesa ka shkuar në adresë të tij", ka thënë Krasniqi.

### Vendim individual

Ndërsa, për njohësin e të drejtës, kushtetuese Mazllum Baraliu, kjo çështje do të ketë mjaft ndikim në partneritetin e dy partive në koalicion. Mirëpo, drejtues të GJK-së kanë thënë se mund të merret edhe një vendim që të përsëritën procedurat e votimit të Presidentit, që sipas Baraliut është në kompetencën e tyre edhe në bazë të bindjeve të tyre individuale, por edhe në bazë të dokumentacionit që u shkon nga organet kompetente që i kanë kërkuar. "Gjithsesi edhe dokumentacioni duhet të shkojë atje i kompletuar nga organet që kërkohen nga GJK-ja, që të trajtohet në mënyrë substanciale çështja dhe në qoftë se ka ndodhur shkelja e Kushtetutës,

atëherë është diskutabile se si mundet që një njëri që ka shkelur Kushtetutën të jetë kandidat për t'u rizgjedhur aty, nëse përsëriten procedurat e zgjedhjes. Është shumë diskutabile, por është qëndrim individual i njerëzve që punojnë aty" ka thënë Baraliu. Mirëpo, sipas tij duhet të dihet mirë se çfarë shkelje ka qenë aty, se a ka qenë shkelje serioze apo çka, e mandej ata që e shkelin duhet t'i mbajnë pasojat e tyre politike, që ose duhet të kërkohet shkarkimi i tyre ose të japë dorëheqje nëse kanë të drejtë të japin dorëheqje. Por, sipas tij në qoftë se GJK -ja konstaton se dhe të ripërsëritet votimi i presidentit dhe lejon që Pacolli të jetë prapë kandidat, atëherë ai mund të kandidojë përsëri.

### **Mund të rrezikohet qeveria**

Çështje mjaft e nxehtë mund të jetë ajo se në rast të dhënies së vendimit që janë shkelur procedurat e votimit të Presidentit, atëherë kjo rrezikon që të prishet koalicioni qeverisës. Baraliu thotë se nëse Pacolli nuk do të mund të kandidohej për President, atëherë a do ta tërheqë partinë e tij nga koalicioni dhe vendi do të rrezikohet të shkonte në zgjedhje të parakohshme. "Rrezikohet nëse GJK-ja vendos që ai kandidat nuk mund të marrë pjesë si kandidat për President, dhe nëse ka pasur shkelje atëherë është dashtë të ketë edhe reprovime të atyre dhe të ballafaqohen me reprovime ndonjë kandidat atëherë mund të ketë tronditje të koalicionit dhe ndoshta edhe prishje të marrëdhënieve dhe mund të ketë probleme dhe mund të bie qeveria dhe të ketë zgjedhje të reja" ka thënë Baraliu.

---

## **Rrahim Pacolli kundruall Ibrahim Makollit në garën për president të AKR-së**

---

Këshilli Drejtues i Aleancës Kosova e Re ka analizuar të shtunën kapacitetet e Rrahim Pacollit dhe të Ibrahim Makollit për të qenë president i Aleancës Kosova e Re. Burime të gazetës brenda AKR - së kanë thënë se fundi i analizës së anëtarëve të Këshillit Drejtues të kësaj partie të ketë qenë më i mirë për Rrahim Pacollin sesa për Ibrahim Makollin. "Duke marrë për bazë disponimin e të gjitha strukturave të AKR - së do të jetë Rrahim Pacolli ai që do ta marrë postin e presidentit të partisë. Ai është favoriti kryesor, sepse gjatë kohës kur ai ishte sekretar organizativ partia ka qenë forca e tretë më e madhe në Kosovë dhe ishte në tendencë për rritje", kanë thënë ato. "Për Makollin nuk është disponimi njësoj sikur për Pacollin". I njëjti burim ka thënë që në mbledhjen që ka zgjatur më shumë sesa pesë ore, e cila është mbajtur larg mediave, shqyrtimi i potencialeve të Pacollit dhe të Makollit të mos ketë qenë pika e vetme e rendit të ditës. Ai ka thënë se Këshilli Drejtues i AKR - së ka caktuar datën e organizimit të Kuvendit të Jashtëzakonshëm, formimin e dy grupeve punuese dhe zëvendësministrat e Qeverisë së Kosovës. "Më 16 prill është vendosur që të mbahet Kuvendi Jashtëzakonshëm me një pikë të rendit të ditës: zgjedhjen e presidentit", kanë thënë ai. "Janë formuar dy komisione: Grupi për amendamentim të statutit dhe ai për përgatitje teknike të Kuvendit të Jashtëzakonshëm". I njëjti burim ka treguar se është vendosur për zëvendësministrat që i takojnë kësaj partie në Qeverinë e Kosovës. Është vendosur që Gëzim Mehmeti të jetë zëvendësministër i Punëve të Jashtme, Selami Shkodra në Ministrinë Drejtësisë, Emin Gërbeshi në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Avdi Mehmeti në Ministrinë e Punëve të Brendshme", ka treguar ai. "Një vend i zëvendësministrit i është lënë Partisë së Drejtësisë". Dorëheqja e Behgjet Pacollit nga kreu i AKR-së me t'u bërë president i AKR-së i ka hapur rrugën kësaj partie të mbajë kuvendin për të zgjedhur kryetarin e ri, kurse deri më tash për pozitën e presidentit të AKR - së, sipas burimeve, është diskutuar, por zyrtarisht nuk është lajmëruar asnjë kandidat. Ushtruesi i detyrës së presidentit të AKR - së, Ibrahim Makolli, e ka konfirmuar mbledhjen e Këshillit Drejtues të partisë së tij të shtunën. Makolli ka thënë që nuk manifeston ambicie për t'u bërë president i AKR - së në Kuvendin e Jashtëzakonshëm zgjedhor. "Propozimet e kandidatëve për president të partisë do të vijnë goftë paraprakisht apo edhe ditën kur do të mbahet Kuvendi", ka thënë ai. "Unë nuk kam ambicie për të udhëhequr me AKR - në", Presidenti i përkohshëm i "AKR - së ka treguar që Këshilli Drejtues i AKR - së të mos ketë vendosur për ndonjë datë të caktuar, por ta ketë menduar si kohë të qëlluar mesin e prillit për organizimin e Kuvendit të Jashtëzakonshëm. Kohë orientimore e kemi lënë mesin e Prillit, por edhe më tutje jemi në aspekte konsultative ka thënë ai. Makolli e ka konfirmuar formimin e dy grupeve punuese të partisë tij. "Janë krijuar grupet punuese për amendamentim të statutit dhe ai për përgatitje teknike të Kuvendit", është shprehur ai. Ushtruesi i detyrës së presidentit të AKR - së ka thënë që Këshilli Drejtues të mos ketë vendosur për emrat e zëvendësministrave të saj. "Nuk kemi vendosur ende për emrat e zëvendësministrave", ka thënë ai. "Ende nuk kemi biseduar, sepse brenda radhëve tona ende nuk jemi marrë vesh se cilat ministri do të na takojnë". AKR - ja ekziston si parti politike që nga viti 2006. Prej atëherë atë e ka udhëhequr themeluesi kryesor i saj, Behgjet Pacolli. Ai ishte zgjedhur dhe është konfirmuar president i AKR - së në tri kuvendet

që kjo parti i kishte mbajtur më herët në tetor të vitit 2006, në maj të vitit 2007 dhe në korrik të vitit 2009. Në Kuvendin e fundit, Behgjet Pacolli ishte zgjedhur president i AKR në një mandat trevjeçar. Sikur të mos zgjidhej Pacolli tash president i Kosovës, AKR ja nuk do të kishte nevojë që të organizonte Kuvend të Jashtëzakonshëm, por do ta mbante Kuvendin e rregullt vitin e ardhshëm më 2012.

---

## **Del i rremë paralajmërimi për bombën në shtëpinë e Pacollit**

---

PRISHTINË, 5 MARS - Policia e Kosovës ka kontrolluar disa orë për një mjet shpërthyes të shtunën në Hajvali, por nuk ka gjetur asgjë. Policia e kishte pranuar një informatë për praninë e një mjeti shpërthyes në afërsi të shtëpisë së presidentit të Kosovës, Behgjet Pacolli. Zëdhënësi i Policisë së Kosovës, Brahim Sadria, ka treguar se njësitet e këtij organi kanë kontrolluar prej orës 11 e 18 minuta deri në orën 14:00, por s'kanë gjetur mjete shpërthyes. "Qendra operative e Policisë së Kosovës e ka pranuar një informatë të premtën, në orën 11 e 18 minuta, se është një mjet shpërthyes në afërsi të vendit ku banon presidenti në Hajvali. Policia e Kosovës ka dalë menjëherë në vend të ngjarjes, duke kontrolluar deri në orën 14:00, por nuk ka gjetur asgjë", ka treguar ai. "Rasti është mbyllur, ngase s'ka pasur asgjë". Sadria nuk ka treguar se në çfarë mënyre ishte plasuar informata te Policia e Kosovës.



## Opozita “shpërblen” Pacollin

**Nëse “çështja e Pacollit” rikthehet në Kuvend për rivotim dhe Pacolli i merr votat e mjaftueshme, atëherë opozita nuk mund t’i drejtohet më Kushtetueses për shkelje tjera**

**Secili vendim i kësaj gjykate duhet të respektohet, sepse ajo është e thirrur për të interpretuar kushtetutshmërinë”, thotë ushtruesi i detyrës së kryetarit të AKR-së, Ibrahim Makolli**

PRISHTINË - Nëse Gjykata Kushtetuese vendos që përfundimisht çështjen e zgjedhjes së presidentit ta kthejë për rivotim në Kuvend, sipas ekspertëve të së drejtës kushtetuese, mund të shkojë më së shumti në favor të vetë Behgjet Pacollit. Sipas tyre, pretendimet e partive opozitare se ka pasur shkelje të Kushtetutës nga Pacolli edhe në dy raste tjera, kur ai ka votuar qeverinë "Thaçi II", pak kohë pasi është zgjedhur president i vendit dhe "zgjedhja e tij sipas Kornizës Kushtetuese e jo sipas Kushtetutës", mund të hidhen poshtë dhe të mos kenë mundësi më t'ia adresojnë Kushtetueses. Njëri nga këta ekspertë, që nuk ka dashur t'i dalë emri në gazetë, ka thënë se rikthimi i Pacollit në pikën zero, sikurse që ka paralajmëruar kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, disa ditë më parë, përfundimisht ia heq qafe Pacollit Gjykatën Kushtetuese. "Nëse rikthehet në rivotim sepse zgjedhja e presidentit ka qenë e parregullt, atëherë kjo nënkupton se ai kur e ka votuar qeverinë nuk ka qenë president "me letra", por vetëm deputet, e deputeti ka të drejtë ta votojë qeverinë“, ka sqaruar ky ekspert, duke shtuar se edhe zgjedhja "sipas Kornizës Kushtetuese ose sipas Kushtetutës" mbyllet përfundimisht. Sipas tij, nëse Pacolli e kalon edhe sfidën e rivotimit, atëherë, ai me të drejtë mund t'i "shpërblejë" dy partitë që e kanë iniciuar "fatin" e tij në Kushtetuese, Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Aleancën për ardhmërinë e Kosovës (AAK), sepse, do ta lirojnë përfundimisht jo vetëm nga presioni i Gjykatës Kushtetuese, por edhe nga epiteti i “shkelës i Kushtetutës”. Megjithatë, partitë politike opozitare nuk kanë qëndrime të prera nëse do t’i drejtohen ose jo Gjykatës Kushtetuese për votën e Pacollit në favor se si është zgjedhur ai. Drejtuesit e LDK-së thonë se kryesia e kësaj partie do të diskutojë shumë shpejt për votën që Pacolli ka dhënë për Qeverinë “Thaçi II”, ndërsa më pas do të dalë me qëndrime konkrete. "Ne jemi në bisedime të brendshme, kryesia e LDK - së me kohë do të vendosë. Nëse kjo ndodh, lënda shumë shpejt do të shkojë në Gjykatën Kushtetuese“, është shprehur anëtari i kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri. Ai është i bindur se pavarësisht çfarë vendimi sjell Gjykata Kushtetuese për rastin e parë të "çështjes Pacolli", kjo nuk do ta mbyllë mundësinë që nga institucioni më i lartë në vend për interpretim të Kushtetutës të kërkohet mendim për votën e Pacollit dhe për formën si është zgjedhur ai. Ngjashëm me LDK - në mendojnë edhe drejtuesit e "Vetëvendosjes", të cilët thonë se ekziston mundësia që për çështjen e ushtrimit të dy mandateve nga ana e Pacollit, pra, mandatit të presidentit dhe atë të deputetit, kur ka votuar për ekzekutivin, kjo lëvizje t'i drejtohet Kushtetueses. "Mund ta iniciojmë. Nuk është e sigurt, por nëse nuk procedohet kjo nga tjetërkush, atëherë "Vetëvendosje" mund ta iniciojë këtë. Ka një muaj afat, brenda kësaj kohe do ta bëjmë këtë”, ka thënë Glauk Konjufca, nga "Vetëvendosja". Por, më të mëshirshëm me presidentin e Kosovës, duket se janë drejtuesit e AAK - së, të cilët thonë se gjasat që të "trokasin" në derën e Kushtetueses për çështje tjera që ndërliken me Pacollin janë të vogla. "Meqenëse çështja e parë e drejtuar në Gjykatë Kushtetuese nuk është përmyllur, nuk besoj se Aleanca do të iniciojë edhe një procedurë tjetër. Tash ne i jemi bashkuar një kërkesë që i është bërë në Gjykatën Kushtetuese, të presim çfarë po ndodh me

të“, thotë anëtari i kryesisë së AAK - së, Avni Arifi. Sipas tij, ndonëse AAK - ja nuk i drejtohet Kushtetueses për dy çështje tjera që ndërlidhen me Pacollin, kjo nuk nënkupton "humbjen e një shansi të mirë" për ta rrëzuar presidentin. Ndërsa, zyrtarët e ish - partisë së Behgjet Pacollit, Aleanca Kosova e Re, shprehen më të rezervuar në raport me mundësinë që për "fatin" e Pacollit të votohet përsëri në Kuvend dhe me mundësinë që ish - liderit të tyre, t'i hiqet qafe Kushtetuesja. "Gjykata Kushtetuese e ka marrë këtë çështje në duar, ndërsa ne e presim vendimin e saj. Secili vendim i kësaj gjykate duhet të respektohet, sepse ajo është e thirrur për të interpretuar kushtetutshmërinë”, thotë ushtruesi i detyrës së kryetarit të AKR - së, Ibrahim Makolli. Presidenti i vendit, Behgjet Pacolli, është zgjedhur në këtë pozitë në fund të muajit të kaluar. Ai nuk ka arritur t'i marrë votat e mjaftueshme për të qenë president në dy raundet e para, ndërsa para se të mbahet rundi i tretë, Partia Demokratike e Kosovës ka “vjedhur” një pauzë që ndonëse është thënë se do të jetë pesë minuta, ka zgjatur më shumë se gjysmë ore. Është pikërisht kjo pauzë dhe deklarata e kryetarit të Kuvendit Jakup Krasniqi, se “kështu po shkelen procedurat dhe Kushtetuta” që është marrë për bazë nga dy partitë opozitare, LDK-ja dhe AAK-ja, për të kërkuar mendimin nga Gjykata Kushtetuese nëse vërtetë është shkelur kushtetuta.

## **AAK-ja, gati ankesën për shkeljen kushtetuese të Pacollit**

Edhe procesverbali i seancës së 22 shkurtit mund të jetë ndër provat që do të mund t'ia prezantojë Gjykatës Kushtetuese opozita, për të argumentuar shkeljen Kushtetutës që ka bërë presidenti. Në të evidencohet vota e Pacollit. Në seancën e së enjtes Qeveria nuk ka gjetur mbështetje as te deputetët e PDK - së për të zhvlerësuar votën. Ndërkaq Gjykata Kushtetuese ka pranuar të martën një kërkesë të opozitës, me të cilën kontestohet procedura e zgjedhjes së Pacollit president. Kërkesa, në mënyrën se si është bërë, që tash besohet se do të marrë përgjigje negative. Në të 34 deputetët e LDK - së dhe AAK - së nuk kanë përfshirë argumentin kryesor që pretendohet se do ta çonte në shkarkim Pacollin - votimin e tij për qeverinë në cilësinë e deputetit, pasi kishte dhënë betimin si president por vetëm është kontestuar kushtetutshmëria e vendimit të Kuvendit për vënien e biznesmenit kontrovers në majë të pushtetit. Nga pritja e aktvendimit të Kushtetueses në kërkesën rreth kushtetutshmërisë së procedurës së zgjedhjes së presidentit, mund të humbasë afati ligjor kur deputetët mund të deponojnë në gjykatë kërkesën e radhës. Prononcimet e zyrtarëve të LDK - së dhe puna e AAK - së në këtë lëndë, që nuk është bërë publike deri tash, ka shtyrë deputetët e "Vetëvendosjes" që të mendojnë për ta bërë vetë një kërkesë në Kushtetuese. Glauk Konjufca, deputet i "Vetëvendosjes", ka konfirmuar iniciativën që do të merrte ky subjekt për ta ngritur te gardiani i aktit më të lartë juridik çështjen e votës së presidentit. "Nëse nuk kishin për të vazhduar këta (deputetët e LDK - së dhe AAK se vj.) me atë që e kanë filluar, atëherë ne mendojmë që kjo shkelja e tij (presidentit Pacolli v.j.) është serioze. Bile mendojmë që më serioze është shkelja që e ka gjetur "Koha Ditore" dhe më e pakontestueshmja, më e dukshmja dhe më e argumentueshmja", ka thënë Konjufca, që është edhe nënkryetar i Kuvendit. "Lëvizja Vetëvendosje do të bënte diçka në këtë drejtim". Ismet Beqiri, shef i Grupit Parlamentar të LDK - së, ka thënë se po presin verdiktin e Kushtetueses në këtë kërkesë, para se të marrin një qëndrim të mundshëm për të deponuar kërkesën që lidhet me shkeljen e Kushtetutës nga presidenti. Ndërkaq Arben Gashi, deputet i kësaj partie, ka theksuar se paraprakisht Kushtetuesja do të tregojë nëse Pacolli është president, duke lënë të kuptueshme edhe ky se Pacolli nuk do të pandehet për shkelje të Kushtetutës. Pavarësisht këtyre deklaratave, anëtari i Kryesisë së LDK - së, Kujtim Shala, ka thënë se kjo parti nuk ka një qëndrim akoma, nëse duhet pritur përgjigjen në lëndën e parë apo brenda muajit duhet deponuar të dytën. "LDK - ja nuk ka një qëndrim për një deponim të dytë. Nuk është përjashtuar si mundësi, por nuk lidhet me problemin e së parës", ka thënë Shala. "Tash për tash nuk mund t'ju them kur mund të merret qëndrimi. Ndoshta gjatë javës së ardhshme, nëse takohet Kryesia". Gjykata ka dy muaj afat të vendosë në rastin e parë, kurse deputetët kanë vetëm një muaj afat që të deponojnë kërkesën për shkelje të kushtetutës nga Pacolli. Nëse LDK - ja pret verdiktin e Kushtetueses për ankesën e parë, siç ka thënë Beqiri, kjo nënkupton humbje e afatit deponim të ankesës së dytë. Subjektet opozitare kishin thënë gjatë javës se kanë afat më shumë për ta proceduar ankesë të tillë në gjykatë, duke përdorur si shembull rastin e një kërkesë të ngjashme në rastin e ish - presidentit Fatmir Sejdiu. Mirëpo gjatë një interviste në KTV, kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, ka saktësuar se në rastin Sejdiu bëhej fjalë për cenim të vazhdueshëm të Kushtetutës, ndërsa rasti me Pacollin është tjetër. Pikërisht kur e ka dëgjuar interpretimin e Hasanit, sa u takon afateve, deputeti Glauk Konjufca ka thënë të jetë e nevojshme që brenda tri javësh të bëhet kërkesa. "Atëherë (kërkesa v.j.) duhet të

dërgohet brenda këtij muaji", ka thënë ky deputet i "Vetëvendosjes", i cili ka shprehur besimin se do të gjejnë mbështetje edhe në LDK e AAK. "Unë besoj që nëse është në interes të drejtësisë dhe nëse ka deputetë të vullnetit të mirë, se kjo çështje është në të mirë të Kosovës, dhe që të mos kemi një president të paligjshëm, atëherë bashkë duhet të jemi", ka shtuar ai. Por Kujtim Shala i LDK - së nuk ka qenë në gjendje të thotë nëse si grup parlamentar LDK - ja do ta mbështeste kërkesën e ndonjërit subjekt politik opozitar, qoftë AAK së apo "Vetëvendosjes". Mirëpo ka thënë se deputetët individualisht e kanë lirinë të firmosin. "Së pari, nuk ka qëndrim të partisë, pastaj nuk është shumë e rëndësishme kush merr iniciativën", ka thënë Shala. Në fund të fundit duhet nënshkrimi i deputetëve e ai deponohet sipas vullnetit deputetëve". AAK - ja ka 11 deputetë, kurse "Vetëvendosja" 14. Edhe po u bënë bashkërisht, kërkesa e tyre nuk do të jetë e pranueshme ngaqë ajo duhet të ketë firmat e së paku 30 deputetëve. Kaq deputetë kishin firmosur vitin e shkuar një kërkesë, me të cilën supozohej shkelja e Kushtetutës nga Fatmir Sejdiu, që atëkohë ushtronte dy funksione - atë të presidentit të shtetit dhe funksionin e kryetarit të LDK - së. Kushtetuesja kishte konstatuar se kjo përbënte shkelje të rëndë të Kushtetutës, që e çoi në dorëheqje Sejdiun nga funksioni i presidentit. Karriera politike e tij mori fund ngaqë në Kuvendin e përgjithshëm të LDK - së, që është organizuar pak kohë pas verdiktit të Kushtetueses Sejdiu është mundur nga Isa Mustafa në garën për kryetar të partisë.

---

## Shkel edhe kufirin në veri

---

**"Gjatë vizitës presidenti Pacolli është njohur me gjendjen në këtë pjesë të vendit, ndërsa gjatë takimit me policët kufitarë dhe me doganierët, ai është informuar me punën e tyre dhe qarkullimin e njerëzve dhe mallrave në këto dy pika kufitare mes Kosovës dhe Serbisë", është thënë në njoftim për medie nga Presidenca**

MITROVICË, 7 MARS - Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, i shoqëruar me bashkëpunëtorët e vet dhe komandanti i KFOR - it, gjenerali Erhard Buhler, ka qëndruar të hënën për vizitë në pjesën veriore të Kosovës, në pikat kufitare 1 dhe 31, njëra afër Zubin Potokut, tjera afër Leposaviqit. "Gjatë vizitës presidenti Pacolli është njohur me gjendjen në këtë pjesë të vendit, ndërsa gjatë takimit me policët kufitarë dhe me doganierët, ai është informuar me punën e tyre dhe qarkullimin e njerëzve dhe mallrave në këto dy pika kufitare mes Kosovës dhe Serbisë", është thënë në njoftim për medie nga Presidenca. Në këtë njoftim thuhet se presidenti Pacolli është shprehur i shqetësuar për gjendjen në këtë pjesë të vendit, ku nga aktivitetet e paligjshme ekonomike dëmtohet në masë të madhe buxheti i Kosovës, ndërsa popullata serbe e shqiptare, që jeton në këtë pjesë, mbahet peng nga strukturat e pakontrolluara dhe që veprojnë jashtë ligjit.

---

## Presidenti Pacolli: Në Prekaz u vulos pavarësia e Kosovës

---

**"Prekazi është një vend që i bashkon të gjithë shqiptarët nga Kosova, nga të gjitha trojet dhe nga diaspora", theksoi Presidenti Pacolli.**

SKËNDERAJ, 6 MARS - Prekazit, tashmë i shndërruar në vend të shenjtë për shqiptarët, të dielën, në ditën e dytë të manifestimit gjithëkombëtar "Epopeja e UÇK-së" që organizohet për të 13 herë, pra në përvjetorin e 13 të luftës dhe sakrificës sublime të familjes Jashari, në krye me Komandantin Legjendar Adem Jashari, ia kishin mësyre udhëheqësit më të lartë të institucioneve të Kosovës dhe qytetarë nga gjithë gjeografia shqiptare, përfaqësues të institucioneve arsimore, kulturore, të shoqatave të ndryshme etj. Të gjithë ata sot kishin vetëm një qëllim, që në Prekaz të përulën para atyre që sakrifikuuan gjithçka që patën, që më në fund pas shumë përpjekjeve dhe flijimeve shekullore të këtij popull, të arrihet synimi shekullor liria dhe pavarësia e Kosovës dhe e të gjitha trojeve shqiptare. Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, në ditën e dytë të manifestimeve për shënimin e 13-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bëri sot homazhe para varrit të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe dëshmorëve të tjerë në varrezat e Prekazit. Në një deklaratë bërë më këtë rast, Presidenti Pacolli theksoi se Prekazi është vendi ku u vulos pavarësia e Kosovës. **"Prekazi është një vend që i bashkon të gjithë shqiptarët nga Kosova, nga të gjitha trojet dhe nga diaspora. Këtu u vulos pavarësia e Kosovës, të cilën ne e gëzojmë sot. Lavdi këtyre dëshmorëve dhe të gjithë dëshmorëve të tjerë të rënë në luftën për liri. U qoftë i lehtë dheu i Kosovës"** theksoi Presidenti Pacolli. Presidenti Pacolli vizitoi edhe familjen Jashari ku u prit nga Rifat Jashari dhe anëtarët e tjerë të familjes Jashari. Në një bisedë të ngrohtë dhe miqësore, Rifat Jashari e falënderoi Presidentin Pacolli për vizitën dhe kujdesin ndaj familjes së tyre. Nga ana e tij, Presidenti Pacolli çmoi lart sakrificën e familjes Jashari, e cila ka dhënë kaq shumë për pavarësinë dhe shtetin e Kosovës. Gjatë qëndrimit në Prekaz, Presidenti Pacolli vendosi kurora lulësh edhe para lapidarit të Sale e Hamit Jasharit, duke nderuar kujtimin e tyre dhe të rënëve të tjerë për liri. Presidenti Pacolli me bashkëpunëtorët, në Prekaz, gjithashtu vizitoi familjen e Habib Jasharit, e cila gjatë luftës ka qenë e strehuar te familjarët e Presidentit Pacolli. Për kryeministrin e Kosovës Hashim Thaçi, Dita e sakrificës sublime e kësaj familje është dita e bashkimit, afrimit, respektit për të kaluarën dhe marrjes së energjive për të ardhmen. "Ne kemi fituar lirinë, kemi fituar pavarësinë, dhe tani po ndërtojmë shtetin tonë. Jemi në rrugë për t'u anëtarësuar në NATO dhe në Bashkimin Evropian, prandaj në 13-vjetorin e rënies së komandantit legjendar, Adem Jashari, Kosova është në rrugë të mbarë, është në rrugë të suksesit, është një garanci për të ardhmen e saj më një vizion euro-atlantik", është shprehur kryeministri Hashim Thaçi në Prekaz, i cili shoqërohej nga ministra të kabinetit të tij qeveritar. Përmasat e dhimbjes dhe krenarisë për kryetarin Parlamentit të Kosovës, Jakup Krasniqin janë ato që njeriun e shtyjnë të vijë dhe të nderojë në Prekaz dhe nëpër këtë ai është i bindur që duke nderuar këto përmasa të dhimbjes kombëtare i nderojmë gjithë familjet në Kosovë, i nderojmë të gjitha familjet shqiptare, por njëkohësisht edhe historinë e lavdishme të kombit tonë. Në Prekaz ishin edhe përfaqësues të shoqatave të ndryshme si tjera, përfaqësues të arsimit, të atyre të dala nga lufta dhe të kulturës, studentëve dhe qytetare nga të gjitha viset shqiptare dhe nga mërgata. Ky manifestim do të përfundojë në hënën në Natën e Zjarreve në Prekaz.

## Ndërrimi i Kushtetueses nuk e “prek” Pacollin

**Partitë politike dhe ekspertët e zgjedhjeve e konsiderojnë si të domosdoshme ndryshimin e Kushtetueses që precizon zgjedhjen e Pacollit. Kërkohet që i pari i Kosovës të zgjidhet drejtpërdrejt nga populli**

PRISHTINË - Zgjedhja e fundit e presidentit të vendit nga Kuvendi i Kosovës, tashmë i kontestuar nga opozita për shkak të parregullsive të shoqëruara gjatë zgjedhjes, ka shtuar kërkesat nga qarqet ndërkombëtare dhe ato vendore, që të ndërrohet ligji për zgjedhjen e presidentit, që ky i fundit të zgjidhet nga populli. Përfaqësuesit e partive politike, por dhe ekspertët zgjedhorë e konsiderojnë të nevojshme që presidenti të zgjidhet drejtpërdrejt nga populli, por sipas tyre, kjo çështje nuk mund të determinohet vetëm me ligj, para se të ndryshohet Kushtetuta. Profesori i të Drejtës Kushtetuese, Vigan Qorrolli, konsideron se edhe po të ndërrohej Kushtetuta, respektivisht neni 87 pika 2, sa i përket zgjedhjes së presidentit, Behgjet Pacolli është i paprekshëm, mandati i të cilit është, pesë vjet. Qorrolli ka thënë se ndryshimet kushtetuese vlejnë vetëm për rastin vijues të zgjedhjes së Presidentit, nëse Kushtetuta nuk e parasheh ndryshe. "Me fjalë të tjera, mandati i presidentit aktual nuk ndërpritet në asnjë rrethanë tjetër, përveç rasteve të parapara me Kushtetutë dhe me Ligjin për Presidentin e Republikës së Kosovës", ka thënë Qorrolli. Ndërkaq, Mazllum Baraliu ekspert zgjedhor ka thënë se nuk mund të ndërrohet ligji dhe të mbetet me Kushtetutë zgjedhja e presidentit nga parlamenti. "Së pari duhet të ndërrohet Kushtetuta e më pas ligji për zgjedhjen", ka thënë Baraliu, sipas të cilit është shumë e domosdoshme që të ketë reforma urgjente të sistemit zgjedhor në Kosovë. Mirëpo, sipas tij, zgjedhja e presidentit nuk është nevojë urgjente, sepse ka punë të tjera më të rëndësishme në këtë proces. Pra duhet që të gjitha ligjet e pakos së Ahtisarit të rishikohen dhe të procedohen në proceduar normale ashtu si e do ligji dhe të diskutohet për to, e jo siç janë miratuar “blanko” pa u trajtuar nga Kuvendi dhe pa u parë se çfarë përmbajnë ato ligje”, ka thënë Baraliu. Nëse, sipas tij, nuk ndryshohet kushtetuta tek nenet ku precizohet zgjedhja e presidentit, atëherë është i kotë ndryshimi i ligjit për zgjedhje. Baraliu thotë se Kuvendi i Kosovës duhet të ketë një iniciativë të tillë. "Pra deputetet ose kuvendi duhet të reagoj dhe të kërkoj që menjëherë të fillohet me modifikimin e kushtetutës dhe në vënien e saj në suaza të një përmase specifike Kosovare që e kërkon momenti dhe rasti. Pikërisht, kushtetuta është pengesa kryesore e zhvillimit të proceseve normale në vend", tha ai. Kujtim Shala nga LDK ka thënë se kërkesa për zgjedhjen e presidentit nga populli është një prej kërkesave të hershme të LDK - së, mirëpo edhe ai kërkon ndryshimin e Kushtetutës sa i takon sistemit zgjedhor. "Kjo është një prej pikave themelore të LDK - së dhe se për ndryshimin e Kushtetutës duket që ka njëfarë konsensusi, mirëpo për një gjë të tillë kërkohen dy të tretat e votave të Kuvendit dhe gjithashtu dy të tretat e votave të minoriteteve", ka thënë Shala. LDK, sipas tij, gjithsesi do të kërkojmë ndryshimin e Kushtetutës, sepse nuk mund të ndryshohet sistemi zgjedhor. Ndërkaq, Glauk Konjufca nga Vetëvendosje tha se edhe nëse ka konsensus ndërmjet forcave politike për ndryshimin e kushtetutës, pa dy të tretën e votave të minoriteteve është e pamundur të arrihet një gjë e tillë. Sipas tij, është shumë me rëndësi ndërrimi i nenit 142 në Kushtetutë, i cili e parasheh planin Ahtisari mbi Kushtetutën e vendit. "Gjithsesi që do të ketë iniciativa për ndryshim. Vetëvendosje do t'i shfrytëzoj të gjitha mënyrat që të ndërrohen

këtë nene, dhe të gjitha ato që nuk janë të përshtatshme për vendin, ka thënë Konjufca. Kurse, analisti Avni Zogiani nuk mendon që duhet të zgjidhet presidenti nga populli, megjithatë, sipas tij, shtetet me demokraci parlamentare kryesisht nuk e zgjedhin presidentin me votë, shembull i kësaj janë të gjithë presidentet e rajonit. "Nuk është e domosdoshme, sepse presidenti në rregullimin e tillë shtetëror ka vetëm një rol simbolik, prandaj nuk është e thënë që të zgjidhet nga vota e popullit. Pazaret nuk bëhen pse ai zgjidhet nga parlamenti, por pse politika substancialisht është e korruptuar dhe joparimore", ka thënë Zogiani. Ndryshe, kërkesa e fundit për ndryshimin e ligjit për zgjedhje ka ardhur nga erodeputetja Ulrike Lunacek. "Kam qenë e shqetësuar me disa procedura të votimit gjatë zgjedhjeve të institucioneve. Për këtë arsye presidentit duhet te zgjedhet nga populli në mënyrë që të mos ketë ndonjë lloj presioni dhe loje në Parlament", ka thënë Lunaçek.



---

## **Pacolli sërish në Veri**

---

PRISHTINË - Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli sërish ka kaluar në pjesën veriore të Kosovës të banuar me popullatë serbe, ndërsa në agjendë kësaj here ai ka pasur dy vendkalimet problematike, pikën 1 dhe 31, në Zubin Potok përkatësisht Leposaviq. Këtë vizitë, numri një i shtetit e ka bërë në shoqëri me komandantin e KFOR - it, gjeneralin Erhard Buhler. "Presidenti u njoh me gjendjen në këtë pjesë të vendit, ndërsa gjatë takimit me policët kufitarë dhe me doganierët, ai u njoh me punën e tyre dhe qarkullimin e njerëzve dhe mallrave në këto dy pika kufitare mes Kosovës dhe Serbisë", ka njoftuar presidenca nëpërmjet një kumtese. Presidenti Pacolli, sipas kumtesës, është shprehur i shqetësuar përgjithësisht me gjendjen në këtë pjesë të vendit, ku nga aktivitetet e paligjshme ekonomike dëmtohet në masë të madhe buxheti i vendit, ndërsa popullata, që jeton në këtë pjesë, mbahet peng nga strukturat e pakontrolluara dhe që veprojnë jashtë ligjit. S. B.

---

## **SHBA-të mbështesin dialogun**

---

BEOGRAD - Shtetet e Bashkuara të Amerikës e përkrahin fillimin e dialogut midis Prishtinës dhe Beogradit, ka deklaruar ambasadorja e SHBA - së në Serbi, Mary Warlick, e cila ka kërkuar që në këtë proces të zgjidhen çështjet kyçe. "Është shumë me rëndësi që bisedimet të fillojnë dhe të dyja palët të zgjidhin çështjet që do të përmirësonin kushtet e jetesës së njerëzve në Serbi dhe në Kosovë", ka thënë Warlick për mediet serbe. Ajo është shprehur e bindur se të dyja palët këtë javë do të ulen në të njëjtën tavolinë në Bruksel, me vullnet të mirë dhe optimizëm. "SHBA - të do të ofrojnë përkrahje të plotë në këto bisedime dhe të dyja palëve u dëshirojnë bisedime të suksesshme, ka thënë ajo.

## Presidenti Pacolli u del zot kufijve verior

**Pikat kufitare dikur të lëna jetim nga institucionet e Kosovës, më nuk janë të braktisura. Për herë të parë ato janë vizituar të hënën nga një kryetar shteti, Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij dhe komandanti i KFOR-it, gjenerali Erhard Buhler, të cilët në pjesën veriore të Kosovës vizituan në këmbë pikat kufitare 1 dhe 31, në Zubin Potok dhe Leposaviq, pas një udhëtimi me helikopterë. Gjatë vizitës, Presidenti u njoh me gjendjen në këtë pjesë të vendit, ndërsa gjatë takimit me policët kufitar dhe me doganierët, ai u njoh me punën e tyre dhe qarkullimin e njerëzve dhe mallrave në këto dy pika kufitare mes Kosovës dhe Serbisë.**

Presidenti Pacolli u shpreh i shqetësuar përgjithësisht me gjendjen në këtë pjesë të vendit, ku nga aktivitetet e paligjshme ekonomike dëmtohet në masë të madhe buxheti i vendit, ndërsa popullata, si ajo serbe, si ajo shqiptare, që jetojnë në këtë pjesë, mbahen peng nga strukturat e pa kontrolluara dhe që veprojnë jashtë ligjit. Ai tha se ka shkuar atje për t'u njohur nga afër me gjendjen, përkatësisht me qarkullimin e njerëzve dhe mallrave në këto dy pika kufitare mes Kosovës dhe Serbisë. **"Ka qenë arsye që të shkoj edhe atje të vizitoj bashkatdhetarët tonë, punëtorët tonë që punojnë për institucionet e Kosovës dhe të inkurajoj ata që punojnë edhe më tutje. Të inkurajoj edhe ata që dikush është duke u kujdesur edhe për atë anë dhe ajo pjesë është e Kosovës dhe të lansoj një mesazh që nga atje që nuk janë të vetmuar, por janë nën përkuqjesjen e Kosovës"**, ka thënë ai. Ndërkaq i pyetur nga gazetarët lidhur me bisedimet Kosovë - Serbi, pas një takimi që pat me një grup mësimitdhënësish përfshirë ish profesorë fakulteti dhe veteranë të arsimit, Presidenti tha se është i gatshëm të bëjë çfarëdo që kërkohet në mënyrë që të sigurohet një fat më i mirë për Kosovën. Presidenti i Republikës së Kosovës Behgjet Pacolli të hënën në nder të festës së 7 marsit ditës së mësuesit pati një takim me disa mësimitdhënës, duke vlerësuar lart mësuesit dhe edukatorët për kontributin e tyre në edukimin e brezave. **"Nuk kam pasur mundësi që të gjitha kategoritë t'i pranojë sot, por simbolikisht pata nderin t'i kaloj disa çaste të bukura me një pjesë të mësimitdhënësve, me të cilët ndërruam mendime të ndryshme, duke u frymëzuar edhe më tepër, që të punojmë për shoqërinë tonë. Shoqëria jonë ka nevojë të ecë përpara, ka nevojë për ndihmë dhe për këshilla"**, u shpreh Pacolli. Ndërkaq, prof. Ramiz Kelmendi tha se ndihej i lumtur që shteti po i nderon arsimtarët. "Desha të them vetëm këtë se lum ai shtet dhe ai pushtet, i cili nderon arsimtarët e vet", tha Kelmendi. Ndërsa mësuesja Sofije Kllokoçi, që ka qenë arsimtare e Presidentit Pacolli, evokoi kujtime nga ajo kohë dhe u shpreh shumë e gëzuar që nxënësi i saj ka arritur kaq shumë suksese dhe është bërë President i vendit. "Jam krenare se nxënësi im ka mbërritur këtu dhe tani është president. Ai ka qenë një nxënës i shkëlqyeshëm dhe nuk dyshojë në punën e tij kurrë", tha znj. Kllokoçi. Ajo tha se që kur e kishte nxënësis kishte besuar se z.Pacolli do të arrinte shumë. "Ma ka marr menja që Behgjeti, tani Presidenti i Kosovës, do të arrinte shumë, por zgjedhja president i shtetit më të ri, kjo është një arritje e shkëlqyeshme", tha ish mësuesja e Presidentit Pacolli.



*Pikat kufitare dikur të lëna jetim nga institucionet e Kosovës, për herë të parë ato janë vizituar nga kryetari i shtetit, Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli*

---

## **Pacolli: Kontributi i Zvicrës në shtetndërtimin e Kosovës ishte shumë i madh**


---

Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli priti të martën, në takime të ndara ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, z. Lukas Beglinger, dhe atë të Austrisë, Johann Brieger. Ambasadori i Zvicrës në Kosovë, z. Lukas Beglinger, ia uroi z. Pacolli zgjedhjen në detyrën e re, si dhe i përcolli urimet e Presidentes së Konfederatës së Zvicrës, znj. Micheline Calmy-Rey. "Kontributi i zonjës Micheline Calmy-Rey dhe i Zvicrës në shtetndërtimin e Kosovës ka qenë shumë i madh", tha Presidenti Pacolli në takim, duke çmuar ndihmën e vazhdueshme të Zvicrës, si në të kaluarën ashtu edhe sot, për popullin dhe institucionet e vendit tonë. Ai theksoi se përveç ndihmës në të gjitha fushat, e një rëndësie të veçantë është prania e trupave të Zvicrës në Kosovë, të cilat japin kontribut të çmueshëm në ruajtjen e paqes dhe sigurisë dhe në dhënien e asistencës së komunitetit. Presidenti Pacolli tha se Kosova ka nevojë ende për ndihmë nga Zvicra, në përcjelljen e përvojave të këtij shteti në vendin tonë, si dhe theksoi fushën e drejtësisë, si një fushë ku Zvicra mund t'u japë një ndihmë të çmueshme institucioneve përkatëse të vendit tonë. Gjithashtu, ai theksoi edhe kërkesën që sa më shumë biznese nga ky vend të investojnë në Kosovë, duke ndihmuar zhvillimin ekonomik të vendit tonë dhe duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e shkallës së lartë të papunësisë. Nga ana e tij, ambasadori z. Lukas Beglinger tha se vendi i tij ka ndihmuar në vazhdimësi popullin dhe institucionet e Kosovës dhe këtë do të vazhdojë ta bëjë edhe në të ardhmen, në të gjitha fushat. Ai theksoi se Zvicra nuk do të zvogëlojë kontingjentin e ushtarëve të vet në kuadër të KFOR-it, ndërsa do të vazhdojë kontributin e saj edhe në kuadër të EULEX-it. Ai gjithashtu përmendi se Kosova dhe Zvicra kanë të nënshkruara marrëveshje bashkëpunimi që mbulojnë disa fusha, ndërsa në të ardhmen do të nënshkruhen edhe marrëveshje të tjera. "Austria gjithmonë ka qenë mike e jona dhe ka mbetur mike e vërtetë e Kosovës. Kontributi i Austrisë për vendin tonë është shumë i madh dhe ne e vlerësojmë shumë këtë", tha Presidenti i Republikës së Kosovës. Pasi përkujtoi një varg fushash në të cilat Austria ka dhënë një ndihmesë shumë të madhe, duke veçuar këtu ndihmën në fushën e arsimit të lartë, Presidenti Pacolli theksoi se Kosova ka edhe më tej nevojë të përfitojë nga ndihmat dhe përvojat austriake në shumë fusha. Edhe në këtë takim, Presidenti Pacolli foli për projektet e Kosovës për rritjen ekonomike dhe sidomos për krijimin e ambientit për ardhjen në Kosovë të sa më shumë investitorëve nga Austria. Ambasadori Johann Brieger, nga ana e tij, uroi Presidentin Pacolli për zgjedhjen dhe i dorëzoi atij letrën e urimit që Presidenti Fisher i dërgoi Presidentit Pacolli. Z. Brieger theksoi bashkëpunimin e vazhdueshëm të mirë mes Austrisë dhe Kosovës, në shumë fusha, bashkëpunim ky që ka dhënë frytet e veta, por edhe e ka forcuar edhe më miqësinë mes dy shteteve. Në planin ekonomik, ai shfaqti shpresën se në të ardhmen do të ketë edhe më shumë biznese austriake që do të shtrijnë investimet e tyre në Kosovë, edhe pse numri i tashëm i bizneseve të këtij shteti që zhvillojnë aktivitet në vendin tonë nuk është i vogël. "Kosova duhet të ketë një plan afatmesëm të zhvillimit", theksoi zonja Lubranti, duke shtuar se sfidat më të mëdha të vendit mbetet kontingjenti i madh i të rinjve të gatshëm për të hyrë në tregun e punës, si dhe shkalla e lartë e papunësisë. Presidenti i Republikës, z. Behgjet Pacolli, pasi falënderoi zonjën Lubranti për ndihmën që kanë dhënë dhe po japin për Kosovën organizatat që ajo përfaqëson, theksoi një varg prioritetesh të institucioneve të vendit, në drejtim të sigurimit të zhvillimit sa më të shpejtë ekonomik dhe kapërcimit të gjendjes së tanishme. Ai foli për hapat e domosdoshëm që duhet ndjekur në reformën e zhvillimit ekonomik, duke theksuar se vetëm një rritje ekonomike prej 5-6 për qind gjatë këtij viti do të ishte një garanci e zhvillimit dhe e gjenerimit të vendeve të

reja të punës. Presidenti Pacolli gjithashtu theksoi edhe domosdoshmërinë e reformave në fushën e drejtësisë, të shëndetësisë e fusha të tjera, ku duhet të ndërmerren hapa të menjëhershëm me qëllim të përmirësimit të gjendjes dhe të ofrimit të shërbimeve me të mira për qytetarët.



*Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli pret në takim ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, z. Lukas Beglinger. z. Beglinger, ia uroi z. Pacolli zgjedhjen në detyrën e re, si dhe i përcolli urimet e Presidentes së Konfederatës së Zvicrës, znj. Micheline Calmy-Rey*



*Kontributi i zonjës Micheline Calmy-Rey dhe i Zvicrës në shtetndërtimin e Kosovës ka qenë shumë i madh", tha Presidenti Pacolli në takim, duke çmuar ndihmën e vazhdueshme të Zvicrës, si në të kaluarën ashtu edhe sot, për popullin dhe institucionet e vendit tonë*



*Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli ka pritur në takim edhe ambasadorin e Austrisë, Johann Brieger. Kontributi i Austrisë për vendin tonë është shumë i madh dhe ne e vlerësojmë shumë këtë”, ka thënë Presidenti i Republikës së Kosovës*



---

## Pacolli pritet ta publikojë pasurinë

---

Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, pritet ta deklarojë pasurinë e tij. “Mendoj se është dashur edhe vitin e kaluar të precizohet, por kanë qenë dy ligje në të cilat zoti Pacolli është thirrur në atë kohë. Ligji për qasjen në dokumentet zyrtare, i cili në një mënyrë ia mundësonte një gjë të tillë, me specifikat që i ka kërkuar zoti Pacolli. Ne, atë komunikimin mes agjencisë dhe zotit Pacolli e kemi bërë publik dhe të gjitha ato komunikime janë publike në ueb - faqen e AKK - së. Për këtë vit, ne mendojmë që do t'i evitojmë këto mangësi. Tashmë janë realizuar takimet e para; dy zyrtarë të agjencisë kanë biseduar me zotin president dhe shpresoj që 31 marsi do t'i evitojë ato mangësi dhe ato pengesa që kanë qenë vitin e kaluar dhe do të ketë dëshirë më të fuqishme që të evitohet ajo mangësi. Shpresoj që këtë vit, më 31 mars, do të kemi mundësi ta publikojmë edhe pasurinë që e deklaroi zoti president", ka deklaruar kreu i Agjencisë kundër Korrupsionit, Hasan Preteni, në një intervistë për REL - in .

---

## Pacolli 'privatizon' Presidencën

---

**Një ndër punët e para që ka bërë presidenti i ri i Kosovës është pajisja e zyrës me mobilie të reja. Kjo nuk është paraparë me buxhetin e Presidencës, por është bërë me fondet e tij private**

Presidentit Behgjet Pacolli nuk i ka pëlqyer që të ulet në karriget ku ishin ulur presidentët e mëhershëm Ibrahim Rugova, Fatmir Sejdiu dhe së fundmi ushtruesi i detyrës Jakup Krasniqi. Tri - katër ditë pasi që është betuar për të qenë president i vendit, Pacolli është kujdesur që të ndërroje enterierin e zyrës ku do të punojë dhe atë duke i ndërruar të gjitha mobilet të cilat ishin të vendosura në dhomën e pritjes së presidentit. Mobilet e reja, të cilat kanë një ngjyrë të kuqe, tashmë janë vendosur, ndërsa ato të vjetrat të cilat ishin vendosur në zyrën e presidentit janë larguar nga aty. Sipas zyrtarëve të presidencës, iniciativa për ndërrimin e mobileve në zyrën e presidentit ka ardhur nga vetë presidenti Pacolli, i cili i ka blerë mobilet me paratë e veta dhe të njëjtat ia ka dhuruar presidencës. Blerja e këtyre mobileve është konfirmuar nga sekretari i presidencës Fahri Breznica. Sipas tij, presidenti ka vendosur ta freskojë kabinetin me mobilie të reja duke ia dhuruar mobilet presidencës. Breznica nuk ka dhënë detaje nëse mobilet e vjetra të presidencës ishin ndokund të dëmtuara, mirëpo ai ka thënë se për vitin 2011 presidenca nuk kishte paraparë ndërrimin e mobileve në zyrën e presidentit. "Projeksion buxhetor nuk ka pasur për t'u bërë kjo. Ne e kemi buxhetin e vogël dhe në bazë të kufijve buxhetorë që ministria na e ka paraparë, ne kemi paraparë në buxhetin e 2011 - së të blejmë mobilie, por jo për kabinetin e presidentit", ka thënë Breznica. Ai nuk i di saktë nëse pamundësia buxhetore për të blerë mobilie të reja ka qenë arsyeja që e ka shtyrë presidentin Pacolli t'i dhurojë këto mobilie. Madje Breznica nuk e di saktë se në emër të cilës kompani janë dhuruar dhe sa është vlera e saktë e këtyre mobileve. Sipas Breznicës, presidenca në ditët në vijim do të llogarisë vlerën e këtyre mobileve dhe më pas të njëjtat do të regjistrohen në librat kadastralë. Breznica po ashtu ka paralajmëruar se disa prej mobileve të vjetra të cilat janë përdorur nga presidentët do të konservohen dhe ruhen si suvenire. Përndryshe, gazeta gjatë ditës ka tentuar të marrë edhe një qëndrim zyrtar rreth asaj se pse Pacolli ka vendosur t'i ndërrojë mobilet, mirëpo kjo ka qenë e pamundur pasi këshilltari i Pacollit, Arbër Gecaj, ka thënë se nuk është kompetent për të folur për këtë çështje, përderisa këshilltari tjetër, Ibrahim Gashi, nuk ka qenë i arritshëm në telefon.

K.GASHI

---

## **Presidenti Pacolli, me helikopterë të KFOR-it, viziton kufirin verior**

---

Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, të hënën i ka bërë edhe një vizitë veriut të Kosovës, kësaj radhe i shoqëruar me komandantin e forcave paqeruajtëse, gjeneralin Erhard Buhler. Presidenti Pacolli, pas një vizitë të shkurtër në shtabin e KFOR - it, në Prishtinë, bashkë me COMKFOR - in Buhler janë nisur, me dy helikopterë të KFOR - it, për në veri të vendit. Siç ka shpjeguar për "Kohën Ditore zëdhënësi i KFOR – it, kapiteni Hans Dieter Wichter, e tëra ishte një vizitë pune, prej së cilës presidenti Pacolli ka dashur të shohë funksionimin e forcave të sigurisë, të KFOR - it, sikur edhe atyre në pikat kufitare në veri të vendit. Po ashtu, presidenti ka dashur ta shohë Kosovën prej qiellit. Fluturimi me helikopterë e ka dërguar presidentin Pacolli së pari mbi pikën kufitare Porta 31, në Zubin Potok, dhe më pas në pikën tjetër. Porta 1 në Leposaviq, ku edhe është bërë ndalesa. Vizita nuk ka qenë e paralajmëruar, por megjithatë disa media kishin qenë prezentë në Portën 1 kur presidenti kishte qëndruar aty. Nga Presidenca është lëshuar një njoftim për shtyp në lidhje me vizitën shumë orë pas realizimit të saj, në mbrëmje, pas interesimit të mediave në një takim tjetër të presidentit. Vetë presidenti Pacolli, i pyetur në lidhje me vizitën në kufirin verior të vendit, tha se qëllimi ishte të njoftohet me punën atje. **"Ka qenë arsyeja që të shkoj edhe atje t'i vizitoj bashkatdhetarët tanë, punëtorët tanë që punojnë për institucionet e Kosovës"**, ka thënë Pacolli, pas takimit me mesimdhënësit, duke i përshkruar gabimisht zyrtarët në pikat doganore veriore si "bashkatdhetarë". Ai ka shtuar se vizita e tij atje është bërë edhe me qëllimin që t'i inkurajojë njerëzit që punojnë atje, në pikat doganore, **"që të punojnë edhe më tutje, t'i inkurajoj ata që dikush është duke u përkujdesur edhe për atë anë, edhe ajo pjesë është e Kosovës dhe të lansojë një mesazh edhe atje se nuk janë të vetmuar, por janë nën përkujdesjen e institucioneve të Kosovës"**. **"Mirëpo shkuarja ime nuk është varur vetëm prej meje. Normalisht unë kam pasur një përcjellje edhe prej njerëzve të mi, por edhe normalisht prej Policisë së Kosovës dhe KFOR - it"**, ka shtuar Pacolli. Komunikata zyrtare, e lëshuar në mbrëmje, thotë se gjatë vizitës, "presidenti u njoh me gjendjen në këtë pjesë të vendit, ndërsa gjatë takimit me policët kufitarë dhe me doganierët, ai u njoh me punën e tyre dhe qarkullimin e njerëzve dhe mallrave në këto dy pika kufitare mes Kosovës dhe Serbisë". Në komunikatë thuhet edhe se Pacolli është shprehur i shqetësuar përgjithësisht me gjendjen në këtë pjesë të vendit, ku nga aktivitetet e paligjshme ekonomike dëmtohet në masë të madhe buxheti i vendit, ndërsa popullata, si ajo serbe, si ajo shqiptare, që jetojnë në këtë pjesë, mbahen peng nga strukturat e pakontrolluara dhe që veprojnë jashtë ligjit.

---

## Ish-kryetari Rugova dhe kryetari aktual Pacolli

---

Te ne, në Kosovë, por edhe më gjerë, në gjithë botën shqiptare, është praktikuar, tashmë, që për njerëzit e gjallë, sidomos për ata që janë dëshmuar të suksesshëm, flitet dhe shkruhet "zi e ma zi", ndërsa për të vdekurit, edhe në qoftë se nuk janë dëshmuar aq të suksesshëm, flitet dhe shkruhet në superlativ. Derisa, siç thotë populli, në "gjellën" e të parëve vërehet edhe qimja e flokut, pra "miza bëhet buall", në "gjellën" e të dytëve nuk vërehet as trari (!). Nga kjo praktikë, tashmë e njohur për të gjithë shqiptarët, nuk ka mundur të përjashtohet as kryetari aktual i Kosovës, Behgjet Pacolli. Qysh në ditën e parë të zgjedhjes së tij kryetar i Republikës së Kosovës dhe deri sot e gjithë ditën, pas gjurmimeve nga larg, me dylbi, dhe nga afër me llupë dhe me mikroskop, janë publikuar "qimet" e zbuluara në veprimtarinë e tij tejet të suksesshme, si njeri i punës dhe i biznesit.

### Nëna e keqe është njerka

Njëra nga "qimet e flokut, të zbuluara në biografinë e pasur të Pacollit qenka gjetur diku, në një interviste të tij, dhënë mediave të huaja, në të cilin ai paska thënë se "Serbia ka qenë nënë e keqe e Kosovës. Ne këtë "prove materiale, zbuluesit, publikuesit dhe interpretuesit e kësaj fraze, e kanë mbështetur një akuzë të tyre kundër Pacollit dhe, gjithnjë sipas tyre, për arsye të kësaj fraze, Pacolli nuk është i denjtë për të qenë kryetar i Republikës së Kosovës. Por, për të kuptuar se sa absurde është kjo akuzë, mjafton të kihen parasysht dy faktet e para, nëna e keqe nuk është tjetër veçse njerka dhe, për një fëmijë, nuk ka gjë më të mirë dhe më të dashur se nëna, sikundër që nuk ka gjë më të keqe dhe më të urryer se njerka. E dyta, Behgjet Pacolli nuk është letrar, që i stërhollon fjalët, por njeri i punës dhe i biznesit, siç dihet dhe siç është deklaruar në vazhdimësi edhe vetë. Pra, me fjalë të tjera, Pacolli në këtë rast ka thënë "Serbia ka qenë njerka e Kosovës, pra e keqe dhe e urryer. Kaq. As me pak, as më shumë.

### Akuza për sukseset në Lindje

Kundërshtarët e Pacollit janë munduar, jo vetëm t'i minimizojnë e t'i injorojnë sukseset e tij, por edhe t'i shndërrojnë ato suksese në dështime të Pacollit. Ata ia shohin për të madhe, madje edhe e akuzojnë Pacollin, sepse ai nuk e ka orientuar biznesin e tij në perëndim, por në ish-vendet e BRSS-së, pra edhe në Rusi. Ata, natyrisht, nuk janë aq naivë sa të mos e dinë që secili biznes, edhe kapitali aktual i perëndimit, orientohet në vendet ku tatimet janë më të vogla, fuqia punëtore më e lirë, konkurrenca më e dobët dhe fitimi më i sigurt e më i madh. Kjo është normale dhe e natyrshme. Ata e dinë, gjithashtu, që edhe firma gjigande perëndimore kanë investuar në Rusi dhe në ish vendet e BRSS-së dhe kjo nuk i prish punë askujt, as në Lindje as në Perëndim. As investimet e Pacollit në Lindje nuk do të duhej t'i prishte punë askujt, sikur ato të mos rezultonin shumë të suksesshme. Dhe janë pikërisht sukseset e Pacollit që nuk mund të honepsen nga kundërshtarët e tij. Ato, prandaj, në vend që t'i hapin rrugë, po bëhen, çuditërisht, pengesë për ecjen e Pacollit në Kosovë.

## **Akuza për hetimet në Zvicër**

Gjurmuesit e "qimeve të flokut" në biografinë e Pacollit nuk po e honepsin as vendimin e prokurorisë zvicerane për mbylljen, në mungesë të provave, të një procesi hetimor kundër Pacollit. Të pakënaqur dhe të dëshpëruar me tërheqjen e prokurores zvicerane nga pandehmat e saj lidhur me Pacollin, ata e kanë marrë rolin e ekstra prokurorëve dhe i kanë aktualizuar, duke i kokorisur në vazhdimësi, akuzat e tyre, por tani, çuditërisht, për hetime të mbyllura kundër Pacollit, gjë që është në kundërshtim me çdo teori dhe praktikë juridike dhe demokratike të botës së qytetëruar.

## **Fati i njëjtë i ish-kryetarit**

Rugova dhe kryetarit aktual Pacolli Kur në fillim të këtij shkrimi e përmenda praktikën shqiptare të shkrimeve "zi e ma zi" për njerëzit e gjallë dhe të shkrimeve në supërlativ për të vdekurit, e kisha parasysh ish-kryetarin e Kosovës, Ibrahim Rugova. Siç dihet tashmë, kundërshtarët e tij politikë, jo vetëm që shkruanin "zi e ma zi" kundër tij, por, sa ishte gjallë Rugova, e patën dënuar edhe me vdekje. Pas luftës në Kosovë, ata e kundërshtuan zgjedhjen e Rugovës kryetar të Kosovës. Tani, të njëjtët njerëz, gjunjëzohen dhe përkulen para varrit të tij (!). Gjykuar me këtë logjikë, fatin e ish-kryetarit Rugova do ta ketë edhe kryetari aktual i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli. Sot kundërshtarët e tij po e akuzojnë dhe po shkruajnë "zi e ma zi" për të. Ai, si edhe Rugova", me një procedurë të vështirë e të mundimshme, u zgjodh kryetar i Republikës së Kosovës. Nesër mund të pritët që, kundërshtarët e tij të sotëm, do të gjunjëzohen dhe përkulen para tij.

## **Fillimi premtues i kryetarit Pacolli**

Përkundër rrëmujës së krijuar gjatë zgjedhjes së kryetarit Pacolli dhe të qeverisë Thaçi 2, në Kuvendin e Kosovës, dhe zhurmës së pakuptimshme, pas mbledhjes së Kuvendit, për shkeljen e procedurës zgjedhore, të Rregullores së Kuvendit dhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pra në kushtet e një presioni brutal politik dhe medial, Pacolli e ka filluar i qetë mandatin e tij- kryetar i Republikës së Kosovës. Qysh në hapat e parë në mandatin e tij, si i pari i vendit, kryetari Pacolli ka dhënë mesazhe të qarta për synimet e tij në të ardhmen. Vizita me bashkëpunëtorët e tij në familjet Jashari dhe Rugova, shkuarja në Veriun e Mitrovicës dhe në pikat kufitare nr.1 dhe 31, në Zubin Potok dhe në Leposaviq dhe vizita në familjet skamnore, dëshmojnë se Pacolli do të jetë kryetar i unitetit të vendit, i shtrirjes së sovranitetit dhe kontrollit shtetëror në gjithë territorin e Kosovës dhe i përkujdesjes së shtetit për të gjithë skamnorët. Në opinion është pritur mirë edhe përfshirja në kabinetin e tij e njerëzve profesionistë, pavarësisht përkatësitë e tyre partiake, pra edhe nga partitë që e kanë kundërshtuar me forcë zgjedhjen e tij kryetar dhe që, ende pa e filluar punën si kryetar, e kanë paditur për shkelje të Kushtetutës (!), siç është rasti i emërimit të Naim Malokut (të AAK-së) këshilltar për siguri në Presidencën e Kosovës. Këta hapa janë tregues i qartë i një fillimi të mbarë dhe premtues të punës së kryetarit të ri të Kosovës, Behgjet Pacolli, i cili, siç po duket, nuk e ka ndërmend të punojë për hatër as për inate të askujt, por vetëm për interes të Kosovës dhe të të gjithë qytetarëve të saj.

Shkruan: Shemsi Reçica, sociolog

---

## Dorasi të kapet dhe të dal para drejtësisë

---

Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Behgjet Pacolli vizitoi të mërkurën familjen Musliu në fshatin Uglar të komunës së Gjilanit, djali i së cilës, Leutrim Musliu, u vra të shtunën, derisa po kthehej nga mali së bashku me babanë e tij. Gjatë vizitës në familjen e babait të Leutrimit, Rrahim Musliu, Presidenti Pacolli kërkoi që organet e drejtësisë ta zbardhin sa më parë këtë rast. **"Ne ju shprehim ngushëllime. Jemi këtu që ta ndajmë së bashku me ju këtë dhimbje dhe ne kërkojmë nga organet përkatëse që sa më shpejt dorasi të kapet dhe të dalë para organeve të gjyqësisë"**, tha Presidenti Behgjet Pacolli. **"Në këtë kohë kur Kosova ballafaqohet edhe me probleme të tjera të ndjeshme, unë besoj se këtë rast në mënyrë korrekte, në mënyrë të drejtë do ta zgjidhin organet e drejtësisë"**, tha Presidenti Pacolli. Duke folur në emër të familjes, Burhan Zejnullahu falënderoi Presidentin Pacolli për vizitën dhe që në këto momente dhembjeje u gjen pranë familjes Musliu. "Në emër të familjes, ju falënderojmë në mënyrën më të sinqertë që keni gjetur kohë dhe keni ardhur ta ndani me neve këtë dhimbje, këtë humbje të një djali shqiptar", tha ai.

### Presidenti priti shefin e OSBE -së

"OSBE ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në demokratizimin e vendit tonë", theksoi Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli gjatë një takimi me shefin e Misionit të OSBE - së në Kosovë, z. Werner Almhofer. Presidenti Pacolli theksoi se synimi i institucioneve dhe i popullit të Kosovës është integrimi sa më i shpejtë në institucionet euroatantike. "Ne synojmë të hyjmë në Evropë dhe për ta arritur këtë duhet të jemi të kompletuar në të gjitha fushat", tha ai. Në këtë plan, ai theksoi se Kosova ka nevojë për reforma në një varg fushash, ku një nga më kryesoret është reforma në fushën e drejtësisë. Presidenti Pacolli theksoi se institucionet e vendit duhet të gjejnë një zgjidhje për të kapërcyer gjendjen e tanishme në gjyqësor, ku ka një grumbullim të lëndëve të pashqyrtuar dhe kjo, tha ai, mund të bëhet me angazhimin e juristëve të rinj, studentëve të cilët kanë kryer studimet dhe nuk kanë gjetur angazhim, duke i trajnuar ata dhe duke i dërguar për të ndihmuar gjyqtarët dhe prokurorët për përballimin e numrit të madh të lëndëve që presin shqyrtim në gjykatat përkatëse. Gjithashtu, Presidenti Pacolli theksoi nevojën e ndryshimit të Ligjit për Zgjedhje, ndërsa përsëriti edhe një herë se Presidenti i vendit duhet të zgjidhet me votat e qytetarëve. Në këtë drejtim, ai theksoi se OSBE mund të asistojë me këshillat e saj. Shefi i Misionit të OSBE-së, në Kosovë, z. Werner Almhofer, theksoi gatishmërinë e organizatës që ai drejton për të dhënë ndihmesën e tij kudo që kërkohet. Ai theksoi se Misioni i OSBE-s është tash e 12 vjet në Kosovë, ndërsa kjo organizatë është prezentë edhe në vendet e rajonit. Z. Almhofer theksoi se ndihma e OSBE-së konsiston në ofrimin e këtyre vendeve, edhe të Kosovës, drejt Bashkimit Evropian, duke dhënë ndihmesën e saj në zhvillimin e demokracisë së mirëfilltë, në fushën e sundimit të ligjit dhe në krijimin e ambientit për investime të huaja.

**"Këtë rast ta zbardhin sa më parë dhe fajtorin ta sjellin para drejtësisë. Unë besoj se këtë do ta bëjnë organet tona. Është një dhimbje e madhe që ne e ndajmë bashkë me familjen, është një humbje dhe një rast, i cili është dashtë t'i takojë të kaluarës, jo kësaj kohe"**, tha presidenti Pacolli.

---

## **Drejtori i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës i raportoi Presidentit Pacolli**

---

Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli priti të mërkurën në një takim drejtorin e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës (AKI), z. Bashkim Smakaj. Z. Smakaj e njoftoi Presidentin Pacolli me punën e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, e cila tashmë po hyn në vitin e tretë të funksionit të saj, organizimin e saj dhe sfidat që e presin në të ardhmen. Nga ana e tij, Presidenti Pacolli përgëzoi z. Smakaj dhe drejtuesit e tjerë të kësaj agjencie për punën që po bëjnë dhe u ofroi bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme të tij dhe të institucioneve të vendit.

### **Presidenti Pacolli është takuar edhe me Ombudspersonin e Kosovës, z. Sami Kurteshi.**

Presidenti Pacolli theksoi në takim rëndësinë shumë të madhe që ka për vendin dhe shoqërinë institucioni i Ombudspersonit, si një institucion në mbrojtje të të drejtave të qytetarëve të vendit. Duke qenë se institucioni i Ombudspersonit shihet nga gjithë qytetarët si një institucion me rëndësi dhe shpresëdhënëse, Presidenti Pacolli theksoi nevojën e bashkëpunimit sa më të mirë me këtë institucion dhe përkrahjen e punës së tij. Ombudspersoni i Kosovës, z. Sami Kurteshi e njoftoi Presidentin Pacolli me punën dhe shtrirjen e zyrave të këtij institucioni në komuna të ndryshme të Kosovës dhe për sfidat me të cilat përballet institucioni që ai drejton, në përpjekje për të përfaqësuar e mbrojtur sa më mirë të drejtat e të gjithë qytetarëve të vendit tonë.

---

## Presidenti vlerëson AKI-në dhe Avokatin e Popullit

---

Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, është takuar të mërkurën me drejtorin e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës (AKI), Bashkim Smakaj. Ky i fundit e ka njoftuar presidentin Pacolli me punën e AKI-së, e cila tashmë po hyn në vitin e tretë të funksionit të saj. Ndërsa, presidenti Pacolli e përgëzoi Smakajn dhe drejtuesit e tjerë të kësaj agjencie për punën që po bëjnë, ndërsa u ofroi bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme të tij dhe të institucioneve të vendit. Gjithashtu, të mërkurën, presidenti Pacolli është takuar me Avokatin e Popullit, Sami Kurteshin. Pacolli e ka vlerësuar Avokatin e Popullit si institucion të një rëndësie të madhe për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve të vendit. Ky institucion mirëpritet nga qytetarët, prandaj theksojmë nevojën e bashkëpunimit sa më të mirë”, - tha Pacolli. Ndërsa, Avokati i Popullit, Sami Kurteshi, e ka njoftuar presidentin Pacolli për punën dhe shtrirjen e zyrave të këtij institucioni në komuna të ndryshme të Kosovës. “Folëm për sfidat me të cilat përballet institucioni në përpjekje për të përfaqësuar e mbrojtur sa më mirë të drejtat e të gjithë qytetarëve”, - ka thënë Kurteshi. Ne kuadër të agjendës së ditës së mërkure, presidenti Pacolli ka vizituar familjen Musliu në fshatin Uglar të komunës së Gjilanit, djali i së cilës, Leutrim Musliu, u vra të shtunën, derisa po kthehej nga mali së bashku me babanë e tij. Ne këtë rast, presidenti Pacolli kërkoi që organet e drejtësisë ta zbardhin sa më parë këtë vrasje.



---

## **Behgjet Pacolli, dritëhijet e një biznesmeni dhe Presidenti atipik**

---

Pallati i Behgjet Pacollit, në lagjen 'Hajvali' në periferi të Prishtinës, është konceptuar njësoj si ai i presidentit të Kazakistanit, Nursulltan Nazarbajev. Prej këtu, nga ky vend që e ka ndërtuar enkas sipas ambicies dhe ëndrrës së tij të shproporcionuar, u nis Behgjet Pacolli ditën e 22 shkurtit, për t'u bërë President i Kosovës. Shtypi i përditshëm, me të gjithë zërat, pro dhe kundër, ishte në tryezën e mëngjesit. Ishte aty edhe fjalimi i gatshëm, që ai kish përgatitur të mbante, nëse disa orë më vonë, më shumë se gjysma e deputetëve të Kuvendit, do të votonin pro tij, disa orë më pas.

### **Selia e AKR-së, aty ku nisi rrugëtimi politik**

Ndalesa e fundit e Pacollit, vetëm pak çaste para votimit, është pikërisht aty, te selia qendrore e partisë së tij. Ai e themeloi Aleancën për Kosovën e Re në vitin 2007, disa muaj përpara zgjedhjeve të përgjithshme. Ishte ndoshta momenti më i volitshëm për këtë ish-banor të fshatit Marec, pranë Prishtinës, që e kish lënë Kosovën që në moshën 20 vjeçare, për të bërë para dhe emër në Gjermani e Zvicër. Pikërisht në këto zyra u hartua edhe strategjia. Kosova ishte e lodhur nga qeverisja e gjatë e LDK-së. Tre vite më parë fushata e AKR-së ishte plot bujë dhe pompë. Ashtu siç duket edhe në vargjet gati feminare që këndonte në mitingjet elektorale Bleona Qerreti, fjalori i kësaj partie të re ishte i ndryshëm. Më shumë se programet e partive tradicionale që kishin kryefjalë të tyren "Pavarësinë", forca e re fliste më shumë për zero tolerancë, për mirëqenie ekonomike dhe për një qytetar më të pasur. Madje, në spotet e saj publicitare jepet ideja se me Pacollin Kosova do t'i ngjante shumë shpejt vendeve ku Presidenti i Mabetex-it kishte ndërtuar. Ky ishte premtimi i Behgjet Pacollit. Asgjë e ngjashme me atë që elektorati kosovar kishte dëgjuar deri më 2007. Njerëzve, përpos sloganeve patriotike, po dilte një parti që po u tregonte ëndrrën. Fabula e përgatitur me kujdes nga strategët e fushatës së Pacollit, plotësohej edhe nga trajektorja e jetës së tij. Një njeri që e kish filluar nga hiçi dhe që sot numëronte rreth gjysmë miliardë euro. Një fshatar që për të udhëtuar drejt Perëndimit, kishte shitur fshehtas viçin më të mirë të tufës e që sot konsiderohej si ndërtuesi i Kremllit. Fabula ishte e bukur, pavarësisht nga mundësia e realizimit të saj. Këtë pjesë e mbulonte vetë Pacolli, që u prekte votuesve telat e varfërisë, me një gjuhë të ndryshme nga e mëparshmeja.

### **Thaçi dhe prapaskenat e votimit për Presidentin**

Pesha më e rëndë kish mbetur mbi partnerin e tij Hashim Thaçi. Kryeministri i Kosovës, i sfilatur nga kritikant në shtypin ndërkombëtar, i dërrmuar nga zgjedhjet e kontestuara, i vënë në vështirësi nga refuzimet e partive të tjera për të qeverisur me të, kish mbetur i varur nga numrat e AKR - së. Por, shpesh, pushteti justifikon çdo sakrificë, pavarësisht nga kostoja morale e saj. Dhe Thaçi e kish bërë atë. E vetmja pengesë që i mbetej për të kapërcyer ishte të mbante të shtrënguara radhët e partisë së tij. Kjo e mundonte. Shumë nga figurat e saj ishin kundër Pacollit. Ndaj edhe kur filloi votimi gjithçka dukej e pasigurt. Në dy raunde, as gjysma e deputetëve nuk pranonin të votonin kandidaturën për president. Revolta ndaj Pacollit qe e madhe. Dështimi i votimit të tretë e çonte vendin në zgjedhje të parakohshme. Kryeministri nuk i trembej më fatit të Pacollit. Ankthi i vërtetë i Thaçit ishte delegjitimimi i mazhorancës së tij. Ndërsa, ankthi i Pacollit qe përmbysja e një ëndrre. Nënshtrimi para një sfide. Në emër të

këtij makthi, të kësaj sfide, ai duket sikur u thërret në ndihmë perëndive. Dhe ato, si shpeshherë në vendet e Botës së Tretë, banojnë në Ambasadën Amerikane. Kryediplomati amerikan në Prishtinë, Kris Dell, do të rezultojë një pikë kyçe e këtij votimi që luhet më shumë në kulisa. Falë ndërhyrjes së tij, vota e shumë deputetëve të Kuvendit të Kosovës do të ndërrojë. Ata që votojnë për Pacollin duhet të jenë më shumë se 60. Të gjithë skenën e kësaj ndërhyrjeje do ta bëjë publike fotoaparati i reporterëve të mediave kosovare, të cilat nga lozha arritën të fotografojë në mesazhet në iPhone të kandidatit për president, të shkruara prej këshilltarit të tij Esad Pushkar. Aty duket qartë ndërhyrja dhe udhëzimet e Ambasadorit amerikan. Gjithashtu përmes këshilltarit të vet, Pacolli njoftohet se ambasadori i thotë se ai duhet të flasë me Thaçin, për raundin e tretë. Ai i thotë gjithashtu se ambasadori Dell ka dalë jashtë për dy minuta, me sa duket për të ri luajtur fijet që lëvizin pas skene. Aty ku vendoset realisht për këtë votim.

### **Një President i kontestuar**

Për shumëkënd zgjedhja e Pacollit u bë në shkelje të hapur të Kushtetutës. Sepse përpara raundit të tretë votimi iu ndërpre, e një gjë e tillë nuk parashikohet në ligj. Porosia e Ambasadorit amerikan për të biseduar me Kryeministrin, çoi në këtë shkelje, e cila vendosi fatin e votimit të tretë dhe revoltoi jo pak drejtuesin e seancës, Jakup Krasniqi. Por me gjithë debatin rreth këtij incidenti, me gjithë shijen e hidhur që ai i la procesit të votimit, rezultati u shpall. Po si arriti Behgjet Pacolli deri këtu? Cila ishte rruga e tij e beftë politike, që e shndërroi në më pak se katër vjet nga një milioner në President të Kosovës? Cila qe strategjia që ndoqi, armët që përdori, anët e errëta dhe meritat e kësaj ngjitjeje rrufe? Shumëkush e akuzon ende sot Behgjet Pacollin se, sidomos në hyrjen e tij në politikë, ai abuzoi me skamjen dhe hallet e njerëzve. Se ai krijoi një imazh të rremë, të asaj që mund të bënte për të varfrit dhe për mbarë Kosovën, pavarësisht se vetë Pacolli pretendon se, ende pa hyrë në politikë, fondacioni i tij kishte shpenzuar mbi 32 milionë euro për të varfrit, mënyra sesi ai e përdori këtë ndihmë, herë pas here linte një shije të keqe. Ai qe nisur për një rrugë, ku kish pak sinqeritet e ku kërkohej shumë pushtet. Dhe kjo dukej edhe në spotet e tij elektorale. Edhe më flagrant ishte rasti i një polici të aksidentuar në detyrë, Mazllum Bajraktarit, për të cilin qeveria e Kosovës kishte shpenzuar rreth 200 mijë euro për kurim, e Pacolli i kish lidhur një pension të përjetshëm dhe e përdorte më pas si një ikonë publicitare. Por bëmat e këtij rishtari në politikë, që hyri nga porta e saj e madhe me sloganin "I pakrahasueshëm", vërtet nuk kanë krahasim. Herë pas here ato kanë prekur e kanë kaluar çdo cak njerëzor. Kur dëshira për t'u dukur vërtet i paarritshëm nga të tjerët e bënte liderin e AKR - së të përdorte në fushatë edhe fëmijët e gjymtuar gjatë një tubimi elektorale në Prizren. Dhe si një aktor i keq, edhe vet Pacolli merrte pjesë në këtë farsë, duke bërë të pavlefshëm jo vetëm sinqeritetin e donacioneve të tij, po edhe vetë qëllimin. Por si një politikan tashmë i mësuar të justifikojë gjithçka, Pacolli ka një përgjigje për gjithçka? Madje edhe për pyetjen e kujdesshme, sesa elegante është të përdorësh njerëzit e gjymtuar.

### **Pacolli sipas Pacollit**

Behgjet Pacolli pretendon të ketë qenë afër, edhe atëherë kur ka qenë shumë larg. Brenda mureve të Kremlinit. Ai krenohet sot, që ish-pallatin e carëve, këtë mrekullitë arkitekturës së fillim shekullit të 18-të e ka rikonstruktuar me punëtorë shqiptarë. Por pikërisht kjo pjesë e historisë së tij, kjo fazë e pasurimit të shpejtë e të errët, i përmendet sot shumë nga kundërshtarët e tij. Lidhja e tij me shefin e kabinetit Rus, Pavel Borodin dhe me vajzën e presidentit Jelcin, hedhin shumë hije dyshimi, sidomos në mesin e teoricienëve konspirativë të Ballkanit, që shohin këtu një mëkat. Për shumëkënd sot, Pacolli është një njeri i Moskës, që ka bërë para atje, pikërisht në kohën kur ky vend mohonte ndërhyrjen mbi Jugosllavi dhe çlirimin e Kosovës.

Në librin e tij autobiografik "Nga Sfida në Sfidë" Behgjet Pacolli i kushton më shumë se 70 faqe asaj ngjarjeje që mori emrin "Rusiagate" dhe që u bë e njohur në mbarë botën, për shkak se tentonte të pengonte rizgjedhjen e Jelcinit president. Në të Pacolli akuzohej, nga kryeprokurorja e Zvicrës, Karla del Ponte, dhe kryeprokurori rus Skuratov, se i kishte rritur faturat e punëve që kish bërë në Kremlin me 30 deri në 50 për qind (faqe 265). Ai akuzohej gjithashtu se kish hapur një llogari bankare me rreth 11 milionë dollarë, paratë e kartat e të cilave përdorshin nga delegacionet e zyrtarëve të lartë rus, përfshirë këtu edhe familjen e Jelcinit. Një tjetër kosto politike për Pacollin ka qenë edhe martesat e tij me gruan ruse, me të cilën Mashën nga Shën Peterburgu, ka dhe dy fëmijët Isën dhe Hanën. Në një vend ku martesat mikse me ortodoksë janë parë gjithnjë me dyshim, kjo zgjedhje e lirë e një njeriu të lirë, është e vështirë të pranohet, aq më tepër kur tashmë bëhet fjalë për Zonjën e Parë të Kosovës.

### **Behgjeti i pamposhtur**

Ky vullnet dhe kjo vendosmëri e ka ndjekur Behgjet Pacollin të gjitha sfidat e jetës së tij. Edhe kur arriti t'i mbijetojë një aksidenti vdekjeprurës dhe një kome të gjatë, e cila e detyroi të qëndrojë për 17 muaj me kokën mes këtyre hekurave. Edhe kur i vetëm depërtoi në Moskën e Perestrojkës, për të ngritur biznesin e tij. Edhe kur mësoi të fluturojë lart e të ngasë vetë avionin e tij personal. Edhe kur diti të joshë jurinë e Sanremos, për t'i dhënë ish gruas së tij Ana Oksës çmimin e parë të këtij festivali. Behgjet Pacolli është ai duke qenë shumëçka në të njëjtën kohë. Një njeri plotë dritë dhe hije.

**Shkruan:** Andi Bushati

---

## **Buhler përshëndet nisjen e dialogut**

---

PRISHTINË - Komandanti i KFOR - it, Erhard Buhler, përshëndeti fillimin e dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, duke e konsideruar këtë proces të rëndësishëm ndërfqinjësor për afrimin e palëve ndërmjet veti. Këto komente numri një i paqeruajtësve ndërkombëtarë në Kosovë i bëri me rastin e pritjes vjetore që komandanti i KFOR - it bëri për përfaqësuesit e institucioneve vendore e ndërkombëtare të akredituara në Kosovë. Të pranishëm me këtë rast ishin edhe presidenti Behgjet Pacolli e zyrtarë tjerë të Qeverisë së Kosovës, ministra, kryetarë të komunave, e përfaqësues të shoqërisë civile etj. "Ju dëshiroj një dialog të mirë me të gjithë fqinjët tuaj, në mënyrë që të afroheni më shumë me njëri - tjetrin dhe të afroheni më shumë me bashkësinë ndërkombëtare. Ne të gjithë duhet të punojmë në këtë drejtim", deklaroi komandanti Buhler. Me këtë rast ai shfrytëzoi rastin që në këtë takim të përshëndesë edhe strukturat e reja të Qeverisë Kosovës, duke u kërkuar atyre që të kontribuojnë në zhvillimin dhe normalizimin në shumë fusha. Kurse sa i përket bashkësisë ndërkombëtare, saktësisht KFOR - it, i cili para disa ditësh ka ndryshuar strukturën e tij, sipas Buhler, me strukturën e re të forcave, KFOR - i do të vazhdojë t'i mbajë kapacitetet operacionale. "I siguroj të gjithë njerëzit në Kosovë se NATO - ja, KFOR - i dhe unë personalisht, jemi dhe vazhdojmë të jemi tejet të përkushtuar ndaj njerëzve në Kosovë, si dhe ndaj paqes dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor, tha ai.

---


## Sarkozy Pacollit, mund të llogarisë në ju për të dyfishuar sukseset e Kosovës

---

*Kosova po forcohet në fushën ndërkombëtare dhe ka marrë gjithnjë njohje të shumta. Ka ditur të udhëheqë përpjekje të rëndësishme në një kontekst delikat dhe kompleks. Unë e di se mund të llogarisë në ju për të dyfishuar zellin e madh në këtë punë.*

Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli priti të enjtën ambasadorin e Republikës së Francës në vendin tonë, Jean Francois Fitou, i cili i dorëzoi letrën e urimit të Presidentit të Francës, Nicolas Sarkozy me rastin e zgjedhjes së Presidentit Pacolli. Në takim, Presidenti Pacolli falënderoi për urimin e Presidentit Sarkozy, duke u quajtur atë një mik të madh të Kosovës dhe duke vlerësuar shumë lart kontributin e Francës në shtetndërtimin e Kosovës. Ndërsa, Ambasadori Fitou theksoi se përkrahja e Francës për Kosovën ka ekzistuar gjithmonë dhe ajo do të jetë e vazhdueshme. Këtë, tha ai, e thekson fuqishëm edhe Presidenti Sarkozy në letrën e tij të urimit. Në letrën drejtuar Presidentit Pacolli nga Presidenti Sarkozy thuhet: Zotëri Kryetar, Ju uroj ngrohtësisht për zgjedhjen e juaj në krye të Kosovës dhe jam i lumtur t'ju adresoj dëshirat e mia më të mira për suksesin, në përmbushjen e funksioneve të larta, në emrin tim personal. Kaluan tri vjet nga pavarësia. Kosova po forcohet në fushën ndërkombëtare dhe ka marrë gjithnjë njohje të shumta. Ka ditur të udhëheqë përpjekje të rëndësishme në një kontekst delikat dhe kompleks. Unë e di se mund të llogarisë në ju për të dyfishuar zellin e madh në këtë punë. Kosova ka bërë reforma kryesore për konsolidimin e institucioneve dhe në mbizotërimin e Ligjit. Është angazhuar me vendosmëri në rrugën drejt Bashkimit Evropian. Nuk kam dyshim se, me nxitjen e juaj, Kosova do të mund të përballet me sfidat që e presin. Mbetet shumë për të bërë në fushat e konsolidimit të institucioneve dhe në mbizotërimin e Ligjit. Llogaris në angazhimin e vendit tuaj për të bërë reformat e rëndësishme në zhvillimin ekonomik dhe social. Franca do të vazhdojë të punoj për ju në këtë perspektivë, me qëllim të forcimit të lidhjeve miqësore dhe besueshmërisë në mes të dy vendeve tona. Franca ju sjell tërë mbështetjen e saj në këtë detyrë. Përfitoj, po ashtu, këtë rast për t'i shprehur dëshirat për prosperitet dhe lumturi për Kosovën dhe popullin e saj. Ju lutem, Zotëri Kryetar i Republikës, pranoni sigurinë e konsideratës time të lartë.

Nicolas SARKOZY




*Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli pret në takim ambasadorin e Republikës së Francës në vendin tonë, Jean Francois Fitou, i cili i dorëzoi letrën e urimit të Presidentit të Francës, Nicolas Sarkozy me rastin e zgjedhjes së Presidentit Pacolli*



*Në takim, Presidenti Pacolli e falënderoi z.Fitou për urimin e Presidentit Sarkozy, duke u quajtur atë një mik të madh të Kosovës dhe duke vlerësuar shumë lart kontributin e Francës në shtetndërtimin e Kosovës*

## Presidenti Pacolli priti drejtuesit e Bankës Qendrore

Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli priti të enjten ushtruesin e detyrës së guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), z. Gani Gërguri dhe zëvendës guvernatorin, Nexhat Kryeziu. Z. Gërguri e njoftoi Presidentin Pacolli për gjendjen në Bankën Qendrore të Kosovës, punën që bën ky institucion, rezultatet e arritura, por edhe sfidat që e presin në të ardhmen. Ai tha se Kosova ka një sistem stabil, të sigurt dhe të shëndoshë financiar. Presidenti Pacolli vuri theksin tek projektet e së ardhmes, duke pasur gjithnjë synim zhvillimin e vendit dhe integrimin e tij sa më të shpejtë në institucione dhe struktura ndërkombëtare. Ai tha se zhvillimi ekonomik, prosperiteti i vendit, është rruga më e mirë edhe për përparimin e vendit edhe për integrimin e Kosovës në familjen e madhe evropiane. BS



*Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli priti sot ushtruesin e detyrës së guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), z. Gani Gërguri dhe zëvendësguvernatorin, Nexhat Kryeziu. Gërguri e njoftoi Presidentin Pacolli për gjendjen në Bankën Qendrore të Kosovës, punën që bën ky institucion, rezultatet e arritura, por edhe sfidat që e presin në të ardhmen*



---

## **Pacolli, letër Shoqatës së të Burgosurve Politikë**

---

Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, në një letër drejtuar Shoqatës të Burgosurve Politik, me rastin e 30 të demonstratave të 11 marsit të vitit 1981, vlerësoi lart angazhimin e të gjithë organizatorëve dhe pjesëmarrësve të këtyre demonstratave. Në letrën e Presidentit Pacolli thuhet: **"Të nderuar veprimtarë, organizatorë dhe pjesëmarrës të demonstratave studentore dhe gjithë popullore të 11 Marsit të vitit 1981. Kam kënaqësinë dhe nderin që t'ju përshëndes dhe t'ju përgëzoj për veprimtarinë tuaj të çmuar atdhetare në përpjekjet tona shekullore për çlirim dhe për pavarësi. Duke e çmuar lart kontributin tuaj, më lejoni që edhe në emër të qytetarëve të Kosovës t'ju shpreh mirënjohjen dhe falënderimin e thellë për kurajon dhe guximin tuaj atdhetar, që t'i jepni impuls një lëvizjeje çlirimtare që kishte nisur shumë herët, por që me demonstratat e vitit 1981 mori karakter masovik dhe gjithë popullor dhe u bë fundament i lëvizjes së mëvonshme politike dhe ushtarake që shtyri krijimin e shtetit të pavarur të Kosovës. Duke u përkulur para veprës tuaj dhe gjithë atyre veprimtarëve që ranë në altarin e lirisë, zotohem se do të vihem me gjithë qenien time, brenda Institucionit që përfaqësoj, në mision të jetësimit të idealit dhe amanetit të atyre brezave që i vunë themelet e shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës. Qoftë e lavdishme vepra e juaj, populli i Kosovës është mirënjohës për këtë".**

---

## **Presidenti Pacolli ngushëllon udhëheqjen dhe popullin e Japonisë**

---

Me rastin e tërmetit dhe cunamit shkatërrues që goditi Japoninë, Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli u dërgoi telegrame ngushëllimi, në emrin e tij dhe në emër të popullit të Kosovës, Lart madhërisë së Tij, Perandorit Akihito dhe kryeministrit të Japonisë, Naoto Kan. Populli i Kosovës, qeveria jonë dhe unë personalisht ndjejmë thellësisht dhimbjen për humbjen e jetëve dhe dëmet e shkaktuara nga tërmeti dhe cunami shkatërrimtar, Populli i Kosovës është shumë i prekur nga kjo tragjedi. Në mendime dhe në lutje jemi me ju në këto çaste të vështira, shkruan Presidenti Pacolli. Ai gjithashtu thekson se populli i Kosovës është i gatshëm të solidarizohet, në çfarëdo forme që ka nevojë, me popullin e Japonisë, për ta ndihmuar atë për të përballuar tragjedinë dhe për të riparuar sa më parë dëmet që shkaktoi tërmeti i sotëm.

---

## Presidenti “rrëfeket” në Kushtetuese

---

**Presidenti Behgjet Pacolli e ka deponuar në Gjykatën Kushtetuese një dokument 10 faqesh, brenda të cilit ka futur argumentet mbrojtëse për zgjedhjen e tij në krye të shtetit. As kryeparlamentari Jakup Krasniqi nuk e ka lënë pa përgjigje gardianin e Kushtetutës. Por ky i fundit, në vend të komenteve dhe të argumenteve, e ka proceduar në Gjykatë vetëm stenogramin e seancës së 22 shkurtit**

Behgjet Pacolli dhe Jakup Krasniqi i kanë dhënë shpjegime Gjykatës Kushtetuese, secili në variantin e vet, mbi atë sesi ka rrjedhur seanca e 22 shkurtit, gjatë së cilës Pacolli është zgjedhur kryetar shteti. Derisa i pari ka deponuar në Kushtetuese një lëndë 10 faqesh, i dyti e ka parë të udhës që t'ia përcjellë të njëjtit institucion vetëm stenogramin e seancës së jashtëzakonshme. Si njëri ashtu edhe tjetri, ndonëse jo detyrimisht, është dashur t'i jepnin komentet e tyre brenda dhjetë ditësh, prej ditës kur 34 deputetë të LDK - së dhe të AAK - së kanë ngritur "rastin Pacolli" në Gjykatë. Ky rast është ngritur më 1 mars. Iniciuesit e kësaj lënde kanë shprehur dyshime se gjatë zgjedhjes së presidentit nuk është respektuar neni 86 i Kushtetutës. Në këtë nen precizohet që "zgjedhja e presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputeteve të Kuvendit", dhe nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve, të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë, dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve zgjidhet president i Republikës së Kosovës. Mirëpo në momentin e votimit të Pacollit për president kanë qenë të pranishëm vetëm 67 deputetë. Për këtë shkak, pala iniciuese e lëndës ka ngritur dilemën nëse ka pasur kuorum për të votuar gjatë dy rundeve të para. Dilema tjetër e ngritur është nëse Kuvendi ka mundur ta zgjedhë presidentin në raundin e tretë, pa pasur kundërkandidat. Kjo për faktin se Kushtetuta e parasheh që dy kandidatë mund të shkojnë në këtë raund dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të zgjidhet president. Deputetët e opozitës nuk e kanë përfshirë në lëndë edhe çështjen e votimit të Pacollit për Qeverinë në cilësinë e presidentit, që, sipas hartuesve të Kushtetutës, është parë si shkelja më e pakontestuar e Kushtetutës. Këshilltari i parë i presidentit Pacolli, Ibrahim Gashi, ka bërë të ditur të premtën se Gjykatës Kushtetuese i janë dhënë përgjigje në tri pikat që janë shtruar në lëndën e ngritur nga deputetët. Gashi beson se këshilltari ligjor i presidentit bashkë me ekipin e tij kanë bërë një punë të mirë. "Kam bindjen se ky ekip ka dhënë argumente të mjaftueshme që dëshmojnë se procesi i zgjedhjes së presidentit ka qenë i rregullt", ka thënë ai përmes një bisede të shkurtër telefonike. Në lëndën 10 - faqeshe, sipas tij, nuk janë futur vetëm argumentet juridike, por edhe shembuj analogë të zgjedhjeve kryetarëve në shtetet e tjera. Por, për detaje Gashi nuk ka qenë në gjendje të flasë. "Unë nuk kam qenë i angazhuar drejtpërdrejt në këtë proces, por ajo që mund të them është se ne e kemi kryer obligimin tonë për t'i kthyer përgjigje Gjykatës Kushtetuese brenda afatit të përcaktuar ligjor, i cili në fakt është mbyllur dje (të enjten v.j)", ka theksuar Gashi. Ky afat është respektuar edhe nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi. Mirëpo, ai nuk e ka parë të udhës që të japë shpjegime mbi legalitetin e zgjedhjes së Behgjet Pacollit president. "E vërteta është se Gjykata Kushtetuese ka kërkuar nga unë që t'i jap komentet rreth seancës së 22 shkurtit, mirëpo unë e kam parë të arsyeshme që t'ia procedoj asaj vetëm stenogramin e mbledhjes", ka thënë Krasniqi për "Kohën Ditore". Ketë veprim ai e ka arsyetuar me faktin se seanca e Kuvendit ka qenë e hapur dhe çdokush ka pasur

rastin ta shihte rrjedhën e saj. "Unë s'kam pasur çka të them, sepse gjithçka ka qenë transparente. Tash le të gjykojë Gjykata Kushtetuese nëse ka pasur shkelje ose jo. Mua s'më takon të gjykoj", ka deklaruar Krasniqi. Kreu i Kuvendit pati reaguar pas ndërprerjes së procesit të votimit të presidentit në raundin e tretë. "Ta dini se kjo është shkelje e Kushtetutës dhe e Rregullores së Kuvendit, sepse ky është një presion mbi deputetët e Kuvendit të Kosovës ... Çdo ndryshim i rezultatit është i papranueshëm", pati thënë ai, kur Hajredin Kuçi, me insistimin e Thaçit, pati dalë në foltore për të theksuar se duhej bërë pauzë për konsulta. Dhe pikërisht çështja e presionit, sipas një hartuesi të Kushtetutës, mund të merret si argument nga Kushtetuesja që procesi i votimit të presidentit të përsëritet. "Neni 70 i Kushtetutës e definojnë që deputeti është përfaqësues i popullit dhe si i tillë nuk i nënshtrohet asnjë mandati detyrues. Në rastin konkret, shkuarja e deputetëve të PDK - së në pauzë, me ç'rast disa prej kundërshtuesve të Pacollit kanë ndërruar qëndrim, mund të llogaritet si presion mbi deputetin", ka thënë burimi i gazetës. As kryetari Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, dite më parë gjatë një interviste në KTV nuk e ka përjashtuar mundësinë që procesi i votimit për presidentin të përsëritet, nëse gjyqtarët vërtetojnë se ka pasur shkelje. "Nëse vërtetohet se ka pasur shkelje të Kushtetutës, atëherë procedura duhet të kthehet nga pika zero. Me këtë nënkuptohet se presidenti nuk ka nevojë të japë dorëheqje, por duhet t'i kthehet edhe një herë garës në Kuvend, është shprehur Hasani. Ai ka shpjeguar se "rasti Pacolli parashihet të përfundojë brenda 60 ditësh, nga dita kur lënda është proceduar në Kushtetuese. Gjyqtare raportuese në këtë rast është Iliriana Islami, kurse në kolegjin shqyrtues janë Enver Hasani, Sneshana Botusharova Doicheva dhe Ivan Çukaloviq.

---

## **Kontestimi i personalitetit të Pacollit kapitull tjetër**

---

**Lëvizja "Vetëvendosje" dhe Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK - së mund të mos durohen shpeshherë mes vete, por për Pacollin ato e kanë një të përbashkët: asnjëra nuk e njeh për president të Kosovës. Në të dyja këto subjekte thonë se kontestimi i tyre për Pacollin nuk ka të bëjë aspak me aspektin procedural të zgjedhjes, por me personalitetin e tij**

PRISHTINË, 12 MARS - Behgjet Pacolli nuk është duke u ballafaquar vetëm me kontestimin e procedurës së zgjedhjes së tij president, por edhe me atë të personalitetit të tij. Lëvizja "Vetëvendosje" dhe Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK - së mund të mos durohen shpeshherë mes vete, por për Pacollin ato e kanë një të përbashkët: asnjëra nuk e njeh për president të Kosovës. Në të dyja këto subjekte thonë se kontestimi i tyre për Pacollin nuk ka të bëjë aspak me aspektin procedural të zgjedhjes, por me personalitetin e tij. Në "Vetëvendosje" thonë se kontestimi i personalitetit të Pacollit nga kjo lëvizje nuk do të ndryshojë përgjatë tërë kohës sa ai do të jetë president. Anëtari i udhëheqjes qëndrore të "Vetëvendosje", Erzen Vraniqi, është shprehur se një verdikt i Gjykatës Kushtetuese se nuk ka pasur shkelje gjatë procedurës së zgjedhjes së Pacollit president, nuk do ta bënte të pranueshëm atë për subjektin e tij. "Ne mendojmë që Behgjet Pacolli nuk është person unifikues për popullin, aq më keq është njeri me një të kaluar të dyshimtë, marrë parasysh lidhjet e tij me ish regjimin serb, atë rus, si dhe mënyrën sesi e ka krijuar atë pasuri", ka arsyetuar Vraniqi. "Për më tepër ne mendojmë se vetë kandidatura e tij është prodhim i një koalicioni totalisht joparimor, ku për interesa personale Hashim Thaçi po ia kthen nderin që Pacolli ia ka bërë vitin e kaluar, duke e bërë të mundshëm shkarkimin e Qeverisë, e rrjedhimisht edhe zgjedhjet parakohshme". Ndryshe nga "Vetëvendosje", në OVL të UÇK - së kontestimi i personalitetit të Pacollit mund të jetë për afat më të shkurtër kohor: deri në atë kohë kur ai t'u përgjigjet në Kuvendin e Kosovës pyetjeve që ia kishin bërë para se të zgjidhej president. Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK - së, Muharrem Xhemajli, ka thënë se veteranët e UÇK - së nuk e kanë kontestuar procedurën e zgjedhjes së Pacollit president, ndaj për ta ai do të mund të bëhej i pranueshëm vetëm nëse do t'u përgjigjej në Kuvend pyetjeve që ata ia kishin bërë. "Kërkesa jonë ka qenë që ai për t'u njohur nga veteranët duhet të japë sqarime për deklaratat që janë bërë publike", ka thënë Xhemajli. "Përderisa nuk jep sqarime në Kuvendin e Kosovës para deputetëve dhe para të gjithë qytetarëve të Kosovës në pyetjet të cilat ne i kemi parashtruar, ne i kemi qëndrimet e njëjta dhe do të vazhdojmë që t'i mbajmë ato".

### **LDK - ja dhe AAK-ja e pranojnë Pacollin president nëse s'gjen shkelje Kushtetuesja**

Gjykata Kushtetuese do të mund t'ia heqë qafesh Pacollit kontestimin procedural. Dy partitë që e kontestojnë procedurën e zgjedhjes së Pacollit, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, që tash thonë se do ta pranojnë çfarëdo vendimi të Gjykatës Kushtetuese ndaj kërkesës për interpretim që kanë bërë. Por tek anëtarët e këtyre subjekteve sërish ngelin dyshime mbi personalitetin e Pacollit. LDK-ja është parti e Kosovës dhe që i respekton institucionet. Secili qytetar i Kosovës dhe secili institucion është i obliguar që ta respektojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Askush nuk ka të drejtë që të ketë një gjykim mbi

atë të kësaj gjykate", ka thënë nënkryetarja e LDK - së, Teuta Sahatqija. "Presidenti i Kosovës duhet të jetë person unifikues dhe i pranueshëm për të gjithë. Mënyra sesi është zgjedhur ka treguar që ai nuk i ka bërë dy të tretat, ku nuk është konsultuar fare opozita, dhe kjo nuk mund ta bëjë person konsensual të të gjithë spektrit". Sekretari i përgjithshëm i AAK së, Burim Ramadani, ka thënë se kjo parti s'ka për t'i bërë "naze" vendimit të Kushtetueses. "Rasti është në Gjykatë Kushtetuese dhe ne do ta pranojmë interpretimin e saj, sepse ka një sistem legal i cili duhet të pranohet. Por ne po presim që Gjykata ta rrëzojë këtë njeri", ka thënë ai. "Kemi të bëjmë me një person që ka shumë dilema rreth agjendës së tij politike", ka thënë ai. Përderisa LDK - ja dhe AAK - ja e pranojnë çfarëdo verdikti të Gjykatës Kushtetuese, është shoqëria civile ajo e cila do që Kushtetuesja ta marrë një vendim në përputhje me, siç kanë thënë, integritetin e saj. "Në rastin e zotit Pacolli ne besojmë që aty ka pasur shkelje të proceduarave dhe të Kushtetutës", ka thënë Petrit Zogaj nga lëvizja FOL, njëra nga nëntëmbëdhjetë organizatat e shoqërisë civile që patën reaguar një ditë pas zgjedhjes së Pacollit president. Por Zogaj sërish nuk e ka parë Pacollin të denjë si personalitet për ta bërë përfaqësimin e qytetarëve të Kosovës si president.

---

## Veteranët duan që Pacolli të sqarohet në Kuvend e jo në Presidencë

---

**“Ne nuk kemi asnjë takim me ta pa i dhënë ai (Pacolli v.j) sqarimet në Kuvendin e Kosovës. Ata e dinë këtë punë mirë, unë ua kam treguar edhe atyre. Përderisa nuk i jep sqarimet, ai me ne nuk ka kurrgjë, është i papranueshëm për ne”, thotë kryetari i OVL të UÇK-së, Muharrem Xhemajli**

PRISHTINË, 13 MARS - Veteranët e UÇK - së nuk duan që presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, të sqarojë deklaratat e tij në Presidencë. Ata, bile, kanë thënë të mos e kenë në plan fare të shkojnë e ta dëgjojnë Pacollin në zyrën e tij duke u rrëfyer. "Ne u kemi thënë që ne nuk kemi asnjë takim e as që e njohim, përderisa nuk i jep sqarimet në Kuvendin e Kosovës para deputetëve të Kosovës", ka thënë kryetari i OVL të UÇK - së, Muharrem Xhemajli, të dielën. Deklarata e të parit të OVL të UÇK - së ka qenë kundërreagim ndaj Ibrahim Gashit, këshilltar kryesor i presidentit Pacolli. Në një prononcim për gazetën Gashi nuk e ka parë të nevojshme që shefi i tij të sqarohet në Kuvend. "Ai (Pacolli v.j) do t'i presë në Presidencë shumë shpejt dhe do të bisedojmë, dhe unë besoj që një pjesë e madhe e këtyre kategorive tashmë jo vetëm që e kanë pranuar atë, por janë optimistë dhe presin që përmes një pune qaq proaktive që po bën zoti Pacolli mund të përfitojnë edhe këto kategori shumë më shumë sesa në të kaluarën", ka thënë Gashi. Mirëpo Xhemajli ka ngulur këmbë. "Ne nuk kemi asnjë takim me ta pa i dhënë ai (Pacolli v.j) sqarimet në Kuvendin e Kosovës. Ata e dinë këtë punë mirë, unë u kam treguar edhe atyre. Përderisa nuk i jep sqarimet, ai me ne nuk ka kurrgjë, është i papranueshëm për ne", ka thënë Xhemajli. "Ata na kanë thirrur që njëqind herë, por nuk kemi shkuar ne". I pari i veteranëve të UÇK - së ka thënë se nuk ka shanse që veteranët ta fitojnë simpatinë siç ka pretenduar Gashi, pa i sqaruar Pacolli ato që i ka thënë. Ai ka pohuar se përfaqëson mijëra ish - luftëtarë të UÇK - së. "Organizata që unë e drejtoj i ka njëzet e pesë mijë anëtarë", ka thënë Xhemajli. "Ne i përfaqësojmë ata veteranë, asnjë prej tyre deri më tash nuk ka dalë për të thënë deri tash se nuk e keni mirë ose nuk jeni duke vepruar mirë. Ne besojmë që e kemi pëlqimin e të gjithë veteranëve". E tëra midis veteranëve dhe Pacollit kishte nisur më 19 shkurt të këtij viti, kur OVL e UÇK - së e kishte nisur një letër publike në adresë të kryetarit, të Kryesisë dhe të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilët do të zgjidheshin më 21 shkurt. Veteranët kërkonin që Pacolli t'i sqaronte deklaratat e tij kontroverse dhënë medieve ndërkombëtare. Por kur Pacolli u zgjodh president ai foli për shumë gjëra në Kuvendin e Kosovës, por nuk dha edhe përgjigje për ish - luftëtarët e UÇK - së. Reagimi i tyre erdhi fillimisht verbal duke thënë se nuk e njohin Pacollin për president, por më pas u materializua edhe në veprim, kur në manifestimin qendror të "Epopesë së UÇK - së" në kazermën "Adem Jashari" ata nuk morën pjesë fare, meqë aty gjendej edhe Pacolli. Xhemajli i ka thënë gazetës se kontestimi i Pacollit si president do të vazhdojë deri kur ai të veprojë ashtu siç i kanë kërkuar ata. Behgjet Pacolli që zgjedhur president i Kosovës më 22 shkurt të këtij viti në një seancë problematike të Kuvendit të Kosovës. Jo shumë kohë pastaj Gjykata Kushtetuese pranoi një kërkesë të një pjese të opozitës, me të cilën kontestohet procedura e zgjedhjes së Behgjet Pacollit president. Por në të 34 deputetët e LDK - së dhe të AAK - së nuk kanë përfshirë argumentin kryesor që pretendohet se do ta çonte në shkarkim Pacollin - votimin e tij për

Qeverinë në cilësinë e deputetit, pasi kishte dhënë betimin si president por vetëm është kontestuar kushtetutshmëria e vendimit të Kuvendit për vënien e biznesmenit kontrovers në majë të pushtetit. "Rasti Pacolli" parashihet të përfundoj brenda 60 ditësh, nga dita kur lënda është proceduar në Kushtetuese. Gjyqtare raportuese në këtë rast është Iliriana Islami, kurse në kolegjin shqyrtues janë: Enver Hasani, Snezhana Botuaharova Doicheva dhe Ivan Çukaloviq. Veç kontestimit procedural, Pacolli ballafaqohet edhe me kontestim të personalitetit të tij.



---

## **Plan për rrëzimin e Pacollit dhe Thaçi**

---

**Është zbuluar një plan i shoqërisë civile për rrëzimin e institucioneve të reja të vendit. Kryeministri Thaçi i pyetur nga mediat, ka mohuar të ketë dijeni për këtë**

Është zbuluar një plan i një pjesë të shoqërisë civile për të rrëzuar nga pushteti Presidentin Behgjet Pacolli dhe Kryeministrin Hashim Thaçi. Agjencia e lajmeve Qendra, ka zbuluar një plan të shoqërisë civile, sipas të cilit do të rrëzohej Qeveria dhe Presidenti. Aty parashihet fushatë, protesta dhe aksione tjera që do të çonin në rrënimin e institucioneve. Emrat e organizatorëve janë të njohur për redaksinë Qendra, por ata kanë vendosur të botojnë vetëm planin e tyre dhe jo emrat e personave.

### **Plani**

"Më datën 22 shkurt 2011, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në një seancë të jashtëzakonshme, ka zgjedhur Presidentin dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës. Procesi i zgjedhjes së Presidentit është shoqëruar me parregullsi të cilat dëmtojnë integritetin e institucionit të Presidentit të Republikës, si dhe funksionimin demokratik institucioneve shtetërore të Kosovës. Në anën tjetër, përbërja e qeverisë së re, të votuar në të njëjtën seancë, nuk pasqyron vullnetin e qytetarëve të Kosovës për qeveri me duar të pastra dhe kompetente për të implementuar agjendën e shtetndërtimit në raport me sfidat që e presin shtetin e ri. Shqetësim tjetër mjaft serioz i këtyre ngjarjeve është edhe ndërhyrja direkte e faktorit ndërkombëtar në përzgjedhjen e bartësve të institucioneve shtetërore, duke e tejkaluar çdo normë të pranueshme diplomatike. Për këtë arsye, organizatat e shoqërisë civile, të tubuara rreth fushatës për integritetin e institucioneve, e kanë vlerësuar si të domosdoshëm shprehjen e organizuar të pakënaqësisë dhe mospajtimit qytetar me zhvillimet e fundit politike, të cilat e shkelin vullnetin qytetar dhe Kushtetutën e vendit. Veprimet të cilat do të ndërmerren në kuadër të kësaj fushate synojnë korrigjimin e këtyre parregullsive dhe nuk do të ndalen derisa të sigurohen standardet e nevojshme të respektimit të vullnetit qytetar, ligjshmërisë (kushtetutshmërinë) nëpër institucione dhe funksionimit demokratik të shtetit të Kosovës", thuhet në planin e veprimit të kësaj fushate të shoqërisë civile për integritetin e institucioneve shtetërore. Organizatat e shoqërisë civile që do të implementojnë fushatën për institucione demokratike dhe legjitime, fazën e parë të fushatës kanë paraparë ta implementojnë gjatë marsit të këtij viti. "Në javën e fundit të marsit, organizatat e fushatës, bazuar në (mos) veprimin e institucioneve shtetërore, do të përgatisin fazën e dytë të fushatës, e cila do të fillojë në javën e parë të prillit. Plani i detajuar i aktiviteteve për fazën e parë të fushatës gjendet në fund të dokumentit. Gjatë fushatës, organizatat e involvuara do të ndërmarrin veprimet e mëposhtme, por nuk do të kufizohen vetëm me to, protesta ditore, shkrime në gazeta, deklarata të përbashkëta publike, konferenca për media, dekonstruktiv i ngjarjeve, takime mobilizuese me organizata joqeveritare nëpër komuna tjera, takime mobilizuese me sindikatat e punës, takime mobilizuese me studentët, performanca artistike, debate televizive, grupi në Facebook, posterët dhe flajerë, protesta e madhe ...", thuhet në planin e veprimit.

## **Kjo nuk është demokraci**

Ndërkohë, Kryeministri Hashm Thaçi, i pyetur të dielën nga mediat lidhur me këtë informatë, ka thënë se nuk është në dije dhe, sipas tij, pretendime të tij nuk janë demokratike dhe janë në kundërshtim me vullnetin e qytetarëve. “Qytetarët i kanë zgjedhur institucionet me vullnetin e tyre, qeverinë edhe të gjitha institucionet, natyrisht edhe partitë opozitare. Vullneti i qytetarëve duhet respektohet nga të gjithë, prandaj duhet të respektohet legjitimiteti dhe prandaj asesi të pretendohet që dikush përmes dhunës dhe të uzurpojë apo të marrë diçka të tillë nuk pranon populli i Kosovës dhe as bota demokratike”, ka thënë ai.

---

## Dështon Komploti

---

### Planifikonin t'i rrëzonin Thaçin dhe Pacollin

**Në këtë plan përmenden emri i Flaka Surroit, Halil Matoshit, Enver Robellit dhe Arbana Xharrës. Ramadan Ilazi nga Lëvizja "Fol" ka konfirmuar ekzistimin e këtij plani, por ka mohuar përfshirjen në të, edhe pse i përmendet emri. Ai, po ashtu, ka mohuar se këtë plan e ka përgatitur shoqëria civile, edhe pse ka pranuar se këtë plan e ka propozuar një person i respektuar nga shoqëria civile, emrin e të cilit nuk e ka bërë publik**

PRISHTIË, 13 MARS - Ka dështuar plani për rrëzimin e institucioneve të Kosovës, i përgatitur nga një pjesë e shoqërisë civile. Ky plan ishte planifikuar të nisë në javën e parë të muajit mars deri në prill, duke mbajtur çdo ditë protesta nga 45 minuta para Kuvendit të Kosovës. Për realizimin e këtij plani ishte paraparë mbajtja e kontakteve me sindikalistët e punëtorëve, me studentët si dhe përhapja e fushatës nëpërmjet mjeteve të informimit dhe rrjetit social "Facebook". Sipas këtij plani, më 7 mars do të protestonin mësuesit, më 8 mars gratë, më 9 mars gazetarët, artistët, intelektualët, më 10 mars studentët, më 11 mars (nuk përcaktohet cila kategori, më 14 mars minatorët, kurse më 20 mars ishte planifikuar mbajta e një proteste të madhe. Po sipas këtij plani, paralajmërimi i fushatës i ishte besuar Halil Matoshit, kolumnist i "Kohës Ditore", kurse për dekonstruktimin e ngjarjeve, për kredibilitetin e presidentit dhe kryeministrit, për bisedimet me Serbinë, rritjen e rrogave dhe krizën sociale, ishte paraparë të shkruanin Enver Robelli (kolumnist në të përditshmen "Koha Ditore", Flaka Surroi (drejtoreshë e kompanisë mediale "Koha" dhe Arbana Xharrë (redaktore në të përditshmen "Zëri"). Plani, të cilin e ka siguruar "Epoka e re" ishte paraparë të implementohet në dy faza. Faza e parë ishte paraparë të implementohet gjatë muajit mars, faza e dytë në javën e parë të muajit prill. "Gjatë fushatës organizatat e përfshira do t'i ndër marrin veprimet e mëposhtme, por nuk do të kufizohen vetëm me to: Protesta ditore, shkrime në gazeta, deklarata të përbashkëta publike, konferenca për medie, dekonstruktim të ngjarjeve, takime mobilizuese me OJQ - të nëpër komunitatet e tjera, takime mobilizuese me sindikatën e punës, takime mobilizuese me studentët, performanca artistike, debate televizive, grupi në 'Facebook', posterët dhe flyerët, protesta e madhe", është planifikuar në planin për rrëzimin e institucioneve të Kosovës.

### Matoshi dhe Lëvizja "Fol" mohojnë përfshirjen në këtë plan

I kontaktuar nga "Epoka e re" njëri nga emrat e përfolur në këtë plan, publicisti Halil Matoshi, ka mohuar të ketë qenë pjesë e këtij plani. Ai ka thënë se nuk është në dijeni se për çfarë plani bëhet fjalë. "Absolutisht jo. Nuk jam i inkuadruar në asnjë prej organizatave qeveritare dhe joqeveritare. Kështu që nuk po di se për çfarë është ai send. Unë vazhdoj të merrem me punën time profesionale dhe kaq", ka thënë Matoshi. Edhe pse i përmendet emri, përfshirjen në këtë plan e ka mohuar edhe përfaqësuesi i Lëvizjes "Fol", Ramadan Ilazi. Por, Ilazi ka thënë për "Epokën e re" se kanë qenë në dijeni për këtë plan. "Ai nuk është plan i shoqërisë civile. Ka qenë plan i propozuar nga një individ, i cili ka menduar nga pikëvështrimi i tij i mirë, pra në aspektin e reagimit për një shkelje që është evidentuar në seancën e Kuvendit të Kosovës. Pra, ka qenë propozim i një personi të respektuar prej shoqërisë civile. Por, ky plan nuk është realizuar asnjëherë, siç mund ta vëreni edhe nga datat", ka thënë Ilazi. Ai ka thënë se Lëvizjes

"Fol" i është ofruar si propozim ky plan. "Ky plan na është ofruar si propozim nga ai individ, por nuk e kemi mbështetur. As organizatat e tjera që iu përmendet emri në atë plan nuk e kanë mbështetur", ka treguar Ilazi. Ilazi ka thënë se emri i Lëvizjes "Fol" është përmendur pa lejen e tyre në plan. "Nuk ka pasur dakordim të shoqërisë civile për atë plan. Ka pasur diskutim brenda shoqërisë civile për mënyrën e reagimit apo mosreagimit. I vetmi dakordim i shoqërisë civile ka qenë një deklaratë e përbashkët, të cilën e kemi dhënë në një konferencë për medie", ka thënë Ilazi. Pavarësisht përpjekjeve të gazetës, ka qenë e pamundur të kontaktohet redaktorja e së përditshmes "Zëri", Arbana Xharra, emri i së cilës figuron në këtë plan.

---

## **Pacolli dhe Daka dakordohen për ndryshimin e sistemit të zgjedhjeve**

---

Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, zhvilloi të hënën një takim me kryetaren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, i cili konsiderohet si takim në të cilin u dhanë nismat e para rreth ndryshimeve në ligjin e zgjedhjeve, por edhe për ndryshimin e pikës së Kushtetutës, e cila e përcakton Kosovën si një zonë zgjedhore. Presidenti theksoi se eksperiencia jo e mirë në zgjedhjet e fundit është ajo që duhet të na shtyjë të punojmë për këto ndryshime, ndërsa u angazhua për një tryezë të përbashkët ku do të diskutohen këto çështje. **“Zyra e presidentit synon që sa më shpejtë të organizojë një tryezë me përfaqësuesit e partive të ndryshme, qofshin ato parlamentare, të opozitës ose të koalicionit, qofshin edhe ato jashtë Parlamentit, si dhe me shoqërinë civile në mënyrë që të dëgjojmë idetë në çfarë mënyre t’ia fillojmë reformimit të Ligjit zgjedhor. Në bazë të këtyre ideve ne do të formojmë edhe një komision, i cili do të punojë drejtpërsëdrejti në formulimin e një propozimi, i cili në të ardhmen, me miratimin e spektrit politik dhe shoqërisë civile, do të jetë edhe ligji zgjedhor i ardhshëm”**, tha presidenti Pacolli para gazetarëve pas takimit. **“Po ashtu kemi biseduar edhe marrjen parasysh të aspektit teknologjik të organizimit të zgjedhjeve të ardhshme, kemi pasur një mirëkuptim nga të dyja palët dhe nga sot vazhdon bashkëpunimi ynë në reformimin e Ligjit zgjedhor të Republikës së Kosovës”**, tha presidenti Pacolli. Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve tha se me presidentin diskutuan lidhur me reformën zgjedhore, sidomos lidhur me rolin e KQZ-së në këtë reformë zgjedhore, e cila pritet të bëhet shumë shpejtë, me ndihmën edhe të presidentit dhe të zyrës së tij dhe e falënderoi presidentin për përkrahje, ndërsa shfaqti shpresën që grupi punues do të fillojë sa më shpejtë punën.



*Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, zhvilloi një takim me kryetaren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, i cili konsiderohet si takim në të cilin u dhanë nismat e para rreth ndryshimeve në ligjin e zgjedhjeve por edhe për ndryshimin e pikës së Kushtetutës, e cila e përcakton Kosovën si një zonë zgjedhore*

---

## **Pacolli me lëndën e dytë në Gjykatë**

---

**Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do ta dërgojë edhe padinë e dytë kundër Presidentit Behgjet Pacolli që ka të bëjë me votimin e tij pas zgjedhjes President dhe betimit të tij para deputeteve. Ndërsa, dy partitë tjera opozitare ende nuk kanë qëndrim nëse do ta përkrahin ose jo AAK-në**

Presidentit të Kosovës, Behgjet Pacolli, do t'i deponohet edhe lënda e dytë në Gjykatën Kushtetuese. Iniciativën për këtë e ka marrë partia opozitare, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Partia e katërt në vend, këtë kërkesë do ta bëjë për shkak të shkeljes së Kushtetutës së Kosovës nga presidenti i sapo zgjedhur në seancën e 22 shkurtit, kur kishte votuar qeverinë, pasi që ishte zgjedhur në postin e presidentit dhe kishte dhënë betimin. Sekretari i kësaj partie Burim Ramadani ka thënë se janë në përfundim të ankesës dhe posa ta përfundoj në do ta dërgojnë në Gjykatën Kushtetuese. "Ende se kemi përfunduar, po sa ta kompletojmë do ta dërgojmë", ka thënë Ramadani. Ndërsa, AAK-së patjetër i duhet edhe ndihma e dy partive tjera opozitare për t'i siguruar 30 nënshkrime të deputetëve, pasi ajo ka vetëm 11 deputetë, derisa Kushtetuta thotë se patjetër duhet të jenë nënshkrimet e 30 deputetëve. Megjithatë, AAK-ja ende nuk u ka bërë asnjë kërkesë dy partive tjera opozitare, LDK-së dhe Vetëvendosjes, për ta mbështetur rreth kësaj çështjeje. E për këtë edhe Ramadani ka thënë se ende nuk i kanë dërguar kërkesë dy partive tjera opozitare që ta nënshkruajnë këtë ankesë.

### **LDK e Vetëvendosje ende pa qëndrime**

Por, për iniciativën e AAK-së, dy partitë tjera opozitare ende nuk kanë marrë vendim nëse do ta përkrahin ose jo, edhe pse votimin e presidentit për qeverinë e cilësojnë si shkelje kushtetuese. Lidhja Demokratike e Kosovës thotë se nuk kanë ndonjë kërkesë nga AAK-ja për këtë çështje, por, në momentin që do t'u shkojë një kërkesë e tillë, do ta shqyrtojnë seriozisht këtë. Zëdhënësi LDK-së, Kujtim Shala ka thënë se një mundësi për të bërë kërkesë e kanë lënë për shqyrtim edhe ata si parti. "Do ta shqyrtojmë edhe do të vendosim edhe për këtë. Ne edhe ashtu kemi pasur në plan që të diskutojmë për këtë pavarësisht a kërkon AAK-ja apo jo. Ne kemi pas lënë që të diskutojmë dhe të vendosim a do të bëjmë kërkesën e dytë për interpretim", ka thonë Shala. Edhe Glauk Konjufca nga Vetëvendosja ka thënë se ende nuk iu ka shkuar ndonjë kërkesë nga AAK-ja për t'iu ndihmuar në kompletimin e nënshkrimeve të dhura për të dërguar një ankesë në Gjykatë. "Po ne së pari nuk kemi kërkesë nga AAK-ja, nuk na ka ardhur, por pasi të kemi ndonjë kërkesë, ne do ta shqyrtojmë dhe do të vendosim. Do ta shikojmë çka përmban pastaj marrim qëndrim", ka thënë Konjufca. Por, megjithatë edhe pse kanë qëndrim final, sipas Konjufcës votat e Pacollit për qeverinë pas zgjedhjes së tij në postin e presidentit është shkelje kushtetuese. "Ajo është shkelje dhe ne mbështesim këtë qëndrim. Por nëse është nevoja do ta mbështesim, nëse ju vyen numrat apo diçka tjetër, por mendoj se edhe me LDK-në mund ta bëjnë këtë", ka thënë Konjufca.

---

## Presidenti Italian Giorgio Napolitano e fton për vizitë presidentin Pacolli

---

*"Ju e dini se kemi pas një eksperiencë jo të mirë në zgjedhjet e fundit, prandaj e pash si të arsyeshme që të fillohet ndërrimi i Kushtetutës, e sidomos ajo pikë në Kushtetutë, e cila e përcakton Kosovën si një zonë zgjedhore", tha Pacolli .*

Ligji zgjedhor duhet të reformohet dhe se zgjedhjet e fundit treguan shumë dobësi të tij, pohoi presidenti Pacolli pas takimit me kryetaren e KQZ-së.

Presidenti i Republikës së Italisë, Giorgio Napolitano i ka dërguar një ftesë zyrtare Presidentit të Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli për ta vizituar vendin e tij. Presidenti Pacolli do të takohet me Presidentin Napolitano. Ai gjithashtu do të marrë pjesë në ceremoninë zyrtare të 150 vjetorit të formimit të Italisë së bashkuar, që do të mbahet më 2 qershor në Romë. "Prania Juaj do të ishte një nder për mua e për Qeverisë Italiane dhe do të përbënte një dëshmi të re domethënëse të lidhjeve të forta të miqësisë që bashkojnë Kosovën me Italiane. Me shpresën se shumë shpejt do t'ju takoj në Romë, kam kënaqësinë t'ju shpreh përshëndetjet e mia më të përzemërta", shkruan ndër të tjera në ftesën e tij Presidenti i Italisë, Giorgio Napolitano. Presidenti Pacolli e ka pranuar ftesën të hënën nga ambasadori i Italisë në Kosovë, z. Michael Giffoni, bën të ditur Zyra për informim e Presidencës. Gjatë vizitës në Romë, Presidenti Pacolli do të realizojë takime edhe me zyrtarë të tjerë të lartë të shtetit italian, me komunitetin e biznesit dhe takime të tjera. Ndërsa, në një takim tjetër presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, pas një takimi me kryetaren e Komisionit Qendror Zgjedhor, Valdete Daka, paralajmëroi ndryshimin e Ligjit për zgjedhjet. Presidenti Pacolli tha se ishte një takim në të cilin me kryetaren e KQZ-së, znj. Daka, bisedoi për reformimin e sistemit zgjedhor. **"Ju e dini se kemi pas një eksperiencë jo të mirë në zgjedhjet e fundit, prandaj e pash si të arsyeshme që të fillohet ndërrimi i Kushtetutës, e sidomos ajo pikë në Kushtetutë, e cila e përcakton Kosovën si një zonë zgjedhore"**, tha Pacolli. Ai tha se qëllimi i Presidencës është që sa më shpejtë të organizojë një tryezë me përfaqësuesit e partive politike, atyre parlamentare dhe joparlamentare dhe me shoqërinë civile, në mënyrë që të fillohet reformimi i sistemit zgjedhor. **"Në bazë të këtyre ideve, ne do të formojmë një komision, i cili do të punojë drejtpërsëdrejti në formulimin e një propozimi, i cili në të ardhmen me miratimin e spektrit politik dhe shoqërisë civile do të jetë edhe ligji zgjedhor i ardhshëm"**, tha Pacolli. Edhe kryetarja e KQZ- së, Valdete Daka theksoi se me presidentin kanë biseduar për reformat zgjedhore dhe pret ndihmë nga zyra e presidentit. "Kemi pasur një takim për reformën zgjedhore, sidomos për rolin e KQZ-së në reformën zgjedhore, e cila pritet të bëhet me ndihmën e presidentit dhe të zyrës së presidentit. Ne e falënderojmë zotin president lidhur me grupin punues, ne shpresojmë se shumë shpejt ky grup punues do të fillojë punën", tha Daka. B.S



---

## Pacolli nuk i deklaron milionat

---

Presidenti Behgjet Pacolli mund të përballet me ndëshkim ligjor për kundërvajtje nëse brenda afatit të paraparë nuk e paraqet deklaratën e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit. Kreu i kësaj agjencie, Hasan Preteni, tha për gazetën se për të parin e vendit afati i paraqitjes së pasurisë së tij përfundon javën e fundit të muajit mars, derisa për deputetët e rinj është paraparë afati ligjor prej 60 ditësh, që nga data e konstituimit të Kuvendit të ri të Kosovës. "Ai duhet ta deklarojë pasurinë deri më 31 mars. Vetëm ata që e deklarojnë pasurinë për herë të parë vlen afati prej 60 ditësh, kurse Presidenti në mandatin e kaluar ka qenë deputet", tha për gazetën z. Preteni. Gazeta ka provuar gjatë ditës së djeshme të vendosë kontakt me Zyrën e Presidentit, por një kontakt i tillë nuk ka qenë i mundur.

Kreu i AKK - së ka sqaruar se deri tash në AKK janë pranuar 124 lista të zyrtarëve të lartë publikë nga institucionet e Republikës së Kosovës me deklaratat e pasurisë, kurse AKK - ja është në pritje edhe të 11 listave tjera, që ende nuk i ka pranuar. "Duke u bazuar në listat momentale që i kemi pranuar në AKK nga institucionet përkatëse, konstatohet se kemi 1788 zyrtarë të lartë publikë që e kanë për obligim ta bëjnë deklarimin e pasurisë së tyre", tha Preteni. Sipas ligjit, deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publikë, parashihet që të gjithë zyrtarët e lartë publikë e kanë për obligim të bëjnë deklarimin e rregullt vjetor brenda tremujorit të parë të vitit, që nënkupton datën 31 mars të çdo viti kalendarik. Po ky ligj parasheh kriteret tjera për personalitetet që detyra të larta zyrtare marrin për herë të parë. "Deklarimi me rastin e marrjes së detyrës duhet të bëhet brenda gjashtëdhjetë ( 60 ) ditëve", precizon ligji në fjalë. Gjithashtu po me këtë ligj parashihet që deklarimi i pasurisë të behët edhe pas largimit nga funksioni brenda një afatit prej 30 ditësh. Ana e dobët e këtij ligji, që edhe nuk respektohet ndonjëherë nga figura të larta politike, është se nëpërmjet tij nuk ka mundësi të penalizimit të atyre që nuk e përfillin në tërësi. Në rastet kur zyrtarët e lartë publike nuk i respektojnë afatet ligjore, AKK - ja e ka për obligim ta iniciojë procedurën kundërvajtës në instancat e drejtësisë, konform nenit 16 të këtij ligji , S.A.

---

## **Pacolli: S'ka Dialog për statusin**

---

**I garantoj qytetarët e Kosovës se asnjëherë nuk do të ketë dialog apo biseda që e prekin sovranitetin e Kosovës. Nuk do të ketë dialog as për sovranitetin e Kosovës, as për kufijtë e Kosovës, as për statusin, as për Kushtetutën. Këto janë gjëra të kryera. Ndryshimi i këtyre gjërave iu përket ekskluzivisht kosovarëve", ka thënë Pacolli**

PRISHTINË, 14 MARS - Presidenti Behgjet Pacolli ka garantuar të gjithë qytetarët se nuk do të ketë kurrfarë dialogu me Serbinë për çështjet të cilat kanë të bëjnë me integritetin dhe sovranitetin e Kosovës. **"I garantoj qytetarët e Kosovës se asnjëherë nuk do të ketë dialog apo biseda që e prekin sovranitetin e Kosovës. Nuk do të ketë dialog as për Sovranitetin e Kosovës, as për kufijtë e Kosovës, as për statusin, as për Kushtetutën. Këto janë gjëra të kryera. Ndryshimi i këtyre gjërave iu përket ekskluzivisht kosovarëve"**, ka thënë Pacolli, duke shtuar se ky dialog ka të bëjë vetëm me çështje teknike. Gjatë ditës lidhur me këtë temë ka folur edhe ambasadori i Francës në Prishtinë, Jean François Fitou. Ai ka thënë se dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit nuk ka të bëjë me çështjet politike, por teknike, me qëllim të përmirësimit të jetës së qytetarëve të dy vendeve. Ambasadori Fitou ka thënë se qëndron prapa fjalëve të kryeministrit Hashim Thaçi, i cili të dielën, para nisjes për në Turqi, pati deklaruar se përjashton çdo mundësi që pjesë e dialogut të jetë statusi dhe integriteti territorial i Kosovës. "Po, për shkak se ne kemi thënë se ky dialog nuk ka të bëjë me çështjet e territorit, të kufijve dhe sovranitetit. Dialogu ka të bëjë me çështjet teknike dhe të jetës së përditshme të qytetarëve shqiptarë dhe serbë. Ky dialog do ta lehtësojë lëvizjen e njerëzve, si dhe do ta lehtësojë tregtinë", ka thënë ambasadori Fitou me rastin e hapjes së Festës Ndërkombëtare të Frankofonisë në Kosovë.

## **Admirali Locklear vëren ndryshime pozitive**

**Në takim, presidenti Pacolli ka kërkuar nga komandanti i forcave të bashkuara të NATO-s në Napoli, admiral Samuel J. Locklear, që eprorët e FSK-së të shkollohen në akademitë ushtarake të NATO-së**

PRISHTINË, 15 MARS - Komandanti i Forcave të Bashkuara të NATO - së në Napoli, admiral Samuel J. Locklear, ka deklaruar të martën në Prishtinë se gjatë gjashtë muajve të fundit ka qenë disa herë në Kosovë dhe ka vërejtur një varg ndryshimesh pozitive, rezultat i të cilave është edhe zvogëlimi i trupave të KFOR - it në Kosovë, zvogëlim ky që nuk e zbeh rëndësinë e kësaj force. Këtë deklaratë ai e bëri pas takimit me presidentin e Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, i cili në këtë takim shoqërohej nga komandanti i trupave të KFOR - it, gjeneralmajori Erhard Bühler. Presidenti Pacolli ka falënderuar admiralin Locklear për gjithë kontributin që NATO -ja ka dhënë dhe po jep në vazhdimësi për popullin e Kosovës, me theks të veçantë në ndihmën e vazhdueshme për trajnimin dhe profesionalizimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK). Në këtë plan ai ka kërkuar që eprorët e FSK së të shkollohen në akademitë e ndryshme ushtarake të NATO - s. Gjithashtu, presidenti Pacolli ka përsëritur kërkesën që pjesëtarët e FSK - së të jenë pjesë e misioneve paqësore në botë, në kuadër të NATO - s, kudo ku kjo shihet e nevojshme. Në një deklaratë bërë pas takimit, presidenti Pacolli theksoi se nga admiral Samuel J. Locklear ka marrë garanci që NATO - ja do të jetë pjesë e halleve të qytetarëve të Kosovës, NATO - ja do të ndihmojë Forcën e Sigurisë të Kosovës. **"Nga ana ime shpreha gatishmërinë e bashkëpunimit pa limite me NATO - në, sidomos me KFOR - in këtu në Kosovë, shpreha falënderimet e popullit të Kosovës dhe të miat personale për këtë çka KFOR - i është duke bërë për Kosovën në drejtim të përgatitjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës për të rrugëtuar së bashku në të ardhmen në shtëpinë e madhe të NATO - s",** tha Pacolli. Presidenti Pacolli ka folur edhe për rolin e pranisë së trupave të KFOR - it në Kosovë, që është një prani shumë e rëndësishme dhe për të cilën qytetarët e Kosovës kanë një admirim dhe respekt të pakufishëm. Ai gjithashtu ka folur edhe për reduktimin e trupave të KFOR - it, duke shtuar se krahas zvogëlimit të trupave është shtuar kualiteti i tyre veprimit, ndërkohë që vetë zvogëlimi i këtyre trupave është shenjë e gjendjes stabile në vend, por edhe e rritjes së kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe të Policisë së Kosovës. Komandanti i forcave të bashkuara të NATO - s në Napoli, admiral Samuel J. Locklear, ka theksuar se gjatë gjashtë muajve të fundit ka qenë disa herë në Kosovë dhe ka vërejtur gjatë kësaj periudhe një varg ndryshimesh pozitive. "Kosova dhe NATO - ja kanë bërë një rrugë të gjatë bashkë dhe do ta vazhdojnë këtë rrugëtim", tha ai, ndërsa shtoi se zvogëlimi i trupave të KFOR-it në Kosovë nuk e zvogëlon rëndësinë e tij. Ai premtoi se në periudhën e ardhshme do të bëhet vlerësimi i përbushjes së kapaciteteve të plota operative të Forcës së Sigurisë Kosovës.



*Komandanti i Forcave të Bashkuara të NATO - s në Napoli, admirali Samuel J. Locklear u prit në takim nga presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, i cili në këtë takim shoqërohej nga komandanti i trupave të KFOR - it, gjeneralmajori Erhard Bühler.*

---

## Pacolli për ndryshimin e Kushtetutës

---

**Reforma zgjedhore dhe mënyra e zgjedhjes së presidentit nga vota e qytetarëve janë prioritetet e kryetarit të shtetit, Behgjet Pacolli**

PRISHTINË - Zgjedhja e presidentit në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vota e qytetarëve dhe ndarja e Kosovës në shumë zona zgjedhore janë prioritetet në të cilat do të fokusohet kryetari i vendit, Behgjet Pacolli. I pari i shtetit tha të hënën se shumë shpejt do të fillojnë procedurat për ndryshimin e Kushtetutës në nenet që flitet për zgjedhjen e presidentit, por edhe të Ligjit për zgjedhjet. Sipas tij, për këtë çështje do të organizohet një tryezë e përbashkët e të gjitha subjekteve politike parlamentare dhe joparlamentare dhe shoqërisë civile. Këto komente Pacolli i bëri pas takimit të parë që ka zhvilluar me kryetaren e Komisionit Qendror Zgjedhor, Valdete Daka, të cilët u pajtuan se duhet filluar me reformimin e Ligjit për zgjedhjet. Duke marrë parasysh parregullsitë e shumta që e kanë shoqëruar procesin zgjedhor në zgjedhjet e jashtëzakonshme nacionale të 12 dhjetorit, kreu i vendit, Behgjet Pacolli e konsideroi të pashmangshme reformën zgjedhore. **"Kemi pasur një eksperiencë jo të mirë në zgjedhjet e fundit, prandaj duhet fillohet me ndërrimin e Kushtetutës, e sidomos ajo pikë, e cila e përcakton Kosovën si një zonë zgjedhore"**, deklaroi Pacolli. Sipas tij, në bazë të ideve që do të dalin nga tryeza e përbashkët e gjithë spektrit politik dhe shoqërisë civile, do të formohet një komision, i cili do të punojë drejtpërdrejt në formulimin e një propozimi për Ligjin e ri të zgjedhjeve. Edhe kryetarja e KQZ - së, Valdete Daka, theksoi se institucioni që ajo drejton do të bëjë një analizë të detajuar të rrjedhës së procesit të fundit zgjedhor pengesave dhe problemeve që, me qëllim të evidentimit të pengesave dhe problemeve që e kanë shoqëruar procesin e zgjedhjeve. "Ne kishim një takim për reformën zgjedhore, sidomos për rolin e KQZ - së në reformën zgjedhore, e cila pritet të bëhet me ndihmën e presidentit dhe të Zyrës së Presidentit. Prandaj, presim që shumë shpejt grupi punues të fillojë punën", ka thënë Daka. Ndërkaq, sa i përket ndryshimit të Kushtetutës, gjegjësisht nenit që flet për zgjedhjen e presidentit Pacolli tha se **"është lobues i madh i ndryshimit të këtij neni"**. Sipas tij, presidenti i zgjedhur nga vota e popullit është legjitim dhe për këtë ai premtun që do t'i mobilizojë gjithë mekanizmat për ndërrimin e nenit për zgjedhjen e presidentit. **"Në këtë drejtim jemi duke punuar dhe shumë shpejt do të krijohet një komision i përbërë nga partitë politike dhe shoqëria civile për ndryshimin e Kushtetutës në nenin për zgjedhjen e presidentit"**, ka thënë kryetari Behgjet Pacolli.



*Presidenti Behgjet Pacolli ka zhvilluar një takim me kryetaren e Komisionit Qendror Zgjedhor, Valdete Daka, të cilët u pajtuan se duhet filluar me reformimin e Ligjit për zgjedhjet*

---

## **Pacolli: Eprorët e FSK-së t'i shkollojë NATO-ja në akademitë e saj**

---

PRISHTINË, 15 MARS - Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli priti të martën në takim admiralin Samuel J. Locklear, komandant i Forcave të Bashkuara të NATO-s në Napoli, i cili shoqërohej nga komandanti i trupave të KFOR-it, gjenerali Erhard Buhler. Presidenti Pacolli ka falënderuar admiralin Locklear për gjithë kontributin që NATO-ja ka dhënë dhe po jep në vazhdimësi për popullin e Kosovës, me theks të veçantë në ndihmën e vazhdueshme për trajnimin dhe profesionalizimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës. Presidenti Pacolli ka kërkuar që eprorët e FSK-së të shkollohen në akademitë e ndryshme ushtarake të NATO-s. Gjithashtu, Presidenti Pacolli ka kërkuar që pjesëtarët e FSK-së të jenë pjesë e misioneve paqësore në botë, në kuadër të NATO-s, kudo ku kjo shihet e nevojshme. **"Ne do të bashkëpunojmë edhe me NATO-n edhe me KFOR-in këtu dhe biseduam po ashtu edhe për trajnimin e trupave të FSK-së në akademi të ndryshme ushtarake të NATO-s dhe pse jo edhe pjesëmarrjen e trupave tonë misionet humanitare jashtë Kosovës, bashkë me NATO-n"**, pohoi presidenti Pacolli. Presidenti Pacolli theksoi para medieve se nga admirali Samuel J. Locklear ka marrë çdo garanci që NATO-ja do të jetë pjesë e halleve të qytetarëve të Kosovës, dhe se do t'i dal në ndihmë FSK-së. **"Edhe një herë mora çdo garanci se NATO-ja do të jetë pjesë e halleve të qytetarëve të Kosovës, NATO-ja do të ndihmojë, trupat e FSK-së që të përgatiten dhe në të ardhmen të rrugëtojnë bashkë me to"**, tha presidenti Pacolli. Në anën tjetër Pacolli tha se ka shprehur falënderimet e tij në emër të popullit të Kosovës për gjithçka KFOR-i ka bërë për Kosovën dhe për ndihmën që i ka ofruar FSK-së. **"Nga ana ime shpreha gatishmërinë e bashkëpunimit pa limite me NATO-në, e sidomos me KFOR-in këtu në Kosovë, shpreha falënderimet e popullit të Kosovës dhe të miat personale për këtë çka KFOR-i është duke bërë për Kosovën në drejtim të përgatitjes të Forcës së Sigurisë së Kosovës për të rrugëtuar së bashku në të ardhmen në shtëpinë e madhe të NATO-s"**, tha ai. Gjithashtu, presidenti Pacolli ka folur edhe për rolin e pranisë së trupave të KFOR-it në Kosovë, që është një prani shumë e rëndësishme dhe për të cilën qytetarët e Kosovës kanë një admirim dhe respekt të pakufishëm. Presidenti Pacolli gjithashtu përmendi edhe reduktimin e trupave të KFOR-it, duke shtuar se krahas zvogëlimit të trupave është shtuar kualiteti i tyre i veprimtimit, ndërkohe që vetë zvogëlimi i këtyre trupave është shenjë e një gjendje stabile në vend, por edhe i rritjes së kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Policisë së Kosovës. Ndërsa Komandanti i Forcave të Bashkuara të NATO-s në Napoli, admirali Samuel J. Locklear, ka theksuar se gjatë gjashtë muajve të fundit ka qenë disa herë në Kosovë dhe ka vërejtur gjatë kësaj periudhe një varg ndryshimesh pozitive. "Kosova dhe NATO kanë bërë një rrugë të gjatë bashkë dhe do ta vazhdojnë këtë rrugëtim", tha admirali Locklear. Ndërsa, duke folur për zvogëlimin e trupave të KFOR-it, admirali Locklear theksoi se ky numër më i vogël i trupave të KFOR-it në vendin tonë, nuk e zvogëlon rëndësinë e KFOR-it në Kosovë. Kurse lidhur me Forcën e Sigurisë së Kosovës, admirali Locklear pohoi se në periudhën e ardhshme do të bëhet vlerësimi i përmbushjes së kapaciteteve të plota operative të kësaj force.

---

## Reduktimi nuk e zbeh rolin e KFOR - it

---

Presidenti Pacolli ka përsëritur kërkesën që pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës të jenë pjesë e misioneve paqësore në botë, në kuadër të NATO - s, kudo ku kjo shihet e nevojshme. Ndërsa po ashtu ka kërkuar që eprorët e FSK - së të shkollohen në akademitë e ndryshme ushtarake të NATO - s. Këtë kërkesë ai i adresoi gjatë një takimi me admiralin Samuel J. Loklir, komandant i Forcave të Bashkuara të NATO - s në Napoli, i cili shoqërohej nga komandanti i trupave të KFOR - it, gjenerali Erhard Buhler. Me këtë rast Pacolli ka falënderuar admiralin Loklir për gjithë kontributin që NATO - ja ka dhënë dhe po jep në vazhdimësi për popullin e Kosovës, me theks të veçantë në ndihmën e vazhdueshme për trajnimin dhe profesionalizimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK). Në këtë plan, ai ka kërkuar që eprorët e FSK - së të shkollohen në akademitë e ndryshme ushtarake të NATO - s. Kreu i vendit tha se nga admiralin Samuel Loklear ka marrë çdo garanci që NATO - ja do të jetë pjesë e halleve të qytetarëve të Kosovës, do të ndihmojë Forcat e Sigurisë së Kosovës që të përgatisin ato dhe në të ardhmen të rrugëtojmë bashkë me to. **“Nga ana ime shpreha gatishmërinë e bashkëpunimit pa limite me NATO - n, e sidomos me KFOR - in këtu në Kosovë, shpreha falënderimet e popullit të Kosovës dhe të miat personale për këtë çka KFOR - i është duke bërë për Kosovën në drejtim të përgatitjes të Forcës së Sigurisë së Kosovës për të rrugëtuar së bashku në të ardhmen në shtëpinë e madhe të NATO - s”**, tha ai. Pacolli ka folur edhe reduktimin e trupave të KFOR - it, duke shtuar se krahas zvogëlimit të trupave është shtuar kualiteti i tyre i veprimit, ndërkohë që vetë zvogëlimi i këtyre trupave është shenjë e gjendjes stabile në vend, por edhe i rritjes së kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Policisë së Kosovës. Nga ana e tij, komandanti i Forcave të Bashkuara të NATO - s në Napoli, admiralin Samuel J. Loklir, pasi ka urren presidentin Pacolli për zgjedhjen në detyrën e re, ka theksuar se gjatë gjashtë muajve të fundit ka qenë disa herë në Kosovë dhe ka vërejtur gjatë kësaj periudhe një varg ndryshimesh pozitive. "Kosova dhe NATO - ja kanë bërë një rrugë të gjatë bashkë dhe do ta vazhdojnë këtë rrugëtim", tha ai, duke shtuar se zvogëlimi i trupave nuk e zvogëlon rëndësinë e KFOR - it në Kosovë. Duke folur për zvogëlimin e trupave të KFOR - it, admiralin Samuel J. Loklir tha se ky zvogëlim nuk e zvogëlon rëndësinë e KFOR - it në Kosovë. Ndërkaq, lidhur me Forcën e Sigurisë së Kosovës, admiralin Loklir theksoi se në periudhën e ardhshme do të bëhet vlerësimi i përmbushjes së kapaciteteve të plota operative të kësaj force. I.K.





*Presidenti Pacolli ka përsëritur kërkesën që pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës të jenë pjesë e misionëve paqësore në botë, në kuadër të NATO - s, kudo ku kjo shihet e nevojshme. Këtë e ka bërë gjatë një takimi me admiralin Samuel J. Locklear, komandant i Forcave të Bashkuara të NATO - s në Napoli*

Vizita e parë e presidentit të Kosovës në Tiranë

---

## Pacolli kërkon unifikimin e Shqiptarëve

---

**Ndërmjet dy vendeve në të ardhmen duhen thyer të gjitha barrierat, deri në arritjen e një unifikimi në ligje, kufij, kulturë, ose, siç e quajti Pacolli, një bashkim kombëtar, sipas rekomandimeve evropiane**

Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, vizitën e tij të parë zyrtare jashtë shtetit e zhvilloi në kryeqytetin shqiptar. Takimin e parë e zhvilloi me kreun e shtetit shqiptar, Bamir Topi, ndërsa e mbajti një fjalim në Kuvendin e Shqipërisë. Me shprehjet vëllezër shqiptarë, Shqipëria ime, Shqipëria amë, Presidenti i Kosovës iu drejtua të gjithë shqiptarëve, ndërsa u shpreh se ndërmjet dy trojeve shqiptare nuk duhet të ekzistojnë barrierat. **"I nisa vizitat nga Shqipëria ime, nga Shqipëria amë. Fjala nuk ka qenë pika ime e fortë, të dashur vëllezër të Shqipërisë, por vij në Tiranë për të parën vizitë si President i Kosovës, prandaj do doja të mos i keqkuptonit luhatjet e zërit tim"**, e nisi Pacolli fjalimin e tij. Duke e falënderuar presidentin Topi për ftesën, Pacolli rikonfirmoi edhe një herë dëshirën e tij për thellimin e marrëdhënieve ndërmjet dy trojeve shqiptare. **"Me vlerat e së kaluarës do ta ndërtojmë të ardhmen, nuk duhet të kënaqemi me arritjet e deritanishme në ekonomi e kulturë. T'u japim vlera përpjekjeve shekullore të intelektualëve"**, tha më tej Pacolli. Ai tha më tej se ndërmjet dy vendeve në të ardhmen duhen thyer të gjitha barrierat, deri në arritjen e një unifikimi në ligje, kufij, kulturë, ose, siç e quajti Pacolli, një bashkim kombëtar sipas rekomandimeve evropiane.



*Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, vizitën e tij të parë zyrtare jashtë shtetit e zhvilloi në kryeqytetin shqiptar. Takimin e parë e zhvilloi me kreun e shtetit shqiptar, Bamir Topi, ndërsa e mbajti një fjalim në Kuvendin e Shqipërisë.*

## Propozimi

Sipas agjendës zyrtare, Pacolli u prit sot në një ceremoni solemne në Pallatin e Brigadave nga presidenti Bamir Topi. Më tej, të dy presidentët mbajtën një konferencë të përbashkët për shtyp për përfaqësuesit e medie. Pacolli propozoi sot një nismë në Tiranë, sipas së cilës dy shtetet, Kosova dhe Shqipëria, do të përfitonin shumë, si në aspektin ekonomik, por dhe në atë të integritit. Në konferencën e përbashkët për shtyp me presidentin Bamir Topi, Pacolli theksoi se bashkëpunimi Kosovë - Shqipëri duhet të plotësohet edhe më shumë, sidomos në lëvizjen e lirë të mallrave dhe ligjet që asistojnë në këtë pikë. **"Ajo rrugë për të cilën më parë duheshin 10 orë, Rruga e Kombit, sot bëhet për 3 orë. Por, ajo nuk është përplot e ngarkuar sa duhet me leje të mallrave dhe njerëzve. Ne do bëjmë këtë për ta formuar një treg të përbashkët. Por, kjo bëhet nëse ne tani do t'i heqim tarifatat doganore, që përcjellësit e këtyre mallrave të kenë licenca të unifikuara. Të bëjmë ligje të njëjta, standarde të njëjta, e kjo do na çojë drejt integritit në BE. Me këtë nuk do ta lëndojmë askënd t'i respektojmë normat me komunitetet e tjera"**. Sipas Pacollit, kjo dhe nismat e tjera duhet të realizohet më shpejt, pasi për Kosovën nuk ka më kohë.

Presidenti Bamir Topi theksoi se biseda ndërmjet dy presidenteve kishte të bënte pikërisht me pikat sesi të dyja vendet ta rritin dimensionin e komunikimit ndërmjet tyre, por edhe tema të ndjeshme, siç janë problemet me tekstet. "Lindin probleme për përsosjen e teksteve që kanë të bëjnë me dimensionin e arsimit, për ta rritur standardin e arsimit. Diskutova me presidentin që Rruga e Kombit, një element infrastrukturor tejet i rëndësishëm të shfrytëzohet më mirë për lëvizjen e mallrave me një element shumë simbolik". Topi theksoi se edhe pse e pati një gëzim shumë të madh kur Shqipëria mori përgjigjen për lëvizjen e lirë në vendet e BE - së, i mbeti një brengë e madhe për Kosovën. Presidenti i Shqipërisë garantoj se Shqipëria në çdo tryezë do të insistoj në këtë pikë për Kosovën.



*Ceremonia solemne e organizuar në Pallatin e Brigadave nga presidenti Bamir Top me rastin e pritjes së Presidentit të Kosovës Behgjet Pacolli*



*Më tej, të dy presidentët mbajtën një konferencë të përbashkët për shtyp për përfaqësuesit e medieve*

---

## Pacolli takon admiralin

---

Presidenti Behgjet Pacolli priti admiralin Samuel J. Locklear, komandant i Forcave të Bashkuara të NATO-s në Napoli, i cili shoqërohej nga komandanti i trupave të KFOR-it, gjenerali Erhard Buehler. Gjatë takimit, presidenti Pacolli ka falënderuar admiralin Locklear për gjithë kontributin që NATO-ja ka dhënë dhe po jep në vazhdimësi për popullin e Kosovës, me theks të veçantë në ndihmën e vazhdueshme për trajnimin dhe profesionalizimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK). Në këtë plan, Pacolli ka kërkuar që eprorët e FSK-së të shkollohen në akademitë e ndryshme ushtarake të NATO-s, Presidenti theksoi se nga admiralin Loklear ka marrë **“Çdo garanci që NATO-ja do të jetë pjesë e halleve të qytetarëve të Kosovës, NATO-ja do të ndihmojë FSK-në që të përgatisin ato dhe në të ardhmen të rrugëtojmë bashkë me to”**. Admirali Locklear, duke e uruar Pacollin për zgjedhjen në postin e presidentit, ka theksuar se gjatë gjashtë muajve të fundit ka qenë disa herë në Kosovë dhe ka vërejtur gjatë kësaj periudhe një varg ndryshimesh pozitive. Lidhur me FSK-në, admiralin Locklear ka theksuar se në periudhën e ardhshme do të bëhet vlerësimi i përmbushjes së kapaciteteve të plota operative të kësaj force.

---

## **Pacolli kërkon që FSK-ja të trajnohet nga NATO**

---

**“Mora garanci se NATO do të jetë pjesë e halleve të qytetarëve të Kosovës dhe se do të vazhdojë ta ndihmojë FSK-në”, ka thënë presidenti Behgjet Pacolli**

PRISHTINË, 15 MARS - Presidentit i Kosovës, Behgjet Pacolli, ka thënë se NATO edhe më tutje do ta ndihmojë shtetin e Kosovës, në veçanti Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK). **"Mora garanci se NATO do të jetë pjesë e halleve të qytetarëve të Kosovës dhe se do të vazhdojë ta ndihmojë FSK- në"**, ka thënë presidenti Behgjet Pacolli të martën pas takimit me komandantin e Forcave të Bashkuara të NATO - s në Napoli, admiralin Samuel Locklear. Pacolli ka kërkuar nga admiral Locklear që pjesëtarët e FSK - së të shkollohen në akademitë e ndryshme ushtarake të NATO - s. **"Në kuadër të bashkëpunimit me NATO - n dhe me KFOR - in biseduam edhe për mundësinë e trajnimit të trupave të FSK - së nëpër akademi të ndryshme të NATO - s. Pse mos të jenë edhe pjesëtarët e FSK - së pjesë e misioneve paqësore në botë, në kuadër të NATO - s, kudo ku është e nevojshme?"**, ka deklaruar Pacolli. I pari i vendit ka shprehur gatishmërinë e institucioneve të Kosovës për të bashkëpunuar edhe në të ardhmen me NATO-n. **"Nga ana ime shpreha gatishmërinë e bashkëpunimit pa limit me NATO - në, sidomos me KFOR-in këtu në Kosovë. Po ashtu, shpreha falënderimet e popullit të Kosovës për kontributin që KFOR – i, që ka dhënë dhe është duke dhënë për Kosovën në drejtim të përgatitjes së trupave të FSK - së për të rrugëtuar së bashku"**, ka deklaruar Pacolli. Presidenti Pacolli ka folur edhe për shkurtimin e numrit të ushtarëve të KFOR - it në Kosovë. **"Zvogëlimi i këtyre trupave është shenjë e gjendjes stabile në vend, por edhe e rritjes së kapaciteteve të FSK - së dhe Policisë së Kosovës"**, është shprehur presidenti Pacolli. Ndërkaq, komandanti i Forcave të Bashkuara të NATOS - s në Napoli, admiral Saquel Locklear, ka vlerësuar se muajt e fundit në Kosovë ka parë një varg ndryshimesh pozitive. Ai ka premtuar se NATO - ja dhe shteti i Kosovës do ta vazhdojnë rrugëtimin së bashku. **"Kosova dhe NATO kanë bërë një rrugë të gjatë bashkë dhe do ta vazhdojnë këtë rrugëtim edhe në të ardhmen"**, ka thënë admiral Locklear, duke shtuar, ndër të tjera, se shkurtimi i trupave të KFOR - it nuk e zvogëlon rëndësinë e KFOR - it në Kosovë.



## Pacolli i shërbeu Titos, gjyshi i tij Kralit!

Diktatori Tito që pas Luftës së dytë Botërore ankesoi Kosovën me terror, vrasje e masakra dhe deri në fund të jetës së tij i mbushi burgjet e ish-Jugosllavisë me shqiptarë, për presidentin e ri të Kosovës, Behgjet Pacolli, ishte një njeri vizionar. Madje Pacolli në një intervistë të dhënë këto ditë, ka thënë se përzgjedhja e tij për të qenë në Gardën e Titos është bërë në bazë të një klasifikimi tradicional.

Presidenti i vendit, Behgjet Pacolli, ndjen nostalgji për ‘‘Shokun Tito’’, flet për të si Lama i ditëve të sotme apo Xhon Kenedi i djeshëm. Nuk e fsheh krenarinë që për 11 muaj i shërbeu Jospi Brozit, që për shqiptarët e Kosovës ishte si diktatori i Ugandës, Adi Amin. I pyetur se si shpjegohet fakti se është përzgjedhur për të shërbyer si ushtar në Gardën e Marshallit Tito, presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, thotë se kjo ka ardhur natyrshëm dhe tregon se familjarisht kanë qenë në shërbim të ish-Jugosllavisë, pasi gjyshi ka qenë në shërbim të Kralit e më vonë këso shërbimesh kanë kryer edhe babi dhe axha i tij. ‘‘Ashtu. Këtu është bërë një klasifikim i njerëzve. Ishte një kriter pothuajse tradicional, i traditës familjare, sepse edhe gjyshi im ishte në një gardë të tillë të Kralit në atë kohë, babai im dhe mixha im ishin në një funksion të tillë. Dhe unë u përzgjodha si një ushtar që më vonë duhej të shkonte afër Beogradit në një kurs intensiv tremujor dhe në atë kurs unë pashë që njerëzit që ishin aty, ishin pak a shumë të privilegjuar’’, - ka thënë ai. Gjatë intervistës, Pacolli thotë se kishte privilegjin të shkonte në atë shkollë shumë speciale, ku bëheshin përgatitjet për një mision shumë specifik dhe më vonë praktikisht duhej të punonte afër presidentit të atëhershëm, Tito. Pacolli thotë se shërbimin ndaj Titos e ka kryer me nder dhe se ka qenë privilegj të jetë pranë ish-udhëheqësit të Jugosllavisë. ‘‘Ishim të privilegjuar sepse ishim në një shkollë shumë speciale, ku bëheshin përgatitjet për një mision shumë specifik dhe më vonë ky mision ishte praktikisht që unë duhej të funksionoja afër presidentit të atëhershëm. Unë nga mbi 11 muaj kam qenë me presidentin dhe e kam kryer këtë punë me nder’’, - është shprehur ai.

### Çfarë vizioni kishte Tito, z President ?

Madje edhe pse diktatori Tito që pas Luftës së Dytë Botërore aneksoi Kosovën me terror, vrasje e masakra dhe deri në fund të jetës së tij i mbushi burgjet e ish-Jugosllavisë me shqiptarë, për presidentin e ri të Kosovës, Behgjet Pacolli, ishte një njeri vizionar. ‘‘Për mua ka qenë një vizionar. Ka qenë një njeri i cili e ka shikuar çdokënd në atë Jugosllavi. Unë kam menduar që është ashtu, ndoshta ka qenë, ndoshta jo, mundem edhe të gaboja. Por kuptimin që e kisha atëherë, atë që unë kuptoja atëherë, ishte kjo se ishte njeri që ishte për mua i njëjtë për të gjithë. Dhe ka qenë një njeri që ka pasur shumë respekt tek shtetet tjera, si në lindje ashtu edhe në perëndim’’, - ka thënë ai. Gjatë intervistës rreth dy orë të gjatë, dhënë për TV Klan javën e kaluar dhe e cila u ritransmetua ditën e hënë më 14 mars, Pacolli ka folur edhe për shumë çështje tjera. Ai ka folur edhe për jetën e tij luksoze dhe pasurinë qindra milionëshe.

### Dëmton imazhin

Përveç deklaratave të mëhershme që tregojnë kundërthënien e presidentit Pacolli, së fundi kreu i Republikës së Kosovës ka dhënë edhe deklaratat tjera, duke e quajtur ish-udhëheqësin e ish-Jugosllavisë, Josip Broz Tito, vizionar ndërsa për përzgjedhjen e tij në Gardën e Titos ka thënë

se është bërë mbi bazë të një klasifikimi tradicional. Kryeparlamentari Jakup Krasniqi nuk ka dëshiruar t'i komentojë këto deklarata, ndërsa deputeti i Lëvizjes "Vetëvendosje", Florin Krasniqi, ka thënë se vetë fakti që Pacolli është president është dëmtim për imazhin e Kosovës.

---

## Presidenti Pacolli beson se do të provohet pafajësia e ish-pjesëtareve të UÇK-së

---

Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Behgjet Pacolli ndan shqetësimin e tij lidhur me akuzat e ngritura ndaj ish-pjesëtarëve të UÇK-së me dyshimin për krime lufte. **"Ne besojmë thellë se Lufta e UÇK-së ka qenë luftë e pastër, çlirimtare e popullit të Kosovës kundër një agresioni të egër me synime asgjësimi dhe gjenocidi. Ajo ka qenë dhe mbetet njëra nga faqet më të ndritshme të historisë sonë"** thotë presidenti Pacolli në deklaratën e tij. Ai beson se drejtësia do të provojë pafajësinë. **"Ne besojmë se akuzat e ngritura ndaj ish-pjesëtarëve do të cilësohen si të pabazuara dhe shpejt do të provohet pafajësia e tyre, sikundër edhe shumë herë deri më tani"**, thotë ai. "Presidenti i Republikës së Kosovës, në të njëjtën kohë, beson se organet e drejtësisë në Kosovë, pa ndikime anësore, do ta kryejnë punën e tyre. Të ndërgjegjshëm se ligji është mbi të gjithë, i inkurajojmë organet e drejtësisë kosovare dhe ato të EULEX-it që sundimin e ligjit ta shtrijnë në çdo cep të Kosovës", bën të ditur zyra për informim e Presidencës nëpërmjet një komunikate. "Presidenti i Republikës së Kosovës shpreh konsideratën për gatishmërinë e treguar nga ana e të akuzuarve për të bashkëpunuar me autoritetet e drejtësisë, duke e konsideruar këtë si rrugën e vetme për të dëshmuar pafajësinë e tyre përfundon komunikata. BS

---

## Shqipëria ndihmoi Kosovën që ajo të promovohet si shtet i pavarur

---

Në një intervistë për televizionin shqiptar “Albniian Screen” presidenti i Kosovës Behgjet Pacolli flet për sfidën e tij si president i Kosovës

**Pyetje: Zoti President, e keni marrë detyrën e Presidentit të Kosovës në një moment mjaft delikat për Kosovën veç të tjerash ajo ka filluar edhe bisedimet me Serbinë. Në mendimin tuaj a mund të rrezikojnë këto bisedime pozitën e Kosovës si një shtet i pavarur?**

**B. Pacolli:** Është shumë e vërtetë, Kosova është duke kaluar një fazë jashtëzakonisht me rëndësi dhe shumë delikate, jo vetëm fillimi i bisedimeve me Serbinë por edhe vakuumi politik që ekzistonte kohët e fundit në Kosovë, stërzgatja e procesit të zgjedhjeve, situata ekonomike imazhi i Kosovës që u dëmtua shumë kohët e fundit, normalisht tani është edhe koha kur Kosova filloi dialogun me Serbinë, krejt këto probleme kanë rënduar situatën në Kosovë, një sfidë jashtëzakonisht e madhe që duhet tejkaluar dhe këtu unë i bëj thirrje të gjithë dashamirësve të Kosovës, të gjithë spektrit politik, të gjithë popullit të Kosovës që të jenë sa më unik, për arsye se shansi i Kosovës është uniteti. Nëse jemi unik para këtyre sfidave ne do t'i tejkalojmë ato. Jam i bindur se qeveria e Kosovës dhe të gjitha institucionet e saj tani janë të përkushtuara që të fillojnë tejkalimin e këtyre sfidave, të fillojnë ballafaqimin me këto sfida të cilat janë shumë të vështira por dhe që kanë zgjidhje.

### Veriu i Kosovës është peng i grupeve kriminale serbe

**Pyetje: Zoti President siç të gjithë e dimë një problem i trashëguar i Kosovës është çështja e veriut të Mitrovicës. Ju ishit kryetari i parë i shtetit që dhatë personalisht një mesazh duke kaluar urën mbi lumin Ibër por dhe që vizituat disa nga pikat kufitare me Serbinë apo jo ..?**

**B. Pacolli:** Unë sa e di institucionet e Kosovës kanë munguar që të vizitojnë këtë pjesë të Kosovës, kanë munguar që të inkurajojnë këtë pjesë të qytetarëve të Kosovës se di kush përkujdeset për ta, ky ishte dhe qëllimi i vizitës sime. Nuk kam sfiduar askënd, unë kam kaluar urën dhe kam shkuar në një pjesë të Kosovës ashtu siç kam shkuar edhe në pjesë të tjera, asgjë e jashtëzakonshme. Kam kuptuar gjatë vizitës sime se ajo pjesë e qytetarëve të Kosovës është peng e grupeve kriminale që e kanë lodhur këtë pjesë të qytetarëve dhe jam i bindur se kjo pjesë e qytetarëve mezi presin që të lirohen prej këtyre bandave të cilat janë të mbështetura, perëndia e di prej kujt. Vizita ime në dy pikat kufitare ishte e lidhur me një qëllim që unë të shkoj dhe t'u dal krah edhe atyre pjesëtarëve të institucioneve të Kosovës, atyre bashkëpunëtorëve që janë në Kosovë, atyre bashkëpunëtorëve të ministrisë së Brendshme, atyre që e ruajnë kufirin e Kosovës. Isha në ato dy pika dhe t'ju them të drejtën isha sa i inkurajuar ashtu dhe i demoralizuar. I demoralizuar për arsye se unë gjatë rrugës time që e bëra me makinë deri në pikën 31 pashë së ajo pjesë mbahet peng nga bandat kriminale, dhe nuk duhet të them që bandat kriminale janë vetëm pjesëtarë prej Serbisë por janë një grup kriminal që nuk është e thënë të mos ketë edhe pjesëtarë të anës tjetër të Kosovës, dhe kam parë atë standard të jetës ku kishte mbetur, asgjë nuk kishte ndodhur pas viteve 99 në atë pjesë të

Kosovës. Arrita në kufi dhe pata një inkurajim për faktin se policët që ishin me shërbim atje, çdo njëri prej tyre fliste shqip, dhe unë më vonë e kuptova se ata ishin të etnisë serbe. Secili prej tyre ishte i gatshëm që të kryejë punën e vet me dinjitet dhe ata mua më rrëfyan për mënyrën sesi bandat e dëmtojnë Kosovën, si bandat e dëmtojnë bashkëjetesën atje, si këto banda e dëmtojnë edhe ekonominë e Serbisë për arsye se në radhë të parë është e dëmtuar ekonomia e Serbisë vetë dhe duhet të jetë interesi i saj që ti luftoj këto banda, për arsye se vinin kamionët, cisternat me radhë plot me derivate, të cilat vinin në kufirin serb merrnin një vulë dhe inkasonin 20 % të TVSH-së mbasi që ishte eksport.

## **Nuk ka ndarje të Kosovës**

**Pyetje: A rrezikojnë bisedimet me Serbinë ta shtyjnë çështjen e veriut të Mitrovicës së Veriut deri tek ndarja ?**

**B. Pacolli:** Nuk do të ketë ndarje të Kosovës. Ndarja e Kosovës nuk është opsion dhe nuk do të ketë. Unë personalisht asnjëherë nuk do të jem pjesë e asnjë transaksioni jo vetëm për pjesën veriore të Mitrovicës por për çdo cep të Kosovës. Duhet çdokush edhe partneri ynë i bashkëbisedimeve, edhe bashkëbiseduesi ynë duhet ta ketë të qartë si dikush mund të kërkoj të njëjtat standarde edhe për një pjesë tjetër të Serbisë. Normalisht nëse dikush kërkon veriun e Kosovës diçka jashtë standardeve do të jetë dikush i plotfuqishëm në mënyrë të drejtë të kërkoj përmbushjen këtyre standardeve edhe në jugun e Serbisë, kështu që këto gjëra janë të lidhura. Unë besoj se edhe pala e bashkëbiseduesit tonë e ka të qartë këtë dhe asnjëherë nuk do ta hedhë si ndonjë opsion të mundshëm. Sot ka kaluar koha e dhunës, është koha e dialogut, koha e paqes, koha e bisedimeve, koha e urtësisë e respektit dhe normalisht në këtë mënyrë do të rrugëtojmë përpara. Ne do të bisedojmë me palën tjetër deri atëherë kur të jemi të respektuar prej tyre në atë nivel do të respektojmë palën tjetër, por në moment që mungon respekti ndaj palës sonë atëherë unë do të promovoj idenë që këto bisedime menjëherë të ndërpriten.

**Pyetje: Zoti President në fjalën tuaj pas zgjedhjes si president ju thatë se u kthyet në Kosovë dhe e kuptuat që ky është vendi juaj dhe falënderuat familje shumë të rëndësishme, presidentin Rugova, familjen Jashari , familjen Haradinaj, ato familje dhe shumë të tjera që kanë mbajtur lart vlerat morale të Kosovës, kanë mbajtur lart dinjitetin e vendit pa diskutim. Sa do të jenë të rëndësishme për ju këto vlera tani në pozicionin e Presidentit?**

**B. Pacolli:** Sigurisht këto vlera janë shumë të rëndësishme, vlera që nuk i kam zbuluar vetëm tani, këto kanë qenë gjithmonë pjesë e sensibilizimit tim, pjesë e jetës sime duke ditur se familja Rugova, sakrificat e familjes Jashari, Haradinaj, Pajaziti etj, kanë ndikuar drejtpërdrejt në një realitet që ne e gëzojmë sot, që është pavarësia e Kosovës. Ideja pacifiste e shtetndërtimit të Ibrahim Rugovës për një shtet të lirë dinjitoz, për një shtet të pavarur të Kosovës që u bë e mundur, u përshpejtua me luftën e shenjtë të UÇK-së, ata bënë të mundur që kjo ide të bëhet realitet dhe këtu askush nuk mund të harrohet, askush nuk mund të jetë jashtë sofrës, të gjithë kanë kontribuar dhe të gjithëve ne u përkulemi sot kudo që të jenë, familjeve të dëshmorëve, janë shumë të respektuara për ne, të shenjta për neve. Dëshmorëve duhet t'u garantojmë që ne tani duhet të punojmë që idetë e tyre ti bëjmë realitet. Secili që ka ra për Kosovën në mendjen e vet e ka patur një qëllim që ka qenë pavarësia e Kosovës, shteti i Kosovës për qytetaret e Kosovës. Qytetaret e Kosovës duhet ta ndjejnë veten të lirë por me një mirëqenie dinjitoze ekonomike dhe për këto synime ne duhet të punojmë. Unë përkulem para dëshmoreve. Familjet e respektuara gjithmonë i kam respektuar personalisht dhe do t'i respektoj gjithmonë. Nuk do të mundemi asnjëherë tua kthejmë hakun atyre por ne do të mundohemi që të jemi pjesë e tyre, pjesë e

hallevë të tyre, do të jem para tyre. Edhe njëherë ju them se mrekullia që ka ndodhur në Kosovë është një gjë e shenjtë. Ne sot jemi të lirë, ne sot jemi shteti më i ri në botë dhe këtu do të bëj thirrje edhe njëherë për çdo kënd që ta ketë parasysh se për këtë liri është sakrifikuar shumë dhe askush nuk ka të drejtë ta nëpërkëmb këtë. Këtu qytetarët e Kosovës duhet të jenë unik dhe ato ide për të cilat kanë rënë dëshmorët tanë, ti çojnë deri në fund, që është respektimi i shtetit të Kosovës, respektimi i vlerave të shtetit demokratik, të pavarur dhe të qytetarit. Një shtet i pavarur pa qytetarë nuk do të ekzistonte.

## **Dua që një ditë ta shoh Kosovën në NATO**

**Pyetje: Si e imagjiloni Kosovën në fund të mandatit tuaj?**

**B. Pacolli:** Unë dua ta shoh Kosovën, anëtare të bashkësisë evropiane, anëtare në NATO. Unë para pak ditësh e pashë se prezenca e NATO-s këtu në Kosovë ka ndikuar shumë që një ditë Kosova të jetë anëtare e plotë e NATO-s. Unë dua ta shoh Kosovën të globalizuar, anëtare të të gjitha organizatave botërore dhe anëtare fuqiptotë të OKB-së. Unë dua ta shoh Kosovën të barazuar aty ku janë shoqëritë e civilizuar. Unë dua ta shoh Kosovën ekonomikisht të ngritur dhe nuk dua ta shoh Kosovën që ballafaqohet me problemet që ballafaqohet tani. Dua ta shoh Kosovën me një standard jetësor më të mirë, me përkujdesje shëndetësore të mirë, normalisht më një standard të ri modern akademik.

**Pyetje: Ju shumë shpejt do të zhvilloni dhe një vizitë zyrtare në Tiranë, si e mendoni rolin e Shqipërisë dhe qeverisë shqiptare në këto sfida tuaja për të cilat folëm deri tani?**

**B. Pacolli:** Shqipëria ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm për Kosovën. Ne konsiderojmë se shumë gjëra Kosova do ti kishte të pamundura ti zotëroj pa prezencën e Shqipërisë. Së pari falënderoj Shqipërinë, çdo kënd në Shqipëri dhe institucionet në Shqipëri që i ndihmuan Kosovës aty ku ajo pati nevojë dhe aty ku munda Shqipëria të japë kontributin e vet nuk hezitoi dhe ishte aty. Në rrafshin diplomatik Shqipëria ndihmoi Kosovën që ajo të promovohet si shtet i pavarur, që tek ajo të vijë njohje. Unë do të doja shumë që ky bashkëpunim të vazhdojë.


---

## Promovojnë paqen dhe dialogun

---

### Presidenti Pacolli priti një delegacion të federatës Universale të Paqes

Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli priti të premtën një delegacion të Federatës Universale të Paqes, të prirë nga z.Wiliam Song dhe z.Tim Miller. Presidenti Pacolli i njoftoi mysafirët me gjendjen e përgjithshme në vendin tonë. Ai theksoi se Kosova, si një shtet i ri, është njohur deri tash nga 75 vende dhe është anëtarësuar në disa organizata të rëndësishme ndërkombëtare, ndërsa synim kryesor është rritja e numrit të njohjeve dhe anëtarësimi në sa më shumë mekanizma ndërkombëtarë. Përkundër faktit se kanë kaluar shumë vite nga lufta shkatërrimtare dhe është bërë shumë në rindërtimin dhe në zhvillimin e vendit, Presidenti Pacolli tha se Kosova ende nuk i ka shëruar plagët e luftës. Vendi ynë, tha ai, ka nevojë për përkrahje nga miqtë e saj të shumtë, në mënyrë që sa më shpejtë të futet në familjen e vendeve të përparuara. "Drejtuesit e Federatës Universale të Paqes, pasi uruan Presidentin Pacolli për zgjedhjen në detyrën e re, thanë se kanë njohuri për të gjitha zhvillimet që kanë ndodhur në vendin tonë në të kaluarën dhe për zhvillimet e tanishme dhe se do të japin kontributin e tyre në drejtim të promovimit të paqes dhe të dialogut, si forma të zhvillimit e të përparimit të të gjithë popujve e shteteve", bën të ditur Presidenca e Kosovës.



*Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli priti të premtën një delegacion të Federatës Universale të Paqes, të prirë nga z. Wiliam Song dhe z. Tim Miller. Presidenti Pacolli i njoftoi mysafirët me gjendjen e përgjithshme në vendin tonë. Ai theksoi se Kosova, si një shtet i ri, është njohur deri tash nga 75 vende dhe është anëtarësuar në disa organizata të rëndësishme ndërkombëtare, ndërsa synim kryesor është rritja e numrit të njohjeve dhe anëtarësimi në sa më shumë mekanizma ndërkombëtarë.*



## **Presidenti Pacolli priti drejtuesit e BSPK-së**

Presidenti Pacolli gjatë ditës priti në takim një delegacion të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), të kryesuar nga Haxhi Arifi, kryetar. Z. Arifi e njoftoi Presidentin Pacolli me organizimin e BSPK-së dhe përgjithësisht për gjendjen ekonomike në vend. Ai ritheksoi edhe një herë gjendjen e rëndë të punëtorëve, që përfaqëson ky organizëm dhe përpjekjet që po bëhen, në bashkëpunim me institucionet e vendit, për kapërcimin e kësaj gjendjeje. Kryetari i BSPK-së foli edhe për gjendjen e krijuar pas premtimeve për rritjen e pagave të punëtorëve të një varg sektorësh, rritje kjo që është shtyrë deri në miratimin e buxhetit për këtë vit. Ai shfaqti shpresën e tij dhe të punëtorëve se rritja e pagave do të realizohet. Presidenti Behgjet Pacolli nga ana e tij tha se vlerëson lart punën dhe kontributin e BSPK-së, si një zëdhënëse dhe përfaqësuese e interesave të punëtorëve të Kosovës. Presidenti Pacolli dhe delegacioni i BSPK-së diskutuan për nevojën e ngritjes së pagave, që ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e punëtorëve, por biseduan edhe për gjendjen jo të lehtë ekonomike, në të cilën po kalon vendi, e sidomos për nevojat e mëdha për investime kapitale dhe për vështirësitë e mbulimit të këtyre investimeve.

## **Pagat**

Kryetari i BSPK-së foli edhe për gjendjen e krijuar pas premtimeve për rritjen e pagave të punëtorëve të një varg sektorësh, rritje kjo që është shtyrë deri në miratimin e buxhetit për këtë vit. Ai shfaqti shpresën e tij dhe të punëtorëve se rritja e pagave do të realizohet.



*Presidentin Pacolli gjatë ditës priti në takim një delegacion të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), të kryesuar nga kryetari Haxhi Arifi. Z. Arifi e njoftoi Presidentin Pacolli me organizimin e BSPK-së dhe përgjithësisht për gjendjen ekonomike në vend*

---

## **Presidenti i Kosovës viziton zyrtarisht Shqipërinë**

---

### **Pacolli nderohet me titullin “Doktor Honoris Causa”**

Universiteti Evropian i Tiranës (UET), i ka akorduar titullin e nderit "Doctor Honoris Causa", Presidentit të Republikës së Kosovës, zotit Behgjet Pacolli. Këtë titull UET do t'ia dorëzojë Presidentit Pacolli, në një ceremoni solemne që do të mbahet të martën në kuadër të vizitës shtetërore që Presidenti do të zhvillojë në Shqipëri. "Ne mbetemi të mrekulluar nga shembulli juaj i jashtëzakonshëm jetësor, nga arritjet tuaja në një karrierë të shkëlqyer biznesi, nga shkrirja e kësaj karriere me një veprimtari filantropike unike, dhe nga aktiviteti juaj politik, ku shquhet veprimtaria lobuese e nivelit të lartë. Ne kemi ditur të mos mbetemi peng i paragjyqimeve tipike për shoqëritë tona dhe të shohim tek kjo veprimtari, forcën dhe krijimtarinë e individit që ka çarë vetë rrugën e jetës, duke afirmuar këtë forcë dhe krijimtari në një rrafsh global, së bashku me shqiptarësinë e tij. Mbështetur në të gjitha këto dëshmi të një aktiviteti shumëprmasor që lartëson mbi të gjitha individin shqiptar në hapësirën botërore, senati akademik i Universitetit tonë ju ka akorduar njëzëri nderimin akademik "Doctor Honoris Causa" në fushën e biznesit me motivacionin: Për rezultatet e shkëlqyera akademike; për qasjen krijuese në biznesin e ndërtimit dhe për gjurmët e pashlyera që ka lënë me veprat e tij ndërtimore anembanë botës nga Lindja në Perëndim; për sensin e spikatur të ndërmarrësisë që ka treguar me themelimin dhe drejtimin me sukses të një kompanie globale si MABETEX; për veprimtarinë e shquar filantropike brenda vendit të tij Kosovës, por dhe jashtë vendit, për veprimtarinë aktive pajtuese në politikën shqiptare të Kosovës në përputhje me frymën më të mirë të kësaj shoqërie", thuhet ndër të tjera në arsyetimin e vendimit të UET për dekorimin e Presidentit Pacolli me titullin "Doctor Honoris Causa". Në këtë ceremoni solemne, pritet të marrin pjesë personalitetet më të larta politike e institucionale të shtetit shqiptar.



*Universiteti Evropian i Tiranës (UET), i ka akorduar titullin e nderit "Doctor Honoris Causa", Presidentit të Republikës së Kosovës, zotit Behgjet Pacolli*

*Ky çmim i është dhënë për rezultatet e shkëlqyera akademike; për qasjen krijuese në biznesin e ndërtimit dhe për gjurmët e pashlyera që ka lënë me veprat e tij ndërtimore anembanë botës nga Lindja në Perëndim; për sensin e spikatur të ndërrmarrësisë që ka treguar me themelimin dhe drejtimin me sukses të një kompanie globale si MABETEX; për veprimtarinë e shquar filantropike brenda vendit të tij Kosovës, por dhe jashtë vendit, për veprimtarinë aktive pajtuese në politikën shqiptare të Kosovës në përputhje me frymën më të mirë të kësaj shoqërie", thuhet ndër të tjera në arsyetimin e vendimit të UET për dekorimin e Presidentit Pacolli me titullin "Doctor Honoris Causa"*

---

## **Haxhinasto: Shteti i Kosovës po ndërtohet mbi idenë e Rugovës**

---

**Presidenti Pacolli dhe shefi i diplomacisë shqiptare premtuan se Shqipëria dhe Kosova do të hartojnë një plan të përbashkët për njohjet**

PRISHTINË, 19 MARS - Kryediplomati dhe zëvendëskryeministri shqiptar Edmond Haxhinasto, në ditën e dytë të vizitës në Kosovës, të shtunën, është takuar me presidentin e Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli. Haxhinasto tha me këtë rast se pavarësisht kontestimit që dikush i bënë zgjedhjes së Pacollit president, ai e respekton vullnetin e deputetëve të cilët votuan për presidentin e ri të Kosovës. Presidenti Pacolli ka falënderuar popullin dhe institucionet e Republikës së Shqipërisë për gjithë çfarë kanë bërë dhe po bëjnë për popullin dhe shtetin e Kosovës. Ai gjithashtu e ka njoftuar Haxhinaston për gjendjen e përgjithshme në Kosovë, për periudhën e rëndësishme që po kalon shteti i Kosovës në shumë sfera dhe angazhimet e gjithë institucioneve të vendit që, me ndihmën e miqve dhe përkrahësve të vazhdueshëm, t'i kapërcejë një varg sfidash, që gjenden përpara.

### **Shqipëria e Kosova dy shtete pa kufij**

Ndërsa sa i takon çështjes së njohjes së pavarësisë së Kosovës, presidenti Pacolli ka vlerësuar lartë punën e diplomacisë shqiptare në këtë rrafsh, duke falënderuar me këtë rast shefin e diplomacisë shqiptare dhe pararendësit e tij, për siç ka vlerësuar presidenti Pacolli, punën shumë të madhe që kanë bërë për sigurimin e një numri sa më të madh të njohjeve për shtetin e ri të Kosovës. Ai shprehu shpresën se diplomacia e Shqipërisë do të vazhdojë te punoj në këtë fushe dhe do të shtoj edhe me shume angazhimin ndërsa edhe presidenti theksoi nevojën e krijimit të një agjende të përbashkët angazhimesh, në mënyrë që Kosova të shtojë sa më shumë numrin e njohjeve, por edhe të arrijë sa më shpejtë të bëhet pjesë e mekanizmave ndërkombëtarë, një synim ky i përhershëm i popullit dhe institucioneve të Republikës së Kosovës. Në këtë takim mes presidentit Pacolli dhe ministrit Haxhinasto është prekur edhe tema e bashkëpunimit ndërshtetëror, ku presidenti Pacolli përsëriti idenë e krijimit të kushteve për lëvizjen e lirë të njerëzve, ideve e mallrave, duke jetësuar në këto hapësira, idenë e Minishengenit, që do të jetë në të mirë të lëvizjes së lirë të qytetarëve, por që do të shërbejë edhe si parapërgatitje për integrimin sa më të shpejtë në familjen e madhe evropiane. Pacolli i kushtoi një rëndësi të madhe në këtë takim edhe bashkëpunimit ekonomik, ku sipas tij ka shumë mundësi, por edhe nevojë që të krijohen lehtësira të tjera për bizneset e të dy shteteve, por edhe të shteteve të tjera të rajonit. Kryediplomati shqiptar, Haxhinasti theksoi se të dy shtetet tona kanë nivel shumë të mirë bashkëpunimi, por koordinimi më i madh do të shtojë edhe më tej efikasitetin e bashkëpunimit. Ai u zotua për angazhimin e Shqipërisë, që Kosova të mos mbetet jashtë nismave të ndryshme rajonale. Ndërsa duke folur për procesin e njohjeve, Haxhinasto tha se Shqipëria do të vazhdojë lobimin për të siguruar sa më shumë njohje dhe, në këtë plan, në bashkëpunim me institucionet e Kosovës, do të hartohet një program i përbashkët i veprimit në këtë fushë. Kurse sa i takon bashkëpunimit ekonomik, ministri Haxhinasto tha se të dy vendet mund të shtojnë edhe më tej bashkëpunimin ekonomik, gjë që sipas tij është mundësuar edhe nga infrastruktura rrugore dhe veprimet e përbashkëta në fusha të tjera që do të mundësojnë një shkallë më të lartë të bashkëpunimit. Pas takimit me presidentin Pacolli, të shtunën, shefi i diplomacisë shqiptare bëri nderime tek varri i presidentit Ibrahim Rugova. Ai

tha se është obligim i secilit të nderoj figurën e Rugovës në idenë e të cilit, siç u shpreh ai, po mbindërtohet shteti i Kosovës.



*Kryediplomati dhe zëvendëskryeministri shqiptar Edmond Haxhinasto, në ditën e dytë të vizitës në Kosovës, është takuar me presidentin e Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli. Haxhinasto tha me këtë rast se pavarësisht kontestimit që dikush i bënë zgjedhjes së Pacollit president, ai e respekton vullnetin e deputetëve të cilët votuan për presidentin e ri të Kosovës*

## **Nderohet familja Jashari**

Ministri i jashtëm Edmond Haxhinasto, vizitoi edhe Prekazin ku bëri Homazhe para varrit të Adem Jasharit. Kryediplomatet shqiptar kanë qëndruar në kullë të Jasharëve ku janë pritur nga Rifat Jashari. Pas takimit, Murat Jashari, ka thënë se me ambasadorin shqiptar kanë biseduar për familjen Jasharaj dhe sakrificën e popullit tonë gjatë historisë. "Biseduam për historinë e familjes Jashari, për sakrificën e shqiptarëve në histori, për një të ardhme më të mirë, për një integritet të të gjithë shqiptarëve", tha Jashari. Jashari ka folur edhe për arrestimet e ish pjesëtarëve të UÇK - së, nga EULEX-i, ku sipas tij, ky është realitet i hidhur dhe fatkeqësisht ndoshta gjatë këtij rrugëtimi ne nuk kemi mundur ta kryejmë punën tonë si duhet. "Është e dhimbshme kur viktimat shndërrohet në agresor e agresori në viktimë, por shpresoj se bashkërisht do ta tejkalojmë edhe këtë pengesë", tha Jashari. Kurse i pyetur për përgjegjësin e klasës politike të Kosovës rreth arrestimeve, ai ka thënë se të gjithë jemi përgjegjës, por natyrisht ata që kanë pozita, kanë përgjegjësi më të madhe. Ndërsa, Haxhinasto, ka thënë se edhe për të ishte nderë që ishte në Prekaz. "Familja Jashari është obligim i madh dhe është bërë vendi mishëruar për vlerat më të mira që ka sot kombi ynë dhe për vlera të lirisë", ka deklaruar ministri i jashtëm shqiptar. Haxhinasto po qëndron në Kosovë me ftesë të ministrit të Punëve të Jashtme të Kosovës, Enver Hoxhaj. Kurse të premtën ai është takuar me kryeministrin Hashim Thaçi, me kryetarin e Kuvendit, Jakup Krasniqi, me zëvendës-kryeministrin dhe Ministrin e Pushtetit Lokal, Slobodan Petroviq dhe me krerët e partive opozitare LDK, Vetëvendosje dhe AAK.

## **RUGOVA**

Pas takimit me presidentin Pacolli, të shtunën, shefi i diplomacisë shqiptare bëri nderime tek varri i presidentit Ibrahim Rugova. Ai tha se është obligim i secilit të nderoj figurën e Rugovës mbi idenë e të cilit po ndërtohet shteti i Kosovës.

## **LOBIMI**

Haxhinasto tha se Shqipëria do të vazhdojë lobimin për të siguruar sa më shumë njohje dhe, në këtë plan, në bashkëpunim me institucionet e Kosovës, do të hartohet një program i përbashkët i veprimit në këtë fushë.

---

## **Qeveria dhe Presidenca mbështetin sulmet e Perëndimit mbi Libinë**

---

PRISHTINË, 20 MARS - Qeveria dhe Presidenca e Kosovës i kanë mbështetur sulmet e Perëndimit mbi Libinë e Muammar Gaddafi. Një ditë pasi, aeroplanët e Aleancës Veriatlantike kanë nisur sulmet mbi caqet libiane, Qeveria e Kosovës përmes një komunikate ka thënë se sulmet paraqesin akte në dobi të paqes dhe sigurisë në rajon. "Qeveria e Republikës së Kosovës mbështet intervenimin ushtarak të forcave ajrore të disa nga shtetet e NATO - s mbi caqet ushtarake të diktatorit Gaddaf në Libi, dhe këto sulme i konsideron si akte në dobi të paqes dhe të sigurisë në rajonin e Mesdheut e më gjerë", ka shkruar Qeveria e Kosovës. "Intervenimi mbi pozicionet e diktatorit Gaddaf është akt human në mbrojtje të popullatës civile libiane, e cila kërkon largimin e diktatorit, liri, demokraci dhe prosperitet për popullin e Libisë". Komunikata qeveritare ka kujtuar se Kosova e ka të provuar rëndësinë e intervenimeve të natyrës së tillë vitin 1999, kur Aleanca Veriatlantike me sukses udhëhoqi fushatën e bombardimeve kundër caqeve serbe, duke e përmbjllur me sukses çlirimin e Kosovës, por edhe rënien e diktatorit serb, Milosheviq. "Qeveria e Kosovës solidarizohet me shtetet që mbështetin intervenimin ajror në Libi, përgëzon Këshillin e Sigurimit për dhënien e së drejtës për intervenim dhe konsideron se ky veprim është i drejtë, legjitim dhe i domosdoshëm", ka komunikuar qeveria. Presidenca e Kosovës ka thënë se sulmi i forcave të Perëndimit kundër pozicioneve ushtarake të ushtrisë së Libisë është një akt humanitar, në mbrojtje të popullit të Libisë, kërkesat e të cilit për liri, demokraci dhe prosperitet kanë gjetur përgjigjen e dhunshme të ushtrisë së udhëhequr nga diktatori Gaddaf". Shfaqim shpresën se këto sulme do ta detyrojnë Gaddafin të ndalë sulmet ndaj popullit të tij dhe të largohet nga pushteti, duke i mundësuar popullit libian që të zgjedhë në mënyrë të lirë udhëheqjen e vet", është shkruar në komunikatë. "Populli i Kosovës e di më së miri i çfarë rëndësie është intervenimi i forcave të NATO - s, të cilat, me bombardimet mbi caqet serbe të diktatorit Milosheviq në vitin 1999, ndalën përpjekjet për shfarosjen e popullit shqiptar dhe ky intervenim pa hezitim u mundësoi shqiptarëve të çlirohen, të kthehen në vendin e tyre dhe të ndërtojnë shtetin me vlerat më të larta të lirisë e demokracisë që sot e gëzojnë". Po ashtu, edhe Tirana zyrtare ka mbështetur vendimin për sulmet ndaj Libisë. Një kumtesë qeveritare pohon se Shqipëria mbështet fillimin e sulmeve ajrore mbi Libinë, duke i quajtur ato si legjitime. Në një deklaratë shtypi të lëshuar nga Zyra e kryeministrit thuhet se Tirana zyrtare përshëndet vendimin e koalicionit ndërkombëtar për fillimin e operacioneve ushtarake në mbështetje të Rezolutës 1973 të Këshillit të Sigurimit dhe kërkesës së Lidhjes Arabe, për të mbrojtur civilët libianë nga sulmet e regjimit të Gaddafi që kanë shkaktuar qindra viktima.



---

## **Pacolli viziton Tiranën**

---

PRISHTINË - Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, vizitën e parë zyrtare që pas marrjes së detyrës së kreut të shtetit, do ta realizojë në Shqipëri. Ai sot (e hënë) do të qëndrojë për një vizitë dyditëshe në Tiranë, ndërsa takimin e parë zyrtar do ta zhvillojë me homologun e tij, Bamir Topi, në një pritje zyrtare, që ky i fundit do t'i bëjë në Pallatin e Brigadave. Pas takimit që do ta zhvillojnë të dy presidentet është paraparë që në orën 12:00 e 40 minuta, ta mbajnë edhe një konferencë të përbashkët për shtyp. Presidenti Pacolli do të ketë takime të veçanta edhe me kryeministrin Sali Berisha dhe kryetaren e Kuvendit, Jozefina Topalli. Me këtë rast, ai do t'i drejtohet me një fjalë përshëndetëse edhe Parlamentit shqiptar. Pacolli do të takohet edhe me liderin e opozitës dhe kryetarin e Bashkisë së Tiranës, Edi Rama, i cili në shenjë simbolike do t'i dhurojë Presidentit të Kosovës, çelësin e kryeqytetit. Ndërkaq, në ditën e dytë të vizitës së tij në Shqipëri, presidenti Pacolli do të takohet edhe me Shpëtim Idrizin, kryetarin e Partisë së Drejtësisë, Integrim dhe Unitet, dhe me kreun e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Ilir Meta. Në një ceremoni të veçantë, presidentit Pacolli do t'i jepet çmimi "Honoris Causa" nga Universiteti Evropian i Tiranës, ku do të jetë i pranishëm edhe presidenti Topi. Pas kthimit nga Tirana, kreu i shtetit, Behgjet Pacolli do të qëndrojë për një vizitë tjetër zyrtare në Maqedoni. L. BLAKAJ

---

## Sot e fillon vizitën Presidenti Pacolli në Shqipëri

---

Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, do të vizitojë sot e nesër Republikën e Shqipërisë. Lajmin e ka konfirmuar këshilltari politik i presidentit, Ibrahim Gashi. "Është vizitë shtetërore, pra formati më i lartë i vizitës. Presidenti do të vizitojë Republikën e Shqipërisë me disa ministra dhe me një grup të madh të biznesmenëve kosovarë. Biznesmenët do të shkojnë një ditë më vonë dhe do të kenë takime të përbashkëta me biznesmenët e Shqipërisë dhe ministrat e fushave përkatëse", sqaroi Gashi. Pacolli pritet të takojë krerët më të lartë institucionale si dhe përfaqësues të opozitës shqiptare. Vizita e presidentit të Kosovës në Shqipëri është vizita e parë zyrtare jashtë shtetit.

---

## **Presidenti Pacolli përshëndet intervenimin e NATO-s në Libi**

---

Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli përkrah intervenimin ushtarak të disa vendeve anëtare të NATO-s kundër ushtrisë së diktatorit Gadafi, e cila me javë të tëra ka terrorizuar popullin e vet. "Sulmi i forcave të NATO-s kundër pozicioneve ushtarake të ushtrisë së Libisë është një akt humanitar, në mbrojtje të popullit të Libisë, kërkesat e të cilit për liri, demokraci dhe prosperitet kanë gjetur përgjigjen e dhunshme të ushtrisë së udhëhequr nga diktatori Gadafi", thuhet në reagimin e Presidencës së Kosovës. "Këto sulme, gjithashtu, janë në dobi të paqes dhe të sigurisë në gjithë rajonin e Mesdheut dhe më gjerë. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, duke dhënë lejen për intervenim në këtë rast, ka ndërmarrë një hap të drejtë dhe të domosdoshëm, në mbrojtje të jetës së qytetarëve të Libisë. Shfaqim shpresën se këto sulme do ta detyrojnë Gadafin të ndalë sulmet ndaj popullit të tij dhe të largohet nga pushteti duke i mundur popullit libian që të zgjedhë në mënyrë të lirë udhëheqjen e vet. Populli i Kosovës e di më së miri çfarë rëndësie është intervenimi i forcave të NATO-s, të cilat, me bombardimet mbi caqet serbe të diktatorit Milosheviq në vitin 1999, ndalën përpjekjet për shfarosjen e popullit shqiptar dhe ky intervenim i pahezitim u mundësoi shqiptarëve të çlirohesh, të kthehen në vendin e tyre dhe të ndërtojnë shtetin me vlerat më të larta të lirisë e demokracisë që sot e gëzojnë. Presidentit i Kosovës uron që sa shpejtë të vijë deri te plotësimi i kërkesave të koalicionit nga diktatori Gadafi, në mënyrë që të hapen korridoret e ndihmave, për t'i dalë krah popullit të Libisë, që populli të fillojë jetën dinjitoze dhe të vendosë për të ardhmen e vet në mënyrë demokratike. Depërtimi i paqeruajtësve dhe ndihmave humanitare sa më shpejt, do të ndikojë në daljen në ndihmë popullit të Libisë dhe ruajtjen e jetës së tyre", thuhet në komunikatën e Presidencës. BS

## **E nis me Shqipërinë**

**Në vizitën e tij të parë zyrtare jashtë shtetit, presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, pritet t'i takojë krerët më të lartë institucional si dhe përfaqësuesit e opozitës shqiptare. Në ditën e dytë të qëndrimit në Tiranë ai do të jetë i pranishëm në Universitetin Evropian të Tiranës, ku do t'i jepet çmimi "Honoris Causa"**

PRISHTINË, 20 MARS - Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, vizitën e tij të parë zyrtare jashtë shtetit do ta zhvillojë në Shqipëri. Sot (e hënë) ai do ta vizitojë Tiranën. Lajmin e ka konfirmuar këshilltari politik i presidentit, Ibrahim Gashi. "Është vizitë shtetërore, pra formati më i lartë i vizitës. Presidenti do ta vizitojë Republikën e Shqipërisë me disa ministra dhe me një grup të madh të biznesmenëve kosovarë. Biznesmenët do të shkojnë një ditë më vonë dhe do të kenë takime të përbashkëta me biznesmenët e Shqipërisë dhe ministrat e fushave përkatëse", ka sqaruar Gashi. Pacolli pritet t'i takojë krerët më të lartë institucionalë si dhe përfaqësues të opozitës shqiptare. Vizita e presidentit të Kosovës në Shqipëri është vizita e parë zyrtare jashtë shtetit. Sipas agjendës zyrtare publikuar nga Presidenca, kreu i shtetit të Kosovës do të pritet paraditen e së hënës në një ceremoni zyrtare në Pallatin e Brigadave nga homologu i vet shqiptar Bamir Topi, me të cilin do të zhvillojë fillimisht një takim kokë më kokë dhe më pas do të dalin në konferencë me gazetarë. Presidenti Pacolli do të ketë takime të veçanta edhe me kryeministrin Sali Berisha si dhe me kryetaren e Kuvendit, Jozefina Topalli. Gjatë vizitës së tij ai do t'i drejtohet me një fjalë përshëndetëse Parlamentit shqiptar. Presidenti i Kosovës do të takohet edhe me kryetarin e bashkisë së Tiranës, Edi Rama, i cili do t'ia jap "Çelësin e Qytetit". Në ditën e dytë të vizitës së tij, nesër (e martë) në Shqipëri, presidenti Pacolli do të takohet me kryetarin e Partisë të Drejtësisë, Integrim dhe Unitet, Shpëtim Idrizi dhe me kryetarin e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Ilir Meta. Pas ceremonisë së vendosjes së kurorës për nder të të rënëve në Monumentin "Nënë Shqipëri", presidenti i Kosovës do të jetë i pranishëm në Universitetin Evropian të Tiranës, ku do t'i jepet çmimi "Honoris Causa". Agjenda e tij vijon me pjesëmarrjen në punimet e Forumit të Biznesit Shqipëri - Kosovë, për t'u pasuar nga një vizitë në qytetin e Krujës, ku do ta vizitojë Muzeun Historik Kombëtar, Muzeun Etnografik dhe Pazarin e Vjetër Gjithashtu, presidenti Pacolli do të vendosë edhe një kurorë në "Varrin e Skënderbeut në qytetin e Lezhës.

### **UET nderon presidentin Pacolli me titullin e nderit "Doctor Honoris Causa"**

Universiteti Evropian i Tiranës (UET) i ka akorduar titullin e nderit "Doctor Honoris Causa", presidentit të Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli. Këtë titull UET do t'ia dorëzojë presidentit Pacolli, në një ceremoni solemne që do të mbahet nesër (e martë) në kuadër të vizitës shtetërore që presidenti do të zhvillojë në Shqipëri. "Ne mbetemi të mrekulluar nga shembulli juaj i jashtëzakonshëm jetësor, nga arritjet tuaja në një karrierë të shkëlqyer biznesi, nga shkrirja e kësaj karriere me një veprimtari filantropike unike, dhe nga aktiviteti juaj politik, ku shquhet veprimtaria lobuese e nivelit të lartë. Ne kemi ditur të mos mbetemi peng i paragjykimeve tipike për shoqëritë tona dhe të shohim te kjo veprimtari, forcën dhe krijimtarinë e individit që ka çarë vetë rrugën e jetës, duke afirmuar këtë forcë dhe krijimtari në një rrafsh

global, së bashku me shqiptarësinë e tij. Mbështetur në të gjitha këto dëshmi të një aktiviteti shumëpërmasor që lartëson mbi të gjitha individin shqiptar në hapësirën botërore, Senati akademik i Universitetit tonë ju ka akorduar njëzëri nderimin akademik. 'Doctor Honoris Causa' në fushën e biznesit me motivacionin: Për rezultatet e shkëlqyera akademike, për qasjen krijuese në biznesin e ndërtimit dhe për gjurmët e pashlyera që ka lënë me veprat e tij ndërtimore anembanë botës nga Lindja në Perëndim, për sensin e spikatur të ndërmarrësisë që ka treguar me themelimin dhe drejtimin me sukses të një kompanie globale si MABETEX, për veprimtarinë e shquar filantropike brenda vendit të tij Kosovës, por dhe jashtë vendit, për veprimtarinë aktive pajtuese në politikën shqiptare të Kosovës në përputhje me frymën më të mirë të kësaj shoqërie", është thënë, ndër të tjera, në arsyetimin e vendimit të UET për dekorimin e presidentit Pacolli me titullin "Doctor Honoris Causa".

Arsim OSMANI

## Rama ia dorëzoi Pacollit Çelësin e Tiranës

Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, u takua të hënën edhe me kryetarin e Bashkisë së Tiranës, Edi Rama. Kryetari Rama, me këtë rast, ia dorëzoi presidentit Pacolli Çelësin e Tiranës. **"Besoj se këtë Çelës e kam merituar. Do të jap kontributin tim për Bashkinë e Tiranës, që është kryeqyteti edhe i Kosovës, edhe i kombit"**, tha me këtë rast presidenti Pacolli. Ndërsa, kryebashkiaku i Tiranës, Rama, u shpreh pas takimit: "Ishte një ditë e bukur pranvere në Tiranë dhe nuk kishte ditë më të përshtatshme për të mirëpritur presidentin e ri të Kosovës, duke i dhënë në dorë Çelësin e qytetit dhe duke i shtrënguar dorën e vëllazërimit, dorën e bashkëpunimit, dorën e një lidhjeje që bëhet gjithmonë e më e fortë mes shqiptarëve këtej dhe andej kufirit, ndërkohë që kufiri të bëhet gjithmonë e më simbolik".



*Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, u takua të hënën edhe me kryetarin e Bashkisë së Tiranës, Edi Rama. Kryetari Rama, me këtë rast, ia dorëzoi presidentit Pacolli Çelësin e Tiranës.*

***"Besoj se këtë Çelës e kam merituar. Do të jap kontributin tim për Bashkinë e Tiranës, që është kryeqyteti edhe i Kosovës, edhe i kombit"*, tha me këtë rast presidenti Pacolli**

---

## **Pacolli: Koha të krijojmë të ardhmën**

---

### **Presidenti Pacolli mban fjalim në Kuvendin e Shqipërisë 21 mars**

TIRANË, 21 MARS Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, gjatë vizitës tij në Tiranë ka mbajtur një fjalë në Parlamentin e Shqipërisë. **“I nisa vizitat nga Shqipëria ime, nga Shqipëria amë. Fjala nuk ka qenë pika ime e fortë, të dashur vëllezër të Shqipërisë, por vij në Tiranë të parën vizitë si president i Kosovës, prandaj do të doja të mos keqkuptonit luhatjet e zërit tim”**. Me këto fjalë që nuk fshihnin dot emocionin që presidenti Pacolli nisi fjalimin para parlamentarëve shqiptar. Por emocionet nuk do ta pengonin atë të shpaloste më pas një sër idesh që sipas tij do të ndryshonin imazhin e deritanishëm të dy vendeve dhe do t'i bënin ata një fuqi ekonomike. Duke thënë se ka ardhur koha për të ndërtuar të ardhmen tonë, Pacolli u shpreh se **“dua të shohim përpara dhe me vlerat e së kaluarës të krijojmë të ardhmen tonë, që do të jetë e ndritshme. I thërras ndërgjegjes suaj kombëtare për të menduar pak, a duhet të kënaqemi me rezultatet e deritanishme në rrafshin ekonomik? Kemi pasur rezultate, por nuk duhet të kënaqemi. T’u hapim rrugë pistave të bashkëpunimit”**, është shprehur Pacolli, duke vendosur theksin dhe në këtë fjalim ashtu si gjatë takimit me presidentin Bamir Topi, tek efikasiteti i domosdoshëm në fushën e ekonomisë. Ai kërkoi që dy vendet të thyejnë të gjitha barrierat, deri në arritjen e një unifikimi në ligje, kufij, kulture, ose siç e quajti Pacolli një bashkim kombëtar sipas rekomandimeve evropiane. Propozoj një takim periodik përfaqësuesish të shteteve tona, ashtu siç bëjnë ata të vendeve të BE - së, si dhe mbajtjen e forumit ekonomik të bizneseve më shumë se dy herë në vit. Të rrisim kapacitetet energjetike, të kemi të njëjtat fatura për shkëmbimin e mallrave. Të zhvillojmë biznesin tonë aty ku gjendemi. T’ia fillojmë punës, vendet tona janë në vonesë. Të fillojmë punën me vullnet të madh dhe sukcesi do të jetë i garantuar ka thënë Pacolli. Duke u ndalur te rruga Durrës - Morinë, kreu i ri i Kosovës u shpreh se shqiptarët mund ta nderojnë atë dhe paratë e shpenzuara për ndërtimin e saj duke e mbushur atë plotë e përplot me lëvizjen e njerëzve, ideve dhe mallrave. **“Ne duhet të prodhojmë më shume zhvillim për qytetarët tanë. Duhet të qarkullojmë shumëçka, por këto pista të reja bashkëpunimi duhet të zhvillohen mbi një bazament të fortë”**, ka thënë Pacolli, duke propozuar bashkimin kombëtarë në mes Shqipërisë dhe Kosovës, jo atë territorial, por atë ekonomik. Të njëjtin qëndrim për një rritje të bashkëpunimit në të gjitha fushat mes dy vendeve ai e ka shprehur dhe gjatë takimit që pati me kryeparlamentaren Jozefina Topalli. Kjo e fundit pasi e uroi zgjedhjen e tij në detyrën e presidentit të Republikës së Kosovës, shprehu angazhimin e parlamentit si dhe të Qeverisë shqiptare për të bashkëpunuar me institucionet e reja të Kosovës të dala nga zgjedhjet. Ndihej krenar që vizitën e parë si president i Republikës së Kosovës e zhvilloj në Shqipëri. Marrëdhëniet tona midis vendeve janë miqësore dhe të shkëlqyera dhe vlerësoj të ecim me këto ritme për të hequr çdo barrierë që pengon bashkëpunimin tonë të mëtejshëm, në të gjitha fushat”, tha presidenti Pacolli. Gjatë takimit, dy bashkëbiseduesit u ndalën edhe te proceset integruese rajonale. Duke theksuar perspektivën e të dyja vendeve të Bashkimit Evropian. **“Pavarësia e Kosovës është një proces i pakthyeshëm i cili shërben edhe si një faktor i rëndësishëm për paqen dhe stabilitetin në rajon”**, ka thënë Topalli.



*Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, gjatë vizitës tij në Tiranë ka mbajtur një fjalë në Parlamentin e Shqipërisë*



---

## **FOL: Pesë shkelje kushtetuese në zgjedhjen e presidentit**

---

**Lëvizja FOL ka evidentuar pesë shkelje kushtetuese dhe tri shkelje ligjore gjatë procesit të zgjedhjes së Behgjet Pacollit president. Shkeljet kryesisht konsistojnë në: mungesën e kuorumit të deputetëve gjatë votimit në dy raundet e para; në mungesën e kundërkandidatëve për president; në cenimin e së drejtës së deputetit për ta shprehur lirshëm vullnetin e vet, si dhe në ndërhyrjet që janë bërë nga jashtë Kuvendit gjatë votimit për njeriun e parë të shtetit**

PRISHTINË, 21 MARS - Lëvizja FOL është treguar më e shpejtë se Gjykata Kushtetuese në dhënien e interpretimit, nëse zgjedhja e presidentit Behgjet Pacolli ka qenë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe me ligjet në fuqi në Kosovë. Pas një vështrimi ligjor që kjo OJQ ia ka bërë seancës së jashtëzakonshme të mbajtur me 22 shkurt në Kuvendin e Kosovës, ka ardhur në përfundim se zgjedhja e kreut të shtetit është shoqëruar me parregullsi, të cilat e dëmtojnë integritetin e institucionit të presidentit të Republikës, si dhe funksionimin demokratik të shtetit të Kosovës. Në dokumentin e FOL - it, të cilin e disponon "Koha Ditore", e një kopje e të cilit i është dorëzuar edhe "gardianit" të Kushtetutës, specifikohen pesë shkelje kushtetuese dhe tri shkelje ligjore dhe procedurale. Shkeljet kushtetuese konsistojnë në nenin 86, pika 4; në nenin 86 paragrafi 5, në nenin 70 paragrafi 1, në nenin 86 pika 1 si dhe në nenin 83 të Kushtetutës. Kurse shkeljet ligjore dhe procedurale, sipas FOL - it, rëndojnë mbi nenin 3, pika 1 dhe pika 2 të Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësit e deputetit, si dhe mbi nenin 5, pika 2 të Ligjit për presidentin e Republikës së Kosovës. Drejtori ekzekutiv i kësaj OJQ - ja, Ramadan Ilazi, ka bërë të ditur se analiza është kryer nga juristët e organizatës me qëllim që Gjykatës Kushtetuese t'i jepen dëshmi shtesë rreth lëndës që është ngritur nga deputetët opozitarë. "Me ligj, jepet mundësia që pala e tretë, të japë dëshmi shtesë në një lëndë të ngritur. Në këtë rast, pala e tretë jemi ne. Tash varet nga Gjykata Kushtetuese nëse e merr ose jo në shqyrtim vështrimin ligjor që e kemi bërë ne", ka deklaruar Ilazi. FOL ka sqaruar se neni 86, pika 4 të Kushtetutës përcakton që zgjedhja e presidentit të bëhet me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve. Kuvendi i Kosovës përbëhet nga 120 deputetë, çka sipas kësaj organizate, nënkupton se 2/3 e deputetëve janë e pakta 80 prej tyre. "Në një proces i cili kushtëzohet me votimin e të paktën 2/3 të të gjithë deputetëve të Kuvendit, kuorumi i nevojshëm për të filluar procesin e tillë është 80 deputetë. Kjo nënkupton që nuk mund të kërkohen 80 vota nëse në sallë nuk janë të pranishëm së paku 80 deputetë", thuhet në vështrimin ligjor të Lëvizjes FOL. Në Kuvendin e Republikës së Kosovës në kohën e votimit për president ishin të pranishëm vetëm 67 deputetë. Kjo e bën automatikisht të pamundshëm konstatimin e kuorumit të nevojshëm prej 80 deputetësh, respektivisht arritjen e 2/3 të votave. Prezencën e vetëm 67 deputetëve në sallë e ka konstatuar edhe Kryetari i Kuvendit", sqaron kjo OJQ. Sipas kësaj organizate, në mungesë të një kuorumi të tillë, dy raundet e para të votimit për president kanë qenë improvizim dhe si të tilla kanë shkelur drejtpërdrejt nenin 86, paragrafin 4 të Kushtetutës. Për të argumentuar shkeljen tjetër, Lëvizja FOL i është referuar nenit 86 paragrafit 5 të Kushtetutës, i cili e specifikon organizmin e raundit të tretë të votimit për president në rast se asnjëri nga kandidatët për këtë post nuk arrijnë që t'i marrin votat e mjaftueshme në dy raundet e para. Në rastin konkret, atë të zgjedhjes së Pacollit, nuk ka pasur kunderskandidatë. "Përgjatë gjithë këtij paragrafi, (5 v.j) kur flitet për

kandidatët për president, përdoret vetëm shumësi (ngjashëm edhe në paragrafin 6 të po këtij neni). Kjo në vetvete nuk jep asnjë mundësi tjetër alternative, përveç domosdoshmërinë e pasjes së më shumë se një kandidati për president", ka konstatuar Lëvizja FOL. Nevoja për të pasur më shumë se një kandidat, sipas kësaj lëvizje, shihet edhe në paragrafin 3 të po këtij neni, pasi në të përcaktohet se për të qenë kandidat i nominuar për president, duhet të sigurosh nënshkrimet e së paku 30 deputetëve. Pasi Kuvendi ka 120 deputetë, ky paragraf, sipas FOL - it, lejon mundësinë e nominimit të deri katër kandidatëve për kryetar shteti. "Duke pasur për kandidat vetëm z. Behgjet Pacolli, procesi i zgjedhjes së presidentit ka shkelur nenin 86, paragrafin 5 të Kushtetutës", nxjerr konstatimin Lëvizja FOL. Kjo lëvizje ka konstatuar se zgjedhja e Pacollit president, është bërë duke e cenuar edhe të drejtën e deputetit për ta shprehur lirshëm vullnetin e vet, gjë që i garantohet me nenin 70, paragrafi 1 të Kushtetutës. "Zhvillimi i procesit të zgjedhjes së presidentit dhe intervenimet e ndryshme jashtë autorizimeve të tyre nga zyrtarë dhe persona të ndryshëm brenda dhe jashtë Kuvendit kanë dëshmuar që deputetët e Kuvendit kanë zgjedhur për president të Republikës së Kosovës z. Behgjet Pacolli nën presion. Duke pasur dhe ndikuar nga këto presione, të dëshmuara edhe nga vetë Kryetari i Kuvendit si dhe nga raportimet e mëvonshme në media, deputetët e pranishëm në sallë kanë bërë shkeljen e nenit 70, paragrafi 1 të Kushtetutës", ka vlerësuar Lëvizja FOL. Kjo OJQ ka nxjerrë konstatimin se gjatë zgjedhjes së presidentit të ri është shkelur vullneti i deputetit për ta shprehur lirshëm qëndrimin e tij për kandidatin për president, përmes votimit të fshehtë. Neni 86, paragrafi 1 i Kushtetutës, përcakton që Presidenti zgjidhet nga Kuvendi, dhe me votim të fshehtë. Fshehtësinë e votës së deputetëve për procese të tilla të rëndësishme, përveç tjerash, garanton pavarësinë e tyre dhe siguron mbrojtje nga ndikimet e jashtme. Në rundin e parë dhe të dytë të votimit për President, kandidati Behgjet Pacolli nuk ka arritur të merrte me shumë se 54, përkatësisht 58 vota pro. "Pas një pauze kontroverse, kandidati Behgjet Pacolli është votuar me 62 vota pro, si President i Republikës së Kosovës. Fakti që votat e deputeteve janë ndryshuar nga kundër ose abstenim në pro pas pauzës, është dëshmi logjike e presionit të deputetët për të ndryshuar votat e tyre në favor të kandidatin për president", thuhet në analizën e FOL-it. Për më tepër, provat e mesazheve të shkëmbyera ndërmjet kandidatin për president dhe këshilltarit të tij dëshmojnë identifikimin e deputeteve që kanë votuar kundër ose kanë abstenuar, dhe ndikimet tek ta. Duke i konstatuar të gjitha këto më lart, gjatë procesit të zgjedhjes së presidentit të Kosovës është shkelur fshehtësia e votës, e me këtë është shkelur neni 86, paragrafi 1 i Kushtetutës", shtohet më tej në këtë dokument. Dhe shkelja e pestë kushtetuese, sipas FOL - it, është bërë në nenin 83, nën ky që e definojnë rolin unikues që duhet ta ketë presidenti i vendit. "Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës", thuhet në këtë nen. Nisur nga kjo. Lëvizja FOL ka ardhur në përfundim se presidenti Pacolli është zgjedhur pa kuorum, prezencën në sallë vetëm të shumicës së thjeshtë të deputetëve të Kuvendit si dhe si pasojë e presionit të ndikimit të votave të deputetëve. Për më tepër, opozita, e cila përfaqëson "shumicën e votave popullore" të Kosovës, ka braktisur sallën. Me këtë rast FOL jep edhe një propozim. "Duke e përcaktuar presidentin si përfaqësues të unitetit të popullit, duke e përcaktuar mandatin e presidentit për (5) vite, ndryshe nga mandati i Qeverisë, si dhe duke ndaluar presidentin që të ushtroj funksione të tjera janë dëshmi se Kushtetuta kërkon që kjo pozitë të mos bëhet pjesë e "pazarit politik" por në këtë pozitë duhet të vijë individë përmes konsensusit". Lëvizja FOL ka vlerësuar se për të qenë vendimet e Kuvendit të ligjshme, nuk duhet të ketë shkelje as të Kushtetutës, e as të ligjeve dhe Rregullores së Kuvendit. Kjo lëvizje ka rikujtuar se kryetari i Kuvendit si interpretues i rregullores së punës ka deklaruar se pauza pas raundit të dytë të votimeve për presidentin e vendit ishte shkelje e

Rregullores së punës. FOL ka nxjerrë përfundimin se ndaj deputetëve është bërë presion për ta shprehur lirshëm vullnetin e tyre. "Presioni i bërë ndaj deputetëve të pranishëm në sallë është evident edhe sipas deklaratës së Kryetarit të Kuvendit, ku thekson se çfarëdo ndryshimi në vota pas pauzës, pas rundit të dytë do të ishte rezultat i presioneve. Në këtë rast kryetari i Kuvendit, duke qenë edhe pjesë e grupit parlamentar të PDK-së, është dëshmitarë se deputetët nuk i janë nënshtruar vetëm ndërgjegjes së tyre, por kanë votuar për presion", ka konstatuar Lëvizja Fol. Kjo OJQ ka bërë vërejtje edhe për angazhimin e Pacollit në ndërtimin e koalicionit qeverisës. Posti i presidentit ka qenë pjesë e negociatave për formimin e qeverisë së vendit. Në këtë mënyrë PDK-ja praktikisht ka ofruar postin e presidentit për partinë AKR-në në shkëmbim të votave për qeverinë, respektivisht duke ndërlidhur drejtpërdrejtë postin e presidentit me institucionet tjera, respektivisht Qeverinë, thuhet në vështrimin e FOL-it.

## **Pacolli në Tiranë kërkon bashkim ekonomik**

**Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, për vizitë zyrtare në Shqipëri**

Deklaratat e presidentit Pacolli, kreu i shtetit shqiptar i quajti "si një mendje e hapur me një vizion të qartë për bashkëpunimin midis Shqipërisë dhe Kosovës. Duke marrë shkas nga deklaratat e homologut kosovar, presidenti Topi u shpreh se ka ardhur koha që dy vendet të pozicionohen qartë me ide të qarta për perspektivën ekonomike. Për presidentin Pacolli lëvizja e lirë nis pikërisht duke i krijuar vetes një lëvizje të lirë. **"Ne duhet të bisedojmë për tarifat doganore që ato të mos ekzistojnë, sidomos mes Shqipërisë dhe Kosovës, që mallrat, prodhimtaria jonë të jetë prodhimtari plotësuese. Ajo që nuk është në Kosovë, të merret nga Shqipëria dhe ajo që është në Kosovë dhe nuk prodhohet në Shqipëri, të merret nga Kosova. Kemi shembullin e rrushit tonë, kemi shembullin e patateve tona. Sot patatet e Kosovës shiten nëpërmes Serbisë në vendet e Lindjes dhe ne do të mundemi ta bëjmë këtë, por jo vetëm patatën, por kemi dhe shumë gjëra të tjera"**, tha presidenti Pacolli, duke shtuar se "të mos mbetemi vetëm te lëvizja e lirë e njerëzve dhe e mallrave, por të kemi edhe lëvizje të lirë të ideve, unifikimin e teksteve shkollore, unifikimin e dokumenteve përcjellëse etj, etj.



*Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, për vizitë zyrtare në Shqipëri takon presidentin Topi dhe bisedojnë për bashkëpunimin ekonomik dhe jo vetëm këtë por z.Pacolli shtoi se përveç lëvizjes së lirë të njerëzve dhe e mallrave, të kemi edhe lëvizje të lirë të ideve, unifikimin e teksteve shkollore, unifikimin e dokumenteve përcjellëse etj etj*

## **Bisedimet Prishtinë – Beograd**

Bisedimet Prishtinë - Beograd janë quajtur si tepër të rëndësishme për të ardhmen jo vetëm të dy vendeve, por edhe të rajonit. Presidenti Pacolli tha se **"Kosova nuk mund të ketë mbi 60-65 % të kufijve të saj të blinduar, të mbyllur. Sot Kosova nuk mund të vuajë nga banda kriminale, të cilat veprojnë në territorin e saj. Prandaj Kosova ka nevojë për bisedime"**. **"Ua them edhe një herë që Kosova ka nevojë që të bisedojë me fqinjin tonë të veriut për arsye se humbësja më e madhe ka qenë Kosova. Kur u larguan nga Kosova, serbët morën çdo gjë me vete. Morën paratë tona, morën pensionet tona, shkatërruan fabrikat tona, vodhën fabrikat tona, prandaj jemi ne ata që u kërkojmë atyre llogari. Llogaritë nuk mund të kërkojnë më sot, në kohë paqeje, me dhunë. Ne ato do t'i kërkojmë dhe do t'i arrijmë me bisedime. Nuk do të ndalemi asnjëherë që të mos bisedojmë"**, tha presidenti Pacolli, duke quajtur të mbrapshtë idenë për të mos biseduar. **"Është fakt se ne kemi shumë gjëra për të biseduar. Edhe një herë ju garantoj, edhe juve, zoti president, edhe gjithë kombit shqiptar, edhe qytetarëve të Kosovës, se kurrë, asnjëherë nuk do të bisedohet për statusin tonë! Asnjëherë nuk do të bisedohet për integritetin tonë! Asnjëherë nuk do të bisedohet për kufijtë tanë! Prandaj çdo gjë tjetër që bisedohet do të duhet të konsiderohet si e nevojshme dhe ne i quajmë biseda që do të lehtësojnë jetën e qytetarëve të Kosovës"**, tha kreu i Kosovës duke i kërkuar mbështetje homologut shqiptar në këto bisedime. Për presidentin Bamir Topi këto bisedime janë tepër të rëndësishme. **"Shqipëria e konsideron si shumë të rëndësishëm bashkëpunimin rajonal edhe me vende të tilla si Serbia, sepse jashtë çdo lloj paragjykimi, në kontekstin historik retrospektiv, ne e kemi bërë të qartë, që ndonëse me Serbinë na ndan një gjë shumë e madhe që ka të bëjë me pozicionimin për Kosovën, kjo në kontekste të reja rajonale dhe evropiane, nuk do të thotë që midis dy vendeve të mos ketë dialog politik, të mos ketë bashkëpunim në interes të vendeve, të popujve tanë dhe të paqes rajonale"**, tha presidenti Topi. **"Bisedimet që ekzistojnë midis Kosovës dhe Serbisë po zhvillohen në një lloj konteksti të tillë, në respekt të sovranitetit të vendeve respektive, duke diskutuar për çështje të karakterit teknik, të rëndësishme për interesat e dy vendeve"**, shtoi Topi.

## **Shqipëria lobon për Kosovën**

Tirana zyrtare do të vijojë të llojë jo vetëm për njohjen e mëtejshme të pavarësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare, por dhe për heqjen sa më shpejt të regjimit të vizave për qytetarët e saj. **"Në bisedë me të gjithë partnerët, në të gjitha tryezat, natyrisht ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë që pikërisht kjo të bëhet e mundur sa më shpejt edhe për qytetarët e Kosovës, të cilët nuk mund të mbeten të izoluar. Jam i bindur që shumë shpejt, dhe kjo është edhe në interes të partnerëve tanë ndërkombëtarë, që së bashku me popujt e tjerë të rajonit, kjo të bëhet e vlefshme edhe për qytetarët e Kosovës"**, ka thënë presidenti Topi. Mbështetje për të fituar sa më shpejt liberalizimin e vizave apo integrimin në Aleancën e madhe të NATO - s ka qenë dhe një kërkesë e presidentit kosovar Pacolli. **"Një ditë pse jo, edhe kosovarët, ashtu si edhe Ushtria Shqiptare, të jenë pjesë e paqeruajtësve jashtë Kosovës, gjerësisht, jashtë Shqipërisë. Ndihma juaj këtu, zoti president, do të jetë shumë e evidente. Ne dëshirojmë të jemi aty ku jeni ju! Ne dëshirojmë të rreshtohemi aty ku ju rreshtoheni, për arsye se tradita është në anën tuaj, eksperiencia është në anën tuaj, dhe mbetet pothuajse një përgjegjësi e Republikës së Shqipërisë që t'ia shtrijë dorën Kosovës, aty ku Kosova ka nevojë"**, tha presidenti Pacolli. Gjatë këtij takimi të dy

presidentët kanë folur dhe për vazhdimin e një tradite të re takimesh që ka lindur midis presidentëve të Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe të Kosovës. Filloi në Vlorë në vitin 2009, vazhdoi në Prizren. Tashmë dy presidentët shqiptarë janë ftuar nga presidenti Ivanov i Maqedonisë dhe takimin e radhës do ta realizojnë në Ohër dhe pas kësaj i takon Malit të Zi.

### **Takimi Berisha - Pacolli**

Presidenti i sapo zgjedhur i Kosovës u prit në një takim edhe nga kryeministri Sali Berisha. Kreu i Qeverisë shqiptare e uroi presidentin për detyrën e marrë dhe rikonfirmoi besimin se me eksperiencën e tij ai do ta përmbushë me sukses këtë detyrë. Në këtë takim u rikonfirmuan edhe një herë marrëdhëniet e mira mes dy vendeve e popujve dhe angazhimi i të dyja vendeve për të ndërtuar bashkëpunimin më të ngushtë e të shkëlqyer në të ardhmen, duke e shndërruar kështu faktorin shqiptar në shembull të marrëdhënieve të shkëlqyera të bashkëpunimit e miqësisë në rajon. "Bashkëpunimi është në shërbim të interesit më të mirë të qytetarëve të Shqipërisë dhe të Kosovës, paqes, stabilitetit e miqësisë midis vendeve të Ballkanit Perëndimor e më gjerë, si dhe ecjes përpara me shpejtësi drejt të ardhmes së përbashkët në Bashkimin Europian dhe në komunitetin euroatlantik", ka thënë kryeministri Berisha. Duke folur për intensifikimin e mëtejshëm të këtyre marrëdhënieve, kryeministri Berisha dhe presidenti Pacolli rikonfirmuan vullnetin për ndërtimin e një sërë veprash infrastrukturore që do të lidhin dy vendet dhe do të forcojnë shkëmbimet midis qytetarëve të Shqipërisë dhe Kosovës, përfundimin e Rrugës së Kombit dhe akset e tjera rrugore që lidhin dy vendet, nevojën për lidhje hekurudhore, si dhe fillimin e punimeve brenda këtij viti të linjës së interkonjeksionit 400 kilovolt Tiranë - Prishtinë. Duke folur për bisedimet e nisura mes Prishtinës dhe Beogradit, kryeministri Berisha tha se "ky dialog do t'i shërbejë lehtësimit të jetës së përditshme të qytetarëve të të dyja vendeve".



*Presidenti i sapo zgjedhur i Kosovës u prit në një takim edhe nga kryeministri Sali Berisha. Kreu i Qeverisë shqiptare e uroi presidentin për detyrën e marrë dhe rikonfirmoi besimin se me eksperiencën e tij ai do ta përmbushë me sukses këtë detyrë*

---

## Më 16 prill, AKR zgjedh kryetarin

---

**Aleanca Kosova e Re më 16 prill do t'i zgjedhë organet e saj drejtuese në kuvendin e jashtëzakonshëm zgjedhor, që e ka caktuar Këshilli i Përgjithshëm i kësaj partie. Për postin e kryetarit ende nuk ka kandidat zyrtarisht, por "Infopress" mëson se interesim për ta udhëhequr AKR-në ka shprehur Rrahim Pacolli, djali i axhës së ish-presidentit të AKR-së, Behgjet Pacolli**

Këshilli i Përgjithshëm i AKR-së ka vendosur që më 16 prill ta mbajnë kuvendin e jashtëzakonshëm zgjedhor, për t'i zgjedhur strukturat udhëheqëse të kësaj partie. Edhe pse ende zyrtarisht nuk ka asnjë kandidat që ka shprehur ambicie për të marrë postin e kreut të AKR-së, "Infopress" mëson nga burime shumë të sigurta, se tashmë Rrahim Pacolli, djali i axhës së ish-presidentit të AKR-së, Behgjet Pacolli, ka shprehur interesim për ta marrë drejtimin e partisë. Mirëpo, ushtruesi i detyrës së presidentit të AKR-së, Ibrahim Makolli ka thënë se deri më tani ende nuk ka asnjë kandidat zyrtar, duke thënë se çdo anëtar i kësaj partie mund ta marrë drejtimin e AKR-së. Mirëpo, nëse Pacolli "2" do ta drejtojë AKR-në, do të vendosin strukturat e partisë në kuvendin zgjedhor.

### **S'ka ambicie për kryetar**

Ndërsa, ushtruesi i detyrës së presidentit të AKR-së, Ibrahim Makolli ka thënë se tash për tash nuk ka asnjë kandidat për të marrë postin e kryetarit të AKR-së, edhe pse ai shprehet se brenda AKR-së ka kuadro të mjaftueshëm për të ardhur në krye të kësaj partie. "Edhe pse jam i vetëdijshëm se është zor me e zëvendësu Pacollin në atë vend, megjithatë po presim deri në kuvend ose edhe në kuvend të ketë kandidatura", ka thënë Makolli. Ndërsa, përveç Rrahim Pacollit që ka shprehur interesim për këtë post, njëri nga kandidatët për të marrë drejtimin e AKR është folur se mund të jetë edhe Ibrahim Makolli. Por, Makolli thotë se ai nuk ka ambicie për ta marrë kreun e kësaj partie, pasi ndihet komod me pozitat që i ka aktualisht. "Unë e kam theksuar se nuk kam ambicie, këto detyra që jam duke i kryer, si shef i Grupit Parlamentar, nënkryetar i AKR-së dhe u.d. i presidentit të AKR-së, janë të mjaftueshme për mua, natyrisht unë do të jem pjesë e ndërtimit të politikave të AKR-së, por nuk kam ambicie personale që të jem në krye të AKR-së", ka thënë Makolli. Ndërsa, në kuvendin zgjedhor të 16 prillit, përveç se do të emërohen organet drejtuese të AKR-së, delegatët do ta miratojnë edhe statutin e partisë me ndryshimet që do t'i bëjnë. Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur para dy javësh përveç se ka caktuar datën e mbajtjes së kuvendit të jashtëzakonshëm zgjedhor, gjithashtu ka caktuar edhe dy grupe punuese. Njëri grup ka të bëjë me përgatitjet teknike të Kuvendit të jashtëzakonshëm zgjedhor, ndërsa, grupi i dytë do të bëjë amendamentimin e statutit të AKR - së, i cili pastaj do të hidhet në votim me amendamentet në kuvendin e AKR-së. Makolli ka thënë se kanë parashikuar të bëjnë disa ndryshime në statut, sidomos të kompetencat e kryetarit të partisë.

### **Jo president, por kryetar**

Ndërsa, në ndryshimet që priten të bëhen në këtë kuvend është edhe ndryshimi i emrit të udhëheqësit të partisë, që mos të quhet president, por vetëm kryetar i AKR-së.



---

## **Pacolli ngushëllon Obamën**

---

PRISHTINË - Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli ngushëlloi të hënën presidentin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Barack Obama dhe popullin amerikan për vdekjen e ish - sekretarit amerikan të Shtetit, Warren Christopher. Duke qenë një diplomat i kalibrit botëror, ish - sekretari Christopher, sipas Pacollit, ishte në vazhdimësi i angazhuar në promovimin e paqes, lirisë dhe demokracisë në mbarë botën, e në veçanti për rajonin e Ballkanit. **"Populli i Kosovës i është jashtëzakonisht mirënjohës kontributit të diplomatit Christopher, për promovimin e paqes dhe lirisë nëpër botë, si dhe çmon lart angazhimin e tij në mbështetjen e aspiratave tona për liri dhe pavarësi"**, thuhet në ngushëllimin e Pacollit. Vdekja e ish - sekretarit amerikan të Shtetit, sipas presidentit kosovar, është humbje e madhe për të gjithë popujt lirisdashës.

## Kosova e Shqipëria bashkohen në Evropë

**Presidenti Behgjet Pacolli tha para ligjvënësve shqiptarë se bashkimi kombëtar është synimi i tij. Ky bashkim, siç tha ai, nuk do të ndodhë në mënyrë territoriale por ekonomike dhe vetëm gjatë integritit në BE.**

TIRANË - Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, i cili po qëndron për një vizitë zyrtare në Tiranë, ka deklaruar të hënën se Kosova dhe Shqipëria së bashku do të jenë pjesë e Bashkimit Evropian, por jo të bashkuar në aspektin territorial, por në atë ekonomik, duke tejkaluar barrierat që ekzistojnë. Presidenti Pacolli ka zgjedhur që vizitën e tij të parë jashtë shtetit ta zhvillojë pikërisht në kryeqytetin shqiptar, në shtetin amë, siç e ka quajtur vetë ai. I pritur me një ceremoni solemne në Pallatin e Brigadave serinë e takimeve të parapara me agjendën dyditore të qëndrimit në Shqipëri, Pacolli e ka nisur me takimin me presidentin Bamir Topi. Me shprehjet vëllezër shqiptarë, Shqipëria ime, Shqipëria amë, presidenti i Kosovës ka nisur fjalimin e tij para ligjvënësve shqiptarë, duke shfaqur nevojën e intensifikimit të bashkëpunimit dypalësh në fushën ekonomike, por edhe në atë të integritit. **"Nuk po propozoj diçka tabu që mund të frikësojë dikë, porse kufirin e kemi rrënuar para 11 vjetësh, prandaj e ardhmja është bashkimi ynë kombëtar, por jo në atë mënyrë destruktive që mund të kuptojë dikush, por ne synojmë bashkimin që rekomandon edhe Bashkimi Evropian"**, ka thënë Pacolli, duke shtuar se rruga e kombit duhet të jetë më shumë e qarkullueshme, në mënyrë që shqiptarët të afrohen më shumë mes veti. Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, ndërkaq në takimin që ka zhvilluar me homologun e tij shqiptar, Bamir Topi, ka deklaruar se vizita e tij e parë zyrtare në Tiranë vjen në një moment shumë të rëndësishëm, kur Kosova sapo ka dalë nga një vakuum i vështirë institucional. Duke folur për bisedimet me Serbinë, ai ka garantuar se bisedimet Prishtinë - Beograd do jenë vetëm në nivel teknik dhe kurrë nuk do të debatohet me Serbinë për çështjen e pavarësisë apo territoreve. Edhe presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi, ndau të njëjtin qëndrim, duke thënë se Tirana zyrtare e konsideron shumë të rëndësishëm bashkëpunimin rajonal, e në këtë drejtim edhe me Serbinë. Presidenti Topi nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit për shtimin e njohjeve për Kosovën, duke premtuar se do të bëjë gjithçka që është e mundur për krijimin e një reputacioni të ri dhe Kosova të njihet nga sa më shumë shtete. Kreu i shtetit të Kosovës, Behgjet Pacolli, është përgjigjur edhe në interesimin e gazetarëve rreth mënyrës së zgjedhjes së tij si president. Sipas tij, presidenti i Kosovës duhet të zgjidhet me referendum, që të vijë nga vota e popullit. Kurse kreu i shtetit Bamir Topi theksoi se si qytetar do të ishte pro referendumit nga populli, kurse si president, kjo çështje tha ai i takon Parlamentit për diskutim. Të dy presidentet kanë theksuar se duhet të ketë një unifikim të standardeve në sektorë të caktuar, sikurse është unifikimi i teksteve shkollore. Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, gjatë ditës është takuar edhe me kryeministrin Sali Berisha. Duke e çmuar të rëndësishëm faktin se Pacolli vizitën e parë si president i Kosovës po e bën në Shqipëri, kryeministri Berisha theksoi se kjo vizitë do të jetë një kontribut i rëndësishëm për intensifikimin e marrëdhënieve në mes të dy vendeve. Ai ka deklaruar se Qeveria e Shqipërisë nuk do të hezitojë të marrë të gjitha vendimet që krijojnë mjedis të lirë për shqiptarët e Kosovës e të Shqipërisë. Berisha ka folur gjithashtu për bisedimet e filluara mes Kosovës dhe Serbisë, duke theksuar se statusi dhe kufijtë e Kosovës nuk do të jenë pjesë e këtyre bisedimeve. Në ditën e dytë të vizitës së tij në Shqipëri, presidenti Pacolli do të ketë edhe takime të tjera me personalitete shqiptare, ndërkaq do të qëndrojë në Krujë dhe Lezhë, kurse do t'i dorëzohet çmimi "Honoris Causa" nga Universiteti Evropian i Tiranës. - Lumturie Blakaj

## Presidenti Topi e Pacolli pajtohen për forcimin e dy shteteve pa kufij

I pyetur nga "Bota sot" se a do të ndryshoni kushtetutën dhe a do të kandidoni përsëri për president të Kosovës, Behgjet Pacolli tha: "Po do të kandidoj për president në votimet e drejtpërdrejta nga populli".

TIRANË, 21 MARS - Me ceremonitë më të larta shtetërore për një burrështetas është pritur sot në Tiranë presidenti i Republikës së Kosovës Behgjet Pacolli. Ai nisi kështu vizitën e parë shtetërore në Shqipëri dhe këtë fakt e theksoi me krenari në një konferencë për shtyp vetë presidenti Pacolli pas takimit që pati me homologun e tij Bamir Topi. Në fillim të vizitës së presidentit Behgjet Pacolli në Shqipëri atij i u bënë nderime të larta nga Garda Kombëtare e Shqipërisë. Nën intonimin e himnit kombëtar presidenti Behgjet Pacolli dhe presidenti Bamir Topi parakaluan dhe nderuan Gardën Kombëtare e më pas zhvilluan një takim sa miqësor aq edhe përmbajtjesor. Në takime ku merrnin pjesë delegacione të larta të dy shteteve janë diskutuar çështje me rëndësi për të dy vendet e me theks të veçantë bashkëpunimi ekonomik e kulturor mes dy shteteve, Shqipërisë e Kosovës.



*Presidenti i Republikës së Kosovës Behgjet Pacolli është pritur sot në Tiranë me ceremonitë më të larta shtetërore për një burrështetas*



*President Behgjet Pacolli dhe presidenti Bamir Topi, më pas zhvilluan një takim sa miqësor aq edhe përmbajtjesor. Ata kanë diskutuar çështje me rëndësi për të dy vendet dhe me theks të veçantë mbi bashkëpunimin ekonomik e kulturor mes dy shteteve, Shqipërisë e Kosovës.*

### **Topi: Kosova do të ketë mbështetjen e Serbisë**

Pas takimit të dy presidentët mbajtën një konferencë për shtyp në të cilën pos që shpалosën përmbajtjen e takimit të tyre, iu përgjigjën edhe interesimeve të gazetarëve. Në fjalën e tij presidenti Topi bëri të ditur se me Presidentin Pacolli kanë biseduar në kontekstin rajonal dhe zhvilluan bisedime për stabilitetin e raporteve të reja politike. Topi nënvizoi se do të intensifikon marrëdhëniet mes dy vendeve, sidomos në fushën ekonomike dhe tregtare, por është në atë kulturor dhe arsimor. Presidenti Topi ka theksuar rëndësinë që ka rruga e Kombit "Durrës - Kukës", e cila sipas tij i shërben dy vendeve. Ai kërkoi që infrastruktura rrugore duhet të shfrytëzohet më mirë, duke kërkuar të rriten shkëmbimet tregtare mes dy vendeve. Duke iu referuar bisedimeve me Serbinë dhe Kosovën, Presidenti Topi nënvizoi se në mes dy vendeve duhet të ketë dialog. "Dialogu me Serbinë në të mirë të bashkëpunimi dhe paqes në rajon. Do të ketë përpjekje të përbashkëta që Kosova të njihet nga sa më shumë vende", tha Topi. Kosova në një të ardhme të afërt do të integrohet në BE së bashku me Shqipërinë. Në këtë rrugëtim dhe sfidë, Kosova do të ketë mbështetjen e Shqipërisë, e cila do të bëjë të gjitha përpjekjet dhe do të japë kontribut që Kosova të njihet nga sa më shumë shtete të botës. Kjo është deklarata që Presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi ka bërë, menjëherë pas takimit që zhvilloi me homologun e tij nga Kosova, Behgjet Pacolli, kur të dy dolën në një konferencë të përbashkët shtypi. Topi theksoi se të dyja vendet së bashku do të bëjnë të mundur të krijohet një reputacioni i ri dhe të njihet me sa më shumë shtete. "Ne kemi pasur një gabim të madh në fund të vitit që kaloi për lëvizjen e lirë por kam shprehur brengën time që kjo nuk ndodhi edhe për Kosovën. Kosova

nuk mund të mbetet e izoluar dhe kjo është në interesin e partnerëve që kjo të bëhet e vlefshme" theksoi Topi.

### **Pacolli: Shqipëria është shteti ynë amë!**

Ndërkaq pasi përshëndeti presidentin Bamir Topi për këtë pritje kaq të ngrohtë e vëllazërore, presidenti Behgjet Pacolli tha se sot me Presidentin e Topi biseduam për **"intensifikimin e kontakteve dhe kanë vendosur që së paku dy herë të takohemi në nivel presidentësh, në nivel kryeministrash dhe në nivel deputetësh"**, tha ai. Pacolli u shpreh se duke bashkëpunuar do të jemi me të fortë, ndërsa theksoi se duhet të nis bashkëpunimi ekonomik për të krijuar deri edhe një treg të përbashkët. Pacolli tha se bisedimet me Serbinë janë të rëndësishme, sepse i shërbejnë paqes dhe ecjes përpara. **"Kosova nuk mund të ketë mbi 65 për qind të kufijve të saj të blinduar. Atje vepron krimi i organizuar dhe kjo gjendje duhet të ndryshohet. Kosova ka nevojë për biseda. Kur u larguan nga Kosova, ata morën paratë tona, pensionet tona të ardhurat tona, ndaj bisedimet janë të nevojshme. Është e mbrapsht ideja që të mos bisedojmë. Kemi shumë gjëra për të biseduar. Ju garantojmë juve president, asnjëherë nuk do të bisedohet për statutin tonë"**, tha sot Pacolli. Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli e ka cilësuar shumë të rëndësishme vizitën e tij në Shqipëri, vendin amë siç e cilësoi ai. Presidenti i Kosovës Pacolli theksoi se vizita e tij vjen në një moment kur Kosova ka dalë nga një vakum i vështirë institucional. **"Jam i lumtur që ndodhem në Shqipëri, tek shtet amë, tek shteti mik, tek shteti vëlla, dhe kjo është një frymëzim i madh për mandatin tim"**, theksoi Pacolli. Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli tha sot në konferencën e përbashkët për mediet me Presidentin Bamir Topi se bisedimet me Serbinë nuk do të diskutojnë asnjëherë statusin e Kosovës. Nga ana tjetër Pacolli u shpreh se është nevoja për të pasur sa më shumë kontakte mes dy vendeve dhe përpërcaktimin e një agjende të përbashkët punimesh. **"Sot me Presidentin Topi biseduam për intensifikimin e kontakteve dhe duke vendosur që së paku dy herë të takohemi në nivel presidentësh, në nivel kryeministrash dhe në nivel deputetësh"**, tha ai. I pyetur nga "Bota sot" se a do të ndryshoni kushtetutën dhe a do të kandidoni përsëri për president të Kosovës, Behgjet Pacolli tha se ka nisur iniciativën që në ditën e parë të marrjes së detyrës së presidentit për ndryshime kushtetuese në mënyrë që zgjedhja e presidentit të bëhet nga votimi i drejtpërdrejtë i popullit. **"Po do të kandidoj për president në votimet e drejtpërdrejta nga populli"** është përgjigjur Behgjet Pacolli. Edhe presidenti Topi shprehu qëndrimin e tij për zgjedhje të drejtpërdrejta parlamentare por siç tha ai, kjo përgjegjësi u takon më shumë partive politike shqiptare që të ndërmarin një iniciativë të tillë.



*Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli e ka cilësuar shumë të rëndësishme vizitën e tij në Shqipëri, vendin amë siç e cilëson ai. Pas takimit të dy presidentët mbajtën një konferencë për shtyp në të cilën përveç që shpalosën përmbajtjen e takimit të tyre, iu përgjigjën edhe interesimeve të gazetarëve*

---

## **Pacoli: Shqiptarët të unifikohen**

---

**"Duhet të ecim përpara për ta krijuar të ardhmen tonë, e cila do të jetë e ndritshme. Kemi pasur rezultate, por nuk duhet të kënaqemi me kaq. Duhet t'i japim kuptim angazhimit shekullor të paraardhësve tanë", ka thënë presidenti i Kosovës përpara deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë**

PRISHTINË / TIRANË, 21 MARS - Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacoli, ka nisur të hënën vizitën dyditore në Shqipëri me takimin e parë me presidentin Bamir Topi. Të dy presidentët kanë zhvilluar një takim kokë me kokë dhe më pas kanë drejtuar bisedimet zyrtare dypalëshe të delegacioneve shtetërore përkatëse. Presidenti i Kosovës Behgjet Pacoli dhe ai i Shqipërisë Bamir Topi janë shprehur skeptikë lidhur me bisedimet me Serbinë. Pacoli ka garantuar se bisedimet mes dy vendeve do të jenë vetëm në nivel teknik dhe kurrë nuk do të debatohet çështja e pavarësisë apo territoreve. **"Kosova ka nisur bisedimet me Serbinë për ardhmërinë politike të saj. Nuk mund t'i ketë Kosova 66 përqind të kufijve të blinduar, nuk mund të vuajë nga bandat kriminale. Kosova sot ka nevojë për bisedime. Serbët morën çdo gjë me vete, shkatërruan fabrikat tona, lekët tona, pensionet tona. Dhe llogaritë tona nuk mund të kërkohen në kohë paqeje me dhunë, por me biseda. Nuk do të ndalemi së biseduari",** ka thënë Pacoli. Sipas tij, është e mbrapshtë ideja kur nuk bisedohet, ngaqë ka shumë gjëra për të biseduar me Serbinë, **"Garantoj se kurrë nuk do të bisedohet për statusin tonë, integritetin tonë, asnjëherë nuk do të bisedohet për kufijtë tanë. Çdo gjë tjetër do të jetë e nevojshme, por jam i bindur se bisedat do ta lehtësojnë jetën e qytetarëve të Kosovës",** ka thënë Pacoli. Presidenti Pacoli gjatë vizitës në Tiranë ka propozuar një nismë, sipas së cilës, dy shtetet - Kosova dhe Shqipëria do të përfitonin shumë si në aspektin ekonomik, por dhe në atë të integritetit. Në konferencën e përbashkët me gazetarë me presidentin Topi, Pacoli ka thënë se bashkëpunimi - Kosovë - Shqipëri duhet të plotësohet edhe më shumë, sidomos lëvizja e lirë e mallrave dhe ligjet që asistojnë në këtë pikë. **"Ajo rrugë, për të cilën më parë qytetarëve tanë u nevojiteshin 10 orë, 'Rruga e Kombit' sot bëhet për tri orë. Por, ajo nuk është e përplotë. Ne do ta bëjmë këtë për të formuar një treg të përbashkët. Por, kjo bëhet nëse ne që tani do t'i heqim tarifat doganore që përcjellësit e këtyre mallrave të kenë licencë të unifikuar. Të bëjmë ligje të njëjta e standarde, të cilat do të na çojnë drejt integritetit në BE",** ka thënë Pacoli. Sipas tij, kjo ide dhe nismë duhet të realizohet sa më shpejt, pasi nuk ka më kohë për Kosovën. Ai ka thënë se, përpos lëvizjes së lirë, duhet të ketë edhe unifikim të teksteve shkollore. Ndërsa presidenti Topi ka thënë se në bisedat mes dy presidentëve ishin pikërisht pikat se si dy vendet ta rritin dimensionin e komunikimit mes tyre, por edhe tema të ndjeshme, siç janë problemet me tekstat. **"Lindin probleme për përsosjen e teksteve që kanë të bëjnë me dimensionin e arsimit, për ta rritur standardin e arsimit. Diskutova me presidentin që 'Rruga e Kombit', një element infrastrukturor tejet i rëndësishëm, të shfrytëzohet më mirë për lëvizjen e mallrave me një element shumë simbolik. Pacoli e konsideroi rrugën si shkëmbim të ideve, mundësi e madhe për të komunikuar për interesat tona politike, personale, ekonomike, ku dimensionin e lirisë të jetë i shprehur në mënyrë të veçantë",** ka thënë Topi. Në vazhdim presidenti Topi ka deklaruar se Shqipëria e konsideron shumë të rëndësishëm bashkëpunimin rajonal. **"Edhe pse me Serbinë na ndan një gjë shumë e madhe që ka të bëjë me Kosovën, në kontekstet evropiane nuk do të**

thotë të mos kemi një bashkëpunim. Jam i bindur se dhe bisedimet që ekzistojnë mes Kosovës dhe Serbisë bëhen në këtë kontekst", ka thënë Topi. Topi ka thënë se, edhe pse pati një gëzim shumë të madh kur Shqipëria mori përgjigjen për lëvizjen e lirë në vendet e BE, kishte një brengë të madhe për Kosovën. Topi ka garantuar se Shqipëria në çdo tryezë do të insistojë në këtë pikë për Kosovën.

### **Takimi me Berishën, Topallin dhe Ramën**

Gjatë së hënës presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, është takuar edhe me kryeministrin Sali Berisha, kryeparlamentaren Jozefina Topalli dhe kreun socialist Edi Rama. Kryeministri shqiptar Sali Berisha dhe presidenti i Kosovës Behgjet Pacolli, të cilët u takuan të hënë në Tiranë, kanë shprehur angazhimin e të dy vendeve për ta zgjeruar dhe thelluar bashkëpunimin në të gjitha fushat. Ky bashkëpunim bazohet në kuadrin më të mirë e lehtësues ligjor, në veçanti për sa i përket bashkëpunimit në fushën ekonomike, bujqësore, investimeve të gjithanshme, infrastrukturave të rëndësishme që do t'i lidhin dy vendet dhe mbarë rajonin. Presidenti Pacolli dhe kryeministri Berisha kanë biseduar që mes dy shteteve të vazhdohet me lehtësimin edhe më tej të qarkullimit të njerëzve, mallrave dhe ideve. Ata kanë biseduar edhe për nevojën e harmonizimit të legjislationit, si dhe të krijimit të lehtësirave për bizneset në të dyja shtetet. Në këtë kontekst, ata rikonfirmuan vullnetin për ndërtimin e një sërë veprash infrastrukturore që do t'i lidhin dy vendet dhe do t'i forcojnë shkëmbimet midis qytetarëve të Shqipërisë dhe Kosovës, përfundimin e "Rrugës së Kombit" dhe akset e tjera rrugore që lidhin dy vendet, nevojën për lidhje hekurudhore, si dhe fillimin e punimeve brenda këtij viti të linjës së interkonjeksionit 400 kilovoltë Tiranë - Prishtinë. **"Heqja e vizave për qytetarët shqiptarë është një mrekulli e vërtetë për të cilën shqiptarët do t'ju jenë përherë mirënjohës juve, zoti kryeministër, por edhe reformave të qeverisë suaj"**, ka thënë Pacolli. Në takim është diskutuar situata politike në rajon dhe është konfirmuar rëndësia për vazhdimin e dialogut për të gjitha çështjet teknike midis Prishtinës dhe Beogradit, i cili do t'i shërbejë lehtësimit të jetës së përditshme të qytetarëve të të dy vendeve. Gjithashtu, në takim është vlerësuar fakti se Kosova është shndërruar tashmë në një faktor real stabiliteti, paqeje e miqësie në rajon.

### **Unifikim duke bashkëpunuar**

Në vizitën e tij të parë si president i Kosovës, Behgjet Pacolli në fjalën e tij në Kuvendin e Shqipërisë bëri thirrje për unifikim të qëndrimeve dhe bashkëpunim në të gjitha fushat. **"Duhet të ecim përpara për të krijuar të ardhmen tonë, e cila do të jetë një e ardhme e ndritshme"**, ka thënë Pacolli para deputetëve shqiptarë. **"Kemi pasur rezultate, por nuk duhet të kënaqemi me kaq. Duhet t'i japim kuptim angazhimit shekullor të paraardhësve tanë"**, ka thënë ai. Presidenti i Kosovës bëri disa propozime konkrete në fjalën e tij përpara deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë. **"Propozoj një takim periodik të drejtuesve të vendeve tona të modelit të Këshillit Evropian, duke ftuar këtu edhe Maqedoninë dhe Malin e Zi. Ta zhvillojmë edhe forumin periodik të bizneseve. Iniciativat janë të pakta. Është normale që bizneset tona të konkurrojnë ashpër me njëra - tjetrën"**, ka theksuar ai. Presidenti Pacolli e ka quajtur të pafalshme shfrytëzimin e burimeve tona nga vende të treta, duke e vënë theksin te burimet energjetike. **"Të njehsohet prodhimi i energjisë elektrike, një sistem energjetik i përbashkët. T'i eliminojmë barrierat për lëvizjen e mallrave, për dhënien e licencave, për themelimin e ndërmarrjeve, të trajtohem njëjloj. Ta njehsojmë legjislationin dhe rregullat e komunikacionit"**, ka thënë ai.



## **Rama ia dhuron Pacollit "Çelësin e Tiranës"**

Pas fjalës së tij në Kuvendin e Shqipërisë, Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, është takuar me kreun e Bashkisë së Tiranës, Edi Rama, i cili ia ka dhuruar Pacollit "Çelësin e Tiranës". Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, ka thënë se Rama ka bërë një punë të mirë me Tiranën, ndërsa e konsideroi si kryeqytetin e kombit. Ai premtoi se do ta japë kontributin e tij për Tiranën.

---

## **Franca dhe Austria mbështesin Kosovën**

---

PRISHTINË, 21 MARS - Kryeministri Hashim Thaçi ka marrë telegrame urimi nga kryeministri i Francës François Fillon dhe kancelari austriak Werner Faymann me rastin e formimit të kabinetit të ri qeveritar. "Kryeministri i Francës, François Fillon, nëpërmjet kësaj letre i ka përcjellë kryeministrit Hashim Thaçi urimet më të mira për zgjedhjen për kryeministër dhe konsolidimin e institucioneve të reja të Republikës së Kosovës", është bërë me dije në një komunikatë për medie të lëshuar nga Zyra e Informimit e Kryeministrit. Me këtë rast Fillon ka shprehur mbështetjen e Francës në rrugën e zhvillimit ekonomik dhe të përafrimit të Kosovës me BE - në. "Në vazhdim, kryeministri Fillon ka shprehur bindjen se Qeveria e Kosovës, në të cilën janë përfshirë edhe përfaqësuesit e minoriteteve nën drejtimin e kryeministrit Thaçi, do të vazhdojë të angazhohet me vendosmëri për konsolidimin e institucioneve dhe të sundimit të ligjit dhe në luftën e pakompromis kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar", thuhet më tej në komunikatë. Fillon nëpërmjet kësaj letre ka shprehur rëndësinë e dialogut në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, në mbështetje të BE - së, me qëllim të përmirësimit të jetës së të dy popujve dhe të stabilitetit të rajonit. Kryeministri Thaçi ka pranuar edhe një telegram urimi për rizgjedhjen e tij në krye të Qeverisë së Republikës së Kosovës edhe nga homologu i tij austriak, kancelari Werner Faymann. Kancelari Faymann, pasi ka uruar kryeministrin Thaçi për rizgjedhjen e tij dhe formimin e kabinetit qeveritar, ka shprehur bindjen se marrëdhëniet e mira mes Kosovës dhe Austrisë do të thellohen, duke ndërtuar një bashkëpunim të frytshëm në të gjitha çështjet me interes të përbashkët.

## Presidenti Pacolli nderohet me Çmimin “Honoris Causa”

TIRANË, 22 MARS - Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, në një ceremoni solemne, është nderuar të martën me Çmimin "Honoris Causa" në Universitetin Evropian të Tiranës (UET). Në ceremoni ishin të pranishëm presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi, ish - presidentët Alfred Moisiu e Rexhep Meidani, ministra të Qeverisë së Shqipërisë e të Qeverisë së Kosovës, profesorë, studentë e mysafirë të tjerë të shumtë. Në fjalën e tij pas nderimit me këtë çmim, presidenti Pacolli tha: **"Dua të më besoni fuqimisht kur them se jam shumë i prekur, shumë i emocionuar ndërsa marr këtë titull nderimi akademik prej universitetit tuaj". "Kam mësuar shumë rreth Universitetit Evropian të Tiranës. Kam mësuar se ai lindi si një initiative studiuesish të rinjë që vinin nga Perëndimi dhe shumë shpejtë është shndërruar në një qendër të rëndësishme mendimi, debati akademik, politik dhe shoqëror në Shqipërinë tonë. Ndaj e vlerësoj posaçërisht nderimin tuaj, sepse ai është i pari në llojin e vet për mua; sepse ai vjen prej vendit tim, që unë e dua shumë; sepse ju pa neglizhuar asgjë, keni vendosur të më nderoni për aktivitetin tim njerëzor në çdo fushë",** ka thënë presidenti Pacolli.



*Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, në një ceremoni solemne, është nderuar të martën me Çmimin "Honoris Causa" në Universitetin Evropian të Tiranës (UET)*

---

## **Kryeministri Berisha priti presidentin Pacolli**

---

### **Zotohen për ndërtimin e një sërë veprash infrastrukturore**

**Kryeministri Berisha dhe Presidenti Pacolli vlerësuan se bashkëpunimi është në shërbim të interesit më të mirë të qytetarëve të Shqipërisë dhe të Kosovës.**

Në selinë e kryeministrisë kryeministri shqiptar Sali Berisha organizoi një pritje për presidentin e Kosovës Behgjet Pacollin. Ky takim u zhvillua pa praninë e medieve ndërsa të dy burrështetasit e lartë shqiptar ecën këmbë për në Bulevardin e Kombit drejt një restoranti ku kryeministri Berisha shtroi drekë pune për presidentin e Republikës së Kosovës. Po sot paradite presidenti Behgjet Pacolli është pritur me nderime të larta nga presidentin Bamir Topin. Ndërkohë, që zyra për informim e kryeministrisë së Shqipërisë, bëri të ditur detajet e takimit ndërmjet kryeministrit Berisha dhe presidentit Pacolli. Kryeministri Berisha në një takim me Presidentin e Republikës së Kosovës z. Behgjet Pacolli, pasi i uroi përzemërsisht mirëseardhjen në vizitën e tij të parë zyrtare si President i Kosovës, në Shqipëri, vizita e parë zyrtare kjo jashtë Kosovës, Kryeministri Berisha i rishprehu atij urimet e tij më të përzemërta për detyrën e re dhe i rikonfirmoi edhe një herë bindjen e tij të thellë se me përkushtim dhe eksperiencë do të përmbushë me sukses këtë detyrë të lartë. Presidenti Pacolli e falënderoi kryeministrin Berisha për pritjen e ngrohtë e miqësore. Duke shprehur kënaqësinë e veçantë që ndodhet në Tiranë dhe takohet me Kryeministrin Berisha, Presidenti Pacolli i përcolli atij përshëndetjet më të përzemërta të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe e falënderoi me mirënjohjen më të thellë për përkushtimin, angazhimin, vizionin dhe energjitë e tij të pashtershme në mbështetje dhe ndihmë të Kosovës e çështjes kombëtare. Në takim u rikonfirmuan marrëdhëniet e shkëlqyera vëllazërore, të gjithanshme, midis dy vendeve e popujve dhe angazhimi i të dyja vendeve për të ndërtuar bashkëpunimin më të ngushtë e të shkëlqyer në të ardhmen, duke e shndërruar kështu faktorin shqiptar në shembull të marrëdhënieve të shkëlqyera të bashkëpunimit e miqësisë në rajon. Kryeministri Berisha dhe Presidenti Pacolli vlerësuan se bashkëpunimi është në shërbim të interesit më të mirë të qytetarëve të Shqipërisë dhe të Kosovës, paqes, stabilitetit e miqësisë midis vendeve të Ballkanit Perëndimor e më gjerë, si dhe ecjes përpara me shpejtësi drejt të ardhmes së përbashkët në Bashkimin Evropian dhe në komunitetin euroatlantik. Gjatë takimit, bashkëbiseduesit shprehën angazhimin e të dy vendeve për të zgjeruar dhe thelluar bashkëpunimin në të gjitha fushat, bazuar kjo në kuadrin më të mirë e lehtësues ligjor, në veçanti për sa i përket bashkëpunimit në fushën ekonomike, bujqësore, investimeve të gjithanshme, infrastrukturave të rëndësishme që do lidhin dy vendet dhe mbarë rajonin. Në këtë kontekst, ata rikonfirmuan vullnetin për ndërtimin e një sërë veprash infrastrukturore që do të lidhin dy vendet dhe do të forcojnë shkëmbimet midis qytetarëve të Shqipërisë dhe Kosovës, përfundimin e rrugës së kombit dhe asket e tjera rrugore që lidhin dy vendet, nevojën për lidhje hekurudhore, si dhe fillimin e punimeve brenda të këtij viti të linjës së interkonjeksionit 400 kilovolt Tiranë-Prishtinë. Presidenti Pacolli vlerësoi, gjithashtu, reformat e jashtëzakonshme dhe arritjet e mëdha të qeverisë shqiptare gjatë kësaj periudhe, të cilat kanë transformuar vendin dhe kanë bërë të mundur ecjen e tij përpara në drejtim të integritetit euroatlantik, siç ishte integrimi në NATO dhe rruga drejt integritetit në Bashkimin Evropian. **"Heqja e vizave për qytetarët shqiptarë është një mrekulli e vërtetë për të cilën shqiptarët do t'ju jenë përherë mirënjohës ju, zoti Kryeministër, dhe reformave të qeveria tuaj"**, u

shpreh presidenti Pacolli. Në takim u diskutua situata politike në rajon dhe u konfirmua rëndësia për vazhdimin e dialogut për të gjitha çështjet teknike midis Prishtinës dhe Beogradit, i cili do t'i shërbejë lehtësimit të jetës së përditshme të qytetarëve të të dy vendeve. Gjithashtu, në takim u vlerësua fakti që Republika e Kosovës është shndërruar tashmë në një faktor real stabiliteti, paqeje e miqësie në rajon. Në orën 16 presidenti Behgjetiu është drejtuar me një fjalë rasti deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë. Kjo është vizita e parë që presidenti Behgjetiu Pacolli po e bën në cilësinë e presidentit të Kosovës dhe ka zgjedhur Shqipërinë si shtetin e parë për të bërë këtë vizitë zyrtare.



*Kryeministri Berisha dhe Presidenti Pacolli vlerësuan se bashkëpunimi është në shërbim të interesit më të mirë të qytetarëve të Shqipërisë dhe të Kosovës. Kryeministri Berisha i rishprehu atij urimet e tij më të përzemërta për detyrën e re dhe i rikonfirmoi edhe një herë bindjen e tij të thellë se me përkushtim dhe eksperiencë do të përmbushë me sukses këtë detyrë të lartë*

## **Bashkimi i shqiptarëve nëpërmjet bashkimit ekonomik**

**Pacolli foli edhe për krijimin e një grupi, i cili do të punojë për krijimin e një tregu të gjerë, që sipas tij do t'i përfshijë edhe shqiptarët që jetojnë jashtë dy shteteve shqiptare, si ata në Maqedoni e në Malin e Zi.**

TIRANË, 22 MARS - Presidenti i Republikës së Kosovës Behgjet Pacolli, në ditën e dytë të vizitës së tij në Tiranë, i cili po qëndron atje me ftesë të Presidentit shqiptar Bamir Topi, u takua me disa personalitete të jetës politike shqiptare. Në një takim me kryetarin e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Ilir Metën, ata diskutuan për një varg temash të rëndësishme për bashkëpunimin në mes të dy vendeve, por edhe për projektet e përbashkëta dhe vazhdimin e punës për sigurimin e sa më shumë njohjeve për Kosovën, si dhe për trasimin e rrugës së saj drejt integriteteve euroatlantike. Me këtë rast Meta theksi se zgjedhje e Pacollit president, është një mundësi që të kontribuoj edhe më shumë në njohjen e pavarësisë së Kosovës. "Ishte kënaqësi e madhe që të takohemi me presidentin e ri të Kosovës, z. Behgjet Pacolli për t'i uruar edhe nga afër për këtë detyrë shumë të rëndësishme. Unë besoj se kjo detyrë e re dhe shumë e lartë është një mundësi e shkëlqyer për Presidentin Pacolli për të çuar më tej kontributin e tij i cili ka qenë mjaft i ndjeshëm edhe më parë në procesin e njohjes së Kosovës, pasi konsolidimi i pozitës ndërkombëtare është një prioritet i jashtëzakonshëm, ashtu sikur edhe vizioni i tij për ekonominë besoj se do të ndihmojë shumë në zhvillimin ekonomik jo vetëm të Kosovës, por edhe zhvillimin ekonomik të të dy vendeve", tha Meta. Ai ka shprehur mbështetjen e partisë që drejton për politikën e presidentit Pacolli, që sipas tij, ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit midis shtetit të Kosovës dhe atij të Shqipërisë. "LSI mbështet politikën e presidentit të Kosovës, të qeverisë së Kosovës, mbështet forcimin e bashkëpunimit midis dy vendeve, midis dy qeverive, midis dy parlamenteve, dhe jemi të bindur se projektet madhore të cilat kanë përparuar me mjaft sukses në Shqipëri, por po përparojnë edhe në Kosovë do t'i forcojnë edhe më tej marrëdhëniet e shkëlqyera midis shqiptarëve në të dyja anët e kufirit, i cili është fare konvencional", u shpreh Meta. Ndërsa, presidenti Pacolli e vlerësoi kontributin e Metës për afirmimin e shtetit të Kosovës dhe për njohjen e Kosovës. **"Ishte një takim i rëndësishëm për mua. Takimi me mikun është gjithnjë i veçantë. Z. Meta është njeri që ka dhënë kontribut shumë të madh për afirmimin e shtetit të Kosovës, ka punuar shumë për njohjet e Kosovës"**, tha Pacolli. Në anën tjetër, presidenti Pacolli u shpreh se ka ftuar Metën që të vijë në Kosovë, dhe të vazhdojnë bashkëpunimin, sepse siç u tha ai, ka ende punë për shtimin e njohjeve të reja për Kosovë, duke vlerësuar se puna dhe kontributi më i nevojshëm i Metës do të jetë në aspektin e njohjeve. **"Mund t'ju them se ai ka lënë ende punë të pakryera, për të cilat është nevojitur kohë dhe unë sot e luta që kërjt këtë punë që ka mbetur pa u kryer, që të vijë në Kosovë dhe të bisedojmë, që të mos ndalemi. Kemi shumë punë për të kryer dhe puna e z.Meta për njohjet është shumë e rëndësishme. Jam i sigurt se z.Meta, me energjinë e tij, me vullnetin e madh do të përballoj çdo sfidë në mënyrë të suksesshme. Bashkëpunimi me të do të jetë shumë i madh. Ne e vlerësojmë shumë punën që ka bërë për Kosovën dhe besoj se ky aktivitet do të vazhdojë edhe më tej"**, theksoi Presidenti Pacolli.



*Presidenti Pacolli në një takim me kryetarin e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Ilir Metën, biseduan për një varg temash të rëndësishme për bashkëpunimin në mes të dy vendeve, por edhe për projektet e përbashkëta dhe vazhdimin e punës për sigurimin e sa më shumë njohjeve për Kosovën, si dhe për trasimin e rrugës së saj drejt integritimeve euroatlantike*

### **Presidenti Pacolli premtoj krijim e një tregu të gjerë gjithë shqiptarë**

Presidenti Pacolli u takua edhe me Shpëtim Idrizi, kryetar i Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet. Me këtë rast Idrizi vlerësoi se bashkimi i shqiptareve mund të bëhet përmes bashkimit ekonomik. "Ne kemi nevojë të shohim veten tonë si një bashkim ekonomik, si një treg të madh prej shtatë milionë shqiptarëve. Zoti Pacolli, edhe me eksperiencën tij, po i shtyn të dy qeveritë tona që këtë ta shohin në mënyrë të strukturuar", shtoi ai. Ndërsa zgjedhja e Pacollit në krye të shteti të Kosovës, Idrizi vlerësoi se do tu jap hovë njohjeve të reja për Kosovën. Në anën tjetër ai shtoi se Kosova ka nevojë të mbajë të gjallë memorien kolektive për krimet e ndodhura në shtetin e Kosovës, mbi qytetarët e Kosovës nga dhuna e Miloshviqit. Ndërsa, Presidenti Behgjet Pacolli tha më këtë rast se me Idrizin kanë biseduar për gjendjen politike dhe ekonomike, për problemet që i mendojnë Kosovën dhe Shqipërinë, dhe për të drejtat e njeriut duke theksuar se tani ka marrë edhe mbështetjen e madhe të bashkësisë ndërkombëtare e cila e ndihmon kauzën. Pacolli gjithashtu foli edhe për krijimin e një grupi, i cili do të punojë për krijimin e një tregu të gjerë, që sipas tij do t'i përfshijë edhe shqiptarët që jetojnë jashtë dy shteteve shqiptare, si ata në Maqedoni e në Malin e Zi, duke u shprehur se në takimin tjetër me Idrizin, këto nuk do të jenë vetëm fjalë, por do të shihen edhe rezultatet e punës. **"Biseduam për tregun e madh shqiptar, për të cilin unë kam insistuar që të jetë temë e bisedimeve. Kosova nuk do ta lë këtë iniciativë vetëm në fjalë, por do të fillojë punë intensive. Ne do të formojmë një grup, i cili do t'ia fillojë punës që nga tani dhe besoj se deri te takimi**

**tjetër ne do të kemi rezultatet e para të formimit të një tregu të gjerë, që del jashtë kufijve të Shqipërisë, jashtë kufijve të Kosovës, por pse të mos përfshihen në këtë edhe bashkatdhetarët tanë edhe në Maqedoni edhe në Mal të Zi",** tha presidenti Pacolli. Më pas, presidenti Pacolli, vendosi kurora lulesh dhe bëri homazhe para Monumentit "Nëna Shqipëri" në Tiranë. Vendorsja e kurorave u përcoll me ceremoni shtetërore nga Garda e Republikës, ndërsa Presidentin u shoqërua nga komandanti i Përgjithshëm i Gardës së Republikës së Shqipërisë dhe anëtarët e delegacionit të Kosovës.



*Presidenti Pacolli u takua edhe me Shpëtim Idrizi, kryetar i Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet. "Ne kemi nevojë të shohim veten tonë si një bashkim ekonomik, si një treg të madh prej shtatë milionë shqiptarëve. Zoti Pacolli, edhe me eksperiencën tij, po i shtyn të dy qeveritë tona që këtë ta shohin në mënyrë të strukturuar", shtoi ai*



**Presidenti i Kosovës Behgjet Pacolli**

---

**Do ta çoj para amanetin e heronjve të pavarësisë**

---

Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Behgjet Pacolli, në një ceremoni solemne, u nderua sot me çmimin "Honoris Causa" në Universitetin Evropian të Tiranës. Në ceremoni ishin të pranishëm Presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi, ish-presidentët Alfred Moisiu e Rexhep Meidani, ministra të Qeverisë së Shqipërisë e të Qeverisë së Kosovës, profesorë, studentë e mysafirë të tjerë të shumtë. Në vijim po sjellim fjalimin që Presidenti Pacolli mbajti pas nderimit me çmimin prestigjioz: Dua të më besoni fuqimisht kur them se jam shumë i prekur, shumë i emocionuar ndërsa marr këtë titull nderimi akademik prej Universitetit tuaj. Kam mësuar shumë rreth Universitetit Evropian të Tiranës. Kam mësuar se ai lindi si një iniciativë studiuesish të rinj që vinin nga Perëndimi dhe shumë shpejt është shndërruar në një qendër të rëndësishme mendimi, debati akademik, politik dhe shoqëror në Shqipërinë tonë. Ndaj e vlerësoj posaçërisht nderimin tuaj, sepse ai është i pari në llojin e vet për mua; sepse ai vjen prej vendit tim, që unë e dua shumë; sepse ju pa neglizhuar asgjë, keni vendosur të më nderoni për aktivitetin tim njerëzor në çdo fushë. Dhe me këtë rast të lumtur unë dua të them diçka. Unë jam bir i Mareci, i njërit prej katundeve më të mëdhenj të Kosovës. Prej ku kam lindur unë dhe deri ku shtrihej horizonti, ishte Mareci. Jam mësuar që i vogël me horizontet e gjera. Majtas, apo djathtas, në jug apo në veri, unë shihja larg dhe nuk i gjeja fundin largësisë që rrokte syri im. Kështu e kam parë gjithmonë botën edhe kur u rrita, megjithëse s'isha më në Marec, por atje lashë qendrën e botës. Jam nisur nga Kosova për të gjetur fundin e sferës. Në Kosovë lashë fillimin dhe gjeta fundin e sferës që ishin bashkë. Dikush thotë se njeriu bredh gjithë botën për të kërkuar diçka që i nevojitet dhe më në fund kthehet ta gjejë në shtëpinë e vet. Kjo është forca tërheqëse e atdheut. Që në fillim të jetës kur nisa të kuptoja nga bota, unë pata fatin të kisha prijës shpirtëror, gjyshin tim Osman. Ai më mësoi të bëhesha i pari në mësim; të isha bujar dhe ti gëzohesha vizitës së miqve. Të doja kafshët, natyrën, por mbi të gjitha t'i doja shumë njerëzit. Sipas profecive të tij, dikur do t'ia dilja të udhëtoja me ballon dhe të takoja shumë burrshtetas. Me ballon kam udhëtuar. Burrështetas kam takuar dhe dua të takoj akoma. Jeta ime derisa isha më i ri i ka ngjarë shpërhapjes së një vije uji, krijuar nga një gur që hidhet në mes të një liqeni. Ajo merr formën e rrathëve bashkëqendrorë që sa vijnë e zgjerohen. Në rrethin e parë të udhës sime jetësore ka qenë shkollimi fillor në Marec. Normalja dhe Gjymnazi në Prishtinë, ku mësova konceptet e para të shëndosha të dijës, frëngjishten dhe pjesë të latinishtes që i kam aktive edhe sot. Prej pasurive shoqërore të asaj periudhe morra stimuj të fortë që më shërbyen shumë për të çarë rrugën e përbotshme të jetës sime. Në rrethin e dytë të udhëtimit tim jetësor janë studimet universitare në Hamburg dhe studimet master në Cyrih. Punoja dhe studioja shumë. I kam të gjalla si tani kërkimet për tema përfundimtare në këto studime. Ndërsa merresha me tregun, dhe magjinë e tij u përqendrova në rëndësinë që ka origjina e mallit për çmimin dhe përfytyrova globalizmin. Shumë herët ama. Në 1976. Ndërsa mundohesha të kuptoja preferencat e klientëve në një kërkim tregu, e vura gishtin në rëndësinë e vendit ku bëhet sondazhi për rezultatin e tij. U bëra ithtar i tregut global, i tregut të lirë dhe renda nëpër të, nga Lindja në Perëndim në rrethin tim të tretë të udhëtimit njerëzor në biznes. Edhe në këtë udhëtim krijova dhe shijova frytet e krijimit tim. Krijova një formulë prodhimi tekstilësh, unikale për mbarë botën, ku informatika pati rol kryesor. Për herë të parë në një vend të madh futa teknikën tredimensionale në paraqitjen e projekteve arkitekturore dhe në këtë rreth të tretë u ndala në ndërtim. E gjeta veten në këtë zeje të lashtë njerëzore, pse kështu mund t'i kontribuoja më mirë brezave në të gjitha kohërat. E dija që ishte tregtia, por zgjodha të ndërtoj.

Rrethi i katërt i udhëtimit tim njerëzor ishte filantropia. Mora mësim të thelluara të bujarisë njerëzore nga një humaniste si Nënë Tereza. E vizitova atë menjëherë sapo bota filloi të fliste rreth saj në 1979-ën e largët. U mundova ta lehtësoj vuajtjen njerëzore, të liroj pengjet e luftërave të padrejta, të ndihmoj qytetarët e mi që kanë nevojë për ndihmë. Rrethi i pestë i rrugëtimit tim ishte lobimi i pandalshëm nëpër botë, për të arritur tek shpallja e pavarësisë së vendit tim dhe më pas që shtetet e ndryshme ta njohnin atë. Rrethi i fundit i endjes sime ishte politika, ku ofrova pajtim, ide zhvillimi dhe paqe. Sot jam President i Kosovës. Jam betuar që do t'i shërbej vendit tim me përkushtim. Do të çoj para amanetin e heronjve të pavarësisë; Do të çoj para idealet e pasardhësit tim të ndritshëm, babait themelues të pavarësisë së Kosovës, Ibrahim Rugovës. Më vjen shumë mirë që ju miq të nderuar të botës akademike të vendit tim, keni kuptuar se unë në jetën time, siç thotë Ruzvelti, kam bërë gjithçka që kam mundur. Me çfarë kam patur. Kudo që kam qenë. Kështu në formën e rrathëve bashkëqendrorë unë i jam sjellë për qark botës. Rrathët e krijuar nga hedhja e një guri në ujë siç dihet kanë një qendër të përbashkët atje ku bie guri! Unë këtë fazë të jetës sime dua t'i ngjaj gurit. Ku rëndon më shumë guri? Në vendin e vet! Dhe diçka tjetër krejt për fund. Ndërsa një qytet si Lezha, e njohur për besëlidhjen e Skënderbeut, për bashkëjetesën fetare mes tre feve, më nderoi me titullin Qytetar nderi, unë nisa të përdor një shprehje latine: "nemo propheta in patria sua": askush nuk të bën profet në atdheun tënd. Ishte shprehje e emocionit dhe vlerësimit që ndjej për titullin e lartë që ma dha për herë të parë një qytet i Shqipërisë dhe jo i Kosovës. Dikush më qortoi se u paskësua vetëquajtur profet. Sot ju, një universitet i shquar i vendit tim, i vendit tuaj, po më nderoni për herë të parë me titullin Doktor nderi, të parin në historinë e universitetit tuaj të ri, dhe të parin për mua. Dua ta korrigjoj shprehjen latine. Profet s'jam, as nuk dua të behëm, se jam tokësor. Si njeri i tokës dhe atdheut. Atë e kam në Kosovë, por edhe këtu.



*Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Behgjet Pacolli, në një ceremoni soleme, u nderua sot me çmimin "Honoris Causa" në Universitetin Evropian të Tiranës. Në ceremoni ishin të pranishëm Presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi, ish-presidentët Alfred Moisiu e Rexhep Meidani, ministra të Qeverisë së Shqipërisë e të Qeverisë së Kosovës, profesorë, studentë e mysafirë të tjerë të shumtë*

---

## Kosova mos t'i harrojë krimet e Serbisë

---

**Këtë mesazh presidentit Pacolli ia përcolli njëri nga politikanët shqiptarë, Shpëtim Idrizi, kryetar i PDIU - së,**

Presidenti i Kosovës në ditën e tij të dytë të vizitës në Shqipëri është takuar me krerët e partive PDIU, Shpëtim Idrizi dhe LSI, Ilir Meta. Në fjalën e tij, kryetari i PDIU - së, Idrizi, nënvizoi se për Kosovën është e rëndësishme të mos harrojë krimet e luftës që janë bërë ndaj qytetarëve të saj nga Millosheviqi. "Ndamë pikëpamje të përbashkëta që Kosova ka nevojë që të mbajë të fortë dhe të fuqishme memorien kolektive për krimet e ndodhura në shtetin e Kosovës mbi qytetarët nga dhuna e Millosheviqit. Është e mirëpritur për të gjithë shqiptarët vizita e Pacollit në Shqipëri", tha më tej Idrizi. Ndërsa presidenti i Kosovës u shpreh se për kauzën e saj Kosova ka mbështetjen e evropianëve. **"Biseduam për të drejtat e njeriut, kemi mbështetjen e evropianëve që ndihmojnë kauzën tonë të madhe, biseduam për një treg të madh shqiptar, për të cilin unë kam këmbëngulur që të jetë temë e bisedimeve, unë i thashë mikut tim se Kosova nuk do ta lërë këtë iniciativë vetëm me fjalë"**, nënvizoi Pacolli. Ndërsa takimin me Ilir Metën, Pacolli e ka konsideruar si një takim me një mik që ka punuar shumë për çështjen e Kosovës. **"Takimi me mikun tim Ilir Meta ka rëndësi të veçantë, është një njeri që ka dhënë kontribut të madh për afirmimin e Kosovës, ka punuar shumë për njohjet e Kosovës"**, tha Pacolli. Kreu i LSI - së nga ana e tij u shpreh se mes dy vendeve, ku kufijtë janë fare konvencionalë do vazhdojnë të thellohen bashkëpunimet. "LSI - ja mbështet politikën e presidentit të Republikës së Kosovës, Qeverisë së Kosovës, forcimin e bashkëpunimit mes dy vendeve, projektet madhore që kanë përparuar me sukses do t'i forcojmë edhe më tej në marrëdhëniet e shkëlqyera në të dyja anët e kufirit, i cili është fare konvencional", deklaroi Meta. Agjenda e tij vijon me pjesëmarrjen në punimet e Forumit të Biznesit Shqipëri - Kosovë, për t'u pasuar nga një vizitë në qytetin e Krujës ku do të vizitojë Muzeun Historik Kombëtar, Muzeun Etnografik dhe Pazarin e Vjetër. Gjithashtu, presidenti Pacolli do të vendosë dhe një kurore në "Varrin e Skënderbeut" në qytetin e Lezhës. Presidenti i Kosovës mbërriti dje në Tiranë për një vizitë zyrtare, e para si president i Kosovës. Ai u prit dje paradite nga homologu shqiptar Bamir Topi, ndërsa rreth orës 16:30 mbajti një fjalim në Kuvendin e Shqipërisë. Pacolli u takua me Kreun e PS, Edi Rama, të cilin e vlerësoi si një takim me një mik të vjetër, ndërsa nuk nguroi të uronte që kryebashkiaku Rama t'i sjellë më shumë mbarësi Tiranës. Pacolli takoi gjithashtu dhe kryeministrin Berisha e kryetaren e Parlamentit, Jozefina Topalli.



*Presidenti i Kosovës në ditën e tij të dytë të vizitës në Shqipëri është takuar me krerët e partive PDIU, Shpëtim Idrizi dhe LSI, Ilir Meta*



*Pacolli theksoi se miku i tij Ilir Meta është një njeri që ka dhënë kontribut të madh për afirmimin e Kosovës, ka punuar shumë për njohjet e Kosovës*

*Agjenda e Presidentit Pacolli vijon me një vizitë në qytetin e Krujës ku do të vizitohet Muzeun Historik Kombëtar, Muzeun Etnografik dhe Pazarin e Vjetër*



*Presidenti Pacolli viziton Muzeun Historik Kombëtar*



*Vizita e Presidentit Pacolli në Muzeun Etnografik*



*Vizita e Presidentit pacolli në pazarin e vjetër në Krujë*





*Gjithashtu, presidenti Pacolli ka vendosur dhe një kurorë në "Varrin e Skënderbeut" në qytetin e Lezhës*



*Pacoli takoi gjithashtu edhe kryetaren e Parlamentit, Jozefina Topalli*

---

## Bashkërisht në rrugën e integritit

---

**Në ditën e dytë të qëndrimit në Tiranë, presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, është takuar me kryetarin e Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI), Ilir Meta dhe me Shpëtim Idrizin, kryetar i Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU)**

PRISHTINË / TIRANË, 22 MARS - Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, në ditën e dytë të qëndrimit në vizitë zyrtare në Tiranë, të martën ka zhvilluar një takim me kryetarin e Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI). Ilir Meta, me të cilin ka diskutuar për projektet e përbashkëta dhe vazhdimin e punës për sigurimin e sa më shumë njohjeve për Kosovën, si dhe për trazimin e rrugës së saj drejt integritimeve euroatlantike. Presidenti Pacolli ka thënë se puna e ish ministrit të Jashtëm, Ilir Meta, për njohjet e shtetit të Kosovës është shumë e rëndësishme. **"Mund t'ju them se ai ka lënë ende punë të pakryera, për të cilat është nevojitur kohë dhe unë sot e luta që krejt këtë punë që ka mbetur pa u kryer, të vijë në Kosovë dhe të bisedojmë, që të mos ndalemi. Kemi shumë punë për të kryer dhe puna e Metës për njohjet është shumë e rëndësishme. Jam i sigurt se Meta, me energjinë e tij, me vullnetin e madh, do ta përballojë çdo sfidë në mënyrë të suksesshme. Bashkëpunimi me të do të jetë shumë i madh. E vlerësojmë shumë punën që ka bërë për Kosovën dhe besoj se ky aktivitet do të vazhdojë edhe më tej"**, ka theksuar Pacolli. Edhe LSI-ja ka mbështetur politikën e presidentit të Kosovës, të Qeverisë së Kosovës, si dhe forcimin e bashkëpunimit midis dy vendeve. "Ishte kënaqësi e madhe të takohemi me presidentin e ri të Kosovës, Behgjet Pacolli, për t'a uruar edhe nga afër për këtë detyrë shumë të rëndësishme. Besoj se kjo detyrë e re dhe shumë e lartë është një mundësi e shkëlqyer për presidentin Pacolli për ta çuar më tej kontributin e tij, i cili ka qenë mjaft i ndjeshëm edhe më parë në procesin e njohjes së Kosovës, pasi konsolidimi i pozitës ndërkombëtare është prioritet i jashtëzakonshëm, ashtu sikur edhe vizioni i tij për ekonominë besoj se do të ndihmojë shumë në zhvillimin ekonomik jo vetëm të Kosovës, por edhe zhvillimin ekonomik të të dy vendeve", ka thënë Meta. Ai ka thënë se LSI - ja mbështet politikën e Kosovës, mbështet forcimin e bashkëpunimit midis dy vendeve, midis dy qeverive, midis dy parlamenteve. "Jemi të bindur se projektet madhore, të cilat kanë përparuar me sukses në Shqipëri, por po përparojnë edhe në Kosovë, do t'i forcojnë edhe më tej marrëdhëniet e shkëlqyera midis shqiptarëve në të dyja anët e kufirit, i cili është fare konvencional", ka thënë Meta.

### **Mos i harroni krimet serbe në Kosovë**

Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, të martën është takuar edhe me Shpëtim Idrizin, kryetar i Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU). Në këtë takim është thënë se u ndanë pikëpamjet e përbashkëta që Kosova ka nevojë ta mbajë të gjallë memorien kolektive për krimet e ndodhura në shtetin e Kosovës, mbi qytetarët e Kosovës nga dhuna e ish - presidentit serb Slobodan Milosheviq. Presidenti në ditën e dytë të vizitës së tij në Shqipëri ka thënë se është biseduar për gjendjen politike dhe ekonomike, për problemet që e mendojnë Kosovën dhe Shqipërinë. **"Biseduam për tregun e madh shqiptar, për të cilin unë kam insistuar të jetë temë e bisedimeve. Kosova nuk do ta lërë këtë iniciativë vetëm në fjalë, por do të fillojë punë intensive. Ne do të formojmë një grup, i cili do t'ia fillojë punën që nga**

tani dhe besoj se deri në takimin tjetër do t'i kemi rezultatet e para të formimit të një tregu të gjerë, që del jashtë kufijve të Shqipërisë, jashtë kufijve të Kosovës, por pse të mos përfshihen në këtë edhe bashkatdhetarët tanë edhe në Maqedoni edhe në Mal të Zi", ka thënë Pacolli. Ndërkaq, kryetar i PDIU - së, Shpëtim Idrizi, ka thënë se ndamë pikëpamjet e përbashkëta që Kosova ka nevojë ta mbajë të gjallë memorien kolektive për krimet e ndodhura në shtetin e Kosovës, mbi qytetarët e Kosovës nga dhuna e Milosheviqit. Më tej, Idrizi është shprehur. "I shprehëm urimet e subjektit që ne përfaqësojmë për detyrën e re dhe në radhë të parë për qasjen pragmatike dhe shumë realiste që ai ka për bashkimin kombëtar si një bashkim ekonomik, duke i shtyrë dy qeveritë tona në initiative direkte, realiste dhe që vërtet të bëjnë të mundur, larg folklorizmit, atë që të gjithë shqiptarët dëshirojnë. "Ne kemi nevojë ta shohim vetën tonë si një bashkim ekonomik, si një treg të madh të shtatë million shqiptarëve. Pacolli, edhe me eksperiencën e tij, po i shtyn të dy qeveritë tona që këtë ta shohin në mënyrë të strukturuar", ka shtuar idrizi. Presidenti Pacolli edhe në ditën e dytë të qëndrimit të tij në Shqipëri është nderuar. Qyteti i Lezhës e ka shpallur atë qytetar nderi.



*Qyteti i Lezhës shpalli qytetar nderi Presidentin e ri të Kosovës z.Behgjet Pacolli*

---

## **LDK-ja mbron shkeljen kushtetuese të presidentit**

---

Burime të tjera të gazetës kanë bërë të ditur se Mustafa ka qenë në konakun e Pacollit për t'ia uruar postin e presidentit, ndonëse në publik ai dhe partia e tij po e kontestojnë procesin e zgjedhjes së kreut të shtetit. Vetë presidenti Pacolli ka thënë publikisht të ketë zhvilluar kontakte me përfaqësues të subjekteve politike, edhe opozitare, por nuk ka përmendur emra. Sipas një zyrtari të LDK - së, në këtë takim Mustafa e ka siguruar Pacollin se nuk do të ketë pasoja nga çështja që do ta ngrinte LDK -ja në gjykatë një ditë më vonë. "Takimi është zhvilluar në mbrëmje dhe ka zgjatur gati dy orë", ka thënë ky burim. "Është siguruar Pacolli se në lëndë nuk do të futet çështja e votimit të tij për Qeverinë dhe se çështja e procedurave rreth zgjedhjes së presidentit nuk do të prodhojë pasoja". Arben Gashi, njeri i afërt me Mustafën, nuk ka qenë në gjendje të demantojë këtë informatë. I kontaktuar nga gazeta, ai vetëm ka shprehur besimin se një takim i tillë nuk ka ndodhur. Prej vitesh është vërejtur një afri midis Pacollit e Mustafës. Megjithëkëtë, në LDK kanë mohuar se refuzimi për të nënshkruar kërkesën e AAK - së, ka ardhur për shkak të kësaj. Ismet Beqiri është përpjekur që ta argumentojë këtë, duke rikujtuar qëndrimin që ka mbajtur Grupi parlamentar i LDK - së më 22 shkurt, kur është votuar Qeveria dhe presidenti. LDK - ja, sikurse edhe AAK - ja e "Vetëvendosja" kishin bojkotuar seancën. "Nëse dikush ka pasë qëndrim serioz në ndërtimin e institucioneve, ka qenë LDK - ja", ka thënë Beqiri. "Qëndrimi ynë ka qenë që të mos e votojmë as presidentin dhe as kryeministrin, dhe konsiderojmë se ka qenë një qëndrim i drejtë", ka shtuar ai. Nisma e AAK - së në fakt nuk është mbështetur as nga lëvizja "Vetëvendosje". Mirëpo, shefi i GP të AAK - së, Ardian Gjini, ka folur me gjuhë tjetër për këtë subjekt politik. "Vetëvendosja" shumë herët është deklaruar se nuk dëshiron që të procedojë asnjë lëndë në Gjykatë Kushtetuese për arsyet e veta. Definitivisht, ne i kemi kontaktuar edhe ata", ka theksuar Gjini. Pacolli është bërë president një muaj më parë, pasi posti mbeti vakant që prej 28 shtatorit të vjetëm kur pati dhënë dorëheqje Fatmir Sejdiu. Sejdiu që detyruar të marrë të tillë hap, për të mos pritur shkarkimin nga Kuvendi. Deputetët detyrohen të shkarkojnë presidentin kur ai shkel Kushtetutën, e Gjykata Kushtetuese gjeti se Sejdiu po e shkelte vazhdimisht aktin më të lartë juridik të vendit duke ushtruar njëkohësisht postin e presidentit dhe atë të kreut të LDK - së. Pesë muaj rresht funksionin e presidentit në detyrë e ka ushtruar Jakup Krasniqi, që me automatizëm i ka takuar ky nga pozita e kryeparlamentarit që ka pasur. Fakti që ai ushtronte aktivitet edhe në PDK, sekretar i përgjithshëm i së cilës është, bëri që LDK - ja ta denonconte në Kushtetuese, me pretendimin se po bënte të njëjtën shkelje sikurse Sejdiu. Por, Gjykata e shpalli të pabazuar pretendimin e LDK - së, ngaqë ka konsideruar se Krasniqi nuk ishte president i zgjedhur.

---

## **Pacolli: Nuk jam profet, jam tokësor**

---

Në nëntor të një viti më parë kur qyteti i Lezhës e nderoi me çmimin "Qytetar Nderi", presidenti Pacolli, atëherë thjesht kryetar i AKR - së përdori shprehjen latine "Nemo propheta in patria sua" (Askush nuk të bën profet në atdheun tënd!). Të martën teksa mbyllte fjalimin pas marrjes së çmimit "Honoris Causa" nga UET, presidenti Pacolli e quajti atë çka kishte thënë një vit më parë si **"shprehje e emocionit dhe vlerësimit që ndieja për titullin e lartë që ma dha për herë të parë një qytet i Shqipërisë dhe jo i Kosovës"**. Ai tha se një vit më vonë do ta korrigoj shprehjen latine, duke thënë **"Profet s'jam, as dua të bëhem, se jam tokësor. Si njeri i tokës, i falem atdheut. Atë e kam në Kosovë, por edhe këtu"**.



*Profet s'jam, as dua të bëhem, se jam tokësor. Si njeri i tokës, i falem atdheut. Atë e kam në Kosovë, por edhe këtu në Shqipëri disa nga fjalët e Presidentit të Ri të Kosovës*

## **Pacolli rrëfen në Tiranë pesë rrathët e jetës së tij**

**Në ditën e dytë të vizitës së tij në Shqipëri, kreu i shtetit të ri të Kosovës u takua me ish-zv.kryeministrin Ilir Meta, me kreun e PDI-së Shpëtim Idrizi, si dhe përshëndeti Forumin e Biznesit Shqipëri-Kosovë. Vizita e presidentit u mbyll me një udhëtim në qytetin historik të Krujës.**

22 MARS - Në ditën e dytë të vizitës së tij në Shqipëri, presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, është nderuar me titullin e lartë "Doctor Honoris Causa" nga Universiteti Evropian i Tiranës. Ky titull është shoqëruar me një ceremoni solemne ku merrnin pjesë ish - presidentë, stafi i zgjedhur akademik i këtij Universiteti, intelektualë, studentë dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Motivacioni që shoqëroi këtë titull, arsyetuar sipas Bordit akademik të këtij Universiteti ishte "Për rezultatet e shkëlqyera akademike; për qasjen krijuese në biznesin e ndërtimit dhe për gjurmët e pashlyera që ka lënë me veprat e tij ndërtimore anembanë botës nga Lindja në Perëndim; për sensin e spikatur të ndërmarrësisë që ka treguar me themelimin dhe drejtimin me sukses të një kompanie globale si MABETEX: për veprimtarinë e shquar filantropike brenda vendit të tij Kosovës, por dhe jashtë vendit; për veprimtarinë aktive pajtuese në politikën shqiptare të Kosovës në përputhje me frymën më të mirë të kësaj shoqërie". Duke arsyetuar motivet që e çuan këtë Universitet për të vlerësuar me titull presidentin e sapozgjedhur të Kosovës, senati i UET – së është shprehur se ka lënë jashtë paragjykimet që mund të krijohen në një situatë të tillë, dhe ka vlerësuar energjinë pozitive dhe forcën që bëri presidentin Pacolli të ishte një lider në fushën e biznesit. "Ne mbetemi të mrekulluar nga shembulli juaj i jashtëzakonshëm jetësor, nga arritjet tuaja në një karrierë të shkëlqyer biznesi, nga shkrirja e kësaj karriere me një veprimtari filantropike unike, dhe nga aktiviteti juaj politik, ku shquhet veprimtaria lobuese e nivelit të lartë. Ne kemi ditur të mos mbetemi peng i paragjykimeve tipike për shoqëritë tona dhe të shohim te kjo veprimtari, forcën dhe krijimtarinë e individit që ka çarë vetë rrugën e jetës, duke afirmuar këtë forcë dhe krijimtari në një rrafsh global, së bashku me shqiptarësinë e tij. Mbështetur në të gjitha këto dëshmi të një aktiviteti shumëpërmasor që lartëson mbi të gjitha individin shqiptar në hapësirën botërore, senati akademik i Universitetit tonë jua ka akorduar njëzëri nderimin akademik Doctor honoris causa në fushën e biznesit. Duke iu drejtuar presidentes së këtij Universiteti Teuta Dobi, presidentit Bamir Topi dhe ish - presidentëve Moisiu dhe Meidani të pranishëm në këtë ceremoni, presidenti Pacolli tha se ndihej i nderuar që ky çmim i vinte prej vendit të tij. Duke dashur të shpjegojë më pas forcën e atdheut, kreu i shtetit të Kosovës solli në kujtesë fëmijërinë e tij në Marec, ëndrrat për hapësirat dhe kthimin sërish në shtëpi (Marec) "**pasi atdheu yt është gjithnjë qendra e botës**". "**Jam nisur nga Kosova për të gjetur fundin e sferës. Në Kosovë lashë fillimin dhe gjeta fundin e sferës që ishin bashkë. Dikush thotë se njeriu brend gjithë botën për të kërkuar diçka që i nevojitet dhe më në fund kthehet ta gjejë në shtëpinë e vet. Kjo është forca tërheqëse e atdheut**", tha presidenti. Në një fjalim me tone letrare presidenti kujtoi gjyshin e tij Osman, duke e quajtur atë një prijës shpirtëror i cili e mësoi për gjithçka, si të ishte i pari me mësim, apo si të donte natyrën. Jeta ime derisa isha më i ri, i ka ngjarë shpërhapjes së një vije uji, krijuar nga një gur që hidhet në mes të një liqeni. Ajo merr formën e rrathëve bashkëqendrorë që sa vijnë e zgjerohen. Në rrethin e parë të udhës sime

jetësore ka qenë shkollimi fillor në Marec, Normalja dhe Gjinnazi në Prishtinë, ku mësova konceptet e para të shëndosha të dijes, frëngjishten dhe pjesë të latinishtes që i kam aktive dhe sot. Në rrethin e dytë të udhëtimit tim jetësor janë studimet universitare në Hamburg dhe studimet master në Zyrih. Punoja dhe studioja shumë. I kam të gjalla si tani kërkimet për temat përfundimtare në këto studime”, kujtoi presidenti, duke vijuar kështu historinë e tij drejt një biznesi. “U bëra ithtar i tregut global, i tregut të lirë dhe renda nëpër të, nga Lindja në Perëndim në rrethin tim të tretë të udhëtimit njerëzor, në biznes. Edhe në këtë udhëtim krijova dhe shijova frytet e krijimit tim. Krijova një formulë prodhimi tekstilesh, unike për mbarë botën, ku informatika pati rol kryesor. Për herë të parë në një vend të madh futa teknikën tredimensionale në paraqitjen e projekteve arkitekturore dhe në këtë rreth të tretë u ndala në ndërtim. E gjeta veten në këtë zeje të lashtë njerëzore, pse kështu mund t'u kontribuojmë mirë brezave në të gjithë kohërat. E dija ç'ishte tregtia, por zgjodha të ndërtoj”, tha presidenti. Rrethi i katërt i udhëtimit të tij njerëzor ishte filantropia. Ai kujtoi mësimet e marra nga Nënë Tereza, humanistja e madhe, të cilën e ka takuar më 1979. Dhe rrethi i pestë, por jo më pak i rëndësishëm në jetën e tij ka qenë lobingu për pavarësinë e Kosovës. Duke e quajtur politikën rrethin e fundit të jetës së tij, Pacolli deklaroi se do të mbetet në këtë rreth vetëm për një qëllim, për t'i shërbyer deri në fund vendit të tij. “Do të çoj para idealet e pasardhësit tim të ndritshëm, babait themelues të pavarësisë së Kosovës, Ibrahim Rugovës”, tha presidenti Pacolli. Ai e ka mbyllur fjalimin me shprehjen e njohur ndërshqiptare që në Tiranë thuhet “guri i rëndë në vendin e vet”, ndërsa Pacolli e perifranoi kështu: **“Unë në këtë fazë të jetës sime dua t'i përngjaj gurit. Ku rëndon më shumë guri? Në vendin e vet!”**. Presidenti Behgjet Pacolli është takuar të martën edhe më ish kryeministrin dhe kreun e Lëvizjes Socialiste Ilir Meta. Gjatë këtij takimi kreu i LSI - së ka shprehur mbështetjen maksimale për Qeverinë e re të Kosovës, duke e quajtur zhvillimin e shtetit të ri si një proces të pandalshëm. Meta shprehu besimin se njohjet e shumta në të gjithë botën të presidentit Pacolli do të kontribuojnë për një ritëm të ri të konsolidimit të pozitës ndërkombëtare të Kosovës. Ndërsa presidenti Pacolli pasi vlerësoi kontributin e ish - ministrit të Jashtëm Meta për çështjen e Kosovës, i ka kërkuar mikut të tij Meta që gjithë këtë bagazh që ka mbetur pa u kryer, që të vijë dhe t'i ndihmojë Kosovës. Të martën presidenti Behgjet Pacolli, është takuar edhe me kryetarin e Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Shpëtim Idrizi. “Me presidentin Pacolli ndamë pikëpamje të përbashkëta që Kosova ka nevojë që të mbajë të fortë dhe të fuqishme memorien kolektive për krimet e ndodhura në shtetin e Kosovës mbi qytetarët nga dhuna e Milosheviqit”, tha Idrizi. Gjatë këtij takimi është mbështetur ideja e hedhur nga presidenti Pacolli për krijimin e një tregu të përbashkët ekonomik. Për presidentin Pacolli "njësimi i tregut, jo vetëm mes Shqipërisë dhe Kosovës, por edhe mes shqiptarëve në Maqedoni, Mal të Zi dhe Preshevë është një nevojë e ditëve të sotme. Presidenti i Kosovës Behgjet Pacolli ka përshëndetur të martën punimet e Forumit të Biznesit Shqipëri - Kosovë mbajtur në "Hotel Sheraton". Duke e quajtur këtë forum shumë të rëndësishëm, Pacolli përsëriti idenë e bashkimit përmes ekonomisë. Vizitën e tij në Shqipëri, kreu i shtetit të Kosovës e mbylli me një vizitë në qytetin historik të Krujës. Ai vizitoi Muzeun e qytetit, ku ruhen detaje nga jeta e heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, si dhe pazarin e vjetër karakteristik të qytetit.



---

## Ivanov e Pacolli shqyrtojnë lëvizjen e qytetarëve me letërnjoftime

---

**Temë e takimit të presidentit kosovar Pacolli me homologun e tij maqedonas Ivanov kanë qenë lëvizja ndërmjet shtetasve pa pasaportë, bashkëpunimi ekonomik, shkëmbimi i përvojave për eurointegrimet, marrëdhëniet ndëretnike dhe të tjera. Nga ana e Ivanovit është paralajmëruar një takim i presidentëve të rajonit në Ohër. Ndërkohë, Pacolli ka vijuar takimet edhe me liderët shqiptarë Ahmeti, Thaçi e Selmani, ku temë e diskutimeve ka qenë kriza politike në vend**

SHKUP, 23 MARS - Për herë të parë ne rezidencën e presidentit të Maqedonisë Gjorgje Ivanov, është pritur të mërkurën presidenti kosovar Behgjet Pacolli. Temë e diskutimeve kanë qenë lëvizja ndërmjet shtetasve pa pasaportë, bashkëpunimi ekonomik, shkëmbimi i përvojave për eurointegrimet, marrëdhëniet ndëretnike, ndërsa kanë firmosur bashkërisht edhe marrëveshje në sferën e bujqësisë. Pacolli ka takuar edhe kryetarin e Parlamentit Trajko Veljanovski, zëvendëskryeministrin e Maqedonisë, Vasko Naumovski, për të vijuar takimet edhe me liderin e BDI - së Ali Ahmeti, të PDSH - së Menduh Thaçi dhe atë të DR - së Imer Selmani. "Me liberalizimin e vizave të Kosovës, dy palët do të kenë mundësi të lëvizin nga një shtet në tjetrin vetëm me letërnjoftime", kanë paralajmëruar homologët Pacolli e Ivanov. "Konsideroj se kjo do të ndodh shumë shpejt, unë promovova idenë dhe kërkova ndihmën e Ivanovit, në këtë drejtim që edhe në mes Kosovës dhe Maqedonisë të ketë lëvizje të lirë të njerëzve normalisht me më pak formalitete, me letërnjoftime, por biseduam edhe për nevojën që kufijtë të humbin sensin e tyre, të hapim edhe pika të reja kufitare që të mundësojmë lëvizjen vërtetë të lirë të qytetarëve tanë. Tani ka ardhur koha që ne të fillojmë punën në këtë drejtim dhe besoj se në kohë shumë të shkurtër qeveritë tona këtë do ta marrin shumë seriozisht", ka thënë nga ana tjetër, presidenti kosovar Pacolli, duke shtuar se mes dy shteteve është filluar mbarë, nuk ka asnjë çështje të hapur dhe se janë lidhur marrëdhënie diplomatike në kohë të duhur. **"Maqedonia ka bërë një hap të madh në sferën e integritimeve, Kosova është në rrugë të mbarë që të kyçet në rrugën evropiane, ne presim mbështetje nga ana e Maqedonisë"**, ka shtuar më tej Pacolli. "Po, biseduam gjatë takimit edhe për këtë temë. Këtë çështje ua kemi lënë qeverive ta shqyrtojnë dhe të vazhdojnë bashkëpunimin në atë plan. Sepse rajoni duhet t'i plotësojë kriteret që neve na i kërkon Evropa, sepse duhet të gjithë t'i plotësojmë standardet që i kërkon Evropa për liberalizimin e vizave. Besoj se kur t'i plotësojmë këto kriterë qytetarët do të mund të lëvizin lirshëm me letërnjoftime", ka thënë presidenti Ivanov. "Pas takimeve në Vlorë dhe vitin e kaluar në Prizren, në korrik do të mbahet takim në Ohër. Presim në këtë takim të silltet deklarata e Ohrit me të cilën do të obligohen trashëgimtarët tanë që të vazhdojnë të takohen, për këto iniciativa rajonale të mund të bëhen pjesë e iniciativave më të gjera, por edhe të mund të vazhdohet të bisedohet për infrastrukturën për të cilën rajoni ka nevojë me qëllim që ai të mund të hapet", ka thënë Ivanov. Homologu i tij kosovar ka vlerësuar se kjo është mundësi e mirë për bashkëpunim për të gjitha vendet e rajonit dhe se mbështet çfarëdo iniciativa për të cilat hapur flitet për të ardhmen. **"Vetëm shpresoj se krahas Maqedonisë, Kosovës, Shqipërisë e Malit të Zi do të bashkohen edhe Serbia dhe Greqia, të cilat duhet ta pranojnë realitetin, të pranojnë se ne jemi reale dhe ekzistojmë dhe se**

**takimet janë në interes të qytetarëve tanë",** ka thënë Pacolli. Gjatë qëndrimit në vizitë zyrtare në Republikën e Maqedonisë, presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, ka zhvilluar një takim edhe me zëvendëskryeminstriin Vasko me Naumovski. Në takim, zëvendëskryeminstri Naumovski shprehu kënaqësinë që mirëpret presidentin e shtetit më të ri të rajonit. "Shpreh konsideratat për takimin e presidentit Pacolli me presidentin Ivanov, kryetarin e Parlamentit dhe pjesëmarrjen në samitin e komunitetit të biznesit. Vlerësojmë që së bashku do të shkojmë drejt integritit të përbashkët në Bashkimin Evropian dhe ne NATO", tha zëvendëskryeminstri i Maqedonisë, Vasko Naumovski. Presidenti Pacolli përgëzoi zëvendëskryeminstriin Naumovski për progresin e shënuar në fushën e integritit euroatlantik. Ai gjithashtu u zotua dhe kërkoi nga Qeveria e Maqedonisë që të dy vendet të jenë në funksion të integritit të përbashkët ekonomik dhe të politikës në përmirësimin e mirëqenies sociale të dy vendeve fqinje. Po kështu, presidenti Pacolli u zotua për krijimin e një perceptioni të ri në shoqërinë e dy vendeve tona, ku ndasitë politike, etnike, fetare do të jenë pjesë e së kaluarës. Nga ana tjetër, implementimi i Marrëveshjes së Ohrit, zhvillimet politike në Maqedoni dhe mundësitë për bashkëpunim mes Maqedonisë dhe Kosovës kanë qenë temat e diskutimit mes presidentit të Kosovës, Behgjet Pacolli, dhe kryetarit të BDI – së Ali Ahmeti. Ndërkohë, lideri i DR-së, Imer Selmani ka informuar presidentin Pacolli për situatën aktuale politike në Maqedoni, duke cekur se ngërçi politik ka shkaktuar ndjenjë të paperspektivës te qytetarët e vendit. Nëse krizës politike i shtohen edhe raportet e acaruar ndëretnike dhe ndërfitare, ekonomia e dobët dhe mungesa e investimeve, dhe procesi i bllokuar euro - integrujes i Maqedonisë, sipas Selmanit, "zgjidhje e vetme për dalje nga ky qorrsohak i vendit janë zgjedhjet e parakohshme parlamentare të cilat duhet të jenë fer dhe demokratike dhe në sipërfaqe të sjellin forca të reja progresive të cilat do të udhëheqin shtetin drejt binarëve të duhur - barazisë së plotë mes shqiptarëve dhe maqedonasve dhe integritin e Maqedonisë në NATO dhe BE". Ditën e dytë të vizitës Pacolli do të realizojë në Tetovë, si dhe do të vizitojë disa kompani të rëndësishme biznesi.



*Presidenti Pacolli takohet me homologun e tij maqedonas Gjorge Ivanov. Temë e takimit të presidentit kosovar Pacolli me homologun e tij maqedonas Ivanov kanë qenë lëvizja ndërmjet shtetasve pa pasaportë, bashkëpunimi ekonomik, shkëmbimi i përvojave për eurointegrimet, marrëdhëniet ndëretnike dhe të tjera*

---

## **Isa Mustafa arsyeton shkeljen kushtetuese të Pacollit**

---

**Isa Mustafa e njeh për president Behgjet Pacollin, ndonëse partia e tij konsideron se ai ka ardhur në krye të shtetit nëpërmjet një procesi votimi jokushtetues. Madje ka arsyetuar edhe presidentin kur ka shkelur Kushtetutën pak minuta pas zgjedhjes. Ka thënë se pjesëmarrja e Pacollit në kapacitetin e deputetit gjatë votimit të Qeverisë, disa minuta pasi ishte zgjedhur president, është problem “i mbarëvajtjes së mbledhjes së Kuvendit, për të cilën është kujdesur kryetari i Kuvendit”**

Ne si LDK kemi iniciuar një procedurë në Gjykatën Kushtetuese që ka të bëjë me bazueshmërinë kushtetuese të vendimit për zgjedhjen e z. Behgjet Pacolli president dhe, përderisa kjo të mos sqarohet, ne nuk kemi pasur asnjë arsye që të merremi me aktet që i kryen në cilësinë e presidentit", ka thënë Mustafa. "Ne kemi bërë pyetje se a është i bazuar vendimi për zgjedhjen e tij apo jo, dhe ne këtë përgjigje e presim nga Gjykata Kushtetuese", ka shtuar ai. Nga disa zyrtarë të lartë të LDK së disa herë është arsyetuar mosmbështetja e kërkesës së AAK - së me faktin se ende nuk është marrë përgjigjja nga Kushtetuesja (nëse Pacolli është president ose jo). Më shkoqur ka folur anëtari i Kryesisë i kësaj partie, Eqrem Kryeziu, i cili ka deklaruar për media se Pacolli" nuk e ka shkelur Kushtetutën se nuk është president". Ndryshe nga ta ka folur Mustafa. Ka thënë se LDK - ja njeh presidentin, por ka arritur ta thotë këtë tek pasi gazetarët tri herë ia kanë përsëritur pyetjen e njëjtë: A e njeh LDK - ja Pacollin për president? "Po, thjesht z. Pacolli është president, sepse është zgjedhur me shumicën e votave në Kuvendin e Republikës së Kosovës", ka thënë ai. Gazeta ka raportuar se të hënën Mustafa i ka thirrur në takim sy më sy shumë prej deputetëve të partisë së tij, dhe u ka dhënë instruksione për të mos firmosur lëndën që AAK - ja kishte planifikuar ta depononte në Kushtetuese. Burime të gazetës kanë bërë të ditur se edhe në takimin e së premtes me kryetarët e degëve të LDK - së, Mustafa kishte deklaruar se nuk do të mbështetej kërkesa e AAK-së. Atyre iu kishte thënë se LDK-ja "nuk është korrier për të bartur letra në Gjykatën Kushtetuese". Kryetarët e degëve, nuk kishin kundërshtuar. Po, sikurse deputetët e LDK - se që, pa përjashtim, janë treguar të dëgjueshëm. Mustafa nuk i ka demantuar në konferencën për shtyp takimet me deputetë, por ka demantuar një pjesë të raportit që flet për një takim të tij me Pacollin pas zgjedhjes president. Kreu i LDK-së ka thënë të mos ketë pasur kontakt me Pacollin prejse është vënë në krye të shtetit.

---

## LDK në pikën zero

---

### Isa Mustafa mohon afërsinë me Pacollin, premtan reformat në parti

PRISHTINË - Qëndrimi i fundit rreth presidentit Pacolli dhe mungesa e reformave të premtuara në Lidhjen Demokratike të Kosovës, kanë rikthyer këtë parti në qendër të vëmendjes së opinionit. Megjithëse në opozitë LDK-ja nuk po arrin të dalë nga paslufta, duke u shndërruar në një parti e cila pret që të ndodhin proceset e më pas të merret me pasojat. Kurse reformat e premtuara nga lideri i ri i saj Isa Mustafa nuk po duken ende në formën dhe përmasat e promovuar para ardhjes së tij në krye të LDK-së. Gjithsesi të martën, Kryesia e LDK-së ka marrë vendim dhe ka përcaktuar dinamikën e përsëritjes së zgjedhjeve partiake në degët e saj në Gjakovë, Pejë, Obiliq, dhe Shtime. Kryetar i LDK-së, Isa Mustafa e ka quajtur procesin reformues atë që po ndodh në LDK aktualisht. Sipas tij ky proces parasheh përfshirje të gjerë dhe forcim të LDK-së. “Ne do të vazhdojmë me këto procese sepse ne nuk mund t’i bëjmë reformat vetëm duke hequr njërin dhe duke e vënë tjetrin. Reformat behën me vota dhe ne po dëshirojmë që të kemi përfshirje më të gjerë dhe të kemi proces më të gjerë të vendosjes lidhur me anëtarësimin tonë” ka thënë Mustafa rreth zgjedhjeve në katër degët e LDK-së. Sipas tij në këto degë nuk është përmbyllur tërësisht procesi zgjedhor i kaluar dhe se qëllimi i zgjedhjeve të reja në to është përfshirja sa më e gjerë e anëtarësisë brenda strukturave të degëve dhe fuqizimi, rigjenerimi dhe ngritja e tyre. Kurse rreth rastit të fundit të mos mbështetjes së LDK-së për iniciativën e AAK-së që të nisat proceduar e re në Gjykatën Kushtetuese rreth veprimit të Pacollit i cili votoi për formimin e Qeverisë disa minuta pas zgjedhjes në postin e presidentit, Mustafa ka thënë se LDK-ja nuk e ka bllokuar këtë proces. Sipas tij, AAK-ja nuk ka bërë asnjë kërkesë zyrtare për ta dërguar lëndën në Gjykatën Kushtetuese rreth kësaj çështjeje. Ai ka përjashtuar mundësinë që mosdhënia e nënshkrimeve nga deputetët e LDK-se për këtë çështje është pasojë e afërsisë së tij me Pacollin, duke hedhur poshtë informatat se është takuar me Pacollin në shtëpinë e tij. “Unë prej momentit kur janë bërë zgjedhjet për president dhe për Qeverinë e Kosovës nuk kam pas asnjë kontakt me Pacollin as në zyrën time as në shtëpinë e tij”, ka thënë Mustafa. Kurse sipas kryetarit të LDK-së, bashkëfajtor për shkelje të Kushtetutës në këtë rast është edhe kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, duke mos e udhëzuar Pacollin as nuk duhet të jetë në Kuvend që të votojë për Qeverinë pas zgjedhjes në postin e presidentit. Kurse, analisti Avni Zogjani vlerëson se zhvillimet e fundit në LDK, janë vazhdim i mënyrës së deritanishëm të veprimit të këtij subjekti. Rreth rastit Pacolli, Zogjani ka përshtypjen se ka ekzistuar ndonjë aranzhim ekonomik mes Pacollit dhe krerëve të LDK-së që deputetët e kësaj të fundit të mos mbështesin procedurën e AAK-së në Gjykatën Kushtetuese. Kurse rreth procesit reformues në LDK, Zogjani ka thënë se kjo parti vazhdon të ndjek politikën pasive. Gjithnjë kemi pas një LDK e cila pret që të ndodhin gjërat, por nuk është proaktive asnjëherë që të veprojë për t’i prirë ndonjë procesi”, ka thënë ai.

---

## Presidenti Pacolli kërkon shprishjen e kufijve me Maqedoninë

---

**Ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë lëvizja duhet të bëhet me letërnjoftime, është kërkesa që Presidenti Pacolli ia ka bërë homologut të Maqedonisë.**

SHKUP, 23 MARS - Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli të mërkurën ka filluar vizitën zyrtare dyditore në Republikën e Maqedonisë, me ftesë të Presidentit Gjorgji Ivanov. Presidenti Pacolli, në fillim të vizitës së tij, është pritur nga Presidenti Ivanov me nderime shtetërore. Presidentët kanë konstatuar se si Kosova ashtu edhe Maqedonia janë partnerë strategjikë të njëra-tjetra, duke pasur parasysh marrëdhëniet shumë të mira mes të dy vendeve në të gjitha fushat, si dhe rrugëtimin e tyre drejt integritimit sa më të shpejtë në institucionet ndërkombëtare. Presidenti i Kosovës, kërkoi nga homologu i tij maqedonas Ivanov, që të fillojnë aktivitetet rreth lehtësimit të lëvizjes së lirë të qytetarëve mes të dyja vendeve. **"Unë promovova idenë dhe kërkova ndihmën e presidentit Ivanov në këtë drejtim që edhe mes Kosovës dhe Maqedonisë të ketë lëvizje të lirë të njerëzve, normalisht me më pak formalitete, me letërnjoftime, por biseduam gjithashtu edhe nevojën që kufijtë të humbin sensin e tyre, të hapen edhe pika të reja kufitare që të mundësojmë lëvizjen e vërtetë të lirë të popujve tanë, qytetarëve tanë pasi atë e meritojnë, dhe tani ka ardhur koha kur ne duhet t'ia fillojmë punës në këtë drejtim"**, tha Pacolli. Ndërsa presidenti i Maqedonisë Ivanov tha se një gjë e tillë do të ndodhte pasi Kosova t'i plotësoje kriteret e kërkuara nga BE-ja për liberalizimin e vizave. Presidenti Pacolli pas takimit tha se kjo vizitë dëshmon se Kosova ka fqinjësi të mirë me Maqedoninë, dhe se me këtë shtet tashmë janë zgjedhur të gjitha problemet dhe se tani do të përmbushen marrëveshjet e nënshkruara më këtë shtet. Presidenti i Kosovës vlerësoi se Maqedonia ka bërë hapa gjigantë drejt integritimeve euroatlantike dhe sipas tij, Kosova ballafaqohet edhe me disa probleme për të cilat në këtë periudhë duhet filluar të punohet në mënyrë intensive. Presidenti maqedonas, tha me këtë rast se vizita e presidenti Pacolli në Maqedoni paraqet sinjale të qarta të bashkëpunimit të mëtejshëm të të dy shteteve, duke shprehur mbështetjen e shtetit të tij, për procesin e avancimit dhe të zhvillimit të të gjithë fqinjëve. "Maqedonia është e interesuar për bashkëpunim me Kosovën në të gjithë fushat", tha Ivanov. Ndërsa, sipas tij, demarkacioni i kufirit është një arritje kyçe e bashkëpunimit të deritanishëm mes dy shteteve, që i kontribuon edhe forcimit të sigurisë, stabilitetit dhe prosperitetit në rajon. "Me mbylljen e kësaj çështjeje vendosëm një shembull për shtetet e tjera të rajonit se si duhet t'i tejkalojnë çështjet bilaterale në mënyrë evropiane", u shpreh ai. Gjithashtu, Ivanov theksoi se integritet euroatlantike janë një çështje kyçe, dhe shprehu gatishmërinë për të ndihmuar Kosovën në realizimin e reformave të nevojshme institucionale, reformave në administratën publike, në gjyqësi e fusha të tjera. Dy homologët i vlerësuan të rëndësishme edhe takimet e presidentëve të rajonit, që do të mbahet më 12 korrik në Ohër. Gjatë qëndrimit të tij në Shkup, presidenti i Kosovës Behgjet Pacolli takoi kryeparlamentarin Veljanovski, zëvendëskryeministrin Naumovski, si dhe liderët e partive shqiptare. Presidenti i Kosovës Behgjet Pacolli nesër do të marrë pjesë në një biznes forum në Shkup. Kjo është vizita e parë zyrtare e presidentit Pacolli në Maqedoni.

## **Pacolli forcon marrëdhëniet shtetërore me Maqedoninë**

**Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, të mërkurën në Shkup është takuar me homologun maqedonas Gjorgji Ivanov, me të cilin ka biseduar për marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë dhe për situatën në rajon. Në këtë takim është biseduar edhe për mundësinë e kalimit të kufijve me letërnjoftime, sipas iniciativës së Pacollit, për ç'gjë Ivanov ka thënë se për këtë është e nevojshme të përmbushen të gjitha standardet evropiane, të cilat i cakton Bashkimi Evropian, duke shtuar se kjo çështje u mbetet qeverive.**

PRISHTINË / SHKUP, 23 MARS - Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, ka qëndruar të mërkurën për vizitë zyrtare në Maqedoni, ku është takuar me homologun maqedonas Gjorgji Ivanov. Temat kryesore të takimit kanë qenë marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë dhe gjendja në rajon. Gjatë takimit presidentët Ivanov dhe Pacolli kanë konstatuar se ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës nuk ka çështje të hapura dhe se të dyja vendet duhet ta rrisin bashkëpunimin në sferën ekonomike. Presidenti Ivanov ka shprehur gatishmërinë për ta ndihmuar Kosovën në rrugën e saj euroatlantike. "Ky takim është një sinjal i qartë për bashkëpunimin e mëtejshëm, i cili duhet të pasojë mes Maqedonisë dhe Kosovës. Me presidentin Pacolli kishim një takim shumë të frytshëm, në të cilin biseduam për nxitjen e marrëdhënieve tona dypalëshe si dhe për bashkëpunim ndërmjet vendeve të rajonit. Maqedonia mbështet anëtarësimin e të gjitha shteteve fqinje në strukturat euroatlantike. Maqedonia dëshiron që edhe Kosova sa më shpejt të bëhet pjesë e familjes së madhe evropiane", ka thënë presidenti maqedonas. Ndërkohë, presidenti Pacolli ka thënë se Kosova pret mbështetje nga Maqedonia në rrugën e saj euroatlantike. "Ne kemi filluar mbarë, mes nesh nuk ka asnjë çështje të hapur, kemi lidhur marrëdhënie diplomatike në kohë të duhur, tani do të fillojmë të bashkëpunojmë për të ardhmen tonë të përbashkët. Ne tani duhet t'i zbatojmë të gjitha marrëveshjet që kemi nënshkruar. Maqedonia ka bërë një hap të madh në sferën e integriteteve, Kosova është në rrugë të mbarë që të përfshihet në rrugën evropiane, ne presim mbështetje nga Maqedonia", ka thënë Pacolli. Në këtë takim është biseduar edhe për mundësinë e kalimit të kufijve me letërnjoftime, sipas iniciativës së Pacollit, për ç'gjë Ivanov ka thënë se për këtë është e nevojshme të përmbushen të gjitha standardet evropiane, të cilat i cakton Bashkimi Evropian, duke shtuar se kjo çështje u mbetet qeverive. Ndërsa presidenti Pacolli ka shprehur gatishmërinë e shtetit të Kosovës për qarkullim të lirë të qytetarëve të të dyja vendeve. **"Një prej pikave në të cilat unë i konsideroj se do të ndodhin. Në këtë takim kërkova ndihmën e presidentit Ivanov që edhe mes Maqedonisë dhe Kosovës të ketë lëvizje të lirë, normalisht me më pak formalitete, respektivisht vetëm me letërnjoftime, e gjithë kjo në funksion të lehtësimit të qytetarëve të të dyja vendeve"**, ka thënë presidenti i Kosovës. Pacolli dhe Ivanov kanë biseduar edhe për samitin e presidentit të Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, që do të duhej të mbahet në muajin korrik, në Ohër. Ivanov ka paralajmëruar nismën për deklaratën e Ohrit, me qëllim që të vazhdojnë takimet edhe në të ardhmen, kurse Pacolli ka thënë se shpreson se atyre në njërin nga takimet e ardhshme do t'iu bashkohen edhe presidenti i Serbisë, Boris Tadiq dhe ai i Greqisë, Karlos Papulas. **"Unë çdoherë jam i disponuar për takime të tilla, në të cilat përherë në mënyrë të hapur bisedohet për ardhmërinë, e kjo është e mirë për popujt tanë. Dëshiroj të theksoj se në**

**këto takime në të ardhmen nuk do të jenë vetëm katër shtete, por se ky format do të zgjerohet",** ka thënë Pacolli. "Pse të mos jetë i pranishëm edhe Tadiq, por edhe presidenti grek Papulas. Edhe ata duhet ta kuptojnë realitetin se ne ekzistojmë dhe se nga kjo situatë do të kenë dobi vetëm qytetarët tanë", ka theksuar Pacolli pas takimit me homologun e tij maqedonas, Ivanov. Gjatë takimit është nënshkruar edhe Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës në bujqësi dhe sektorë të ngjashëm, dhe është biseduar edhe për bashkëpunimin ekonomik. Gjatë pasdites presidenti Pacolli do të takohet edhe me kryetarin e Kuvendit, Trajko Veljanovski, si dhe me zyrtarë të tjerë të lartë të Maqedonisë në një drekë të përbashkët pune. Ndërkohë, gjatë vizitës dyditëshe presidenti Pacolli sot (e enjte) do të qëndrojë në Tetovë, ku do të takohet me krerët e partive shqiptare, si dhe do të vizitojë disa kompani të rëndësishme afariste në këtë rajon.



*Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, të mërkurën në Shkup është takuar me homologun maqedonas Gjorgji Ivanov, me të cilin ka biseduar për marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë dhe për situatën në rajon*





*Gjatë takimit është nënshkruar edhe Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës në bujqësi dhe sektorë të ngjashëm, dhe është biseduar edhe për bashkëpunimin ekonomik*

---

## Mesazhet e legjitimitetit të presidentit tonë

---

**Çfarë ka të përbashkët midis refuzimit të LDK - së për ankimim në Kushtetuese për presidentin Pacolli, mikpritjes së jashtëzakonshme që autoritetet më të larta shtetërore të Shqipërisë ia rezervuan atij, ftesës për vizitë nga presidenti italian, mesazheve të urimit nga presidenti francez, apo nga të gjithë homologët e tij perëndimorë dhe të rajonit? E përbashkëta është legjitimiteti i zgjedhjes së presidentit Pacolli. Legjitimiteti i figurës së tij për të qenë president i Kosovës. Le t'i marrim me radhë secilën prej tyre.**

### **Veprimi i LDK - së**

LDK - ja nuk është një parti e afërt me presidentin Pacolli, madje duhet t'ia ketë marrë për të madhe faktin se nëpërmjet koalicionit me PDK - në shmangu mundësinë e zgjedhjeve të parakohshme. Por, LDK - ja është parti serioze që i mbahet një linje racionale veprimi politik. Ajo e di se, nëse konteston procedurën e zgjedhjes së një presidenti, nuk ka kuptim ta kontestojë edhe veprimin e parë që ai ka bërë si president. D.m.th., nëse ai është zgjedhur për shkak të procedurave të gabuara të Kuvendit të Kosovës, ai s'ka qenë president kur ka votuar. Dhe në një rast të tillë ai ka bërë mirë që ka votuar sepse paska qenë deputet (!?). Përveç këtij arsytimi, LDK - ja si parti institucionale e kupton se s'ka arsye ta fusë vendin në një krizë të vazhdueshme institucionale kur ka prioritete të tjera të veprimit politik si opozitë, që zakonisht merret me Qeverinë. LDK mendon kështu, se nëse Gjykata Kushtetuese vendos se presidenti Pacolli është zgjedhur nëpërmjet procedurave të ligjshme, atëherë ai është legjitim.

### **Vizita në Shqipëri**

Kështu si LDK - ja me sa duket mendojnë edhe në Shqipëri. Me gjithë problemet e saj politike, Shqipëria ka qetësinë, ka distancën e nevojshme për t'i kuptuar proceset politike të Kosovës dhe protagonistët e saj. Shqipëria politike, ajo e shoqërisë civile, e universiteteve, është e pajisur me sensin e shtetit dhe institucioneve, me mendim kritik për të mos u instrumentalizuar nga gazeta apo qendra pushteti mediatic që kanë interesa në sulmet ndaj presidentit Pacolli. Kështu shpjegohet fakti se presidenti Pacolli u prit me të gjitha nderimet e një kryetari shteti dhe homologu i tij, Topi, e shoqëroi në të gjitha aktivitetet e mundshme. Kryeministri Berisha i dha drekë dhe shëtitje me të në qendër të Tiranës, diçka për të cilën nuk kishte ndonjë detyrim protokollar. Një parti nacionaliste si PDIU e vlerësoi rolin e tij të mëparshëm për njohjet, vizionin e tij ekonomik, fjalimin në parlament etj. Kreu i opozitës, Rama, e priti me një mirësjellje thellësisht vëllazërore. Parlamenti Shqipërisë, të dy krahët e tij, për herë të parë aq të qetë, e duartrokritën pesë herë fjalimin e presidentit Pacolli, një fjalim i pazakontë, ku për herë të parë u artikulua në praninë e ambasadorëve më të rëndësishëm të Perëndimit dhe rajonit, termi "bashkim kombëtar". Një universitet serioz si UET - i, ku janë pedagogë, ish - kryeministra, ish - prokurorë të përgjithshëm, ish - kryetarë gjykatash të larta, pesë ish - ambasadorë, e vlerësoi presidentin Pacolli me titullin e lartë "honoris causa", për të gjithë spektrin e aktivitetit të tij: ndërtimin, filantropinë, njohjet, politikën. Në ceremoninë e rastit morën pjesë dy ish - presidentë, ministri i Arsimit i Shqipërisë, autoritete intelektuale të vendit, dhe shumë studentë që e bllokuan lëvizjen e presidentit Pacolli në pritje të autografëve të tij etj. A thua vallë në këtë mirënjohje të përgjithshme të Shqipërisë kishte hipokrizi, mirësjellje

diplomatiqe, apo blerje? A duhet të jemi kaq të "të pashpirt", të dyshojmë për një blerje të përgjithshme të shtetit, të shoqërisë shqiptare prej presidentit të Kosovës? Edhe në këtë pritje të jashtëzakonshme, unike për një kryetar shteti të Kosovës, fjala kyçe është legjitimitet. Zoti Pacolli është president legjitim, edhe për shkak të procedurave, edhe për shkak të së kaluarës së tij...

### **Homologët e tij perëndimorë dhe të rajonit**

Presidenti Pacolli ka marrë gjatë gjithë kësaj kohe, mesazhe vlerësimi, urimi, ftesa nga homologë të ndryshëm, si presidenti Sarkozy i Francës, presidenti italian Napolitano, i cili madje e ka ftuar në vizitë shtetërore. Presidenti maqedonas madje e ka ftuar për herë të parë në një vizitë shtetërore presidentin Pacolli, i pari president i Kosovës që viziton Maqedoninë në një format të tillë vizite. Pse? Këto ftesa janë dëshmi e legjitimitetit të zgjedhjes së presidentit, e mungesës së çdo rezerve për figurën e tij dhe për më shumë, janë shprehje respekti për figurën e tij. Nëse do të kishin rezerva, atëherë krerët perëndimorë të shtetit mund të mos i shkruanin, sepse përshëndetja për zgjedhjen e një presidenti nuk është detyrim për një homolog të tij. Siç kuptohet, zoti Pacolli e ka kaluar sfidën e legjitimitetit. Legjitimiteti i tij është legjitimiteti i institucioneve. Legjitimiteti i institucioneve është legjitimiteti i Kosovës. Kështu u sugjeronte kritikëve të tij, një figurë e shquar e diplomacisë së Shqipërisë si Besnik Mustafaj. "Tashmë Behgjet Pacolli është legjitimisht (deri në një vendim të kundërt të Gjykatës Kushtetuese) president i Republikës. Për të gjitha këto ... kritikë ... ai ka marrë verdiktin përfundimtar atje ku e merr verdiktin një politikan: edhe drejtpërdrejt në popull, edhe në Parlament". Zoti Mustafaj më tutje gjithashtu thotë: "Çasti solemn i bërjes së betimit nga ana e tij do të duhej të shënonte një kthesë të plotë edhe në sjelljen e kritikerëve të tij. Ai duhet mbajtur në vazhdim në vëmendjen e opinionit publik dhe të opinionit politik për ato që kryen, apo edhe nuk kryen si Kryetar i Shtetit, e jo më për të djeshmen e tij. Një vëmendje të tillë serioze nuk po e shoh të shfaqet", thotë zoti Mustafaj. Por, siç është dukur edhe në ditët e para të mandatit të tij, ai po e rikonfirmon mandatin e tij edhe në Shqipëri, edhe jashtë vendit. Por dikush gjen kohë të merret prapë me të kaluarën e tij në shenjë proteste sipas një proverbi popullor, me "temperaturën e ujit që po i jepet - i ftohtë, apo i ngrohtë", prej presidentit Pacolli.

**Nga Jetlir Zyberaj**

---

## **Kosova dhe Maqedonia bashkëpunojnë në fushën e bujqësisë**

---

23 MARS (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ujërave e Republikës së Maqedonisë të mërkurën kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi për fushën e bujqësisë dhe për sektorët e ngjashëm. Në kuadër të vizitës zyrtare të delegacionit kosovar në Republikën e Maqedonisë, ministri i MBPZHR - së Blerand Stavileci dhe homologu i tij maqedonas Lupço Dimovski, me qëllim fuqizimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, në veçanti në lëmin e bujqësisë, në Presidencën e Republikës së Maqedonisë kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi, i cili rregullon bashkëpunimin e ndërsjellë për shkëmbimin e informacioneve dhe analizave shkencore, për zhvillimin e shërbimeve këshillimore dhe shkëmbimin e rezultateve hulumtuese, për shkëmbimin e materialeve gjenetike dhe biologjike në prodhimin e bimëve dhe mbarështimin e kafshëve, për organizimin e trajnimeve, seminareve dhe konferencave profesionale. Pastaj, për realizimin e projekteve rajonale dhe zhvillimin e bujqësisë organike, për zhvillimin e turizmit rural dhe tregun bujqësor, për shkëmbimin e përvojave në fushën e politikave bujqësore, masave specifike dhe mbrojtjen e prodhimeve bujqësore, për mbështetjen reciproke në procesin e integritit evropian në kuadër të ministrive përkatëse etj. Për ta zbatuar këtë marrëveshje bashkëpunimi do të formohet një komision, i cili do ta hartojë një plan veprimi konform fushave të dakorduara për bashkëpunim dhe do ta monitorojë procesin e implementimit. Komisioni do të përbëhet nga gjashtë përfaqësues prej secilës palë, si dhe do të mbajë mbledhje të rregullta së paku dy herë në vit. Kohëzgjatja e marrëveshjes është 5 vjet, me mundësi zgjatjeje automatike edhe për një periudhë tjetër 5 - vjeçare, nëse njëra prej palëve nuk dëshiron të tërhiqet pas 5 vjetëve të para. Dispozitat e kësaj marrëveshje nuk kufizojnë marrëveshjet e tjera ekzistuese dhe as marrëveshjet e ardhshme ndërkombëtare që mund të nënshkruhen nga palët.

---

## Presidenti Pacolli: Shqiptarët në Maqedoni duhet të jenë unikë

---


**“Jam kundër çdo barriere që mund ta pengojë lëvizjen e lirë të qytetarëve, të mallrave e të ideve”, tha Pacolli.**

PRISHTINË, 24 MARS - Shqiptarët në Maqedoni duhet të jenë unik, është porosia që ua ka përcjellë Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, i cili është takuar edhe me përfaqësuesit e partive politike në Maqedoni, liderin e BDI-së, Ali Ahmeti, liderin e PDSH-së, Menduh Thaçi dhe kryetarin e Demokracisë së Re, Ymer Selmani. Presidenti Pacolli po ashtu është takuar edhe me kryetarin e Partisë Socialdemokrate, Branko Cervenkovskin. Implementimi i Marrëveshjes së Ohrit, zhvillimet politike në Maqedoni dhe mundësitë për bashkëpunim mes Maqedonisë dhe Kosovës ishin disa nga temat e diskutimit mes Presidentit Pacollit dhe kryetarit të BDI-së, Ali Ahmeti. Presidentin Pacolli e informova për implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, ngecjet në implementim e saj, për zhvillimet politike në Maqedoni“, tha pas takimit z. Ahmeti. "Bashkërisht u morëm vesh që të vazhdojmë bashkëpunimin. I thashë qëndrimet e PDSH-së lidhur me zhvillimet në Maqedoni. I thashë se në Maqedoni po riciklohet kriza", theksoi ndërkaq lideri i PDSH-së, Menduh Thaçi. Ndërsa, lideri i DR-së, Imer Selmani e informoi Presidentin Pacollin për situatën aktuale politike në Maqedoni, duke cekur se ngërçi politik ka shkaktuar ndjenjë të paperspektivës te qytetarët e vendit. Selmani tha se vendi është në krizë politike dhe kur kësaj krize i shtohen edhe raportet e acaruar ndëretnike dhe ndërjetare, ekonomia e dobët dhe mungesa e investimeve, si dhe procesi i bllokuar euro-integrues i Maqedonisë, "zgjidhje e vetme për dalje nga ky qorrsoak i vendit janë zgjedhjet e parakohshme parlamentare, të cilat duhet të jenë fer dhe demokratike dhe në sipërfaqe të sjellin forca të reja progresive që do të udhëheqin shtetin drejtë binarëve të duhur, barazisë së plotë mes shqiptarëve dhe maqedonasve dhe integrimin e Maqedonisë në NATO dhe BE". Presidenti Pacolli në një deklaratë të dhënë pas të gjitha takimeve tha se ai mbetet i përkushtuar që në marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve të ketë prioritet ekonomia. **"Unë gjithmonë e rendis në radhë të parë bashkëpunimin ekonomik, krijimin e mundësive të reja të zhvillimit ekonomik, veprime që çojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve"**, tha ai. **"Jam kundër çdo barriere që mund ta pengojë lëvizjen e lirë të qytetarëve, të mallrave e të ideve. Jetojmë në shekullin 21 dhe për mua këto barriera kanë kuptim banal"**, shtoi ai. Duke folur për shqiptarët në Maqedoni, ai tha se pozita e shqiptarëve të Maqedonisë është në duart e tyre. **"Partitë politike duhet të jenë të kujdesshme, kanë një përgjegjësi shumë të madhe. Unë bëj thirrje për unitet. Ato mund të kenë divergjenca, programe të ndryshme që u ofrojnë qytetarëve. Por, kur është në pyetje kauza kryesore, atëherë duhet të jenë unikë"**, tha Presidenti Pacolli. M. N.

"Biseduam për situatën politike në Maqedoni dhe në Kosovë, për mundësitë e bashkëpunimit", tha presidenti Pacolli.



*Foto e takimit në mes Presidentit Behgjet Pacolli dhe kryetarit të BDI-së, Ali Ahmeti. Presidentin Pacolli e informova për implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, ngecjet në implementim e saj dhe për zhvillimet politike në Maqedoni“, tha pas takimit z. Ahmeti*



*Takimi i Presidentit Pacolli me liderin e PDSH-së, Menduh Thaçin. I thashë qëndrimet e PDSH-së lidhur me zhvillimet në Maqedoni. I thashë se në Maqedoni po riciklohet kriza", theksoi ndërkaq lideri i PDSH-së, Menduh Thaçi*



*Presidenti Pacolli takon edhe kryetarin e Demokracisë së Re, Ymer Selmani. Ky i fundit e informoi Presidentin Pacollin për situatën aktuale politike në Maqedoni, duke cekur se ngërçi politik ka shkaktuar ndjenjë të paperspektivës te qytetarët e vendit*



---

## **Pacolli: Së bashku ta formojmë një forcë...**

---

**"Asnjëherë nuk mund të anashkalohet kjo anë dhe popullata e kësaj ane dhe ne të gjithë së bashku duhet të formojmë një forcë", ka thënë presidenti Pacolli të enjten në Tetovë.**

PRISHTINË / TETOVË, 24 MARS - Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli të enjten është pritur nga kryetari i komunës së Tetovës, Sadi Bexheti dhe qytetarë të Tetovës. Pacolli pasi ka rikujtuar ndihmën që ky qytet dhe rrethina i dhanë Kosovës në ditët më të vështira, ka thënë se Tetova dhe kjo anë e Maqedonisë është pjesë përbërëse e të gjitha zhvillimeve shoqërore, kulturore dhe politike të rajonit. **"Asnjëherë nuk mund të anashkalohet kjo anë dhe popullata e kësaj ane dhe ne të gjithë së bashku duhet të formojmë një forcë"**, ka thënë presidenti Pacolli. **"Ishte kënaqësi që sot disa momente t'i kaloj me kryetarin e komunës së Tetovës, komunë kjo me traditë shumë të lashtë ndërmarrëse, komunë kjo që atëherë kur populli i Kosovës pati nevojë për ndihmë i doli në ndihmë, hapi dyert e veta, hapi shpirtin, zemrën dhe pranoi të gjithë ata që ishin të dëbuar. Komunë kjo që sot mund të quhet edhe qendër akademike e gjithë shqiptarëve të kësaj ane, komunë kjo që ka marrë çdo gjë që ka qenë e përdorshme dhe e mirë edhe nga Shqipëria dhe Kosova dhe e ka zbatuar me sukses"**, ka theksuar presidenti Pacolli. Presidenti Pacolli ka shprehur edhe njëherë përcaktimin e tij për mbështetje të fortë të idesë së lëvizjes së lirë të mallrave dhe të njerëzve, të ideve dhe të kapitalit. **"Kjo begati që e ka falë natyra duhet të kultivohet nga njerëzit dhe unë jam promovues i idesë që kjo zonë të deklarohet si Zonë e Lirë Ekonomike që njerëzit lirshëm ta fillojnë skijimin nga Tetova dhe të mbarojnë në anën perëndimore të këtyre maleve"**, ka thënë presidenti Pacolli. Sipas tij, rruga që do të lidhë Tetovën me Prizrenin do të ketë një rëndësi të madhe dhe është pjesë e idesë që garanton lëvizje të lirshme të mallrave dhe të ideve. Kryetari i komunës së Tetovës, prof. dr. Sadi Bexheti ka deklaruar se me presidentin Pacolli ka biseduar për shumë tema, duke e informuar lidhur me zhvillimin ekonomik, kulturor, turistik, marrëdhëniet ndërnacionale në Republikën e Maqedonisë dhe konkretisht në Tetovë. Sipas tij, komuna e Tetovës është e përcaktuar për intensifikim të bashkëpunimit me komunat dhe institucionet e Republikës së Kosovës, ndërsa ka theksuar se nga presidenti Pacolli ka marrë mbështetje të fuqishme për realizimin e të gjitha projekteve të rëndësishme në të mirë të qytetarëve. Me këtë rast, kryetari i komunës së Tetovës nderoi presidentin e Republikës së Kosovës Behgjet Pacolli me mirënjohje për kontributin e tij në kultivimin dhe afirmimin e vlerave të përbashkëta kombëtare dhe për avancimin e vlerave moderne evropiane. Gjatë qëndrimit në Tetovë, presidenti Pacolli ka zhvilluar takime me drejtuesit fetarë lokalë të Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë si dhe bektashinjtë në Teqen Arabati në Tetovë. Ai më as ka ndarë kohën për t'u takuar edhe me pronarin e kompanisë Ecolog Lazim Destani.



*Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli të enjten është pritur nga kryetari i komunës së Tetovës, Sadi Bexheti. Pacolli pasi ka rikujtuar ndihmën që ky qytet dhe rrethina i dhanë Kosovës në ditët më të vështira, ka thënë se Tetova dhe kjo anë e Maqedonisë është pjesë përbërëse e të gjitha zhvillimeve shoqërore, kulturore dhe politike të rajonit*



*Me këtë rast, kryetari i komunës së Tetovës nderoi presidentin e Republikës së Kosovës Behgjet Pacolli me mirënjohje për kontributin e tij në kultivimin dhe afirmimin e vlerave të përbashkëta kombëtare dhe për avancimin e vlerave moderne evropiane*



*Presidenti Pacolli ka zhvilluar takime me drejtuesit fetarë lokalë të Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë, të cilë e kanë nderuar me një dhuratë*



*Presidenti Pacolli takoi edhe bektashinjtë në Teqen Arabati në Tetovë, nga të cilët u nderua me Mirënjohje si burrështetas dhe humanitar shqipëtar për respektin dhe ndihmën që ja ka kushtuar komunitetit Bektashian.*



*Presidenti Pacolli më pas ka ndarë kohën për t'u takuar edhe me pronarin e kompanisë Ecolog Lazim Destani.*

## Pacolli këmbëngul për heqjen e barrierave në tregti

Maqedonia dhe Kosova duhet të angazhohen me seriozitet për kapërcimin e të gjitha barrierave në bashkëpunimin ekonomik", ka theksuar presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, në forumin e biznesit Maqedoni - Kosovë, që mbahet në Shkup. Presidenti Pacolli, para biznesmenëve maqedonas dhe atyre kosovarë, ka thënë se **"tregu më i mirë është tregu, i cili është më afër"**. Andaj, sipas tij, bashkëpunimi mes dy vendeve është i domosdoshëm, duke pasur parasysh **"kapacitetin e ulët tregtar brenda këtyre shteteve"**. Ministri i Ekonomisë së Maqedonisë, Fatmir Besimi, ka vlerësuar se Kosova është shumë e rëndësishme për shtetin maqedonas, andaj dhe "Qeveria e vendit ka intensifikuar një varg aktivitete për ta lehtësuar bashkëpunimin mes dy vendeve fqinje, përfshirë këtu përmirësimin e infrastrukturës dhe ndërtimin e autostradës Shkup - Bllacë", kanë bërë të ditur mediet lokale. "Forumi i sotëm, i organizuar mes biznesmenëve të Kosovës dhe Maqedonisë, është në kuadër të vizitës zyrtare të presidentit kosovar, Behgjet Pacolli. Rëndësia e këtij takimi është që bashkëpunimi i deritanishëm, shkëlqyer në politikë, të jetë i qëndrueshëm, me një përcjellje adekuate edhe në fushën e ekonomisë", ka thënë Besimi.





*Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, në forumin e biznesit Maqedoni - Kosovë, që është mbajtur në Shkup. Presidenti Pacolli, para biznesmenëve maqedonas dhe atyre kosovarë, ka thënë se "tregu më i mirë është tregu, i cili është më afër"*



---

## Vija të kuqe për Serbinë

---

PRISHTINË - Presidenti i vendit, Behgjet Pacolli, ka deklaruar të premten se gjatë bisedimeve me Serbinë, nuk do të diskutohet për çështje që lidhen me kufijtë dhe sovranitetin e Republikës së Kosovës. Sipas tij, në këto bisedime do të bisedohet vetëm për çështje teknike, jo edhe për ato politike. **"Ne nuk duhet të ndalemi që të mos bisedojmë. Ne jemi humbësit, ne kemi humbur, ne i kemi njerëzit e pagjetur, neve na mungojnë fondet që janë vjedhur, shkatërrimet që janë bërë këtu te ne. Ne kemi interes që të ulemi e të bisedojmë dhe ato t'i kthehen prapë Kosovës, i kemi vijat e kuqe ku nuk ka bisedime"**, është shprehur ai. Në takimin e parë me gazetarë pas vizitës së tij në Shqipëri dhe Maqedoni, ai ka thënë se në këto dy vende ka zhvilluar takime të frytshme, ku mes tjerash ka promovuar idenë e bashkëpunimit ekonomik. Ai ka folur edhe për Lidhjen Demokratike të Kosovës, parti kjo e cila nuk e ka mbështetur Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës që të kërkojë mendim nga Gjykata Kushtetuese nëse Pacolli ka bërë shkelje të Kushtetutës, kur ka votuar për Qeverinë pak kohë pasi është zgjedhur president. **"Me plot përgjigje si po e them se me Isa Mustafën prej dhjetë ditë para se të zgjidhem president nuk kam pasur takim, thirrje telefonike apo ndërmjetësim. E kam respektin e njëjtë për Isa Mustafën, si para shumë vitesh kur ai ishte oponent politik i imi, atëherë kur ishim në Rahovec, që patëm tendencë koalicioni për zgjedhjet në Rahovec, por edhe tani. E kam një qëndrim shumë vertikal, të njëjtë, pa luhatje. E njëjta sikurse përpara, edhe tani ka thënë Pacolli. Kreu i vendit nuk ka lënë pa komentuar edhe arrestimet e fundit të ish - luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Nuk ka të drejtë askush të shkelë mbi vlerat e UÇK-së, UÇK-ja ka qenë dhe mbetet pika referuese e shtetbërjes së Kosovës, UÇK - ja ka mundësuar pavarësimin e shtetit tonë dhe i ka dalë në ndihmë popullit"**, ka thënë Pacolli.

---

## Trembëdhjetë këshilltarët e Pacollit

---

**Ibrahim Gashi, këshilltar i parë i presidentit Pacolli, njëherësh edhe shef i stafit politik, ka thënë se numri i kolegëve të tij mund të shtohet vetëm po qe se del në pah nevoja e përfaqësimit të Presidencës në dialogun e Kosovës me Serbinë. "Numri i këshilltarëve mund të rritet vetëm nëse kërkohet që të jemi pjesë e bisedimeve, që Presidenca të ketë përfaqësuesin e saj, ku mbase do të mund të kërkohet ndonjë person me përvojë në atë fushë të negociatave", ka thënë ai**

PRISHTINË, 26 MARS - Behgjet Pacolli e ka kompletuar ekipin e njerëzve që do ta këshillojnë atë si president i Kosovës. Pacolli do t'i ketë gjithsej trembëdhjetë këshilltarë, prej të cilëve dhjetë të brendshëm që do të paguhen nga buxheti i Kosovës dhe tre të tjerë të jashtëm, të cilët nuk do të marrin para nga taksapaguesit kosovarë. Ibrahim Gashi, këshilltari i parë i presidentit Pacolli, njëherësh edhe shef i stafit politik, i ka treguar të premten gazetës emrat e njerëzve që do ta "furnizojnë" me këshilla presidentin Pacolli. "Ibrahim Gashi, këshilltar i parë dhe shef i stafit politik, Naim Maloku, këshilltar për siguri, Fatos Makolli, këshilltar për siguri publike, Ilir Shala, këshilltar për çështje ligjore, Shpend Kallaba, këshilltar për marrëdhënie me jashtë dhe protokoll", ka numëruar ai pesëshen e parë të brendshëm këshilltarëve të brendshëm. "Kushtrim Bajrami, këshilltar për misionet diplomatike, Nebojsa Toshevski, këshilltar për komunitete, Arber Geci, këshilltar për rini dhe sport, Ardian Kastrati, këshilltar për marrëdhënie me publikun, dhe Shefki Abdullahu, këshilltar për pushtet lokal dhe politika sociale". Pos tyre, Gashi ka numëruar edhe këshilltarët e jashtëm. "Ata janë: Blerim Reka, këshilltar për integritet evropian, Mentor Nazarko, për media, dhe Jetlir Zyberaj për media", ka treguar Gashi. Këshilltari kryesor i Pacollit ka thënë se numri i kolegëve të tij mund të shtohet vetëm po qe se del në pah nevoja e përfaqësimit të Presidencës në dialogun e Kosovës me Serbinë. "Numri i këshilltarëve mund të rritet vetëm nëse kërkohet të jemi pjesë e bisedimeve, që Presidenca të ketë përfaqësuesin e saj, ku mbase do të mund të kërkohet ndonjë person me përvojë në atë fushë të negociatave", ka thënë ai. "Por për momentin ne konsiderojmë se niveli i bisedimeve është i ulët e teknik dhe Presidenca s'ka nevojë që të involvohet në to". Gashi ka treguar edhe kriterin të cilin është dashur ta plotësojnë ata që kanë dashur të jenë këshilltarë të Pacollit. "Duhet të jenë personalitete që kanë emër në fusha të caktuara, njerëz që në një mënyrë kanë kredenciale edhe profesionale edhe morale", ka thënë ai. "Por edhe njerëz që edhe presidenti ka besim tek ta". Këshilltari i parë i presidentit ka thënë që shefi i tij konsultohet për çështje të ndryshme edhe me ekspertë të jashtëm, por ai nuk e ka përmendur në mënyrë të veçantë nëse Esad Pushkar është në ndonjë mënyrë i angazhuar për ta këshilluar Pacollin. "Presidenti Pacolli ka një konsulentë edhe të ekspertëve të jashtëm, të cilët mund t'i shfrytëzojë ndonjëherë edhe për çështje të njohjeve apo për çështje të kontakteve ndërkombëtare" ka thënë Gashi. Krahasuar me ish - paraardhësin e tij në postin e presidentit të Kosovës, Fatmir Sejdiu, Pacolli ka të angazhuar dy këshilltarë më shumë. Ish - presidenti Sejdiu i ka pasur gjithsej njëmbëdhjetë këshilltarë: nëntë të brendshëm dhe dy të tjerë të jashtëm.

---

## **Pacolli: Reciprociteti i serbëve të Kosovës me Luginën e Preshevës**

---

Presidenti i Kosovës Behgjet Pacolli ka deklaruar për agjencinë "Presheva jonë" se çështja e komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës do të jetë temë e dialogut Prishtinë - Beograd, nëse delegacioni serb e aktualizon çështjen e serbëve të Kosovës. Pacolli ka theksuar se bashkësisë serbe nuk i është premtuar asgjë, dhe ka thënë se në dialogun me Beogradin, Prishtina do t'u përmbahet "vijave të kuqe". Presidenti kosovar ka sqaruar se në të ardhmen, me Serbinë do të bisedohet vetëm për çështjet teknike, dhe "kursesi për çështjet tjera politike siç janë kufijtë, apo disa çështje të brendshme, siç është ajo e Mitrovicës".

---

## Ivanov refuzon kërkesën e Pacollit për letërnjoftimet

---

Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, u prit me nderime të larta nga homologu i tij maqedonas, presidenti Gjorgji Ivanov, gjatë vizitës zyrtare dyditore në Shkup. **"Mes dy vendeve fqinje, Maqedonisë dhe Kosovës, nuk ka çështje të hapura. Duke shfrytëzuar këtë avantazh, vendet duhet të intensifikojnë bashkëpunimin në sferën ekonomike dhe lëvizjen e lirë të qytetarëve"**, tha Pacolli, në konferencën me nikoqirin e tij. Duke u përgjigjur në pyetjet e gazetarëve rreth lëvizjes së lirë të qytetarëve, respektivisht mundësinë që qytetarët e të dyja vendeve ta kalojnë kufirin vetëm me letërnjoftime, presidenti Pacolli shpreh gatishmërinë e shtetit të Kosovës për qarkullim të lirë të qytetarëve të të dyja vendeve. **"Është një prej pikave, që unë konsideroj se do të ndodhin. Në këtë takim kërkova ndihmën e presidentit Ivanov, që edhe në mes Kosovës dhe Maqedonisë të ketë lëvizje të lirë, normalisht me më pak formalitete, respektivisht vetëm me letërnjoftime, e gjithë kjo në funksion të lehtësimit të qytetarëve të të dyja vendeve"**, deklaroi Pacolli. Duke u përgjigjur po në këtë çështje, pra rreth lëvizjes së qytetarëve vetëm me karta identiteti, presidenti i Maqedonisë, Gjorgje Ivanov, u shpreh më i përmbajtur, me arsyetimin se kjo çështje u mbetet ta zgjidhin qeverive të të dyja vendeve. Ivanov theksoi nevojën e intensifikimit të bashkëpunimit në më shumë sfera mes dy vendeve, veçanërisht në synimin e përbashkët për t'u integruar në strukturat euroatlantike. "Ky takim është një sinjal i qartë për bashkëpunimin e mëtejshëm, i cili duhet të pasojë ndër mjet Maqedonisë dhe Kosovës. Me presidentin Pacolli kishim një takim shumë të frytshëm, në të cilin biseduam për nxitjen e marrëdhënieve tona dypalëshe, si dhe për bashkëpunimin mes vendeve të rajonit". "Maqedonia mbështet anëtarësimin e të gjitha shteteve fqinje në strukturat euroatlantike. "Maqedonia dëshiron që edhe Kosova sa më shpejt të bëhet pjesë e familjes së madhe evropiane", deklaroi presidenti i Maqedonisë, Gjorgje Ivanov. Gjatë vizitës dyditëshe presidenti Pacolli të enjten do të qëndrojë në Tetovë, ku do të takohet me krerët e partive shqiptare, si dhe do të vizitojë disa kompani të rëndësishme biznesi në këtë rajon. /rel/

---

## **Pacolli, koha për bashkim kombëtar**

---

**"Do t'i rekomandoj gjithë spektrit politik, Qeverisë, shoqërisë civile, njerëzve intelektualë, që ta mbështesin idenë e bashkimit kombëtar, duke filluar prej veprimeve ekonomike", është shprehur presidenti Pacolli**

PRISHTINË, 25 MARS - Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, ka bërë thirrje për bashkim kombëtar. T'ia fillojmë nga bashkimi ekonomik. Ne duhet t'ia fillojmë punës tani. Jemi vonë. Askush nuk do të na falë. Pse territoret tona duhet të jenë të ndara? Pse ne duhet të kemi barriera për të bashkëpunuar ndërmjet vete? Pse duhet të kemi diferenca? Duhet të krijojmë kushte të barabarta", ka thënë Pacolli gjatë një konference për medie pas kthimit në Kosovë nga vizita zyrtare që pati në Tiranë dhe Shkup veç bashkimit ekonomik, ai ka thënë duhet të kemi edhe ligje të njëjta e tekste shkollore. **"Duhet të krijojmë hapësirë të barabartë, lëvizje të lirë të mallrave, të ideve. Pse ne të mos kemi tekste të njëjta shkollore? Pse ligjvënësit tanë të vënë ligje të ndryshme në Shqipëri dhe të ndryshme këtu në Kosovë, kur flasim të njëjtën gjuhë, jemi të njëjtë dhe ia dimë hallin njëri tjetrit? Dhe mënyra e mendimit është e njëjtë, synimet tona janë të njëjta. Synimi ynë drejt shtëpisë së madhe atlantike është i qartë"** ka thënë Pacolli. I pari i vendit i ka bërë thirrje spektrit politik në vend dhe shoqërisë civile, që të mbështesin idenë e tij për bashkim kombëtar. **"Do t'i rekomandoj gjithë spektrit politik, Qeverisë, shoqërisë civile, njerëzve intelektualë, që ta mbështesin idenë e bashkimit kombëtar, duke ia filluar prej veprimeve ekonomike",** është shprehur Pacolli.

### **Nuk kam folur me Isa Mustafën prej që jam bërë president**

Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, në këtë konferencë ka mohuar të ketë pasur ndonjë marrëveshje me kryetarin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, për të mos e mbështetur AAK - në për ta dërguar lëndën në Gjykatën Kushtetuese lidhur me votimin e tij për Qeverinë. Pacolli ka treguar se prej ditës kur është bërë president nuk e ka takuar Mustafën dhe as nuk ka folur me të në telefon lidhur me një marrëveshje të përfolur ditët e fundit në disa medie vendore. **"Me plot përgjegjësi po them se me Isa Mustafën, prej dhjetë ditësh para se të zgjidhem president i Kosovës, nuk kam pasur takim, thirrje telefonike apo ndërmjetësim. Çfarë di për Isa Mustafën, di nga gazetatat që i lexoj",** ka thënë Pacolli. Megjithatë, Pacolli ka thënë se nuk e ka ndryshuar respektin për Isa Mustafën. **"E kam respektin njëjtë për Isa Mustafën. Para shumë ditësh, atëherë kur ishte oponent politik i imi, atëherë kur ishim në Rahovec, kur patëm tendencë koalicioni për zgjedhjet në Rahovec dhe tani, e kam një qëndrim shumë vertikal, të njëjtë, pa luhatje. Të njëjtë sikurse përpara, sikurse tash",** është shprehur Pacolli.

## **“Askush nuk ka të drejtë të shkelë mbi vlerat e UÇK-së”**

Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, ka folur edhe për arrestimet e ish pjesëtarëve të UÇK - së nga policia e EULEX - it dhe për fletarrestimin për deputetin e Kuvendit të Kosovës, Fatmir Limaj. Pacolli ka kërkuar nga organet e drejtësisë në vend që çdo veprim ta ndërmarrin në përputhshmëri të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ai ka thënë se askush nuk ka të drejtë të shkelë mbi vlerat e UÇK - së dhe ta njollosë luftën e shenjtë që ka bërë UÇK - ja. **"Në çdo veprim që bëhet nga ana e gjyqësisë të merret parasysh Kushtetuta. Nëse ka vend kushtetues, që ata njerëz të ndalen dhe të kryhen normalisht procedurat, le të kryhen, mirëpo nëse është në pyetje shkelja e Kushtetutës, atëherë të respektohet 100 për qind"**, ka thënë Pacolli. Pacolli ka deklaruar se nuk ka asnjë prej fakteve që EULEX - i, gjegjësisht organet e drejtësisë, kanë mbi njerëzit të cilët janë të arrestuar. **"Unë nuk kam fakte, nuk kam mbledhur asgjë prej fakteve që EULEX - i, gjegjësisht organet e drejtësisë, kanë mbi njerëzit të cilët janë të arrestuar. Kështu që, çdo deklaratë e imja nuk do të ishte e drejtë. Nuk kam njohuri. Po ashtu nuk kam njohuri se për çka flitet, duke pasur parasysh se ndoshta edhe nuk është edhe akuzë e ngritur ndaj zotit Limaj. Do të ishte jashtë normalitetit që unë të deklarohej për diçka këtu. Unë kërkoj t'i qasemi në mënyrë konstruktive çdo fakti. Duhet të kemi parasysh se faktet duhet të jenë të vërteta, jo thashetheme"**, ka thënë Pacolli.

---

## **Kushtetuesja e bën fajtor dhe të pashkollë Jakup Krasniqin**

---

**"Gjykata Kushtetuese njëzëri vendosi ta shpallë Kërkesën të pranueshme dhe, me shumicë votash dhe me dy gjyqtarë mospajtues, shpall se Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Nr. 04 - V - 04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, më datë 22 shkurt 2011, është jokushtetues, pasi është në kundërshtim me kërkesat e nenit 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe parimet demokratike të mishëruara aty", është thënë në vendimin e Gjykatës Kushtetuese**

PRISHTINË, 28 MARS - Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me shumicë votash kanë marrë vendim të hënën se zgjedhja e Behgjet Pacollit president i Kosovës, më 22 shkurt 2011, ka qenë jokushtetuese. "Gjykata Kushtetuese njëzëri vendosi ta shpallë Kërkesën të pranueshme, dhe, me shumicë votash dhe me dy gjyqtarë mospajtues, shpall se Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04 - V - 04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, më datë 22 shkurt 2011, është jokushtetues, pasi është në kundërshtim me kërkesat e nenit 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe parimet demokratike të mishëruara aty", është thënë në vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Vendimi i lëndës me numër KO 29/11 "Sabri Hamiti dhe deputetët e tjerë" do t'u dërgohet palëve me shkrim në një afat sa më të shkurtër. "Teksti i plotë i aktgjykimit do t'u dërgohet palëve së shpejti", është thënë në komunikatën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Një burim Brenda Gjykatës Kushtetuese i ka thënë "Epokës së re" se të mërkurën pritet ta marrin arsyetimin e plotë të vendimit të dyja palët, LDK - ja dhe Presidenca e Kosovës, kur edhe pritet të bëhet e ditur masa eventuale që do t'i kërkohet Kuvendit të Kosovës në këtë rast. Këshilltari i parë i presidentit Pacolli, Ibrahim Gashi, pavarësisht shumë përpjekjeve të gazetës, nuk e ka hapur telefonin për ta dhënë një përgjigje lidhur me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, në fillim të muajit mars, në një intervistë dhënë një mediumi, pati deklaruar se, nëse gjykata vërteton se ka pasur shkelje të Kushtetutës në zgjedhjen e presidentit, atëherë mënyra e zgjedhjes së presidentit duhet të kthehet nga pika zero. "Nëse vërtetohet se ka pasur shkelje të Kushtetutës, atëherë procedura duhet të kthehet nga pika zero. Me këtë nënkuptohet se presidenti nuk ka nevojë të jap dorëheqje, por duhet t'i kthehet edhe një herë garës në Kuvend", kishte deklaruar Hasani.

## **Mënyra se si u zgjodh Pacolli president**

Behgjet Pacolli është zgjedhur president i Kosovës më 22 shkurt të këtij viti në një seancë të jashtëzakonshme parlamentare. Pacolli në dy raunde të votimit në Kuvendin e Kosovës nuk kishte arritur ta merrte numrin e mjaftueshëm të votave për t'u zgjedhur president i vendit sepse për këtë nevojiteshin të paktën 81 vota, apo dy të tretat e deputetëve. Në sallë ishin të pranishëm vetëm 67 deputetë, pasi tri partitë politike opozitare, LDK - ja, Vetëvendosje! dhe AAK - ja, kishin lëshuar sallën e Kuvendit, duke mos u pajtuar me kandidaturën e Pacollit për president të Kosovës. Në raundin e parë të votimit Behgjet Pacolli kishte marrë 54 vota për, 11 kundër dhe dy abstenime. Pacolli as në raundin e dytë nuk i kishte fituar votat e mjaftueshme për t'u zgjedhur president. Por, në këtë raund të votimit Pacolli kishte dalë pak më mirë me vota sesa në raundin e parë, duke marrë 58 vota për, 7 kundër dhe dy abstenime. Partnerja e koalicionit, PDK - ja, duke e parë rrjedhshmërinë e procesit të votimit të presidentit, ishte konsultuar edhe një herë me grupin saj parlamentar. Nënkryetari i PDK - së, Hajredin Kuçi, kishte dalë në foltore të Kuvendit të Kosovës dhe kishte kërkuar një pauzë prej pesë minutash. Por, kjo nuk ishte pritur mirë nga drejtuesi i seancës, Jakup Krasniqi, i cili pati thënë se kjo pauzë ishte antikushtetuese. "Unë po jap pesë minuta pauzë, por ta dini se kjo është shkelje Kushtetutës dhe e Rregullores së Punës së Kuvendit. Çdo ndryshim rezultatit është i papranueshëm dhe është thjesht presion mbi deputetët", pati deklaruar Krasniqi. Pas kësaj pauze, e cila kishte zgjatur rreth 40 minuta, në raundin e tretë Behgjet Pacolli ishte zgjedhur president i Republikës së Kosovës.



---

## **Pacolli president antikushtetues**

---

**Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se zgjedhja e Presidentit Behgjet Pacolli nga ana e Kuvendit ka qenë kundërkushtetuese, pasi nuk janë respektuar procedurat që janë përcaktuar me Kushtetutë**

Kuvendi i Kosovës, kur ka zgjedhur për president të Kosovës, Behgjet Pacollin, ka vepruar në mënyrë kundërkushtetuese. Ky ka qenë vlerësimi i organit më të lartë të interpretimit të Kushtetutës, Gjykatës Kushtetuese, në përgjigjen që i ka dhënë ankesës së LDK-së dhe AAK-së lidhur me procedurat e zgjedhjes së Pacollit në postin e presidentit. Në vendimin e Gjykatës thuhet se me vendim të shtatë gjyqtarëve pro dhe dy gjyqtarëve kundër, Gjykata ka marrë vendim në bazë të së cilit konstaton se janë shkelur procedurat gjatë zgjedhjes së presidentit në seancën e 22 shkurtit të Kuvendit të Kosovës. Palët ende nuk e kanë marrë vendimin e plotë nga Gjykata Kushtetuese, por kjo pritet që t'u dërgohet të mërkurën pasdite. Anëtarja e kryesisë së LDK-së, Vjosa Osmani ka thënë se ende nuk kanë marrë tekstin e plotë nga Gjykata me arsyet dhe sqarimet se në cilat pika janë pajtuar në kërkesën e dërguar për këtë çështje. "Të mërkurën i kuptojmë arsyet e plota se si e kanë arsyetuar këtë dhe sa janë pajtuar me argumentet tona", ka thënë Osmani.

### **Dallon nga rasti Sejdiu**

Gjykata në këtë rast për dallim me rastin e ish - presidentit Sejdiu, konstaton se shkelja është bërë nga Kuvendi e jo nga Presidenti. Në këtë rast Kuvendi i Kosovës, ka bërë veprim antikushtetues duke shkelur procedurat gjatë zgjedhjes së presidentit. Vjosa Osmani thotë se Gjykata i propozon Kuvendit një masë të caktuar që duhet të ndërmarrin ata në bazë të këtij vendimi. "Sepse këtu po flasim për një akt të Kuvendit e jo presidentit dhe nuk kërkohet asgjë prej tij, por kërkohet prej Kuvendit që ta implementojë vendimin e Gjykatës, por ende se dimë saktësisht çka ka me kërkuar Gjykata nga Kuvendi", ka thënë Osmani. Ajo thotë se Presidentit nuk mund t'i kërkohet shkarkimi, sepse vendimi thotë se zgjedhja e tij ka qenë jo kushtetuese, e jo që ai ka shkelur Kushtetutën. "Për këtë, shkarkimin e presidentit nuk mund të kërkojë, por prapëseprapë nuk mundem me qenë e sigurt çka do të kërkohet, pasi ka mundësi të ndryshme. Kështu që kërkesa për implementimin e këtij vendimi të gjykatës si rregull është dashtë t'i shkojë edhe Kuvendit në bazë të vendimit të Gjykatës t'i ndërmarrë masat. Por, të mërkurën sqarohet e gjitha", është shprehur Osmani.

## **VENDIMI I PLOTË I GJYKATËS**

Lidhur me rastin KO 29/11 "Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë", Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr.04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, i 22 shkurtit 2011, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës më 28 mars 2011, ka shqyrtuar dhe votuar lidhur me rastin KO 29/11, "Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë", Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr.04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, i datës 22 shkurt 2011. Gjykata Kushtetuese, njëzëri, vendosi që të shpallë kërkesën të pranueshme dhe, me shumicë votash, dhe me dy gjyqtarë mospajtues, shpall se Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, më datën 22 shkurt 2011, është jo kushtetues pasi që është në kundërshtim me kërkesat e nenit 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe parimet demokratike të mishëruara aty. Teksti i plotë i aktgjykimit do t'u dërgohet palëve së shpejti.

---

## **Dorëheqje ose shkarkim**

---

**Presidenti Behgjet Pacolli, tash pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese duhet të japë dorëheqje ose në të kundërtën do ta shkarkojë Kuvendi. Kështu ka thënë nënkryetari i kryesisë së Kuvendit, Xhavit Haliti. Por, Pacolli edhe nëse do të rikandidohet, opozita sërish ka paralajmëruar bojkotim. Pra, shanset janë fare të vogla që Pacolli të mund t'i rikthehet postit të tij, tek i cili i ka mbetur vetëm "hija"**

Vetëm 35 ditë pas mori postin e Presidentit të Kosovës, Behgjet Pacolli, do të mund t'i rikthehet kandidimit për këtë post, ose të heqë fare dorë nga ai, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese se gjatë zgjedhjes së tij, janë shkelur procedurat kushtetuese. Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, Xhavit Haliti ka thënë pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit të Kosovës se do të marrë të gjitha veprimet e duhura në përputhje me rregulloren dhe Kushtetutën, për vendimin e Gjykatës Kushtetuese që konstatoi se zgjedhja e Presidentit është bërë në mënyrë antikushtetuese. Haliti ka thënë se ata nuk kanë biseduar për këtë çështje, pasi nuk kanë pasur vendimin me interpretim të Gjykatës në administratën e Kuvendit për ta shqyrtuar si pikë të rendit të ditës. "Kuvendi do të procedojë gjithçka konform rregullave dhe konform vendimit të Gjykatës. Është i detyruar edhe Kuvendi edhe çdo institucion në Kosovë, që të veprojnë konform vendimit të Gjykatës Kushtetuese", ka thënë Haliti. Por, Haliti nuk ka thënë nëse Presidenti duhet të japë dorëheqje pas këtij vendimi, por ka përmendur praktikën e gjashtë muajve më parë, me rastin e ish-Presidentit Fatmir Sejdiu. "Nuk është e rregulluar saktësisht procedura, por kemi pasur një praktikë jo shumë të largët se si ka funksionuar", ka thënë Haliti.

### **Nëse jo Pacolli, vepron Kuvendi**

Sipas kësaj praktike, Haliti thotë se Pacolli duhet të japë dorëheqje, ose përndryshe Kuvendi vepron dhe e shkarkon atë. "Unë e thash, s'mund ta detyroj askënd ta propozojë dorëheqjen, por në bazë të Kushtetutës nëse ai nuk paraqet dorëheqjen, atëherë Kuvendi duhet të ndërmarrë hapat e tij", është shprehur Haliti. Mirëpo, Gjykata Kushtetuese në vendimin e vet ka konstatuar se gjatë zgjedhjes së Pacollit në postin e Presidentit, janë shkelur procedurat, por nuk ka cituar nëse Pacolli duhet të japë dorëheqje ose jo. Mirëpo, Haliti thotë se vendimeve të Gjykatës Kushtetuese duhet t'i përbehen të gjithë, pasi nuk mund të bëhet ndonjë ankesë për vendimet e saj. "Shiko, në momentin që ne marrim vendimin është gjithçka e përfunduar, sepse është Gjykata Kushtetuese dhe nuk është ndonjë gjykatë për kundërvajtje që ka marrë ndonjë vendim që mund të ankimohet ndaj tij, ne s'mund të ankimojmë në vendimet e GJK-së", ka thënë Haliti. Ndërsa, nuk ka mundur të thotë një qëndrim të PDK-së karshi këtij vendimi, pasi ende nuk e kanë diskutuar në kryesinë e partisë.

## **Opozita prapë kundër**

Por, pavarësisht mundësisë që Gjykata ta kthejë çështjen në pikën zero, partitë opozitare janë shprehur kundër Pacollit nëse ai vendos të rikandidojë. Nënkryetari tjetër i Kuvendit, nga Lëvizja Vetëvendosje, Glauk Konjufca ka thënë për "Infopress", se ata edhe nëse kthehet çështja në pikën zero, do të veprojnë si në herën e parë dhe nuk do të rrinë brenda në seancë. "Lëvizja Vetëvendosje ashtu sikurse edhe herën e parë nuk e ka ndërmend që ta votojë Pacollin për President, madje as që do të jenë prezentë në seancë kur të bëhet ky votim. Ne që nga fillimi kemi deklaruar që zgjedhja e Presidentit, në mënyrën se si është bërë është jokushtetuese, megjithatë mirëpresim vendimin e gjykatës, por ne edhe nëse Pacolli rikandidohet edhe për një herë tjetër, ne nuk do ta votojmë atë, dhe as nuk do të jemi të pranishëm në seancë", ka thënë Konjufca. Por, edhe partia tjetër opozitare, AAK-ja nuk është shprehur e gatshme ta përkrahë Pacollin nëse ai rikandidon.

## **S'e njohin si President**

Madje nënkryetari i AAK-së, Ardian Gjini ka thënë se Pacolli duhet t'i kthejë mbrapsht të gjitha vendimet që ai i ka marre sa ishte duke ushtruar postin e Presidentit, për shkak se nuk janë valide, si pasojë e shkeljes së Kushtetutës gjatë zgjedhjes së tij. "Në momentin që Gjykata Kushtetuese thotë se zgjedhja e Presidentit ka qenë jokushtetuese, kjo nënkupton vetvetiu, se Kosova nuk ka president dhe se presidenti duhet të zgjidhet, dhe se të gjitha vendimet të cilat janë marrë nga presidenti duhet të shpallen invalide, sepse kemi të bëjmë me një proces jo të rregullt për zgjedhjen e Presidentit të Kosovës", ka thënë Gjini. Por sipas tij edhe nëse situata kthehet në pikën zero, atëherë, qëndrimet e AAK-së nuk do të ndryshojnë nga ato të mëparshmet. "Nëse prapë do të kthehem në pikën zero aty ku kemi qenë, qëndrimet e AAK-së nuk do të ndryshojnë, do të thotë se janë çështje parimore dhe nuk ndryshojnë dhe nuk kanë të bëjnë me një tempo apo me një afat kohor. Qëndrimet e tona mbasin ato që kanë qenë, shpresojmë që Kosova të mos sillet në pikën zero edhe njëherë ka thënë Gjini.

Gjykata Kushtetuese rrëzon presidentin e dytë

## Pacolli jokushtetues

**Gjykata Kushtetuese e cilësoi procedurën e zgjedhjes së presidentit Behgjet Pacolli si antikushtetuese, duke konstatuar shkeljen e nenit 86. Procedura pritet të kthehet në pikën zero, por nuk përjashtohet që vendi të hyjë në krizë politike, në rast se nuk ka marrëveshje ndërmjet pozitës dhe opozitës**

Mënyra e zgjedhjes së presidentit nga ana e Kuvendit është kundërshtuar nga institucioni më i lartë kushtetues. Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim negativ për mënyrën e zgjedhjes së tij në këtë post. Forcat politike të shumicës, por edhe ato të spektrit opozitar, iu kanë shmangur komenteve pas këtij vendimi, duke nënvizuar se ende nuk kanë në duar akt gjykimin. Të hënën Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka ardhur në përfundim se Kuvendi ka shkelur nenin 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës me rastin e zgjedhje së Presidentit të vendit, thuhet në njoftimin që ky institucion ia ka dërguar sot zyrtarisht administratës së Kuvendit. Te mërkurën Kushtetuesja do të dorëzojë tekstin e aktgjykimit në të cilin sqarohen në mënyrë të detajuar shkeljet në bazë të cilave edhe do të mund të përcaktohen veprimet që duhet të ndjekë forumi më i lartë politik i vendit. "Përmes kësaj shkrese ju informojmë që më 28 mars 2011 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka shqyrtuar dhe votuar lidhur me rastin KO29 / 11 "Sabri Hamitit deputetë të tjerë", vlerësim i Kushtetutshmërisë të vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr . 04. - V - 04, lidhur me zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës, të 22 shkurtit 2011", thuhet në shkresën e Gjykatës Kushtetuese. Më tutje bëhet e ditur se Gjykata Kushtetuese njëzëri vendosi që të shpallë Kërkesën të pranueshme dhe me shumicë votash, dhe me dy gjyqtarë mospajtues, shpall se Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 04.-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, të 22 shkurtit 2011, është jo kushtetues pasi që është në kundërshtim me kërkesat e nenit 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe parimet demokratike të mishëruara aty.

### Konfuzion në politikën kosovare

Në këtë komunikatë të Gjykatës Kushtetuese nuk saktësohet se a do të hyjë në procedurë të rivotimit edhe njëherë presidenti Pacolli apo duhet të zgjidhet një president i ri. Përkundër përpjekjeve gazeta nuk ka arritur të kontaktojë ndonjë nga zyrtarët e Presidencës. Ndërkohë që forcat politike mbesin të rezervuara në deklaratimet e tyre deri në marrjen e aktgjykimit ku të gjitha do të jenë të sqaruara. Në rast të nevojës së rivotimit, pak a shumë pozicionet e partive janë të parapërcaktuara edhe pse askush nuk e di qartë proceset që mund të pasojnë vendimin e Kushtetueses. Teksa AKR - ja nuk përjashton që me këtë vendim vendi të rrëshqet në krizë, PDK - ja thekson se në rast të një rivotimi do të mbështesin sërish kandidaturën e Pacollit . Por në këtë variant LDK - ja thekson se do të mbajnë sërish pozicion të njëjtë. Nënkryetari i AKR-së, Ibrahim Makolli, nuk deshi të komentojë vendimin e Kushtetueses, pasi ende nuk kanë marrë aktgjykimin për të cilën nuk përjashtoi që vendin mund ta çojë nga kriza. "Tash për tash nuk kemi kurrfarë qëndrimi, pasi nga mediet jemi njoftuar për vendimin. Do të shohim lidhur me veprimet e mëtutjeshme që do të ndjekim pas marrjes së aktgjykimit, pasi vendi po rrëshqet në krizë politike", ka thënë ai. I vetmi person që ka arritur të kontaktojë gazeta ka qenë një nga zyrtarët e lartë të PDK-se, Bajram Rexhepi, i cili nuk parasheh ndonjë krizë, pavarësisht vendimit të gjykatës, për të cilin tha se nuk mund të komentojë, duke qenë që ende nuk ka

arritur në duar të tij. Por, ai nuk parasheh prishje të koalicionit dhe se në rast se gjykata kërkon rivotim të presidentit, atëherë do ta mbështesin Pacollin. "Ne jemi në koalicion dhe nuk bëjmë lojëra politike. Nuk parashohë ndonjë krizë, tamam puna të hyjmë në kriza", ka thënë ai. Forca me e madhe opozitare, LDK - ja, pret që të marrë vendimin për të parë se çfarë do të kërkohej nga institucionet dhe mbi atë bazë do të formësojnë qëndrimin. Anëtari i Kryesisë së LDK - së, Kujtim Shala, tha se paraprakisht duhet parë se çfarë do të kërkohej, pasi deri më tani dihet se është shkelur procedura gjatë zgjedhjes së presidentit. "Tash për tash nuk mund të them asgjë lidhur me hapat që do t'i ndjekim. Në herën e parë nuk kemi marrë pjesë dhe kemi bërë të njohura arsyet. Nëse përsëritet e njëjta skemë, pozicioni ynë do të jetë i njëjtë. Pra nëse çështja e presidentit vazhdon të jetë çështje e partnerëve të koalicionit, ne s'do të jemi pjesë e atij procesi", ka thënë Shala.

### **Ankesa e iniciuar nga LDK-ja**

Lidhja Demokratike e Kosovës më 2 mars 2011 e dorëzoi në Gjykatën Kushtetuese lëndën në emër të 34 deputetëve, të cilët e kanë nënshkruar kërkesën me të cilën kontestohet procedura përmes së cilës ishte zgjedhur presidenti Pacolli. Ky vendim nuk ka të bëjë me Qeverinë e Kosovës, e cila më 22 shkurt është zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës dhe në anën tjetër kryeministri Hashim Thaçi nuk ka qenë i nominuar nga presidenti Behgjet Pacolli, por nga u.d të presidentit, Jakup Krasniqi. Më 22 shkurt, me 62 vota pro, katër kundër dhe një e pavlefshme, Behgjet Pacolli është zgjedhur president i Republikës së Kosovës, pas tri raundeve të votimit, në Kuvendin e Kosovës. Në sallën e votimit nuk ishin të pranishëm deputetët nga LDK-ja, 'Vetëvendosja' dhe AAK-ja, të cilët kanë shprehur kundërshtimin e tyre ndaj kandidaturës së Pacollit. Diskutabile mund të jenë dy dispozita të nenit 86, ku zgjedhja e presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Dhe nëse asnjëri kandidat e nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve, të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë, dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve zgjidhet president i Republikës së Kosovës.

I. K.

---

## **Kosova pa president**

---

**Zgjedhja e Behgjet Pacollit për president të vendit është bërë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe parimet demokratike të mishëruara në të është vendimi i Gjykatës Kushtetuese që me automatizëm e lë Kosovën pa president. Rrugëdalja nga situata e krijuar, është ende e paqartë**

### **Shkeljet e Kushtetutës**

Burime të gazetës brenda Presidencës së Kosovës, të cilat iu kanë referuar argumenteve të paraqitura nga trupi gjykues i Kushtetueses, kanë treguar se Gjykata Kushtetuese nuk ka asnjë sugjerim për Kuvendin e Kosovës sesi duhet të veprohet tutje. Gjithashtu nuk është dhënë ndonjë afat kohor se brenda sa kohe duhet të zgjidhet presidenti. Të njëjtat burime kanë treguar se në arsyetimin e Gjykatës nuk është përmendur fare termi "kuorum". Por është lënë të kuptohet se në procesin e votimit për zgjidhjen e presidentit të Kosovës medoemos duhet të jenë të pranishëm në salle 2/3 e deputetëve e që në rastin e zgjedhjes së Pacollit president nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm. Përveç kësaj Kushtetuesja thuhet të ketë gjetur edhe një shkelje tjetër atë të procedimit të raundit të tretë, i cili nuk është dashur të mbahej pasi që nuk ka pasur kundërkandidat, si dhe kuorum të mjaftueshëm. Në nenin 86 të Kushtetutës së Kosovës specifikohet se zgjedhja e të parit të shtetit duhet të bëhet me 2/3 e votave të gjithë deputetëve, gjë që nuk ka ndodhur me rastin e Pacollit. Në zgjedhjen e tij, kanë marrë pjesë vetëm 67 deputetë në të tri raundet e votimit. Pacolli ka arritur t'i marrë 62 vota vetëm në raundin e tretë të votimit, pas "presioneve" që lideri i PDK - së, Hashim Thaçi, thuhet t'u ketë bërë deputetëve të partisë së tij gjatë një "pauze të dhunshme", të mbajtur pas përfundimit të raundit të dytë të votimit. Në dy raundet e para, Pacolli kishte marrë vetëm 54, përkatësisht 58 vota. Dy nga figurat qendrore të PDK - së, Jakup Krasniqi dhe Fatmir Limaj, më vonë e kanë konfirmuar trysninë që Thaçi ua kishte bërë bashkëpartiakëve të tyre, për ta votuar Pacollin. Pacolli ishte zgjedhur edhe pa kundërkandidat, ndonëse me Kushtetutë parashihet gara mes kandidatëve për ta fituar postin e presidentit. "Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjidhet president i Republikës së Kosovës", thuhet në nenin 86, pika 5 e Kushtetutës.

### **Rrugëdalja, ende e paqartë**

Mungesa e kuorumit dhe e kundërkandidatëve gjatë procesit të zgjedhjes së presidentit, ishin marrë si argumente të mjaftueshme nga Lidhja Demokratike e Kosovës, për ta ngritur lëndën në Gjykatën Kushtetuese. Lënda e njohur si "Sabri Hamiti dhe deputetët e tjerë", ishte deponuar në Gjykatën Kushtetuese më 1 mars nga ish - këshilltarja e presidentit, Fatmir Sejdiu, tani deputete, Vjosa Osmani. Lënda e LDK - së, e cila ishte mbështetur edhe nga deputetët e AAK - së, nuk e ka përfshirë edhe argumentin e shkeljes që Pacolli kishte bërë pak minuta pas ishte zgjedhur president, duke marrë pjesë në votimin e kabinetit qeveritar. Dhe pikërisht këto

argumente të paraqitura nga dy partitë e sipërpërmendura kanë bërë që mënyra e zgjedhjes së presidentit të shpallet jokushtetuese nga gjykata. Në tashmë ish - partinë e Pacollit, AKR, kanë thënë se duhet ta presin vendimin e plotë të Kushtetueses për të dhënë përgjigje në këtë çështje. Ushtruesi i detyrës së kryetarit të AKR - së, Ibrahim Makolli, nuk ka pasur koment, meqë tha se në parti nuk e kanë parë arsyetimin mbi të cilin është marrë vendimi. Në anën tjetër, nga Partia Demokratike e Kosovës është thënë se do të priten zhvillimet e më tutjeshme, ndërsa nuk kanë parë arsye për shqetësim rreth mundësisë që vendimi i Kushtetueses të ndikojë në koalicionin qeverisës. "Nuk besoj që vendimi i Gjykatës Kushtetuese mund ta destabilizojë koalicionin qeverisës. Megjithatë presim zhvillimet e reja konsekuente dhe vendimin që do ta marrë Kuvendi i Kosovës. Vetëm atëherë mund të saktësohen qëndrimet tona të ardhshme", ka thënë Blerand Stavileci nga PDK - ja, që është edhe ministër i Bujqësisë në Qeverinë e re. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i është përcjellë të hënën edhe Kuvendit të Kosovës. Sekretari i këtij institucioni, Ismet Krasniqi, është shprehur se ky institucion duhet ta presë aktgjykimin e plotë të Gjykatës për të kuptuar sesi do të procedohet tutje pas vendimit të Kushtetueses. "Kuvendi i Kosovës ka pranuar njoftimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila duhet të na tregojë se ku është bërë shkelja dhe të na sugjerojë neve si të procedojmë tutje", ka deklaruar Krasniqi. Legjislativi i Kuvendit nuk pritet të marrë ndonjë vendim rreth kësaj çështjeje deri pas kthimit të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, i cili ka udhëtuar të hënën për një vizitë zyrtare në Hungari. "Kryesia duhet të mbledhet dhe të diskutojë për këtë çështje, por kryetari i Kuvendit nuk është këtu dhe ai kthehet nga udhëtimi zyrtar më 31 mars", është shprehur Krasniqi.

### **Opozita, sërish bojkot Pacollit nëse rikandidohet?**

Partitë opozitare të cilat e kanë dërguar në Kushtetuese këtë çështje e kanë mirëpritur vendimin e këtij institucioni. Deputetja e LDK - së, Vjosa Osmani, është shprehur se "vendimi i Gjykatës Kushtetuese tregon se argumentet të cilat i kemi dërguar kanë qenë të qëndrueshme". "Por kjo çështje edhe më tutje është në dorën e Gjykatës Kushtetuese se ajo duhet të sugjerojë sesi do të procedohet tutje që të kemi një president të zgjedhur sipas normave kushtetuese", ka thënë Osmani. Ajo ka shtuar se LDK - ja ende nuk ka vendosur nëse do të marrë pjesë në seancën e zgjedhjes së presidentit nëse Behgjet Pacolli do të rikandidohet për këtë post. "Nuk e di, sepse kjo çështje nuk është diskutuar ende në parti, por supozoj që nëse shkohet në rivotim gjithsesi duhet të jenë dy të tretat në sallë si kuorum, se përndryshe zgjedhja e presidentit është e pamundshme", ka theksuar Osmani. Vendimi i Kushtetueses është përshëndetur edhe nga AAK - ja. Shefi i Grupit parlamentar të këtij grupi, Ardian Gjini, e ka vlerësuar të drejtë vendimin e Gjykatës Kushtetuese. "Është vendim i drejtë. AAK - ja kur e ka nënshkruar petitionin ka besuar se ajo zgjedhje nuk është konform Kushtetutës dhe jemi të bindur se Gjykata Kushtetuese e ka kryer punën në mënyrë të pavarur", ka thënë Gjini. Duke e komentuar vendimin e këtij institucioni ai ka shtuar se "një përkthim i asaj që ka thënë Kushtetuesja është se Kosova nuk ka pasur fare president, kjo do të thotë që të gjitha vendimet që i ka marrë ai duhet të shpallen të pavlefshme dhe Kosova duhet ta zgjedhë presidentin", tha Gjini. Ai ka thënë se AAK - ja nuk do ta ndryshojë qëndrimin e saj nëse Pacolli do të rikandidohet për ta marrë postin e presidentit të cilin e mbajti një muaj e një javë. "AAK - ja nuk e ka ndryshuar asnjë qëndrim lidhur me këtë çështje", është përgjigjur Gjini.



## **Zgjedhja e presidentit - nga pika zero**

Shumica e ekspertëve të fushës nuk kanë dëshiruar të analizojnë vendimin pa e parë aktgjykimin e plotë, i cili, sipas burimeve të gazetës, pritet të bëhet publik të mërkurën. Megjithatë, një ekspert i së drejtës kushtetuese, që ka kërkuar të mbetet anonim, ka vlerësuar se pas vendimit të Kushtetueses çështja e zgjedhjes së presidentit duhet të kthehet në pikën zero. Sipas tij, zgjedhja e presidentit do të mbetet problem i madh nëse Behgjet Pacolli do të rikandidohet për këtë post dhe mbetet kandidati i vetëm. "Është proces që duhet të nisë nga fillimi. Do të ketë shumë telashe nëse Pacolli do të jetë prapë kandidati i vetëm, sepse partitë opozitare sërish do ta lëshojnë seancën dhe ngjashëm nuk do të ketë kuorum të mjaftueshëm për ta proceduar zgjedhjen e presidentit. Do të krijohet një situatë e rëndë në këtë drejtim që lë të hapur mundësinë edhe për koalicione të reja apo edhe kërkim për votëbesim të Qeverisë. Duke pasur parasysh se Pacolli kërkon me ngulm që ai të rimarrë postin e presidentit", ka vlerësuar profesori i së drejtës kushtetuese, i cili ka preferuar që mos ti përmendet emri. Sipas tij, "duke iu referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, del se Behgjet Pacolli nuk ka qenë president fare". Gjykata Kushtetuese është institucioni më i lartë juridik i vendit që brenda më pak se një viti mori dy vendime për dy përfaqësuesit më të lartë të shtetit, Fatmir Sejdiun, për të cilin pati vlerësuar se ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës duke ushtruar dy poste, atë të partisë dhe postin e presidentit të vendit, si dhe këtë të fundit për Pacollin.

---

## **Përse u ngut Shqipëria me Pacollin**

---

**Kjo nuk turpëron Pacollin, pasi ai nuk ka shkelur vetë Kushtetutën. Ai ka detyruar politikën e Kosovës të shkelë Kushtetutën për të, dhe politikën zyrtare të Shqipërisë ta noterizoj këtë shkelje**

Mero Baze - Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka vendosur njëzëri të shpallë se Vendimi i Kuvendit të Kosovës, nr. 04 - V - 04, lidhur me zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës më 22 shkurt, 2011, është jokushtetues". Sipas vendimit të gjykatës, "zgjedhja është në kundërshtim me kërkesat e nenit 86 të Kushtetutës së Republikës Kosovës dhe parimet demokratike të mishëruara aty". E thënë shqip, Behgjet Pacolli nuk është më president i Kosovës. Gafat në zgjedhjen e tij janë në dukje procedurale, por në thelb janë politike. Presidenti është zgjedhur duke injoruar Kushtetutën e miratuar në vitin 2008, dhe është tentuar të imitohet zgjedhja përmes Kornizës Kushtetuese e cila nuk kërkon një kourum me dy të tretat e Kuvendit. Kjo ka qenë e vetëdijshme. E vetëdijshme ka qenë po ashtu kalimi tri herë në votim i procedurës së zgjedhjes, ndërkohë Pacolli ishte kandidat i vetëm. I përmenda këto jo aq për të komentuar vendimin e Gjykatës, sa për të shprehur shqetësimin për nxitimin e Tiranës zyrtare për të legjitimuar një president antikushtetues. Fryma politike që dominon Prishtinën, është dukshëm një epidemi e çuar aty nga Tirana. Sjelljet politike janë thuajse njësoj, dhe tentimi për të dhunuar Kushtetutën është po njësoj. Ndryshimi qëndron te gjyqësori. Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka rrëzuar dy presidentë në gjashtë muaj, dhe askush nuk ka vënë në dyshim vendimet e saj. Sali Berisha ka hedhur në kosh të plehrave plot 28 vendime të Gjykatës Kushtetuese qysh kur ka ardhur në pushtet. Por rasti më flagrant ishte mënyra sesi u sollën me ligjshmërinë e presidentit të Kosovës. Ndërkohë që opozita me bllok e çoi çështjen në Gjykatë Kushtetuese, Pacolli nisi emisarët e tij në Tiranë për të legjitimuar zgjedhjen diskutueshme. Edhe pse ai u prit formalisht sipas protokollit nga presidenti Topi, kryeministri Berisha dhe kryebashkiaku Rama, detyrimin për të realizuar vizitën e ka protokollit i shtetit, që varet nga qeveria. Në këtë rast ky institucion është përdorur politikisht në funksion të mbulimit të një shkeljeje të rëndë kushtetuese. Tirana zyrtare, u përdor si gjethe fiku për të mbuluar lakuriqësinë antikushtetuese të zgjedhjes së tij. Një tufë biznesmenësh dhe argatësh të Pacollit u lëshuan në Tiranë për të zbuluar vizitën nga populli i Kosovës. Ishte përveç turpit dhe një përprjekje e ulët për të eksportuar në Kosovë mungesën e respektit që ne kemi për Gjykatën Kushtetuese dhe ligjin në përgjithësi. Por ajo që është bërë me sukses duke eksportuar këtë virus te klasa politike në Kosovë, për fat nuk ka ndodhur me gjyqësorin. E pata theksuar në ditët që Pacolli po tentonte të përdorte Shqipërinë para se të zgjidhej, se në Kosovë nuk duhet të na e marrin për ters që Meidani apo ndonjë këshilltar i tij flasin në emër të Shqipërisë për të legjitimuar Pacollin si njeri që vlen për president. Por ajo që bëri Meidani dhe ndihmësit e tij, nuk ishte asgjë jolegjitime. Ishte thjesht lobizëm që presidentët në pension e bëjnë dhe për ndonjë çek. Ajo që bëri Tirana zyrtare më pas ishte e turpshme, pasi ajo injoroi një çështje që ishte në Gjykatë Kushtetuese dhe i shtruan qilimin e kuq një njeriu që nuk është shkarkuar me turp. Kjo nuk turpëron Pacollin, pasi ai nuk ka shkelur vetë Kushtetutën. Ai ka detyruar politikën e Kosovës të shkelë Kushtetutën për të, dhe politikën zyrtare të Shqipërisë ta noterizojë këtë shkelje. Falë Gjykatës Kushtetutës të Kosovës ne kemi sot një rikthim në

normalitet demokratik dhe një shije të hidhur nga përpjekjet e Tiranës zyrtare për të forcuar paternalizmin si mënyrë për të noterizuar paligjshmërinë në shtetin e ri.

---

## **Bajrami: Rënia e Pacollit kërcënon Qeverinë, me të edhe dialogun**

---

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, sipas të cilit zgjedhja e Behgjet Pacollit ka qenë jokushtetuese, mund të ndikojë në stabilitetin e Qeverisë së Kosovës, e me këtë edhe në procesin e dialogut mes Kosovës e Serbisë, të nisur në Bruksel. Kështu ka thënë Agron Bajrami, kryeredaktor i "Kohës Ditore", në një deklaram për gazetën "Danas", në të cilin ka theksuar se "rrezimi" i Pacollit nga Gjykata Kushtetuese ka mundësi të shkaktojë edhe destabilizimin e koalicionit qeverisës të tubuar rreth Hashim Thaçit. "Pacolli ka hyrë në koalicion me Thaçin me kushtin që të jetë president, andaj edhe mund të pritet që partia e tij të dalë nga koalicioni nëse Pacolli nuk arrin ta ruajë këtë pozicion, dhe kjo do ta vinte në pikëpyetje edhe Qeverinë, dhe, me këtë, edhe dialogun me Serbinë. Rrugëdalja e mundshme është në rizgjedhjen e Behgjet Pacollit, një gjë që teorikisht është e mundur, meqë ai ka të drejtë të kandidohet", ka thënë Bajrami për "Danas", duke shpjeguar se sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese shkelja nuk është bërë nga Pacolli, por nga Parlamenti. Por, sipas Bajramit, kjo mundësi nuk ka shumë gjasa, sepse sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese gjatë zgjedhjes së presidentit duhet të jenë të pranishëm dy të tretat e deputetëve. "Thaçi e Pacolli nuk mund ta sigurojnë këtë pa opozitën, e cila mundet që, sikur edhe herën e kaluar, të bojkotoje seancën. Por, nëse Thaçi do të arrinte të rizgjedhë Pacollin, dialogu do të mund të vazhdonte pa asnjë ndërprerje", ka thënë Bajrami. Kryeredaktori i "Kohës Ditore" 33 ka përmendur për "Danas" edhe një mundësi tjetër, sipas së cilës kryeministri Thaçi do të mund të gjente një tjetër partner për Qeverinë në vend të Pacollit, për shembull AAK - në e Ramush Haradinajt. "Në atë rast dialogu do të mund të vazhdohej, ndoshta me një ndërprerje, e cila zyrtarisht ndoshta edhe nuk do të bëhej publike. Varianti i tretë është të hyjmë në një krizë të re, prej së cilës dalja do të ishte në zgjedhjet e parakohshme, gjë që definitivisht do të thoshte edhe ndërprerje të dialogut në Bruksel", ka thënë Bajrami. "Problemi qëndron në faktin se Qeveria e Kosovës po bën bisedime me Serbinë pa konsensus parlamentar e shoqëror, dhe sa më jostabile dhe e lëndueshme të jetë Qeveria, aq me të mëdha janë gjasat që dialogu të kërcënohet dhe, në instancën e fundit, të ndërpritet". Bajrami më tutje ka thënë se është e qartë që Kosova shumë shpejt duhet të zgjedhë një president të ri, dhe nëse kjo nuk do të ndodhë është e mundur që rrugëdalja të kërkohet në zgjedhje të reja. "Por, pa reformë të sistemit zgjedhor vështirë se do të mund të arrinim deri te një rezultat më kualitativ dhe një situatë më të shëndoshë politike", ka konkluduar Agron Bajrami.

---

## **BE-ja respekton vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës**

---

**Bashkimi Evropian është shprehur se e respekton vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, se do ta studiojë në hollësi atë dhe thërret të gjithë aktorët në Kosovë të jenë konstruktivë dhe të veprojnë në bazë të ligjeve dhe procedurave në fuqi**

BRUKSEL, 29 MARS - Vetëm një muaj pasi kishin përshëndetur zgjedhjen e Behgjet Pacollit për kryetar të Kosovës, këtë të martë në selinë e BE - së thanë po ashtu se respektojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës sipas së cilës zgjedhja e Pacollit ishte në kundërshtim me Kushtetutën e vendit. "Ne presim që të gjitha palët të punojnë drejt një zgjidhje konstruktive dhe në bazë të procedurave përkatëse të brendshme" thuhet në një komunikatë të përbashkët të lëshuar nga Përfaqësuesja e Lartë Catherine Ashton dhe Komisioneri për Zgjerim dhe Fqinjësi Evropiane, Stefan Füle. Në Konferencën për shtyp në selinë e Komisionit Evropian zëdhënësja e Baroneshes Ashton, Maja Kocijancic, tha se BE -ja do të studiojë hollësitë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. E pyetur nga gazetarët pse BE - ja kishte përshëndetur zgjedhjen e Pacollit kur që atëherë kishte shumë njoftime se ajo zgjedhje ishte ilegale, Kocijancic tha se "kemi përshëndetur por po ashtu kemi thënë se jemi në dijeni për raporte rreth parregullsive dhe organet përkatëse duhet të kryejnë punën e tyre". Në disa pyetje të njëpasnjëshme se a ka mbështetur BE - ja idenë që me çdo kusht në Kosovë, pa marrë parasysh se a është legale apo jo, demokratike apo jo, të zgjidhen institucionet, presidenti dhe Qeveria, vetëm për të nisur sa më shpejt dialogu me Serbinë, Kocijancic tha se "dialogu ishte përgatitur edhe ashtu me muaj të tërë më parë dhe se BE - ja vazhdon ta konsiderojë demokracinë dhe sundimin e ligjit si vlerë themelore". Në pyetjet se a do të ndikojë kjo situatë e krijuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, zëdhënësja e Përfaqësueses së Lartë ka thënë se "Interlokutor në dialog është Qeveria e Kosovës, ajo qeveri ka emruar shëfën e delegacionit dhe ky dialog tashmë po jep rezultatet e para, prandaj nuk pritët që vendimi rreth zgjedhjes së presidentit të ndërhyjë në procesin e dialogut". Në BE disa diplomatë privatisht kanë shprehur shqetësim për faktin se me këtë vendim Kosova përsëri po dëshmohej si një shtet ku ka aq shumë shkelje dhe që duket sikur të mos jetë shtet serioz. Por disa kanë thënë se së paku duket se Gjykata Kushtetuese është profesionale dhe po vepron pa presione politike. Por shumë diplomatë privatisht kanë pranuar se edhe BE ja edhe të tjerët nga bashkësia ndërkombëtare duhet të jenë më të kujdesshëm kur mbajnë qëndrime për zhvillimet në Kosovë. "I kuptojmë shqetësimet që dëgjohen se nganjëherë bashkësia ndërkombëtare, për interesa të politikës së momentit, nuk insiston në vlerat më të larta demokratike në Kosovë dhe i sakrifikon ato, por nuk duhet të ndihmojmë në krijimin e një imazhi të tillë, sepse Kosova është në Evropë dhe duam të ndihmojmë demokratizimin e saj", ka thënë një diplomat i BE - së.

---

## Dikush e shkeli

---

**Gjykata Kushtetuese e shpalli jo kushtetuese zgjedhjen e kryetarit të Kosovës Behgjet Pacolli. Ende nuk tregoi se kush e shkeli Kushtetutën dhe cilat do të jenë pasojat, apo ata do të ndalen te rizgjedhja e kryetarit.**

"Gjykata Kushtetuese, njëzëri vendosi që të shpallë kërkesën të pranueshme dhe me shumicë votash, dhe me dy gjyqtarë mospajtues, shpall se vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04 - V - 04, lidhur me zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës, më 22 shkurt 2011, është jokushtetues pasi që është në kundërshtim me kërkesat e Nenit 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe parimet demokratike të mishëruara aty", thuhet në një kumtesë të lëshuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Ende mbetet e paqartë se cili do të jetë fati i institucioneve të Kosovës, pasi që gjykata ende nuk e ka lëshuar aktgjykimin e plotë në të cilën do të përshkruheshin shkeljet konkrete dhe rekomandimet se si të veprohet më tutje.

### Presidenca gojëbyllur

Palëve në procedurë, sipas komunikatës së GJKK - së, vendimi i plotë do t'u dërgohet brenda dy ditëve, ndërsa në ditën e kumtimit të këtij vendimi, zyrtarët e Presidencës kanë qëndruar gojëbyllur. Me gjithë përpjekjet e gazetës për orë të tëra, nuk janë lajmëruar në telefon, për të dhënë një opinion qoftë edhe subjektiv, rreth zhvillimeve të mëtejshme. Se a do të shkohet në rivotim presidenti, apo në zgjedhje të parakohshme gjithë institucionet, për këtë çështje nuk kanë mundur të flasin as analistët. I rezervuar në këtë çështje është edhe njëri nga përpiluesit e organit më të lartë juridik, profesori Riza Smaka. "Në këtë rast jam i hendikepuar pjesërisht ngase nuk e di nëse gjykata ka konstatuar se gjatë zgjedhjes së presidentit ka pasur shkelje të rëndë të Kushtetutës apo shkelje e rëndomtë të saj", ka thënë Smaka, pa dhënë sqarime se cili është dallimi ndërmjet të parës dhe së dytës. Duke paragjykuar detajet e aktgjykimit, Smaka thotë se në qoftë se është vërtetuar se Kuvendi ka bërë shkelje gjatë zgjedhjes së presidentit, atëherë një kuvend i tillë nuk mund të votojë edhe njëherë një president. "Presidenti ka qenë palë në procedurë. Në qoftë se supozojmë se vendimi i Gjykatës ka të bëjë me atë se ka pasur shkelje nga ana e Kuvendit atëherë automatikisht kuvendi duhet të shpartallohet dhe me shpërbërjen e Kuvendit bie edhe qeveria", ka thënë Smaka, sipas të cilit, Pacolli llogaritet president deri në përfundim të tërësishëm të procedurës. Vendimi i Kushtetueses, sipas tij, mund të jetë i apelueshëm dhe në të njëjtën kohë mund t'i udhëzojë institucionet se si të veprojnë më tutje.

### Gëzohet opozita

Pavarësisht paqartësive, opozita i është gëzuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila ka rezultuar pas ankesës së LDK - së të regjistruar në GJK si lënda KO 29/1, "Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë". "Sot për sot nuk kam ndonjë koment të veçantë. E kemi marrë njoftimin për vendimin që ka marrë gjykata, të cilin unë besoj se e kanë bërë publik ndërsa presim aktgjykimin për ta parë saktësisht se çfarë kanë vendosur. Ajo, sipas tyre, pritet që të ndodhë pas dy ditësh dhe atëherë mund të bisedojmë më gjatë. Kërkesa jonë ka qenë e drejtë ashiqare edhe kemi marrë një gjykim pozitiv", është shprehur Sabri Hamiti, nënkryetar i LDK – së. Edhe ata që e kanë nënshkruar nismën e LDK - së për vlerësimin e kushtetutshmërisë së zgjedhjes

së presidentit, deputetët e AAK - së janë jo më pak të kënaqur nga vendimi. "Na vjen mirë që gjykata ka marrë vendim të shpejtë dhe të saktë. Ajo që ne e vlerësojmë nga ky vendim është se Kosova nuk ka pasur president që prej asaj dite në aspektin kushtetues dhe të gjitha vendimet të cilat eventualisht i ka marrë Pacolli në emër të presidentit të Kosovës duhet të shpallen të papranueshme dhe Kosova duhet të zgjedhë presidentin e ri", ka pohuar Ardian Gjini, shef i Grupit parlamentar të AAK - së. Deputeti i lëvizjes "Vetëvendosje", Glauk Konjufca, nga ana tjetër e vlerëson vendimin e drejtë ngase shton se ky vendim e dëshmon atë që lëvizja e ka thënë më herët, se presidenti është zgjedhur në mënyrë të pa ligjshme. "Ende nuk i dimë me saktësi pasojat legale dhe politike që do të ketë vendimi, ndërkaq gjykata nuk e ka dhënë ndonjë rekomandim se do të shkohet në rivotim ose jo, për procedurat e mëtejme të kuvendit apo diçka më e thellë. Presim ta marrim edhe fizikisht dokumentin dhe ta vlerësojmë më tutje", ka thënë Konjufca. Më 22 mars, pas tri raundesh të votimit, Behgjet Pacolli me 62 vota për, 4 kundër dhe një të përmbajtur është zgjedhur presidenti i Kosovës. "Në këtë rast jam i hendikepuar pjesërisht ngase nuk e di nëse gjykata ka konstatuar se gjatë zgjedhjes së presidentit ka pasur shkelje të rëndë të Kushtetutës apo shkelje e rëndomtë të saj ", ka thënë Smaka.

---

## **Vllasi: Pacolli duhet të tërhiqet menjëherë**

---

PRISHTINË, 29 MARS (FONET) - Duke vepruar sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Behgjet Pacolli duhet që menjëherë të lëshojë postin e presidentit të Kosovës, sepse në të kundërtën pasojat do të mund të ishin edhe rënia e Qeverisë së Kosovës dhe ndërprerja e dialogut me Beogradin, ka thënë për Radio KIM avokati prishtinas Azem Vllasi. Duke interpretuar vendimin Gjykatës Kushtetuese, sipas së cilës zgjedhja e Pacollit për president ka qenë jokushtetuese, Vllasi ka thënë se Kuvendi i Kosovës menjëherë duhet të shkojë drejt zgjedhjes së presidentit të ri. Kandidat mund të jetë sërish Pacolli, ka thënë Vllasi, duke shtuar se vendimi i Gjykatës Kushtetuese duhet të zgjidhet në mënyrë konstruktive, sepse në të kundërtën Kosova rrezikon në futet në krizë institucionale. "Behgjet Pacolli, nëse nuk dëshiron të kandidohet sërish për president, mund të marrë vendim për tërheqje nga koalicioni qeverisës me Thaçin, gjë që si pasojë mund të ketë rënien e Qeverisë, sikur që ishte rasti vjeshtë e kaluar", tha Vllasi. Sipas tij, gjithçka mund të përfundojë në mënyrë shumë më të thjeshtë, dhe kjo është që të shkohet drejt zgjedhjes së kandidatit të njëjtë për president. Vllasi ka shtuar se Pacolli duhet që menjëherë, duke vepruar sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, të tërhiqet nga posti i presidentit dhe që atë detyrë t'ia dorëzojë kryetarit të Kuvendit të Kosovës deri në zgjedhjen përfundimtare. Vllasi tha edhe se rënia e Qeverisë do të shkaktonte edhe ndërprerjen e bisedimeve me Beogradin, sepse palën kosovare në dialog e përfaqëson nënkryetarja e Qeverisë. Por, ai vlerësoi se prej këtyre bisedimeve edhe ashtu nuk ka gjë, sepse në dialog është hyrë me nguti.



---

## **Pacolli obligohet ta lirojë Presidencën**

---

**Kryeparlamentari, Jakup Krasniqi, pritet t'i rimarrë përgjegjësit e ushtruesit të detyrës së presidentit, mesditën e së mërkurës. Në atë kohë Behgjet Pacollit, edhe zyrtarisht, do t'i kumtohet aktgjykimi i "gardianit" të Kushtetutës, se zgjedhja e tij në krye të shtetit nuk është bërë në harmoni me aktin më të lartë juridik të vendit. Pas kësaj, atij s'i mbetet tjetër, pos që ta lirojë zyrën e presidentit dhe ta dorëzoj çelësin e thesarit të shtetit.**

### **Kahja e zhvillimeve të reja**

Një njohës i çështjeve juridike dhe kushtetuese ka thënë se kahja e zhvillimeve të ardhshme, në masë të madhe do të varet nga formulimi i aktgjykimit të Kushtetueses. Sipas tij, Gjykata i ka dy mundësi: të japë ndonjë rekomandim për Kuvendin se çka duhet bërë tutje, por edhe të mos e bëjë këtë gjë, dhe vetëm ta konstatojë shkeljen që është bërë me rastin e zgjedhjes së presidentit. "Rasti i parë do të ishte më i favorshëm për Kuvendin, për shkak se do të dihej se çka duhet bërë, kurse rasti i dytë mund të linte prapë hapësira për interpretime të ndryshme, sesi duhet proceduar çështja e zgjedhjes së presidentit", është shprehur ky jurist. Për bindjen e tij, në rast se Gjykata nuk jep rekomandime, Kuvendi nuk ka nevojë që ta thërrasë ndonjë seancë të re për rivotim të presidentit. "Në një situatë të tillë, kryeministri Thaçi, pas konsultave me partnerët e koalicionit, do të duhej t'i bënte kërkesë u.d të presidentit, për thirrjen e një seance, me të vetmen pikë të rendit të ditës: zgjedhjen e presidentit", ka thënë ai. Por, burime të gazetës brenda Presidencës së Kosovës, duke iu referuar argumenteve të paraqitura nga trupi gjykues i Kushtetueses, një ditë më herët, kanë treguar se Gjykata Kushtetuese nuk ka asnjë sugjerim për Kuvendin e Kosovës sesi duhet vepruar tutje. Gjithashtu nuk është dhënë ndonjë afat kohor se brenda sa kohe duhet të zgjidhet presidenti. Të njëjtat burime kanë treguar se në arsyetimin e Gjykatës nuk është përmendur fare termi "kuorum". Por është lënë të kuptohet se në procesin e votimit për zgjedhjen e presidentit të Kosovës medoemos duhet të jenë të pranishëm në sallë 2/3 e deputetëve e që në rastin e zgjedhjes së Pacollit president nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm. Të martën është mbajtur mbledhja e Kryesisë së Kuvendi, por askush nuk e ka vënë në gojë faktin se vendi ka mbetur pa president. Mbledhja e organit drejtues të Kuvendit është drejtuar nga nënkryetari Xhavit Haliti, mirëpo ai nuk i ka dhënë vetes të drejtë që ta interpretojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Nuk ka qenë në gjendje të saktësoje nëse Kosova ka president, nga e hëna, e as të japë shpjegime konkrete sesi duhet vepruar tash e tutje Kuvendi për të kthyer kushtetutshmërinë e shkelur me 22 shkurt. "Kuvendi do të procedoj konform rregullave dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Ky është obligim ka thënë ai. Por, gjërat, sipas tij do të qartësohen tek pasi administrata dhe Kryesia e Kuvendit do ta marrin zyrtarisht aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese. Haliti, megjithatë, e ka bërë një ndërlikim mes rastit Pacolli dhe rastit Sejdiu. "Nuk është e rregulluar saktësisht procedura, por ne e kemi pasur një praktikë jo shumë të largët sesi ka funksionuar. Unë po them sinqerisht nuk i di rrjedhat e sotme dhe nuk kam ndonjë informacion për qëndrimin e presidentit Pacolli, por vendimi i Gjykatës Kushtetuese është obligim për të gjithë", ka deklaruar ai. "Unë s'mund ta detyroj askënd që të paraqesë dorëheqje, por në bazë të Kushtetutës nëse ai nuk paraqet dorëheqjen, atëherë Kuvendi duhet t'i ndërmarrë hapat e tij", ka thënë Haliti. Vendimet e Kushtetueses,

sipas tij, nuk janë vendime për kundër vajtje, por janë vendime që nuk lënë hapësirë për asnjë lloj ankimi.

### **Pacolli në rikandidim**

Shefi i Grupit parlamentar i Koalicionit Kosova e Re, Ibrahim Makolli, ka parapëlqyer të rezervohet në dhënien e shpjegimeve sesi do të rrjedhin gjërat gjatë ditëve në vijim, ndonëse nuk e ka përjashtuar mundësinë që Pacolli të rikandidohet sërish për president shteti. "Ne nuk kemi asnjë arsye që të mos e rikandidojmë Behgjet Pacollin për president, Pacolli nuk ka bërë asnjë lloj shkeljeje, përkundrazi ai e ka marrë pozitën e presidentit me vendim të Kuvendit. Pse Kuvendi ka bërë shkelje, kjo është një çështje që duhet diskutuar", ka thënë Makolli. Shefi i AKR - së e ka cilësuar interpretimin e Kushtetueses si logjikë dhe politik por jo edhe juridik. Ai ka rikujtuar se mes KKR-së dhe PDK-së ekziston një marrëveshje, përmes së cilës Pacollit i garantohet posti i presidentit. Prandaj ne presim nga kryetari i PDK - së, Hashim Thaçi, që ta përmbushë marrëveshjen", ka shtuar Makolli. Në fakt, Thaçi ka qenë ai që ia ka siguruar Pacollit postin e presidentit, përmes trysnisë që ka bërë mbi deputetët e PDK - së. Lideri i PDK - së e pati tërhequr grupin e vet parlamentar në pauzë pas raundit të dytë të votimit, pa vullnetin e Krasniqit, dhe aty u kishte thënë deputetëve se "vota për Pacollin, është votë që ua garanton edhe mandatin e tyre". Bile, burime të gazetës brenda PDK - së patën konfirmuar se për pak minuta Thaçi kishte kërcënuar edhe me dorëheqje nga posti i kryetarit të partisë. Presidenca ka dy ditë që është mbyllur për media. Askush nuk ka dashur të flasë për vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Për shefin e Grupit parlamentar të AAK - së, Ardian Gjini, Kosova faktikisht nuk ka president. "Në momentin që Gjykata Kushtetuese thotë se zgjedhja e presidentit ka qenë jokushtetuese kjo nënkupton vetvetiu se Kosova nuk ka president dhe se presidenti duhet të zgjidhet", ka thënë ai. Gjini ka shkuar edhe më larg duke i shpallur të gjitha vendimet që mund t'i ketë marrë Pacolli si të pavlefshme. Të gjitha vendimet të cilat janë marrë nga presidenti duhet të shpallen invalide, sepse kemi të bëjmë me një proces jo të rregullt për zgjedhjen e presidentit të Kosovës", ka deklaruar ai. Mirëpo, me këtë konstatim nuk është pajtuar eksperti për çështje kushtetuese. "Pacolli nuk ardhur me dhunë në atë post, në mënyrë që pasuesi i tij t'ia hedhë poshtë vendimet që i ka marrë", ka thënë juristi, që nuk ka dashur t'i përmendet emri. Për dallim nga Haliti, Gjini ka thënë se Kuvendi tash i ka dy opsione për ta zgjidhur çështjen e zgjedhjes së presidentit. Pacolli ka dhënë betimin për president më 22 shkurt, në prani të 67 deputetëve. Në këtë post kishte ardhur kundërkandidat, ndonëse me Kushtetutë parashihet të jenë së paku dy rivalë. "Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve, të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjidhet president i Republikës së Kosovës", thuhet në nenin 86, pika 5 e Kushtetutës. Mungesa e kuorumit dhe e kundërkandidatëve gjatë procesit të zgjedhjes së presidentit ishin marrë si argumente të mjaftueshme nga Lidhja Demokratike e Kosovës, për ta ngritur lëndën në Gjykatën Kushtetuese. Lënda e njohur si "Sabri Hamiti dhe deputetët e tjerë" ishte deponuar në Gjykatën Kushtetuese më 1 mars nga ish këshilltarja e presidentit, Fatmir Sejdiu, tani deputete, Vjosa Osmani. Lënda e LDK - së, e cila ishte mbështetur edhe nga deputetët e AAK - së, nuk e ka përfshirë edhe argumentin e shkeljes që Pacolli kishte bërë pak minuta pasi ishte zgjedhur president, duke marrë pjesë në votimin e kabinetit qeveritar.

---

## Mungesa e presidentit nuk e ndal dialogun

---

**Qeveria e Kosovës nuk e ka ndërmend të ndalë dialogun me Serbinë, edhe pse Kosova nuk ka president. Javën tjetër, përfaqësues të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, ekspertë të EULEX - it dhe përfaqësues të autoritetit të regjistrave civile në Serbi, do të takohen në Bruksel për t'u marrë vesh rreth regjistrave civile**

PRISHTINË, 30 MARS - Qeveria e Kosovës nuk e ka ndërmend të ndalë dialogun me Serbinë, edhe pse Kosova nuk ka president. Javën tjetër, përfaqësues të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, ekspertë të EULEX - it dhe përfaqësues të autoritetit të regjistrave civile në Serbi do të takohen në Bruksel për t'u marrë vesh rreth regjistrave civilë. Aty nuk do të shkojnë as Edita Tahiri e as Borko Stefanoviq. Takimi do të jetë i nivelit teknik. Grupi i ekspertëve do të quhet Komiteti për verifikimin e regjistrave civilë. Burime të gazetës në Bruksel kanë shpjeguar se ekspertët serbë, me vete do të sjellin edhe regjistrat civilë që Serbia i ka rrëmbyer nga Kosova, në kohën kur ushtria dhe policia serbe po tërhiqeshin nga vendi, në vitin 1999. Kosova nuk do të marrë origjinalin e dokumenteve. Ekspertët, sidomos ata të EULEX - it, do të ndihmojnë në verifikimin e kopjeve që do të sjellë Serbia. Nëse ato dalin si të qëndrueshme, do të çertifikohen. Burimet kanë specifikuar, se takimi nuk do të mund të mbahet këtë javë, por se janë duke u bërë të gjitha përpjekjet që ai të ndodhë javën tjetër. Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, pas mbledhjes së Qeverisë, i është shmangur komentimit të origjinalitetit të regjistrave civilë, por ka rikonfirmuar se dialogu me Serbinë do të vazhdojë, me gjithë mungesën e presidentit. "Kosova duhet të vazhdojë rrugën e vet të suksesit me gjithë zhvillimet e brendshme. Ne do të jemi në rrugëtim, çfarëdo rasti që mund të kemi, nuk guxojmë të kemi trandje në kuptimin e obligimit që kemi përballë qytetarëve, por edhe përballë pritjeve të partnerëve tanë ndërkombëtarë. Ne do t'i kryejmë punët tona dhe këtu duhet të kemi secili nga pak tejkallim të vetes dhe qëndrimeve partiake", ka thënë Kuçi. Sipas tij, institucionet e Kosovës edhe ashtu shumë shpejt do ta bëjnë "zgjedhjen e presidentit". Në kushte anonimiteti, një zyrtar i lartë evropian ka shpjeguar se ende nuk është vendosur mënyra se si lehtësuesi i bisedimeve Robert Cooper do t'ua prezantojë arritjet. Mes takimit të parë dhe të dytë, Cooper e pati vizituar Prishtinën e Beogradin, për t'u treguar palëve përparimet që ishin bërë dhe për t'u marrë vesh për temat që do të diskutoheshin në të dytin. Kësaj radhe mund të mos ndodhë kështu. "Kësaj radhe mundet që njoftimi të bëhet vetëm me telefon", ka thënë ky burim. Sipas tij, verifikimi i kopjeve të regjistrave civilë, dhe certifikimi i tyre, do t'i bëjë të barasvlershme kopjet me origjinalin. Në këtë mënyrë do të shënohet edhe përparimi i parë konkret në dialog, me çka një çështje do të konsiderohej e zgjidhur. Në dy takime sa janë mbajtur gjithsej, përveç regjistrave civile, delegacionet e udhëhequra nga zëvendëskryeministrja e Kosovës Edita Tahiri dhe shefi i delegacionit serb Borko Stefanoviq, kanë biseduar edhe për vulat e Doganave të Kosovës në kufi me Serbinë, trafikun ajror, energjinë elektrike dhe telekomunikacionin. Udhëheqësja e delegacionit kosovar, Edita Tahiri, i ka paralajmëruar dëmet e luftës; çështjen e të zhdukurve, fondet pensionale dhe bashkëpunimin rajonal, si tema që do të trajtohen në takimet e ardhshme.

---

## **Pacolli: Do ta respektoj vendimin e Gjykatës Kushtetuese**

---

**"Do ta respektoj vendimin, edhe pse ende nuk e kam marr. Këtë vendim do ta shoh nesër. Cilido që të jetë vendimi i Gjykatës, do ta respektoj pikë për pikë. Ajo rregullon funksionimin e institucioneve të Kosovës. Ajo është e shenjtë dhe duhet të respektohet, ka thënë Pacolli**

PRISHTINË, 29 MARS - Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, ka thënë se është në dijeni për vendimin që ka marrë Gjykata Kushtetuese lidhur me zgjedhjen e tij president. Pacolli në një intervistë për "RTK" -në dhënë të martën ka thënë se do ta respektojë pikë për pikë vendimin e Gjykatës Kushtetuese. **"Do ta respektoj vendimin, edhe pse ende nuk e kam marr. Këtë vendim do ta shoh nesër. Cilido që të jetë vendimi i Gjykatës, do ta respektoj pikë për pikë. Ajo rregullon funksionimin e institucioneve të Kosovës. Ajo është e shenjtë dhe duhet të respektohet"**, ka thënë Pacolli. Ndërkohë, gazeta ka mësuar se të martën në mesditë se presidenti Pacolli ka zhvilluar një takim larg medieve me kryeministrin Hashim Thaçi, në të cilin është biseduar për vendimin e Kushtetueses për zgjedhjen e presidentit. Gjatë ditës së martë deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë deklaruar se vendimi i Gjykatës Kushtetuese ia ka lënë dy mundësi Behgjet Pacollit: të japë dorëheqje ose të shkarkohet nga Kuvendi. Nënkrjetari i Kuvendit të Kosovës nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Xhavit Haliti, pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit ka thënë se Behgjet Pacolli duhet ta respektojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Ai ka rikujtuar praktikën që ish - presidenti Fatmir Sejdiu kishte ndjekur pasi e njëjta gjykatë kishte deklaruar se e ka shkelur Kushtetutën. "Nuk është e rregulluar saktësisht procedura, por e kemi pasur një praktikë jo shumë të largët se si ka funksionuar. Singërisht, nuk i di rrjedhat e sotme dhe nuk kam informacion për qëndrimin e presidentit Pacolli, por vendimi i Gjykatës është obligues për të gjithë. Nuk mund ta detyrojë askënd ta propozojë dorëheqjen, por në bazë të Kushtetutës, nëse ai nuk paraqet dorëheqjen, atëherë Kuvendi duhet t'i ndërmarrë hapat e vet", ka deklaruar Haliti. Në këtë kontekst, ai ka deklaruar se Kuvendi dhe çdo institucion kushtetues në Kosovë është i detyruar të veprojë konform vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Vendimin e Gjykatës Kushtetuese e ka komentuar edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Ardian Gjini, shef i Grupit Parlamentar të AAK - së, ka deklaruar se vendimi i Kushtetueses ka treguar se Kosova deri më tani nuk ka pasur president dhe se të gjitha vendimet, të cilat janë marrë nga Behgjet Pacolli, duhet të anulohen. "Shumica e këtyre çështjeve janë të parapara me Kushtetutë. Në çastin që Gjykata Kushtetuese thotë se zgjedhja e presidentit ka qenë jokushtetuese, kjo nënkuptohet vetvetiu se Kosova nuk ka president dhe se presidenti duhet të zgjidhet dhe se të gjitha vendimet, të cilat janë marrë nga presidenti, duhet të shpallen jovalide, sepse kemi të bëjmë me një proces jo të rregullt", ka theksuar Gjini. Gjini ka folur edhe për opsionet që në këtë rast institucionet e vendit mund të ndjekin. "Opsioni i Kuvendit është që të silllet një kandidat i ri apo i njëjti për zgjedhjen e Opsionit të dytë është që të provohet të gjenden modalitete dhe zgjedhje tjera, qoftë për ndryshimin e formulave, apo për çfarëdo qoftë tjetër dhe, në këtë rast, kemi afat gjashtë muaj. Pra, gjashtë muaj do të kemi ushtrues të detyrës së presidentit, që do të jetë prapë z. Krasniqi. E nëse pas kësaj periudhe nuk e zgjedhim presidentin, duhet të shkohet në zgjedhje të reja", ka theksuar Gjini. Më pas ai ka deklaruar, të gjitha partitë politike duhet të provojnë dhe t'i gjejnë zgjidhjet më të mira për shkak të problemeve jetike që ka Kosova. I pyetur se si

do të veprojnë AAK - ja, nëse prapë z. Pacolli kandidon për president, Gjini është përgjigjur: "AAK-ja ka qenë Konsistente në qëndrimet e veta. Kemi dëshmuar dy ose tri parime jashtëzakonisht të qëndrueshme për ne. Kosova e ka parë se AAK - ja nuk ka vrapuar pas pushtetit, edhe pse është ofruar një gjë e tillë për shkak të parimeve".

---

## Sërish Pacolli për President

---

**Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se Behgjet Pacolli nuk ishte dhe nuk është president. Këtë e ka kuptuar edhe vetë Pacolli, pasi me të marrë këtë vendim, ka thënë se ai nuk ka nevojë të japë dorëheqje, por vetëm të largohet nga zyra. Ai ka thënë se i mbetet koalicionit të vendos nëse do të rikandidohet. E këshilltari i tij, Ibrahim Gashi, ka thënë se koalicioni do ta rikandidojë Pacollin për President.**

Behgjet Pacolli, ka pranuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në bazë të këtij vendimi edhe ai nuk e konsideron veten President i Kosovës, e në bazë të kësaj ka thënë se nuk ka nevojë fare të japë dorëheqje nga ky post, por vetëm të largohet nga aty. "Nuk ka nevojë për dorëheqje, unë praktikisht largohem nga zyra e Presidentit, dhe procesi do të rifillojë drejt pikës zero", ka thënë Pacolli, pak kohë pasi Gjykata Kushtetuese ka publikuar vendimin e plotë. Ai ka shtuar se nuk është i sigurt nëse do të rikandidohet sërish për postin e Presidentit, pasi sipas tij, kjo çështje i takon koalicionit. "Nëse koalicioni vendos kështu unë do të marr në konsideratë këtë vendim", ka thënë ai, duke shtuar se një vendim përfundimtar nëse rikandidohet apo jo do ta marrë gjatë 24 orëve të ardhshme. Por në anën tjetër, partia e cila e kishte propozuar Pacollin për President, shprehet e vendosur, që Pacolli sërish të jetë kandidat për të parin e vendit. "Duke e konsideruar se do të ketë përsëritje të procedurës së zgjedhjes së Presidentit të Kosovës, ju njoftojmë se Behgjet Pacolli do të jetë kandidat nga radhët e koalicionit meqenëse sipas vendimit që e pranuan sot nga Gjykata Kushtetuese, Behgjet Pacolli personalisht me asgjë nuk ka bërë shkelje të Kushtetutës", ka thënë Ibrahim Gashi, këshilltar i Presidentit dhe ish-nënkryetar i AKR-së.

### **Nuk ndihet fajtor, por viktimë**

Pacolli më tej ka thënë se nuk ndihet aspak fajtor për këtë situatë, pasi vlerëson se ai personalisht nuk e ka shkelur Kushtetutën. "Unë nuk e kam shkelur Kushtetutën, jam viktimë e saj dhe unë respektoj çdo vendim të Gjykatës", ka thënë Pacolli. Ai tash edhe pse më nuk është President as i vendit e as i AKR-së, ka thënë se insiston që partia të cilën ka drejtuar deri më 22 shkurt të këtij viti, duhet të vazhdojë koalicionin me PDK-në, dhe të jetë konstruktive në çështjet madhore për vendin. Gjithashtu, edhe kryeministri Hashim Thaçi, në mbledhjen e rregullt të Qeverisë, ka thënë se e respekton vendimin e Gjykatës Kushtetuese të vendit, lidhur me procedurat e zgjedhjes së Presidentit të vendit më 22 shkurt. Thaçi, me këtë rast ka thënë se me përgjegjësi të larta shtetërore do të angazhohen edhe për veprime të shpejta dhe konkrete në përputhje edhe me ligjet dhe Kushtetutën e vendit që të vazhdohet me zgjidhjen e duhur dhe të shpejtë të këtyre çështjeve. "Do të plotësojmë këtë agjendë që e kemi para nesh besoj shumë shpejt që javën tjetër, si Kuvendi i Kosovës, partitë politike, por edhe partnerët e koalicionit", është shprehur Thaçi. E ndërkaq, kryeparlamentari Jakup Krasniqi, me t'u kthyer nga vizita e tij zyrtare në Hungari, ka mbajtur një konferencë me gazetarë, me ç'rast duke iu përgjigjur interesimit të mediave rreth asaj se si do të reflektojë vendimi i Gjykatës Kushtetuese rreth zgjedhjes së Presidentit të Kosovës, ka thënë se ende nuk e ka parë vendimin e plotë të gjykatës, megjithatë ka shtuar se respekton çdo vendim të kësaj Gjykate. "Jemi para një realiteti që na është krijuar nga një vendim i Gjykatës Kushtetuese, mirëpo ende nuk kemi një informacion më të plotë, përkatësisht nuk e kemi vendimin e plotë të Gjykatës Kushtetuese. Edhe në këto momente jo krejt normale, ndoshta del diçka e mirë, e kjo është gatishmëria e të gjithë faktorëve

që ishin përfshirë në këto procese që të respektojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, pra të mësohemi që vendimet e institucioneve të pavarura, të institucioneve kushtetuese, të respektohen nga të gjithë. Kjo është më e mira që mund të thuhet në këtë moment nga përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës", ka thënë kryetar i Kuvendit, Krasniqi.

### **Zgjedhja e Presidentit, javën e ardhshme**

Zhvillimet e fundit në vend, pas vendimit të Kushtetueses, për shkeljen e procedurave me rastin e zgjedhjes së Presidentit më 22 shkurt, i ka komentuar edhe zëvendëskryeministri i Kosovës, Hajredin Kuçi menjëherë me të përfunduar mbledhja e Qeverisë. Ai me këtë rast ka shprehur besimin e tij që do të gjendet çfarëdo zgjidhje për të gjitha këto qysh në javën e ardhshme e që është në të mirë të qytetarit të vendit. "Institucionet e Kosovës shumë shpejt do ta bëjnë zgjidhjen adekuate, kushtetuese dhe ligjore, në mënyrë që të kemi të plotësuar çdo institucion të Republikës. Unë besoj që sa më shpejt që është e mundur, por gjithmonë duke i respektuar procedurat. Besoj se do të jemi racionalë të gjithë në vendimet tona. Ne jemi të gatshëm të lëvizim sa më shpejt që është e mundur. Kjo nënkupton që në fillim të javës që do të vijë. Po ashtu, presim që do të kemi sjellje racionale të të gjithëve dhe me përgjegjësi edhe në Kuvendin e Kosovës", ka thënë Kuçi.

---

## **Makolli: Sërish Pacollin**

---

**Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, interpretim jojuridik**

**- Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka dhënë një interpretim logjik, jojuridik**

**- Pacolli dhe Kuvendi i Kosovës, viktimë të zbrazëtirave të Kushtetutës së Kosovës**

**- AKR - ja sërish do ta kandidojë Behgjet Pacollin për president**

PRISHTINË, 29 MARS - Ushtruesi i detyrës së presidentit të Aleancës Kosova e Re (AKR), Ibrahim Makolli, në një bisedë për "Epokën e re" ka thënë se vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës më tepër ka të bëjë me interpretim logjik sesa juridik. "Nëse analizohet mirë Kushtetuta, më tepër kemi të bëjmë me një interpretim logjik dhe politik të dy të tretave të votave sesa me një interpretim juridik", ka thënë Makolli. Makolli ka deklaruar se Gjykata Kushtetuese në këtë rast është duke bërë përpjekje t'i mbulojë zbrazëtirat e Kushtetutës së vendit. Në këtë kontekst, ai ka thënë se presidenti Pacolli dhe Kuvendi i Kosovës janë viktima të zbrazëtirave të Kushtetutës së Kosovës. "Gjykata Kushtetuese është duke u përpjekur për t'i mbuluar zbrazëtirat e Kushtetutës së vendit. Në këtë kontekst, ai ka thënë se presidenti Pacolli dhe Kuvendi i Kosovës janë viktima të zbrazëtirave të Kushtetutës së Kosovës. "Gjykata Kushtetuese është duke u përpjekur për t'i mbuluar zbrazëtirat e Kushtetutës. Z. Pacolli, por edhe Kuvendi i Kosovës, janë viktima të zbrazëtirave të Kushtetutës së Kosovës", ka thënë Makolli. Ai ka deklaruar se në asnjë nen të Kushtetutës së Kosovës nuk përcaktohet kuorumi i veçantë për seancën në të cilën bëhet zgjedhja e presidentit të Kosovës. "Ajo çfarë është qenësore për mua është kjo: prapë po e përsëris se Gjykata Kushtetuese është duke u përpjekur për t'i mbuluar zbrazëtirat e Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese është e obliguar të bëjë interpretim juridik të Kushtetutës. Vetëm shikoni nenin 69 të Kushtetutës së Kosovës, kur është fjala për kuorum. Thotë kështu: 'Kuvendi ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve'. Pra, nëse një nen i veçantë thotë se kuorumi për seancë është 50 përqind, plus 1 deputet dhe nuk ka shtesë tjetër, që do të thoshte përjashtimisht në rastet e tjera, nënkuptohet se seancat e Kuvendit, pavarësisht për çfarë rasti, kuorumi është gjysma, plus 1 e deputetëve të Kuvendit. Pikërisht në këtë pikë Gjykata Kushtetuese e gjen defektin e parë", ka thënë Makolli, duke shtuar se, ashtu sikurse nuk është e përcaktuar as pjesëmarrja e vetëm një kandidati për president. "Shikoni defektin tjetër, edhe aty kur thotë të një kandidati. Kushtetuta e Kosovës parasheh kur ka më shumë kandidatë, por nuk thotë në asnjë çast se nuk bën me një kandidat. Kjo lë për të nënkuptuar. Por, tash, në çfarë gjendje kemi ardhur, mund të nënkuptohet në forma të ndryshme. Po i shihni edhe deklaratat e të tjerëve se si po e interpretojnë në mënyra të ndryshme këtë çështje", ka thënë Makolli. Pavarësisht këtyre defekteve Makolli ka thënë se AKR - ja do ta respektojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese por, sipas tij, praktikat e tilla mund t'i bëjnë dëm shumë të rënda shtetit të Kosovës. "Asnjëherë nuk do të mund të ketë garanci se në Kuvendin e Kosovës, kur është fjala në rastin e zgjedhjes së presidentit, mund të jenë të pranishëm të gjithë deputetët e opozitës", është shprehur Makolli. Nëse çështja e presidentit do të kthehet në pikën zero, Makolli ka paralajmëruar se sërish AKR - ja do ta kandidojë Behgjet Pacollin për president të Kosovës, "AKR - ja do ta kandidojë prapë për president të vendit zotin Pacolli", ka bërë me dije Makolli. Paralajmërimeve të partive



opozitare, se nëse AKR - ja e kandidon prapë për president të vendit Behgjet Pacollin do ta bojkotojnë sërish seancën parlamentare, Makolli iu është përgjigjur: "Kjo çështje do të bie në përgjegjësinë e klasës politike në Kosovë. Pra, do të vijë në shprehje se sa klasa politike në Kosovë është e përgjegjshme për gjendjen në të cilën është vendi ynë. Në rast të ndonjë dështimi eventual, atëherë vendi shkon në zgjedhje të parakohshme, të cilat duhet të mbahen brenda 45 ditëve, e atëherë vendi hyn në kriza të thella, për të cilat përgjegjësinë duhet ta bartë klasa politike, në veçanti ata të cilët i bojkotojnë seancat në të cilat zgjedhën institucionet", ka thënë Makolli.

---

## **Presidenti Pacolli paralajmëron tri njohje për Kosovën**

---

Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli ka siguruar të paktën tri njohje për shtetin tonë, vetëm në udhëtimin e parë jashtë Ballkanit, gjatë qëndrimit në fundjavë në Paris bëjnë ditur për gazetën burime të afërta me Presidentin. "Presidenti Pacolli pas takimeve të zhvilluara të premtën në mbrëmje në Paris, e të cilat kanë qenë shumë të suksesshme në procesin e afirmimit të Kosovës si shtet, pritet t'i sjellë shtetit së paku tri njohje", i tha të martën gazetës, ky burim zyrtar nga Presidenca. Burime të gazetës kanë bërë të ditur se këto njohje janë gati, ndërsa pritet një kohë më e përshtatshme për t'i prezantuar. "Këto njohje do të prezantohen shumë shpejt, sapo të normalizohen proceset", thotë ky burim. Burimet bëjnë të ditur se Guinea Conacry është njëri prej tri shteteve që do ta njohin Kosovën së shpejti. Presidenti Behgjet Pacolli, kishte udhëtuar të premtën për në Paris, ku pati një darkë pune me homologun e tij nga Guinea Conakry, Alfa Kondez ka diskutuar për intensifikimin e marrëdhënieve midis dy vendeve. Dy presidentët ishin pajtuar që në të ardhmen të intensifikohen edhe më shumë marrëdhëniet në mes të dyja vendeve. Presidenti Pacolli edhe para zgjedhjes në postin më të lartë të shtetit, kishte arritur të siguronte më shumë se 20 njohje të drejtpërdrejta, ndërsa numri i njohjeve në të cilat ka kontribuar edhe ai, është shumë më i lartë. Të paktën tri njohjet e fundit të siguruara pas krizës institucionale, ishin meritë e tij. Një nga përparësitë e Presidencës së Pacollit, vlerësohej lobimi, përkatësisht diplomacia në arritjen e sa më shumë njohjeve, për të shtuar gjasat në integrimet në strukturat jashtë vendit. - Bota sot

### **Guinea Conacry**

"Këto njohje do të prezantohen shumë shpejt, sapo të normalizohen proceset", thotë ky burim. Burimet bëjnë të ditur se Guinea Conacry është njëri prej tri shteteve që do ta njohin Kosovën së shpejti.

## Pacolli: Do të rikandidohem për president

### Presidenti i Republikës së Kosovës

Behgjet Pacolli është shprehur i gatshëm që të respektojë vendimin dhe se do të veproj ashtu siç është shkruar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, dhe se do t'i hyjë sërish procesit të rivotimit. **"Jam në dijeni lidhur me njoftimin e Gjykatës Kushtetuese dhe unë siç kam deklaruar më parë do ta respektoj totalisht vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Vendimin nuk e kam marr ende, por pritet ta shohim të mërkurën, dhe unë do të veproj ashtu siç është e shkruar në vendim për këtë jam i përkushtuar dhe do të implementojë pikë për pikë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Është mirë që kemi Gjykatë Kushtetuese ajo rregullon mbarëvajtjen e institucioneve të Kosovës, ajo është e shenjtë, ajo duhet të respektohet"**, theksoi Pacolli në një intervistë për RTK-në. Ndërsa, duke folur për ditën kur Pacolli është zgjedhur presidentë theksoi se deri në momentin e fundit i ka implementuar të gjitha rregullat që i janë thënë nga drejtuesi i Kuvendit. **"Unë kam qenë në funksion të deputetit, deri në momentin e fundit i kam implementuar të gjitha rregullat që duhet t'i përmbahet një deputet dhe atyre iu kam përmbajtur. Normalisht ka ardhur momenti kur jam votuar unë tri herë, i jam nënshtruar votës së deputetëve dhe mbas raundit të tretë më është thënë se fitorja është në anën time dhe jam ftuar që të dal të betohem, unë kam shkuar dhe ekzakt iu kam nënshtruar asaj që më është thënë. Më është dhënë fletbetimi, jam betuar dhe më është thënë se mikrofonin është për ju"**, theksoi Pacolli.



*z.Pacolli po ashtu tha se ka vendosur të rikandidohet për president dhe se për këtë do të konsultohet edhe me partnerin e koalicionit Hashim Thaçi, dhe se nëse është e nevojshme do të kërkojë vota edhe nga opozita.*

---

## Pa president, pa marrëveshje

---

**Ndonëse opozita nuk e ka ndryshuar mendimin për të, Pacolli do të rikandidohet. LDK-ja kërkon marrëveshje politike dhe president konsensual, AAK-ja dhe "Vetëvendosje" mbeten në qëndrimet e mëhershme. Por, PDK - ja ka vendosur ta provojë edhe një herë me kandidatin e rrëzuar nga Gjykata Kushtetuese**

### Braktiset Presidenca

Pacolli e ka pranuar njoftimin për aktgjykim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Në një deklaratë nga zyra presidenciale thuhet se presidenti është i gatshëm të respektojë aktgjykimin dhe me qëllim të respektimit të institucionit të Gjykatës Kushtetuese, nuk ka asnjë koment lidhur me vendimin. "Konsiderojmë se Kuvendi i Kosovës është organi kompetent për të ndërmarrë sa më parë hapat e ardhshëm", thuhet në fund të kësaj deklaratë. Menjëherë pas marrjes së vendimit, Pacolli dhe këshilltarët e tij e kanë braktisur Presidencën. Gjykata Kushtetuese i ka shpallur të pavlefshme procedurat e zgjedhjes së Behgjet Pacollit në postin e presidentit, në seancën e 22 shkurtit 2011. Vendimi i plotë u publikua dje dhe konstaton se presidenti nuk është zgjedhur në pajtim me procedurat kushtetuese, andaj ai nuk është më president i Kosovës. Burimet tona theksojnë se janë duke u bërë përpjekje që këtë të premtë, ose më së largu të hënën, të bëhet zgjedhja e presidentit, por nuk dihet nëse do të arrihet marrëveshja, marrë parasysh pozicionet e forcave politike. Kryeministri Hashim Thaçi tha në mbledhjen e Qeverisë se institucionet do ta respektojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Paraprakisht ai është takuar me Pacollin, ndërsa ky i fundit një takim e ka zhvilluar edhe me shefin e ICO-s, Piter Fejt. Thaçi ka thënë se gjatë javës së ardhshme do të merren veprime konkrete për zgjedhjen e presidentit të Kosovës. "Koalicioni vazhdon agjendën e vet të plotë shtetërore, andaj unë kam besim të plotë në mundësinë dhe mirëkuptimin e qytetarëve të vendit, në mbështetjen e partnerëve tanë të plotë ndërkombëtarë, që do ta bëjnë zgjidhjen e shpejtë kushtetuese", tha Thaçi, duke besuar në rolin pozitiv dhe aktiv edhe të opozitës. Këshilltari i parë i Behgjet Pacollit, Ibrahim Gashi, ka thënë se presidenti është i gatshëm ta respektojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Duke konsideruar se çështja e Pacollit do të kthehet në "pikën zero", Gashi ka thënë se Pacolli do të jetë përsëri kandidat, pasi ai, në bazë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nuk e ka shkelur Kushtetutën. Sipas Ibrahim Makollit, koalicioni qeverisës, PDK AKR dhe minoritet, ka mbledhur numrin e nënshkrimeve të nevojshme për rikandidimin e Pacollit.

### Opozita kërkon marrëveshje

Forcat politike të spektrit opozitar thonë se nuk do të ketë lëvizje në qëndrimet e tyre nëse do të përsëritet skenari i njëjtë. Në një intervistë për programin e mëngjesit në RTK, të mërkurën, deputeti Arben Gashi tha se partia e tij do të kërkojë një marrëveshje politike për të shmangur krizën, ndërsa nuk e ka mohuar se mund të dalin me një kandidat presidencial, që sipas tyre duhet të jetë konsensual. Ndërkohë burime të AAK - së thonë se janë të gatshëm për një koalicion të gjerë ose një koalicion me PDK - në me kusht që postin e kryeministrit ta marrë kjo parti. As Lëvizja "Vetëvendosje" nuk ka lëvizur nga pozicioni i saj i njohur. Ndërsa zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi ka thënë se tani ka nevojë për një zgjidhje të gjerë, mirëpo ai ka thënë se nuk bëhet fjalë për çështje të partnerit të ri qeverisës, por për një racionalitet dhe qëndrueshmëri brenda Kuvendit. Në një konferencë për media, pas mbledhjes së Qeverisë,

Kuçi ka thënë se zgjedhja e presidentit do të bëhet gjatë javës së ardhshme. "Nëse kërkohet me Kushtetutë të jenë dy kandidatë, do të bëhen dy", tha ai. Kuçi ka theksuar se të gjitha grupet parlamentare duhet të jenë më racionale në veprimet e tyre. Ai ka theksuar se Partia Demokratike e Kosovës është e gatshme për çdo zgjidhje që është në të mirë të vendit. Sidoqoftë, i pyetur nëse do të bisedojë me LDK-në dhe AAK-në për t'i bindur që të jenë në sallë në mënyrë që të krijohet kuorumi në rastin e zgjedhjes së presidentit, Kuçi ka thënë se secili deputet ka obligim para Kushtetutës dhe para interesit të qytetarëve. Ai nuk beson në zgjedhje të jashtëzakonshme, të cilat janë mbajtur muaj më parë. Si udhëheqës i Komisionit për hartimin e Kushtetutës, vetë Kuçi thekson se në Kushtetutë ka dilema, sidomos sa i përket kuoromit. "Unë kam dilema a duhet të jenë dy të tretat në Kuvend apo jo, sepse ky është një bllokim që mund të jetë edhe pas pesë vjetësh, të jeni të bindur, jo vetëm sot", ka thënë ai.

### **Vendimi i Gjykatës, në votim duhen 120 deputetë**

Gjykata Kushtetuese e ka publikuar aktgjykimin në të cilin e vlerëson si të pranueshme ankesën e Lidhjes Demokratike të Kosovës lidhur me mënyrën e zgjedhjes së presidentit të Kosovës, Behgjet Pacolli, duke vlerësuar kështu se vendimi për zgjedhjen e tij ka qenë jokushtetues. Ky akt gjykim do të ketë efekt të menjëhershëm", thuhet në vendimin e publikuar në ueb-faqen e Gjykatës Kushtetuese. Lidhur me procedurën e zgjedhjes së presidentit, siç parashihet në nenin 86.6 të Kushtetutës, Gjykata thekson se nëse deputetët paraqesin vetëm një kandidat për zgjedhjen e presidentit të Kosovës, kushtet formale për të vënë në lëvizje procedurën e zgjedhjes nuk janë plotësuar. Në një situatë të tillë, çdo procedurë e cila u pasua me vetëm një kandidat për t'u zgjedhur president i Republikës së Kosovës ka qenë shkelje e nenit 86 të Kushtetutës. Gjykata është e mendimit se formulimi i nenit 86 (Zgjedhja e presidentit) të Kushtetutës duhet të ekzaminohet në tërësi. Interpretimi i nenit mund të jetë vetëm se duhet të ketë më shumë se një kandidat për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës, me qëllim që procedura e votimit të vihet në lëvizje. Në veçanti, në paragrafin 5 të tij, në mënyrë eksplicite përcaktohet së, nëse 2/3 e shumicës nuk është arritur nga asnjë kandidat në raundin e parë të votimit, atëherë zhvillohet edhe një raund i tretë i votimit midis dy kandidateve të cilët kanë marrë numrin më të madh të votave gjatë raundit të dytë. Po ashtu, në vendim thuhet se ndërprerja e votimit është në kundërshtim me Rregulloren e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës bazuar në konkluzionin e kryetarit të Kuvendit, si interpretuesi përfundimtar i Rregullores së punës. Mungesa e kuoromit është vlerësuar, gjithashtu, antikushtetuese. Po ashtu, Gjykata kërkon që gjatë votimit të presidentit të Republikës duhet të votojnë të gjithë 120 deputetët. Gjykata vëren se lidhur me numrin e votave që kërkohen për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës, neni 86-4 i Kushtetutës siguron se presidenti i Republikës së Kosovës do të zgjidhet me dy të tretat (2/3) e "votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, që do të thotë se të gjithë 120 deputetët duhet të votojnë, minus ata deputetë të cilët kanë marrë leje nga kryetari i Kuvendit dhe kandidati i cili merr 80 ose më shumë vota nga votat e të gjithë deputetëve në raundin e parë dhe të dytë do të zgjidhet. Vetëm nëse nuk arrihen dy të tretat e shumicës mbahet raundi i tretë. Neni 27 i Ligjit për deputetë dhe neni 27-4 i Rregullores së punës së Kuvendit përmban formulim identik të fjalëve: "dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përmban formulim identik të fjalëve: "dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit", thuhet në pikën 85 të arsyetimit të aktgjykimin. I. K & S. A

---

## **Kthehuni në fillim**

---

**Gjykata Kushtetuese ka shpallur aktvendimin final lidhur me procedurën e zgjedhjes së Behgjet Pacollit President. Kjo gjykatë ka sugjeruar që procesi të nisë edhe një herë nga fillimi për t'u respektuar procedurat kushtetuese.**

Behgjet Pacolli nuk ka dhënë dorëheqje nga posti i Presidentit edhe pasi ka marrë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila konstaton se ai është zgjedhur në postin e Presidentit në mënyrë antikushtetuese më 22 shkurt të këtij viti në një seancë të jashtëzakonshme, pasi gjykata konstatoi se ai nuk ishte fare President. Në vendimin e Gjykatës që i ka shkuar të gjitha palëve e thuhet se gjatë zgjedhjes së Pacollit, janë hasur dy shkelje kushtetuese, ajo e mungesës së kuorumit, pra prezencës së 81 deputetëve në sallë, dhe ajo votimit me vetëm një kandidat për President, e që në bazë të Kushtetutës, kërkohet të jenë minimum dy kandidatë. Gjykata pas vlerësimit të kërkesës se dy partive opozitare, LDK-së dhe AAK-së që kishte të bënte pikërisht me këto procedura, vendosi me shumicë votash me 7 pro dhe 2 kundër, që ankesën ta marrë si të pranueshme.

### **Duhet më shumë kandidatë**

Me aktvendimin thuhet se zgjedhja e Pacollit si President pa asnjë kundër kandidat ka paraqitur shkelje të nenit 86 të Kushtetutës së Kosovës. Po ashtu, edhe mungesa e kuorumit është vlerësuar si antikushtetuese. "Gjykata është e mendimit se formulimi i nenit 86 (Zgjedhja e Presidentit) të Kushtetutës duhet të ekzaminohet në tërësi. Interpretimi i nenit mund të jetë vetëm se duhet të këtë me shumë se një kandidat për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, me qëllim që procedura e votimit të vihet në lëvizje. Në veçanti, në paragrafin 5 të tij, në mënyrë eksplicite përcaktohet se, nëse 2/3 e shumicës nuk janë arritur nga asnjë kandidat në raundin e parë të votimit, atëherë, zhvillohet edhe një raund i tretë i votimit midis dy kandidatëve, të cilët kanë marrë numrin më të madh të votave gjatë raundit të dytë. Për më tepër, neni 86.6 i Kushtetutës gjithashtu shprehet për më shumë se, një kandidat. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk zgjidhet, neni 27, pika 4 dhe 5 i Rregullores së punës së Kuvendit përmban dispozita të ngjashme", thuhet në aktvendim. Më tutje në argumentet e gjyqtarëve në aktvendim thuhet se nëse qëllimi i hartuesve të Kushtetutës do të kishte qenë që të paraqisnin një procedurë alternative për zgjedhje, vetëm me një kandidat të nominuar. Kushtetuta, shprehimisht do të kishte parashikuar një procedurë të tillë. "Në këto rrethana, Gjykata konkludon se procedura për zgjedhjen e z. Behgjet Pacolli si President i Republikës së Kosovës, mbajtur në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit, më 22 shkurt 2011, përbën shkelje të nenit 86 të Kushtetutës dhe prandaj, është kundërkushtetuese", thuhet në aktvendim.

### **Edhe mungesa e kuorumit antikushtetuese**

Po ashtu, në kërkesën e dy partive opozitare ishte përfshirë edhe çështja e mungesës së kuorumit në seancën e 22 shkurtit kur është votuar presidenti, kërkesë kjo që është përkratur nga Gjykata, e cila e ka vlerësuar si antikushtetuese, mungesën e kuorumit prej dy të tretave të deputetëve të Kuvendit, në kohën kur u mbajt raundi i parë dhe i dytë i zgjedhjes së presidentit.

"Si përfundim, Gjykata Kushtetuese në seancën e mbajtur më 28 mars 2011, shpall njëzëri, se Kërkesa është e pranueshme dhe me shtatë vota për dhe dy kundër shpall se vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, më 22 shkurt 2011, është jokushtetues dhe nuk do të jetë në fuqi nga data e publikimit të tij në përputhshmëri me nenin 116.3 të Kushtetutës, meqenëse është në kundërshtim me kërkesat e nenit 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe parimet demokratike të mishëruara aty", thuhet në aktvendim. Kështu me këtë aktvendim Kushtetuesja rekomandon që në rivotimin e presidentit, deputetët duhet të jenë në sallë, ngase është obligim kushtetues dhe ligjor. Po ashtu, duhet që të ketë edhe kundër kandidat për president.

### **Mospajtimi i dy gjyqtarëve ndërkombëtarë**

Po ashtu, në aktvendim është futur edhe mospajtimi i dy gjyqtarëve ndërkombëtarë të Gjykatës Kushtetuese, që votuan kundër. Arsyetimi i tyre ishte se Gjykata nuk ka të drejtë që të urdhërojë Kuvendin që të kandidojë dy apo më tepër kandidatë për President. "Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencë për t'i urdhëruar Kuvendit që t'i nominojë së paku dy kandidatë për Zyrën e Presidentit ose për t'i urdhëruar Kuvendit të rivotojë për të katërtën herë. Megjithatë, që në fillim, kur Gjykata përcakton që ka pasur shkelje të Kushtetutës në procedurën zgjedhore të Kuvendit, Kushtetuta me pas urdhëron që Kuvendi të shpërndalet dhe zgjedhjet e reja të përgjithshme të mbahen brenda dyzet e pesë ditësh. Duke deklaruar që procesi zgjedhor i 22 shkurtit 2011 e shkeli Kushtetutën, kjo Gjykatë deklaroi që Kuvendi nuk e kishte zgjedhur Presidentin pas raundit të tretë të votimit. Kushtetuta më pas urdhëron shpërndarjen e Kuvendit dhe zgjedhjet e reja të përgjithshme brenda 45 ditësh. Vendimi i sotëm i gabuar i Gjykatës, që nuk mund të jetë pa pasoja, e imponon atë përfundim. Gjykata, duke deklaruar thjesht që procesi zgjedhor i 22 shkurtit 2011, e shkeli Kushtetutën, në mënyrë implicite pranon që nuk ka kompetencë për t'i urdhëruar Kuvendit që të rivotojë. Pasi Gjykata nuk ka kompetencë për ta shpallur zgjedhjen jo kushtetuese pa asnjë mjet, vendimi i shumicës imponon shpërndarjen e Kuvendit dhe zgjedhjet e reja të përgjithshme", thuhet në arsyetimin e dy gjyqtarëve mospajtuës, arsyetim i cili nuk interferon në vendimin e Gjykatës, pasi këta dy gjyqtarë, u mbivotuan nga kolegët e tyre.

## Gati për rikandidim

PRISHTINË, 30 MARS - Behgjet Pacolli i ka dhënë fund punës në zyrën e Presidentit të Kosovës që e kishte filluar me 22 shkurt, pas zgjedhjes në krye të shtetit në Kuvend, në një votim të cilën Gjykata Kushtetuese këto ditë e shpalli jokushtetues. Vendimi i Gjykatës më të lartë nuk e detyroi njeriun e parë të vendit të japë dorëheqje nga posti, por Pacolli tha se do të largohet nga Presidenca. **“Nuk ka nevojë për dorëheqje, unë praktikisht largohem nga Zyra e Presidentit dhe procesi do të rifillojë drejt pikës zero”**, ka thënë Pacolli për Radio Dukagjinin, të mërkurën. Ai ka shtuar se nuk është i sigurt nëse do të rikandidohet për postin më të lartë. **“Nuk është e sigurt nëse unë do të rikandidohem për post të presidentit, kjo çështje i takon koalicionit, nëse koalicioni vendos kështu, unë do të marr në konsideratë këtë vendim”**, ka thënë Pacolli. Vendimi i Gjykatës është përmendur edhe në njoftimin që është lëshuar nga Presidenca. Në të thuhet se Pacolli do ta respektojë vendimin e Gjykatës, duke mos komentuar për të. **“Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Behgjet Pacolli, sikurse ka paralajmëruar se është i gatshëm të respektojë në plotëni aktgjykimin dhe, me qëllim të respektimit të institucionit të Gjykatës Kushtetuese asnjë koment lidhur me vendimin. Konsiderojmë që kuvendi i Kosovës është organi kompetent për të ndërmarrur sa më parë hapat e ardhshëm”**, thuhet në njoftim. Pavarësisht se Pacolli nuk ka konfirmuar rikandidimin, zyrtarë të lartë të AKR-së kanë thënë se ai është kandidati i vetëm, përderisa kanë pohuar se gjatë ditës kanë siguruar edhe nënshkrimet për kandidaturën e tij. Ushtruesi i detyrës së kreut të AKR-së, Ibrahim Makolli, ka thënë se çështja e nënshkrimeve nuk ka qenë asnjëherë problem, derisa ka theksuar se seanca e jashtëzakonshme në të cilën do të përsëritet votimi për Presidentin e vendit do të mbahet shumë shpejt. Të mërkurën është folur për mundësinë që seanca e jashtëzakonshme të mbahet ose të premtën, ose të hënën e ardhshme. Madje, burimet të Ekspresit kanë thënë se partnerët e koalicionit tashmë kanë filluar të mendojnë edhe për një kundërkandidat të Pacollit, i cili ka gjasa të jetë edhe nga partitë e pakicave. Për këto ende nuk është vendosur asgjë. Si do që të jetë, Kryeministri Hashim Thaqi ka thënë se Qeveria e tij do ta respektojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe do të sillet konform këtij vendimi. Ai paralajmëroi se në fillim të javës së ardhshme do të ketë një zgjidhje kushtetuese për presidentin, duke ftuar opozitën për bashkëpunim.



## Kthimi në pikën zero

Sidoqoftë, në reagimet e para pas vendimit të Kushtetutës, Behgjet Pacolli është pajtuar dhe ka pranuar ta respektojë në tërësi vendimin e Kushtetutës. Ndërsa ka ndërprerë të gjitha aktivitetet si President i Kosovës, Pacolli është rikandiduar për postin e presidentit, ka bërë të ditur këshilltari i tij, Ibrahim Gashi. “Konsiderojmë që Kuvendi i Kosovës është i vetmi organ i Kosovës, është i vetmi organ kompetent për të ndërmarrë sa më parë hapat e ardhshëm”, deklaroi Gashi. Ai rikonfirmon gatishmërinë e Pacollit dhe koalicionit për një sfidë të re në Kuvend. “Duke konsideruar se do të ketë përsëritje të procedurës së zgjedhjes së presidentit të Republikës së Kosovës, ju njoftojmë se Behgjet Pacolli do të jetë kandidat nga radhët e koalicionit, meqenëse sipas vendimit që morëm sot nga Gjykata Kushtetuese, Pacolli nuk ka bërë asnjë shkelje kushtetuese”, thotë Gashi. Gjatë ditës së djeshme, Pacolli ka zhvilluar një takim me kryeministrin Hashim Thaçi. Ky i fundit menjëherë pasi thirri edhe mbledhjen e qeverisë ku deklaroi se vendimet e Gjykatës Kushtetuese do të respektohen, kurse zgjedhja e presidentit, sipas tij, pritet të procedohet në Kuvend qysh javën tjetër. “Do të plotësojmë këtë agjendë që e kemi para nesh, besoj shumë shpejt që javën tjetër, si Kuvend i Kosovës, si parti Politike, por edhe si partner të koalicionit. Koalicioni vazhdon agjendën e vet të plotë shtetërore”, tha Thaçi. Kryeministri ka ftuar edhe opozitën që të luajë rol konstruktiv dhe të marrë pjesë në procedimin e mëtutjeshëm në Parlament të rastit të zgjedhjes së presidentit të Kosovës. Njëherësh ai u shpreh optimist se Parlamenti do të ketë mundësi që të zgjedhë presidentin sipas procedurave kushtetuese. “Do të bëjmë zgjidhjen e shpejtë kushtetuese për çka besoj edhe në rolin pozitiv edhe të opozitës, për çka edhe i ftoj për participim aktiv në jetën demokratike. Kam besim të plotë se do ta kalojmë me sukses këtë aspekt procedural në Kuvendin e Kosovës”, u shpreh u Thaçi. Ai thotë se nuk ndihet fajtor për shkak të zgjedhjes së presidentit është cilësuar tani si jo kushtetuese, duke sqaruar se stenogramin e seancës e përgatit administrata. “Unë i kryej përgjegjësitë e mia konform stenogramit që e kam përgatitur dhe unë asnjë shtesë ose mangësi nuk e kam përdorur në stenogramin mbi të cilin mbahen seancat plenare”, tha Krasniqi. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka pasuar kërkesën e 34 deputetëve të LDK-së dhe AAK-së të cilët kërkuan interpretimin në lidhje me procedurat e zgjedhjes së Pacollit në postin e presidentit në seancën e 22 shkurtit. Përveçse e kthen rivotimin për president, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar po ashtu se edhe braktisja e seancës, siç ndodhi me opozitën më 22 shkurt, përbën shkelje, ngase për respektimin e kushtetutshmërisë në Parlament patjetër duhet të ketë të paktën dy kandidat në garën për president si dhe kërkohet që në sallë gjatë votimit të jenë dy të tretat apo 80 deputetë të pranishëm. Ky konstatim i Gjykatës Kushtetuese e hedh topin në fushën e partive opozitare të cilat do të detyrohen që në seancën e radhës kur do të votohet për zgjedhjen e presidentit të qëndrojnë në sallë duhet të ketë dy a më shumë kandidat. Një përkufizim i tillë e vë në siklet tash gjithë Kuvendin, partitë në pushtet dhe ato në opozitë, që ta gjejnë edhe një kundër kandidat. Në të kundërtën, vendi i rrezikon të zhytet në një krizë të re, e cila do të çonte drejt zgjedhjeve të reja të jashtëzakonshme. Të tri partitë opozitare, LDK, Vetëvendosje dhe AAK, të kontaktuar dje, janë shprehur të pa interesuara që të dalin me ndonjë kundër kandidat vetëm sa për t’i plotësuar procedurat. Kurse të tria thonë se do të braktisin seancën nëse kandidat për president është sërish Behgjet Pacolli.

---

## AKR nuk lëshon pe

---

### **Në rast se PDK-ja nuk do të mund t'i garantojë AKR-së pozitën e Presidentit atëherë prishja e koalicionit bëhet pothuajse e pashmangshme**

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, përveç që ka kthyer në fillim procesin e zgjedhjes së presidentit, ka vënë në dyshim edhe funksionimin e koalicionit qeverisës ndërmjet PDK-së dhe AKR-së. Kjo e fundit, ndërkaq kërkon që të respektohet në përpikëri, kontrata e koalicionit, duke siguruar votat e mjaftueshme për rizgjedhjen e Pacollit në Kuvend, në të kundërtën dështimi i Pacollit, sipas përfaqësuesve të AKR-së, është edhe fundi i koalicionit qeverisës. Ibrahim Makolli, nënkryetar i AKR-së megjithatë beson se marrëveshja për koalicion me PDK-në ende është në fuqi, duke e kundërshtuar kështu çdo opion tjetër të mundshëm. “Behgjet Pacolli është dhe do të jetë kandidat i partnerëve të koalicionit për president”, u shpreh Makolli, sipas të cilit, AKR nuk do të pranojë asnjë opion tjetër. “Ne nuk e pranojmë asnjë opion tjetër sepse ne e kemi një marrëveshje dhe natyrisht ajo marrëveshje ende është valide. Në të parashihet edhe pozita e presidentit dhe ky koalicion qeverisës ka kandiduar Pacollin për president, prandaj edhe më tutje vazhdon të jetë kandidat për këtë pozitë”, ka thënë Makolli. Nga ana tjetër, analisti Krenar Gashi thotë se marrëveshja për koalicionin qeverisës mes PDK-së dhe AKR-së, ndërthen në vete edhe postin e Presidentit të Republikës, gjë që sipas tij, e bënë këtë marrëveshje jokushtetuese. “Në rast se PDK-ja nuk do të mund t'i garantojë AKR-së pozitën e Presidentit, atëherë prishja e koalicionit bëhet pothuajse e pashmangshme”, ka thënë Gashi. Ndërkaq, rreth asaj se a do të jetë përfundimisht Pacolli rikandidat për president, nënkryetari i PDK-së, Hajredin Kuçi tha se kjo çështje mbetet të shihet, duke e lënë të hapur mundësinë. Ai ka thënë se javën e ardhshme, Kuvendi i Kosovës duke respektuar procedurat, do të bëjë zgjidhjen adekuate, kushtetuese dhe ligjore të kësaj çështje. Sipas tij, tani ka nevojë për një zgjidhje të gjerë dhe për një sjellje më racionale të të gjitha grupeve parlamentare. “Ne jemi të gatshëm të lëvizim sa më shpejtë që është e mundur që nënkupton që në fillim të javës që do të vijë do të lëvizim. Po ashtu presim që do të kemi sjellje racionale të të gjithëve dhe me përgjegjësi edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës”, ka thënë Kuçi, duke shtuar se zgjidhje më e gjerë nuk nënkupton zgjerim në kuptimin e koalicionit. Edhe këshilltari i parë i Pacollit, Ibrahim Gashi ka thënë se do të ketë përsëritje të procedurës së zgjedhjes së presidentit dhe se Behgjet Pacolli do të jetë kandidat nga radhët e koalicionit. Në anën tjetër, vetë presidenti tashmë i kontestuar nga Gjykata, Behgjet Pacolli është dukur më i relaksuar sesa bashkëpunëtorët e tij. Ai ka inkurajuar këta të fundit që të vazhdojnë punën në qeveri, pavarësisht “fatit të tij”. Madje ai tha se ikja e tij nga Presidenca nuk do të thotë edhe fundi i koalicionit me PDK-në.

Behgjet Pacolli Lëshon Zyrën e Presidentit Të Kosovës

## Pacolli rikandidohet për president

Behgjet Pacolli është shprehur i gatshëm për ta lëshuar karrigen e të parit të shtetit, duke paralajmëruar se prapë mund të rikandidohet për president të vendit. Pacolli ka paralajmëruar se do ta lëshojë zyrën e Presidentit të Kosovës, por nuk do të japë edhe dorëheqje pasi, sipas tij, në bazë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nuk ka nevojë për dorëheqje. Ndërsa, Qeveria dhe Kuvendi kanë thënë se e respektojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, ka paralajmëruar se do ta lëshojë zyrën e Presidentit të Kosovës, pasi në bazë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nuk ka nevojë për dorëheqje. Por ai ka paralajmëruar se prapë mund të rikandidojë për të parin e shtetit. Në një intervistë dhënë “Radio Dukagjinit”, pak minuta pas marrjes së vendimit të plotë të Gjykatës, Pacolli ka thënë se do ta respektojë plotësisht këtë vendim, ndërsa po ashtu ka thënë se nuk është i sigurt nëse do të rikandidohet për postin e presidentit. **“Nuk ka nevojë për dorëheqje, unë praktikisht largohem nga zyra e presidentit, dhe procesi do të rifillojë drejtë pikës zero. Nuk është e sigurt nëse unë do të rikandidohem për post të presidentit, kjo çështje i takon koalicionit, nëse koalicioni vendos kështu unë do të marr në konsideratë këtë vendim”**, ka thënë Pacolli. Megjithatë, sipas tij, një vendim përfundimtar nëse rikandidohet apo jo do ta marrë gjatë 24 orëve të ardhshme. Pacolli më tej ka thënë se nuk ndihet aspak fajtor për këtë situatë, pasi ai vlerësoi se personalisht nuk e ka shkelur kushtetutën. **“Unë nuk e kam shkelur kushtetutën. Jam viktimë e saj dhe unë e respektoj çdo vendim të Gjykatës”**, ka thënë Pacolli. Ai ka thënë se do të insistojë që AKR të vazhdojë koalicionin me PDK-në, dhe të jetë konstruktive në çështjet madhore për vendin. Por këshilltari i parë i Behgjet Pacollit, Ibrahim Gashi, ka zyrtarizuar rikandidimin e Behgjet Pacolli për president të Kosovës. Duke konsideruar se çështja e Pacollit do të kthehet në ‘pikën zero’, Gashi ka thënë se Behgjet Pacolli do të jetë përsëri kandidat, pasi ai, në bazë të vendimit të Gjykatës Kushtetutës, nuk e ka shkelur Kushtetutën. “Presidenti Pacolli i ka ndërprerë të gjitha aktivitetet dhe presim vendimin e Kuvendit për largim nga Presidenca”, ka thënë Gashi, në një konferencë për media të mërkurën në Presidencë.

### Krasniqi nuk ndihet fajtor

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, me t’u kthyer nga vizita e tij në Hungari ka thënë se nuk ndihet fajtor për shkak se zgjedhja e Behgjet Pacollit president është cilësuar jokushtetuese nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Kryeparlamentari me këtë rast ka thënë se ka udhëhequr një seancë të Kuvendit të Kosovës të përgatitur nga dikush tjetër dhe si kryetar i Kuvendit vetëm që e ka zbatuar planin që i është ofruar nga administrata. Ai ka theksuar se e respekton vendimin e Gjykatës, ndërkaq sipas tij procedurat e mëtejshme do të ndihen pasi ta

shohë vendimin. I pari i Kuvendit Jakup Krasniqi ka thënë se është i gatshëm të ofrojë edhe dorëheqje nëse një gjë e tillë do të kërkohej për interes të vendit dhe qytetarëve të saj. “Nëse është interes mbi të gjitha i Kosovës, ne jemi këtu për t’i mbrojtur interesat e Kosovës dhe atëherë kur mund të cenohen interesat personale të individit”, ka thënë ai. Krasniqi ka ndërprerë vizitën zyrtare në Hungari për t’u kthyer në vend pas zhvillimeve të fundit politike. Ai megjithatë tha se gjendje të tilla kanë gjëra pozitive. “Edhe në këto momente ndoshta jo krejt normale del diçka e mirë, do të thotë gatishmëria e gjithë këtyre akteve që të respektojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, dhe ne duhet të mësohemi të respektohemi nga të gjithë” ka theksuar Krasniqi. Gjykata kushtetuese e Republikës së Kosovës e ka vlerësuar si të pranueshme ankesën e Lidhjes Demokratike të Kosovës lidhur me mënyrën e zgjedhjes së presidentit të Kosovës, Behgjet Pacolli, duke vlerësuar kështu se vendimi për zgjedhjen e tij ka qenë jo kushtetues.

---

## Presidenca pa president

---

**I pari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, edhe pse ka ardhur me urgjencë nga Hungaria, nuk i merrë përgjegjësitë e u.d. të presidentit. Me këtë veprim ai e ka lënë pezull edhe Behgjet Pacollin. Me gjithë vullnetin e tij për ta respektuar verdiktin e Gjykatës Kushtetuese, Pacolli nuk ka ditur kujt t'ia lërë Presidencën**

"Ajo që është qenësore, presidenti Pacolli e ka respektuar në plotëni vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Ai i ka ndërprerë të gjitha aktivitetet dhe presim vendimin e Kuvendit për largim nga Presidenca. Mirëpo, deri tani ai nuk është kontaktuar nga kryetari i Kuvendit", ka thënë Gashi. Ai ka rikujtuar se Pacolli nuk është shkelës i Kushtetutës, por viktimë e një procesi që ka dalë të ketë qenë i parregullt në Kuvendin e Kosovës. Të njëjtën gjë e ka thënë edhe vetë Pacolli për Radio - Dukagjinin, duke e lënë të hapur edhe mundësinë e moskandidimit për këtë post. "Nuk është e sigurt nëse unë do të rikandidohem për post të presidentit, kjo çështje i takon koalicionit. Nëse koalicioni vendos kështu, unë do ta marr në konsideratë këtë vendim", ka thënë ai. Në fakt partia, të cilën ai e ka themeluar në vitin 2006, këmbëngul për rikandidimin e tij. U.d. i presidentit të AKR-së, Ibrahim Makolli, ka deklaruar se tashmë janë mbledhur edhe nënshkrimet e duhura për rikandidimin e Pacollit për president. Ish-kryetari i AKR-se ka thënë se do të insistojë që partia, të cilën e ka themeluar, ta vazhdojë koalicionin me PDK-në dhe të jetë konstruktive në çështjet madhore për vendin.

### **Krasniqi i gatshëm për pranim fajësie**

Kryeparlamentari Jakup Krasniqi, pas kthimit të parakohshëm nga vizita zyrtare në Hungari, nuk ka folur për mundësinë e marrjes së përgjegjësisë të reja si u.d. i presidentit, por më tepër është përqendruar në sqarimet mbi rrjedhën e seancës, kur u zgjodh Behgjet Pacolli president. Edhe gjatë asaj seance ai kishte thënë se po shkeleshin rregullat dhe vetë Kushtetuta. Por tash, për shkeljet e evidencuara nga Kushtetuesja, nuk e ka konsideruar veten përgjegjës. "Unë e kam udhëhequr një seancë në bazë të stenogramit që e kam pasur të përgatitur. Realisht unë i kryej përgjegjësitë e mia konform stenogramit që e kanë përgatitur dhe unë asnjë shtesë ose mangësi nuk e kam përdorur, përpos asaj që e kam pasur në stenogramin, mbi të cilat mbahen seancat plenare", ka thënë Krasniqi, në një konferencë shtypi në Aeroportin e Prishtinës pas kthimit nga Hungaria. "Unë nuk mund dhe nuk dua ta vlerësoj punën që e kemi bërë, në rrethana të ngutshme, mjaft të shpejta". I pyetur se kush është përgjegjës për stenogramin që ai e ka quajtur, e që në fakt është skenar për seancën, ai ka refuzuar të tregojë. Sipas kryeparlamentarit, këtë duhet ta thotë Gjykata Kushtetuese. Megjithatë, ka thënë të mos i ikë përgjegjësisë. "Nëse është interesi edhe imi, mbi të gjitha i Kosovës, po them përsëri mbi të gjitha i Kosovës, ne jemi këtu për t'i mbrojtur interesat e vendit tonë, edhe atëherë kur mund të cenohen interesat personale të individit", ka shtuar ai. Krasniqi ka vlerësuar se vendi tash ndodhet para një realiteti të ri. I ka quajtur si momente "jo krejt normale", por që në to, sipas tij, del diçka e mirë - gatishmëria e të gjithë aktorëve që ishin në këto procese për të respektuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese. "Kjo mendoj që është diçka që duhet të mësohemi, që vendimet e institucioneve të pavarura dhe të institucioneve kushtetuese të respektohen nga të gjithë dhe mendoj që kjo është më e mira që mund të thuhet dhe që del në këtë moment nga përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme në Kosovë", ka thënë kryeparlamentari Krasniqi.

"Ekzistojnë institucionet, ekzistojnë individët që kanë pasur përgjegjësi institucionale deri më tani dhe përgjegjësia është e tyre që t'i marrin vendimet konform Kushtetutës dhe interesit në të cilin po kalon Kosova".

### **Pacollit nuk i garantohet posti i presidentit**

Karshi zhvillimeve të fundit, nuk ka mundur të qëndrojë indiferent as bartësi i procesit të krijimit të institucioneve të dala nga zgjedhjet e 12 dhjetorit, Hashim Thaçi. Ai është shprehur optimist se vendi do të bëhet me president qysh javën e ardhshme. Qeveria, sipas tij, do të angazhohet për veprime të shpejta në përputhje të plotë me Kushtetutën, ligjet dhe normat demokratike të vendit. "Do ta plotësojmë këtë agjendë që e kemi para nesh, besoj shumë shpejt, që javën tjetër, si Kuvendi i Kosovës, partitë politike, por edhe partnerët e koalicionit", ka premtuar Thaçi. Ai ka shprehur vullnet për vazhdimin e koalicionit qeverisës, por nuk i ka premtuar Pacollit mbështetje në një rikandidim të mundshëm për president. "Koalicioni vazhdon agjendën e vet shtetërore, prandaj kam besim të plotë në mundësitë dhe mirëkuptimin e qytetarëve të vendit, në mbështetje të partnerëve tanë që të bëjmë zgjidhjen e shpejtë kushtetuese, për çka besoj në rolin pozitiv dhe aktiv edhe të opozitës, të cilët i ftoj për participim në jetën aktive", ka deklaruar ai. Për nevojën e zgjedhjes së presidentit të ri ka folur edhe zv. kryeministri, Hajredin Kuçi. Edhe ky e ka lënë të hapur mundësinë që zgjidhja për presidentin të kërkohet në një rrafsh më të gjerë politik. "Kemi nevojë për një zgjidhje më të gjerë. Mendoj se do të jemi racional të gjithë në vendimet tona. Ne jemi të gatshëm që të lëvizim sa më shpejt, që nënkupton në fillim të javës tjetër, e po ashtu presim sjellje racionale edhe nga të tjerët", është shprehur Kuçi. Ai nuk e ka parë të arsyeshme që vendi të shkojë sërish në zgjedhje të parakohshme, për sa kohë që ekzistojnë rrugë për ta tejkaluar këtë situatë. "Jemi të gatshëm të bëjmë çdo zgjidhje", është shprehur Kuçi. Zv. kryeministri nga PDK - ja nuk e ka parë si problem çështjen e kandidatëve për president. "Nëse kërkohet me Kushtetutë që të jenë dy kandidatë, do t'i bëjmë dy", ka theksuar ai. Por, ai ka shfaqur dilema nëse mund të gjendet një president konsensual, i cili do të votohej edhe nga opozita. "Në demokraci është vështirë me gjet personalitete konsensuale", ka thënë Kuçi. Kur i është përmendur Murat Jashari, si një nga opsionet e mundshme, ai ka thënë se ka aluduar në ata që aktualisht janë në politikë. Ndonëse ka qenë kryesues i Komisionit për hartimin e Kushtetutës, Kuçi ka shprehur rezervat e tij nëse duhet të jenë 2/3 e deputetëve në Kuvend gjatë zgjedhjes së presidentit. Ky (kriter v.j.) mund të jetë një bllokim që mund të shfaqet edhe pas pesë vjetëve e jo vetëm sot. Unë nuk e kam ditur se ka qenë një çështje e tillë", ka thënë ai. Kuçi nuk ka dhënë përgjigje nëse Kosova ka pasur president që nga 22 shkurti, duke u arsyetuar se nuk i interpreton vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Por në një gjë ai është shprehur i sigurt. Ka thënë se barra më e madhe i mbetet kryeministrit Thaçi që ta gjejë zgjidhjen për të dalë nga gjendja e krijuar në vend.

## Opozita jashtë sa herë që votohet për Pacollin

**Ndërsa kryeministri Thaçi u shpreh i bindur se Kuvendi shumë shpejt do ta zgjedhë presidentin, opozita këmbëngul se do ta lëshojë sallën në momentin që Pacolli kandidon për president**

Jemi në një marrëveshje kalimtare e cila do t'i afatizojë gjërat. Do të jetë një agjendë e qartë e zhvillimeve, e ndryshimit të Ligjit zgjedhor Kushtetutës dhe caktimi i datës së re të zgjedhjeve.

Largimi i Behgjet Pacollit nga Presidenca pas konstatimit të Gjykatës Kushtetuese për mos respektim procedurash gjatë zgjedhjes së tij në postin e presidenti, nuk ka ndryshuar diç në formulën e ardhshme qeverisë. Kryeministri Hashim Thaçi shprehet i bindur se nuk ka vakum institucional dhe se presidenti do të zgjidhet së shpejti, përderisa opozita kërkon një marrëveshje për një qeverisje të përkohshme deri në zgjedhjet e reja. Nga koalicioni qeverisës, Behgjet Pacolli është rikandiduar, ndërkaq janë në përfundim e sipër edhe diskutimet se kush do t'i dalë përballë Pacollit vetëm sa për të përmbushur procedurat kushtetuese. Pasi që opozita nuk e ka ndërmend t'i qesë një kundërkandidat Pacollit dhe madje as të qëndrojë në seancë kur do të votohet për të, i mbetet koalicionit që të dalë me dy kandidatë. Por, halli i pozitës është se si të sigurojë kuorumin prej 80 deputeteve në sallë, të cilin e ka kërkuar Kushtetuesja, si pjesë të procedurave para se të shkohet në votim. Deputetët e opozitës morën dje një "kërcënim" publik nga deputeti i PDK - së, Berat Buzha tha, se nëse e lëshojnë seancën e ardhshme kur do të votohet për presidentin, ai do t'i padisë në Gjykatën Kushtetuese. "Unë e di se ju nuk keni respekt për votën që ju kanë dhënë qytetarët që të merrni pjesë në seancë. Por, bojkotit tuaj i ka ardhë fundi dhe herën tjetër do të përballeni me padinë personale në Kushtetuese", iu drejtua Buzhala deputeteve opozitare. Si kundërpërgjigje, Buzhala mori një seri kritikash nga deputeti i LDK - së, Ismet Beqiri i cili i tha atij se nuk ka kapacitete ta kuptojë vendimin e fundit të Kushtetueses. "Ky duhet me e ditë më së pari edhe me shku në shkollë, se ky nuk ka shkollë të kryeme për këtë punë. Nëse është mësue në ndonjëfarë regjimi ku merren sanksione kjo është punë e tij", tha Beqiri. Kushtetuta, nënvizoi Beqiri, me asnjë nen nuk u kërkon deputetëve të jenë të pranishëm në sallë gjatë kohës së votimit për presidentin, dhe se interpretimi i Kushtetueses është më shumë i karakterit moral. Si edhe para seancës së 22 shkurtit, opozita nuk jep asnjë shenjë se do të tregojë respekt për Pacollin, kandidat i PDK së dhe AKR - së për president të vendit. Por, ky fakt nuk e shqetëson kryeministrin Hashim Thaçi, i cili beson në një zgjidhje të shpejtë. "Është në autoritetin e Kuvendit dhe Kuvendi do të mblidhet shpejt dhe Kosova do ta ketë presidentin e vet", u shpreh Thaçi. "Ne do të vazhdojmë me hapa konkretë sipas marrëveshjes që e kemi pasur edhe më herët. Në asnjë rrethanë nuk do të lejohet vakum por funksionim i mirë i institucioneve", deklaroi ai. Krejt ndryshe këtë situatë e shohin partitë në opozitë. LDK u dërgon sërish sinjale partive tjera që të arrihet një marrëveshje kalimtare deri në zgjedhjet e ardhshme. "Jemi për një marrëveshje kalimtare e cila do t'i afatizojë gjërat. Do të jetë një agjendë e qartë e zhvillimeve, e ndryshimit të Ligjit zgjedhor, Kushtetutës dhe caktimi i datës së re të zgjedhjeve", thotë Beqiri. Kjo marrëveshje, sipas tij, nuk e përfshin LDK - në në koalicionin qeverisës. "Nuk mendojmë në asnjë formë të hyjmë në qeveri, por jemi të gatshëm të japim kontributin tonë", thekson ai. Lëvizja Vetëvendosje, e cila deri më tani ka funksionuar kryesisht "solo" pa u ndërlidhur me veprimet e partive në pushtet apo atyre në opozitë, ka një qëndrim të qartë, nuk e mbështet Pacollin për president. Visar Ymeri, deputet i Vetëvendosjes, thotë se qëndrimi mbetet i njëjtë, nuk ka mbështetje dhe vota për Pacollin, kurse vendimet tjera ai thotë se ky subjekt do t'i marrë para

seancës kurdo që ajo planifikohet të thirret. Përderisa AAK vazhdon ta ketë "halë në sy" Hashim Thaçin, të cilin e fajëson për zhvillimet negative në vend. Deputeti i AAK - së, Ardian Gjini, thotë se shteti po mbetet peng i tekave të Thaçit dhe të dy tre njerëzve. "Nuk ka faj opozita që po thotë se ky njeri, Pacolli, nuk përfaqëson as minimumin e unitetit të popullit, nuk mund të bëhet president, ndërkaq Hashim Thaçi, i cili i ka bërë dëme të pariparueshme vendit, nuk duhet të jetë kryeministër", thotë Gjini. Në bazë të qëndrimeve të partive në pushtet dhe atyre në opozitë në lidhje me rastin Pacolli, sigurimi i kuorumit për zgjedhjen e tij president i vendit duket të jetë i pamundshëm. Çdo bojkotim i seancës në momentin e votimit, do ta detyronte kryeparlamentarin Krasniqi të ndërpriste menjëherë mbledhjen. Kjo për arsye se Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se për zgjedhjen e presidentit në sallë duhet të ketë dy të tretat apo minimumi prej 80 deputetëve në sallë, si dhe të ketë një kundër kandidat.



---

## LDK e ndarë në dysh për Pacollin

---

**Behgjet Pacolli do të rikandidojë për President. Ndërsa, për dallim nga hera e kaluar, ai po pretendon të marrë edhe mbështetjen e LDK-së, të paktën që ajo të jetë prezentë në sallë. Mirëpo, për këtë LDK-ja është e ndarë në dysh. Burime të gazetës mësojnë se grupi i "hamitëve" është duke kundërshtuar që Pacollit t'i jepet mundësia të zgjidhet President**

Behgjet Pacolli ka arritur të marrë edhe mbështetjen e Lidhjes Demokratike të Kosovës, për t'i dalë në krye zgjedhjes së tij president edhe njëherë, kanë mësuar burime të gazetës Infopress. Por siç mësohet, kjo mbështetje vjen vetëm nga një pjesë e partisë, pasi grupi i "hamitëve" në LDK, me në kryedeputetin Sabri Hamiti, është duke kundërshtuar mbështetjen për Pacollin. Se LDK ka nisur të zbusë qëndrimin e saj, mund të nënkuptohet edhe nga deklarata e shefit të Grupit Parlamentar të LDK - së, Ismet Beqiri, i cili thotë se LDK-ja do të qëndrojë në sallën e Kuvendit të Kosovës, gjatë zgjedhjes së Presidentit, nëse paraprakisht arrihet marrëveshje për disa nga kërkesat e kësaj partie, që kanë të bëjnë me caktimin e një date të re për zgjedhjet e ardhshme.

### Po me kushte

Ismet Beqiri, tha se ata do të mund që të jepnin kontributin e tyre si LDK, në çdo çështje që është në të mirë të vendit, por jo për të hyrë në koalicion dhe assesi pa u bërë të qarta disa çështje që kanë të bëjnë me të ardhmen. "Ne i kemi qëndrimet e qarta, si LDK kemi thënë jemi për një marrëveshje kalimtare, marrëveshje e cila do t'i afatizojë gjërat, do të jetë një agjendë e qartë e zhvillimeve të ndryshimit të ligjit zgjedhor kushtetues në Kosovë dhe caktimi i datës së re të zgjedhjeve dhe kjo nuk nënkupton që LDK-ja është e gatshme me hy në koalicion në qeveri në asnjë formë, por jemi të gatshëm me e dhënë kontributin tonë si LDK nëse bëhet kjo marrëveshje dhe përcaktohet kjo agjendë e qartë për të ardhmen. A do të shkojë një vit a një vit e gjysmë nuk është e imja ta paragjykoj, por nëse kjo agjendë miratohet dhe arrihet kjo marrëveshje ne do ta japim kontributin tonë që të shkojmë në zgjedhje të përgatitur mirë", ka thënë Beqiri.

---

## **AKR me dy kandidatë për President**

---

**Sikurse herën e parë, por me një dallim të vogël, Behgjet Pacolli do të jetë kandidati kryesor për President të vendit. Vetëm se kësaj here për të përmbushur obligimin kushtetues të garës me dyandidate, AKR ka mbledhur nënshkrimet për të kandiduar për president edhe Suzana Novobërdailun, anëtare e AKR - së**

Aleanca Kosova e Re, ka mbledhur nënshkrimet e nevojshme për të proceduar me zgjedhjen e Presidentit të Kosovës. Në këtë rast jo me një kandidat, por me dy. Përveç Behgjet Pacollit, kandidat për president do të jetë edhe Suzana Novobërdaliu, anëtare e AKR-së. Me këtë AKR ka arritur të plotësojë njërin nga kushtet kushtetuese për të proceduar me zgjedhjen e presidentit. Ndërsa, kushti tjetër ai i pranisë së dy të tretave të deputetëve në sallë gjatë zgjedhjes së Presidentit, nuk dihet nëse do të arrihet, pasi opozita ka paralajmëruar sërish bojkot. Ndërsa, partneri tjetër i koalicionit, PDK, gjegjësisht kryetari i saj, Hashim Thaçi nuk ka dashur që të komentojë gjatë çështjes së zgjedhjes së Presidentit apo edhe procedimin e kandidatit, por vetëm ka thënë se kjo çështje do të zgjidhet shumë shpejt nga Kuvendi. "Është në autoritetin e Kuvendit, prandaj Kuvendi do të mblidhet shpejt dhe Kosova do ta ketë Presidentin e vet. Koalicioni është duke punuar në funksionim të shkëlqyeshëm, andaj do të vazhdojmë me hapat tonë konkretë sipas marrëveshjes që kemi pasur. Kosova do ta ketë Presidentin e vet, dhe në asnjë rrethanë nuk do të lejohet ndonjë vakuum, por funksionim i mirë i institucioneve", ka thënë Thaçi duke mos dashur që të komentojë nëse Pacolli do të rikandidohet ose jo për president.

### **Janë mbledhur nënshkrimet për Behgjet Pacollin**

Myzejene Selmani, në emër të Aleancës Kosova e Re, ka konfirmuar që propozimi i kandidatit për president të vendit, Behgjet Pacolli, tashmë i ka marrë edhe nënshkrimet e nevojshme që të rikandidohet. "Të gjitha nënshkrimet për kandidimin e z.Pacollit janë mbledhur, janë mbledhur edhe nënshkrimet për seancë të jashtëzakonshme dhe tash do të pritet të aprovohen prej administratës së Kuvendit dhe të qiten në kryesi të Kuvendit se kur do të mbahet seanca e jashtëzakonshme. Ato janë të gatshme që sot të dorëzohen. Sipas të gjitha gjasave ne pas protokollimit të zyrës së protokollit të Kuvendit, atëherë i drejtohet kryesisë dhe ajo cakton seancën e radhës kur do të bëhet zgjedhja e Presidentit", ka thënë Selmani. Edhe deputetja Selmani, konfirmoi para gazetarëve se marrëveshja e koalicionit qeverisës PDK -AKR, është ende e vlefshme sa i përket kandidimit për president të z. Pacolli, por ajo gjithashtu tha se do të ketë edhe një kandidat tjetër për president përpos Pacollit, emri i të cilit sipas saj do të bëhet i ditur shumë shpejt, e që sipas burimeve të gazetës, kandidate është Suzana Novobërdaliu, për të cilën gjithashtu janë mbledhur nënshkrimet e nevojshme.

### **Opozita paralajmëron sërish bojkotin**

Megjithatë, në anën tjetër janë opozita që po vazhdojnë kundërshtimet e rikandidimit të Pacollit për president. Ata ende vazhdojnë me qëndrimet e tyre, madje përsërisin se ka gjasa që edhe kësaj radhe ta lëshojnë seancën e Kuvendit sikurse edhe herën e parë. Visar Imeri, shef i Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, duke komentuar interpretimin e Kushtetueses që dalja nga seanca e parlamentit me rastin e votimit të presidentit është akt joligjor, ka thënë se kjo është e

drejtë e gjithë secilit që në rast se dëshiron të kundërshtojë një veprim edhe ta bojkotojë seancën, gjë e cila ndodh në të gjitha vendet demokratike. Ndërkaq, ai ripërsëriti edhe një herë qëndrimin e Vetëvendosjes, që nuk do ta votojnë Pacollin për president nëse ai rikandidohet. "Vetëvendosje e ka bërë të qartë kundërshtimin parimor ndaj kandidaturës së Pacollit në seancën e parë kur u votua për të dhe meqenëse Pacollin e kemi quajtur të papranueshëm edhe aktualisht, por edhe për shkak të historikut të tij kemi konsideruar që gjatë votimit për të nuk duhet të qëndrojmë në sallë. Aktgjykimi kushtetues për sa i përket daljes së deputetëve nga salla me rastin e votimit për Presidentin ka qenë më shumë një lloj interpretimi moralizues sesa që mund të interpretohet Kushtetuta në një aspekt të tillë", ka thënë Imeri. Edhe shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri ka thënë se qëndrimet e LDK-së tashmë janë të qarta, ato që kanë qenë edhe më parë. "Si LDK kemi thënë jemi për një marrëveshje kalimtare, marrëveshje e cila do t'i afatizojë gjërat, do të jetë një agjendë e qartë e zhvillimeve të ndryshimit të ligjit zgjedhor kushtetues në Kosovë dhe caktimi i datës së re të zgjedhjeve dhe kjo nuk nënkupton që LDK-ja nuk është e gatshme me hy në koalicion në qeveri në asnjë formë, por jemi të gatshëm me e dhënë kontributin tonë si LDK nëse bëhet kjo marrëveshje dhe përcaktohet kjo agjendë e qartë për të ardhmen. A do të shkojë një vit a një vit e gjysmë nuk është e imja ta paragjykoj, por nëse kjo agjendë miratohet dhe arrihet kjo marrëveshje ne do ta japim kontributin tonë që të shkojmë në zgjedhje të përgatitura mirë", është shprehur Beqiri. Rikandidimin për president të Pacollit e ka komentuar edhe Ardian Gjini i AAK-së, i cili tha se AAK-ja prapë do ta braktisë seancën si atë të kaluarën, ndërkaq sipas tij ka rrethana të tjera se si mund të zgjidhen të gjitha këto çështje. "Nëse rrethanat do të jenë të njëjta ne prapë do ta braktisim seancën e Kuvendit të Kosovës. Mendojmë se ka mundësi për shumë rrethana ndryshe, nuk dua të spekulojë tash, mund të jenë 100 rrethana ndryshe. Nëse do të jetë z. Pacolli kandidat për President të Kosovës, në këtë koalicion me z. Thaçi, ne prapë do ta lëshojmë sallën e Kuvendit", ka thënë Gjini.

---

## **Myzejene Selmani, kundërkandidatja e Pacollit**

---

Kundërkandidatja e Behgjet Pacollit për postin e Presidentit të Kosovës vie nga subjekti i njëjtë politik, nga AKR, dhe ajo është deputetja Myzejene Selmani. Sipas raportimeve në medie të ndryshme, thuhet se deri më tani janë mbledhur 100 nënshkrime, nga të cilat 40 janë nënshkrimet e nevojshme për tu thirrur mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit, e cila duhet të mbahet të hënën. Nënshkrimet do t'i dorëzohen Zyrës përgjegjëse të Kuvendit të premtën paradite. Krahas kësaj, tanimë janë mbledhur edhe nga 30 nënshkrimet e nevojshme për kandidatët për presidentin e ardhshëm të Kosovës dhe të njëjtat do të dorëzohen poashtu të premtën. Seanca e ardhshme e Kuvendit do të ketë në rend të ditës zgjedhjen e Presidentit. Po ashtu më parë gjatë ditës është spekuluar se kandidatë për president është deputetja Syzana Novobërdaliu, po nga AKR-ja.

### Zgjedhja e presidentit e bllokuar

**LDK - ja kërkon një marrëveshje politike për të marrë pjesë në seancën ku do të rivotohet kandidati për president, Behgjet Pacolli. Vetëvendosje dhe AAK - ja janë kundër rikandidimit të tij. Nëse qëndrimet nuk ndryshojnë, vendi mund të shkojë në zgjedhje të reja**

Partnerët e koalicionit kanë mbledhur të gjitha nënshkrimet e nevojshme për kandidaturën e Behgjet Pacollit. Por ky i fundit këtë herë nuk do të jetë i vetëm në garë. Ai do të ketë edhe një kundër kandidat sipas burimeve tona, për të cilën janë afër përfundimit të nënshkrimeve. Jo zyrtarisht raportohet se bëhet fjalë për ish deputeten Suzana Novobërdaliu. Megjithatë, votimi nuk mund të ketë sukses nëse nuk merr pjesë opozita. Forcat e opozitës kanë theksuar se prapë do ta bojkotojnë seancën nëse Pacolli do të jetë kandidat për president. Por, kreu i ekzekutivit të vendit, Hashim Thaçi, ka thënë se Kosova do të bëhet shumë shpejt me president legjitim dhe se në asnjë rrethanë nuk do të lejohet vakum institucional. "Ne nuk kemi nevojë për eksperimente, por për funksionim efektiv dhe efikas të institucioneve me respektimin e plotë të vullnetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës", ka thënë Thaçi. Deputetja e AKR-së, Myzejene Selmani, ka bërë të ditur se janë mbledhur nënshkrimet për kandidaturën e Pacollit dhe për seancën e jashtëzakonshme, dhe pritet të aprovohet prej administratës së kuvendit dhe t'i dorëzohen Kryesisë së Kuvendit për ta caktuar seancën. "Jemi afër me nënshkrimet edhe për kandidatin e dytë", tha znj. Selmani, pa dhënë hollësira rreth asaj se cili do të jetë. Me këtë besohet se do të përmbushet obligimi kushtetues, në mënyrë që ana formale të plotësohet. Ajo shfaq bindjen që opozita do të jetë racionale. "Besoj që kësaj radhe opozita do të jetë konstruktive në të mirë të shtetit të Kosovës. Duke marrë parasysh se edhe unë kam qenë në opozitë, në çështjet me rëndësi asnjëherë nuk e kam llogaritur veten opozitë, por i kam kryer obligimet", ka thënë ajo. Në vendimin e kushtetueses është vlerësuar se mungesa e kuorumit është gjithashtu antikushtetuese.

### Beqiri: Kosova nuk është Kubë

Opozita konsideron se as Gjykata Kushtetuese, as askush tjetër nuk mund t'ia mohojë deputetit apo një grupi parlamentar që ta lëshojë seancën. Shefi i Grupit parlamentar të LDK - së, Ismet Beqiri, nuk e ka thënë direkt nëse LDK-ja do ta lëshojë sallën, por ka thënë se Kosova nuk është Kubë dhe nuk është shtet me diktaturë, dhe askush nuk ka të drejtë që t'i obligojë deputetët që të rrinë në sallë. "Kjo që tentohet nga dikush të thuhet që është obligative të rrijë dhe nuk guxon askush të dalë nga seanca, kjo nuk ka ndodhur as në botën demokratike, as nuk mund t'i ndodhë Kosovës. Askush nuk mund ta ndalojë deputetin, as grupin parlamentar të cilësdo parti ta lëshojë seancën nëse nuk pajtohet për një propozim, duke llogaritur se ai është në interes të shtetit. Edhe lëshimin e seancës për një çështje të caktuar e llogarisim se mund të jetë në interes të shtetit", ka thënë Beqiri. Pozicioni i LDK-së është për një marrëveshje kalimtare, për të cilën siç tha Beqiri "do t'i afatizojë gjërat, do të jetë një agjendë e qartë e zhvillimeve të ndryshme, ndryshimi i Ligjit zgjedhor, Kushtetutës dhe caktimi i datës së zgjedhjeve të reja". Por kjo sipas tij nuk nënkupton që LDK-ja është e gatshme të hyjë në koalicion me qeverinë, por është e gatshme të japë kontributin si LDK nëse bëhet kjo marrëveshje dhe nëse përcaktohet kjo agjendë. "A do të shkojë një vit, apo një vit e gjysmë nuk është imja ta paragjykoj, por nëse kjo

agjendë miratohet dhe arrihet kjo marrëveshje, ne do ta japim kontributin tonë që të shkojmë në zgjedhje të përgatitura mirë dhe le të fitoj kush fiton", tha ai. Beqiri tha se nuk ka pasur asnjë kontakt me mazhorancën. Dështimi eventual i zgjedhjes së presidentit mund të çojë në zgjedhje të jashtëzakonshme. "LDK ja nuk ia ka drojën asnjërit prej varianteve. Ajo që kërkojmë është të mbrohet ligjshmëria, kushtetutshmëria dhe vota", ka thënë ai.

### **Edhe AAK - ja paralajmëron bojkot**

Ardian Gjini nga AAK - ja është shprehur qartë se deputetët e kësaj partie nuk do të rrinë në sallë nëse Pacolli do të jetë kandidat. "Nëse do të jetë zoti Pacolli kandidat për president të Kosovës në këtë koalicion me zotin Thaçi, ne prapë do ta lëshojmë sallën e kuvendit", ka thënë shkurt Gjini. Ai nuk e konsideron si antikushtetues bojkotin e seancave. "Është e drejtë demokratike shumë legjitime. Është gabim shumë i madh të tentohet në çfarëdo mënyre të obligohen deputetët me u thirrur në mënyrën qysh dikujt i konvenon. Gjini konsideron se vendi nuk është pa president. "Shteti i Kosovës ka institucionet, ka kryetar të kuvendit, i cili mund të ushtrojë postin e presidentit. Kemi qeverinë e votuar, edhe pse e keqe, por është votuar. Kemi Gjykatën Kushtetuese, do të thotë se shteti nuk ka mbetur peng. Ai tha se nuk është në dijeni nëse ditë më parë zyrtarë të këtij subjekti janë takuar me kryeministrin Thaçi. Por nëse një gjë e tillë ka ndodhur, sipas tij është jovalide. "Zyrtarisht askush nga zyrtarët e AAK-së, askush nuk ka kontaktuar me kryeministrin dhe nuk jam në dijeni për këtë si nënkryetar. Nëse ka pasur jashtë dijenisë së nënkryetarëve, atëherë janë totalisht jovalide", ka thënë Gjini . I. KRASNIQI

---

## **Gjykata Kushtetuese e “emërton” Jakup Krasniqin U.D president të vendit**

---

*Sa i përket pyetjes se tretë nëse Kosova ka President, përkatësisht ushtrues të detyrës së Presidentit, përgjigja është që Kosova ka ushtrues të detyrës së Presidentit që nga 31 marsi 2011.*

PRISHTINË, 1 PRILL - Gjykata Kushtetuese ka dhënë sqarime shtesë në lidhje me vendimin e nxjerrë ditë më parë nga kjo gjykatë me të cilin shfuqizoi procedurat e zgjedhjes së presidentit, të cilat u vlerësuan si jo kushtetuese. Në vendimin e së premtes, i cili përmban sqarime për pyetjet e parashtruara nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, nga Qeveria e Kosovës dhe Behgjet Pacolli, Kushtetuesja thekson se vendimi i saj për shfuqizimin e mandatit të presidentit ka hyrë në fuqi nga 30 marsi.

### **Vendi nuk ka vakuum institucional**

Në pyetjet e parashtruara nga kryetari i Kuvendit, se çka nënkupton termi praktik se Aktgjykimi nuk ka efekt retroaktiv, si pasojë e këtij Aktgjykimi, a duhet të shkojë vendi në zgjedhje të parakohshme dhe aktualisht, a ka vendi President, përkatësisht ushtrues detyre të Presidentit, në sqarimin e Kushtetueses thuhet se vendi nuk ka vakuum institucional dhe se aktvendimi i gjykatës nuk imponon shpërndarjen e Kuvendit, dhe se ka ushtrues detyre të presidentit të vendit, pa sqaruar se cili është ai.

"Sa i përket pyetjes se parë nëse Aktgjykimi i kësaj Gjykate ka efekt retroaktiv, përgjigja është se Aktgjykimi i kësaj Gjykate hyn në fuqi me efekt të menjëhershëm me 30 mars 2011 dhe se Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04 - V - 04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, i 22 shkurtit 2011, më nuk është në fuqi që nga 31 marsi 2011, që është data e publikimit të këtij Aktgjykimi në Gazetën Zyrtare. Sa i përket pyetjes se dytë nëse Aktgjykimi i kësaj Gjykate imponon shpërndarjen e Kuvendit dhe mbajtjen e zgjedhjeve të reja, përgjigja është jo. Sa i përket pyetjes se tretë nëse Kosova ka President, përkatësisht ushtrues të detyrës së Presidentit, përgjigja është që Kosova ka ushtrues të detyrës së Presidentit që nga 31 marsi 2011. Pra, nuk ka vakuum institucional që nga data e publikimit të këtij Aktgjykimi", sqaron Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj.

### **Gjykata nuk i obligon deputetët**

Ndërkaq, në pyetjen e parashtruar nga qeveria nëse është detyrim kushtetues prania e dy të tretave të deputetëve në sallë, në rundin e parë dhe të dytë të zgjedhjes së presidentit dhe nëse mund të shkohet direkt në rundin e tretë, po që se nuk janë 80 deputetë të pranishëm, Gjykata nuk ka dhënë sqarim në këtë pyetje. "Gjykata rikujton që qëllimi i këtij sqarimi është ta sqarojë Aktgjykimin dhe nuk ka autoritet për të dalë jashtë objektit të çështjes së kërkesës. Prandaj, situatat hipotetike, siç janë përmendur në letrën e kryeministrit, janë jashtë kufirit të objektit të çështjes dhe mund të jenë bazë për një rast të ri", thuhet në sqarimin e Gjykatës Kushtetuese. Ndërsa në pyetjen e Behgjet Pacollit se a shkakton largimi i tij nga zyra vakuum institucional të institucionit më të lartë të shtetit, duke pasur parasysh se askush nuk ka kërkuar që ta marrë

përsipër ushtrimin e detyrës së Presidentit deri të zgjedhja e re, Kushtetuesja është përgjegjur se Kosova ka ushtrues detyrë të presidentit nga 31 marsi dhe se nuk ka vakuum institucional. "Sa u përket çështjeve të ngritura nga z. Pacolli në letrën e tij të 31 marsit 2011, përgjigja në të është dhënë në paragrafin 12, që Kosova ka ushtrues të detyrës së Presidentit që nga 31 marsi 2011. Pra, nuk ka vakuum institucional që nga data e publikimit të këtij Aktgjykimi", thuhet në këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese. Përgjigja e Gjykatës Kushtetuese duket se edhe më tutje nuk i ka sqaruar të gjitha çështjet dhe dilemat e Qeverisë dhe të Kuvendit. Se çka do të ndodhë në ditën në vazhdim do të shohim, por se megjithatë në institucionet e Kosovës mbretëron një gjendje "kaotike" kjo është shumë e vërtetë.



---

## **Pacolli: Vetëm sinqeriteti mund ta nxjerrë Kosovën nga kjo gjendje**

---

**Bota sot:** z. Pacolli, ka disa pohime në media të paqarta rreth rikandidimit për President. A do të rikandidoheni për këtë post?

**Z. Pacolli:** Faktikisht nuk jam deklaruar ende asgjë dhe askush nuk ka biseduar me mua për të ushtruar ndonjë presion dhe asnjë bisedë që të rikandidohem. Pra, nuk kam biseduar me askënd që të më shtyj që të tërhiqem apo të rikandidohem. Kështu që këto ditë u jam larguar edhe medieve edhe thashethemeve. Asgjë të re nuk ka në lidhje me Presidencën, krejt deklarimet që i bënë partia, i bënë në emër të saj duke shprehur qëndrimin e AKR-së. Çdo gjë deri tash mbetet ashtu siç ka qenë dhe unë besoj se të martën do të deklarohej se çka do të bëjë më tutje.

**Bota sot:** Deri të martën nuk prisni ndonjë zhvillim?

**Pacolli:** I kanë mbledhur nënshkrimet për të rikandiduar unë, prap me idenë për të mirën e Kosovës, por unë ende nuk jam deklaruar se a dua apo nuk dua të kandidohem?

**Bota sot:** A keni pasur përpjekje për të kontaktuar me LDK-në dhe parti tjera për të zgjidhur situatën?

**Pacolli:** Jo. Unë nuk kam kontaktuar me askënd. Mua më kanë vizituar njerëz të politikës, por nuk kam fol për këtë punë, se a duhet të marrë pjesë apo jo. Po shohim nëpër portale se LDK-ja është deklaruar se nuk do të marrë pjesë dhe kjo është e drejtë e tyre.

**Bota sot:** Sa jeni duke gjetur tani përkrahje nga njerëzit, qytetarët, politikanë dhe partitë?

**Pacolli:** Po kam shumë përkrahje nga qytetarët që të rikandidohem. Më inkurajojnë, që të rikandidohem dhe njerëzit që janë përkrahësit dhe simpatizuesit e mi. Unë për këto ditë sa kam qenë President nuk e kam shpenzuar buxhetin e Kosovës. Të gjitha udhëtimet që i kam bërë, i kam bërë me shpenzimet e mia. Kështu që ka qenë një plan njëvjeçar dhe çdo gjë ka qenë e parashikuar, veçanërisht në muajin e dytë e kam pasur një agjendë të ngjeshur për të udhëtuar me qëllim të marrjes e sa më shumë njohjeve.

**Bota sot:** Do të thotë se muaji i dytë i Presidencës suaj, do të ishte një kontribut serioz për njohjet, kështu mendoni?

**Pacolli:** Muaji i dytë ka qenë i parashikuar shumë më aktiv se i pari, sidomos në planin ndërkombëtarë, kam pasur të bëjë vizita të përgatitura në vendet afrikane për të punuar në rrafshin e njohjeve, mirëpo tani ato vizita kanë rënë krejt deri në një vendim të ri të Kuvendit. Mirëpo, ajo që ka ngjarë, e rikthen idenë time që presidenti të zgjidhet nga qytetari.

**Bota sot:** A jeni të gatshëm që ta rimerrni detyrën e presidentit me një marrëveshje që pas një viti të ketë zgjedhje të presidentit nga populli?

**Pacolli:** Unë do të insistoj që të ndodhë kjo, që presidenti të zgjidhet me votën e qytetarit, mirëpo nuk e di se a do të rikandidoj. Sinqerisht e kam parë se në Kosovë nëse t'i don të punosh

sinqerisht dhe për të mirën e vendit, të pengojnë shumë. Do të doja shumë që të dominonte një klimë ku puna dhe sinqeriteti të respektohet.

---

## **Pacolli ia dorëzon Krasniqit postin e Presidentit**

---

Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Jakup Krasniqi merr të shtunën postin e Ushtruesit të Detyrës së Presidentit të Kosovës. Në Kabinetin e Presidentit do të organizohet ceremonia e dorëzimit të detyrës nga presidenti i deritashëm, Behgjet Pacolli dhe pranimi i saj nga ana e kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Gjykata Kushtetuese e Kosovës, të mërkurën, e bëri publik aktvendimin e plotë mbi zgjedhjen e Behgjet Pacollit si president. Në aktvendim thuhet se zgjedhja e tij si president pa asnjë kundërkandidat ka paraqitur shkelje të nenit 86 të Kushtetutës së Kosovës. Po ashtu edhe mungesa e kuorumit është vlerësuar si antikushtetuese.

## President konsensual ose zgjedhje në maj

Ndërsa kryeministri Hashim Thaçi i bëri thirrje opozitës të mos vazhdojë bojkotin që për zgjedhjen e presidentit, këta të fundit thonë se për këtë duhet një marrëveshje. Por, deri më tani nuk ka një ide të artikuluar qartë rreth daljes nga kjo krizë e re. Në Kryesinë e Kuvendit deri në orët e pasdites nuk ka arritur asnjë kërkesë për seancë të jashtëzakonshme. Qëndrimin bojkotues të opozitës, Thaçi e ka vlerësuar të rrezikshëm për stabilitetin e vendit në procesin zhvillimor e integruar. Ai e ka ftuar opozitën që mos ta vazhdojë bojkotin, por të marrë pjesë në seancën në të cilën pritet të zgjidhet presidenti, ndryshe bojkoti i opozitës mund ta çojë vendin në zgjedhje të jashtëzakonshme, të cilat nuk i meritojnë qytetarët e Kosovës, por nuk i pret as Uashingtoni dhe Brukseli. Këto komente Thaçi i bëri pas takimit me përfaqësuesin e Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan, Avni Mustafa, me ç' rast ka bërë të ditur se seanca në të cilën do të bëhet zgjedhja e presidentit do të mbahet shumë shpejt. Paraprakisht, sipas tij Qeveria pas mbledhjes së djeshme, i ka dërguar Gjykatës Kushtetuese një kërkesë për të sqaruar nëse deputetët e shkelin Kushtetutën, duke e bojkotuar seancën. Megjithatë, ai ka thënë se gjykata ka konfirmuar se shkelja ka ndodhur nga bojkotuesit e seancës dhe jo nga ata që kanë marrë pjesë në seancë.

### Thaçi: Mund të shkojmë në zgjedhje për 45 ditë

Menjëherë pasi gjykata të japë përgjigje, Thaçi ka paralajmëruar se Kuvendi do të mblidhet për të bërë zgjedhjen e presidentit. Ai ka thënë se në asnjë mënyrë nuk do të lejohet që të mbahet peng ky post, për shkak se do të dështojë edhe buxheti nëse nuk ka kush ta nënshkruajë. "Nuk është shkollë e mirë që bojkoti të bartet në Prishtinë, qoftë i rrugës apo në Parlament", ka thënë Thaçi. Ai tha se nëse kjo pjesë e opozitës vendos të vazhdojë bojkotimin, atëherë detyrimisht e çojnë vendin drejt zgjedhjeve të jashtëzakonshme, brenda 45 ditësh, të cilat në gjykimin e tij nuk i konvenojnë as popullit të Kosovës, as miqve ndërkombëtarë, Brukselit dhe Uashingtonit. "Ftoj opozitën të jetë aktive dhe të dalë mbi interesat e ngushta partiake apo individuale, por këtë proces të ngrirë të zgjedhjes së presidentit nuk mund ta mbajë askush. Do të gjejmë hapësirën legale dhe presidenti do të zgjidhet dhe ne do të procedojmë në orët e ardhshme", është shprehur Thaçi. Ai ka përmendur me këtë rast sjelljen e PDK-së si parti opozitare, duke thënë se në të gjitha rastet, si në vitin 2001, në vitin 2004, 2006 dhe 2008, ka qenë pjesë aktive e zgjedhjes së presidentit dhe e të gjitha institucioneve tjera të Kosovës. Ai tha se mënyra e bojkotit do t'i dështojë reformat demokratike të Kosovës, do ta dështojë dialogun për liberalizimin e vizave, marrëdhëniet kontraktuale me BE - në, do ta rrezikojë shtyrjen e agjendës euro - atlantike dhe investimet kapitale, e po ashtu do ta rrezikojë edhe buxhetin e Kosovës, për shkak se nuk ka kush ta nënshkruaj. I pyetur për mundësinë e një presidenti konsensual, ngase Pacolli nuk është i pranueshëm prej opozitës, Thaçi ka theksuar se partnerët e koalicionit gjithmonë i kanë propozuar kandidatët e tyre, qoftë për president, apo për kryeministër dhe në këtë rast ai ka rikujtuar se Kosova ka pasur edhe kryeministër më 7 për qind të votave. Ditë më parë, kryeparlamentari Jakup Krasniqi ka thënë se është më mirë të gjendet një president konsensual. Por, kryeministri Thaçi nuk deshi ta komentojë deklaratën e z. Krasniqi, duke i bërë thirrje opozitës që të dalë mbi interesat e ngushta partiake apo individuale, që mos ta lërë të ngrirë postin e presidentit, për të cilin ka thënë se nuk mund ta mbajë askush dhe se do të gjendet hapësirë legale që presidenti të zgjidhet shumë shpejt dhe

në këtë drejtim ai ka thënë se kjo çështje do të procedohet brenda orëve të ardhshme. Ndërsa, kryeparlamentari Jakup Krasniqi ka pranuar se është krijuar një konfuzitet me rastin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, mirëpo pret që ky konfuzitet do të zgjidhet shumë shpejt. Për këtë, ai nuk e fajëson kryeministrin Hashim Thaçi, ndërkohë, paralajmëron se asnjë vendim i Gjykatës Kushtetuese nuk mund t'i obligojë deputetët të jenë në sallë në kohën kur votohet për presidentin e vendit. Ai ka bërë të ditur se ende nuk ka përgjigje nga Gjykata Kushtetuese, nëse ai si kryetar i Kuvendit mund ta ushtrojë detyrën e presidentit të vendit. "Kjo çështje mendoj se është shumë mirë e precizuar me Kushtetutë. Më tepër konfuzioni është krijuar nga ata që e kanë interpretuar edhe vendimin, edhe Kushtetutën. Kushtetuta në mungesë të presidentit përcakton që detyrën e presidentit e ushtron kryetari i Kuvendit të Kosovës", ka thënë ai.

### **GJKK - ja: Kosova ka u.d. të presidentit**

Gjykata Kushtetuese ka dhënë sqarime shtesë në lidhje me vendimin për shfuqizimin e procedurave të zgjedhjes së presidentit, të cilat u konsideruan si jokushtetuese. Në vendimin që përmban sqarime për pyetjet e parashtruara nga kryetari i Kuvendit, kryeministri dhe z.Behgjet Pacolli, Gjykata verën se vendimi i saj për të shfuqizuar mandatin e presidentit ka hyrë në fuqi më 31 mars. Nga kjo datë, thuhet se Kosova ka ushtrues detyre të presidentit, por nuk sqaron se cili është ai. Gjithnjë duke iu përgjigjur pyetjeve, Gjykata ka sqaruar se vendi nuk shkon në zgjedhje të parakohshme, nuk ka nevojë të zhbëhet Kuvendi dhe se vendi nuk është në vakuum institucional. Ndërkaq, në pyetjen e parashtruar nga Qeveria nëse është detyrim kushtetues prania e 2 të tretave të deputetëve në sallë, në rundin e parë dhe të dytë të zgjedhjes së presidentit dhe nëse mund të shkohet direkt në rundin e tretë, po që se nuk janë 80 deputetë të pranishëm, Gjykata është përgjigjur: " ...Gjykata rikujton që qëllimi i këtij sqarimi është ta sqarojë Aktgjykimin dhe nuk ka autoritet për të dalë jashtë objektit të çështjes së Kërkesës. Prandaj, situatat hipotetike, siç janë përmendur në letrën e kryeministrit, janë jashtë kufirit të objektit të çështjes dhe mund të jenë bazë për një rast të ri", thuhet në sqarimin e Gjykatës Kushtetuese. Sipas këtij sqarimi, presidenti nuk mund të zgjidhet me shumicën e thjeshtë në dy rundet e para, kur kjo mund të bëhet vetëm me dy të tretat e deputetëve të numrit të përgjithshëm të deputetëve. Njoftimet e sotme për një mundësi tjetër bien poshtë.

### **Mustafa: Hashim Thaçi është shkelës i Kushtetutës**

Dy subjektet politike opozitare LDK-ja dhe AAK-ja, mendojnë si më parë, se vendit i duhet një president që e përfaqëson unitetin e popullit dhe duhet të sigurohet një konsensus për të. Nga të dyja këto subjekte politike preferohet një marrëveshje pak a shumë koncensuale që të dilet nga kriza, ndonëse fajtor i dështimit të parë, sipas tyre është vetëm kryeministri Thaçi. Në një deklaratë për gazetën "Kosova Sot", kreu i LDK - së, Isa Mustafa thotë se nga vetë adresimi i Gjykatës Kushtetuese shkelës është PDK-ja dhe koalicioni, pasi siç theksoi, ata kanë vendosur në mënyrë jashtë kushtetuese. "Ata këtë çështje po e drejtojnë te të tjerët, por shkelës në mënyrë eksplicite është Hashim Thaçi, sepse i ka detyruar deputetët për të votuar në mënyrë të parregullt, në mënyrë jo kushtetuese për zgjedhjen e presidentit.

---

## **Presidenti, më së largu të hënën**

---

**Kuvendi i Kosovës ka gjasa që të shtunën, ose më së largu të hënën të mbliidhet për ta zgjedhur Presidentin e ri, edhe pse kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi ka thënë se ende nuk e kanë marrë kërkesën me nënshkrime për seancë të jashtëzakonshme**

Ndonëse ende kryesia e Kuvendit nuk ka marre kërkesën për seancë të jashtëzakonshme nga koalicioni qeverisës, një seancë e tillë mund të mbahet të shtunën, ose më së largu të hënën. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi ka thënë se në kryesinë e Kuvendit nuk ka arritur kërkesë, por sipas tij në momentin që arrin, do të procedohet më tutje. Mirëpo, mundësinë e mbajtjes së seancës së jashtëzakonshme të shtunën e ka konfirmuar edhe nënkryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca. Sipas tij ka mundësi që ndodh të shtunën, apo më së largu të hënën. "Po ka mundësi që të mbahet të shtunën seanca e Kuvendit, mirëpo, së pari duhet të mbliidhet kryesia e Kuvendit, por ende nuk është mbledhur dhe do të ishte e pakuptimtë mbajtja e seancës pa u mbajtur mbledhja e kryesisë. Mirëpo, ka mundësi që edhe mbledhja e kryesisë edhe seanca të mbahen të shtunën. Por, sipas të gjitha gjasave kjo do të ndodhë të hënën", ka thënë Konjufca. Myzejane Selmani nga AKR-ja ka thënë se tashmë janë mbledhur nënshkrimet për dy kandidatët për president të Kosovës, ku edhe një herë do të rikandidojë Behgjet Pacolli, e për kunderkandidate do ta ketë Suzana Novobërdaliun nga partia e tij.

### **S'e votojnë as Suzanën, nuk qëndrojnë në seancë**

Mirëpo, pavarësisht mbledhjes së nënshkrimeve për një seancë të jashtëzakonshme, opozita prapë do të jetë kundër Behgjet Pacollit për t'u rizgjedhur në postin e Presidentit. Madje opozita prapë ka paralajmëruar se nuk do të jetë në sallë në momentin e votimit për President. Derisa as kandidimi i deputetes së AKR-së si kunderkandidate e Pacollit, Suzana Novobërdaliu, nuk ua ka ndërruar mendjen opozitarëve. Glauk Konjufca nga Vetëvendosje ka thënë se nuk do ta votojnë as kandidaten Novobërdaliu, pasi edhe ajo është njësoj si Pacolli. "Jo nuk do ta votojmë, sepse edhe ajo është e njëjtë sikurse edhe Pacolli, por as që do të rrimë në sallë gjatë votimit të Presidentit", ka thënë Konjufca. Ndërsa, qëndrim të njëjtë sikurse edhe në herën e parë do të ketë edhe partia më e madhe opozitare LDK-ja. Deputeti i kësaj partie, Arben Gashi ka thënë se ata nuk do të ndërrojnë qëndrim në situata të njëjta. "Ne nuk ndërrojmë mendim në situata të njëjta nuk ndërrohet as mendimi as vendimi. Ne jemi të vendosur që duhet të kemi zgjidhje konsensuale për situatën që është krijuar në Kosovë", ka thënë Gashi.

### **AAK-ja pa qëndrim**

Ndërsa, ndryshe nga dy partitë më të mëdha opozitare, LDK-ja dhe Vetëvendosje, partia tjetër AAK-ja ende nuk ka një qëndrim të prerë se çfarë do të bëjë në seancën e jashtëzakonshme kur të votohet për ta zgjedhur presidentin e vendit. Nënkryetarja e AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi ka thënë se brenda këtyre dy ditëve pritet të mbliidhet edhe Këshilli drejtues i AAK-së për të diskutuar situatën e re të krijuar pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, për të dalë edhe me formulën adekuate të zgjidhjes së ngërçit institucional. "AAK shumë shpejt do të ketë një takim me strukturat e veta, me kryesinë dhe Këshillin Drejtues, do t'i diskutojmë të gjitha temat, dhe deri të hënën do të dalim edhe me alternativën dhe gatishmërinë tonë që të kontribuojmë të dalim nga kriza", ka thënë Kadaj-Bujupi. Mirëpo, se janë kundër Pacollit për president edhe

këtë herë, e ka konfirmuar Kadaj-Bujupi duke thënë se zgjedhja e Pacollit është zgjedhje e Hashim Thaçit dhe jo e tyre. "Po e përsëris edhe njëherë se zgjedhja e z. Behgjet Pacolli është zgjedhje e Hashim Thaçit dhe jo e AAK-së, dhe do të thotë se në asnjë mënyrë nuk do të kontribuojmë që ky proces të ketë një rezultat pozitiv, sepse konsiderojmë që është zgjedhja më e keqe e mundshme", është shprehur Kadaj-Bujupi.

## **Pacolli apo një president konsensual**

**Duke e fajësuar opozitën, kryeministri Thaçi thotë se vendi mund të shkojë sërish në zgjedhje të jashtëzakonshme. Për ta evituar këtë gjendje, LDK dhe AAK janë në gjendje të gjejnë një president konsensual, bashkë me një marrëveshje kalimtare deri në zgjedhje**

PRISHTINË - Një president konsensual, bashkë me marrëveshjen për reformat zgjedhore, ndryshimet kushtetuese dhe caktimi i zgjedhjeve për vjeshtën e vitit 2012, duket të jetë oferta më e re e opozitës për kryeministrin Hashim Thaçi dhe koalicionin e tij qeverisës, nëse mëtohet që në seancën e zgjedhjes së presidentit të ketë kuorum të mjaftueshëm. Në anën tjetër, burime nga qeveria thonë se heqja dorë nga kandidatura e Behgjet Pacollit, siç po insiston opozita, mund të prishë koalicionin aktual qeverisës. Kurse kërkesat për reforma zgjedhore dhe ndryshimeve kushtetuese thuhet se janë edhe kërkesa të pozitës. Por, dallime ka tek data e zgjedhjeve të lira, pasi që partia më e madhe në pushtet, PDK, synon të vazhdojë mandatin e plotë. Tani mbetet tek Pacolli, nëse ai është në gjendje të heqë dorë nga kolltuku i preferuar i presidentit për t'ia lëshuar vendin një kandidati konsensual. Nëse ky president do të kërkohej nga pozita, ai emër besohet se do të ishte Agim Çeku. Ndërkaq, nëse kërkohet nga opozita, atëherë do t'u mbetej LDK - së dhe AAK - së që të merreshin vesh se kush do të mund të kandidonte. Në çdo variant, burimet e njëjta thonë se pjesë e këtyre kalkulimeve nuk është edhe lëvizja Vetëvendosje, e cila vazhdon të jetë një opozitë e të gjithëve. Koalicioni qeverisës i Thaçit dhe Pacollit dje ka marrë një "goditje" nga Gjykata Kushtetuese, e cila vetëm e rikujtoi qeverinë me dispozitat kushtetuese për zgjedhjen e presidentit.

### **Krasniqi sërish në ulësen e presidentit**

Në pyetjen e parashtruar nga qeveria, nëse është detyrim kushtetues prania e 2 të tretave të deputetëve në sallë, në rundin e parë dhe të dytë të zgjedhjes së presidentit dhe nëse mund të shkohet direkt në rundin e tretë, po qe se nuk janë 80 deputetë të pranishëm, Gjykata vetëm e ka rikujtuar qeverinë me rastin Pacolli. "Gjykata rikujton që qëllimi i këtij sqarimi është ta sqarojë aktgjykimin dhe nuk ka autoritet për të dalë jashtë objektit të çështjes së kërkesës. Prandaj, situatat hipotetike, siç janë përmendur në letrën e kryeministrit, janë jashtë kufirit të objektit të çështjes dhe mund të jenë bazë për një rast të ri", thuhet në sqarimin e Gjykatës Kushtetuese. Ky interpretim i ka lënë pak hapësirë koalicionit që të gjejë 80 deputetë të gatshëm të rrinë në sallë në momentin që do të votohej për Pacollin. Ndërkohë, edhe kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ka thënë se qëndrimi në sallë në kohën e votimit për presidentin nuk është i detyrueshëm me ligj. Por, për dallim nga qeveria, Krasniqi ka "dalë fitues" në kërkesën e tij drejtuar Kushtetueses në lidhje me ushtruesin e detyrës së presidentit të Kosovës. Nga data 31 mars, Gjykata Kushtetuese ka sqaruar se Kosova ka ushtrues detyre të presidentit. Ndonëse nuk i përmendet emri, në bazë të Kushtetutës këtë post e merr nën ushtrim kryetari i Kuvendit, në këtë rast Jakup Krasniqi. Gjithnjë duke iu përgjigjur pyetjeve, Gjykata ka sqaruar se vendi nuk shkon në zgjedhje të parakohshme, nuk ka nevojë të zhbëhet Kuvendi dhe se vendi nuk është në vakum institucional.

### **Thaçi akuzon opozitën: Po e çojnë vendin në zgjedhje të reja**

Por, për sa kohë do të zgjasë një gjendje e tillë, këtë e ka sqaruar sado pak edhe kryeministri i vendit, Hashim Thaçi. Ai thotë se vendi mund të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme nëse



opozita vazhdon me bojkotimin e seancës në të cilën do të votohet për presidentin. Kryeministri kërkon nga deputetët ta respektojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, përfshirë edhe opozitën, me kërkesën që deputetët opozitarë të qëndrojnë në seancë gjatë zgjedhjes së presidentit dhe të mos ndikojnë që vendi të shkojë sërish në zgjedhje të jashtëzakonshme. Mirëpo, përderisa koalicioni qeverisës ka si kandidat Behgjet Pacollin për president, opozita duket të jetë e vendosur që të veprojë njësoj sikurse në seancën e 22 shkurtit. Deputeti i LDK - së, Ismet Beqiri, i ka ftuar partitë e koalicionit që të merren vesh me opozitën për një president konsensual. "Ne jemi për gjetjen e zgjidhjes për një president konsensual, që do të simbolizonte unitetin e qytetarëve", thotë Beqiri. Ndërkohë, edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, përmes deputetes Donika Kada Bujupi thotë se pozita dhe opozita mund të gjejnë një figurë tjetër politike, përveç Pacollit. Me propozimet e opozitës aktualisht nuk merret AKR - ja e Behgjet Pacollit. Ky subjekt politik i ka caktuar Pacollit edhe kundër kandidatën që do të dilte në garën për president, zonjën Suzanë Novobërdaliu. Por, AKR nuk mund ta gjejë edhe kuorumin për të mbajtur seancën dhe ky mund të jetë një problem serioz. U.D i kryetarit të AKR - së, Ibrahim Makolli, thotë se nënshkrimet janë mbledhur dhe tani do t'i kërkohej kryesisë së Kuvendit që të thërrasë seancë të jashtëzakonshme ku Pacolli dhe rivalja e saj nga e njëjta parti do të garonin për postin e presidentit të Kosovës. "Do të procedojmë me një kërkesë për një seancë të jashtëzakonshme, ndaj edhe më tutje jemi duke e shqyrtuar këtë çështje, besoj se do të ketë kërkesë për seancë të jashtëzakonshme", u shpreh Makolli. Megjithatë, përderisa opozita të mos bindet të qëndrojë në sallë, votimi për presidentin dhe mungesa e kuoromit do ta çonte Kosovën në zgjedhje të jashtëzakonshme.

**AKR-JA KËRCËNON ME PRISHJE TË KOALICIONIT, KRASNIQI NUK MOHON ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME**

## **Pacolli nuk e dorëzoi detyrën**

**Behgjet Pacolli, i cili sipas Gjykatës Kushtetuese nuk është më president, nga 31 marsi nuk e dorëzoi detyrën, siç e kishte paraparë të shtunën. AKR-ja kërcënon me dalje nga koalicioni nëse nuk zgjidhet president Pacolli. Kryekuvendari Jakup Krasniqi nuk i përjashton zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe ka thënë se duhet të mblidhen krejt partitë për të diskutuar një zgjidhje të përshtatshme**

Kriza politike merr drejtim të ri. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh ushtrues detyre i presidentit, Jakup Krasniqi, ka deklaruar se pas vendimit të fundit të Kushtetueses është krijuar një realitet i ri në skenën politike të vendit, ndërsa nuk ka dashur të komentojë kërcënimin e AKR-së për dalje nga koalicioni qeverisës me PDK-në. Ai këto komente i bëri të shtunën, duke iu përgjigjur interesimit të medieve të shumta lidhur me zhvillimet e fundit në vend pas akt gjykimit të Kushtetueses sipas të cilës zgjedhja e Behgjet Pacollit për president ka qenë jo kushtetuese dhe rreth kërcënimit të AKR-së për dalje nga koalicioni. Krasniqi ka thënë se pas vendimit të fundit të Kushtetueses, në Kosovë është krijuar një realitet i ri dhe kësaj pune, sipas tij, duhet gjetur një zgjidhje imediate, pasi nuk mund të vazhdojë si e tillë. Ai nuk e ka pohuar e as mohuar mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme. "Unë nuk do të kisha thënë zgjedhje të jashtëzakonshme. Zgjedhjet i kemi kryer, por besoj se partitë politike duhet të ulen dhe të bisedojnë dhe të dakordohen që brenda një kohe të bëjnë reformën zgjedhore, që është e domosdoshme që të bëjnë ndryshime kushtetuese dhe pastaj të gjejnë rrugën më të mirë për të shkuar përpara", ka thënë Krasniqi. I pyetur nëse do t'iu bëjë thirrje partive opozitare për të diskutuar lidhur me këtë çështje, Krasniqi ka thënë se duhet të mblidhen krejt partitë për të diskutuar një zgjidhje të përshtatshme.

### **AKR - ja shqyrton shkëputjen nga koalicioni**

Aleanca Kosova e Re po shqyrton seriozisht mundësinë e daljes nga koalicioni qeveritar me PDK-në, derisa nuk heq dorë nga dorëzimi i kërkesës për seancë të veçantë për votimin e presidentit, respektivisht kandidaturës së Behgjet Pacollit. Në një njoftim të dërguar për mediat të shtunën, AKR-ja thotë se është e gatshme ta ndërpresë marrëveshjen me PDK-në nëse nuk arrihet të përmbushet marrëveshja që presidenti të jetë i votuar nga ky subjekt politik. "Zyrtarë të lartë të AKR - së dhe Koalicionit për Kosovë të Re, njëzëri janë pajtuar për të shqyrtuar seriozisht mundësinë e shkëputjes së menjëhershme të koalicionit qeverisës. Qëndrimi për shkëputje koalicionit qeverisës vjen si pasojë e zhvillimeve të fundit politike në vend. AKR-ja në kuadër të Koalicionit për Kosovë të Re, gjatë këtyre konsultave është shprehur e gatshme ta ndërpresë kontratën e koalicionit qeverisës nëse kjo kontratë nuk do të përmbushet në tërësinë e saj. Konsultat kanë vazhduar edhe ditën e shtunë në një takim të Kryesisë së AKR-së dhe Koalicionit për Kosovë të Re për të vendosur për hapat e mëtejme lidhur me shkëputjen e koalicionin qeverisës me PDK-në", thuhet në njoftim. Megjithatë, Behgjet Pacolli, i cili sipas Gjykatës Kushtetuese nuk është më president nga 31 marsi, nuk e dorëzoi detyrën, siç ishte paraparë të shtunën. Ndryshe, njoftimi i AKR-së në një kohë të pazakonshme, pason atë të Presidencës që njoftoi para mesnate se me kërkesë të Pacollit është shtyrë dorëzimi i detyrës tek u.d. i presidentit, Jakup Krasniqi, për të hënë. "Me kërkesë të presidentit të deritashëm, z.

Behgjet Pacolli, për shkaqe objektive, dorëzim-pranimi i detyrës së presidentit të Republikës së Kosovës nga z. Behgjet Pacolli, te kryetari i Kuvendit, njëkohësisht ushtrues i detyrës së presidentit, z. Jakup Krasniqi, nuk do bëhet ditën e shtunë, datë 2 prill, siç ishte planifikuar, por do të bëhet të hënën, më datë 4 prill 2011, në orën 10:00, në kabinetin e presidentit", thuhet në një njoftim zyrtar të presidencës së Kosovës.

### **E hëna sqaron gjithçka**

Mirëpo, nga ana tjetër AKR - ja nuk do të heqë dorë deri në mundësinë e fundit për të provuar që kandidati i këtij subjekti politik të rivotohet në Kuvend dhe mbase edhe të marrë shumicën e nevojshme të votave. Shefi i Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, Ibrahim Makolli tha se kërkesa për seancë të veçantë të Kuvendit do të bëhet në fillim të javës, pasi që të premtën nuk ka arritur ta procedojë atë në Kuvend për shkaqe objektive. Sipas tij, kjo vonesë është shkaktuar për shkak të pritjeve të sqarimeve nga Gjykata Kushtetuese, të cilat janë pritur të premtën nga të gjitha palët e paraqitura. "Sqarimet e Gjykatës kanë ardhur në orën 16:00, në kohën kur administrata e Kuvendit, ka qenë në përfundim të orarit të punës. Kështu që, procedimi i kërkesës ka mbetur për ditët në vijim, sepse tashmë gjithçka është bërë gati", ka thënë Makolli. Mirëpo, i kontaktuar nga gazeta, nënkryetari i PDK-së, Rustem Mustafa tha se strukturat drejtuese të PDK-së nuk kanë ndonjë njoftim zyrtar, dhe as qëndrim të formësuar ndryshe nga marrëveshja për koalicionin që kanë me AKR-në. "Nuk ka ndonjë gjë të re në këto zhvillime. Me siguri që ditën e hënë do të mund të sqarohet gjithçka rreth zhvillimeve të reja", tha Mustafa.

### **LDK - ja diskuton sot për krizën**

Pozicioni i partive politike opozitare, si pozicion përfundimtar rreth procedurës së votimit për kandidaturën e presidentit të vendit, në formulën e tashme të koalicionit PDK-AKR, pritet të definohet përfundimisht gjatë ditës së sotme. LDK-ja e ka pikë qendrore të trajtimit situatën e fundit të krijuar në vend dhe veprimet e LDK-së në këtë situatë në takimin e Këshillit Qendror të partisë. "Ne e kemi thirrur Këshillin Qendror të LDK-së për të dielën, do ta mbajmë seancën e Këshillit Qendror, dhe do të njoftojmë edhe organin më të lartë ndërmjet kuvendeve lidhur me situatën në të cilën jemi, sepse dëshirojmë që ta zhvillojmë një demokraci të plotë të brendshme në LDK, dhe pjesë e qëndrimeve të jenë ata që e kanë përgjegjësinë dhe sipas asaj do të marrim edhe qëndrimet e caktuara", i ka deklaruar të premtën gazetës kryetari i LDK - së, Isa Mustafa. Ndryshe, në AAK nuk kanë vendosur as gjatë ditës së djeshme se si do të veprohet rreth kësaj situate. Një takim i radhës i Këshillit Drejtues të AAK-së, i paralajmëruar si mundësi nga nënkryetarja Donika Kada Bujupi për këto dy ditë, as dje nuk është thirrur nga AAK - ja. "Nëse do të ketë ide të ndryshimit të qëndrimit për t'u diskutuar në këtë forum do të shikohet mundësia e thirrjes dhe diskutimit në të, por ende nuk ka ndonjë qëndrim tjetër", tha dje për gazetën sekretari i përgjithshëm i AAK - së, Burim Ramadani. S. AHMETI

## **PDK e AKR të hënën qartësojnë dilemën për koalicionin**

*"Megjithatë përderisa të vazhdojë të ekzistojë marrëveshja dhe derisa vazhdon që ajo marrëveshje të zbatohet me partnerët e koalicionit, natyrisht ne do të ecim tutje", u shpreh Makolli.*

PRISHTINË, 3 PRILL - Ditën e hënë dy partitë në pushtet, Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca Kosova e Re pritët të qartësojnë qëndrimet e tyre nëse edhe më tutje këto dy parti do të vazhdojnë të mbesin në koalicion, apo marrëveshjes për të qeverisur do t'i jepet fund pas gjashtë javë bashkëjetese. Kriza e partneritetit qeverisës është reflektuar pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese për shkelje të Kushtetutës me rastin e zgjedhjes së presidentit Pacolli më 22 shkurt, dhe të dy partitë PDK-ja dhe AKR-ja janë në ankth se si do të veprohet më tutje. Ndonëse ende me dilema, asnjëra palë nuk ka përjashtuar mundësinë e prishjes së marrëveshjes për koalicion. E para që ka shqyrtuar mundësinë e prishjes së koalicionit është AKR-ja, parti e cila në marrëveshje partneriteti ka hy me kompromisin që presidenti t'i takojë kësaj partie. Një marrëveshje e tillë ndonëse është kundërshtuar nga shumica e anëtarëve të PDK-së, sikur edhe partive opozitare, ajo ishte realizuar me zgjedhjen e presidentit Pacolli, duke shkelur kështu procedurat ligjore, e që kjo çojë rastin në Gjykatën Kushtetuese. Rivotimi i presidentit, sipas vendimit të Gjykatës nuk e ka penalizuar Pacollin që të rikandidojë për president por rikandimin e tij nuk e pranojnë partitë opozitare, të cilët janë shprehur qartë se nuk do të jenë prezentë në sallë gjatë votimit të tij. Një deklaram i tillë i partive opozitare, ka shtyrë edhe protagonistin e bërjes së qeverisë, Hashim Thaçin që të kërkojë nga Pacolli të heqë dorë nga kandidatura për president, gjë e cila do të reflektonte një zgjidhje funksionale dhe nuk do ta dërgonte vendin në zgjedhje të jashtëzakonshme.

### **AKR: Edhe më tutje ekziston marrëveshja**

Ndonëse flitet për ftohje të marrëdhënieve ndërmjet PDK-së dhe AKR-së, ushtruesi i detyrës së kryetarit të AKR-së, Ibrahim Makolli, tha se nuk ka ndonjë ndryshim të situatës dhe se edhe më tutje ekziston marrëveshja me partnerin e koalicionit. Ai pret që shumë shpejt të mbahet seanca e radhës dhe të votohet për president, derisa shpreh qëndrimin e partisë se nuk heqin dorë nga kandidatura e Pacollit për president të vendit. "Të premtën kemi pritur sqarimet shpesh të Gjykatës Kushtetuese dhe nuk kemi arritur të dorëzojmë kërkesën për seancë, por edhe nominimet për president dhe besoj se të hënën do të procedojmë më tutje kërkesën për seancën në të cilën pritet të zgjidhet presidenti i vendit", tha Makolli. Mundësinë e AKR-së për tërheqje nga koalicioni, Makolli më shumë e sheh si ngjarje që ka dalë pas situatës së krijuar, e cila padyshim se rrit shqetësimin brenda partive. "Situata e re e krijuar në vend pas vendimit dhe sqarimit të Gjykatës, natyrisht se brenda partive politike rrit shqetësimet për zhvillime. Megjithatë përderisa të vazhdojë të ekzistojë marrëveshja dhe derisa vazhdon që ajo marrëveshje të zbatohet me partnerët e koalicionit, natyrisht ne do të ecim tutje", u shpreh Makolli. Ai e quan stabil koalicionin qeverisës, duke theksuar se tash për tash nuk ka pasur ndonjë arsye të veprimeve të tjera. Ai nuk e komentoi kërkesën e kryeministrit Thaçi për tërheqjen e kandidaturës së Pacollit për president, duke thënë se nuk dua të komentoj për situata hipotetike, për diçka që mund të krijohet. Ai shpreson se marrëveshja e koalicionit do të realizohet në përpikëri, meqë është marrëveshje valide.

## **Haliti: Nuk jemi armiq me asnjë parti**

Nënkryetari i PDK-së, Xhavit Haliti nuk dëshiron të komentoj zhvillimet e fundit, me arsyetimin se nuk ka informacione se rreth mundësisë së prishjes të koalicionit. "Nuk po e ndjej vetën mirë të deklarohej për këto zhvillime. Të shohim nesër, ditë e re, nafakë e re. Unë nuk kam informacion rreth prishjes apo jo të koalicionit", i ka thënë gazetës "Bota sot", nënkryetari Haliti. Sa i përket kërkesës së z. Thaçi për tërheqjen e z. Pacolli nga kandidatura për president, ai tha se partia ka një qëndrim dhe kur flet lideri i partisë, atëherë flasin të gjithë. Por si i sheh ai zhvillimet e ditës së hënë. Duke mos dashur të deklarohet publikisht për atë se çfarë mund të ndodhë ndërmjet partnerëve të koalicionit, Haliti me humor flet për një ditë të mirë, gjithnjë në kushtet atmosferike, por jo edhe për ato politike. "Ishalla nuk bie shi, është një ditë pranvere. Temperatura politike nuk ka, të shohim nesër se çfarë po ndodh, sepse nuk është mirë të flasim para kohe", shprehet ai. Haliti mendon se është e drejtë e AKR-së që të tërhiqet nga koalicioni, apo edhe të luftojë për të mbetur në koalicion, megjithëse thotë se për të bërë tërheqje është më së lehti. Në rast të prishjes së koalicionit me AKR, ai nuk përjashton mundësinë që PDK-ja, si partia më e madhe në vend të gjejë një partner tjetër të koalicionit, duke mos përjashtuar këtu as LDK-në dhe AAK-në, por as mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme. "Kjo është formulë politike, në qoftë se ka koalicion me tjerat parti, nëse jo shkojmë në zgjedhje të reja. Ne nuk jemi armiq me asnjë parti dhe me të gjitha mund të arrijmë. Mendoj se AAK, LDK, AKR, të gjitha mund të jenë në koalicion. Secila parti që formohet e pretendon pushtetin dhe me nda pushtetin nuk është humbje për asnjë parti", vlerëson ai.

## **LDK, presidenti të zgjidhet me konsensus**

Partia më e madhe opozitare, LDK - ja, e cila deklarativisht kundër kandidimit të Pacollit për president, është shprehur e gatshme që të ulet në një tryeze me të gjitha partitë parlamentare për të gjetur një zgjidhje. LDK-ja është e vendosur që presidenti të zgjidhet me konsensus politik. "Zgjedhja e presidentit do të duhej të ishte rezultat i një marrëveshjeje politike që do të shprehte interesat, jo vetëm të pozitës, por edhe të opozitës, përkatësisht të qytetarëve të Republikës së Kosovës", tha të dielën kryetari i LDK-së, pas takimit të Këshillit të Përgjithshëm të LDK-së. Ai nuk ka përjashtuar mundësinë që partia e tij të bojkotojë seancën sikurse më 22 shkurt, nëse nuk ka një marrëveshje paraprake politike për kandidimin e presidentit.

## **Hapur**

Në rast të prishjes së koalicionit me AKR, ai nuk përjashton mundësinë që PDK-ja , si partia më e madhe në vend të gjejë një partner tjetër të koalicionit, duke mos përjashtuar këtu as LDK-në dhe AAK-në, por as mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme, thotë Xhavit Haliti.

## **Njëjtë**

Ibrahim Makolli, tha se nuk ka ndonjë ndryshim të situatës dhe se edhe më tutje ekziston marrëveshja me partnerin e koalicionit. Ai pret që shumë shpejt të mbahet seanca e radhës dhe të votohet për president, derisa shpreh qëndrimin e partisë se nuk heqin dorë nga kandidatura e Pacollit për president të vendit.

**Kosova, sfidat politike dhe juridike**

---

**Shembulli Pacolli, alternativë që nuk mundet të ndalet**

---

Shkruan: Selami Shkodra

Sistem normash juridike që kanë vlerë e rëndësi kushtetuese, quhen dispozitat të cilat janë në aktin më të lartë juridik të shtetit në (Kushtetutë) ligjet themelore të shtetit janë paraqitur shumë herët, me paraqitjen e institucioneve themelore shtetërore dhe të rregullave për funksionimin e tyre d.m.th. me paraqitjen e shtetit, studiuesit e kësaj fushe janë të ndarë rreth historikut, mënyrës së ekzistimit të këtyre ligjeve themelore, duke marr për bazë se qysh në shtetet antike, si në Kinën e lashtë, Egjipt, shtetet e Afrikës Veriore, Indi dhe në shtetet tjera në Azi, e sidomos, në Greqinë antike dhe Romën e vjetër, janë nxjerr disa akte të shkruara me të cilat janë rregulluar çështje të rëndësishme shoqërore e politike, siç janë: marrëdhëniet ekonomike, institucionet e pushtetit, të drejta dhe privilegjet e shtresave të caktuara të shoqërisë si dhe të bartësve të pushtetit, aktet e tilla e sidomos Kushtetuta në Romën e vjetër paraqesin bazën dhe elementet e para kushtetuese, me evoluimin e shoqërisë piqu kushtet për nxjerrjen e disa akteve, të cilat rregullojnë marrëdhëniet e reja, që kontribuan edhe në zhvillimin e vetë Kushtetutës, rëndësi të veçantë në këtë drejtim kanë: Karta e Medinës - 622, Magna Karta Libertatum (Karta e Madhe e Lirive) në Angli në vitin 1215. Aktet në formë të “deklaratave”, “kodeve”, “edikteve”, nxirren prej shekullit VIII deri në shekullin e XVIII. Këto dokumente përmbajnë parime dhe elemente lidhur me pozitën, autorizimet, kufizimet, organizimin dhe funksionimin e pushtetit politik, lidhur me pozitën e klasave të individëve në shoqëri.

**Akti më i lartë juridik (Kushtetuta) në Kosovë shikuar në retrospektivë**

Kosova për herë të parë ka patur Kushtetutën e saj në vitin 1974. Në atë kohë në saje të reformave kushtetuese të ish-federatës, Kosova u bë me aktin më të lartë juridik, e cila avanconte pozitën e Kosovës në njësitë e tjera, apo thënë ndryshe barazohej me elementët konstituiv të Federatës, mirëpo me ngjitjen në skenë të elementëve nacionalist në Serbi, nga mesi i viteve të '80-ta Serbia filloi një fushat në mënyrë që të amandamentohej Kushtetuta e Kosovës. Kjo u përmbyll më 1990 ku Serbia nëpërmjet një regjimi policor arriti që Kosovës t'ia abrogonte Kushtetutën, në mënyrë krejt të dhunshme dhe të pavullnetshme. Me krijimin e rrethanave të reja, të asaj kohe, elita intelektuale dhe politike i hynë punës dhe hartuan Kushtetutën e Kaçanikut, e cila për shkak të rrethanave okupuese hasi në vështirësi për tu implementuar në praktikë. Çlirimi i Kosovës dhe administrimi nga misioni i Kombeve të Bashkuara UNMIK, si nevojë e kohës erdhi edhe deri te hartimi i aktit më të lartë juridik, i cili quhet korniza kushtetuese, me përfundimin e një pjese të tranzicionit dhe me konsolidimin e organeve vendore u pjekën kushtet dhe Kosova shpalli pavarësinë e saj, si rezultat i rrethanave të reja dhe realitetit të ri, ishte nevojë e domosdoshme që të hartohet ligji themelor i shtetit (Kushtetuta). Mirëpo, pavarësia e Kosovës vinte si rezultat i një marrëveshje të arritur në mes bashkësisë ndërkombëtare dhe Kosovës, e cila prodhoi edhe të ashtuquajturën pako të

presidentit Ahtisari, e cila do duhej të implementohej në periudhat e ardhshme kohore, Kushtetuta e Kosovës së pavarur duhej të ishte në frymën e një Kushtetute me standarde europiane dhe do të duhej të kishte në veten e saj edhe propozimin gjithëpërfshirës të Ahtisarit. Me gjithë përpjekjet e hartuesve, Kushtetuta tregoi që në disa pjesë të vendit nuk gjeti zbatim sidomos në pjesën veriore dhe në disa situata nuk ishte funksionale dhe në më pak se tri vjet jetë të saj u shtrua nevoja e ndryshimit të sajë. Me fillimin e hyrjes së sajë në fuqi u ballafaqua edhe me shkelje serioze dhe permanente nga ana e të parit të vendit, i cili në bazë të mandatit që kishte duhej të ishte garant i Kushtetutës, me iniciativën e disa ligjvënësve të legjislaturës së shkuar, çështja shkoi në Gjykatën Kushtetuese. Me të u konstatua fakti se ish presidenti i vendit paska shkel Kushtetutën. Ky vendim prodhoi edhe pasojat e veta duke çuar në dorëheqje shkelësin permanent të Kushtetutës, pas dorëheqjes dhe jo vullnetit të mirë të partnerit qeverisës të asaj kohe LDK-së, u morën edhe vendime të njëanshme duke tërhequr pjesën e ministrave të saj nga koalicioni, e duke lënë shumë institucione pa titullar, përkundër caktimit të një date të zgjedhjeve nga ana e u.d. të asaj kohe pas një tryeze të partive politike, u ndërrua për shkak të rrethanave të reja, papërgjegjësia dhe bllokada vazhdoi dhe vinte nga ky subjekt që tanimë nuk ishte diçka risi, por një rutinë, e cila e përcjellë vendin që nga momenti kur nuk janë pjesë e pushtetit. Ky avaz e përcolli skenën politike madje edhe u thellua gjatë gjithë procesit zgjedhor, dhe pas publikimit të rezultateve të dala si rezultat i zgjedhjeve të lira. LDK si parti që është mplakur në pushtet dhe është përgjegjëse për të gjitha proceset dhe dështimet në Kosovën e pas luftës, pasi që asnjë ditë të vetme nuk din se si është të qenurit në opozitë, siç duket e ka të paqartë dhe të pa mundur ta dijë, se cilat janë përgjegjësitë dhe detyrat e sajë kur gjendet në opozitë, me konstituimin e Kuvendit dhe me krijimin e kushteve për zgjedhjen e organeve, të cilat dalin nga Kuvendi siç janë Presidenti dhe Qeveria fillojnë edhe të dalin në pah deklarata të papërgjegjshme dhe aspak demokratike nga ana e liderëve të partive politike, se nuk do të jenë pjesë e procesit, të cilat prodhojnë organet tjera që janë aq të domosdoshme në këtë fazë në të cilën gjendet vendi, të ashtuquajturit burrshtetas nuk patën fare dert që vendi ishte pa organet më vitale siç janë presidenti dhe qeveria! Kur Kosovën po e priste një proces i ri negociatash, kur në vend filluan arrestimet për ish çlirimtarët, kur në raportet shpifëse të ndryshme si ai i Dik Martit po thuhej zi dhe terr pa asnjë fakt dhe vetëm e vetëm për të dëmtuar imazhin e Kosovës, kur vendi ishte pa ligjin për buxhetin e 2011, si pasojë veprimeve të njëanshme dhe të papërgjegjshme. Mirëpo, kulmi i një papërgjegjësie dhe papërgjegjshmërie arrin në seancën e 22 shkurtit, kur koalicioni PDK-AKR, kishte kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që të thërras një seancë dhe të procedojë në mënyrë krejt të rregullt me qëllim të konsolidimit të institucioneve, aq shumë të nevojshme.

## **Meskititeti**

Opozita për qëllime meskine merr veprime të njëanshme dhe instalon logjikën e bojkotit duke e lëshuar seancën, në momentin kur vendosej për fatin e vendit, i cili po vuante më shumë se 5 muaj nga një krizë institucionale dhe politike, përkundër veprimeve të cilat s'janë fare të pëlqyeshme për një vend që aspiron anëtarësimin në unionin evropian. Nuk mbaron me kaq qëllimi që ta zgjasin edhe më shumë krizën e krijuar nga vetë ata, duke marr iniciativën që procedurat e zgjedhjes së presidentit të shkojnë në Gjykatën Kushtetuese për një interpretim juridiko kushtetues, pas shqyrtimit nga ana e organit kompetent për këtë kërkesë që bënë, dhe marrjes së një aktgjykimi, cili prodhoi pasojat e veta duke konstatuar, që procedurat e zhvilluara nga parlamenti për zgjedhjen e Presidentit, paskan qenë jo kushtetuese, edhe përkundër faktit që dy nga gjykatësit ndërkombëtar nuk ndanin këtë mendim. Mirëpo, mendimi i shumicës ishte

se dalja e deputetëve nga salla në momentin e zgjedhjes së organeve vitale apo çështjeve të rëndësishme të veçantë, është e përgjegjshme dhe thuhet jo kushtetuese, na dolën disa interpretime dhe deklarata të vrazhda në adresë të Gjykatës Kushtetuese nga vetë ata që e quan çështjen për shqyrtim, krejt çka dua të pyes këta politikanë që kanë përgjegjësi para qytetarëve e në veçanti para votuesve të subjekteve të tyre se a duhet zbatuar në mënyrë selektive interpretimet e Gjykatës Kushtetuese? Kur kemi parasysh se edhe moszbatimi i vendimeve nuk pason ndonjë sanksion, i cili do të ekzekutohej me anë të mekanizmave, të cilat do duhet implementuar apo është çështje, e cila do duhej bërë për hir të interesave të vendit dhe në zbatim të vetë Kushtetutës, pasi që një interpretim i tillë është tanimë pjesë e praktikës gjyqësore, që nga momentet kur është shkruar në përmbajtjen e aktgjykimit të sipërpërmendur. Krejt çka do të duhej të bënte opozita dhe liderët e tyre, është që të marrin shembull nga presidenti z. Behgjet Pacolli, i cili me të marrë aktgjykimin nga Gjykata Kushtetuese u soll me përgjegjësi dhe e lëshoi zyrën e presidentit edhe pse nuk ishin shkeljet nga ana e tij dhe pa fajin e tij. Me këtë rast presidenti Pacolli vuri një standard për politikën në Kosovë, e cila vuan nga një mungesë e tillë duke mos pasur standarde, është e çuditshme, mënyra se si sillet akoma opozita, e cila siç duket ka marrë një model të keq, të të bërit opozitë sipas modelit Rama dhe të PS-së, i cili ka kohë që kërkon të marr pushtetin në tavolinë. Kjo mënyrë e të sjellurit nga ana e asaj opozite po frenon proceset integruese në Shqipëri. Votuesit e opozitës nuk votuan për një model të tillë, dhe jam i sigurt që kërkojnë me heq dorë sa më shpejt nga mendësia e marrjes së pushtetit në tavolinë, të mos pengojë reformat e nevojshme, të cilat janë të domosdoshme për Kosovën që të fillojë proceset integruese.



---

## **PDK lë në lloç Pacollin**

---

**Edhe opozita po të merrte pjesë në seancën e zgjedhjes së presidentit, Pacolli nuk do të mund të zgjidhej, sepse tani Thaçi nuk i ka numrat e mjaftueshëm brenda PDK-së**

Rizgjedhja e Behgjet Pacollit në krye të shtetit duket se do të jetë më e vështirë se sa më 22 shkurt. Sikur edhe opozita të merrte pjesë në seancën parlamentare të zgjedhjes së presidentit, Pacolli nuk do të mund të zgjidhej, sepse tani kryeministri Hashim Thaçi nuk i ka numrat e mjaftueshëm brenda partisë së tij, kanë bërë të ditur burime të “Zërit” brenda PDK-së: Sipas këtyre burimeve, Thaçi nuk po arrin që t’i bindë të gjithë deputetët nga radhët e partisë së tij për ta votuar kreun e AKR-së, sidomos tani kur shumë deputetë i kanë zëvendësuar ministrat aktualë, të cilët mësohet se janë shprehur hapur kundër votimit të Pacollit për president. Megjithatë, vetë Behgjet Pacolli i ka deklaruar gazetës “Zëri” përmes telefonit se gjithçka do të definohet ditën e martë, ndonëse ka mohuar të jetë “kërcënuar” nga kryeministri Thaçi që të tërhiqet nga gara për kreun e shtetit. Ai nuk ka dashur t’i komentojë paralajmërimet e fundit të AKR-së se do të tërhiqet nga koalicioni me PDK-në në rast se ai nuk do jetë kandidat për president. “Unë nuk jam më pjesë e AKR-së dhe nuk më takon që të komentoj qëndrimet e këtij subjekti politik, pasi kam dhënë dorëheqje me të marrë detyrën e presidentit”, është shprehur Behgjet Pacolli. Pavarësisht kësaj, vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka bërë që i gjithë procesi për zgjedhjen e presidentit të kthehet në pikën zero dhe partnerët e koalicionit qeverisës PDK-AKR t’i rishqyrtojnë pozicionet e tyre për mundësinë e bashkëqeverisjes. Zyrtarë të AKR-së vazhdojnë të këmbëngulin se do t’i tërheqin ministrat e tyre nga kabineti qeveritar Thaçi 2, nëse PDK nuk garanton se Behgjet Pacolli do të rizgjedhet president. Ibrahim Makolli i AKR-së pohon se marrëveshja në mes partnerëve të koalicionit vazhdon të jetë valide, duke mohuar të ketë krizë apo përplasje në mes partnerëve pas zhvillimeve të fundit që kanë ndodhur, ku Gjykata Kushtetuese vërtetoi se ka pasur shkelje të Kushtetutës gjatë zgjedhjes së presidentit Behgjet Pacolli. Ndërkaq, partia më e madhe në vend, PDK është “mbyllur” për medie duke mos dashur t’i komentojë zhvillimet e fundit dhe “kërcënimin” e AKR për ikje nga koalicioni nëse nuk do të kandidohet Pacolli. I vetmi që është deklaruar për disa media, ka qenë ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, i cili ka pohuar se sipas të gjitha gjasave, Kuvendi gjatë javës së ardhshme, sërish do të zgjedhë presidentin e Kosovës. Ai megjithatë, nuk di nëse Behgjet Pacolli do të jetë kandidat për president, apo dikush tjetër nga partia e tij. “Topi” për zgjedhjen e të parit të shtetit, ka mbetur në anën e subjekteve politike opozitare. Kjo është pranuar edhe nga vetë Ibrahim Makolli i AKR-së, i cili ka theksuar se “nëse opozita nuk do të jetë e pranishme në momentin e votimit, atëherë pamundësohet zgjedhja e presidentit”. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka thënë se duhet të gjendet konsensus i përgjithshëm politik për çështjen e presidentit, por edhe për situatën politike në përgjithësi, përndryshe, sipas tij, “LDK është e vendosur që të bojkotojë seancën e Kuvendit për zgjedhjen e presidentit nëse nuk ka konsensus paraprak me partitë”. Edhe Glauk Konjufca i lëvizjes Vetëvendosje, rikujton qëndrimin e këtij subjekti politik se në asnjë formë nuk do ta votojë Pacollin për president. Ngjashëm është shprehur edhe Avni Arifi i AAK-së, i cili ka përjashtuar çdo mundësi se deputetët e kësaj partie do ta votojnë Behgjet Pacollin për president.

**DJE U MBLODHËN LDK-JA DHE AAK-JA, KËRCËNOJNË ME BOJKOT**

## **LDK-ja e do presidentin konsensual**

**Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, ka thënë se zgjedhja e presidentit të Kosovës duhet të jetë rezultat i një marrëveshjeje konsensuale ndërmjet partive politike, në të kundërtën LDK - ja nuk do ta përkrahë zgjedhjen e presidentit të vendit. Edhe AAK-ja nuk lëviz nga pozicionet e mëparshme. Sot pritet të qartësohet shumëçka në lidhje me garën për president, në një takim të PDK-së dhe AKR-së**

Ndërsa të hënën pritet një takim ndërmjet udhëheqësve të PDK-së dhe AKR-së lidhur me çështjen më të debatueshme, atë të zgjedhjes së presidentit, forca më e madhe e opozitës, LDK-ja, vetëm sa e ka rikonfirmuar qëndrimin, pas një takimi të Këshillit të saj të Përgjithshëm, i cili për objektivi kishte situatën e re politike të krijuar pas vendimit të Kushtetueses se zgjedhja e Behgjet Pacollit për president ishte jokushtetuese.

### **LDK - ja e bojkoton seancën nëse nuk ka marrëveshje**

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, ka thënë se zgjedhja e presidentit të Kosovës duhet të jetë rezultat i një marrëveshjeje konsensuale të partive politike, në të kundërtën LDK-ja nuk do të përkrahë zgjedhjen e presidentit të vendit. Kryetari LDK - së, Isa Mustafa, ka thënë se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e ka përsëritur kërkesën e saj për një marrëveshje konsensuale për zgjedhjen e presidentit të vendit, në kohën kur koalicioni qeverisës është lëkundur, pas kërcënimit të AKR - së për ta shkëputur koalicionin me PDK - në. "Ky qëndrim ka të bëjë me nevojën që të arrihet një marrëveshje ndërmjet partive parlamentare në Kuvendin e Kosovës rreth zgjedhjes së presidentit dhe zgjedhja e presidentit të jetë rezultat i një marrëveshjeje politike që do t'i shprehë interesat, jo vetëm të subjekteve politike që janë në pozitë, por edhe të atyre që janë në opozitë, përkatësisht të qytetarëve të Republikës së Kosovës", ka thënë Mustafa. Nëse nuk ka një marrëveshje paraprake politike, LDK - ja do të bëjë atë që ka bërë më 22 shkurt, bojkotimin e seancës së zgjedhjes së presidentit të Kosovës. I pyetur nëse LDK-ja do ta përkrahë kandidaturën e Behgjet Pacollit për president, Mustafa ka thënë se gjatë mbledhjes nuk i janë referuar mbështetjes së kandidaturave. "Ne nuk i kemi referuar mbështetjes së kandidaturave të çështjeve të veçanta, por çështjeve parimore, që kanë të bëjnë me uljen në një tryezë me subjektet politike për t'u marrëvesh me këto çështje. Qëndrimi do të jetë ai që ka qenë deri më tani", ka thënë ai. Sa i përket gatishmërisë së LDK-së për të marrë pjesë në rast se mbahen zgjedhjet e jashtëzakonshme, Mustafa ka thënë se subjekti politik që ai drejton është i gatshëm për çdo proces politik, ndërsa nuk ka bërë të ditur nëse LDK - ja do ta bojkotojë seancën ku do të bëhet zgjedhja e presidentit. "Zgjedhjet e jashtëzakonshme janë politike dhe për çdo proces politik ne kemi të gatshëm", ka theksuar Mustafa. Mbledhja e Këshillit të Përgjithshëm të LDK - së e thirrur pas zhvillimeve më të reja në Kosovë, përkatësisht për ta marrë qëndrimin e strukturave të partisë se si të ecet më tutje konform zhvillimeve të fundit politike, është zhvilluar e mbyllur për media.

### **AAK - ja nuk e ndryshon pozicionin**

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me strukturën e saj në përbërje të ngushtë, e ka mbajtur një takim, në të cilin për diskutim i kishte zhvillimet e fundit në skenën politike. Në

këtë takim, që ka zgjatur rreth një orë e gjysmë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk ka marrë ndonjë qëndrim sa u përket hapave të mëtejshme që do të ndiqen lidhur me zgjedhjen e presidentit. Zëdhënësi i AAK-së, Ernest Luma, ka thënë se në takim është biseduar për situatën aktuale dhe zhvillimet politike aktuale në Kosovë. Por, ai nuk ka dashur të komentojë nëse në takim është diskutuar për mundësinë e pjesëmarrjes së AAK - së në seancën për zgjedhjen e presidentit. "Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është në korrent me ngjarjet dhe e ruan këtë kontinuitet. Situata nëpër të cilën po kalojmë është shumë serioze dhe natyrisht si parti politike qasemi shumë seriozisht për të mirën e vendit. Nuk mund të flasim në këtë moment për një vendim të tillë. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do ta marrë seriozisht edhe këtë çështje, sigurisht që organet më të larta dhe më të rëndësishme të partisë do të mbledhen, flas për Kryesinë dhe Këshillin Drejtues", ka thënë Luma. Ai ka bërë të ditur se në takimin e Këshillit Drejtues nuk është diskutuar lidhur me mundësinë e hyrjes në koalicion me PDK-në, ndërsa ka përsëritur se AAK-ja do ta bojkotojë seancën për zgjedhjen e presidentit në rast se Behgjet Pacolli do të jetë sërish kandidat. "Qëndrimi i deritashëm zyrtar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës është mospjesëmarrja në seancën parlamentare deri në një moment tjetër, në ndërkohë derisa zotëri Pacolli do të jetë kandidat për president të Kosovës nuk do të marrim pjesë në seancë", ka thënë ai. Sipas Lumës, çështja e ndryshimit të nenit kushtetues, i cili i referohet presidentit si rrugëzgjidhje nga kriza duhet të jetë pjesë e diskutimeve dhe konsultimeve të gjera të të gjitha partive politike, "Këto janë çështje që duhet të diskutohen më vonë dhe në vazhdimësi dhe me një konsultim më të gjerë. Nuk është momenti dhe mënyra për ta dhënë një përgjigje të tillë", është shprehur Luma. Të hënën pritet pranimit-dorëzimi i postit të presidentit, e paralelisht me këtë, sipas burimeve tona, pritet një takim ndërmjet dy partnerëve të koalicionit.

### **Pas pranimit-dorëzimit të detyrës, tryeza PDK-AKR**

Zyrtarë të Aleancës Kosova e Re gjatë ditës së diel nuk janë deklaruar lidhur me hapat e mëtejshme që mund të marrë kjo parti, pas kërcënimeve për braktisje të koalicionit qeverisës. Por, sipas disa deklaratave nën zë, i vetmi kandidat për president mbetet Pacolli, sado që flitet për mundësinë e ndonjë kandidature tjetër. Përkundër përpjekjeve, nuk kemi arritur të kontaktojmë me ndonjërin nga zyrtarët e PDK-së. Pacolli duket se nuk i pranoi me shumë qetësi qëndrimet e forcave politike, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Teksa opozita kërkon një marrëveshje politike, AKR-së i ka fshikulluar në mendje dalja nga koalicioni nëse lëvizet nga marrëveshja paraprake me PDK-në. Kjo e fundit tashmë ka filluar të përballet me aritmetikën parlamentare të votave, duke marrë parasysh qëndrimin e një pjese sado të vogël brenda saj, që në mënyrë publike kanë shprehur qëndrime të kundërta me liderin e saj. Ministri i Brendshëm dhe nënkryetari i PDK-së, Bajram Rexhepi, ka thënë se nuk e di nëse kandidat për president do të jetë Pacolli, apo dikush tjetër nga partia e tij. "Opozita duhet të jetë konstruktive dhe nuk mund ta bojkotojë Parlamentin, sepse për këtë me siguri nuk kanë marrë vota", tha Rexhepi për mediet serbe. Ai po ashtu ka vlerësuar se Kosova pothuajse katër vjet është larg zgjedhjeve parlamentare. Për votimin e presidentit opozita duhet të jetë e pranishme në Kuvend në dy raundet e para të votimit, derisa në raundin e tretë presidenti zgjidhet me shumicën e të pranishmëve. Rexhepi shpreson se opozita do të ketë mirëkuptim, sepse nuk është mirë që çdo tre muaj të humbin rreth 20 milionë euro për zgjedhje. Ai tha se Pacollit duhet dhënë shansi që të tregohet në 100 ditë e para, duke shtuar se nuk e di nëse ai apo dikush tjetër nga partia e tij do të jetë kandidat për president. I.KRASNIQI

---

**Pacolli, kusht i koalicionit**

---

**Aleanca Kosova e Re ka ritheksuar qëndrimin se do të dalë nga koalicioni qeverisës me PDK-në, në rast se Behgjet Pacolli nuk kandidohet përsëri për president, ashtu siç parasheh marrëveshja politike. Ndërkohë, liderët e PDK-së, LDK-së dhe AKR-së kanë nisur të hënën takimet me ambasadorin amerikan Christopher Dell në kërkim të opsioneve për daljen nga situata aktuale politike e krijuar pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese**

Aleanca për Kosovën e Re (AKR) e ka “kërcënuar” PDK-në e Hashim Thaçit se nëse kjo parti nuk pranon që Behgjet Pacolli të rikandidojë për president të vendit do të tërhiqet nga koalicioni qeverisës. Në mbledhjen e kryesisë së AKR-së është vendosur që kjo parti t’i mbetet besnik koalicionit qeverisës me PDK-në. Ushtruesi i detyrës së kryetarit të kësaj partie, Ibrahim Makolli ka thënë se AKR-ja do ta propozojë sërish Behgjet Pacollin për president të Kosovës, ndërsa ka paralajmëruar se nëse ky vendim nuk përmbushet nga PDK-ja, atëherë AKR-ja do ta shqyrtojë marrëveshjen për bashkëqeverisje. Ai ka thënë se Behgjet Pacolli është kandidat jo vetëm i Koalicionit për Kosovë të Re, por njëkohësisht edhe pjesë e marrëveshjes së koalicionit në mes partnerëve qeverisës. ”Kemi një marrëveshje para vetes dhe do të jemi në mbështetje të kësaj marrëveshje në secilën pikë të saj. Për çfarëdo arsye të mosplotësisimit të ndonjëres prej këtyre pikave natyrisht AKR-ja do ta rishikojë dhe do të ndërmarrë veprime të tjera të mëtutjeshme. Ne jemi të vendosur që kjo marrëveshje me partnerin e koalicionit të realizohet në përpikëri më të madhe”, ka thënë Makolli.

**Problem kuorumi**

Tutje Makolli ka theksuar se janë në kontakt të vazhdueshëm me partnerët në koalicion, PDK-në, për dalje nga kriza. ”Me vet faktin që bashkërisht me PDK-në kemi arritur që të mbledhim nënshkrimet për kandidaturën, nominimin e kandidatëve për president të vendit, me vet faktin që me PDK-në dhe partner të tjerë të koalicionit qeverisës kemi mbledhur nënshkrimet për seancë të jashtëzakonshme, nënkupton përkushtimin dhe vullnetin e plotë të PDK-së për të zbatuar marrëveshjen që e kemi arritur bashkë” ka thënë Makolli. Por, pengesë kryesore për koalicionin qeverisës, sipas Ibrahim Makollit, po paraqet sigurimi i kuorumit të nevojshëm në ditën e zgjedhjes së presidentit në Kuvend. “Asnjëherë nuk janë vënë në pikëpyetje votat e deputetëve brenda, problemi është tek kuorumi dhe sikurse e dini Gjykata Kushtetuese, në njëfarë forme ka konstatuar se deputetët e Kuvendit të Kosovës, duhet ta ndiejnë obligim kushtetues për të marrë pjesë në seancat e Kuvendit, përkundër faktit që deputeti është i lirë të vendosë me bindje të vet. Por ne jemi zgjedhur deputetë dhe duhet ti kryejmë detyrimet e tona kushtetuese dhe një nga këto është zgjedhja e udhëheqësve”, ka thënë Makolli. Në lidhje me paralajmërimet e opozitës për bojkot të seancës nëse Behgjet Pacolli kandidohet për president. Makolli ka thënë se partitë opozitare pakënaqësinë e vet duhet ta shfaqin me anë të votës në Kuvend. “Është e drejtë e partive politike që të bojkotojnë, por nuk e di nëse kështu po i bëjmë një shërbim të mirë vendit, sepse po krijojmë praktika që edhe nesër partitë opozitare të

bojkotojnë ose të mos marrin pjesë në seanca’’, ka theksuar Makolli, duke u bërë thirrje partive opozitare që në ditën e zgjedhjes së Presidentit mos ta bojkotojnë seancën.

U.d. i AKR-së ka përjashtuar mundësinë e propozimit të një kandidati konsensual, pasi siç ka thënë ai, një gjë e tillë nuk parashihet me Kushtetutë. ‘‘Vendimi i Kushtetutës e përjashton mundësinë e presidentit konsensual. Sepse, sipas kësaj logjike i bie që ne pajtohemi ta zgjedhim njërin kandidat për president, ndërsa një kandidati tjetër do t’i themi që t’i duhet të aplikosh sa për të plotësuar një numër, kjo është përqeshje me autoritetin’’, ka theksuar Makolli. Ai ka paralajmëruar se në ditët në vazhdim do të konsultohen më të gjitha partitë parlamentare për dalje nga kriza.

### **Ibrahim Makolli kandidat për president ?**

Liderët e PDK-së, LDK-së dhe AKR-së kanë nisur të hënën takimet me ambasadorin amerikan Christopher Dell në kërkim të opsioneve për daljen nga situata aktuale politike e krijuar pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila shpalli jokushtetuese zgjedhjen e Behgjet Pacollit president. Mediat kanë raportuar se ambasadori Dell ka mbajtur një takim të përbashkët me kryeministrin Hashim Thaçi dhe ish-presidentin Behgjet Pacolli ku është diktuar për mundësitë e gjetjes së një zgjidhje për presidentin. Gjithashtu, Dell ka takuar të hënën edhe liderin e LDK-së, Isa Mustafa po me të njëjtin qëllim. Në kuadër të këtyre konsulteve, pasdite vetura e Pacollit është parë të hyjë në Ambasadën Amerikane, duke shënuar kështu takimin e dytë brenda ditës në mes Pacollit dhe Dellit. Njoftohet se Pacolli ka kundërshtuar kandidaturën e mundshme të Agim çekut si president konsensual dhe qëndrimin për koalicion, ndërsa ka lënë të hapur mundësinë e kandidimit të Ibrahim Makollit nga AKR deri në ndryshimin e nenit 86 të Kushtetutës së Kosovës.

### **Tri kushtet e Kryesisë së AKR-së për koalicionin qeverisës:**

1. AKR mbështet koalicionin në të gjitha pikat dhe kërkon zbatimin e saj të plotë,
2. Vetëm Pacolli dhe askush tjetër duhet të jetë për president,
3. Kryesia e AKR-së, i bën thirrje opozitës për një reflektim pozitiv për interesat e vendit për të dalë nga situata e krijuar.

---

## **Pranohet Pacolli! - zgjedhjet në mot?!**

---

**LDK-ja do të mbështetë Behgjet Pacollin për president, por jo pa kushte. Kryetari i partisë më të madhe opozitare, Isa Mustafa, ka paraqitur një paketë për rrugëdalje nga kriza e cila parasheh një marrëveshje për mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme, përfshirë edhe ato për president në verën e vitit të ardhshëm. AAK kërkon mbajtjen e një tryeze të partive parlamentare. U.d i presidentit për nesër i ka ftuar partitë në takim**

LDK-ja do ta pranonte Pacollin për president vetëm nëse paraprakisht do të siguronte me marrëveshje se deri në verën e ardhshme (2012) vendi të shkonte në zgjedhje të përgjithshme, përfshirë edhe ato për presidentin. Kështu ka deklaruar kreu i LDK-së, Isa Mustafa në emisionin Rubikon të KTV-së. Me pretendimin se opozita në Kosovë ka më shumë vota se pozita, kreu i LDK-së, Isa Mustafa, është i vendosur që të mos lejojë zgjedhjen e presidentit parlamentar, ndonëse sërish vetë nuk do të caktojë një kundërkandidat. Duke lënë fajtor kryeministrin Thaçi për gjendjen e tanishme, Mustafa ka thënë se koalicioni qeverisës do të mund të llogaritet në pjesëmarrjen e deputetëve të tij në parlament gjatë votimit të presidentit vetëm, nëse nënshkruan kontratë me Thaçin dhe partitë parlamentare që pas një viti vendi të shkojë në zgjedhje të reja. Kreu i LDK-së ka prezantuar paketën për rrugëdaljen nga kriza, për të cilën ka thënë se ka biseduar edhe me AAK-në, por ende jo edhe me Vetëvendosjen. Ai ka shprehur gatishmërinë për takimin me Thaçin, por sipas tij, iniciativa i takon atij apo u.d. të presidentit të Kosovës, Krasniqi. Ndërsa ka thënë se nëse ai dhe koalicioni mund të sigurojë 2/3 pa LDK-në, le të urdhërojë e le të zgjedhet presidenti. Sa i përket akuzave të Thaçit se deputetët opozitarë shkelën kushtetutën me bojkotimin e seancës. Mustafa ka thënë se këtë version e shohin vetëm syzat e Thaçit.

### **Krasniqi: Të ndryshohet Kushtetuta**

U.D i presidentit, Jakup Krasniqi, e ka quajtur “proces të ngutshëm” zgjedhjen e Behgjet Pacollit për president, ngase, sipas tij, nuk kishte një komunikim ndërmjet subjekteve politike që janë pjesë e Kuvendit. Krasniqi ka kërkuar që brenda 6 muajsh, sa do të jetë shef i shtetit, të ndryshohet neni 86 i Kushtetutës, që ka të bëjë me zgjedhjen e presidentit. “Brenda gjashtë muajve mund të bëjmë ndryshimin e Kushtetutës dhe presidenti të zgjidhet në zgjedhje të drejtpërdrejta”, ka thënë Krasniqi të hënën gjatë një interviste për RTK-në. Ai ka thënë se do të përpiqet të bisedojë me të gjitha partitë parlamentare për të dal nga situata e krijuar rreth zgjedhjes së presidentit. “Do të bëj përpjekje me të gjitha partitë në Kuvend që nëpërmjet bisedimeve të mund të vihet deri te një tryezë për një konsensus për dalje nga kriza dhe për të gjetur zgjidhjen për presidentin” ka thënë Krasniqi.

### **AAK kërkon tryezë politike**

Kryesia e AAK-së, të hënën ka kërkuar ndryshimin e Ligjit për zgjedhje, që sipas AAK-së do të garantonte një stabilitet afatgjatë në vend, ndërsa e ka hedhur idenë e mbajtjes së një tryeze politike nga partitë parlamentare, për gjetjen e një konsensusi politik. Nënkryetari i parë i AAK-së, Blerim Shala, e ka vlerësuar si të thelluar krizën politike në Kosovë. Ai ka thënë se kryesia e AAK-së rikonfirmon qëndrimin e saj se situata e tashme mund të tejkalohet përmes respektimit të plotë të Kushtetutës së Kosovës, krijimit të konsensusit politik në Kosovë, përgatitjes së mirë politike dhe teknike të proceseve të ardhshme. Sipas tij, ndryshimi i Kushtetutës së Kosovës dhe i Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme janë të domosdoshme për

stabilizimin afatgjatë të skenës politike të vendit, e cila është e dëmtuar rëndë me zgjedhjet e manipuluar parlamentare të dhjetorit të vitit të kaluar.

## Pacolli nuk e deklaroi pasurinë

**Te rasti Pacolli situata ka ndryshuar, pasi vendimi i Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit anulohet zgjedhja e presidentit, është komunikuar 10 ditë para skadimit të afatit ligjor për deklarimin e pasurisë**

Ndonëse në Agjencinë Kosovare Kundër Korrupsionit ka qenë një pritje premtuese se deri në fund të muajit mars, së bashku me deklaratat financiare të të gjithë zyrtarëve të lartë, të obliguar me ligj, do të deponohet edhe deklarata financiare e ish-presidentit në tentativë z. Behgjet Pacolli, kjo nuk ka ndodhur. I kontaktuar të hënën nga gazeta, kreu i Agjencisë Kundër Korrupsionit, Hasan Preteni, tha se akoma nuk janë sistemuar të gjithë formularët që janë dorëzuar me të madhe javën e fundit në AKK, por kjo punë është duke u bërë me të madhe në këtë institucion. Megjithatë, sipas Pretenit, është shumë e sigurt se në dosjet që ditët e fundit kanë arritur edhe me thasë në AKK nuk do të gjendet për t'u sistemuar dosja e deklarimit të pasurisë nga Behgjet Pacolli. "Me gjasë, z. Pacolli nuk e ka deklaruar pasurinë e tij, ndonëse ka pasur bisedime se kjo do të bëhej deri në fund të muajit. Ditët e fundit në AKK kemi qenë të vërshuar nga dosjet enorme të formularëve që kanë ardhur lidhur me deklarimin e pasurisë së zyrtarëve, që afatin e fundit e kanë pasur 31 marsin. Por, te rasti Pacolli ka ndryshuar situata, pasi vendimi i Gjykatës Kushtetuese, sipas të cili anulohet zgjedhja e presidentit është komunikuar 10 ditë para skadimit të afatit ligjor për deklarimin e pasurisë", tha Preteni, në një prononcim për gazetën "Kosova Sot". Ai ka deklaruar madje se Pacolli nuk i nënshtrohet as obligimit tjetër në cilësinë e deputetit për ta bërë deklarimin e pasurisë sipas ligjit, pasi ai e ka liruar këtë mandat me rastin e zgjedhjes së kontestueshme për president të vendit.

### S'ka obligim, sipas Pretenit

"Z. Pacolli e ka liruar mandatin e deputetit dhe nuk ka obligim ligjor që ta deklarojë pasurinë as në cilësinë e deputetit, siç e parasheh ligji për deputetët tjerë që janë zgjedhur dhe duhet ta bëjnë këtë deri më 21 prill", tha Preteni. Sipas drejtorit të AKK - së, tash z. Pacolli mund të mendohet një vit të plotë deri në deklarimin e pasurisë së tij, pas rrëzimit nga Gjykata Kushtetuese dhe lirimit të postit të deputetit, që e ka bërë me rastin e futjes në garë për të parin e vendit. "Sipas ligjit për deklarimin pasurisë së zyrtarëve të lartë, Pacolli e ka një vit afat që ta bëjë deklarimin e pasurisë pas lirimit nga mandati i tij si deputet, e nuk ka obligime tjera të mëhershme që ta bëjë këtë, nëse nuk ndodh rizgjedhja e tij në postin e presidentit, që tash mbetet çështje e negociatave politike që zhvillohen ndërmjet subjekteve. Nëse ndodh zgjedhja në postin e presidentit, atëherë ai përsëri obligohet që në afatin njëmuajor ta përmbushë obligimin në bazë të ligjit", tha z. Preteni. Sa i përket numrit të zyrtarëve të lartë që e kanë kryer obligimin e tyre ligjor që deri më 31 mars ta bëjnë deklarimin e pasurisë, Preteni tha se një raport përmbledhës preliminar pritet të hartohet në AKK gjatë kësaj fillim jave, derisa të dhënat e detajuara do të publikohen vetëm pasi të jetë sistemuar dhe skanuar i gjithë materiali i grumbulluar. S. AHMETI



---

## **Aktivizohet ambasadori Dell**

---

**Ambasadori amerikan në Prishtinë, Christopher Dell, ka takuar kryeministrin Hashim Thaçi, kreun e LDK-së, Isa Mustafa dhe Behgjet Pacollin, për të diskutuar mundësitë e gjetjes së një zgjidhje për zgjedhjen e Presidentit**

Situata politike në vend, duket se është futur udhë pakrye, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, për të rrëzuar zgjedhjen e Behgjet Pacollit për President të Kosovës. Disa ditë pas, duket se ambasadori amerikan në Kosovë, Christopher Dell e ka parë se situata nuk është në rrugë të mirë, dhe ndërhyrja e tij, është më se e nevojshme. Ai të hënën sipas burimeve të Kosova Online, ka takuar kryeministrin Hashim Thaçi, liderin e LDK-së, Isa Mustafa dhe Behgjet Pacollin.

### **Takimi me Thaçin dhe Pacollin**

Mësohet se ambasadori Dell ka mbajtur një takim të përbashkët me Kryeministrin Hashim Thaçi dhe ish-Presidentin Behgjet Pacolli, ku është diskutuar për mundësitë e gjetjes së një zgjidhje për presidentin. Gjithashtu Dell ka takuar sot edhe liderin e LDK-së, Isa Mustafa po me të njëjtin qëllim. Në kuadër të këtyre konsultave, pasdite vetura e Pacollit është parë të hyjë në Ambasadën Amerikane, duke shënuar kështu takimin e dytë brenda ditës në mes Pacollit dhe Dellit. Këto burime brenda AKR-së bëjnë të ditur se Pacolli ka kundërshtuar kandidaturën e mundshme të Agim Çekut si president konsensual dhe qëndrimin në koalicion, ndërsa ka lënë të hapur mundësinë e kandidimit të Ibrahim Makollit nga AKR deri në ndryshimin e nenit 86 të Kushtetutës së Kosovës.

### **Qëndrimet e Mustafës**

Gjithashtu, mësohet se Isa Mustafa gjatë takimit me diplomatin amerikan ka ritheksuar qëndrimin e LDK-së për gjetjen e një kompromisi. Ai është duke kërkuar caktimin e një date të zgjedhjeve të parakohshme për vitin e ardhshëm. Ndërsa deri në atë kohë do të bëheshin ndryshime në ligjin elektoral dhe ndryshime tjera me konsensusin e spektrit politik në vend.

---

## Po Pacolli, po zgjedhjet më 2012

---

Lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa ka thënë se partia që ai drejton, do ta votonte edhe Pacollin për President të vendit dhe këdo tjetër, por me kushtin e vetëm nëse merren vesh që zgjedhjet e reja të mbahen më 2012. "LDK-ja do ta pranonte Pacollin për President vetëm nëse paraprakisht do të siguronte me marrëveshje se deri në verën e ardhshme vendi do të shkonte në zgjedhje të përgjithshme, përfshirë edhe ato për presidentin". Kështu ka deklaruar kreu i LDK - së, Isa Mustafa, transmeton KTV. Duke lënë fajtor kryeministrin Thaçi për situatën aktuale, Mustafa ka thënë se koalicioni qeverisës do të mund të llogarisë në pjesëmarrjen e deputetëve të tij në parlament gjatë votimit të Presidentit vetëm nëse nënshkruan kontratë me Thaçin dhe partitë parlamentare që pas një viti vendi të shkojë në zgjedhje të reja. Ai po ashtu me këtë rast ka prezantuar një paketë për rrugëdaljen nga kriza, për të cilën ka thënë se ka biseduar edhe me AAK-në, por ende jo edhe me Vetëvendosjen.

---

## **Pacolli “nuk e dorëzon” detyrën e presidentit**

---

AKR-ja përmes një deklaratë për shtyp ka njoftuar se Behgjet Pacolli nuk do të jetë i pranishëm në ceremoninë e pranim-dorëzimit të detyrës së presidentit. Sipas njoftimit, zoti Pacolli nuk mund ta bëjë dorëzimin e detyrës te kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, "duke u bazuar në nenin 90 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në aktgjykimin e fundit të Gjykatës Kushtetuese, të datës 1 prill 2011". Ky vendim vjen edhe për faktin se Jakup Krasniqi tashmë e ka filluar ushtrimin e detyrës së presidentit, prandaj Behgjet Pacolli, e sheh të panevojshme pjesëmarrjen në ceremoninë e pranim-dorëzimit, njofton AKR.

---

## Sërish me Pacollin

---

**PDK nuk po e pranon ofertën e LDK-së për zgjedhje të reja pas një viti. President konsensual nuk ka, prandaj koalicioni do të provoj rizgjedhjen e Pacollit, ose zgjedhje brenda dy muajve**

Si kohë optimale për këto zgjedhje përmenden pranvera apo vjeshta e vitit 2012. Hashim Thaçi dhe PDK-ja duket se kanë nevojë për një parti më të vogël partnere pasi që e kanë kuptuar se një koalicion eventual parazgjedhor midis LDK-së dhe AAK-së mund të çojë në opozitë PDK-në në mandatin e ardhshëm. Një situatë e tillë ka sjellë si rezultat faktin tjetër që të pesë partitë në parlament kalkulimet e tyre politike i bëjnë në llogari të zgjedhjeve të ardhshme, të cilat vetëm se po japin shkëndijat e para në horizont. Kontaktet e djeshme ndërmjet kreut të PDK-së Thaqit dhe atij të AKR-së Pacollit kanë lënë të nënkuptohet se fillimisht do të provohet që të ulen me opozitën në një tryezë politike për të diskutuar të gjitha opsionet. Nikoqiri i parë i këtyre takimeve do të jetë ushtruesi i detyrës së presidentit, Jakup Krasniqi duke mos e përjashtuar mundësinë që më pas, javën apo javët në vijim, bisedimet të vazhdojnë edhe në ambiente tjera jashtë institucioneve. Aleanca Kosova e Re sërish kërcënon se nëse Pacolli nuk do të jetë president, marrëveshja me PDK-në do të prishet. Prishja e koalicionit nuk e çon detyrimisht vendin në zgjedhje brenda 45 ditësh nëse në Kuvend nuk do të ngrihet mocioni i mosbesimit ndaj qeverisë. Sfida e zgjedhjes së presidentit të Kosovës ka nxjerrë në shesh shumë skenarë në mënyrë që vendi të mos shkojë sërish në zgjedhje të shpejta. Skenari i parë është ai që vendi të vazhdojë me ushtruesin e detyrës dhe të ndryshojë nenin 86 të Kushtetutës, në mënyrë që presidenti të mos zgjidhet më nga Kuvendi, por drejtpërdrejtë nga qytetarët. Dobësitë e këtij skenari janë se përveç zgjidhjes së njëjës së presidentit, nuk parashihen reforma zgjedhore. Ky skenar është prezantuar aktualisht nga përfaqësues të partive në pushtet. Mirëpo një nismë e tillë kërkon ndryshimin e Kushtetutës, e cila mund të ndryshojë vetëm me dy të tretat e deputetëve në Kuvend, të cilat pozita nuk i ka. Andaj duket se partitë në pushtet, sidomos PDK-ja do të detyrohet t'i bëjë disa kompromise me opozitën në lidhje me reformat zgjedhore. E reformat zgjedhore paraqesin pikërisht skenarin e dytë në të cilin synon opozita. Ndryshimi i sistemit zgjedhor i Kushtetutës, i Ligjit për presidentin si dhe caktimi i datës së zgjedhjeve, përbën pikërisht kërkesën e opozitës që të tejkalohet nyja e zgjedhjes së presidentit. LDK dhe AAK propozojnë një marrëveshje me partitë në pushtet deri në zgjedhjet e ardhshme. Anëtari i Kryesisë së LDK-së Kujtim Shala thotë se synimi i LDK-së nuk është që të përfshihet në ndonjë formulë të re qeverisëse. Madje, ai nuk e përjashton as mundësinë që të vazhdohet me mandatin e një qeverie të pakicës nëse ndodh prishja e koalicionit aktual apo një qeverie teknike. Me rëndësi është që para se të shkohet në zgjedhje të ketë edhe një marrëveshje thotë Shala. “Në këtë marrëveshje do të afatizohej koha e kësaj qeverie që e kemi tani, do të përcaktoheshin disa mandate ose detyra, në radhë të parë reformat zgjedhore, ndryshimi i Kushtetutës, i Ligjit për zgjedhjen e presidentit, i sistemit zgjedhor etj”, thekson Shala. Nga marrëveshja deri në zgjedhjet e ardhshme, Shala thotë se mund të ketë një kohëzgjatje prej një viti, në mënyrë që të ketë afat të mjaftueshëm për reformat që po synohen. Me rëndësi sipas Shalës, është që të gjendet një kandidaturë e mirë për president dhe të merren garanci për zhvillimin e reformave në rast të dështimit të marrëveshjes, Shala thotë se vendi mund të shkojë

edhe në zgjedhje të shpejta. “Ajo që kërkojmë ne është që vendi të ketë sa më shumë kohë që t’i bëjë reformat dhe të përgatitet për zgjedhjet e parakohshme. Ne nuk mendojmë që është e domosdoshme që ato të bëhen brenda 45 ditëve, por nëse PDK nuk ka vullnet për atë që përmbushë kërkesat tona dhe të bisedojë me ne për çështje të tilla atëherë ne jemi të gatshëm edhe për atë variant”, thotë Shala. Për të arritur një marrëveshje rreth tejkalimit të gjendjes, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës fton spektrin politik, si atë në pushtet ashtu edhe partitë opozitare që të ulen në një tryezë të përbashkët për të propozuar hapat e mëtejshëm. Sekretari i përgjithshëm i AAK-së Burim Ramadani thotë se pa një marrëveshje politike, Grupi Parlamentar i AAK-së do ta bojkotojë çdo seancë që mund të thirret për zgjedhjen e presidentit. “Në çfarëdo lloj procedimi të presidentit pa e pasur këtë tryezë politike grupi parlamentar i AAK-së nuk do të qëndrojë në sallë. Një procedim i tillë do të ishte vërtet me pasoja të paparashikueshme për vendin dhe të ardhmen e Kosovës”, thotë Ramadani. Edhe AAK kërkon që subjektet politike të merren vesh në lidhje me disa ndryshime kushtetuese e ligjore që kanë të bëjnë me reformat zgjedhore. Por të gjithë këta skenarë sipas Ramadanit të AAK-së, mund të akordohen përmes një tryeze të përbashkët politike. “Ndryshimi i Kushtetutës dhe i Ligjit për zgjedhje janë të domosdoshme, por të gjitha këto tema duhet të vendosen në tryezën politike të të gjitha partive politike parlamentare. Pra, ne duam që të ketë tryezë politike për çështje madhore dhe të gjitha përgatitjet për tejkalimin e kësaj situate janë çështje madhore për vendin”, thekson Ramadani. Aktualisht, më e përmbajtur nga iniciativat është Lëvizja Vetëvendosje, e cila ka shprehur pakënaqësinë e vet si në raport me pozitën, ashtu edhe me dy partitë tjera opozitare. Sidoqoftë edhe në rast se Kuvendi nuk arrin ta zgjedh presidentin, ushtruesi i detyrës ka një mandat prej 6 muajve që vendi të mos zhytet në një vakuum institucional. Ndërkaq edhe në rast të skenarit të prishjes së koalicionit aktual qeveria nuk shkarkohet, përderisa të mos ketë një kërkesë për mocion votëbesimi në Kuvend.

---

## Thaçi, Pacolli e Mustafa takojnë kuintin

---

“Gjithsesi besoj shumë që vendi do të ketë president të zgjedhur ditët në vijim”, ka thënë Makolli.

Në prani të përfaqësuesve të vendeve të Kuintit, të martën është zhvilluar një takim ndërmjet kryeministrit Hashim Thaçi, kandidatit të koalicionit qeverisës për president të Kosovës, Behgjet Pacolli, dhe kryetarit të LDK-së, Isa Mustafa. Por, rezultatet e këtij takimi nuk janë bërë të qarta, dhe se sa është e sigurt zgjedhja e presidentit të Kosovës, me mandat të plotë. Deri më tani në lidhje me këto përpjekje politike për tejkalimin e bllokadës së zgjedhjes së presidentit, është prononcuar ushtruesi i detyrës së kryetarit të AKR-së, Ibrahim Makolli. Ai pohon se beson që këto përpjekje politike, ku janë përfshirë edhe ndërkombëtarët, do të rezultojnë me një zgjidhje dhe marrëveshje konkrete. "Unë besoj që do të mbizotërojë arsyeja dhe përgjegjësia e klasës politike në Kosovë për t'u dhënë zgjidhje problemeve, me të cilat po përballet vendi. Në këtë mënyrë edhe të hapet rrugë për proceset shumë të rëndësishme, në të cilat ka hyrë Kosova dhe që do të përballet ditëve dhe javëve në vijim. Gjithsesi besoj shumë që vendi do të ketë president të zgjedhur ditët në vijim", ka thënë Makolli. Lidhja Demokratike e Kosovës për tejkalimin e gjendjes në lidhje me zgjedhjen e presidentit, ka propozuar që si kompromis, koalicioni qeverisës, dhe sidomos PDK-ja, të pajtohet që të caktohet edhe data e zgjedhjeve për një afat prej një apo një viti e gjysmë, si dhe që ndërkohë, të bëhen ndryshime kushtetuese dhe të zhvillohen disa reforma në sistemin zgjedhore. Por, Ibrahim Makolli ka theksuar se për ofertat e opozitës ka dëgjuar vetëm përmes medieeve. Andaj, takimet e tilla si ai i ditës së martë, sipas tij, mund të jenë të domosdoshme për arritjen e disa marrëveshjeve të nevojshme për tejkalimin e bllokadës, "Përmes mjeteve të informimit jemi njoftuar për kërkesa të tilla. Natyrisht që çdo ide e partive politike do të trajtohet në tryezë të partive politike, në mënyrë që të gjenden zgjidhje të pranueshme, përmes të cilave vendi do të dilte nga kriza". Ndryshe, edhe presidenti në detyrë, Jakup Krasniqi nga e mërkura ka paralajmëruar se do t'i ftojë partitë politike në konsultime për të gjetur një zgjidhje në lidhje me zgjedhjen e presidentit të Kosovës. Kriza me zgjedhjen e presidentit pasoi aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, me të cilin konstatohet se zgjedhja e Pacollit në postin e presidentit në seancën e 22 shkurtit nuk i ka respektuar procedurat kushtetuese, kështu që procesi tani është kthyer në zero. Andaj, çdo dështim i serishëm i zgjedhjes së presidentit mund të çojë Kosovën në zgjedhje të parakohshme. "Gjithsesi që, ne, si parti politike, si edhe të tjerat, në vazhdimësi kemi theksuar nevojën për ndryshimin e ligjit zgjedhor, si edhe amendamentim të Kushtetutës, prandaj këto janë veprime që do të duhej ndërmarrë në të ardhmen në kuvendin e Kosovës", ka theksuar Makolli.

## Të bashkuar për Atifetën

**Zëvendësdirigjtorja e Policisë, Atifete Jahjaga, është kandidatja e përbashkët për presidente e PDK - së, LDK - së dhe AKR - së, me mbështetjen amerikane. Marrëveshja parasheh zgjedhje për presidentin pas afërsisht 15 muajve dhe zgjedhje parlamentare pas afërsisht 30 muajve**

Sipas marrëveshjes, ky komision do ta kryejë punën e vet brenda 6-9 muajve. Kurse zgjedhjet e para për presidentin do të mbaheshin jo më vonë se gjashtë muaj pas fuqizimit të ndryshimeve kushtetuese. Pikë tjetër e marrëveshjes, nënvizoi Thaçi, është ndryshimi i Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme. Edhe për këto ndryshime do të formohet një komision, i cili do të udhëhiqet nga opozita. Puna e komisionit do të përmbyllet në një afat prej 8 deri në 12 muaj. Kurse zgjedhjet parlamentare në vend do të shpallen jo më vonë se 18 muaj pasi që ligji i ndryshuar të hyjë në fuqi. Këto zgjedhje u tha se do të jenë në një afat me ato lokale. I impresionuar me arritjen e marrëveshjes, ambasadori Dell tha se Kosova kaloi një fazë të vështirë për formimin e institucioneve. "Liderët u treguan të gatshëm t'i vendosin interesat e shtetit para interesave të tyre. Fakti që unë jam me liderët kosovare tregon se ata mund të punojnë për të mirën e këtij vendi", tha Dell. Ndërsa lavdëroi konstruktivitetin e Pacollit, i cili me tërheqjen e tij mundësoi tejkalimin e krizës, Dell tha se kandidatja e ardhshme Atifete Jahjaga është në gjendje të marrë detyrën dhe të ushtrojë atë me përgjegjësi, siç bëri edhe sa ishte e angazhuar në kreun e Policisë së Kosovës.

Ai që më së shumti mori lëvdata për arritjen e marrëveshjes, ishte Behgjet Pacolli, i cili që zgjedhur nga Kuvendi në postin e presidentit me 22 shkurt. Por, vetëm 35 ditë me pas u detyrua të largohet pasi që Gjykata Kushtetuese nxori aktvendimin me të cilin konstatoi se Pacolli ishte zgjedhur me procedura anti - kushtetuese. Pacolli nuk ishte kandidat që gëzonte mbështetjen e opozitës, andaj ai tha se ishte tërhequr nga gara që të mos lejonte që vendi të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme. **"Koalicioni qeverisës do të vazhdojë, ndërkaq me qëllim të tejkalimit të kësaj krize politike dhe institucionale, unë jam tërhequr nga rikandidimi im për postin e presidentit të Republikës"**, ka thënë Pacolli. Marrëveshja është përshëndetur edhe nga lideri opozitar Isa Mustafa. Ai tha se me marrëveshje ishin respektuar disa nga kërkesat kryesore të LDK së, që kishin të bënin me presidentin e pranueshëm, reformat zgjedhore e kushtetuese dhe caktimin e afatit për zgjedhjet e përgjithshme. Pavarësisht kësaj marrëveshjeje, tani mbetet që në Kuvendin e Kosovës të ketë edhe një kundër kandidat për zgjedhjen e presidentit. Ndërkaq ka mbetur pa një përgjigje insistimi i gazetareve se a paraqet shkelje kushtetuese nominimi i një kandidati për president me afat prej 1 deri në 2 vjet, përderisa Kushtetuta parasheh që presidenti të ketë mandatin pesëvjeçar. Sipas procedurave tani marrëveshja i dërgohet Kuvendit ku do të procedohet tutje deri në finalizim dhe zgjedhje të presidentit të ri të Kosovës. Nëse do të plotësoheshin procedurat kushtetuese, Jahjaga do të duhet të ketë një kundërkandidat për president. Përderisa kuorumi prej dy të tretat e deputeteve tashmë është siguruar pasi që LDK si opozitë i është bashkuar kandidimit me pozitën.

---

## **Pacolli: Shkova por kthehem**

---

**Ish-Presidenti i kontestuar nga Gjykata, Behgjet Pacolli, thotë se nuk është tërhequr nga kandidati për president si pasojë e presioneve ndërkombëtare, por nga arsyeja që populli të mos vuajë nga “budallallëqet e liderëve politik”**

PRISHTINË - Ish-presidenti Behgjet Pacolli ka pranuar të tërhiqet nga kandidatura për president, duke u ndjerë si viktimë e pazareve politike. Ai tha se shkon përkohësisht me një marrëveshje politike që brenda këtij viti të ndryshohet Kushtetuta dhe të shkohet në zgjedhje të drejtpërdrejta për president, në të cilat do të garojë sërish. Në një intervistë dhënë gazetës "Zëri", afaristi i kthyer në politikë, Pacolli, kundërshton mundësinë që në qeverinë Thaçi 2 të ushtrojë detyrën e shefit të diplomacisë, duke e ndjerë veten si njeri i varur nga të tjerët. Duke qëndruar vetëm 36 ditë në postin e presidentit, Pacolli thotë se ka qenë i suksesshëm, ndërsa presidenti pasues, siç tha ai, do të jetë Atifete Jahjaga, një femër e pranuar nga dy partitë e mëdha politike, PDK dhe LDK. Ish - presidenti po ashtu tha se nuk është tërhequr nga kandidatura për president si pasojë e presioneve politike, por nga arsyeja që populli të mos vuajë nga "budallallëqet e liderëve politikë". Pacolli deklarohet kundër daljes së AKR - së nga qeverisja, ndërsa shprehet paksa i zemëruar ndaj kolegut të tij, Isa Mustafa, që nuk e ka përdorur një "eufemizëm" politik në relacion me të si president. Pacolli po ashtu ndihet mirë kur e sheh në TV ushtruesin e detyrës së president, Jakup Krasniqin ulur në kolltukët që ai i kishte blerë. "Shih sa të bukura janë", thotë Pacolli. Edhe Krasniqi i kishte përkohësisht.

**Zëri: Zoti Pacolli, Gjykata konteston mënyrën se si jeni zgjedhur president. Si e vlerësoni këtë ... vendim politik apo juridik?**

**Pacolli:** Unë kam thënë se e implementoj pikë për pikë vendimin e Gjykatës Kushtetuese. A ka qenë vendim i drejtë apo i pa drejtë, sigurisht që mua nuk më takon ta komentoj. Ai vendim për mua është i plotfuqishëm, dhe si të tillë, në momentin kur e kam marrë, e kam lexuar dhe kam dhënë dorëheqje nga detyra ime si president i Kosovës.

**Zëri: A ndjeheni i relaksuar për faktin se për një muaj keni qenë shumë aktiv?**

**Pacolli:** Jam i bindur se ajo presidencë gjatë kohës sa isha aty ka qenë proaktive. Unë atë presidencë e kam kthyer në një zyre të vërtetë, siç i ka hije një presidencës, si me staf, si me logjistikë, si me dokumentacion, si me çdo gjë e kam digjitalizuar çdo gjë që ka qenë në atë presidencë dhe si e tillë ka qenë e gatshme të fillojë reformat, që unë i kisha ndërmend t'i bëja në gjyqësi, në ekonomi dhe në diplomaci.

**Zëri: Gjykata jua ndali hovin. A ju ka demotivuar kjo?**

**Pacolli:** Nuk më ka demotivuar ... E ardhmja do ta vërtetojë se a ka pasur ndonjë veprim politik brenda, a ka pasur ndonjë abuzim në dy vendimet e saja që ka marrë. Unë nuk i kundërshtoj ato se si kanë qenë, por besoj se në krejt këtë sigurisht unë nuk jam ai që kam humbur, por kam arritur të jem president i Kosovës. Bile, mos po humb Kosova në këtë rast.



**Zëri: Nuk po ndjeheni humbës?**

**Pacolli:** Unë nuk jam humbës, përkundrazi jam krenar që sa kam qenë aty, asnjë cent nuk ja kam shpenzuar buxhetit të Kosovës, as pagë, as rrugë. Çdo gjë e kam financuar vetë. Nuk ndjehem fajtor për asgjë. Kushtetutën unë nuk e kam shkelur, procedurat nuk i kam bërë unë, i ka bërë krejtësisht tjetërkush. Unë jam vetëm viktimë. Më dhimbset sepse unë e lashë edhe subjektin tim ekonomik, e lashë partinë time, e lashë edhe postin e deputetit, tash kam mbetur edhe pa punë. Më duket e padrejtë kjo që është bërë ... Absolutisht nuk do të vij asnjëherë më në atë situatë që të jem subjekt i fyerjeve, sharjeve, nënçmimeve. Asnjëherë më nuk do ta bëj këtë.

**Zëri: Atëherë a jeni i gatshëm të sprovoheni në zgjedhjet e drejtpërdrejta nga populli?**

**Pacolli:** Atëherë po. Sepse është ide e imja e vjetër. Ju e dini që në vitin 2006 kur kam ardhur, kam qenë i pari që e kam thënë. Po e shihni se idetë e mia kuptohen, por kuptohen me vonësë. Mënyra e zgjedhjes së presidentit nuk është e drejtë. Unë këto reforma i kam nisur, duhet të vazhdohen.

**Zëri: Pra zoti Pacolli keni vendosur që të largoheni, mos të kandidoheni më fare për president?**

**Pacolli:** Unë nuk kam dashtë të jem objekt i pazareve të ndryshme. Kam thënë gjithmonë dhe them se posti i presidentit, ose posti politik që unë dua ta synojnë në Kosovë, nuk ishte post për interesa personale e partiake. Prandaj mbi këtë ide nuk kam lejuar që qytetari i Kosovës të shkojë prapë në zgjedhje. Do të thotë unë nuk do të provokoj kurrë këtë. Edhe tash isha në takim me njerëzit e mi duke i bindur ata se duhet të vazhdojnë koalicionin në mënyrën më të drejtë, më të sinqertë.

**Zëri: Pa Behgjet Pacollin president?**

**Pacolli:** Pa Behgjet Pacollin president.

**Zëri: Ju po thoni se vraponi në shtigje të gjata?**

**Pacolli:** Po, e vërtetë. Unë nuk do të ndalem pavarësisht se çka do të bëhet edhe me riformatimin e qeverisë, sepse Presidenca ishte vetëm një pjesë e kontratës, ndërsa me humbjen e saj ne do kemi të drejtë të kemi më shumë në qeveri.

**Zëri: A pranon të jesh ministër i Jashtëm?**

**Pacolli:** Unë asnjëherë nuk do të mbështetëm në dëshirën e dikujt tjetër. Nuk do të jem ministër i Jashtëm, sigurisht. Ndoshta AKR - së i takon kjo, por me siguri që Behgjet Pacolli nuk do të jetë ai (bën një digresion duke shikuar TV – në, në të cilën Jakup Krasniqi qëndron ulur në kolltukët që i kishte blerë ai. Shih sa të bukura janë). Në asnjë ministri s' do të jem. Do ishte mëkat që të mbyllem në një zyre, por dimensionet e mia janë globale.

**Zëri: Vendimi për tërheqje a është presion i jashtëm?**

**Pacoli:** Nuk kam pasur as presion e as rekomandim. Ata kanë thënë që unë të kandidohem, por unë kam heqë dorë nga kjo. Por, me një kusht që në 6 muajshin e parë të kalojë reforma ose amendamenti i Kushtetutës për zgjedhjen e presidentit. Dhe pas 6 apo 7 muajve të mbahen zgjedhjet e lira për president?

**Zëri: Keni pasur takime me ambasadorin Dell, shefin e ICO-s Feith, Thaçin, Mustafën?**

**Pacoli:** Ka pasur takime intensive për zgjidhjen e problemit, për mënyrën se si të gjendet zgjidhja. Punonim, punonim dhe në fund topi mbeti te unë dhe unë duhet të përgjigjem. Dhe praktikisht duhet të ishte një viktimë, dhe askush nuk ishte në gjendje të merrte përgjegjësi prandaj viktima isha unë ... unë nuk jam njeri që bllokoj procese, por jam njeri që ndërtoj dhe nuk shkatërroj dhe në këtë çështje kam hequr dorë..

**Zëri: Prapa leni AKR - në që është në koalicion, çka nëse edhe ata tërhiqen dhe bie qeveria?**

**Pacoli:** Unë asnjëherë nuk kisha bërë që kjo qeveri të bjerë. Kjo qeveri ka ministra të mirë. Kjo qeveri meriton të vazhdojë punën dhe dëshiroj të vazhdojë më tutje. Është gabim që të dalë nga qeverisja. Fundi i fundit është vetëm një ministri e AKR - së, dy tjera janë të koalicionit. Qëllimi është që qeveria të vazhdojë dhe të mos shkohet në zgjedhje të parakohshme. Askush nuk do të ma falte këtë dhe nuk do ta marr këtë përgjegjësi.

**Zëri: A do t'i mbetet AKR - së posti i presidentit?**

**Pacoli:** Nuk insisto. Për çdo kënd në qeveri nuk do të kishte efekt, sepse ai post ka pasur sens ta ushtroj unë sepse di ta bëj këtë dhe do t'i sillte Kosovës sukses. Jam krenar që unë me ndihmën e miqve ndërkombëtarë kam arritur t'i uli në një tryezë dy liderët e partive më të mëdha, Thaçin e Mustafën. Kam insistuar që këtu të këtë rezultat dhe ky ka qenë qëllimi im, në mënyrë që qytetarët e Kosovës të mos i paguajnë budallallëqet e liderëve partiakë.

**Zëri: Isa Mustafën e keni mik në biznes?**

**Pacoli:** Kur të flas për Isa Muatafën, unë gjithmonë e ndaj biznesin prej ideologjisë dhe miqësisë. Këto janë tri gjëra. Ai është mik imi, ideologjikisht ndryshojmë, edhe profesionalisht ai ka tjetër profesion e unë tjetër, por ai e ka respektin tim të madh edhe pse ai këtu ka mundur të jetë më i butë me ne, duke thënë se ne jemi për Behgjet Pacollin për president. Por, para së gjithash këto janë gjëra të vogla në krahasim me miqësinë. Miqësia për mua është shumë e shenjtë.

**Zëri: Çka do të bëni tani, nuk jeni deputet, nuk jeni kryetar i kompanisë suaj, nuk jeni kryetar i partisë dhe nuk jeni president?**

**Pacoli:** Tash nuk do të largohem nga ideja ime që në mënyrë direkte t'i ndihmoj Kosovës. Nëse AKR më pranon si kryetar, këtë do ta bëjë.

TËRHIQET PACOLLI, ARRIHET MARRËVESHJA PDK- LDK-AKR

## Oficere Jahjaga presidente, zgjedhjet pas 18 muajsh

Kreu i PDK-së dhe njëherësh kryeministër i Kosovës, Hashim Thaçi, kryetari i LDK-së Isa Mustafa, dhe ish-kryetari i AKR-së, Behgjet Pacolli, me ndihmën e ambasadorit amerikan Kristofer Dell, arritën marrëveshjen politike, sipas së cilës Atifete Jahjaga propozohet për presidente të Kosovës. Jahjaga aktualisht e ushtron detyrën e zëvendës drejtoreshës së Policisë së Kosovës. Partitë janë marrë vesh që pas zgjedhjes së presidentit të fillohet me ndryshimet e Kushtetutës, ndryshimin e kodit elektorale, dhe pas 18 muajsh të mbahen zgjedhjet e përgjithshme

Tri ditë konsultime intensive të liderëve kryesorë politikë, Hashim Thaçit, Isa Mustafës dhe Behgjet Pacollit, me ndërmjetësimin e ambasadorit amerikan në Kosovë, Kristofer Dell, kanë përfunduar me një marrëveshje për tejkalimin e situatës politike. Kjo u bë e ditur në një konferencë shtypi, pas nënshkrimit të marrëveshjes. Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, tha se kjo marrëveshje është arritur ndërmjet pozitës dhe opozitës për daljen e vendit nga kriza politike. Në këtë konferencë të përbashkët, Thaçi së bashku me kryetarin e LDK-së, Isa Mustafën, Behgjet Pacollin dhe ambasadorin e SHBA-së në Kosovë, Kristofer Dell, është bërë e ditur se në bazë të marrëveshjes presidenti i vendit do të emërohet zyrtarja e lartë e Policisë së Kosovës, Atifete Jahjaga. Kryeministri Thaçi, pasi falënderoi Pacollin, theksoi se marrëveshja e arritur ndërmjet Pacollit, Mustafës e Thaçit është kjo: Ne nominojmë Atifete Jahjagen kandidatë për presidente të Kosovës. Pajtohemi që menjëherë të formojmë një komision për reformën e zgjedhjeve presidenciale, në mënyrë që presidenti të zgjidhet drejtpërdrejt nga populli. Komisioni duhet ta përfundojë punën nga 6-9 muaj. Zgjedhjet do të mbahen jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese lidhur me zgjedhjen e presidentit nga populli", tha Thaçi. Sipas këtij memorandumi, do të formohet edhe komisioni përkatës për ndryshimin e Ligjit zgjedhor dhe që zgjedhjet e reja parlamentare dhe ato lokale të mbahen në vitin 2013.

### Mustafa : Marrëveshja nuk nënkupton përjashtimin e ndonjë kandidati

Kreu i LDK-së, Isa Mustafa, falënderoi Pacollin, ambasadorin Dell dhe Thaçin për gatishmërinë që kishin për të arritur marrëveshje. Ai tha se kjo është një marrëveshje e rëndësishme për reformën e sistemit zgjedhor. "Ne kemi arritur një marrëveshje të rëndësishme për reformën e sistemit zgjedhor, për reformën e Kushtetutës dhe për një kandidat, i cili do të ushtrojë për një periudhë të caktuar detyrën e presidentit, për çfarë jemi pajtuar të gjithë dhe të gjithë do të bëjmë përpjekje që t'i ndihmojmë që marrëveshjen që e kemi realizuar të realizohet pikë për pikë. Besoj në këtë marrëveshje dhe qëndroj tërësisht pas marrëveshjes së arritur me PDK-në dhe AKR-në në prezencë të ambasadorit të SHBA-së", tha Mustafa. Presidenti i deritanishëm i vendit, Pacolli, theksoi se nuk do të rikandidojë për këtë post dhe se, sipas tij, nuk ka pasur asnjë presion as nga kryeministri Thaçi e as nga ambasadori Dell për këtë vendim. "Unë i falënderoj dhe u uroj sukses të gjithëve. E falënderoj Lidhjen Demokratike të Kosovës, e cila kontribuoi në zgjidhjen e kësaj krize. Zgjedhje nuk do të kemi", theksoi Pacolli. Ai tha se qëndrimin e tij e ka marrë me përgjegjësi shumë të madhe, duke konsideruar se do të ishte gabim fatal që të jetë pengesë dhe shteti të shkojë në zgjedhje. "Jam tërhequr pasi kam konsideruar se qytetari i Kosovës duhet të jetë në rend të parë", tha ai, duke konsideruar se

koalicioni është edhe më i fortë dhe do të ketë qeveri edhe më të fortë që do t'i rezistojë sfidave. Thaçi, Mustafa dhe Pacolli janë zotuar për zbatimin e plotë të marrëveshjes. Thaçi ka thënë se kjo është kandidaturë e përbashkët dhe do të ketë angazhim të përbashkët për realizimin e plotë të kësaj marrëveshje. I pyetur nëse shkelet Kushtetuta nëse nuk do të ketë kundërkandidat, Mustafa ka thënë se marrëveshja për një kandidat nuk nënkupton përjashtimin e ndonjë kandidati tjetër. Ai ka thënë se partitë e koalicionit do ta japin edhe kandidatin e dytë. "Ajo që është me rëndësi është se ne qëndrojmë prapa kandidates që kemi propozuar", ka thënë Mustafa. Edhe Thaçi ka thënë se Jahjaga do të ketë mbështetjen e tri partive, ndërkaq do të plotësohet edhe ana formale me një kundërkandidat.

### **Dell: Marrëveshje për interesa të shtetit**

Ambasadori amerikan Kristofer Dell ka folur me admirim për Jahjagën duke thënë se ajo është një oficerë që është dëshmuar se është e aftë për sundimin e rendit dhe ligjit, e në këtë drejtim ai ka shprehur bindjen se ajo do të jetë edhe mbrojtëse e Kushtetutës së Kosovës. Ai tha se Atifetja kur është zgjuar në mëngjes nuk e ka menduar se tani do të propozohet për president të vendit. Ai tha se me këtë marrëveshje liderët kanë vendosur që interesat e shtetit t'i vendosin para interesave të tyre. "Fakti që jam këtu me dy partnerët e koalicionit dhe opozitës më të madhe tregon se udhëheqësit e Kosovës mund të punojnë për të mirën e Kosovës. Shpresoj se kjo mund të shënojë një fillim të ri për qëllimin tuaj politik", tha ai.

### **"Vetëvendosje" paraqiti tri kushte**

"Vetëvendosje" nuk do ta kandidojë Adem Demaçin për president, pasi kjo parti nuk e ka "komoditetin numerik" për ta bërë një gjë të tillë. Kështu ka bërë të ditur deputeti i "Vetëvendosjes", Glauk Konjufca, pas një takimi që ai ka zhvilluar me kryeparlamentarin Jakup Krasniqi, njëherësh ushtrues detyre i presidentit. Lëvizja "Vetëvendosje" e ka kushtëzuar bashkëpunimin e saj me subjektet politike për gjetjen e zgjidhjes së krizës politike me ndalimin e tri proceseve që i konsideron të dëmshme në Kosovë. Zbatimi i Planit të Ahtisarit, bisedimet me Serbinë dhe privatizimi i aseteve kombëtare janë tri proceset që kjo lëvizje kërkon që të ndalohen. "Ne shpjeguam se çfarëdo bashkëpunimi i Lëvizjes Vetëvendosje" me subjektet politike do të kanalizohet nëpërmjet këtyre tri kushteve që i kemi ne", ka thënë Konjufca. Edhe pajtueshmërinë për zgjedhjen e presidentit ai e lidh me këto tri procese. "Ne mendojmë se kushdo që të ishte president, jashtë Behgjet Pacollit, do të vlenin të njëjtat kushte, sepse këto mendojmë se nuk janë të rëndësishme as për presidentin si të tillë, as për Lëvizjen 'Vetëvendosje', por mendojmë se ky është interesi i Kosovës dhe ne pajtohemi vetëm me atë forcë politike apo me atë personalitet që e mishëron këtë interes të Kosovës që po mundohemi ta artikulojmë ne", ka theksuar ai. Ndërkaq, edhe për ndryshimet kushtetuese kjo lëvizje ka kushte. Konjufca ka thënë se duhet të ndërrohen së pari dy nene që i mohojnë Kosovës vetëvendosjen e jashtme dhe atë të brendshme, sikur që është neni 1.3 dhe neni 143 i Kushtetutës së Kosovës. I. KRASNIQI & S. AHMETI

---

## Jahjaga presidente

---

**36-vjeçarja, Atifete Jahjaga u zgjodh me 80 vota, nga 100 deputetët e pranishëm në sallë, pas konsensusit mes PDK-së, LDK-së dhe AKR-së, me ndërmjetësimin e ambasadorit amerikan Dell**

Kandidatja Atifete Jahjaga, 36 vjeçare është zgjedhur presidente e Republikës së Kosovës, me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Jahjaga ka fituar qysh në raundin e parë, duke marrë 80 vota, nga 100 deputetët e pranishëm në sallë. Kandidatja tjetër Suzanë Novobërdaliu, mori 10 vota, kurse 10 fletëvotime ishin të pavlefshme. Atifete Jahjaga ishte kandidatja e përbashkët e PDK-së, LDK-së dhe AKR-së në bazë të marrëveshjes së arritur ndërmjet liderëve të këtyre tri partive politike nën ndërmjetësimin e ambasadorit amerikan në Prishtinë, Kristofer Dell. Përveç zgjedhjes së presidentes, Kuvendi ka miratuar me 75 vota për, asnjë kundër dhe dy abstenime, rezolutën në mbështetje të marrëveshjes së nënshkruar një ditë më parë nga Hashim Thaçi, Isa Mustafa dhe Behgjet Pacolli për ndryshimet në Ligjin Zgjedhor dhe në Nenin 86 të Kushtetutës së Kosovës. Para votimit, Lëvizja "Vetëvendosje" e ka lëshuar mbledhjen e Kuvendit të Kosovës. Në emër të "Vetëvendosjes", Visar Ymeri ka thënë se kandidatja "konsensuale", Atifete Jahjaga është e panjohur për opinionin e Kosovës, nuk dihen qëndrimet e saj për çështjet e rëndësishme politike dhe ekonomike, siç është veriu, Pakoja e Ahtisarit, privatizimi i PTK-së etj. Pas fjalës së Ymerit, deputetët e "Vetëvendosjes" e kanë lëshuar sallën. Gjatë votimit në sallë ka qëndruar Grupi Parlamentar i AAK - së, por të gjithë kanë abstenuar nga votimi. Por, AAK - ja nuk ka qëndruar në sallë gjatë diskutimit dhe miratimit në formë të rezolutës së marrëveshjes së arritur.

### **Jahjaga: E gatshme t'i shërbejë vendit**

Pas marrjes së besimit Atifete Jahjaga, e nominuar nga PDK - ja, AKR - ja, LDK - ja, ka dhënë betimin para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, si dhe ka mbajtur një fjalim gjatë të cilit shprehu zotimin se do të jetë faktor unifikues politik dhe përfaqësuese e të gjithë qytetarëve pa dallime etnike. "Zgjedhja ime presidente e Republikës së Kosovës, shpreh qëndrimin konsensual dhe marrëveshjen ndërmjet partive politike, parlamentare për kapërcimin e krizës politike dhe për gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për të ardhmen e vendit. Duke bërë ndryshimet e nevojshme në Kushtetutën e Kosovës dhe në sistemin zgjedhor, si dhe duke caktuar një agjendë të qartë të veprimeve Institucionale për tre vjetët e ardhshëm", ka thënë Jahjaga. Me këtë rast, ajo është zotuar se në punën e saj si presidente do të udhëhiqet nga Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës dhe se do të jetë garantuese e Kushtetutës së Republikës. Duke përkujtuar se asnjëherë nuk ka menduar se do të ketë një post kaq të rëndësishëm politik, presidentja Jahjaga ka thënë se është shprehur e gatshme të shërbejë për vendin, për ndërtimin e institucioneve më të rëndësishme demokratike. "Do të përpiqem të sigurohem që Kosova t'i dëshmojë vlerat më të mira të demokracisë dhe Kushtetutës", ka thënë ajo. Jahjaga ka shprehur besimin tek Qeveria dhe qytetarët, duke shtuar se Kosova nuk duhet të mbesë prapa vendeve tjera në procesin e integritimeve evropiane, vetëm për shkak të asaj nëpër të cilën ka kaluar. Presidentja e sapo zgjedhur, ndër të tjera ka folur edhe për dialogun Kosovë-Serbi, të cilin e ka cilësuar një proces normal dhe i cili sipas saj do të ketë sukses, dhe pas përfundimit të tij rajoni do t'i kthehet paqes dhe stabilitetit.

## **Thaçi: Kjo është një e arritur e re e Kosovës**

Kryeministri i vendit, Hashim Thaçi zgjedhjen e presidentes Atifete Jahjaga e ka quajtur një të arritur të madhe të klasës politike, me çka i hapet rruga vazhdimit të agjendës shtetërore të Kosovës. Sipas Thaçit, kjo është zgjidhje e përbashkët e spektrit politik dhe tani Kosova do të vazhdojë me agjendën zhvillimore, që ka të bëjë me sundimin e ligjit, reformave të thella ligjore dhe ekonomike dhe dialogun për liberalizimin e vizave. Kryeministri me këtë rast uroi qytetarët e Kosovës për zgjedhjen e kreut të vendit, që është rezultat i konsensusit të arritur ndërmjet PDK -se, LDK-së dhe AKR-së. Këto komente, Thaçi i bëri në një konferencë për media, menjëherë pas zgjedhjes së presidentes Jahjaga, me ç'rast i ka falënderuar deputetët që kanë marrë pjesë në votimin për president. I.Krasniqi

## FORMOHET KOMISIONI PËR NDRYSHIM TË KUSHTETUTËS NË ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT

### **Pacolli garon, LDK-ja me kandidat të vetin**

Ndonëse ende nuk është bërë asnjë hap konkret në krijimin e dy komisioneve për reformën kushtetuese dhe atë zgjedhore, mbi bazën e marrëveshjes koncensuale për zgjedhjen e presidentit të Kosovës në mes të PDK-së, AKR-së dhe LDK-së, partitë politike nuk e përjashtojnë mundësinë që në zgjedhjet e reja për president, secila të japë një kandidaturë të veten preferenciale.

#### **LDK-ja e do drejtimin e komisionit të reformës zgjedhore**

Anëtari i kryesisë së LDK-së, Kujtim Shala i tha dje gazetës se nuk përjashtohet mundësia që edhe LDK -ja në rastin e zgjedhjes së presidentit të ri, pas ndryshimeve në Kushtetutë, të dalë me kandidaturën e vet preferenciale, por në këtë fazë të hershme shtoi se nuk është preokupim parësor kjo çështje. "Fillimisht duhet të konstituohen dy komisionet përkatëse, ai për ndryshimin e dy dispozitave në Kushtetutë, që kanë të bëjnë me zgjedhjen e presidentit dhe komisioni tjetër, i cili ka të bëjë me një çështje shumë më komplekse, e kjo është reforma e sistemit zgjedhor. Ne me siguri që kur të vijë koha për zgjedhjen e presidentit të ri do ta kemi një kandidaturë tonën preferenciale, kandidat që mund ta propozojmë sikur që mund të propozojnë edhe subjektet e tjera politike, mirëpo, në këtë fazë është shumë herët të flitet për emra", tha Kujtim Shala. Për të shkuar më shpejt në procesin e reformave në Kushtetutë dhe sistemin zgjedhor, Shala tha se LDK -ja është përcaktuar që ta drejtojë komisionin e reformës zgjedhore, me ambicie se këtu kërkohet më shumë punë dhe kjo për interesin e shkuarjes më të shpejtë në zgjedhjet, sikur që është paraparë në marrëveshje, duhet të punohet seriozisht dhe me afate shumë të respektueshme. "Reforma në Kushtetutë nuk kërkon shumë punë. Thjesht janë dy dispozita që duhet të ndryshohen dhe pastaj të merret mendimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut. Çështja e reformës zgjedhore dhe sistemit është më komplekse, prandaj ne jemi përcaktuar që pikërisht këtë barrë serioze ta bartim mbi vete dhe ta kryejmë sa më shpejtë që të jetë e mundur", tha Shala.

#### **AKR - ja mendon për zgjedhje të brendshme**

Ajo që pak a shumë dihet dhe mund të jetë si mundësi e afërt e kandidimit për kryetar shteti në zgjedhjet pas reformës kushtetuese është emri i Behgjet Pacollit. Nënkrjetari i AKR - së, Ibrahim Makolli tha të shtunën se edhe në këtë subjekt politik parësore është tash për tash funksionalizimi i trupave që do të merren me të dyja reformat, asaj kushtetuese dhe reformës së sistemit zgjedhor, që duhet të bëhen në bashkëkoordinim edhe me Kuvendin e Kosovës, derisa për emrat preferencialë për të parin e shtetit në zgjedhjet që mund të ndodhin pas një viti është herët të bisedohet. "Po, me siguri që z. Pacolli edhe do të kandidojë për president, kur për këtë të vijë koha, por tash për tash jemi të preokupuar me realizimin e obligimeve për reformat që janë paraparë edhe me rezolutën e miratuar nga Kuvendi mbi bazën e marrëveshjes", tha Makolli. Në AAK, përndryshe theksojnë se derisa nuk janë pjesë e kësaj marrëveshje, tash për tash nuk janë fare duke u preokupuar rreth pritjeve që prodhon kjo marrëveshje. "As nuk jemi pjesë e kësaj marrëveshjeje, as nuk jemi duke menduar për ndonjë opsion të tillë në këtë fazë. Është shumë herët të mendohet për këto gjëra, sepse në AAK kemi procese të tjera, për të cilat

po përgatitemi, po mendojmë për zgjedhjet e brendshme dhe fuqizimin e AAK-së", tha nënkryetari Ardian Gjini. Gazeta ka provuar dje të kontaktojë edhe me zyrtarët të PDK-së dhe "Vetëvendosjes" për të marrë ndonjë opinion të tyre, por nuk arritëm të kontaktojmë dikë që flet për këtë temë.

S. AHMETI



**Ish-presidenti, ministër i jashtëm!**

---

## **A ka një vend në Qeveri edhe për Pacollin?**

---

A ka një vend në Qeveri edhe për Behgjet Pacollin? Megjithëse ka paralajmëruar se nuk do të jetë pjesë e ekzekutivit të Kosovës, Behgjet Pacollit do t'i shkonte shumë për dore të drejtonte diplomacinë e Kosovës!

PRISHTINË, 7 PRILL - Sakrifika e ish-presidentit Behgjet Pacolli, për të heq dorë nga rikandidimi për president i hapi rrugë zgjidhjes së problemeve politike të vendit. Për hir të interesave të njërit apo tjetrit subjekt politik, Pacolli para vendorëve dhe ndërkombëtarëve la të kuptojë se Kosova ka burrështetas, se Kosova ka dhe do të këtë njerëz që 'sakrifikojnë' çdo gjë sa herë kërkohet për të mirën e vendit. Për 35 ditët sa ishte në krye të shtetit, vrulli i punëve në të mirë të vendit ishte sikur asnjëherë me parë. Vizita e tij në pjesën e Veriut të Kosovës, vizitat jashtë shtetit, takime me biznesmenë, liderë e dashamirë të sportit botërore, u ndërroi mendjen edhe atyre që dikur me skepticizëm e shikonin rolin e Pacollit në krye të Presidencës. Ish-Presidenti Pacolli bëri atë që asnjë tjetër president se kishte bërë më parë, jo për 35 ditë, por as për një mandat të tërë, ngase ishte i pari president që foli hapur për bashkimin kombëtar.

### **AKR edhe dy poste ministrore**

Ndonëse të mërkurën janë bërë të ditura pikat e marrëveshjes ndërmjet dy partnerëve të koalicionit dhe partisë më të madhe opozitare, nuk është bërë publike nëse Pacolli dhe Thaçi kanë arritur ndonjë marrëveshje që AKR-së t'i kompensohet posti i humbur i presidentit. Burime brenda qeverisë bëjnë të ditur se partneri i koalicionit, AKR-ja, në bazë të marrëveshjes pritet t'i ketë edhe dy poste ministrore, tetë zëvendësministra, por nuk është përjashtuar as mundësia që z. Pacolli të pranojë postin e zëvendëskryeministrit. Nuk dihet zyrtarisht nëse do të ketë shkarkim të ndonjë ministri nga radhët e PDK-së për t'ua lënë vendin ministrave të rinj që pritet të vijnë nga radhët e koalicionit për Kosovën e re, apo do të shtohen numri i ministrive. Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, i ka deklaruar gazetës "Bota sot", se tash për tash nuk është diskutuar ndarja e ndonjë posti ministror për AKR-në. As Ibrahim Gashi, ish-këshilltar i Behgjet Pacollit, njëherësh nënkryetar i AKR-së, nuk është në dijeni se cilat ministri do t'i ketë AKR-ja, si pjesë e marrëveshjes që Pacolli të heqë dorë nga posti i presidentit, por ai shpreson se AKR-së do t'i kompensohet posti i humbur. "Shpresojmë se këtyre ditëve do të bisedohet dhe do të kompensohet ajo që Koalicioni për Kosovë të Re ka humbur duke e lënë postin e parë të shtetit", u shpreh Gashi. Për zyrtarët e AKR-së, Pacolli veç postit të presidentit do ta meritonte postin e ministrit të Punëve të Jashtme, ministri kjo të cilën tashmë e udhëheq ministri i PDK-së, Enver Hoxhaj.

## **Sakrifikoi veten e ndihmoi vendin**

Duke i adresuar merita të shumta në fushën e diplomacisë, Pacolli duket si njeriu më meritor që do të udhëhiqte me Ministrin e Punëve të Jashtme, por ende nuk dihet përfundimisht nëse ai do të pranonte një post të tillë. Për Ibrahim Gashin, nënkryetar i AKR-së, s'ka asnjë dyshim se z. Pacolli e ka merituar postin e presidentit, e gjithsesi ai e meriton edhe atë ministrit të jashtëm. "Z. Pacolli me moskandidimin e tij ka dashur ta ndihmoj vendin, t'i evitoj zgjedhjet e parakohshme për të cilat vendi më së paku ka pasur nevojë dhe konfom këtij qëndrimi z. Pacolli mund të mos jetë i interesuar edhe për postin e Ministrit të Jashtëm", shprehet Gashi. I bindur në përkushtimin e shefit të tij për t'i dalë në mbrojtje vendit, Gashi thotë se Pacolli do të kontribuoj edhe pa qenë fare pjesë e qeverisë, do të ndihmoj ashtu siç e ka ndihmuar Kosovën në të gjitha aspektet e në veçanti në çështjen e njohjeve. "Është çështje e z. Pacolli se si do të pozicionohet, kjo është çështje e tij, por sigurisht se ai e meriton më shumë se pozitën e ministrit të Jashtëm, por në të njëjtën kohë është i gatshëm ta ndihmoj Kosovën edhe pa qenë në pozitë ministrore", deklaroi Gashi. Në kohën sa ishte në opozitë, Behgjet Pacolli ishte i pandalshëm në rrugën e tij drejt shtimit të numrit të njohjeve për shtetin e Kosovës. I njohur si ndër biznesmenët e fuqishëm, Pacolli pa asnjë kusht, pa asnjë përkrahje morale e as financiare nga institucionet e shtetit, kishte kontribuar në çështjen e lobimit dhe shtimit të numrit të njohjeve. Ai do të vazhdojë kontributin e tij atëherë kur Kosova ka nevojë. Lobimin për shtimin e numrit të njohjeve për Kosovën e ka pasur gjithmonë në vend të parë. Duke e konsideruar këtë si detyrën më madhore për shtetin e Kosovës, ai ishte deklaruar hapur se sakrifikon kohën e tij, familjen, por edhe partinë për çështjet madhore të Kosovës. Përkundër injorimit që i është bërë nga institucionet e vendit sa ishte në opozitë, Pacolli premtun se nuk do të ndalet që ta kryej detyrën e tij që i takon si qytetari Republikës së Kosovës, aty ku mundet për ta ndihmuar shtetin e Kosovës. Biznesmenit të njohur nga Kosova, Behgjet Pacollit, i cili njëkohësisht është Konsull Nderi i Republikës së Liberisë në Zvicër, i janë adresuar një numër njohjesh që kanë ndodhur në Kosovë, pavarësisht se një gjë të tillë nuk e pranojnë institucionet e vendit.

Vetëvendosje e AAK kritikojnë marrëveshjen

---

## Opozita e nervozuar, bëhet gati për ankesë në Gjykatën Kushtetuese

---

Liderët e Vetëvendosjes e AAK - së thonë se kjo marrëveshje nuk ka zgjidhur por ka thelluar krizën dhe se ata do të ankohen përsëri në Gjykatën Kushtetuese!

PRISHTINË, 7 PRILL - Dy partitë opozitare, Lëvizja Vetëvendosje dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës kanë shprehur kritika për mënyrën e arritjes së marrëveshjes të së mërkurës, në mes të Hashim Thaçi, Isa Mustafës dhe Behgjet Pacollit, në bazë të së cilës, Pacolli u tërhoq nga kandidimi për president, ndërsa Atifete Jahjaga u propozua si kandidate e përbashkët e koalicionit qeveritar dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës për këtë post. Në anën tjetër u caktuan edhe afate për zgjedhjet e reja, reformën zgjedhore dhe ndryshimet kushtetuese. Përfaqësues të lëvizjes Vetëvendosje gjatë një konference për media, lidhur me nënshkrimin e marrëveshjes mes Thaçit, Mustafës e Pacollit vlerësuan se më këtë marrëveshje nuk ka kurrfarë tejkalmimi të krizës në Kosovë, duke e quajtur marrëveshje e arritur pazarin.

### **Kurti: Ata ishin, janë dhe do të jenë së bashku!**

Lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti tha se kjo marrëveshje nuk ka tejkalluar krizën, por nuk ka lënë pa kritikuar as liderin e partisë më të madhe opozitare, Isa Mustafën se i dha kohë Thaçit, siç u shpreh ai për të shitur PTK - në, KEK - un e Trepçën. "Behgjet Pacolli, Isa Mustafa dhe Hashim Thaçi arritën konsensus mbrëmë duke na e dëshmuar edhe njëherë se ata më shumë janë bashkë se sa të ndarë. Qysh moti në kemi thënë se këta politikanë po i përçajnë qytetarët ndërkohë që hesapet i bëjnë bashkë. Konsensusin e tyre partiak e bënë publik nga ndërtesa e Qeverisë së Kosovës thuajse për të na treguar që kemi të bëjmë me uzurpim konsensual të institucioneve. Nuk kemi kurrfarë tejkalmimi të krizës në Kosovë me pazarin e mbrëmshëm. Vetëm sa u akomoduan ambiciet e politikanëve që drejtojnë partitë për hir të vetes së tyre. Nuk do të rritet standardi i jetesës së qytetarëve por rehatia e kreut të PDK - së dhe LDK - së. Isa Mustafa po ia jep dy vjet e gjysmë kohë Hashim Thaçit për ta shitur PTK-në, KEK-un e Trepçën me privatizim të egër dhe për ta sajuar një shtet serb brenda shtetit të Kosovës përmes negociatave me Serbinë. Këto dy vjet e gjysmë mund t'i duken të shkurtra Isa Mustafës porse ato janë shumë të gjata për qytetarët e Kosovës", tha Kurti. Madje sipas Kurtit, kjo marrëveshje dëshmoi se në Kosovë po instalohen dy kampe, në njërin anë siç e quajti ai kampi i regjimit dhe në anën tjetër kampi i rezistencës duke kritikuar se PDK-ja ka instaluar mina në institucionet e shtetit, të cilat po i eksplodon kur i konvenon. "Këto parti politike, posaçërisht PDK - ja në krye me Thaçin tregon qartë se kanë instaluar mina në procedurat dhe funksionalizimin e institucioneve të Kosovës, mina këto të cilat ata i eksplodojnë atëherë kur iu konvenon atyre dhe ata nuk përtojnë që çdo institucion dhe mekanizëm shtetëror ta vënë në shërbim të mbijetesës së tyre në pushtet, por përderisa mbijeton ky pushtet, gjithnjë më vështirë do të bëhet për qytetarët", u shpreh ai. Ndërsa lidhur me emrin e kandidates për presidente, ai theksoi se Atifete Jahjaga, si kandidate e këtij ekipi të ri të unitetit, nuk është e njohur për opinionin kosovar, dhe sipas Kurtit, duke qenë se ajo duhet ta përfaqësojë unitetin e popullit, del se uniteti arrin të përfaqësohet vetëm përmes të panjohurës. "Ne nuk e dim se çka mendon Atifete Jahjaga për privatizimin dhe vjedhjen e votave. Planin e Ahtissarit apo bisedimet me

Serbinë. Dhe, ne nuk e dimë se cili nga tre nënshkruesit e marrëveshjes e propozoi Atifete Jahjagen", u shpreh ai. Edhe Shpend Ahmetit i cili ditë më parë i është bashkuar Vetëvendosjes tha se kjo marrëveshje legjitimoi vjedhjet, parregullsitë e mëdha që përshkuan zgjedhjet e 12 dhjetorit, ndërsa sipas tij, ata që më së shumti e ngritën zërin ndaj parregullsive dhe vjedhjeve, mbrëmë u dorëzuan. Ata që në mënyrë parimore dolën nga salla jo për shkak të kundërshtimit që kishin ndaj z. Pacolli, por ndaj procesit zgjedhor, dje nuk folën asnjë fjalë për zgjedhjet jo legjitime.

### **AAK thotë se nuk jemi pjesë e pazareve politike**

As AAK - ja nuk e ka pritur mirë këtë marrëveshje. Ahmet Isufi, nënkryetar i kësaj partie ka kritikuar se kjo marrëveshje nuk është tashme por që të tre nënshkruesit e kësaj marrëveshje kanë kontribuar për prishjen e institucioneve në mandatin e kaluar, dhe sipas tij kjo është një pazar politik, në dëm të qytetarëve të Kosovës. "Ne kemi mbajtur qëndrimin tonë konstant, dhe nuk jemi bërë pjesë e pazareve të ulëta në dëm të qytetarëve të Kosovës ndërsa qëllimi kryesor i shkatërrimit të institucioneve të kaluara ka qenë i njëjti që përsëri të bëjnë ndonjë marrëveshje që e bien vendin në këtë krizë institucionale që e kanë sjell deri sot", u shpreh Isufi. Ndërsa se a ka qenë zgjedhja e vetme e krizës institucionale dhe politike në vend, marrëveshja në fjalë, Isufi theksoi se njerëzit kanë një qëllim dhe kjo është bërë për interesa ekskluzivisht individuale të tre personave që kanë bërë këtë marrëveshje. "Marrëveshja e mbrëmshme i jep një mandat nëntë mujor Atifete Jahjages edhe pse në Kushtetutë dhe nuk ka asnjë lidhje me ndonjë dispozitë që mund ti jap dikujt një mandat nëntë mujor. Çka do të ndodhë, a do të jap presidentja e ardhshme dorëheqje pas nëntë muajsh apo do ta rrezojnë me ndonjë puç si gjithmonë kur kanë nevojë të mbledhin nënshkrime, por është e pamundur sepse vet ajo duhet të shkelë ligjin për të mundur ta rrezojnë, ndryshimet kushtetuese mund të bëhen, por mandati i presidentit është pesë vjeçar", tha Ahmeti. Por, duket se Gjykata Kushtetuese do të ketë në dorë edhe një lëndë për presidentin e vendit. Të paktën kjo është paralajmëruar nga Lëvizja Vetëvendosje, ku sipas Ahmetit nëse në seancën e Kuvendit kur do të zgjidhet presidentja do të thuhet se po zgjidhet me mandat nëntë mujor, atëherë do të mblidhen nënshkrimet dhe do të kërkohet mendimi i Kushtetueses.

### **Marrëveshja që shkel Kushtetutën!**

Edhe analisti Avni Mazrreku vlerëson se me këtë marrëveshje është bërë shkelje e Kushtetutës së Kosovës. "Nuk mund ta di se si apo ku e kanë bazuar këtë marrëveshje politike këta lider politik, kur dihet se Kushtetuta në fuqi në momentin e zgjedhjes së presidentit i jep mandat pesë vjeçar, ndërsa nëse një marrëveshje politike e prejudikon kohëzgjatjen apo mandatin e presidentit atëherë automatikisht e ke kontestuar dhe je në kundërshtim me parimet kushtetuese", tha ai. Sipas Mazrreku, deri tani më tani e kem parë se Gjykata Kushtetuese ka qenë aktive, funksionale dhe ka vepruar shpejt, në anën tjetër ai shpreh besimin e tij se Gjykata Kushtetuese do ta interpretoj dhe do të jap qëndrimin e vet për këtë çështje. Sipas Mazrreku, kandidatja e propozuar për presidente të vendit, nuk e plotëson atributin kryesor kushtetues ku presidenti përfaqëson unitetin e popullit, pasi që sipas tij, emri i propozuar është anonim për shumicën e qytetarëve të Kosovës. Kurse, sa i përket marrëveshjes, Mazrreku pohon se ajo ka qenë e panevojshme dhe ndonëse pjesë e saj ka qenë edhe LDK-ja, kjo marrëveshje nuk ka shkuar në funksion të agjendës së kësaj partie, dhe marrëveshja si e tillë nuk ka zgjidhur krizën institucionale në vend. "Zgjidhja e kësaj krize institucionale nuk është dashur të trajtohej në këtë formë çfarë ka ndodhur, është dashur ushtruesi i detyrës së presidentit Jakup Krasniqi të ushtrojë këtë detyrë për gjashtë muaj dhe brenda kësaj periudhe kohore të përgatitet korniza

ligjore për ndryshimin e kushtetutës dhe ligjit zgjedhor që të kemi president të zgjedhur drejtpërdrejt", u shpreh ai.

### **E shiti**

“Isa Mustafa po ia jep dy vjet e gjysmë kohë Hashim Thaçit për ta shitur PTK - në, KEK - un e Trepçën. Këto dy vjet e gjysmë mund t'i duken të shkurtra Isa Mustafës porse ato janë shumë të gjata për qytetarët e Kosovës”, tha Kurti.

### **Në Gjykatë**

“Duhet të shohin procedurën e zgjedhjes së presidentes në Kuvend, nëse aty thonë se po e zgjedhim për nëntë muaj, natyrisht se menjëherë duhet mbledhur nënshkrimet për ta dërguar në Gjykatën Kushtetuese”, tha Ahmeti.

---

## **Topi: Pacolli, tregoi që është në standardet e politikanit evropian**

---

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Prof. Dr. Bamir Topi mori pjesë të premtën në ceremoninë e dorëzimit të diplomave në përfundim të Projektit mbarëkombëtar trevjeçar të OSBE-së për rritjen e rolit të grave në qeverisje: Rritja e kapaciteteve të grave kandidatë në funksion të zgjedhjeve vendore 2011, e cila u zhvillua në ambientet e "Hotel Sheraton" në Tiranë. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm Kreu i Prezencës së OSBE-së në vendin tonë, Eugen Volfart, Zëvendësambasadorja e Suedisë, Brita Olofson, njëkohësisht Drejtore e Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim e Bashkëpunim, Zëvendës drejtues i Misionit dhe njëkohësisht Zëvendësambasadori i Mbretërisë së Holandës, Hans Teunisen, si dhe anëtarë të Kabinetit të Presidentit. Ambasadori i OSBE-së në Tiranë, Eugen Volfart, i cili e vuri theksin tek rëndësia e pjesëmarrjes së grave në proceset zgjedhore dhe e rritjes së numrit të tyre në politikë. Presidenti i Republikës Topi, tha se ka kënaqësinë e veçantë të rishpreh vlerësimin e lartë personal dhe institucional për nismën në funksion të rritjes së përfaqësimit politik gjinor në Shqipëri. "Brenda kompetencave të mia kushtetuese dhe kriterëve ligjore kam arritur të promovoj një numër të madh grash profesioniste në poste drejtuese, qoftë në Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë, nivelet e tjera të gjykatave, në shërbimin diplomatik, në institucionet kushtetuese me lidhje funksionale me Presidentin, si edhe në vetë stafin tim politik", tha ai. Ai tha se Shqipëria prin në Evropë sa i përket përfaqësimit në institucionet e drejtësisë. "Jo rastësisht ne jemi ndoshta vendi i vetëm në Evropë ku drejtuesit nominalë të Gjykatës së Lartë dhe të institucionit të Prokurorisë janë gra, të cilat janë njëherësh edhe të parat gra drejtuese në këto institucione në gati një shekull të shtetit shqiptar", tha presidenti Topi. Duke iu referuar zhvillimeve të fundit në Kosovë, presidente Topi uroi zgjedhjen e presidentes Atifete Jahjaga. "Unë sot kam rastin e veçantë që të përshëndes zgjedhjen e një zonje në krye të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së saj, Zonjës Jahjaga, e cila u zgjodh në atë pozicion jo artificialisht, por mbi bazën e vlerave reale të personalitetit të saj, të integritetit të saj", tha presidenti Topi duke uruar zgjedhjen e presidentes së Kosovës. Por, presidenti Topi nuk e la pa e kujtuar mikun e tij, Behgjet Pacollin, i cili ra viktimë e një vendimi, që më shumë vlerësohet si politikë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, e cila konstatoi se kishte pasur shkelje procedurale nga Kuvendi gjatë zgjedhjes së Presidentit. "Kam rastin sot këtu të vlerësoj dhe rolin e Presidentit Pacolli, i cili respektoi vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe tregoi që është në standardet e një politikani evropian, që, duke bashkëpunuar edhe me forcat e tjera politike në Kosovë, i dha shansin që të gjejnë një zgjidhje që Kosova e re, institucionet e saj të jenë të qëndrueshme e t'i japin asaj një vizion të sigurt euroatlantik", tha Topi. Presidenti Topi i pat bërë pritje shtetërore madhështore në Shqipëri presidentit Pacolli menjëherë pas zgjedhjes së tij në këtë post. "Unë do të doja, që edhe në emrin tuaj besoj, të inkurajoj Presidenten e re të Kosovës që të ushtrojë me vendosmëri detyrën e saj, për ta bërë Kosovën një vend të civilizuar në respekt të të drejtave të të gjitha pakicave, por në mënyrë bazale, esenciale, duke respektuar, inkurajuar dhe promovuar të drejtat e grave", tha Topi.

---

## Zbutet AKR

---

**AKR mbështet koalicionin në të gjitha pikat dhe kërkon zbatimin e saj të plotë. Vetëm Pacolli dhe askush tjetër nuk duhet të jetë President si dhe opozita duhet të jetë konstruktive, këto janë tri pikat kryesore të cilat duhet të përmbushen dhe në rast se nuk do të ndodhin këto, AKR-ja paralajmëron rishikimin e marrëveshjes që e ka me PDK-në, por kësaj radhe jo si më parë, nuk ka kërcënuar me prishje të koalicionit**

Mosmarrëveshjet e partive politike, dhe kriza e krijuar në vend pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, lidhur me procedurat për zgjedhjen e Presidentit, ka vazhduar edhe gjatë ditës së hënë pa ndonjë zgjidhje, por duke vazhduar me kushte të njëpasnjëshme nga subjektet politike. Partia më e madhe në vend PDK dhe partneri i saj AKR, që nga njoftimi i kësaj të fundit rreth shqyrtimit për shkëputje të kontratës së koalicionit, veç kanë filluar të jenë të luhatura. PDK zyrtarisht është pa qëndrim e në AKR kanë thënë se nëse PDK nuk i përmbahet marrëveshjes së koalicionit, ata janë të gatshëm ta rishikojnë atë. Kësaj radhe jo si në fillim, nuk kanë kërcënuar drejtpërdrejt me prishje të koalicionit.

### **AKR me 4 kushte**

AKR, gjatë ditës së hënë ka mbajtur mbledhjen e Kryesisë së saj, në mes të cilëve është diskutuar për çështjet aktuale në vend. Pas takimit nënkryetari i AKR-së, Ibrahim Makolli ka bërë me dije edhe katër pikat kryesore të AKR-së që do duhej të respektoheshin nga ana e partnerit të koalicionit, e të cilat nëse nuk respektohen, atëherë AKR-ja do të rishikonte koalicionin me PDK-në. "Kryesia e AKR-së mbështet koalicionin qeverisës në të gjitha pikat e saj me PDK-në. AKR i qëndron besnik marrëveshjes së arritur me partnerin e koalicionit në të gjitha pikat e saj dhe po ashtu kërkon zbatimin e saj në përpikëri. AKR, rikonfirmon mbështetjen për z. Pacolli për kandidat të koalicionit për Kosovë të Re për President. AKR, i bën thirrje opozitës për një reflektim pozitiv për interesat e vendit për të dalë nga situata e krijuar. Inkurajon partitë politike parlamentare dhe joparlamentare për konsulta të vazhdueshme që kanë të bëjnë me reformat në sistemin dhe ligjin zgjedhor veçanërisht në ndryshimet kushtetuese që kanë të bëjnë me zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit nga ana votuesve të Kosovës", ka thënë Makolli. Pikat e përmendura të AKR-së, sipas Makollit do duhej të përmbushen patjetër, pasi në rast se ato nuk respektohen, AKR-ja do ta rishikojë dhe ndërmarrë veprime të tjera të mëtutjeshme. "Çdo ndryshim i saj natyrisht krijon situata të tjera për të cilat organet e partisë do të vendosin për veprimet e mëtutjeshme. Në rast të çfarëdo arsyesh të mosplotësimit të ndonjëres prej këtyre pikave, natyrisht AKR-ja do ta rishikojë dhe do të ndërmarrë veprime të tjera të mëtutjeshme. Ne jemi të vendosur që kjo marrëveshje me partnerin e koalicionit të realizohet në përpikërinë më të madhe", ka thënë Makolli.

## **PDK-AKR, po diskutojnë**

Makolli konfirmoi që AKR-ja ka zhvilluar takime edhe me partnerin e koalicionit PDK, me të cilin ka diskutuar për çështjet aktuale në vend. Ndërkaq që konsulta të tilla ka pasur dhe do të ketë edhe në ditën në vazhdim edhe me partitë opozitare, të cilët do të mundohen t'i bindin që edhe ata të jenë pjesë në seancë e jo ta bojkotojnë atë siç edhe është paralajmëruar, pasi siç tha Makolli, nënshkrimet dhe votat i kanë, por jo edhe kuorumin. "Asnjëherë nuk janë vënë në pikëpyetje votat e deputetëve brenda, problemi është tek kuorumi dhe sikur e dini Gjykata Kushtetuese, në njëfarë forme ose tjetër e ka konstatuar se deputetët, duhet ta ndien obligim kushtetues për të marrë pjesë në seancat e Kuvendit", ka thënë Makolli.



---

## **E zyrtarizojnë në Kuvend**

---

**Marrëveshja e arritur në mes Hashim Thaçit, Isa Mustafës dhe Behgjet Pacollit, që parasheh ndryshime kushtetuese në zgjedhjen e Presidentit dhe legjislacionin zgjedhor, është miratuar me shumicë votash në Kuvendin e Kosovës**

Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash miratoi në seancën e jashtëzakonshme të së enjtes rezolutën në mbështetje të memorandumit të marrëveshjes ndërmjet kreut të PDK-së, Hashim Thaçi, atij të LDK-së, Isa Mustafa dhe Behgjet Pacollit, për fillimin e reformave kushtetuese dhe legjislacionit zgjedhor. Nga 77 deputetë sa ishin të pranishëm, në seancën e Kuvendit të Kosovës me 75 vota pro kësaj marrëveshje dhe dy abstenime, Kuvendi i Kosovës miratoi rezolutën në mbështetje të memorandumit të kësaj marrëveshjeje, votimi i së cilës u bojkotua nga dy partitë opozitare, të cilat nuk ishin pjesë e kësaj marrëveshjeje, Vetëvendosje dhe AAK. Shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, këtë marrëveshje të arritur në mes tri partive politike e ka quajtur vetëm zgjatje e qeverisjes së keqe në Kosovë. "Do të jemi jashtë sallës kur ky votim do të bëhet, sepse ky memorandum është në kundërshtim me frymën kushtetuese në Kosovë. Ky memorandum vetëm sa e zgjat qeverisjen e keqe në Kosovë", është shprehur Gjini. Në anën tjetër, Arsim Bajrami, deputet i PDK-së, me këtë duke i dhënë mbështetje kësaj rezolute ka sqaruar para deputetëve ndikimet që do të dalin nga kjo marrëveshje politike. "Është e drejtë e plotë kushtetuese që të miratohen rezoluta politike, sepse në kapacitetin e vendimmarrjes politike rezolutat kanë qëndrime politike dhe në këtë rast tri partitë politike kanë ndërtuar një qëndrim politik për një agjendë reformuese kushtetuese dhe legjislative. Por, duhet të kemi të qartë që ky është një vullnet politik, pasojat juridike të këtij pëlqimi do të fillojnë të rrjedhin nga dita e ndryshimeve kushtetuese dhe ndryshimeve legjislative, ky edhe ka qenë qëllimi i arritjes së kësaj marrëveshjeje, që praktikisht të futet në një agjendë reformuese në procesin e reformës kushtetuese dhe legjislative, por pasojat konkrete do të rrjedhin me rastin e ndryshimeve kushtetuese kur amendamentet kushtetuese do të përcaktojnë qartazi afatet që janë përcaktuar që kanë arritur tri partitë politike", ka shpjeguar deputeti Bajrami.

### **MARRËVESHJA**

Me udhëheqësit e AKR-së, LDK-së dhe PDK-së:

1. Nominojmë Atifete Jahjagën, si kandidatë tonë për Presidente të Kosovës dhe shprehim përkrahjen e plotë të partive tona respektive për kandidaturën e saj. Jemi të përkushtuar ta vëjmë interesin e vendit mbi atë tonin.
2. Ne pajtohemi që menjëherë të formojmë një komision për reformën e zgjedhjeve presidenciale që do të hartojë amendamentet e nevojshme kushtetuese dhe çfarëdo legjislacioni të ndërlidhur të nevojshëm për të amendamentuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në mënyrë që presidenti të zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli. Komisioni do të synojë të përfundojë punën e vet brenda 6 deri në 9 muaj nga data e themelimit të tij. Një anëtar i Kuvendit i identifikuar nga koalicioni qeverisës do të udhëheqë komisionin e themeluar për këtë qëllim. Ne pajtohemi që zgjedhjet e para

presidenciale në Republikën e Kosovës do të mbahen jo më vonë se 6 muaj nga data në të cilën ndryshimet e nevojshme kushtetuese dhe legjislative hyjnë në fuqi.

3. Ne pajtohemi që menjëherë të formojmë një komision për reformën e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, i cili mes dispozitave tjera do të përkrahë krijimin e më shumë distrikteve zgjedhore në Kosovë dhe do të hartojë ndryshimet e nevojshme legjislative dhe kushtetuese për të arritur këtë qëllim. Komisioni do të synojë të përfundojë punën brenda 8 deri në 12 muaj nga data e themelimit të tij. Një anëtar i Kuvendit i identifikuar nga partitë opozitare do të udhëheqë komisionin e themeluar për këtë qëllim.
4. Ne pajtohemi se Ligji i reformuar për zgjedhje të përgjithshme do të përfshijë një dispozitë që thotë se zgjedhjet e para të përgjithshme, sipas ligjit të amendamentuar do të mbahen jo më vonë se 18 muaj nga data në të cilën ligji i reformuar për zgjedhjet e përgjithshme dhe amendamentet e ndërlidhura kushtetuese hyjnë në fuqi.
5. Ne po ashtu pajtohemi se si pjesë e kësaj marrëveshjeje do të paraqesim ndryshimet e përmendura në paragrafët 2, 3, 4 në mbledhjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në të cilën zgjidhet Presidenti i Kosovës.

---

## **Pacolli, zëvendëskryeministër**

---

**Ish-presidenti i vendit, Behgjet Pacolli, është emëruar zëvendëskryeministër i parë i Qeverisë së Kosovës**

PRISHTINË - Ende pa kaluar dy ditë nga tërheqja e Behgjet Pacollit nga rikandidimi për president të vendit, kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, e ka "rehatuar" atë në qeveri, duke ia dhënë postin e zëvendëskryeministrit të parë. Me këtë veprim, i pari i qeverisë i ka ndihmuar ish - presidentit Pacolli që ta mbajë premtimin e tij të dhënë gjatë një interviste në "Zëri", se është tërhequr nga rikandidimi për president, por se shumë shpejt do të rikthehet. Dallimi i vetëm është se ai nuk do të jetë më president, por zëvendëskryeministër. Lajmin për emërimin e Pacollit në postin e zëvendëskryeministrit të parë e ka konfirmuar kryeministria përmes një kumtese të lëshuar për medie pak orë pas mbledhjes së Qeverisë. "Behgjet Pacolli emërohet zëvendëskryeministër i Parë i Qeverisë së Kosovës. Pacolli do të jetë i ngarkuar i veçantë për marrëdhënie ndërkombëtare për të siguruar njohje të reja për shtetin e Kosovës, si dhe për të sjellë investime të huaja në Kosovë. Ai do të ketë detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara për Zëvendëskryeministrin e Parë të Qeverisë së Kosovës, në pajtim me legjislacionin në fuqi", thuhet në njoftimin e qeverisë. Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese i cili zgjedhjen e Pacollit në krye të shtetit e kishte vlerësuar si jokushtetues, ka bërë që Pacolli ta lë presidencën e vendit të cilën e kishte drejtuar për më shumë se një muaj. Kompromisi i arritur ndërmjet PDK-së, AKR-së dhe LDK-së që Pacolli të tërhiqet nga pretendimi i tij për postin e presidentit dhe të gjendet një kandidat konsensual, ka bërë që partnerët e koalicionit t'i diskutojnë mundësitë e një "mini - riformatizimi" të kabinetit qeveritar. Më saktësisht, pas tërheqjes së Pacollit, AKR-së pritet t'i takojnë më shumë pozita ekzekutive. Megjithatë, zyrtarë të Qeverisë së Kosovës të premtën nuk kanë qenë në gjendje ta thonë se cilat pozita ministrore do t'i jepen AKR-së në shkëmbim të humbjes së pozitës së presidentit të vendit. "Natyrisht se kanë ndodhur rrethana të reja në kuptimin e balancit në mes të partnerëve të koalicionit. Raportet e balancuara do të jenë temë e diskutimit në ditët në vijim. Ende nuk janë përcaktuar, por do të bisedohet dhe me siguri që do të ketë një balancë të ri", ka thënë zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi. Zëvendëskryetarja e kësaj partie, Mimoza Kusari - Lila, i ka thënë "Zërit" se është duke ndodhur procesi i negociimit me PDK - në, por ajo nuk e ka specifikuar se cilat ministri do t'i përkasin AKR - së. "Ne kemi pasur profile shumë profesionale dhe kemi ende të inkuadruar. Ne kemi qenë të interesuar që ta kemi një koalicion stabil, profesional, i cili ka sukses dhe varësisht nga koordinimi dhe bashkëpunimi do të mendohen njerëzit e caktuar për pozita të caktuara", ka thënë Kusari - Lila. Ndërkohë, burime të afërta me koalicionin qeverisës kanë thënë se është duke u përfolur mundësia që AKR - së t'i jepet posti i ministrit të Jashtëm dhe ai të jetë ish - nënkryetari i kësaj partie, Ibrahim Gashi, i cili ka dhënë dorëheqje nga të gjitha pozitat në momentin kur është bërë këshilltar i ish - presidentit Pacolli. Por një gjë e tillë është mohuar edhe nga zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi edhe nga vetë Ibrahim Gashi. "Jo, nuk ka asgjë të vërtetë këtu. Ministër i Jashtëm do të mbetet Hoxhaj. Ende nuk janë përcaktuar, do të zhvillohen bisedimet. Unë nuk do të jem ministër i jashtëm, por do të jem në ndonjë pozitë tjetër", ka thënë Gashi, duke shtuar se pozitën më të ultë që do ta ketë në qeveri do të jetë ajo e këshilltarit të Pacollit. Analisti Ardian Arifaj thotë se kryeministri Thaçi e ka shpërblyer Pacollin, meqenëse ka dështuar që ta bëjë president.

## Gashi e Makolli ministra nga AKR-ja

---

### Ministria e Infrastrukturës dhe ajo e Administratës Publike pritet t'i kalojnë AKR-së

Pas emërimit të Behgjet Pacollit zëvendëskryeministër të parë, riformatimi i kabinetit qeveritar, si pjesë e koalicionit të brishtë qeverisës në mes të PDK-së, AKR-së dhe minoriteteve, mund të vazhdojë edhe me një ndryshim të ri. Sipas burimeve të gazetës, pa post ministror ka gjasa të mbetet ministri i Infrastrukturës, Fehmi Mujota, dhe ministri i Administratës Publike, Mahir Jaghillar, kurse në këto dy ministri mund të emërohen Ibrahim Gashi dhe Ibrahim Makolli nga AKR-ja.

### Fillimi i javës qartëson gjithçka

Sipas burimeve të gazetës, Ibrahim Gashi mund të jetë në postin e Ministrisë së Infrastrukturës ndërsa Ibrahim Makolli në atë të Administratës Publike. "Bisedimet dhe konsultat në mes të partnerëve janë duke vazhduar. Besojmë që në fillim të javës që vjen do të qartësohet gjithçka në këtë drejtim, por nuk do të ketë koncesione të mëdha. Është një opsion real që pas emërimit të Pacollit zëvendëskryeministër të parë, partnerit të koalicionit t'i besohet edhe Ministria e Infrastrukturës", tha për gazetën një zyrtar i lartë brenda kabinetit qeveritar.

### Postet e zëvendësministrave

Në PDK nuk ka disponim që të zgjerohet me më tepër se një ministri fuqia e Koalicionit për Kosovë të re, mirëpo burime brenda AKR-së theksojnë se është në opsion real edhe marrja e Ministrisë së Administratës Publike: AKR-ja në këtë ndryshim do të ketë edhe disa zëvendësministra, që do të jenë pjesë e rasoreve të ndryshme ministrorë. Në poste të zëvendësministrave përforolën emrat e Banush Pacollit, Emin Gërbeshit, Gëzim Mehmetit, Selami Shkodres, Avdi Mehmetit dhe Feti Mejdut. Tri ditët e para të javës që vjen pritet ta përmbyllin edhe këtë riformatim të vogël të Qeverisë së Kosovës, pas zgjidhjes së problemit me presidentin e vendit. S. AHMETI

## Pacolli, kërkon sqarime nga Thaçi

**Deri në fund të javës, Pacolli i ka kërkuar Thaçit t'ia sqaroje kompetencat e zëvendëskryeministrit të parë të ngarkuar për njohje, pasi qe ai kishte pritur se do të drejtonte Ministrinë e Jashtme**

Tani, sipas partive partnere, AKR si kundërshpagim për postin e presidentit kërkon që përveç postit të zëvendëskryeministrit të parë që i është dhënë tashmë Pacollit, AKR të marrë nën drejtim edhe dy ministri dhe tri poste zëvendësministrash. Ushtuesi i detyrës së kryetarit të AKR - së, Ibrahim Makolli thotë se një marrëveshje e tillë është dakorduar gjatë takimeve të zhvilluara ndërmjet kryeministrit Hashim Thaçi me Bengjet Pacollin që sollën tejkalimin e ngërçit politik me zgjedhjen e presidentit. "Është shtruar tashmë nevoja për një rishikim të marrëveshjes mes partnerëve të koalicionit. Në biseda me PDK - në jemi dakorduar që të ketë plus dy ministri shtesë të udhëhequra nga AKR - ja dhe 3 zëvendëskryeministra, do të thotë përpos postit të zëvendëskryeministrit të parë. Përmes këtyre ndryshimeve do të kompensohej për koalicionin e AKR se, pozita e presidentit të vendit", thotë Makolli. Duke folur për ndryshimet që priten në qeveri, zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi ka deklaruar se ato nuk do të sjellin destabilizim në qeverisje. Këto ndryshime ai i ka cilësuar të vogla dhe ka tërhequr vëmendjen se ministrat tash do të përqendrohen në punë, ngase mos puna mund t'i kërcënojë ata çdo herë me largim nga qeveria. Qeveria është stabile, po funksionon. Ndërsa lëvizje të vogla do të ketë vazhdimisht. Pres që shumë shpejt të bëhet je kompletim i tërësishëm. Puna do të jetë ajo që do ta mbajë dikë apo jo", ka thënë Kuçi. Se a do të ketë vetëm zëvendësim të ministrave të PDK - së me ata të AKR - së në kuadër të ministrive ekzistuese apo do të shtohen ministri të reja në Qeveri, kjo çështje, sipas Ibrahim Makollit ka mbetur të definohet ditët në vijim. "Nuk kemi biseduar për këtë çështje nëse do të ketë ministri të reja. Ka mbetur që ditët në vijim të ulemi të bisedojmë për dikasteret të cilat do të udhëhiqen nga ana e AKR - së", thekson Makolli. Pritjet janë që ndarjet e reja të përfshijnë ministrinë ekzistuese pasi që buxheti nuk parasheh mjete për ministri shtesë. Sidoqoftë, bisedimet e ardhshme ndërmjet Thaçit dhe Pacollit mund të sjellin marrëveshjen e re të koalicionit qeverisës. Ajo që aktualisht flitet si mundësi, është që AKR të marrë nën drejtim Ministrinë e Infrastrukturës dhe atë të Arsimit. Të dyja këto ministri aktualisht udhëhiqen nga PDK - ja. Gjithashtu, AKR - ja, sipas burimeve të tjera në këtë parti, ka kërkuar që gjatë javës të bëhet e qartë se çfarë nënkupton posti i zëvendëskryeministrit të parë, Behgjet Pacolli, pasi që pritet e kësaj partie kanë qenë që ai të jetë edhe ministër i Jashtëm, përderisa me vendimin e kryeministrit Thaçi, Pacolli ka marrë më shumë kompetenca në fushën e njohjeve, por jo edhe Ministrinë e Jashtme. Pritet që Pacolli me vete të marrë edhe këshilltarët e tij që i kishte ngarkuar në presidencë, si Ibrahim Gashin, Naim Malokun dhe Arbër Gecin. Marrëveshja fillestare e koalicionit i kishte mundësuar PDK - së të udhëhiqte me 10 ministri, kurse AKR - së me 3 ministri. Kurse rishikimi i marrëveshjes mund të sjellë si rrjedhojë që PDK të mbetet me 8, e AKR - së t'i shtohet numri në 5 ministri. Qeveria ka edhe pesë ministri të tjera. Tri ministri udhëhiqen nga serbët, 1 nga komuniteti turk dhe një nga lista Ibrahim Rugova. Kjo e fundit është në pritje të marrëveshjes me kryeministrin Hashim Thaçi, që përveç ministrisë që drejton, të marrë edhe postin e zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, për të cilin post ishte dominuar Astrit Haraçia. Qeveria këto ditë ka qenë e zënë me planin ekonomik, të cilin nuk e hartoi në Kosovë, por jashtë vendit, në Bullgari, kështu që pritet që kryeministri Thaçi t'i qartësojë marrëveshjet e reja që i ka aranzhuar, për të cilat edhe disa zyrtarë të lartë në PDK thonë se nuk kanë asnjë informatë. "Qeveria është stabile,

po funksionon. Ndërsa lëvizje të vogla do të ketë vazhdimisht. Pres që shumë shpejt të bëhet një kompletim i tërësishëm. Puna do të jetë ajo që do ta mbajë dikë apo jo" , ka thënë Kuçi.

---

## **Pacolli ende nuk i di detyrat**

---

Ndonëse shefi i Qeverisë, kryeministri Hashim Thaçi javën që e lamë pas, emëroi si zëvendëskryeministër të parë Behgjet Pacollin, këtij të fundit nuk i janë bërë të qarta ende detyrat dhe përgjegjësitë që duhet t'i kryejë ai si zëvendëskryeministër i parë i Qeverisë së Kosovës. Behgjet Pacolli në një deklaratë dhënë mediave vendore ka thënë se ai nuk është i njoftuar dhe nuk i ka të qarta detyrat e tij të zëvendëskryeministrit të parë. Ndërkaq, ai ka thënë se nëse paraqet pengesë për dikë dhe puna e tij mund të interferojë në përzjerje të kompetencave ai mund dhe është i gatshëm të japë dorëheqje edhe nga kjo pozitë. "Ende nuk kam një vendim nga Qeveria ku janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë e mia. Unë nuk jam i gatshëm që t'i kundërvihem apo të jem pengesë e dikujt tjetër që është duke vazhduar punën. Në rast se mund të thuhet se MPJ është në rrugë të mirë dhe ka të gjitha performancat që të çojë procesin e njohjeve përpara, atëherë unë mund edhe të largohem, absolutisht nuk kam problem", ka thënë Pacolli. Ndryshe Behgjet Pacolli hoqi dorë nga kandidati për president të vendit, hoqi dorë edhe nga partia dhe nga bizneset e tija. Tash ai ka shprehur gatishmërinë që të heqë dorë edhe nga posti i ri të cilin ia ka ndarë kryeministri Hashim Thaçi, atë të zëvendëskryeministrit të parë, që sipas edhe vendimit të Qeverisë, ai do të jetë i ngarkuar për marrëdhënie ndërkombëtare, për të siguruar njohje të reja si dhe për të sjellë investime të huaja në Kosovë.

---

## **Pacolli paralajmëron njohjen edhe nga Egjipti**

---

Njohja e Kosovës nga ana e Pakistanit do të shqyrtohet dhe kjo çështje është prioritet i lartë i Qeverisë në Islamabad, ka bërë të ditur për radio Dukagjinin, Israr Hussain, drejtor për Evropë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Pakistanit. "Mund të them që është një çështje e nivelit më të lartë. Është e qartë se çështja e njohjes do të shqyrtohet. E për këtë vendosin udhëheqësit tonë, e sigurisht që atyre ju duhet kohë. Por se kur do të merret ky vendim nuk mund të ju them asgjë", ka thënë Hussain, raporton Telegrafi. Ndërkaq, Behgjet Pacolli, i emëruar zëvendëskryeministër i parë nga kryeministri Hashim Thaçi i ka thënë Radio Dukagjinit se javën e ardhshme do të vizitoj një varg shtetesh, përfshirë edhe Egjiptin. Ai pohon se nëse ata që protestuan në Egjipt marrin pushtetin përmes votës së lirë, shteti i faraonëve do ta njeh Kosovën. "Në zgjedhjet e lira nëse fiton rryma e cila ka protestuar në rrugët e Kajros, aty janë shumë miq të mi, me të cilët unë shumë lehtë do të bisedoja për njohjen sa më të shpejt të Kosovës nga ana e Egjiptit", është shprehur Pacolli. Por, ish presidenti Pacolli pat deklaruar se ai kishte një plan të qartë diplomacie për muajin prill, me qëllim që të arrinte sa më shumë njohje, por mbeti pa u realizuar shkaku se u shkarkua. Më shumë se 20 njohje i atribuohen lobimit të tij nga 75 shtete, që e kanë njohur deri më tash Kosovën. Në ndërkohë, presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga pas një takimi me ministrin e Jashtëm Enver Hoxhaj, tha se tashmë vendi e ka një strategji lobimi. Presidentja me këtë rast theksoi, se si bartëse e politikës se jashtme do të angazhohet që diplomacia të jetë më aktive se që ka qenë. BS

### **Njohja?**

“Nëse fiton rryma, e cila ka protestuar, aty janë shumë miq të mi, me të cilët unë shumë lehtë do të bisedoja për njohjen sa më të shpejt të Kosovës nga ana e Egjiptit”, thotë Pacolli.



---

## **Ministria e Jashtme nuk pranon që të jetë nën “kontroll” të Pacollit**

---

Ministri i Jashtëm Enver Hoxhaj pranon se Behgjet Pacolli është anëtar i kabinetit të kryeministrit, por thotë se llogari i jep vetëm shefit të tij, kryeministrit Thaçi.

**PRISHTINË, 13 PRILL** - Pa i mbushur dy muaj nga formimi i saj, qeveria Thaçi 2 ka nisur reformat brenda kabinetit qeveritar. Ky reformatim ka ardhur jo për shkak të "ndëshkimit" për mos punë të ndonjë ministri, por si rezultat i marrëveshjes së bërë ndërmjet partnerëve të koalicionit dhe partisë më të madhe opozitare, e cila e detyronte Pacollin të hiqte dorë nga kandidatura për president, dhe si kompensim për këtë partisë së tij do t'i shtohet numri i ministrave në ekzekutiv. Ndonëse ishte vetë kryeministri Hashim Thaçi që kishte marrë vendim që z. Pacolli ta shpërblej me postin e zëvendëskryeministrit të parë, post ky që e ngarkon atë edhe për marrëdhënie ndërkombëtare, për të siguruar njohje të reja për shtetin e Kosovës, si dhe për të sjellë investime të huaja në Republikën e Kosovës, ky vendim ka mbetur pezull që nga 8 prilli, ditën kur edhe është nënshkruar nga shefi i qeverisë. Ky vendim i kryeministrit ka krijuar shumë paqartësi, edhe për faktin se postin e parë të zëvendëskryeministrit vazhdon të mbaj edhe Hajredin Kuçi, i cili edhe në mandatin e kaluar ka ushtruar të njëjtin post në kabinetin Thaçi. Kjo ka qenë edhe një arsye më shumë, që Pacolli, megjithëse ka pranuar të ushtroj detyrën e re në qeverinë Thaçi, ka shfaqur habinë pse deri më tash nuk është njoftuar dhe nuk i ka të qarta detyrat e tij të zëvendëskryeministrit të parë. Edhe pse është paraparë që gjatë kësaj jave të merren vendimet përfundimtare për ndryshimet në qeveri, kryeministri Thaçi ka udhëtuar në Bullgari për t'iu bashkuar grupit të ministrave të cilët po hartojnë planin e qeverisë për zhvillimin ekonomik të vendit, pa përfunduar marrëveshjen me AKR-së, dhe pa sqaruar mirë pozicionin e Behgjet Pacollit në qeveri. Me vendimin e kryeministrit Thaçi, z. Pacolli ka marrë më shumë kompetenca në fushën e njohjeve, por vetë ministri i Punëve të Jashtme ka mohuar që ministria që drejton ai të jetë nën kontrollin e z. Pacolli.

### **Hoxhaj: Do ta mbështes Pacollin, llogari i jap Thaçit**

Në një deklaratë për gazetën "Bota sot", ministri i Punëve të Jashtme Enver Hoxhaj, ka bërë publik bisedën që kanë zhvilluar javën e kaluar së bashku me kryeministrin Thaçi, z. Pacolli, me nënkryetarët e AKR-së Ibrahim Gashin dhe Ibrahim Makollin, në cilësi jo vetëm të përfaqësuesve institucional, por edhe të përfaqësuesve të partive politike, në të cilin takim vetë z. Pacolli ka propozuar që ai të bëhet zëvendëskryeministër dhe të trajtoj çështjet në marrëdhëniet ndërkombëtare, ta mbështes republikën e Kosovës për njohje dhe mbi të gjitha ta mbështes Republikën e Kosovë për sjellje të investimeve të reja. "Sipas përshkrimit të punës jemi pajtuar që ne si Ministri e Punëve të Jashtme ta mbështesim z. Pacolli që ta ndihmojë Kosovën, ta rritë numrin e njohjeve dhe do të ketë koordinim të plotës ndërmjet meje personalisht dhe vetë z. Pacolli. Unë kam një miqësi jashtëzakonisht të mirë me të çfarëdo që kërkohet nga ana ime, në cilësinë time si ministër dhe si njeri me politikë do ta mbështes z. Pacolli", u shpreh ministri Hoxhaj. Ai mohon që ministria që ushtron të jetë nën kontroll të z. Pacolli, duke thënë se z. Pacolli është zëvendëskryeministër dhe përshkrimi i punës së tij është i qartë, do të ndihmojë Kosovën në fuqizimin e pozitës së saj ndërkombëtare, rritje të numrit të njohjeve, dhe sjellje investimeve të huaja. Ai tashmë pranon se z. Pacolli është anëtar i kabinetit të kryeministrit por thotë se llogari i jep vetëm shefit të tij, kryeministrit Thaçi. "Nuk ka asnjë

kundërshti as paqartësi dhe unë besoj se z.Pacolli do ta ndihmojë shumë Kosovën, qeverinë dhe MPJ-në për shkak të profilit, përvojës dhe kontributit të tij edhe në të kaluarën sa i përket njohjeve u shpreh Hoxhaj. Duke folur ndërkaq, në cilësinë e nënkryetarit të partisë sa i përket marrëveshjes për ndarjen e ministrive, z. Hoxhaj nuk ka dashur të paragjykoj se kush mund të jenë ministrat e PDK-së që do të mund të largohen nga kabineti Thaçi, meqë sipas tij kjo është çështje që i takon kryeministrit dhe kryetarit të PDK-së, z. Thaçi. "Qeveria e Kosovës është kabinet i tij dhe realisht ai si shefi kabinetit si udhëheqës politik merr vendime sa i përket vetë profilit të ministrive dhe ministrave", tha Hoxhaj.

### **Makolli: Pacolli me pozicion të qartë**

Vizitat e zyrtarëve të lartë të PDK-së në cilësinë e përfaqësuesve të shtetit, ka pamundësuar arritjen e një marrëveshje me AKR-në për ndarjen edhe të dy ministrive dhe tre zëvendësministrave që do t'i takojnë AKR-së, si pjesë e marrëveshjes. Ibrahim Makolli, ushtrues detyre i kryetarit të AKR-së tha se pas kthimit në Kosovë të një pjese të madhe të zyrtarëve të qeverisë, përfaqësuesit e të dy partive do të ulen dhe të bisedojnë për këtë çështje. Ndërsa, sa i përket qartësimit të pozicionit të z. Pacolli si zëvendëskryeministër, ai tha se Pacollit i është caktuar pozicioni me një vendim të Qeverisë të cilin e ka nënshkruar kryeministri Thaçi. Ai mohoi deklaratimet se gjoja z. Pacolli ka paqartësi në detyrat që i ka, duke thënë se Pacolli menjëherë ka udhëtuar pas vendit dhe detyra e tij është përcaktuar me një rregullore të qeverisë e cila përcakton fushën e veprimit të secilit anëtarë të kabinetin qeveritar. "Z. Pacolli ka udhëtuar jashtë vendit dhe sapo të kthehet do të filloj punën që tashmë i është besuar", deklaroi Makolli. Partitë e koalicionit qeverisës, PDK dhe koalicioni për Kosovën e Re, pritet të ridefinojnë marrëveshjen deri në fund të kësaj. Tashmë flitet se AKR-ja do të marrë nën drejtim Ministrinë e Infrastrukturës dhe atë të Arsimit. Nënkryetari Makolli nuk e ka konfirmuar një gjë të tillë, duke thënë se kjo do të jetë pjesë e marrëveshjes që do ta kemi me PDK-në dhe gjatë bisedave do të përcaktohet se cilat dikastere do t'i ndahen AKR-së. Por, AKR-ja është shprehur e gatshme që të marr nën drejtim ato dikastere që kanë të bëjnë me zhvillimin e vendit, në të cilat AKR-ja, sipas Makollit do të mund të jepte një kontribut të madh. Siç shihet nga deklaratimet e zyrtarëve të dy partive politike, relacionet mes partnerëve të koalicionit janë ende "pezull" sa i përket reformatizimit të qeverisë. Kështu ministrat e PDK-së shprehin vetëm konsideratën e tyre për hyrjen në qeveri të Behgjet Pacollit por ata nuk janë aq të gatshëm që të bashkëpunojnë me Pacollin apo aq më pak t'i japin atij ndonjë llogari të punës së tyre. Kjo çështje ka mbetur pezull për faktin se pothuaj gjysma e kabinetit qeveritar gjendet në Bullgari në një seminar pune. Kështu duket se edhe këtë javë nuk do të ketë reformatizim të qeverisë e me këtë madje as zyrë për zëvendëskryeministrin e parë z. Behgjet Pacolli.

---

## Reformat e “treshes”

---

**Ndryshimet kushtetuese dhe reformat zgjedhore të akorduara me marrëveshjen Thaçi - Mustafa - Pacolli pritet të implikojnë ndryshime rrënjësore kushtetuese dhe jo sipërfaqësore**

PRISHTINË - Marrëveshja e arritur ndërmjet Hashim Thaçit, Isa Mustafës dhe Behgjet Pacollit pritet të implikojë ndryshime rrënjësore dhe jo sipërfaqësore. Kështu të paktën thonë përfaqësues të partive nënshkruese të kësaj marrëveshjeje, mirëpo sipas tyre ende nuk është përcaktuar mënyra se si do t'u qasen institucionet këtyre reformave. Aktualisht, Kuvendi dhe institucionet e Kosovës nuk i kanë iniciuar ende procedurat për formimin e këtyre komisioneve. Ato pritet të formohen konform kushtetutës, ligjeve, marrëveshjes së arritur ndërmjet kryeministrit Thaçi, Mustafes e Pacollit dhe rezolutës së aprovuar me pas nga Kuvendi. Kryetari i Komisionit për Legjislacion, deputeti i LDK - së, Arben Gashi thotë se ende nuk është përcaktuar mënyra se si do t'u qasen institucionet këtyre reformave. Por, sipas tij, është e mundur që të formohen komisione "ad hok" të cilat do të punojnë në këto reforma dhe ndryshime, të cilat në fund duhet të aprovohen nga Kuvendi. Ndërkohë, eksperti i çështjeve kushtetuese juridike, Arsim Bajrami, deputet i PDK - së thotë se nisja e ndryshimeve kushtetuese dhe reformave zgjedhore duhet të iniciohet nga presidenti, një e katërta e parlamentit apo qeveria. Varësisht se kush nga këto tri instanca inicion ndryshimet, ka të drejtë të propozojë edhe formimin e komisioneve, thotë Bajrami. Ai rikujton se ndryshimi i Kushtetutës nuk do të mund të përkufizohet vetëm në zgjedhjen e presidentit, por edhe në kompetencat e tij. Po ashtu edhe te reformat zgjedhore, marrëveshja për shtimin e zonave zgjedhore do të sjell nevojën e ndryshimeve në Kushtetutë. "Ndryshimet kushtetuese nuk prekin vetëm një nen të Kushtetutës, por një materie më të gjerë të Kushtetutës, sepse ndërrimi i mënyrës së zgjedhjes së presidentit implikon pozitë më të fuqishme të presidentit dhe kërkon ndryshime në disa nene të Kushtetutës dhe të paktën në dy ligje të miratuara tashmë", thotë Bajrami. Në përgjithësi, nënvizon Bajrami, këto reforma janë rrënjësore dhe kërkojnë kohë, andaj ai inkurajon që të ketë lëvizje të shpejtë në drejtim të formimit të komisioneve gjegjëse. Marrëveshja Thaçi, Mustafa, Pacolli është kundërshtuar nga lëvizja Vetëvendosje. Nënkrjetari i Kuvendit nga radhët e Vetëvendosjes, Glauk Konjufca thotë se të gjitha grupet parlamentare qysh moti janë pajtuar në parim se duhet të ketë reforma zgjedhore. Por, këto reforma, sipas jush, nuk ka nevojë që të iniciohen me marrëveshje politike jashtë institucioneve, por se ato duhet të kalojnë përmes komisioneve gjegjëse parlamentare, duke përfshi më pas edhe shoqërinë civile. "Lëvizja Vetëvendosje mendon që gjithçka që do të shkojë në këtë drejtim të shkojë brenda trupave ekzistuese ku janë kompetencat e sqaruara siç është komisioni për legjislacion i cili mund të krijojë më pas një trup që merret me ligjin për zgjedhjet", thekson Konjufca. Përveç ndryshimeve kushtetuese dhe reformave zgjedhore, "treshja" ishte pajtuar edhe në lidhje me afatet zgjedhore, duke parashikuar zgjedhjet për presidentin diku pas një viti e gjysmë dhe zgjedhjet parlamentare pas afërsisht dy vjet e gjysmë, apo në kohën kur edhe pritet të mbahen edhe zgjedhjet lokale. Sidoqoftë, akordimi i marrëveshjes brenda tri ditëve mund të ketë qenë edhe rezultat ose pasojë e presionit ndërkombëtar mbi Thaçin dhe Mustafen që të tejkalohet nyja e zgjedhjes së presidentit.

Pasuria e liderëve “informacion i ndaluar” për opinion

---

## Mustafa më i pasur se Thaçi, Pacolli më pasanik se krejt Qeveria

---

Sa peshon pasuria e liderëve politikë të Kosovës, sa ka pasuri Hashim Thaçi, Behgjet Pacolli, Isa Mustafa, Albin Kurti, Ramush Haradinaj etj.

**PRISHTINË, 14 PRILL** - Janë qytetarë të Republikës së Kosovës, por nuk jetojnë njësoj sikur të gjithë qytetarët e tjerë. Janë liderë politikë, kanë pasuri milionëshe dhe bëjnë një jetë luksoze që shumë kush ua ka lakmi. Ata nuk kanë lindur milionerë dhe as nuk rrjedhin nga familje aq të pasura, por shumica prej tyre janë bërë milionerë falë punës në politikë, që tash për tash mund të konsiderohet si profesioni më profitabil në Kosovë. Këta janë liderët tanë që udhëheqin partitë politike, që janë në funksione shtetërore, e që janë pasuruar pas përfundimit të luftës. Edhe pse Kosova llogaritet ndër vendet më të varfra, me mbi 20 për qind varfëri të skajshme dhe papunësi prej më shumë se 50 për qind, udhëheqësit politikë posedojnë qindra mijëra euro, apo edhe miliona e miliarda euro. Një numër i konsiderueshëm deri te pasurimi i jashtëzakonshëm brenda natës, kanë ardhur në sajë të paligjshmërive, zbrazëtirës ligjore dhe mos disiplinës së kontrollit ekonomik.

### Të gjithë milionerë

Hashim Thaçi, Behgjet Pacolli, Isa Mustafa, Albin Kurti e Ramush Haradinaj, janë liderë që udhëheqin pesë parti të ndryshme politike. Kush më shumë e kush më pak të gjithë janë milionerë të pas luftës, por që asnjëherë nuk deklarojnë pasurinë e tyre të përgjithshme. Derisa shumë prej tyre janë pasuruar brenda natës, njëri nga ta, Behgjet Pacolli ka qenë milionerë edhe para se të aktivizohej në jetën politike në Kosovë. Ai ka zhvilluar biznesin e tij jashtë Kosovës, në vendet e zhvilluara ekonomikisht, dhe në Kosovë konsiderohet si lideri më i pasur edhe pse asnjëherë nuk e ka deklaruar publikisht pasurinë e tij. Kosova tashmë ka Ligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe është obligim shtetëror për organet kompetente që në bazë të këtij Ligji të hetojnë prejardhjen e pasurisë së kryetarëve milionerë të Kosovës. Madje Ligji detyron të gjithë zyrtarët publik ta deklarojnë pasurinë që kur fillojnë të punojnë në shërbimin publik si dhe pasurinë e fituar gjatë ushtrimit të pozitës së tij si zyrtar publik, dhe të ardhurat monetare apo përfitimet tjera materiale dhe detyrimet financiare siç parashihet ligj. Deklarimin e rregullt vjetor zyrtarët e lartë publik detyrohen ta bëjnë në Agjencion, brenda datës 31 mars të çdo viti. Po ashtu zyrtarët e lartë publik të cilët kanë bërë deklarimin e pasurisë në vitin paraprak, detyrohen që brenda datës 31 mars të çdo viti ta deklarojnë çdo ndryshim në gjendjen e pasurive të deklaruara. Por, jo të gjithë janë të gatshëm të deklarojnë pasurinë e tyre.

### Pacolli miliarderë, Mustafa milionerë, Thaçi gjysmëmilionerë!

"Sa peshon pasuria e liderëve politikë të Kosovës, sa ka pasuri Hashim Thaçi, Behgjet Pacolli, Isa Mustafa, Albin Kurti, Ramush Haradinaj etj. Edhe pse nuk ka deklaruar pasurinë, për shkaqe sigurie, siç ka thënë vetë ai, Behgjet Pacolli, konsiderohet jo vetëm si lideri më i pasur, por edhe njeriu më i pasur në Kosovë. Në formularin e KQZ-së, në prag të zgjedhjeve Pacolli, ka deklaruar pagën vjetore në Kuvend në vlerë 22.000 euro, të ardhurat në kompani të

ndryshme biznesi jashtë Kosovës në vlerë 500.000 euro. Në llogari bankare në Bankën Ekonomike ai ka deklaruar se ka 210.000 euro, ndërsa në NLB 190.000 euro. Biznese në pronësi ai ka deklaruar se ka në vlerë 15.000.000 euro në Bankën Ekonomike dhe 22.000.000 në K.S.Siguria, derisa kompani me aksione anonime jashtë dhe brenda Kosovës ka deklaruar 100.000.000 euro. Pacolli ka deklaruar troje-shtëpi në vlerën prej se 26.000.000 euro. Pasuria e z. Pacolli në bazë të këtij deklarim kap shumën 1 miliardë e 85 milionë euro. Kryetari i partisë më të madhe në vend, PDK-së, Hashim Thaçi në formularin e KQZ-ka ka deklaruar pagën vjetore të kryeministrit në vlerë 17.318 euro. Në llogarinë bankare në NLB bank ka deklaruar 180.000 euro, tokë për ndërtimin e shtëpisë në vlerë 157.000, shtëpi në ndërtim e sipër në vlerë 203.000 euro, shtatë hektarë tokë të trashëguar nga familja në vlerë 180.000 euro dhe një shtëpi nga familja në vlerë 80.000 euro, derisa ka deklaruar se ka borxh në vlerë prej 100.000 euro në NLB - Bank. Nga ky deklarim i del se pasuria e kryeministrit peshon 655.318 euro. Në formularin e paraqitur në KQZ, Isa Mustafa, kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka deklaruar se ka pagë vjetore si kryetar komunë në vlerë 13.200 euro, 4.000 në ASHAK dhe 3.000 euro në Universitet, si punë jashtë orarit. Ai ka deklaruar se ka 700 euro para të gatshme, llogari bankare në vlerë 11.566 në Bankën e Biznesit , 29.200 në Pro Credit Bank. Mustafa ka deklaruar bizneset në vlerë 20.000 në Riinvest, 8.000 euro në Inter-europa, 19.600 në "Mak-car" LLC dhe 6000 euro në K.F. - Prishtina. Si pasuri të patundshme ai ka deklaruar shtëpinë me 180 metra katrorë në vlerë 138.000 euro, tokë në lagjen Arbëria në vlerë 400.000 euro, banesë 70 metra katrorë në vlerë 45.000 euro dhe tokën në Prapashticë në vlerë 57.000 euro. Nga ajo që ka deklaruar z. Mustafa në formularin e pasurisë në Komisionin Qendror Zgjedhor, pasuria e tij arrin shumën 1.454.566 euro.

## **Haradinaj 2 milion e sa Euro, Kurit shtëpi në Prishtinë e në Ulqin**

Si lider më i pasur konsiderohet Ramush Haradinaj, kryetar i AAK-së, i cili në formularin e dërguar në Komisionin Qendror Zgjedhor ka deklaruar pagën vjetore të kryetarit të partisë në vlerë 9.600 euro, pagën mujore të bashkëshortes të tij gazetares në RTK në vlerë 560 euro, llogari bankare 9.000 në Raifaisen Bank, 11.800 në Raifaisen Bank, shtëpinë-rezidencë 1200 metra katrorë në vlerë 700.000 euro, shtëpinë familjare në Gllogjan në vlerë 150.000 euro, tokë në Gllogjan 36 hektarë në vlerë 600.000 euro, dhe po ashtu tokë në Gllogjan në vlerë 75.000 euro. Ai ka deklaruar veturën e blinduar të tipit Mercedes në vlerë 150.000 euro, veturën e blinduar Chevrolet në vlerë 200.000 euro, motoçikletë në vlerë 10.000 euro, dhe medalje ari në vlerë 11.000 euro, para të deponuara në bankë në vlerë 25.400 euro. Pasuria e deklaruar e kryetarit Haradinaj kap shumën 2 milion e 511.800 euro. Lideri i lëvizjes Vetëvendosje Albin Kurti, ka deklaruar se ka pagë vjetore në vlerë 2.052 si kolumnist në gazetën Zëri, shtëpinë dhe truallin në Ulqin prej 400 metra katrorë në vlerë 100.000 euro, para të gatshme në vlerë 70.000 euro. Ai ka deklaruar në llogarinë bankare 171 euro në NLB dhe 1.808 në BKT - Raifaisen Bank, NLB . Kurti ka deklaruar edhe banesën 65 metra katrorë në Prishtinë në vlerë 65.000 euro, shtëpinë 220 metra katrorë në Ulqin në vlerë 100.000 euro , veturën Golf 2 në vlerë 2.000 euro. Nga ajo që ka deklaruar Kurti, pasuria e tij arrin në 511.860 euro. Kjo është pasuria e këtyre liderëve politikë të Kosovës. Nëse nuk u besoni shifrave besoni realitetit. Ata janë të pasur, janë pasanikë, janë shumëfish më të pasur se sa shkalla e mesatares së gjendjes ekonomike të pjesës dërmuese të popullit të Kosovës.

---

## **Ka nisur implementimi i “marrëveshjes”**

---

**Marrëveshja e "treshes" për ndryshimet kushtetuese dhe të legjislacionit zgjedhor, ende nuk është iniciuar, përveç miratimit të saj në Kuvendin e Kosovës. Këto ndryshime vlerësohet se duhet iniciuar nga Presidentja e vendit**

Kuvendi i Kosovës ende nuk i ka iniciuar procedurat për formimin e komisioneve që do të ngarkohen me përgatitjen e propozimeve për ndryshime kushtetuese dhe reforma zgjedhore. Këto dy komisione sipas REL pritet të formohen konform marrëveshjes së arritur ndërmjet kryeministrit Hashim Thaçi, liderit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa dhe Behgjet Pacollit, nën ndërmjetësimin e ambasadorit amerikan, Kristofer Dell, dhe rezolutës së aprovuar më pas nga Kuvendi. Kryetari i Komisionit për Legjislacion, deputeti i LDK-së, Arben Gashi, tha se ende nuk është përcaktuar mënyra se si do t'iu qasen institucionet këtyre reformave. Sipas tij, është e mundur që të formohen komisione "ad hok" që do të punojnë në këto reforma dhe ndryshime, të cilat në fund duhet të aprovohen nga Kuvendi. "Nuk ka një qëndrim zyrtar, Kryesia e Kuvendit duhet që, në bashkëpunim me grupet parlamentare, të vendosë dhe më pas ta dërgojë në rend të ditës në Parlament, ku mbetet të aprovohen komisionet ose që t'i jepen detyra shtesë Komisionit për Legjislacione dhe komisioneve tjera adekuate", tha Gashi.

### **Presidenti duhet t'i iniciojë ndryshimet**

Eksperti i çështjeve kushtetuese juridike, Arsim Bajrami, deputet i PDK-së, tha se nisja e ndryshimeve kushtetuese dhe reformave zgjedhore duhet të iniciohet nga Presidenti, një e katërta e Parlamentit apo Qeveria, "Varësisht se kush nga këto tri instanca inicion ndryshimet, ka të drejtë të propozojë edhe formimin e komisioneve", tha Bajrami. Ai rikujtoi se ndryshimi i Kushtetutës nuk do të mund të përkufizohet vetëm në zgjedhjen e Presidentit, por edhe në kompetencat e tij. Edhe shtimi i zonave zgjedhore do të sjellë nevojën e ndryshimeve në Kushtetutë. "Ndryshimet kushtetuese nuk prekin vetëm një nen të Kushtetutës, por një materie më të gjerë të Kushtetutës, sepse ndërrimi i mënyrës së zgjedhjes së presidentit implikon pozitë më të fuqishme të Presidentit dhe kërkon ndryshime në disa nene të Kushtetutës dhe të paktën në dy ligje të miratuara tashmë. Te legjislacioni zgjedhor, natyrisht që edhe këto ndryshime kushtëzohen me ndryshimin e Kushtetutës, sepse Kushtetuta e ka përcaktuar Kosovën si njësi të vetme zgjedhore. Andaj, çfarëdo mundësie për aplikimin e më shumë zonave do të kërkojë së pari ndryshimin e Kushtetutës", theksoi Bajrami.

### **Pajtim i të gjithëve për ndryshime**

Nënkryetari i Kuvendit nga radhët e Vetëvendosjes, Glauk Konjufca, tha se të gjitha grupet parlamentare qysh moti janë pajtuar në parim se duhet të ketë reforma zgjedhore. Por, këto reforma, sipas tij, nuk ka nevojë të iniciohen me marrëveshje politike jashtë institucioneve, porse duhet të kalojnë përmes komisioneve gjegjëse parlamentare, duke përfshirë më pas edhe shoqërinë civile. "Lëvizja Vetëvendosje mendon se gjithçka që do të shkojë në këtë drejtim, duhet të shkojë brenda trupave ekzistuese ku janë kompetencat e sqaruara, siç është Komisioni për Legjislacion, i cili mund të krijojë më pas një trup që merret me Ligjin për zgjedhjet", deklaroi Konjufca. Sa u përket ndryshimeve kushtetuese, Konjufca tha se nuk është i

mjaftueshëm vetëm ndryshimi i nenit për Presidentin. Ai ripërsëriti qëndrimin e Vetëvendosjes se Kushtetuta duhet të pësojë ndryshime rrënjësore duke u shmangur nga baza e saj - Pakoja e Ahtisarit. Përveç ndryshimeve, kushtetuese dhe reformave zgjedhore, "treshja" ishte pajtuar edhe në lidhje me afatet zgjedhore, duke parashikuar zgjedhjet për presidentin diku pas një viti e gjysmë dhe zgjedhjet parlamentare pas afërsisht dy vjetësh e gjysmë, apo në kohën kur pritet të mbahen edhe zgjedhjet lokale.

## **Qeveria në seminare, Pacolli për vizitë jashtë shtetit**

**Marrëveshja për ndryshimet në qeveri ndërmjet Thaçit dhe Pacollit ka mbetur pezull për faktin se pothuaj gjysma e kabinetit qeveritar gjendet në Bullgari në një seminar pune, derisa edhe vetë z. Pacolli është për vizitë jashtë shtetit.**

PRISHTINË, 15 PRILL - Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca Kosova e Re as gjatë kësaj jave nuk kanë arritur të përfundojnë marrëveshjet për reformatizimin e qeverisë, megjithëse zyrtarë të të dy partive në koalicionin qeverisës kishin deklaruar se gjatë kësaj jave bisedimet do të përmbylleshin. Ndryshmet në qeveri, që do të vijnë si rezultati marrëveshjes PDK-AKR-LDK, kanë mbetur peng i kryeministrit Thaçi dhe z. Pacolli. Dy nënshkruesit e marrëveshjes për koalicion, lideri i PDK-së, njëherësh kryeministër i Kosovës Hashim Thaçi dhe lideri i AKR-së, Behgjet Pacolli, nuk janë takuar që nga data 8 prill, datë kjo në të cilin kryeministri kishte marrë vendim që z. Pacolli si kompensim për postin e presidentit ta emëroj zëvendëskryeministër të parë të Qeverisë së Kosovës. Pas marrjes së atij vendimi, të dy liderët partiak ishin pajtuar që pjesa tjetër e marrëveshjes të diskutohet në ditët në vijim, por meqë një pjesë e kabinetit qeverisës dhe vetë z. Pacolli nuk gjenden në Kosovë gjatë gjithë kësaj jave, ka mbetur që në ditët e vikendit dhe në fillim të javës të arrihet një pajtim dhe të finalizohet kjo marrëveshje. Marrëveshja Thaçi- Pacolli ka mbetur pezull për faktin se pothuaj gjysma e kabinetit qeveritar gjendet në Bullgari në një seminar pune, derisa edhe vetë z. Pacolli është për vizitë jashtë shtetit. Kështu duket se edhe këtë javë nuk do të ketë reformatizim të qeverisë e me këtë madje as zyrë për zëvendës-kryeministrin e parë z. Behgjet Pacolli. Edhe pse është paralajmëruar se Aleancës Kosova e Re do t'i takojnë edhe dy ministri të reja dhe postet e tre zëvendëskryeministrave, zyrtarisht nuk ka konfirmim nga partia më e madhe në pushtet. Aleanca Kosova e Re ka shprehur gatishmërinë për të udhëhequr me ato ministri që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik, meqë sipas zyrtarëve të këtij subjekti politik kjo parti në këto dikastere mund të jap një kontribut të madh. Zyrtarë të Partisë Demokratike të Kosovës nuk fajësojnë shefin e tyre për vonesat në reformatizimin e qeverisë, megjithëse pranojnë se bisedimet ndërmjet partnerëve nuk janë zhvilluar gjatë javës jo vetëm për shkak se z. Behgjet Pacolli ndodhet jashtë Kosovës, por edhe për faktin se një pjesë e madhe e kabinetit qeveritar, në këtë mes edhe vetë zëvendëskryeministrja Mimoza Kusari-Lila, njëherësh nënkryetare e AKR-së dhe pjesë e grupit punues për bisedime, gjenden në një takim pune.

Ndonëse gjithçka është në duar të shefit të tyre, zyrtarë të Partisë Demokratike të Kosovës nuk dëshirojnë të flasin për kohën se kur mund të arrihet marrëveshja për reformatimin e qeverisë, megjithëse janë optimist se do të përfundoj sa më shpejt që është e mundur. "Deri tash nuk ka diçka konkrete dhe kjo vonesë është bërë edhe për shkak se z. Pacolli dhe një pjesë e qeverisë nuk kanë qenë prezentë në Kosovë. Pritet që javën që vjen liderët e dy partive të pajtohen për ndarjen edhe të ministrive të reja për AKR-në", deklaruan zyrtarë të PDK-së. Nënkryetari i Aleancës Kosova e re, Ibrahim Gashi arsyeton vonesat për reformatizimin e qeverisë, meqë sipas tij as z. Pacolli dhe as një pjesë e qeverisë nuk kanë qenë të pranishëm në Kosovë. Sido që të jetë ai beson se gjatë javës së ardhshme do të qartësohet pozicioni i secilit në kabinetin "Thaçi 2" me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së Koalicionit për Kosovë të Re edhe me dy ministri të reja dhe me tre zëvendësministra. "Nesër është dita kur do të kthehen të gjithë ministrat në Kosovë dhe shpresojmë se do të kthehet edhe z. Pacolli dhe do të fillojnë bisedimet për të arritur marrëveshjen për zgjerimin e pjesëmarrjes së Koalicionit për Kosovë të Re në



koalicionin qeverisës", deklaroi nënkryetari Gashi. Por ende nuk dihet nëse partnerët e koalicionit do të pajtohen që vendimi për ndryshimet qeveritare të merret nga kryeministri Thaçi apo do të rishkruhet një marrëveshje e re me AKR-në, pas asaj të datës 19 shkurt, datë kjo kur Thaçi si fituesi i zgjedhjeve të 12 dhjetorit kishte arritur të lidhte një marrëveshje për koalicion me AKR-në e Pacollit. Përveç liderëve të dy partive, janë formuar edhe dy grupe punues të cilët do të bisedojnë për arritjen e marrëveshjes. Grupin e AKR-së e përbëjnë Ibrahim Gashi, Ibrahim Makolli dhe Mimoza Kusari-Lila, ndërkaq nga PDK-ja është zëvendëskryeministri Kuçi dhe disa anëtarë të tjerë të partisë. Por, janë liderët e dy partive politike, Thaçi dhe Pacolli, ata që do të finalizojnë bisedimet me nënshkrimin e marrëveshjes pasi grupet do të pajtohen për ndarjen e dikastereve qeveritare. Reformatizimi i qeverisë po ecën me hapa të ngadaltë për arsye tashmë të njohura, ndërkohë që ekzekutivi vazhdon punën pa probleme edhe pa këtë reformatizim. Ndonëse marrëveshja për ndryshime në kabinetin qeveritar është arritur tashmë, një gjë e tillë pritet të finalizohet javën e ardhshme kur edhe përfaqësuesit e të dy subjekteve do të jenë në Kosovë dhe të qartësojnë pozicionet e tyre në ekzekutivin e vendit. Java që vjen pritet të nxjerrë edhe dy emra të rinj nga AKR-ja që do të jenë pjesë e qeverisë në kabinetin Thaçi 2, derisa ende nuk dihet se cili ministër nga PDK-ja do ta ketë fatin e hidhur që pa përmbushur 100 ditë pune të largohet nga ekzekutivi i vendit. Po ashtu nuk dihet nëse pjesë e këtij reformatizim do të jetë edhe lista "Dr. Ibrahim Rugova".

---

## **Pacolli mund të bëhet sërish president i AKR-së**

---

Behgjet Pacolli mund të bëhet sërish president gjatë javës së ardhshme, por jo president i Kosovës, nga ku e rrëzoi Gjykata Kushtetuese. Ai tash mund të bëhet vetëm president ku ka qenë para se të zgjidhej president i Kosovës, në Aleancën Kosova e Re. Ekzistimin e mundësisë që Pacolli të ngjitet sërish në postin e të parit të AKR-së e ka nxjerrë në pah të shtunën ushtruesi i detyrës së presidentit të AKR-së, Ibrahim Makolli, Sipas tij, kanë përfunduar përgatitjet për Kuvendin e jashtëzakonshëm në këtë parti, që do të mbahet nga fundi i javës së ardhshme.

Zbatimi i marrëveshjes PDK-LDK-AKR

## Gati për ndryshimet kushtetuese

Ndryshe nga forcat politike nënshkruese të marrëveshjes politike, PDK - AKR - LDK, në bazë të së cilës ka derivuar rezoluta për formimin e komisioneve për reforma, forcat opozitare tashmë i kanë caktuar emrat e anëtarëve të tyre që marrin pjesë në këto komisione. Forcat politike që e kanë firmosur marrëveshjen thonë se rezoluta e miratuar në Kuvend i përkufizon ndryshimet kushtetuese të zgjedhjes së Presidentit dhe jo më shumë, teksa segmente të opozitës thonë se do të insistojnë në ndryshime thelbësore. Ajo që është e sigurt, Kushtetuta aktuale e Kosovës do të hyjë në rishikim këtë mandat dhe me fillimin e mandatit të ardhshëm, kur edhe do të skadojnë obligimet e dala me pakon e Ahtisari. Eksperti kushtetues, Arsim Bajrami, theksoi për gazetën se ndryshimet kushtetuese, të cilat po priten, do të fokusohen kryesisht në çështjen e pozitës së Presidentit. "Pra, këto ndryshime nënkuptojnë ndryshimin e plotë të nenit 86, që flet për mënyrën e zgjedhjes së Presidentit, por që do të implikojnë edhe segmente tjera sa u përket kompetencave të Kuvendit, ku forumi më i lartë politik nuk do të ketë të drejtë ta zgjedhë Presidentin. Po ashtu, ajo do të prekë disa dispozita që kanë të bëjnë me Gjykatën Kushtetuese dhe së paku dy ligje: Ligjin për Presidentin dhe ish Presidentin dhe do të ketë nevojë që të përgatitet dhe hartohet ligji për zgjedhjen e Presidentit. Kjo nënkupton komplet një reformë që ka të bëjë me Presidentin dhe përfshin amendamentet që hapin rrugë për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit dhe ndryshimet legjislativë që mundësojnë zgjedhjet presidenciale për Presidentin", tha Bajrami. Por, këto ndryshime, sipas tij, nuk do t'i prekin kompetencat Presidentit që janë paraparë me Kushtetutën aktuale. "Sa u përket të drejtave të Presidentit, janë të drejta të sistemit gjysmëpresidencial, që i ka rreth 30 kompetenca ekzekutive të mjaftueshme dhe Kosova me zgjedhjet e drejtpërdrejta të Presidentit shkon drejt sistemit gjysmëpresidencial, prandaj nuk ka nevojë të shtohet asnjë kompetencë, sepse edhe ashtu me Kushtetutën e Kosovës, Presidenti ka kompetenca të mjaftueshme të sistemit gjysmëpresidencial", tha Bajrami. Ndryshe, ai e ka përjashtuar që nëpërmjet ndonjë marrëveshje politike të shtohen apo të kufizohen të drejtat e Presidentit. Ndërkaq deputeti Ibrahim Makolli, nga AKR - ja, thotë se aktualisht ndryshimet do të bëhen vetëm në pjesën e paraparë me rezolutë. "Rezoluta në Kuvend i kufizon ndryshimet në veprime konkrete vetëm sa i përket zgjedhjes së Presidentit", tha Makolli. Por, ai e pranoi që duhet në të ardhmen, në mandatin e ardhshëm, një rishikim i tërë i Kushtetutës. "Duhet një rishikim i Kushtetutës, kur Kuvendi do ta autorizojë një komision. Por, për çdo ndryshim duhet kërkuar mendimin kushtetues", ka thënë Makolli. Sipas tij, në të ardhmen Kushtetuta do të duhej të hyjë në rishikim për shkak të defekteve që janë shënuar në të, pra për t'i për mirësuar ato pjesë, në të cilat janë vërejtur defektet. Ndërkaq Glauk Konjufca, nga lëvizja "Vetëvendosje" shpreh qëndrimin e betonuar se edhe tani duhet insistuar në ndryshime rrënjësore të Kushtetutës, ndonëse edhe këtë mandat nuk lejohet me pakon Ahtisari. "Forcat politike PDK dhe LDK tha se janë të gatshme të bëjnë ndryshime kushtetuese për gjërat formale, me të cilat zhbllkohet kriza e tyre, por jo për ndryshime, aty ku zhbllkohet Kosova", tha Konjufca. LV, sipas tij, do të insistojë në ndryshimin e Kushtetutës në çështje thelbësore.

## **PDK-ja dhe LDK-ja sot i deponojnë emrat**

Sidoqoftë, me marrëveshje, subjektet politike kanë marrë përsipër reformat kushtetuese për zgjedhjen e Presidentit dhe reformën zgjedhore, si një mundësi në drejtim të përmirësimit të ligjit aktual. Të vetmet që nuk i kanë zyrtarizuar emrat e kryesuesve dhe anëtarëve të këtyre komisioneve janë PDK - ja dhe LDK - ja, të cilat theksojnë se të hënën përfundimisht do t'ia vënë kapakun kësaj çështjeje. Komisionet parashihet t'i kenë nga nëntë deputetë. Jozyrtarisht, emri më i përmendur për kryesues të komisionit për ndryshime kushtetuese është ai i Arsim Bajramit nga PDK-ja, ndërsa për legjislacion të zgjedhjeve Haki Demolli. Mirëpo, këto dy subjekte pritet të procedojnë edhe nga dy emra për anëtarë të komisioneve, për të cilat pritet të vendosin të hënën. Siç mësohet, të martën do të jetë gjithçka e gatshme, kur edhe Kryesia e Kuvendit pritet të mblidhet, ndërkaq një nga pikat që do ta shqyrtojë do të jetë edhe kërkesa e grupeve kuvendare për formimin e komisioneve të veçanta për reformën zgjedhore, sipas marrëveshjes PDK-LDK-AKR. Me zyrtarizimin e këtyre komisioneve do të fillojë edhe fillimi i afatit të përcaktuar me marrëveshje. Me këtë marrëveshje, partitë politike parlamentare pritet t'i bëjnë ndryshimet e nevojshme për të reflektuar vullnetin e shprehur politik, por edhe rekomandimet e organizatave të ndryshme zgjedhore që i kanë monitoruar zgjedhjet e fundit. Ata pritet t'i shpalosin përballë njëri-tjetrit pikat që do të duhej të përfshiheshin në reformat ligjore që do t'i garantonin standardet e nevojshme politike, të rekomanduara edhe nga faktorët ndërkombëtarë. Ushtruesi i detyrës së kryetarit të AKR-së, Ibrahim Makolli, tha se gjatë kësaj jave pritet t'i procedohet kërkesa Kryesisë për seancë plenare, në emër të shefave të grupeve parlamentare. "AKR-ja tashmë i ka caktuar emrat e anëtarëve për këto komisione. Ne besojmë se gjatë ditëve në vijim, edhe subjektet tjera t'i caktojnë emrat, në mënyrë që gjithçka të jetë gati, në mënyrë që Kryesia e Kuvendit të procedojë për seancën plenare", tha Makolli.

I.Krasniqi

## **Edhe një javë PDK-ja e shtynë marrëveshjen me AKR-në**

PRISHTINË, 17 PRILL - Marrëveshja e fundit ndërmjet PDK-AKR-LDK për dalje nga kriza institucionale, ka reflektuar, përveç me një zgjidhje të përkohshme të daljes nga kriza edhe në riformatimin e Qeverisë. Brenda marrëveshjes trepalëshe, tashmë është arritur edhe marrëveshja ndërmjet dy liderëve partnerë qeverisës Thaçit dhe Pacollit që ka të bëjë me ndryshimet në kabinetin qeveritar. Derisa, AKR tashmë në shkëmbim të postit të presidentit, përveç postit të zëvendëskryeministrit, kërkon edhe dy ministri të tjera që ende nuk dihet se cilat do të jenë ato edhe për kundër përfoljeve se AKR-ja do të menaxhojë me Ministrinë e Arsimit dhe atë të Punëve të Jashtme. Tashmë kanë kaluar 10 ditë nga pajtimi për riformatizim të qeverisë në mes të partnerëve të koalicionit, por kjo marrëveshje ende ka mbetur e pakonkretizuar për shkaqe subjektive, por jo për mungesë të vullnetit për ta realizuar atë. Konkretizimi i kësaj marrëveshje do të mund të ndodhë në fillim apo edhe në fund të javës gjë e cila do të varet nga bisedimet që do të zhvillohen në mes të partnerëve qeverisës dhe konsensusit që do të mund ta arrijnë ata sa i përket ndarjeve të posteve ministrore.

### **Pacolli dhe ministrat jashtë vendit, riformatimi neglizhohet**

Nënshkruesit e marrëveshjes për koalicion, lideri i PDK-së, gjegjësisht kryeministrit të Kosovës Hashim Thaçi dhe lideri i AKR-së, Behgjet Pacolli, nuk janë takuar që nga data 8 prill, datë kur edhe Kryeministri kishte marrë vendimin që z. Pacolli të emërohet zëvendëskryeministër i parë i Qeverisë së Kosovës, në këmbim të postit të presidentit që ishte dhe posti i kërkuar për arritjen e marrëveshjes për partneritet qeverisës pas zgjedhjeve të përgjithshme 12 dhjetorit të vitit 2010. Por, riformatimi i qeverisë, praktikisht pjesa tjetër e marrëveshjes që ka të bëjë me postet ministrore, ka mbetur ende pezull për faktin se një pjesë e kabinetit qeverisës dhe vetë z. Pacolli nuk kanë qenë në Kosovë gjatë gjithë javës së kaluar. Ndonëse nga përfaqësuesit e partive në qeverisje ishte paralajmëruar që në vikend, mbase edhe do të jetë koha e finalizimit të marrëveshjes për riformatim të kabinetit qeveritarë, një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Se gjatë vikendit nuk ka pasur takime në mes të partnerëve të qeverisjes është konfirmuar nga përfaqësuesit e AKR-së, derisa arsyet tjera nuk dihen përveçse asaj që tashmë është konfirmuar se z. Pacolli gjendej jashtë vendit, sikur edhe një pjesë e madhe e kabinetit qeveritar për më tepër edhe mungesën e zëvendëskryeministrit Kuqi i cili me gjasë ka rol të rëndësishëm në bisedimet në mes të partnerëve të koalicionit. Edhe pse është paralajmëruar se Aleancës Kosova e Re do t'i takojnë edhe dy ministri të reja dhe postet e tre zëvendëskryeministrave, nuk ka ende konfirmim zyrtarë për një ndarje të tillë.

### **AKR, dy ministra e tre zëvendësministra**

Përfaqësuesit e partisë mandatare e krijimit dhe tani e reformatizimit të Qeverisë, kanë vullnetin për jetësimin e marrëveshjes me partnerin e tyre qeverisës, porse sipas deklaratave të tyre ditë më parë, një gjë e tillë nuk është konkretizuar për shkak të mungesës së vetë liderit Pacolli dhe disa ministrave, ndër ta edhe zëvendësministrja Mimoza Kusari-Lila e cila është edhe nënkryetare e AKR-së. Pra zyrtarë të Partisë Demokratike të Kosovës, pohojnë se arsye e mos zhvillimit të bisedimeve në mes të partnerëve të koalicionit nuk është për fajin e kryeministrit Thaçi, por për shkak të mungesës së liderit Pacolli, që është edhe personi kyç në bisedime për konkretizimin e ndryshimeve në kabinetin qeverisës. Ndonëse gjithçka është në

duar të shefit të tyre, zyrtarë të Partisë Demokratike të Kosovës nuk kanë folur për kohën se kur mund të arrihet marrëveshja për riformatimin e qeverisë, megjithëse janë optimist se do të përfundoj sa më shpejt që është e mundur. "Deri tash nuk ka diçka konkrete dhe kjo vonesë është bërë edhe për shkak se z. Pacolli dhe një pjesë e qeverisë nuk kanë qenë prezentë në Kosovë. Pritet që javën që vjen liderët e dy partive të pajtohen për ndarjen edhe të ministrive të reja për AKR-në", deklaruan zyrtarë të PDK-së. Ibrahim Makolli, ushtrues detyre i kryetarit të AKR-së, thotë se gjatë javës që po e lëmë pas nuk ka pasur as edhe një takim në mes të partnerëve të koalicionit PDK-AKR , për faktin siç thotë ai se një pjesë e madhe e kabinetit qeveritar nuk kanë qenë në Kosovë. "Besoj se javën që po hyjmë do ta arrihet të rrubullakësohet ky proces dhe marrëveshja do të realizohet me qëllimin më të mirë për mbarëvajtjen e punës në qeveri", shprehet Makolli. Makolli nuk konfirmon përfoljet se AKR-ja kërkon ministrinë e Arsimit apo edhe atë të Punëve të Jashtme, por thotë ai se askush nga ata nuk e ka thënë se AKR-ja do këtë apo atë ministri, këto janë spekulime mediatike. "Ne kemi nevojë të takohemi me ta. Dy ministri jemi pajtuar që t'i takojnë AKR-së dhe tre zëvendësministra. Nuk e kemi biseduar asnjëherë se cilat do të jenë ministrinë e mundshme që do t'i menaxhoj AKR-ja", thotë Makolli. Ai shprehet optimist se gjatë javë do të konkretizohen veprimet e partnerëve të koalicionit në raport me riformatimin e kabinetit qeverisës. Ndonëse marrëveshja për ndryshime në kabinetin qeveritar është arritur tashmë, një gjë e tillë pritet të finalizohet javën e ardhshme kur edhe përfaqësuesit e të dy subjekteve do të jenë në Kosovë dhe të qartësojnë pozicionet e tyre në ekzekutivin e vendit. Pra, kjo javë pritet të nxjerrë edhe dy emra të rinj nga AKR-ja që do të jenë pjesë e qeverisë në kabinetin Thaçi 2, por se kush do të jenë ata ministra të PDK-së që duhet t'i lirojnë postet ministrore mbetet të shihet.

---

## Pacolli shqyrton tërheqjen nga Qeveria

---

**Brenda javës do të dihet nëse Behgjet Pacolli do të tërhiqet edhe nga posti i zëvendëskryeministrit, për shkak të paqartësive rreth kompetencave të tij**

PRISHTINË - Nuk përjashtohet mundësia që Behgjet Pacolli të tërhiqet nga pozita e zëvendëskryeministrit, për shkak të paqartësive të krijuara rreth kompetencave në politikën e jashtme në mes presidentes Atifete Jahjaga, atij si zëvendëskryeministër dhe shefit të diplomacisë. Jozyratrisht merret vesh se Pacolli deri në fund të javës pritet t'iu japë fund dilemave për tërheqje ose jo nga posti i zëvendëskryeministrit të parë të Qeverisë së Kosovës, i cili ishte ngarkuar për marrëdhënie ndërkombëtare për të siguruar njohje të reja për shtetin e Kosovës, si dhe për të sjellë investime të huaja në Republikën e Kosovës. Biznesmeni kosovar, që ishte president i Kosovës për 35 ditë, është emëruar zëvendës i parë i kryeministrit Hashim Thaçi, por që të hënën nuk mori pjesë në mbledhjen e kabinetit qeveritar. Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte në gjendje të saktësojë se kush është zëvendëskryeministri i parë, porse ka theksuar se nuk është në dijeni nëse Pacolli do të tërhiqet. "Nuk i kam informatat e tilla. Kryeministri është ai që i emëron veprimet e tilla dhe cilindo veprim që e merr kryeministri është vendim ligjor, kushtetues dhe respektohet", ka thënë Kuçi. Mungesën e Pacollit në këtë mbledhje të Qeverisë, Kuçi e ka arsyetuar me mungesën e tij fizike në Kosovë. "Për aq sa kam informacione, ai fizikisht nuk është në Kosovë", ka thënë Kuçi, duke shtuar se është në dorën e kryeministrit Hashim Thaçi që të komplotojë kabinetin qeveritar edhe me zëvendësministrin në konsultim me partnerin e koalicionit qeverisës AKR - në. Mirëpo, zyrtarë të AKR - së nuk shohin përzierje të kompetencave e në mes Pacollit, presidentes dhe ministrit të Punëve të Jashtme, por përkundrazi si një mundësi për krijimin e një politike të fortë të jashtme që do t'i shërbejë vendit. Edhe këshilltari i Pacollit, Shefki Avdullahu, ka konfirmuar për gazetën "Zëri" se shefi i tij gjendet për një vizitë jashtë vendit. "Nuk ka asgjë definitive për mundësinë e tërheqjes së Pacollit dhe në momentin që ai kthehet në Kosovë do të ulet së bashku me kryeministrin Hashim Thaçi për shqyrtimin e të gjitha mundësive për respektimin e marrëveshjes së përgjithshme mes partnerëve të koalicionit. Prandaj, them se deri në fund të kësaj jave do të dihet saktë rreth çështjes së Pacollit se a do të marrë pozitën e zëvendëskryeministrit, i cili u emërua nga Thaçi", ka thënë Avdullahu. Sipas tij, në takimin që pritet të zhvillohet mes kryeministrit Thaçi dhe ish - presidentit Behgjet Pacolli, do të definohen edhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me emërimin e zëvendësministrave në bazë të marrëveshjes ndërmjet partnerëve të koalicionit PDK - AKR. "Çështja e kompetencave do të definohet qartë me kryeministrin Thaçi dhe në këtë drejtim nuk besoj se do t'ia prishë disponimin as zëvendëskryeministrit të parë aktual Hajredin Kuçi. Mendoj se Kuçi është shumë elastik në gjëra të tilla dhe besoj se do t'i tejkalojnë interesat personale me qëllim të krijimit të një qeverie efektive", është shprehur Avdullahu. Edhe ish - këshilltari tjetër i Pacollit, Ibrahim Gashi, i cili pritet të marrë post ministror, ka thënë se nuk ka duplikim të kompetencave dhe në këtë drejtim nuk ka asnjë arsye që Pacolli të tërhiqet nga pozita e zëvendëskryeministrit. Biznesmeni Behgjet Pacolli ditë më parë humbi postin e presidentit, të cilin e ushtroi pak më shumë se një muaj, pas një vendimi që mori Gjykata Kushtetuese për shkelje të procedurave gjatë zgjedhjes së tij. Ai arriti të ruajë marrëveshjen e koalicionit mes PDK së dhe AKR - së, duke u "viktimizuar" që karrigën e të parit të shtetit t'ia lëshojë Atifete Jahjagës. "Nuk ka asgjë definitive për mundësinë e tërheqjes së Pacollit dhe në momentin që ai kthehet në Kosovë do të ulet së bashku me kryeministrin Hashim Thaçi për shqyrtimin e të gjitha mundësive për

respektimin e marrëveshjes së përgjithshme mes partnerëve të koalicionit" , ka thënë Shefki Abdullahu.



---

## Është apo jo pjesë e Qeverisë?

---

**Behgjet Pacolli nuk ka marrë pjesë në mbledhjen e parë të qeverisë që nga emërimi i tij në postin e zëvendëskryeministrit të parë**

Ka mbushur një javë që nga emërimi i Behgjet Pacollit në postin e zëvendëskryeministrit të parë për njohje, por ende nuk ka filluar punën e tij. Ditë me parë Pacolli pati thënë se ai nuk dëshiron të përzihet në detyrat që i kanë Presidentja dhe ministri i Punëve të Jashtme në çështjen e lobimit për njohje, funksion që edhe Pacolli e ka marrë nga shefi i tij Thaçi. Ndërsa, për shkak të përzierjeve të kompetencave, është thënë se ai edhe mund të tërhiqet nga ky post. Pacolli nuk ka marrë pjesë as në mbledhjen e qeverisë, e para prejse ai është emëruar në këtë post. Ndërsa, pas mbledhjes zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, ka thënë se nuk ka informacione nëse Pacolli do të tërhiqet. "Unë nuk i kam informatat e tilla. Kryeministri është ai që i emëron veprimet e tilla. Cilindo veprim që e merr kryeministri, është vendim ligjor, kushtetues dhe respektohet", ka thënë Kuçi. Ndërsa, për mungesën e Pacollit në këtë mbledhje Kuçi e ka arsyetuar me mungesën e tij fizike në Kosovë. "Për aq sa kam informacione, ai fizikisht nuk është në Kosovë", është shprehur Kuçi. Pacolli u emërua në këtë post pasi humbi postin e presidentit, meqë Gjykata Kushtetuese vendosi se procedura e zgjedhjes së tij ishte antikushtetuese. Ndërsa, për ta ruajtur koalicionin qeverisës arritën konsensus për zgjedhjen e presidentes Atifete Jahjaga. Ndërsa, sipas Kushtetutës, presidentja është bartëse e politikës së jashtme, Ministria e Punëve të Jashtme është hartuese dhe ekzekutuese e kësaj politike dhe po ashtu edhe zëvendës-kryeministrja Edita Tahiri është e emëruar për politik të jashtme. Pacolli ka konsideruar ditë më parë se nuk dëshiron të përzihet në kompetenca të tjerëve, duke kërkuar qartësim të kompetencave të tij. Mirëpo, në anën tjetër përfaqësuesit e koalicionit qeveritar nuk e shohin këtë si përzierje të kompetencave, pasi përkundrazi e shohin si një mundësi për krijimin e një bërthame të fortë të politikës së jashtme të Kosovës.

## Koalicioni në krizë apo me marrëveshje të re

PRISHTINË, 19 PRILL - Aleanca Kosova e Re Behgjet Pacollit është në pritje të rifillimit të bisedimeve për finalizimin e marrëveshjes për ndryshimet në kabinetin qeveritar me kryeministrin Hashim Thaçi, njëherësh kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës. Nuk dihet nëse mosmarrëveshjet ndërmjet partnerëve të koalicionit qeverisës për ndarjen e dikastereve, apo edhe ato brenda partisë më të madhe në vend, po shkaktojnë vonesat në ndryshimet në kabinetin qeveritar, meqë palët fillimisht ishin pajtuar që ndryshimet të ndodhnin brenda javës. As të martën nuk kanë nisur bisedimet, edhe përkundër deklarimeve të përfaqësuesve të të dy partive se ato do të fillojnë qysh në fillim të kësaj jave. Mungesa e liderit të AKR-së, Behgjet Pacolli në Kosovë dhe e zyrtarëve qeveritar kanë qenë shkaktarë të shtyrjes së bisedimeve, por tashmë kur kabineti qeveritar është mbledhur, takimi ndërmjet Thaçit dhe Pacollit shtyhet dita ditës. Edhe pse është emëruar zëvendëskryeministër i parë në qeveri, z. Pacolli nuk ka qenë i pranishëm në mbledhjen e fundit të kabinetit qeveritar. Mos pjesëmarrja e tij në mbledhje, përveç se është arsyetuar me mungesën fizike të z. Pacolli, duket se ka edhe qëllime të tjera. Përzjerja e kompetencave duket se është arsyeja kryesore që ka shtyrë z. Pacolli të mendohet nëse do të pranojë të zë një ulëse në kabinetin Thaçi. Deri para hyrjes në koalicion me PDK-në, Pacolli si lider opozitar kishte shfrytëzuar të gjitha lidhjet dhe mundësitë e tij për të lobuar për njohjen e Kosovës. Këtë kontribut ai e jepte pa pasur mbështetjen financiare dhe as morale të institucioneve shtetërore. Duke ditur fuqinë dhe angazhimin e tij në çështjen e lobimit, kryeministri Thaçi e kishte emëruar z. Behgjet Pacollin pikërisht në një post që atij do t'i përshtatej, atë të zëvendëskryeministrit të parë, që e ngarkon atë edhe me marrëdhënie ndërkombëtare për të siguruar njohje të reja për shtetin e Kosovës, si dhe për të sjellë investime të huaja në Republikën e Kosovës. I vetëdijshëm se çështja e njohjeve është fushë që i përket Ministrisë së Punëve të Jashtme, Pacolli për shkak të paqartësive të krijuara rreth kompetencave në politikën e jashtme, që nga 8 prilli kur edhe zyrtarisht është emëruar zëvendëskryeministër i parë nuk ka ushtruar për asnjë ditë detyrën e tij. Më shumë sesa arsyetimi se Pacolli ndodhet jashtë shtetit, duket se paqartësitë rreth funksionit të tij, po neglizhojnë reformatizimin e qeverisë. Sido që të jetë, zyrtarë të Aleancës Kosova e Re janë optimist se marrëveshja e tyre do të realizohet edhe nga partneri qeverisës, dhe do të gjinden zgjidhjet e pranueshme. Ata mohojnë deklaratimet në media se Pacolli është duke e shqyrtuar mundësinë për tërheqje nga qeveria. "Z. Pacolli kthehet të mërkurën në Kosovë dhe unë mendoj se ajo që kërkon z. Pacolli dhe ne si AKR është që të respektohet marrëveshja e cila përveç postit të zëvendëskryeministrit, AKR-së i jep edhe dy ministri dhe tre zëvendësministra. Unë nuk shoh ndonjë arsye që kjo të mos realizohet. Ne kemi konsideratë për partnerin qeverisës që ata t'i gjejnë zgjidhjet e pranueshme edhe për njerëzit që janë brenda qeverisë aktualisht, andaj edhe jemi në pritje të formalizimit të asaj marrëveshje", ka deklaruar Ibrahim Gashi, nënkryetar i AKR-së. Nga ana tjetër, zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi nuk është në dijeni nëse z. Pacolli është duke shqyrtuar mundësitë e tërheqjes nga qeveria. "Nuk kam informata të tilla", tha shkurt zëvendës-kryeministri Kuçi. Ai nuk ka dashur të flas se kur pritet të nisur bisedimet me AKR - në, me arsyetimin se gjithçka është në dorë të kryeministrit dhe të liderit të AKR-së, z. Pacolli, i cili tashmë ndodhet jashtë Kosovës.

## I painteresuar për qeverinë

**Behgjet Pacolli është i painteresuar që të jetë pjesë e kabinetit Thaçi. As në mbledhjen e radhës së qeverisë Pacolli nuk ka marrë pjesë.**

PRISHTINË - Behgjet Pacolli është i pa interesuar për të qenë pjesë e Qeverisë së Kosovës. Edhe pse ditë më parë ishte emëruar si njeriu numër dy në qeveri nga kryeministri Hashim Thaçi, Pacolli nuk ka marrë pjesë në asnjë mbledhje të ekzekutivit. Sipas burimeve të gazetës "Zëri", të afërta me Pacollin, bëhet me dije se ish - kryetari i Aleancës Kosova e Re nuk është i interesuar që të jetë pjesë e kabinetit Thaçi. "Pacolli është kthyer të mërkurën (ditën kur u mbajt mbledhja e qeverisë) nga një vizitë lobuese, mirëpo nuk ka marrë pjesë në mbledhje", ka thënë ky burim i gazetës, i afërt me Pacollin, duke mos dhënë detaje tjera. Edhe vetë ish - presidenti i vendit, Behgjet Pacolli, ditën e arritjes së marrëveshjes politike ndërmjet tij, Hashim Thaçit dhe Isa Mustafës, nën ndërmjetësimin e ambasadorit amerikan në Kosovë, Christofer Dell, ka thënë se nuk pranon të mbajë ndonjë post ministror, sepse kjo vetvetiu, sipas tij, "e bën të jetë i varur nga dikush". **"Unë asnjëherë nuk do të mbështetem në dëshirën e dikujt tjetër. Nuk do të jem ministër i Jashtëm, sigurisht. Ndoshta AKR - së i takon kjo ministri, por me siguri që Behgjet Pacolli nuk do të jetë ai. Në asnjë ministri s'do të jem. Do të ishte mëkat që të mbyllem në një zyrë, por dimensionet e mia janë globale"**, kishte thënë Pacolli gjatë kësaj interviste. Në anën tjetër, zyrtarë të ekzekutivit që i takojnë PDK - së thonë se nuk janë të informuar për tërheqjen eventuale të Pacollit nga pozita numër 2 e qeverisë. Zëvendëskryeministri i dytë i Kosovës, Hajredin Kuçi, ka thënë se nuk ka informacione nëse Pacolli nuk e ka pranuar këtë post. Sipas Kuçit, ish - kryetari i AKR së nuk ka qenë refuzues në momentin kur vendimi për emërim e tij është bërë publik. Ai madje u shpreh i bindur se bisedimet Thaçi -Pacolli do të vazhdojnë në drejtim të kompletimit të qeverisë me postet vakante. Zyrtarë të Aleancës Kosova Re kanë thënë, ndërkaq, se Pacolli nuk e ka refuzuar pozitën e zëvendëskryeministrit të parë. Sipas tyre, mospjesëmarrja e Pacollit në mbledhjen e qeverisë ka të bëjë me atë se ai ka qenë jashtë shtetit. "Pacolli nuk ka qenë në Kosovë dhe për këtë arsye ai nuk ka marrë pjesë në mbledhjen e qeverisë", ka thënë ushtruesi i detyrës së presidentit të AKR së, Ibrahim Makolli. Mirëpo, ai nuk ka saktësuar se në çfarë kohe është kthyer Pacolli të mërkurën në Kosovë, para apo pas mbledhjes së qeverisë. Megjithatë, Makolli ka thënë se për këtë çështje shumë më mirë do të ishte që të pyetj vetë Pacolli. Ndryshe, Ibrahim Makolli ka bërë të ditur se as për punën e vendeve vakante në Qeverinë e Kosovës, pra për zëvendësministrat e as për ministrinë e reja që do t'i takojnë AKR - së nuk ka pasur biseda ndërmjet partnerëve të koalicionit. "Nuk jemi takuar ende me PDK - në për të vendosur për çështjen e ministrive të reja që do të na takojnë dhe as për punën e zëvendësministrave" , ka thënë Makolli. Behgjet Pacolli menjëherë pas emërimit në postin e të dytit në qeveri kishte kërkuar sqarime nga kryeministri Thaçi në lidhje me pozitën e tij si zëvendëskryeministër, për shkak të paqartësive të krijuara rreth kompetencave në politikën e jashtme mes presidentes Atifete Jahjaga, atij si zëvendëskryeministër dhe shefit të diplomacisë, Enver Hoxhaj. Emërimi i Pacolli në postin e zëvendëskryeministrit të parë është bërë pak kohë pasi ai ishte tërhequr nga kandidatura për president të vendit, duke ia hapur rrugën zgjidhjes së një presidenti konsensual dhe tejkalimit të krizës politike. Pacolli ishte zgjedhur president i Kosovës më 22 shkurt, në një seancë të jashtëzakonshme parlamentare, të cilën e kishte bojkotuar opozita. Mirëpo, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, pas ankesës që kishte bërë opozita, e kishte vlerësuar zgjedhjen e tij si antikushtetuese, çka kishte detyruar liderët e tri partive kryesore, PDK - së,

AKR - së dhe LDK - së të mblidheshin dhe të arrinin një kompromis. "Pacolli nuk ka qenë në Kosovë dhe për këtë arsye ai nuk ka marrë pjesë në mbledhjen e qeverisë", ka thënë ushtruesi i detyrës së presidentit të AKR - së, Ibrahim Makolli.

---

## Pacolli me plan për Qeverinë

---

**Ish - presidenti Pacolli nuk pranon që të jetë pjesë e qeverisë Thaçi veç për dekor. Ai po e përgatit një plan i cili precizon detyrat e tij si zëvendëskryeministër**

PRISHTINË - Ish - presidenti Behgjet Pacolli ka vendosur që të marrë pjesë në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë së Kosovës, por deklaroi se nuk do të pranojë apriori të ushtrojë detyrën e zëvendëskryeministrit të parë, nëse kryeministri Hashim Thaçi nuk ia merr për bazë planin e tij operativ që do ta shpalojë para tij. Pacolli tha për gazetën "Zëri", se është duke e përgatitur tashmë një plan për kryeministrin Thaçi, e nëse ky i fundit nuk ia merr për bazë atëherë ai mund të mos jetë pjesë e ekzekutivit. **"Unë jam duke formuluar një dokument i cili i përcakton aktivitetet e mia në qeveri. Nuk e shoh të arsyeshme të shkoj pa kurrfarë përgjegjësie të zë vend dhe të shkoj aty e të këqyri çka të punoj"**, ka thënë Pacolli duke shtuar se dëshiron t'i përcaktojë detyrimet dhe të drejtat e tij në atë post. **"Unë do të bëhem gati për të martën e ardhshme të takohem me kryeministrin Thaçi, po besoj që ai do të gjejë kohë dhe të ulet pakëz dhe të përcaktohem për të ardhmen"**, ka thënë Pacolli, duke mos precizuar se çfarë do të bëhet në rast të mospranimit të kushteve të tij nga ana e kryeministrit Thaçi. Ish - presidenti i Kosovës i kontestuar nga Gjykata për mënyrën se si është zgjedhur, tha se nuk është person që i duhet puna, por është person që bart mbi vete përgjegjësi. "Nuk jam njëri që i nevojitet vendi i punës dhe të dal në punë", ka thënë Pacolli duke shtuar se koha e mospjesëmarrjes së tij në mbledhjet e qeverisë i ka mjaftuar që t'i përcaktojë limitet dhe veprimet e tij politike. Ndërkaq, kompletimin ose mos kompletimin e qeverisë me ministra e zëvendësministra, Pacolli e konsideron sekondare. **"Ato janë pjesë e koalicionit dhe duhet të diskutohen. Por më e rëndësishmja është që ne t'i përcaktojmë detyrat tona"**, ka thënë Pacolli. Nga ana tjetër, zëvendëskryeministri i Kosovës Hajredin Kuçi ka thënë se sa i përket raporteve me Behgjet Pacollin, është kryeministri Hashim Thaçi, ai i cili po mban kontaktet me të. Por, ndryshe e percepton situatën Ylli Hoxha nga Klubi për Politikë të Jashtme. "Nuk shoh ndonjë kapacitet të Pacollit për të bërë një obstrukcion shumë të madh. Sidoqoftë Pacolli paraqet një problem të madh, i cili duhet të zgjidhet nga koalicioni qeverisës. Në këtë drejtim besoj që do të fillohen negociata për ndonjë përfitim më të madh të partisë që përfaqëson Pacolli, ngase Pacolli ka qenë humbësi më i madh i marrëveshjes për zgjedhjen e presidentit", ka thënë Hoxha. Pas tejkalimit të krizës së zgjedhjes së presidentit, sipas Hoxhës, pozicioni i Pacollit dukshëm është zvogëluar. "Dhe nuk shoh krizë të madhe të cilën do të mundë ta shkaktonte Pacolli me pakënaqësitë e tij. Mirëpo, ai tash ka hapësirë që të bëjë presion për të marrë edhe ndonjë resor tjetër, konsideron Hoxha. Ndërkaq, për mos kompletim të Qeverisë së Kosovës, përfaqësuesi i KPJ - së ka thënë se janë produkt i paaftësive apo pjesës së kapacitetit për të gjetur marrëveshje brenda subjekteve politike që e përbëjnë koalicionin. Sipas Hoxhës, duke i siguruar funksionet optimale të qeverisë dhe duke emëruar ministra, kryeministri Hashim Thaçi duket që e ka gjetur qetësinë dhe nuk i ngutet në formësimin e gjithmbarshëm të kabinetit të tij. "Unë konsideroj se e gjithë kjo hyn brenda një kohezioni, brenda vetë koalicionit qeverisës dhe brenda vetë subjektit të kryeministrit dhe mbi atë se cilët do të duhej të ishin emrat për kabinetin e Thaçit", ka thënë Hoxha. "Unë do të bëhem gati për të martën e ardhshme të takohem me kryeministrin Thaçi, po besoj që ai do të gjejë kohë dhe të ulet pakëz dhe të përcaktohem për të ardhmen", ka thënë Pacolli.

---

## Pacolli pret sqarimet e Thaçit

---

**Roli aktual i Pacollit në qeveri, sipas AKR-së, ngjason më shumë në angazhimin e një OJQ-je, një diplomati në pension, apo të një aktivisti politik**

PRISHTINË - Behgjet Pacolli mbetet në kërkim të një formule e cila do ta mbante atë lart në hierarkinë e institucioneve. Posti i zëvendëskryeministrit të parë, duket se nuk i mjafton Pacollit, sikurse që nuk e kënaq politikisht as mandati ende i padefinuar i tij me kompetenca shtesë në çështjen e lobimit për njohje të reja. Pas humbjes së postit të presidentit, Pacolli nuk e merr "afër zemrës edhe nëse do të humbte një pozitë në qeveri, thonë burime nga AKR - ja, parti kjo e themeluar nga afaristi i njohur kosovar. Për dallim nga biznesi, politika duket të mos jetë "arma" e fortë e Pacollit. Loja e tij politike drejt kreut të shtetit, e la atë për pak javë pa postin e kryetarit të partisë, pa pozitën e deputetit dhe më pas edhe pa postin e presidentit të shtetit. Ndërkaq kontributi i tij politik ishte vendimtar për mbijetesën e mandatit të institucioneve aktuale duke e shpëtuar vendin që të shkoj në zgjedhje të reja. Pas largimit të tij nga Presidenca, ka mjaftuar vetëm që ai të braktiste koalicionin me PDK- në dhe Qeveria Thaçi do të mbeste me automatizëm qeveri e pakicës dhe si e tillë do të humbte jo vetëm legjitimitetin, por edhe logjikën për të ekzistuar deri në zgjedhjet e rregullta. Tani kur Pacolli pranoi që partia e tij dhe koalicioni i partive që drejton të mos e braktisin qeverinë, ai vet ka mbetur pezull duke mos e ditur se çka në fakt përfaqëson si zëvendëskryeministri i parë. Aktiviteti i vazhduar politik i Pacollit këto vitet e fundit ishte përqendruar në diplomaci dhe lobim për njohje të reja. Por, Pacolli ishte treguar zemërgjerë duke mos pretenduar, të paktën jo haptas, për postin e ministrit të Jashtëm. Si satisfaksion, Thaçi i ofroi atij një pozitë që e mbanë në diplomaci e lobim, por me kompetenca aspak të qarta. Roli i tij, sipas një zyrtari të AKR - së, do të ngjasonte me një angazhim të një OJQ - je, një diplomati në pension, apo të një aktivisti politik. Andaj, AKR - ja kishte kërkuar nga kreu i qeverisë të qartësohet se çka përfaqëson Pacolli në qeveri dhe në politikën Kosovare aktualisht me postin e ri. Politika e jashtme, është në përgjegjësi të presidentit dhe qeverisë, përkatësisht Ministrisë së Jashtme, kështu që Pacolli në këtë rast nuk e kishte të qartë se çfarë do të punonte në punën, angazhimin e tij të ri. Pacolli kishte paralajmëruar se do t'i dorëzonte kryeministrit Thaçi një plan pune, i cili do ta mbante atë në qeveri. Pa definimin e kompetencave, ai e kishte paralajmëruar Thaçin se nuk do të shihte arsye pse do të qëndronte në qeveri, qoftë edhe si zëvendëskryeministri i parë. Këtë plan Thaçi tashmë e ka në duart e veta, thanë të njëjtat burime dhe se sipas tyre, pas një "muhabeti" shtesë me Pacollin, shefi i ekzekutivit pritet ta prezantoj në qeveri, si pjesë e punës dhe angazhimeve të kabinetit të tij. Por ajo që e brengosë Thaçin nuk është Pacolli sa është sistemimi i dy ministrave të rinj të AKR - së dhe caktimi i zëvendësministrave: Pas largimit nga posti i presidentit si rrjedhojë e procedurave jo kushtetuese, Pacolli ishte marrë vesh me Thaçin që AKR të merrte nën udhëheqje edhe dy ministri si dhe të delegonte tre zëvendësministra. Pritjet e AKR - së ishin se kjo marrëveshje do të zbatohet qysh para dy javësh, por kreu i qeverisë nuk kishte pa ndonjë arsye që të ngutej.

## MAKOLLI PROPOZOHEP PËR MINISTËR TË INFRASTRUKTURËS

### Pacolli e kërkon edhe Ministrinë e Jashtme

Koalicioni Kosova e Re ka paralajmëruar negociata me kryeministrin Hashim Thaçi për të vendosur për çështjen e portofolave qeveritare. Me gjithë përpjekjet gjatë ditës së djeshme, askush nga zyrtarët e AKR-së nuk është deklaruar lidhur me kërkesat e tyre, me gjasë në pritje të takimit zyrtar të krerëve të dy subjekteve, PDK dhe AKR, për të realizuar më pas edhe bërjen publike të pozicioneve. Pas dorëzimit të postit të presidentit, Koalicioni Kosova e Re ka thënë se ekziston një pajtim që si kompensim t'i marrin dy ministri, por PDK-ja e konsideron si të tepërt kërkesën e tyre. Nëpërmjet burimeve konfidenciale, merret veshë se AKR-ja i ka pikëtuar dy ministri, atë të Infrastrukturës dhe të Jashtmen, madje për udhëheqjen e tyre përmenden emrat e Ibrahim Makollit dhe Behgjet Pacollit. Me vendimin e Qeverisë, ky i fundit është emëruar zëvendëskryeministër i parë i Qeverisë së Kosovës, por deri më tani nuk ka marrë pjesë në asnjë mbledhje. Pacolli ditë më parë ka paralajmëruar se është duke e përpiluar një dokument, i cili do t'i dorëzohet të mërkurën kryeministrit Thaçi. Sipas tij, dokumenti i përcakton detyrat që ai dëshiron t'i realizojë nga kjo pozitë. Reformat diplomatike, ekonomike dhe sundimi i ligjit, janë disa nga kërkesat e tij. **"Nëse nuk përfilllet ky dokument, i cili është shumë i arsyeshëm, atëherë nuk kam çfarë të kërkoj në Qeveri, sa për ta zënë një vend, pa e ditur se cila do të jetë detyra ime. Nuk mund të kontaktoj investitorët e huaj dhe t'i sjell në Kosovë, e të mos ketë asnjë perspektive"**, tha Pacolli.

#### Përzierja e kompetencave

Ai tha se ka përzierje kompetencash sa i përket politikës së jashtme, pasi brenda kabinetit qeveritar përgjegjës në këtë fushë, përveç ministrit Enver Hoxhaj, është edhe Edita Tahiri, zëvendëskryeministre për çështjet e jashtme dhe të sigurisë nacionale. Por, ai në këtë prononcim për RTK-në nuk i ka artikuluar ende postet që i kërkon subjekti i tij politik, duke mos përmendur dikastere konkrete, por ka lënë të nënkuptohet se synojnë të marrin më shumë se një ministri. Pavarësisht kësaj, të dy partnerët e koalicionit nuk e kanë mbyllur ende skemën e përfaqësimit edhe në nivele të dyta. Kjo duket më së miri edhe në deklaratat e zyrtarëve, që u kujtojnë demokratëve të Thaçit se janë partneri kryesor. Burimet theksojnë se AKR-ja kërkon edhe dy poste ministrore si kompensim dhe tri poste të nivelit të dytë, e për të cilat thekson se ekziston një pajtim. Por, kjo deri më tani nuk është konfirmuar nga asnjë zyrtar i PDK - së, të cilët konsiderojnë se deri më tani nuk ka asnjë marrëveshje. Sa i përket ridizajnimit të Qeverisë, javë më parë zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi ka thënë se kjo do të ndodhë shumë shpejt, por, sipas tij, e tëra varet edhe prej partnerit të koalicionit. "Unë dua të besoj shumë shpejt. Kjo do të ndodhë shumë shpejt, mund të jetë një javë, ose dhjetë ditë, por besoj që shumë shpejt", ka thënë Kuçi. Ai më tej sqaroi se ka pasur zhvillime që nuk kanë qenë të natyrshme dhe jo shumë të pritura edhe në raport me partnerët e koalicionit, edhe pozitat institucionale, për të cilat Qeveria ka qenë e interesuar të japë përgjigje. Ai tha se në rastin e postit të presidentit është dhënë përgjigje shumë më e shpejtë se sa është pritur. "Me këtë është krijuar një stabilitet institucional dhe politik, meqë tani ka mundësi të frymohet më lehtë", tha Kuçi, i pyetur nëse ky proces po vonon. Sido që të jetë, koalicioni i tashëm qeveritar, sipas Pacollit, do ta vazhdojë punën, pavarësisht nëse do ta ushtrojë ai postin e zëvendëskryeministrit të parë, apo jo.

P. M. & L. K.

## **Thaçi e Pacolli vazhdojnë bashkë**

**Pacolli Zëvendëskryeministër i parë, kurse Ibrahim Makolli ministër i Diasporës e Ibrahim Gashi ministër, por ende pa e caktuar i cilës, është marrëveshja më e re PDK - AKR**

PRISHTINË - Hashim Thaçi dhe Behgjet Pacolli kanë ridizajnuar marrëveshjen e koalicionit qeverisës ndërmjet PDK - së dhe AKR-së. Si kundërshpagim për postin e humbur të presidentit, Pacolli mori për vete postin e zëvendëskryeministrit të parë, ndërkaq për partinë e tij siguroi edhe dy ministri të reja, njëra prej tyre ministri e re. Marrëveshja kushtoi me formimin e një ministrie të re, atë të Diasporës, duke e rritur në 19 numrin e tërësishëm të tyre. Në një komunikatë të PDK - së sqarohet se Thaçi e Pacolli kanë fuqizuar dhe ridizajnuar marrëveshjen për partneritet qeverisës. Gjatë takimit është arritur pajtueshmëri që të themelohet Ministria për Diasporë, e cila do të udhëhiqet nga përfaqësuesi i koalicionit për Kosovën e Re (AKR), përkatësisht nga Ibrahim Makolli. Kurse brenda një afati të pacaktuar kohor, AKR - ja e Pacollit do të drejtojë edhe një ministri. "Partnerët e koalicionit janë pajtuar që të bashkëpunojnë në implementimin e programit qeveritar dhe politikave të përbashkëta programore", thuhet në komunikatën e PDK - së. Rinegociimi dhe marrëveshja e re erdhi si pasojë e humbjes së postit të presidentit nga ana e Pacollit, pas aktvendimit të Gjykatës Kushtetuese se Pacolli ishte zgjedhur president duke mos respektuar procedurat kushtetuese. Fillimisht Pacolli mori një ofertë publike nga kryeministri Hashim Thaçi, që ai të marrë postin e zëvendëskryeministrit të parë me disa kompetenca në çështjet e lobimit. Por, Pacolli nuk u pajtua me këtë ofertë, duke i kërkuar Thaçit që kompetencat e tij në këtë post të definohen në bazë të një plani. Këtë plan Pacolli ia dorëzoi vetë Hashim Thaçit. Dje, Behgjet Pacolli mungoi sërish në mbledhjen e qeverisë. Ulësja në anën e djathtë të shefit të qeverisë, Hashim Thaçi, sërish ishte pa Pacollin. Numri dy i qeverisë, Pacolli, të paktën sipas një vendimi të kryeministrit, po priste ende përgjigjen e Thaçit në lidhje me kompetencat e tij në qeveri, të cilat Pacolli i ka përmbledhur në planin e të tij të punës. Në të kundërtën, ai e kishte paralajmëruar Thaçin se do të prishte koalicionin qeverisës dhe do të kërkonte mocion votëbesimi ndaj qeverisë në Kuvend, për ta rrëzuar atë sërish, ngjashëm me mandatin e kaluar. Pas largimit nga kandidatura për president, Pacolli dukej se i kishte vënë përfundimisht vijat e kuqe Thaçit. Zëvendëskryeministri dhe nënkryetari i PDK - së, Hajredin Kuçi, thotë se "plani apo letra e Pacollit po diskutohet dhe se ai shumë shpejt do ta marrë një përgjigje nga kreu i ekzekutivit". Nuk është ndonjë letër që nuk pranohet. Gjërat po shkojnë në suaza normale, por gjithmonë në kuadër të ligjit, fuqisë politike që e kemi secili, por edhe të rregullores së punës të qeverisë", theksoi Kuçi në lidhje me kushtet e Pacollit. Madje, sipas Kuçit, marrëveshja Thaçi - Pacolli nuk parashihte që AKR - ja të merrte edhe dy ministri të reja, siç pretendonin në vazhdimësi Pacolli dhe zyrtarët më të lartë të AKR - së. Marrëveshja më e re Thaçi- Pacolli i ka hapur rrugë një partneriteti për të ardhmen mes dy partive të tyre. Pacolli ka rikonfirmuar se ai do të garojë në zgjedhjet e ardhshme presidenciale kur presidenti i vendit do të zgjidhet drejtpërdrejt nga votat e qytetarit. Madje, nuk e përjashton mundësinë që t'i kërkojë ndihmën edhe kryeministrit Thaçi, që kandidatura e tij të mbështetet edhe nga PDK - ja. Përderisa për postin e kryetarit të AKR - së Pacolli nuk sheh me interes, pasi që edhe ashtu ai drejton Koalicionin për Kosovën e Re, ku bëjnë pjesë edhe AKR-ja dhe 5-6 parti tjera të vogla politike, por të cilat përfaqësohen në qeverinë Thaçi.



---

## **Pajtohen, AKR-ja plus dy ministri**

---

**Behgjet Pacolli ka pranuar të mbetet zëvendëskryeministër në qeverinë "Thaçi 2" vetëm pasi i janë plotësuar kërkesat që i kishte paraqitur në tavolinën e kryeministrit Hashim Thaçi. Tashmë edhe zyrtarisht të dy partitë kanë pranuar se është realizuar marrëveshja e koalicionit qeveritar**

"Telenovela" Behgjet Pacolli e filluar para me shumë se dy muajsh, kur ai u zgjodh president në mënyrë antikushtetuese, ka mbaruar duke përfunduar në postin e zëvendëskryeministrit. Të mërkurën në mbrëmje të dy partnerët e koalicionit kanë arritur marrëveshje që të ridizajnohet marrëveshja e koalicionit qeveritar. Të dyja partitë me anë të një komunikate, edhe zyrtarisht njoftuan se pas shumë diskutimeve në mes vete kanë arritur ta finalizojnë ridizajnimin e marrëveshjes. Me këtë Pacollit i janë qartësuar kompetencat që do t'i ketë si numri dy i qeverisë. Nënkryetari i AKR-së Ibrahim Gashi ka thënë se për momentin janë qartësuar kompetencat e zëvendëskryeministrit, përkatësisht Pacollit dhe nuk ka asnjë dilemë me kompetencat e ministrave. "Tash për tash është caktuar vetëm Ministria e Diasporës dhe brenda një afati optimal do të caktohet edhe ministria tjetër. Por, Pacolli do të jetë zëvendëskryeministër", ka thënë Gashi. Po ashtu, në komunikatën e lëshuar nga të dyja partitë thuhet se të dy partnerët e koalicionit janë pajtuar që të bashkëpunojnë në implementimin e programit qeveritar dhe politikave të përbashkëta programore, duke rikonfirmuar fuqishëm marrëveshjen për bashkëqeverisje.

### **Pacolli i vuri kushte Thaçit**

Mirëpo, kjo çështje u arrit vetëm pasi ish-presidenti Pacolli i vuri kreut të ekzekutivit Hashim Thaçi disa kushte. Pak para se të arrihet marrëveshja, Pacolli në një intervistë për emisionin Rubikon të KTV-së, ka thënë se do të pranojë postin e numrit dy të qeverisë, por pas plotësimit të disa kushteve. "Në qoftë se PDK-ja nuk e krijon hapësirën e veprimit, ku përfshihet edhe programi disapikësh i paraqitur nga ne, atëherë do të mund të kërkohej edhe një mocion votëbesimi në qoftë se anashkalohej koalicioni i AKR-së", ka thënë Pacolli. Ndërsa, ai vet i ka përmendur edhe dy emrat që do t'i udhëheqin dy ministrinë e reja që do t'i drejtojë AKR-ja. Ai ka bërë të ditur se dy ministrat e rinj të AKR-së do të jenë Ibrahim Makolli dhe Ibrahim Gashi, i pari si ministër i Diasporës, kurse i dyti mbetet të përcaktohet.

### **Pacolli kandidon për president**

Gjithashtu, Pacolli ka bërë të ditur se do të garojë në zgjedhjet e ardhshme presidenciale, kur presidenti i vendit do të zgjidhet drejtpërdrejt nga votat e qytetarit. Ai, shtoi se për këtë, do të kërkojë ndihmën edhe të kryeministrit Thaçi, ndoshta duke qenë edhe kandidat i PDK-së. Po ashtu, Pacolli ka zbuluar edhe se kryetar i AKR-së do të jetë ndonjë person tjetër, derisa vetë do të mbetet në cilësinë e liderit të Koalicionit për Kosovën e Re.

---

## Nuk ka rëndësi a jam i pari

---

Ndonëse, i ulur larg kryeministrit Hashim Thaçi, edhe zyrtarisht Behgjet Pacolli është zëvendëskryeministër i parë. Numri dy i qeverisë ka marrë pjesë në seancën e Kuvendit, pasi i janë sqaruar kompetencat që do t'i ketë si numri dy i ekzekutivit. Ai ka thënë se për të, s'ka rëndësi a është i pari

Rreth një muaj Behgjet Pacolli ishte më lart se Hashim Thaçi në hierarkinë shtetërore të Kosovës, por kur mbeti jashtë institucioneve dhe u mendua pak, pranoi të jetë edhe vartës i tij. Pacolli u pajtua të ketë për shef Hashim Thaçin. Si numri dy i qeverisë, ai ka thënë se ka pranuar këtë pozitë pasi i janë sqaruar kompetencat e tij dhe fusha vepruese pa qenë i përzier me asnjë dikaster tjetër. Zëvendëskryeministri Pacolli ka qenë i pranishëm në seancën e Kuvendit i ulur në pjesën e kabinetit qeveritar edhe pse jo afër kryeministrit Thaçi, ashtu siç e do edhe hierarkia ekzekutive. Mirëpo, Pacolli ka thënë se atij nuk i interesin se ku është ulur, e as s'ka rëndësi a është i pari. Ai ka sqaruar se tani i është krijuar hapësira për të vepruar. Pacolli do të ketë përgjegjësi lobuese për të sjellë njohje të reja dhe për të sjellë investitorë të huaj. Ai thotë se kurrë nuk i ka interesuar karrigia, se ku do të ulet, por hapësira për të vepruar në kuadër të qeverisë, të cilën tashmë e ka siguruar nga shefi i tij Hashim Thaçi.

### Nuk ishte pjesë e qeverisë

Mirëpo, atij iu deshën shumë kohë për të filluar punën si numri dy i qeverisë. Shefi i tij Hashim Thaçi ka rreth një muaj kur mori vendim për ta emëruar Pacollin zëvendëskryeministër të parë edhe pse nuk e kishte pyetur. Por, Pacolli as nuk e kishte pranuar e as mohuar këtë post. Ai tha se deri ditën e sqarimit të kompetencave të tij nuk ishte pjesë e qeverisë. **"Unë nuk kam qenë pjesë e qeverisë. Unë nga dje e kam pranuar këtë post, për arsye se kam dashur që ta ridimensionoj pak funksionin tim. Unë nuk kam nevojë për një vend në qeveri, apo aty ku mbahen mbledhjet, por kam nevojë që të më sigurohet hapësira e veprimit dhe kjo hapësirë e veprimit është siguruar nga dje dhe ajo që është me rëndësi disa pika që unë i quaj si reforma në programin qeveritar janë pranuar dhe këto krijojnë mundësi që ne të veprojmë"**, ka thënë Pacolli.

### S'i intereson karrigia

Për numrin dy të qeverisë, e rëndësishme është që ai nga dje i ka institucionet e vendit mbrapa dhe ai do të veprojë. **"Për mua është me rëndësi se unë e kam institucionin prapa dhe unë do të veproj. Unë do të ulem kudo që ka një vend të lirë. Nuk është për mua me rëndësi ulësja, por me rëndësi është puna që do ta bëj dhe sukcesi për Kosovën dhe asnjëherë nuk do ta gjeni Behgjet Pacollin aty duke u shtyrë me bërryla ku do të ulet"**, ka thënë numri dy i qeverisë. Megjithatë, këtë ai nuk e pati për kolegun e tij Hajredin Kuçi, që ishte ulur afër Thaçit, aty ku ulet zëvendëskryeministri i parë. **"Hajredin Kuçi është një punëtor shumë i madh, një njeri shumë i denjë i kësaj qeverie një njeri që ka meritat e veta dhe unë e respektoj punën e tij. Kam shumë respekt të madh edhe për personin edhe për punën e tij edhe për profesionalizmin e tij"**, ka thënë Pacolli.

## **Plotësim të njëri-tjetrit**

E me këtë marrëveshje ai do të llojë për të sjellë njohje dhe për të sjellë investitorë të huaj. Ndërsa, ai tashmë nuk e konsideron përzierje kompetencash çështjen e lobimit me Ministrinë e Punëve të Jashtme. Pacolli e ka quajtur plotësim të njëri-tjetrit, dhe qysh në fillim të punës se tij ka paralajmëruar njohje gjatë kësaj vere nga ana e Bangladeshit dhe Pakistanit. E sjellja e investimeve, për këtë Pacolli ka thënë se duhet të funksionojë ligji në Kosovë, por edhe të përmirësohet imazhi i vendit që nuk e ka edhe aq të mirë. Numri dy i ekzekutivit ka thënë se duhet të ketë një avokat të popullit që do t'i mbrojë interesat e investitorëve të huaj. Ndërsa, për bashkërendimin e tri dikastereve, lobimit, investimeve të huaja dhe funksionimin e ligjit në Kosovë, Pacolli ka thënë se është menduar të krijohet një Task Forcë, e cila do të mundësojë koordinim dhe punë më transparente dhe më efektive.

---

## Plani i Pacollit

---

**Vetëm pasi është siguruar se do të jetësohet plani i tij për qeverisje, Behgjet Pacolli ka vendosur të bëhet zëvendëskryeministër i parë**

PRISHTINË - Ish - presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli, më nuk ka pengesa për realizimin e objektivave qeverisëse. Nuk do të jenë më institucionet ato që do ta pengojnë biznesmenin kosovar, që t'i realizojë projektet e tij për Kosovën. Pacolli jo vetëm që do të jetë njeriu i dytë në ekzekutivin e vendit, por atij i është miratuar edhe plani personal qeverisëse nga ana e kabinetit qeveritar, duke i mundësuar atij që si zëvendëskryeministër i parë t'iu qaset problemeve nga këndvështrimi i tij. Plani i tij prej nëntë pikash, kryesisht me përmbajtje ekonomike, që është pranuar nga kryeministri Hashim Thaçi, si dokument mbi bazën e të cilit do të punojë Pacolli, atij i ka hapur rrugë që të shërbejë si zëvendës i Thaçit. Dokumenti, një kopje të të cilit e ka siguruar gazeta, ka të bëjë me krijimin e kushteve për investime, duke themeluar agjenci të veçantë për trajtimin e problemeve që kanë investitorët nga dita e parë e punës kur vijnë në Kosovë, me rregullimin e infrastrukturës ligjore për investime të ndryshme si dhe me krijimin e një institucioni që do të merret me mbrojtjen e të drejtave të investitorëve. Ndërkaq, për të promovuar sa më mirë Kosovën dhe hapësirën që ofron vendi për investime, Pacolli ka paraparë që të themelohet një Task Forcë (që do ta drejtojë vetë) dhe e cila përbëhet nga ministri i Drejtësisë, ministri i Jashtëm dhe drejtuesit e dikastereve qeveritare që kanë të bëjnë me ekonominë e vendit. **"Nëse kjo nuk ndodh, nuk do të kemi investitorë të huaj"**, shprehet Pacolli. Ai sqaron se ka vendosur ta pranojë vendimin e Thaçit për emërimin e tij si zëvendëskryeministër të parë, vetëm pasi është bindur se prania e tij në qeveri do të jetë frytdhënëse dhe jo "dekorative". **"Unë nuk kam vendosur menjëherë, kur zotëri Thaçi e mori vendimin qeveritar për të më emëruar zëvendëskryeministër, për arsye se kam dashur të reflektoj dhe të shoh cilat janë përparimet dhe cilat janë dobësitë e atij pozicioni"**, pohon ai. Pacolli shprehet i bindur se puna e tij nuk do të "prekë" në kompetencat e zëvendësministrave të tjerë, dhe si e tillë, vetëm se do të jetë e dobishme për anëtarët e qeverisë. Unë nuk po i quaj tash pika reformiste për qeverinë. Ato janë pika të cilat e mundësojnë zhvillimin e punëve dhe obligimeve të kësaj qeverie në mënyrë më të lehtë", thotë Pacolli, duke komentuar planin e tij për qeverisje. Personi që drejtoi presidencën e vendit vetëm për dyzet e pesë ditë, shprehet i bindur se reformat që ai ka paraparë në planin e tij shumë shpejt do të sjellin frytet e para, posaçërisht në fushën e investimeve. Ai thotë se në kohën sa do të shërbejë si zëvendëskryeministër i parë, përqendrimi i tij do të jetë te rregullimi i imazhit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, që sipas tij, përpos që është njëra nga pikat e programit të tij, kjo gjithashtu është e rëndësishme për të joshur investitorët. "Unë do të jem i përqendruar edhe brenda (në Kosovë) edhe jashtë (në politikën e jashtme). Unë do të jem ai që do të sjell investitorë të huaj, por do të jem edhe ai që do të krijojë kushte brenda dhe do ta shtyjë përpara idenë se investitori i huaj nuk duhet të ketë probleme këtu, por ta gjejë një ambient për investime të tij, sikurse që e gjen në Kazakistan, në Lituani, në Gjeorgji, që janë vende si shembull", tha të Pacolli. Ish - presidenti i vendit, Behgjet Pacolli, thotë se njëri nga qëllimet e tij është rregullimi i sistemit të privatizimit, siç thotë ai, duke riorganizuar Agjencinë e Privatizimit të Kosovës dhe duke krijuar infrastrukturë të veçantë ligjore për privatizim të suksesshëm. Në kohën sa do të shërbejë si zëvendëskryeministër i parë, Pacolli thotë se përqendrimi i tij do të jetë te rregullimi i imazhit të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

## **Kosova do të ngrejë padi penale kundër Serbisë për krimet ndaj shqiptarëve**

**Zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi tha se ky Institut do të jetë një institucion publik hulamtues në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.**

PRISHTINË, 29 PRILL - Pas marrëveshjes me PDK-në, Behgjet Pacolli ka vendosur që të marrë pjesë në mbledhjen e qeverisë. Në mbledhjen e tij të parë të qeverisë, zëvendëskryeministri Pacolli ka zënë vendin e zëvendëskryeminstres Mimoza Kusari-Lila, derisa nga zëvendëskryeministri Kuçi, Pacolli është quajtur zëvendëskryeministri i parë i qeverisë. Në mbledhjen e tij të parë, Pacolli premtoi mbështetje për kabinetin qeveritar, por nuk ka paraqitur ndonjë plan për sferën që ai do të mbuloj.

### **Themelohet Instituti për hulamtimin e krimeve të luftës**

Dymbëdhjetë vjet nga përfundimi i luftës gjenocidale në Kosovë, Qeveria ka marrë vendim të themelojë Institutin për hulamtimin e krimeve të luftës, i cili do të evidentojë krimet e kryera gjatë viteve 1990-1999 dhe do të përgatisë Kosovën për të ngritur padi kundër Serbisë. Ky institut ka për qëllim grumbullimin, përpunimin, klasifikimin, dhe arkivimin e lëndëve për krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare, duke filluar nga viti 1990, deri në vitin 1999. Zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi tha se ky Institut do të jetë një institucion publik hulamtues në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim të koordinimit, përcjelljes dhe hulamtimit të krimeve të luftës, krimeve kundër paqes, krimeve të gjenocidit dhe shkelje të tjera të rënda të së drejtës ndërkombëtare. "Disa nga detyrat kryesore të këtij instituti do të jenë: grumbullimi, përpunimi, klasifikimi dhe arkivimi i lëndëve për krimet e luftës, krimeve të kryera kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare dhe të ngjarjeve tjera në territorin e Republikës që nga vitit 1990 deri në vitin 1999. Analizën e krimeve të kryera dhe ngjarjeve tjera relevante, përpunimin e tyre, verifikimin dhe zhvillimin në bazë të të dhënave, pasojat, shënimet dhe lëndët tjera për ndjekje penale eventuale, mund të jenë punë e këtij instituti dhe mund të shfrytëzohen nga institucionet tjera të specializuara", tha Kuçi, para kabinetit qeveritar, i bindur se në punën e këtij instituti të përfshihen ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë. Sipas tij përgatitja e të dhënave statistikore dhe e të dhënave tjera mbi rezultatet do të jenë të publikuara dhe do të jenë pjesë të rezultateve të hulamtimeve që bëhen nga ekspertët vendor dhe ndërkombëtarë. Ai ka bërë të ditur se ky institut do të bashkëpunoj edhe me organet e gjyqësorit, me organizatat tjera qeveritare dhe joqeveritare, por edhe me individë brenda dhe jashtë Kosovës. Ndërsa sa i përket ngritjes së një padie për krimet e kryera në Kosovë, zëvendëskryeministri Kuçi tha se në këtë rast kërkohet të plotësohen disa kushte, ngase dihet se Kosova duhet të jetë anëtare e OKB-së ose nënshkruese e Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në mënyrë që të mund të ngritë padi. "Ne nuk jemi në as njërin as tjetrën, por kjo nuk do të thotë se në të ardhmen nuk do të jemi. Por ne duhet të jemi të përgatitur. Kjo është punë profesionale e institutit nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, e cila do të kërkojë një kohë që të finalizohet", është shprehur Kuçi. Ai tha se do të ketë bashkëpunim edhe me KMDLNJ e po ashtu do të shfrytëzohen arkivat vendorë dhe ndërkombëtare.

## **Thaçi i përgjigjet opozitës**

Duke folur për zhvillimin ekonomik, dhe kritikën që vijnë nga opozita, kryeministri Thaçi tha vizioni i tij për zhvillimin ekonomik ka marrë përkrahjen edhe jashtë qeverisë, duke e vlerësuar këtë si përgjegjësi shtesë për implementimin e shpejtë dhe në afat kohor të rritjes ekonomike, uljes së papunësisë dhe zbatimin e prioriteteve tjera. "Ka kritikë, por është krejt normale dhe këto kritika janë të pajustificueshme dhe të motivuara politikisht. Unë nga dje kam vendosur që të kemi edhe një pikë shtesë në agjendën tonë, atë të rregullimit të shtigjeve të lehta për kursistët fillestar, në mënyrë që disa opozitar të mësojnë skijimin, dhe se me këtë na sigurojnë mbështetje për projektin për Brezovicën", tha Thaçi. Qeveria në mbledhjen e sotme miratoi vendimin për studimin e fizibilitetit dhe fillimin e procedurave për analizimin e opsioneve kontraktuese për operim dhe mirëmbajtje të autostradës Vermicë-Merdare dhe vendimin për studimin e fizibilitetit dhe fillimin e procedurave për ndërtimin e autostradës Prishtinë - Hani i Elezit. Po ashtu, kabineti qeveritar ka miratuar ratifikimin e konventës së Këshillit Botëror të Doganave, vendimin për aplikimin e normës së tatimit të akcizës në lojëra të fatit, vendimin për themelimin e Këshillit të Konsultatit për Drejtësi, derisa ka shqyrtuar kornizën afatmesme të shpenzimeve për vitin 2012-2014.

---

## **Krijohet Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës**

---

**"Disa nga detyrat kryesore të këtij instituti do të jenë: grumbullimi, përpunimi, klasifikimi dhe arkivimi i lëndëve për krimet e luftës, krimeve të kryera kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare dhe të ngjarjeve të tjera në territorin e Republikës që nga viti 1990 - 1999", ka thënë zëvendëskryeministri i Kosovës, Hajredin Kuçi**

PRISHTINË, 29 PRILL - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim të themelohet Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës gjatë periudhës 1990 - 1999. Ky institut do t'i grumbullojë, t'i përpunojë, t'i klasifikojë dhe t'i arkivojë lëndët për krimet e luftës, si dhe do ta bëjë gati padinë ndaj Serbisë, që një ditë Kosova do ta dorëzojë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) në Hagë. Zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, ka thënë të premten, gjatë mbledhjes së Qeverisë, se ky institut do të veprojë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim të koordinimit, përcjelljes dhe hulumtimit të krimeve të luftës si dhe shkeljeve të tjera të rënda të së drejtës ndërkombëtare. "Disa nga detyrat kryesore të këtij instituti do të jenë: grumbullimi, përpunimi, klasifikimi dhe arkivimi i lëndëve për krimet e luftës, krimeve të kryera kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare dhe të ngjarjeve të tjera në territorin e Republikës që nga viti 1990-1999", ka thënë Kuçi. Ai ka bërë me dije se përgatitja e të dhënave statistikore do të bëhet nga ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë. "Ky institut do të bashkëpunojë edhe me organet e gjyqësorit dhe me organizatat e tjera qeveritare dhe joqeveritare, por edhe me individët brenda dhe jashtë Kosovës", është shprehur ai. Duke treguar procedurën e dorëzimit të një padie në GJND, Kuçi ka thënë se për të bërë një gjë të tillë Kosova duhet të jetë anëtare e OKB - së ose nënshkruese e Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. "Ne nuk jemi as në njërin as në tjetrën, por kjo nuk do të thotë se në të ardhmen nuk do të jemi. Ne do të jemi të përgatitur. Kjo është punë profesionale e institutit në të cilin do të punojnë ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë", ka thënë Kuçi. Kabineti qeveritar në mbledhjen e së premtes ka miratuar edhe krijimin e Këshillit Konsultativ për Drejtësi, i cili ka për qëllim avancimin e sistemit të drejtësisë dhe organeve të tjera prokuroriale dhe gjyqësore. Gjithashtu, është miratuar vendimi për studimin e fizibilitetit dhe fillimin e procedurave për analizimin e opsioneve kontraktuese për operim dhe mirëmbajtje të autostradës Vermicë - Merdar dhe vendimi për studimin e fizibilitetit dhe fillimin e procedurave për ndërtimin e autostradës Prishtinë- Hani i Elezit. Po ashtu, kabineti qeveritar ka miratuar ratifikimin e Konventës së Këshillit Botëror të Doganave dhe vendimin për aplikimin e normës së tatimit të akcizës në lojëra të fatit.





## PËRMBAJTJA:

PARATHËNIE .....	III-VI
Parathënie nga z.Behgjet Pacolli.....	VII-X
Fjalimi i BEHGJET PACOLLI- it para Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës pas zgjedhjes president.....	XI

### Negociatat për arritjen e koalicionit në mes të AKR-së dhe PDK-së

Figura të reja në dhjetëshen e më të votuarve.....	16
Kam raporte korrekte dhe bashkëpunuese me gjithë faktorët ndërkombëtar .....	18
MPJ dhe Pacolli ndihmojnë evakuimin e shtetasve të Kosovës .....	20
Pengesa e Pacollit, bashkëshortja .....	22
Kusari Lila: Kusht për AKR-në, posti i presidentit .....	23
Kosovës i duhet paqja dhe mirëkuptimi politik i të gjithëve .....	24
Interesimi i studentëve më vuri në lëvizje .....	28
PDK-ja vështirë të bashkëqeverisë me dy parti shqiptare .....	29
Thaçi e Pacolli pajtohen për bashkëqeverisje .....	30
AAK-ja i “bie vijë” Hashim Thaçit .....	31
Shpresat e Thaçit, te Pacolli e minoritetet .....	33
Feith: Nuk përzihemi në formimin e koalicionit qeverisës.....	35
Lëkundjet e Pacollit .....	38
AKR: Pacolli president, pastaj qeveria .....	40
Tensione në PDK për postin e presidentit.....	42
Pacolli ende s’lëshon pe për Presidencën .....	43
Pacollit i ofrohen dy poste në vend të presidentit .....	44
PDK, ftesë vetëm për AKR-në.....	45
Pacolli refuzoi negociatorët e PDK-së.....	47
Kandidatët për president me rreth 4 përqind të votave .....	48
PDK e do krejt pushtetin.....	50
Thaçi në hall, çka të bëjë me Krasniqin dhe Pacollin .....	51
Bisedimet për qeverinë e re, zbutet AKR-ja .....	53
Lojë nervash mes PDK-së dhe AKR-së.....	55
Pacolli, i pasigurt në votat e PDK-së .....	57
Presidenti, nyja gordiane e PDK-së .....	58
PDK: Krasniqi mbetet kandidati ynë .....	60
AKR – Zgjidhja është president.....	60
KD mbështet Pacollin .....	61
PDK e bën Pacollin president .....	63
Pacolli – president dhe Thaçi kryeministër, drejtojnë shtetin.....	64
PDK-ja presidencën ia lë Pacollit .....	66
PDK-ja dorëzohet para Pacollit .....	67
PDK-ja lëshon pe, Pacolli President .....	70
Koalicioni Zyrtarizohet pas 17 shkurtit .....	73
Kush do të jenë ministrat e qeverisë së ardhshme të Kosovës.....	74
Pacolli i gatshëm të “braktisë” AKR-në.....	76

Mitet e rrejshme kundër Pacollit.....	77
Behgjet Pacolli, do të respektoj Kushtetutën e Kosovës.....	79
Behgjet Pacolli drejt Presidencës, Rrahim Pacolli drejt kreut të AKR-së.....	81
Pacolli e ka ëndërr "pajtimin e serbëve dhe kosovarëve".....	83
AKR-ja do më shumë.....	84
Rrahim Pacolli merr timonin e AKR-së?.....	86
Marrëveshja në xhepat e Thaçit e Pacollit.....	87
Bojkotohet Pacolli.....	88
Pacollit i kërkohet publikimi i pasurisë.....	90
Ëndrra e Behgjet Pacolli për president.....	91

## **Arritja e Marrëveshjes për Koalicionin PDK-AKR**

Sot nënshkruhet marrëveshja.....	93
Pacolli, një burrë shteti.....	95
PDK-AKR në prag të “kurorëzimit”.....	97
Figura e dyshimtë e Pacollit.....	98
I dërguari i Rosisë.....	100
PDK pa konsensus për Pacollin president.....	102
Pse unë jo, e Pacolli mund të jetë president?!!.....	104
Veteranët e UÇK - së i kërkojnë Pacollit t'i sqarojë deklaratat për mediumet e huaja.....	106
‘Kurorëzohet’ PDK – AKR dhe Minoritetet.....	108
Partitizmi i presidentit.....	110
Takimi im me Behgjetin në shtëpinë e Ramush Haradinajt.....	112
Thaçi i bëri numrat?.....	115
Thaçi e ndan Qeverinë me Pacollin dhe minoritetet.....	117
Deklaratat e Pacollit.....	119
Pacolli: "Srbija [je] još majka Kosova, nažalost, zla majka".....	119
Përmbyllen marrëveshjet e koalicionit.....	120
Populli zgjodhi Pacollin, jo Surroin.....	122

## **Zgjedhja e Pacollit President**

Pacolli: Nuk kam thënë se Serbia është nëna e Kosovës.....	124
Misioni në shërbim të qarqeve sllave.....	125
Personalitet i përmasave botërore, e mira e Kosovës dhe kombit!.....	128
Pacolli dyshohet se është “Kali i Trojës i Rosisë”.....	130
Thaçi e Pacolli "të përshtatshëm” për dialogim me Serbinë.....	131
Zvicra demanton pohimet e Pacollit se është konsull nderi i Liberisë.....	134
Limaj kundër Pacollit për president.....	135
Konstituohet Kuvendi, presin Qeveria dhe presidenti.....	137
DPA: Miliarderit i diskutueshëm për President të Kosovës.....	139
Pacolli President, shkelet Kushtetuta.....	140
Kaloi Krasniqi, sfidon Thaçi e Pacolli.....	142
Prokuroria e Zvicrës: Pacolli i pastër juridikisht.....	143
PDK - ja s'është unike për Pacollin.....	145

Biznesmeni që realizoi ëndrrën të bëhet president .....	147
Pacolli President, festë në Rrugët e Prishtinës .....	148
Votova kundër Pacollit .....	149
Për 5 minuta .....	151
Pacolli: Do të fitoj si president.....	154
Behgjet Pacolli, presidenti i tretë i Republikës së Kosovës .....	155
Kosova sot ballafaqohet me sfida të mëdha.....	158
Thaçi e Pacolli Fitimtarë .....	161
Perëndimi është rruga jonë.....	164
Kontestohet zgjedhja e Pacollit.....	167
Presidenti i Kosovës i hetuar nga prokuroria zvicerane.....	169
Pacolli e nis ditën me homazhe e premtime.....	170
Presioni i Thaçit e nxjerr Pacollin president .....	173
Presidenti "kazanovë", zonja e parë ruse .....	176
1/Zoti na ndihmoftë në rrugëtimin tonë të përbashkët! .....	178
2/Koalicioni PDK-AKR.....	178
Biografia e Presidentit të Kosovës, Behgjet Pacollit .....	180
Pacolli në Kushtetuese .....	182
Pacolli e nis me homazhe.....	183
Pacolli drejt Kushtetueses .....	184
Të vjetrit i dorëzojnë detyrat, të rinjtë i pranojnë .....	187
Opozita e dërgon Pacollin në Gjykatën Kushtetuese .....	188
Franca uron Presidentin Pacolli dhe kryeministrin Thaçi .....	190
Presidenti Pacolli: Do të ndjekë rrugën e Ibrahim Rugovës e të Adem Jasharit .....	191
Presidenti i ri në Gjykatë.....	194
Përkulet para familjeve të shenjta .....	196
Do të ndihmoj aq sa mundem! .....	198
Presidenti Pacolli mori urime.....	200
Pacolli ftohet ta vizitojë Shkupin .....	201
Pacolli: “Do ta bëjë Kosovën komb multietnik” .....	202
AKR-ja javën e ardhshme vendos për Kuvendin që do ta bëjë me president.....	204
Presidenti Pacolli merr detyrën zyrtarisht, dorëzohet Krasniqi .....	205
Presidenti Pacolli takoi kryeministrin Thaçi.....	207
Në cilin shtet Presidenti do të fillojë vizitat diplomatike?.....	208
Britania e Madhe afirmon përkrahjen për integrimin euro-atlantik.....	209
Pacolli merr detyrën .....	210
Pacolli i gatshëm të përballet me Kushtetuesen.....	211
Zyrtarisht President, s’i komenton SMS-at.....	212
Pacolli President, ‘fajtor’ Haradinaj .....	213
Pacolli: Presidenca do të bashkëpunojë me Kuvendin dhe Qeverinë .....	214
Jam President i pa kontestuar.....	216
Punë për Enver Hasanin.....	217
Presidenti Pacolli dhe De Marnak premtojnë bashkëpunim për sundim të ligjit.....	219
Prioriteti ynë është Shqipëria .....	220
Pacolli premtun për një diplomaci moderne dhe të përfaqësuar me dinjitet.....	225
Presidentit Pacolli vazhdojnë t’i mbërrijnë urime për zgjedhjen në detyrën e re.....	227
Presidenti i Turqisë Abdullah Gyl uroi Presidentin Pacolli .....	228
Pacolli e Hoxhaj, plan të përbashkët diplomatik .....	229
‘Freskohen’ ambasadat .....	230
Plane për njohje të reja.....	231

Pacolli: Do t'i luftojmë grupet kriminale në veri.....	232
Pritet Definimi i agjendës dhe datës së dialogut.....	235
Pacolli lobi t'ia jepte PTK-në partnerit të tij të biznesit.....	237
Pacolli: Ideali i lirisë është ujitur me gjakun e dëshmorëve tanë.....	238
Pacolli zgjedh variantin e Sejdiut.....	243
Pacolli, këmbë në veri.....	245
Kusari-Lila: Qeveri e pastër.....	247
Pacolli, presidenti i parë i Kosovës që kalon përtej urës së Mitrovicës.....	250
Presidenti votoi qeverinë, shkeli Kushtetutën.....	252
Dhjetë familje skamnore ndajnë pagën e presidentit Pacolli.....	254
Këshilltarët e Pacollit.....	258
Lunaçek nuk mendon se është shkelur Kushtetuta.....	259
LDK-ja vendos ta çojë Pacollin në gjykatë.....	260
Paga humanitare e presidentit.....	262
Opozita i duartroket vizitës së Pacollit në veri.....	263
Pacolli: Do të hapim dyert edhe më shumë për biznesin turk.....	265
Pacolli u zgjodh sipas Kornizës Kushtetuese të UNMIKU-ut.....	266
Sot, ankesa kundër Pacollit në Gjykatën Kushtetuese.....	268
Pacolli: Franca është mike e madhe e Kosovës.....	270
Nuk është qëndrim i Zvicrës.....	271
Ambasadorët në “Odën” e Pacollit.....	272
Pacolli përfundimisht në Gjykatë.....	273
Pacolli u takua me Buhlerin.....	275
Kontestojnë zgjedhjen e presidentit.....	277
Posti i Pacollit në Kushtetuese.....	279
Presidenti u dërgua në Gjykatë.....	281
“Pacolli” deponohet në Kushtetuese.....	283
Presidenti: Nuk mund të na pengojnë të aplikojmë ligje dhe standarde të njëjta.....	285
Presidenti Pacolli takon përfaqësuesit e tri shteteve afrikane.....	286
Pacolli -Wall: Të tejkalohet kriza ekonomike.....	287
Presidenti Pacolli ngushëlloi presidentin Barack Obama.....	288
Presidenti Pacolli i shkroi presidentit të Gjermanisë, z. Wulff.....	289
Presidenti Pacolli priti Imzot Vincenzo Paglian, president i komunitetit “Shën Egjidio”.....	290
Pasuria e Pacollit do të Publikohet.....	292
Nëse shkon Pacolli, bie Qeveria.....	296
Pacolli i fton vendet afrikane të na njohin.....	297
Zgjedhja e Pacollit mund të anulohet.....	298
Vota antikushtetuese e Pacollit mbetet në procesverbal.....	299
President të ri për Kosovën.....	301
Në rivotimin e mundshëm, Pacolli s'i ka të 62 votat.....	303
Kuvendi “legalizon” votën e presidentit.....	305
FOL i kërkon Pacollit që t'i kërkojë AKK-së që t'ia publikoj pasurinë.....	306
Gati për përballje.....	308
Rrahim Pacolli kundruall Ibrahim Makollit në garën për president të AKR-së.....	310
Del i rremë paralajmërimi për bombën në shtëpinë e Pacollit.....	312
Opozita “shpërblen” Pacollin.....	313
AAK-ja, gati ankesën për shkeljen kushtetuese të Pacollit.....	315
Shkel edhe kufirin në veri.....	317
Presidenti Pacolli: Në Prekaz u vulos pavarësia e Kosovës.....	318
Ndërrimi i Kushtetueses nuk e “prek” Pacollin.....	319

Pacolli sërish në Veri .....	321
SHBA-të mbështesin dialogun.....	322
Presidenti Pacolli u del zot kufijve verior.....	323
Pacolli: Kontributi i Zvicrës në shtetndërtimin e Kosovës ishte shumë i madh .....	325
Pacolli pritet ta publikojë pasurinë .....	329
Pacolli ‘privatizon’ Presidencën .....	330
Presidenti Pacolli, me helikopterë të KFOR-it, viziton kufirin verior.....	331
Ish-kryetari Rugova dhe kryetari aktual Pacolli .....	332
Dorasi të kapet dhe të dal para drejtësisë.....	334
Drejtori i Agjencisë Kosovare të inteligjencës i raportoi Presidentit Pacolli .....	335
Presidenti vlerëson AKI-në dhe Avokatin e Popullit.....	336
Behgjet Pacolli, dritëhijet e një biznesmeni dhe Presidenti atipik.....	337
Buhler përshëndet nisjen e dialogut.....	340
Sarkozy Pacollit, mund të llogarisë në ju për të dyfishuar sukseset e Kosovës.....	341
Presidenti Pacolli priti drejtuesit e Bankës Qendrore .....	344
Pacolli, letër Shoqatës së të Burgosurve Politikë.....	345
Presidenti Pacolli ngushëllon udhëheqjen dhe popullin e Japonisë.....	346
Presidenti “rrëfëhet” në Kushtetuese .....	347
Kontestimi i personalitetit të Pacollit kapitull tjetër .....	349
Veteranët duan që Pacolli të sqarohet në Kuvend e jo në Presidencë .....	351
Plan për rrëzimin e Pacollit dhe Thaçit.....	353
Dështon Komploti.....	355
Pacolli dhe Daka dakordohen për ndryshimin e sistemit të zgjedhjeve.....	357
Pacolli me lëndën e dytë në Gjykatë.....	359
Presidenti Italian Giorgio Napolitano e fton për vizitë presidentin Pacolli .....	360
Pacolli nuk i deklaroi milionat .....	361
Pacolli: S’ka Dialog për statusin.....	362
Admirali Locklear vëren ndryshime pozitive .....	363
Pacolli për ndryshimin e Kushtetutës .....	365
Pacolli: Eprorët e FSK-së t’i shkollojë NATO-ja në akademitë e saj.....	367
Reduktimi nuk e zbeh rolin e KFOR - it.....	368
Pacolli kërkon unifikimin e Shqiptarëve.....	370
Pacolli takon admiralin .....	375
Pacolli kërkon që FSK-ja të trajnohet nga NATO .....	376
Pacolli i shërbeu Titos, gjyshi i tij Kralit!.....	377
Presidenti Pacolli beson se do të provohet pafajësia e ish-pjesëtareve të UÇK-së.....	379
Shqipëria ndihmoi Kosovën që ajo të promovohet si shtet i pavarur .....	380
Promovojnë paqen dhe dialogun.....	383
Presidenti i Kosovës viziton zyrtarisht Shqipërinë .....	387
Haxhinasto: Shteti i Kosovës po ndërtohet mbi idenë e Rugovës .....	389
Qeveria dhe Presidenca mbështesin sulmet e Perëndimit mbi Libinë .....	392
Pacolli viziton Tiranën.....	393
Sot e fillon vizitën Presidenti Pacolli në Shqipëri .....	394
Presidenti Pacolli përshëndet intervenimin e NATO-s në Libi .....	395
E nis me Shqipërinë .....	396
Rama ia dorëzoi Pacollit Çelësin e Tiranës .....	398
Pacolli: Koha të krijojmë të ardhmën .....	399
FOL: Pesë shkëlqe kushtetuese në zgjedhjen e presidentit.....	401
Pacolli në Tiranë kërkon bashkim ekonomik.....	404
Më 16 prill, AKR zgjedh kryetarin .....	408

Pacolli ngushëllon Obamën .....	409
Kosova e Shqipëria bashkohen në Evropë.....	410
Presidenti Topi e Pacolli pajtohen për forcimin e dy shteteve pa kufij .....	411
Pacolli: Shqiptarët të unifikohen.....	415
Franca dhe Austria mbështesin Kosovën.....	418
Presidenti Pacolli nderohet me Çmimin “Honoris Causa” .....	419
Kryeministri Berisha priti presidentin Pacolli .....	420
Bashkimi i shqiptarëve nëpërmjet bashkimit ekonomik .....	422
Do ta çoj para amanetin e heronjve të pavarësisë .....	425
Kosova mos t’i harrojë krimet e Serbisë.....	427
Bashkërisht në rrugën e integritit.....	435
LDK-ja mbron shkeljen kushtetuese të presidentit .....	437
Pacolli: Nuk jam profet, jam tokësor .....	438
Pacolli rrëfen në Tiranë pesë rrathët e jetës së tij .....	439
Ivanov e Pacolli shqyrtojnë lëvizjen e qytetarëve me letërnjoftime .....	441
Isa Mustafa arsyeton shkeljen kushtetuese të Pacollit .....	444
LDK në pikën zero.....	445
Presidenti Pacolli kërkon shprishjen e kufijve me Maqedoninë .....	446
Pacolli forcon marrëdhëniet shtetërore me Maqedoninë .....	447
Mesazhet e legjitimitetit të presidentit tonë .....	450
Kosova dhe Maqedonia bashkëpunojnë në fushën e bujqësisë .....	452
Presidenti Pacolli: Shqiptarët në Maqedoni duhet të jenë unikë.....	453
Pacolli: Së bashku ta formojmë një forcë... ..	457
Vija të kuqe për Serbinë.....	465
Trembëdhjetë këshilltarët e Pacollit.....	466
Pacolli: Reciprociteti i serbëve të Kosovës me Luginën e Preshevës.....	467
Ivanov refuzon kërkesën e Pacollit për letërnjoftimet .....	468
Pacolli, koha për bashkim kombëtar .....	469

## **Lirimi i Postit të Presidentit**

Kushtetuesja e bën fajtor dhe të pashkollë Jakup Krasniqin.....	471
Pacolli president antikushtetues .....	473
Dorëheqje ose shkarkim.....	475
Pacolli jokushtetues .....	477
Kosova pa president.....	479
Përse u ngut Shqipëria me Pacollin .....	482
Bajrami: Rënia e Pacollit kërcënon Qeverinë, me të edhe dialogun.....	484
BE-ja respekton vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës .....	485
Dikush e shkeli.....	486
Vllasi: Pacolli duhet të tërhiqet menjëherë .....	488
Pacolli obligohet ta lirojë Presidentencën.....	489
Mungesa e presidentit nuk e ndal dialogun.....	491
Pacolli: Do ta respektoj vendimin e Gjykatës Kushtetuese .....	492
Sërish Pacolli për President .....	494
Makolli: Sërish Pacollin.....	496
Presidenti Pacolli paralajmëron tri njohje për Kosovën .....	498
Pacolli: Do të rikandidohem për president.....	499

Pa president, pa marrëveshje.....	500
Kthehuni në fillim .....	502
Gati për rikandidim .....	504
Kthimi në pikën zero.....	505
AKR nuk lëshon pe.....	506
Pacolli rikandidohet për president .....	507
Presidenca pa president.....	509
Opozita jashtë sa herë që votohet për Pacollin .....	511
LDK e ndarë në dysh për Pacollin .....	513
AKR me dy kandidatë për President.....	514
Myzejane Selmani, kundërkandidatja e Pacollit.....	516
Zgjedhja e presidentit e bllokuar.....	517
Gjykata Kushtetuese e “emërton” Jakup Krasniqin U.D president të vendit.....	519
Pacolli: Vetëm sinqeriteti mund ta nxjerrë Kosovën nga kjo gjendje .....	521
Pacolli ia dorëzon Krasniqit postin e Presidentit .....	523
President konsensual ose zgjedhje në maj .....	524
Presidenti, më së largu të hënën.....	526
Pacolli apo një president konsensual .....	528
Pacolli nuk e dorëzoi detyrën.....	530
PDK e AKR të hënën qartësojnë dilemën për koalicionin .....	532
Shembulli Pacolli, alternativë që nuk mundet të ndalet.....	534
PDK lë në lloç Pacollin.....	537
LDK-ja e do presidentin konsensual.....	538
Pacolli, kusht i koalicionit.....	540
Pranohet Pacolli! - zgjedhjet në mot?!.....	542
Pacolli nuk e deklaroi pasurinë .....	544
Aktivizohet ambasadori Dell .....	545
Po Pacolli, po zgjedhjet më 2012.....	546
Pacolli “nuk e dorëzon” detyrën e presidentit.....	547
Sërish me Pacollin.....	548
Thaçi, Pacolli e Mustafa takojnë quintin .....	550
Të bashkuar për Atifetën.....	551
Pacolli: Shkova por kthehem .....	552
Oficere Jahjaga presidente, zgjedhjet pas 18 muajsh.....	555
Jahjaga presidente .....	557
Pacolli garon, LDK-ja me kandidat të vetin .....	559
A ka një vend në Qeveri edhe për Pacollin? .....	561
Opozita e nervozuar, bëhet gati për ankesë në Gjykatën Kushtetuese .....	563
Topi: Pacolli, tregoi që është në standardet e politikanit evropian .....	566
Zbutet AKR.....	567
E zyrtarizojnë në Kuvend.....	569
Pacolli, zëvendëskryeministër.....	571
Gashi e Makolli ministra nga AKR-ja .....	572
Pacolli, kërkon sqarime nga Thaçi.....	573
Pacolli ende nuk i di detyrat.....	575
Pacolli paralajmëron njohjen edhe nga Egjipti .....	576
Ministria e Jashtme nuk pranon që të jetë nën “kontroll” të Pacollit.....	577
Reformat e “treshes” .....	579
Mustafa më i pasur se Thaçi, Pacolli më pasanik se krejt Qeveria.....	580
Ka nisur implementimi i “marrëveshjes” .....	582

Qeveria në seminare, Pacolli për vizitë jashtë shtetit .....	584
Pacolli mund të bëhet sërish president i AKR-së.....	586
Gati për ndryshimet kushtetuese .....	587
Edhe një javë PDK-ja e shtynë marrëveshjen me AKR-në .....	589
Pacolli shqyrton tërheqjen nga Qeveria .....	591
Është apo jo pjesë e Qeverisë?.....	593
Koalicioni në krizë apo me marrëveshje të re.....	594
I paimterësuar për qeverinë.....	595
Pacolli me plan për Qeverinë.....	597
Pacolli pret sqarimet e Thaçit .....	598
Pacolli e kërkon edhe Ministrinë e Jashtme.....	599
Thaçi e Pacolli vazhdojnë bashkë .....	600
Pajtohen, AKR-ja plus dy ministri.....	601
Nuk ka rendësi a jam i pari .....	602
Plani i Pacollit.....	604
Kosova do të ngrejë padi penale kundër Serbisë për krimet ndaj shqiptarëve .....	605
Krijohet Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës .....	607



# LITERATURA

*Materialet janë marrë nga artikujt e gazetave të vitit 2011 nga arkiva e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, dhe ato përfshijnë:*

1. *Bota Sot*
2. *Zëri*
3. *Epoka e Re*
4. *Kosova Sot*
5. *Infopress*
6. *Tribuna Shqiptare*
7. *Express*
8. *Koha Ditore*